



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

**Modulet e trajnimit bazik për
bashkëpunëtorët profesional**
(Penale-materiale dhe procedurale)

Prishtinë, 2021



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët
profesional
(Penale-materiale dhe procedurale)

I publikuar nga

Akademia e Drejtësisë

Autorët:

Burim Ademi, gjyqar në Gjykatën e Apelit

Afrim Shala, gjyqtar në Gjykatën e Apelit

Avni Mehmeti, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë

Hartimi i këtij Manuali është mbështetur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, përkthimi nga OSBE, ndërkaq shtypja dhe publikimi nga Akademia e Drejtësisë.

Mohim:

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim (Modul) janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet zyrtare të Akademisë së Drejtësisë dhe UNDP-së.

Të drejtat e autorit

Të drejtat e autorit për materialet e krijuara nga autorët janë të rezervuara. Nuk lejohet kopjimi/dyfishimi i materialit pa pëlqimin e Akademisë së Drejtësisë dhe autorëve. Nëse ndonjë pjesë apo shprehje individuale në tekst nuk është e ligjshme apo korrekte, përmbajtja apo vlefshmëria e pjesëve të tjera mbetet e paprekur nga ky fakt. Akademia e Drejtësisë mund ta bëjë kopjimin e materialit për nevojat e zbatimit të mandatit të vet ligjor, pa marrë pëlqimin e autorëve.

© 2021 Autorët dhe Akademia e Drejtësisë

Shtypur në Prishtinë

Tetor 2021

PARATHËNJE

Të nderuar,

Trajnimet për sistemin gjyqësor janë një element thelbësor dhe parakusht për një sistem efikas të drejtësisë, për më shumë është garanci për zhvillim të vazhdueshëm në ushtrimin e kompetencës, ruajtjen dhe forcimin e pavarësisë gjyqësore, ngritjen e llogaridhënies dhe fitimin e besimit të publikut. Ngritja e vazhdueshme profesionale është parakusht themelor për ngritjen e performacës së sistemit gjyqësor e prokurorial në zbatimin e efikas të standardeve për sundimin e ligjit.

Në arritjen e këtij synimi, sistemi gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë gjatë punës së tyre ballafaqohet me vështirësi dhe sfida të shumta, duke përfshirë aspektin e ndryshimeve të shpeshta legjislative, aspektin e praktikës gjyqësore, po ashtu edhe çështjet të tjera të cilat janë duke reflektuar në imazhin e gjyqësorit dhe në besimin e publikut. Andaj, disa nga këto sfida Akademia e Drejtësisë, bazuar në mandatin e saj ligjor, është përkushtuar në zhvillimin e kapaciteteve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, dhe atë nëpërmes programeve të saj trajnuese të dizajnuara veçanërisht për gjyqtarë dhe prokurorë të sapo emëruar, gjyqtarë dhe prokurorë në detyrë, për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe profesionistët e tjerë ligjor.

Nisur nga ky këndvështrim, Akademia e Drejtësisë në vazhden e realizimit të Programit Trajnues Kornizë të trajnimeve si të paraparë për vitet 2021-2022, ka vlerësuar rëndësinë e posaçme për pozitën dhe rolin e bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor në ofrimin dhe mebeshtetjen e vazhdueshme profesionale për gjyqtarët, prokurorët, dhe sistemin e drejtësisë në përgjithësi. Në këtë kontekst, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me ekspertet nga sistemi gjyqësor dhe në mbështetje të donatoreve, ka kënaqësinë që nëpërmes këtijë publikimi të prezantojë modulet për trajnim bazik të bashkëpunëtorëve profesional në fushën e drejtësisë penale dhe civile gjithashtu. Modulet trajnuese sikurse të prezantuara në këto publikime, janë ndarë në dy pjesë dhe përfshijnë aspektin material dhe procedural në fushën e drejtësisë penale dhe civile, duke përfshirë edhe forma të vendimeve gjyqësore për çështje të ndryshme ligjore.

Akademia e Drejtësisë është mirënjohëse dhe falënderuese ndaj eksperteve gjyqtarë që kanë punuar në zhvillimin e përmbajtjes së moduleve trajnuese bazike si në fushën civile ashtu edhe penale duke ofruar ekspertizën e tyre profesionale. Gjithashtu një falënderim i veçantë edhe për projektin e UNDP-së për *Sundimin e ligjit* dhe projektin SAEK që kanë mbështetur hartimin e moduleve trajnuese bazike. Ndërsa, mirënjohje e veçantë për OSBE-në që ndihmuan në përkthimin në gjuhën serbe të moduleve trajnuese bazike nga fusha penale, për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor nga ky komunitet.

Me respekt,

Enver Fejzullahu

Drejtor Ekzekutiv, Akademia e Drejtësisë

TABELA E PËRMBAJTJES

Parathënje.....	3
PJESA E PARË.....	18
KAPITULLI I PJESA E PËRGJITHSHME E SË DREJTËS PENALE	18
NOCIONI, LËNDA DHE FUNKSIONI I SË DREJTËS PENALE.....	18
Burimet e së drejtës penale	20
Shqyrtime të përgjithshme	20
NOCIONI, ELEMENTET, OBJEKTI DHE SUBJEKTI I VEPRËS PENALE	22
1. Nocioni i veprës penale.....	22
2. Elementet e veprës penale.....	23
3. Objekti i veprës penale.....	24
4. Subjekti i veprës penale	25
VEPRIMI SI ELEMENT I VEPRËS PENALE.....	27
1. Shqyrtime të përgjithshme	27
2. Veprat penale të kryera me veprim	28
3. Veprat penale të kryera me mosveprim	29
V. VENDI DHE KOHA E KRYERJES SË VEPRËS PENALE.....	29
1. Shqyrtime të përgjithshme	30
2. Vendi i kryerjes së veprës penale.....	30
3. Koha e kryerjes së veprës penale	31
KAPITULLI II.....	32
KUNDËRLIGJSHMËRIA DHE SHKAQET TË CILAT E PËRJASHTOJNË KUNDËRLIGJSHMËRINË	32
KUNDËRLIGJSHMËRIA.....	32
1. Nocioni dhe rëndësia e kundërligjshmërisë	32
2. Rrezikshmëria shoqërore e veprës penale.....	33
2.1. Shqyrtime të përgjithshme	33
2.2. Shkallëzimi i rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale.....	34
II. SHKAQET TË CILAT E PËRJASHTOJNË KUNDËRLIGJSHMËRINË	35
1. Shqyrtime të përgjithshme	35

2. Shkaqet të cilat e përjashtojnë kundërligjshmërinë sipas pjesës së përgjithshme të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.....	35
2.1. Mbrojtja e nevojshme.....	36
Tejkalimi i kufijve të mbrojtjes së nevojshme	39
2.2. Nevoja ekstreme.....	40
2.2.1. Rreziku.....	41
2.2.2. Mënjanimi i rrezikut.....	42
2.2.3. Tejkalimi i nevojës ekstreme	43
2.3. Dhuna ose kanosja	43
2.4. Vepra e rëndësisë së vogël	46
2.5 vepra e kryer nën shtrëngim.....	46
2.6 Urdhrat nga lart.....	47
3. Shkaqet të cilat e përjashtojnë kundërligjshmërinë sipas pjesës së posaçme të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.....	48
4. Shkaqet e përjashtimit të kundërligjshmërisë të cilat nuk janë të parashikuara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.....	49
Kapitulli III.....	50
PËRGJEGJËSIA PENALE	50
I. NOCIONI DHE ELEMENTET E PËRGJEGJËSISË PENALE	50
1. Shqyrtime të përgjithshme	50
2. Nocioni dhe elementet e përgjegjshmërisë penale	51
3. Nocioni i papërgjegjshmërisë penale dhe shkaqet të cilat e bëjnë një person të papërgjegjshëm	51
4. Përgjegjshmëria esencialisht e zvogëluar.....	52
II. F A J I.....	53
1. Nocioni dhe rëndësia e fajit në të drejtën penale	53
2. Dashja	54
2.1. Dashja direkte	54
2.2. Dashja eventuale	55
2.3. Përgjegjësia dhe ndëshkimi për veprat e kryera me dashje direkte dhe eventuale.....	56
3. Pakujdesia	56
3.1. Pakujdesia e vetëdijshme	56
3.2. Pakujdesia e pavetëdijshme	57
3.3. Dallimi i pakujdesisë së pavetëdijshme nga rasti.....	58
3.4. Përgjegjësia për veprat penale të kryera nga pakujdesia.....	59

III. VEPRAT PENALE TË CILËSUARA APO TË KUALIFIKUARA.....	59
Nocioni dhe llojet e veprave penale të cilësuara apo të kualifikuara	59
2. Veprat penale të cilësuara apo të kualifikuara me pasojë më të rëndë.....	60
3. Veprat penale të cilësuara apo të kualifikuara me rrethana të posaçme.....	61
KAPITULLI IV	63
FAZAT E KRYERJES SË VEPRËS PENALE.....	63
1. Shqyrtime të përgjithshme	63
2. Lindja e mendimit dhe vendimi për të kryer vepër penale.....	63
3. Veprimet përgatitore	64
4. Tentativa e veprës penale	65
4.1. Shqyrtime të përgjithshme	65
4.2. Ndëshkimi i tentativës sipas KPRK	66
4.3. Tentativa e plotë dhe e metë	66
4.4. Tentativa e cilësuar	67
4.5. Tentativa e papërshtatshme	67
5. Heqja dorë vullnetare nga kryerja e veprës penale	69
KAPITULLI V	71
BASHKËPUNIMI NË KRYERJEN E VEPRËS PENALE.....	71
1. Nocioni, kushtet dhe format e bashkëpunimit në të drejtën penale	71
2. Bashkëkryerja	72
3. Shtytja	73
4. Ndihma.....	75
5. Bashkimi kriminal.....	77
6. Marrëveshja për të kryer vepër penale	78
KAPITULLI VI	79
I. SANKSIONET PENALE.....	79
1. Nocioni dhe funksioni i sanksioneve penale.....	79
2. Sanksionet penale dhe masat tjera sipas të drejtës penale të Republikës së Kosovës.....	79
II. DËNIMET	80

1. Shqyrtime të përgjithshme	80
2. Llojet e dënimeve	81
3. Qëllimi i dënimit	82
4. Dënimet kryesore	83
4.1 Dënimi me burgim të përjetshëm	83
4.2. Dënimi me burgim	85
6.3. Dënimi me gjobë	86
5. Dënimet alternative	87
5.1. Shqyrtime të përgjithshme	87
5.2. Dënimi me kusht	88
5.3. Forma themelore e dënimit me kusht	88
5.4. Dënimi me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues	90
5.5. Dënimi me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues	91
5.6. Dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme	93
5.7. Gjysmëliria	94
6. Dënimet plotësuese	95
6.1. Shqyrtime të përgjithshme	95
6.2. Sistemi i dënimeve plotësuese	95
III. VËREJTJA GJYQËSORE	99
Shqyrtime të përgjithshme	99
KAPITULLI VII	101
MATJA E DËNIMIT DHE PARASHKRIMI	101
I. MATJA E DËNIMIT	101
1. Shqyrtime të përgjithshme	101
2. Individualizimi i dënimit	103
3. Rrethanat rënduese dhe lehtësuese	103
4. Zbutja e dënimit	105
5. Lirimi nga dënimi	107
6. Matja e dënimit për bashkim të veprave penale	109
8. Llogaritja e paraburgimit dhe e dënimit të mëparshëm	110
II. PARASHKRIMI	111
1. Shqyrtime të përgjithshme	111

2. Parashkrimi i ndjekjes penale	111
3. Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit	114
PJESA E DYTË	116
PJESA E POSAÇME E SË DREJTËS PENALE	116
KAPITULLI I	116
1. Nocioni dhe lënda e pjesës së posaçme të së drejtës penale	116
2. Marrëdhënia midis pjesës së përgjithshme dhe pjesës së posaçme të së drejtës penale	118
3. Figura e veprës penale	119
4. Përmbajtja e dispozitave të pjesës së posaçme të së drejtës penale	124
5. Sistemi i pjesës së posaçme të së drejtës penale	129
KAPITULLI II	131
VEPRAT PENALE KUNDËR RENDIT KUSHTETUES DHE SIGURISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	131
I. Shqyrtime të përgjithshme	131
II. Veprat penale të këtij Kapitulli	132
1. Sulmi kundër rendit kushtetues të Republikës së Kosovës (neni 114)	132
2. Veprat penale të terrorizmit	133
2.1. Kryerja e veprave terroriste (neni 129)	135
2.2. Ndihma në kryerjen e veprave terroriste (neni 130)	136
2.3. Lehtësimi i kryerjes së terrorizmit (neni 131)	137
2.4. Organizimi, përkrahja dhe pjesëmarrja në grupet terroriste (neni 136)	138
3. Veprat e tjera penale të këtij kapitulli	139
KAPITULLI III	140
VEPRAT PENALE KUNDËR NJERËZIMIT DHE VLERAVE TË MBROJTURA ME TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE	140
I. Shqyrtime të përgjithshme	140
II. Veprat penale të këtij Kapitulli	141
1. Gjenocidi (neni 142)	141
2. Piratëria (neni 162)	146

3. Kontrabandimi me migrantë (neni 164).....	146
4. Trafikimi me njerëz (neni 165).....	148
5. Veprat e tjera penale të këtij kapitulli	151
KAPITULLI IV	154
VEPRAT PENALE KUNDËR JETËS DHE TRUPIT	154
I. Shqyrtime të përgjithshme	154
II. Veprat penale të këtij Kapitulli	155
1. Vrasja (neni 172).....	155
2. Vrasja e rëndë (neni 173).....	158
4. Ndërprerja e palejuar e shtatzënisë (neni 178).....	172
5. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli	175
KAPITULLI V.....	177
VEPRAT PENALE KUNDËR LIRIVE DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT	177
I. Shqyrtime të përgjithshme	177
II. Veprat penale të këtij Kapitulli	179
1. Rrëmbimi (neni 191).....	179
2. Shtrengimi (neni 192)	181
3. Privimi i kundërligjshëm nga liria (neni 193).....	183
4. Marrja e deklaratave me anë të shtrengimit (neni 194).....	186
5. Cënimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve (neni 197).....	187
6. Kontrollimi i kundërligjshëm (neni 198)	188
7. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli	189
KAPITULLI VI	190
VEPRAT PENALE KUNDËR TË DREJTAVE TË VOTIMIT	190
1. Shqyrtime të përgjithshme	190
2. Cenimi i së drejtës për të kandiduar (neni 207)	191
3. Kanosja e kandidatit (neni 208)	192
4. Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar (neni 209)	193
5. Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve (neni 210).....	193

6. Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve (neni 211).....	194
7. Dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin (neni 212).....	194
8.keqpërdorimi i të drejtës së votimit (neni 213).....	196
9. Pengimi i procesit të votimit(neni 214).....	197
10. Cenimi i fshehtësisë së votimit (neni 215).....	197
11. Falsifikimi i rezultateve të votimit (neni 216).....	198
12. Asgjësimi i dokumenteve të votimit (neni 217).....	198
KAPITULLI VII.....	200
VEPRAT PENALE KUNDËR TË DREJTAVE NË MARRËDHËNIET E PUNËS	200
I. Shqyrtime të përgjithshme	200
II. Veprat penale të këtij Kapitulli	201
1. Cenimi i të drejtave nga marrëdhëniet e punës (neni 218)	201
2. Cenimi i të drejtave të punësimit dhe papunësisë (neni 219)	201
3. Cenimi i të drejtave nga sigurimi social (neni 223)	202
4. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli	203
KAPITULLI VIII.....	204
VEPRAT PENALE KUNDËR INTEGRITETIT SEKSUAL	204
I. Shqyrtime të përgjithshme	204
1. Dhunimi (neni 227)	204
2. Sulmi seksual (neni 229)	210
3. Degradimi i integritetit seksual (neni 230)	213
4. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli	215
KAPITULLI IX	217
VEPRAT PENALE KUNDËR MARTESËS DHE FAMILJES	217
I. Shqyrtime të përgjithshme	217
II. Veprat penale të këtij Kapitulli	218
1. Bigamia (neni 205)	218
2. Mundësimi i lidhjes së martesës së kundërligjshme (neni 239).....	219
3. Martesa e detyruar (neni 239).....	219
4. Bashkësia jashtëmartesore me personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet (neni 240)	221

5. Shkelja e detyrimeve familjare (neni 244).....	222
6. Shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës (neni 245).....	223
7. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli	224
KAPITULLI X.....	226
VEPRAT PENALE KUNDËR SHËNDETIT PUBLIK.....	226
I. Shqyrtime të përgjithshme.....	226
II. Veprat penale të këtij Kapitulli	227
1. Përhapja e sëmundjeve ngjitëse (neni 249).....	227
2. Mosveprimi sipas dispozitave shëndetësore gjatë kohës së epidemisë (neni 250)	228
3. Përhapja e virusit HIV (neni 252).....	229
4. Punësimi i personave të infektuar nga sëmundjet ngjitëse (neni 253)	230
5. Mosdhënia e ndihmës mjekësore (neni 255).....	231
6. Ndotja e ujit të pijshëm (neni 264).....	232
7. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli	233
KAPITULLI XI	235
VEPRAT PENALE TË NARKOTIKËVE	235
I. Shqyrtime të përgjithshme.....	235
2. Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge (neni 267).....	235
3. Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike (neni 268)	238
4. Lehtësimi i sigurimit apo përdorimit të narkotikëve, substancave psikotropike apo analogëve (neni 271).....	239
5. Veprat e tjera penale të këtij kapitulli	240
KAPITULLI XII.....	241
VEPRAT PENALE KUNDËR EKONOMISË.....	241
I. Shqyrtime të përgjithshme.....	241
II. Veprat penale të këtij Kapitulli	241
1. Cenimi i barazisë në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike (neni 278).....	241
2. Shkaktimi i falimentimit (neni 280).....	242
3. Kumtimi i paautorizuar i sekretit tregtar (neni 286)	243
4. Mashtrimi i blerësve (neni 293).....	245

5. Falsifikimi i parasë (neni 296)	246
6. Tregtia e ndaluar (neni 299).....	249
7. Shmangia nga tatimi (neni 307)	250
8. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli	251
KAPITULLI XIII	253
VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË	253
I. Shqyrtime të përgjithshme	253
II. Veprat penale të këtij Kapitulli	254
1. Vjedhja (neni 313)	254
2. Vjedhja e rëndë (neni 315).....	257
3. Vjedhja grabitqare (neni 316)	260
4. Grabitja (neni 317).....	261
5. Shpërdorimi i pasurisë së huaj (neni 318).....	263
6. Marrja në posedim e pasurisë së luajtshme (neni 319)	264
7. Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme (neni 320).....	265
8. Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë së luajtshme (neni 321).....	266
9. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli	268
KAPITULLI XIV	269
VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT, KAFSHËVE, BIMËVE DHE OBJEKTEVE KULTURORE	269
Shqyrtime të përgjithshme	269
II. Veprat penale të këtij Kapitulli	270
1. Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit (neni 338).....	270
2. Dëmtimi i objekteve dhe pajisjeve për mbrojtjen e mjedisit (neni 341)	272
3. Prodhimi, shitja dhe vënia në qarkullim e materieve të dëmshme për mjekimin e shtazëve (neni 342).....	273
4. Ushtrimi i kundërligjshëm i shërbimeve veterinare (neni 344).....	274
5. Moszbatimi i urdhrave për luftimin e sëmundjeve të shtazëve dhe të bimëve.....	275
(neni 345).....	275
6. Shkretërimi i pyjeve (neni 348)	276
8. Vjedhja e pyllit (neni 349)	277
9. Gjuetia e kundërligjshme (neni 350).....	278
10. Peshkimi i kundërligjshëm (neni 353)	280

11. Dëmtimi, shkatërrimi dhe nxjerrja e paautorizuar e monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës (neni 354).....	281
12. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli	283
KAPITULLI XV	284
VEPRAT PENALE KUNDËR SIGURISË SË PËRGJITHSHME TË NJERËZVE DHE PASURISË.....	284
I. Shqyrtime të përgjithshme	284
II. Veprat penale të këtij Kapitulli	285
1. Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm (neni 356)	285
2. Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike (neni 357).....	289
3. Punimet ndërtimore të kundërligjshme (neni 360).....	290
4. Mosevitimi i rrezikut (neni 362)	291
5. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli	292
KAPITULLI XVI.....	293
VEPRAT PENALE KUNDËR SIGURISË SË TRAFIKUT PUBLIK	293
Shqyrtime të përgjithshme	293
II. Veprat penale të këtij Kapitulli	294
Rrezikimi i trafikut publik (neni 370)	294
2. Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur (neni 371)	296
3. Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik (neni 301).....	298
4. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli	300
KAPITULLI XVII	301
VEPRAT PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE.....	301
I. Shqyrtime të përgjithshme	301
II. Veprat penale të këtij Kapitulli	302
1. Moslajmërimi i përgatitjes së veprave penale (neni 377)	302
2. Moslajmërimi i veprave penale apo kryerësit të tyre (neni 378).....	303
3. Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale (neni 380)	305
4. Lajmërimi ose kallëzimi i rremë (neni 382).....	307
5. Deklarimet e rreme (neni 384)	309
6. Falsifikimi i dokumenteve (neni 390).....	310

7. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli	313
KAPITULLI XVIII.....	314
VEPRAT PENALE KUNDËR RENDIT PUBLIK	314
I. Shqyrtime të përgjithshme	314
II. Veprat penale të këtij Kapitulli	314
1. Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare (neni 401)	314
2. Sulmi ndaj personit zyrtar (neni 402).....	316
3. Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave (neni 406)	318
4. Vetëgjyqësia (neni 410)	319
5. Dëmtimi i varreve apo i kufomave (neni 413)	320
6. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli	321
KAPITULLI XIX.....	323
VEPRAT PENALE KUNDËR DETYRËS ZYRTARE.....	323
PJESA E TRETË	356
SISTEMI I DREJTËSISË PËR TË MITUR	356
1. Shqyrtime të përgjithshme	356
Parimet e procedurës ndaj të miturve.....	357
Masat dhe dënimet ndaj të miturve	358
KAPITULLI-I.....	362
PARIMET, KOMPETENCA DHE PALET NE PROCEDUREN PENALE	362
Parimet e procedurës penale	362
II Palët ne Procedurën penale.....	368
KAPITULLI – II –	372
VEPRIMET PARAPENALE DHE FAZAT E PROCEDURES PENALE	372
Veprimet fillestare të policisë.....	372
NËN KAPITULLI I	376
MASAT E FSHEHTA TEKNIKE TË HETIMIT DHE VËZHGIMIT NË PROCEDURË PENALE.....	376
Nocioni dhe veçoritë e masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit nëprocedurën penale	376
Parimet themelore:	377

Aktet ndërkombëtarë lidhur me privatësinë dhe jetën private	378
Deklarata universale për të drejtat e njeriut	379
Pakti Ndërkombëtarë për të Drejtat Civile dhe Politike.....	380
Llojet e masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit dhe kuptimi i tyre	380
Vëzhgim i fshehtë fotografik ose me video	381
Monitorim i fshehtë i bisedave.....	382
1.3. Kontrollim i dërgesave postare	383
Përgjimi telekomunikimeve	384
Dërgim i kontrolluar i dërgesave postare	385
Përgjimi komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik.....	386
Shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes	387
Blerje e simuluar e ndonjë sendi	388
Simulim i veprës së korrupsionit	389
Hetim i fshehtë	390
Zbulim i të dhënave financiare.....	391
NËNKAPITULLI II	400
FAZAT E PROCEDURES PENALE	400
1.Fazat e procedurës penale	400
Ekspertimi	404
Angazhimi i ekspertit nga i pandehuri	410
Përmbajtja e raportit të akt ekspertimit	410
Këqyrja dhe rikonstruksioni.....	411
Kërkesat ndërkombëtare apo provat e siguruara jashtë vendit.....	412
Provat e pranueshme dhe vlerësimi i tyre	413
Marrja në pyetje në procedurë paraprake	413
Marrja e deklaratës në procedurën paraprake.	415
Mundësia hetuese e veçantë.....	419
A K T V E N D I M	446
Ndaj të pandehurit:.....	446
NËNKAPITULLI III	451
AKTAKUZA DHE DELARIMI	451
SHQYRTIMI FILLESTAR	455

NËNKAPITULLI IV	471
SHQYRTIMI GJYQESOR DHE AKTGJYKIMI	471
SHQYRTIMI GJYQËSOR	471
Shqyrtimi gjyqësor mund të ndahet në disa faza	471
Përgatitja për shqyrtimin gjyqësor	471
Publiciteti i shqyrtimit gjyqësor	473
Zbatimi i shqyrtimit gjyqësor	474
Parakushtet për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor	476
Përfundimi, shtyrja dhe ndërprerja e shqyrtimit gjyqësor	478
Koha për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor	479
Fillimi i shqyrtimit gjyqësor	480
Rendi i paraqitjes së provave në shqyrtimin gjyqësor	482
A r s y e t i m.....	497
GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË	498
NËNKAPITULLI V	512
MJETET JURIDIKE.....	512
KAPITULLI III.....	530
ADMINISTRIMI I PROCEDURES	530
KAPITULLI IV	539
PROCEDURAT E VEÇANTA	539
Pjesa e parë	539
Procedura për dhënien e urdhrit ndëshkues si procedure e veçantë.....	539
Pjesa e dytë.	541
Procedura ndaj personave me çrregullime mendore	541
Shqiptimi dhe llogaritja e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik.....	563
Llojet e masave të trajtimit të detyrueshëm	563
-trajtimit i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor	563
Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri	564
Pjesa e tretë – procedura e shlyerjes së dënimeve nga evidenca si procedurë e veçantë.....	567
Procedura e shlyerjes së dënimeve nga evidenca	567

Pjesa e KAtËrt – procedura e shlyerjes se dënimeve nga evidenca si procedurË e veÇantË	570
Procedura për shpalljen e letë rreshtimit dhe shpalljeve publike	570

PJESA E PARË

KAPITULLI I PJESA E PËRGJITHSHME E SË DREJTËS PENALE

NOCIONI, LËNDA DHE FUNKSIONI I SË DREJTËS PENALE

a) Nocioni i së drejtës penale - Me termin “e drejtë penale” nënkuptojmë një **degë të sistemit pozitiv të së drejtës** (aspekti ligjor) dhe **një degë të shkencave juridike** (aspekti shkencor).¹

Si degë e sistemit pozitiv të së drejtës, e drejta penale është tërësi e dispozitave ligjore me të cilat përcaktohen se cilat sjellje apo veprime konsiderohen vepra penale dhe çfarë lloje të sanksioneve penale apo masave tjera do të mund t’iu shqiptohen kryesve të veprave penale. Të drejtën penale nga aspekti ligjor e përbën Kodi Penal i Republikës së Kosovës² dhe ligjet tjera penale.

E drejta penale si degë e shkencave juridike apo siç quhet ndryshe shkenca e së drejtës penale, është disiplinë shkencore e cila merret me studimin e së drejtës penale si degë e sistemit pozitiv të së drejtës. Pra, e drejta penale nga aspekti shkencor merret me studimin e të drejtës penale nga aspekti ligjor. E drejta penale si degë e shkencave juridike (shkenca e së drejtës penale) përfshin tërësinë e studimeve dhe hulumtimeve të së drejtës penale, ku në radhë të parë shkencën e së drejtës penale e përbëjnë komentaret e kodit penal, librat, punimet monografike dhe punimet e tjera të autorëve, artikujt e ndryshëm që i referohen të drejtës penale³ etj.

b) Lënda e së drejtës penale - Lëndë e së drejtës penale është **vepra penale, kryesi i veprës penale dhe sanksionet penale**.⁴ Përveç sanksioneve penale, si lëndë e së drejtës penale konsiderohen edhe masat e trajtimit të detyrueshëm, masat dhe dënimet të cilat zbatohen ndaj të miturve, si dhe dënimet dhe sanksionet tjera penale ndaj personave juridikë.

Vepra penale është një sjellje apo veprim që manifestohet në botën e jashtme dhe që është e parashikuar me ligj si vepër penale. Vepra penale është një veprim apo sjellje e caktuar e cila dëmton apo rrezikon vlerat elementare të njeriut, shoqërisë dhe sistemit juridik të një shteti.

Në nenin 1 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se veprat penale parashihen vetëm për ato sjellje me të cilat cenohen apo dëmtohen në atë masë liritë dhe të drejtat e njeriut si dhe të drejtat tjera dhe vlerat shoqërore të garantuara dhe të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me të drejtën ndërkombëtare, mbrojtja e të cilave nuk do të mund të realizohej pa sanksione penale të shtetit ligjor.

Personi i cili e kryen veprën penale quhet kryes i veprës penale. Përveç atyre që ndërmarrin drejtpërdrejt veprimin e kryerjes së veprës penale, si kryes i veprës penale, sipas KPRK

¹ SHALA, AFRIM, Hytje në të drejtën penale, Botimi i tretë, Prishtinë, 2019, f. 13.

² Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr.06/L-074, i datës 23.11.2018 (në tekstin e mëtejshëm KPRK).

³ SHALA, AFRIM, Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, Gjilan, 2010, f. 21.

⁴ SALIHU, ISMET, E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2015, f. 27.

konsiderohet edhe: personi i cili thelbësisht ka kontribuar në ndonjë mënyrë tjetër në kryerjen e veprës penale⁵, shtytësi⁶, ndihmësi⁷, pjesëmarrësit në bashkimin kriminal⁸, si dhe personat që janë marrë vesh për kryerjen e veprës penale⁹.

Mjetet me të cilat e drejta penale e ushtron mbrojtjen juridike nga veprat penale janë sanksionet penale. Sanksionet penale janë masa të dhunshme penalo-juridike të cilat i shqipton gjykata në procedurën e përcaktuar me ligj ndaj kryesit të veprës penale, me qëllim të mbrojtjes së shoqërisë dhe individit nga kriminaliteti, ndërsa, konsistojnë në marrjen ose kufizimin e lirive dhe të drejtave të caktuara apo në tërheqjen e vërejtjes kryesit se do t'i merren apo kufizohen liritë apo të drejtat nëse sërish kryen vepër penale¹⁰.

Sanksionet penale, sipas nenit 4 paragrafi 1 të KPRK, janë:

1. Dënimet kryesore,
2. Dënimet alternative,
3. Dënimet plotësuese dhe
4. Vërejtja gjyqësore.

Ndaj kryesit i cili nuk është penalisht përgjegjës, ka aftësi esencialisht të zvogëluar mendore ose është i varur nga droga apo alkooli shqiptohen masat e trajtimit të detyrueshëm. Sipas nenit 4 paragrafi 2 të KPRK, masat e trajtimit të detyrueshëm, janë:

1. Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor,
2. Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri dhe
3. Trajtimi me rehabilitim të detyrueshëm të personave të varur nga droga apo alkooli.

c) Funkzioni i së drejtës penale - Funkzioni i së drejtës penale është mbrojtja e shoqërisë nga kriminaliteti. Kriminaliteti nënkupton tërësinë e veprave penale që kryhen në një vend, brenda një kohe të caktuar. Kriminaliteti është një dukuri e dëmshme për shoqërinë në përgjithësi dhe qytetarin në veçanti. Me anë të kriminalitetit dëmtohet apo rrezikohet siguria e vendit, vlerat më vitale të njeriut, siç janë: jeta e njeriut, integriteti trupor, pasuria, liria e lëvizjes, liritë dhe të drejtat e njeriut, si dhe një varg vlerash tjera individuale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Funkcionin e mbrojtjes së shoqërisë nga kriminaliteti, e drejta penale e realizon duke parashikuar se cilat vepra shoqërore konsiderohen vepra penale dhe duke parashikuar sanksione penale, si dhe masa tjera ndaj kryesve të veprave penale.

⁵ Neni 31 i KPRK.

⁶ Neni 32 i KPRK.

⁷ Neni 33 i KPRK.

⁸ Neni 34 i KPRK.

⁹ Neni 35 i KPRK.

¹⁰ SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 28.

BURIMET E SË DREJTËS PENALE

Shqyrtime të përgjithshme

Burimet e së drejtës penale, si edhe të çdo dege të së drejtës, ndahen në burime materiale dhe në burime formale.

Burime materiale të së drejtës penale konsiderohen marrëdhëniet shoqërore, ekonomike, si dhe të mirat dhe vlerat, që një shoqëri i kultivon, zhvillon dhe i mbron.

Burime formale të së drejtës penale janë tërësia e dispozitave juridike penale që aplikohen në Kosovë. Si burime formale të së drejtës penale në Kosovë, konsiderohen : Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Konventat dhe deklaratat e ndryshme ndërkombëtare etj.

a) Kodi Penal i Republikës së Kosovës - Kodi Penal i Republikës së Kosovës konsiderohet burimi kryesor dhe themelor i së drejtës penale. KPRK ka gjithsej 34 kapituj me 434 nene dhe ndahet në dy pjesë : në pjesën e përgjithshme dhe në pjesën e posaçme. Pjesën e përgjithshme të KPRK e përbëjnë kapitujt I-XIII (nenet 1-113), ndërsa pjesën e posaçme të KPRK e përbëjnë kapitujt XIV-XXXIII (nenet 114-429). Ndërsa, dispozitat kalimtare dhe përfundimtare gjenden në kapitullin XXXIV (nenet 431-434).

Pjesa e përgjithshme e KPRK përbëhet nga tërësia e dispozitave ligjore që janë të karakterit të përgjithshëm dhe parimor, të cilat u referohen veprave penale në përgjithësi, kushteve për përgjegjësi penale dhe sanksioneve penale. Po ashtu, në pjesën e përgjithshme të KPRK gjenden dispozita që kanë të bëjnë me mbrojtjen e nevojshme, nevojën ekstreme, format e fajit (dashja dhe pakujdesia), fazat e kryerjes së veprës penale, bashkëpunimin në kryerjen e veprës penale, parashkrimin etj.

Në pjesën e posaçme të KPRK gjenden dispozita me anë të të cilave përcaktohen veprat penale të veçanta dhe sanksionet penale për çdo vepër penale.

Pjesa e posaçme e së drejtës penale përbëhet prej këtyre kapitujve:

Kapitulli XIV: Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës;

Kapitulli XV: Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare;

Kapitulli XVI: Veprat penale kundër jetës dhe trupit;

Kapitulli XVII: Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut;

Kapitulli XVIII: Veprat penale kundër të drejtave të votimit;

Kapitulli XIX: Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës;

Kapitulli XX: Veprat penale kundër integritetit seksual;

Kapitulli XXI: Veprat penale kundër martesës dhe familjes;

Kapitulli XXII: Veprat penale kundër shëndetit publik;

Kapitulli XXIII: Veprat penale të narkotikëve;

Kapitulli XXIV: Krimi i organizuar;
Kapitulli XXV: Veprat penale kundër ekonomisë;
Kapitulli XXVI: Veprat penale kundër pasurisë;
Kapitulli XXVII: Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore;
Kapitulli XXVIII: Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe të pasurisë;
Kapitulli XXIX: Veprat penale të armëve;
Kapitulli XXX: Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik;
Kapitulli XXXI: Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike;
Kapitulli XXXII : Veprat penale kundër rendit publik dhe
Kapitulli XXXIII : Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare.

b) Kushtetuta e Republikës së Kosovës - Si në çdo shtet tjetër në botën bashkëkohore, edhe në Kosovë, Kushtetuta konsiderohet burim i së drejtës penale, madje në disa raste edhe burim i drejtpërdrejt i së drejtës penale.

c) E drejta penale ndërkombëtare - E drejta penale ndërkombëtare mund të konsiderohet burim i së drejtës penale, nëse një gjë e tillë është parashikuar me ligj. Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës është parashikuar se një numër i caktuar i akteve juridike ndërkombëtare do të aplikohen në mënyrë të drejtpërdrejt në Kosovë, krahas kësaj Kushtetute.¹¹ Andaj, dispozitat penalo-juridike të këtyre akteve juridike ndërkombëtare konsiderohen edhe pjesë përbërëse e legjislacionit penal në Kosovë.

d) Ligjet tjera - Në pjesën e posaçme të KPRK, gjenden edhe dispozita të atilla ligjore me anë të të cilave lidhur me tiparet e veprës penale të caktuar, udhëzohet aplikimi i një ligji tjetër apo i referohen një ligji tjetër, për të sqaruar përmbajtjen e tij. P.sh. neni 178 i KPRK, me të cilin parashihet vepra penale e ndërprerjes së palejuar të shtatzënisë, i referohet Ligjit mbi ndërprerjen e shtatzënisë¹², neni 249 i KPRK, me të cilin parashihet vepra penale e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse, i referohet ligjeve dhe dispozitave tjera me të cilat përcaktohet se cilat sëmundje konsiderohen ngjitëse dhe si mund të përhapen¹³, neni 218 i KPRK, me të cilin parashihet vepra penale e cenimit të të drejtave në marrëdhëniet e punës, i referohet ligjit¹⁴ apo kontratës kolektive etj. Në të gjitha këto raste, këto ligje mund të konsiderohen burim i së drejtës penale.

¹¹Në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është parashikuar se të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

¹²Ligji Nr.03/L-110 Për Ndërprerjen e Shtatzënisë, i datës 06.11.2008.

¹³Ligji Nr.02/L-109 Për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, i datës 10.05.2007.

¹⁴Ligji Nr.03/L-212 i Punës, i datës 01.11.2010.

e) **Burimet tjera të së drejtës penale** - Sipas rregullit, gjykatat e çdo shteti e zbatojnë ekskluzivisht të drejtën penale të atij shteti. Mirëpo, në disa raste ligjet e shteteve tjera apo e drejta e huaj penale mund të paraqitet si burim indirekt i të drejtës penale dhe vetëm kur një gjë e tillë është parashikuar në mënyrë shprehimore në ligj. Kështu, p.sh. në nenin 108 paragrafi 4 të KPRK, është parashikuar se legjislacioni penal i Republikës së Kosovës zbatohet ndaj çdo shtetasi të Republikës së Kosovës që kryen veprë penale jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe nëse kjo veprë po ashtu është e dënueshme në vendin ku është kryer. Andaj, në këtë rast, për tu zbatuar ligjet penale të Republikës së Kosovës ndaj një personi i cili është shtetas i Republikës së Kosovës, për një veprë penale të kryer jashtë territorit të Republikës së Kosovës, duhet që kjo veprë të jetë e parashikuar me ligjin penal të atij shteti si veprë penale. Pra, në këto raste, e drejta e huaj penale duhet të merret parasysht, përkatësisht konsiderohet burim i së drejtës penale.

Si rregull, e drejta zakonore, praktika gjyqësore dhe shkenca e së drejtës penale, nuk konsiderohen si burime të drejtpërdrejta të së drejtës penale. Mirëpo, nga kjo rregull bëhet përjashtim në rastet kur bëhet fjalë për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kështu, në nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është parashikuar se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut¹⁵. Andaj, duke u bazuar në këtë dispozitë kushtetuese, mund të konkludojmë se vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, konsiderohen burime të së drejtës penale në Republikën e Kosovës, nëse bëhet fjalë për interpretimin e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

NOCIONI, ELEMENTET, OBJEKTI DHE SUBJEKTI I VEPRËS PENALE

1. Nocioni i veprës penale

Në teorinë e së drejtës penale, ekziston nocioni formal, material dhe formal-material i veprës penale.

Sipas **nocionit formal**, veprë penale konsiderohet ai veprim apo mosveprim i cili në legjislacionin penal është parashikuar si veprë penale.

Sipas **nocionit material**, veprë penale konsiderohet ai veprim apo mosveprim me anë të të cilit dëmtohen apo rrezikohen vlerat elementare të njeriut, shtetit dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Ndërsa, **nocioni formalo-material**, veprën penale e përkufizon duke i marrë për bazë si elementet formale, ashtu edhe elementet materiale. Kështu, sipas **nocionit formalo-material**, veprë penale konsiderohet ai veprim ose mosveprim që në legjislacionin penal është

¹⁵ Më gjerësisht lidhur me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, shih : www.echr.coe.int

parashikuar si vepër penale dhe me anë të të cilit dëmtohet apo rrezikohet ndonjë vlerë elementare e njeriut, shoqërisë, shtetit apo të bashkësisë ndërkombëtare.

KPRK, ngjashëm sikur shumica e ligjeve penale të regjionit¹⁶, e ka përcaktuar nocionin e veprës penale. Kështu, sipas nenin 7 të KPRK, vepra penale është një vepër e kundërligjshme e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është përcaktuar sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm. Ndërsa, në nenin 1 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se veprat penale dhe sanksionet penale parashihen vetëm për ato sjellje me të cilat cenohen apo dëmtohen në atë masë liritë dhe të drejtat e njeriut si dhe të drejtat tjera dhe vlerat shoqërore të garantuara dhe të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me të drejtën ndërkombëtare, mbrojtja e të cilave nuk do të mund të realizohej pa sanksione penale të shtetit ligjor. Ndërsa, sipas paragrafit 2 të këtij neni, parashikimi i veprave penale si dhe llojet e masave dhe lartësia e sanksioneve penale për kryesit e veprave penale bazohen në domosdoshmërinë e sanksionit penalo-juridik dhe proporcionalitetit të shkallës dhe natyrës së rrezikshmërisë për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të vlerave shoqërore.

2. Elementet e veprës penale

Elementet e veprës penale, ndahen në dy grupe :

- 1) Elemente themelore apo të përgjithshme të veprës penale dhe
- 2) Elemente të posaçme të veprës penale.

1) Elementet themelore apo të përgjithshme të veprës penale janë:

- a) Veprimi i njeriut;
- b) Kundërligjshmëria;
- c) Përcaktueshmëria e veprës penale në ligj dhe
- d) Përgjegjësia penale e kryesit.

Çdo veprim apo mosveprim, për t'u konsideruar vepër penale, duhet të posedojë në mënyrë kumulative të gjitha këto elemente. Të gjitha këto elemente së bashku përbëjnë anatominë e veprës penale dhe çdonjëri prej tyre është pjesë e strukturës së veprës penale. Këto elemente e përbëjnë të ashtuquajturën “figurë të përgjithshme të veprës penale”. Me gjithë faktin se vepra penale përbëhet prej këtyre katër elementeve themelore, vepra penale është unike, një tërësi, ngase vetëm tërësia e tyre formon kuptimin e plotë social dhe juridik. Për nga rëndësia e tyre shoqërore dhe juridike, të gjitha këto elemente janë të njëjta. Së këndejmi, nëse mungon njëri

¹⁶ Komentari krivičnik/kaznenih zakona u Bosni i Hercegovini, Savjet/Vijeće Evrope, Evropska Komisija, Sarajevo, 2005, f. 120.

prej këtyre elementeve, vepra penale nuk mund të ekzistojë. Pra, të gjitha këto elemente janë pjesë konstituive të çdo veprë penale.

Varësisht se prej çfarë këndi vështrohen, elementet themelore të veprës penale mund të ndahen në dy grupe :

- 1) Elemente objektive dhe
- 2) Elemente subjektive.

Në grupin e elementeve objektive bëjnë pjesë: veprimi i njeriut (veprimi me pasojën e shkaktuar); kundërligjshmëria dhe përcaktueshmëria e veprës penale në ligj, ndërsa, në grupin e elementeve subjektive bën pjesë vetëm përgjegjësia penale e kryesit (fajësia).

2) Elementet e posaçme të veprës penale janë ato elemente që nuk janë të përbashkëta për të gjitha veprat penale, por që paraqiten te disa vepra penale dhe janë elemente që ndikojnë që një veprë penale të dallohet prej një veprë tjetër penale¹⁷. Elementet e posaçme të veprës penale ndryshe emërtohen edhe si “**tipare të veprës së caktuar penale**“ dhe njëherazi tërësia e elementeve të veprës penale të caktuar e përbëjnë “**figurën e veprës penale**“. Ndërsa, elementet themelore apo të përgjithshme të veprës penale duhet të shprehen te çdo veprë penale dhe ato në fakt e sajojnë kuptimin e përgjithshëm të veprës penale. Nga kjo del se, përderisa elementet themelore apo të përgjithshme të veprës penale (veprimi, kundërligjshmëria etj.), duhet të shprehen te çdo veprë penale, elementet e posaçme janë tipare apo janë karakteristikë e veprës penale të caktuar dhe këto shprehen krahas elementeve të përgjithshme. Pra, çdo veprë penale i posedon elementet e veta të posaçme, që shprehen krahas elementeve të përgjithshme dhe që bëjnë që një veprë penale të dallohet nga vepra tjetër penale.

Elementet e posaçme të veprës penale grabitja, nga neni 317 paragrafi 1 KPRK janë :

- 1) kryesi duke e përdorur forcën apo kanosjen serioze për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër;
- 2) e përvetëson;
- 3) pasurinë e luajtshme;
- 4) të personit të tillë dhe
- 5) me qëllim që t’i sjellë vetes apo personit tjetër dobi pasurore të kundërligjshme.

3. Objekti i veprës penale

Objekt i veprës penale janë të mirat juridike që janë të mbrojtura me të drejtën penale. Pra, objekt i veprës penale është e mira juridike kundër së cilës është e drejtuar vepra penale.¹⁸

¹⁷SHALA, AFRIM, Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, Gjilan, 2020, f. 27.

¹⁸ SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 186.

Objekte të veprës penale janë të mirat apo vlerat vitale të njeriut, të popullit të një vendi dhe të bashkësisë ndërkombëtare. Këto janë jeta e njeriut, integriteti i tij trupor, liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit, siguria, paqja, barazia, prona, rregullimi shoqëroro-politik, siguria e vendit, integriteti territorial, liria në sferën seksuale, martesë, familja, mjedisi, kafshët, bimët, objektet kulturore etj.

Objekti i veprës penale është substrat material i çdo veprë penale, ngase me veprë penale rrezikohet apo dëmtohet ndonjë e mirë, e cila për shkak të rëndësisë së saj shoqërore mbrohet nga e drejta penale. Në rastet kur vepra inkriminohet edhe në fazat që i paraprijnë veprimit të kryerjes, siç është organizimi i shoqatës kriminale apo veprimet përgatitore, që në fakt akoma nuk paraqesin veprim të kryerjes, kjo nuk do të thotë se veprat e këtilla ndëshkohen vetëm për shkak të vetë veprimit, por ngase edhe me këto vepra, edhe pse në një relacion më të largët, rrezikohen të mirat që janë të mbrojtura me të drejtën penale.

4. Subjekti i veprës penale

Në teorinë e së drejtës penale, subjekt i veprës penale konsiderohet **personi që e kryen veprën penale**. Përveç atyre që ndërmarrin drejtpërdrejt veprimin e kryerjes së veprës penale, si kryes i veprës penale, sipas KPRK konsiderohen edhe këta persona: **personi i cili thelbësisht ka kontribuar në ndonjë mënyrë tjetër në kryerjen e veprës penale**¹⁹, pastaj, **shtytësi**²⁰, **ndihmësi**²¹, **pjesëmarrësit në bashkimin kriminal**²², si dhe **personat që janë marrë vesh për kryerjen e veprës penale**²³. Gjithashtu, tani subjekt të veprës penale konsiderohen edhe **personat juridikë**²⁴, ngase me Ligjin për Përgjegjësinë e Personave Juridike për Vepra Penale²⁵, është parashikuar se edhe personat juridikë mund të jenë kryes të veprave penale.

Lidhur me moshën, subjekt të veprës penale konsiderohen vetëm personat që kanë mbushur moshën katërmëdhjetë vjeçare. Në nenin 17 paragrafi 3 të KPRK, është parashikuar se personi nuk është penalisht përgjegjës nëse në kohën e kryerjes së veprës penale është nën moshën katërmëdhjetë vjet.

Varësisht se çfarë kriteri zbatohet, subjektet e veprës penale mund të ndahen në disa kategori.

Nëse merret për bazë moshë, kryesit e veprave penale ndahen në **të mitur** dhe **madhor**. Të mitur konsiderohen personat prej moshës katërmëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjet. Personat e mitur, sipas nenit 3 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, ndahen në **të mitur të rinj** (prej moshës 14 deri në 18 vjet) dhe **të mitur të rritur** (prej moshës 16 deri në 18 vjet). Sipas, kësaj dispozite ligjore, **madhor** konsiderohen personat mbi moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeçare, kurse persona

¹⁹ Neni 31 i KPRK.

²⁰ Neni 32 i KPRK.

²¹ Neni 33 i KPRK.

²² Neni 34 i KPRK.

²³ Neni 35 i KPRK.

²⁴ Nenet 37 dhe 112 të KPRK.

²⁵ Ligji Nr.04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale, i datës 31.08.2011.

madhorë të rinj konsiderohen personat ndërmjet moshës 18 (tetëmbëdhjetë) deri në 21 (njëzetënjë) vjet.

Sipas kriterit të aftësive psikike të kryesve të veprave penale, se a kanë qenë në gjendje ta kuptojnë rëndësinë e veprës dhe t'i kontrollojnë sjelljet e tyre, legjislacioni penal bën dallimin midis **personave të përgjegjshëm**²⁶, **personave të papërgjegjshëm**²⁷ dhe **personave me përgjegjshmëri të zvogëluar**²⁸.

Nëse merret për bazë fakti se a kanë qenë më parë të dënuar, legjislacioni penal bën dallimin midis **kryesve që për herë të parë kanë kryer veprë penale** dhe **recidivistëve**, atyre që edhe më parë kanë qenë të dënuar për kryerjen e ndonjë veprë tjetër penale.

Nëse merret për bazë roli dhe kontributi i tyre në kryerjen e veprës penale, në KPRK njihet :

- 1) kryesi i veprës penale,
- 2) shtytësi,
- 3) ndihmësi,
- 4) pjesëmarrësit e bashkimit kriminal dhe
- 5) personat që janë marrë vesh për të kryer veprën penale.

Kryesi i veprës penale konsiderohet personi, me veprimin e drejtpërdrejtë të të cilit shkaktohet pasoja e veprës penale, si dhe personi i cili thelbësisht ka kontribuar në kryerjen e veprës penale në ndonjë mënyrë tjetër.

Shtytësi konsiderohet personi i cili ndërmerr veprime të atilla me të cilat te personi tjetër me dashje shkaktohet ose forcohet vendimi për të kryer veprën penale.

Ndihmësi konsiderohet personi i cili ndërmerr me dashje veprime të atilla me të cilat personi tjetër ndihmohet për të kryer veprën penale.

Pjesëmarrësit e bashkimit kriminal janë penalisht përgjegjës dhe dënohen nëse kanë arritur shprehimisht apo në mënyrë të heshtur marrëveshje me një ose më shumë persona për të kryer ose për të nxitur kryerjen e një veprë penale për të cilën ligji parasheh së paku pesë vjet burgim dhe ndërmerr veprime përgatitore për realizimin e marrëveshjes së tillë, si dhe merr pjesë në bashkimin kriminal.

Personat që janë marrë vesh për kryerjen e veprës penale janë penalisht përgjegjës dhe dënohen, nëse ata janë marrë vesh për të kryer veprë penale dhe një apo më shumë nga ata persona ndërmarrin çfarëdo veprimi të rëndësishëm për kryerjen e veprës penale.

²⁶ Neni 17 paragrafi 1 i KPRK.

²⁷ Neni 18 paragrafi 1 i KPRK.

²⁸ Neni 18 paragrafi 2 i KPRK.

Nëse merret për bazë pozita e tyre, në të drejtën penale njihen dy lloje të subjekteve të veprave penale, subjekti aktiv dhe subjekti pasiv.

Subjekti aktiv i veprës penale konsiderohet personi i cili me veprimin e tij shkakton pasojën e veprës penale.

Në të shumtën e rasteve veprat penale mund t'i kryejë çdo person (çdo subjekt). Veprat penale të cilat mund t'i kryejë çdo person quhen *“delicta communia”*. Këto janë veprat penale që ligjdhënësi i përcakton me formulimin *“Kushdo që kryen”*, p.sh. vrasjen, lëndimin trupor, vjedhjen, grabitjen etj. Mirëpo, ekzistojnë disa vepra penale të cilat për shkak të tipareve të tyre të posaçme, nuk mund t'i kryejë çdo person, por vetëm një kategori e personave që posedojnë veti apo që gjenden në marrëdhënie të caktuara apo të posaçme. Kështu, p.sh. veprën penale të vrasjes së foshnjës gjatë lindjes²⁹ mund ta kryejë vetëm nëna; veprën penale të marrjes së ryshfetit³⁰ mund ta kryejë vetëm personi zyrtar; veprën penale mosdhënia e ndihmës mjekësore³¹ mund ta kryejë mjeku ose punonjësi tjetër shëndetësor etj. Veprat e tilla penale, të cilat mund t'i kryejnë vetëm personat që posedojnë veti të caktuara apo që gjenden në marrëdhënie të caktuara, quhen *“delicta propria”*.

Subjekt pasiv i veprës penale konsiderohet personi që është dëmtuar apo rrezikuar me veprën penale. Pra, subjekti pasiv i veprës penale është i dëmtuari apo viktimja e veprës penale. I dëmtuar apo viktimë, konsiderohet personi, të cilit çfarëdo e drejte personale apo pasurore i është dëmtuar apo rrezikuar me vepër penale³². I dëmtuar mund të jetë si personi fizik, ashtu edhe personi juridik.

VEPRIMI SI ELEMENT I VEPRËS PENALE

1. Shqyrtime të përgjithshme

Veprimi konsiderohet njëri ndër elementet themelore apo të përgjithshme të çdo vepre penale. Me shprehjen **“veprim”** në të drejtën penale nënkuptojmë të gjitha sjelljet apo veprimet që manifestohen në botën e jashtme dhe të cilat janë të përcaktuara me ligj si vepra penale.³³ Pra, me veprim nënkuptojmë veprimet me të cilat realizohet figura e ndonjë vepre penale. Ose me fjalë të tjera, veprimi është lëvizje trupore e vullnetshme e njeriut me të cilin kryhet vepra penale,

Shembuj të veprimit si element i veprës penale

- shkrepija me armë te vepra penale e vrasjes;
- goditja me ndonjë send e personit tjetër te veprat penale të lëndimit të lehtë apo të rëndë trupor;

²⁹ Neni 176 i KPRK.

³⁰ Neni 421 i KPRK.

³¹ Neni 255 i KPRK.

³² Neni 19 paragrafi 1, nën-paragrafi 7 të KPP.

³³ SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 212.

- marrja e sendit të huaj te vepra penale e vjedhjes etj.

Veprimet që ngjajnë në psikiken dhe vullnetin e brendshëm të njeriut, siç janë mendimi, dëshira, vendimi dhe qëllimi për të kryer veprë penale, nuk mund të konsiderohen veprime në kuptimin penalo-juridik dhe nuk dënohen nëse nuk manifestohen në botën e jashtme³⁴.

Përveç kësaj, për t'u konsideruar një veprim relevant në të drejtën penale, ai duhet të jetë i vullnetshëm. I vullnetshëm konsiderohet ai veprim që është ndërmarrë dhe është drejtuar nga ana e personit të vetëdijshëm dhe në bazë të vullnetit të lirë. Në këtë drejtim, sipas të drejtës penale, nuk do të konsiderohen si veprim dhe nuk do të dënohen sjelljet apo veprimet që ndërmerren apo shkaktohen **pa vetëdije, rastësisht apo nën ndikimin e dhunës ose të kanosjes**.

Shembuj të veprimeve që shkaktohen pa vetëdije, rastësisht apo nën ndikimin e dhunës apo kanosjes

- veprimi në gjumë, me ç' rast nëna ia zë frymën foshnjës së vet të sapolindur dhe e mbyt;
- personi duke ecur në trotuar për shkak të ngricës rrëshqet dhe me atë rast i shkakton lëndim tjetrit që është gjendur pranë tij;
- kur personi A ia drejton revolen personit B, që është duke punuar në sportelin e bankës dhe në këtë mënyrë e detyron t'ia dorëzohë të gjitha të hollat që gjenden në kasafortë.

Siç shihet nga këta shembuj, veprimet e këtilla, që kanë shkakuar pasoja të dëmshme, janë ndërmarrë pa vetëdije ose rastësisht apo kundër vullnetit të njeriut (nën ndikimin e dhunës apo kanosjes). Për këtë arsye veprimet e këtyre personave në të drejtën penale nuk konsiderohen vepra penale. Në të drejtën penale janë të rëndësishme vetëm ato veprime të njeriut të cilat i përgjigjen ndonjë veprimi të përcaktuar në figurën ligjore të veprës penale përkatëse.

Në nenin 8 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se vepra penale mund të kryhet me veprim ose me mosveprim. Andaj, lidhur me mënyrën nëpërmjet së cilës manifestohet veprimi i kryerjes së veprës penale, në të drejtën penale njihen dy lloje të veprave penale: **veprat penale të kryera me veprim dhe veprat penale të kryera me mosveprim**.

2. Veprat penale të kryera me veprim

Sipas KPRK, shumica e veprave penale mund të kryhen me veprim, përkatësisht duke ndërmarrë veprime aktive me qëllim të kryerjes së veprës penale. Veprat penale të cilat mund të kryhen me veprim, në teorinë e së drejtës penale ndryshe emërtohen **delikte komisive**. Me anë të veprave penale të kryera me veprim apo delikteve komisive cenohen normat penalo-juridike, të cilat e ndalojnë veprimin e caktuar, norma këto të cilat ndryshe emërtohen si **norma**

³⁴KAMBOVSKI, VLLADO, E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, Shkup, 2007, f. 164.

*prohibitive*³⁵. Te këto vepra penale, personi vepron në kundërshtim me normën e caktuar penalo-juridike e cila e ndalon veprimin e caktuar, p.sh. te vepra penale e vrasjes³⁶ cenohet norma penalo-juridike, e cila ndalon privimin e ndonjë personi nga jeta; te vepra penale e bigamisë³⁷ cenohet norma penalo-juridike, e cila e ndalon martesën e re, derisa kryesi është i martuar etj.

3. Veprat penale të kryera me mosveprim

Veprat penale të kryera me mosveprim, në teorinë e së drejtës penale ndryshe emërtohen edhe si *deliktet omisive*. Veprat penale me mosveprim kryhen me mosndërmarrjen e veprimit që ka qenë i detyruar ta ndër marrë kryesi. Ky përkufizim i veprave penale me mosveprim është i parashikuar edhe në nenin 8 paragrafi 2 të KPRK, sipas të cilit vepra penale kryhet me mosveprim vetëm kur kryesi nuk e ndërmerr veprimin të cilin ka qenë i obliguar ta ndër marrë. Pra, kjo mënyrë e kryerjes së veprës penale shprehet si qëndrim pasiv i njeriut në rrethanat e caktuara, për shkak të të cilit qëndrim shkaktohet pasoja e ndaluar në botën e jashtme.

Si vepra penale të kryera me mosveprim të cilat janë të parashikuara

në pjesën e posaçme të KPRK, janë :

- mosdhënia e ndihmës mjekësore³⁸,
- mosveprimi sipas dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë³⁹,
- mos evitimi i rrezikut⁴⁰,
- mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësitë e trafikut publik⁴¹,
- moslajmërimi i përgatitjes së veprave penale⁴²,
- moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre⁴³,
- moslajmërimi i personit të akuzuar nga tribunali ndërkombëtar penal⁴⁴ etj.

Duke u bazuar në nenin 8, paragrafi 2, të KPRK, veprat penale me mosveprim mund t'i kryejnë vetëm ata persona që, sipas ndonjë baze juridike, kanë qenë të obliguar që t'i ndërmarrin veprimet e caktuara. Obligimi për të vepruar mund të rrjedhë nga profesioni ose nga marrëdhënia e punës, nga ligji, nga veprimi që është ndërmarrë më parë etj.

V. VENDI DHE KOHA E KRYERJES SË VEPRËS PENALE

³⁵SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 214.

³⁶ Neni 172 i KPRK.

³⁷ Neni 237 i KPRK.

³⁸ Neni 255 i KPRK.

³⁹ Neni 250 i KPRK.

⁴⁰ Neni 362 i KPRK.

⁴¹ Neni 374 i KPRK.

⁴² Neni 377 i KPRK.

⁴³ Neni 378 i KPRK.

⁴⁴ Neni 379 i KPRK.

1. Shqyrtime të përgjithshme

Veprat penale mund të kryhen në vende dhe në kohë të ndryshme. Përcaktimi i vendit dhe kohës së kryerjes së veprës penale ka rëndësi të madhe për të drejtën penale. Në të drejtën penale, çështja e përcaktimit të vendit dhe kohës së kryerjes së veprës penale shtrohet në rastet kur veprimi i kryerjes së veprës penale është ndërmarrë në një vend, kurse pasoja shkaktohet në vendin tjetër apo kur veprimi i kryerjes është ndërmarrë në një kohë, kurse pasoja shkaktohet më vonë.

2. Vendi i kryerjes së veprës penale

Zakonisht pasoja e veprës penale shkaktohet në vendin ku është ndërmarrë veprimi i kryerjes. Në raste të tilla, si vend i kryerjes konsiderohet vendi ku është ndërmarrë veprimi dhe ku është shkaktuar pasoja dhe nuk paraqitet kurrfarë dileme. Mirëpo, në disa raste veprimi i kryerjes ndërmerret në një vend, kurse pasoja shkaktohet në vendin tjetër.

Shembuj kur veprimi ndërmerret në një vend, kurse pasoja shkaktohet në vendin tjetër

Personi A e vendos eksplozivin në autobusin me udhëtarë i cili është i ndalur në Gjilan dhe ky eksploziv eksplodon pasi që ky autobus të arrijë në Prishtinë. Ose p.sh. rasti tjetër, personi A, i cili ndodhet në Kosovë, përmes telefonit të tij mobil e dërgon një mesazh kërcënues në telefonin e personit B, i cili ndodhet në Gjermani, duke iu kërcënuar personit B se do ta privojë nga jeta. Siç shihet në këto raste, veprimi i kryerjes së veprës penale është ndërmarrë në Gjilan, përkatësisht në Kosovë, kurse pasoja është shkaktuar në Prishtinë, përkatësisht në Gjermani.

Këto vepra penale, tek të cilat veprimi i kryerjes është ndërmarrë në një vend, kurse pasoja është shkaktuar në një vend tjetër, në shkencën e së drejtës penale quhen **vepra penale distancionale**. Te veprat penale distancionale, shtrohet pyetja se cili vend konsiderohet vend i kryerjes së veprës penale : vendi ku është ndërmarrë veprimi i kryerjes apo vendi ku është shkaktuar pasoja.

Përcaktimi i vendit të kryerjes së veprës penale është me rëndësi për këto shkaqe:

- prej vendit ku është kryer vepra penale varet se cili ligj penal do të zbatohet;
- prej vendit të kryerjes së veprës penale përcaktohet kompetenca territoriale e gjykatave;
- te disa vepra penale, vendi i kryerjes së veprës penale konsiderohet element konstitutiv⁴⁵ dhe

⁴⁵ P.sh. forma themelore e veprës penale gjuetia e kundërligjshme, nga neni 350 paragrafi 1 KPRK, mund të kryhet vetëm nëse ndonjë person gjuan kafshë të egra në territorin (vandin) në të cilin gjuetia është e ndaluar. Lidhur me këtë shih: SHALA, AFRIM, *Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës*, Revista “Avokatura”, nr. 14, Oda e Avokatëve të Kosovës, Prishtinë, 2012, f. 15-31.

- në disa raste, në aspektin e së drejtës penale ndërkombëtare, është me rëndësi përcaktimi i vendit të kryerjes së veprës penale, kur veprimi i kryerjes është ndërmarrë në një shtet, kurse pasoja është shkaktuar në shtetin tjetër.

Në lidhje me vendin e kryerjes së veprës penale, në nenin 10 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se vepra penale kryhet në vendin ku kryesi ka vepruar apo ka qenë i detyruar të veprojë, ashtu si dhe në vendin ku është shkaktuar pasoja.

Në paragrafin 2 të nenit 10 të KPRK, është përcaktuar vendi i kryerjes të përgatitja e veprës penale dhe të veprat penale të mbetura në tentativë. Kështu, sipas kësaj dispozite ligjore vepra penale është përgatitur ose është tentuar në vendin ku kryesi ka vepruar si dhe në vendin ku kryesi ka dashur që të shkaktohet pasoja.

3. Koha e kryerjes së veprës penale

Edhe koha e kryerjes së veprës penale, ngjashëm sikur edhe vendi i kryerjes së veprës penale, ka një rëndësi të posaçme praktike për të drejtën penale. Përcaktimi i kohës së kryerjes së veprës penale ka rëndësi për këto shkaqe:

- prej kohës kur konsiderohet se është kryer vepra penale varet se cili ligj do të zbatohet, ligji që ka qenë në fuqi në kohën kur është ndërmarrë veprimi apo ligji që ka qenë në fuqi në kohën kur është shkaktuar pasoja;
- sipas kohës së kryerjes së veprës penale përcaktohet përgjegjësia penale dhe fajësia e kryesit, përkatësisht nëse kryesi kishte arritur moshën për përgjegjësi penale dhe nga kjo në disa raste varet edhe shqiptimi i dënimeve, p.sh. dënimet mund t'iu shqiptohen vetëm personave të mitur të rritur (personave prej moshës gjashtëmbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjet),
 - afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të ecë prej momentit të kryerjes së veprës penale dhe
 - në disa raste koha e kryerjes së veprës penale është element konstitutiv i disa veprave penale, p.sh. nëse vepra penale është kryer në kohë paqe, kohë lufte, gjendje të jashtëzakonshme apo gjatë kohës së ndonjë epidemie⁴⁶.

Në lidhje me kohën e kryerjes së veprës penale, në nenin 9 të KPRK, është parashikuar se vepra penale kryhet në kohën kur kryesi ka vepruar apo ka qenë i detyruar të veprojë, pa marrë parasysh kohën kur është shkaktuar pasoja.

⁴⁶ Ose p.sh. forma themelore e veprës penale peshkimi i kundërligjshëm, nga neni 353 paragrafi 1 i KPRK, mund të kryhet vetëm nëse ndonjë person peshkon gjatë kohës kur peshkimi është i ndaluar.

KAPITULLI II

KUNDËRLIGJSHMËRIA DHE SHKAQET TË CILAT E PËRJASHTOJNË KUNDËRLIGJSHMËRINË

KUNDËRLIGJSHMËRIA

1. Nocioni dhe rëndësia e kundërligjshmërisë

Vepra penale është vepër e kundërligjshme e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është përcaktuar sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm⁴⁷. Pra, kundërligjshmëria është element themelor apo i përgjithshëm i çdo veprë penale. Çdo vepër për t'u konsideruar vepër penale, duhet që të jetë e kundërligjshme. Një vepër konsiderohet e kundërligjshme nëse është në kundërshtim me normat e rendit juridik. Parimisht, veprimi apo mosveprimi i njeriut i cili është në pajtim me figurën e veprës penale është edhe i kundërligjshëm. Me sjelljet e tilla zakonisht shkelen normat e ligjit penal që e ndalojnë ndonjë veprim (**normat prohibitive**) apo që urdhërojnë të ndërmerret ndonjë veprim (**normat imperative**)⁴⁸.

Kundërligjshmëria, si element i përgjithshëm i veprës penale, si rregull **ka karakter objektiv**⁴⁹ dhe kjo përcaktohet duke vënë në relacion veprimin e caktuar me dispozitat e së drejtës penale. Në këtë drejtim, në të gjitha rastet kur veprimi i caktuar është në kundërshtim me normat e legjislacionit penal, të cilat urdhërojnë apo ndalojnë këtë veprim, atëherë mund të konstatojmë se veprimi i tillë është i kundërligjshëm, se personi i caktuar ka kryer vepër penale, me kusht që me atë rast të mos ketë ekzistuar ndonjë bazë juridike e cila lejon atë veprim. Mirëpo, edhe pse kundërligjshmëria, sipas natyrës së saj, është komponent i natyrës objektive, në disa raste ajo përmban edhe elemente subjektive. Kështu, nëse i analizojmë figurat e disa veprave penale të parashikuara në pjesën e posaçme të KPRK, do të shohim se në disa raste, për t'u konsideruar një veprim i kundërligjshëm, duhet të konstatohet se personi e ka kryer veprën për motive apo qëllime të caktuara. Pra, motivi apo qëllimi janë të ashtuquajturat **elemente subjektive të kundërligjshmërisë**. Në rastet kur elementi subjektiv është element përbërës i veprimit si akt i kundërligjshëm, atëherë prej tij varet ekzistimi apo kualifikimi i veprës së caktuar penale.

Shembuj kur elementi subjektiv konsiderohet element përbërës i veprës penale

- Falsifikimi i parasë, nga neni 296 i KPRK, do të konsiderohet si vepër penale, vetëm nëse është bërë me qëllim që paraja e falsifikuar të vihet në qarkullim dhe në këtë rast, nëse mungon ky qëllim, nuk do të konsiderohet se është kryer kjo vepër penale.

- Nëse personi A e merr automjetin e personit B, me qëllim të përvetësimit të tij për vete apo për një person tjetër, atëherë, do të ekzistojë vepra penale e vjedhjes, nga neni 313 i KPRK. Nëse personi A

⁴⁷ Neni 7 i KPRK.

⁴⁸ SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 227.

⁴⁹ ELEZI, ISMET-KAÇUPI, SKËNDER-HAXHIA, MAKSIM, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2004, f. 45.

automjetin e personit B nuk e ka marrë me këtë qëllim, por vetëm sa për t'i kryer disa punë nëpër qytete tjera, atëherë do të ekzistojë vepra penale marrja në posedim e pasurisë së luajtshme, nga neni 319 i KPRK.

Në teorinë e së drejtës penale, kundërligjshmëria mund të kuptohet nga aspekti formal dhe nga aspekti material.

Kundërligjshmëria nga aspekti formal është veprim apo mosveprim që është në kundërshtim me ndonjë dispozitë juridike penale.

Kundërligjshmëria nga aspekti material nënkupton atë veprim i cili është në kundërshtim me ndonjë dispozitë juridike penale, por e cila në të njëjtën kohë edhe e dëmton apo e rrezikon të mirën juridike që është e mbrojtur pikërisht me këtë dispozitë juridike penale. Pra, kundërligjshmëria nga aspekti material i korrespondon rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale.

2. RREZIKSHMËRIA SHOQËRORE E VEPRËS PENALE

2.1. Shqyrtime të përgjithshme

Siç u tha edhe me lartë, kundërligjshmëria nga aspekti material manifeston rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale. Pra, rrezikshmëria është tipar social dhe element material, komponent material i kundërligjshmërisë, përkatësisht i veprës penale. Andaj, nuk mund të konsiderohet veprë penale ajo veprë që nuk është e rrezikshme për një bashkësi të caktuar shoqërore. Në anën tjetër, duhet theksuar se në të drejtën penale nuk konsiderohet çdo veprë shoqërore e rrezikshme si veprë penale. Për t'u konsideruar një veprim i rrezikshëm si veprë penale, është e domosdoshme që ai veprim të manifestohet me një shkallë më të lartë të rrezikshmërisë dhe të jetë i përcaktuar me ligj si veprë penale. Kjo për faktin se ekzistojnë një numër i konsiderueshëm i veprave tjera të dëmshme dhe të ndaluara me ligj, por për shkak se posedojnë një dozë më të vogël të rrezikshmërisë, nuk konsiderohen si vepra penale, por mund të konsiderohen si: kundërvajtje, shkelje disiplinore, shkelje administrative etj. Përveç këtyre, në botën bashkëkohore ushtrohen edhe shumë veprimtari të cilat konsiderohen shumë të rrezikshme për jetën e njerëzve dhe pasurinë, siç është puna në xeherore, trafikun, përkatësisht transportin e të gjitha llojeve, shfrytëzimi i centraleve nukleare, prodhimi i armëve, helmeve etj., mirëpo dobia, të cilën e sjellin këto veprimtari, është vlerësuar shumë më e madhe se sa rreziku që paraqesin, andaj si të tilla edhe pse janë të rrezikshme janë të lejuara me ligj⁵⁰. Nga kjo del se çdo veprë e rrezikshme nuk konsiderohet veprë penale, kurse çdo veprë penale duhet të jetë edhe e rrezikshme.

Rrezikshmëria dhe intensiteti i saj, janë relative dhe për nga përmbajtja kanë karakter dinamik, kjo për faktin se rrezikshmëria dhe intensiteti i saj vlerësohen duke pasur parasysh kohën në të

⁵⁰SHALA, AFRIM, Vepra e cituar, f. 271.

cilën është ndërmarrë ndonjë veprim dhe duke pasur parasysh rrethanat shoqërore në të cilat është ndërmarrë ai veprim.

2.2. Shkallëzimi i rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale

Rrezikshmëria është tipar i çdo vepre penale dhe çdo veprim ose mosveprim për t'u konsideruar si vepër penale duhet që të jetë veprim ose mosveprim i rrezikshëm. Mirëpo, rrezikshmëria shoqërore e veprës penale mund të shkallëzohet dhe të jetë me intensitet të ndryshëm. Kështu, disa vepra penale janë më pak të rrezikshme, kurse disa vepra penale janë më shumë të rrezikshme. P.sh. vepra penale e vrasjes⁵¹ është më e rrezikshme se sa vepra penale e lëndimit të lehtë trupor⁵², vepra penale e grabitjes⁵³ është më e rrezikshme se sa vepra penale e vjedhjes⁵⁴ etj.

Shkallëzimi i rrezikshmërisë shoqërore bëhet duke marrë parasysh intensitetin dhe rëndësinë e së mirës juridike që është rrezikuar apo dëmtuar.

Shkalla e rrezikshmërisë përcaktohet edhe duke marrë parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale, mjetet e kryerjes, kohën e kryerjes, vendin e kryerjes, cilësitë e viktimës⁵⁵ etj. Përveç këtyre, shkalla e rrezikshmërisë varet edhe nga vetë kryesi i veprës penale dhe atë nga motivi për të cilin personi e ka kryer veprën, qëllimi, jeta e tij e mëparshme, cilësitë e tij personale, mënyra e kryerjes së veprës penale, fakti se a është recidivist etj. Nga gjitha këto, rezulton se rrezikshmëria është nocion objektiv-subjektiv, ngase në vete ngërthen elemente objektive që i përkasin veprës penale dhe elemente subjektive që i përkasin personalitetit të kryesit të veprës penale.

Duke u mbështetur në shkallën e rrezikshmërisë, përcaktohet edhe pesha e veprës penale. Kështu, në rastet kur rrezikshmëria është më e madhe, edhe vepra penale konsiderohet më e rëndë dhe anasjelltas, kur rrezikshmëria është më e vogël, edhe vepra penale konsiderohet më e lehtë. Shkalla e rrezikshmërisë së veprës penale shprehet posaçërisht te sanksionet penale. Kështu, për veprat penale më të rrezikshme parashihen dhe shqiptohen sanksione më të rënda, ndërsa për vepra penale më pak të rrezikshme parashihen dhe shqiptohen sanksione më të buta.

Përcaktimi i rrezikshmërisë ka rëndësi, ngase me anë të saj bëhet dallimi midis veprave penale të njëjta.

⁵¹ Neni 172 i KPRK.

⁵² Neni 185 i KPRK.

⁵³ Neni 317 i KPRK.

⁵⁴ Neni 313 i KPRK.

⁵⁵ P.sh. në pjesën e posaçme të KPRK, janë parashikuar si forma të rënda të veprave penale nëse ato janë kryer ndaj viktimave të ndjeshme. Sipas nenit 113 paragrafi 39 të KPRK, viktimë e ndjeshme është viktimja e veprës penale që është fëmijë, person me aftësi të kufizuara fizike apo mendore, person me aftësi të zvogëluar, grua shtatzënë, i/e moshuar ose person marrëdhënia apo varësia e të cilit ndaj kryesit e bën atë veçanërisht të ndjeshëm ndaj viktimit të përsëritur, frikësimit të përsëritur apo hakmarrjes së përsëritur.

Shembuj se si veprat penale të njejta posedojnë shkallë të ndryshme të rrezikshmërisë

Kështu, p.sh. personi A me kryerjen e veprës penale të vjedhjes, e përvetëson një send që ka vlerë prej 2,500 €, kurse personi B me kryerjen e veprës penale të vjedhjes përvetëson një send që ka vlerë prej 100 €. Këtu, edhe pse është fjala për veprë penale të njëjtë, rrezikshmëria e veprës penale të personit A është më e madhe sesa ajo e veprës penale të personit B, andaj edhe do të ndëshkohen me masa të ndryshme të dënimeve, përkatësisht personi A do të dënohet me dënim më të rëndë se sa personi B.

III. SHKAQET TË CILAT E PËRJASHTOJNË KUNDËRLIGJSHMËRINË

1. Shqyrtime të përgjithshme

Zakonisht, të gjitha veprimet që i posedojnë elementet e përgjithshme dhe të posaçme të figurës konkrete të veprës penale, konsiderohen edhe vepra të kundërligjshme, përkatësisht vepra penale dhe kryesit e tyre do të përgjigjen penalisht. Mirëpo, ekzistojnë shkaqe apo rrethana të përcaktuara me norma penalo-juridike, të cilat në rastin konkret, për shkak të bashkëndodhjes së rrethanave përkatëse, veprën e bëjnë të lejuar, edhe pse ajo i përmban të gjitha tiparet e veprës penale. Këto norma juridike penale emërtohen **norma permissive** apo norma që lejojnë veprimet e caktuara, të cilat përndryshe janë veprime të ndaluara dhe që konsiderohen vepra penale.

Shkaqet apo rrethanat të cilat e përjashtojnë kundërligjshmërinë janë të shumta dhe të natyrave të ndryshme. Në teorinë e së drejtës penale, shkaqet të cilat e përjashtojnë kundërligjshmërinë ndahen tri grupe:

- 1) shkaqet e përjashtimit të kundërligjshmërisë sipas pjesës së përgjithshme të KPRK;
- 2) shkaqet e përjashtimit të kundërligjshmërisë sipas pjesës së posaçme të KPRK dhe
- 3) shkaqet e përjashtimit të kundërligjshmërisë sipas degëve të tjera të drejtësisë.

2. Shkaqet të cilat e përjashtojnë kundërligjshmërinë sipas pjesës së përgjithshme të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Në pjesën e përgjithshme të KPRK janë parashikuar në mënyrë shprehimore këto shkaqe apo rrethana, të cilat e përjashtojnë kundërligjshmërinë e veprimit të caktuar:

- mbrojtja e nevojshme⁵⁶,
- nevoja ekstreme⁵⁷,
- vepra e rëndësisë së vogël⁵⁸,

⁵⁶ Neni 12 i KPRK.

⁵⁷ Neni 13 i KPRK.

⁵⁸ Neni 11 i KPRK.

- dhuna ose kanosja⁵⁹,
- veprat e kryera nën shtrëngim⁶⁰ dhe
- urdhrat nga lartë.⁶¹

2.1. Mbrojtja e nevojshme

Në nenin 12 paragrafi 2 të KPRK, është përcaktuar se: “Mbrojtja e nevojshme është mbrojtje e cila është e domosdoshme për të zmbarsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atëçastshëm ndaj vetes ose personit tjetër, me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi”.

Shembuj të mbrojtjes së nevojshme

Nëse personi A e sulmon me thikë personin B, mirëpo personi B, duke mbrojtur jetën e vet derisa ishte i sulmuar, e vret personin A.

Siç shihet nga ky shembull, me rastin e mbrojtjes së nevojshme, realizohen të gjitha tiparet e veprës penale të vrasjes, mirëpo, meqë vepra është kryer në mbrojtje të nevojshme, konsiderohet se vepra penale nuk ekziston, sepse në këtë rast janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të cekura më lart dhe në rastet e tilla, i sulmuari ka të drejtë të zmbars sulmin e kundërligjshëm. Në nenin 12 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar në mënyrë shprehimore se “vepra e kryer në mbrojtje të nevojshme nuk është vepër penale”.

Mbrojtja e nevojshme, si rrethanë e cila e përjashton kundërligjshmërinë, është e parashikuar në të gjitha legjislacionet penale të shteteve bashkëkohore⁶².

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 të KPRK, për t’u konsideruar se ekziston mbrojtja e nevojshme, duhet të shfaqen **sulmi** dhe **mbrojtja**. Sulmi dhe mbrojtja njëherësh janë dy elementet kryesore të mbrojtjes së nevojshme, të cilat duhet t’i përmbushin kushtet e caktuara. Nëse mbrojtja dhe sulmi nuk i përmbushin kushtet e caktuara, atëherë nuk mund të bëhet fjalë për ekzistimin e mbrojtjes së nevojshme.

2.1.1. Sulmi

Sulmi është çdo veprim i njeriut i cili është i drejtuar në dëmtimin apo rrezikimin e ndonjë të mire juridike të personit tjetër.

Kushtet të cilat duhet të përmbushen me rastin e sulmit:

a) Sulmues duhet të jetë njeriu - Për të ekzistuar mbrojtja e nevojshme, sulmi duhet të ndërmerret vetëm nga njeriu. Në rastet kur sulmi vjen nga shtazët, egërsirat apo fuqitë mbinatyrore, mund të vijë në shprehje nevoja ekstreme. Ky kusht, që sulmi duhet të ndërmerret

⁵⁹ Neni 14 i KPRK.

⁶⁰ Neni 15 i KPRK.

⁶¹ Neni 16 i KPRK.

⁶²GARAČIĆ, ANA, Kazneni zakon u sudskoj praksi, Zagreb, 2011, f. 29.

nga njeriu, është një kërkesë e domosdoshme që e dallon mbrojtjen e nevojshme nga nevoja ekstreme⁶³.

Sulmi mund të ndërmerret nga çdo person, nga personi madhor, nga i mituri, nga fëmija apo personi i sëmurë psikik etj.

b) Sulmi mund të jetë i drejtuar kundër çdo të mire - Në KPRK nuk përmenden të mirat juridike, të cilat mund të jenë objekt i sulmit, por flitet në përgjithësi për zbrapsjen e sulmit prej vetes apo personit tjetër. Në këtë mënyrë, sulmi mund të jetë i drejtuar ndaj të mirave juridike që u përkasin personave fizikë, personave juridikë, sigurisë apo integritetit territorial të Kosovës etj. Mirëpo, në jetën e përditshme më së shpeshti sulmohet jeta e njeriut, integriteti trupor, liria seksuale dhe pasuria⁶⁴.

c) Sulmi duhet të jetë i kundërligjshëm - Sulmi konsiderohet i kundërligjshëm kur sulmuesi nuk ka kurrfarë autorizimesh juridike për veprimtarinë e vet dhe kur kjo veprimtari e vet cenon sistemin juridik. Pra, sulmi është i kundërligjshëm kur është në kundërshtim me ndonjë dispozitë ligjore.

Nga kushti që sulmi duhet të jetë i kundërligjshëm del se sulmi që ndërmerret në bazë të ndonjë autorizimi ligjor, nuk është i kundërligjshëm dhe kundër një sulmi të tillë nuk është e lejuar mbrojtja e nevojshme. Kështu, p.sh., nuk është e lejuar mbrojtja e nevojshme ndaj oficerit policor, i cili në bazë të urdhrorit të ligjshëm e privon nga liria personin e caktuar, ose qytetari nuk mund t'u kundërshtojë organeve të ndjekjes penale që në bazë të ligjit e bëjnë kontrollimin e banesës së tij.

Mirëpo, nëse personi i autorizuar zyrtar tejkalon autorizimet e veta, atëherë ky lloj tejkalimi konsiderohet sulm i kundërligjshëm dhe kundër tij është e lejuar mbrojtja e nevojshme. Prej kërkesës që sulmi duhet të jetë i kundërligjshëm rrjedh parimi sipas të cilit nuk është e lejuar mbrojtja e nevojshme kundër personit që mbrohet në mbrojtje të nevojshme (*mbrojtja e nevojshme kundër mbrojtjes së nevojshme*)⁶⁵.

d) Sulmi duhet të jetë i atëçastshëm - Sulmi konsiderohet i atëçastshëm në rastet kur ai në çdo moment pritet se do të fillojë, kur ka filluar të veprojë dhe derisa të zgjasë, përkatësisht derisa të përfundojë. Duke u bazuar në këtë kusht, del se nuk është e lejuar mbrojtja ndaj ndonjë sulmi që do të pasojë pas një kohe dhe as mbrojtja ndaj sulmit i cili ka përfunduar, ka pushuar së vepruari.

⁶³ELEZI, ISMET-KAÇUPI, SKËNDER-HAXHIA, MAKSIM, Vepra e cituar, f. 135; MUÇI, SHEFQET, E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, Tiranë, 2006, f. 178.

⁶⁴Për dallim nga KPRK, në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë (Ligji nr.7895, i datës 27.01.1995), përmenden të mirat juridike të cilat mund të jenë objekt i sulmit. Kështu, në nenin 19 të këtij Kodi, është parashikuar se: “nuk ka përgjegjësi penale personi që ka kryer veprën duke qenë i detyruar të mbrojë jetën, shëndetin, të drejtat dhe interesat e tij ose të një tjetri...”. ELEZI, ISMET-KAÇUPI, SKËNDER-HAXHIA, MAKSIM, Vepra e cituar, f. 134; LUARASI, ALEKS, Kodi penal me praktikë gjyqësore, Tiranë, 2003, f. 34.

⁶⁵SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 241.

Sulmi konsiderohet se pritet të fillojë në çdo moment, p.sh. në rastin kur në grindje e sipër midis dy personave, njëri prej tyre mbush revolen apo nxjerr thikën nga këllëfi. Mbushja e revoles me predha apo nxjerrja e thikës janë veprime paraprake të cilat, vështruar objektivisht, bëjnë të ditur qartas se sulmi pritet të fillojë në çdo moment. Apo rasti tjetër, p.sh: nëse personi A, me thikë në dorë, ndjek personin B me qëllim që ta godasë dhe nëse personi B, posa i afrohet personi A, nxjerr revolen dhe shkrep në të; në këto raste, konsiderohet se mbrojtja është e atëçastshme me sulmin, edhe pse ai ende nuk ka filluar, mirëpo në çdo moment është pritur të fillojë. Pra, sulmi konsiderohet i atëçastshëm edhe atëherë kur ai ende nuk ka filluar, mirëpo në çdo moment pritet të fillojë⁶⁶.

Te rastet kur sulmi ka filluar të veprojë, atëherë mbrojtja mund të ndërmerret menjëherë dhe mund të zgjasë gjersa zgjat edhe sulmi. Në momentin kur sulmi pushon së vepruari apo kur sulmi refuzohet apo zotërohet, duhet të pushojë (të ndalet) edhe mbrojtja.

e) Sulmi duhet të jetë i vërtetë - Njëri prej kushteve për t'u konsideruar se ekziston mbrojtja e nevojshme, është se sulmi duhet të jetë i vërtetë. Nëse ndokush gabimisht mendon se është i sulmuar dhe duke qenë në lajthitje, e lëndon apo e privon nga jeta "sulmuesin", në këto raste bëhet fjalë për të ashtuquajturën *mbrojtje të nevojshme fiktive apo mbrojtje e nevojshme putative*. P.sh. personi A, me qëllim që të bëjë shaka me personin B, në errësirë e sulmon këtë me revole fëmijësh, kurse personi B, duke menduar se sulmi është i vërtetë, e vret "sulmuesin" - personin A. Në këto raste nuk ekziston mbrojtja e nevojshme, ngase sulmi nuk është i vërtetë, përkatësisht sulmi nuk ka ekzistuar realisht⁶⁷.

2.1.2. Mbrojtja

Mbrojtja është çdo veprim i njeriut, me të cilin dëmtohet apo rrezikohet ndonjë e mirë e sulmuesit.

Në praktikë në shumicën e rasteve, tek mbrojtja e nevojshme, sulmi zbrapset prej vetes.

Shembuj kur sulmi zbrapset edhe nga personi i tretë

- Nëse personi A e sulmon personin B, kurse personi C, me qëllim që ta zbraps këtë sulm, e dëmton apo e rrezikon ndonjë të mirë juridike të personit A.

- Nëse personi A tenton që me dhunë të kryej marrëdhënie seksuale me personin B, ndërsa personi C, me qëllim që ta zbrapsë këtë sulm, e dëmton apo rrezikon ndonjë të mirë juridike të personit A.

Në teorinë e së drejtës penale, kjo mbrojtje e nevojshme emërtohet edhe si *ndihmë e nevojshme apo e domosdoshme*.

Kushtet të cilat duhet të përmbushen me rastin e mbrojtjes (zbrapsjes së sulmit), janë:

⁶⁶ Idem, f. 241.

⁶⁷ KAMBOVSKI, VLLADO, Vepra e cituar, f. 223-224; SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 242.

a) Mbrojtja duhet të jetë e drejtuar kundër sulmuesit - Për t'u konsideruar se ekziston mbrojtja e nevojshme, veprimet e mbrojtjes duhet të jenë të drejtuara kundër sulmuesit, kundër asaj të mire juridike të sulmuesit, e cila është e nevojshme për zbrapsjen e sulmit. Nëse sulmuesi si mjet sulmi përdor mjetet e personit të tretë, atëherë i sulmuari, gjatë mbrojtjes, ka të drejtë t'i dëmtojë apo asgjësojë edhe këto të mira juridike (mjetet e personit të tretë).

b) Mbrojtja duhet të jetë domosdo e nevojshme për zbrapsjen e sulmit - Për t'u konsideruar një mbrojtje si mbrojtje e nevojshme, ajo duhet të jetë domosdo e nevojshme që personi prej vetes apo tjetrit të zbraps sulmin. Një mbrojtje konsiderohet e nevojshme në rastet kur konstatohet se nuk ka mundur të zbrapsset sulmi pa iu shkaktuar ndonjë dëmtim sulmuesit. Se a ka qenë mbrojtja domosdo e nevojshme, është çështje faktike, të cilën e konstatojnë gjykata apo prokurori i shtetit në çdo rast konkret.

Mirëpo, edhe pse në të drejtën penale kërkohet që mbrojtja të jetë domosdo e nevojshme, kjo nuk do të thotë se personi i cili është sulmuar është i detyruar që të ikë, të fshihet nga sulmuesi, t'i shmanget rrugës në të cilën është duke pritur sulmuesi, që ta thirrë dikë në ndihmë etj. Gjithashtu, nga i sulmuari nuk kërkohet që duke i sakrifikuar disa të mira të veta, ta evitojë sulmin.

c) Mbrojtja duhet të jetë proporcionale me intensitetin e sulmit - Për të qenë mbrojtja domosdo e nevojshme, duhet që të ekzistojë një proporcionalitet (përpjesëtuueshmëri) midis intensitetit të sulmit dhe mbrojtjes. Përmes kushtit që mbrojtja duhet të jetë proporcionale me intensitetin e sulmit janë vënë kufijtë e mbrojtjes së nevojshme. Sipas këtij kushti, mbrojtja duhet të jetë e natyrës dhe e intensitetit të tillë e cila është e mjaftueshme që të zbrapsset sulmi. Masa dhe intensiteti i lejueshmërisë së mbrojtjes varet p.sh. prej qëllimit të sulmuesit, mjeteve që i përdorë me rastin e sulmit, forcës fizike të sulmuesit, cilësive të sulmuesit, mjeteve që posedon i sulmuari etj. Nëse i sulmuari ka mundësi dhe kohë që të zgjedhë mënyrën dhe mjetet për mbrojtje, ai duhet të përdorë atë mënyrë dhe ato mjete të cilat sulmuesit i shkaktojnë lëndime më të lehta apo dëmtime më të vogla.

2.1.3 Tejkalmimi i kufijve të mbrojtjes së nevojshme

Tejkalmimi i kufijve të mbrojtjes së nevojshme shprehet në rastet kur mbrojtja nuk është proporcionale me sulmin apo kur mbrojtja ndërmerret pasi që është zbrapsur ose ka pushuar së vepruari sulmi.

Shembuj kur mbrojtja nuk është proporcionale me intensitetin e sulmit

- Në rastin kur një person madhor i zhvilluar fizikisht e privon nga jeta fëmijën e moshës pesë vjeçare, duke e goditur me sopat disa herë.

Shembuj kur mbrojtja është ndërmarrë pasi që sulmi është zbrapsur

- Në rastin kur i sulmuari ka sukses që t'ia thyejë dorën dhe t'ia marrë thikën sulmuesit, e mandej po me atë thikë i shkakton plagë vdekjeprurëse.

Shembuj kur sulmi ka pushuar së vepruari

- Në rastet kur sulmuesi pasi që i shkakton disa të qëlluara të sulmuarit, e ndërpret veprimin dhe fillon të tërhiqet, kurse i sulmuari vrapon në drejtim të tij dhe i shkakton lëndime të rënda trupore apo e privon nga jeta.

Lidhur me situatat e këtilla, në paragrafin 3 të nenit 12 të KPRK, është parashikuar se disproporcioni ndërmjet sulmit dhe zbrapsjes së sulmit konsiderohet tejkalim i kufijve të mbrojtjes së nevojshme. Në të gjitha këto raste kur i sulmuari i tejkalon kufijtë e mbrojtjes së nevojshme, çdo dëmtim që i shkakton sulmuesit konsiderohet vepër penale dhe personi i këtillë përgjigjet penalisht sikur për çdo vepër tjetër penale.

Mirëpo, edhe pse vepra (dëmtimi) që kryhet me rastin e tejkalimit të mbrojtjes së nevojshme konsiderohet vepër penale, në KPRK është parashikuar mundësia që kryesi i veprës penale të këtillë të dënohet më lehtë, madje edhe të lirohet nga dënimi. Një gjë e tillë është parashikuar në mënyrë shprehimore në paragrafin 4 të nenit 12 të KPRK, në të cilën është parashikuar se kryesi i cili i tejkalon kufijtë e mbrojtjes së nevojshme mund të dënohet më lehtë. Nëse kryesi tejkalon kufijtë për shkak të tronditjes së fortë apo frikës së shkaktuar nga sulmi, ai mund të lirohet nga dënimi.

2.1.4. Nevoja ekstreme

Sipas nenit 13 paragrafi 2 të KPRK, nevoja ekstreme ekziston nëse personi e kryen veprën për të zbrapsur prej vetes ose tjetrit rrezikun e atëçastshëm e të paprovokuar, i cili nuk mund të evitohet në mënyrë tjetër, me kusht që e keqja e shkaktuar të mos jetë më e madhe se e keqja që është kanosur. Ndërsa, në paragrafin 1 të nenit 13 të KPRK, është parashikuar në mënyrë shprehimore se vepra e kryer në kushtet e nevojës ekstreme nuk është vepër penale. Andaj, nevoja ekstreme është rrethanë apo shkak i dytë që e përjashton kundërligjshmërinë e veprës, edhe pse vepra e kryer përmban të gjitha tiparet e veprës penale.

Nevoja ekstreme, për nga natyra dhe efekti i saj juridiko-penal, është shkak i përgjithshëm që përjashton kundërligjshmërinë, përkatësisht ekzistimin e veprës penale. Arsyeshmërinë e njohjes së nevojës ekstreme në të drejtën penale e determinojnë rastet që mund të ndodhin në jetën e përditshme. Rrjedhimisht, në bashkëndodhje të rrethanave të ndryshme, mund të krijohen aso gjendje apo situata të rrezikshme, të cilat mund të mënjanohen vetëm me dëmtimin apo asgjësimin e të mirave juridike të personave të tretë.

Shembuj të nevojës ekstreme

- mjeku që disponon me një aparat për reanimim, kurse ka dy pacientë në gjendje kritike, e përjashton njërin nga ata, që ta shpëtoj tjetrin⁶⁸;
- personi A me qëllim që ta shpëtojë jetën e fëmijës, depërton me dhunë në shtëpinë e personit B, të cilën e ka kapluar zjarri;
- gjatë shtatzënisë patologjike, mjeku e ka viktimizuar frytin për ta shpëtuar jetën e nënës;
- personi A e merr barkën e huaj me qëllim që ta shpëtojë jetën e fëmijës që është duke u fundosur në ujë;
- shoferi i cili me qëllim që ta shpëtojë jetën e fëmijës, i cili papritmas i del para automobilit, del në trotuar me ç'rast lëndon këmbësorin etj. Në teorinë e së drejtës penale përmenden edhe rastet shumë të rënda të nevojës ekstreme. Është i njohur rasti kur nga barka e fundosur në detin e hapur mbetet vetëm një dërrasë e cila mund ta mbajë vetëm një njeri, kurse duke u mbajtur në të mundohen të shpëtojnë dy persona, njëri e shtytë tjetrin, i cili mbytet duke mos pasur ku të mbahet, ndërsa ai që shtytë, e shpëton veten⁶⁹.

Duke u bazuar në nenin 13 paragrafi 2 të KPRK, te nevoja ekstreme duhet të shprehet **rreziku dhe mënjanimi i rrezikut**.

2.1.5. Rreziku

Rreziku përkufizohet si situatë në të cilën, në bazë të rrethanave ekzistuese objektive, me arsye supozohet se në çdo moment, aty për aty, mund të dëmtohet e mira juridike e personit fizik apo juridik. Me fjalë tjera, rreziku përkufizohet si gjendje e cila aty për aty dhe drejtpërdrejt mund ta dëmtojë apo ta asgjësojë të mirën juridike të personit fizik ose juridik.

Ndryshe nga mbrojtja e nevojshme, ku siç pamë, sulmi mund të vijë vetëm prej njeriut, te nevoja ekstreme, rreziku mund të jetë rezultat i shkaqeve të ndryshme. Kështu, p.sh. rreziku mund të vijë nga fuqitë dhe dukuritë natyrore, siç janë p.sh. vërshimet, rrufeja, tërmetet, acaret e mëdha, shembja e dheut, ortekët e bores, erërat e forta etj., sulmet e shtazëve apo egërsirave, prishja e pajisjeve teknike, siç është p.sh. prishja e mekanizmit frenues të automobilit, autobusit apo kamionit; veprimet apo sjelljet e njeriut që shkaktojnë zjarrin, rreziku në komunikacion, eksplozimet etj.

Kushtet që duhet të përmbushen me rastin e rrezikut janë :

a) Rreziku nuk duhet të jetë i provokuar apo i shkaktuar - Sipas këtij kushti, nuk mund të konsiderohet se personi i cili ka vepruar në nevojën ekstreme nëse me fajin e tij, me dashje apo nga pakujdesia, e ka shkaktuar rrezikun. P.sh. nëse personi A me dashje apo nga pakujdesia e shkakton zjarrin dhe duke u gjendur edhe vetë në rrezik, për ta shpëtuar veten e lëndon tjetrin; ose nëse personi A në vendin e banuar vozit me shpejtësi të madhe me ç'rast papritmas i del në rrugë fëmija, nuk mund të thirret në nevojën ekstreme nëse për ta shpëtuar fëmijën, del në

⁶⁸KAMBOVSKI, VLLADO, Vepra e cituar, f. 231.

⁶⁹SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 246.

trotuar dhe me atë rast u shkakton lëndime të rënda disa këmbësorëve. Gjithashtu, nuk konsiderohet se vepron në nevojën ekstreme shoferi i cili e di se automjetin nuk e ka në rregull dhe për t'i ikur ndeshjes, ngase nuk mund të frenojë, del në anën e kundërt të rrugës dhe këmbësorit të rastit i shkakton lëndime të rënda apo vdekjen⁷⁰.

Në rastet kur konstatohet se rreziku është shkaktuar nga vetë personi që gjendet në nevojën ekstreme, KPRK e bën dallimin lidhur me atë se a është shkaktuar rreziku me dashje apo nga pakujdesia. Nëse rreziku është shkaktuar nga pakujdesia, gjykata mundet që kryesin e tillë ta dënojë me dënim më të butë⁷¹.

b) Rreziku mund t'i kanoset çdo të mire juridike - Në KPRK nuk përcaktohen të mirat juridike që mund të rrezikohen. Mirëpo, parimisht rreziku mund t'i kanoset çdo të mire juridike që është e mbrojtur me sistemin juridik, mirëpo në praktikë rreziku më së shpeshti është i drejtuar kundër jetës, trupit, shëndetit, lirisë, pasurisë etj.

c) Rreziku duhet të jetë i vërtetë - Rreziku konsiderohet se është i vërtetë në rastet kur ai realisht ekziston, përkatësisht është objektiv. Rreziku është i vërtetë apo real kur ka filluar të veprojë apo në çdo moment pritet të veprojë. Nëse personi gabimisht mendon se ekziston rreziku për ndonjë të mirë të tij apo të ndonjë personi tjetër, atëherë është fjala për të ashtuquajturën *nevojë ekstreme putative* apo *nevojë ekstreme fiktive*. Nevoja ekstreme putative apo fiktive do të ekzistonte p.sh. nëse ndonjë person ka menduar se është duke ndodhur tërmeti dhe duke ikur e ka lënduar tjetrin ose ia ka dëmtuar tjetrit pasurinë.

2.1.6. Mënjanimi i rrezikut

Mënjanim i rrezikut konsiderohet veprimi që ndërmerret me qëllim që të shpëtohet e mira juridike së cilës i kanoset rreziku.

Kushtet që duhet përmbushur me rastin e mënjanimit të rrezikut janë:

a) Që rreziku të mos ketë pasur mundësi të mënjanohet në ndonjë mënyrë tjetër - Për t'u konsideruar se ekziston nevoja ekstreme duhet të konstatohet se në rastin konkret rreziku nuk ka mundur të mënjanohet pa u dëmtuar apo asgjësuar e mira juridike e personit tjetër. Nëse në rastin konkret konstatohet se rreziku ka mundur të mënjanohet në ndonjë mënyrë tjetër, p.sh. duke ikur, duke thirrur në ndihmë, duke u larguar nga vendi i ngjarjes etj., kurse personi nuk i ka shfrytëzuar këto mundësi, atëherë rrezikun e ka mënjanuar duke e dëmtuar të mirën juridike të personit tjetër. Në raste të këtilla nuk do të ekzistojë nevoja ekstreme, ngase rreziku ka mundur që të mënjanohet në ndonjë mënyrë tjetër.

b) Mënjanimi i rrezikut duhet të jetë i atëçastshëm - Konsiderohet se rreziku është i atëçastshëm në rastet kur veprimi me të cilin mënjanohet rreziku është ndërmarrë gjatë kohës

⁷⁰SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 250; ELEZI, ISMET-KAÇUPI, SKËNDER-HAXHIA, MAKSIM, Vepra e cituar, f. 149; KAMBOVSKI, VLLADO, Vepra e cituar, f. 231.

⁷¹ Neni 13 paragrafi 3 i KPRK.

kur vepron rreziku ose kur pritet që rreziku të fillojë apo të paraqitet në çdo moment. Nëse dëmtimi i të mirës juridike është bërë para se të paraqitet rreziku ose pasi që ai ka pushuar, atëherë të gjitha dëmtimet e të mirave juridike paraqesin keqpërdorimin e këtij institucioni dhe veprimet e këtilla konsiderohen vepra penale.

c) Në mes të keqes së kanosur dhe të keqes së shkaktuar duhet të ekzistojë proporcionaliteti i caktuar - Për të ekzistuar nevoja ekstreme duhet që në mes të keqes së kanosur dhe të keqes së shkaktuar të ekzistoj proporcionaliteti.

2.1.7. Tejkalimi i nevojës ekstreme

Tejkalimi i nevojës ekstreme shprehet në rastet kur mënjanimi i rrezikut nuk është bërë në pajtim me kushtet që janë përcaktuar me KPRK. Përkatësisht, tejkalimi apo siç quhet ndryshe ekcesi i nevojës ekstreme shprehet në këto raste:

- a) kur e keqja e shkaktuar është më e madhe se e keqja e kanosur;
- b) kur rreziku ka mundur të mënjanohet duke e dëmtuar në përmasa më të vogla të mirën juridike të personit tjetër dhe
- c) kur dëmtimi i të mirës juridike të personit tjetër është bërë pasi që ka pushuar, pasi që ka kaluar rreziku.

Vepra e cila kryhet me rastin e tejkalimit të kufijve të nevojës ekstreme konsiderohet vepër penale.

Nëse tejkalimi i nevojës ekstreme është bërë me dashje, kryesi do të dënohet për vepër penale të kryer me dashje, kurse nëse tejkalimi i nevojës ekstreme është bërë nga pakujdesia, kryesi do të dënohet vetëm po qe se ligji në mënyrë shprehimore parashikon përgjegjësi penale edhe kur vepra është kryer nga pakujdesia. Mirëpo, meqë në të shumtën e rasteve rreziku që paraqitet me rastin e nevojës ekstreme ushtron presion në gjendjen psikike të kryesit, ligjdhënësi me arsye ka parashikuar mundësinë e zbutjes së dënimit për veprat penale që kryhen në tejkalimin e nevojës ekstreme. Madje, KPRK ka parashikuar mundësinë edhe të lirimit nga dënimi, nëse konstatohet se kapërcimi i kufijve të nevojës ekstreme është bërë në rrethana veçanërisht lehtësuese⁷².

2.1.8. Dhuna ose kanosja

Dhuna dhe kanosja janë parashikuar në mënyrë shprehimore si rrethana të cilat e përjashtojnë kundërligjshmërinë. Kështu, në paragrafin 1 të nenit 14 të KPRK, është parashikuar se vepra e kryer nën ndikimin e dhunës së papërballueshme ose kanosjes së papërballueshme nuk është vepër penale vetëm nëse personi menjëherë pas pushimit të rrezikut e lajmëron shtërëngimin dhe veprën e kundërligjshme tek organet kompetente. Dhuna nënkupton përdorimin e forcës

⁷² Neni 13 paragrafi 3 i KPRK.

ndaj një personi me qëllim që të detyrohet të ndërmarrë apo të mos ndërmarrë një veprim, me të cilin realizohen tiparet e një veprë penale. Përveç kësaj, si dhunë apo forcë duhet konsideruar edhe zbatimi i hipnozës ose të mjeteve të tjera dehëse me qëllim të vënies së personit kundër dëshirës së vet në gjendje të pavetëdijshme apo të paaftësohet për rezistencë⁷³.

Duke u bazuar në dispozitën e lartcekur ligjore, dhuna konsiderohet si rrethanë, e cila përjashton ekzistimin e veprës penale në rastet kur kryesi e ka detyruar personin tjetër që të ndërmarrë një veprim apo mosveprim të caktuar dhe nëse ajo ka qenë e papërballueshme. Dhuna konsiderohet e papërballueshme atëherë kur personi nuk ka pasur mundësi t'i kundërvihet asaj dhe kështu nuk ka mundur të veprojë ndryshe. Nga kjo rrjedh se çdo lloj dhune nuk e përjashton fajësinë, së këndejmi as veprën penale, por vetëm dhuna e cila ka qenë e papërballueshme.

Dhuna mund të jetë **absolute** dhe **relative**.

- a) **Dhuna absolute** është ajo dhunë me të cilën personi në tërësi, në mënyrë absolute, është i privuar që lirisht të vendosë për sjelljen e vet.

Shembuj të dhunës absolute

Nëse personi A e lidh punëtorin e autorizuar të hekurudhës, i cili për këtë shkak kurrsesi nuk mund të japë sinjal për ndaljen e trenit dhe kështu shkaktohet ndeshja e trenave, me ç'rast shkaktohen viktima në njerëz dhe dëme të mëdha materiale.

Nga ky shembull shihet se kryesi i drejtpërdrejtë i veprës penale, për shkak të dhunës absolute që është zbatuar ndaj tij, nuk ka pasur mundësi që, sipas vullnetit të tij, t'i ndërmarrë masat e duhura për të parandaluar shkaktimin e pasojave të dëmshme. Dhuna absolute do të ekzistojë edhe në rastin kur një person e hipnotizon tjetrin ose e detyron me dhunë që të konsumojë alkool ose ndonjë mjet tjetër dehës dhe pasi që e bën plotësisht të pavetëdijshëm, kërkon prej tij që ta kryejë një veprë penale dhe ky duke qenë plotësisht i pavetëdijshëm vepron sipas kërkesës së dhunuesit⁷⁴.

- b) **Dhuna relative** shprehet në rastet kur personi ndaj të cilit është drejtuar dhuna, nuk privohet në tërësi nga mundësia për të vendosur, mirëpo dhuna që zbatohet bën presion dhe ka një intensitet të tillë që e shtrëngon të ndërmarrë apo të mos ndërmarrë veprimin e caktuar

Shembuj të dhunës relative

- Nëse personi A ia drejton revolen zyrtarit i cili punon në arkën e bankës dhe kërkon prej tij që t'ia dorëzojë të hollat nga arka.

Ndryshe nga dhuna absolute, e cila është e drejtuar vetëm ndaj personit që duhet të ndërmarrë veprimin, pra është gjithherë e drejtpërdrejtë, dhuna relative mund të jetë e drejtpërdrejtë ose e

⁷³ Neni 113 paragrafi 15 i KPRK.

⁷⁴ SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 254.

tërthortë. Dhuna relative është e drejtpërdrejtë në rastet kur përdoret ndaj personit i cili detyrohet të veprojë apo të mosveprojë, kurse dhunë relative e tërthortë është në rastet kur p.sh., ndërmerret ndaj fëmijës në mënyrë që të detyrohet prindi i tij të kryejë ndonjë veprim; nëse ndërmerret ndaj pasurisë, me qëllim që pronari kundër vullnetit të tij të ndërmarrë ndonjë veprim të cilin dhunuesi e kërkon prej tij etj.

Përveç dhunës, edhe kanosja konsiderohet rrethanë e cila e përjashton ekzistimin e veprës penale, nëse plotësohen kushtet e parashikuara me nenin 14 të KPRK. Kanosja është deklaratë apo ndonjë veprim tjetër, me të cilin i bëhet e ditur ndokujt se do ta gjejë një e keqe, nëse nuk vepron ashtu si dëshiron personi që kanoset. Kanosja është një lloj presioni, një lloj dhune psikike, me të cilën ndikohet mbi vullnetin e personit tjetër që të ndërmarrë një veprim i cili ka tiparet e veprës penale. Personi ndaj të cilit është e drejtuar kanosja gjendet para alternativës të kryejë veprimin e caktuar ose të pranojë ta godasë e keqja që i kanoset⁷⁵.

Kanosja në shumicën e rasteve kryhet në mënyrë verbale, me gojë, me anë të deklaratave të ndryshme, mirëpo, ajo mund të kryhet edhe me shkrim, me dërgimin e mesazheve telefonike, me e-mail, përmes facebook-ut apo rrjeteve tjera sociale (instagram, twitter, snapchat, etj.) ose me veprime konkludente. Për ekzistimin e kanosjes nuk është e domosdoshme që personi që kanos të mendojë seriozisht ta realizojë kanosjen. Madje nuk kërkohet që të ekzistojnë as mundësitë reale për realizimin e kanosjes. Kanosja do të konsiderohet se ekziston, nëse personi ndaj të cilit është e drejtuar ajo, në bazë të rrethanave të situatës konkrete, të formojë bindjen se vërtet do të realizohet kanosja.

Edhe kanosja, ngjashëm sikur dhuna, duhet të jetë e papërballueshme.

Përveç kësaj, për t'u përjashtuar kundërligjshmëria dhe fajësia tek veprat e kryera nën ndikimin e dhunës ose të kanosjes, duhet që personi menjëherë pas pushimit të rrezikut të lajmërojë dhunën ose kanosjen dhe veprën e kundërligjshme tek organet kompetente. Organe kompetente, në kuptim të kësaj dispozite ligjore konsiderohen Policia e Republikës së Kosovës, Prokurori i Shtetit etj.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, në mënyrë që dhuna ose kanosja ta përjashtojë kundërligjshmërinë, atëherë duhet që në mënyrë kumulative të plotësohen këto kushte:

1. Vepra të jetë kryer nën ndikimin e dhunës apo kanosjes;
2. Që dhuna ose kanosja të jenë të papërballueshme dhe
3. Personi menjëherë pas pushimit të rrezikut ta lajmërojë dhunën ose kanosjen dhe veprën e kundërligjshme tek organet kompetente.

Në paragrafin 2 të nenit 14 të KPRK, është parashikuar se nëse vepra penale është kryer nën ndikimin e dhunës së përballueshme apo kanosjes së përballueshme, dënimi mund

⁷⁵*Idem*, f. 258.

të zbutet vetëm nëse personi menjëherë pas pushimit të rrezikut e lajmëron shtrëngimin dhe veprën e kundërligjshme tek organet kompetente.

Kurse, në paragrafin 3 të këtij neni, është parashikuar se kushdo që përdor dhunën ose kanosjen sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni konsiderohet kryes i veprës penale.

2.1.9. Vepra e rëndësisë së vogël

Instituti i veprës së rëndësisë së vogël është parashikuar në nenin 11 të KPRK. Sipas kësaj dispozite ligjore, nuk përbën vepër penale ajo vepër e cila edhe pse përmban tiparet e veprës penale të përcaktuar me ligj, paraqet vepër të rëndësisë së vogël. Vepra është e rëndësisë së vogël kur rrezikshmëria e saj është e parëndësishme për shkak të natyrës ose peshës së veprës; mungesës ose pasojave të dëmshme të parëndësishme; rrethanave në të cilat është kryer vepra; shkallës së ulët të përgjegjësisë penale të kryesit; ose rrethanave personale të kryesit.

Shembuj të veprës së rëndësisë së vogël

- Nëse personi A vjedh në ndonjë market një çokollatë apo një fletore etj.

Në veprimin e personit A janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale të vjedhjes, nga neni 313 të KPRK, mirëpo, meqë shkalla e rrezikshmërisë së kësaj vepre është e parëndësishme, tejet e imët, kjo vepër nuk konsiderohet si vepër penale, ngase kjo vepër apo veprat e ngjashme e humbasin karakterin kriminal. Mirëpo, edhe pse vepra me rëndësi të vogël, e cila përmban në vete një shkallë të ulët rrezikshmërie, nuk konsiderohet vepër penale, ajo megjithatë mbetet vepër e kundërligjshme, por jo për të drejtën penale, por për ndonjë degë tjetër të së drejtës, p.sh. si kundërvajtje apo delikt disiplinor etj.

Për t'u konsideruar një vepër si vepër me rëndësi të vogël, janë vendimtare të gjitha elementet objektive dhe subjektive që e përbëjnë figurën e veprës penale të kryer. Këto elemente janë, p.sh., mënyra e kryerjes së veprës, vendi i kryerjes, koha e kryerjes, mjetet që janë përdorë me rastin e kryerjes, forma e fajësisë, marrëdhënia e kryesit dhe viktimës, qëllimi i kryesit, jeta e tij e mëparshme dhe rrethanat e ngjashme.

Duke u bazuar në nenin 11 të KPRK, për të ekzistuar vepra e rëndësisë së vogël duhet që të përmbushen në mënyrë kumulative dy kritere:

1) që vepra, e cila i ka të gjitha tiparet e veprës penale të përcaktuara me ligj, të ketë rrezikshmëri të vogël, të parëndësishme (kriteri objektiv) dhe

2) që rëndësia e vogël e veprës të shfaqë një shkallë të ulët të përgjegjësisë penale të kryesit apo rrethanave të tij personale (kriteri subjektiv).

2.1.10 vepra e kryer nën shtrëngim

Në paragrafin 1 të nenit 15 të KPRK, është parashikuar se vepra e kryer nën shtrëngim nuk është vepër penale.

Sipas paragrafit 2 të nenit 15 të KPRK, vepra kryhet nën shtrëngim kur personi i ballafaquar me dhunën e pashmangshme apo kanosjen e dhunës që nuk mund të shmanget e që rrezikon jetën, trupin ose lirinë, kryen veprën të kundërligjshme për të mënjeluar rrezikun nga vetja ose personi tjetër. Vepra do të konsiderohet se është kryer nën shtrëngim vetëm nëse personi menjëherë pas pushimit të rrezikut e lajmëron shtrëngimin dhe veprën e kundërligjshme tek organet kompetente.

Duke u bazuar në dispozitën e lartcekur ligjore, për të qenë shtrëngimi relevant, duhet që në mënyrë kumulative të plotësohen këto kushte:

1. Duhet që personi të jetë ballafaquar me dhunën e pashmangshme apo kanosjen e dhunës që nuk mund të shmanget;
2. Dhuna e pashmangshme ose kanosja e pashmangshme të rrezikojë jetën, trupin ose lirinë e personit ose ndonjë personi tjetër me të cilin ka lidhje familjare;
3. Që personi ta kryejë veprën e kundërligjshme me qëllim që ta mënjanojë rrezikun e lartcekur dhe
4. Që personi menjëherë pas pushimit të rrezikut ta lajmërojë shtrëngimin dhe veprën e kundërligjshme tek organet kompetente.

Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 15 të KPRK, është parashikuar se vepra nuk kryhet nën shtrëngim deri në masën që nga kryesi mund të pritët në rrethanat e shkaktuara që të pranojë rrezikun, në veçanti nëse ai ka shkaktuar rrezikun ose nëse ka qenë i detyruar ligjërisht që të ballafaqohet me një dhunë të tillë të atëçastshme apo me kërcënim të dhunës. Në rrethana të tilla dënimi mund të zbutet.

2.1.11 Urdhrat nga lart

Sipas rregullit, në rastet kur personi në një shërbim të caktuar administrativ, policor, ushtarak etj. kryen një veprim në bazë të urdhrit qeveritar ose të një eprori, qoftë ushtarak ose civil, veprim ky që është i parashikuar si veprë penale, personi i këtillë do të konsiderohet penalisht përgjegjës dhe do të dënohet. Me fjalë tjera, kur vepra penale është kryer nga një person në bazë të një urdhri qeveritar ose të një eprori, qoftë ushtarak ose civil, kryesi nuk lirohet nga përgjegjësia penale. Një gjë e tillë është parashikuar në mënyrë shprehimore në nenin 16 paragrafi 1 të KPRK. Mirëpo, në këtë dispozitë ligjore është parashikuar situata kur personi lirohet nga përgjegjësia penale për një veprë penale të kryer në bazë të një urdhri qeveritar ose të një eprori, qoftë ushtarak ose civil, nëse përmbushen këto tri kushte në mënyrë kumulative:

1. Personi ka qenë i detyruar ligjërisht që t'i bindet urdhrit të tillë;
2. Personi nuk e ka ditur se urdhri i tillë ka qenë i paligjshëm dhe
3. Urdhri i tillë nuk ishte në mënyrë të dukshme i paligjshëm.

Në paragrafin 2 të nenit 16 të KPRK, është parashikuar se urdhrat për të kryer gjenocid ose krime të tjera kundër njerëzimit janë të paligjshëm në të gjitha rrethanat.

3. Shkaqet të cilat e përjashtojnë kundërligjshmërinë sipas pjesës së posaçme të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Në disa dispozita të pjesës së posaçme të KPRK janë të parashikuara disa shkaqe apo rrethana të cilat e përjashtojnë kundërligjshmërinë e disa veprave penale, dispozita këto të cilat ndryshe emërtohen si **norma speciale permissive**. Në pjesën e posaçme të KPRK, shkaqet e posaçme që përjashtojnë kundërligjshmërinë janë të parashikuara në nenet 178, 187, 200, 202, 377, 378, 379, 380, 381 etj.

Kështu, në nenin 178 të KPRK, është parashikuar si vepër penale ndërprerja e palejuar e shtatzënësisë. Mirëpo, në nenin 15 dhe 16 të Ligjit për Ndërprerjen e Shtatzënësisë⁷⁶, të cilave i referohet kjo dispozitë ligjore e KPRK, janë caktuar dy grupe të arsyeve apo shkaqeve për të cilat mund të bëhet ndërprerja e shtatzënësisë⁷⁷ dhe atë:

- 1) Arsyet mjekësore dhe
- 2) Arsyet kriminologjike.

1) **Ndërprerja e shtatzënësisë për arsye mjekësore** mund të bëhet në çdo periudhë të shtatzënësisë, me vendimin e komisionit mjekësor dhe me pëlqimin e femrës shtatzënë përderisa ajo është e vetëdijshme, në rastet kur konstatohet se vazhdimi i shtatzënësisë ose lindja e fëmijës rrezikon jetën ose shëndetin e femrës, si dhe kur vërtetohet se fetuesi ka keqformime të papajftueshme me jetën, sëmundje ose gjendje të rënda që lënë invaliditet të rëndë dhe kanë trajtim të pasigurt.

2) **Ndërprerja e shtatzënësisë për arsye kriminologjike** mund të bëhet deri në javën e njëzetedytë të shtatzënësisë dhe te lindja e indukuar edhe më vonë me rekomandimin mjekësor dhe pas konfirmimit nga institucionet kompetente të cilat janë të autorizuar të përcaktojnë nëse shtatzënësia është pasojë prej njëres nga veprat penale në vijim:

- a) dhunimit;
- b) marrëdhënieve të padëshiruara të femrave të cilat janë viktima të trafikimit dhe shfrytëzimit seksual të detyruar ose
- c) marrëdhënies seksuale me të mitur ose incestit.

Andaj, nëse ndërprerja e shtatzënësisë është bërë për shkaqet e përmendura nuk konsiderohet vepër penale, pra bëhet përjashtimi i kundërligjshmërisë së kësaj vepre.

Te vepra penale pjesëmarrja në rrahje, nga neni 187 i KPRK, personi nuk konsiderohet penalisht përgjegjës nëse ka marrë pjesë në rrahje pa fajin e tij ose thjesht për të mbrojtur vetën apo për t'i ndarë pjesëmarrësit e tjerë në rrahje.

⁷⁶Ligji Nr.03/L-110 Për Ndërprerjen e Shtatzënësisë, i datës 6.11.2008 (në tekstin e mëtejshëm LNSH).

⁷⁷SHALA, AFRIM, Vepra e cituar, f. 104.

Personi nuk konsiderohet penalisht përgjegjës, te vepra penale zbulimi i paautorizuar i informacionit konfidencial, nga neni 200 i KPRK, nëse ai e ka zbuluar informacionin konfidencial për interes publik, nëse interesi i tillë peshon më shumë se sa moszbulimi i informacionit konfidencial.

Gjithashtu, te vepra penale fotografimi dhe incizimet tjera të paautorizuar, nga neni 202 i KPRK, personi nuk ka përgjegjësi penale, nëse fotografimi ose incizimi bëhet me qëllim të zbulimit të veprës penale dhe të kryesit të veprës penale ose për t'i paraqitur si dëshmi në polici, prokurori ose në gjykatë dhe nëse fotografitë dhe incizimet u dorëzohen këtyre organeve.

Pastaj, te vepra penale moslajmërimi i përgatitjes së veprave penale, nga neni 377 i KPRK, me përjashtim të veprave penale që përfshijnë abuzimin e fëmijëve dhe dhunën në familje, personi nuk është penalisht përgjegjës sipas paragrafit 1 të këtij neni, nëse është në lidhje familjare me kryesin e veprës penale si prind, fëmijë, bashkëshort ose bashkëshorte, vëlla ose motër, prind adoptues apo fëmijë i adoptuar ose person me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore.

Të gjitha dispozitat e lartcekura ligjore, konsiderohen **norma të posaçme permissive**, ngase nën rrethanat e caktuara, e përjashtojnë kundërligjshmërinë e këtyre veprave penale.

4. Shkaqet e përjashtimit të kundërligjshmërisë të cilat nuk janë të parashikuara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës

Shkaqet dhe rrethanat e përjashtimit të kundërligjshmërisë, të cilat nuk janë të parashikuara në KPRK, janë relativisht të shumta dhe të natyrave të ndryshme. Në këtë grup të shkaqeve që e përjashtojnë kundërligjshmërinë bëjnë pjesë:

- 1) veprimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare;
- 2) rreziku i lejuar;
- 3) veprat e kryera në bazë të së drejtës prindërore dhe të drejtës së edukimit;
- 4) intervenimet mjekësore;
- 5) pëlqimi i të dëmtuarit,
- 6) veprimi në interes të të dëmtuarit dhe “pëlqimi i supozuar”, si dhe
- 7) vetëlëndimi.

KAPITULLI III

PËRGJEGJËSIA PENALE

I. NOCIONI DHE ELEMENTET E PËRGJEGJËSISË PENALE

1. Shqyrtime të përgjithshme

Përgjegjësia penale është element i përgjithshëm i veprës penale. Në të drejtën penale, një person konsiderohet penalisht i përgjegjshëm nëse në kohën e kryerjes së veprës penale ka poseduar cilësi të caktuara psikike dhe nëse tek ai ka ekzistuar një marrëdhënie e caktuar psikike ndaj veprës të cilën e ka kryer. Me fjalë të tjera, një person konsiderohet penalisht i përgjegjshëm, nëse në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm dhe i fajshëm.

Duke u bazuar në këtë që u tha më lartë, del se përgjegjësia penale përbëhet nga këto dy elemente:

1. Nga vetitë e caktuara psikike të kryesit (nga përgjegjshmëria) dhe
2. Nga qëndrimi apo marrëdhënia e kryesit ndaj veprës që e ka kryer (nga fajësia)⁷⁸.

Pra, përgjegjësia penale në të drejtën penale përbëhet prej përgjegjshmërisë dhe fajësisë. Një person konsiderohet i përgjegjshëm, atëherë kur posedon ato veti apo cilësi psikike që i bëjnë të mundur të kuptojë rëndësinë e veprës dhe t'i kontrollojë sjelljet e veta. Ndërsa, një person konsiderohet i fajshëm atëherë kur ndaj veprës penale të kryer, ka pasur qëndrim apo raport të caktuar i cili bën të mundshme që t'i ngarkohet vepra, përkatësisht kur veprën e konsideron si të veten. Nga kjo rezulton se, për të ekzistuar përgjegjësia penale, kryesi duhet të jetë i përgjegjshëm dhe i fajshëm. Përgjegjshmëria dhe fajësia, si elemente përbërëse të përgjegjësisë penale, janë të lidhura ngushtë midis tyre. Në këtë aspekt, nëse një person nuk është i përgjegjshëm, nuk është i aftë të kuptojë rëndësinë e veprës dhe t'i kontrollojë sjelljet e veta, atëherë nuk mund të konsiderohet i fajshëm. Kjo për faktin se përgjegjësia është bazë, themel mbi të cilën ndërtohet dhe mbështetet fajësia.

Në nenin 17 paragrafi 1 të KPRK është parashikuar se kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia. Siç shihet nga kjo dispozitë ligjore, KPRK nuk përdor termin fajësi, por përdor dy format e fajësisë - dashjen dhe pakujdesinë, me të cilat njëherësh përcakton edhe shkallën e intensitetit të fajësisë së kryesit të veprës penale. KPRK i shmanget përdorimit të termit fajësi, për shkak se këtij termi apo nocioni në teorinë e së drejtë penale, varësisht prej autorëve, i jepet kuptim dhe rëndësi e ndryshme.

⁷⁸SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 276.

Për t'u konsideruar një person penalisht i përgjegjshëm dhe që të mund t'i shqiptohet dënimi, ai duhet që në kohën, përkatësisht në momentin e kryerjes së veprës penale, të ketë qenë i përgjegjshëm dhe i fajshëm. Pra, përgjegjshmëria dhe fajësia duhet të konstatohen në momentin e kryerjes së veprës penale.

2. Nocioni dhe elementet e përgjegjshmërisë penale

Siç është theksuar edhe më lart, për t'u konsideruar një person penalisht i përgjegjshëm dhe për të mundur të ndëshkohet për veprën e kryer, ai duhet të jetë i përgjegjshëm. Pra, përgjegjshmëria është element i përgjegjësisë penale. Në të drejtën penale një person konsiderohet i përgjegjshëm nëse posedon veti apo aftësi intelektuale (mendore) dhe volitive që i bënë të mundur të mendojë, të gjykojë, të vendosë dhe t'i kontrollojë sjelljet dhe veprimet e veta. Me fjalë të tjera, një person konsiderohet i përgjegjshëm kur është në gjendje psikike të kuptojë, është i vetëdijshëm për rëndësinë dhe pasojën e veprës që e kryen dhe është në gjendje t'i kontrollojë sjelljet e veta. Pra, njeriu konsiderohet i përgjegjshëm kur është në gjendje psikike normale, gjendje kjo që i mundëson atij që veprën ta kryejë me vetëdije dhe vullnet.

Nga kjo që u tha më lart rezulton se përgjegjshmëria përbëhet prej dy elementeve:

- 1) Elementit intelektual apo të vetëdijes dhe
- 2) Elementit volitiv apo të dëshirës.

Në të drejtën penale, elementi i intelektit apo aftësia intelektuale ekziston atëherë kur kryesi i veprës penale është i aftë të kuptojë rëndësinë e veprës së vet, të ketë pasqyrë (përfytyrim) të qartë se është duke kryer një vepër të rrezikshme dhe të kundërligjshme.

Kurse, elementi volitiv apo elementi i dëshirës, përkatësisht vullnetit, ekziston atëherë kur personi është në atë gjendje apo ka aftësi psikike të vendosë dhe t'i kontrollojë sjelljet e veta. Pra, aftësia psikike e personit që i bën të mundshme vullnetarisht të vendosë për të kryer një vepër dhe aftësia për t'i kontrolluar sjelljet e veta, është element volitiv ose element i vullnetit - dëshirës.

Për të qenë penalisht përgjegjës, përveç tjerash, duhet që personi në kohën e kryerjes së veprës penale të ketë arritur moshën katërbëdhjetë vjet. Një gjë e tillë është parashikuar në nenin 17 paragrafi 3 të KPRK. Sipas kësaj dispozite ligjore, personi nuk është penalisht përgjegjës nëse në kohën e kryerjes së veprës penale është nën moshën 14 (katërbëdhjetë) vjet.

3. Nocioni i papërgjegjshmërisë penale dhe shkaqet të cilat e bëjnë një person të papërgjegjshëm

Në nenin 18 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se personi i cili ka kryer vepër penale konsiderohet i paaftë mendërisht nëse në kohën e kryerjes së veprës penale lëngonte nga një sëmundje mendore e përkohshme ose e përhershme, nëse kishte çrregullim mendor apo ngecje në zhvillimin mendor që e ka prekur funksionimin e tij mendor dhe si pasojë e kësaj, nuk ka

qenë në gjendje të kuptojë natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimeve ose mosveprimeve të tij, ose nuk ka qenë në gjendje t'i kontrollojë veprimet ose mosveprimet e tij apo të kuptojë se kryer vepër penale.

Sipas kësaj dispozite ligjore, ekzistojnë tri lloje apo grupe të sëmundjeve apo çrregullimeve psikike që mund ta bëjnë një person të papërgjegjshëm, edhe atë:

- 1) Sëmundjet mendore të përkohshme apo të përhershme;
- 2) Çrregullimet mendore dhe
- 3) Ngecjet në zhvillimin mendor.

Mirëpo, duhet të theksohet se çdo lloj i këtyre sëmundjeve apo çrregullimeve mendore nuk e bën kryesin e veprës penale të papërgjegjshëm, por vetëm nëse njëra prej këtyre sëmundjeve ka pasur efekt të caktuar në jetën psikike të njeriut, në atë mënyrë që personin e bën të paaftë për t'i kuptuar apo për t'i kontrolluar veprimet apo mosveprimet e tij ose për të kuptuar se është duke kryer vepër penale.

4. Përgjegjshmëria esencialisht e zvogëluar

Përgjegjshmëria dhe papërgjegjshmëria, janë dy gjendje të mundshme shpirtërore apo psikike të njeriut në përgjithësi dhe të kryesit të veprës penale në veçanti. Mirëpo, gjendja shpirtërore apo psikike e njeriut, përkatësisht sëmundjet mendore, çrregullimet mendore apo ngecja në zhvillimin mendor mund të jenë edhe me intensitet të tillë, të cilat personin nuk e bëjnë në tërësi të papërgjegjshëm, mirëpo personi i tillë, megjithatë të mos jetë edhe në tërësi i përgjegjshëm. Në këto raste, sëmundja mendore, çrregullimi apo ngecja në zhvillimin mendor, vetëm në një masë apo pjesërisht, iu privon personave aftësinë që të kuptojnë rëndësinë e veprës dhe që t'i kontrollojnë sjelljet e tyre. Në të drejtën penale, kjo gjendje e njeriut ndryshe quhet edhe si **përgjegjshmëri esencialisht e zvogëluar** apo **aftësi e zvogëluar mendore**. Në nenin 18 paragrafi 2 të KPRK, është parashikuar përgjegjshmëria esencialisht e zvogëluar apo aftësia e zvogëluar mendore. Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se: “Personi i cili ka kryer vepër penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimeve ose mosveprimeve të tij ka qenë esencialisht e zvogëluar për shkaqet e cekura në paragrafin 1 të këtij neni (*Sëmundjet mendore të përkohshme apo të përhershme; çrregullimet mendore dhe ngecjet në zhvillimin mendor*). Personi i tillë konsiderohet penalisht përgjegjës, por këto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos mbi kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masën e trajtimit të detyrueshëm”.

Nga kjo dispozitë ligjore shihet se përgjegjshmëria esencialisht e zvogëluar është një gjendje e atillë e personit në kohën e kryerjes së veprës, nëse për shkak të sëmundjes mendore të përhershme ose të përkohshme, çrregullimit mendor apo ngecjes në zhvillimin mendor, aftësia e kryesit për të kuptuar rëndësinë e veprës ose aftësia për t'i kontrolluar sjelljet e veta ka qenë dukshëm apo esencialisht e zvogëluar.

Përgjegjshmërinë esencialisht të zvogëluar, mund ta shkaktojnë sëmundjet mendore, çrregullimet mendore dhe ngecjet në zhvillimin mendor, por të cilat nuk janë të asaj natyre dhe intensiteti që ta shpijnë personin në gjendje plotësisht të papërgjegjshme, mirëpo që personi nuk mund të konsiderohet edhe plotësisht i përgjegjshëm.

Sipas nenit 18 paragrafi 2 të KPRK, personi i cili veprën penale e kryen në gjendje të përgjegjshmërisë esencialisht të zvogëluar, konsiderohet penalisht përgjegjës, mirëpo këto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masën e trajtimit të detyrueshëm. Pra, përgjegjshmëria esenciale e zvogëluar nuk e përjashton përgjegjësinë penale dhe se këta persona konsiderohen penalisht të përgjegjshëm, mirëpo gjykata duhet që ta ketë në konsideratë këtë fakt me rastin e vendosjes për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masën e trajtimit të detyrueshëm.

II. F A J I

1. Nocioni dhe rëndësia e fajit në të drejtën penale

Siç është cekur më parë, për t'u konsideruar një person penalisht përgjegjës për veprën e kryer, ai duhet të jetë **i përgjegjshëm** dhe **i fajshëm**. Pra, përgjegjshmëria dhe fajësia janë elemente përbërëse të përgjegjësisë penale.

Për të mundur të dënohet një person për veprën e tij, nuk mjafton të ketë kryer vetëm vepër të kundërligjshme, që parashikohet me ligj si vepër penale, por ai atë vepër duhet ta ketë kryer me fajin e tij.

Sipas legjisllacioneve penale të shteteve bashkëkohore, në mungesë të fajit, nuk mund t'i shqiptohet dënimi kryesisht të veprës penale. Lidhur me këtë, në teorinë e së drejtës penale është i njohur parimi **“nullum crimen nulla poena sine culpa”** që në përkthim të drejtpërdrejt do të thotë **“nuk ka vepër penale dhe nuk ka dënim pa faj”**.

Faji është përgjegjësia personale e kryesisht për veprën e vet. Një person konsiderohet se veprën penale e ka kryer me faj në rastet kur ka ditur se me veprimin apo mosveprimin e tij do të shkaktojë pasojë të ndaluar në botën e jashtme, pasojë kjo që në ligj është e parashikuar si vepër penale dhe nëse ndaj pasojës - ndaj veprës, ka pasur aso marrëdhënie apo relacioni që ia bën të mundshme gjykatës t'ia ngarkojë atë vepër. Marrëdhënia apo relacioni psikik i kryesisht ndaj veprës në të drejtën penale quhet **fajësi**⁷⁹.

Nga ky përkufizim i fajit del se fajësia përfshin veprimin dhe pasojën e veprës penale. Për këtë shkak, në teorinë e së drejtës penale njihet:

- a) faji lidhur me veprimin dhe

⁷⁹SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 293.

b) faji lidhur me pasojën e veprës penale.

Në KPRK janë parashikuar dy forma kryesore të fajit:

- 1) Dashja (dolus) dhe
- 2) Pakujdesia (culpa).

Në nenin 22 të KPRK, është parashikuar se dijenia, dashja, pakujdesia ose qëllimi i kërkuar si element i veprës penale mund të nxirret nga rrethanat faktike.

2. Dashja

Sipas paragrafit 1 të nenit 21 të KPRK, vepra penale mund të kryhet me dashje direkte ose me dashje eventuale. Andaj, duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, dashja mund të jetë :

- a) Dashje direkte dhe
- b) Dashje eventuale.

Sipas paragrafit 2 të nenit 21 të KPRK, personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj, kurse sipas paragrafit 3 të këtij neni, personi vepron me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij dhe ai pranon shkaktimin e saj.

2.1. Dashja direkte

Siç është cekur edhe më lart, dashja direkte apo e drejtpërdrejtë (*dolus direktus*) ekziston atëherë kur kryesi është i vetëdijshëm se me veprimin apo mosveprimin e vet do të kryejë veprën të dëmshme (veprën penale) dhe dëshiron kryerjen e saj, dëshiron që të shkaktohet pasoja e ndaluar në botën e jashtme. Nga kjo shihet se, për t'u konsideruar se personi e ka kryer veprën penale me dashje direkte apo të drejtpërdrejtë, është e domosdoshme që ai të jetë i vetëdijshëm për veprën e vet dhe ta ketë dëshiruar kryerjen e saj. Pra, te dashja direkte duhet të shprehet elementi intelektual dhe elementi volitiv.

Elementi intelektual (vetëdija) dhe elementi volitiv (vullneti, dëshira), në të cilat sajohet dhe mbështetet dashja direkte apo e drejtpërdrejtë, paraqesin dy faqe të një çështje të njëjtë dhe janë të gërshetuara midis tyre. Me gjithë këtë, këto dy elemente të një nocioni të njëjtë kanë dallime cilësore mes tyre dhe se për arsye teorike dhe praktike, ato duhet të shtjellohen ndaras.

1) Elementi i intelektual apo i vetëdijes, te dashja direkte apo e drejtpërdrejtë, shprehet në rastet kur kryesi është i vetëdijshëm (e di) apo ka përfytyrim të qartë për veprën që e kryen dhe

pasojat që do të shkaktohen nga ajo vepër. P.sh. te vepra penale e vrasjes, nga neni 172 i KPRK, kryesi është i vetëdijshëm për veprimet e tij (shkrepja e armës, goditja disa herë me thikë afër zemrës etj.) dhe për pasojën që do të shkaktohet nga ky veprim (privimi i personit tjetër nga jeta).

2) Elementi volitiv apo i dëshirës, te dashja direkte shprehet atëherë kur kryesi ka dashur (ka dëshiruar) që me veprimin apo mosveprimin e vet, të shkaktojë pasojën e caktuar. Konsiderohet se personi e ka dëshiruar kryerjen e veprës kur ndërmerr veprimin me qëllim që të shkaktojë pasojën, e cila është tipare e veprës penale të caktuar. P.sh. te vepra penale lëndimi i lehtë trupor, nga neni 185 i KPRK, është dëshira e kryesit që duke e ndërmarr veprimin e caktuar (goditja me ndonjë shkop apo me grushte) që të shkaktojë pasojën e caktuar (shkaktimin e lëndimit të lehtë trupor personit tjetër).

2.2. Dashja eventuale

Dashja eventuale (*dolus eventualis*) ekziston atëherë kur kryesi ka qenë i vetëdijshëm se për shkak të veprimit apo mosveprimit, mund të shkaktohet pasoja e ndaluar, mirëpo me vetëdije është pajtuar (dakorduar) që ajo të shkaktohet. Ose, dashja eventuale ekziston kur personi është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij dhe ai pranon shkaktimin e saj⁸⁰.

Te dashja eventuale personi vendos të ndërmarrë një veprim apo mosveprim, edhe pse është i vetëdijshëm se mund të shkaktohet pasoja e ndaluar. Këtu duhet theksuar se pasoja e shkaktuar nuk është ajo të cilën e dëshiron, mirëpo ai llogarit, supozon me një probabilitet të madh se ajo vepër do të shkaktohet dhe me gjithë këtë, ai pajtohet, pranon që të shkaktohet edhe ajo pasojë në mënyrë që ta realizojë qëllimin e vet kryesor.

Shembuj të dashjes eventuale

- Personi A shkrep revolen me qëllim që ta vrasë personin B, që është duke drejtuar automobilin, në të cilin ndodhet edhe personi C. Këtu personi A është i vetëdijshëm se mund ta godasë edhe personin C, apo me vrasjen e personit B, do të shkaktohet edhe vdekja e personit C për pasojë të përplasjes apo rrokullisjes së automobilit dhe ai e pranon shkaktimin e kësaj pasoje;

- Personi A i vë flakën shtëpisë së personit B, edhe pse është i vetëdijshëm se mund të humbë jetën edhe ndonjë anëtar i familjes së personit B, por ai pajtohet që të shkaktohet edhe kjo pasojë (vdekjen e ndonjë anëtari të familjes së personit B).⁸¹

Siç shihet, në të gjitha këto raste kryesi, edhe pse është i vetëdijshëm, supozon se mund të shkaktohet pasoja e ndaluar, me gjithë këtë, për ta realizuar qëllimin e tij kryesor, ai nuk abstenon nga veprimi, pra pranon që të shkaktohet pasoja e ndaluar në botën e jashtme, përkatësisht që të kryejë vepër penale.

⁸⁰ Neni 21 paragrafi 3 i KPRK.

⁸¹ SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 300.

Edhe kjo formë e dashjes, përbëhet prej dy elementeve: **elementi intelektual apo i vetëdijes** dhe **elementi volitiv apo i vullnetit**.

1) Elementi intelektual apo i vetëdijes ekziston atëherë kur kryesi është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij. P.sh. te rasti i lartcekur, personi A është i vetëdijshëm se nëse shkrep në drejtim të personit B, atëherë mund të privohet nga jeta edhe personi C, për arsyt e cekura më lart.

2) Elementi volitiv ose i vullnetit - Kjo formë e dashjes shprehet kur kryesi pranon apo dakordohet që të shkaktohet pasoja e ndaluar. Pra, te rasti i lartcekur, kryesi pranon apo dakordohet, që duke shkrepur me armë në drejtim të personit B, të privohet nga jeta edhe personi C.

2.3. Përgjegjësia dhe ndëshkimi për veprat e kryera me dashje direkte dhe eventuale

Sipas KPRK, për veprat penale të kryera me dashje, kryesi gjithherë përgjigjet penalisht, pa marrë parasysh se a është kryer vepra me dashje direkte apo me dashje eventuale. Madje, KPRK nuk bën kurrfarë dallimi parimor në pikëpamje të ndëshkimit për veprat e kryera me këto dy forma të dashjes. Mirëpo, në teorinë e së drejtës penale dhe në praktikën gjyqësore, në të shumtën e rasteve, veprat penale të kryera me dashje direkte konsiderohen më të rënda se veprat penale të kryera me dashje eventuale. Kjo për faktin se te dashja direkte intensiteti i elementit intelektual dhe volitiv manifestohen në një shkallë më të lartë. Për këtë arsye, parimisht kryesit e veprave penale të kryera me dashje direkte dënohen më rëndë, se sa kryesit e veprave penale të kryera me dashje eventuale.

3. Pakujdesia

Pakujdesia (*culpa*) është formë e dytë e fajit dhe për nga intensiteti i përgjegjësisë penale, është një formë më e lehtë e fajësisë. Në përgjithësi, pakujdesia ekziston atëherë kur kryesi nuk e dëshiron pasojën e shkaktuar, përkatësisht kur pasoja shkaktohet kundër vullnetit të tij.

Në KPRK, njihen dy forma të pakujdesisë:

1. Pakujdesia e vetëdijshme dhe
2. Pakujdesia e pavetëdijshme.

Këto dy forma të pakujdesisë dallohen midis tyre vetëm sipas elementit të vetëdijes ose elementit intelektual. Kurse të dyja këto forma të pakujdesisë dallohen nga dashja, ngase në asnjë formë nuk shprehet dëshira apo vullneti për të shkaktuar pasojën e ndaluar në botën e jashtme.

3.1. Pakujdesia e vetëdijshme

Pakujdesia e vetëdijshme apo siç quhet ndryshe mendjehetësia (*luxuria*), sipas paragrafit 2 të nenit 23 të KPRK ekziston atëherë kur personi është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të

shkaktohet si rezultat i veprimit apo i mosveprimit të tij, por me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet apo se ai do të mund ta parandalojë shkaktimin e saj.

Shembuj të pakujdesisë së vetëdijshme

- Personi A në stinën e verës, gjatë kohës kur temperaturat janë të larta, e ndez një zjarr në arën e tij, për t'i djegur disa mbeturina, edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se zjarri mund të përhapet edhe në hapësirat tjera të fqinjëve të tij, mirëpo ka shpresuar se do të mund ta mbajë nën kontroll zjarrin dhe i njëjti nuk do të përhapet në hapësirat tjera. Kështu, për një moment zjarri përhapet dhe përfshinë një sipërfaqe të gjerë në male dhe pemishte, duke shkaktuar një dëm të konsiderueshëm material;

- Personi A në stinën e dimrit, në kohë me mjegull dhe në rrugë me ngrica, drejton veturën me shpejtësi të madhe, edhe pse e di dhe supozon se mund të shkaktojë aksident komunikacioni, për shkak të ngricës dhe mjegullës, mirëpo mendon dhe shpreson se me aftësitë dhe përvojën e tij profesionale, si shofer, do të jetë në gjendje ta kontrollojë veturën. Ndërkaq, në një moment vetura i rrëshqet dhe përmbysset në greminë me ç'rast njëri prej udhëtarëve humb jetën, kurse të tjerët pësojnë lëndime të rënda trupore;

- Personi A në dhomën përdhese, në ahengun që është organizuar në dasmë, shtie me revole, edhe pse, para se të shkrepë, i shkon ndërmend, supozon se mund ta godasë ndokënd në katin e dytë⁸².

- Punëtari i ndërtimitarisë prej katit të tretë e hedh tullën në trotuar, edhe pse është i vetëdijshëm se mund ta godasë ndonjë kalimtar të rastit etj.

Karakteristikë kryesore dhe tipike e pakujdesisë së vetëdijshme është se kryesi nuk e dëshiron pasojën, madje as nuk e pranon, nuk dakordohet me shkaktimin e saj. Shprehja mendjelehtësi apo pakujdesi e vetëdijshme, të cilën e përdor ligjdhënësi për ta përcaktuar këtë formë të fajësisë, ka për qëllim që veprimin e kryesit ta kualifikojë si sjellje mendjelehtë, sipërfaqësore, të papërgjegjshme, apo sjellje me të cilën ai i ka mbivlerësuar aftësitë e veta.

Nga kjo del se brendia e pakujdesisë së vetëdijshme qëndron në faktin se kryesi nuk dëshiron kryerjen e veprës penale. Shpreson se nuk do të shkaktohet pasoja e ndaluar, përkatësisht veprimin e ndërmer me bindjen se do t'i shmanget pasojës, do ta parandalojë atë. Te pakujdesia e vetëdijshme personi nuk do ta ndërmernte veprimin e kryerjes po ta dinte me siguri se pasoja do të shkaktohej.

3.2. Pakujdesia e pavetëdijshme

Pakujdesia e pavetëdijshme apo siç quhet ndryshe “neglizhenca” ekziston kur personi nuk është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij, edhe pse në rrethanat dhe sipas vetive të tij personale, ka mundur të ishte apo duhej të ishte i vetëdijshëm për këtë mundësi. Pakujdesia e pavetëdijshme, është parashikuar në paragrafin 3 të nenit 23 të KPRK, sipas së cilës personi vepron me pakujdesi të pavetëdijshme kur nuk është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij edhe pse në rrethanat dhe sipas vetive të tij personale ka mundur të ishte apo do të duhej të

⁸²SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 309-310.

ishte i vetëdijshëm për këtë mundësi. Pra, brendia e pakujdesisë së pavetëdijshme qëndron në faktin se personi e kryen veprën penale, të cilën jo vetëm që nuk ka dashur ta kryej, por për të cilën fare nuk ka menduar, nuk ka supozuar se nga veprimi apo mosveprimi i tij ajo mund të kryhet. Këtu edhe qëndron dallimi i pakujdesisë së vetëdijshme nga pakujdesia e pavetëdijshme, ngase, siç pamë më lart, te pakujdesia e vetëdijshme kryesi parashikon mundësinë, është i vetëdijshëm se nga veprimi apo mosveprimi i tij mund të shkaktohet pasoja e ndaluar, kurse te pakujdesia e pavetëdijshme apo neglizhenca kryesi nuk është i vetëdijshëm, fare nuk i shkon ndërmend, nuk supozon se nga veprimi apo mosveprimi i tij mund të shkaktohet pasoja e ndaluar.

Gjithashtu, pakujdesia e pavetëdijshme dallohet prej të gjitha llojeve të tjera të fajësisë, ngase këtu personi nuk ka kurrfarë raporti psikik ndaj veprës së kryer. Pohimi i këtillë mbështetet në rrethanën se në rastet kur kryhet vepra penale nga pakujdesia e pavetëdijshme, mungon si elementi i intelektual, ashtu dhe elementi volitiv.

Shembuj të pakujdesisë së pavetëdijshme

- Personi A me rastin e parkimit të automjetit të tij (kombi) në rrugë, nuk e aktivizon frenin e dorës për të pasur një parkim të sigurt, në ndërkohë që pas parkimit, automjeti nis të drejtim të shtëpisë së personit B, e cila ka qenë në një largësi prej 60 metra nga vendi i parkimit, ku është përplasur me murin e kësaj shtëpie, duke hapur një vrimë në të dhe duke dëmtuar kuzhinën që ka qenë brenda në dhomë, me ç'rast ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material, si dhe janë rrezikuar anëtarët e familjes së të dëmtuarit, të cilët në ato momente kanë qenë në shtëpi⁸³;
- Mjeshtri, që është duke ndërtuar shtëpinë, nga kati i dytë hedh bllokun e thyer dhe me atë rast i shkakton lëndim të rëndë personit që rastësisht është gjendur aty;
- Gjuetari shtie mbi egërsirën, mirëpo me atë rast godet njeriun që ka qenë duke prerë dru në mal etj.

3.3. Dallimi i pakujdesisë së pavetëdijshme nga rasti

Në të drejtën penale konsiderohet se ekziston rasti (*casus*) atëherë kur një person e shkakton pasojën e ndaluar, të cilën, sipas rrethanave objektive, nuk ka qenë i detyruar ta parashikojë, kurse sipas vetive dhe aftësive të tij, nuk ka mundur ta parashikojë. Në këto raste, konsiderohet se pasoja shkaktohet rastësisht. Te rasti mungon lidhja subjektive midis veprimit dhe pasojës së shkaktuar, por shprehet vetëm lidhja objektive. Për këtë arsye, për shkak të mungesës së elementit subjektiv (të fajësisë), edhe pse shkaktohet pasoja e ndaluar, e cila në KPRK është parashikuar si vepër penale, për shkak se kjo pasojë është shkaktuar rastësisht, në të drejtën penale nuk konsiderohet se është kryer vepër penale, andaj kryesi i saj nuk konsiderohet penalisht i përgjegjshëm dhe nuk dënohet.

⁸³ SHALA, AFRIM, Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, f. 277.

Shembuj të rastit në të drejtën penale

- Personi A duke ecur rrugës rrëshqet dhe me atë rast i shkakton lëndim trupor shokut të tij që ka qenë afër tij;

- Personi A duke drejtuar automjetin natën, e shkel personin tjetër të cilin nuk e sheh, ngase ka qenë i shtrirë në rrugë në gjendje të dehur etj.

3.4. Përgjegjësia për veprat penale të kryera nga pakujdesia

Siç pamë më sipër, në krahasim me dashjen, pakujdesia është një formë më e lehtë e fajit. Për veprat penale të kryera me dashje, kryesi gjithherë konsiderohet penalisht përgjegjës dhe dënohet. Kurse, në rastet kur vepra penale kryhet nga pakujdesia, dënohet vetëm përjashtimisht dhe vetëm atëherë kur me ligj është parashikuar shprehimisht se kryesi do të dënohet edhe për rastet kur veprën e kryen nga pakujdesia. Një gjë e tillë është paraparë në nenin 17 paragrafi 2 të KPRK, në të cilin thuhet se një person është penalisht përgjegjës për veprën penale të kryer nga pakujdesia vetëm nëse këtë shprehimisht e përcakton ligji. Në rastet kur me ligj është parashikuar që kryesi do të dënohet edhe për veprat penale të kryera nga pakujdesia, dënimi i parashikuar është më i butë sesa për veprat penale të kryera me dashje. Në pjesën e posaçme të KPRK, janë parashikuar në mënyrë shprehimore rastet kur kryesi është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprave penale nga pakujdesia. Në këtë aspekt vlen të përmenden këto vepra penale të cilat janë më të shpeshta në praktikën tonë gjyqësore:

- Vrasja nga pakujdesia⁸⁴;
- Shërbimi me pije alkoolike i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet⁸⁵;
- Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit⁸⁶;
- Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm⁸⁷;
- Punimet ndërtimore të kundërligjshme⁸⁸;
- Rrezikimi i trafikut publik⁸⁹ etj.

III. VEPRAT PENALE TË CILËSUARA APO TË KUALIFIKUARA

Nocioni dhe llojet e veprave penale të cilësuar apo të kualifikuara

⁸⁴ Neni 175 i KPRK.

⁸⁵ Neni 266 i KPRK.

⁸⁶ Neni 338 i KPRK.

⁸⁷ Neni 356 i KPRK.

⁸⁸ Neni 360 i KPRK.

⁸⁹ Neni 370 i KPRK.

Vepër penale e cilësuar apo e kualifikuar konsiderohet rasti kur kryesi ndërmerr një veprim me qëllim që të shkaktojë një pasojë, mirëpo në fakt shkaktohet pasoja tjetër, më e rëndë nga ajo që ka dëshiruar të shkaktojë kryesi dhe e cila zakonisht shkaktohet. Gjithashtu, si vepër penale e cilësuar apo e kualifikuar konsiderohen edhe rastet kur një person kryen veprën penale në rrethana dhe kushte të posaçme, siç janë: mënyra e kryerjes, mjetet, vendi, koha, cilësitë e kryesit, cilësitë e viktimës, motivet etj., të cilat e bëjnë atë vepër më të rrezikshme.

Veprat penale të cilësuar apo të kualifikuara konsiderohen forma të rënda të veprave penale dhe natyrisht duhet ndëshkuar edhe me dënime më të rënda.

Nga kjo që është paraqitur më lart, rezulton se në të drejtën penale njihen dy lloje të veprave penale të cilësuar:

- Veprat penale të cilësuar apo të kualifikuara me pasojë më të rëndë dhe
- Veprat penale të cilësuar apo të kualifikuara me rrethana të posaçme.

2. Veprat penale të cilësuar apo të kualifikuara me pasojë më të rëndë

Vepra penale e cilësuar apo e kualifikuar me pasojë më të rëndë, ekziston atëherë kur kryesi ndërmerr veprimin me qëllim që të shkaktojë një pasojë të caktuar, mirëpo në fakt shkakton pasojë më të rëndë nga ajo që ka dashur dhe e cila zakonisht shkaktohet⁹⁰. Në rastet e tilla, si rezultat i veprës penale themelore shkaktohet pasojë më e rëndë, për të cilën ligji parashikon edhe dënim më të rëndë. Një gjë e tillë është parashikuar në nenin 24 të KPRK, nen ky i cili emërtohet si “përgjegjësia për pasojat më të rënda”. Sipas kësaj dispozite ligjore, nëse kryerja e një vepre penale shkakton pasoja të cilat e tejkalojnë qëllimin e kryesit dhe për këtë ligji përcakton një dënim më të rëndë, dënimi më i rëndë mund të shqiptohet në rast se pasoja i atribuohet pakujdesisë së kryesit.

Vepra penale e cilësuar apo e kualifikuar me pasojë më të rëndë mund të konsiderohet se ekziston vetëm atëherë kur me ligj është parashikuar shprehimisht ky lloj i konstruksionit juridik - **vepra penale themelore dhe pasoja më e rëndë**, e cila shkaktohet nga vepra penale themelore.

Shembuj të veprës penale të cilësuar apo të kualifikuar

- Nëse personi A me qëllim që t'i shkaktojë lëndim trupor personit B, e godet personin B me një shufër metalike, mirëpo nga kjo goditje e personit A shkaktohet vdekja e personit B;

⁹⁰ SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 321.

- Nëse personi A i shkel detyrimet e tij familjare, duke e lënë në gjendje të rëndë anëtarin e familjes, i cili nuk është në gjendje të kujdeset për vetën e tij dhe si rezultat i kësaj shkaktohet vdekja e anëtarit të familjes;
- Nëse personi A në kundërshtim me Ligjin mbi ndërprerjen e shtatzënisë, bën ndërprerjen e shtatzënisë së ndonjë gruaje shtatzënë dhe nga kjo ndërprerje e shtatzënisë shkaktohet vdekja e gruas shtatzënë etj.

Te këto raste, veprë penale themelore konsiderohet lëndimi trupor, shkelja e detyrimeve familjare dhe ndërprerja e palejuar e shtatzënisë, kurse pasoja më e rëndë konsiderohet vdekja e personit B, vdekja e anëtarit të familjes dhe vdekja e gruas shtatzënë.

Sa i përket formës së fajit, me të cilën mund të kryhet vepra penale e cilësuar apo e kualifikuar me pasojë më të rëndë, duhet theksuar se ndaj veprës penale themelore, kryesi duhet të ketë vepruar me dashje, kurse përjashtimisht edhe nga pakujdesia. Ndërsa, ndaj pasojës më të rëndë, që është shkaktuar nga vepra penale themelore, kryesi duhet të ketë vepruar nga pakujdesia.

3. Veprat penale të cilësuar apo të kualifikuara me rrethana të posaçme

Rrethanat në të cilat kryhen veprat penale janë, p.sh. koha, vendi, mjeti, mënyra e kryerjes, motivi për të cilin kryhet vepra penale, qëllimi, objekti apo vlera juridike ndaj të cilit është i drejtuar veprimi i kryerjes, cilësitë personale të kryesit apo të viktimës etj. Në disa raste, nëse vepra penale kryhet në rrethanën e caktuar, të parashikuar me ligj, ajo veprë fiton atributin e veprës penale më të rrezikshme apo më të rëndë, e cila në të drejtën penale quhet **veprë penale e cilësuar apo e kualifikuar me rrethanë të posaçme**. Për këtë arsye, në pjesën e posaçme të KPRK, në disa raste është parashikuar një dënim më i rëndë për veprën penale themelore, nëse kryhet në rrethana të posaçme. Këtu është fjala për rrethanat e caktuara, të cilat ekzistojnë në kohën e kryerjes së veprës penale apo të cilat janë ngushtë të lidhura me të.

Shembuj të veprave penale të cilësuar apo të kualifikuara me rrethana të posaçme

- Nëse vepra penale e spiunazhit⁹¹ është kryer gjatë kohës së luftës, rrezikut të pashmangshëm për luftë apo konfliktit të armatosur. Në raste të tilla veprë penale themelore konsiderohet spiunazhi, ndërsa rrethanë kualifikuese konsiderohet koha e luftës, rreziku i pashmangshëm për luftë apo konfliktit të armatosur;

- Nëse vepra penale e kanosjes⁹² është kryer me përdorimin e ndonjë mjete të rrezikshëm, atëherë në rastet e tilla, veprë penale themelore konsiderohet kanosja, ndërsa rrethanë kualifikuese konsiderohet mjete i rrezikshëm;

⁹¹ Neni 124 i KPRK.

⁹² Neni 181 i KPRK.

- Nëse vepra penale e lëndimit të rëndë trupor⁹³ është kryer ndaj viktimës së ndjeshme, atëherë në rastet e tilla vepër penale themelore konsiderohet lëndimi i rëndë trupor, ndërsa rrethanë kualifikuese viktima e ndjeshme;

- Nëse vepra penale e privimit të kundërligjshëm nga liria⁹⁴ është kryer në mënyrë mizore, atëherë vepër penale themelore konsiderohet privimi i kundërligjshëm nga liria, kurse rrethanë kualifikuese konsiderohet mënyra mizore e kryerjes së kësaj vepre penale;

- Nëse vepra penale vjedhja e pyllit⁹⁵ është kryer në pyllin e mbrojtur, në parkun nacional ose në pyje të tjera me destinim të posaçëm, atëherë vepër penale themelore konsiderohet vjedhja e pyllit, kurse rrethanë kualifikuese konsiderohen veçoritë e objektit mbrojtës - pylli i mbrojtur, parku nacional ose pyjet tjera me destinim të posaçëm;

- Nëse vepra penale marrja ose mbajtja e kundërligjshme e fëmijës⁹⁶ është kryer për përfitim material ose për motive tjera të ulëta, ku në rastet e tilla vepër penale themelore konsiderohet marrja ose mbajtja e kundërligjshme e fëmijës, kurse rrethanë kualifikuese konsiderohet qëllimi i përfitimit material ose motivet tjera të ulëta;

- Nëse vepra penale blerja, posedimi, shpërndarja ose shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge⁹⁷ është kryer nga personi duke keqpërdorur pozitën apo autorizimet e tij, atëherë në rastet e tilla vepër penale themelore konsiderohet blerja, posedimi, shpërndarja ose shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm, ndërsa rrethanë kualifikuese konsiderohet cilësia e personit zyrtar i cili e keqpërdor pozitën apo autorizimet e tij etj.

Siç shihet, rrethanat të cilat një vepër penale e bëjnë të cilësuar apo të kualifikuar u referohen modaliteteve të kryerjes së veprës, siç janë: mënyra, mjetet, vendi dhe koha e kryerjes, objekti ndaj të cilit është i drejtuar veprimi, cilësitë e viktimës, cilësitë e kryesit etj.

Vepra penale e cilësuar apo e kualifikuar me rrethanë të posaçme zakonisht kryhet me dashje, mirëpo mund të kryhet edhe nga pakujdesia. Konsiderohet se ky lloj i veprës penale është kryer me dashje, në rastet kur kryesi, krahas veprës themelore, ka qenë i vetëdijshëm edhe për rrethanat e posaçme, të cilat e bëjnë veprën më të rrezikshme dhe ka dëshiruar që atë vepër ta kryejë pikërisht në ato rrethana.

Në disa raste, vepra penale e cilësuar apo e kualifikuar me rrethanë të posaçme mund të kryhet edhe nga pakujdesia. Kjo vepër konsiderohet e kryer nga pakujdesia kur kryesi është i vetëdijshëm se veprën është duke e kryer në ndonjë rrethanë që veprën penale e bën më të rrezikshme apo më të rëndë, mirëpo lehtë mendon se ajo rrethanë nuk ekziston (pakujdesia me vetëdije) apo kur nuk është i vetëdijshëm se veprën është duke e kryer në rrethanën e cila veprën e bën më të rrezikshme, por, sipas rrethanave objektive në të cilat ka vepruar dhe sipas vetive të tij personale, ka mundur të jetë i vetëdijshëm dhe ka qenë i detyruar të jetë i vetëdijshëm se vepra është duke u kryer në ato rrethana (pakujdesia pa vetëdije).

⁹³ Neni 186 i KPRK.

⁹⁴ Neni 193 i KPRK.

⁹⁵ Neni 349 i KPRK.

⁹⁶ Neni 242 i KPRK.

⁹⁷ Neni 267 lidhur me nenin 275 të KPRK.

KAPITULLI IV

FAZAT E KRYERJES SË VEPRËS PENALE

1. Shqyrtime të përgjithshme

Veprimi i njeriut që është i drejtuar në kryerjen e veprës penale është një proces i ndërlikuar dhe si i tillë zakonisht kalon nëpër disa faza. Në teorinë e së drejtës penale, ka mendime të ndryshme lidhur me atë se cilat janë fazat të cilat shprehen gjatë kryerjes së veprës penale.⁹⁸ Sidoqoftë, konsiderojmë se fazat të cilat mund të shprehen gjatë kryerjes së veprës penale janë:

- 1) Lindja e mendimit për të kryer vepër penale;
- 2) Vendimi për të kryer vepër penale;
- 3) Veprimet përgatitore të cilat ndërmerren me qëllim të kryerjes së veprës penale;
- 4) Fillimi i kryerjes së veprës penale, që mund të mbetet edhe në tentativë dhe
- 5) Kryerja e veprës penale (vepra penale e përfunduar).

Këto faza të kryerjes së veprës penale nuk janë të domosdoshme të shprehen në çdo rast, ngase disa vepra penale në raste të caktuara mund të kryhen edhe pa kaluar nëpër të gjitha këto faza. Gjithashtu, mund të ndodhë në praktikë që personi të heq dorë vullnetarisht nga përfundimi i veprës penale, edhe pse ka mundësi që ta përfundojë veprën penale (heqja dorë vullnetare).

2. Lindja e mendimit dhe vendimi për të kryer vepër penale

Sipas të drejtës penale bashkëkohore, në rastet kur personi vetëm ka menduar ose ka vendosur për të kryer vepër penale, nuk mund të dënohet, përkatësisht lindja e mendimit për të kryer vepër penale dhe vendimi për të kryer vepër penale, nuk hyn në sferën e së drejtës penale, nëse nuk janë manifestuar në botën e jashtme. Arsyet për të cilat personi nuk dënohet vetëm pse i ka lindë mendimi ose ka vendosur për të kryer vepër penale, janë të shumta dhe të natyrave të ndryshme. Në teorinë e së drejtës penale, përmenden këto arsye:

- Vështirësitë në argumentimin e lindjes së mendimit dhe vendimit për të kryer vepër penale;
- Me lindjen e mendimit për të kryer vepër penale, nuk do të thotë se personi do të kryej vepër penale, ngase një mendim i tillë mund të ndryshohet para se të manifestohet në botën e jashtme;

⁹⁸ SHALA, AFRIM, Hyrje në të drejtën penale, f. 121.

- Gjithashtu, edhe vendimi për të kryer veprë penale, në ndërkohë mund të ndryshohet para se ato të manifestohet në botën e jashtme;
- Do të krijohet një pasiguri për të drejtat dhe liritë e njeriut, për faktin se do të krijoheshin mundësi që personat të dënohen në bazë të supozimeve të ndryshme;
- Lindja e mendimit ose vendimi për të kryer veprë penale, nuk mund të shkaktojnë pasoja të dëmshme, nuk mund t'i rrezikojnë apo dëmtojnë të mirat juridike etj.

3. Veprimet përgatitore

Në KPRK veprimet përgatitore janë parashikuar në mënyrë decidive dhe shprehimore. Sipas paragrafit 1 të nenit 27 të KPRK, kushdo që me dashje përgatit kryerjen e veprës penale do të dënohet vetëm nëse parashihet shprehimisht me ligj një gjë e tillë.

Siç tregon edhe vetëm emërtimi i këtij instituti, veprimet përgatitore konsistojnë në përgatitjen e kryerjes së veprës penale, përkatësisht me veprime përgatitore personi ndërmerr veprime të atilla me anë të të cilave përgatitet kryerja e veprës penale.

Në paragrafin 2 të nenit 27 të KPRK, është parashikuar se veprimet përgatitore konsistojnë:

- në furnizimin ose aftësimin e mjeteve për kryerjen e veprës penale;
- në mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale;
- në arritjen e marrëveshjes, planifikimin apo organizimin me personin tjetër për të kryer veprë penale, si dhe
- në veprime të tjera me të cilat krijohen kushte për kryerjen e drejtpërdrejt të veprës penale, por të cilat nuk e përbëjnë veprimin e kryerjes.

Duke u bazuar në dispozitën e lartcekur ligjore, veprimet përgatitore dënohen vetëm nëse shprehimisht është parashikuar një gjë e tillë me ligj. Nëse i shikojmë më vëmendje dispozitat e pjesës së posaçme të KPRK, atëherë vërejmë se përgatitja e veprës penale dënohet vetëm kur bëhet fjalë për veprat penale shumë të rënda, siç janë:

- Kryerja e veprave terroriste⁹⁹;
- Ndihma në kryerjen e terrorizmit¹⁰⁰;
- Lehtësimi dhe financimi në kryerjen e terrorizmit¹⁰¹;
- Rekrutimi për terrorizëm¹⁰²;
- Trajnimi për terrorizëm¹⁰³;
- Shtytja për kryerjen e veprave terroriste¹⁰⁴;

⁹⁹ Neni 129 i KPRK.

¹⁰⁰ Neni 130 i KPRK.

¹⁰¹ Neni 131 i KPRK.

¹⁰² Neni 132 i KPRK.

¹⁰³ Neni 133 i KPRK.

¹⁰⁴ Neni 134 i KPRK.

- Fshehja ose moslajmërimi i terroristëve apo grupeve terroriste¹⁰⁵;
- Organizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës¹⁰⁶;
- Bashkimi kriminal¹⁰⁷ etj,

Në rastet kur pas ndërmarrjes së veprimeve përgatitore vepra penale edhe kryhet, nuk konsiderohet se janë kryer dy vepra penale, ngase veprimet përgatitore konsumohen nga vepra penale e kryer. Kështu, p.sh., nëse një person ka organizuar grupin për të kryer krime të gjenocidit dhe më pas edhe vetë kryen krime të gjenocidit, nuk do të konsiderohet se i ka kryer dy vepra penale në bashkim (organizimin e grupit i cili konsiderohet si veprim përgatitor, nga neni 154 i KPRK dhe kryerjen e krimit të gjenocidit, nga neni 142 i KPRK).

4. Tentativa e veprës penale

4.1. Shqyrtime të përgjithshme

Tentativa e veprës penale, sipas nenit 28, paragrafi 1 të KPRK, ekziston kur ndokush me dashje ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale, por vepra nuk është kryer ose elementet e veprës penale nuk janë realizuar. Sipas këtij përkufizimi ligjor, tentativa do të ekzistojë në rastet kur vepra penale ka filluar të kryhet, mirëpo nuk është shkaktuar pasoja e dëshiruar.

Shembuj të tentativës së veprës penale

- Personi A shkrepi me armë zjarri në drejtim të personit B, me qëllim që ta privojë nga jeta personin B, mirëpo nuk e qëllon;

- Personi A me qëllim që ta vjedhë veturën e personit B, e thyen dritaren e kësaj veture, hyn në veturë, mirëpo, derisa ishte duke e thyer bravën për aktivizimin e timonit të veturës, arrestohet nga Policia e Republikës së Kosovës etj.

Në aspektin juridiko-penal, për t'u konsideruar se është kryer tentativa e veprës penale, duhet që në mënyrë kumulative të përmbushen këto tri kushte:

- 1) që të ndërmerret veprimi i kryerjes së veprës penale;
- 2) që veprimi të ndërmerret me dashje dhe
- 3) që vepra të mos përfundohet, përkatësisht të mos shkaktohet pasoja e veprës penale.

¹⁰⁵ Neni 135 i KPRK.

¹⁰⁶ Neni 154 i KPRK.

¹⁰⁷ Neni 34 i KPRK.

Tentativa dallohet nga veprimet përgatitore, për faktin se me veprimet përgatitore vetëm krijohen kushtet për kryerjen efikase të veprës penale, ndërsa me tentativë fillohet kryerja e veprës penale, ndërmerret veprimi i kryerjes, mirëpo nuk shkaktohet pasoja e dëshiruar nga ana e kryesit.

4.2. Ndëshkimi i tentativës sipas KPRK

Sipas paragrafit 2 të nenit 28 të KPRK, tentativa dënohet nëse bëhet fjalë për veprë penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me tre ose më shumë vjet burgim. Ndërsa, tentativa për të kryer ndonjë veprë tjetër penale dënohet vetëm nëse shprehimisht parashihet me ligj. Në paragrafin 3 të këtij neni, është parashikuar se personi që tenton të kryejë veprë penale dënohet sikur ta kishte kryer veprën penale, por dënimi mund të zbutet.

Siç është cekur edhe më lart, përveç veprave penale për të cilat mund të shqiptohet dënimi me tre ose më shumë vjet burgim, tentativa dënohet edhe për veprat tjera penale më të lehta, nëse një gjë e tillë është parashikuar në mënyrë shprehimore në pjesën e posaçme të KPRK.

Raste të tilla ku është e ndëshkuar tentativa, sipas pjesës së posaçme të KPRK, janë:

- Vepra penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare¹⁰⁸;
- Kontrabanda me migrantë¹⁰⁹;
- Cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve¹¹⁰;
- Degradimi i integritetit seksual¹¹¹;
- Falsifikimi i letrave me vlerë dhe instrumenteve të pagesës¹¹²;
- Marrja në posedim e pasurisë së luajtshme¹¹³;
- Vjedhja e identitetit dhe pajisja e qasjes¹¹⁴;
- Vjedhja e pyllit¹¹⁵;
- Dëmtimi, shkatërrimi dhe nxjerrja e paautorizuar e monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës¹¹⁶;
- Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme¹¹⁷ etj.

4.3. Tentativa e plotë dhe e metë

Meqë tentativa konsiderohet se është kryer si në rastin kur veprimi i kryerjes ka përfunduar, ashtu edhe në rastin kur veprimi i kryerjes vetëm ka filluar, por gjithherë me kusht që pasoja e

¹⁰⁸ Neni 140 paragrafi 4 i KPRK.

¹⁰⁹ Neni 164 paragrafi 4 i KPRK.

¹¹⁰ Neni 197 paragrafi 2 i KPRK.

¹¹¹ Neni 230 paragrafi 8 i KPRK.

¹¹² Neni 287 paragrafi 6 i KPRK.

¹¹³ Neni 319 paragrafi 2 i KPRK.

¹¹⁴ Neni 336 paragrafi 7 i KPRK.

¹¹⁵ Neni 349 paragrafi 4 i KPRK.

¹¹⁶ Neni 354 paragrafi 6 i KPRK.

¹¹⁷ Neni 428 paragrafi 3 i KPRK.

veprës penale të mos jetë shkaktuar, në të drejtën penale njihen dy lloje të tentativës : tentativa e plotë dhe tentativa e metë.

Tentativa e plotë konsiderohet se ekziston atëherë kur veprimi i kryerjes ka filluar dhe ka përfunduar, mirëpo pasoja nuk është shkaktuar.

Shembuj të tentativës së plotë

Personi A shkrep me armë zjarri në personin B, por nuk mundet që ta godasë.

Tentativa e metë konsiderohet se ekziston atëherë kur personi e fillon veprimin e kryerjes, por nuk e përfundon.

Shembuj të tentativës së metë

Personi A merr në shenjë me revole personin B, por nuk shkrep, ngase personi B fshihet në një vend të caktuar.

Tentativa e metë, në teorinë e së drejtës penale, ndryshe quhet edhe si “tentativë e papërfunduar”¹¹⁸.

4.4. Tentativa e cilësuar

Tentativa e cilësuar, në të drejtën penale konsiderohet se ekziston në rastet kur me veprimin e ndërmarrë është tentuar të kryhet vepra penale, por në fakt, është realizuar figura e një vepre penale tjetër, e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale e posaçme.

Shembuj të tentativës së cilësuar

Personi A shkrep me armë zjarri në drejtim të personit B me qëllim që ta privojë nga jeta, mirëpo i shkakton vetëm lëndime të rënda trupore.

Në këtë rast personi A, në fakt, e ka kryer veprën penale të lëndimit të rëndë trupor, por meqë dashja e tij ka qenë e orientuar që të kryejë veprën penale të vrasjes, në të drejtën penale do të konsiderohet se ky person e ka kryer veprën penale vrasje të mbetur në tentativë dhe jo veprën penale të lëndimit të rëndë trupor.

Pra, në këto raste, për kualifikimin e veprës penale është vendimtare dashja e kryesit dhe fakti që personi me këtë tentativë ka shkaktuar lëndimin e rëndë trupor, do t’i merret parasysh si rrethanë rënduese me rastin e matjes së dënimit.

4.5. Tentativa e papërshtatshme

Tentativa e papërshtatshme ekziston atëherë kur mjetet të cilat janë përdorë për kryerjen e veprës apo objekti ndaj të cilit është ndërmarrë veprimi i kryerjes, nuk kanë mundë të

¹¹⁸MUÇI, SHEFQET, Vepra e cituar, f. 215.

shkaktojnë pasojën e veprës penale. Tentativa e papërshtatshme ekziston në rastet kur personi dëshiron kryerjen e veprës penale dhe për atë qëllim ndërmerr veprimin e kryerjes, por duke e bërë këtë me mjete të cilat i përdor apo mbi objektin ndaj të cilit është ndërmarrë veprimi i kryerjes, objektivisht, ka qenë e pamundur të kryhet vepra penale. Kështu, në nenin 29 të KPRK, është parashikuar se gjykata mund ta lirojë nga dënimi personin i cili tenton të kryejë veprën penale me mjet të papërshtatshëm ose ndaj objektit të papërshtatshëm. Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, tentativa e papërshtatshme mund të jetë:

- a) Tentativë e papërshtatshme lidhur me mjetet dhe
- b) Tentativë e papërshtatshme lidhur me objektin.

Tentativa e papërshtatshme lidhur me mjetet me të cilat është tentuar të kryhet vepra penale ekziston kur arma e zjarrit nuk shkrep, ngase gjilpëra ka qenë e thyer; kur ndokush shkrep me revole të zbrazët, kurse kryesi ka menduar se revolja është e mbushur; kur ndokush i qet helm tjetrit në pije, por helmi, për shkak se ka qëndruar gjatë në depo, e ka humbur efektin e vet¹¹⁹.

Ndërsa, tentativa e papërshtatshme lidhur me objektin ekziston atëherë kur objekti i veprës penale fare nuk ekziston apo kur objekti nuk i ka ato tipare që janë të domosdoshme që të mund të kryhet vepra penale. P.sh. shkrep me pushkë mbi kufomën, kurse kryesi mendon se është njeri i gjallë; abortimi ndaj femrës që nuk është shtatzënë; kur kryesi hyn në shtëpinë e fqinjit të tij për të vjedhur para, të cilat i kishte parë se fqinji i tij i kishte futur në komodinë, mirëpo pasi e hap komodinën nuk i gjen paratë, sepse fqinji i tij më parë i kishte deponuar në bankë këto para etj.

Në teorinë e së drejtës penale, njihen dy lloje të tentativës së papërshtatshme: tentativa e papërshtatshme absolute dhe tentativa e papërshtatshme relative.

a) Tentativa e papërshtatshme absolute ekziston atëherë kur mjetet me të cilat është tentuar kryerja e veprës penale apo objekti ndaj të cilit është tentuar të kryhet vepra penale, kursesi dhe në asnjë rast, nuk ka mundur të kryhet vepra penale. P.sh. shkrepja me revole të zbrazët; shkrepja me revole mbi personin që ka vdekur më parë. Në rastin e parë është fjala për tentativën e papërshtatshme absolute lidhur me mjetin, kurse në rastin e dytë është fjala për tentativën e papërshtatshme absolute lidhur me objektin ndaj të cilit është tentuar të kryhet vepra penale.

b) Tentativa e papërshtatshme relative ekziston atëherë kur mjetet që janë përdorë apo objekti ndaj të cilit është ndërmarrë veprimi i kryerjes, marrë në përgjithësi, janë të përshtatshme për kryerjen e veprës penale, kanë mundur të shkaktojnë pasojën e ndaluar, mirëpo në rastin konkret, për shkak të ekzistimit dhe efektit të disa rrethanave, ato kanë qenë

¹¹⁹ SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 350.

të papërshtatshme. P.sh. me qëllim të kryerjes së veprës penale të vrasjes përdoret një sasi shumë e vogël e helmit¹²⁰ etj.

Siç është cekur edhe më parë, në nenin 29 të KPRK, është parashikuar mundësia lirimit nga dënimi, nëse personi ka tentuar për të kryer veprë penale me mjete të papërshtatshme ose ndaj objektit të papërshtatshëm.

5. Heqja dorë vullnetare nga kryerja e veprës penale

Heqja dorë vullnetare nga kryerja e veprës penale ekziston në rastet kur ndokush ndërmerr veprimet përgatitore apo tentativën me qëllim të kryerjes së veprës penale, por, me gjithë faktin se mund ta kryejë veprën penale, heq dorë vullnetarisht nga kryerja e saj. Nga kjo rezulton se heqja dorë duhet të jetë e vullnetshme, përkatësisht që vetë kryesi të vendosë të mos e kryejë veprën, edhe pse e di se veprimin mund ta përfundojë dhe të shkaktojë ashtu pasojën e ndaluar në botën e jashtme.

Sipas paragrafit 1 të nenit 30 të KPRK, heqja dorë vullnetare nga kryerja e veprës penale ekziston nëse personi me vullnetin e tij heq dorë nga kryerja e veprës penale, të cilën e ka filluar, ndonëse është i vetëdijshëm se në pajtim me të gjitha rrethanat ai mund ta vazhdojë veprën ose nëse pas kryerjes së një veprë të tillë parandalon shkaktimin e pasojave.

Heqja dorë vullnetare nga kryerja e veprës penale është e mundur si te tentativa e metë, ashtu edhe te tentativa e plotë.

1) Heqja dorë vullnetare nga tentativa e metë ekziston në rastet kur personi, me vullnetin e tij të lirë, ndal veprimin e mëtejshëm, pushon së vepruari. P.sh. me revole merr në shenjë personin tjetër, por nuk shkrep.

2) Heqja dorë vullnetare nga tentativa e plotë shprehet në rastet kur personi, pasi të ketë përfunduar veprimin e kryerjes, ndërmerr një veprim tjetër, me të cilin pengon shkaktimin e pasojës.

Shembuj të heqjes dorë vullnetare nga tentativa e plotë

- Nëse personi A i hedh në ushqim apo në pije një dozë vdekjeprurëse të helmit personit B, por menjëherë i jep edhe kundërhelme ose e dërgon në spital dhe kështu e pengon shkaktimin e vdekjes së personit B.

- Kur personi A i dërgon me postë një paketë me eksploziv personit B, por ndërkohë e ndërron mendimin dhe e lajmëron personin B para se ta ketë marrë paketën dhe kështu parandalon shkaktimin e lëndimit apo të vdekjes së personit B¹²¹.

Nuk do të konsiderohet se ekziston heqja dorë vullnetare nga kryerja e veprës penale, nëse kryesi ka ndërmarrë të gjitha masat, me qëllim që të parandalojë shkaktimin e pasojës, por

¹²⁰SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 351.

¹²¹ *Idem*, f. 353.

megjithatë, pasoja është shkaktuar. P.sh. ia jep kundërhelmin ose e dërgon në spital personin që e ka helmuar, por, përkundër kësaj, shkaktohet pasoja e vdekjes. Në situatat e tilla veprimet e kryesit, që kanë pasur për qëllim të parandalojnë pasojën e ndaluar, gjykata mund t'i marrë vetëm si rrethanë lehtësuese me rastin e matjes së dënimit.

Sipas nenit 30 paragrafi 1 i KPRK, në mënyrë që ndokush të mund të lirohet nga dënimi, heqja dorë nga kryerja e veprës penale duhet të jetë e vullnetshme. Heqja dorë konsiderohet e vullnetshme, nëse personi, me vullnetin e tij të lirë, abstenon nga përfundimi i veprës penale¹²². Në këtë drejtim, nuk do të konsiderohet heqje dorë e vullnetshme, nëse personi abstenon nga kryerja e veprës penale, për shkak të ndikimit të rrethanave të jashtme, p.sh., për shkak se nuk mund ta thyejë kasafortën në të cilën gjenden të hollat ose për shkak se në momentin kur është duke depërtuar në market paraqitet roja ose për shkak se bindet se mjetet të cilat i përdor për të depërtuar në market janë të papërshtatshme. Gjithashtu, për të qenë relevante për të drejtën penale, heqja dorë vullnetare nga kryerja e veprës penale duhet të jetë përfundimtare.

Në nenin 30 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar mundësia fakultative e lirimit nga dënimi, nëse personi heq dorë vullnetarisht nga kryerja e veprës penale.

Motivet që e shtyjnë një personin për të heqë dorë vullnetarisht nga kryerja e veprës penale, mund të jenë të natyrave të ndryshme.

Ndërsa, në paragrafin 2 të nenit 30 të KPRK është parashikuar se kryesi, me rastin e heqjes dorë vullnetare, do të dënohet për ato veprime, të cilat përbëjnë vepër tjetër penale të veçantë.

¹²²ELEZI, ISMET-KAÇUPI, SKËNDER-HAXHIA, MAKSIM : vepra e cituar, f. 173; MUÇI, SHEFQET : vepra e cituar, f. 223.

KAPITULLI V

BASHKËPUNIMI NË KRYERJEN E VEPRËS PENALE

1. Nocioni, kushtet dhe format e bashkëpunimit në të drejtën penale

Bashkëpunimi në të drejtën penale nënkupton rastet kur në kryerjen e veprës penale marrin pjesë dy ose më shumë persona, kurse personat me veprimin ose mosveprimin e të cilëve është kryer vepra penale quhen bashkëpunëtorë. Ose, bashkëpunimi nënkupton kryerjen e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje ndërmjet tyre¹²³.

Pjesëmarrja e dy apo më shumë personave në kryerjen e veprës penale, para të drejtës penale shtron një varg çështjesh që duhen zgjidhur dhe ato kanë të bëjnë me përcaktimin e rolit dhe kontributit të çdo bashkëpunëtori në kryerjen e veprës penale, si dhe me përcaktimin e përgjegjësisë penale të tyre.

Bashkëpunimi është një institucion i së drejtës penale i cili rregullohet me dispozitat e pjesës së përgjithshme të KPRK, mirëpo për shkak të rrezikshmërisë më të madhe, edhe në pjesën e posaçme të KPRK, gjenden disa dispozita ligjore të cilat i referohen këtij institucioni.

Për t'u konsideruar se ekziston bashkëpunimi në të drejtën penale, midis pjesëmarrësve duhet të ndodhë një **lidhje e caktuar objektive dhe subjektive**¹²⁴.

Lidhja objektive qëndron në atë se secili bashkëpunëtor duhet të ndërmarrë ndonjë veprim, me të cilin kontribuon në kryerjen e veprës penale, kurse lidhja subjektive qëndron në atë se të gjithë bashkëpunëtorët duhet të jenë të vetëdijshëm se në kryerjen e veprës penale të caktuar do të marrin pjesë apo veprojnë së bashku në mënyra të ndryshme.

Në nenet 31 deri 35 të KPRK janë të parashikuar këto forma të bashkëpunimit:

- 1) Bashkëkryerja,
- 2) Shtytja,
- 3) Ndhima,
- 4) Bashkimi kriminal dhe
- 5) Marrëveshja për të kryer vepër penale.

Personat që marrin pjesë dhe veprojnë në këto pesë forma të bashkëpunimit quhen :

- 1) bashkëkryes,

¹²³ELEZI, ISMET-KAÇUPI, SKËNDER-HAXHIA, MAKSIM, Vepra e cituar, f. 176.

¹²⁴SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 373.

- 2) shtytës,
- 3) ndihmës,
- 4) organizatorë ose anëtarë të bashkimit kriminal, si dhe
- 5) persona që janë marrë vesh për të kryer veprë penale.

2. Bashkëkryerja

Sipas nenit 31 të KPRK, bashkëkryerja ekziston nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër. Me fjalë tjera, bashkëkryerja ekziston nëse dy apo më shumë persona, duke marrë pjesë në veprimin e kryerjes ose në ndonjë mënyrë tjetër, kryejnë së bashku veprën penale. Nga kjo rezulton se për t'u konsideruar se ka ndodhur bashkëkryerja, si formë e bashkëpunimit, duhet që dy apo më shumë persona të kenë marrë pjesë në veprimin e kryerjes së veprës penale. P.sh. dy ose tre persona shtinë me armë në drejtim të personit tjetër dhe kështu kryejnë

veprën penale të vrasjes¹²⁵, apo dy ose më shumë persona së bashku e kryejnë veprën penale të vjedhjes së rëndë¹²⁶.

Në dispozitën e lartcekur ligjore është parashikuar se secili bashkëkryes është përgjegjës dhe do të dënohet me dënimin e parashikuar për veprën penale të kryer. Në këtë rast, bashkëkryesi përgjigjet penalisht brenda kufijve të dashjes apo të pakujdesisë së tij¹²⁷. Nga kjo dispozitë ligjore rezulton se bashkëkryesit në kryerjen e veprës penale mund të veprojnë me forma të ndryshme të fajit dhe është e mundur që njëri të veprojë me dashje direkte, kurse tjetri me dashje eventuale. Po ashtu, është e mundur që të njëri bashkëkryes të ekzistojë dashja, kurse te tjetri pakujdesia. Pra, përgjegjësia penale dhe dënimi përcaktohen veçmas për secilin bashkëkryes, varësisht prej formës së fajit me të cilin kanë vepruar dhe varësisht sa kanë kontribuar në kryerjen e veprës penale.

Sipas nenit 36 paragrafi 3 të KPRK, është parashikuar se rrethanat personale, përfshirë marrëdhëniet dhe cilësitë të cilat mund të rezultojnë në përjashtimin nga përgjegjësia penale, lirimin nga dënimi, ekzistimin e formave të rënda apo të lehta të veprës penale ose që ndikojnë në përcaktimin e dënimit, mund të merren parasysh vetëm ndaj personit për të cilin vlejnë. Nëse rrethanat personale të cilat ndërliken me kryesin kanë ndikim në zbutjen ose ashpërsimin e dënimit dhe këto rrethana konstituojnë elementë të veprës penale, bashkëkryesi, shtytësi ose ndihmësi është përgjegjës për dënimin e paraparë për veprë penale kur ai ka ditur për këtë rrethanë, edhe nëse nuk ka pasur lidhshmëri me të.

¹²⁵ Neni 172 i KPRK.

¹²⁶ Neni 315 i KPRK.

¹²⁷ Neni 36 paragrafi 1 i KPRK.

3. Shtytja

Shtytja, si formë e bashkëpunimit është rregulluar me nenin 32 të KPRK. Sipas paragrafit 1 të këtij neni, kushdo që me dashje e shtytë personin tjetër të kryejë veprë penale, dënohet sikurse ai ta kishte kryer atë veprë penale, nëse vepra penale është kryer. Pra, siç shihet në këtë dispozitë ligjore nuk është përcaktuar nocioni i shtytjes, si formë e bashkëpunimit. Në teorinë e së drejtës penale, shtytja përkufizohet si ndërmarrje e veprimeve të atilla me të cilat te personi tjetër me dashje shkaktohet ose forcohet vendimi për të kryer veprën penale¹²⁸.

Nga ky përkufizim rezulton se shtytja mund të kryhet në rastet kur ndaj një personi, i cili fare nuk ka ndërmend të kryejë veprë penale dhe me veprime të caktuara ndikohet që të formojë vendimin (të vendosë) të kryejë veprë penale. Ndërsa, si formë tjetër e shtytjes, konsiderohet rasti kur personi tjetër e ka ndërmend të kryejë veprë penale, por ai ende nuk ka vendosur përfundimisht, përkatësisht kur vendimi i tij është i luhatsëm apo ende është në mëdyshje nëse do ta kryejë ose jo veprën penale dhe nëse personi tjetër me veprimet e tij ndikon që vendimi i tij të forcohet, të vendosë për të kryer veprë penale. Te kjo formë e shtytjes, iniciativa për të kryer veprën penale nuk fillon nga shtytësi. Lidhur me këtë, shtytja konsiderohet se ekziston edhe në rastet kur personi ka hartuar planin për të kryer veprën penale, mirëpo ende nuk ka vendosur për ta realizuar atë plan. Nëse ndonjë person e shtytë tjetrin, i cili tashmë ka vendosur për të kryer veprën penale, atëherë në të drejtën penale nuk konsiderohet se është kryer shtytja, por në këto raste bëhet fjalë për të ashtuquajturën “shtytje të pasuksesshme”.

Në KPRK, përveç nocionit, nuk përcaktohen as mënyrat dhe mjetet me të cilat mund të kryhet shtytja. Mirëpo, në teorinë e së drejtës penale dhe në praktikën gjyqësore është përvetësuar pikëpamja se shtytja mund të kryhet me çdo lloj veprimi, me të cilin te tjetri mund të formohet apo të forcohet vendimi për të kryer veprën penale. Si veprime të shtytjes mund të konsiderohen, p.sh., veprimet me të cilat bindet tjetri, dhënia e dhuratës, insistimi për të kryer veprë penale, premtimi i dhuratës, lutja, kanosja, dhënia e këshillave, përqeshja për shkak të mosvendos mërisë, vënia në dijeni për të mirat që do të realizohen me kryerjen e veprës penale, etj.

Shtytja mund të ndërmerret nga një ose më shumë persona. Në rastet kur shtytja ndërmerret nga dy apo më shumë persona, kjo në teorinë e së drejtës penale quhet “bashkështytje”.

Shtytja duhet të jetë e drejtuar ndaj personit të caktuar, si kryes i ardhshëm dhe me qëllim që të kryhet vepra penale e caktuar.

Shtytja mund të kryhet vetëm me dashje, si formë më e rëndë e fajësisë dhe një gjë e tillë është parashikuar në mënyrë shprehimore, në nenin 32 të KPRK. Pra, shtytësi duhet të jetë i vetëdijshëm se me veprimin e tij shtytë tjetrin të kryejë veprë penale dhe njëherësh dëshiron kryerjen e saj. Shtytja gjithherë është e drejtuar në kryerjen e një vepre penale të caktuar.

¹²⁸SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 390; KAMBOVSKI, VLLADO, Vepra e cituar, f. 372.

Shtytësi, pra, është personi që dëshiron ose pranon realizimin e veprës penale të caktuar, me ndërmjetësimin e kryesit.

Duhet theksuar se shtytja është e mundur të kryhet edhe nga pakujdesia, por kjo sipas KPRK nuk dënohet, përkatësisht nuk hyn në zonën kriminale.

Sa i përket ndëshkimit të shtytësit, në nenin 32 të KPRK, është parashikuar se shtytësi dënohet për çdo lloj vepre penale sikur ta kishte kryer vetë veprën penale, pa marrë parasysh peshën e saj, me kusht që vepra penale të jetë kryer nën ndikimin e tij. Pra, që shtytësi të mundë të ndëshkohet, kërkohet që kryesi ta ketë kryer veprën penale dhe siç është cekur më lart, shtytësi dënohet sikur ta kishte kryer vetë veprën penale.

Në paragrafin 2 të nenit 32 të KPRK, është rregulluar çështja e ndëshkimit të shtytësit, në rastet kur vepra penale vetëm është tentuar që të kryhet. Sipas kësaj dispozite ligjore, kushdo që me dashje shtytë personin tjetër të kryejë vepër penale dënohet sikurse ta kishte kryer vetë atë vepër penale nëse vepra penale është tentuar, por nuk është kryer.

Ndërsa, në paragrafin 3 të nenit 32 të KPRK, është parashikuar se kushdo që me dashje shtytë personin tjetër të kryejë vepër penale të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim dhe vepra penale as që është tentuar, shtytësi dënohet për tentativë.

Për shkak të rrezikshmërisë shumë të madhe të disa veprave penale dhe natyrës specifike të tyre, në disa raste KPRK shtytjen e parashikon si vepër penale të posaçme apo të pavarur. Në pjesën e posaçme të KPRK, shtytja është parashikuar si vepër penale e posaçme në këto raste:

- Shtytja për kryerjen e veprave terroriste¹²⁹;
- Nxitja e përçarjes dhe mosdurimit¹³⁰;
- Shtytja për luftë agresive ose konflikt të armatosur¹³¹;
- Shtytja në vetëvrasje dhe ndihma në vetëvrasje¹³²;
- Nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës¹³³ etj.

Në këto raste, kur shtytja është parashikuar në ligj si vepër penale e posaçme, konsiderohet se vepra është kryer, pa marrë parasysh nëse ajo është kryer apo ka mbetur në tentativë. Në të gjitha rastet kur shtytja është parashikuar si vepër penale e posaçme, kryesi nuk do të gjykohet sipas dispozitave mbi bashkëpunimin, por do të gjykohet si për çdo vepër penale të pavarur.

¹²⁹ Neni 134 i KPRK.

¹³⁰ Neni 141 i KPRK.

¹³¹ Neni 156 i KPRK.

¹³² Neni 177 i KPRK.

¹³³ Neni 233 i KPRK.

4. Ndhurma

Ndhurma është ndërmarrje e veprimeve të atilla me të cilat një person ndihmon me dashje personin tjetër për të kryer veprën penale. Në nenin 33 paragrafi 1 i KPRK, është parashikuar se kushdo që me dashje ndihmon personin tjetër për kryerjen e veprës penale dënohet me dënim më të butë se sa kryesi i veprës.

Në paragrafin 2 të nenit 33 të KPRK, është parashikuar se ndihma për të kryer një vepër penale përfshin por nuk kufizohet në:

- dhënien e këshillave ose udhëzimeve se si të kryhet vepra penale;
- vënien në dispozicion të mjeteve për kryerjen e veprës penale;
- krijimin e kushteve ose mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale; ose
- premtimi paraprak se do të fshehë provat e kryerjes së veprës penale, kryesin apo identitetin e kryesit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale.

Nga kjo dispozitë ligjore, shihet se ndihma si formë e bashkëpunimit mund të jetë ndihmë fizike dhe ndihmë psikike.

Si ndihmë fizike mund të konsiderohen: vënia në dispozicion të kryesit mjetet për kryerjen e veprës penale dhe mënjanimi i pengesave për kryerjen e veprës penale. Si ndihmë fizike mund të konsiderohen edhe të gjitha ato veprime të tjera me të cilat, objektivisht, ndihmohet personi tjetër që të kryejë veprën penale.

Shembuj të ndihmës fizike

- Bërja roje gjatë kohës së kryerjes së veprës penale,
- Bartja apo dërgimi i personit deri në vendin ku duhet kryer vepra penale,
- kontrollimi i gatishmërisë së mjeteve me të cilat duhet të kryhet vepra penale etj.

Si ndihmë psikike mund të konsiderohet: dhënia e këshillave ose e udhëzimeve si të kryhet vepra penale dhe premtimi paraprak se do të fshehë provat e kryerjes së veprës penale, kryesin apo identitetin e kryesit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale.

Ndryshe nga shtytja, e cila për shkak të natyrës së saj mund të kryhet vetëm me veprim, ndihma mund të kryhet me veprim dhe me mosveprim. Ndhurma, konsiderohet se kryhet me veprim në rastet kur ndihmësi duke ndërmarrë veprime aktive i ndihmon kryesit për të kryer veprën penale. Kurse, ndihma kryhet me mosveprim në ato raste kur personi nuk ndërmerr atë veprim që ka qenë i detyruar që ta ndërmarrë dhe në këtë mënyrë e ka ndihmuar tjetrin të kryejë vepër

penale. P.sh. rojtari i ndonjë marketi, me qëllim që t'i ndihmojë tjetrit në kryerjen e veprës penale të vjedhjes, nuk e mbyll derën e marketit.

Sa i përket kohës, ndihma jepet zakonisht para se të fillojë kryerja e veprës penale dhe kjo ndryshe quhet edhe **ndihmë paraprake**. Mirëpo, ndihma mund të kryhet edhe gjatë kohës së kryerjes së veprës penale, derisa nuk ka përfunduar vepra penale në kuptimin material. Veprimet që ndërmerren pasi të jetë kryer vepra penale nuk mund të konsiderohen si ndihmë, me kusht që të mos jenë premtuar më parë, para se të ketë filluar kryerja e veprës penale. Kështu, p.sh. do të konsiderohet si ndihmë nëse një person i premtton tjetrit se pas kryerjes së veprës penale të vjedhjes, do ta fshehë kryesin dhe pasurinë e vjedhur. Në të kundërtën, nëse dikush e fsheh kryesin e veprës penale, edhe pse nuk i ka premtuar këtë më parë, atëherë një person i tillë do të përgjigjet si kryes i posaçëm i veprës penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale¹³⁴.

Ndihma mund të jetë e suksesshme dhe e pasuksesshme. Ndihma e pasuksesshme do të ekzistojë atëherë kur personi, të cilit i është dhënë ndihma nuk e ka kryer veprën penale ose nuk ka tentuar ta kryejë apo nuk ka ndërmarrë veprime përgatitore të ndëshkueshme. Gjithashtu, do të konsiderohet se ekziston ndihma e pasuksesshme edhe në rastet kur kryesi i veprës penale fare nuk i ka shfrytëzuar veprimet e ndihmësit. P.sh. personi A veprën penale të vrasjes¹³⁵ e kryen me revole dhe jo me thikën që ia ka dhënë ndihmësi; ose nëse personi A veprën penale të vjedhjes së rëndë¹³⁶, e kryen duke thyer dritaren dhe jo me çelësin fals që ia ka dhënë ndihmësi etj. Meqë, KPRK nuk përmban ndonjë dispozitë ligjore, me të cilën do të rregullonte çështjen e ndëshkimit për ndihmë të pasuksesshme, andaj mund të konkludojmë se ndihma e pasuksesshme nuk ndëshkohet, me kusht që mos t'i përmbaj elementet e ndonjë veprë penale të posaçme.

Në paragrafin 1 të nenit 33 të KPRK, është parashikuar se kushdo që me dashje ndihmon personin tjetër për kryerjen e veprës penale dënohet me dënim më të butë se sa kryesi i veprës.

Për shkak të natyrës së disa veprave penale dhe rrezikshmërisë së tyre, për të cilat jepet ndihma dhe për disa shkaqe kriminalo-politike, ndihma në disa raste në pjesën e posaçme të KPRK është parashikuar si vepër penale e posaçme apo e pavarur. Rastet e tilla janë:

- Dhënia e ndihmës në vetëvrasje¹³⁷;
- Ndihma gruas shtatzënë për ta ndërprerë shtatzënësinë¹³⁸;
- Dhënia e ndihmës kryesit pas kryerjes së veprës penale¹³⁹;

¹³⁴ Neni 380 i KPRK.

¹³⁵ Neni 172 i KPRK.

¹³⁶ Neni 315 i KPRK.

¹³⁷ Neni 177 i KPRK.

¹³⁸ Neni 178 i KPRK.

¹³⁹ Neni 380 i KPRK.

- Mundësimi ose detyrimi në prostitucion¹⁴⁰;
- Dhënia e ndihmës personit të akuzuar nga tribunali ndërkombëtar penal¹⁴¹ etj.

5. Bashkimi kriminal

Bashkimi kriminal është forma e katërt dhe më e rëndë e bashkëpunimit në kuptimin e ngushtë. Sipas të drejtës penale, termi bashkim kriminal nënkupton organizatën kriminale, përkatësisht grupin e personave, të cilët janë marrë vesh për të kryer veprë penale, rrjeti i personave me qëllime kriminale, si dhe format e tjera të ngjashme të bashkëpunimit për kryerjen e veprave penale.¹⁴² Përmes kësaj forme të bashkëpunimit, kryhen vepra penale shumë të rënda, siç janë: trafikimi i drogës, i armëve, i njerëzve, terrorizmi, format e rënda të vrasjeve, grabitjet, shantazhet, korrupsioni, pastrimi i parave, si dhe krimet e kryera kundër njerëzimit dhe së drejtës ndërkombëtare gjatë konflikteve të armatosura apo luftërave në vende të ndryshme të botës. Në nenin 34 paragrafi 1 të KPRK, është përcaktuar nocioni i bashkimit kriminal, i cili manifestohet në rastet kur ndonjë person në mënyrë shprehimore ose të heshtur merret vesh me një apo me më shumë persona për të kryer ose për të nxitur kryerjen e një veprë penale të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim dhe ndërmerr veprime përgatitore për realizimin e marrëveshjes së tillë, dënohet me dënimin e paraparë për atë veprë penale.

Bashkimi kriminal, si institucion i përgjithshëm i së drejtës penale, është parashikuar me qëllim të inkriminimit të fazës më të hershme të kryerjes së veprës penale, në fazën e përgatitjes së veprës penale. Me këtë institucion, në fakt, ndëshkohen veprimet përgatitore, vepra këto që ndryshe quhen “*delicta preparata*”. Sipas dispozitës së lartcekur ligjore, personat hyjnë në zonën kriminale, pra ndëshkohen, vetëm nëse merren vesh, përkatësisht arrijnë marrëveshje që të kryejnë apo shtyjnë të tjerët për të kryer veprën penale të dënueshme me së paku pesë vjet burgim dhe nëse ndërmarrin edhe veprime përgatitore për realizimin e marrëveshjes.

Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, te rastet e bashkimit kriminal, personi konsiderohet penalisht përgjegjës dhe dënohet, nëse janë plotësuar këto kushte:

- kur ka arritur marrëveshje në mënyrë shprehimore apo të heshtur me një apo me më shumë persona që të kryejë veprë penale;
- kur ka arritur marrëveshje me një apo me më shumë persona që të shtyjnë të tjerët të kryejnë vepra penale;
- kjo marrëveshje në të drejtën penale konsiderohet relevante, vetëm nëse është kryer me dashje;

¹⁴⁰ Neni 234 i KPRK.

¹⁴¹ Neni 381 i KPRK.

¹⁴² SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 402-403.

- vepra penale për të cilën është arritur marrëveshja, duhet të jetë e dënuar me së paku pesë vjet burgim dhe

- nëse me qëllim të kryerjes së veprës penale, për të cilën është arritur marrëveshja, janë ndërmarrë edhe veprime përgatitore për realizimin e marrëveshjes, p.sh. është bërë furnizimi me armë me qëllim të kryerjes së vrasjes etj.

Të gjitha këto kushte duhet të përmbushen në mënyrë kumulative për t'u konsideruar se ekziston bashkimi kriminal dhe që të mundë të ndëshkohen personat për këtë formë bashkëpunimi.

Është me rëndësi të theksohet se sipas KPRK, bashkimi kriminal, si formë e bashkëpunimit do të konsiderohet se ekziston dhe pjesëmarrësit e tij do të dënohen, edhe pse nuk është kryer apo nuk është tentuar të kryhet vepra penale, për të cilën janë marrë vesh, mjafton që të jetë arritur marrëveshja dhe që të jenë ndërmarrë veprime përgatitore me qëllim të realizimit të marrëveshjes.

Duke e marrë për bazë faktin se bashkimi kriminal, për shkak të natyrës së tij, vështirë zbulohet dhe kryhet në mënyrë konspirative, në nenin 34 paragrafi 2 të KPRK, është parashikuar shprehimisht se gjykata mund ta zbusë dënimin apo ta lirojë nga dënimi personin i cili është penalisht përgjegjës në këto raste:

- vullnetarisht heq dorë nga marrëveshja;
- vullnetarisht ndërmerr veprime për parandalimin e ekzistencës së vazhdueshme të bashkimit kriminal ose të kryerjes së veprës penale në pajtim me qëllimet e saj; ose
- vullnetarisht ia zbulon policisë njohuritë e marrëveshjes në kohën kur vepra penale e planifikuar ende mund të parandalohet.

6. Marrëveshja për të kryer vepër penale

Marrëveshja për të kryer vepër penale është një institut ri në KRPK, me anë të së cilës inkriminohet vetë fakti i arritjes së marrëveshjes për të kryer vepër penale. Sipas nenit 35 paragrafi 1 të KPRK, kushdo që merret vesh me një apo me më shumë persona për të kryer vepër penale dhe një apo më shumë nga ata persona ndërmerr çfarëdo veprimi të rëndësishëm për kryerjen e veprës penale dënohet me dënimin e paraparë për atë vepër penale.

Ndërsa, në paragrafin 2 të këtij neni, është parashikuar se për qëllime të këtij neni, shprehja **“veprim i rëndësishëm drejt kryerjes së veprës penale”** nuk duhet të jetë veprim penal por duhet të jetë hap i rëndësishëm përgatitor drejt kryerjes së veprës penale të cilën personat janë pajtuar që ta kryejnë.

KAPITULLI VI

I. SANKSIONET PENALE

1. Nocioni dhe funksioni i sanksioneve penale

Sanksionet penale që parashikohen në të drejtën penale janë masa shtrënguese që zbatohen nga ana e shtetit me qëllim të luftimit dhe parandalimit të kriminalitetit. Me anë të sanksioneve penale, kryesit të veprës penale i kufizohen apo i merren të drejtat, liritë dhe vlerat e tjera shumë të rëndësishme, siç janë: liria e lëvizjes, pasuria, të drejta të caktuara, siç janë: e drejta pasive e votës, e drejta për të drejtuar automjetin, e drejta për të qëndruar në një shtet etj. Ndërsa, në disa shtete ku akoma njihet si lloj i sanksionit edhe dënimi me vdekje, kryesit të veprës penale i merret edhe jeta.

Në teorinë e së drejtës penale, theksohet se sanksionet penale janë masa të dhunshme penalo-juridike, të cilat i shqipton gjykata në procedurën e përcaktuar në ligj ndaj kryesit të veprës penale, me qëllim të mbrojtjes së shoqërisë dhe individit nga kriminaliteti, ndërsa konsistojnë në marrjen apo kufizimin e lirive dhe të drejtave të caktuara ose në paralajmërimin e kryesit se do t'i merren apo do t'i kufizohen liritë apo të drejtat, nëse sërish kryen veprë penale.

Duke u bazuar në këtë definicion dhe në atë që u tha më lart, sanksionet penale, kanë këto karakteristika themelore:

a) Me anë të sanksioneve penale shoqëria mbron nga kriminaliteti vlerat më të rëndësishme të individit dhe të shoqërisë në përgjithësi;

b) Sanksionet penale mund t'u shqiptohen vetëm kryesve të veprave penale;

c) Ndaj kryesve të veprave penale mund të shqiptohet vetëm ai sanksion penal që është parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale ("*nulla poena sine lege*");

ç) Sanksionet penale mund t'i shqiptojë vetëm gjykata në bazë të procedurës së përcaktuar me ligj dhe

d) Me anë të sanksioneve penale, kryesve të veprave penale u merren ose u kufizohen liritë dhe të drejtat e caktuara.

2. Sanksionet penale dhe masat tjera sipas të drejtës penale të Republikës së Kosovës

Sanksionet penale sipas nenit 4 paragrafi 1 të KPRK, ndahen në dy grupe:

1) Dënime dhe

2) Vërejtje gjyqësore.

Dënimet ndahen në :

- a) Dënime kryesore,
- b) Dënime plotësuese dhe
- c) Dënime alternative.

Përveç sanksioneve penale, në KPRK, janë të parashikuara edhe disa masa tjera të cilat aplikohen ndaj kategorive të caktuara të kryesve të veprave penale, siç janë p.sh. masat e trajtimit të detyrueshëm.

Masat e trajtimit të detyrueshëm, sipas nenit 4 paragrafi 2 të KPRK, janë:

- 1) Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor;
- 2) Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri dhe
- 3) Trajtimi me rehabilitim i personave të varur nga droga dhe alkooli.

Këto masa të trajtimit të detyrueshëm, sipas nenit 84 paragrafi 1 të KPRK, mund t'i shqiptohen kryesit i cili nuk është penalisht përgjegjës, ka aftësi esencialisht të zvogëluar mendore apo është i varur nga droga ose alkooli.

II. DËNIMET

1. Shqyrtime të përgjithshme

Dënimi është lloji më i vjetër i sanksioneve penale dhe deri në fund të shekullit XIX dënimi ka qenë i vetmi lloj i sanksioneve penale. Dënimi edhe tani është një domosdoshmëri dhe mjet kryesor në luftë kundër kriminalitetit.

Në teorinë e së drejtës penale njihet nocioni formal, material dhe formalo-material i dënimit.

Sipas **nocionit formal**, dënimi përkufizohet duke i marrë parasysh elementet juridike formale të dënimit, siç janë përcaktueshmëria e tij në ligj, ligjshmëria me rastin e caktimit të tij, organi i cili është kompetent për caktimin e tij, procedura e caktimit të tij etj.

Sipas **nocionit material**, dënimi përkufizohet duke e marrë parasysh qëllimin e dënimit e që është mbrojtja e qytetarit dhe shoqërisë nga kriminaliteti.

Sipas **nocionit formalo-material**, dënimi përkufizohet duke i marrë parasysh elementet e nocionit formal dhe material. Sipas këtij nocioni, dënimi përkufizohet si masë e dhunshme e parashikuar me ligj, të cilin e shqipton gjykata ndaj kryesit penalisht të përgjegjshëm të veprës penale, me qëllim të mbrojtjes së qytetarit dhe shoqërisë në përgjithësi dhe i cili konsiston në marrjen ose kufizimin e lirive dhe të drejtave të caktuara të kryesit të veprës penale.

Nga kjo që u tha më lart, rezulton se dënimi posedon këto elemente themelore:

a) Sipas brendisë së tij, dënimi duhet të paraqesë një vlerësim negativ moralo-etik ndaj veprës penale dhe kryesit;

b) Dënimi duhet të paraqesë një të keqe, e cila e godet personin i cili ka kryer vepër penale¹⁴³. Kjo e keqe qëndron në marrjen apo kufizimin e të mirave të caktuara juridike, siç janë: liria, pasuria, ndalimi i drejtimit të automjetit, ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë, detyrës ose funksionit, ndalimi i të drejtës për t'u zgjedhur etj.

c) Dënimi duhet të ketë qëllimin e caktuar, i cili dëshirohet të arrihet me ekzekutimin e tij. Qëllimi i përgjithshëm i dënimit është mbrojtja e shoqërisë dhe e qytetarëve prej veprave të rrezikshme, me të cilat dëmtohen apo rrezikohen vlerat më të rëndësishme të individit dhe të shoqërisë;

d) Dënimi duhet të jetë i përcaktuar në ligj. Ky është parimi i ligjshmërisë së dënimit i sublimuar në maksimumin e mirënjohur latine “*nulla poena sine lege*” (nuk mund të shqiptohet dënimi, nëse ai nuk është i parashikuar me ligj);

dh) Dënimi mund të shqiptohet vetëm ndaj kryesve të veprave penale të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë të përgjegjshëm dhe të fajshëm;

e) Dënimin mund ta shqiptojë vetëm gjykata në procedurën e përcaktuar me ligj.

2. Llojet e dënimeve

Sipas KPRK, dënimet ndahen në:

- a) Dënime kryesore,
- b) Dënime plotësuese dhe
- c) Dënime alternative.

Dënimet kryesore janë ato lloje të dënimit që ligji i parashikon se mund të shqiptohen si masë kryesore e ndëshkimit. Këto janë ato lloje të dënimeve që mund të shqiptohen si të vetme ndaj kryesit të veprës penale, pavarësisht prej llojit tjetër të dënimit.

Dënimet kryesore, sipas nenit 40 të KPRK janë:

- a) Dënimi me burgim të përhershëm,
- b) Dënimi me burgim dhe

¹⁴³SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 423; KAMBOVSKI, VLLADO, Vepra e cituar, f. 441.

c) Dënimi me gjobë.

Dënimet plotësuese janë ato lloje të dënimeve të cilat parimisht mund të shqiptohen vetëm krahas dënimit kryesor apo alternativ. Mirëpo, në nenin 59 paragrafi 3 të KPRK, është parashikuar se dënimi plotësues me ndalimin e drejtimit të automjetit mund të shqiptohet së bashku me dënimin me kusht, me vërejtjen e gjykatës ose me lirimin nga dënimi.

Dënimet plotësuese, në fakt, janë dënime komplementare dhe duhet ta përforcojnë efektin e dënimit kryesor. Në nenin 59 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar shprehimisht se dënimi plotësues mund të shqiptohet së bashku me dënimin kryesor ose dënimin alternativ.

Dënimet plotësuese sipas nenit 59 paragrafi 2 të KPRK, janë:

1. Heqja e të drejtës për t'u zgjedhur;
2. Urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit;
3. Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik;
4. Ndalimi i ushtrimit të profesionit, i veprimtarisë ose detyrës;
5. Ndalimi i drejtimit të automjetit;
6. Marrja e lejes së vozitjes;
7. Urdhri për publikimin e aktgjykimit dhe
8. Dëbimi i të huajit nga territori i Republikës së Kosovës.

Dënimet alternative janë rezultat i prirjeve bashkëkohore në të drejtën penale dhe kanë për qëllim që, në të gjitha rastet e mundshme të parashikuara me ligj, në vend të dënimit me burgim, të shqiptohen dënime alternative, që janë dënime jo izoluese, jo me burgim.

Dënimet alternative sipas nenit të KPRK janë:

1. Dënimi me kusht;
2. Gjysmëliria dhe
3. Urdhri për punë në dobi të përgjithshme.

Në paragrafin 2 të nenit 46 KPRK, është parashikuar se kur shqipton dënimin me kusht, gjykata po ashtu mund të shqiptojë:

1. Urdhrin për trajtim të detyrueshëm rehabilitues dhe
2. Urdhrin për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues

3. Qëllimi i dënimit

Qëllimet e dënimit janë parashikuar në nenin 38 të KPRK. Sipas kësaj dispozite ligjore, qëllimet e dënimit janë:

1. Të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij;
2. Të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale;
3. Të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe
4. Të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

4. Dënimet kryesore

4.1 Dënimi me burgim të përjetshëm

Dënimi me burgim të përjetshëm është dënimi më i rëndë që parashihet në KRPK. Dënimi me burgim të përjetshëm nënkupton privimin e lirisë së lëvizjes (qarkullimit) të personit të dënuar përgjithmonë, deri sa të jetojë personi i dënuar¹⁴⁴.

Dënimi me burgim të përjetshëm është dënim kryesor dhe mund të shqiptohet vetëm nëse është parashikuar në mënyrë shprehimore me ligj. Në KRPK, dënimi me burgim të përjetshëm është parashikuar për veprat më të rënda penale të kryera në rrethana veçanërisht rënduese ose për vepra penale që kanë shkaktuar pasoja shumë të rënda¹⁴⁵.

Dënimi me burgim të përjetshëm në asnjë rast nuk është parashikuar si lloj i vetëm i dënimit, madje as për llojet më të rënda të veprave penale. Një gjë e tillë është parashikuar në mënyrë shprehimore në nenin 41 paragrafi 2 të KRPK, sipas të cilit ligji nuk mund të parasheh dënimin me burgim të përjetshëm si të vetmin dënim kryesor për një vepër të veçantë penale. Me fjalë të tjera, dënimi me burgim të përjetshëm duhet që të parashihet çdo herë në mënyrë alternative me dënimin me burgim.

Dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund t'i shqiptohet personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i ka mbushur njëzetënjë (21) vjet ose personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka pasur aftësi esencialisht të zvogëluar mendore¹⁴⁶.

Meqë dënimi me burgim të përjetshëm është parashikuar dhe mund të shqiptohet vetëm për veprat penale jashtëzakonisht të rënda, në mënyrë që ky ta ruajë ashpërsinë, represionin e domosdoshëm, në nenin 90 paragrafi 3 të KRPK është parashikuar se personi i dënuar me burgim të përjetshëm mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur tridhjetë (30) vjet nga dënimi me burgim i shqiptuar. Periudha minimale e mbikëqyrjes nga ana e shërbimit sprovues do të jetë së paku pesë (5) vjet.

¹⁴⁴ SHALA, AFRIM, Hyrje në të drejtën penale, Botimi i tretë, Prishtinë, 2019, f. 170.

¹⁴⁵ Neni 41 paragrafi 1 i KRPK.

¹⁴⁶ Neni 41 paragrafi 3 i KRPK.

Në pjesën e posaçme të KPRK, dënimi me burgim të përjetshëm është parashikuar për këto vepra penale :

- Pranimi i kapitullimit dhe okupimit¹⁴⁷;
- Tradhtia ndaj vendit¹⁴⁸;
- Vrasja e përfaqësuesve të lartë të Republikës së Kosovës¹⁴⁹;
- Spiunazhi¹⁵⁰;
- Veprat e rënda kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës¹⁵¹;
- Kryerja e veprës terroriste¹⁵²;
- Gjenocidi¹⁵³;
- Krimet kundër njerëzimit¹⁵⁴;
- Krimet e luftës¹⁵⁵;
- Kontrabandimi me migrantë¹⁵⁶;
- Trafikimi me njerëz¹⁵⁷;
- Rrezikimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare¹⁵⁸;
- Rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to¹⁵⁹;
- Vrasja e rëndë¹⁶⁰;
- Rrëmbimi¹⁶¹;
- Shërbimet seksuale të viktimit të trafikimit¹⁶²;
- Sulmi seksual¹⁶³;
- Degradimi i integritetit seksual¹⁶⁴;
- Dhunimi¹⁶⁵;
- Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar¹⁶⁶ etj.

¹⁴⁷ Neni 116 i KPRK.

¹⁴⁸ Neni 117 i KPRK.

¹⁴⁹ Neni 119 i KPRK.

¹⁵⁰ Neni 124 i KPRK.

¹⁵¹ Neni 126 i KPRK.

¹⁵² Neni 129 i KPRK.

¹⁵³ Neni 142 i KPRK.

¹⁵⁴ Neni 143 i KPRK.

¹⁵⁵ Nenet 144, 145, 146, 147, etj. të KPRK.

¹⁵⁶ Neni 164 i KPRK.

¹⁵⁷ Neni 165 i KPRK.

¹⁵⁸ Neni 167 i KPRK.

¹⁵⁹ Neni 168 i KPRK.

¹⁶⁰ Neni 173 i KPRK.

¹⁶¹ Neni 191 i KPRK.

¹⁶² Neni 228 i KPRK.

¹⁶³ Neni 229 i KPRK.

¹⁶⁴ Neni 230 i KPRK.

¹⁶⁵ Neni 227 i KPRK.

¹⁶⁶ Neni 277 i KPRK.

4.2. Dënimi me burgim

Dënimi me burgim është lloji i dytë i dënimit me heqje të lirisë, i cili është parashikuar në nenin 42 të KPRK.

Sikundër dënimi me burgim të përjetshëm, edhe dënimi me burgim, është dënim kryesor. Mirëpo, ndryshe nga dënimi me burgim të përjetshëm, dënimi me burgim është i parashikuar për numrin më të madh të veprave penale.

Shqiptimi i dënimit me burgim është parashikuar gjithëherë edhe në mënyrë alternative me dënimin me burgim të përjetshëm. Në disa raste tjera, në raport me dënimin me gjobë, dënimi me burgim është parashikuar në mënyrë alternative apo kumulative.

Në KPRK është përcaktuar minimumi i përgjithshëm dhe maksimumi i përgjithshëm i dënimit me burgim.

Minimumi i përgjithshëm i dënimit me burgim është **30 (tridhjetë) ditë**, ndërsa maksimumi i përgjithshëm i dënimit me burgim është **25 (njëzetepesë) vjet**. Për vepra penale për të cilat ligji parasheh dënim me burgim të përjetshëm, gjykata mund të shqiptojë dënim me burgim deri në **35 (tridhjetepesë) vjet**¹⁶⁷.

Dënimi me burgim shqiptohet në vite dhe muaj të plotë. Ndërsa, nëse këtë lloj dënimi gjykata e shqipton në kohëzgjatje deri në gjashtë muaj, atëherë dënimi me burgim shqiptohet në ditë të plota¹⁶⁸.

Në nenin 44 dhe 45 të KPRK, është rregulluar mënyra e zëvendësimit të dënimit me burgim në dënim me gjobë ose me urdhër për punë në dobi të përgjithshme.

Kështu, sipas nenit 44 të KPRK, kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në gjashtë muaj, gjykata njëkohësisht mund të vendosë që dënimi me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, me pëlqimin e personit të dënuar. Në raste të tilla, kur dënimi në burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, gjykata nuk kufizohet me shkallën e përlllogaritjes të përcaktuar në nenin 43 paragrafi 3 të KPRK. Kjo do të thotë që rastet kur dënimi me burgim zëvendësohet me dënim me gjobë, sipas dispozitës së lartcekur ligjore, atëherë përlllogaritja e dënimit me burgim në dënim me gjobë nuk bëhet duke e llogaritur 1 (një) ditë burgim me 20 € (njëzet Euro) të dënimit me gjobë.

Ndërsa, sipas paragrafit 1 të nenit 45 të KPRK, gjykata, me pëlqimin e personit të dënuar, mund të zëvendësojë dënimin me burgim deri në 6 (gjashtë) muaj me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme.

Nëse e shqipton urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, gjykata e urdhëron personin e dënuar të kryejë punë në dobi të përgjithshme pa pagesë për një periudhë të caktuar kohore prej 30

¹⁶⁷ Neni 42 paragrafi 1 i KPRK.

¹⁶⁸ Neni 42 paragrafi 2 i KPRK.

(tridhjetë) deri në 240 (dyqind e dyzet) orë pune. Shërbimi sprovues vendos për llojin e punës në dobi të përgjithshme që duhet kryer nga personi i dënuar, cakton organizatën e veçantë për të cilën personi i dënuar do të kryejë punën në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës gjatë të cilave puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet dhe e mbikëqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme. Puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet brenda kohës së caktuar nga gjykata dhe kjo kohë nuk mund të jetë me gjatë se 1 (një) vit¹⁶⁹.

Sipas paragrafit 4 të nenit 45 të KPRK, nëse pas kalimit të kohës së caktuar personi i dënuar nuk e ka kryer punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht punën e tillë në dobi të përgjithshme, gjykata urdhëron dënimin me burgim. Një ditë burgim do të urdhërohet për çdo 8 (tetë) orë pune në dobi të përgjithshme që nuk është kryer.

Personi i dënuar me burgim mund të lirohet me kusht në përputhje me dispozitat e KPRK dhe me dispozitat e Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nëse ka bazë të arsyeshme se ai nuk do të kryejë vepër të re penale. Kur merret vendimi për lirim me kusht, duhet të merret parasysh sjellja e personit të dënuar gjatë mbajtjes së dënimit.

Personi i dënuar për vepër penale për të cilën është paraparë dënim me të paktën pesë (5) vjet burgim, mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur dy të tretat (2/3) e dënimit të shqiptuar. Për vepra tjera penale, personi i dënuar mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur gjysmën e dënimit të shqiptuar¹⁷⁰.

4.3. Dënimi me gjobë

Me anë të dënimit me gjobë, kryesi i veprës penale detyrohet që brenda afatit të caktuar të paguajë një shumë të parave në dobi të shtetit.

Dënimi me gjobë, si sanksion penal njihet nga të gjitha legjislacionet penale të shteteve bashkëkohore¹⁷¹.

Minimumi i përgjithshëm i dënimit me gjobë është 100 € (njëqind Euro), ndërsa maksimumi i përgjithshëm është **25.000 € (njëzetepesë mijë Euro)**, kurse për vepra penale lidhur me terrorizëm, trafikim me njerëz, krim të organizuar ose veprat penale të kryera me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore nuk mund të tejkalojë **500.000 € (pesëqind mijë Euro)**¹⁷².

Në paragrafin 2 të nenit 43 të KPRK, është parashikuar se në aktgjykim caktohet afati i pagesës së dënimit me gjobë. Afati nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë e as më i gjatë se 3 (tre) muaj, mirëpo në rrethana të arsyeshme gjykata mund të lejojë që dënimi me gjobë të paguhet me këste për një periudhë që nuk tejkalon 2 (dy) vjet. Aktgjykimi po ashtu

¹⁶⁹ Neni 46 paragrafët 2 dhe 3 të KPRK.

¹⁷⁰ Neni 90 paragrafët 1 dhe 2 të KPRK.

¹⁷¹SHALA, AFRIM, *Sistemet kryesore të caktimit të dënimit me gjobë në të drejtën penale bashkëkohore*, Revista "E drejta", Nr.2/2011, Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2011, f. 129-137.

¹⁷² Neni 43 paragrafi 1 i KPRK.

duhet të përcaktojë se kur duhet të paguhen këstet dhe duhet të cek se mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë.

Në nenin 43 të KPRK, është rregulluar edhe mënyra e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim ose urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Kështu, sipas paragrafit 3 të nenit 43 të KPRK, nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim. Kur dënimi me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, 1 (një) ditë burgim llogaritet me 20 (njëzet) Euro gjobë. Dënimi me burgim nuk mund të tejkalojë 3 (tre) vjet.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim, siç parashihet në paragrafin 3 të këtij neni. Nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet¹⁷³.

Ndërsa, nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e personit të dënuar, në vend të shqiptimit të dënimit me burgim, ta zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Urdhri për punë në dobi të përgjithshme llogaritet ashtu që 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme llogariten me 20 (njëzet) Euro gjobë. Kohëzgjatja e punës në dobi të përgjithshme nuk mund të tejkalojë 240 (dyqind e dyzet) orë¹⁷⁴.

Në paragrafin 6 të nenit 43 të KPRK, është parashikuar se dënimi me gjobë nuk ekzekutohet pas vdekjes së personit të dënuar.

5. Dënimet alternative

5.1. Shqyrtime të përgjithshme

Qëllimi kryesor i dënimeve alternative, të cilat janë të parashikuara me KPRK, është që në të gjitha rastet e mundshme të ushtrohet luftë efikase kundër kriminalitetit, pa u ekzekutuar dënimi me burgim, përkatësisht të luftohet kriminaliteti me sanksione dhe masa jo izoluese, jo me burgim. Një që e tillë mund të kuptohet edhe nga vetë fakti, se ligjdhënësi këto dënime i emërton “dënime alternative”¹⁷⁵.

Dënimet alternative janë parashikuar në nenin 46 të KPRK, kurse në nenet vijuese janë rregulluar në mënyrë më të hollësishme.

Sipas paragrafit 1 të nenit 46 të KPRK, dënimet alternative janë:

¹⁷³ Neni 43 paragrafi 4 i KPRK.

¹⁷⁴ Neni 43 paragrafi 5 i KPRK.

¹⁷⁵ SHALA, AFRIM, Roli i Shërbimit Sprovues në shqiptimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative, Gjilan, 2011, f. 1.

- 1) Dënimi me kusht;
- 2) Gjysmëliria dhe
- 3) Urdhri për punë në dobi të përgjithshme.

Në paragrafin 2 të nenit 46 të KPRK, është parashikuar se kur shqipton dënimin me kusht, gjykata, po ashtu mund të shqiptojë:

- 1) Urdhrin për trajtim të detyrueshëm rehabilitues dhe
- 2) Urdhrin për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues.

5.2. Dënimi me kusht

Dënimi me kusht është pezullim i ekzekutimit të dënit të shqiptuar për një kohë të caktuar dhe me kushte të caktuara. Nëse personi i dënuar me kusht nuk kryen vepër penale të re, brenda afatit të caktuar dhe nëse i përmbush kushtet të cilat ia ka caktuar gjykata, dënimi i shqiptuar nuk do të ekzekutohet. Në të kundërtën, nëse personi i dënuar me kusht gjatë afatit të pezullimit të këtij dënimi, kryen vepër të re penale apo nuk i përmbush kushtet e tjera, të cilat ia ka caktuar gjykata me rastin e shqiptimit të dënit me kusht, ky lloj i sanksionit penal mund të revokohet, përkatësisht do të revokohet, kështu që personi i dënuar me kusht do të detyrohet ta mbajë dënimin.

5.3. Forma themelore e dënit me kusht

Sipas paragrafit 2 të nenit 48 të KPRK, me rastin e caktimit të dënit me kusht, gjykata ia cakton kryesit të veprës penale dënimin dhe në të njëjtën kohë urdhëron që ky dënim të mos ekzekutohet nëse personi i dënuar nuk kryen vepër tjetër penale për kohën e verifikimit të cilën e cakton gjykata. Koha e verifikimit nuk mund të jetë më e shkurtër se 1 (një) vit dhe as më e gjatë se 5 (pesë) vjet. Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, rezulton se gjykata, kryesit të veprës penale ia cakton dënimin, të cilin edhe e shpall, mirëpo ekzekutimin e tij e shtyn, e pezullon për një kohë dhe me kushte të caktuara.

Qëllimi i dënit me kusht, sipas nenit 47 të KPRK, është që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale.

Sipas paragrafit 3 të nenit 48 të KPRK, në dënimin me kusht, gjykata mund të caktojë që dënimi të ekzekutohet, nëse në afatin e caktuar personi i dënuar nuk e kthen dobinë pasurore të fituar nga kryerja e veprës penale, nuk e kompenson dëmin që e ka shkaktuar me vepër penale ose nuk i përmbush detyrimet e tjera të parapara me dispozitat e KPRK. Gjkata cakton afatin për përmbushjen e këtyre kushteve në kuadër të kohës së verifikimit.

Në paragrafin 1 të nenit 49 të KPRK, është parashikuar se dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në 5 (pesë) vjet. Ndërsa, sipas paragrafit 2 të këtij neni, dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryesit edhe për vepër penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në 10 (dhjetë) vjet, nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit.

Përveç kësaj, dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryesit ashtu siç është paraparë në paragrafin 1 dhe 2 të nenit 49 të KPRK, kur gjykata e shqipton dënim me gjobë ose me burgim deri në 2 (dy) vjet qoftë për një vepër penale, qoftë për bashkim të veprave penale¹⁷⁶.

Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht, gjykata merr posaçërisht parasysh qëllimin e dënimit me kusht, sjelljen e mëparshme të kryesit, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale.

Nëse kryesit i është shqiptuar dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë, gjykata mund të shqiptojë dënimin me kusht për të dy dënimet apo vetëm për dënimin me burgim¹⁷⁷.

Dënimi me kusht mund të revokohet, që në praktikë do të thotë se ndaj personit të dënuar, do të ekzekutohet dënimi.

Revokimi i dënimit me kusht, mund të bëhet për këto tri shkaqe:

- a) Nëse i dënuari gjatë periudhës së verifikimit kryen vepër të re penale,
- b) Nëse pas shqiptimit të dënimit me kusht vërtetohet se i dënuari ka kryer vepër penale, para se të jetë dënuar me kusht dhe
- c) Nëse i dënuari nuk i ka përmbushur detyrimet, të cilat i janë caktuar me dënimin me kusht.

a) Revokimi i dënimit me kusht për shkak të veprës penale të re mund të jetë:

- obligativ dhe
- fakultativ.

Në mënyrë obligative, gjykata e revokon dënimin me kusht nëse personi i dënuar gjatë kohës së verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim prej së paku dy apo më tepër vjet¹⁷⁸.

Sipas paragrafit 2 të nenit 50 të KPRK, gjykata mund (mënyra fakultative) ta revokojë dënimin me kusht nëse i dënuari gjatë kohës së verifikimit kryen një apo shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim me më pak se dy vjet ose dënimi me gjobë pasi t'i ketë vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat u përkasin veprave penale të kryera, si dhe personit të

¹⁷⁶ Neni 49 paragrafi 3 i KPRK.

¹⁷⁷ Neni 49 paragrafët 4 dhe 5 të KPRK.

¹⁷⁸ Neni 50 paragrafi 1 i KPRK.

dënuar dhe sidomos ngjashmëritë e veprave penale të kryera, rëndësinë e tyre dhe motivet për kryerjen e veprave penale.

Nëse e revokon dënimin me kusht, gjykata shqipton dënimin unik për veprën penale të kryer më parë edhe për veprën e re penale, në pajtim me nenin 76 të KPRK dhe trajton dënimin e revokuar me kusht si të përcaktuar.

Nëse gjykata nuk e revokon dënimin me kusht, mund ta shqiptojë dënimin me kusht apo dënimin me burgim ose dënimin me gjobë për veprën e re penale. Nëse gjykata shqipton dënim me kusht për veprën e re penale, gjykata zbaton dispozitat e nenit 76 të KPRK për ta shqiptuar dënimin e bashkuar me kusht për veprën penale të kryer më parë dhe për veprën e re penale dhe po ashtu e cakton një periudhë të bashkuar të verifikimit e cila nuk mund të jetë më pak se 1 (një) vit e as më shumë se 5 (pesë) vjet, duke filluar prej ditës kur vendimi për dënimin bëhet i formës së prerë. Nëse gjykata shqipton dënim me burgim për veprën e re penale, periudha kohore që kalohet në mbajtjen e dënimit me burgim nuk hiqet nga koha e verifikimit e vendosur me dënimin me kusht për veprën penale të kryer më parë¹⁷⁹.

b) Gjkata e revokon dënimin me kusht nëse pas shqiptimit të dënimit me kusht, me vendim të formës së prerë konstaton se personi i dënuar ka kryer një vepër penale tjetër para se të jetë dënuar me kusht dhe nëse gjykata vlerëson se nuk do të kishte bazë për shqiptimin e dënimit me kusht po të dihej për atë vepër.

c) Nëse dënimi me kusht është kushtëzuar me përmbushjen e një apo më shumë kushteve të paraparë me paragrafin 3 të nenit 48 dhe nenin 56 të KPRK dhe personi i dënuar nuk përmbush kushtin apo kushtet brenda afatit të caktuar nga gjykata, gjykata mund ta vazhdojë afatin e përmbushjes së kushtit brenda afatit të verifikimit apo mund ta revokojë dënimin me kusht dhe ta ekzekutojë dënimin i cili është caktuar me dënimin me kusht. Nëse gjykata konstaton se personi i dënuar nuk ka mundur ta përmbushë kushtin për shkaqe të arsyeshme, gjykata e heq përmbushjen e atij kushti ose e zëvendëson atë me një kusht tjetër përkatës të paraparë me ligj.

5.4. Dënimi me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues

Dënimi me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues është lloji i dytë i dënimit me kusht dhe në përgjithësi, ky është një lloj i dënimit alternativ, i cili ndaj kryesve të veprave penale mund të shqiptohet në vend të dënimit me burgim.

Sipas paragrafit 1 të nenit 54 të KPRK, gjykata mund të shqiptojë dënim me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues në rast se personi i dënuar e ka shkelur ligjin për herë të parë dhe është i varur nga droga ose alkooli, nëse gjykata, pas shqyrtimit të raportit të shërbimit sprovues, konsideron se faktori kryesor që ka motivuar kryerjen e veprës penale është i lidhur me varësinë e tij nga droga ose alkooli dhe se trajtimi i suksesshëm do ta zvogëlonte rrezikun për kryerjen e veprës së re penale. Gjkata cakton periudhën gjatë së cilës programi

¹⁷⁹ Neni 50 paragrafët 3 dhe 4 të KPRK.

për trajtim të detyrueshëm duhet të fillojë dhe të përfundojë. Periudha e trajtimit të detyrueshëm nuk mund të jetë më pak se 3 (tre) muaj apo më tepër se 12 (dymbëdhjetë) muaj.

Nga kjo dispozitë ligjore rezulton se dënimi me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues, është i dedikuar ndaj kategorisë së atyre kryesve të veprave penale, të cilët janë alkoolistë apo narkomanë dhe nëse gjykata konstaton se pikërisht vartësia ndaj alkoolit apo drogës ka qenë faktori kryesor që ka kontribuar të kryhet vepra penale.

Me dënimin me kusht me urdhër për trajtim, kryesit të veprës penale gjithashtu i tërhiqet vërejtja seriozisht për shkak të veprës penale dhe i shqiptohet ky lloj dënimi.

Personit të dënuar me kusht me urdhër për trajtim rehabilitues, gjykata ia cakton detyrimin që ai të mjekohet. Ky mjekim nënkupton realizimin e një programi të posaçëm mjekësor, me të cilin personi do të lirohet nga vartësia e alkoolit apo e drogës¹⁸⁰. Programin e trajtimit e mbikëqyrë Shërbimi Sprovues i Kosovës.

Sipas paragrafit 3 të nenit 54 të KPRK, ky lloj dënimi me kusht do të konsiderohet se është mbajtur, nëse kryhet me sukses programi i trajtimit.

Në paragrafin 4 të nenit 54 të KPRK, është parashikuar se nëse personi i dënuar largohet nga programi i trajtimit rehabilitues, nuk mban kontaktin me shërbimin sprovues ose nuk i përmbush detyrimet lidhur me urdhrin për trajtim, gjykata mund të zëvendësojë detyrimin e mëparshëm me një tjetër, ta shtyjë kohëzgjatjen e urdhrin për trajtim ose ta revokojë dënimin me kusht dhe të urdhërojë ekzekutimin e dënimit të caktuar në dënimin me kusht.

5.5. Dënimi me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues

Për nga natyra, përmbajtja dhe mënyra e ekzekutimit, dënimi me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues është një formë e dënimit me kusht të tipit anglo-amerikan, ngase ka të bëjë me pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, si dhe me kontrollin dhe dhënien ndihmë kryesit të veprës penale¹⁸¹.

Gjykata mund të shqiptojë dënimin me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues nëse konsideron se integrimi i të dënuarit në shoqëri ose përmbushja e kushteve të shqiptuara nga gjykata arrihet më mirë përmes mbikëqyrjes nga ana e shërbimit sprovues¹⁸².

Kur shqipton dënimin me kusht me urdhër të mbikëqyrjes nga shërbimi sprovues, gjykata e urdhëron personin e dënuar për të mbajtur kontaktin me shërbimin sprovues.

Gjatë kohës së verifikimit, të cilën ia cakton gjykata brenda minimumit dhe maksimumit të parashikuar në ligj, shërbimi sprovues i jep personit të dënuar me këtë lloj të dënimit me kusht

¹⁸⁰SHALA, AFRIM, Roli i Shërbimit Sprovues në shqiptimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative, Gjilan, 2011, f. 3.

¹⁸¹SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 470.

¹⁸² Neni 55 paragrafi 1 i KPRK.

ndihmë, kujdeset dhe e mbikëqyrë nëse personi i dënuar është duke i përmbushur detyrat e caktuara nga gjykata.

Gjykata po ashtu mund t'i urdhërojë personit të dënuar të kryejë një ose më shumë detyrime në vijim:

1. Mjekimi ose rehabilitimi në entin e kujdesit shëndetësor;
2. Nënshtrimi në programin e trajtimit mjekësor ose të rehabilitimit;
3. Vizita te psikologu ose te këshilluesit e tjerë dhe veprimi në pajtim me rekomandimet e tyre;
4. Aftësimi profesional në një profesion të caktuar;
5. Kryerja e aktiviteteve punuese;
6. Shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave apo pasurisë tjetër për përmbushjen e detyrimeve familjare;
7. Mos ndërrimi i vendbanimit pa informuar shërbimin sprovues;
8. Heqja dorë nga përdorimi i alkoolit apo i drogës;
9. Heqja dorë nga frekuentimi i vendeve apo lokaleve të caktuara;
10. Heqja dorë nga shoqërimi ose kontaktimi me persona të caktuar;
11. Heqja dorë nga mbajtja e çfarëdo lloji të armëve;
12. Të kompensojë ose dëmshpërblejë viktimën e veprës penale;
13. Të kthejë dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale;
14. Të mos posedojë apo përdor kompjuterin ose të mos qaset në internet siç kërkohet nga gjykata ose
15. Të ofrojë raporte financiare siç kërkohet nga gjykata¹⁸³.

Me rastin e zgjedhjes midis detyrimeve të lartcekura, gjykata në veçanti merr parasysh moshën e personit të dënuar; gjendjen e tij të përgjithshme shëndetësore dhe mendore; mënyrën e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht nevojat në lidhje me familjen, shkollën dhe punën; motivet për kryerjen e veprës penale; sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale; sjelljen e tij të kaluar; rrethanat e tij personale dhe ato në lidhje me familjen dhe rrethanat tjera që janë të rëndësishme për zgjedhjen e llojit dhe kohëzgjatjes së mbikëqyrjes¹⁸⁴.

¹⁸³ Neni 56 i KPRK.

¹⁸⁴ Neni 55 paragrafi 3 i KPRK.

Nëse personi i dënuar nuk mban kontaktin me shërbimin sprovues ose nuk e përmbush detyrimin e paraparë me nenin 56 të KPRK, siç është urdhëruar nga gjykata, gjykata mund ta zëvendësojë detyrimin e mëparshëm me një tjetër, ta shtyjë kohëzgjatjen e mbikëqyrjes në kuadër të kohës së verifikimit ose ta revokojë dënimin me kusht¹⁸⁵.

5.6. Dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme

Puna në dobi të përgjithshme, është lloji i katërt i dënimit alternativ i cili është i parashikuar në KPRK. Puna në dobi të përgjithshme apo në interes të përgjithshëm, është një dënim i ri, i cili është paraqitur për herë të parë në vitet e shtatëdhjeta në disa vende të Evropës perëndimore dhe në SHBA. Në fillim, në shtetet ku është parashikuar puna në dobi të përgjithshme apo në interes të përgjithshëm, si lloji i dënimit alternativ, zbatimi i tij është bërë në mënyrë selektive dhe eksperimentale, me një rreth të ngushtë të njerëzve dhe të vendit dhe pastaj gradualisht është shtrirë në tërë vendin¹⁸⁶.

Puna në dobi të përgjithshme si dënim alternativ qëndron në atë se me aktgjykim të gjykatës, kryesit të veprës penale i caktohet detyrimi që brenda një periudhe të caktuar, të kryejë punë në dobi të përgjithshme apo në interes të përgjithshëm dhe këto punë në dobi apo në interes të përgjithshëm i dënuari i kryen pa pagesë.

Sipas nenit 57 paragrafi 1 të KPRK, gjykata mund t'ia shqiptojë personit të dënuar dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme nëse kryesit i shqipton dënim me gjobë deri në 2.500 (dymijë e pesëqind) Euro ose me burgim deri në 1 (një) vit. Puna në dobi të përgjithshme mund të caktohet vetëm me pëlqimin e personit të dënuar.

Andaj, duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, gjykata mund të shqiptojë dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, nëse plotësohen këto kushte:

- që gjykata, kryesit të veprës penale t'i ketë caktuar dënimin me burgim deri në 1 (një) vit ose dënimin me gjobë deri në 2.500 (dymijë e pesëqind) Euro dhe

- të jepet pëlqimi i të dënuarit për kryerjen e punës në dobi të përgjithshme.

Nëse e shqipton dënimin me kusht me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, gjykata e urdhëron personin e dënuar të kryejë pa pagesë punë në dobi të përgjithshme për një periudhë të caktuar prej 30 deri në 240 orë pune.

Shërbimi sprovues vendos për llojin e punës në dobi të përgjithshme që duhet të kryhet nga personi i dënuar, cakton organizatën e veçantë për të cilën personi i dënuar do të kryejë punën në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës gjatë të cilave puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet dhe mbikëqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme¹⁸⁷.

¹⁸⁵ Neni 55 paragrafi 4 i KPRK.

¹⁸⁶ SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 474.

¹⁸⁷ Neni 57 paragrafi 2 i KPRK.

Në nenin 57 paragrafi 3 të KPRK, është parashikuar se puna në dobi të përgjithshme kryhet brenda një periudhe kohore të përcaktuar nga gjykata, e cila nuk e tejkalon 1 (një) vit.

Sipas paragrafit 4 të këtij neni, në rastet e shqiptimit të dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, gjykata po ashtu urdhëron personin e dënuar të përmbushë njërin apo disa prej këtyre detyrimeve:

- të mbajë kontakte me shërbimin sprovues,
- të kthejë dobinë pasurore të fituar nga kryerja e veprës penale,
- të kompensojë dëmin e shkaktuar me veprën penale,
- të përmbushë detyrimet e tjera të parashikuara me ligjin penal, si dhe

- të përmbushë njërin apo disa prej pesëmbëdhjetë llojeve të detyrimeve të parashikuara me nenin 56 të KPRK.

Nëse personi i dënuar nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme, ose e kryen pjesërisht gjykata mund ta shtyjë kohëzgjatjen e mbikëqyrjes brenda kohës së verifikimit ose ta revokojë dënimin. Nëse pas kalimit të kohës së caktuar personi i dënuar nuk e ka kryer punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht punën e tillë në dobi të përgjithshme, gjykata urdhëron dënimin me burgim. 1 (një) ditë burgim do të urdhërohet për çdo 8 (tetë) orë pune në dobi të përgjithshme që nuk është kryer¹⁸⁸.

5.7. Gjysmëliria

Gjysmëliria, si dënim alternativ është parashikuar në nenin 58 të KPRK. Sipas paragrafit 1 të këtij neni, kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në 1 (një) vit, mund të urdhërojë ekzekutimin e dënimit me gjysmëliri për shkak të detyrimeve të personit të dënuar lidhur me punën, arsimimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë esenciale familjare apo me nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor.

Kur e mban dënimin në gjysmëliri, personi i dënuar detyrohet që të kthehet në burg pas kryerjeve të detyrimeve jashtë burgut brenda kohës së caktuar nga gjykata.

Siç shihet, gjysmëliria mund të shqiptohet për rastet e veprave penale relativisht të lehta dhe nëse gjykata konstaton se është e dobishme për kryesin dhe shoqërinë që pjesërisht të mundësohet qëndrimi në liri për vazhdimin apo përfundimin e ndonjë pune të rëndësishme. Krahas kësaj, që të mundë ta shqiptojë këtë lloj dënimi, gjykata duhet të formojë bindjen se edhe me këtë lloj të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, përmirësimi i kryesit dhe se ai në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale.

¹⁸⁸ Neni 57 paragrafët 5 dhe 6 të KPRK.

Në paragrafin 3 të nenit 58 të KPRK, është parashikuar se nëse personi i dënuar nuk i përmbush detyrimet që lidhen me punën, arsimin ose aftësimin profesional, nuk i kryen detyrimet themelore familjare, nuk pranon trajtimin e nevojshëm mjekësor apo rehabilitues apo nuk kthehet në burg pas kryerjes së detyrimeve të tij, gjykata e revokon urdhrin për ekzekutimin e dënimit në gjysmëliri dhe urdhëron mbajtjen e dënimit të mbetur në burg.

Kur gjykata urdhëron ekzekutimin e dënimit në gjysmëliri, ajo po ashtu mund të shqiptojë një apo më shumë nga kushtet e përcaktuara me nenin 48 paragrafi 3 ose nenin 56 të KPRK¹⁸⁹.

6. Dënimet plotësuese

6.1. Shqyrtime të përgjithshme

Dënimet plotësuese janë lloje të posaçme të sanksioneve penale, të cilat u paraqitën si rezultat i njohurive se dënimet kryesore nuk mund të jenë të vetmet mjete efikase ndaj të gjithë kryesve të veprave penale. Për këtë arsye, në të drejtën penale u formësua mendimi se, krahas dënimit kryesor, duhet parashikuar edhe sanksione të tjera penale me karakter komplementar apo plotësues, me të cilat do të bëhej i mundshëm parandalimi më efektiv i kriminalitetit dhe risocializimi i personave të dënuar¹⁹⁰.

Në nenin 59 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se dënimi plotësues mund të shqiptohet së bashku me dënimin kryesor ose alternativ. Ndërsa, në paragrafin 3 të këtij neni, është parashikuar se dënimi plotësues me ndalimin e drejtimit të automjetit ose konfiskimi mund të shqiptohet së bashku me dënimin me kusht, me vërejtjen e gjykatës ose me lirim nga dënimi.

6.2. Sistemi i dënimeve plotësuese

Në nenin 59 të KPRK, janë parashikuar në mënyrë taksative dënimet plotësuese dhe kushtet që duhet të plotësohen për t'u shqiptuar këto dënime. Sipas kësaj dispozite ligjore, dënimet plotësuese janë:

1. Heqja e të drejtës për t'u zgjedhur;
2. Urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit;
3. Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik;
4. Ndalimi i ushtrimit të profesionit, i veprimtarisë ose detyrës;
5. Ndalimi i drejtimit të automjetit;

¹⁸⁹ Neni 58 paragrafi 4 i KPRK.

¹⁹⁰SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 479.

6. Marrja e lejes së vozitjes;
7. Urdhri për publikimin e aktgjykimit dhe
8. Dëbimi i të huajit nga territori i Republikës së Kosovës.

1) Heqja e të drejtës për t'u zgjedhur - Ky dënim plotësues është parashikuar në nenin 60 të KPRK, në të cilin thuhet se gjykata ia heq kryesit të veprës penale të drejtën për t'u zgjedhur prej 1 (një) deri në 4 (katër) vjet, nëse ai person, me qëllim që të zgjidhet, kryen ndonjë nga veprat penale kundër të drejtave të votimit ose vepër tjetër penale për të cilën është paraparë dënimi me së paku 2 (dy) vjet burgim.

Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, dënimi plotësues heqja e të drejtës për t'u zgjedhur mund të shqiptohet në dy raste:

a) Në rastin e parë, këtë dënim gjykata e shqipton nëse personi me qëllim që të zgjidhet si këshilltar në kuvendin komunal, deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës etj., gjatë procesit të zgjedhjeve, kryen ndonjë nga veprat penale kundër të drejtave të votimit.

b) Në rastin e dytë, këtë dënim plotësues gjykata e shqipton, kur personi me qëllim që të zgjidhet kryen vepër penale për të cilën është parashikuar dënimi me së paku 2 (dy) vjet burgim.

Përmes këtij dënimi plotësues, personi i dënuar privohet nga e drejta pasive e votës, për një kohë të caktuar me aktgjykimin e gjykatës, e cila nuk mund të jetë më e shkurtër se një vit e as më gjatë se tre vjet.

2) Urdhri për kompensimin e humbjes ose dëmit - Urdhri për kompensimin e humbjes ose dëmit është një dënim i ri plotësues që parashihet në KPRK. Sipas nenit 61 paragrafi 1 të KPRK, kur gjykata dënon personin i cili është shpallur fajtor për çfarëdo vepre penale që përfshin vjedhjen, humbjen, dëmtimin apo shkatërrimin e pasurisë, gjykata do të urdhërojë kryesin që të bëjë dëmshpërblimin e viktimës së veprës penale. Pra, siç shihet në rastet kur gjykata e ka shpallur fajtor kryesin për kryerjen e veprave penale që përfshin vjedhjen, humbjen, dëmtimin apo shkatërrimin e pasurisë, atëherë gjykata duhet që ta urdhërojë kryesin që të bëjë dëmshpërblimin e viktimës së veprës penale.

Dëmshpërblimi përfshin vlerën e shpenzimeve që janë të barabarta me vlerën e çfarëdo pasurie të vjedhur, humbur, dëmtuar apo shkatërruar. Dëmshpërblimi do të urdhërohet gjithashtu edhe për çfarëdo humbje të të ardhurave të cilat viktimat i përjeton si rezultat i veprës penale dhe procedurave hetimore dhe gjyqësore lidhur me atë vepër¹⁹¹.

3) Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik - Dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në

¹⁹¹ Neni 61 paragrafi 2 të KPRK.

shërbimin publik, gjykata do t'ia shqiptojë personit prej 1 (një) deri në 5 (pesë) vjet pas mbajtjes së dënimit me burgim, nëse personi i tillë ka keqpërdorur këto funksione dhe është dënuar me burgim. Në këto raste, gjykata do ta shqiptojë këtë dënim plotësues në mënyrë obligative.

Gjykata mund t'ia ndalojë kryesit ushtrimin e funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik prej 1 (një) deri në 3 (tre) vjet, nëse personi i tillë i ka keqpërdorur këto funksione dhe është dënuar me gjobë ose me dënim me kusht.

Ndërsa, në paragrafin 3 të nenit 62 të KPRK, është parashikuar se gjykata ia ndalon një personi zyrtar ushtrimin e funksionit në administratë publike apo funksioneve të shërbimeve publike prej 1 (një) deri në 10 (dhjetë) vjet, nëse personi është dënuar për ndonjë nga veprat që përfshihen në Kapitullin XXXIII të këtij Kodi (Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare).

Përmes këtij dënimi plotësues, personi i dënuar privohet për një kohë të caktuar nga e drejta e ushtrimit të funksioneve të caktuara në administratën publike ose në shërbimin publik.

4) Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës - Sipas nenit 63 të KPRK, kryesit të veprës penale gjykata mund t'ia ndalojë ushtrimin e profesionit të caktuar, veprimtarisë së pavarur, detyrës menaxhuese apo administrative ose detyrave që janë të lidhura me sistemimin, menaxhimin apo shfrytëzimin e pasurisë në pronësi publike apo mbrojtjen e pasurisë së tillë, nëse ai person e ka keqpërdoruar pozitën e tij, veprimtarinë apo detyrën me qëllim të kryerjes së veprës penale ose nëse ka arsye të pritet që ushtrimi i profesionit, veprimtarisë apo detyrës së tillë nga ai mund të keqpërdoret për kryerjen e veprës penale.

Kohëzgjatja e këtij dënimi, nuk mund të jetë më e shkurtër se 1 (një) vit e as më e gjatë se 5 (pesë) vjet, duke llogaritur nga dita kur vendimi merr formën e prerë. Koha e mbajtur në burg ose në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatje të këtij dënimi¹⁹².

Sipas paragrafit 3 të nenit 63 të KPRK, kur shqipton dënimin me kusht, gjykata mund të vendosë që ky dënim me kusht të revokohet nëse kryesi nuk e respekton ndalesën e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë apo detyrës.

Gjykata ia ndalon një personi zyrtar ushtrimin e profesionit, aktivitetit të pavarur, të detyrës menaxhuese apo administrative prej 1 (një) deri në 10 (dhjetë) vjet, nëse personi është dënuar për ndonjë nga veprat në Kapitullin XXXIII të këtij Kodi (Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare).

Gjykata ia shqipton kryesit të veprës penale trafikimit me njerëz, nga neni 165 i KPRK apo të veprave penale kundër integritetit seksual, të kryer ndaj fëmijës, ndalimin e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës që përfshin kontaktin e rregullt me fëmijë. Gjykata mund ta shqiptojë këtë dënim në kohëzgjatje të përjetshme, i cili i nënshtrohet shqyrtimit periodik gjyqësor nga gjykata pas skadimit të 10 (dhjetë) viteve nga fillimi i ekzekutimit të masës së

¹⁹² Neni 63 paragrafët 1 dhe 2 të KPRK.

shqiptuar. Gjykata mund ta ndalojë ekzekutimin e saj me propozim të personit të dënuar nëse ka vërtetuar se arsyet për ndalimin nuk ekzistojnë më. Personi i dënuar mund të paraqesë përsëri propozimin e tij apo të saj, por jo më herët se 1 (një) vit pas shqyrtimit të mëparshëm¹⁹³.

Personi i dënuar, përmes këtij dënimi plotësues, privohet nga e drejta për të ushtruar profesionin e caktuar, veprimtarinë apo detyrën e caktuar, për një kohë të caktuar.

5) Ndalimi i drejtimit të automjetit - Sipas paragrafit 1 të nenit 64 të KPRK, kryesit të veprës penale, i cili e rrezikon sigurinë në trafikun publik, gjykata mund t'ia ndalojë drejtimin e automjetit të llojit apo të kategorisë së caktuar. Gjykata e cakton kohëzgjatjen e këtij dënimi plotësues dhe ajo nuk mund të jetë më e shkurtër se 1 (një) vit dhe më e gjatë se 5 (pesë) vjet, duke filluar nga dita kur vendimi të marrë formën e prerë. Koha e kaluar në burg apo në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi.

Në paragrafin 3 të nenit të lartcekur, është parashikuar se në rastet kur është shqiptuar dënimi me kusht, gjykata mund të vendosë që dënimi i tillë të revokohet nëse kryesi e shkel ndalesën e drejtimit të automjetit. Ky paragraf nuk zbatohet nëse paraqiten rrethana të jashtëzakonshme të cilat kërkojnë nga kryesi që të drejtojë automjetin.

Kurse, sipas paragrafit 4 të nenit 64 të KPRK, nëse dënimi nga paragrafi 1 i këtij neni i është shqiptuar personit, i cili e ka lejen e huaj për drejtimin e automjetit, ky dënim do të konsistojë në ndalimin për përdorimin e kësaj leje në territorin e Kosovës.

Përmes këtij dënimi plotësues, personi i dënuar privohet nga e drejta e drejtimit të automjetit të llojit apo të kategorisë së caktuar, për një kohë të caktuar.

6) Marrja e lejes së vozitjes - Në paragrafin 1 të nenit 65 të KPRK, është parashikuar se kryesit të veprës penale që e rrezikon sigurinë në trafikun publik gjykata mund t'ia marrë lejen e vozitjes për llojin apo kategorinë e caktuar të automjetit dhe t'ia ndalojë kryesit marrjen e lejes së re gjatë periudhës prej 1 (një) deri në 5 (pesë) vjet. Nëse kryesi nuk ka leje të vozitjes, gjykata ia ndalon kryesit marrjen e lejes së vozitjes brenda afatit të lartcekur.

Gjykata mund të shqiptojë dënimin plotësues marrja e lejes së vozitjes, nëse kryesi ka kryer vepër penale duke shkaktuar lëndimin e rëndë trupor apo vdekjen e personit ose nëse gjykata konstaton se pjesëmarrja e mëtejshme e tij në trafikun publik është e rrezikshme për sigurinë në trafikun publik për shkak të paaftësisë së tij për drejtimin e sigurt të automjetit.

Sipas paragrafit 3 të nenit 65 të KPRK, leja e vozitjes merret me vendim të formës së prerë të gjykatës. Koha e kaluar në burg apo në entin shëndetësor nuk i llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi.

¹⁹³ Neni 63 paragrafët 4 dhe 5 të KPRK.

Pas skadimit të afatit, të cilin ia ka caktuar gjykata, kryesi mund ta marrë lejen e re të vozitjes sipas kushteve të përgjithshme të parapara për marrjen e lejes përkatëse të vozitjes¹⁹⁴.

7) Urdhri për publikimin e aktgjykimit - Sipas nenit 66 të KPRK, gjykata mund të urdhërojë publikimin e aktgjykimit kur çmon se publikimi është në interes të përgjithshëm, të të dëmtuarit ose të personave të tjerë. Urdhri për publikimin e aktgjykimit kërkon që aktgjykimi të publikohet tërësisht ose pjesërisht në gazetë, të transmetohet në radio ose në televizion me shpenzimet e të dënuarit. Data e publikimit dhe kohëzgjatja caktohen nga gjykata.

Gazeta, radiostacioni ose stacioni televiziv e publikojnë aktgjykimin të cilin ua ka dërguar gjykata.

Sipas paragrafit 5 të nenit 66 të KPRK, publikimi i aktgjykimit nuk urdhërohet nëse e rrezikon fshehtësinë zyrtare, privatësinë e personave apo moralin e shoqërisë.

8) Dëbimi i të huajve nga territori i Republikës së Kosovës - Gjkata mund të urdhërojë dëbimin e të huajit nga territori i Republikës së Kosovës në kohëzgjatje prej 1 (një) deri në 10 (dhjetë) vjet¹⁹⁵.

Kur gjykata vendos për shqiptimin e dënimit dëbimi i të huajve nga territori i Republikës së Kosovës dhe kohëzgjatjen e këtij dënimi, ajo duhet të marrë parasysh llojin dhe peshën e veprës penale, motivet e kryerjes së veprës penale dhe lidhjen e kryesit me Republikën e Kosovës.

Dënimi plotësues dëbimi i të huajve nga territori i Republikës së Kosovës nuk shqiptohet nëse ekzekutimi i dënimit është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.¹⁹⁶

Kohëzgjatja e dëbimit llogaritet nga dita kur vendimi gjyqësor merr formën e prerë. Koha e mbajtur në burg ose në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi.¹⁹⁷

III. VËREJTJA GJYQËSORE

Shqyrtime të përgjithshme

Siç është cekur edhe më parë, përveç dënimeve, si sanksion penal sipas KPRK konsiderohet edhe vërejtja gjyqësore. Esenca e vërejtjes gjyqësore konsiston në atë se kryesit të veprës penale i bëhet me dije se ka kryer një veprë të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën veprë penale dhe nëse kryen prapë veprë të tillë, gjykata do të shqiptojë sanksion më të rëndë penal¹⁹⁸.

¹⁹⁴ Neni 65 paragrafi 4 i KPRK.

¹⁹⁵ Neni 67 paragrafi 1 i KPRK.

¹⁹⁶ Neni 67 paragrafët 2 dhe 3 i KPRK.

¹⁹⁷ Neni 67 paragrafi 4 i KPRK.

¹⁹⁸ Neni 82 paragrafi 1 i KPRK.

Siç shihet pra, vërejtja gjyqësore, në brendinë e saj, paraqet qortim serioz dhe publik që i bëhet kryesit të veprës penale nga gjykata dhe njëherazi i tërhiqet vërejtja që në të ardhmen të mos kryejë vepra penale, sepse për vepra të tilla penale do të dënohet. Në këtë pikëpamje, ky lloj i sanksionit penal ka ngjashmëri me qortimin si masë edukuese që është paraparë për kryesit e mitur të veprave penale¹⁹⁹. Qëllimi i vërejtjes gjyqësore është që t'i jepet kryesit qortimi kur, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me veprën dhe kryesin, vërejtja gjyqësore është e mjaftueshme për të arritur qëllimin e dënimit²⁰⁰.

Duke e pasur parasysh natyrën e saj, vërejtja gjyqësore mund të shqiptohet vetëm për vepra të lehta penale. Sipas nenit 82 paragrafët 2 dhe 3 të KPRK, vërejtja gjyqësore mund të shqiptohet për dy kategori të veprave penale dhe atë:

1. Për vepra penale për të cilat është paraparë dënimi me burgim deri në 1 (një) vit ose dënimi me gjobë, në rastet kur veprat e tilla janë kryer në rrethana lehtësuese të cilat i bëjnë veprat penale veçanërisht të lehta dhe
2. Për vepra penale të caktuara për të cilat është paraparë dënimi deri në 3 (tri) vjet, sipas kushteve të përcaktuara me ligj²⁰¹.

Duke u bazuar në nenet 81 dhe 82 të KPRK, rezulton se vërejtja gjyqësore mund të shqiptohet nëse plotësohen këto kushte:

1. Nëse është fjala për vepra të lehta penale;
2. Nëse shqiptimi i dënimit nuk është i domosdoshëm për mbrojtjen penalo-juridike dhe
3. Nëse gjykata formon bindjen se me këtë lloj të sanksionit do të ndikohet që kryesi në të ardhmen të mos kryejë vepra penale²⁰².

Ekziston mundësia që gjykata të mundë të shqiptojë vërejtjen e gjykatës edhe për më shumë se një veprë penale të kryer në bashkim, nëse për çdonjërin nga këto vepra ekzistojnë kushtet ligjore të lartcekura.

Me rastin e vendosjes për shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, gjykata veçanërisht merr parasysh qëllimin e vërejtjes gjyqësore, sjelljen e kryesit në të kaluarën, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale dhe pjesëmarrjen vullnetare të kryesit në programin e trajtimit²⁰³

¹⁹⁹SALIHU, ISMET-ZHITJA, HILMI-HASANI, FEJZULLAH, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Komentar, Botimi I, 2014, Prishtinë, f. 290.

²⁰⁰ Neni 81 i KPRK.

²⁰¹ Në nenin 185 paragrafi 4 të KPRK (vepra penale lëndimi i lehtë trupor), është parashikuar në mënyrë shprehimore mundësia e shqiptimit të vërejtjes gjyqësore, edhe pse për veprën penale nga paragrafi 1 të këtij neni është parashikuar dënimi me burgim deri në 3 (tre) vjet. Kështu, në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se "Gjykata mund të shqiptojë vërejtjen gjyqësore ndaj kryesit të veprës nga paragrafi 1 të këtij neni, nëse kryesi është provokuar nga sjellja çnjerëzore apo e vrazhdë e të dëmtuarit".

²⁰²SALIHU, ISMET-ZHITJA, HILMI-HASANI, FEJZULLAH, Vepra e cituar, f. 290.

²⁰³ Neni 86 paragrafi 5 i KPRK.

KAPITULLI VII

MATJA E DËNIMIT DHE PARASHKRIMI

I. MATJA E DËNIMIT

1. Shqyrtime të përgjithshme

Pasi që gjykata të ketë vërtetuar se personi i caktuar është kryes i veprës së caktuar penale, atëherë nëse plotësohen edhe kushtet tjera ligjore, duhet që ndaj kryesit të matet dënimi. Me matje të dënimit nënkuptojmë caktimin e llojit dhe të lartësisë së dënimit ndaj kryesit të veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit, duhet medoemos të merren parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, në mënyrë që të caktohet ai lloj dhe masë e dënimit që do t'i përgjigjet peshës së veprës së kryer penale dhe rrezikshmërisë shoqërore të kryesit dhe me të cilën më së miri do të arrihet qëllimi i dënimit.

Kur e cakton dënimin për veprë penale, gjykata duhet të ketë parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për atë veprë penale. Gjkata, pastaj duhet të marrë parasysh qëllimin e dënimit, parimet e përcaktuara në këtë kapitull dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese lidhur me veprën penale të caktuar ose me dënimin. Dënimi

duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryesit²⁰⁴.

Në nenin 69 paragrafi 3 të KPRK, është parashikuar me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme:

1. Shkallën e përgjegjësisë penale;
2. Motivet për kryerjen e veprës;
3. Intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur;
4. Rrethanat në të cilat është kryer vepra;
5. Sjelljen e mëparshme të kryesit;
6. Pranimin e fajit dhe
7. Rrethanat personale të kryesit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale.

1) Shkalla e përgjegjësisë penale - Shkalla e përgjegjësisë penale, siç është cekur më parë, në vete përmban shkallën e përgjegjësisë dhe të fajësisë. Meqë përgjegjësia dhe fajësia, si elemente të përgjegjësisë penale, mund të shkallëzohen, mund të shkallëzohet edhe përgjegjësia penale. Kështu që, në përgjegjësinë penale mund të ndikojnë rrethanat se kryesi i

²⁰⁴ Neni 69 paragrafët 1 dhe 2 të KPRK.

veprës penale ka qenë plotësisht apo pjesërisht i përgjegjshëm. Gjithashtu, në shkallën e përgjegjësisë penale mund të ndikojë edhe rrethana nëse kryesi veprën e ka kryer me dashje të drejtpërdrejtë, me dashje eventuale apo nga pakujdesia me vetëdije apo pa vetëdije. Nga shkalla e përgjegjësisë dhe llojit të fajësisë varet se a do të shqiptohet një masë më e vogël apo një masë më e madhe e dënimit.

2) Motivet nga të cilat është kryer vepra penale janë shkaqe psikike, të cilat e kanë shtyrë personin të kryejë veprën penale. Motivet mund të jenë të dobëta për nga natyra e tyre, si, p.sh., urrejtja, shpirtligësia, egoizmi, hakmarrja, interesi etj. Në këto raste, këto motive konsiderohen si rrethana rënduese. Mirëpo, motivet nga të cilat kryhen veprat penale mund të jenë edhe pozitive (humane), si p.sh. nga dhembshuria, nga dashuria, nga ndjenja e detyrimit apo nderit etj. dhe në raste të tilla, këto motive mund të konsiderohen si rrethana lehtësuese.

3) Intensiteti i rrezikimit ose i dëmtimit të së mirës së mbrojtur është një rrethanë objektive, e cila flet për një shkallë më të lartë ose më të ulët të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe ajo si e tillë, ndikon në matjen e dënimit.

4) Rrethanat në të cilat është kryer vepra penale mund të jenë të natyrës objektive dhe subjektive, si dhe mund t'i referohen veprës penale, kryesit të saj, si dhe subjektit pasiv të veprës penale.

Këto rrethana mund t'i përkasin kohës, mjeteve, mënyrës dhe vendit të kryerjes së veprës penale, disa gjendjeve psikike të kryesit dhe viktimës, raporteve të tyre etj.

5) Sjellja e mëparshme e kryesit është gjithashtu e rëndësishme për të çmuar personalitetin e kryesit dhe rrezikshmërinë e tij shoqërore. Kështu, p.sh., nëse një person në jetën e tij të mëparshme ka pasur sjellje korrekte dhe ka qenë shembull për të mirë në mjedisin e tij, këto tregojnë se kryesi nuk është moralisht i prishur dhe se me zbatimin e një dënimi më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit. Në të kundërtën, nëse kryesi i veprës penale ka qenë edhe më parë i dënuar apo nëse ka zhvilluar një jetë në kundërshtim me rregullat shoqërore apo morale, si p.sh. bredhja, luajtja bixhoz, konsumimi i tepërt i alkoolit etj., atëherë këto veti do t'i merren si rrethana rënduese me rastin e matjes së dënimit, ngase tregojnë qartë se për t'u arritur qëllimi i dënimit, duhet shqiptuar një lloj dhe një masë më e rëndë dënimi.

6) Pranimi i fajit nga kryesi i veprës penale është me rëndësi të posaçme në të drejtën penale. Në këtë mënyrë, nëse kryesi i veprës penale e pranon fajin dhe pranon se ka kryer një veprë penale, e cila është e dëmshme për personin tjetër dhe shoqërinë, kjo tregon se ai është penduar dhe në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale dhe do të sillet mirë. Mirëpo, nëse kryesi nuk e pranon fajin, kjo rrethanë tregon se një person i këtyllë ende nuk e ka kuptuar ose nuk do të kuptojë se ka kryer një veprë të dëmshme, e cila është parashikuar si veprë penale dhe njëherësh kjo rrethanë mund të jetë një tregues se një personi i tillë edhe në të ardhmen do të kryejë vepra penale.

7) Rrethana personale dhe sjellja e kryesit pas kryerjes së veprës penale, gjithashtu, janë me rëndësi për matjen e dënimit dhe këto mund të jenë një tregues se çfarë sjellje do të ketë në

të ardhmen kryesi. Kështu, pranimi i kryerjes së veprës penale ose mohimi kategorik i saj përkundër provave të pakontestueshme, mandej pendimi real ose kënaqësia që shfaq për kryerjen e veprës penale, dhënia e ndihmës viktimës dhe familjes së tij etj., janë rrethana që medoemos ndikojnë që atij t'i shqiptohet një dënim më i butë ose më i rëndë.

Përveç këtyre që u ceken më lartë, në nenin 69 paragrafi 5 të KPRK, është parashikuar se me rastin e caktimit të dënimit me gjobë, gjykata merr parasysh edhe gjendjen pasurore të kryesit dhe posaçërisht merr parasysh shumën e të ardhurave personale, të ardhurat e tjera, pasurinë dhe detyrimet e tij. Gjkata nuk cakton gjobë në lartësinë që është mbi mundësitë e kryesit.

2. Individualizimi i dënimit

Gjkata me rastin e matjes së dënimit ndaj kryesit të veprës penale, duhet që ta individualizojë dënimin. Me individualizim të dënimit nënkuptohet përshtatja e dënimit me veprën penale dhe kryesin e saj dhe qëllimi i individualizimit të dënimit është që të shqiptohet dënim i tillë i cili në mënyrë më efikase do të ndikojë në riedukimin e kryesit të veprës penale dhe në parandalimin e kriminalitetit. Individualizimi i dënimit në të drejtën penale bashkëkohore duhet të bëhet duke respektuar edhe parimin e ligjshmërisë, si lidhur me llojin, ashtu dhe me lartësinë e dënimit.

3. Rrethanat rënduese dhe lehtësuese

Matja e dënimit nga ana e gjykatës bëhet brenda minimumit dhe maksimumit të dënimit të parashikuar me ligj për veprën e caktuar penale, si dhe duke i marrë për bazë rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Në nenin 70 paragrafi 2 dhe 3 të KPRK, janë parashikuar në mënyrë taksative si rrethanat rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese të cilat gjykata duhet t'i marrë parasysh gjatë matjes së dënimit. Sipas këtyre dispozitave ligjore, përveç këtyre rrethanave që janë cekur në mënyrë taksative, gjykatës i është dhënë mundësia që në çdo rast konkret të marrë parasysh edhe rrethana të tjera, të cilat mund të ndikojnë që të caktohet një dënim më i rreptë apo më i butë. Në kuadër të këtyre rrethanave, gjenden rrethanat objektive, që i referohen veprës penale dhe rrethanat subjektive, që i referohen kryesit.

Me rrethana rënduese kuptojmë ato rrethana të cilat ndikojnë që dënimi të jetë më i rëndë brenda kufijve të parashikuar me ligj për atë vepër penale, ndërsa **me rrethana lehtësuese** kuptojmë ato rrethana të cilat ndikojnë që dënimi të jetë më i butë, gjithashtu brenda kufijve të përcaktuar me ligj.

Rrethanat rënduese janë parashikuar në paragrafin 2 të nenit 70 të KPRK, sipas të cilit me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme rënduese:

1. Shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale;
2. Shkallën e lartë të dashjes nga ana e personit të dënuar, përfshirë çfarëdo prove të paramendimit;

3. Prezencën e dhunës ose kanosjes me dhunë në kryerjen e veprës penale;
4. Nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore;
5. Nëse vepra penale përfshin disa viktime;
6. Nëse viktime e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme;
7. Moshën e viktimës, nëse është i ri apo i moshuar;
8. Shkallën e dëmit të shkaktuar nga personi i dënuar, përfshirë vdekjen, lëndimin e përhershëm, transmetimin e sëmundjes tek viktime apo çfarëdo dëmi tjetër të shkaktuar viktimës ose familjes së tij;
9. Çfarëdo keqpërdorimi të pushtetit ose pozitës zyrtare nga personi i dënuar në kryerjen e veprës penale;
10. Dëshmi të shkeljes së besimit nga ana e personit të dënuar;
11. Nëse vepra penale është kryer si pjesë e veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal;
12. Nëse vepra penale është akt i urrejtjes, që nënkupton cilëndo veprë penale të kryer ndaj personit, grupit të personave, ose pronës, motivuar në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, identitetit gjinor, gjuhës, fesë, prejardhjes kombëtare apo shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronë, gjendjes ekonomike, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal, ose për shkak të afërsisë me personat me karakteristikat e lartpërmendura, përveç nëse ndonjë nga këto karakteristika përbën element të veprës penale;
13. Ndonjë dënim penal të mëparshëm të personit të dënuar dhe
14. Nëse vepra penale kryhet brenda marrëdhënies familjar

Ndërsa, rrethanat lehtësuese janë parashikuar në paragrafin 3 të nenit 70 të KPRK, sipas të cilit me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme lehtësuese:

1. Rrethanat të cilat për pak nuk arrijnë të jenë bazë për përjashtimin e përgjegjësisë penale, si për shembull, aftësia e zvogëluar mendore;
2. Dëshmia për provokim nga ana e viktimës;
3. Rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar;
4. Dëshmia që personi i dënuar ka luajtur rol relativisht të vogël në veprën penale;
5. Fakti që personi i dënuar ka marrë pjesë në veprën penale jo si kryes kryesor, por përmes ndihmës, inkurajimit ose duke ndihmuar tjetrin në ndonjë mënyrë tjetër;

6. Moshë e personit të dënuar, i ri apo i moshuar;
7. Dëshmia që personi i dënuar ka bërë restituimin apo kompensimin e viktimës;
8. Bashkëpunimi i përgjithshëm i personit të dënuar me gjykatën, përfshirë dorëzimin vullnetar;
9. Bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin ose ndjekjen penale;
10. Pranimin e fajit;
11. Keqardhjen e shfaqur nga personi i dënuar;
12. Sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit;
13. Në rastet kur personi është i dënuar për veprën penale të marrjes së pengjeve, rrëmbimit apo privimit të kundërligjshëm nga liria ose siç përcaktohet në nenet 169, 191 ose 193 të KPRK, kontributi në mënyrë efektive për lëshimin ose për ta sjellë të gjallë personin e rrëmbyer, marrë apo ndalur ose dhënia vullnetare e informatave që kontribuojnë në identifikimin e përgjegjësve të tjerë për veprën penale dhe
14. Në lidhje me veprat penale të terrorizmit të përcaktuara me KPRK, fakti që kryesi i veprës penale heq dorë nga veprimtaria terroriste para se të ketë pasoja të rënda prej saj dhe i ofron policisë, prokurorëve ose autoriteteve gjyqësore informata, të cilat, organet e tilla, nuk do të kishin mundësi t'i siguronin; ndihmon në parandalimin ose zbutjen e efekteve të veprës penale; identifikon me detaje të mjaftueshme për të lejuar arrestimin ose ndjekjen penale të ndonjë terroristi apo grupi terrorist; gjen prova apo parandalon vepra të tjera terroriste.

4. Zbutja e dënimit

Gjykata e cakton dënimin ndaj kryesit të veprës penale vetëm brenda minimumit dhe maksimumit të dënimit të përcaktuar me ligj për atë veprën penale, duke u bazuar edhe në rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Mirëpo, në jetën e përditshme mund që vepra penale të kryhen në rrethana të caktuara të cilat veprën penale e bëjnë veçanërisht të lehtë dhe në këto raste, caktimi i dënimit brenda kufijve të minimumit dhe maksimumit të posaçëm nuk do të ishte në pajtim me parimin e drejtësisë dhe nuk do t'i përgjigjej qëllimit të dënimit - dënimi do të ishte i rreptë²⁰⁵. Duke e marrë për bazë këtë, në nenet 71 dhe 72 të KPRK, janë parashikuar rastet kur gjykata ka mundësi që të shqiptojë dënim nën minimumin e posaçëm apo të shqiptojë dënim më të butë.

Zbutja e dënimit është një institut, i cili është i njohur në të gjitha legjislacionet penale të shteteve të regjionit dhe më gjerë.

²⁰⁵SALIHU, ISMET, Vepra e cituar, f. 503.

Zbutja e dënimit zbatohet kur me ligj parashikohet mundësia që gjykata të shqiptojë dënimin nën minimumin e posaçëm të dënimit të parashikuar për atë vepër penale dhe këtë deri në minimumin e përgjithshëm të atij lloji të dënimit apo që ta zëvendësojë dënimin e parashikuar për atë vepër me një lloj dënimi më të butë.

Në nenin 71 të KPRK, është parashikuar se gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit:

1. Kur ligji parasheh që dënimi i kryesit mund të zbutet apo të zvogëlohet;
2. Kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese, të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë; ose
3. Në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Andaj, duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, në të drejtën tonë penale njihen tri lloje të zbutjes së dënimit:

- a) zbutja e dënimit në rastet kur shprehimisht parashikohet me ligj,
- b) zbutja e dënimit sipas bindjes së gjykatës dhe
- c) zbutja e dënimit në rastet kur kryesi e pranon fajësinë apo ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Zbutja e dënimit në KPRK është parashikuar në këto raste:

- te tejkalimi i kufijve të mbrojtjes së nevojshme²⁰⁶;
- te tejkalimi i kufijve të nevojës ekstreme²⁰⁷;
- te dhuna ose kanosja²⁰⁸;
- te veprat e kryera nën shtrëngim²⁰⁹;
- te lajthimi juridik²¹⁰;
- te tentativa²¹¹;
- te ndihma, si formë e bashkëpunimit²¹²;
- te bashkimi kriminal, nëse kryesi heq dorë vullnetarisht nga marrëveshja apo ndërmer veprime tjera të parashikuar me ligj²¹³;
- te vepra penale shtytja në vetëvrasje dhe ndihma në vetëvrasje, nëse vetëvrasja vetëm është tentuar që të kryhet²¹⁴;

²⁰⁶ Neni 12 paragrafi 4 i KPRK.

²⁰⁷ Neni 13 paragrafi 3 i KPRK.

²⁰⁸ Neni 14 paragrafi 2 i KPRK.

²⁰⁹ Neni 15 paragrafi 3 i KPRK.

²¹⁰ Neni 26 paragrafi 2 i KPRK.

²¹¹ Neni 28 paragrafi 3 i KPRK.

²¹² Neni 33 paragrafi 1 i KPRK.

²¹³ Neni 34 paragrafi 2 i KPRK.

²¹⁴ Neni 177 paragrafi 5 i KPRK.

- te vepra penale e rrëmbimit, nëse kryesi në mënyrë vullnetare e liron personin e rrëmbyer para se kërkesat për të cilat është kryer rrëmbimi, të jenë përmbushur²¹⁵;
- te vepra penale sulmi ndaj personit zyrtar, nëse kryesi është provokuar nga veprimi i kundërligjshëm apo i vrazhdë i personit zyrtar²¹⁶ etj.

Pra, siç po shihet, zbutja e dënimit është parashikuar si në pjesën e përgjithshme, ashtu edhe në pjesën e posaçme të KPRK.

Në nenin 72 të KPRK, janë parashikuar kufijtë e zbutjes së dënimeve. Sipas paragrafit 1 të këtij neni, kur ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 71 i KPRK, gjykata mund të zbusë dënimin brenda këtyre kufijve në vijim:

1. Nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej së paku dhjetë (10) vjet, dënimi mund të zbutet deri në pesë (5) vjet burgim;

2. Nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej së paku pesë (5) vjet, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) vjet burgim;

3. Nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej së paku tre (3) vjet, dënimi mund të zbutet deri në një (1) vit burgim;

4. Nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej dy (2) vjet, dënimi mund të zbutet deri në gjashtë (6) muaj burgim;

5. Nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej një (1) viti, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) muaj burgim;

6. Nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim me më pak se një (1) vit, dënimi mund të zbutet deri në tridhjetë (30) ditë burgim;

7. Nëse për veprën penale nuk është paraparë masa më e ulët e dënimit, atëherë mund të shqiptohet dënimi me gjobë në vend të dënimit me burgim;

8. Nëse për veprën penale nuk është paraparë shuma më e ulët e gjobës, gjoba mund të zbutet deri në njëqind (100) Euro.

Në paragrafin 2 të nenit 72 të KPRK, është parashikuar se me rastin e vendosjes së shkallës së zbutjes së dënimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, gjykata në veçanti merr parasysh shkallën më të ulët dhe më të lartë të dënimit të paraparë për vepër penale.

5. Lirimi nga dënimi

Në nenin 73 të KPRK është parashikuar mundësia e lirimit nga dënimi nga ana e gjykatës dhe duhet theksuar se gjykata mund ta lirojë kryesin e veprës penale nga dënimi vetëm në rastet kur ligji shprehimisht e parashikon këtë mundësi. Bazuar në çfarë u tha më lart, mund të

²¹⁵ Neni 191 paragrafi 5 i KPRK.

²¹⁶ Neni 402 paragrafi 7 i KPRK.

konstatohet se gjykata nuk mundet ta lirojë nga dënimi kryesin e veprës penale, sipas bindjes së saj të lirë.

Sipas KPRK, njihen dy grupe të rasteve kur kryesi mund të lirohet nga dënimi. Grupi i parë i rasteve është parashikuar **me dispozitat e pjesës së përgjithshme të KPRK**, ndërsa grupi i dytë **me dispozitat e pjesës së posaçme të KPRK**.

Me dispozitat e pjesës së përgjithshme të KPRK, mundësia e lirimit nga dënimi është parashikuar në këto raste:

- te tejkalimi i kufijve të mbrojtjes së nevojshme²¹⁷;
- te tejkalimi i kufijve të nevojës ekstreme²¹⁸;
- te tentativa e papërshtatshme²¹⁹;
- te heqja dorë vullnetare²²⁰ dhe
- te bashkimi kriminal, nëse kryesi heq dorë vullnetarisht nga marrëveshja apo ndërmerr veprimet tjera të parashikuar me ligj²²¹.

Me dispozitat e pjesës së posaçme të KPRK, gjithashtu janë parashikuar rastet kur gjykata mund ta lirojë nga dënimi kryesin e veprës penale. Raste të tilla janë parashikuar te këto vepra penale:

- te vepra penale bashkimi për veprimtari kundër kushtetuese, nëse anëtari i grupit apo i bashkimit e lajmëron grupin para kryerjes së veprës penale²²²;
- te vepra penale organizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës, nëse anëtari i grupit e paraqet grupin para se të ketë kryer veprën penale²²³;
- te vepra penale shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës, nëse kryesi i përmbush detyrimet, para se gjykata ta shqiptojë aktgjykimin²²⁴ etj.

Me rastin e lirimit nga dënimi, gjykata merr aktgjykimin, me të cilin e shpall fajtor kryesin e veprës penale, por e liron nga dënimi²²⁵.

Sipas nenit 73 paragrafi 2 të KPRK, kur gjykata është e autorizuar me ligj që kryesin e veprës penale ta lirojë nga dënimi, ajo mund t'ia zbusë dënimin pa marrë parasysh kufizimet e parapara për zbutjen e dënimit.

²¹⁷ Neni 12 paragrafi 4 i KPRK.

²¹⁸ Neni 13 paragrafi 3 i KPRK.

²¹⁹ Neni 29 i KPRK.

²²⁰ Neni 30 paragrafi 1 i KPRK.

²²¹ Neni 34 paragrafi 2 i KPRK.

²²² Neni 127 paragrafi 3 i KPRK.

²²³ Neni 154 paragrafi 3 i KPRK.

²²⁴ Neni 245 paragrafi 5 i KPRK.

²²⁵ Neni 365 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.3. i KPP.

Në nenin 74 të KPRK, është parashikuar në mënyrë shprehimore mundësia e lirimit nga dënimi për **rastet e posaçme të veprave penale të kryera nga pakujdesia**. Sipas kësaj dispozite ligjore, gjykata mund ta lirojë nga dënimi kryesin e veprës penale të kryer nga pakujdesia në këto situata:

- 1) nëse pasojat e veprës penale e goditin aq rëndë kryesin e veprës penale, sa që dënimi do të ishte i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij ose
- 2) nëse kryesi, menjëherë pas kryerjes së veprës penale, ka bërë përpjekje për evitimin ose zvogëlimin e pasojave të asaj vepre dhe nëse në tërësi apo në një masë të madhe e ka kompensuar dëmin e shkaktuar me atë vepër.

6. Matja e dënimit për bashkim të veprave penale

Bashkimi i veprave penale ekziston në rastet kur kryesi me një ose me shumë veprime kryen një ose më shumë vepra penale, për të cilat gjykohet në të njëjtën kohë dhe për të gjitha këto vepra penale i shqiptohet një dënim unik. Në nenin 76 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se nëse kryesi me një apo me më shumë veprime kryen disa vepra penale për të cilat gjykohet në të njëjtën kohë, gjykata së pari shpall dënime për secilën nga këto vepra, e pastaj për të gjitha këto vepra e shqipton dënimin unik.

Në teorinë e së drejtës penale dhe në legjislacionet penale të shteteve bashkëkohore, njihen tri sisteme të matjes së dënimit unik për veprat penale në bashkim dhe atë:

- 1) sistemi i absorbcionit,
- 2) sistemi i asperacionit dhe
- 3) sistemi i kumulacionit.

1) Sipas sistemit të absorbcionit matet dënimi për çdo vepër penale, mirëpo si dënim unik shqiptohet dënimi më i rëndë i cili i absorbon dënimet më të lehta. Në të drejtën tonë penale, ky sistem aplikohet në rastet kur shqiptohet dënimi me burgim të përjetshëm. Kështu, në nenin 76 paragrafi 2 nën-paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se nëse për ndonjërin prej veprave penale gjykata ka shpallur dënimin me burgim të përjetshëm, atëherë e shqipton vetëm këtë dënim. Pra, sipas kësaj dispozite ligjore, dënimi me burgim të përjetshëm i absorbon në vete dënimet tjera të shqiptuara.

2) Sipas sistemit të asperacionit, së pari maten dënimet veç e veç për çdo vepër penale në bashkim, mandej dënimi më i rëndë merret për bazë, kurse dënimet e tjera i shtohen këtij, por me kusht që dënimi unik të mos e arrijë shumën e të gjitha dënimeve e as mos ta tejkalojë maksimumin e përgjithshëm të atij lloji të dënimit të përcaktuar me ligj. Sistemi i asperacionit aplikohet në rastet kur caktohet dënimi me burgim. Kështu, në nenin 76 paragrafi 2 nën-paragrafi 2 të KPRK, është parashikuar se nëse për secilën prej veprave penale gjykata ka shqiptuar dënimin me burgim, dënimi unik duhet të jetë më i madh se çdo dënim i veçantë, por

dënimi unik nuk mund ta arrijë shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara dhe as të tejkalojë periudhën prej 25 (njëzetepesë) vjetësh;

3) Sipas sistemit të kumulacionit, së pari maten dënimet veç e veç për çdo vepër penale në bashkim, e më pas mbledhen të gjitha dënimet dhe shuma e tyre paraqet dënimin unik. Ky sistem aplikohet vetëm në rastet kur gjykata shqipton dënim me gjobë dhe një gjë e tillë është parashikuar në nenin 76 paragrafi 2 nën-paragrafi 4 i KPRK. Sipas kësaj dispozite ligjore, nëse gjykata ka shqiptuar dënime me gjobë për secilën nga veprat penale, dënimi unik me gjobë është shuma e dënimeve të shqiptuara por nuk mund të tejkalojë shumën prej 25.000 (njëzetepesëmijë) Euro, përkatësisht 500.000 (pesëqind mijë) Euro kur një apo shumë vepra penale janë kryer me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore.

Në nenin 76 paragrafi 2 nën-paragrafi 3 të KPRK, është parashikuar se nëse gjykata e ka shqiptuar dënimin me burgim deri në 3 (tri) vjet për secilën nga veprat penale, dënimi unik me burgim nuk mund të jetë më i lartë se 8 (tetë) vjet, ndërsa sipas nenit 76 paragrafi 2 nën-paragrafi 5 të KPRK, nëse gjykata për disa vepra penale ka shqiptuar dënime me burgim, ndërsa për vepra të tjera ka shqiptuar dënimin me gjobë, gjykata shqipton dënim unik me burgim dhe me gjobë, në pajtim me nën-paragrafët 1 deri 4 të këtij paragrafi.

7. Llogaritja e paraburgimit dhe e dënimin të mëparshëm

Sipas dispozitave të KPP, paraburgimi dhe arresti shtëpiak konsiderohen masa të cilat mund të përdoren për të siguruar praninë e të pandehurit, për pengimin e rikryerjes së veprës penale dhe për zbatimin e suksesshëm të procedurës penale. Edhe pse këto masa nuk konsiderohen dënime, në KPRK është parashikuar se koha e kaluar nën këto masa do të llogaritet në dënimet e shqiptuara, përkatësisht në masat edukative institucionale ndaj të miturve. Kështu, në nenin 79 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak, si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim, burgim për të mitur, në masën edukative institucionale dhe dënimin me gjobë.

Gjithashtu, edhe dënimi me burgim ose me gjobë të cilin personi i dënuar e ka mbajtur, përkatësisht e ka paguar për kundërvajtje apo për delikt ekonomik, përfshihet në dënimin e shqiptuar për vepër penale, elementet e së cilës përfshijnë edhe elementet e kundërvajtjes apo të deliktit ekonomik²²⁶. Në anën tjetër, edhe masa mbrojtëse e cila është shqiptuar për kundërvajtje ose për delikt ekonomik përfshihet në dënimin plotësues për vepër penale, elementet e së cilës i përfshijnë edhe elementet e kundërvajtjes apo të deliktit ekonomik²²⁷.

Sipas nenit 79 paragrafi 4 të KPRK,

1 (një) ditë paraburgim,

²²⁶ Neni 79 paragrafi 2 i KPRK.

²²⁷ Neni 79 paragrafi 3 i KPRK.

1 (një) ditë heqje lirie,

1 (një) ditë burgim dhe

20 € (njëzet Euro) të dënimit me gjobë barazohen për qëllime të llogaritjes sipas këtij neni²²⁸.

Në nenin 80 të KPRK, është parashikuar edhe llogaritja e paraburgimit dhe e dënimeve të mbajtura në juridiksione të tjera. Kështu, sipas kësaj dispozite ligjore, paraburgimi, heqja e lirisë gjatë procedurës së transferimit të personit në një juridiksion tjetër dhe pjesa e dënimit të cilin e ka mbajtur kryesi sipas aktgjyqimit të gjykatës së huaj do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar nga gjykata në Kosovë për të njëjtën vepër, e nëse dënimi i shqiptuar jashtë Kosovës nuk është i llojit të njëjtë, llogaritja do të bëhet sipas vlerësimit të gjykatës.

II. PARASHKRIMI

1. Shqyrtime të përgjithshme

Parashkrimi apo siç emërtohet ndryshe “vjetërsimi” është një institucion juridik që shpie në pushimin e procedurës penale dhe shuarjen e sanksioneve penale, për shkak të kalimit të kohës së caktuar me ligj. Kur paraqitet parashkrimi, shteti e humb të drejtën e zbatimit të sanksioneve penale ndaj kryesit të veprës penale.

Në çdo fazë të procedurës penale, gjykata dhe organet e tjera të ndjekjes penale si dhe organet e ekzekutimit të sanksioneve penale, janë të detyruara që, sipas detyrës zyrtare, të kujdesen, ta marrin parasysh dhe ta zbatojnë parashkrimin.

Në të drejtën penale njihen dy lloje të parashkrimit:

- 1) parashkrimi i ndjekjes penale dhe
- 2) parashkrimi i ekzekutimit të dënimit.

2. Parashkrimi i ndjekjes penale

Parashkrimi i ndjekjes penale qëndron në atë se, për shkak të kalimit të kohës së parashikuar me ligj, nuk mund të ndërmerret ndjekja penale dhe personit nuk mund t'i shqiptohet dënimi për vepër penale që e ka kryer. Koha që duhet të kalojë për t'u bërë parashkrimi, quhet afati i parashkrimit.

²²⁸ Në nenin 57 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë (Ndryshuar paragrafi i III me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001, neni 6) është parashikuar se “Koha e paraburgimit llogaritet në dënimin me burgim ose me gjobë, si dhe në detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik si më poshtë: Një ditë paraburgim baras me një ditë e gjysmë burgim. Një ditë paraburgim baras me 5 mijë lekë gjobë. Një ditë paraburgim baras me tetëmbëdhjetë orë pune në interes publik”.

Afatet e parashkrimit janë të shumëllojshme dhe se sado të jetë i gjatë ky afat, varet nga lloji dhe lartësia e dënimit të parashikuar për veprën e caktuar penale.

Afatet e parashkrimit të ndjekjes penale janë parashikuar në paragrafin 1 të nenit 99 të KPRK. Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se përveç nëse shprehimisht parashihet ndryshe me këtë Kod, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar afatet e mëposhtme:

-Tridhjetë (30) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim të përjetshëm;

-Njëzet (20) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se dhjetë (10) vjet burgim;

-Pesëmbëdhjetë (15) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se pesë (5) vjet burgim;

-Dhjetë (10) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se tre (3) vjet burgim;

-Gashtë (6) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim dhe

-Katër (4) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në një (1) vit burgim ose me dënim me gjobë.

Afatet e lartcekura e përbëjnë **parashkrimin relativ të ndjekjes penale**. Varësisht prej dënimit të parashikuar për veprën penale, minimumi i afatit të parashkrimit relativ të ndjekjes penale është 4 (katër) vjet, ndërsa maksimumi 30 (tridhjetë) vjet.

Në paragrafin 2 të nenit 99 të KPRK, është parashikuar se nëse për veprën penale janë parashikuar shumë dënime, afati i parashkrimit caktohet sipas dënimit më të rëndë.

Afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të ecë nga dita kur është kryer vepra penale. Nëse ndonjë pasojë që përbën element të veprës penale shfaqet më vonë, afati i parashkrimit fillon të rrjedh nga ajo kohë²²⁹.

Në rast se vepra penale është kryer kundër personit nën moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjet, afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga dita kur viktima të ketë mbushur 18 (tetëmbëdhjetë) vjet²³⁰.

Gjatë afatit të parashkrimit mund të paraqiten rrethana të caktuara, të cilat e pengojnë ecjen e parashkrimit të ndjekjes penale dhe shpijnë në ndalje dhe ndërprerje. Në rastet e ndaljes dhe të ndërprerjes, në fakt vazhdojnë afatet e parashkrimit relativ.

Ndalja e parashkrimit të ndjekjes penale paraqitet atëherë kur, për shkak të disa rrethanave të parashikuara me ligj, ndjekja penale nuk mund të fillohet apo, nëse është filluar nuk mund të

²²⁹ Neni 100 paragrafi 1 i KPRK.

²³⁰ Neni 100 paragrafi 2 i KPRK.

vazhdohet sipas ligjit. Gjatë kësaj kohe, derisa janë të pranishme ato rrethana, të cilat e pengojnë fillimin apo vazhdimin e ndjekjes penale, parashkrimi nuk rrjedh. Një gjë e tillë është parashikuar në nenin 100 paragrafi 3 të KPRK, sipas së cilës afati i parashkrimit nuk rrjedh për kohën gjatë së cilës ndjekja nuk mund të fillohet apo të vazhdohet sipas ligjit, përfshirë, por pa u kufizuar në rrethanat e mëposhtme:

1. Kur kryesi është jashtë Republikës së Kosovës dhe kjo shkakton vonesa në procedurë;
2. Kur kryesi kërkohet me urdhërarrest;
3. kur pritet për një kërkesë ligjore ndërkombëtare për të marrë informacion ose prova para një vendi ose autoriteti të huaj; ose
4. Gjatë kohës sa zgjatë procedura për pranimin e fajësisë.

Kur pushojnë (mënjahohen) pengesat që e kanë shkaktuar ndaljen e parashkrimit, afati i parashkrimit vazhdon të ecë. Në këto raste, për aq kohë sa ka zgjatur ndalja, për aq kohë vazhdohet edhe afati i parashkrimit. Në nenin 100 paragrafi 7 të KPRK, është parashikuar se pas çdo ndërprerje fillon të rrjedhë afati i ri i parashkrimit.

Në teorinë e së drejtës penale njihen dy lloje të pengesave, të cilat mund të shkaktojnë ndaljen e afatit të parashkrimit: pengesat faktike dhe pengesat juridike.

Pengesat faktike janë ato rrethana dhe situata reale të cilat e bëjnë të pamundshëm fillimin apo vazhdimin e ndjekjes penale. Rrethana apo situata të tilla janë, p.sh., arratisja e kryesit të veprës penale, kur nuk dihet vendbanimi i kryesit, okupimi i territorit nga ana e një shtetit tjetër, tërmeti, vërshimet, zjarri dhe rrethanat e tjera të ngjashme, të cilat e bëjnë të pamundshme funksionimin e gjykatave.

Pengesat juridike ekzistojnë atëherë kur është fjala për ndonjë rrethanë apo situatë të natyrës juridike, për shkak të të cilave nuk mund të fillohet apo të vazhdohet ndjekja penale. Rrethana apo situata të tilla janë, p.sh., imuniteti i deputetit të parlamentit, sëmundja psikike e të pandehurit gjatë procedurës penale etj.

KPRK njih dy shkaqe, të cilat shpijnë në ndërprerje të parashkrimit. Së pari, parashkrimi i ndjekjes penale ndërpritet me çdo veprim procedural, i cili ndërmerret me qëllim të ndjekjes penale të veprës penale të kryer²³¹. Kryerja e veprës penale të re gjatë afatit të parashkrimit është shkak i dytë që shpien në ndërprerje të afatit të parashkrimit. Vepra penale e re, për nga pesha, duhet të jetë e njëjtë ose më e rëndë se ajo që është kryer më parë²³². Me rastin e vlerësimit nëse vepra penale është e njëjtë apo më e rëndë se ajo që është kryer më parë, vendimtar është dënimi i parashikuar në ligj për atë vepër.

²³¹ Neni 100 paragrafi 5 i KPRK.

²³² Neni 100 paragrafi 6 i KPRK.

Ndalja dhe ndërprerja e parashkrimit mund të bëjnë që, praktikisht, parashkrimi të mos ndodh asnjëherë. Sidomos me ndërprerje, parashkrimi mund të pengohet përherë, ngase organet kompetente shtetërore mund të ndërmarrin veprime, me të cilat do të bënin të

pamundshme kuptimin dhe qëllimin e parashkrimit. Për t'iu shmangur kësaj mundësie, në KPRK, ngjashëm si edhe në legjislacionet e shteteve tjera bashkëkohore është parashikuar parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Parashkrimi absolut i ndjekjes penale paraqitet kur kalon dyfishi i kohës që kërkohet sipas ligjit për parashkrimin relativ. Kështu, sipas nenit 100 paragrafi 8 i KPRK, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit. Kështu, p.sh., nëse për ndonjë vepër penale është parashikuar se parashkrimi shkaktohet pas tri vjetësh, atëherë parashkrimi absolut paraqitet pas skadimit të gjashtë vjetëve.

Institucioni i parashkrimit të ndjekjes penale, si rregull është përvetësuar për të gjitha veprat penale. Nga kjo rregull, bëjnë përjashtim krimi i gjenocidit, krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit, veprat e tjera penale për të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare nuk mund të zbatohet parashkrimi, si dhe vepra penale e vrasjes së rëndë. Një gjë e tillë është parashikuar në mënyrë shprehimore në nenin 104 të KPRK, në të cilin thuhet se: “Asnjë afat i parashkrimit nuk zbatohet për veprat penale të gjenocidit, krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit, ose për vepra tjera penale të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare nuk parashkruhen”. Gjithashtu, në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se “Vepra penale e vrasjes së rëndë nuk parashkruhet”.

3. Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit

Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit qëndron në atë se, pas kalimit të kohës së parashikuar me ligj, dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet.

Afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit fillon të rrjedhë nga dita kur aktgjykimi është bërë i formës së prerë, e nëse është revokuar dënimi alternativ, ai fillon nga dita kur vendimi mbi revokimin është bërë i formës së prerë²³³.

Afatet e parashkrimit të ekzekutimit të dënimit janë të ndryshme dhe ato varen nga lloji dhe lartësia e dënimit të shqiptuar. Në nenin 101 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se përveç nëse parashihet ndryshe me këtë Kod, dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet pasi të kenë kaluar:

- Tridhjetë (30) vjet nga dënimi me burgim të përjetshëm;
- Njëzetë (20) vjet nga dënimi me mbi dhjetë (10) vjet burgim;
- Pesëmbëdhjetë (15) vjet nga dënimi me mbi pesë (5) vjet burgim;

²³³ Neni 103 paragrafi 1 i KPRK.

- Dhjetë (10) vjet nga dënimi me mbi tri (3) vjet burgim;
- Gjashtë (6) vjet nga dënimi me mbi një (1) vit burgim dhe
- Katër (4) vjet nga dënimi me burgim deri në një (1) vit apo dënimi me gjobë.

Afatet e lartcekura e përbëjnë **parashkrimin relativ të ekzekutimit të dënimit**. Sipas kësaj dispozite ligjore, minimumi i afatit të parashkrimit relativ të ekzekutimit të dënimit është 4 (katër) vjet, kurse maksimumi 30 (tridhjetë) vjet.

Ngjashëm me parashkrimin e ndjekjes penale, edhe te parashkrimi i ekzekutimit të dënimit mund të paraqiten rrethana, të cilat shkaktojnë ndaljen dhe ndërprerjen e afatit të parashkrimit.

Ndalja dhe ndërprerja e afatit të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit e kanë të njëjtin efekt, si edhe te parashkrimi i ndjekjes penale. Kështu, në nenin 103 paragrafi 2 të KPRK, është parashikuar se afati i parashkrimit nuk rrjedh gjatë kohës kur sipas ligjit ekzekutimi i dënimit nuk mund të fillohet.

Nëse dënimi zbutet me falje apo me vendim të gjykatës sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, koha e fillimit të parashkrimit caktohet sipas dënimit të ri, derisa llogaritja e parashkrimit bëhet sipas dënimit fillestar²³⁴.

Afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprim të filluar nga organi kompetent me qëllim të ekzekutimit të dënimit²³⁵. Gjithashtu, parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve ndërpritet edhe kur personi i dënuar nuk paraqitet ose nuk dorëzohet për mbajtjen e dënimit me burgim²³⁶.

Sipas nenit 103 paragrafi 5 të KPRK, pas çdo ndërprerjeje fillon të rrjedhë afati i ri i parashkrimit.

Parashkrimi absolut i ekzekutimit të dënimit paraqitet në çdo rast kur të kalojë dyfishi i kohës që kërkohet sipas ligjit për parashkrimin e ekzekutimit të dënimit, pa marrë parasysh sa ndalje dhe ndërprerje kanë ndodhur dhe pa marrë parasysh kohëzgjatjen e tyre. Në rastet kur shkaktohet parashkrimi absolut i ekzekutimit të dënimit, dënimi i shqiptuar kurrsesi nuk mund të ekzekutohet.

²³⁴ Neni 103 paragrafi 3 i KPRK.

²³⁵ Neni 103 paragrafi 4 i KPRK.

²³⁶ Neni 101 paragrafi 2 i KPRK.

PJESA E DYTË
PJESA E POSAÇME E SË DREJTËS PENALE
KAPITULLI I

1. NOCIONI DHE LËNDA E PJESËS SË POSAÇME TË SË DREJTËS PENALE

Siç është theksuar edhe më parë, me termin “e drejtë penale” nënkuptojmë :

- A) një degë të sistemit pozitiv të së drejtës (aspekti ligjor) dhe
- B) një degë të shkencave juridike (aspekti shkencor).

Si degë e sistemit pozitiv të së drejtës, e drejta penale është tërësi e dispozitave ligjore me të cilat përcaktohen se cilat sjellje apo veprime konsiderohen vepra penale dhe çfarë lloje të sanksioneve penale apo masave tjera do të mund t’ju shqiptohen kryerësve të veprave penale. Të drejtën penale nga aspekti ligjor e përbën Kodi Penal i Republikës së Kosovës dhe ligjet tjera penale.

E drejta penale si degë e shkencave juridike apo siç quhet ndryshe shkenca e së drejtës penale është disiplinë shkencore e cila mirret me studimin e së drejtës penale si degë e sistemit pozitiv të së drejtës. Pra, e drejta penale nga aspekti shkencor mirret me studimin e të drejtës penale nga aspekti ligjor. E drejta penale si degë e shkencave juridike (shkenca e së drejtës penale) përfshinë tërësinë e studimeve dhe hulumtimeve të së drejtës penale, në radhë të parë shkencën e së drejtës penale e përbëjnë komentaret e kodit penal, librat, punimet monografike dhe punimet e tjera të autorëve, artikujt e ndryshëm që i referohen të drejtës penale, etj.²³⁷

E drejta penale si degë e sistemit pozitiv të së drejtës dhe si degë e shkencave juridike ndahet në dy pjesë :

- a) në pjesën e përgjithshme dhe
- b) në pjesën e posaçme.

Kjo ndarje e të drejtës penale në dy pjesë, në pjesën e përgjithshme dhe në pjesën e posaçme është prezente në të gjitha shtetet bashkëkohore. Të gjitha kodet penale të shteteve bashkëkohore ndahen në dy pjesë, në pjesën e përgjithshme dhe në pjesën e posaçme.²³⁸

²³⁷ SHALA, AFRIM, Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, Gjilan, 2020, f. 27.

²³⁸ Në historinë e së drejtës penale, ndarja e ligjit penal, përkatësisht e kodit penal në dy pjesë, në pjesën e përgjithshme dhe në pjesën e posaçme, për herë të parë ka gjetur shprehje në Kodin Penal të Francës, të vitit 1791, i cili u nxorr pas ngadhënjimit të Revolucionit borgjez francez. Ndarja e Kodit Penal të Francës në dy pjesë, në pjesën e përgjithshme dhe në pjesën e posaçme, u përvetësua nga të gjitha kodet dhe ligjet penale të Evropës dhe të mbarë botës.

Edhe KPRK, sikundër edhe kodet penale të shteteve tjera ndahet në dy pjesë : në pjesën e përgjithshme dhe në pjesën e posaçme. Në pjesën e përgjithshme të KPRK gjenden dispozita që janë të karakterit të përgjithshëm, që përbëjnë dispozita të përgjithshme dhe parimore, të cilat u referohen veprave penale në përgjithësi, përgjegjësisë penale dhe sanksioneve penale. Poashtu, në pjesën e përgjithshme gjenden dispozita që kanë të bëjnë mbrojtjen e nevojshme, nevojën ekstreme, tentativën, bashkëpunimin në kryerjen e veprës penale, parashkrimin, etj. Ndërsa, në pjesën e posaçme të KPRK gjenden dispozitat me të cilat përcaktohen veprat penale të veçanta dhe sanksionet penale për ato vepra penale.

Dispozitat e pjesës së posaçme të së drejtës sonë penale, si degë e sistemit pozitiv të së drejtës gjenden në pjesën e posaçme të KPRK. Mirëpo, duhet theksuar se me gjithë faktin se KPRK pretendon t'i parashoh të gjitha veprat penale të mundshme, për shkak të ndërlikueshmërisë dhe dinamikës së zhvillimit shoqëror, është e pamundur që në një kod të parashihen të gjitha veprat penale. Andaj, si edhe në shtetet tjera, edhe në Kosovë një numër i vogël i veprave penale janë të parapara me ligje tjera të posaçme. Në Kosovë, si ligje tjera të posaçme me anë të të cilave parashihen vepra penale janë : Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizimit²³⁹, Ligji për luftimin dhe parandalimin e krimit kibernetik²⁴⁰, Kodi Doganor dhe i Akcizave²⁴¹, etj.

Në disa shtete bashkëkohore, veprat penale ushtarake janë të parashikuara me ligje penale të posaçme përkatësisht me ligje (kode) penale ushtarake. Kështu në Republikën e Shqipërisë veprat penale ushtarake janë të parashikuara me Kodin Penal Ushtarak. Andaj edhe veprat penale ushtarake të cilat janë të parashikuara në ligje penale ushtarake konsiderohen pjesë e posaçme e së drejtës penale, si degë e sistemit pozitiv të së drejtës.

Edhe shkenca e së drejtës penale në Kosovë, sikundër edhe në shtetet tjera, ndahet në dy pjesë : **në pjesën e përgjithshme** dhe **në pjesën e posaçme**. Pjesa e përgjithshme e shkencës së të drejtës penale e studion parimisht pjesën e përgjithshme të KPRK, kurse pjesa e posaçme e shkencës së të drejtës penale, e studion pjesën e posaçme të KPRK dhe dispozitat e ligjeve tjera penale, me të cilat parashihen vepra penale.

Lëndë e pjesës së posaçme të së drejtës penale, si degë e së drejtës penale pozitive, është të përcaktojë se cilat vepra dhe sjellje do të konsiderohen vepra penale dhe çfarë lloji dhe mase të dënimit do të mund shqiptohet ndaj kryerësve të tyre.

Ndërsa, lëndë e shkencës së pjesës së posaçme të së drejtës penale është që t'i analizojë dhe t'i shpjegojë elementet e çdo vepre penale, pa marr parasysh se a gjendet në pjesën e posaçme të KPRK apo në ligje tjera të posaçme.

²³⁹ Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizimit, Ligji Nr.05/L-096 i datës 25 maj 2016.

²⁴⁰ Ligji për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik, Ligji Nr.03/L-166 i datës 10 qershor 2020.

²⁴¹ Kodi Doganor dhe i Akcizave në Kosovë, Nr. 03/L-109, i datës 10 nëntor 2008.

Përveç kësaj, lëndë e shkencës së pjesës së posaçme të së drejtës penale është edhe studimi i aplikimit përkatësisht zbatimit konkret të dispozitave të kësaj pjese në praktikën gjyqësore të gjykatave në Kosovë. Gjithashtu, lëndë e shkencës së të drejtës penale është edhe identifikimi i zbrazëtirave eventuale juridike dhe dhënia e propozimeve për parashikimin e masave dhe institucioneve të reja, me qëllim të luftimit dhe parandalimit sa më të suksesshëm të kriminalitetit.

Duke u bazuar në këto që u thanë më lart, shkenca e pjesës së posaçme të së drejtës penale, duhet ta studiojë të drejtën penale “*de lege lata*” (ashtu çfarë është) dhe “*de lege ferenda*” (ashtu çfarë duhet të jetë).

2. MARRËDHËNIA MIDIS Pjesës së përgjithshme dhe pjesës së posaçme të së drejtës penale

Pjesa e përgjithshme dhe ajo e posaçme e së drejtës penale, për nga përmbajtja dhe zbatimi i saj është e pandarë, ngase në aspektin juridik-teknik edhe lënda është sistem integral unik. Kjo shihet nga fakti se dispozitat e pjesës së përgjithshme dhe të pjesës së posaçme të kësaj lënde, plotësohen ndërmjet tyre. Vetëm me aplikimin e njëkohshëm të dispozitave të pjesës së përgjithshme dhe të pjesës së posaçme mund të konstatohet nëse një person ka kryer veprë penale dhe ndaj tij të shqiptohet sanksioni penal. Dispozitat e pjesës së përgjithshme paraqesin bazë për përcaktimin e veprave penale të veçanta.²⁴²

Dispozitat e pjesës së përgjithshme më së shpeshti kanë për qëllim përcaktimin e përmbajtjes së dispozitave të pjesës së posaçme, duke i plotësuar dhe duke ua dhënë kuptimin e qartë. Kështu p.sh. dispozita me të cilën parashihet se vepra penale mund të kryhet edhe me mosveprim, në fakt paraqet zgjerimin e mënyrave me të cilat mund të kryhet vepra penale; dispozitat që i referohen bashkëpunimit e zgjerojnë rrethin e kryerësve të çdo veprë penale me ç’rast me dispozita të pjesës së përgjithshme, konsiderohet bashkëpunëtor edhe kryerësi i drejtpërdrejtë; dispozitat me të cilat janë paraparë sanksionet penale mundësojnë që krahas dënimit, i cili rregullisht është paraparë për çdo veprë penale, të shqiptohen edhe sanksione tjera penale, masa të trajtimit të detyrueshëm, apo dënim më i butë se ai që është i paraparë për atë veprë penale.

Pjesa e përgjithshme dhe e posaçme e së drejtës penale janë dy pjesë të një tërësie integrale dhe organike.

Dispozitat e pjesës së përgjithshme dhe të posaçme të së drejtës penale midis tyre janë komplementare dhe të varura. Këto dispozita të këtyre dy pjesëve ndërlidhen dhe plotësohen. Kështu, përderisa dispozitat e pjesës së përgjithshme janë të karakterit interpretues dhe zbatohen në mënyrë indirekte, siç është p.sh. neni 1 paragrafi 2 i KPRK, sipas së cilës “askujt nuk mund t’i shqiptohet sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm për një veprë nëse

²⁴² SALIHU, ISMET, E drejta penale, Pjesa e posaçme, Prishtinë, 2015, f. 18-19.

para kryerjes së veprës ligji nuk e përcakton veprën si vepër penale...”, me dispozitat e pjesës së posaçme përcaktohet në mënyrë të saktë, precize, përmbajtja dhe forma e veprës penale dhe sanksioni penal i cili do të shqiptohet ndaj kryerësit. Nga kjo rezulton qartë se me dispozitat e pjesës së posaçme, në fakt konkretizohen dispozitat e pjesës së përgjithshme dhe me këtë mundësohet zbatimi i tyre ndaj kryerësve të veprave penale. Andaj, **pjesa e posaçme e së drejtës penale paraqet një lloj konkretizimi i pjesës së përgjithshme të së drejtës penale.**

Pjesa e posaçme e së drejtës penale presupozon njohjen e pjesës së përgjithshme. Njohja e pjesës së përgjithshme është themelore dhe e domosdoshme që të mund të kuptohet materia e pjesës së posaçme. Meqë parimet, institutet dhe çështjet e tjera janë të rregulluara në pjesën e përgjithshme, ato nuk rregullohen në pjesën e posaçme, por vetëm aplikohen në rastet konkrete.

Me rastin e aplikimit në praktikë të dispozitave të kodit penal, detyrë kryesore është kualifikimi i veprave penale. Individualizimi i dënimit presupozon individualizimin paraprak të veprës penale dhe kryerësit. Kjo do të ishte e pamundur të bëhet pa njohjen paraprake të elementeve të posaçme të veprave penale të cilat janë të përcaktuara në kodin penal. Së këndejmi, vetëm njohja e pjesës së përgjithshme nuk është e mjaftueshme te rastet konkrete në praktikë, nëse paraprakisht nuk studiohen veprat penale nga legjislacioni penal pozitiv.

Parimi themelor i së drejtës penale i cili konsiston në maksimën *“nullum crimen, nulla poena sine lege”*, mund të aplikohet në mënyrë adekuate dhe konkrete vetëm me kualifikimin e drejtë të veprës penale. Pikërisht pjesa e posaçme e së drejtës penale ka për qëllim që me anë të analizës së veprave penale veç e veç, studimin e elementeve të tyre, të mundësojë aplikimin e kodit penal, konform parimit të legalitetit.

3. FIGURA E VEPRËS PENALE

Termi **“figurë e veprës penale”** ka qenë i njohur edhe në të drejtën romake. Ky term njihet edhe tani pothuaj në të gjitha të drejtat penale të shteteve bashkëkohore. Me gjithë faktin se termi figurë e veprës penale njihet që moti, edhe sot e kësaj dite është kontestuese se çka duhet nënkuptuar me këtë term. Sipas mendimit të disa autorëve, me figurë të veprës penale duhet nënkuptuar tërësinë e elementeve themelore të veprës penale, e cila ndryshe emërtohet edhe si figurë e përgjithshme e veprës penale. Ndërkaq, sipas mendimit të autorëve të tjerë, me termin figurë e veprës penale duhet nënkuptuar tërësinë e elementeve të posaçme të çdo veprë penale.

Lidhur me këto dilema, përkitazi me nocionin e figurës së veprës penale, tani mbisundon mendimi se me figurë të veprës penale duhet nënkuptuar tërësinë e elementeve të veprës penale të caktuar.²⁴³ Përkatësisht, çdo vepër penale e parashikuar në legjislacionin penal posedon elementet e veta të posaçme, me të cilat ajo edhe dallohet prej veprave tjera penale. Tërësia e elementeve të posaçme sajton fizionominë apo figurën e veprës penale të caktuar. Ndërkaq,

²⁴³ SALIHU, ISMET, E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, fq.184 dhe BAČIĆ, FRANJO, Kazneno pravo, Opći dio, Zagreb, 1998, fq. 103.

elementet themelore apo të përgjithshme, duhet të shprehen te çdo veprë penale dhe ato në fakt, sajojnë kuptimin e përgjithshëm të veprës penale.

Nga kjo del se, përderisa elementet themelore apo të përgjithshme të veprës penale (veprimi i njeriut, kundërligjshmëria, përcaktueshmëria e veprës penale me ligj, etj.) duhet të shprehen te çdo veprë penale, elementet e posaçme janë tipare apo karakteristikë e veprës penale të caktuar dhe këto shprehen krahas elementeve të përgjithshme. Së këndejmi, krahas kuptimit të përgjithshëm të veprës penale, në të drejtën penale njihet edhe kuptimi i posaçëm apo figura e veprës penale.

Figura e veprës penale sajohet duke përcaktuar elementet e posaçme veç e veç dhe duke bërë sintetizimin dhe përgjithësimin e tyre në dispozitën e caktuar penalo-juridike.

Kështu, fjala vjen, vepra penale “**vjedhja**”, nga neni 313 paragrafi i KPRK, përbëhet prej këtyre elementeve :

- 1) marrjes;
- 2) pasurisë së tjetrit;
- 3) pasuria të jetë vlerësuar në shumën prej 50 Euro dhe
- 4) me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete ose për personin tjetër.

Ose vepra penale “**marrja e ryshfetit**”, nga neni 421 paragrafi 1 i KPRK, posedon këto elemente të posaçme :

- 1) personi zyrtar ose personi i huaj zyrtar;
- 2) që kërkon ose pranon ndonjë dhuratë ose ndonjë përfitim tjetër për vete ose personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin dhuratë apo përfitim të tillë dhe
- 3) në mënyrë që të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare.

Pra, me figurë të veprës penale nënkuptojmë të gjitha elementet e posaçme të një vepre penale. Andaj, shtrohet pyetja se çka kuptojmë me elemente të posaçme të veprës penale konkrete?

Elemente të posaçme të veprës penale nënkuptojmë ato elemente që nuk janë të përbashkëta për të gjitha veprat penale, por që paraqiten te disa vepra penale dhe që e dallojnë një veprë penale prej një vepre tjetër penale. Elementet e posaçme të veprës penale ndryshe quhen si **tipare të veprës së caktuar penale**.²⁴⁴

Çdo veprë penale i posedon elementet e veta të posaçme. Në raport me elementet e përgjithshme, elementet e posaçme në fakt janë një lloj konkretizimi i elementeve themelore të

²⁴⁴ SHALA, AFRIM, Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, f. 27.

veprës penale. Pa përcaktimin e elementeve të posaçme, nuk mund të bëhet kualifikimi i veprës penale.

Sikur elementet e përgjithshme, edhe elementet e posaçme të veprës penale, mund të ndahen në dy grupe :

- 1) Elemente të karakterit objektiv dhe
- 2) Elemente të karakterit subjektiv.

1) Elementet e karakterit objektiv - Njëri ndër elementet e figurës së

veprës penale të caktuar, i natyrës objektive është **veprimi i kryerjes së veprës penale konkrete**. Çdo vepër penale e parashikuar në pjesën e posaçme të KPRK nënkupton ndërmarrjen e një veprimi të caktuar.

Veprimi i kryerjes së veprës penale mund të jetë i natyrave të ndryshme

- gjuajtja me armë të vepra penale e vrasjes, nga neni 172 i KPRK,
- marrja e pasurisë së huaj, të vepra penale e vjedhjes, nga neni 313 i KPRK,
- kryerja e aktit seksual me paraardhës apo pasardhës, të vepra penale marrëdhëniet seksuale brenda familjeve, nga neni 236 i KPRK, etj.

Në të gjitha këto raste, ekziston veprimi i kryerjes, mirëpo veprimi i kryerjes është i natyrës së ndryshme dhe si rezultat i kësaj, një vepër penale dallohet prej veprës tjetër penale, p.sh. gjuajtja me armë, marrja e sendit të huaj, kryerja e aktit seksual me paraardhës apo pasardhës, janë veprime të kryerjes së veprës penale të caktuar. Meqë këto veprime janë të ndryshme, atëherë bëjnë që edhe veprat penale të jenë të ndryshme.

Element tjetër i natyrës objektive i figurës së veprës penale është edhe **pasoja**. Në disa raste për të ekzistuar vepra penale konkrete, duhet që të ekzistojë pasoja e caktuar. Pasoja e veprës penale, në disa raste është element që e dallon një vepër penale prej veprës tjetër penale.

Pasoja e veprës penale mund të jetë e natyrave të ndryshme.

- të vepra penale privimi i kundërligjshëm nga liria, nga neni 193 i KPRK, pasoja qëndron në privimin e kundërligjshëm të një personi nga liria;
- të vepra penale asgjësimi ose dëmtimi i pasurisë, nga neni 321 i KPRK, pasoja qëndron në asgjësimin, dëmtimin apo bërjen të papërdorshme të pasurisë së personit tjetër;
- të vepra penale e vrasjes, nga neni 172 i KPRK, pasoja qëndron në privimin e personit tjetër nga jeta, etj.

Në të gjitha këto raste pasojat e veprave penale ishin të ndryshme dhe si rezultat i kësaj bëjnë që të jenë të ndryshme edhe veprat penale.

Në disa raste një veprë penale dallohet prej një veprë tjetër penale, varësisht nga fakti se në çfarë mënyre është kryer vepra penale. Pra, **mënyra e posaçme e kryerjes së veprës penale** është element që e dallon një veprë penale prej veprës tjetër.

Shembuj të mënyrës së posaçme të kryerjes së veprës penale

Kështu, element që e dallon veprën penale të vrasjes, nga neni 172 i KPRK, nga vepra penale e vrasjes së rëndë, nga neni 173 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. i KPRK, është mënyra e kryerjes së veprës penale. P.sh. nëse personi A e privon nga jeta personin B në mënyrë mizore apo dinake, atëherë në veprimet e personit A qëndrojnë elementet e veprës penale të vrasjes së rëndë, nga neni 173 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. të KPRK, e jo të veprës penale të vrasjes, nga neni 172 i KPRK.

Poashtu, edhe **vlera e objektit të mbrojtur** në të drejtën penale mund të jetë rrethanë vendimtare për ta kualifikuar një veprë penale.

Shembuj të vlerës së objektit të mbrojtur

- nëse personi A e vjedh një send që ka vlerë mbi 5,000 € dhe personi A ka vepruar me qëllim të përvetësimit të sendit me vlerë të tillë, atëherë në veprimet e personit A qëndrojnë elementet e veprës penale të vjedhjes së rëndë, nga neni 315 paragrafi 2 nën-paragrafi 2.1. të KPRK, e jo të veprës penale të vjedhjes.

Pra, vepra penale e vjedhjes, përveç tjerash, dallohet nga vepra penale e vjedhjes së rëndë, edhe për shkak të vlerës së sendit të vjedhur.

Në rastet e tjera, për të ekzistuar vepra penale e caktuar, është e nevojshme që të jenë përdorur **mjetet e caktuara**.

Shembuj kur mjetet e kryerjes konsiderohen elemente të figurës së veprës penale

- Vepra penale e peshkimit të kundërligjshëm, nga neni 353 paragrafi 2 të KPRK, ekziston nëse kryerësi peshkon duke përdorur eksploziv, rrymë elektrike, helm ose mjete helmuese.

Te disa vepra penale është i nevojshëm që veprimi të jetë ndërmarrë gjatë **kohës së caktuar**.

Shembuj kur koha e kryerjes së veprës penale konsidrohet element i figurës së veprës penale

- Vepra penale mosveprimi sipas dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë, nga neni 250 i KPRK, mund të kryhet vetëm gjatë kohës së epidemisë

- Krimet e luftës në kundërshtim të rëndë me Konventat e Gjenevës, nga neni 144 mund të kryhen vetëm gjatë kohës së luftës (konfliktit të armatosur), etj.

Edhe **vendi i kryerjes së veprës penale**, mund të jetë element konstituiv i veprës penale.

Shembuj kur vendi i kryerjes konsiderohet element i figurës së veprës penale

- Vepra penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare, nga neni 140 i KPRK mund të kryhet në vendet rreth kufirit ose vijës kufitare të Republikës së Kosovës, përveç në kufirin ose vendkalimet e autorizuara kufitare.

Cilësia e caktuar personale e kryerësit apo marrëdhënia e caktuar, janë tipare të një varg veprash penale, kështu që këto vepra penale mund t'i kryejnë vetëm personat që posedojnë veti të caktuara apo që gjenden në raporte të caktuara. Veprat penale të cilat mund t'i kryejnë vetëm personat që posedojnë veti të caktuara apo që gjenden në marrëdhënie të caktuar, ndryshe quhen edhe si “*delicta propria*”.

Shembuj kur cilësitë e kryerësit apo marrëdhëniet e kryerësit me viktimën konsiderohen elemente të figurës së veprës penale

- Disa vepra penale mund t'i kryejnë vetëm “personat zyrtarë” (neni 194, 195, 198, 414, 416, 417, 418, 421, etj.) apo “personat përgjegjës” (neni 279, 284, 285, etj.), “mjeku” (neni 254, 255, etj), “farmacisti” (neni 258, etj), “gjyqtari” (neni 425, etj.), “dëshmitari” (neni 384), etj.

- Disa vepra tjera mund t'i kryejnë vetëm personat që gjenden në marrëdhënie të caktuar, “marrëdhënie familjare”, (neni 182 paragrafi 2, etj.), etj. Ose, veprën penale vrasja e foshnjeve gjatë lindjes, nga neni 176 i KPRK, mund ta kryejë vetëm nëna, e cila gjendet në raporte personale me viktimën - foshnjën.

Edhe **cilësia personale e viktimës** mund të jetë element konstituiv i një vepre penale.

Shembuj kur cilësitë personale të viktimës konsiderohen elemente të figurës së veprës penale

- vepra penale e vrasjes së rëndë, nga neni 173 paragrafi 1, nën-paragrafët 1 dhe 2 të KPRK, ekziston nëse privohet nga jeta fëmija përkatësisht gruaja shtatëzënë.

Përveç këtyre, në pjesën e posaçme të KPRK, janë parashikuar edhe shumë elemente tjera të natyrës objektive.

2) Elementet e karakterit subjektiv - Për ekzistimin e disa veprave penale duhet që të kryerësi i veprës penale të manifestohen edhe elemente të karakterit subjektiv. Në këtë aspekt, rëndësi të posaçme ka qëllimi dhe motivi i kryerësit, të cilat duhet të ekzistojnë në momentin e kryerjes së veprës penale.

Për ekzistimin e disa veprave penale duhet që ato të jenë kryer me **qëllim të caktuar**.

Shembuj kur qëllimi konsiderohet element i figurës së veprës penale

- Vepra penale e vjedhja, nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK, ekziston vetëm nëse personi A e merr automjetin e personit B me qëllim të përvetësimit të tij për vete ose për personin tjetër. Nëse personi A automjetin e personit B nuk e ka marr me këtë qëllim, por vetëm sa për t'i kryer disa punë në qytetet tjera, atëherë do të ekzistojë vepra penale marrja në posedim e pasurisë së luajtshme, nga neni 319 i KPRK.

- Vepra penale e falsifikimit të dokumenteve, nga neni 390 i KPRK, konsiderohet se është kryer vetëm nëse falsifikimi i dokumentit është bërë me qëllim që ai dokument të përdoret si i vërtetë.

Edhe **motivi** në disa raste është parashikuar si element konstituiv i veprës së caktuar penale.

Shembuj kur motivi konsiderohet element i figurës së veprës penale

- vepra penale e vrasjes së rëndë, nga neni 173 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.10 i KPRK, ekziston vetëm nëse kryësi e privon nga jeta personin tjetër i motivuar në bazë kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit, etj.

4. PËRMBAJTJA E DISPOZITAVE TË PJESËS SË POSAÇME TË SË DREJTËS PENALE

Siç është cekur më parë, pjesa e posaçme e së drejtës penale, si degë e sistemit pozitiv të së drejtës, përfshinë normat juridike me anë të të cilave përcaktohen se cilat sjellje apo veprime përbëjnë vepra penale dhe sanksionet penale që mund t’iu shqiptohen kryerësve të tyre.

Karakteristikë e normave juridike të pjesës së posaçme të së drejtës penale, si degë e sistemit pozitiv të së drejtës, është se parimisht çdonjëra prej tyre përbëhet nga dy pjesë

- 1) dispozitivi dhe
- 2) dënimi.

Përveç kësaj, në pjesën e posaçme të së drejtës penale, gjenden edhe **dispozita me të cilat shpjegohet domethënia e shprehjeve** që janë përdorur në dispozitat përkatëse të kësaj pjese, siç janë p.sh. neni 128 me anë të të cilit përkufizohet terrorizmi, si dhe veprimet tjera që kanë të bëjnë me terrorizmin; neni 225, me anë të të cilit përcaktohet domethënia e shprehjeve që kanë lidhje me veprat penale kundër integritetit seksual, etj.

Pastaj, në pjesën e posaçme të së drejtës penale, gjenden edhe **dispozita të natyrës permissive**, përkatësisht dispozita të cilat në rastet e caktuara e përjashtojnë kundërligjshmërinë, p.sh. te vepra penale e pjesëmarrjes në rrahje, neni 187, paragrafi 3 të KPRK, thuhet se “Personi nuk është penalisht përgjegjës sipas paragrafit 1. i këtij neni nëse ka marrë pjesë në rrahje pa fajin e tij ose thjesht për të mbrojtur veten apo për t’i ndarë pjesëmarrësit e tjerë në rrahje”, etj.

Në pjesën e posaçme të KPRK, gjenden edhe **dispozita të karakterit kriminalo-politik**, ngase kryerësit stimulohen që të heqin dorë nga përfundimi i veprës penale të cilën e kanë filluar që ta kryejnë apo të ndihmojnë organet shtetërore në zbulimin e veprave penale përkatësisht krimet të organizuar. Kështu, p.sh. te krimi i organizuar, nga neni 277 paragrafi 5 të KPRK, është parashikuar se “Gjykata mund të zbusë dënimin e anëtarit të grupit kriminal të organizuar i cili, para se grupi kriminal i organizuar të ketë kryer veprën penale, raporton në polici ose prokurori, ekzistimin, formacionin dhe jep informata për grupin kriminal të organizuar në detaje të mjaftueshme për të mundësuar arrestimin apo ndjekjen e grupit të tillë”. Ose te vepra penale deklarimi i rremë nën betim nga neni 383 paragrafi 3 të KPRK është parashikuar se “Nëse

kryesi i veprës penale nga paragrafi 1. i këtij neni vullnetarisht e tërheq deklaratën e tij para fundit të dëshmisë së tij, gjykata mund ta zbusë dënimin”.

1) Dispozitivi - Dispozitivi është ajo pjesë e normës juridike të pjesës së posaçme të së drejtës penale, me anë të së cilës përcaktohen elementet e veprës penale konkrete. Në dispozitiv përshkruhen tiparet e të ashtuquajturës figurë të veprës penale. Në këtë mënyrë, në dispozitiv përcaktohet se në çka konsiston veprimi i kryerjes së veprës penale, objekti i veprimit, mënyra e kryerjes së veprës penale, kush mund të jetë kryerës, pasoja e veprës penale, mjeti i kryerjes, koha, vendi, qëllimi, etj. P.sh. në nenin 229 paragrafi 1 të KPRK, thuhet “Kushdo që e prek personin tjetër me qëllim seksual ose e cyt personin tjetër të prekë kryerësin ose personin e tretë me qëllim seksual pa pëlqimin e personit të tillë dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit”. Dispozitiv i kësaj norme juridike është kjo fjali “*Kushdo që e prek personin tjetër me qëllim seksual ose e cyt personin tjetër të prekë kryerësin ose personin e tretë me qëllim seksual pa pëlqimin e personit të tillë*”, kurse pjesa tjetër e kësaj norme juridike është dënimi. Nga ky dispozitiv shihet se kush mund të jetë kryerës i kësaj vepre penale, në çka konsiston veprimi i kryerjes, qëllimi, etj.

Varësisht nga mënyra e përcaktimit të elementeve të veprës penale, njihen disa lloje të dispozitivave të normave juridike të pjesës së posaçme të së drejtës penale dhe atë :

a) Dispozitivi i thjeshtë - Në teorinë e së drejtës penale ndryshe quhet edhe si dispozitiv i rëndomtë. Me dispozitiv të thjeshtë nuk përcaktohen tiparet e hollësishme të vepës penale, por përshkrimi i veprës bëhet vetëm duke e përcaktuar emërtimin e veprës. Te ky lloj i dispozitivit, përcaktimi i veprës penale bëhet vetëm duke e përsëritur titullin e asaj vepre penale.

b) Dispozitivi përshkruar - Është ai lloj i dispozitivit me anë të të cilit caktohen tiparet e veprës penale, përkatësisht bëhet përshkrimi i tyre. Dispozitivi përshkruar përfshinë të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale. P.sh. vepra penale e grabitjes, nga neni 317 i KPRK, është përshkruar në këtë mënyrë : “Kushdo që me përdorim të forcës apo kanosjes serioze për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, e përvetëson pasurinë e luajtshme të personit të tillë me qëllim që t’i sjellë vetes apo personit tjetër dobi pasurore të kundërligjshme”. Në këtë dispozitiv janë përshkruar të gjitha elementet objektive dhe subjektive të kësaj vepre penale, personi që mund të kryej këtë vepër, mënyra e kryerjes, qëllimi, etj.

c) Dispozitivi referues - Dispozitivi referues është ai lloj i dispozitivit i cili nuk përmban elementet përbërëse të figurës së veprës penale, por referon në një dispozitë tjetër penale. Kjo bëhet me qëllim që mos të ketë përsëritje në ligj. P.sh. për veprën penale të vjedhjes së rëndë, nga neni 315 i KPRK, përdoret nocioni i vjedhjes, nga neni 313 i KPRK.

d) Dispozitivi udhëzues - Ky lloj dispozitivit ndryshe quhet edhe si dispozitiv i bardhë apo dispozitiv blanket. Me dispozitiv udhëzues kuptojmë atë dispozitiv i cili lidhur me tiparet e veprës penale të caktuar, udhëzon aplikimin e një ligji tjetër apo i referohet një ligji tjetër, për të sqaruar përmbajtjen e tij. P.sh. neni 178 i KPRK me të cilën parashihet vepra penale e

ndërprerjes së palejuar të shtatzënësisë, i referohet ligjit mbi ndërprerjen e shtatzënësisë; neni 249 i KPRK, me të cilën parashihet vepra penale e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse, i referohet ligjeve dhe dispozitave tjera me të cilat përcaktohet se cilat sëmundje konsiderohen ngjitëse dhe si mund të përhapen; pastaj neni 218 i KPRK me të cilën parashihet vepra penale e cenimit të drejtave nga marrëdhëniet e punës, i referohet ligjit apo kontratët kolektive mbi punësimin, etj.

e) Dispozitivi i përbërë - Me anë të këtij lloji të dispozitivit përcaktohen figurat e të ashtuquajturave “vepra penale të përbëra”. Dispozitive të përbëra konsiderohen veprat të cilat kryhen me ndërmarrjen e dy apo më shumë veprimeve, mandej vepra penale e cila konsiderohet se kryhet me ndërmarrjen e njërit prej llojeve të veprimeve të caktuara apo veprimi i kryerjes që është caktuar në mënyrë alternative. P.sh. vepra penale cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve, nga neni 197 i KPRK, e cila konsiderohet që është kryer kur personi hyn apo nuk largohet nga banesa ose në objektin e mbyllur etj. Dispozitiv i përbërë i figurës së veprës penale konsiderohet edhe rasti kur veprën penale të caktuar mund ta kryejnë persona të ndryshëm. P.sh. veprën penale deklarimet e rrejshme, nga neni 384 i KPRK, mund ta kryej pala, dëshmitari, eksperti, përkthyesi apo interpreti, etj. Gjithashtu, dispozitiv i përbërë i veprës penale janë edhe dispozitivët të cilat e parashohin kryerjen e veprës penale në mënyrë alternative ndaj objekteve të caktuara. P.sh. vepra penale cenimi i fshehtësisë së korrespondencës dhe i bazave të të dhënave kompjuterike, nga neni 199 i KPRK, e cila mund të kryhet me rastin e hapjes në mënyrë të paautorizuar të letrës, telegramit, faksimilit apo të ndonjë dokumenti tjetër të mbyllur.

2) Dënimi - Për çdo vepër penale në pjesën e posaçme të KPRK, janë parashikuar edhe llojet e dënimeve të cilat mund t’ju shqiptohen kryerësve të veprave penale. Në bazë të zgjidhjeve të pranishme në KPRK, në teorinë e së drejtës penale njihen disa mënyra për të paraparë dënimet për vepra penale, e këto janë :

a) Parashikimi i një apo më shumë llojeve të dënimeve. Është e mundur që për një vepër penale të parashihet një ose më shumë lloje të dënimeve. Kështu p.sh. për veprën penale të falsifikimit të parasë, nga neni 296 paragrafi 1 të KPRK është parashikuar vetëm një lloj i dënimit dhe atë dënimi me burgim prej një deri në dhjetë vjet. Ndërsa, për veprën penale privimi i kundërligjshëm nga liria, nga neni 193 i KPRK janë parashikuar dy lloje të dënimit dhe atë dënimi me gjobë apo dënimi me burgim deri tre vjet. Në rastet e tilla dënimet janë të parapara **në mënyrë alternative**. Në këto raste dënimet e parapara në mënyrë alternative janë të barabarta dhe gjykata është e autorizuar ta shqiptoj njërin apo tjetrin lloj të dënimit. Nëse për një vepër penale parashihet se kryerësi i saj do të dënohet me burgim dhe me gjobë, atëherë në rastet e tilla është fjala për mundësinë e shqiptimit të dy llojeve të dënimeve **në mënyrë kumulative**. Sipas KPRK, zakonisht mundësia e shqiptimit të dy llojeve të dënimeve në mënyrë kumulative është paraparë për rastet e veprave penale të cilat kryhen me qëllim të fitimit të dobisë pasurore. Rast i tillë i parashikimit të mundësisë së shqiptimit të dënimit me gjobë dhe me burgim në mënyrë kumulative është p.sh. vepra penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave

psikotropike, nga neni 267, paragrafi 1 i KPRK, për të cilën është parashikuar në mënyrë kumulative dënimi me gjobë dhe me burgim prej dy deri në tetë vjet.

b) Dënimet kryesore, alternative dhe plotësuese. Në nenin 39 të KPRK, është parashikuar se ekzistojnë dënimet kryesore, dënimet alternative dhe dënimet plotësuese. Dënime kryesore janë ato dënime për të cilat ligji parasheh se mund të shqiptohen në mënyrë autonome për veprën e caktuar penale. Përkatësisht, dënimet kryesore janë ato lloje të dënimeve që mund të shqiptohen si të vetme ndaj kryerësit të veprës penale, pavarësisht nga lloji tjetër i dënimit. Sipas nenit 40 të KPRK dënimet kryesore janë dënimi me burgim të përjetshëm, dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë.

Dënimet alternative janë të parapara në nenin 46 të KPRK-së. Sipas kësaj dispozite ligjore, dënimet alternative janë : dënimi me kusht, gjysmëliria dhe urdhri për punë në dobi të përgjithshme. Kur shqipton dënim me kusht, gjykata po ashtu mund të shqiptojë:

- 1) Urdhrin për trajtim të detyrueshëm rehabilitues dhe
- 2) Urdhrin për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues.

Dënime plotësuese janë ato lloje të dënimeve të cilat mund të shqiptohen vetëm krahas dënimit kryesor apo alternativ. Dënimet plotësuese, në fakt, janë dënime komplementare dhe duhet ta përforcojnë efektin e dënimit kryesor. Në nenin 59 të KPRK është parashikuar shprehimisht se personave që kanë kryer vepra penale, bashkë me dënimin kryesor ose alternativ, mund t'u shqiptohen edhe këto dënime plotësuese : heqja e të drejtës për t'u zgjedhur; urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit; ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik; ndalimi i ushtrimit të profesionit, i veprimtarisë ose detyrës; ndalimi i drejtimit të automjetit; marrja e lejes së vozitjes; urdhri për publikimin e aktgjykimit dhe dëbimi i të huajit nga territori i Republikës së Kosovës.

c) Dënimet permanente dhe kohore. Dënime permanente janë ato dënime që kryerësit të veprës penale i shqiptohen për gjithë jetën dhe ato ndryshe quhen edhe dënime të përjetshme. Në të drejtën tonë penale dënim permanent është dënimi me burgim të përjetshëm.²⁴⁵ KPRK nuk njeh dënime permanente përkatësisht dënim me burgim të përjetshëm. Dënime kohore janë ato që shqiptohen për një kohë të kufizuar përkatësisht për një kohë të caktuar. Dënim kohor është dënimi me burgim prej 30 ditëve deri në 25 vjet, përkatësisht deri në 35 vjet për veprat penale për të cilat parashihet dënimi me burgim të përjetshëm.²⁴⁶

d) Dënimet e parapara në mënyrë absolute dhe relative. Dënimet e përcaktuara në mënyrë absolute janë ato lloje të dënimeve me burgim apo me gjobë të cilat janë të përcaktuara në mënyrë të saktë për veprën penale të caktuar dhe në rastet e tilla gjykata nuk mund të shqiptojë masë më të vogël apo me të lartë të dënimit. Në mënyrë absolute është i paraparë dënimi me

²⁴⁵ Dënimi me burgim të përjetshëm parashihet edhe në disa kode penale të shteteve tjera (Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, Kodi Penal i Republikës së Bullgarisë, Kodi Penal i Republikës së Hungarisë, etj.).

²⁴⁶ Neni 42 paragrafët 1 dhe 2 të KPRK.

vdekje, në ato kode penale të cilat e njohin këtë lloj të dënimit. Dënimet e parapara në mënyrë absolute e pamundësojnë individualizimin e dënimit dhe si të tilla janë të rralla në legjislacionet penale bashkëkohore.

Dënimet e përcaktuara në mënyrë relative janë dënimet me kohëzgjatje kohore (siç është dënimi me burgim) apo në shumë të caktuar të hollash (siç është dënimi me gjobë), të cilat ligji ua përcakton minimumin e përgjithshëm dhe maksimumin e përgjithshëm, si dhe minimumin e posaçëm dhe maksimumin e posaçëm. Kështu p.sh. në KPRK minimumi i përgjithshëm i dënimit me burgim është 30 ditë, ndërsa maksimumi i përgjithshëm i dënimit me burgim është 25 vjet, përkatësisht 35 vjet. Minimumi i përgjithshëm i dënimit me gjobë është 100 €, kurse maksimumi i përgjithshëm i dënimit me gjobë është 25.000 €, kurse për vepra penale lidhur me terrorizimin, trafikimin me njerëz, krim të organizuar ose vepra penale të kryera me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, maksimumi i dënimit me gjobë është 500.000 €.

Të paraparët në mënyrë relative të dënimeve për veprat penale të caktuara është i mundur në 4 mënyra të ndryshme duke i kombinuar minimumet dhe maksimumet e përgjithshme dhe të posaçme. Në legjislacionin penal kjo bëhet në këto mënyra vijuese

1) Duke paraparë vetëm llojin e caktuar të dënimit, pa e caktuar minimumin dhe maksimumin e posaçëm. Në këto raste aplikohet minimumi dhe maksimumi i përgjithshëm. Kështu p.sh. për veprën penale kanosja, në mënyrë alternative me dënimin me burgim është parashikuar dënimi me gjobë (neni 181 i KPRK). Meqenëse për këtë vepër penale nuk është parashikuar minimumi dhe maksimumi i posaçëm i dënimit me gjobë, atëherë aplikohet minimumi dhe maksimumi i përgjithshëm i dënimit me gjobë, kështu që kryerësit të saj mund t'i shqiptohet dënim me gjobë prej 100 € (minimumi i përgjithshëm) deri në 25.000 €.

2) Duke e paraparë llojin e caktuar të dënimit dhe vetëm minimumin e posaçëm. Në këto raste aplikohet maksimumi i përgjithshëm i atij lloji të dënimit. P.sh. për veprën penale të vrasjes, nga neni 172 i KPRK, është parashikuar dënimi me burgim prej së paku 5 viteve. Për këtë vepër penale është caktuar lloji i dënimit (dënim me burgim) dhe vetëm minimumi i posaçëm i atij lloji të dënimit (së paku 5 vjet burgim). Ose për veprën penale të dhunimit (me pasojë vdekjen e viktimës), nga neni 227 paragrafi 5 të KPRK është parashikuar dënimi me burgim prej së paku 10 vjetëve ose me burgim të përjetshëm. Në këto raste, meqenëse nuk është caktuar maksimumi i posaçëm, atëherë aplikohet maksimumi i përgjithshëm i dënimit me burgim dhe kryerësve të veprave të tilla penale mund t'ju shqiptohet dënimi me burgim deri në 25 vjet burgim.

3) Duke e paraparë llojin e caktuar të dënimit dhe vetëm maksimumin e posaçëm. Në këto raste kur për ndonjë vepër penale konkrete është caktuar vetëm maksimumi i posaçëm i dënimit, por nuk është caktuar minimumi i posaçëm, atëherë aplikohet minimumi i përgjithshëm i atij lloji të dënimit. P.sh. për veprën penale mosdhënia e ndihmës, nga neni 188 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar mundësia e shqiptimit të dënimit me burgim deri një vit. Ose, për veprën penale të vjedhjes, nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar në mënyrë alternative me dënimin me gjobë edhe mundësia e shqiptimit të dënimit me burgim

deri në tri vjet. Në këto raste, meqenëse nuk është caktuar minimumi i posaçëm i dënimit me burgim, atëherë aplikohet minimumi i përgjithshëm i dënimit me burgim dhe kryerësve të veprave të tilla penale mund t'ju shqiptohet dënimi me burgim prej së paku 30 ditëve.

4) Duke e parashikuar llojin e caktuar të dënimit dhe minimumin, si dhe maksimumin e posaçëm të atij lloji të dënimit. Për shumicën dërmuese të veprave penale, në KPRK është parashikuar minimumi dhe maksimumi i posaçëm i llojit të caktuar të dënimit. Kështu, p.sh. për veprën penale të lëndimit të rëndë trupor, nga neni 186 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar dënimi me burgim prej 6 muaj deri në 5 vjet. Në këtë rast, minimumi i posaçëm është 6 muaj burgim, kurse maksimumi i posaçëm është 5 vjet.

5. SISTEMI I PJESËS SË POSAÇME TË SË DREJTËS PENALE

Në kodet penale të shteteve bashkëkohore sistemi i pjesës së posaçme është i ndërtuar duke marrë për bazë objektin mbrojtës grupor. Objekt mbrojtës grupor në fakt janë kapitujt e veprave penale të parapara në pjesën e posaçme të kodit penal.²⁴⁷ Këtë kriter të sistemimit të pjesës së posaçme e ka përvetësuar edhe Kodi Penal i Kosovës.

Pjesa e posaçme e KPRK përbëhet prej 18 kapitujve, prej të cilëve në 17 kapituj janë të parashikuara veprat penale, kurse në kapitullin e fundit gjenden dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Të gjitha veprat penale janë të sistemuara në 17 kapituj me këtë radhitje dhe me këta tituj vijues:

Kapitulli XIV: Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës;

Kapitulli XV: Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare;

Kapitulli XVI: Veprat penale kundër jetës dhe trupit;

Kapitulli XVII: Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut;

Kapitulli XVIII: Veprat penale kundër të drejtave të votimit;

Kapitulli XIX: Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës;

Kapitulli XX: Veprat penale kundër integritetit seksual;

Kapitulli XXI: Veprat penale kundër martesës dhe familjes;

Kapitulli XXII: Veprat penale kundër shëndetit publik;

²⁴⁷ Në pjesën e posaçme të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, veprat penale janë të sistemuara në 11 kapituj apo krerë me këtë radhitje : Kreu I, Krimet kundër njerëzimit; Kreu II, Veprat penale kundër personit; Kreu III, Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike; Kreu IV, Veprat penale kundër mjedisit; Kreu V, Krimet kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues; Kreu VI, Krimet që cenojnë marrëdhëniet me shtetet tjera; Kreu VII, Aktet terroriste; Kreu VIII, Krimet kundër autoritetit të shtetit; Kreu IX, Veprat penale kundër drejtësisë; Kreu X, Veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve dhe Kreu XI, Veprat penale të kryera nga bandat e armatosura dhe organizata kriminale. Më gjerësisht shih ELEZI, ISMET, E drejta penale, Pjesa e posaçme, Tiranë, 2002. Kodi penal i Republikës së Shqipërisë, është miratuar me Ligjin nr.7895, të datës 27.01.1995 dhe është në fuqi që nga data 01.06.1995 (në tekstin e mëtejme KPRSH).

Kapitulli XXIII: Veprat penale të narkotikëve;
Kapitulli XXIV: Krimi i organizuar;
Kapitulli XXV: Veprat penale kundër ekonomisë;
Kapitulli XXVI: Veprat penale kundër pasurisë;
Kapitulli XXVII: Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore;
Kapitulli XXVIII: Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe të pasurisë;
Kapitulli XXIX: Veprat penale të armëve;
Kapitulli XXX: Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik;
Kapitulli XXXI: Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike;
Kapitulli XXXII : Veprat penale kundër rendit publik dhe
Kapitulli XXXIII : Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare.

KAPITULLI II

VEPRAT PENALE KUNDËR RENDIT KUSHTETUES DHE SIGURISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

I. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME

Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës dhe banorëve të saj, zënë vend qendror në strukturën e pjesës së posaçme të KPRK, për arsye se me këto vepra penale rrezikohet apo dëmtohen të mirat juridike që janë shumë të rëndësishme për qytetarin dhe për shoqërinë kosovare në përgjithësi. Për shkak të rrezikshmërisë shumë të madhe dhe të pasojave të cilat mund t'i shkaktojnë, për këto lloje të veprave penale parashihen dënime të rënda.

Këto vepra penale në teorinë e së drejtës penale ndryshe emërtohen edhe si vepra penale politike (*crimes politique*), për arsye se më së shpeshti kryhen me motive politike.

Në kodet penale të shteteve bashkëkohore, këto vepra penale emërtohen me emërtime të ndryshme, si p.sh. “veprat penale kundër shtetit”,²⁴⁸ “veprat penale kundër integritetit të shtetit”,²⁴⁹ “veprat penale kundër sistemit kushtetues dhe sigurisë së shtetit”,²⁵⁰ “krimet kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues”,²⁵¹ etj.

Në këtë kapitull të Kodit Penal të Kosovës, nuk janë parashikuar disa vepra penale, të cilat parashikohen me kodet penale të shteteve tjera bashkëkohore, siç janë : sulmi kundër rendit kushtetues të Republikës së Kosovë, kryengritja e armatosur, vrasja e përfaqësuesve të lartë të Republikës së Kosovës, sabotimi, spiunazhi, etj.

Objekt mbrojtës i këtij Kapitulli të veprave penale, janë integriteti territorial i shtetit, pavarësia e shtetit, rregullimi kushtetues, siguria, funksionimi i rregullt i organeve të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, etj.

Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës dhe banorëve të saj, kryhen vetëm me formën më të rëndë të fajësisë, me dashje. Përveç dashjes, për t'u konsideruar se është kryer vepra e caktuar penale, në disa raste kërkohet që ajo të jetë kryer me motiv të caktuar, përkatësisht me qëllim të caktuar. Kështu p.sh. vepra penale e terrorizmit nga neni 129 i KPRK, konsiderohet se është kryer vetëm nëse njëri nga veprimet e parashikuara me këtë dispozitë ligjore është ndërmarrë me qëllim të frikësimit serioz të popullatës, të detyrimit të padrejtë të një organi publik, të një qeverie ose organizate ndërkombëtare për të kryer ose për të mos kryer çfarëdo vepre apo që seriozisht të destabilizojë ose të shkatërrojë

²⁴⁸ Ligji Penal i Republikës së Kroacisë, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, Kodi Penal i Republikës së Bullgarisë, etj.

²⁴⁹ Kodi Penal i Bosnje dhe Hercegovinës.

²⁵⁰ Kodi Penal i Malit të Zi.

²⁵¹ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Kreu V, nenet 208 - 225.

strukturat themelore politike, ekonomike ose sociale të Kosovës, të një vendi ose të një organizate ndërkombëtare.

Për shkak të rrezikshmërisë shumë të madhe dhe të pasojave të cilat mund t'i shkaktojnë, për këto lloje të veprave penale parashihen dënime të rënda. Kështu p.sh. për veprën penale kryerja e veprave terroriste, nga neni 129 paragrafi 3 të KPRK, është parashikuar mundësia e shqiptimit të dënimit me burgim të përjetshëm.

II. VEPRAT PENALE TË KËTIJ KAPITULLI

1. Sulmi kundër rendit kushtetues të Republikës së Kosovës (neni 114)

Objekt i mbrojtjes penalo-juridike të kësaj vepre penale është sistemi juridik, rendi kushtetues dhe organet e pushtetit të Kosovës.

Sipas nenit 114 paragrafi 1 të KPRK, këtë vepër penale e kryen “Kushdo që me përdorim të dhunës apo me kanosje të dhunës tenton që ta ndryshojë rendin kushtetues të Republikës së Kosovës apo të përmbysë institucionet më të larta të Republikës së Kosovës”.

Forma tjera të kësaj vepre penal janë parashikuar në paragrafët 2 dhe 3 të nenit të lartcekur. Kështu, sipas paragrafit 2 të nenit 114 të KPRK, këtë formë të kësaj vepre penale e kryen “Kushdo që me përdorim të dhunës apo me kanosje të dhunës tenton që të pengojë vendosjen e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës apo me përdorim të dhunës ose kanosjes së dhunës implementon rendin e huaj juridik në ndonjë pjesë të Republikës së Kosovës”

Ndërsa sipas paragrafit 3 të nenit 114 të KPRK, më të rëndë të kësaj vepre penale e kryen “Kushdo që me përdorim të dhunës ose me kanosje të dhunës tenton të rrezikojë pavarësinë e Kosovës, sovranitetin dhe integritetin e saj territorial, tërësinë territoriale dhe karakterin demokratik të shtetit”, për të cilën është parashikuar dënim jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim.

Pasoja e kësaj vepre penale është rreziku abstrakt për funksionimin e pa pengesa dhe të rregullt të këtyre organeve.

Vepra penale konsiderohet se është kryer me vetë faktin e tentativës që të ndryshohet sistemi juridik apo përmbysen organet publike.

Kryerës i këtyre formave të veprës penale mund të jetë çdo person.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Për veprat penale sipas paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 114 është parashikuar dënimi me burgim së paku pesë vjet.

2. Veprat penale të terrorizmit

Shprehja terrorizëm rrjedh nga gjuha latine “**terror**” që do të thotë “**tmerr**”, “**trishtim**”, “**frikë**”, “**dridhje**”.²⁵² Së këndejmi, terrorizmi në kuptimin më të gjerë do të thotë përdorimi i dhunës apo kërcënimit me qëllim të shkaktimit të frikës dhe të pasigurisë ndaj individëve, grupit të qytetarëve apo të mirave materiale.

Shkaktimi i frikës dhe pasigurisë te njerëzit, kryerja e atentateve ndaj bartësve të funksioneve politike apo shtetërore, asgjësimi i objekteve të rëndësishme ekonomike apo ushtarake, përdorimi i dhunës apo kanosjes sistematike dhe të organizuar dhe akte të tjera terroriste, më së shpeshti janë të drejtuara me qëllim të destabilizimit të rendit juridik dhe të sistemit politik të një shteti. Për këtë arsye, si edhe në kodet penale të shteteve tjera, edhe në KPRK, ky lloj i kriminalitetit është sistemuar në kapitullin e veprave penale kundër Kosovës dhe banorëve të saj. Përveç inkriminimit me dispozita të kodeve penale, me qëllim të kundërvënies sa më të suksesshme dhe reagimit adekuat ndaj akteve terroriste, shume shtete përendimore, siç janë : Britania e Madhe, Gjermania, Italia, Franca, etj. kanë nxjerr edhe ligje të posaçme kundër terrorizmit.

Terrorizmi dhe aktet terroriste, në forma të ndryshme janë paraqitur qysh në kohën antike. Nga paraqitja e terrorizmit në kohën antike e deri në ditët e sotme, mënyra dhe mjetet e kryerjes së akteve terroriste kanë ndryshuar vazhdimisht.

Terrorizmi si formë e kriminalitetit tani pothuaj është prezente në të gjitha shtetet e botës bashkëkohore dhe është duke shkaktuar pasoja shumë të rënda, viktima në njerëz, dëme të mëdha materiale, gjendje të pasigurisë, etj.

Me akte terroriste në shumë raste dëmtohen apo rrezikohen të mirat juridike që i përkasin dy apo më shumë shteteve, andaj për këtë arsye terrorizmi konsiderohet edhe si vepër penale me karakter ndërkombëtar. Pikërisht për këtë arsye, lufta kundër terrorizmit konsiderohet njëri ndër problemet dhe brengat më të mëdha të bashkësisë ndërkombëtare. Kjo ka ndikuar që lufta kundër terrorizmit të rregullohet edhe me akte juridike ndërkombëtare.

Aktet terroriste mund të kryhen nga një person, mirëpo për shkak të natyrës dhe kompleksitetit të tyre, më së shpeshti kryhen me pjesëmarrjen e shumë personave dhe zakonisht nga organizata kriminale, në formë të krimit të organizuar.

Aktet terroriste kryhen gjithmonë me dashje dhe me qëllim që të shkaktojnë frikë dhe ndjenjë të pasigurisë te të tjerët. Shkaktimi i frikës dhe pasigurisë është ngusht i lidhur me motivin dhe qëllimin përfundimtar të kryerësit i cili konsiston në dobësimin dhe rrënimin e pushtetit shtetëror mbi një territor të caktuar dhe kështu të krijohen kushtet për të ardhur në pushtet organizata (partia) në kuadër të së cilës veprojnë terroristët.²⁵³

²⁵² DEMOLLI, HAKI, Terrorizmi, Prishtinë, 2002, f. 6.

²⁵³ Idem, f. 183.

Pikërisht motivi dhe qëllimi i kryerësit bën që këto akte të kualifikohen si akte terroriste dhe të dallohen nga disa vepra penale të cilat kryehen me mjete dhe mënyra të ngajshme.

Shembuj kur aktet terroriste dallohen nga disa vepra penale tjera

Nëse personi A e privon nga jeta personin B me qëllim të frikësimit serioz të popullatës, të detyrimit të padrejtë të një organi publik, të një qeverie ose organizate ndërkombëtare për të kryer ose për të mos kryer çfarëdo vepre apo që seriozisht të destabilizojë ose të shkatërrojë strukturat themelore politike, ekonomike ose sociale të Kosovës, të një vendi ose të një organizate ndërkombëtare, atëherë veprimi i personit A do të kualifikohet si akt terrorist. Nëse personi A e privon nga jeta personin B, për qëllime tjera e jo për qëllimet e lartcekura, atëherë veprimet e personit A do të kualifikohen si vrasje e rëndomtë apo vrasje e rëndë, apo ndonjë vepër tjetër penale, varësisht nga rrethanat e rastit konkret.

Kryerës i akteve terroriste mund të jetë çdo person.

Në nenin 128 paragrafi 1 të KPRK, terrorizmi përkufizohet si kryerje e një ose më shumë veprave penale të mëposhtme me qëllim të frikësimit serioz të popullatës, të detyrimit të padrejtë të një organi publik, të një qeverie ose organizate ndërkombëtare për të kryer ose për të mos kryer çfarëdo vepre, apo që seriozisht të destabilizojë ose të shkatërrojë strukturat themelore politike, ekonomike ose sociale të Republikës së Kosovës, të një vendi ose të një organizate ndërkombëtare.

Në pikat 1-19 të paragrafi 1 të nenit 128 të KPRK, si vepra të terrorizmit të kryera me qëllim të sipërpërmendur, konsiderohen :

- 1.1. vrasja apo vrasja e rëndë në shkelje të nenit 172 dhe 173 të këtij Kodi;
- 1.2. shtytja apo ndihma në vetëvrasje në shkelje të nenit 177 të këtij Kodi;
- 1.3. sulmi, sulmi me lëndim të lehtë trupor dhe sulmi me lëndim të rëndë trupor në shkelje të neneve 184-186 të këtij Kodi;
- 1.4. veprat penale kundër integritetit seksual në shkelje të neneve 227-229, 231-232 ose 234 të këtij Kodi;
- 1.5. marrja e pengjeve, rrëmbimi ose privimi i kundërligjshëm nga liria në shkelje të neneve 169, 191 ose 193 të këtij Kodi;
- 1.6. ndotja e ujit të pijshëm ose e produkteve ushqimore; ndotja ose shkatërrimi i mjedisit në shkelje të neneve 264 dhe Kapitullit XXVI të këtij Kodi;
- 1.7. shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm; zjarr vënia apo djegia ose shpërthimi nga pakujdesia ose përdorimi i eksplozivëve ose mjeteve të tjera vdekjeprurëse në shkelje të neneve 322 ose 356 të këtij Kodi;

1.8. shkatërrimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike apo rrezikimi i trafikut publik në shkelje të neneve 122, 357, 370 ose 372 të këtij Kodi;

1.9. furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve, eksplozivit materialeve radioaktive ose armëve nukleare, biologjike ose kimike në shkelje të neneve 170, 361 ose 364-369 të këtij Kodi;

1.10. përvetësimi i paautorizuar, mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose përdorimi i armëve, eksplozivit materialeve radioaktive ose armëve nukleare, biologjike ose kimike, ose hulumtimet për ose ndërtimi i armëve biologjike ose kimike në shkelje të neneve 170, 361 ose 364-369 të këtij Kodi;

1.11. rrezikimi i personave të mbrojtur ndërkombëtarisht në shkelje të nenit 167 të këtij Kodi;

1.12. rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to në shkelje të nenit 168 të këtij Kodi;

1.13. rrëmbimi i fluturakes ose marrja e kundërligjshme e fluturakes në shkelje të nenit 158 të këtij Kodi, ose rrëmbimi i mjeteve tjera të transportit publik apo të transportit të mallrave;

1.14. rrezikimi i sigurisë së aviacionit civil në shkelje të nenit 159 të këtij Kodi;

1.15. rrëmbimi i anijeve ose rrezikimi i sigurisë së lundrimit detar në shkelje të nenit 160 të këtij Kodi;

1.16. rrezikimi i sigurisë së platformave fikse të vendosura në pragun kontinental në shkelje të nenit 161 të këtij Kodi;

1.17. përvetësimi, përdorimi, prodhimi, posedimi, transferimi, ndryshimi, asgjësimi, shpërndarja ose dëmtimi i paautorizuar i materialeve nukleare apo radioaktive në shkelje të nenit 170 të këtij Kodi;

1.18. kanosja për përdorimin apo vjedhjen ose grabitjen e materialeve nukleare apo përdorimin e materialeve radioaktive në shkelje të nenit 171 të këtij Kodi;

1.19. kanosja për kryerjen e ndonjëres prej veprave të saktësuara në nën-paragrafët 1.1 deri në 1.18 të këtij paragrafi.

2.1. Kryerja e veprave terroriste (neni 129)

Veprimi i kryerjes së veprës penale të terrorizmit është përcaktuar në mënyrë alternative. Konsiderohet se kryhet vepra penale e terrorizmit, nëse njëra apo disa nga veprat penale të cekura në pikat 1-19, paragrafi 1, të nenit 128 të KPRK kryhen me këto qëllime :

- me qëllim të frikësimit serioz të popullatës,

- të detyrimit të padrejtë të një organi publik, të një qeverie ose organizate ndërkombëtare për të kryer ose për të mos kryer çfarëdo vepre apo
- që seriozisht të destabilizojë ose të shkatërrojë strukturat themelore politike, ekonomike ose sociale të Republikës së Kosovës, të një vendi ose të një organizate ndërkombëtare.

Pasoja e kësaj vepre penale konsiston në shkaktimin e pasigurisë personale të qytetarët apo grupi i qytetarëve.

Vepra penale konsiderohet se ekziston nëse kryhet njëra apo disa nga veprat e cekura më lart.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje direkte dhe me motivet e cekura më lart.

Për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me burgim jo më pak se pesë vjet.

Në paragrafin 2 të këtij neni, është parashikuar forma e rëndë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se ekziston nëse si rezultat i kryerjes së kësaj vepre penale janë shkakuar lëndime të rënda trupore të ndonjë një ose më shumë personave. Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim jo më pak se dhjetë.

Kurse, në paragrafin 3 të këtij neni, është parashikuar forma edhe më rëndë e kësaj vepre penale, e cila ekziston nëse shkaktohet vdekja e një ose më shumë personave, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim së paku pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim përjetshëm.

2.2. Ndhimja në kryerjen e veprave terroriste (neni 130)

Për shkak të rrezikshmërisë së madhe të veprës penale të terrorizmit, ndihma në kryerjen e kësaj vepre penale është inkriminuar në mënyrë të veçantë në nenin 130 të KPRK. Sipas kësaj dispozite ligjore, kjo vepër penale ekziston nëse vepra penale moslajmërimi i përgatitjes së veprës penale, nga neni 377 i KPRK ose moslajmërimi i veprave penale ose kryesve të tyre, nga neni 378 i KPRK kryhet në lidhje me terrorizmin.

Vepra penale ndihma në kryerjen e veprave terroriste, nga paragrafi 1 i këtij neni, konsiderohet se kryhet në këto tri raste :

- 1) nëse kryerësi duke qenë në dijeni për përgatitjen e kryerjes së veprave terroriste nuk e lajmëron këtë fakt në kohën kur kryerja e veprave terroriste ende ka mund të evitohet, ndërsa vepra terroriste është kryer ose është tentuar që të kryhet (neni 377);
- 2) nëse kryerësi duke qenë në dijeni për identitetin e kryerësit të veprave terroriste ose për kryerjen e veprës së tillë penale, nuk lajmëron faktin e tillë edhe pse zbulimi i kryerësit të veprës penale varet nga ky lajmërim (neni 378) dhe

- 3) nëse personi zyrtar apo personi përgjegjës nuk e lajmëron veprën terroriste të cilën e ka zbuluar gjatë ushtrimit të detyrës së tij.

Formë tjetër e kësaj vepre penale është paraparë në paragrafin 2 të nenit 130 të KPRK, në të cilën është inkriminuar dhënia e ndihmës kryerësit pas kryerjes së veprave terroriste. Këtë formë të kësaj vepre penale e kryen personi i cili e strehon kryerësin e veprave terroriste ose e ndihmon atë në shmangien e zbulimit të veprës përmes fshehjes së mjeteve, provave apo në çfarëdo mënyre tjetër, ose nëse personi e strehon personin e dënuar për vepra terroriste apo ndërmerr veprime për pengimin e ekzekutimit të dënimit apo urdhrit për trajtim të detyrueshëm.

Në paragrafin 3 të nenit 130 të KPRK, është inkriminuar ndihma e cila i jepet kryerësit ose bashkëpjesëmarrësit të veprës penale të terrorizmit, duke siguruar fonde apo burime tjera financiare.

Sipas paragrafi 2 të nenit 128 të KPRK, shprehja “fonde” përfshin pasurinë e çfarëdo lloji, qoftë e prekshme ose e paprekshme, e luajtshme ose e paluajtshme, sido që të jetë fituar, dhe dokumentet apo instrumentet ligjore në çfarëdo forme, përfshirë formën elektronike ose digjitale, të dëshmuarit e pronësisë ose të interesit në pasuritë e tilla, përfshirë por pa u kufizuar në, kreditë bankare, çeqet e udhëtarëve, çeqet bankare, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, detyrimet, çeqet letër kreditë dhe çdo mjet tjetër financiar.

Ndërsa, shprehja “burime financiare” përfshin, por nuk kufizohet në, dhënien me qira, objektet e thezoreve, dokumentacionin ose identifikimin e rrejshëm, shërbimet financiare, pajisjet, personelin, armët, mjetet e transportit, pajisjet e komunikimeve dhe pasurinë tjetër fizike, përveç medikamenteve të domosdoshme.

Kryerës i veprës penale ndihma në kryerjen e veprave terroriste, nga neni 130 i KPRK, mund të jetë çdo person, përveç formës nga paragrafi 1 të këtij neni të cilën mund ta kryejnë edhe personi zyrtar dhe personi përgjegjës.

Kjo veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Dënimi për veprën penale nga paragrafi 1 është parashikuar prej gjashtë muajve deri në pesë vjet burgim, kurse për veprat penale nga paragrafët 2 dhe 3, është parashikuar prej tre deri në dhjetë vjet burgim.

2.3. Lehtësimi i kryerjes së terrorizmit (neni 131)

Lehtësimi i kryerjes së terrorizmit është veprë penale speciale, ngase inkriminon veprimet të cilat i kontribuohet kryerjes së akteve terroriste në mënyrë komplekse dhe shumica e të cilave nuk mund të konsiderohen si vepra të ndihmës në kuptimin klasik, e të cilat në një mënyrë janë në distancë më të largët se ndihma.

Sipas paragrafit 1 të nenin 131 të KPRK, forma themelore e veprës penale të lehtësimit të kryerjes së terrorizmit konsiderohet se kryhet nëse ndonjë person në çfarëdo mënyre, të

drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ofron, kërkon, mbledh ose fsheh, organizon, përgatit, vë në dispozicion fonde apo mjete të tjera materiale ose drejton të tjerët për këto veprime, me dashje se do të përdoren, dijani apo bazë të arsyeshme për të besuar se do të përdoren, tërësisht ose pjesërisht, për apo nga një individ terrorist, grup terrorist, apo për të kryer apo për të kontribuar për kryerjen e veprës terroriste.

Sipas paragrafit 2 të nenit 131 të KPRK, që një vepër të përbëjë vepër penale sipas paragrafit 1 të këtij neni, nuk është e nevojshme që një veprim terrorist të ndodh ose nëse fondet janë përdorur në të vërtetë për të kryer një veprim të tillë terrorist.

Këtë vepër penale mund ta kryejë çdo person dhe mund të kryhet vetëm me dashje.

Për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me gjobë deri në pesëqindmijë Euro dhe dënimi me burgim prej pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

2.4. Organizimi, përkrahja dhe pjesëmarrja në grupet terroriste (neni 136)

Vepra penale e terrorizmit mund të kryhet vetëm nga një person. Mirëpo, për shkak të kompleksitetit, mjeteve të cilat përdoren për kryerjen e tyre dhe për shkak të natyrës së këtyre veprave, veprat terroriste më së shpeshti kryhen me pjesëmarrjen e dy ose më shumë personave në formë të grupit, bandës apo formave tjera të krimit të organizuar.

Me inkriminimin e organizimit, përkrahjes dhe pjesëmarrjes në grupet terroriste, KPRK e zgjeron zonën kriminale edhe për veprimet përgatitore, para se të fillojë kryerja, realizimi i akteve terroriste. Pra, me KPRK ndëshkohen edhe veprimet përgatitore që kanë të bëjnë me kryerjen e veprave terroriste.

Organizimi, përkrahja dhe pjesëmarrja në grupet terroriste është paraparë si vepër penale e veçantë.

Forma e parë dhe themelore e kësaj vepre penale, është parashikuar në paragrafin 1 të nenit 136 të KPRK dhe konsiderohet se kryhet në rastet kur ndonjë person krijon, organizon ose drejton një grup terrorist. Veprime të kryerjes të formës themelore të kësaj vepre penale janë krijimi, organizimi ose drejtimi i një grupi terrorist. Shprehja “grup terrorist” do të thotë grup i strukturuar prej më shumë se dy personave i themeluar gjatë një periudhe kohore dhe i cili vepron në bashkëpunim për kryerjen e terrorizmit (neni 129 paragrafi 5 i KPRK).

Në paragrafin 2 të këtij neni, është inkriminuar edhe pjesëmarrja në veprimtaritë e grupit terrorist. Sipas kësaj dispozite ligjore, do të konsiderohet penalisht përgjegjës çdo person i merr pjesë në veprimtaritë e grupit terrorist.

Te dyja format e kësaj vepre penale mund t'i kryejë çdo person dhe mund të kryhen vetëm me dashje.

Për formën e parë është parashikuar dënimi me gjobë deri në 500.000 € dhe me burgim prej dhjetë deri në njëzet vjet, kurse për formën e dytë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej pesë deri në dhjetë vjet.

3. Veprat e tjera penale të këtij kapitulli

Përveç veprave penale të lartcekura, në këtë kapitull, janë parashikuar edhe këto vepra penale :

- Kryengritja e armatosur (neni 115);
- Pranimi i kapitullimit dhe okupimit (neni 116);
- Tradhtia ndaj vendit (neni 117);
- Rrezikimi i tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës (neni 118);
- Vrasja e përfaqësuesve të lartë të Republikës së Kosovës (neni 119);
- Rrëmbimi i përfaqësuesve të lartë të Republikës Kosovës (neni 120);
- Dhuna ndaj përfaqësuesve të lartë të Republikës Kosovës (neni 121);
- Rrezikimi i rendit kushtetues me shkatërrimin apo dëmtimin e instalimeve dhe pajisjeve publike (neni 122);
- Sabotimi (neni 123);
- Spiunazhi (neni 124);
- Zbulimi i informacioneve të klasifikuara dhe mos ruajtja e informacioneve të klasifikuara (neni 125);
- Veprat e rënda kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës (neni 126);
- Bashkimi për veprimtari kundër kushtetuese (neni 127);
- Rekrutimi për terrorizëm (neni 132);
- Trajnimi për terrorizëm (neni 133);
- Shtytja për kryerjen e veprave terroriste (neni 134);
- Fshehja ose moslajmërimi i terroristëve apo grupeve terroriste (neni 135);
- Udhëtimi për qëllime të terrorizmit (neni 137);
- Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës (neni 138);
- Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare (neni 140) dhe
- Nxitja e përçarjes dhe mos durimit (neni 141).

KAPITULLI III

VEPRAT PENALE KUNDËR NJERËZIMIT DHE VLERAVE TË MBROJTURA ME TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE

I. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME

Ky grup i veprave penale është radhitur në Kapitullin XV të KPRK dhe mban titullin “Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare”. Një emërtim i tillë i këtij kapitulli është bërë me qëllim që maksimalisht të inkriminohen të gjitha veprat e mundshme, me të cilat dëmtohen apo rrezikohen vlerat ndërkombëtare, mbarënjëzore.

Objekt i përbashkët mbrojtës i këtyre veprave penale, siç rezulton edhe nga titulli i këtij kapitulli, janë vlerat e mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare. Rrjedhimisht, me këtë grup të veprave penale mbrohen vlerat, të cilat bashkësia ndërkombëtare i konsideron si vlera mbarënjëzore, siç janë, p.sh. : ekzistenca e grupeve të caktuara nacionale, etnike, racore apo fetare, popullësia civile, paqja, robërit e luftës, etj. Gjithashtu, me këtë Kapitull, mbrohen edhe personat që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare, autoriteti i shteteve të huaja dhe simbolet e tyre, siguria e qarkullimit ajror dhe detar, etj.

Të gjitha veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare në KPRK janë parashikuara në një numër të konsiderueshëm të dispozitave ligjore. Të gjitha këto inkriminime bazohen në shkeljen e rregullave të caktuara të së drejtës ndërkombëtare. Për këtë arsye, edhe pse këto inkriminime janë mjaft voluminoze, shumë dispozita kanë karakter blanket, ngase udhëzojnë që të zbatohen rregullat e së drejtës ndërkombëtare, përkatësisht dispozitat e konventave dhe akteve të caktuara ndërkombëtare.

Me gjithë faktin se veprat penale të këtij kapitulli dallohen midis tyre për nga mënyra e kryerjes, personi që mund t'i kryejë, pasojat që mund të shkaktohen dhe tiparet e tjera, ekzistojnë edhe karakteristika të përbashkëta, të cilat shprehen sidomos në këto elemente:

- bazë e këtyre inkriminimeve janë konventat dhe aktet e caktuara ndërkombëtare. Me këto konventa dhe akte ndërkombëtare janë përcaktuar hollësisht figurat e veprave penale të këtij kapitulli. Së këndejmi, shumica e këtyre inkriminimeve të parashikuara në KPRK, sikundër edhe në kodet penale të shteteve të tjera, janë me karakter blanket.

- me rastin e kryerjes së këtyre veprave penale, dëmtohen apo rrezikohen vlerat e ndryshme, siç janë: jeta dhe trupi, shëndeti, dinjiteti i njeriut, morali, pasuria, liritë dhe të drejtat e caktuara, të mbrojtura edhe me të drejtën ndërkombëtare, etj. Mirëpo, me gjithë numrin relativisht të madh të inkriminimeve, në këtë Kapitull të KPRK, nuk janë përfshirë të gjitha veprat penale, të cilat e kanë bazën në konventat ndërkombëtare, ngase te veprat e tilla penale dominon ndonjë objekt tjetër i mbrojtur. Vepra të këtilla, të cilat edhe pse bazën e kanë në konventat dhe aktet e tjera ndërkombëtare, janë të parashikuara në kapitujt tjerë të KPRK, janë, p.sh. blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave

psikotropike, mundësimi i prostitucionit, keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi, tregimi i materialit pornografik personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç, tortura, etj.

- shumica e veprave penale kundër të drejtës ndërkombëtare mund të kryhen vetëm me dashje. Mirëpo, disa forma të veprave penale të këtij Kapitulli, mund të kryhen edhe nga pakujdesia, si p.sh. vepra penale rrezikimi i sigurisë së aviacionit publik, nga neni 159, paragrafi 6 i KPRK; vepra penale rrezikimi i sigurisë së lundrimit detar, nga neni 160, paragrafi 5 i KPRK, etj. Përveç dashjes, për ekzistimin e disa veprave penale, duhet që të ekzistojë edhe qëllimi i caktuar. Kështu p.sh. te krimi i gjenocidit, nga neni 142 i KPRK, krahas dashjes, gjykata duhet të konstatojë se ky lloj krimi është kryer me qëllim që tërësisht apo pjesërisht të asgjësohet grupi i caktuar nacional, etnik, racor apo fetar.

- për disa vepra penale të këtij Kapitulli nuk zbatohet institucioni i parashkrimit. Lidhur me këtë, në nenin 104 paragrafi 1 të KPRK është parashikuar shprehimisht se : “Asnjë afat i parashkrimit nuk zbatohet për veprat penale të gjenocidit, krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit, ose për vepra tjera penale të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare nuk parashkruhen”.

- për shkak të rrezikshmërisë shumë të madhe të veprave penale kundër të drejtës ndërkombëtare dhe për shkaqe kriminalo-politike, me qëllim që të intervenohet me të drejtën penale në një fazë më të hershme të kryerjes së këtyre veprave penale, me KPRK në disa raste janë inkriminuar edhe veprimet përgatitore të cilat ndërmerren me qëllim të kryerjes së disa prej veprave penale të këtij Kapitulli. Përveç kësaj, ndërmarrja e veprimeve përgatitore për kryerjen e disa veprave penale të këtij Kapitulli, është parashikuar si vepër penale e posaçme. Kështu, me nenin 154 të KPRK, është parashikuar si vepër penale organizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës.

- kryerës i shumicës së veprave penale të këtij Kapitulli mund të jetë çdo person, mirëpo disa nga veprat penale të këtij Kapitulli mund t'i kryejnë vetëm personat që posedojnë cilësi të caktuara, si p.sh. veprën penale përgjegjësia e komandantëve dhe përgjegjësve të tjerë, nga neni 155 i KPRK, mund ta kryejë vetëm “komandanti ushtarak ose personi i cili në mënyrë efektive vepron si komandant usharak”; veprën penale piratëria, nga neni 162 i KPRK, mund ta kryej vetëm “anëtari i ekuipazhit, ose udhëtari i anijës, ose fluturakës”, etj.

II. VEPRAT PENALE TË KËTIJ KAPITULLI

1. Gjenocidi (neni 142)

Termi gjenocid rrjedh prej fjalës greko-latine : “**genos**“ - që do të thotë racë, komb, gjini apo fis dhe fjalës latine “**occidere**“, që domethënë të vrasësh, të zhdukësh, të asgjësosh. Këtë term për herë të parë e ka krijuar polaku Rafael Lemkin (1900-1959), në vitin 1943.

Krimi i gjenocidit është lloji më i rëndë në mesin e të gjitha veprave penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare. Winston Churchill e ka quajtur gjenocidin “**krim pa emër**”,

ndërsa Gjykata Ndërkombëtare Penale për Ruandë²⁵⁴ e ka përshkruar gjenocidin si “**krim i krimeve**”.

Krimi i gjenocidit në të drejtën ndërkombëtare dhe në legjislacionet penale të shteteve aktuale konsiderohet vepra penale, e cila kryhet me qëllim të zhdukjes (asgjësimit) të plotë apo të pjesërishëm të grupit nacional, etnik, racor apo fetar. Për shkak të rëndësisë shumë të madhe, veçanërisht për shkak të pasojave jashtëzakonisht të rënda, të cilat shkaktohen me krimin e gjenocidit, Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, më datën 09.12.1948, e miratoi Konventën për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit.²⁵⁵ Këtë Konventë e kanë ratifikuar shumica e shteteve bashkëkohore, anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, duke i inkorporuar njëherësh dispozitat e kësaj Konvente edhe në legjislacionet e tyre penale. Edhe Kosova gjithashtu e ka paraparë krimin e gjenocidit në nenin 142 të KPRK, duke u bazuar në dispozitat e Konventës për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit.

Në nenin 1 të Konventës për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit thuhet se shtetet kontraktuese ripohojnë se gjenocidi, i kryer qoftë në kohë paqeje, qoftë në luftë, është krim kundër të drejtës së popujve, krim të cilin ata angazhohen ta parandalojnë dhe ta ndëshkojnë. Ndërsa, në nenin 2 të kësaj Konvente, si krime të gjenocidit, i cili kryhet me qëllim të zhdukjes së plotë apo të pjesshme të grupit nacional, etnik, racor apo fetar, konsiderohen këto vepra :

- 1) vrasja e anëtarëve të grupit,
- 2) shkaktimi i lëndimeve të rënda fizike apo mendore të anëtarëve të grupit,
- 3) vënia e qëllimshme e grupit në kushte të atilla të jetës të cilat shpijnë në

shfarosje të plotë apo të pjesërishme fizike,

- 4) vënia e masave me qëllim që të pengohen lindjet brenda grupit dhe
- 5) transferimi me dhunë i fëmijëve të një grupi në grupin tjetër.

²⁵⁴ Gjykata Ndërkombëtare Penale e Ruandës, ka kompetenca për t’i gjykuar penalisht personat e përgjegjës për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare të kryera në territorin e Ruandës dhe qytetarët e Ruandës, përgjegjës për shkelje të tilla të kryera në territorin e shteteve fqinje ndërmjet datës 01.01.1994 dhe 31.12.1994. Më gjerësisht lidhur me këtë shih : www.unict.org

²⁵⁵ Konventa për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit, është miratuar dhe paraqitur për nënshkrim, ratifikim ose aderim nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, me Rezolutën e saj 260 A (III), të datës 09.12.1948. Kjo Konventë ka hyrë në fuqi më datën 12.01.1951.

Të njëjtin përkufizim të krimit të gjenocidit, të parashikuar në Konventën e lartpërmendur, e ka përvetësuar edhe Statuti i Tribunalit të Hagës (neni 4),²⁵⁶ Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare për Gjykimin e Personave Përgjegjës për Gjenocid dhe Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare të Kryera në Territorin e Ruandës (neni 2) dhe Statuti i Gjykatës së Përhershme Ndërkombëtare Penale (neni 6).²⁵⁷

Përkufizim të ngjashëm të krimit të gjenocidit hasim edhe në shumicën e kodeve penale të shteteve bashkëkohore. Në mënyrë të njëjtë është përkufizuar krimi i gjenocidit edhe në nenin 142 të KPRK, sipas së cilit “kushdo që me qëllim të asgjësimit të tërësishëm apo të pjesërishtëm të ndonjë grupi kombëtar, etnik, racor apo fetar si të tillë kryen njërin ose më shumë nga veprimet e mëposhtme, si:

- 1) Vrasjen e anëtarëve të grupit;
- 2) Shkaktimin e dëmeve të rënda trupore apo mendore të anëtarëve të grupit;
- 3) Vënien e qëllimshme të grupit në kushte të tilla të jetës të cilat shpiejnë në shfarosje të plotë apo të pjesërishtë fizike;
- 4) Vënien e masave me qëllim që të pengohen lindjet brenda grupit;
- 5) Transferimin me dhunë të fëmijëve të grupit në një grup tjetër dënohet me së paku pesëmbëdhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm”.

Sipas nenit 3 të Konventës për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit, përveç kryerjes së krimit të gjenocidit, janë të ndëshkueshme edhe këto veprime :

- marrëveshja për kryerjen e gjenocidit,
- shtytja e drejtpërdrejtë dhe publike për të kryer gjenocid,
- tentativa për gjenocid dhe
- bashkëpunimi në gjenocid.

Kurse, në nenin 4 të kësaj Konvente, është parashikuar se personat që kanë kryer gjenocid ose cilëndo nga veprat e cekura në nenin 3 të kësaj konvente, do të ndëshkohen, qofshin ata qeveritarë, funksionarë apo persona të veçantë.

²⁵⁶ Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Individëve Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991. Më gjerësisht lidhur me këtë shih : www.icty.org

²⁵⁷ Statuti i Gjykatës së Përhershme Penale Ndërkombëtare është hartuar duke u bazuar në konventat e Gjenevës dhe në statutet e gjykatave të mëparshme për krime lufte. Në nenin 5 të këtij Statuti, thuhet se Gjykata do të ketë juridiksion që t'i gjykojë kryerësit e krimeve më serioze, që janë në interes të bashkësisë ndërkombëtare. Sipas kësaj dispozite ligjore, në juridiksionin e kësaj Gjykate do të jenë : a) krimi i gjenocidit, b) krimet kundër njerëzimit, c) krimet e luftës dhe d) krimi i agresionit. Më gjerësisht lidhur me këtë shih : *ëëë.icc-cpi.int*

Për shkak të rrezikshmërisë shumë të madhe të krimit të gjenocidit dhe për shkaqe kriminalo-politike, me qëllim që të intervenohet me të drejtën penale në një fazë më të hershme të kryerjes së këtij krimi, në nenin 154 të KPRK, janë inkriminuar edhe veprimet përgatitore të cilat ndërmerren me qëllim të kryerjes së këtij krimi. Kështu, në këtë dispozitë ligjore është parashikuar si vepër penale e posaçme, organizimi dhe anëtarësimi në grupe me qëllim të kryerjes së veprës penale të gjenocidit.

Kryerës i krimit të gjenocidit konsiderohet çdo person që urdhëron kryerjen e këtij krimi, si dhe ai që e kryen atë. Urdhërdhënës konsiderohet personi civil apo ushtarak që gjendet në pozita të larta në hierarkinë shtetërore, ushtarake apo policore, i cili ka autorizime që të japë urdhëra. Si urdhërdhënës konsiderohet edhe personi që, në rrethanat konkrete, mund t'ua imponojë vullnetin e vet të tjerëve ose në rastet kur një grup personash e pranojnë si udhëheqës, i zbatojnë urdhërat e tij.

Kryerës i drejtpërdrejtë mund të jetë një apo më shumë persona. Pozita zyrtare e cilitdo kryerës, pa marrë parasysh nëse është kryetar shteti apo person përgjegjës në qeveri, siç u theksua më sipër, nuk e përjashton atë nga përgjegjësia penale, madje nuk mund të merret as si rrethanë lehtësuese me rastin e matjes së dënimit.²⁵⁸

Konventa e lartpërmendur, veprimin e kryerjes së krimit të gjenocidit e ka përcaktuar në mënyrë restriktive dhe jo ilustrative. Marrë në tërësi, veprimet e kryerjes së këtij krimi qëndrojnë në dëmtimin apo rrezikimin e integritetit biopsikik të anëtarëve të grupit.

Veprimet e kryerjes së krimit të gjenocidit, duke u bazuar në Konventën e lartcekur dhe në KPRK, janë :

- 1) Vrasja e anëtarëve të grupit nacional, etnik, racor apo fetar konsiston në privimin nga jeta të anëtarëve të grupit. Te vrasja e anëtarëve të grupit, kryerësi duhet të ketë qëllim asgjësimin e plotë apo të pjesërishëm të grupit të tillë.
- 2) Shkaktimi i lëndimeve të rënda trupore, nënkupton shkaktimin e lëndimeve të anëtarëve të grupit, ndërsa shkaktim i lëndimeve të rënda psikike nënkupton një formë të atillë të gjenocidit, e cila kryhet duke përdorur narkotikë dhe mënyra të ndryshme të shkaktimit të mundimeve psikike.
- 3) Vënia e grupit në rrethana jetësore, të cilat do të shkaktonin shfarosjen e plotë apo të pjesërishme, nënkupton imponim të aso rrethanave jetësore të cilat me siguri do të shkaktonin vdekjen e personave.
- 4) Pengimi i lindjeve brenda grupit mund të kryhet me ndërmarrjen e veprimeve të ndryshme, si p.sh. me anë të tredhjes, abortimit me dhunë, sterilizimit, duke i veçuar personat e gjinisë (seksit) të kundërt, etj.

²⁵⁸ SALIHU, ISMET, E drejta penale, Pjesa e posaçme, Prishtinë, 2014, f. 86.

- 5) Transferimi me dhunë i fëmijëve të një grupi në një grup tjetër konsiderohet si formë e posaçme e pengimit të lindjeve. Kështu, në këto raste fëmijët e një grupi transferohen në grupin tjetër, në të cilin ata i ekspozohen gjuhës së huaj, kulturës, fesë, zakoneve dhe vlerave tjera të huaja, duke u asgjësuar kështu një brez i tërë, por edhe brezat e ardhshme.

Grup nacional është grupi që identifikohet me shtetin ekzistues nacional, me shumicën e pjesëtarëve të një kombi brenda një shteti. Ndërsa, grupi etnik është i përbërë nga pakica kombëtare apo ndonjë grup që i përket një gjuhe, një kulture, etj., siç janë në Kosovë p.sh. serbët, boshnjakët, turqit, romët, etj. Grupeve etnike, përkatësisht pakicave u ofrohet mbrojtje e posaçme, ngase në të kaluarën zakonisht këto kanë qenë objekt i shkeljeve të të drejtave, sulmeve, madje edhe të krimit të gjenocidit.

Objekt mbrojtës te krimi i gjenocidit është e drejta për të ekzistuar, për të jetuar e grupeve të caktuara nacionale, etnike, racore apo fetare.

Përveç veprimeve të lartcekura, në teorinë e së drejtës penale njihen edhe disa forma tjera të gjenocidit, si p.sh. gjenocidi kulturor, gjenocidi ekonomik, gjenocidi social, gjenocidi demografik-territorial, etj.

Krimi i gjenocidit ka ngjashmëri me veprën penale të vrasjes, por dallohet prej saj, ngase te vepra penale e vrasjes objekt mbrojtës është njeriu si individ, jeta e tij, ndërsa te krimi i gjenocidit objekt mbrojtës është individi si pjesëtar i një grupi të caktuar nacional, etnik, fetar apo racor, përkatësisht, te krimi i gjenocidit objekt mbrojtës është grupi përkatës. Te krimi i gjenocidit, vrasja dhe lëndimet trupore të individit, shërbejnë si mjet për ta arritur qëllimin e kryerësit, që në këtë rast është zhdukja e plotë apo e pjesërishtme e grupit të caktuar nacional, etnik, racor apo fetar. Në teorinë e së drejtës penale bëhet dallimi ndërmjet krimit të gjenocidit dhe vrasjes, duke përshkruar gjenocidin si “mohim i së drejtës për ekzistencë për grupe të tëra njerëzore” dhe vrasjen si “mohim të së drejtës për jetë të qenieve individuale njerëzore”.

Për t’u konsideruar se është kryer krimi i gjenocidit, krahas dashjes, gjykata duhet të konstatojë se ky lloj krimi është kryer me qëllim që tërësisht apo pjesërisht të asgjësohet grupi i caktuar nacional, etnik, racor apo fetar. Pra, përveç dashjes, për ekzistimin e krimit të gjenocidit duhet që të ekzistoj edhe qëllimi “i shkatërrimit (asgjësimit) të plotë apo të pjesërishtëm të një grupi kombëtar, etnik, racor ose fetar”, e cila ndryshe në teorinë e së drejtës penale emërtohet si “dashje e posaçme” (*dolus specialis*).

Krimi i gjenocidit mund të kryhet gjatë kohës së luftës, gjatë kohës së pushtimit apo gjatë kohës së paqes. Në të shumtën e rasteve, gjenocidi kryhet gjatë kohës së luftës ose gjatë kohës së pushtimit.

Lidhur me ekstradimin, sipas nenit 7 të Konventës së lartpërmendur, gjenocidi nuk konsiderohet vepër penale politike dhe shtetet duhet që të angazhohen që në rast të tillë ta kryejnë ekstradimin.

Sipas nenit 104 të KPRK, për krimin e gjenocidit është përjashtuar mundësia e parashkrimit të ndjekjes penale dhe të ekzekutimit të dënimit.

Për krimin e gjenocidit vlen parimi i juridiksionit universal. Në nenin 9 të Statutit të Tribunalit të Hagës, është parashikuar se edhe Tribunali i Hagës, edhe gjykatat nacionale, në të njëjtën kohë janë kompetente për gjykimin e kryerësve të gjenocidit dhe të veprave të tjera penale kundër të drejtës ndërkombëtare. Mirëpo Tribunali i Hagës ka përparësi ndaj gjykatave nacionale dhe ka të drejtë që në çdo fazë të gjykimit të kërkojë kalimin, transferin e lëndës Tribunalit të Hagës.

Sipas KPRK, kryerësit të veprës penale të gjenocidit mund t'i shqiptohet dënimi prej së paku pesëmbëdhjetë vjet ose dënimi me burgim të përjetshëm.

2. Piratëria (neni 162)

Fjala piratëri rrjedhë prej fjalës greke “**pirates**“ që në kuptimin klasik do të thotë **vjedhës i detit, kugar i detit, bandit i detit**, etj.

Sipas nenit 162 paragrafi 1 të KPRK, këtë vepër penale e kryen anëtari i ekuipazhit ose udhëtari i anijes ose fluturakes, pos për anijen apo fluturaken ushtarake apo publike, i cili, duke shkelur rregullat e së drejtës ndërkombëtare, me qëllim që vetes ose personit tjetër t'i sjell pëfitime materiale apo jomateriale ose të plagosjes serioze të personit tjetër, kryen dhunë të kundërligjshme ndaj anijes apo fluturakes tjetër ose kundër personit ose kundër një sendi në anije apo në fluturake në det të hapur apo në territorin i cili nuk është nën juridiksion të ndonjë shteti.

Këtë vepër penale, sipas paragrafit 2 të këtij neni, e kryen gjithashtu edhe anëtari i ekuipazhit të anijes ose i fluturakes ushtarake apo publike i cili është rebeluar dhe ka uzurpuar autoritetet e anijes apo të fluturakes.

Lidhur me përgjegjësinë penale, kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje, zakonisht me dashje direkte.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm në detin e hapur apo në territorin i cili nuk është nën juridiksionin e asnjë shteti.

Si për veprën penale nga paragrafi 1 të këtij neni, ashtu edhe për veprën penale nga paragrafi 2, është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

3. Kontrabandimi me migrantë (neni 164)

Kontrabandimi i migrantëve është një formë e trafikimit me njerëz, mirëpo për shkak të specifikave të tij, e veçmas për shkak se viktima e kësaj vepre janë vetëm migrantët, KPRK është parashikuar si vepër penale e veçantë.

Në kohën në të cilën jetojmë, kontrandimi me migrantë ka marrë përmasa brengosëse dhe shumë të rrezikshme, ku është duke shkaktuar pasoja shumë të rënda.

Kjo dukuri negative është e determinuar kryesisht nga shkaqet ekonomike. Njerëzit nga shtetet me zhvillim të ulët ekonomik pretendojnë të emigrojnë në shtetet më të zhvillura dhe këtë situatë e shfrytëzojnë personat të tjerë, të cilët për përfitime pasurore merren me kontrabandimin, përkatësisht me trafikimin e migrantëve. Për ta luftuar këtë dukuri negative, sikur në shumë kode penale të shteteve tjera, edhe në KPRK kjo veprimtari është paraparë si vepër penale.

Kështu, në paragrafin 1 të nenit 164 të KPRK, është paraparë se kushdo që merret me kontrabandim të migrantëve konsiderohet se e kryen këtë vepër penale.

Sipas nenit 164 paragrafi 8, nën-paragrafi 8.1. të KPRK, **“kontrabandim me migrantë”** nënkupton çdo veprim me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një dobie financiare ose të një dobie tjetër pasurore nga hyrja e paligjshme e personit në Republikën e Kosovës, i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës ose i një personi qoftë shtetas i Republikës së Kosovës apo shtetas i huaj në shtetin në të cilin personi i tillë nuk është banor i përhershëm ose shtetas i atij shteti. Kurse, sipas nën-paragrafit 8.2. të këtij paragrafi, shprehja **”hyrje e paligjshme”** do të thotë kalimin e kufirit ose vijës kufitare të Republikës së Kosovës pa i përfillur kushtet e domosdoshme për hyrje të ligjshme në Republikën e Kosovës ose kalim i kufijve të ndonjë shteti pa i përfillur kushtet e domosdoshme për hyrjen e ligjshme në atë shtet.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin A.B., për shkak të veprës penale kontrabandimi me migrantë, sepse i akuzuari në fillim të muajit tetor të vitit 2008, në Gjilan, me qëllim që vetes t’i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm është marrë me trafikimin e migrantëve, ashtu që fillimisht ka kontaktuar me të dëmtuarin B.B., të cilit i premtonte se mund ta dërgojë në shtetet e Evropës Përendimore, për shumën e të hollave prej 1.500 €, përmes personit tjetër A.H., ashtu që në mungesë të parave ja merr peng traktorin e markës “IMT” F-765, të cilin traktor e dërgon në Preshevë dhe me datën 10.10.2008, rreth orës 21:30, i akuzuari e fton babain e të dëmtuarit, për t’u takuar te restaurant “X”, për t’ia kompenzuar të akuzuarit shumën e të hollave prej 1.500 €, për dërgimin e djalit të tij në shtetet e Evropës Përendimore në mënyrë që t’ia kthejë traktorin, ku me intervenimin e Policisë së Kosovës, i akuzuari arrestohet.²⁵⁹

Në paragrafin 2 të nenit 164, janë ndëshkuar edhe veprimet përgatitore të veprës penale kontrabandimi me emigrantë. Sipas kësaj dispozite ligjore, **“Kushdo që me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore, prodhon, furnizon, siguron ose posedon dokument të rrejshëm të udhëtimit ose të identifikimit me qëllim të mundësimin të kontrabandimit me migrantë, dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë euro (500.000) dhe me burgim deri në pesë (5) vjet”**. Ndëshkimi i veprimeve përgatitore është bërë

²⁵⁹ Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr.185/2008, i datës 20.01.2009.

për shkak të rrezikshmërisë shumë të madhe të kësaj vepre penale dhe për shkaqe kriminalo-politike, me qëllim që të intervenohet me të drejtën penale në një fazë më të hershme të kryerjes së kësaj vepre penale.

Përveç kësaj, në paragrafin 3 të këtij neni, është inkriminuar edhe veprimi i personave të cilët mundësojnë qëndrimin e migrantëve në shtetet tjera. Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se “Kushdo që i mundëson personit i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës të qëndrojë në Republikën e Kosovës ose personit i cili nuk është shtetas apo banor i përhershëm për të qëndruar në shtetin në fjalë, pa i përfillur kushtet e domosdoshme ligjore për qëndrim, me mjetet nga paragrafi 2 i këtij neni ose me çfarëdo mjetesh tjera të paligjshme, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vit”.

Tentativa për të kryer vepër penale të mundësimit të qëndrimit të migrantëve nga paragrafi 3 i këtij neni është e dënueshme.

Në paragrafin 5 të këtij neni është paraparë forma e rëndë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndonjë person organizon ose drejton personat e tjerë për të kryer vepër penale nga paragrafi 1. ose 2 i këtij neni ku me atë rast edhe është parashikuar se kryerëso do të dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej shtatë (7) deri në njëzet (20) vjet, ose me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet për veprën penale nga paragrafi 3. i këtij neni.

Si formë tjetër e rëndë e kësaj vepre penale është paraparë në paragrafin 6 të këtij neni dhe konsiderohet se ekziston nëse kryerësi është anëtar i grupit ose në një mënyrë e cila rrezikon, ose ka gjasë të rrezikojë jetërat apo sigurinë e migrantëve përkatës ose që përfshin trajtimin çnjerëzor apo degradues, duke përfshirë eksploatimin e migrantëve të tillë. Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim së paku pesë vjet.

Ndërsa, në paragrafin 7 të nenit të lartcekur, është parashikuar forma edhe më e rëndë e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se kryhet në rastet format e kësaj vepre penale sipas paragrafëve 1, 2 ose 3 rezultojnë me vdekjen e një ose më shumë personave, për të është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim së paku dhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Kurse, forma të veçanta të kësaj vepre penale janë parashikuar në paragrafin 10 të nenit të lartcekur, e që i referohen kryerjes së kësaj vepre penale në shtetet e Bashkimit Evropian.

Lidhur me fajësinë, të gjitha këto forma të veprave penale kryhen me dashje.

Kryerës i këtyre veprave penale mund të jetë çdo person.

Në paragrafin 9 të këtij neni është parashikuar se personi nuk është penalisht përgjegjës sipas këtij neni nëse ai është migrant që është objekt i veprës penale nga ky nen.

4. Trafikimi me njerëz (neni 165)

Trafikimi me njerëz (trafikimi me qenie njerëzore) në Kosovë për herë të parë është parashikuar si vepër penale me Rregulloren e UNMIK-ut, nr.2001/4 Mbi Ndalimin e Trafikimit me Njerëz në Kosovë.²⁶⁰

Trafikimi me njerëz është parashikuar si vepër penale më pas edhe më KPRK. Edhe në legjislacionet penale të shteteve të ndryshme bashkëkohore, trafikimi me njerëz është parashikuar si vepër penale.

Në paragrafin 1 të nenit 165 të KPRK, është parashikuar se kushdo që merr pjesë në trafikimin e njerëzve dënohet me gjobë dhe me burgim prej pesë deri në dymbëdhjetë vjet. Kurse, sipas paragrafit 8, nën-paragrafi 6.1. të këtij neni, shprehja "trafikim me njerëz" do të thotë rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim i personave me anë të kanosjes ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthimit, keqpërdorimit të pushtetit apo të keqpërdorimit të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies ose marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër, me qëllim të shfrytëzimit.

Sipas kësaj, veprimet e kryerjes së veprës penale të trafikimit me njerëz janë : rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i personave.

Shprehja "**rekrutim**" në sensin e kësaj vepre penale nënkupton punësimin e personit dhe nuk kërkohet që rekrutuesi të ketë për qëllim ta paguajë atë person.

Shprehja "**transportim**" në sensin e kësaj vepre penale nënkupton lëvizjen fizike të personit nga një lokacion në tjetrin. Kjo nuk kërkon domosdoshmërisht kalimin e kufijve të shtetit dhe një person mund të trafikohet edhe brenda Kosovës.²⁶¹

Shprehja "**transferim**" në sensin e kësaj vepre penale nënkupton veprimet e kryerësit që kanë të bëjnë me dhënien e kontrollit mbi viktimën një personi tjetër, i cili pastaj "e pranon" viktimën e trafikimit.

Shprehja "**pranim**" në sensin e kësaj vepre penale është marrja e kontrollit mbi viktimën dhe zakonisht nga ndonjë person që më parë e ka "rekrutuar" ose "transferuar" viktimën e trafikimit me njerëz.

Shprehja "**strehim**" në sensin e kësaj vepre penale nënkupton sigurimin e dhomës ose një hapësire tjetër për personin, por pa e pranuar atë në cilësinë e viktimës. Nëse kryerësi i siguron

²⁶⁰ Rregullorja e UNMIK-ut, nr.2001/4 Mbi Ndalimin e Trafikimit me Njerëz në Kosovë, është shpallur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, z.Bernard Kouchner dhe ka hyrë në fuqi me 12.01.2001.

²⁶¹ Lidhur me këtë shih : Analiza ligjore e rasteve të trafikimit me njerëz në Kosovë, përgatitur nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE), Prishtinë, 2007, f. 7 dhe IDRIZI, NEHAT : Vepër penale e trafikimit të njerëzve, Revista "Justicia", Viti I, Nr.1, Instituti Gjyqësor të Kosovës, Prishtinë, 2009, f. 67-74.

dhomën ose hapsirën tjetër personit, duke e pranuar atë në cilësinë e viktimës së trafikimit me njerëz, atëherë do të ekzistonte “pranimi”, e jo “strehimi”.

Siç shihet, veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe për ekzistimin e kësaj vepre penale mjafton të jetë ndërmarrë njëri nga këto veprime.

Shembuj nga praktika gjyqësore të kësaj vepre penale

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin H.Q., për shkak të veprës penale trafikimi me njerëz, sepse i akuzuari në intervalin kohor prej fundit të muajit Janar të vitit 2005 e deri më datën 29.04.2005, me qëllim shfrytëzimi e ka trafikuar të dëmtuaren S.U., në atë mënyrë që e ka pranuar dhe strehuar në një banesë, e pastaj me anë të kërcënimeve dhe formave tjera të detyrimit, ka ndikuar për të arritur pëlqimin e të dëmtuares për t’i ofruar shërbime seksuale personave tjerë.²⁶²

Duke u bazuar në nenin 165 paragrafi 6, nën-paragrafi 6.1. të KPRK, për ekzistimin e veprës penale të trafikimit me njerëz nuk mjafton që vetëm të jetë ndërmarrë njëri apo disa nga veprimet e kryerjes (rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i personave), por duhet që veprimi i kryerjes të jetë ndërmarrë duke përdorur mjetet e caktuara. Për ekzistimin e kësaj vepre penale, nevojitet që veprimet e kryerjes të jenë ndërmarrë me anë të mjeteve të kërcënimit ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit, apo keqpërdorimit të pushtetit apo të pozitës, ose të një pozite të ndjeshme, ose me anë të dhënies apo marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër. Prandaj, vetëm transferimi, pranimi, strehimi, rekruitimi ose transportimi i personit nuk përbën në vete veprën penale të trafikimit. Ky kusht aplikohet vetëm nëse viktima e trafikimit është e moshës madhore dhe nuk aplikohet nëse viktima e trafikimit është fëmijë, ngase me nenin 165 paragrafi 8, nën-paragrafi 6.4. të KPRK, është parashikuar se rekruitimi, transportimi, transferi, strehimi ose pranimi i fëmijës me qëllim të shfrytëzimit konsiderohet ”trafikim me njerëz”, madje edhe nëse kjo nuk përfshin asnjërin nga mjetet e përcaktuara në nën-paragrafin 6.1. të këtij paragrafi.

Në paragrafin 2 të nenit 165 të KPRK, është parashikuar formë e rëndë e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet në një perimetër prej treqind e pesëdhjetë (350) metrash nga shkolla apo mjedisi tjetër i cili përdoret nga fëmijët ose kur vepra kryhet ndaj personit nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet.

Formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, e cila konsiderohet se ekziston nëse kryerësi organizon një grup personash për të kryer veprën penale trafikimi me njerëz, nga paragrafi 1 i këtij neni, për të cilën është parashikuar dënimi me gjobë deri në 500.000 € dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet. Siç shihet, për formën më të rëndë të veprës penale të trafikimit me njerëz është parashikuar në mënyrë kumulative dënimi me gjobë dhe me burgim.

²⁶² Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr.380/2005, i datës 16.02.2006.

Në paragrafin 4 të këtij neni, është parashikuar një formë tjetër e rëndë e kësaj vepre penale të cilën mund ta kryejë vetëm personi zyrtar. Sipas kësaj dispozite ligjore, nëse vepra penale nga ky nen kryhet nga personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës së tij kryerësi dënohet me burgim prej pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet për veprën penale nga paragrafet 1 ose 2 dhe me burgim prej së paku dhjetë vjetësh për veprën penale nga paragrafi 3.

Në nenin 165 paragrafi 6, nën-paragrafi 6.3. të KPRK, është parashikuar se pëlqimi i viktimës së trafikimit me njerëz për qëllime shfrytëzimi nuk merret parasysh kur cilado prej mjeteve të përcaktuara më lart në nën-paragrafin 6.1 të këtij neni është përdorur kundër viktimës së tillë.

Të gjitha këto forma të veprave penale të trafikimit me njerëz mund t'i kryejë çdo person, përveç formës së rëndë, nga paragrafi 4 i këtij neni, që mund ta kryejë vetëm personi zyrtar.

Lidhur me fajësinë të gjitha këto forma të kësaj vepre penale mund të kryhen vetëm me dashje. Përveç dashjes, për ekzistimin e veprës penale të trafikimit me njerëz duhet që të ekzistoj edhe qëllimi i shfrytëzimit. Sipas nenit 165 paragrafi 6, nën-paragrafi 6.2. të KPRK, shprehja "shfrytëzim" përfshin, por nuk kufizohet në, shfrytëzimin e prostitucionit të tjerëve, pornografisë ose formave tjera të shfrytëzimit seksual, lëmshës, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve apo qelizave.

Duke u bazuar në këtë çka u tha më lart dhe në nenin 165 paragrafi 6, nën-paragrafi 1 të KPRK, shihet se vepra penale e trafikimit me njerëz, parimisht përbëhet prej këtyre tri elementeve :

- 1) **Veprimeve të kryerjes** (rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i personave),
- 2) **Mjeteve të kryerjes** (me anë të kanosjes ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthimit, keqpërdorimit të pushtetit apo të keqpërdorimit të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies ose marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër) dhe
- 3) **Qëllimit të shfrytëzimit** (shfrytëzimin e prostitucionit të tjerëve, pornografisë ose formave tjera të shfrytëzimit seksual, lëmshës, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve apo qelizave).

5. Veprat e tjera penale të këtij kapitulli

Në Kapitullin e veprave penale kundër të drejtës ndërkombëtare, janë paraparë edhe këto vepra penale :

- Krimet kundër njerëzimit (neni 143),
- Krimet e luftës në kundërshtim të rëndë me Konventat e Gjenevës (neni 144),

- Krimet e luftës si shkelje e rëndë e ligjeve dhe e zakoneve që zbatohen në konfliktin e armatosur ndërkombëtar (neni 145),
- Krimet e luftës për shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët me Konventat e Gjenevës (neni 146),
- Krimet e luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar (neni 147),
- Sulmet në konfliktet e armatosura që nuk kanë karakter ndërkombëtar kundër instalimeve që përmbajnë forca të rrezikshme (neni 148),
- Rekrutimi dhe regjistrimi i personave i fëmijëve në konfliktin e armatosur (neni 149),
- Përdorimi i mjeteve ose i metodave të ndaluara të luftimit (neni 150),
- Shtyrja e paarsyeshme e riatdhesimit të robërve të luftës ose e civilëve (neni 151),
- Përvetësimi i kundërligjshëm i sendeve nga të vrarët ose të plagosurit në fushëbetejë (neni 152),
- Rrezikimi i negociatorëve (neni 153),
- Oganizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës (neni 154),
- Përgjegjësia e komandantëve dhe përgjegjësve të tjerë (neni 155),
- Shtytja për luftë agresive ose konflikt të armatosur (neni 156),
- Keqpërdorimi i emblemave ndërkombëtare (neni 157),
- Rrëmbimi i flururakes (neni 158),
- Rrezikimi i sigurisë së aviacionit civil (neni 159),
- Rrezikimi i sigurisë së lundrimit detar (neni 160),
- Rrezikimi i sigurisë së platformave fikse të vendosura në pragun kontinental (neni 161) dhe
- Skllavëria, kushtet e ngjashme me skllavërinë dhe puna e detyruar (neni 163),
- Fshehja e dokumenteve të identifikimit të viktimave të skllavërisë ose trafikimit me njerëz (neni 166),
- Rrezikimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare (neni 167),

- Rrezikimi i personelit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to (neni 168),
- Marrja e pengjeve (neni 169),
- Përvetësimi, pranimi, shfrytëzimi, prodhimi, posedimi, transferi, ndryshimi, asgjësimi, shpërndarja ose dëmtimi i paautorizuar i materialeve nukleare apo radioaktive (neni 170) dhe
- Kanosja për përdorimin ose kryerjen e vjedhjes apo të grabitjes së materialit nuklear ose radioaktiv (neni 171).

KAPITULLI IV

VEPRAT PENALE KUNDËR JETËS DHE TRUPIT

I. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME

Veprat penale kundër jetës dhe trupit janë një ndër inkriminimet më të rëndësishme si në ligjet e kohës së vjetër, ashtu edhe në ligjet e periudhave të mëvonshme dhe deri në ditët e sotme. Disa institute të përgjithshme të së drejtës penale, siç janë mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, bashkëpunimi, etj. në fillim janë shqyrtuar vetëm si probleme të veprave penale kundër jetës dhe trupit, kurse më vonë këto institute janë bërë institute të përgjithshme të së drejtës penale. Për këto vepra penale në legjislacionet penale të lashta, si dhe në ato bashkëkohore, janë parashikuar dënimet më të rënda, sepse pasojat e këtyre veprave penale janë të mëdha dhe në disa raste edhe të pariparueshme.

Me vepra penale kundër jetës dhe trupit, nënkuptojmë veprat penale të cilat personi privohet nga jeta, i shkaktohet lëndim trupor apo i rrezikohet jeta.

Mirëpo, duhet theksuar se jeta dhe trupi i njeriut mbrohen jo vetëm me Kapitullin e veprave penale kundër jetës dhe trupit, por edhe me disa kapituj tjerë të pjesës së posaçme të KPRK. Kështu, p.sh., jeta dhe trupi i njeriut mbrohet edhe me Kapitullin e veprave penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare, me Kapitullin e veprave penale kundër shëndetit publik, me Kapitullin e veprave penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe të pasurisë, etj. Shkaku i parashikimit të veprave penale kundër jetës dhe trupit edhe në kapituj të tjerë të KPRK, qëndron në atë se atje, përveç jetës dhe trupit të njeriut, veçanërisht dhe në masë më të madhe, pretendohet të mbrohen disa vlera të rëndësishme individuale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Andaj, si vepra penale kundër jetës dhe trupit konsiderohen ato vepra penale me të cilat kryesisht dhe në mënyrë ekskluzive sulmohet jeta dhe trupi i njeriut dhe jo ndonjë vlerë tjetër e mbrojtur me të drejtën penale.

Si objekt mbrojtës i veprave penale kundër jetës dhe trupit janë jeta dhe integriteti trupor i njeriut. Jeta e njeriut është objekt mbrojtjeje i së drejtës penale që nga zënia e frytit dhe lindja, e deri në vdekje. Së këndejmi, në këtë kapitull të veprave penale bëjnë pjesë, përveç vrasjes, edhe ndërprerja e palejuar e shtatzënësisë.

Jeta e njeriut është gjëja më e çmuar dhe e pazëvendësueshme me asgjë tjetër. Me humbjen e jetës humbin të gjitha të drejtat tjera të njeriut, humb ekzistenca e njeriut.

E drejta e jetës është e drejtë e cila është e garantuar edhe me kushtetutat e shteteve bashkëkohore dhe me ligje tjera themelore. Kjo e drejtë është e garantuar me nenin 25 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në të cilën është parashikuar se “secili individ gëzon të drejtën për jetën”. Përveç kësaj, e drejta e jetës është e garantuar edhe me dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare, siç janë :

- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (neni 2),
- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (neni 3),
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (neni 6),
- Konventa e të Drejtave të Fëmijës (neni 6), etj.

Pasoja të këtyre veprave penale është asgjësimi, dëmtimi apo rrezikimi i jetës ose i trupit të njeriut.

Kryerës i shumicës së veprave penale kundër jetës dhe trupit mund të jetë çdo person. Mirëpo, disa vepra penale të këtij Kapitulli mund t'i kryejnë vetëm personat që posedojnë cilësi të caktuara apo që gjenden në raporte të caktuara me viktimën, p.sh. veprën penale vrasja e foshnjeve gjatë lindjes, nga neni 176 të KPRK, mund ta kryejë vetëm nëna e foshnjës, etj.

Shumica e veprave penale kundër jetës dhe trupit mund të kryhen vetëm me dashje. Përveç dashjes, për ekzistimin e disa veprave penale të këtij Kapitulli, duhet që të ekzistoj edhe qëllimi apo motivi i caktuar i kryerësit, p.sh. vrasja e rëndë e motivuar në bazë të kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njërën nga këto karakteristika të mbrojtura (neni 173 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.10 të KPRK), vrasja e rëndë me qëllim të fitimit të dobisë pasurore (neni 173 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6 të KPRK), vrasja e rëndë me qëllim të kryerjes apo të fshehjes së ndonjë veprë tjetër penale (neni 173 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7 të KPRK), etj. Mirëpo, disa vepra penale kundër jetës dhe trupit mund të kryhen edhe nga pakujdesia, p.sh. vepra penale vrasja nga pakujdesia, nga neni 175 i KPRK, vepra penale lëndimi i rëndë trupor, nga neni 186 paragrafi 6 i KPRK, etj.

Veprat penale kundër jetës dhe trupit, në teorinë e së drejtës penale mund të ndahen apo kategorizohen në grupe të ndryshme, varësisht se cili kriter mirret për bazë.

Kështu, nëse mirret për bazë forma e fajit, veprat penale kundër jetës dhe trupit mund të ndahen në dy grupe :

- 1) Vepra penale kundër jetës dhe trupit të kryera me dashje dhe
- 2) Vepra penale kundër jetës dhe trupit të kryera nga pakujdesia.

II. VEPRAT PENALE TË KËTIJ KAPITULLI

1. Vrasja (neni 172)

Në KPRK varësisht prej mënyrës së kryerjes, motiveve, personit që është privuar nga jeta (viktimës) dhe rrethanave tjera, parashihen tri lloje vrasjesh :

1. Vrasja (neni 172),
2. Vrasjet e cilësuara ose të rënda (neni 173) dhe
3. Vrasjet e privileguara ose të lehta (neni 174-176).

Nga kjo shihet se e drejta jonë penale e përvetëson sistemin tripartit të vrasjeve, sistem ky që është përvetësuar edhe në shumicën e shteteve të regjionit dhe më gjerë.

Forma themelore e vrasjes është parashikuar në nenin 172 të KPRK. Në teorinë e së drejtës penale kjo vrasje, ndryshe quhet edhe si “vrasje e thjeshtë apo e rëndomtë”.

Në nenin 172 të KPRK, në të cilën parashihet “vrasja e rëndomtë apo e thjeshtë” nuk përmenden tipare të posaçme të kësaj vepre penale, por vetëm thuhet “Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta dënohet...”. Andaj, në bazë të kësaj mund të konstatojmë se si vrasje të rëndomta sipas KPRK, parimisht konsiderohen të gjitha ato vrasje të cilat mungojnë tiparet e posaçme që i karakterizojnë vrasjet e rënda dhe të lehta.

Veprimi i kryerjes së vrasjes, nga neni 172 i KPRK, konsiston në privimin e personit tjetër nga jeta nga ana e kryerësit.

Vepra penale e vrasjes, nga neni 172 i KPRK, mund të kryhet me veprim dhe me mosveprim. Kjo vepër penale kryhet me veprim kur kryerësi ndërmer veprime aktive me qëllim që personin tjetër ta privojë nga jeta, p.sh. e gjuan me armë zjarri, e godet me thikë, etj. Kurse, me mosveprim kjo vepër penale konsiderohet se kryhet atëherë kur kryerësi me qëllim që personin tjetër ta privojë nga jeta, nuk e ndërmer veprimin të cilin ka qenë i obliguar ta kryejë.

Shembuj kur vrasja kryhet me mosveprim

- Nëse nëna me qëllim që ta privojë nga jeta fëmijën e vet nuk i jep ushqim dhe kështu për shkak të mungesës së ushqimit fëmija vdes.

Lidhur me mënyrën e veprimit, vepra penale e vrasjes mund të kryhet me veprim të drejtpërdrejtë apo me veprim indirekt. Me veprim të drejtpërdrejtë vepra penale e vrasjes konsiderohet se kryhet, kur kryerësi me veprimin e tij të drejtpërdrejtë e privon personin tjetër nga jeta, p.sh. duke e goditur me sopatë apo me thikë, etj. Në mënyrë indirekte vepra penale vrasjes konsiderohet se kryhet, jo vetëm me veprimin e kryerësit, por edhe me ndërmjetësimin e ndonjë personi tjetër, madje edhe të vetë viktimës.

Shembuj kur vrasja kryhet me veprim indirekt

- Nëse personi A me qëllim që ta privojë nga jeta personin B, me postë ia dërgon paketën personin B, në të cilën gjendet eksplozivi i cili aktivizohet me rastin e hapjes së paketës dhe kështu shkakton vdekjen e personit B.

- Nëse personi A me qëllim që ta privojë nga jeta personin B, vendos helm në ushqimin e personit B, i cili pas ngrënjes së ushqimit vdes, etj.

Vepra penale e vrasjes mund të kryhet me mjete të ndryshme, mirëpo në praktikën gjyqësore është konstatuar se kjo vepër penale më së shpeshti kryhet me armë zjarri, me thikë, me sopatë, përmes helmit, me eksploziv, me ndonjë send të fortë, etj. Në teorinë e së drejtës penale, mjetet e kryerjes së veprës penale të vrasjes ndahen në tri grupe :

- 1) Mjete fizike apo mekanike (armët, eksplozivët, mjetet e forta, thika, sopata, energjia elektrike, energjia radiologjike, me anë të zjarrit, etj.),
- 2) Mjete kimike (helmi, etj.) dhe
- 3) Mjete psikike (duke shkaktuar frikë të madhe dhe të papritur te viktima, që mund të shkaktojë infarkt, etj

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e kishte shpallur fajtor të akuzuarin A.A., për shkak të veprës penale të vrasjes, sepse i njeiti në një lokal, pas një zënke të shkurtër, e kishte privuar nga jeta të ndjerin B.B., duke e goditur dy herë me thikë, në pjesën e përparme të gjoksit, afër zemrës.

Objekt mbrojtës i veprës penale të vrasjes është jeta e njeriut. Jeta e njeriut është objekt mbrojtës i kësaj vepre penale që nga momenti i lindjes e deri në vdekje. Si moment i lindjes konsiderohet momenti kur bëhet ndarja e frytit nga barku i nënës, kurse si moment i vdekjes konsiderohet momenti kur pushojnë funksionet jetësore të organizmit, pas të cilit vjen menjëherë shuarja e veprimtarisë së indeve dhe qelizave të organizmit të njeriut.

Procesi i vdekjes përbëhet nga dy faza : nga vdekja klinike dhe nga vdekja biologjike.²⁶³ Vdekja klinike karakterizohet nga një gjendje e atillë e organizmit kur pas pushimit të plotë të qarkullimit të gjakut dhe të frymarrjes, vazhdon një veprimtari biologjike e indeve që zgjat jo më shumë se 10 minuta. Me përdorimin e masave mjekësore të ringjalljes, në këtë interval kohor, sot është bërë e mundur që shumë njerëz të kthehen në jetë. Vdekja biologjike vjen menjëherë pas vdekjes klinike dhe karakterizohet nga një gjendje kur organizmi ka vdekur në “tërësi”, pasi në këtë fazë ndodh edhe vdekja cerebrale (e trurit). Mirëpo, në disa raste vdekja mund të jetë biologjike që në fillim të saj.²⁶⁴ Vdekja biologjike është vdekje absolute e njeriut, ngase me gjithë masat e ndërmarra mjekësore, jeta e njeriut nuk mund të kthehet. Andaj, në të drejtën penale bashkëkohore është akceptuar mendimi se si moment i vdekjes te veprat penale të vrasjeve duhet konsideruar momentin kur ndodh vdekja biologjike, me ç’rast shkaktohet edhe vdekja e trurit të njeriut.

Privimi i një personi tjetër nga jeta konsiderohet vepër penale e vrasjes, vetëm nëse në rastin konkret nuk ka ekzistuar ndonjë rrethanë e cila e përjashton kundërligjshmërinë. Kështu, vepra penale e vrasjes nuk do të ekzistojë nëse privimi i një personi nga jeta është bërë duke vepruar në mbrojtje të nevojshme (neni 12 KPRK) ose në kushtet e nevojës ekstreme (neni 13 i KPRK),

²⁶³ MEKSI, SOKRAT; ÇIPI, BARDHYL: Mjekësia ligjore, Tiranë, 2003, f. 19-20.

²⁶⁴ *Idem*, f. 20.

sepse mbrojtja e nevojshme dhe nevoja ekstreme konsiderohen rrethana që e përjashtojnë kundërligjshmërinë.

Pasojë e kësaj vepre penale është shkaktimi i vdekjes së personit tjetër.

Vepra penale e vrasjes, nga neni 172 të KPRK, mund të kryhet vetëm me dashje (direkte ose eventuale). Nëse një person e privon nga jeta personin tjetër nga pakujdesia, atëherë kryerësi do të përgjigjet për veprën penale të vrasjes nga pakujdesia, nga neni 175 i KPRK.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me burgim prej së paku pesë vjet.

Meqë për vepër penale të vrasjes, nga neni 172 të KPRK, është parashikuar dënimi me burgim prej së paku pesë vjet, atëherë duke u bazuar në nenin 28 paragrafi 2 të KPRK, tentativa për kryerjen e kësaj vepre penale ndëshkohet.

Shembuj të veprës penale të vrasjes të mbetur në tentativë

Në një çështje penale, gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin A.T., për vepër penale të vrasjes të mbetur në tentativë, sepse i akuzuari A.T., për shkak të marrëdhënieve të pazgjidhura fqinjësore lidhur me rrethojnë e oborreve të të akuzuarit dhe të dëmtuarit R.C., pas një zënke të shkurtër në mes tyre, i akuzuari A.T. ka shtënë 3 herë nga pushka automatike në drejtim të të dëmtuarit R.C., mirëpo nuk ka mundur që ta qëllojë pasi që i dëmtuari është fshehur pas shtyllës së betonit të shtëpisë së tij.

Ligjet penale të shteteve të regjionit parashikojnë disa forma të posaçme të vrasjeve, të cilat nuk parashihen me KPRK, kështu p.sh. vrasja me paramendim,²⁶⁵ vrasja nga gjakmarrja,²⁶⁶ vrasja e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme,²⁶⁷ vrasja nga motivet fisnike,²⁶⁸ vrasja me kërkesën e viktimës,²⁶⁹ vrasja nga mëshira,²⁷⁰ vrasja e personit me mangësi fizike, psikike apo të sëmurë rëndë,²⁷¹ etj.

2. Vrasja e rëndë (neni 173)

Vrasja e rëndë në teorinë e së drejtës penale ndryshe emërtohen edhe si “vrasje e kualifikuar apo e cilësuar”. Vrasjet e rënda janë vetëm ato raste të vrasjeve të cilat legjislacioni penal i ka parashikuar si të tilla. Këto vrasje konsiderohen të rënda, për arsye se kryhen në rrethana posaçërisht të rënda dhe shkaktojnë pasoja shumë të rënda.

Të gjitha vrasjet e rënda mund të kryhen vetëm me dashje. Përveç dashjes, për ekzistimin e disa vrasjeve të rënda, duhet që të ekzistojë edhe qëllimi apo motivi i caktuar i kryerësit, p.sh.

²⁶⁵ Neni 78 parag.1 i KPRSH.

²⁶⁶ Neni 78 parag.2 i KPRSH.

²⁶⁷ Neni 83 i KPRSH.

²⁶⁸ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë.

²⁶⁹ Ligji Penal i Republikës së Kroacisë.

²⁷⁰ Kodi Penal i Republikës së Serbisë.

²⁷¹ Neni 79 i KPRSH.

vrasja e rëndë me qëllim të fitimit të dobisë pasurore, vrasja e rëndë me qëllim të kryerjes apo të fshehjes së ndonjë vepre tjetër penale, vrasja e rëndë nga motivet racore, nacionale apo fetare, etj.

Kryerës i vrasjeve të rënda (subjekt aktiv) mund të jetë çdo person, kurse viktimë e disa vrasjeve të rënda (subjekt pasiv) mund të jenë vetëm personat që posedojnë cilësi të caktuara, p.sh. fëmija, gruaja shtatzënë, etj.

Për këtë veprë penale është parashikuar dënimi me burgim prej së paku dhjetë vjet burgim apo me burgim të përjetshëm.

Në nenin 173 të KPRK janë parashikuar këto vrasje të rënda :

1. privon nga jeta fëmijën;
2. privon nga jeta femrën shtatzënë;
3. privon nga jeta anëtarin e familjes;
4. privon nga jeta personin tjetër në mënyrë mizore apo dinake;
5. privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose më shumë personave tjerë;
6. privon nga jeta personin tjetër me qëllim të fitimit të dobisë pasurore;
7. privon nga jeta personin tjetër me qëllim të kryerjes apo të fshehjes së ndonjë vepre tjetër penale, ose për të ndaluar personin nga dhënia e dëshmisë ose sigurimi në ndonjë mënyrë tjetër të informatave për policinë apo në procedurë penale;
8. privon nga jeta personin tjetër nga hakmarrja e paskrupullt apo nga motive të tjera të ulëta, përfshirë hakmarrjen për dhënien e dëshmisë ose sigurimin në ndonjë mënyrë tjetër të informatave për policinë apo në procedurë penale;
9. privon nga jeta personin tjetër zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose në lidhje me detyrën zyrtare;
10. privon nga jeta personin tjetër motivuar në bazë të kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njërin nga këto karakteristika të mbrojtura;
11. me dashje kryen dy apo më shumë vrasje, përveç veprave të cilat janë paraparë në nenin 174 dhe 176 të këtij Kodi dhe
12. privon nga jeta personin tjetër dhe më parë ka qenë i dënuar për vrasje, përveç veprave të cilat janë të parapara në nenin 174 dhe 176 të këtij Kodi; ose

Nuk përjashtohet mundësia që privimi i një personi nga jeta të përmbajë elementet e dy ose më shumë vrasjeve të rënda. P.sh. nëse kryerësi e privon nga jeta në mënyrë mizore gruan të cilën e di se është shtatzënë, ose nëse kryerësi e privon nga jeta personin zyrtar gjatë ushtrimit të detyrave të lartcekura, duke vënë me atë rast me dashje në rrezik jetën e një ose më shumë personave tjerë, etj.

Vrasjet e rënda, janë të parapara në mënyrë taksative me nenin 173 të KPRK dhe mund të sistemohen sipas këtyre kritereve :

- a) Sipas mënyrës së kryerjes së vrasjes : vrasja në mënyrë mizore apo dinake; vrasja e personit tjetër duke vënë me atë rast me dashje në rrezik jetën e një ose më shumë personave dhe vrasja e personit në mënyrë mizore apo dinake,
- b) Sipas objektit mbrojtës : vrasja e fëmijës; vrasja e femrës shtatzënë, vrasja e anëtarit të familjes dhe vrasja e personit tjetër zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose në lidhje me detyrën zyrtare,
- c) Sipas motiveve : vrasja nga motivet racore, nacionale apo fetare; vrasja me qëllim të fitimit të dobisë pasurore; vrasja me qëllim të kryerjes apo të fshehjes së ndonjë veprë tjetër penale dhe vrasja për hakmarrje të paskrupullt apo nga motive të tjera të ulëta,
- d) Sipas pasojave : vrasja me dashje e dy apo më shumë personave, përveç veprave penale të cilat janë parashikuar në nenet 174 dhe 176 të KPRK dhe
- e) Sipas sjelljes së mëparshme të kryerësit : vrasja e personit nga kryerësi i cili edhe më parë ka qenë i dënuar për vrasje, përveç veprave penale të cilat janë të parashikuara në nenet 174 dhe 176 të KPRK.

Përkundër sistemimit të lartcekur të vrasjeve të rënda, i cili mund të jetë edhe i arsyeshëm, në vazhdim vrasjet e rënda janë trajtuar sipas rendradhitjes së përcaktuar me nenin 173 të KPRK.

2.1. Vrasja e fëmijës

Sipas nenit 113, paragrafi 22 të KPRK, shprehja “fëmijë” do të thotë personi i cili nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë vjet. Gjithashtu, edhe sipas nenit 1 të Konventës së të Drejtave të Fëmijës,²⁷² me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë vjeçare.

Fëmijët gëzojnë mbrojtje të posaçme me dispozitat ligjore të KPRK, ngase në shumë dispozita ligjore janë parashikuar si forma të rënda apo të cilësuar të veprave penale, rastet kur këto

²⁷² Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës është miratuar në Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, me datën 20.11.1989. Duke u bazuar në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kjo Konventë zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kosovë, sa i përket të drejtave dhe lirive të njeriut që janë të garantuara me të.

vepra penale janë kryer ndaj fëmijëve. Në këtë mënyrë, në nenin 173 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPRK, është parashikuar si vrasje e rëndë, privimi nga jeta i fëmijës. Prandaj, në rastet kur ndonjë person e privon nga jeta fëmijën apo personin që nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeçare, sipas KPRK, konsiderohet se ka kryer vepër penale të vrasjes së rëndë. Duke u mbështetur në këtë koncept, vrasja e fëmijës, në aspektin moral dhe social, është më e rëndë se vrasja e personit madhor.

Për t'u konsideruar penalisht përgjegjës për këtë formë të rëndë të vrasjes së rëndë, kryerësi në momentin e kryerjes duhet të jetë i vetëdijshëm se objekt i sulmit është fëmija. Nëse kryerësi është në lajthim lidhur me moshën, përkatësisht nëse kryerësi gabimisht mendon se është duke e privuar nga jeta personin madhor, atëherë në këto raste ai do të përgjigjet për veprën penale të vrasjes së rëndomtë, kuptohet nëse nuk është shprehur ndonjë element tjetër cilësues.

Nga kjo që u tha më lart shihet se për ekzistimin e kësaj forme të vrasjes së rëndë, janë të nevojshme dy elemente :

- 1) Elementi i natyrës objektive, që konsiston në privimin nga jeta të fëmijës dhe
- 2) Elementi i natyrës subjektive, që konsiston në vetëdijen dhe dëshirën e kryerësit që ta privojë nga jeta fëmijën.

2.2. Vrasja nga jeta e femrës shtatzënë

Rrethana që një femër është shtatzënë në shumë fusha të së drejtës gëzon një trajtim dhe mbrojtje të posaçme. Një mbrojtje e tillë e posaçme është e parashikuar edhe në të drejtën penale. Rrjedhimisht, në rastet kur ndokush, e privon nga jeta femrën shtatzënë, sipas KPRK, konsiderohet se ka kryer vrasje të rëndë, ngase me vrasje të këtillë kryerësi nuk e vret vetëm gruan shtatzënë, por e vret edhe fëmijën në barkun e nënës.

Në nenin 173 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. të KPRK, është parashikuar si vrasje e rëndë, vrasja e femrës për të cilën kryerësi e di se është shtatzënë.

Për t'u konsideruar se është kryer kjo vepër penale e vrasjes së rëndë, kryerësi duhet të jetë i vetëdijshëm, duhet të dijë se femra është shtatzënë dhe përkundër kësaj, e privon nga jeta.

Andaj, për ekzistimin e kësaj forme të vrasjes së rëndë, janë të nevojshme dy elemente :

- 1) Elementi i natyrës objektive, që konsiston në privimin nga jeta të femrës shtatzënë dhe
- 2) Elementi i natyrës subjektive, që konsiston në vetëdijen dhe dëshirën e kryerësit që ta privojë nga jeta femrën shtatzënë.

Nëse kryerësi është në lajthim lidhur me faktin nëse femra të cilën e privon nga jeta është shtatzënë, përkatësisht nëse kryerësi gabimisht mendon se është duke e privuar nga jeta një femër e cila nuk është shtatzënë, atëherë në këto raste ai do të përgjigjet për ndonjë vepër tjetër

penale (vrasje e rëndomtë, vrasje e rëndë, etj.), varësisht nga mënyra e kryerjes, forma e fajit, motivi dhe rrethanat tjera.

2.3. Vrasja e anëtarit të familjes

Anëtar i familjes, sipas nenit 113 paragrafi 26 të KPRK, konsiderohen prindi, prindi adoptues, fëmija, fëmija i adoptuar, vëllai ose motra, bashkëshorti ose bashkëshortja, i afërmi i gjakut që jeton në të njëjtën shtëpi ose personi me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore. Sipas nenit 173 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të KPRK, privimi nga jeta i anëtarit të familjes konsiderohet vrasje e rëndë.

2.4. Vrasja në mënyrë mizore apo dinake

Kjo vepër penale e parashikuar në nenin 173 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. të KPRK ka dy forma :

- 1) Vrasja në mënyrë mizore dhe
- 2) Vrasja në mënyrë dinake.

1) Në teorinë e së drejtës penale vrasja në mënyrë mizore ndryshe quhet edhe si “**vrasje në mënyrë barbare**”. Vrasja në mënyrë mizore ekziston atëherë kur kryerësi ndërmerr me qëllim aso veprimesh të cilat i shkaktojnë dhembje të mëdha fizike dhe psikike viktimës. Dhembjet fizike dhe psikike duhet t’i tejkalojnë dhembjet dhe mundimet që zakonisht shkaktohen me rastin e çdo vrasje. Kjo posaçërisht shprehet me rastin e privimit gradual nga jeta, masakrimin e viktimës, zgjatjen e mundimeve vdekjeprurëse, prerjen e gjymtyrëve të trupit para se të shkaktohet vdekja e viktimës, duke mos i dhënë ushqim apo ujë, goditja me thikë e viktimës në pjesë të ndryshme të trupit, para se t’ia japë goditjen vdekjeprurëse dhe të ngjashme. Nga kjo del se, për ekzistimin e këtij lloji të vrasjes së rëndë, janë të nevojshme dy elemente, njëri i natyrës objektive dhe tjetri i natyrës subjektive.

Elementi objektiv qëndron në shkaktimin e mundimeve dhe dhembjeve të mëdha të viktimës, kurse elementi subjektiv në vetëdijen dhe dëshirën, përkatësisht pajtimin e kryerësit që të shkaktohen mundimet dhe dhembjet e tilla të mëdha fizike dhe psikike.

2) Vrasja në mënyrë dinake dallohet për nga tiparet objektive dhe subjektive. Nga aspekti objektiv, te ky lloj i vrasjes së rëndë kryerësi vepron në mënyrë të fshehtë, kurse në aspektin subjektiv, në mënyrë dinake, përkatësisht mashtruese, të pasinqertë dhe me qëllim të keq, duke keqpërdorur besimin e posaçëm të viktimës, vështirësitë dhe padjallëzinë e saj. Edhe këtu tiparet objektive dhe subjektive i tejkalojnë suazat e fshehtësisë dhe të dinakërisë, të cilat rëndom shprehen te vrasjet me dashje. Si vrasje në mënyrë dinake, konsiderohen vrasjet në gjumë, vrasjet me anë të helmit, vrasja prapa shpinës në mënyrë të fshehtë, etj.

Mirëpo, ka mundësi që privimi i një personi nga jeta t’i përmbajë në vete elementet e vrasjes në mënyrë mizore dhe të vrasjes në mënyrë dinake.

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin N.F., për shkak të veprës penale vrasja e rëndë, sepse i akuzuari me dashje e ka privuar nga jeta në mënyrë mizore dhe dinake të ndjerën L.N., në atë mënyrë që derisa e ndjera ishte duke ecur rrugës, i akuzuari i është afruar të njejtës në një distancë prej 2-3 metrash prapa shpinës së viktimës dhe pa paralajmërim me pushkën e tij automatike ka shtënë rafal disa herë duke e qëlluar në pjesën e pasme të shpinës, nga të cilat viktima është rrëzuar me fytyrë në tokë dhe i pakënaqur me këtë, parapë ka shtënë 7-8 herë në trupin e të ndjerës.²⁷³

2.5. Vrasja e personit tjetër dhe me atë rast me dashje vihet në rrezik jeta e një ose më shumë personave tjerë

Sipas nenit 173 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5. të KPRK, kjo formë e vrasjes së rëndë ekziston kur kryerësi e privon nga jeta personin tjetër tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose më shumë personave tjerë.

Konsiderohet se kryhet kjo vrasje e rëndë kur kryerësi për të kryer veprën penale të vrasjes, përdor aso mjetesh ose vepron në aso rrethana në të cilat vë në rrezik jetën edhe të ndonjë personi tjetër, përveç atij ndaj të cilit është i drejtuar veprimi i kryerjes. Për një veprim të këtillë është e nevojshme të ekzistojë mundësia e rrezikshmërisë konkrete. Fajësia për këtë mund t'i ngarkohet kryerësit, nëse ka qenë i vetëdijshëm për rrezikshmërinë e përmendur dhe e ka dëshiruar atë apo nëse ka qenë i vetëdijshëm për mundësinë e shkakimit të saj dhe është pajtuar me këtë gjë, pra kjo vepër mund të kryhet me dashje direkte ose me dashje eventuale. Kjo vepër rëndom kryhet kur kryerësi përdor aso mjetesh, veprimin e të cilave nuk mund ta kontrollojë, p.sh. eksplozivin, zjarrin, armët automatike, që i përdor në tërësi ose kur shtie në drejtim të viktimës, e cila gjendet në shoqëri me persona të tjerë, në rrugë ku ka kalimtarë, në treg, në stacionin e autobusit, në ndonjë lokal me njëerëz, etj.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin S.S., për shkak të kësaj vepre penale, sepse i akuzuari për shkak të një konflikti të mëhershëm dhe marrëdhënieve jo të mira, me dashje e ka privuar nga jeta të dëmtuarin A.A. dhe e ka sjellur në rrezik jetën e të dëmtuarin B.B., në atë mënyrë që derisa i ndjeri A.A. ishte duke e drejtuar traktorin e tij, në kabinën e të cilit ndodhej edhe i dëmtuari B.B., pasi që i afrohen të akuzuarit S.S., i cili ishte duke i pritur në rrugë, i akuzuari nga brezi nxjerr revolen e tij të markës "TT" dhe shkrep tri herë në drejtim të të ndjerit A.A. të cilit i shkakton vdekjen e menjëhershme dhe me atë rast e vë në rrezik me dashje edhe jetën e të dëmtuarit B.B.²⁷⁴

2.6. Vrasja e personit me qëllim të fitimit të dobisë pasurore

Vrasja e personit me qëllim të fitimit të dobisë pasurore, në teorinë e së drejtës penale emërtohet edhe si **“vrasje për interes”**.

²⁷³ Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, P.nr.113/2007, i datës 26.09.2007.

²⁷⁴ Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, P.nr.99/2007, i datës 23.01.2008.

Vrasja e personit me qëllim të fitimit të dobisë pasurore konsiderohet rasti kur privimi nga jeta i personit tjetër kryhet me qëllim që vetes apo tjetrit t'i sjellë dobi pasurore apo materiale. Dobia pasurore apo materiale mund të qëndrojë si në pretendimin për rritjen e pasurisë, ashtu edhe në pengimin e zvogëlimit të pasurisë.

Për ekzistimin e kësaj vepre penale, nuk është e domosdoshme që dobia pasurore edhe të realizohet dhe as që kërkohet që dobia të jetë e kundërligjshme. Së këndejmi, edhe ai që vret borxhliun e vet me qëllim që t'ia marrë të hollat dhe kështu ta arkëtojë borxhin e vet, konsiderohet se kryen këtë lloj të vrasjes së rëndë.

Dallimi ndërmjet kësaj vrasjeje dhe grabitjes, si dhe vjedhjes grabitqare nga të cilat kanë rezultuar me vdekjen e ndonjë personi, qëndron në faktin se te vrasja për interes, dashja e kryerësit është e drejtuar në vrasjen e ndonjë personi, kurse interesi është vetëm motiv për privimin nga jeta, ndërsa te grabitja dhe vjedhja grabitqare, dashja e kryerësit është e drejtuar në marrjen e sendit të huaj të luajtshëm, kështu që vrasja është vetëm mjet për realizimin e këtij qëllimi. Përveç kësaj, nga ana objektive te grabitja dhe vjedhja grabitqare, kalimi i pasurisë bëhet aty për aty nga viktima te kryerësi i veprës penale, kurse te vrasja e personit me qëllim të fitimit të dobisë pasurore, nuk do të thotë që çdo herë kalimi i pasurisë bëhet aty për aty, nga viktima te kryerësi i veprës penale, por kjo mund të bëhet edhe më vonë, p.sh. trashëgimia.²⁷⁵ Kështu, vrasja e personit me qëllim të fitimit të dobisë pasurore do të ekzistonte nëse kryerësi e privon nga jeta personin tjetër me qëllim që t'ia trashëgoj pasurinë. Gjithashtu, si vrasje e personit me qëllim të fitimit të dobisë pasurore, konsiderohet vrasja e kreditorit me qëllim që mos t'i paguhet borxhi ose **“vrasja e paguar”**, e cila do të ekzistonte nëse p.sh. personi A e paguan personin B, që personi B ta privojë nga jeta personin C.

2.7. Vrasja e personit tjetër me qëllim të kryerjes apo të fshehjes së ndonjë vepre tjetër penale, ose për të ndaluar personin nga dhënia e dëshmisë ose sigurimi në ndonjë mënyrë tjetër të informatave për policinë apo në procedurë penale

Kjo vepër penale ka tre forma :

- 1) Vrasja me qëllim të kryerjes së ndonjë vepre penale,
- 2) Vrasja me qëllim të fshehjes së ndonjë vepre tjetër penale dhe
- 3) Vrasja për të ndaluar personin nga dhënia e dëshmisë ose sigurimi në ndonjë mënyrë tjetër të informatave për policinë apo në procedurë penale.

1) Formën e parë të kësaj vepre penale e kryen kryerësi i cili e privon nga jeta personin tjetër, me qëllim që të bëjë të mundur ose të lehtësojë kryerjen e një vepre tjetër penale. Këtu vrasja i paraprinë kryerjes së ndonjë vepre tjetër penale. Vepra tjetër penale nuk është e domosdoshme të kryhet, është e qenësishme se vrasja është kryer për atë qëllim. Me këtë lloj të vrasjes kemi

²⁷⁵ ELEZI, ISMET: Mbrojtja juridike penale e pasurisë, Tiranë, 2002, f. 90.

të bëjmë atëherë kur ajo është kryer me qëllim të përfundimit të veprës tjetër të filluar. Nëse vepra tjetër penale edhe është kryer, atëherë kemi bashkimin e veprave penale.

2) Forma e dytë e kësaj vepre penale konsiderohet se kryhet, atëherë kur kryerësi e privon tjetrin nga jeta me qëllim që të pengojë zbulimin e veprës penale, të cilën e ka kryer më parë ose të cilën është duke e kryer. Raste të tilla janë p.sh. vrasja e dëshmitarit; ose nëse personi A kryen vepër penale të dhunimit ndaj personit B dhe i frikësuar se personi B do ta lajmëronte në polici, e privon nga jeta personin B, etj.

3) Forma e tretë e kësaj vepra penale konsiderohet se kryhet, atëherë kur kryerësi e privon nga jeta personin tjetër për të ndaluar nga dhënia e dëshmisë ose sigurimi në ndonjë mënyrë tjetër të informatave për policinë apo në procedurë penale.

Në të trija këto forma të kësaj vepre penale është me rëndësi motivi përkatësisht, që personi tjetër të privohet nga jeta me qëllim që të kryhet apo të fshihet vepra tjetër penale apo për të ndaluar personin që të jep dëshmi apo të siguroj në ndonjë mënyrë tjetër informata për policinë apo në procedurë penale. Vepra tjetër duhet të jetë vepër penale dhe jo ndonjë vepër tjetër e kundërligjshme, p.sh. kundërvajtje apo delikt ekonomik.

2.8. Vrasja për hakmarrje të paskrupullt apo nga motive të tjera të ulëta përfshirë hakmarrjen për dhënien e dëshmisë ose sigurimin në ndonjë mënyrë tjetër të informatave për policinë apo në procedurë penale

Çdo vrasje për hakmarrje nuk konsiderohet vrasje e rëndë sipas kësaj dispozite ligjore. Për të ekzistuar kjo vrasje e rëndë, duhet që hakmarrja të jetë e paskrupullt. Në teorinë e së drejtës penale si vrasje për hakmarrje të paskrupullt mund të konsiderohen këto raste²⁷⁶ :

- kur hakmarrja është e drejtuar ndaj anëtarit të pafajshëm të familjes,
- kur ajo haptas nuk është në përpjesëtim me të keqen e pësuar më parë,
- kur privohen nga jeta shumë persona,
- kur edhe vetë është kryer për hakmarrje (hakmarrja ndaj hakmarrjes),
- kur është kryer ndaj personit, i cili për veprën e mëparshme penale është dënuar ose liruar nga dënimi me aktgjykim të formës së prerë,
- kur me rastin e kryerjes së hakmarrjes cenohen disa rregulla ekzistuese pozitive të së drejtës zakonore,

²⁷⁶ SALIHU, ISMET, E drejta penale, Pjesa e posaçme, Prishtinë, 2014, f. 163-167.

- kur hakmarrja është kryer ndaj personit i cili në bazë të ligjit e ka kryer ndonjë veprim ose ka qenë i detyruar të veprojë ashtu (p.sh. vrasja për hakmarrje e policit, prokurorit apo gjyqtarit, i cili ka ndërmarrë ndonjë veprim në bazë të ligjit, etj.).

Ndërkaq, motive të ulëta, në kuptimin e kësaj forme të vrasjes së rëndë, konsiderohen ato motive që janë në kundërshtim të rreptë me rregullat ekzistuese socio-etike dhe për to kryerësi qortohet ashpër në aspektin moral.

Konstatimet e Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me motivin e ulët

Gjykata Supreme e Kosovës, në një çështje penale ka konstatuar se “motivi i ulët i kryerësit, në aspektin subjektiv, shpreh veprimet e një personi me karakter amoral, asocial dhe me tipare të tjera që flasin për prirje negative, jo njerëzore, të cilat nuk janë të denja për njeriun”.²⁷⁷

Këto janë motive veçanërisht të ulëta apo ekstreme. E tillë mund të konsiderohet vrasja e bashkëshortit apo bashkëshortes me qëllim të mënjanimin të pengesës për të vazhduar dashurinë me një person tjetër. Vrasje për motive të ulëta mund të konsiderohet edhe vrasja me qëllim të realizimit të ndonjë përfitimi që nuk është i natyrës materiale, por mund të sjellë fitime të tilla.

Shembuj të vrasjes nga motivet e ulëta

- vrasja me qëllim të mënjanimin të konkurentit në punë ose në ndonjë garë sportive;
- nëse personi A e privon nga jeta personin B, me qëllim që me gruan e personit B në të ardhmen të ketë marrëdhënie seksuale, etj.

Gjithashtu, kjo formë e vrasjes së rëndë përfshinë edhe privimin e personit nga jeta nga hakmarrja e paskrupullt apo nga motive të tjera të ulëta, përfshirë hakmarrjen për dhënien e dëshmisë ose sigurimin në ndonjë mënyrë tjetër të informatave për policinë apo në procedurë penale.

2.9. Vrasja e personit zyrtar gjatë kohës së ushtrimit të detyrës zyrtare ose në lidhje me detyrën zyrtare

Sipas kësaj dispozite ligjore, konsiderohet vrasje e rëndë, privimi nga jeta i personit tjetër zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose në lidhje me detyrën zyrtare. Në nenin 113 paragrafi 2 të KPRK, është parashikuar se person zyrtar nënkupton :

1. personi i cili në organin shtetëror kryen punët zyrtare;
2. personi i zgjedhur, i emëruar ose i caktuar në organin shtetëror, në organin e pushtetit lokal ose personi që përherë ose përkohësisht kryen detyrat zyrtare ose funksionet zyrtare në ato organe;

²⁷⁷ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, AP.nr.120/2000, i datës 19.10.2000.

3. personi në institucion, ndërmarrje ose në ndonjë subjekt tjetër, të cilit i janë besuar kryerja e autorizimeve publike, që vendos për të drejtat, obligimet ose interesat e personave fizik apo juridik ose për interesin publik;

4. person zyrtar konsiderohet edhe personi të cilit i është besuar kryerja faktike e detyrave të caktuara zyrtare apo punëve dhe

5. person ushtarak përpos kur janë në pyetje dispozitat e Kreut XXXIII (Veprat penale kundër detyrave zyrtare) të këtij Kodi.

Është me rëndësi të theksohet se për t'u konsiderohet se është kryer kjo formë e vrasjes së rëndë, duhet që vrasja e personit zyrtar të bëhet gjatë kohës së ushtrimit të detyrës zyrtare ose në lidhje me detyrën zyrtare

2.10. Vrasja e personit tjetër e motivuar në bazë të kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njërën nga këto karakteristika të mbrojtura

Me të drejtën penale jeta e njerëzve mbrohet në mënyrë të njejtë, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre nacionale, fetare, racore, etj. Mirëpo, nëse ndonjë person e privon nga jeta personin tjetër i motivuar në bazë të kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njërën nga këto karakteristika të mbrojtura, motivi i këtillë manifeston një shkallë më të lartë të rrezikshmërisë. Për këtë arsye, edhe KPRK vrasjen nga motivet e lartcekura e konsideron si vrasje të rëndë.

2.11 Vrasja me dashje e dy ose më shumë personave

Kjo vepër penale e vrasjes së rëndë²⁷⁸ kryhet, nëse kryerësi ka privuar me dashje nga jeta dy ose më shumë persona, përveç veprave të cilët janë të parapara në nenin 174 dhe 176 të KPRK (vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore dhe vrasja e foshnjës gjatë lindjes). Sipas kësaj dispozite ligjore, kjo vrasje e rëndë konsiderohet se kryhet nëse kryerësi i kryen dy ose më shumë vrasje në bashkim ideal ose real, por me kusht që procedura penale të jetë e njejtë dhe kryerësit t'i shqiptohet një dënim unik.

Vrasjet duhet të jenë të kryera me dashje, qoftë me dashje direkte apo eventuale. Së këndejmi, vrasjet nga pakujdesia nuk mund të cilësohen sipas kësaj dispozite ligjore. Në teorinë e së drejtës penale, nuk konsiderohet si vrasje e këtillë as vrasja e kryer në tejkalimin e kufijve të mbrojtjes së nevojshme ose të nevojës ekstreme.

²⁷⁸ Kjo vrasje e rëndë në literaturën e huaj njihet si “vrasje serike”, kurse kryerësit e tyre si “vrasës serik”.

Në këtë lloj vrasjesh bëjnë pjesë jo vetëm vrasja e rëndomtë, por edhe vrasja e rëndë.

2.12. Vrasja e personit nga kryerësi i cili edhe më parë ka qenë i dënuar për vrasje

Edhe te kjo vrasje e rëndë, kryerësi i kryen dy ose më shumë vrasje. Kjo vrasje e rëndë ekziston nëse kryerësi e privon nga jeta personin dhe kryerësi më parë ka qenë i dënuar për vepër penale të vrasjes, përveç veprave penale të cilat janë të parapara në nenin 148 dhe 150 të këtij KPRK (vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore dhe vrasja e foshnjës gjatë lindjes).

3. Vrasjet e “privileguara”

Për shkak të rrethanave veçanërisht lehtësuese në të cilat kryhen disa vrasje, në të drejtat penale bashkëkohore konsiderohen si të privileguara, përkatësisht forma të lehta të vrasjeve.

Sipas KPRK, vrasje të privileguara konsiderohen :

- 1) vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore (neni 174),
- 2) vrasja nga pakujdesia (neni 175) dhe
- 3) vrasja e foshnjës gjatë lindjes (neni 176).

Në disa legjislacione penale të shteteve të regjionit, si vrasje e privileguar konsiderohet edhe vrasja e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme dhe vrasja me kërkesën e viktimës.

3.1. Vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore (neni 174)

Vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore²⁷⁹, sipas nenit 174 të KPRK, konsiderohet se kryhet nëse kryerësi e privon nga jeta personin tjetër në gjendje të tronditjes së fortë mendore, të shkaktuar pa fajin e tij nga sulmi, keqtrajtimi apo fyerja e rëndë nga ana e personit të vrarë, .

Për ekzistimin e kësaj vrasje, është e nevojshme të përmbushen këto tri kushte :

- 1) që vrasja të jetë kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore;
- 2) që kryerësi i veprës penale, pa fajin e tij, të ketë rënë në gjendje të këthillë, për shkak të sulmit, keqtrajtimit ose fyerjes së rëndë nga ana e personit të vrarë dhe
- 3) që vrasja të jetë kryer në afekt.

²⁷⁹ Kjo formë e vrasjeve të privileguara në literaturën juridike penale ndryshe quhet edhe si “vrasje e provokuar”, “vrasje në afekt”, “vrasje e çastit”, etj. Në nenin 82 të KPRSH, kjo vrasje emërtohet si “Vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike” dhe e cila konsiston në vrasjen me dashje të kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike të çastit të shkaktuar nga dhuna ose fyerja e rëndë e viktimës.

1) Tronditje e fortë mendore, konsiderohet atëherë kur shkaktohet një gjendje e jashtëzakonshme psikike, me ç' rast kryerësi, pa gjykuar në mënyrë kritike, vendos në çast (aty për aty) të kryejë vrasjen. Këto janë pikërisht gjendje afektive të një shkalle të lartë.

Konstatimet e Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me tronditjen e fortë mendore

Gjykata Supreme e Kosovës në një çështje penale ka konstatuar se “tronditja e fortë mendore konsiderohet gjendja e jashtëzakonshme psikike, me ç' rast kryerësi pa gjykuar në mënyrë kritike kryen krimin, ngase me parë ka qenë i fyer apo i sulmuar nga viktima. Tronditja në kuptim të kësaj dispozite është ajo që prek thellë ndjenjën e dinjitetit të personit, sulmi dhe fyerja duhet të jenë, sipas mënyrës dhe intesitetit të tilla që mund të sjellin të akuzuarin në gjendje të tronditjes së fortë, pra jo çdo fjalosje, fyerje apo sulm”.²⁸⁰

Mirëpo, nëse gjendja afektive e këtyllë e sjell kryerësin në gjendje të plotë të papërgjegjësisë ose në gjendje të përgjegjësisë esencialisht të zvogëluar, atëherë do të zbatohet neni 18, paragrafët 1 apo 2 të KPRK.

2) Kusht tjetër për ekzistimin e kësaj vepre penale është që kryerësi duhet të vihet në gjendje të tronditjes së fortë psikike ose mendore, pa fajin e tij, për shkak të sulmit, keqtrajtimit ose fyerjes së rëndë nga ana e të vrarit. Kryerësi pa fajin e tij, është sjellë në gjendje të tronditjes së fortë psikike ose mendore atëherë kur nuk e ka provokuar sulmin ose fyerjen e rëndë. Ndërmjet sulmit, përkatësisht keqtrajtimit ose fyerjes së rëndë dhe tronditjes së fortë psikike, patjetër duhet të ekzistojë lidhja kauzale. Sulmi, keqtrajtimi ose fyerja e rëndë nuk është e domosdoshme të jenë të drejtuara drejtpërdrejt kundër kryerësit të vrasjes, por ato mund të jenë të drejtuara edhe kundër të afërmeve të tij, si p.sh. prindërve, vëllezërve, fëmijëve, bashkëshortit, etj.

Sulmi, keqtrajtimi ose fyerja duhet të jenë të rënda,²⁸¹ në mënyrë që kryerësin ta sjellin në gjendje të tronditjes së fortë mendore.

Në teorinë e së drejtës penale dhe në praktikën gjyqësore mbizotëron mendimi se sulmi, në kuptimin e kësaj dispozite ligjore, duhet të jetë i drejtuar vetëm ndaj personave, e jo edhe ndaj pasurisë.

Sulmi, keqtrajtimi apo fyerja e rëndë duhet të jenë shkaktuar vetëm nga personi i vrarë, e jo edhe nga personat tjerë.

3) Vrasja konsiderohet se është kryer në gjendje të afektit mendor, nëse ajo ka ndodhur menjëherë pas sulmit, keqtrajtimit, përkatësisht pas fyerjes dhe nën ndikimin e afektit. Mirëpo, nuk është e domosdoshme që çdo herë ajo të jetë kryer menjëherë pas sulmit ose fyerjes. Me

²⁸⁰ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, AP.nr.1/2005, i datës 26.04.2005.

²⁸¹ Sipas profesorit Ismet Elezi, fyerje konsiderohet edhe situata kur kryerësi e takon bashkëshorten e tij duke kryer marrëdhënie seksuale me një person tjetër. ELEZI, ISMET, E drejta penale, Pjesa e posaçme, Tiranë, 2002, f. 56.

rëndësi është që ndërmjet tronditjes dhe vrasjes të ekzistojë vazhdimësia kohore, të ekzistojë uniteti i rrjedhës së zhvillimit të gjendjes afektive të një intensiteti të caktuar.

Pasojë e kësaj vepre penale është privimi i një personi tjetër nga jeta.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person dhe për këtë veprë penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

3.2. Vrasja nga pakujdesia (neni 175)

Vrasja nga pakujdesia ekziston në rastet kur ndonjë person është privuar nga jeta për shkak të pakujdesisë së kryerësit të veprës penale. Kjo veprë penale, konsiderohet si formë e lehtë e vrasjeve apo si vrasje e privilegjuar vetëm për shkak të formës së fajit për të cilën kryhet. Dallimi ndërmjet kësaj vrasjeje dhe vrasjes së rëndomtë dhe të rëndë është i lidhur për fajin, sepse vrasjet e rëndomta dhe të rënda mund të kryhen vetëm me dashje.

Te vrasja nga pakujdesia, privimi i ndonjë personi nga jeta shfaqet në një mënyrë specifike, zakonisht në një mënyrë tjetër në krahasim me privimin me dashje nga jeta. Këtu, zakonisht është fjala për veprimet të cilat janë ndërmarrë me ndonjë qëllim tjetër dhe jo me qëllim të privimit të ndonjë personi nga jeta. Për shkak të veprimeve të kryerësit, vdekja e personit tjetër shkaktohet si pasojë sekondare, pasojë e cila nuk dëshirohet nga ana e kryerësit.

Pasojë e kësaj vepre penale është privimi i një personi tjetër nga jeta.

Dallimi ndërmjet vrasjes nga pakujdesia dhe lëndimit të rëndë trupor, për shkak të të cilit është shkaktuar vdekja (neni 186, paragrafi 5 i KPRK), qëndron në faktin se vepra e parë në tërësi është e kryer nga pakujdesia, kurse te vepra e dytë kryerësi vepron me dashje për të shkaktuar lëndimin e rëndë trupor, por vepron nga pakujdesia për të shkaktuar vdekjen. Në rastin kur lëndimi i rëndë trupor është kryer nga pakujdesia, për të cilën është shkaktuar vdekja, atëherë duhet të konsiderohet se është kryer vetëm vrasja nga pakujdesia, pasi që ligjdhënësi nuk parashikon lëndime të rënda trupore të kryera nga pakujdesia e të cilësuar me vdekje.

Kjo formë e vrasjes mund të kryhet nga pakujdesia e vetëdijshme ose nga pakujdesia e pavetëdijshme. Kryerësi vepron me pakujdesi të vetëdijshme kur është i vetëdijshëm se privimi i një personi tjetër nga jeta mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij, por me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet apo se ai do të mund ta parandalojë shkaktimin e saj (neni 23 paragrafi 2 i KPRK). Kurse, kryerësi vepron me pakujdesi të pavetëdijshme kur nuk është i vetëdijshëm se privimi i një personi tjetër nga jeta mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij edhe pse në rrethanat dhe sipas vetive të tij personale ka mund të ishte apo duhej të ishte i vetëdijshëm për këtë mundësi (neni 23 paragrafi 3 i KPRK).

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Për këtë veprë penale është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.²⁸² Në një çështje penale, gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin S.H., për shkak të veprës penale vrasja nga pakujdesia dhe i njeiti për këtë veprë penale është dënuar me dënim me burgim prej 1 (një) viti.²⁸³

3.3. Vrasja e foshnjës gjatë lindjes (neni 176)

Sipas nenit 176 të KPRK, veprën penale të vrasjes së foshnjës gjatë lindjes e kryen nëna e cila e privon nga jeta foshnjën e vet gjatë lindjes apo menjëherë pas lindjes, derisa te ajo vazhdon çrregullimi i shkaktuar nga lindja.

Nga kjo shihet se elementet e kësaj vepre penale janë :

- 1) Vrasja e foshnjës,
- 2) Kryerës i kësaj vepre penale është nëna,
- 3) Vrasja e foshnjës duhet të bëhet gjatë lindjes ose menjëherë pas lindjes dhe
- 4) Vazhdimi i çrregullimeve të shkaktuara nga lindja tek nëna.

Në këtë mënyrë, kjo formë e vrasjes së privilegjuar qëndron në privimin e fëmijës nga jeta nga ana e nënës së tij gjatë lindjes ose menjëherë pas lindjes, derisa te nëna zgjasin çrregullimet e shkaktuara nga lindja.

Konsiderohet vrasje e privilegjuar, ngase tek nëna (lehona) lindja zakonisht shkakton çrregullime fizike dhe psikike, që shoqërohen me dhembje, si pasojë e të cilave tek ajo shfaqet një gjendje kalimtare e aftësisë së përgjegjësisë së zvogëluar.

Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, për ekzistimin e veprës penale vrasja e foshnjës gjatë lindjes, çrregullimet e nënës duhet të shkaktohen nga lindja, jo edhe nga faktorët tjerë.

Konstatimet e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çrregullimet e lartcekura

Gjykata Supreme e Kosovës, në një çështje penale ka konstatuar se “Çrregullimi që ka ekzistuar tek e ëma, qoftë ky edhe menjëherë pas lindjes, por që nuk është shkaktuar madje as pjesërisht nga akti i lindjes, por ekskluzivisht nga ndonjë rrethanë tjetër, si maltretimi nga ana e personave të tjerë, fyerja, kërcënimi ose me ndonjë veprim tjetër psikik mbi lehonën, nuk mund të paraqesë bazë për cilësimin e veprës penale si vrasja e foshnjës gjatë lindjes, por vepra penale do të cilësohet si vrasje,...”²⁸⁴

Kjo veprë penale mund të kryhet me veprim ose me mosveprim. Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë të ndryshme, mirëpo më së shpeshti në praktikë është konstatuar se kjo veprë

²⁸² Vrasja e kryer nga pakujdesia sipas nenit 85 të KPRSH dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

²⁸³ Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr.146/2004, i datës 17.12.2004, i vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, AP.nr.103/2005, i datës 04.05.2005.

²⁸⁴ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, AP.nr.319/2001, i datës 21.02.2002.

penale është kryer duke mos i dhënë ushqim foshnjës, duke ia zënë frymën, duke e gjuajtur foshnjën në shporta të mbeturinave apo konteiner, duke e goditur me ndonjë send të fortë, etj.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë vetëm nëna, e cila e privon nga jeta foshnjën e vet. Nëse ndonjë person tjetër paraqitet si bashkëpunëtor dhe së bashku me nënën e foshnjës, e privojnë nga jeta këtë foshnje, atëherë personi tjetër do të përgjigjet për vepër penale të vrasjes së rëndë, nga neni 173 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPRK, kurse nëna e foshnjës do të përgjigjet për vepër penale të vrasjes së foshnjës gjatë lindjes, nga neni 150 i KPRK. Personi tjetër që paraqitet si bashkëpunëtor, mund të jetë edhe babai i foshnjes, por mund të jetë edhe ndonjë person tjetër i afërt i tyre.

Viktimë e kësaj vepre penale mund të jetë vetëm foshnja që ka lindur i gjallë. Viktimë e kësaj vepre penale mund të jetë si foshnja që ka lindur para kohës normale, ashtu edhe foshnja që ka lindur në kohë normale.

Pasojë e kësaj vepre penale është privimi i foshnjës nga jeta.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje. Konsiderohet se nëna e kryen këtë formë të vrasjes së privilegjuar edhe në rastet kur para se të lindë, vendos që me rastin e lindjes, ta privojë foshnjën nga jeta dhe nëse këtë edhe e kryen.

Vepra penale mund të kryhet gjatë kohës së lindjes ose menjëherë pas lindjes. Në shkencën e së drejtës penale thuhet se gjatë lindjes te nëna shkaktohen çrregullime të natyrave të ndryshme. Nëse vrasja e foshnjës kryhet pas lindjes, në teori dhe praktikë lindin dilema se brenda cilit afat mund të konsiderohet se zgjasin këto çrregullime.

Disa autorë mendojnë se ky çrregullim nuk mund të zgjasë më shumë se 24 orë. Mirëpo, mbizotëron mendimi se nuk mund të paracaktohet koha se sa do të zgjasë çrregullimi, që të mund të konsiderohet se është kryer ky lloj i vrasjes. Rekomandohet që ekzistimin e çrregullimit pas lindjes, ta konstatojë eksperti mjekësor.

Për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me burgim prej tre muaj deri në tri vjet.

4. Ndërprerja e palejuar e shtatzënisë (neni 178)

Neni 178 i KPRK, me të cilën është parashikuar vepra penale e ndërprerjes së palejuar të shtatzënisë është i karakterit blanket, sepse lidhur me tiparet e kësaj vepre penale i referohet dispozitave të Ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë.²⁸⁵ Andaj, vepra penale e ndërprerjes së palejuar të shtatzënisë përcaktohet duke u bazuar në dispozitat e këtij ligji. Një gjë e tillë është përcaktuar edhe në nenin 23 të LNSH, sipas të cilit në rastet e moszbatimit dhe shkeljeve të dispozitave të këtij ligji, krahas masave tjera, do të merren edhe masa konform nenit 152 të Kodit Penal të Kosovës (tani neni 178). Duke u bazuar në këto dispozita ligjore, çdo ndërprerje e shtatzënisë me pëlqimin e gruas shtatzënë, por në kundërshtim me dispozitat e LNSH,

²⁸⁵ Ligji Nr.03/L-110 Për Ndërprerjen e Shtatzënisë, i datës 06.11.2008 (në tekstin e mëtejshëm LNSH).

konsiderohet vepër penale. Për këtë arsye, në vazhdim i kemi paraqitur në pika të përgjithshme disa dispozita të LNSH, që janë me rëndësi për përcaktimin e veprës penale të ndërprerjes së palejuar të shtatzënësisë.

Sipas nenit 2 të LNSH, shprehja “Embrion” do të thotë organizëm i gjallë nga çasti i fekondimit deri në muajin e tretë të shtatzënësisë, kurse shprehja “Fetus” është fryti prej javës së dhjetë (10) të shtatzënësisë e deri në lindje. Sipas kësaj dispozite ligjore, “Ndërprerja elektive e shtatzënësisë” është ndërprerja e shtatzënësisë me qëllim dhe me dëshirën e femrës, pa arsye mjekësore, ndërsa “Ndërprerja e indukuar e shtatzënësisë” është ndërprerja e shtatzënësisë me qëllim deri në fund të javës së njëzetedytë (22) të shtatzënësisë apo peshën e frytit deri në pesëqind (500) g.

Në nenin 4 të LNSH, është parashikuar se çdo femër ka të drejtë të vendosë lirshëm mbi ndërprerjen e shtatzënësisë sipas kriterëve të përcaktuara me këtë ligj dhe femra e cila është e aftë sipas ligjit nuk i nënshtrohet ndërprerjes së shtatzënësisë pa pëlqimin e saj. Kurse, sipas nenit 5 të këtij ligji, çdo femër e moshës mbi tetëmbëdhjetë (18) vjeç ka të drejtë që të kërkojë ndërprerjen elektive të shtatzënësisë. Femrat që kanë arritur moshën e rritur prej gjashtëmbëdhjetë (16) vjetësh dhe kanë marrë pëlqimin e prindit ose të kujdestarit ligjor kanë të drejtë të kërkojnë ndërprerjen e shtatzënësisë. Ndërprerja elektive e shtatzënësisë mund të bëhet deri në fund të javës së dhjetë (10) të shtatzënësisë duke llogaritur nga dita e parë e ciklit të fundit menstrual (neni 6 i LNSH). Çdo ndërprerje e shtatzënësisë pas javës së dhjetë (10) është në kundërshtim me ligjin e shëndetësisë dhe duhet të bëhet me komision shëndetësor profesional (neni 7 i LNS).

Në nenin 9 të LNSH, është përcaktuar vendi ku mund të bëhet ndërprerja e shtatzënësisë dhe personat që janë të autorizuar që ta bëjnë një gjë të tillë. Kështu, sipas kësaj dispozite ligjore ndërprerja e shtatzënësisë bëhet vetëm në institucionet shëndetësore nga mjekët specialistë obstetër-gjinekologë të licencuar.²⁸⁶

Sipas nenit 12 të LNSH, ndërhyrja mjekësore për ndërprerjen e shtatzënësisë bëhet vetëm në kushte të sigurta mjekësore, që përcaktohen me akt nënligjor. Çdo institucion shëndetësor i cili ofron shërbimet e ndërprerjes së shtatzënësisë duhet të sigurojnë shërbim shëndetësor për trajtimin e ndërlikimeve të mundshme të ndërprerjes së shtatzënësisë, që përcaktohen me akt nënligjor.

Në nenin 14 të LNSH, është parashikuar se ndërprerja e shtatzënësisë me motiv të përzgjedhjes se gjinisë së frytit është e ndaluar.

Përveç këtyre, në nenin 15 dhe 16 të LNSH, janë caktuar edhe dy grupe të arsyeve për të cilat mund të bëhet ndërprerja e shtatzënësisë dhe atë :

²⁸⁶ Në nenin 94 të KPRSH, është parashikuar në mënyrë shprehimore si vepër penale e posaçme ndërprerja e shtatzënësisë në vende dhe nga persona të paautorizuar.

- 1) Arsyet mjekësore (neni 15) dhe
 - 2) Arsyet kriminologjike (neni 16).
- 1) **Ndërprerja e shtatzënisë për arsye mjekësore** mund të bëhet në çdo periudhë të shtatzënisë, me vendimin e Komisionit mjekësor dhe me pëlqimin e femrës shtatzënë përderisa ajo është e vetëdijshme, në rastet kur konstatohet se vazhdimi i shtatzënisë, ose lindja e fëmijës rrezikon jetën ose shëndetin e femrës. Gjithashtu, ndërprerja e shtatzënisë për arsye mjekësore mund të bëhet në çdo kohë pas rekomandimit dhe vendimit të Komisionit mjekësor për ndërprerjen e shtatzënisë dhe me pëlqimin e pacientes përderisa ajo është e vetëdijshme, kur vërtetohet se fetusi ka keq formime të papajtueshme me jetën, sëmundje ose gjendje të rënda që lënë invaliditet të rëndë dhe kanë trajtim të pasigurt.
 - 2) **Ndërprerja e shtatzënisë për arsye kriminologjike** mund të bëhet deri në javën e njëzetedytë (22) të shtatzënisë dhe të lindja e indukuar²⁸⁷ edhe më vonë me rekomandim mjekësor dhe pas konfirmimit nga institucionet kompetente të cilat janë të autorizuar të përcaktojnë nëse shtatzënia është pasojë prej njëres nga veprat penale në vijim :
 - 1.1. dhunimit;
 - 1.2. marrëdhënieve të padëshiruara të femrave të cilat janë viktime të trafikimit dhe shfrytëzimit seksual të detyruar;
 - 1.3. marrëdhënies seksuale me të mitur ose incestit.

Në nenin 178 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar forma themelore e veprës penale të ndërprerjes së palejuar të shtatzënisë, e cila konsiderohet se kryhet nëse ndonjë person në kundërshtim me dispozitat ligjore mbi ndërprerjen e shtatzënisë dhe me pëlqimin e gruas shtatzënë ndërpret shtatzëninë, fillon ta kryejë ndërprerjen e shtatzënisë ose i ndihmon që ta ndërprejë shtatzëninë. Siç shihet, kjo formë e kësaj vepre penale kryhet me pëlqimin e gruas shtatzënë.

Veprimet e kryerjes së formës themelore të kësaj vepre penale, të cilat janë të përcaktuara në mënyrë alternative, konsistojnë në :

- a) Fillimin e kryerjes së ndërprerjes së shtatzënisë,
- b) Ndërprerjen e shtatzënisë ose

²⁸⁷ Shprehja “Lindja e induktuar”, sipas nenit 2 të LNSH, nënkupton daljen apo nxjerrjen e frytit pas javës së njëzetedytë (22) të shtatzënisë nën ndikimin e barërave apo me ndërhyrje kirurgjike.

c) Ndhimën në ndërprerjen e shtatzënisë.

a) Fillimi i kryerjes së ndërprerjes së shtatzënisë është në fakt

tentativë e kësaj veprë penale dhe konsiderohet se është kryer edhe në rastet kur nuk është asgjësuar fryti, përkatësisht kur nuk është ndërprerë shtatzënia. Sipas kësaj dispozite ligjore, tentativa e ndërprerjes së shtatzënisë është njësuar me përfundimin e kësaj veprë penale. Mirëpo, fakti se vepra ka mbetur në tentativë, mund të merret parasysh me rastin e caktimit të dënimit.

b) Ndërprerja e shtatzënisë është asgjësimi i frytit të njeriut dhe nxjerrja e tij nga barku i nënës.

c) Ndhima në ndërprerjen e shtatzënisë nënkupton ndërmarrjen e veprimeve të caktuara me të cilat gruaja shtatzënë ndihmohet që të bëhet ndërprerjen e shtatzënisë. Në rastet kur vetë gruaja në trupin e saj e ndërpret shtatzëninë, atëherë veprimet e saj nuk përbëjnë veprë penale. Pra, në rastet kur p.sh. personi A i ndihmon gruas shtatzënë që në trupin e saj ta ndërpresë shtatzëninë, vetëm personi A, do të konsiderohet se e ka kryer këtë veprë penale, e jo edhe gruaja shtatzënë.

Formë e rëndë e veprës penale të ndërprerjes së palejuar të shtatzënisë është parashikuar në paragrafin 2 të nenit 178 të KPRK dhe konsiderohet se ekziston nëse ndonjë person e ndërprente ose fillon ta ndërprejë shtatzëninë pa pëlqimin e gruas shtatzënë. Për dallim nga forma themelore, forma e rëndë e kësaj veprë penale kryhet pa pëlqimin e gruas shtatzënë.

Në paragrafin 3 të këtij neni është parashikuar forma edhe më e rëndë e kësaj veprë penale, e cila konsiderohet se ekziston në rastet kur nga kryerja e veprës penale nga paragrafi 1 ose 2 të këtij neni, është shkaktuar lëndim i rëndë trupor, dëmtim i rëndë i shëndetit ose vdekja e gruas shtatzënë.

Kryerës i veprës penale të ndërprerjes së palejuar të shtatzënisë, si rregull mund të jetë çdo person, përveç gruas shtatzënë.

Kjo veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Për formën themelore të kësaj veprë penale nga paragrafi 1 është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë muaj deri në tri vjet, kurse për formën e rëndë nga paragrafi 2 është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në tetë vjet. Për formën edhe më të rëndë të kësaj veprë penale nga paragrafi 3, është parashikuar se kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet për veprën penale nga paragrafi 1 ose prej pesë deri në pesëmbëdhjetë burgim për veprën penale nga paragrafi 2.

5. VEPRAT E TJERA PENALE TË KËTIJ KAPITULLI

Në Kapitullin e veprave penale kundër jetës dhe trupit bëjnë pjesë edhe këto vepra penale :

- Shtytja në vetëvrasje dhe ndihma në vetëvrasje (neni 177),
- Sterizilimi i detyruar (neni 179),
- Gjymtimi i organeve gjenitale femërore (neni 180),
- Kanosja (neni 181),
- Ngacmimi (neni 182),
- Ngacmimi seksual (neni 183),
- Sulmi (neni 184),
- Lëndimi i lehtë trupor (neni 185),
- Lëndimi i rëndë trupor (neni 186),
- Pjesëmarrja në rrahje (neni 187),
- Mosdhënia e ndihmës (neni 188) dhe
- Braktisja e personave të paaftë (neni 189).

KAPITULLI V

VEPRAT PENALE KUNDËR LIRIVE DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT

I. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME

E drejta penale e siguron mbrojtjen e një numri të madh të vlerave themelore individuale dhe të përgjithshme. Në mesin e këtyre vlerave, mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut zënë vend të rëndësishëm në tërë korpusin e dispozitave të KPRK. Në pjesën e posaçme të KPRK, në një kapitull të posaçëm, janë parashikuar një numër i konsiderueshëm i veprave penale, me të cilat mbrohen liritë dhe të drejtat e njeriut.

Duhet të theksohet se mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut parashikohet edhe me kapitujtë e tjerë të KPRK, si p.sh., me Kapitullin e veprave penale kundër jetës dhe trupit, me Kapitullin e veprave penale kundër pasurisë, etj. Mirëpo, te këta kapituj primare është mbrojtja e disa vlerave tjera (pasuria, jeta dhe integriteti trupor, etj.), ndërsa liritë dhe të drejtat e njeriut mbrohen si vlera sekondare.

Liritë dhe të drejtat e njeriut, në të kaluarën kanë qenë objekt mbrojtje i shumë dokumenteve juridike ndërkombëtare, siç janë Karta e Madhe e Lirive (*Magna Carta Libertatum*), e vitit 1215, Ligji i të Drejtave (*Bill of Rights*), e vitit 1689, Deklarata mbi Pavarësinë e SHBA-së, e vitit 1776, Deklaratën për të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit, e vitit 1789, etj.²⁸⁸

Për shkak të rëndësisë shumë të madhe, çështja e garantimit dhe e respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut në Kosovë është rregulluar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht me Kapitullin II të kësaj Kushtetute. Në nenin 21 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është parashikuar se “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë. Çdokush e ka për detyrë që t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të tjerëve”. Ndërsa, në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është parashikuar se “Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike :

- 1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut,

²⁸⁸ GRUDA, ZEJNULLAH, Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, Libri I, Prishtinë, 2001, f. 8.

- 2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj,
- 3) Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Qytetare dhe Politike,
- 4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare,
- 5) Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Racor,
- 6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas,
- 7) Konventa për të Drejtat e Fëmijëve,
- 8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve Ndëshkuese të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

Me këtë Kapitull të veprave penale mbrohen liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, kryesisht të lirive dhe të drejtave individuale. Liria do të thotë mundësia e individit që të sillet në një mënyrë të caktuar, kurse të drejtat janë autorizime të cilat u përkasinë dhe i garantohen njeriut me ligj. Duke e marrë për bazë këtë, veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut ndahen në dy nëngrupe :

- 1) Veprat penale kundër lirive të njeriut dhe
- 2) Veprat penale kundër të drejtave të njeriut.

Në nëngrupin e veprave penale kundër lirive të njeriut, bëjnë pjesë këtë vepra penale : rrëmbimi (neni 191), shtrëngimi (neni 192), privimi i kundërligjshëm nga liria (neni 193), etj. Ndërsa, në nëngrupin e veprave penale kundër të drejtave të njeriut bëjnë pjesë : shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës (neni 190), cenimi i të drejtës për ushtrimin e mjetit juridik (neni 205), etj.

Përveç kësaj ndarje, në teorinë e së drejtës penale veprat penale të këtij Kapitulli, klasifikohen në mënyra të ndryshme, varësisht se cili kriter mirret për bazë.²⁸⁹

Pasojë e veprave penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut, është mohimi ose kufizimi i ndonjë lirie apo të drejte të njeriut.

Si kryerës të veprave penale të këtij Kapitulli, mund të paraqiten subjekte të ndryshme. Disa prej këtyre veprave penale mund t'i kryejë çdo person, ndërsa të tjerat vetëm personat me veti të caktuara, p.sh. personat zyrtarë (nenet 194, 195, 196, 198, etj.), avokati (neni 200), etj.

²⁸⁹ Më gjerësisht shih : BAJGORA, ALI, Krimet kundër lirive dhe të drejtave të njeriut në Kosovë, Pjesa e parë, Prishtinë, 1998, f. 30-32.

Të gjitha veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut mund të kryhen vetëm me dashje. Për asnjë vepër penale që bënë pjesë në këtë Kapitull nuk është parashikuar në mënyrë shprehimore se mund të kryhet edhe nga pakujdesia. Krahas dashjes, për t'u konsideruar se janë kryer disa prej këtyre veprave penale kërkohet edhe qëllimi i caktuar, p.sh. te vepra penale rrëmbimi, nga neni 191 i KPRK, përveç dashjes, duhet që kryerësi këtë vepër penale t'a kryejë me qëllim që mos ta liroj para se të nxjerr para, dobi pasurore apo dobi tjera nga ai apo personi tjetër, ose me qëllim që ta detyroj atë apo personin tjetër që të kryej ose mos të kryej një veprim ose të durojë diçka.

II. VEPRAT PENALE TË KËTIJ KAPITULLI

1. Rrëmbimi (neni 191)

Vepra penale e rrëmbimit të personit nuk ka qenë e parashikuar deri vonë në legjislacionet penale të shteteve të botës. Në legjislacionet penale të mëhershme kanë qenë të parapara vetëm disa forma të kësaj vepre penale, siç janë rrëmbimi me qëllim të robërisë, me qëllim të futjes në ushtrinë e huaj, me qëllim të dërgimit në shtetin tjetër për qëllime amoroale, etj.

Sipas paragrafit 1 të nenit 191 të KPRK, këtë vepër penale e kryen kushdo që e merr apo e mban personin, me qëllim që mos ta liroj para se të nxjerr para, dobi pasurore apo dobi tjera nga ai apo personi tjetër, ose me qëllim që ta detyroj atë apo personin tjetër që të kryej ose mos të kryej një veprim ose të durojë diçka

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale është rrëmbimi i personit tjetër.

Me rrëmbim duhet kuptuar çdo veprim me të cilin ndonjë person privohet nga liria në mënyrë të kundërligjshme, kur transferohet në drejtim të panjohur apo kur ndaj tij imponohet një pushtet. Për ekzistimin e kësaj vepre penale nuk është me rëndësi se a është transferuar personi i rrëmbyer në ndonjë vend tjetër apo ka mbetur në të njejtin vend, siç është rasti p.sh. kur grabitet banka duke e mbajtur peng personelin e bankës.²⁹⁰

Rrëmbimi i personit, edhe pse nuk është thënë në mënyrë shprehimore në KPRK, në praktikë kryhet me anë të ushtrimit të dhunës, kanosjes apo lajthimit.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje. Përveç dashjes, për ekzistimin e kësaj vepre penale duhet që kryerësi ta rrëmbejë personin me qëllim që atë apo personin tjetër ta detyrojë të kryejë ose të moskryejë një vepër apo të pajtohet me një vepër. P.sh. personi A e rrëmbeu personin B, me qëllim që personi B apo anëtari i familjes së personit B të jap një shumë të caktuar të të hollave, apo nga këta persona të nxjerret ndonjë përfitim tjetër.

²⁹⁰ SALIHU, ISMET, E drejta penale, Pjesa e posaçme, Prishtinë, 2014, f. 216-217.

Rrëmbimi i personit është një veprë penale permanente, që do të thotë se ajo zgjat deri sa personi i rrëmbyer gjendet nën pushtetin e kryerësit të veprës penale.

Për formën themelore të kësaj veprë penale është parashikuar dënimi prej gjashtë muaj deri në dhjetë vjet burgim.

Forma e rëndë e kësaj veprë penale është parashikuar në paragrafin 2 të nenit 191 të KPRK, sipas së cilës nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet në një apo më shumë prej rrethanave në vijim, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet:

1. kryesi i është kanosur personit të rrëmbyer me vrasje ose dëmtim të rëndë të shëndetit;

2. kryesi ka kryer veprën duke vepruar si anëtar i grupit;

3. kryesi ka kryer veprën duke përdorur armën, mjetin e rrezikshëm apo sendin tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit;

4. kryesi ka kryer veprën kundër viktimës së ndjeshme.

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin F.O, për shkak të formës së rëndë të veprës penale rrëmbimi, sepse i akuzuari si anëtarë i grupit, në bashkëpunim me persona tjerë, e kanë rrëmbyer të dëmtuarin R.A. në lokalet e kompanisë së tij dhe e kanë dërguar në një vend tjetër, ku më pas, rrëmbyesit për lirim të dëmtuarit, kanë kërkuar nga anëtarët e familjes së të dëmtuarit shuma të caktuara të të hollave.²⁹¹

Formë edhe me e rëndë e kësaj veprë penale është parashikuar në paragrafin 3 të nenit 191 të KPRK. Sipas kësaj dispozite ligjore, kur vepra nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në një apo më shumë prej rrethanave në vijim, kryesi dënohet me pesëmbëdhjetë (15) vjet burg ose dënim me burgim të përjetshëm, kur :

1. kryesi ka kryer veprën duke vepruar si anëtar i grupit të organizuar;

2. kryesi i ka shkaktuar personit të rrëmbyer lëndim të rëndë trupor ose vdekje gjatë kryerjes së veprës.

Në paragrafin 4 të nenit 191 të KPRK, është parashikuar se për qëllime të paragrafit 1. të këtij neni, personi i cili merr ose mban fëmijën konsiderohet se vepron pa pëlqimin e fëmijës.

Kryerës i të gjitha formave të kësaj veprë penale mund të jetë çdo person.

Në paragrafin 5 të këtij neni, është parashikuar mundësia fakultative e zbutjes së dënimit, nëse kryerësi vullnetarisht e liron personin e rrëmbyer para se t'i jenë realizuar kërkesat e tij për shkak të të cilave e ka kryer rrëmbimin.

²⁹¹ Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, P.nr.238/2004, i datës 13.04.2007.

2. Shtrëngimi (neni 192)

Veprën penale të shtrëngimit e kryen kushdo që me forcë apo me kanosje serioze e detyron personin tjetër të kryejë apo të mos kryejë një veprim ose të pajtohet me një veprim (neni 192 paragrafi 1 i KPRK).

Shtrëngimi është veprë penale kundër lirisë së vullnetit në kuptimin e lirisë së formimit dhe të realizimit të vullnetit. Kjo veprë është e drejtuar kundër lirisë për të vendosur dhe kundër lirisë për të vepruar.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në detyrimin e personit tjetër përmes forcës apo kanosjes serioze që të kryejë apo të mos kryejë një veprim ose të pajtohet me një veprim.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin F.Q., për shkak të veprës penale shtrëngimi, sepse i akuzuari më datën 08.02.2006, në një fshat të Komunës së Vitisë, përmes kanosjes serioze e kishte detyruar të dëmtuarin V.L., i cili punonte në një kompani për shitjen e gjërave ushqimore, që të akuzuarit t'ia siguroj (t'ia jap) numrin e telefonit të drejtorit të kësaj kompanie.²⁹²

Kryerësi i veprës penale e detyron personin tjetër të ndërmarr diçka, veprim këtë që nuk do ta ndërmerre apo që të mos kryejë ndonjë veprim, të cilin do të dëshironte ta kryente, apo të pajtohet me një veprë, me të cilën, po të mos ushtrohej dhuna apo kanosja serioze ndaj tij, ai nuk do të pajtohej.

Mjete të kryerjes së kësaj vepre penale janë forca dhe kanosja serioze.

Forca apo dhuna është përdorim i forcës ndaj një personi me qëllim që të detyrohet të ndërmarrë apo të mos ndërmarrë një veprim me të cilin realizohen tiparet e një vepre penale. Dhuna mund të jetë absolute dhe relative (kompulsive). Dhuna absolute është ajo dhunë me të cilin personi në tërësi, në mënyrë absolute është privuar që lirisht të vendosë për sjelljen e tij. Kurse, dhuna relative (kompulsive) shprehet në rastet kur personi ndaj të cilit është e drejtuar dhuna, nuk privohet në tërësi nga mundësia për të vendosur, mirëpo dhuna që aplikohet bën presion dhe është e intensitetit të tillë që e shtrëngon të ndërmarrë apo të mos e ndërmarrë veprimin e caktuar.²⁹³

Gjithashtu, si dhunë konsiderohet edhe zbatimi i hipnozës ose i mjeteve të tjera dehëse me qëllim të vënies së personit kundër dëshirës së vet në gjendje të pavetëdijshme apo të paaftësohet për rezistencë (neni 113 paragrafi 15 i KPRK).

²⁹² Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Viti, P.nr.47/2006, i datës 21.04.2008.

²⁹³ SALIHU, ISMET, E drejta penale, Pjesa e posaçme, Prishtinë, 2014, f. 218.

Kanosja është deklaratë apo ndonjë veprim tjetër me të cilin i vëhet në dukje, i bëhet me dije ndokujt se do ta gjejë një e keqe nëse nuk vepron ashtu si dëshiron kryerësi. Kanosja është një lloj presioni, një lloj dhune psikike me të cilën ndikohet në vullnetin e personit tjetër që të ndërmarrë një veprim i cili i ka tiparet e vepës penale.²⁹⁴

Vepra penale konsiderohet se është kryer në rastet kur personi ndaj të cilit është ushtruar dhuna apo kanosja serioze është detyruar që të kryejë një veprim apo mosveprim apo të pajtohet me një veprim.

Për formën themelore të parashikuar në paragrafin 1 të nenit 192 të KPRK, është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Në paragrafin 2 të nenit 192 të KPRK, është parashikuar forma e rëndë e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në një apo më shumë prej rrethanave në vijim:

1. kryesi i është kanosur personit të shtrënguar me vrasje ose dëmtim të rëndë të shëndetit;

2. kryesi ka kryer veprën duke vepruar si anëtar i grupit;

3. kryesi ka kryer veprën duke përdorur armën, mjetin e rrezikshëm apo sendin tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit;

4. kryesi ka kryer veprën ndaj viktimës së ndjeshme.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.

Forma edhe më e rëndë e kësaj vepre penale, sipas paragrafit 3 të këtij neni, ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga kryerësi i cili vepron si anëtar i një grupi të organizuar ose kur është shkaktuar lëndim i rëndë trupor ose vdekja gjatë kryerjes së veprës, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej dy deri në dhjetë vjet.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje dhe me qëllimin e lartcekur.

Vepra penale e shtrëngimit, nga neni 192 i KPRK, është vepër penale e përgjithshme dhe themelore e përdorimit të forcës apo të kanosjes serioze. Kjo vepër penale është e karakterit subsidiar, që konsiderohet se kryhet dhe i përfshinë të gjitha ato lloje të forcës të cilat nuk shfaqen tek veprat tjera penale.

²⁹⁴ Idem, f. 219.

3. Privimi i kundërligjshëm nga liria (neni 193)

Privimi i kundërligjshëm nga liria është vepër penale kundër lirisë së lëvizjes. Liria e lëvizjes është njëra ndër liritë themelore të njeriut e cila është e garantuar me kushtetutat e shteteve bashkëkohore. Përveç kësaj, liria e lëvizjes është e paraparë dhe garantuar edhe me një numër të madhë të akteve juridike ndërkombëtare. Edhe me nenin 29 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është e garantuar liria e lëvizjes, në të cilin është parashikuar se : “Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:

- 1) pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale;
- 2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;
- 3) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij/saj në një institucion kompetent, sipas një urdhri të ligjshëm;
- 4) për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë;
- 5) për hyrje të paligjshme në Republikën e Kosovës ose pas urdhrit të ligjshëm për largim ose ekstradim”.

Liria e lëvizjes është e garantuar edhe me nenin 35 (Liria e Lëvizjes) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në të cilin është parashikuar se : “Shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës, kanë të drejtë të lëvizin lirisht në Republikën e Kosovës dhe të zgjedhin vendbanimin”.

Duke u bazuar në këto dispozita ligjore, në legjislacionin penal të Kosovës është parashikuar si vepër penale privimi i një personi nga liria në mënyrë të kundërligjshme.

Kështu, në nenin 193 të KPRK është parashikuar kjo vepër penale, e cila sipas paragrafit 1 të këtij neni, konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush personin tjetër e burgos në mënyrë të kundërligjshme, e mban të mbyllur ose në ndonjë mënyrë tjetër e privon nga liria.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në privimin e kundërligjshëm të personit nga liria.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale më së shpeshti qëndron në mbylljen e ndonjë personi në ndonjë lokal, shtëpi, banesë, podrum, dhomë, etj.²⁹⁵ Nëse ndonjë person është i mbyllur, veprimi i kryerjes mund të konsistojë edhe në mosndërmarrjen e veprimit që personi të lirohet. Kjo vepër penale mund të kryhet edhe në mënyra tjera. Liria e lëvizjes mund t'i mirret personit tjetër, edhe me çdo veprim tjetër që është i përshtatshëm për t'ia bërë të pamundur lëvizjen personit tjetër, p.sh. duke ja marrë shkallët personit që shërbejnë për zbritje, duke ja marrë mjetet ortopedike invalidit, i cili nuk mund të lëvizë, duke mos e lejuar personin që të largohet nga automjeti, etj.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin T.V, për shkak të veprës penale privimi i kundërligjshëm nga liria, sepse më datën 05.06.2006, në një fshat të Komunës së Kamenicës, i akuzuari e privon në mënyrë të kundërligjshme nga liria të dëmtuarin A.D., duke e futur brenda në një shtëpi të braktisur të këtij fshati, ku pastaj ia kishte lidhur këmbët dhe njëren dorë me një litar dhe i akuzuari më vonë ishte larguar nga kjo shtëpi, kurse i dëmtuari pas 4 orëve kishte arritur që të mënjanoj lidhjen e gjymtyrëve të tij dhe të largohet nga kjo shtëpi e braktisur.²⁹⁶ Në një çështje tjetër penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin R.T., për shkak të kësaj vepre penale, sepse i akuzuari më datën 30.05.2008, në një fshat të Komunës së Ferizajit, e kishte privuar në mënyrë të kundërligjshme nga liria të dëmtuarin Q.D., të cilin i akuzuari e kishte marrë me automjetin e tij dhe e kishte dërguar në kopshtin e shtëpisë së tij, ku të dëmtuarit ia kishte lidhur me tela këmbët dhe duart për një shtyllë të betonit dhe në këtë gjendje e kishte mbajtur deri në ora 22:45, të të njejtës ditë.²⁹⁷

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale, sipas paragrafit 1 të nenit 193 të KPRK janë: **a) burgosja, b) mbajtja mbyllur apo c) privimi i një personi në mënyra tjera nga liria.**

a) Me shprehjen burgosje nënkuptohen rastet kur ndokush e shpie personin tjetër në ndonjë hapësirë, në ndonjë vend apo lokal të caktuar, p.sh., në oborr, shtëpi ose banesë, në automjet etj., nga i cili personi i mbyllur nuk mund të dalë, për shkak të pengesave fizike apo psikike, ngase i mbyllet dera, i vihet roja, etj; apo mund të dalë vetëm duke iu ekspozuar rrezikut, duke kërcyer prej dritares nga lartësia, etj.

b) Mbajtja e ndonjë personi mbyllur do të thotë që ky person të ketë qenë edhe më parë i mbyllur dhe kryerësi i kësaj vepre penale vazhdon ta mbajë në gjendje të tillë (të mbyllur).

c) Mënyra të tjera të privimit nga liria mund të kryhen me çdo lloj veprimi, me të cilin mund t'i hiqet liria e qarkullimit personit tjetër, p.sh. duke e detyruar tjetrin të lëvizë vetëm në një rrugë të caktuar; duke ia hequr shkallët tjetrit që është duke punuar mbi kulmin e shtëpisë, etj.

Vepra penale mund të kryhet ndaj çdo personi që posedon aftësi për të qarkulluar, për të ecur, pa marrë parasysh nëse ai është ose jo i aftë të ecë vetë apo me ndihmën e karrocës, të protezave apo mjeteve të ngjashme.

²⁹⁵ SHALA, AFRIM, Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, f. 121.

²⁹⁶ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Kamenicë, P.nr.187/2006, i datës 16.10.2007.

²⁹⁷ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj, P.nr.25.03.2010.

Për t'u konsideruar se është kryer kjo veprë penale, në ligj është parashikuar shprehimisht që heqja e kësaj lirie duhet të jetë e kundërligjshme. Së këndejmi rezulton se nuk konsiderohet se është kryer kjo veprë penale, nëse heqja e lirisë është bërë në bazë të ligjit përkatësisht në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, siç është arrestimi, ndalimi policor, paraburgimi apo ekzekutimi i dënimit me burgim.

Te kjo veprë penale, pengimi i personit për të lëvizur lirisht, mund të jetë absolut dhe relativ. Pengimi absolut i realizimit të lirisë së lëvizjes tek privimi i kundërligjshëm nga liria, ekziston në rastet kur ndonjë personi i është pamundësuar çdo lëvizje në mënyrë absolute, p.sh. lidhja e këmbëve dhe duarve. Pengimi relativ i lirisë së lëvizjes, ekziston në rastet kur mundësia e lëvizjes është e kufizuar në hapsirë dhe në vend të caktuar, p.sh. në dhomë apo në ndonjë vend të caktuar.²⁹⁸

Për ekzistimin e kësaj veprë penale është e mjaftueshme edhe heqja e lirisë së qarkullimit në kohëzgjatje të shkurtër.

Privimi i kundërligjshëm nga liria është veprë penale e natyrës permanente, ngase gjendja e kundërligjshmërisë zgjat për një kohë të caktuar.

Për formën themelore të kësaj veprë penale të parashikuar në paragrafin 1 të nenit 193 të KPRK, është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Në paragrafin 2 të këtij neni është parashikuar formë e rëndë e kësaj veprë penale e cila konsiderohet se është kryer nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në një apo më shumë prej rrethanave në vijim :

1. kur vepra kryhet ndaj viktimës së ndjeshme;
2. kur vepra kryhet në mënyrë mizore;
3. kur privimi i kundërligjshëm i lirisë zgjatë më tepër se pesëmbëdhjetë (15) ditë;
4. kur vepra penale rezulton me dëmtim të rëndë të shëndetit të personit të mbajtur në mënyrë të kundërligjshme ose në rrethana tjera të rënda dhe
5. kur vepra kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit.

Për këtë formë të rëndë të kësaj veprë penale është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Formë edhe më e rëndë e kësaj veprë penale është parashikuar në paragrafët 3 dhe 4 këtij neni. Kështu, sipas paragrafit 3 të këtij neni, kur vepra penale nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni kryhet nga personi zyrtar duke keqpërdorur detyrën apo autorizimet e tij, kryesi dënohet me

²⁹⁸ BAJGORA, ALI, Veprat penale kundër lirisë së personit në planin krahasues, Prishtinë, 1999, f. 50-51.

burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet. Nëse kjo vepër kryhet me përdorim të armës, mjetit të rrezikshëm apo ndonjë sendi tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet. Ndërsa, sipas paragrafit 4 të këtij neni, kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet me përdorim të armës, mjetit të rrezikshëm apo ndonjë sendi tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 5 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet nëse rezulton me vdekjen e personit të privuar nga liria në mënyrë të kundërligjshme, për të cilën është parashikuar dënimi me jo më pak se pesë vjet burgim.

Të gjitha këto forma të kësaj vepre penale mund të kryhen vetëm me dashje.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, përveç formës së rëndë, nga paragrafi 3 të cilën mund ta kryejë vetëm personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës.

4. Marrja e deklaratave me anë të shtrëngimit (neni 194)

Sipas paragrafit 1 të nenit 194 të KPRK, këtë vepër penale e kryen personi zyrtar, i cili duke keqpërdorë detyrën apo autorizimet e tij, e përdorë forcën apo kanosjen serioze ose mjete apo mënyra të tjera të ndaluara me qëllim të detyrimit të të dyshuarit, të pandehurit, dëshmitarit, ekspertit apo personit tjetër për të dhënë ndonjë deklaratë.

Me këtë vepër penale cenohet liria e shprehjes së lirë të vullnetit të dyshuarit, të pandehurit, dëshmitarit, ekspertit apo e ndonjë personi tjetër.

Me forcë nënkuptohet jo vetëm përdorimi i forcës fizike apo mekanike, por edhe përdorimi i hipnozës ose i mjeteve tjera joshëse. Ndërsa me kanosje, lidhur me këtë vepër penale, nënkuptohet kanosja e rëndomtë, me ç'rast i vihet në dukje të dyshuarit, të pandehurit, dëshmitarit apo ekspertit se do të goditet me një të keqe serioze. Si mjete apo mënyra të ndaluara janë mjetet apo mënyrat me të cilat mund të ndikohet në vullnetin e personit i cili jep aso deklarate e cila nuk do të jepet po të mos ishin përdorur mjetet dhe mënyrat e ndaluara. Mënyrat e marrjes së deklaratës nga personat e lartcekur janë të përcaktuara me dispozitat e KPPK.

Subjekt pasiv apo person ndaj të cilit përdoret dhuna apo kanosja mund të jetë vetëm i dyshuari, i pandehuri, dëshmitari, eksperti ose ndonjë person tjetër që merret në pyetje.

Konsiderohet se është kryer vepra penale, vetëm nëse përdorimi i forcës apo i kanosjes është ndërmarrë me qëllim që të nxjerret deklarata me shtrëngim.

Për formën themelore të kësaj vepre penale të parashikuar në paragrafin 1 të nenit 163 të KPRK, është parashikuar dënimi me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.

Sipas paragrafit 2 të nenit 194 të KPRK, forma e rëndë (e cilësuar) e kësaj vepre penale ekziston, nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet me përdorimin e dhunës së rëndë ose nëse të dyshuarit ose të pandehurit i janë shkaktuar pasoja të rënda në procedurën penale si rezultat i deklaratës së marrë nga ai me detyrim. Me shprehjen dhunë të rëndë duhet nënkuptuar situatat kur shkaktohen lëndime të rënda trupore, ndërsa si pasoja të rënda për të pandehurin, gjithashtu, mund të konsiderohen edhe mbajtja më gjatë në burgun hetues apo shqiptimi i dënimit në bazë të deklaratës së nxjerrë me dhunë. Për formën e rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë vetëm personi zyrtar, gjatë ushtrimit të detyrës.

Kjo vepër penale (forma themelore dhe forma e rëndë) mund të kryhet vetëm me dashje.

5. Cënimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve (neni 197)

Veprën penale të cënimit të paprekshmërisë së banesave, sipas paragrafit 1 të nenit 197 të KPRK, e kryen kushdo që pa autorizim apo në mënyrë të kundërligjshme hyn në banesë ose në objektin e mbyllur të personit tjetër apo nuk largohet nga objektet e tilla sipas kërkesës së personit të autorizuar.

Objekt mbrojtës i kësaj vepre penale janë banesat ose objektet e tjera të mbyllura.

Në sensin e kësaj vepre penale me banesë përfshihen të gjitha ato lokale të cilat shërbëjnë për banim dhe ato hapësira të mbyllura të cilat janë në funksion të shfrytëzimit për banim, p.sh. dhoma e hotelit ose motelit, dhoma e marrë me qira, rimorkioja për kamping, etj. Kurse, objekte të mbyllura, në sensin e kësaj vepre penale konsiderohen ato objekte të cilat nuk janë banesë, mirëpo në to nuk mund të futet lirshëm, siç janë p.sh. garazhi, bodrumi, tavani, etj.

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale konsistojnë në dy forma : a) duke hyrë pa autorizim ose në mënyrë të kundërligjshme në banesën e huaj ose në objekte të mbyllura ose b) duke mos u larguar nga këto objekte me kërkesën e personit të autorizuar.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata i ka shpall fajtorë të akuzuarit F.M. dhe L.D., për shkak të veprës penale cënimi i paprekshmërisë së banesave, sepse të akuzuarit gjatë muajit mars të vitit 2006, në mënyrë të kundërligjshme kanë hyrë në banesën e të dëmtuares L.I., e cila gjendet në Gjilan, në Lagjen “Iliria”, duke e shfrytëzuar të njejtën për nevojat e veta personale dhe familjare, deri më datën 06.07.2007, kur janë larguar nga kjo banesë.²⁹⁹

²⁹⁹ Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Gjilan, P.nr.690/2006, i datës 08.02.2007.

Personi i autorizuar, në kuptim të kësaj vepre penale konsiderohet pronari i banesës, bartësi i të drejtës së banimit, personi që e shfrytëzon banesën me qira, etj.

Vepra penale konsiderohet se është kryer me vetë faktin e hyrjes në banesë apo në objektin e huaj të mbyllur, ose duke mos dalë jashtë nga këto, me kërkesën e personit të autorizuar.

Për formën themelore të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim deri në tri vjet.

Në paragrafin 2 të këtij neni, është parashikuar se tentativa për të kryer vepër penale nga paragrafi 1 i këtij neni është e dënueshme.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 3 të nenit 197 të KPRK, e cila konsiderohet se ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga personi zyrtar në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 4 të nenit 197 të KPRK. Sipas kësaj dispozite ligjore, kjo formë e rëndë e kësaj vepre penale konsiderohet se kryhet nëse kjo vepër penale kryhet me përdorim të armës, mjetit të rrezikshëm apo sendit tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, përveç formës sipas paragrafit 3 të këtij neni, të cilën mund ta kryej personi zyrtar.

Vepra penale e cënimit të paprekshmërisë së banesave, nga neni 197 i KPRK, mund të kryhet vetëm me dashje.

6. Kontrollimi i kundërligjshëm (neni 198)

Sipas nenit 198 të KPRK, këtë vepër penale e kryen personi zyrtar, i cili me keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij bën kontrollim të kundërligjshëm të banesës, objekteve apo personit .

Kontrollimi i banesës, lokaleve apo të personit, duhet të bëhet sipas dispozitave ligjore të KPP. Kontrollimi i banesës, objekteve apo të personit konsiderohet vepër penale, në rastet kur bëhet në kundërshtim me dispozitat ligjore të KPP, nga ana e personit zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në kontrollimin e kundërligjshëm të banesës, objekteve apo personit.

Vepra penale konsiderohet se është kryer me vetë faktin e kontrollimit, përkatësisht të ndërmarrjes së atyre veprimeve të cilat konsistojnë në kontrollimin e banesës, objekteve apo personit.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë vetëm personi zyrtar, gjatë ushtrimit të detyrës.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Për veprën penale kontrollimi i kundërligjshëm është parashikuar dënimi me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

7. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli

Në këtë Kapitull parashihen edhe këto vepra penale :

- Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe të banorëve të Republikës së Kosovës (neni 190),
- Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike (neni 195),
- Tortura (neni 196),
- Cenimi i fshehtësisë së korrespondencës dhe i bazave të të dhënave kompjuterike (neni 199),
- Zbulimi i paautorizuar i informacionit konfidencial (neni 200),
- Përgjimi i paautorizuar (neni 201),
- Fotografimi dhe incizimet e tjera të paautorizuara (neni 202),
- Shkelja e urdhërave për masat e fshehura ose teknike të vëzhgimit ose hetimit (neni 203),
- Parandalimi ose pengimi i tubimit publik (neni 204),
- Cenimi i të drejtës për ushtrimin e mjetit juridik (neni 205),
- Parandalimi i shtypjes ose i shpërndarjes së materialeve të shtypura dhe emetimit të programeve (neni 206).

KAPITULLI VI

VEPRAT PENALE KUNDËR TË DREJTAVE TË VOTIMIT

1. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME

Kapitulli XVIII i KPRK në të cilin janë parashikuar veprat penale kundër të drejtave të votimit konsiderohet njëri ndër kapitujt më të rëndësishëm në pjesën e posaçme të KPRK.

Për shkak të pasojave dhe rrezikshmërisë së tyre, veprat penale kundër të drejtave të votimit, sipas nenit 22 të Kodit të Procedurës Penale, konsiderohen krime të rënda dhe për gjykimin e tyre në shkallë të parë është kompetent Departamenti i Krimeve të Rënda i Gjykatës Themelore, ndërsa në shkallë të dytë është kompetent Departamenti i Krimeve të Rënda i Gjykatës së Apelit të Kosovës.

Kohëve të fundit, këtyre veprave penale i është kushtuar një vëmendje e posaçme nga institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare, për faktin se janë inicuar një numër i konsiderueshëm i procedurave penale ndaj personave që dyshohet se kanë kryer vepra penale të këtyre natyrave gjatë zgjedhjeve të fundit në Republikën e Kosovës.

Shumica e veprave penale të këtij Kapitulli kanë karakter blanket, sepse për të ekzistuar këto vepra penale duhet që veprimet e kryerjes të jenë në kundërshtim me ligjet përkatëse të zgjedhjeve.

Sa i përket kohës së kryerjes, këto vepra penale mund të kryhen si para, ashtu edhe gjatë zgjedhjeve (gjatë procesit të votimit dhe numërimit të votave).

Disa nga veprat penale të këtij Kapitulli, kanë edhe format e rënda apo të cilësuar, të cilat konsiderohen se kryhen nëse format themelore të këtyre veprave penale janë kryer me përdorimin e forcës apo kanosjes serioze, apo këto vepra penale i ka kryer anëtari i komisionit zgjedhor ose ndonjë person tjetër gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare në lidhje me votimin.

Kryes i shumicës së veprave penale kundër të drejtave të votimit mund të jetë çdo person. Mirëpo, disa vepra penale të këtij Kapitulli mund t'i kryejnë vetëm personat që posedojnë cilësi të caktuara, si p.sh. veprën penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve, nga neni 211 i KPRK mund ta kryejë vetëm personi zyrtar.³⁰⁰

Të gjitha veprat penale të këtij Kapitulli mund të kryhen vetëm me dashje dhe me motive të caktuara politike. Veprat penale kundër të drejtave të votimit kryhen me motive politike, ngase janë të ndërlidhura me zgjedhjet që zhvillohen në Republikën e Kosovës. Këto vepra penale

³⁰⁰ Veprat e tilla penale, të cilat mund t'i kryejnë vetëm personat që posedojnë cilësi të caktuara (p.sh. personi zyrtar), në të drejtën penale quhen “*delicta propria*”. SHALA, AFRIM, Hyrje në të drejtën penale, f. 47.

mund të kryhen si gjatë zgjedhjeve lokale (duke përfshirë këtu edhe zgjedhjet për kryetar të komunave), ashtu edhe gjatë zgjedhjeve të përgjithshme.

2. Cenimi i së drejtës për të kandiduar (neni 207)

E drejta e votës përfshinë të drejtën aktive të votës dhe të drejtën pasive të votës. E drejta aktive e votës nënkupton të drejtën e qytetarëve që kanë arritur moshën madhore që të votojnë në zgjedhjet që mbahen në Republikën e Kosovës, kurse e drejta pasive e votës nënkupton të drejtën e qytetarëve që kandidohen për t'u zgjedhur në pozita të caktuara. E drejta e votës është e garantuar me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës³⁰¹ dhe të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës,³⁰² i cili është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.³⁰³ Duke u bazuar në këto dispozita ligjore, shfrytëzimi i të drejtës së votës është i garantuar edhe me dispozitat e legjislacionit penal të Republikës së Kosovës, përkatësisht me dispozitat e KPRK.³⁰⁴

Përmes kryerjes së kësaj vepre penale çënohet e drejta pasive e votës.

Sipas paragrafit 1 të nenit 207 të KPRK, formën themelore të kësaj vepre penale e kryen kushdo që në mënyrë të kundërligjshme parandalon ose pengon ndonjë person nga kandidimi në zgjedhje.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në ndërmarrjen e veprimeve të atilla të kundërligjshme me anë të të cilave një person parandalohet ose pengohet nga kandidimi në zgjedhje.

Objekt mbrojtës i kësaj vepre penale është e drejta për tu kandiduar në zgjedhje.

Pasojë e kësaj vepre penale është parandalimi ose pengimi i një personi nga kandidimi në zgjedhje, përkatësisht pamundësia e një personi që të kandidojë në zgjedhje.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të nenit 207 të KPRK. Sipas kësaj dispozite ligjore, forma e rëndë e kësaj vepre penale ekziston në rastet kur forma themelore e kësaj vepre penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer me përdorim të forcës

³⁰¹ Ligji Nr.03/L-072 Për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, i datës 05.06.2008 (Në tekstin e mëtejme LZLRK).

³⁰² Ligji Nr.03/L-073 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i datës 05.06.2008 (Në tekstin e mëtejme LZPRK).

³⁰³ Ligji Nr.03/L-56 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-073 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i datës 29.10.2010.

³⁰⁴ SHALA, AFRIM, Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, f. 128.

apo kanosjes serioze, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet.

Kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

3. Kanosja e kandidatit (neni 208)

Sipas paragrafit 1 të nenit 208 të KPRK, formën themelore të kësaj vepre penale e kryen kushdo që në mënyrë të kundërligjshme detyron ndonjë kandidat që të tërheq kandidaturën e tij.

Veprimi i kryerjes së kësaj forme të veprës penale konsiston në ndërmarrjen e veprimeve të atilla të kundërligjshme me anë të të cilave kryesi e detyron ndonjë kandidat që të tërheqë kandidaturën e tij.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Formë tjetër e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush në mënyrë të kundërligjshme e parandalon ose e pengon ndonjë kandidat nga ushtrimi i ndonjë veprimtarie gjatë fushatës elektorale.

Objekt mbrojtës i kësaj forme të kësaj vepre penale është ushtrimi i lirë dhe i papenguar i ndonjë veprimtarie elektorale të ndonjë kandidati gjatë fushatës elektorale.

Veprimi me të cilin kryhet kjo formë e kësaj vepre penale është parandalimi ose pengimi i ndonjë kandidati që të ushtrojë ndonjë veprimtari gjatë fushatës elektorale.³⁰⁵

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Ndërsa, formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur format e kësaj vepre penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhen me përdorim të forcës apo kanosjes serioze. Pra, kjo formë e rëndë e kësaj vepre penale konsiderohet se është kryer nëse kryesi në mënyrë të kundërligjshme me përdorimin e forcës ose të kanosjes serioze detyron ndonjë kandidat që të tërheq kandidaturën e tij ose me përdorimin e forcës ose të kanosjes serioze në mënyrë të kundërligjshme e parandalon ose e pengon ndonjë kandidat nga ushtrimi i ndonjë veprimtarie gjatë fushatës elektorale.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet.

Kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

³⁰⁵ SALIHU, ISMET; ZHITIJA, HILMI; HASANI, FEJZULLAH, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Komentar, f. 574.

4. Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar (neni 209)

Formën themelore të veprës penale parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar, sipas paragrafit 1 të nenit 209 të KPRK, e kryen kushdo që gjatë ushtrimit të detyrave të besuara lidhur me zgjedhjet, në mënyrë të kundërligjshme dhe me qëllim të pengimit të personit tjetër nga ushtrimi i së drejtës së tij për të votuar, nuk e regjistron personin e tillë në listën e regjistrimit të votuesve ose e heq personin e tillë nga lista e regjistrimit të votuesve.

Veprimet e kryerjes së kësaj forme të veprës penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë në mosregjistrimin e personit në listën e regjistrimit të votuesve ose heqja e personit të tillë nga lista e regjistrimit të votuesve nga kryesi në mënyrë të kundërligjshme.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në tre vjet.

Kjo formë e kësaj vepre penale mund të kryhet vetëm me dashje, e cila në vehte përfshin edhe qëllimin e pengimit të personit tjetër nga ushtrimi i së drejtës së tij për të votuar.

Kryes i kësaj forme të veprës penale mund të jetë vetëm personi të cilit i janë besuar detyra të caktuara gjatë zgjedhjeve.

Formë tjetër e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se është kryer në rastet kur kryesi gjatë votimit ose referendumit, në mënyrë të kundërligjshme parandalon, pengon ose ndikon në përcaktimin e lirë të votuesit ose në ndonjë mënyrë tjetër pengon personin tjetër në ushtrimin e së drejtës së tij për të votuar.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim deri në një vit.

Kjo formë e kësaj vepre penale mund të kryhet vetëm me dashje dhe kryes i saj mund të jetë çdo person.

Ndërsa, forma e rëndë e kësaj vepre penale, e parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, ekziston në rastet kur veprën penale nga paragrafët 1 ose 2 të këtij neni, kryesi e kryen me përdorim të forcës apo kanosjes serioze.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në pesë vjet.

5. Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve (neni 210)

Njëri ndër parimet kryesore të zgjedhjeve në Republikën e Kosovës, është edhe parimi se “vota është e lirë”. Ky parim është parashikuar në nenin 45 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në të cilën është parashikuar se “vota është e lirë”, çka do të thotë se çdo qytetar i Republikës së Kosovës është i lirë që të votojë për cilindo kandidat apo subjekt politik që ai apo ajo dëshiron. Gjithashtu, edhe në nenin 2 të LZPRK është parashikuar se liria e votës është e garantuar dhe se askush nuk ka të drejtë të detyrojë ndonjë qytetar që të votojë në një mënyrë

të caktuar ose të mbajë atë përgjegjësi për votën. Duke u bazuar në këto dispozita ligjore, në nenin 210 të KPRK, është parashikuar edhe si vepër penale cënimi i përcaktimit të lirë të votuese. Sipas kësaj dispozite ligjore, këtë vepër penale e kryen kushdo që me përdorim të forcës apo kanosjes serioze, ose me keqpërdorim të varësisë ekonomike dhe profesionale të votuesit ndikon ose detyron votuesin në Republikën e Kosovës që të votojë në mënyrë të caktuar ose të mos votojë në zgjedhje.

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale konsistojnë në ndikimin mbi vullnetin e votuesit ose detyrimin e tij për të votuar në mënyrën e caktuar ose për të mos votuar në zgjedhje.

Mjete të kryerjes së kësaj vepre penale janë përdorimi i forcës, kanosjes serioze, keqpërdorimi i varësisë ekonomike apo profesionale.

Vepra penale konsiderohet se është kryer në rastet kur personi ndaj të cilit është ushtruar dhuna, kanosja serioze, keqpërdorimi i varësisë ekonomike apo profesionale, nën ndikimin e këtyre mjeteve ka votuar në mënyrën e caktuar ose nuk ka votuar.

Kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person dhe kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në pesë vjet.

6. Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve (neni 211)

Sipas nenit 211 të KPRK, këtë vepër penale e kryen çdo person zyrtar të cilit i janë besuar detyra lidhur me zgjedhjet, i cili e keqpërdor pozitën, detyrën apo autoritetin e tij duke urdhëruar, këshilluar ose kryer ndonjë vepër të kundërligjshme me qëllim të ndryshimit apo ndikimit të listës së regjistrimit të votuesve ose votimit të cilitdo person ose në ndonjë mënyrë tjetër vepron me qëllim që të ndryshojë, ndikojë ose pengojë ndonjë person nga ushtrimi i të drejtës së tij për të votuar, për të mos votuar, për të hedhur një votë të pavlefshme ose për të votuar në favor apo kundër një personi ose propozimi të caktuar.

Për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej dy deri në pesë vjet.

Kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person zyrtar të cilit i janë besuar detyra lidhur me zgjedhjet në Republikën e Kosovës.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje, e cila në vehte përfshin edhe qëllimin e cekur më lartë.

7. Dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin (neni 212)

Sipas paragrafit 1 të nenit 212 të KPRK, veprën penale dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin e kryen kushdo që premtion, ofron ose jep ndonjë përfitim ose dhuratë të pamërituar

ndonjë personi, me qëllim që të ndikojë atë person për të votuar, për të mos votuar, për të votuar në favor apo kundër një personi apo propozimi të caktuar ose për të hedhur një votë të pavlefshme në zgjedhje apo në referendum.

Veprimet e kryerjes së kësaj forme të veprës penale janë premtimi, ofrimi ose dhënia e ndonjë përfitimi ose dhurate të pamerituar ndonjë personi.

Kjo formë e kësaj vepre penale konsiderohet se është në momentin e dhënies së premtimit, ofrimit ose dhënies së ndonjë përfitimi ose dhurate të pamerituar ndonjë personi.

Kjo formë e kësaj vepre penale mund të kryhet vetëm me dashje dhe me qëllim të ndikimit tek personi tjetër për të votuar, për të mos votuar, për të votuar në favor apo kundër një personi apo propozimi të caktuar ose për të hedhur një votë të pavlefshme në zgjedhje apo në referendum.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në pesë vjet.

Formë tjetër e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të nenit 212 të KPRK. Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se formën e dytë të kësaj vepre penale e kryen kushdo që kërkon ose pranon ndonjë përfitim ose dhuratë të pamerituar për vete ose për ndonjë person tjetër, ose pranon ofertën apo premtimin për përfitim apo dhuratë të tillë, për të votuar ose për të mos votuar, për të votuar në favor apo kundër një personi apo propozimi të caktuar ose për të hedhur një votë të pavlefshme në zgjedhje apo në referendum.

Veprimet e kryerjes së kësaj forme të veprës penale konsistojnë në kërkimin ose pranimin e ndonjë përfitimi ose dhurate të pamerituar për vete ose për ndonjë person tjetër, ose pranon ofertën apo premtimin për përfitim apo dhuratë të tillë.

Kjo formë e kësaj vepre penale konsiderohet se kryhet në momentin e kërkimit ose pranimin të ndonjë përfitimi ose dhurate të pamerituar për vete ose për ndonjë person tjetër.

Kjo formë e kësaj vepre penale mund të kryhet vetëm me dashje dhe me qëllim për të votuar ose për të mos votuar, për të votuar në favor apo kundër një personi apo propozimi të caktuar ose për të hedhur një votë të pavlefshme në zgjedhje apo në referendum.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në pesë vjet.

Formë e veçantë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 3 të nenit 212 të KPRK. Këtë formë të kësaj vepre penale e kryen personi i cili shërben si ndërmjetësues dhe shkel paragrafin 1 ose 2 të këtij neni.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në pesë vjet.

Ndërsa, forma e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 4 të këtij neni, e cila konsiderohet se ekziston në rastet kur vepra penale nga paragrafët 1 deri 3 të këtij neni kryhet nga anëtari i Komisionit Zgjedhor ose ndonjë person tjetër gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare në lidhje me votimin.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej tre deri në pesë vjet.

Në paragrafin 5 të këtij neni, është parashikuar se dhurata, përfitimi i pranuar apo i ofruar në kundërshtim me këtë nen konfiskohet.

Formën e rëndë të kësaj vepre penale, mund ta kryejë vetëm anëtari i Komisionit Zgjedhor ose ndonjë person tjetër gjatë ushtrimit të detyrave në lidhje me votimin, kurse format tjera të kësaj vepre penale mund ti kryejë çdo person.

8.keqpërdorimi i të drejtës së votimit (neni 213)

Sipas legjislacionit në fuqi, qytetari i Republikës së Kosovës, ka të drejtë që të votojë vetëm një herë gjatë zgjedhjeve. Gjithashtu, ai ka të drejtë që të votojë vetëm në emër të tij dhe ta shfrytëzojë vetëm një listë të votimit. Kështu, mosrespektimi i këtyre rregullave konsiderohet vepër penale sipas neni 213 të KPRK dhe emërtohet “Keqpërdorimi i të drejtës së votimit”. Sipas kësaj dispozite ligjore, këtë vepër penale e kryen kushdo që kryen një ose më shumë nga veprat në vijim :

1. Voton ose tenton të voton në emër të personit tjetër;
2. Voton ose tenton të voton edhe pse ka votuar një herë ose
3. Shfrytëzon më shumë se një listë votimi.

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë në rastet kur kryesi voton në emër të personit tjetër ose tenton që të votojë në emër të personit; voton edhe pse ka votuar më parë (voton për herë të dytë) ose tenton të voton edhe pse ka votuar një herë më parë, ose shfrytëzon më shumë se një listë votimi.

Kryerës i formës themelore të kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet.

Forma e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 neni 213 të KPRK, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur anëtari i Komisionit Zgjedhor i mundëson tjetrit të kryejë ose të tentojë të kryejë veprë penale nga paragrafi 1 i këtij neni.

Veprimet e kryerjes së kësaj forme të veprës penale konsistojnë në mundësimin nga ana e anëtarit të Komisionit Zgjedhor për të kryer formën themelore të kësaj vepre penale nga ana e personit tjetër.

Kryes i kësaj forme të veprës penale mund të jetë vetëm anëtari i Komisionit Zgjedhor.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej tre deri në pesë vjet.

9. Pengimi i procesit të votimit (neni 214)

Formën themelore të veprës penale pengimi i procesit të votimit, sipas paragrafit 1 të nenit 214 të KPRK, e kryen kushdo që në mënyrë të kundërligjshme pengon ose ndërprejnë procesin e votimit.

Veprimet e kësaj forme të veprës penale konsistojnë në ndërmarrjen e veprimeve të kundërligjshme me anë të të cilave pengohet ose ndërprehet procesi i votimit.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në dy vjet.

Forma e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur kryesi me përdorim të forcës apo kanosjes serioze, pengon votimin me nxitje të prishjes së rendit publik në qendrën e votimit, që rezulton me ndërprerje në procesin e votimit, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në tre vjet.

Kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

10. Cenimi i fshehtësisë së votimit (neni 215)

Në paragrafin 2 të nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është garantuar fshehtësia e votës. Ndërsa, duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, cenimi i fshehtësisë së votimit në KPRK, është parashikuar si vepër penale. Kështu, sipas paragrafit 1 të nenit 215 të KPRK, këtë vepër penale e kryen kushdo që në zgjedhje ose në referendum cenon fshehtësinë e votimit.

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale konsistojnë në cenimin e fshehtësisë së votimit në zgjedhje ose në referendum.

Për formën themelore të kësaj vepre penale të parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, është parashikuar dënimi me burgim deri në gjashtë muaj.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush me përdorimin e forcës, kanosjes serioze ose në ndonjë mënyrë tjetër të kundërligjshme kërkon nga personi të tregojë se si ka votuar.

Mjete të kryerjes së kësaj forme të veprës penale janë përdorimi i forcës, kanosjes serioze ose ndonjë mënyrë tjetër të kundërligjshme.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim deri në një vit.

Në paragrafin 3 të këtij neni, është parashikuar forma edhe më e rëndë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se ekziston nëse veprën penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni e kryen anëtari i Komisionit Zgjedhor ose ndonjë person tjetër në keqpërdorim të detyrave, pozitës apo autorizimeve të tij në zgjedhje ose në votim.

Për këtë formë të rëndë është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në pesë vjet.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, përveç formës më të rëndë të parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, të cilën mund ta kryejnë anëtari i Komisionit Zgjedhor ose personi tjetër në keqpërdorim të detyrave, pozitës apo autorizimeve të tij në zgjedhje ose në votim.

11. Falsifikimi i rezultateve të votimit (neni 216)

Sipas paragrafit 1 të nenit 216 të KPRK, formën themelore të veprës penale falsifikimi i rezultateve të votimit e kryen personi i cili shton, heq apo fshin votat apo nënshkrimet, regjistron në mënyrë të pasaktë votën apo rezultatet e zgjedhjeve në dokumentet zgjedhore ose publikon votën apo rezultatet e zgjedhjeve apo të votimit që nuk i përgjigjen votimit të vërtetë, ose në ndonjë mënyrë tjetër falsifikon votën apo rezultatet e zgjedhjeve.

Siç po shihet veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe kjo formë e kësaj vepre penale konsiderohet se kryhet nëse ndërmerret ndonjëri nga veprimet e cekura më lartë.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në tre vjet.

Forma e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se ekziston në rastet kur veprën penale nga paragrafi 1 të këtij neni e kryen anëtari i Komisionit Zgjedhor ose ndonjë person tjetër në keqpërdorim të detyrave, pozitës apo autorizimeve të tij lidhur me zgjedhjet.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej tre deri në pesë vjet.

Formën themelore të kësaj vepre penale mund ta kryejë çdo person, kurse formën e rëndë të kësaj vepre penale mund ta kryejë vetëm anëtari i Komisionit Zgjedhor ose ndonjë person tjetër në keqpërdorim të detyrave, pozitës apo autorizimeve të tij lidhur me zgjedhjet.

12. Asgjësimi i dokumenteve të votimit (neni 217)

Formën themelore të kësaj vepre penale, sipas paragrafit 1 të nenit 217 të KPRK, e kryen çdo person i cili i asgjëson, fsheh, dëmton apo e merr fletën e votimit ose ndonjë tjetër send apo dokument lidhur me zgjedhjet ose referendumin.

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë në asgjësimin, fshehjen, dëmtimin apo marrjen e fletëve të votimit ose të ndonjë sendi tjetër apo dokumenti lidhur me zgjedhjet ose referendumin.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në tre vjet dhe kryes i kësaj forme të veprës penale mund të jetë çdo person.

Forma e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të nenit 217 të KPRK. Kjo formë e rëndë e kësaj vepre penale konsiderohet se kryhet në rastet, kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga anëtari i Komisionit Zgjedhor ose ndonjë person tjetër në keqpërdorim të detyrave, pozitës apo autorizimeve të tij lidhur me zgjedhjet.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej tre deri në pesë vjet dhe kryes i kësaj forme të veprës penale mund të jetë anëtari i komisionit zgjedhor ose ndonjë person tjetër i cili e keqpërdor detyrën, pozitën apo autorizimet e tij lidhur me zgjedhjet.

KAPITULLI VII

VEPRAT PENALE KUNDËR TË DREJTAVE NË MARRËDHËNIET E PUNËS

I. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME

Objekt mbrojtës i veprave penale të këtij Kapitulli, janë të drejtat që rrjedhin apo burojnë nga marrëdhëniet e punës. Për shkak të rëndësisë së madhe që kanë, të drejtat që burojnë nga marrëdhëniet e punës janë të mbrojtura edhe me kushtetutat e shteteve bashkëkohore dhe me një numër të konsiderueshëm të akteve juridike ndërkombëtare (Karta Sociale Evropiane,³⁰⁶ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore,³⁰⁷ etj.). Kështu, me nenin 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është garantuar e drejta e punës, si dhe e drejta e secilit person që lirisht të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.

Të drejtat të cilat burojnë nga marrëdhëniet e punës bëjnë pjesë në radhën e të drejtave ekzistenciale të njeriut, ngase këto ua mundësojnë sigurimin e mjeteve për nevojat e tyre dhe njëherish dalin si parakusht për realizimin e numrit të madh të të drejtave dhe lirive të tjera (ekonomike, kulturore, sociale, etj.).³⁰⁸

Të gjitha veprat penale të këtij Kapitulli janë të karakterit blanket, sepse me dispozitat penalo-juridike të këtij Kapitulli, udhëzohet që lidhur me veprat penale konkrete të aplikohen dispozitat e ligjeve tjera, kontratës kolektive, akteve tjera të përgjithshme, rregullave teknike mbi masat e sigurisë në punë, etj.

Në këtë Kapitull nuk parashihen disa vepra penale të cilat parashihen me legjislacionet e shteteve të regjionit, siç është p.sh. vepra penale cenimi i të drejtës për grevë, etj.

Pasojë e veprave penale të këtij Kapitulli është mohimi apo kufizimi i ndonjë të drejte që burojnë nga marrëdhëniet e punës.

Kryerës i veprave penale të këtij Kapitulli është parashikuar se mund të jetë çdo person, mirëpo duke e marrë parasysh përmbajtjen dhe natyrën e veprave penale të këtij Kapitulli, kryerës të këtyre veprave penale zakonisht mund të jetë personi të cilit i janë besuar pozita menaxheriale apo pozita në të cilat ka mundësi që të vendosë lidhur me çështje të caktuara nga sfera e të drejtave në marrëdhëniet e punës.

Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës mund të kryhen vetëm me dashje.

³⁰⁶ Karta Sociale Evropiane, është nënshkruar nga shtetet anëtare të Këshllit të Evropës, në Torino, më 18.10.1961 dhe ka hyrë në fuqi më 26.02.1965.

³⁰⁷ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, është miratuar më 19.12.1966, nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe ka hyrë në fuqi më datën 03.01.1976.

³⁰⁸ SALIHU, ISMET, E drejta penale, Pjesa e posaçme, f. 261.

II. VEPRAT PENALE TË KËTIJ KAPITULLI

1. Cenimi i të drejtave nga marrëdhëniet e punës (neni 218)

Sipas nenit 218 të KPRK, këtë vepër penale e kryen kushdo që me vetëdije nuk e zbaton ligjin apo kontratën kolektive për punësimin apo ndërprerjen e marrëdhënies së punës; pagat apo të ardhurat e tjera; kohëzgjatjen e orarit të punës; punën jashtë orarit apo punën me ndërrime; pushimin apo mungesën nga puna; ose mbrojtjen e grave, fëmijëve apo personave me aftësi të kufizuara dhe kësisoj punëtorit ia mohon apo ia kufizon të drejtat që i takojnë. Këto të drejta nga marrëdhënia e punës janë të parashikuara me Ligjin e Punës në Kosovë³⁰⁹ dhe me disa akte tjera juridike.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në mosrespektimin me vetëdije të ligjit, kontratës kolektive apo akteve tjera të përgjithshme, të cilat i parashohin të drejtat e punëtorëve që rezultojnë nga marrëdhëniet e punës dhe të cilat parashohin mbrojtje të veçantë të grave, të fëmijëve dhe të personave me aftësi të kufizuara.

Vepra penale cenimi i të drejtave nga marrëdhëniet e punës është e karakterit blanket, ngase me të mbrohen të drejtat nga marrëdhënia e punës të cilat janë të përcaktuara në ligjin mbi punën, kontratën kolektive dhe në akte tjera të përgjithshme.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, mirëpo për nga natyra dhe përmbajtja e saj, këtë vepër penale mund ta kryejë vetëm ai person që ka ndonjë pozitë për të nxjerrë vendime me të cilat punëtorit ia mohon apo ia kufizon ndonjë të drejtë që i takon.

Pasoja e kësaj vepre penale konsiston në mohimin apo kufizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës të cilat i takojnë punëtorit.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me gjobë apo dënimi me burgim deri në një vit.

2. Cenimi i të drejtave të punësimit dhe papunësisë (neni 219)

Këtë vepër penale sipas paragrafit 1 të nenit 219 të KPRK, e kryen kushdo që ia mohon apo ia kufizon personave të tjerë të drejtën në punësim në kushte të njejta, ashtu siç është përcaktuar me ligj. Me këtë formë të kësaj vepre penale mbrohen të drejtat e personave që të punësohen nën kushte të njejta, siç është përcaktuar me ligj.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale shprehet në rastet kur në kushte të njejta të parapara me ligj, me akte të përgjithshme dhe sipas kriterëve të cekura në konkurs, punësohet personi i

³⁰⁹ Ligji Nr.03/L-212 i Punës i datës 01.11.2010.

cili nuk i plotëson kushtet e parapara, ndërsa refuzohet personi i cili i ka plotësuar këto kushte. Në praktikë kjo do të ndodhte p.sh. nëse personi A dhe personi B konkurojnë për një vend pune, ku me atë rast pranohet personi A, i cili nuk i ka plotësuar kushtet e parapara me ligj, kurse nuk pranohet personi B, i cili i ka plotësuar kushtet e parapara me ligj.

Në paragrafin 2 të këtij neni, është parashikuar forma e dytë e kësaj vepre penale, e cila i mbron të drejtat e personave të papunësuar. Sipas kësaj dispozite ligjore, këtë formë të kësaj vepre penale e kryen kushdo që nuk vepron në pajtim me legjislacionin mbi të drejtat e personave të papunësuar dhe me këtë ia mohon apo ia kufizon të drejtat që iu takojnë atyre. Pra, me këtë formë të kësaj vepre penale mbrohen të drejtat e personave të papunësuar.

Kjo veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, mirëpo për nga natyra dhe përmbajtja e saj, këtë veprë penale mund ta kryejë vetëm ai person i cili ushtron ndonjë pozitë, në të cilën ka mundësi që të vendos për çështjet e lartcekura.

Për këtë veprë penale, si për formën e parë ashtu edhe për formën e dytë është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

3. Cenimi i të drejtave nga sigurimi social (neni 223)

Kjo veprë penale sipas nenit 223 të KPRK, kryhet në rastet kur ndonjë person me vetëdije nuk e zbaton ligjin apo kontratën kolektive nga lëmi i sigurimit shëndetësor, pensional apo invalidor apo nga ndonjë formë tjetër e sigurimit social dhe me këtë ia mohon apo ia kufizon të drejtat që i takojnë punëtorit. Siç shihet, të drejtat nga sigurimi shëndetësor, pensional, invalidor apo nga ndonjë formë tjetër e sigurimit social, janë objekt i mbrojtjes së kësaj vepre penale. Në Kosovë, këto të drejta janë të parapara me disa ligje, por vlen të përmenden : Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti³¹⁰, Ligji për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë³¹¹, etj.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në mosrespektimin ose moszbatimin me vetëdijshëm të ligjit, të dispozitave të tjera apo të akteve të përgjithshme lidhur me sigurimin social.

Mosrespektimi ose moszbatimi me vetëdije i ligjit në sensin e kësaj vepre do të thotë se personi e di, pra është i vetëdijshëm se tjetrit ia mohon apo ia kufizon shfrytëzimin e të drejtave nga lëmi i sigurimit shëndetësor, pensional, invalidor dhe format e tjera të sigurimit social.

Pasoja e kësaj vepre penale konsiston në mohimin apo kufizimin e të drejtave të cilat i takojnë ndonjë personi nga fushat e cekura më lart.

Sipas kësaj dispozite ligjore kryerësi i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, mirëpo duke e marrë parasysh përmbajtjen dhe natyrën e kësaj vepre penale, kryerës i saj zakonisht mund

³¹⁰ Ligji Nr.04/L-131 Për Skemat Pensionale të Finacuara nga Shteti i datës 06.05.2014.

³¹¹ Ligji Nr.2003/15 Për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë i datës 18.08.2003.

të jetë personi i cili sipas detyrës apo pozitës të cilën e ushtron, ka mundësi që të vendosë lidhur me të drejtën e ndonjë personi në sferën e sigurimit shëndetësor, pensional, invalidor apo formave tjera të sigurimit social.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Për këtë vepër është paraparë dënimi me gjobë apo me burg deri në një vit.

4. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli

Në këtë Kapitull parashihen edhe këto vepra penale :

- Cenimi i të drejtës në menaxhim (neni 220),
- Cenimi i të drejtës në grevë (neni 221),
- Keqpërdorimi i të drejtës në grevë (neni 222) dhe
- Keqpërdorimi i të drejtave nga sigurimi social (neni 224).

KAPITULLI VIII

VEPRAT PENALE KUNDËR INTEGRITETIT SEKSUAL

I. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME

Në teorinë e së drejtës penale veprat penale të këtij Kapitulli emërtohen në mënyra të ndryshme, si vepra penale seksuale, krime seksuale, delikte seksuale, etj.

Objekt mbrojtës i këtij Kapitulli të veprave penale është integriteti seksual i personit. Integriteti seksual i personit në të kaluarën ka qenë objekt mbrojtës, jo vetëm me dispozita juridike penale, por edhe me normat e së drejtës zakonore dhe me norma të moralit.

Veprat penale seksuale apo krimet seksuale, tradicionalisht populli shqiptar i ka konsideruar krime tepër të rënda, të papajtueshme me konceptin e nderit, të moralit dhe të respektit ndaj gruas.³¹²

Mbrojtje e posaçme të integritetit seksual dhe të lirive të kësaj sfere në kuadër të këtij Kapitulli, u është kushtuar fëmijëve dhe personave të paaftë apo me aftësi të kufizuar, si dhe personave që gjenden në pozita vartëse apo në gjendje të vartësisë materiale, pozitë apo gjendje e cila keqpërdoret, abuzohet me qëllim të shfrytëzimit seksual.

Kryerës apo subjekt aktiv i shumicës së veprave penale të këtij Kapitulli, mund të jetë çdo person, si mashkulli, ashtu edhe femra.

Viktimë apo subjekt pasiv, i shumicës së veprave penale të këtij Kapitulli, mund të jetë çdo person, si mashkulli, ashtu edhe femra.

Veprat penale të këtij Kapitulli, për shkak të natyrës së tyre, mund të kryhen vetëm me dashje dhe me qëllime seksuale.

II. VEPRAT PENALE TË KËTIJ KAPITULLI

1. Dhunimi (neni 227)

Në KPRK parashihen disa forma të kryerjes së veprës penale të dhunimit. Konsiderohet se kryhet forma e parë apo themelore e kësaj vepre penale, sipas paragrafit 1 të nenit 227 të KPRK, në rastet kur ndonjë person e detyron personin tjetër për të kryer akt seksual pa pëlqimin e këtij të fundit. Kjo formë e parë e veprës penale të dhunimit, kryhet në situatat kur nuk përdoret dhuna apo kanosja, por akti seksual kryhet pa pëlqimin e viktimës, përkatësisht kundër vullnetit të viktimës.

³¹² ELEZI, ISMET, E drejta penale, Pjesa e posaçme, f. 93.

Pra, për ekzistimin e kësaj forme të veprës penale, duhet që akti seksual të kryhet pa pëlqimin e personit tjetër (viktimës). Lidhur me këtë, sipas paragrafit 1 të nenit 225 të KPRK, shprehja **“pëlqim”** do të thotë pajtim i vullnetshëm i personit i cili ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare për të kryer aktin seksual. Gjithashtu, pëlqim, në kuptim të këtyre veprave penale konsiderohet marrëveshja vullnetare e dy personave të cilët kanë arritur moshën katërmëdhjetë (14) vjet dhe ku dallimi në moshën e tyre nuk tejkalon dy (2) vjet, për të kryer aktin seksual në fjalë.³¹³

Sipas paragrafit 2 të këtij neni, nuk do të konsiderohet se ekziston pëlqimi nëse :

1. personi i tillë me fjalë ose me sjellje shpreh mungesë të pajtimit për të kryer aktin ose për ta vazhduar atë;
2. pajtimi është shprehur me fjalë ose me sjelljen e një personi tjetër dhe jo të viktimës;
3. pajtimi i viktimës është marrë me mashtrim, frikësim ose me kërcënim, nëse mënyrat e tilla nuk përfshijnë përdorimin e forcës, kanosjes serioze ose shfrytëzimin, siç është paraparë në nenin 227 paragrafi 3 të KPRK ose
4. personi i tillë është i paaftë për të dhënë pajtimin për aktivitet seksual për shkak të aftësisë së zvogëluar mendore apo fizike ose dehjes me alkool, drogë apo me substanca tjera.

Veprimi i kryerjes së formës së parë të kësaj vepre penale qëndron në detyrimin e personit tjetër për të kryer akt seksual pa pëlqimin e këtij të fundit. Sipas nenit 225 paragrafi 5 të KPRK, shprehja **“detyrim i personit tjetër në kryerjen e aktit seksual”** do të thotë :

- kryerjen e aktit seksual mbi personin tjetër nga kryesi;
- cytja e personit tjetër në kryerjen e aktit seksual me kryesin apo me personin e tretë ose
- cytja e personit të tretë për kryerjen e aktit seksual në personin tjetër.

Vepra penale konsiderohet se është kryer në momentin e kryerjes së aktit seksual me personin tjetër pa pëlqimin e këtij të fundit. Sipas nenit 225 paragrafi 4 të KPRK, shprehja **“akt seksual”** do të thotë :

- 1) penetrim³¹⁴ nënkupton penetrim sado i vogël i organit seksual ose i objektit për qëllime seksuale në cilëndo pjesë të trupit të personit;
- 2) penetrim sado i vogël në hapjen anale, orale apo gjenitale të personit me ndonjë send për qëllim seksual ose me cilëndo pjesë tjetër të trupit, ose me cilëndo pjesë të kafshës.

³¹³ Neni 225 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. të KPRK.

³¹⁴ Shprehja “penetrim” rrjedh nga fjala latine “*penetration*”, që në gjuhën shqipe do të thotë depërtim, futje brenda, përshkrim për qëllime të ndryshme, e në sensin e kësaj dispozite ligjore për qëllime seksuale. NDRECA, MIKEL, Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja, Prishtinë, 2000, faqe 540.

Sipas kësaj dispozite ligjore, kjo forma e dytë e aktit seksual konsiderohet se është kryer edhe në rastet kur kryesi e penetron ndonjë send apo cilëndo pjesë të trupit të tij (me përjashtim të organit seksual) në hapjen anale, orale apo gjenitale të personit tjetër. Gjithashtu, kjo formë e aktit seksual konsiderohet se është kryer edhe në rastet kur penetrimi është bërë me cilëndo pjesë të kafshës. Nëse kryesi e penetron organin seksual të tij në cilëndo pjesë të trupit të personit tjetër (gojë, veshë, etj.), atëherë ekziston forma e parë e aktit seksual.

Elementet e veprës penale të dhunimit

Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, vepra penale e dhunimit përbëhet nga këto elemente :

- 1) Detyrimin e personit tjetër për të kryer aktin seksual;
- 2) Kryerjen e aktit seksual dhe
- 3) Mungesën e pëlqimit të personit tjetër për të kryer aktin seksual.

Sipas kësaj dispozite ligjore, kryerës i kësaj vepre penale (subjekt aktiv) mund të jetë çdo person, si personi i gjinisë mashkullore, ashtu edhe personi i gjinisë femërore.

Gjithashtu, edhe subjekt pasiv i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person. Ndryshe nga legjislacioni penal i mëparshëm i cili është aplikuar në Kosovë deri me datën 6 prill të vitit 2004, sipas të cilit dhunimi ka mundur të kryhet vetëm ndaj femrës me të cilën kryesi nuk ka jetuar në bashkësi martesore, tani sipas KPRK, kjo vepër penale mund të kryhet edhe ndaj bashkëshortes (bashkëshortit), përkatësisht edhe ndaj femrës (mashkullit) me të cilin kryesi jeton në bashkësi martesore. Gjithashtu, ndryshe nga legjislacioni i mëparshëm sipas të cilit këtë vepër penale ka mundur ta kryejë vetëm mashkulli ndaj femrës, tani sipas KPRK kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë si mashkulli, ashtu edhe femra. Pra, sipas KPRK këtë vepër penale mund ta kryejë edhe mashkulli ndaj mashkullit, femra ndaj mashkullit, femra ndaj femrës dhe mashkulli ndaj femrës.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje dhe me qëllime seksuale. Sipas nenit 225 paragrafi 10 të KPRK, shprehja “**qëllim seksual**” nënkupton çdo veprim i bërë për qëllimet e kënaqësisë seksuale të një personi.

Për këtë formë të veprës penale është paraparë dënimi me burgim prej dy deri në dhjetë vjet.

Formë tjetër e kësaj vepre penale është e parashikuar në paragrafin 2 të nenit 227 të KPRK, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush e detyron personin tjetër për të kryer akt seksual duke e kanosur me zbulimin e një fakti që do të dëmtonte rëndë nderin ose reputacionin e personit të tillë apo të personit të lidhur ngushtë me personin e tillë.

Siç po shihet nga figura e kësaj vepre, kjo vepër penale është e ngjashme me veprën penale të dhunimit, nga paragrafi 1 të nenit të lartcekur. Dallimi ekziston në faktin se me rastin e kryerjes së kësaj vepre penale, akti seksual kryhet duke u kanosur se do të zbulojë ndonjë fakt i cili do të dëmtonte rëndë nderin apo autoritetin e viktimës apo të ndonjë të afërmi të ngushtë të tij.

Kanosja se do të zbulohet diç, e cila do të dëmtonte rëndë nderin dhe autoritetin e subjektit pasiv, mund t'i referohet nxjerrjes së fakteve të vërteta, por që për to nuk kanë njohuri personat tjerë apo një numër i caktuar i personave tjerë. Gjithashtu, kanosja mund t'i referohet edhe fakteve të pavërteta apo të trilluara.

Faktet, për të cilat kanoset kryesi se do t'i zbulojë mund t'i përkasin viktimës së kësaj vepre penale apo ndonjë personi në lidhje të ngushtë me viktimën. Persona në lidhje të ngushtë me viktimën, në sensin e kësaj vepre penale mund të konsiderohen prindërit e viktimës, motra, vëllau, bashkëshorti, fëmijët, etj.

Këto fakte mund të i referohen jetës personale (intime), familjare, përfundimit të studimeve, kryerjes së ndonjë vepre penale, etj. të viktimës apo personit në lidhje të ngushtë me viktimën.

Shembuj të kësaj forme të veprës penale

Kjo formë e kësaj vepre penale do të ekzistonte, nëse personi A e detyron personin B për të kryer akt seksual, duke ju kanosur se do ta njofton bashkëshortin e saj apo personat tjerë, se personi B ka kryer akt seksual me një person të tretë apo se bashkëshorti i saj nuk është baba i fëmijës së personit B, apo se personi B më parë ka ushtruar prostitucion, apo se personi B ka përfunduar studimet në mënyrë të kundërligjshme, apo se personi B apo ndonjë person në lidhje të ngushtë me të ka kryer ndonjë vepër penale, etj.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, si mashkulli, ashtu edhe femra. Gjithashtu, edhe viktimë e kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, si mashkulli, ashtu edhe femra. Për nga fajësia kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje dhe me qëllime seksuale.

Për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me burgim prej tre deri në dhjetë vjet.

Në paragrafin 2 të nenit 227 të KPRK, janë parashikuar format e rënda të dhunimit, të cilat konsiderohen se kryhen, kur ndokush e detyron personin tjetër për të kryer akt seksual:

- 1) me kanosje serioze ose me kanosje për përdorim të dhunës;
- 2) me kanosje të rrezikimit të atëçastshëm të jetës ose trupit të personit të tillë apo të personit tjetër; ose
- 3) duke shfrytëzuar situatën në të cilën personi është i pambrojtur dhe ku siguria e tij është në rrezik³¹⁵.

Veprimi i kryerjes së kësaj forme të veprës penale të paraparë në nën-paragrafin 1 të dispozitës së lartcekur ligjore, qëndron në kryerjen e aktit seksual me kanosje serioze ose me kanosje për përdorimin e dhunës me qëllim të kryerjes së aktit seksual.

³¹⁵ Si duket kjo dispozitë ligjore është akceptuar nga legjislacioni penal i Gjermanisë, ngase një dispozitë të tillë të formuluar në këtë mënyrë nuk kemi mundur që ta hasim në ndonjë legjislacion të shteteve të regjionit dhe me gjerë. Lidhur me këtë shih: WEIGEND, THOMAS, Strafgesetzbuch, Betäubungsmittelg und weitere Vorschriften, München, 2006, f. 93 dhe nenin 177 të Kodit Penal të Gjermanisë.

Veprimi i kryerjes së kësaj forme të veprës penale të paraparë në nën-paragrafin 2 të dispozitës së lartcekur ligjore, qëndron në kanosjen për rrezikimin e atqasshëm të jetës ose trupit të personit të tillë apo të personit tjetër.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin B.J., për shkak të kësaj forme të veprës penale të dhunimit, sepse i akuzuari duke ju kërcënuar për rrezikimin e atqasshëm të jetës ose trupit të dëmtuarës R.I., e detyron të dëmtuaren për të kryer akt seksual me të akuzuarin, pa pëlqimin e saj.³¹⁶

Kurse, forma tjetër e kësaj vepre penale e parashikuar në nën-paragrafin 3 të dispozitës së lartcekur, konsiston në kryerjen e veprës penale, duke shfrytëzuar një situatë në të cilën personi është i pambrojtur dhe siguria e tij është në rrezik.

Shembuj të kësaj forme të veprës penale

Kjo formë e kësaj vepre penale do të ekzistonte : kur viktimi gjendet në periferi të largët të qytetit, në mal, në bodrum, në ndonjë vend të largët dhe të errët, etj. në të cilat rrethana edhe thirrjet për ndihmë nuk do të kishin efekt, nuk do të dëgjoheshin nga askush.

Për këtë formë të veprës penale është paraparë dënimi me burgim prej pesë deri në dhjetë vjet.

Në paragrafin 4 të këtij neni, janë parashikuar format edhe më të rënda të veprës penale të dhunimit. Kështu, sipas këtij paragrafi, si forma të rënda të dhunimit konsiderohen nëse :

1. veprës i ka paraprirë, ajo është shoqëruar ose përcjellur nga tortura apo trajtimi çnjerëzor;

2. kryesi e përdor forcën;

3. kryesi shkakton lëndime të rënda trupore ose çrregullim të rëndë për shëndetin mendor apo fizik të personit;

4. kryesi përdor ose kanos se do të përdor armë apo mjet të rrezikshëm;

5. kryesi me dashje shkakton dehjen e personit me anë të alkoolit, drogës apo substancave tjera;

6. vepra është kryer bashkërisht nga më shumë se një person;

7. kryesi e di që personi është posaçërisht i ndjeshëm për shkak të moshës, aftësive të kufizuara mendore apo fizike, çrregullimit apo paaftësisë fizike apo mendore, ose shtatzënisë;

³¹⁶ Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr.380/2005, i datës 16.02.2006.

8. viktima është ndërmjet moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet;

9. kryesi është prindi, prindi adoptues, prindi birësues, njerku apo njerka, gjyshi ose gjyshja, daja apo axha, tezza apo halla, vëllai ose motra e personit ose kryesi është në marrëdhënie familjare me viktimën ;

10. kryesi është mësimdhënës, udhëheqës fetar, profesionist i kujdesit shëndetësor, person të cilit i është besuar rritja apo kujdesi për personin e tillë ose që në ndonjë mënyrë tjetër ka autoritet ndaj personit:

10.1. duke keqpërdorur kontrollin e tij mbi gjendjen financiare, familjare, shoqërore, shëndetësore, të punësimit, shkollimit, fetare ose rrethanave tjera të personit të tillë apo të personit të tretë;

10.2. kur viktima mbahet në burg, paraburgim, qendër disiplinore, në një institucion të edukimit apo institucion edukativo-korrektues, është pacient në spital, qendër të shëndetit mendor apo rehabilitimit, banor i shtëpisë së kujdesit apo strehimores, ose mbahet apo është i mbyllur në çfarëdo vendi tjetër me urdhër të gjykatës apo prokurorisë ose sipas ligjit; ose

10.3. duke keqpërdorur pozitën ose autoritetin e tij mbi viktimën dhe e cila i është besuar kryesit për rritjen, edukimin apo kujdesin.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, të akuzuarit M.E, G.M. dhe G.R., janë shpallur fajtor secili veç e veç, për shkak të kësaj forme të veprës penale të dhunimit, sepse të njejtit me datën 04.05.2004, e marrin me dhunë të dëmtuaren H.K. duke e futur në automjetin e tyre, të cilët e dërgojnë në malet e një fshati të Komunës së Prishtinës. Në veturë kanë qenë 5 persona të cilët me radhë e dhunojnë, prej tyre i pari G.R, të cilin e dëmtuara e ka njohur edhe më parë, meqë me të përpara ka kaluar, por marrëdhëniet i ka ndërprerë para disa muajve, për arsye se i akuzuari G.R. kishte qenë i arrestuar në Burgun e Prizrenit, prandaj edhe në rastin kritik i ka thënë të dëmtuarës se “kjo është hakmarrja e Prizrenit”, duke iu kërcënuar me thikë, e detyron që e dëmtuara të zhvishet dhe e dhunon e më pastaj me radhë e dhunojnë të akuzuarit M.E dhe G.M. dhe dy persona tjerë. Gjatë dhunimit i akuzuari M.E. e godet të dëmtuaren me disa shuplaka, e pas dy orëve me automjetin e tyre e kthejnë në Prishtinë.³¹⁷

Për këto forma të rënda të kësaj vepre penale sipas paragrafit 4 të këtij neni, është paraparë dënimi me burgim prej pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Ndërsa, konsiderohet se kryhet forma edhe më e rëndë e veprës penale të dhunimit, e parashikuar në paragrafin 5 të këtij neni, nëse kryerja e kësaj vepre penale rezulton me vdekjen e viktimës.

³¹⁷ Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr.393/2004, i datës 06.10.2004.

Për këtë formë veçanërisht të rëndë, është parashikuar dënimi me burgim prej së paku dhjetë vjet apo me burgim të përjetshëm.

Forma tjera të rënda të veprës penale të dhunimit janë parashikuar në paragrafët 6 deri 9 të KPRK, të cilat konsiderohet se ekzistojnë nëse veprat penale të larcekura janë kryer ndaj fëmijëve.

Kështu, në paragrafin 6 të nenit të lartcekur është parashikuar se nëse vepra penale nga paragrafët 1 ose 2 i këtij neni kryhet ndaj personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, atëherë kryesi i saj dënohet me burgim prej pesë deri në njëzetë vjet.

Kurse, në paragrafin 7 të nenit të lartcekur, është parashikuar formë tjetër e rëndë e kësaj vepre penale që kryhet ndaj fëmijëve. Kështu, në këtë dispozitë ligjore, është parashikuar si formë e rëndë e kësaj vepre penale nëse vepra nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet ndaj personit nën moshën katërmbëdhjetë vjet.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej së paku dhjetë vjet.

Në paragrafin 8 të nenit të lartcekur, është parashikuar formë edhe më e rëndë që mund të kryhet ndaj fëmijëve. Kështu, sipas kësaj dispozite ligjore, nëse vepra nga paragrafët 6 ose 7 i këtij neni kryhet nën një ose më shumë nga rrethanat e parapara në paragrafët 3 ose 4 të këtij neni, atëherë kryesi dënohet me burgim prej së paku pesëmbëdhjetë vjet.

Formë veçanërisht e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 9 të nenit të lartcekur. Sipas kësaj dispozite ligjore, nëse vepra nga paragrafët 6 ose 7 të këtij neni rezulton në vdekjen e viktimës, atëherë kryesi dënohet me burgim prej së paku njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.

Konsiderojmë se ligjdhënësi është dashur që ta parashikoj si formë të rëndë të kësaj vepre penale, edhe rastet kur kryerja e veprës penale të dhunimit ka sjell si pasojë vetëvrasjen e të dëmtuarit, siç parashihet me Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë³¹⁸.

2. Sulmi seksual (neni 229)

Sipas paragrafit 1 të nenit 229 të KPRK, këtë vepër penale e kryen kushdo që e prek personin tjetër me qëllim seksual ose e cyt personin e tillë të prekë kryesin ose personin e tretë me qëllim seksual pa pëlqimin e personit të tillë.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale është përcaktuar në mënyrë alternative dhe konsiston në prekjen e personit tjetër me qëllim seksual ose cytjen e personit të tillë që ta prekë kryesin ose personin e tretë me qëllim seksual pa pëlqimin e personit të tillë. Në paragrafin 7

³¹⁸ Neni 100 paragrafi 3, neni 101 paragrafi 3, neni 102 paragrafi 3, neni 102/a paragrafi 3 dhe neni 103 paragrafi 3 i KPRSH.

të nenit 225 të KPRK, është parashikuar se shprehja “**prekje**” do të thotë kontakt direkt ose indirekt, pa penetrim, midis trupit të personit me cilëndo pjesë të trupit të personit tjetër apo me ndonjë send. Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në prekjen e personit tjetër, ledhatimin, puthjen sipërfaqësore, përqafimin, fërkimin e ndonjë pjese të trupit me ndonjë pjesë të trupit të viktimës, etj.

Pra, siç shihet te vepra penale sulmi seksual, nga neni 229 të KPRK, mungon penetrimi (depërtimi, futja), që ishte karakteristikë e veprës penale të dhunimit, nga neni 227 të KPRK.

Elementet e kësaj forme të veprës penale

Duke u bazuar në nenin 229 paragrafi 1 të KPRK, forma themelore e veprës penale të sulmit seksual përbëhet nga këto elemente :

- Kushdo që e prek personin tjetër ose e cyt personin e tillë të prekë kryesin ose personin e tretë;
- Prekja duhet të bëhet me qëllim seksual;
- Prekja duhet të bëhet pa pëlqimin e personit të tillë (viktimës).

Formë tjetër e veprimit e kësaj vepre penale është edhe cytja apo shtytja e viktimës që ta prekë kryesin apo personin e tretë me qëllime seksuale dhe pa pëlqimin e viktimës.

Për t’u konsideruar se është kryer kjo vepër penale, duhet që veprimet e kryerjes të jenë ndërmarrë pa pëlqimin e viktimës, ndërsa domethënia e shprehjes pëlqim është paraqitur më parë.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, si mashkulli, ashtu edhe femra. Gjithashtu, edhe viktimë e kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, si mashkulli, ashtu edhe femra.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje. Për ekzistimin e kësaj vepre penale, duhet që veprimet e kryerjes të jenë ndërmarrë me qëllime seksuale.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Në paragrafin 2 të këtij neni, është parashikuar forma e rëndë e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndonjë person e prek personin tjetër me qëllim seksual ose e cyt personin tjetër që ta prekë kryesin apo personin e tretë me qëllim seksual :

1. me kanosje serioze ose me kanosje për përdorim të dhunës;
2. me kanosje të rrezikimit të atëçastshëm të jetës ose trupit të personit të tillë apo të personit tjetër; ose
3. duke shfrytëzuar situatën në të cilën personi i tillë është i pambrojtur dhe ku siguria e tij është në rrezik.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin A.A., për shkak këtë veprë penale, sepse më datën 20.01.2007, në një fshat të Komunës së Vitisë, në shtëpinë e personit B.B., e ka prekur për qëllime seksuale të dëmtuaren M.M., në atë mënyrë që derisa e dëmtuara ishte e shtrirë në shtrat në dhomën në të cilën banonte, në atë dhomë ka hyrë i akuzuari A.A. dhe e ka mbyllur me çelës derën nga ana e brendshme, pastaj është vërsulur te e dëmtuara, duke e përdorur dhunën (forcën) ka filluar që ta ledhatojë, ta puthë dhe ta prekë nëpër fytyrë, nëpër gjoks dhe nëpër pjesë të tjera të trupit, ku më pas edhe e ka kafshuar në qafë.³¹⁹

Për këtë formë të rëndë të kësaj veprë penale, nga paragrafi 2 i këtij neni, është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në shtatë vjet.

Në paragrafin 3 të nenit 229 të KPRK, janë parashikuar format edhe më të rënda të kësaj veprë penale, e cila konsiderohet se kryhet nëse :

1. veprës i ka paraprirë, ajo është shoqëruar ose përcjellur nga tortura apo trajtimi çnjerëzor;
2. kryesi e përdor forcën;
3. kryesi shkakton lëndime të rënda trupore ose çrregullim të rëndë për shëndetin mendor apo fizik të personit ose viktimës tenton të bëjë vetëvrasje pas veprës penale;
4. kryesi përdor ose kanos se do të përdor armë apo mjet të rrezikshëm;
5. kryesi me dashje shkakton dehjen e personit me anë të alkoolit, drogës apo substancave tjera;
6. vepra është kryer bashkërisht nga më shumë se një person;
7. kryesi e di që personi është posaçërisht i ndjeshëm për shkak të moshës, aftësive të kufizuara mendore apo fizike, çrregullimit fizik apo mendor, paaftësisë ose shtatzënisë;
8. viktimës është ndërmjet moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet;
9. kryesi është prindi, prindi adoptues, prindi birësues, njerku apo njerka, gjyshi ose gjyshja, daja apo axha, tezja apo halla, vëllai ose motra e personit ose kryesi është në marrëdhënie familjare me viktimën;
10. kryesi është mësimdhënës, udhëheqës fetar, profesionist i kujdesit shëndetësor, person të cilit i është besuar rritja apo kujdesi për personin e tillë ose që në ndonjë mënyrë tjetër ka autoritet ndaj personit;

³¹⁹ Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, P.nr.14/2007, i datës 23.03.2007.

10.1. duke keqpërdorur kontrollin e tij mbi gjendjen financiare, familjare, shoqërore, shëndetësore, të punësimit, shkollimit, fetare ose rrethanave tjera të personit të tillë apo të personit të tretë;

10.2. kur viktimë mbahet në burg, paraburgim, qendër disiplinore, në një institucion të edukimit apo institucion edukativo-korrektues, është pacient në spital, qendër të shëndetit mendor apo rehabilitimit, banor i shtëpisë së kujdesit apo strehimores, ose mbahet apo është i mbyllur në çfarëdo vendi tjetër me urdhër të gjykatës apo prokurorisë ose sipas ligjit; ose

10.3. duke keqpërdorur pozitën ose autoritetin e tij mbi viktimën dhe e cila i është besuar kryesisht për rritjen, edukimin apo kujdesin.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej tre deri në dhjetë vjet.

Një formë tjetër e rëndë e veprës penale sulmi seksual është parashikuar në paragrafin 4 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafët 1 ose 2 të këtij neni rezulton me vdekjen e viktimës, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim jo më pak se dhjetë vjet ose dënim me burgim të përjetshëm.

Në paragrafët 5 deri 8 të këtij neni, janë parashikuar edhe format tjera të rënda të kësaj vepre penale, të cilat kryhet ndaj personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, përkatësisht nën moshën katërmëdhjetë (14) vjet ose të njëjtat rezultojnë në vdekjen e viktimës, për të cilat janë parashikuar dënime tejet të rënda, madje edhe dënim me burgim të përjetshëm.

3. Degradimi i integritetit seksual (neni 230)

Këtë vepër penale, sipas nenit 230 paragrafi 1 të KPRK, e kryen kushdo që e caktuar personin tjetër t'i ekspozojë pjesët intime të trupit të personit të tillë, të masturbojë ose të kryejë një akt tjetër seksual që e degradon integritetin seksual të personit të tillë pa pëlqimin e tij.

Veprime të kryerjes së kësaj vepre penale janë caktuar apo shtytja e personit tjetër që t'i ekspozojë pjesët intime të trupit të personit të tillë, të masturbojë ose të kryejë një akt tjetër seksual që e degradon integritetin seksual të personit të tillë.³²⁰

Sipas nenit 225 paragrafi 6 të KPRK, shprehja “pjesë intime” nënkupton gjinjtë e një femre, penisi, vagina dhe/apo anusi.

Të gjitha këto veprime duhet të ndërmerren pa pëlqimin e viktimës.

³²⁰ Kjo vepër penale në një mënyrë ka ngjashmëri me kundërvajtjen e cila emërtohet “*Sjelljet e pahijshme seksuale*”, që parashihet në nenin 6 të Ligjit Nr.03/L-142 Për Rendin dhe Qetësinë Publike, i datës 17.09.2009. Sipas kësaj dispozite ligjore kushdo që në vend publik kryen ndonjë akt seksual, ose ekspozon ndonjë pjesë intime të trupit apo bën ndonjë sjellje të pahijshme seksuale që shkakton shqetësim te qytetarët dënohet për kundërvajtje.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim prej tre mujave deri në një vit.

Në paragrafin 2 të këtij neni, është parashikuar formë e rëndë e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush e cyt personin tjetër t'i ekspozojë pjesët intime të trupit të personit të tillë, të masturbojë ose të kryejë një akt tjetër që e degradon integritetin seksual të personit:

1. me kanosje serioze ose me kanosje për përdorim të dhunës;
2. me kanosje të rrezikimit të atëçastshëm të jetës ose trupit të personit të tillë apo të personit tjetër; ose
3. duke shfrytëzuar situatën në të cilën personi është i pambrojtur dhe ku siguria e tij është në rrezik.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në tri vjet.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin J.K., për shkak të veprës penale degradimi i integritetit seksual, sepse i akuzuari më datën 24.06.2005, në shtëpinë e tij në Gjilan, duke ju kërcënuar për rrezikimin e jetës të dëmtuares S.L., e ka detyruar që të zhveshë pjesën e sipërme të trupit (gjoksit), pa pëlqimin e saj, duke e cytur që të ekspozojë këtë pjesë intime të trupit para të akuzuarit.³²¹

Formë tjetër edhe më e rëndë është parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, e cila konsiderohet se ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet në një ose më shumë rrethana të mëposhtme :

1. veprës i ka paraprirë, ajo është shoqëruar ose përcjellur nga tortura apo trajtimi çnjerëzor;
2. kryesi e përdor forcën;
3. kryesi shkakton lëndime të rënda trupore ose çrregullim të rëndë për shëndetin mendor apo fizik të personit ose viktima tenton të bëjë vetëvrasje pas veprës penale;
4. kryesi përdor ose kanos se do të përdor armë apo mjet të rrezikshëm;

³²¹ Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Gjilan, P.nr.758/2005, i datës 13.10.2008.

5. kryesi me dashje shkakton dehjen e personit me anë të alkoolit, drogës apo substancave tjera;

6. vepra është kryer bashkërisht nga më shumë se një person;

7. kryesi e di që personi është posaçërisht i ndjeshëm për shkak të moshës, çrregullimit apo paaftësisë fizike apo mendore, ose shtatzënisë;

8. viktima është ndërmjet moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet;

9. kryesi është prindi, prindi adoptues, prindi birësues, njerku apo njerka, gjyshi ose gjyshja, daja apo axha, tezza apo halla, vëllai ose motra e personit ose kryesi është në marrëdhënie familjare me viktimën;

10. kryesi është mësimdhënës, udhëheqës fetar, profesionist i kujdesit shëndetësor, person të cilit i është besuar rritja apo kujdesi për personin e tillë ose që në ndonjë mënyrë tjetër ka autoritet ndaj personit:

10.1. duke keqpërdorur kontrollin e tij mbi gjendjen financiare, familjare, shoqërore, shëndetësore, të punësimit, shkollimit, fetare ose rrethanave tjera të personit të tillë apo të personit të tretë;

10.2. kur viktima mbahet në burg, paraburgim, qendër disiplinore, në një institucion të edukimit apo institucion edukativo-korrektues, është pacient në spital, qendër të shëndetit mendor apo rehabilitimit, banor i shtëpisë së kujdesit apo strehimores, ose mbahet apo është i mbyllur në çfarëdo vendi tjetër me urdhër të gjykatës apo prokurorisë ose sipas ligjit; ose

10.3. duke keqpërdorur pozitën ose autoritetin e tij mbi viktimën dhe e cila i është besuar kryesit për rritjen, edukimin apo kujdesin

Për këtë formë edhe më të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Në paragrafët 4 deri 7 të këtij neni, janë parashikuar edhe format tjera të rënda të kësaj vepre penale, të cilat kryhet ndaj personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, përkatësisht nën moshën katërmëdhjetë (14) vjet ose të njejtat rezultojnë në vdekjen e viktimës, për të cilat janë parashikuar dënime tejet të rënda, madje edhe dënim me burgim të përjetshëm.

Sipas paragrafit 8 të nenit të lartcekur, tentativa për të kryer veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni është e dënueshme.

4. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli

Përveç këtyre veprave penale të lartcekura, në Kapitullin e veprave penale kundër integritetit seksual, janë paraparë edhe këto vepra penale:

- Shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit (neni 228),

- Ofrimi i materialit pornografik personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet (neni 231),

- Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi (neni 232),

- Nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës (neni 233),

- Mundësimi ose detyrimi në prostitucion (neni 234),

- Ofrimi i lokeleve për prostitucion (neni 235) dhe

- Marrëdhëniet seksuale brenda familjes (neni 236).

KAPITULLI IX

VEPRAT PENALE KUNDËR MARTESËS DHE FAMILJES

I. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME

Martesa dhe familja, kanë rëndësi shumë të madhe në një shoqëri. Për këtë shkak, martesa dhe familja janë të mbrojtura edhe me kushtetutat dhe ligjet e shteteve bashkëkohore. Edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, martesa dhe familja janë të garantuara dhe gëzojnë një mbrojtje të veçantë. Me Ligjin mbi Familjen të Kosovës³²² janë rregulluar në mënyrë specifike martesa dhe raportet juridike në martesë, bashkësia jashtëmartesore dhe familja.

Martesa, familja dhe fëmijët janë një ndër vlerat më të rëndësishme të shoqërisë. Martesa dhe familja janë bazë e çdo shoqërie. Në nenin 2 të LFK, thuhet shprehimisht se familja është bërthamë natyrore dhe themelore e shoqërisë dhe si e tillë gëzon të drejtën në mbrojtje. Familja është bashkësi vitale e prindërve dhe fëmijëve të tyre, si dhe personave tjerë në gjini. Në nenin 14 të LFK, është parashikuar se martesa është bashkësi e regjistruar ligjërisht në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes. Sipas kësaj dispozite ligjore, mashkulli dhe femra kanë të drejtë të lidhin martesë dhe të formojnë familje pa ndonjë kufizim në bazë të racës, kombësisë apo religjionit, si dhe janë të barabartë gjatë lidhjes së martesës, vazhdimit të martesës dhe zgjidhjes së saj.

Përveç këtyre, martesa dhe familja janë të mbrojtura edhe me të drejtën penale. Kështu, në KPRK është hartuar një kapitull i veçantë në të cilën janë paraparë si vepra penale të posaçme rastet e cenimit të vlerave të kësaj sfare shumë të rëndësishme për çdo person dhe për tërë shoqërinë. Duhet theksuar se martesa dhe familja mbrohen edhe me disa vepra penale të cilat janë të sistemuara edhe nëpër disa kapituj tjerë të KPRK, siç janë disa vepra penale kundër integritetit seksual, etj.

Për nga natyra, shumicën e veprave penale të këtij kapitulli mund t'i kryejnë personat e caktuar, personat me veti të caktuara apo në raport të caktuar me viktimën. Pra, shumica e veprave penale të këtij kapitulli janë të ashtuquajtura *delicta propria*.

Figurat e veprave penale të këtij kapitulli janë të përcaktuara me terma dhe shprehje të së drejtës familjare. Andaj, nocioni i këtyre termave dhe shprehjeve duhet të interpretohet sipas kuptimit që kanë në të drejtën familjare, përkatësisht në LFK.

Objekt mbrojtës i këtij Kapitulli të veprave penale është martesa, familja dhe fëmijët. Duke e marrë për bazë këtë, mendojmë se emërtimi i këtij Kapitulli, do të duhej të ishte “Veprat penale

³²² Ligji mbi Familjen i Kosovës, nr.2004/32, i datës 20.01.2006 (në tekstin e mëtejshëm LFK).

kundër martesës, familjes dhe fëmijëve”, siç kanë vepruar shumica e legjislacioneve penale të shteteve të regjionit (Shqipëria, Kroacia, Sllovenia, Maqedonia, Bullgaria, etj.).

Sipas objektit mbrojtës në aspektin juridiko-penal, parimisht të gjitha veprat penale të këtij kapitulli, mund të ndahen në tri grupe :

- në vepra penale kundër martesës,
- në vepra penale kundër familjes dhe
- në vepra penale kundër fëmijëve.

Në grupin e veprave penale kundër martesës bëjnë pjesë : bigamia (neni 237), mundësimi i lidhjes së martesës së kundërligjshme (neni 238) dhe martesa e detyruar (neni 239). Në grupin e veprave penale kundër familjes, në parim janë të sistemuara: ndryshimi i statusit familjar të fëmijës (neni 241), shkelja e detyrimeve familjare (neni 244), shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës (neni 245) dhe dhuna në familje (neni 248). Ndërsa, në grupin e veprave penale kundër fëmijëve bëjnë pjesë: bashkësia jashtëmartesore me personin nën moshën gjashtëmbëshjetë vjetë (neni 240), marrja apo mbajtja e kundërligjshme e fëmijës (neni 242), keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës (neni 243), pengimi dhe mosekzekutimi i masave për mbrojtjen e fëmijëve (neni 246) dhe mos raportimi i abuzimit të fëmijëve (neni 247).

II. VEPRAT PENALE TË KËTIJ KAPITULLI

1. Bigamia (neni 205)

Sipas paragrafit 1 të nenin 237 të KPRK këtë vepër penale e kryen kushdo që lidh martesë tjetër derisa është i martuar.

Kryerës i veprës penale të bigamisë mund të jetë personi femër ose mashkull, i cili lidh martesë tjetër, edhe pse gjendet në martesë. Nëse mashkulli dhe femra gjenden në martesë dhe me gjithë këtë lidhin martesë të re, në këto raste paraqiten si bashkëkryerës.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në lidhjen e martesës tjetër me një person, derisa kryerësi është i martuar edhe me një person tjetër.

Çështja e nocionit të martesës dhe kushtet që duhet të plotësohen për lidhjen e martesës janë të përcaktuara me LFK.

Për nga forma e fajësisë, kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje. Konsiderohet se vepra penale është kryer me dashje në rastet kur kryerësi është i vetëdijshëm, e di se gjendet në martesë dhe me gjithë këtë lidh martesë tjetër.

Për këtë formë të veprës penale është paraparë dënimi me burgim deri në një vit.

Në paragrafin 2 të nenit 237 të KPRK, është paraparë forma e dytë e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se ekziston nëse një person që nuk është i martuar lidh martesë me personin tjetër për të cilin e di se është i martuar, përkatësisht për të cilin e di se gjendet në martesë.

Edhe kjo formë e veprës penale mund të kryhet vetëm me dashje. Dënimi i paraparë edhe për formën e dytë është deri në një vit burgim.

Në paragrafin 3 të këtij neni, është paraparë mundësia e përjashtimit të kësaj vepre penale e cila shprehet në rastet kur pas kryerjes së veprës penale nga ky nen martesë e mëparshme nuk është më e vlefshme, është prishur ose është ndërprerë. Në këto raste, ndjekja për veprën nga ky nen nuk fillohet e nëse ndjekja është filluar ajo duhet të ndërpritet.

2. Mundësimi i lidhjes së martesës së kundërligjshme (neni 239)

Martesa konsiderohet e vlefshme vetëm nëse është lidhur para organit kompetent të komunës nga personi zyrtar i autorizuar. Personi zyrtar është i autorizuar që të mundësojë lidhjen e martesës vetëm nëse janë përmbushur kushtet e kërkuara me ligj. Kushtet dhe procedura për lidhjen e martesës, janë të përcaktuara me nenet 16 - 38 të LFK.

Sipas nenit 239 të KPRK, këtë vepër penale konsiderohet se e kryen personi i autorizuar zyrtar para të cilit lidhet martesë, cili në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij lejon lidhjen e martesës, ndonëse është në dijeni për pengesat ligjore të cilat e ndalojnë martesën.

Duke marr parasysh natyrën e dispozitës së këtij neni, kjo vepër penale është e karakterit blanket.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë vetëm personi zyrtar, përkatësisht personi i autorizuar para të cilit lidhet martesë.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me burgim prej tre muajve deri në tre vjet.

3. Martesa e detyruar (neni 239)

Sipas LFK, kusht themelor për lidhjen e martesës së ligjshme është që dy persona të gjinive të ndryshme të vendosin në mënyrë të lirë që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes.

Sipas nenit 239 të KPRK, kjo vepër penale mund të kryhet si ndaj mashkullit ashtu edhe ndaj femrës.

Në nenin 239 të KPRK, është parashikuar se këtë vepër penale e kryen kushdo që e detyron personin tjetër të lidh martesë ose lidh martesë me personin për të cilin e di se është detyruar të hyj në martesë.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person. Por këtë vepër penale praktikisht e kryen personi që dëshiron të lidh martesë me personin që e detyron. Lidhur me këtë duhet theksuar se si kryerës të kësaj vepre penale mund të jenë edhe personat tjerë, si p.sh. prindërit, vëllau, motra apo ndonjë person tjetër.

Kjo formë e kësaj vepre penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim ëprej një deri në tetë.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur detyrohet fëmija që të lidhë martesë. Rrethanë kualifikuese e kësaj forme të rëndë është moshë e subjektit pasiv. Fëmijë konsiderohet personi nën moshën tetëmbëdhjetëvjeçare. Kjo rrethanë duhet të jetë e ditur për kryerësin e veprës penale. Në të kundërtën, nëse kryerësi nuk e ka ditur se personi tjetër është fëmijë, atëherë do të përgjigjet për formën themelore të kësaj vepre penale e cila është e parashikuar në paragrafin 1 të nenit 239 të KPRK.

Edhe këtë formë të kësaj vepre penale mund ta kryejë çdo person dhe vetëm me dashje.

Për formën e rëndë (të kualifikuar) të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej dy deri në dhjetë vjet.

Gjithashtu, edhe në katër paragrafët vijues janë parashikuar format tjera të rënda të kësaj vepre penale.

Kështu, sipas paragrafit 3 të këtij neni, kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga prindi, prindi adoptues, kujdestari apo ndonjë person tjetër që ushtron autoritet prindëror ndaj personit në mes të moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet, kryesi dënohet me burgim prej tre deri në dhjetë vjet.

Në paragrafin 4 të këtij neni, është parashikuar se nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga prindi, prindi adoptues, kujdestari apo ndonjë person tjetër që ushtron autoritet prindëror ndaj personit në mes të moshës katërmëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë vjet, kryesi dënohet me burgim prej pesë deri në dhjetë vjet.

Ndërsa, në paragrafin 5 të këtij neni është parashikuar se nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga prindi, prindi adoptues, kujdestari apo personi tjetër që ushtron autoritet prindëror ndaj personit nën moshën katërmëdhjetë vjet, kryesi dënohet me burgim së paku pesëmbëdhjetë vjet.

Kurse, kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim së paku pesë vjet, ndërsa kur vepra penale

nga paragrafi 2, 3, 4 ose 5 i këtij neni kryhet me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim së paku pesëmbëdhjetë vjet.³²³

4. Bashkësia jashtëmartesore me personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet (neni 240)

Qëllimi i këtij inkriminimi është mbrojtja e të miturve nën moshën gjashtëmbëdhjetëvjeçare. Kjo nga fakti se jeta në bashkësinë martesore presupozon pjekuri të duhur biopsikike dhe sociale. Shkalla e duhur e pjekurisë biopsikike dhe sociale nuk ekziston tek personat e mitur. Për këtë arsye bashkëjetesa jashtëmartesore e të miturit zakonisht shkakton pasoja të dëmshme në personalitetin e të miturit dhe në zhvillimin e tij.

Sipas paragrafit 1 të nenit 240 të KPRK, këtë veprë penale e kryen personi madhor i cili bashkëjeton në një bashkësi jashtëmartesore me personin në mes të moshës katërmëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë vjet .

Nga kjo shihet se kryerës i kësaj veprë penale mund që të jetë vetëm personi madhor i cili bashkëjeton në një bashkësi jashtëmartesore me personin në mes të moshës katërmëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë vjet. Sipas nenit 39 paragrafi 1 të LFK, bashkësia jashtëmartesore (bashkësia faktike) konsiderohet marrëdhënia faktike midis burrit dhe gruas që jetojnë në çifte, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie.

Bashkësia jashtëmartesore në kuptimin e këtij inkriminimi duhet të jetë sajuar me pëlqimin e personit të mitur.

Veprimi i kryerjes së kësaj veprë penale është të jetuarit në bashkësi jashtëmartesore me personin e mitur të rritur, përkatësisht me personin në mes të moshës katërmëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë vjet.

Subjekt pasiv, viktimë e kësaj veprë penale është personi i mitur midis moshës katërmëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë vjet.

Kjo veprë penale mund të kryhet me dashje. Konsiderohet me dashje në rastet kur personi madhor e di, është i vetëdijshëm se jeton në bashkësi jashtëmartesore me personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet. Në të kundërtën, nëse kryerësi i kësaj veprë penale është në lajthim lidhur me moshën e subjektit pasiv, përkatësisht mendon gabimisht se subjekti pasiv është mbi moshën gjashtëmbëdhjetë vjet, pra gjendet në lajthim real, në këto raste do të përjashtohet përgjegjësia penale dhe personi i këtillë nuk do të dënohet.

Për këtë formë të kësaj veprë penale është parashikuar dënimi me burgim prej pesë deri në njëzetë vjet.

Forma e dytë e kësaj veprë penale është parashikuar në paragrafin 2 të nenit 240 të KPRK, e cila konsiderohet se kryhet nëse prindi, prindi adoptues, kujdestari apo ndonjë person tjetër që

³²³ Neni 239 paragrafi 6 të KPRK.

ushtron autoritet prindor, e lejon ose e shtyn personin në mes të moshës katërbëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë vjet të bashkëjetojë në një bashkësi jashtëmartesore me personin tjetër.

Veprimi i kryerjes së kësaj forme të veprës penale është caktuar në mënyrë alternative dhe konsiston në lejimin apo cytjen (shtytjen, nxitjen) e personit të mitur të rritur që të bashkëjetojë në bashkësi jashtëmartesore me personin tjetër.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin J.R., për shkak të kësaj vepre penale, sepse i akuzuari më datën 08.10.2006, në Gjilan, duke e ushtruar autoritetin prindor e lejon të dëmtuarën, vajzën e tij A.R. që të jetojë në një bashkësi jashtëmartesore me personin madhor B.R., duke e dërguar të dëmtuaren A.R. në shtëpinë e B.R., edhe pse e ka ditur se e dëmtuara është nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet.³²⁴

Subjekt pasiv, viktimë e kësaj vepre penale është personi i mitur midis moshës katërbëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë vjet.

Kryerës i formës së dytë të kësaj vepre penale mund të jetë vetëm prindi, prindi adoptues, kujdestari apo personi tjetër që ushtron autoritet prindor.

Edhe forma e dytë e kësaj vepre penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Si për formën e parë, ashtu edhe për këtë formë të veprës penale është paraparë dënimi me burgim prej pesë deri në njëzet vjet.

Në paragrafin 3 të nenit 240 të KPRK, është parashikuar formë e rëndë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur vepra penale e paraparë në paragrafët 1 ose 2 kryhet ndaj personit nën moshën katërbëdhjetë vjet. Kryerësi duhet të jetë i vetëdijshëm për moshën e subjektit pasiv të kësaj vepre penale përkatësisht të viktimës.

Për këtë formë të rëndë është parashikuar dënimi me burgim prej së paku dhjetë vjet.

Në paragrafin 4 të këtij neni është parashikuar formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale dhe konsiderohet se kryhet në rastet kur vepra penale nga paragrafi 2 ose 3 i këtij neni kryhet me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim prej së paku pesëmbëdhjetë vjet.

5. Shkelja e detyrimeve familjare (neni 244)

³²⁴ Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Gjilan, P.nr.798/2006, i datës 13.12.2006.

Sipas paragrafit 1 të nenit 244 të KPRK, këtë vepër penale e kryen kushdo që shkel detyrimet e tij ligjore familjare, duke lënë në gjendje të rëndë anëtarin e familjes i cili nuk është në gjendje të kujdeset për vetën e tij .

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në shkeljen e detyrimeve ligjore familjare, me ç'rast lihet në gjendje të rëndë anëtarin e familjes, i cili nuk është në gjendje të kujdeset për veten. Prandaj, nuk konsiderohet si vepër penale çdo shkelje e detyrimeve familjare, por vetëm shkeljet e vrazhda të detyrimeve familjare. Si raste të kryerjes së kësaj vepre penale konsiderohen : nëse fëmija madhor nuk kujdeset për prindërit e tij të moshuar apo të sëmurë duke mos u siguruar barna, duke mos i dërguar te mjeku edhe pse ka mundësi, etj.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë vetëm anëtarin e familjes.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Për formën themelore të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej tre muaj deri në tri vjet.

Në paragrafin 2 të këtij neni, është parashikuar forma e rëndë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni ka të bëjë me fëmijën, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet. Si raste të kryerjes së kësaj vepre penale konsiderohen: nëse prindi e largon (përzënë) fëmijën e tij në kohë dimri; nëse prindi nuk e dërgon tek mjeku fëmijën e tij të sëmurë, etj.

Në paragrafin 3 të këtij neni është parashikuar formë edhe më rëndë e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me vdekjen e anëtarit të familjes apo me dëmtimin e rëndë të shëndetit të tij, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në tetë vjet.

Sipas paragrafit 4 të nenit 244 të KPRK, nëse gjykata shqipton dënimin me kusht ajo mund të urdhërojë si kusht që kryerësi rregullisht të paguajë dhe rregullisht të përmbush detyrimet e tij të kujdesit, arsimimit dhe mjeteve të jetesës.

6. Shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës (neni 245)

Vepra penale shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës, nga neni 245 i KPRK, konsiderohet vepër penale speciale në raport me veprën penale shkelja e detyrimeve familjare, nga neni 244 i KPRK.

Veprën penale shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës, sipas paragrafit 1 të nenit 245 të KPRK, e kryen kushdo që i shmanget sigurimit të mjeteve të jetesës për personin për të cilin është i detyruar të kujdeset në bazë të vendimit të plotfuqishëm të gjykatës, marrëveshjes së plotfuqishme gjyqësore ose vendimit të organit tjetër kompetent, me anë të shmangies së punësimit, raportimit të rrejtshëm të punësimit apo të të ardhurave, ndërrimit të vendit të punës,

ndërrimit të vendbanimit apo vendqëndrimit, tjetërsimit të pasurisë ose në ndonjë mënyrë tjetër i shmanget sigurimit të mjeteve të jetesës për personin e tillë.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në shmangien e sigurimit të mjeteve për jetesë.

Obligimi i kryerësit për sigurimin e mjeteve për jetesë mund të rrjedhë nga vendimi i formës së prerë i gjykatës, nga marrëveshja e arritur para gjykatës ose nga vendimi i një organi tjetër kompetent.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin B.A., për shkak të kësaj vepre penale, sepse i akuzuari B.A. nuk e ka zbatuar aktvendimin e kësaj gjykate C.nr.319/2006, të datës 06.12.2006, në atë mënyrë që i është shmangur pagesës së mjeteve për jetesë për të dëmtuaren D.A. dhe fëmijën e saj L.A.³²⁵

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë vetëm personi i cili në bazë të vendimit të gjykatës që ka hyrë në fuqi, marrëveshjes së arritur para gjykatës që ka hyrë në fuqi ose vendimit të një organi tjetër kompetent, është obliguar që personit tjetër t'ia sigurojë mjetet për jetesë.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me burgim deri në një vit.

Në paragrafin 2 të këtij neni është parashikuar forma e rëndë e kësaj vepre penale e cila kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me vdekjen e anëtarit të familjes apo me dëmtim të rëndë të shëndetit, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në tetë vjet.

Formë tjetër e rëndë është parashikuar edhe në paragrafin 3 të këtij neni, e cila kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni ka të bëjë me fëmijën, për të cilën është parashikuar dënimi me buergim prej tre muaj deri në tre vjet.

Sipas paragrafit 4 të këtij neni, nëse gjykata e shqipton dënimin me kusht ajo mund të urdhërojë si kusht që kryesi rregullisht t'i përmbush detyrimet e tij të sigurimit të mjeteve të jetesës dhe të paguajë detyrimet e papaguara.

Në paragrafin 5 të nenit 245 të KPRK, është parashikuar mundësia fakultative e lirimit nga dënimi, nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 1 i këtij neni i ka përmbushur detyrimet e veta para shqiptimit të aktgjykimit.

7. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli

³²⁵ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, P.nr.35/2007, i datës 16.02.2007.

Në Kapitullin e veprave penale kundër martesës dhe familjes, janë parashikuar edhe këto vepra penale :

- Ndryshimi i statusit familjar të fëmijës (neni 241),
- Marrja apo mbajtja e kundërligjshme e fëmijës (neni 242),
- Keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës (neni 243),
- Pengimi dhe mosekzekutimi i masave për mbrojtjen e fëmijëve (neni 246),
- Mos raportimi i abuzimit të fëmijëve (neni 247) dhe
- Dhuna në familje (neni 248).

KAPITULLI X

VEPRAT PENALE KUNDËR SHËNDETIT PUBLIK

I. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME

Në botën bashkëkohore, mbrojtjes së shëndetit publik i kushtohet një rëndësi e madhe dhe me dispozita ligjore pozitive të shteteve përcaktohen si vepra penale një mori veprimesh me të cilat rrezikohet shëndeti dhe jeta e qytetarëve.

Veprat penale kundër shëndetit publik e rrezikojnë shëndetin e personave veç e veç, por në raste të caktuara e rrezikojnë shëndetin e shumë personave, madje edhe tërë popullsinë e një shteti. Përveç, shëndetit të qytetarëve me Kapitullin e veprave penale kundër shëndetit publik, mbrohet edhe shëndeti dhe jeta e kafshëve.

Veprat penale kundër shëndetit publik janë të sistemuara në Kapitullin XXII të KPRK, prej nenit 249 deri në nenin 266 dhe këto vepra penale kryesisht kryhen në rastet e cenimit të legjislacionit, të dispozitave nga fusha e mjekësisë, farmacisë dhe mjedisit. Andaj, shumica e këtyre veprave penale të këtij Kapitulli janë të karakterit blanket.

Pasojë e shumicës së veprave penale kundër shëndetit publik është rrezikimi i shëndetit të njerëzve.

Kryerës i shumicës së veprave penale të këtij Kapitulli mund të jetë çdo person (*delicta communia*). Mirëpo, disa vepra penale të këtij Kapitulli mund t'i kryejnë vetëm personat që posedojnë veti të caktuara (*delicta propria*), si p.sh. veprën penale mosdhënia e ndihmës mjekësore, nga neni 255 të KPRK, mund ta kryejë vetëm “mjeku ose punonjësi tjetër shëndetësor”; veprën penale përgatitja dhe dhënia e pandërgjegjshme e barërave, nga neni 258 të KPRK, mund ta kryejë vetëm “farmacisti apo personi tjetër që është i autorizuar të përgatisë apo shpërndajë barna”; veprën penale kontrollimi i pandërgjegjshëm i produkteve shtazore të destinuar për konsumim, nga neni 262 të KPRK, mund ta kryejë vetëm “veterinari ose personi tjetër i autorizuar i veterinarisë”, etj.

Sa i përket formës së fajësisë, shumica e veprave penale të këtij Kapitulli mund të kryhen me dashje dhe nga pakujdesia. Mirëpo, disa vepra penale të këtij Kapitulli, mund të kryhen vetëm me dashje, p.sh. mosveprimi sipas dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë, nga neni 250 i KPRK, etj.

Te disa vepra penale të këtij Kapitulli është paraparë marrja e detyrueshme e mjetit me të cilin është kryer vepra penale, si dhe sendeve që janë rezultat i veprës penale, si p.sh., te vepra penale prodhimi dhe shpërdarja e produkteve të dëmshme mjekësore nga neni 260 paragrafi 8 të KPRK, është parashikuar se produktet mjekësore dhe mjetet e prodhimit sipas këtij neni konfiskohen, etj.

Procedura penale për shumicën absolute të veprave penale të këtij Kapitulli, fillohet sipas detyrës zyrtare pa marrë parasysh vullnetin e palës së dëmtuar, mirëpo për veprën penale përhapja e sëmundjeve venerike, nga neni 251, paragrafi 4 të KPRK, është parashikuar se procedura penale fillohet sipas propozimit.

Disa nga veprat penale të këtij Kapitulli, kanë edhe format e rënda apo të cilësuar, të cilat konsiderohen se kryhen nëse si rezultat i kryerjes së veprës penale themelore është shkaktuar lëndim i rëndë trupor apo dëmtim i rëndë i shëndetit, apo vdekja e një ose më shumë personave.

II. VEPRAT PENALE TË KËTIJ KAPITULLI

1. Përhapja e sëmundjeve ngjitëse (neni 249)

Sipas paragrafit 1 të nenit 249 të KPRK, këtë vepër penale e kryen kushdo që nuk vepron sipas dispozitave apo urdhrave të organit publik kompetent në fushën e shëndetësisë, e cila ka për qëllim parandalimin apo luftimin e sëmundjeve ngjitëse te njerëzit apo kafshët dhe me këtë shkakton përhapjen e sëmundjes ngjitëse te njerëzit. Siç shihet, vepra penale e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse është vepër penale e karakterit blanket, ngase me ligje dhe dispozita tjera është përcaktuar se cilat sëmundje konsiderohen sëmundje ngjitëse dhe si mund të përhapen ato. Dispozita ligjore të kësaj natyre gjenden në Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse,³²⁶ me të cilin janë përcaktuar sëmundjet ngjitëse, masat për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, etj. Sipas nenit 2 të këtij ligji, sëmundje ngjitëse konsiderohet ajo sëmundje e cila shkaktohet nga mikroorganizma dhe parazitë sëmundje shkaktues, që barten drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga njeriu i sëmurë ose bartësi i shkaktarit tek njeriu i shëndoshë dhe nga kafshët e prodhimet blegtorale tek njerëzit.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në mosndërmarrjen e masave të parapara me dispozita apo të përcaktuara me urdhra të organeve kompetente.

Masat që parashihen sipas dispozitave apo urdhrave të organeve kompetente me qëllim të luftimit apo të parandalimit të sëmundjeve ngjitëse zakonisht, janë dezinfektimi, kontrollimi, veçimi i të sëmurëve, ndalesa apo kufizimi i qarkullimit të njerëzve, ndalesa e tubimit të njerëzve, obligimi që të paraqiten rastet e sëmundjeve ngjitëse, etj.

Vepra penale konsiderohet se kryhet në rastet kur për shkak të mosrespektimit të dispozitave dhe urdhrave të organeve kompetente shkaktohet sëmundja ngjitëse.

Pasoja e kësaj vepre penale konsiston në përhapjen e sëmundjes ngjitëse tek personat tjerë.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

³²⁶ Ligji nr.02/L-109 Për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, i datës 10.05.2007.

Në paragrafin 2 të nenit 249 të KPRK, është paraparë një formë e veçantë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se kryhet nëse ndokush nuk ju përmbahet dispozitave apo urdhrave nga paragrafi 1 i këtij neni dhe me këtë shkakton përhapjen e sëmundjeve ngjitëse te kafshëtt.

Për këtë formë të veçantë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim deri në një vit.

Në paragrafin 3 të këtij neni, është parashikuar forma e lehtë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafët 1 ose 2 i këtij neni kryhet nga pakujdesia. Për këtë formë të lehtë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë apo me burgim deri në gjashtë muaj.

Forma më e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 4 të nenit 249 të KPRK, e cila ekziston në rastet kur vepra penale nga paragrafët 1 ose 2 të këtij neni rezulton me vdekjen e një ose më shumë personave, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet.

Formë e rëndë e kësaj vepër penale është parashikuar në paragrafin 5 të nenit 249 të KPRK, sipas së cilës nëse vepra penale nga paragrafët 1 ose 2 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëmtim të rëndë të shëndetit, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

Kurse, në paragrafin 6 të këtij neni, është parashikuar se nëse veprat penale nga paragrafët 1 dhe 2 të nenit të lartcekur, janë kryer nga pakujdesia dhe rezultojnë me lëndime të rënda trupore ose me dëmtim të shëndetit, kryerësi dënohet me burgim deri në tri vjet. Ndërsa, sipas paragrafit 7, nëse vepra penale nga paragrafi 3, rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

Kryerës i të gjitha këtyre formave të kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

2. Mosveprimi sipas dispozitave shëndetësore gjatë kohës së epidemisë (neni 250)

Kjo vepër penale, sipas nenit 250 të KPRK, kryhet në rastet kur ndokush gjatë kohës së epidemisë ose të ndonjë sëmundjeje ngjitëse nuk vepron sipas urdhrave apo vendimeve të tjera të nxjerra në bazë të dispozitave të organit kompetent, i cili cakton masat që kanë për qëllim luftimin apo parandalimin e tyre.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në mosveprimin përkatësisht në sjelljen në kundërshtim me urdhrat apo vendimet e tjera të nxjerra në bazë të dispozitave të organit kompetent, andaj edhe konsiderohet vepër penale e karakterit blanket.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me mosveprim (*delikte omisive*) dhe vetëm gjatë kohës së epidemisë ose ndonjë sëmundjeje ngjitëse.

Pasoja e kësaj vepre penale konsiston në rrezikimin e shëndetit të njerëzve, përkatësisht në rrezikimin abstrakt.

Kjo veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Kryerës i kësaj veprë penale mund të jetë çdo person.

Për këtë veprë penale është parashikuar dënimi me burgim deri në dy vjet.

3. Përhapja e virusit HIV (neni 252)

Virusi HIV është një lloj virusi i cili në stadin e tanishëm të zhvillimit të mjekësisë tani për tani në përgjithësi është i pashërueshëm dhe që përhapet tek të tjerët kryesisht me anë të marrëdhënieve seksuale të pambrojtura.³²⁷ Mirëpo, marrëdhëniet seksuale nuk janë e vetmja mënyrë e përhapjes së këtij virusi.

Forma themelore e kësaj veprë penale, nga paragrafi 1 i këtij neni, konsiderohet se kryhet në rastet kur ndonjë person që duke ditur se është infektuar me virusin HIV, nuk e zbulon këtë fakt dhe infektton personin tjetër.

Veprimi i kryerjes së kësaj veprë penale manifestohet në rastet kur ndonjë person e di se është i infektuar me virusin HIV dhe me qëllim e fsheh këtë fakt duke e infektuar në këtë mënyrë personin tjetër.

Vepra penale konsiderohet se është kryer, është përfunduar nëse me marrëdhëniet seksuale është infektuar personi tjetër me virusin HIV. Së këndejmi, kjo veprë konsiderohet se është kryer vetëm nëse është bartur ky virus tek personi tjetër.

Kjo veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje, e cila në vete përfshin vetëdijen e personit se është i infektuar nga virusi HIV apo sëmundja dhe dëshirën që me këtë virus ta infektoj edhe një person tjetër.

Kryerës i kësaj veprë penale mund të jetë çdo person.

Për këtë veprë penale është parashikuar dënimi me burgim prej dy deri në dymbëdhjetë vjet burgim.

Formë e lehtë e kësaj veprë penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 1, është kryer nga pakujdesia, për të cilën është parashikuar dënim me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Në paragrafin 3 të këtij neni, është paraparë forma e rëndë e kësaj veprë penale e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni, rezulton me vdekjen e personit. Për këtë formë të rëndë të kësaj veprë penale është parashikuar dënimi me burgim prej pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

³²⁷ SALIHU, ISMET, E drejta penale, Pjesa e posaçme, f. 342.

Ndërsa, nëse vepra penale nga paragrafi 2 (nga pakujdesia) rezulton me vdekjen e personit, atëherë kryesi do të dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

Kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

4. Punësimi i personave të infektuar nga sëmundjet ngjitëse (neni 253)

Sipas paragrafit 1 të nenit 253 të KPRK, forma themelore e kësaj vepre penale kryhet në rastet kur ndonjë person në kundërshtim me ligjet e shëndetësisë, në spital, në maternitetet të spitalit, në shkollë, në restorant, në punëtori ose organizatë biznesi apo në ndonjë vend të ngjashëm ku përpunohen artikujt ushqimorë apo ku kryhen shërbime higjienike, e punëson apo e mban në punë personin për të cilin e di se lëngon nga sëmundja ngjitëse dhe me këtë shkakton përhapjen e sëmundjes.

Nga kjo shihet se kjo vepër penale është e karakterit blanket.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale është përcaktuar në mënyrë alternative dhe konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush e punëson apo e mban në punë personin i cili lëngon nga ndonjë sëmundje ngjitëse.

Duke u bazuar në paragrafin 1 të këtij neni, kjo vepër penale mund të kryhet vetëm në vende të caktuara. Si vende të kryerjes së kësaj vepre penale ceken spitali, materniteti, shkolla, restorante, mandej në farmaci, në punëtori ku përpunohen artikujt ushqimorë, etj.

Vepra penale konsiderohet se është kryer në rastet kur nga punësimi i personit që lëngon nga sëmundja ngjitëse është shkaktuar përhapja e sëmundjes ngjitëse tek personat tjerë. Për ekzistimin e kësaj vepre penale mjafton të jetë infektuar edhe vetëm një person.

Sipas kësaj dispozite ligjore, kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person. Mirëpo, për shkak të përmbajtjes dhe natyrës së kësaj vepre penale, zakonisht si kryerës konsiderohet personi në kompanitë dhe institucionet e cekura më lart, i cili ka mundësi të vendosë për pranimin e punëtorëve në vendet e caktuara të punës apo për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të personave që lëngojnë nga sëmundjet ngjitëse.

Kjo formë e kësaj vepre penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Në paragrafin 2 të këtij neni, është parashikuar një formë e lehtë e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia. Për këtë formë të lehtë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë apo me burgim deri në gjashtë muaj.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale, është parashikuar në paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet, nëse nga kjo vepër penale është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit.

Nëse kjo formë e rëndë është kryer me dashje, kryerësi i saj dënohet prej gjashtë muaj deri në tre vjet burgim, kurse nëse është kryer nga pakujdesia atëherë kryerësi i saj dënohet me burgim deri në tri vjet.

Në paragrafët 5 dhe 6 të nenit 253 të KPRK, është parashikuar formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se kryhet nëse është shkaktuar vdekja e një apo më shumë personave. Nëse kjo formë shumë e rëndë është kryer me dashje, atëherë kryerësi i saj mund të dënohet prej një deri në dhjetë vjet burgim, kurse nëse është kryer nga pakujdesia, dënimi është i paraparë prej një deri në pesë vjet burgim.

5. Mosdhënia e ndihmës mjekësore (neni 255)

Sipas paragrafit 1 të nenit 255 të KPRK, këtë vepër penale e kryen mjeku ose punonjësi tjetër shëndetësor, i cili në kundërshtim me detyrën e tij refuzon t'i ofrojë ndihmën mjekësore personit të cilit i nevojitet ndihma e tillë, ndonëse ai është i vetëdijshëm ose do duhej të ishte i vetëdijshëm se mosveprimi i tillë mund të rezultojë në lëndim të rëndë trupor apo dëmtim të rëndë të shëndetit ose vdekjen e personit.

Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, vepra penale mosdhënia e ndihmës mjekësore, nga neni 220 paragrafi 1 të KPRK, është vepër penale që rrezikon dhe për ekzistimin e saj, nuk kërkohet që të shkaktohet pasoja e caktuar, ngase vepra penale konsiderohet se është kryer me vetë faktin e mosdhënies së ndihmës mjekësore.

Sa i përket mënyrës së kryerjes, kjo vepër penale mund të kryhet me mosveprim, ngase mjeku nuk e ndërmerr veprimin të cilin ka qenë i obliguar që ta ndërmarrë përkatësisht dhënien e ndihmës mjekësore. Obligimi i mjekut për të dhënë ndihmë mjekësore rrjedh nga natyra e profesionit të tij dhe nga ligji.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në mosdhënien e ndihmës mjekësore personit tjetër, ndihmë kjo e cila është e domosdoshme ngase i kanoset rreziku që t'i shkaktohet dëmtimi i rëndë i shëndetit apo vdekja.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin B.R., për shkak të kësaj vepre penale, sepse i akuzuari B.R. me datën 01.05.2007, në Qendrën Emergjente në Gjilan, në cilësinë e kujdestarit të kësaj Qendre, nuk i ka dhënë ndihmë mjekësore fëmijës së moshës 3 vjeqare, i cili ishte sjellur në këtë Qendër nga gjyshi i tij, për shkak se kishte pësuar lëndime të rënda në kokë dhe gjendja e tij ishte shumë e vështirë, edhe përkundër faktit se i akuzuari ishte thirrur në telefon disa herë nga personeli mjekësor i kësaj Qendre.³²⁸

Për ekzistimin e kësaj vepre penale, duhet të konstatohet në çdo rast se mjeku ka pasur mundësi që ta ofrojë ndihmën mjekësore.

³²⁸ Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Gjilan, P.nr.887/2007, i datës 24.10.2008.

Vepra penale konsiderohet se është kryer me vetë faktin e mosdhënies së ndihmës mjekësore.

Nga kjo dispozitë ligjore shihet se kryerës apo subjekt aktiv i kësaj vepre penale mund të jetë vetëm mjeku ose punonjësi tjetër shëndetësor (*delicta propria*). Mjek konsiderohet personi i cili ka diplomuar në fakultetin e mjekësisë. Edhe në disa kode

penale shteteve të regjionit,³²⁹ është parashikuar në mënyrë shprehimore që kryerës i kësaj vepre penale, përveç mjekut, mund të jenë edhe punëtorët tjerë shëndetësorë.

Viktimë apo subjekt pasiv i kësaj vepre penale konsiderohet pacienti.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me burgim deri në tri vjet.

Në paragrafin 2 të këtij neni është parashikuar forma e rëndë e kësaj vepre penale e cila ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëmtim të rëndë të shëndetit të personit të cilit nuk iu është dhënë ndihma mjekësore, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.

Formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, e cila konsiderohet se është kryer nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e personit të cilit nuk iu është dhënë ndihma mjekësore, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në tetë vjet.

6. Ndotja e ujit të pijshëm (neni 264)

Në paragrafin 1 të nenit 264 të KPRK, është parashikuar forma themelore e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush me ndonjë materie të dëmshme e ndot ujin të cilin njerëzit e përdorin si ujë të pijshëm dhe kështu rrezikon jetën apo shëndetin e njerëzve.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në ndotjen e ujit të cilin njerëzit e përdorin si ujë të pijshëm. Me ndotje, duhet nënkuptuar rastet kur kryerësi me ndonjë materie të ndryshme e shëndërron ujin në gjendje të rrezikshme për shëndetin dhe jetën e njerëzve, si p.sh. duke hedhur në ujë helme, materie kimike të rrezikshme, vajra të ndryshme, plehra, kafshë të ngordhura, etj.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin N.U., për shkak të kësaj forme të veprës penale ndotja e ujit të pijshëm, sepse i akuzuari N.U. më datën 02.02.2007, në një fshat të Komunës së Gjilanit, me materie të dëmshme e ka ndot ujin të cilin njerëzit e përdorin si ujë të pijshëm, në atë mënyrë që në pusin (bunarin), me ramje të lirë të ujit me të cilin furnizohet familja e të dëmtuarit M.B.,

³²⁹ Neni 189 i Kodit Penal të Republikës së Sllovenisë, neni 208 i Kodit Penal të Maqedonisë, neni 243 i Ligjit Penal të Republikës së Kroacisë, etj.

i akuzuari N.U. ka hedhur vaj motorik të djegur, të cilin vaj kohë më parë e ka siguruar nga punëtorja “Dielli”, me ç’rast e ka rrezikuar jetën dhe shëndetin e anëtarëve të familjes së të dëmtuarit M.B.³³⁰

Kjo formë e kësaj vepre penale konsiderohet se është kryer me vetë faktin e ndotjes së ujit të cilin njerëzit e përdorin për pije.

Pasoja e kësaj forme të veprës penale është shkaktimi i rrezikut abstrakt për jetën dhe shëndetin e njerëzve.

Kjo formë e kësaj vepre penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Për formën themelore të kësaj vepre penale nga paragrafi 1 i këtij neni është parashikuar dënimi me burgim deri në tri vjet.

Në paragrafin 2 të këtij neni, është parashikuar forma e lehtë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia. Për këtë formë të lehtë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë apo me burgim deri në një vit.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, e cila konsiderohet se ekziston nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëmtim të rëndë të shëndetit, për të cilën është paraparë dënim me burgim deri në tetë vjet për veprën penale nga paragrafi 1 (me dashje) ose me burgim deri në tri vjet për veprën nga paragrafi 2 (nga pakujdesia).

Formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafët 5 dhe të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, për të cilën është parashikuar dënim me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet për veprën nga paragrafi 1 (me dashje) ose me burgim prej një deri në tetë vjet për veprën nga paragrafi 2 (nga pakujdesia).

Kryerës i të gjitha formave të kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

7. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli

Përveç këtyre veprave penale, në Kapitullin e veprave penale kundër shëndetit publik, parashihen edhe këto vepra penale :

- Përhapja e sëmundjeve venerike (neni 251),
- Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor (neni 254),
- Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike (neni 256),

³³⁰ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, P.nr.191/2007, i datës 14.01.2008.

- Eksperimentet e kundërligjshme mjekësore dhe testimi i barërave (neni 257),
- Përgatitja dhe dhënia e pandërgjegjshme e barnave (neni 258),
- Transplantimi i kundërligjshëm dhe trafikimi i organeve dhe qelizave njerëzore (neni 259),
- Prodhimi dhe shpërndarja e produkteve të dëmshme mjekësore (neni 260),
- Prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimorë (neni 261),
- Kontrollimi i pandërgjegjshëm i produkteve shtazore të destinuara për konsumim (neni 262),
- Dhënia ose përdorimi i certifikatës së rreme të mjekut apo të veterinarit (neni 263),
- Ndotja e artikujve ushqimorë të destinuar për përdorim për njerëz apo për kafshë (neni 265) dhe
- Shërbimi i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet me pije alkoolike (neni 266).

KAPITULLI XI

VEPRAT PENALE TË NARKOTIKËVE

I. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME

Narkomania, paraqet dukurinë negative shoqërore e cila manifestohet në përdorimin dhe konsumimin e drogave dehëse dhe pijeve të tjera narkotike. Kjo dukuri është shumë e përhapur në botën bashkëkohore. Prania e saj në shoqërinë bashkëkohore, e sidomos marrja masovike e të rinjve me të, paraqet një rrezik për mbarë shoqërinë njerëzore. Kjo dukuri sipas shumë autorëve shkakton pasoja të rënda për shëndetin psikik dhe fizik të njeriut.³³¹ Narkomania mund të sjellë në pyetje jo vetëm shëndetin e individit por edhe jetën e gjeneratave të tëra të njerëzimit. Për këtë arsye, në të gjitha legjislacionet penale bashkëkohore janë parashikuar si vepra penale një mori veprimesh që kanë të bëjnë me këtë dukuri negative shoqërore. Në legjislacionet penale bashkëkohore janë parashikuar dënime shumë të rënda për kryerësit e këtyre veprave penale, madje në disa shtete edhe dënime me burgim të përjetshëm³³² dhe dënime me vdekje.³³³

Edhe në KPRK, janë parashikuar si vepra penale një numër i konsiderueshëm i veprimeve që kanë të bëjnë me narkotikët e rrezikshëm dhe substancat psikotropike.

Për shkak të pasojave shumë të dëmshme në shëndetin mental dhe fizik, si dhe pasojave të tjera sociale, krahas legjislacioneve të shteteve bashkëkohore, çështja e luftimit dhe vënies në qarkullim në mënyrë të paautorizuar të narkotikëve dhe substancave psikotrope, është preokupim edhe ndërkombëtar. Kësisoj, për luftimin e tregtisë me drogë janë aprovuar edhe konventa ndërkombëtare.³³⁴

Kryes i të gjitha veprave penale të këtij kapitulli parimisht mund të jenë çdo person dhe këto vepra penale mund të kryhen me dashje

2. Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge (neni 267)

Sipas paragrafit 1 të nenit 267 të KPRK, forma themelore e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge, e cila konsiderohet se ekziston në rastet kur ndokush pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur

³³¹ HALILI, RAGIP, Kriminologjia, Prishtinë, 2002, f. 296.

³³² Në nenin 16 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit Kundër Narkotikëve të Afganistanit (Official Gazette, no.875, published on 04.02.2006), është parashikuar se për veprën penale të trafikimit të narkotikëve, në sasi mbi 5 kilogramë, kryerësi do të dënohet me burgim të përjetshëm dhe dënim me gjobë.

³³³ Në Republikën Islamike të Iranit, është parashikuar mundësia e shqiptimit të dënimit me vdekje për këtë veprë penale. Neni 2 paragrafi 4 i Ligjit Kundër Narkotikëve të Republikës Islamike të Iranit, i datës 08.11.1997.

³³⁴ SALIHU, ISMET, E drejta penale, Pjesa e posaçme, f. 375.

me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge. Siç shihet, kjo vepër penale është e natyrës blankete, ngase cilat substanca apo preparate janë shpallur të rrezikshme, është e përcaktuar me dispozita tjera ligjore. Dispozita të kësaj natyre gjenden në Ligjin për barnat narkotike, substancat psikotropike dhe prekursorë, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.³³⁵ Sipas nenit 2 paragrafi 1 të këtij ligji, shprehja “**Narkotikë**” nënkupton barnat narkotike dhe substancat psikotrope, që janë të renditura në Tabelat I, II dhe III, të bashkangjitura si shtojcë e këtij ligji. Pra, sipas kësaj dispozite ligjore, shprehja “narkotikë”, është një kuptim i gjerë dhe në vete përfshinë barnat narkotike dhe substancat psikotrope. Sipas po kësaj dispozite ligjore, shprehja “**Bar narkotik**” nënkupton çdo substancë, natyrore ose sintetike, të paraqitur në Tabelën II, si shtojcë e këtij ligji të bazuar në Listat I, II dhe IV të Konventës së Vetme për Barnat Narkotike të vitit 1961, të përmirësuara me protokolin e vitit 1972, kurse shprehja “**Substancë psikotrope**” nënkupton çdo substancë, natyrore ose sintetike, të paraqitur në Tabelën III, si shtojcë e këtij ligji të bazuar në Listat I, II, III dhe IV të Konventës mbi Substancat Psikotrope të vitit 1971. Në nenin 9 të këtij ligji, është bërë ndarja dhe klasifikimi i narkotikëve, të cilat janë të përcaktuara në mënyrë taksative në 4 Tabela, në këtë mënyrë :

Tabela I : Bimët, barnat narkotike dhe substancat psikotrope me rrezikshmëri të lartë që nuk kanë përdorim në mjekësi dhe veterinë, veprimtaria e të cilave është e ndaluar në Kosovë;

Tabela II : Barnat narkotike dhe substancat psikotrope, me rrezikshmëri të lartë, që kanë përdorim në mjekësi dhe veterinë;

Tabela III : Barnat narkotike, substancat psikotrope dhe përgatesat e tyre, me rrezikshmëri të lartë, që përdoren në mjekësi dhe veterinë;

Tabela IV : Substancat që përdoren në prodhimin e barnave narkotike dhe substancave psikotrope - Prekursorët.

Veprimet e kryerjes së formës së parë të kësaj vepre penale, nga paragrafi 1 i nenit 267 të KPRK, janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë : blerjen ose posedimin me qëllim shitje, shpërndarje ose ofrimi për shitje i substancave apo preparateve të cilat janë shpallur të rrezikshme, narkotikë, substanca psikotropike apo substanca analoge.

Për ekzistimin e kësaj vepre penale, duhet që çdonjëra nga format e kryerjes së kësaj vepre të jenë ndërmarrë në mënyrë të paautorizuar.

Objekt mbrojtës i kësaj vepre penale është shëndeti i njerëzve.

Pasoja e kësaj vepre penale është rreziku abstrakt për shëndetin e njerëzve.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

³³⁵ Ligji Nr.02/L-128 Për Barnat Narkotike, Substancat Psikotrope dhe Prekursorë, i datës 02.11.2007.

Kjo veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje dhe me qëllimin e lartcekur.

Për këtë formë të kësaj veprë penale është parashikuar në mënyrë kumulative dënimi me gjobë dhe me burgim prej dy deri në tetë vjet.

Formë e rëndë e kësaj veprë penale është parashikuar në paragrafin 2 të nenit 267 të KPRK, e cila konsiderohet se ekziston në rastet kur ndokush pa autorizim shpërndan, shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon ose dërgon në transit substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge, me qëllim të shpërndarjes, shitjes ose ofrimit për shitje.

Veprimet e kryerjes së kësaj forme të veprës penale konsiderohen shpërndarja, shitja, transportimi, dorëzimi, ndërmjetësimi, dërgimi ose dërgimi në transit i substancave apo preparateve të cilat janë shpallur narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge me qëllim shpërndarjeje, shitjeje ose oferte për shitje. Kjo formë e kësaj veprë penale, do të ekzistonte në praktikë, p.sh. nëse personi A i shet personit B, substanca apo preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme, narkotikë ose substanca psikotrope, me qëllim që edhe personi B, t'i shpërndajë, t'i shet apo t'i ofrojë për shitje këto substanca apo preparate.

Për këtë formë të rëndë të kësaj veprë penale është parashikuar në mënyrë kumulative dënimi me gjobë dhe me burgim prej tre deri në dymbëdhjetë vjet.

Në paragrafin 3 të këtij neni, është parashikuar një formë tjetër e kësaj veprë penale, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush pa autorizim eksporton ose importon substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge.

Veprimet e kryerjes së kësaj forme të veprës penale janë eksportimi ose importimi i paautorizuar i substancave apo preparateve të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge. Shprehja **“eksporton”** në sensin e kësaj veprë penale do të thotë dërgon apo transporton substanca të tilla nga Kosova në shtetet tjera, kurse shprehja **“importon”** në sensin e kësaj veprë penale do të thotë fuqta apo sjellja e këtyre substancave apo preparateve nga shtetet tjera në Kosovë.

Për këtë formë të kësaj veprë penale është parashikuar në mënyrë kumulative dënimi me gjobë dhe burgim prej tre deri në dhjetë vjet.

Në paragrafin 4 të këtij neni, është parashikuar se për qëllime të këtij kapitulli, shprehja **“analog”** nënkupton çfarëdo substance e cila nuk është e autorizuar dhe struktura kimike e së cilës është esencialisht e ngjashme me atë të substancave apo preparateve që janë shpallur si narkotikë ose substanca psikotrope dhe efektet e të cilave i riprodhon.

Ndërsa, në paragrafin 5 të këtij neni, është parashikuar se substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge dhe mjetet për prodhimin, shpërndarjen apo transportimin e tyre konfiskohen.

3. Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike (neni 268)

Sipas paragrafit 1 të nenit 268 të KPRK, formën e parë të kësaj vepre penale e kryen kushdo që pa autorizim prodhon, kultivon, përpunon, nxjerr ose përgatit substanca apo preparate që janë shpallur si narkotikë ose substanca psikotrope.

Siç shihet, edhe kjo vepër penale është e natyrës blankete, ngase cilat substanca apo preparate janë shpallur si narkotikë apo substanca psikotrope, është e përcaktuar me dispozita tjera ligjore.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale është i përcaktuar në mënyrë alternative dhe konsiston në prodhimin, kultivimin, përpunimin, nxjerrjen ose përgatitjen e substancave apo preparateve që janë shpallur si narkotikë ose substanca psikotrope. Për t'u konsideruar se është kryer kjo vepër penale duhet që veprimet e kryerjes të jenë ndërmarrë në mënyrë të paautorizuar.

Pasoja e kësaj vepre penale është rreziku abstrakt për shëndetin dhe jetën e njerëzve.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Kjo formë e kësaj vepre penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar në mënyrë kumulative dënimi me gjobë dhe burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Në paragrafin 2 të këtij neni, është parashikuar formë tjetër e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se ekziston në rastet ndokush pa autorizim prodhon, kultivon, përpunon, shet ose ofron për shitje substancën analoge.

Veprimet e kryerjes së kësaj forme të veprës penale janë prodhimi, kultivimi, përpunimi, shitja ose ofrimi për shitjet i substancave analoge.

Për t'u konsideruar se është kryer kjo formë e veprës penale duhet që veprimet e kryerjes të jenë ndërmarrë në mënyrë të paautorizuar.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar në mënyrë kumulative dënimi me gjobë dhe me burgim prej gjashtë muajve deri në tri vjet.

Ndërsa, në paragrafin 3 të nenit të lartcekur, është parashikuar një formë tjetër e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se është kryer në rastet kur ndokush prodhon, transporton ose shpërndan preparate duke e ditur se ato do të përdoren për prodhim ose përpunim të paautorizuar të narkotikëve apo substancave psikotrope. Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej dy deri në dhjetë vjet.

Formë e posaçme e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 4 të këtij neni, e cila konsiderohet se ekziston në rastet kur ndokush pa autorizim prodhon, transporton, shpërndan, shet ose furnizon me vegla, pajisje apo materiale narkotike, duke ditur se këto janë përdorë ose

do të përdoren për kultivim, prodhim, përpunim, trafikim apo përdorim të paautorizuar të çfarëdo substance ose preparati të cilat janë shpallur si narkotikë, substanca psikotrope apo analoge.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin L.U., për shkak të kësaj vepre penale, sepse i akuzuari më datën 01.05.2007, në Gjilan, pa autorizim kishte shitur pajisje të caktuara, duke e ditur se ato do të përdoren për kultivimin e paligjshëm të substancave ose preparateve që janë shpallur të rrezikshëm si narkotik ose substanca psikotropike apo analoge.³³⁶

Në paragrafin 5 të këtij neni, është parashikuar se substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge dhe mjetet për prodhimin, shpërndarjen apo transportimin e tyre konfiskohen.

4. Lehtësimi i sigurimit apo përdorimit të narkotikëve, substancave psikotropike apo analogëve (neni 271)

Sipas paragrafit 1 të nenit 271 të KPRK, këtë vepër penale e kryen kushdo që administron me narkotikë, me substanca psikotropike ose analoge dhe për shkak të detyrës që ka, lehtëson sigurimin ose përdorimin e tyre në kundërshtim me ligjin.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në lehtësimin e sigurimit ose përdorimit të narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge në kundërshtim me ligjin.

Pasoja e kësaj vepre penale është shkaktimi i rrezikut abstrakt për shëndetin e njerëzve.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë vetëm personi i cili për shkak të detyrës që ka, administron me narkotikë, me substancë psikotropike ose analoge. Në sensin e kësaj vepre penale, persona që administrojnë me narkotikë për shkak të detyrës që kanë konsiderohen farmacistët, teknikët e farmacisë, punëtorët tjetër të autorizuar në entet shëndetësore apo laboratore në të cilat administrohet me narkotikë, substancë psikotropike ose analoge, etj.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Formë tjetër e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur drejtuesi ose pronari i lokalit apo i hapësirës tjetër të

³³⁶ Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Gjilan, P.nr.450/2007, i datës 28.01.2009.

mbyllur të cilën e përdor publiku i cili lejon apo toleron përdorimin e narkotikëve, substancave psikotropike ose substancave analoge.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në lejimin ose tolerimin e përdorimit të narkotikëve, substancave psikotropike ose substancave nga drejtuesi ose pronari i lokalit apo i hapësirës tjetër të mbyllur të cilën e përdor publiku.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë vetëm drejtuesi ose pronari i lokalit apo i hapësirës tjetër të mbyllur të cilën e përdor publiku. Drejtues, në sensin e kësaj vepre penale duhet nënkuptuar qiramarrësin apo personin i cili e shfrytëzon, menaxhon apo administron me lokalit ose hapësirën tjetër të mbyllur, kurse pronar, duhet nënkuptuar personin i cili e ka në pronësi lokalit apo hapësirën tjetër të mbyllur.

Kjo veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.

5. Veprat e tjera penale të këtij kapitulli

Përveç këtyre veprave penale, në Kapitullin e veprave penale kundër narkotikëve, parashihen edhe këto vepra penale:

- Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge (neni 269),
- Intoksikimi i personit tjetër me narkotikë ose substanca psikotrope (neni 270),
- Kultivimi i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit (neni 272),
- Organizimi, drejtimi apo financimi i trafikimit të narkotikëve apo substancave psikotrope (neni 273),
- Konvertimi apo transferimi i pasurisë që rrjedh nga veprat penale nga ky kapitull (neni 274) dhe
- Dënimi për raste të rënda të veprave penale nga ky Kapitull (neni 275).

KAPITULLI XII

VEPRAT PENALE KUNDËR EKONOMISË

I. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME

Ekonomia është themel i çdo shoqërie, i çdo kombi dhe se ajo jo vetëm që siguron ekzistencën materiale të njerëzve, por njëherësh është motor i zhvillimit të gjithëmbarshtëm dhe si e tillë është lëmi më i rëndësishëm në një shtet.

Veprat penale kundër ekonomisë, në teorinë juridike-penale dhe kriminologjike ndryshe emërtohen edhe si kriminalitet ekonomik.

Zhvillimi ekonomik i shteteve, veçmas zhvillimi më i shpejtuar i disa degëve të ekonomisë dhe interesimi i shtetit që ta mbrojë dhe ta mundësojë këtë zhvillim, ka zgjeruar edhe sferën e mbrojtjes me normat e së drejtës penale. Ky trend i këtillë ka kontribuar që të formohet dhe të zhvillohet edhe një degë e re e së drejtës penale - **e drejta penale ekonomike**.

Si kryerës të veprave penale të këtij kapitulli, mund të paraqiten subjekte të ndryshme. Disa nga këto vepra penale mund t'i kryejë çdo person, ndërsa të tjerat vetëm personat me veti të caktuara, siç janë p.sh. vepra penale e shkaktimit të falimentimit, nga neni 280 i KPRK, vepra penale keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike, nga neni 284 të KPRK, lidhja e kontratës së dëmshme, nga neni 285 të KPRK, etj. të cilat mund t'i kryejnë vetëm personat përgjegjës të organizatës së biznesit.

Shumica e këtyre veprave penale mund të kryhen vetëm me dashje dhe se për ekzistimin e disa prej këtyre veprave penale kërkohen që ato të jenë kryer me qëllim që vetes apo tjetrit t'i sjellin dobi pasurore juridike.

Te disa vepra penale të këtij Kapitulli është paraparë marrja e obligueshme e mjetit me të cilin është kryer vepra penale, si dhe sendet që janë rezultat i veprës penale, si p.sh. vepra penale e falsifikimit të parasë, nga neni 296 i KPRK, vepra penale tregtia e ndaluar, nga neni 299 i KPRK, etj.

II. VEPRAT PENALE TË KËTIJ KAPITULLI

1. Cenimi i barazisë në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike (neni 278)

Veprën penale të cenimit të barazisë në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike, nga neni 278 të KPRK, e kryen personi zyrtar i cili duke keqpërdorur detyrën zyrtare apo autorizimet e tij, kufizon qarkullimin e lirë të kapitalit, njerëzve, mallrave, shërbimeve, punës apo mjeteve të riprodhimit në territorin e Republikës së Kosovës, ose mohon apo kufizon të drejtën e organizatës së biznesit apo të personit juridik që në territorin e Republikës së Kosovës të merret me qarkullimin e mallit apo të shërbimeve, ose e vë organizatën e biznesit apo personin juridik

në pozitë të pabarabartë ndaj organizatës së biznesit ose personit tjetër juridik lidhur me kushtet për punë apo qarkullimin e mallit apo të shërbimeve, ose e kufizon këmbimin e lirë të mallit ose të shërbimeve dhe me këtë realizohet fitim i konsiderueshëm për atë organizatë të biznesit ose person juridik ose shkaktohet dëm i konsiderueshëm për tjetrin.

Të gjitha këto forma të veprimit me të cilat mund të kryhet kjo vepër penale realizohen duke e keqpërdorur detyrën zyrtare apo autorizimet dhe se kjo vepër penale kryhet me qëllim që të realizohet fitim i konsiderueshëm për organizatën e biznesit ose personin juridik ose me qëllim që të shkaktohet dëm i konsiderueshëm për tjetrin.

Kryerës i kësaj vepre penale në të shumtën e rasteve është personi zyrtar, si dhe personi përgjegjës. Sipas nenit 113 paragrafi 2 të KPRK, shprehja “person zyrtar” do të thotë personi i cili në organin shtetëror kryen punët zyrtare; personi i zgjedhur, i emëruar ose i caktuar në organin shtetëror, në organin e pushtetit lokal ose personi që përherë ose përkohësisht kryen detyrat zyrtare ose funksionet zyrtare në ato organe; personi në institucion, ndërmarrje ose në ndonjë subjekt tjetër, të cilit i janë besuar kryerja e autorizimeve publike, që vendos për të drejtat, obligimet ose interesat e personave fizik apo juridik ose për interesin publik; person zyrtar konsiderohet edhe personi të cilit i është besuar kryerja faktike e detyrave të caktuara zyrtare apo punëve; person ushtarak përpos kur janë në pyetje dispozitat e Kreut XXXIII (Veprat penale kundër detyrave zyrtare) të këtij Kodi.

Kjo vepër penale mund të kryehet vetëm me dashje.

Për këtë vepër penale është paraparë dënimi me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

2. Shkaktimi i falimentimit (neni 280)

Sipas nenit 280 të KPRK, veprën penale shkaktimi i falimentimit, e kryen kushdo që duke ditur borxhin e tepërt ose insolvencën aktuale apo të pashmangshme, përfshihet në një apo më shumë nga veprimtaritë në vijim, nëse:

1. fsheh apo deformon ose në ndonjë mënyrë tjetër në kundërshtim me standardet e rregullta të afarizmit, e shkatërron, dëmton ose e bën të pashfrytëzueshëm ndonjë aset, i cili në rast të procedurave të insolvencës do ti takonte pronës falimentuese;

2. në ndonjë mënyrë në kundërshtim me standardet e rregullta të afarizmit, hyn në sipërmarrje humbëse apo spekulative ose këmbime të mallrave apo letrave me vlerë ose konsumon shuma të tepërta ose bëhet debitor për shkak të shpenzimeve joekonomike, bixhosit ose vënies së basteve;

3. prokuron mallra, shërbime apo kredi, ndërmerr veprimtari ekonomike të cilat krijojnë borxh tepër të madh, konkludon ose rinovon kontrata të paarsyeshme, nuk i mbledh borxhet që i kanë të tjerët, nuk i zbaton kërkesat me kohë dhe/ose i tjetërson mallrat apo shërbimet, letrat me vlerë apo gjërat e prodhuara nga këto të mira dukshëm nën vlerën e tyre në kundërshtim me standardet e rregullta të afarizmit;

4. simulon ekzistimin e të drejtave të tjetrit ose me dijeni i njeh të drejtat e fabrikuara;
5. nuk mban librat e kontabilitetit, të cilat me ligj është i detyruar t'i mbajë, ose i mban apo i modifikon ashtu që analizimi apo auditimi i aseteve neto të jetë më i vështirë;
6. deformon, fsheh, shkatërron ose dëmton librat e kontabilitetit apo dokumentacionin tjetër me qëllim që të bëjë analizimin apo auditimin e aseteve neto më të vështirë, të fsheh asetet apo të mashtrojë ndonjë person;
7. zvogëlon asetet neto ose fsheh marrëdhëniet aktuale të afarizmit në ndonjë mënyrë tjetër që është dukshëm në kundërshtim me standardet e rregullta të afarizmit;
8. merr përsipër detyrime të tepërta ose
9. konkludon ose rinovon kontrata të paarsyeshme me subjekte insolvente.

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë në ndërmarrjen e veprimeve të lartcekura.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Forma themelore e kësaj vepre penale mund të kryhet me dashje, e cila në vete përfshin përveç tjerash edhe vetëdijen mbi borxhin e tepërt ose insolvencën aktuale apo të pashmangshme.

Për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Në paragrafin 2 të nenit 280 të KPRK, është parashikuar se vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni dënohet vetëm nëse likuidimi i detyrueshëm ose procedura e falimentimit janë filluar.

Ndërsa, në paragrafin 3 të nenit të lartcekur është parashikuar forma e lehtë e kësaj vepre penale e cila ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim deri në tre vjet.

3. Kumtimi i paautorizuar i sekretit tregtar (neni 286)

Kjo vepër penale konsiderohet se kryhet në rastet kur ndonjë person në shkelje të detyrave të tij për ruajtjen e sekreteve afariste apo tregtare, ia kumton apo ia përcjell personit tjetër të dhënat lidhur me sekretet afariste apo tregtare ose në ndonjë mënyrë tjetër ia mundëson ndonjë personi të paautorizuar qasjen në të dhënat e tilla ose mbledh të dhëna të tilla me qëllim që t'ia përcjell personit të paautorizuar, (neni 286 paragrafi 1).

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale është përcaktuar në mënyrë alternative dhe atë

- duke ia kumton personit tjetër të dhënat lidhur me sekretet afariste apo tregtare;
- duke ia përcjell personit tjetër të dhënat lidhur me sekretet afariste apo tregtare;

- në ndonjë mënyrë tjetër ia mundëson ndonjë personi të paautorizuar qasjen në të dhënat e tilla ose
- mbledh të dhëna të tilla me qëllim që t'ia përcjell personit të paautorizuar.

Objekt i veprimit të kësaj vepre penale është sekreti afarist apo tregtar. Nocioni i sekretit afarist është përcaktuar në paragrafin 7 të nenit 286 të KPRK, ndërsa nocioni i sekretit tregtar është përcaktuar në paragrafin 8 të këtij neni.

Kryerës i kësaj forme të kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, mirëpo për shkak të natyrës së saj, këtë veprë penale e kryejnë zakonisht personat që janë të punësuar në ndonjë organizatë të biznesit, bankë, fabrikë, në ndonjë person tjetër juridik, etj.

Kjo formë e kësaj vepre penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Për këtë formë të veprës penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në tri vjet.

Formë tjetër e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të nenit 286 të KPRK, e cila konsiderohet se kryhet nëse ndonjë person me qëllim të përdorimit në mënyrë të paautorizuar, arrin në mënyrë të kundërligjshme deri te të dhënat të cilat ruhen si sekrete të afarizimit apo të tregtisë, siç parashihet në paragrafin 1. të këtij neni.

Si veprim i kryerjes së kësaj vepre penale konsiderohet çdo veprim të cilin kryerësi e ndërmerr me qëllim që të arrin në mënyrë të kundërligjshme deri te të dhënat të cilat ruhen si sekrete të afarizimit apo të tregtisë.

Kryerës i kësaj forme të kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Edhe kjo formë e kësaj vepre penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Për këtë formë të veprës penale është paraparë dënimi me gjobë ose burgim deri në tri vjet.

Forma e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, sipas të cilit është konsideruar formë e rëndë, nëse të dhënat nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni janë të një rëndësie të veçantë ose nëse të dhënat e këtylla i përcjellën personit tjetër me qëllim që këto të dhëna t'i nxjerrë jashtë Republikës së Kosovës, ose nëse vepra është kryer me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore.

Kryerës i kësaj forme të rëndë mund të jetë çdo person dhe mund të kryhet vetëm me dashje. Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim deri në pesë vjet.

Kurse, në paragrafin 4 është parashikuar forma e lehtë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 3 i këtij neni kryhet nga pakujdesia. Për këtë formë të lehtë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose burgim deri në një vit.

Një formë tjetër e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 5 të nenit 286 të KPRK, e cila ekziston në rastet kur ndonjë person me qëllim të këmbimit të sekretit tregtar për përfitim ekonomik të cilitdo përveç pronarit të tij, vjedh ose merr pa autorizim, ose përmes mashtrimit apo lajthimit merr të dhënat sipas paragrafit 1. të këtij neni.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me me gjobë dhe me burgim deri në pesë vjet.

Formë e veçantë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 6 të nenit të lartcekur, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndonjë person pranon, blen apo posedon sekretin tregtar, duke ditur se ky sekret është vjedhur ose marrë pa autorizim.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

4. Mashtrimi i blerësve (neni 293)

Me këtë vepër penale mbrohen blerësit nga mashtrimet e ndryshme. Për nga përmbajtja dhe dimensionet kjo vepër në një masë i tejkalon edhe suazat e mashtrimit dhe fiton tipare edhe të veprave tjera penale. Kjo vepër penale paraqitet edhe si **“reklamim i rrejshëm”**, por ka ngjashmëri edhe me veprën penale të përdorimit të paautorizuar të shenjës apo firmës së huaj. Përveç me dispozita juridike penale, blerësit në përgjithësi dhe konsumatorët në veçanti, janë të mbrojtur edhe me dispozita të ligjeve tjera. Në këtë drejtim vlen të përmendet Ligji për Mbrotjen e Konsumatorëve,³³⁷ në të cilin gjenden dispozita me anë të të cilave pretendohet që të mbrohet konsumatori.

Vepra penale e mashtrimit të blerësve kryhet nëse personi me qëllim të mashtrimit të blerësve vë në qarkullim prodhime me shenjën në të cilën janë shënuar të dhëna të cilat nuk i përgjigjen përmbajtjes, llojit, prejardhjes apo kualitetit të produktit, vë në qarkullim produkte të cilat për nga pesha apo kualiteti nuk i përgjigjen asaj që rregullisht parashihet te produktet e tilla apo vë në qarkullim produkte pa shenjat që tregojnë për përmbajtjen, llojin, prejardhjen apo kualitetin e produktit kur shenja e tillë kërkohet me ligj,

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale është paraparë në mënyrë alternative, përkatësisht kjo vepër penale mund të kryhet në tri forma :

- 1) Forma e parë e veprimit me të cilin kryhet kjo vepër penale shprehet duke vënë në qarkullim prodhime me shenjën në të cilën janë shënuar të dhëna të cilat nuk i përgjigjen përmbajtjes, llojit, prejardhjes apo kualitetit të produktit;

³³⁷ Ligji nr.06/L-034 Për Mbrotjen e Konsumatorit, i datës 14.06.2018.

- 2) Forma e dytë e veprimit me të cilin kryhet kjo vepër penale është rasti kur vehen në qarkullim produkte të cilat për nga pesha apo kualiteti nuk i përgjigjen asaj që rregullisht parashihet te produktet e tilla;
- 3) Forma e tretë e veprimit me të cilën kryhet kjo vepër penale është rasti kur në qarkullim lëshohen produkte pa shenja që tregojnë përmbajtjen, llojin, prejardhjen apo kualitetin e tyre, kur shenja e tillë kërkohet me ligj.

Vepra penale konsiderohet se është kryer në rastet kur produktet e tilla vehen në qarkullim.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është paraparë dënimi me gjobë apo me burgim deri në tri vjet.

Në paragrafin 2 të këtij neni, është paraparë një formë tjetër e kësaj vepre penale e cila gjithashtu paraqet një lloj të mashtrimit të blerësve. Kjo formë e veprës penale konsiderohet se kryhet nëse ndokush me qëllim të mashtrimit të blerësve shpall rrejshëm se është zbritur çmimi i mallit apo se pritet rritja e çmimeve ose në ndonjë mënyrë tjetër përdor haptazi reklamë të rreme.

Vepra penale konsiderohet se është kryer me ndërmarrjen e njëres nga format e theksuara të veprimit dhe me kusht që të jenë ndërmarrë me qëllim të mashtrimit të blerësve.

Për këtë formë të dytë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë apo me burgim deri në një vit.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, mirëpo për shkak të natyrës dhe përmbajtjes së saj, këtë vepër penale në të shumtën e rasteve e kryejnë personat e caktuar në ndërmarrjet tregtare.

Kjo formë e kësaj vepre penale mund të kryhet vetëm me dashje. Krahas dashjes, duhet të ekzistojë edhe qëllimi që të mashtrohen blerësit.

5. Falsifikimi i parasë (neni 296)

Sipas paragrafit 1 të nenit 296 të KPRK, këtë vepër penale e kryen kushdo që prodhon para të falsifikuara me qëllim për t'i vënë në qarkullim si të vërteta.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale sipas paragrafit 1 të nenit të lartcekur konsiston në prodhimin e parave të falsifikuara me qëllim që të njejtat të vihen në qarkullim si para të vërteta.

Me shprehjen prodhim i parave të falsifikuara duhet nënkuptuar krijimin apo bërjen e parasë së falsifikuara, me qëllim që të vihet në qarkullim si e vërtetë.

Kjo formë e kësaj vepre penale konsiderohet se është kryer në momentin kur është prodhuar apo krijuar paraja e falsifikuara, me qëllim që ajo të vihet në qarkullim si e vërtetë. Mirëpo, duhet theksuar se do të konsiderohet se është kryer kjo formë e kësaj vepre penale edhe në

rastet kur kryerësi nuk ka arritur që paranë e falsifikuar ta vërë në qarkullim, p.sh. për shkak se është zbuluar, i janë konfiskuar paratë e falsifikuara në shtëpinë apo në automjetin e tij, etj.³³⁸

Objekti i falsifikimit mund të jetë paraja e cila është në qarkullim në Republikën e Kosovës, si dhe paraja që është në qarkullim në ndonjë shtet tjetër. Sipas nenit 113 paragrafi 9 të KPRK, shprehja **”para”** do të thotë monedhë metalike dhe e letrës, e cila në bazë të ligjit është në qarkullim në Republikën e Kosovës ose në ndonjë juridiksion tjetër. Andaj, duke u bazuar në këtë objekt i falsifikimit mund të jetë si monedha metalike, ashtu edhe ajo e letrës.

Në teorinë e së drejtës penale theksohet se paraja e cila është falsifikuar duhet të jetë e ngjashme me paranë e vërtetë, përkatësisht ajo duhet të jetë e atillë që nuk mund të hetohet në shikim parë.

Objekt i veprës penale të falsifikimit të parasë, nuk mund të jenë paratë që nuk janë në qarkullim, si p.sh. marka gjermane, dinari jugosllavë, etj. Gjithashtu, objekt i kësaj i kësaj vepre penale, nuk mund të jenë as monedhat antike, që nuk janë në qarkullim, por që kanë vetëm vlera numizmatike për muzeumet.³³⁹

Për ekzistimin e kësaj vepre penale nuk është me rëndësi sasia e parasë së falsifikuar. Kjo veprë penale ekziston edhe në rastet kur është prodhuar apo përdorur vetëm një monedhë. Sasia, përkatësisht vlera e monedhave të falsifikuara mund të merret parasysht vetëm me rastin e matjes së dënimit nga ana e gjykatës.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata i ka shpallur fajtorë të akuzuarit L.K., I.K. dhe K.SH., për shkak të veprës penale falsifikimi i parasë, sepse më datën 06.11.2008, në Gjilan, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, në bashkëveprim dhe me dashje kanë bërë prodhimin e parave të falsifikuara në shumë prej 650 € dhe atë në apoene prej 5, 10, 20 dhe 50 €, përmes një aparati të markës “HPpcs 2175-skaner”, në atë mënyrë që i akuzuari I.K., ka bërë prodhimin e këtyre parave të falsifikuara, i akuzuari K.SH. ka dhënë idenë dhe ka ofruar fletët e formatit A4, kurse i akuzuari L.K. ka bërë prerjen e këtyre parave të falsifikuara, të gjitha këto me qëllim për t’i vënë në qarkullim si të vërteta, kështu që ditën kritike pas një punë operative të Policisë së Kosovës, janë nxënë në kryerjen e veprës penale dhe janë arrestuar.³⁴⁰

Kjo formë e kësaj vepre penale mund të kryhet vetëm me dashje dhe me qëllim që paratë e falsifikaura të vihen në qarkullim si para të vërteta.

³³⁸ SALIHU, ISMET, E drejta penale, Pjesa e posaçme, f. 430.

³³⁹ ELEZI, ISMET, E drejta penale, Pjesa e posaçme, f. 242.

³⁴⁰ Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr.4/2009, i datës 03.02.2009.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Formë e veçantë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të nenit të lartcekur, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndonjë person duke ditur se paraja është e falsifikuar merr, vë në qarkullim, transporton, pranon, përdorë ose posedon parane e falsifikuar me qëllim që ta vë në qarkullim si të vërtetë.

Siç mund të shihet, veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë në marrjen, vënjën në qarkullim, transportimin, pranimin, përdorimin ose posedimin e prave të falsifikuara, me qëllim që të njejtat të vëhen në qarkullim si të vërteta.

Me shprehjen e vënë në qarkullim nënkuptohet veprimi me të cilin mundësohet që paraja e falsifikuar të përdoret në mënyra të ndryshme si e vërtetë.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në tetë vjet.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin XH.Q., për shkak të veprës penale falsifikimi i parasë, sepse i akuzuari më datën 04.09.2008, në ProCredit Bank në Ferizaj, ka vënë në qarkullim parane në shumë prej 100 €, me numër serik x13382195639, të cilën e ka ditur se është e falsifikuar, ku gjatë verifikimit të kësaj paraje nga ana e zyrtarit të autorizuar të bankës është dyshuar në origjinalitetin e saj dhe për këtë qëllim, paraja është konfiskuar përkohësisht për t'u njoftuar më pastaj Policia e Kosovës në Ferizaj, e cila pas ekzaminimit të saj në laboratorin kriminalistik ka konstatuar se kjo para është e falsifikuar.³⁴¹

Kurse, në paragrafin 3 të nenit 296 të KPRK, është parashikuar formë e lehtë e kësaj vepre penale e cila ekziston në rastet kur ndonjë person pranon parane e falsifikuar prej pesëdhjetë Euro ose më pak duke besuar se është e vërtetë dhe pastaj e përdorë duke ditur se është e falsifikuar.

Për këtë formë të lehtë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Gjithashtu, formë e lehtë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 4 të KPRK, e cila ekziston në rastet kur ndonjë person ka dijeni për prodhimin apo përdorimin e parave të falsifikuara dhe këtë nuk e raporton.

Kjo formë e lehtë e kësaj vepre penale kryhet me mosveprim, duke mos e raportuar prodhimin ose përdorimin e parave të falsifikuara.

³⁴¹ Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Ferizaj, P.nr.459/2009, i datës 29.12.2009.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Ndërsa formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 5 të nenit të lartcekur, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni ka të bëjë me një shumë të parave të falsifikuara që tejkalon njëqindmijë Euro.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me jo më pak se tre vjet burgim

Kryerës i të gjitha formave të kësaj vepre penale mund të jetë çdo person dhe të gjitha këto kryhen me dashje. Përveç dashjes, për ekzistimin e kësaj vepre penale është e domosdoshme që kryerësi të vepruar me qëllimet e lartcekura.

Në paragrafin 6 të këtij neni, paraaja e falsifikuar, si dhe pajisjet për prodhimin apo ndryshimin e saj do të konfiskohen.

6. Tregtia e ndaluar (neni 299)

Sipas paragrafit 1 të nenit 299 të KPRK, këtë veprë penale e kryen kushdo që pa autorizim shet, blen apo bën shkëmbimin e mallrave, sendeve apo shërbimeve.

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë në shitjen, blerjen apo shkëmbimin e mallrave, sendeve apo shërbimeve pa autorizim.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin A.L., për shkak të veprës penale tregtia e ndaluar, sepse i akuzuari i kishte blerë pa autorizim dhe pa dokumentacion përkatës 14 dema, në tregun e kafshëve të fshatit Roganë, Komuna e Kamenicës të cilët më pas i ngarkon në kamionin e tij, për t'i dërguar për prerje (therrje) në therrtoren e tij.³⁴²

Tregtia e ndaluar është veprë penale e përgjithshme, sepse edhe me disa dispozita tjera të KPRK janë parashikuar si veprë penale tregtia me disa mallra apo sende të caktuara, si p.sh. prodhimi dhe vënia në qarkullim e artikujve të dëmshëm ushqimorë, nga neni 261 i KPRK; blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge, nga neni 267 i KPRK; importimi, eksportimi, furnizimi, transporti, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse, nga neni 364 i KPRK, etj. Andaj, në raste të tilla, duke u bazuar në parimin e specialitetit, shitja e artikujve të dëmshëm ushqimorë, shitja e narkotikëve ose shitja e armëve, nuk do të kualifikohen si veprë penale e tregtisë së ndaluar, nga neni 299 i KPRK, por të kualifikohen sipas neneve të lartcekura.

³⁴² Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Kamenicë, P.nr.109/2004, i datës 02.06.2005.

Për ekzistimin e veprës penale tregtia e ndaluar duhet që veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale (blerja, shitja ose shkëmbimi), të bëhen pa autorizim.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej tre muajve deri në katër vjet.

Formë tjetër e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se është kryer nëse personi i cili kryen veprën nga paragrafi 1 i këtij neni për herë të parë dhe kur vlera e mallrave nuk tejkalon shumën prej pesëqind (500) Euro, për të cilën është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 3 të nenit të lartekur, e cila ekziston në rastet kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga personi i cili ka organizuar rrjetin e shitësve ose të ndërmjetësve apo ka realizuar përfitim që kalon shumën prej pesëmbëdhjetëmijë Euro, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në tetë vjet.

Në paragrafin 4 të këtij neni, është parashikuar se mallrat dhe sendet nga tregtia e ndaluar do të konfiskohen.

Kryerësi i kësaj vepre penale (formës themelore dhe formës së rëndë) mund të jetë çdo person.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

7. Shmangia nga tatimi (neni 307)

Sipas paragrafit 1 të nenit 907 të KPRK, formën themelore të kësaj vepre penale e kryen kushdo i cili me qëllim që ai apo personi tjetër të fsheh apo t'i shmanget, pjesërisht apo tërësisht, pagesës së tatimit, apo kontributeve të tjera që kërkohen me ligj, apo i shmanget tatimit duke përfituar rimbursimet tatimore apo kreditë tatimore të pajustificuara, jep të dhëna të pavërteta për të ardhurat apo nuk i përfshin të dhënat lidhur me të ardhurat e tij, gjendjen ekonomike apo fakte të tjera, ose përndryshe ofron informata false relevante për vlerësimin e detyrimeve të tilla.

Kjo vepër penale për nga natyra dhe përmbajtja është e natyrës blankete, ngase me ligje të posaçme janë të përcaktuara obligimet dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me tatimet në Kosovë. Ligje të kësaj natyre konsiderohen : Ligji për tatimin në vlerën e shtuar,³⁴³ Ligji për tatimin në të ardhurat personale,³⁴⁴ Ligji për tatimin në të ardhurat e korporatave³⁴⁵ dhe ligje tjera të posaçme.³⁴⁶

³⁴³ Ligji nr.05/L-037 Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar, i datës 17.08.2015.

³⁴⁴ Ligji nr.05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale, i datës 14.08.2015.

³⁴⁵ Ligji nr.06/L- 105 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, i datës 19.07.2019.

³⁴⁶ Më gjerësisht lidhur me ligjet tjera të kësaj natyre, shih : Legjislacioni Tatimor i Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, Botimi I, Prishtinë, 2010.

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë në dhënien e të dhënave të pavërteta për të ardhurat ose në mospërfshirjen e informative lidhur me të ardhurat, gjendjen ekonomike apo faktet tjera relevante për vlerësimin e detyrimeve të lartcekura.

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale duhet të kryhen me qëllim që kryerësi apo personi tjetër t’i shmanget pjesërisht apo tërësisht pagimit të tatimit, tarifave apo kontributeve të tjera të përcaktuara me ligj.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin M.R., për shkak të veprës penale shmangia nga tatimi, sepse i akuzuari në cilësinë e pronarit të kompanisë NSH “NN”, me numër të biznesit 1234567, me seli në Gjilan, në periudhën kohore prej 19.04.2006 deri më 31.01.2009, sipas raportit të Administratës Tatimore të Kosovës në Gjilan, ju ka shmangur pagesës së tatimit nga vlera e shtuar në shumë prej 10.366.42 €, duke e dëmtuar për këtë shumë buxhetin e Republikës së Kosovës.³⁴⁷

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje, e cila në vete përfshinë edhe qëllimin e kryerësit për t’iu shmangur pagesës së tatimit, tarifave apo kontributeve të tjera të përcaktuara me ligj.

Për formën themelore të kësaj vepre penale është parashikuar në mënyrë kumulative dënimi me gjobë dhe me burgim deri në katër vjet.

Në paragrafin 2 të këtij neni, është parashikuar forma e rëndë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se kryhet nëse shuma e detyrimit nga paragrafi 1 i këtij neni, pagimi i të cilit shmanget është më e lartë se pesëmbëdhjetëmijë Euro.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar në mënyrë kumulative dënimi me gjobë dhe me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 3 të nenit të lartcekur, e cila ekziston në rastet detyrimi nga paragrafi 1. i këtij neni tejkalon shumë prej pesëdhjetëmijë Euro, për të cilën është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej një deri në tetë vjet.

8. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli

Në këtë Kapitull, bëjnë pjesë edhe këto vepra penale :

- Veprimtaria e pandërgjegjshme ekonomike (neni 279),
- Shkaktimi i falimentit të rrejshëm (neni 281),

³⁴⁷ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, P.nr.612/2009, i datës 26.11.2009.

- Mashtrimi në procedurën e falimentimit (neni 282),
- Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve (neni 283),
- Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi (neni 284),
- Lidhja e kontratës së dëmshme (neni 285),
- Falsifikimi i letrave me vlerë dhe instrumenteve të pagesës (neni 287),
- Falsifimi i shenjave me vlerë (neni 288),
- Cenimi i të drejtave të patentës (neni 289),
- Cenimi i të drejtave të autorit (neni 290),
- Shmangia e masave teknologjike (neni 291),
- Mashtrimi i konsumtarove (neni 292),
- Organizimi i skemave piramidale dhe i bixhozit të paligjshëm (neni 294),
- Keqpërdorimi i pozitës së monopolit (neni 295),
- Prodhimi dhe përdorimi i shenjave të etiketave, masave dhe peshave të rreme (neni 297),
- Prodhimi, furnizimi, shitja, posedimi ose dhënia në shfrytëzim e mjeteve për falsifikim (neni 298),
- Prodhimi i ndaluar (neni 300),
- Lëshimi i çeqeve pa mbulesë ose të rreme dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo kreditit (neni 301),
- Shpërlarja e parave (neni 302),
- Marrëveshjet për kufizimin e konkurrencës përmes ftesave për tender (neni 303),
- Mashtrimi në shkëmbimin e letrave me vlerë (neni 304),
- Keqpërdorimi i informatave të brendshme (neni 305),
- Marrëveshja dhe mashtrimi me letrat me vlerë të Qeverisë (neni 306),
- Dokumentet e rrejshme lidhur me tatimin (neni 308),
- Pranimi i ryshfetit në sektorin privat (neni 309),
- Dhënja e ryshfetit në sektorin privat (neni 310),
- Kontrabandimi i mallrave (neni 311) dhe
- Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore (neni 312).

KAPITULLI XIII

VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË

I. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME

Veprat penale kundër pasurisë përbëjnë një ndër Kapitujt më të rëndësishëm të pjesës së posaçme të KPRK.

Veprat penale kundër pasurisë bëjnë pjesë në kuadër të të ashtuquajturit “**kriminalitet klasik**”, ngase shumica e veprave penale të këtij Kapitulli kanë qenë të njohura edhe në ligjet më të vjetra penale. Ky Kapitull i veprave penale është i njohur, me disa ndryshime të vogla, në të gjitha ligjet penale të shteteve bashkëkohore.

Në përgjithësi, objekt mbrojtësi i këtij Kapitulli të veprave penale është pasuria. Me termin “pasuri” kuptojmë sendet e paluajtshme, sendet e luajtshme, të drejtat dhe interesat pasurore të cilat i takojnë subjekteve të së drejtës (personave fizikë dhe juridikë).

Mirëpo, duhet theksuar se pasuria mbrohet edhe me kapitujt tjerë të KPRK, p.sh. me Kapitullin e veprave penale kundër ekonomisë, me Kapitullin korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, me Kapitullin e veprave penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë, etj. Ndryshe nga Kapitujt tjerë të KPRK, në të cilat gjithashtu në mënyrë indirekte garantohet mbrojtja e pasurisë, në Kapitullin e veprave penale kundër pasurisë garantohet mbrojtja parësore dhe e drejtpërdrejtë e pasurisë.

Pasuria, përveç me KPRK është e mbrojtur edhe me akte tjera juridike. Në këtë drejtim pasuria mbrohet dhe garantohet edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 46), pastaj me Ligjin për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore,³⁴⁸ si dhe me ligje tjera civile. Duhet theksuar, se shteti mbrojtjen e pasurisë, parimisht e realizon me dispozitat e ligjeve civile dhe ekonomike, kurse me dispozitat e ligjeve penale vetëm atëherë kur deri te rrezikimi i pasurisë, bëhet duke e përdorur dhunën, kanosjen, mashtrimin dhe veprimet tjera të rrezikshme.

Shumicën e veprave penale të këtij Kapitulli mund t’i kryejë çdo person (*delicta communia*). Mirëpo, disa prej këtyre veprave penale mund t’i kryejnë vetëm personat që posedojnë cilësi të caktuara, p.sh. veprën penale të keqpërdorimit të besimit, etj.

Veprat penale kundër pasurisë mund të kryhen vetëm me formën më të rëndë të fajësisë, përkatësisht vetëm me dashje. Për asnjë vepër penale që bënë pjesë në këtë Kapitull nuk është parashikuar në mënyrë shprehimore se mund të kryhen edhe nga pakujdesia.

Karakteristikë themelore e shumicës së veprave penale kundër pasurisë është se pjesa dërmuese e tyre kryhen me qëllim të përfitimit pasuror të kundërligjshëm për vete apo për persona të tjerë

³⁴⁸ Ligji Nr. 03/L-154 Për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, i datës 25.06.2009.

(p.sh. vepra penale e vjedhjes, vjedhjes së rëndë, etj.). Mirëpo, disa vepra penale kryhen edhe me qëllime tjera, p.sh. vepra penale e marrjes në posedim e pasurisë së luajtshme, kryhet me qëllim të mbajtjes në posedim të pasurisë, por jo të përvetësimit, ose vepra penale e dëmtimit të drejtave të personit tjetër, kryhet me qëllim të pengimit të realizimit të kërkesave pasurore përkatësisht me qëllim të pengimit të pagimit të borxhit, etj. Te disa vepra tjera penale të këtij Kapitulli, qëllimi i kryerësit është që vetëm të dëmtohet pasuria e tjetërit, p.sh. vepra penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë.

Ndjekja penale për shumicën e këtyre veprave penale ndërmirret sipas detyrës zyrtare. Mirëpo, për disa vepra penale ndjekja ndërmirret sipas propozimit të palës së dëmtuar, p.sh. vepra penale shpërdorimi i pasurisë së huaj nga neni 318 paragrafi 7 të KPRK, etj. Kurse, në nenin 335 të KPRK, është parashikuar se kur vepra penale nga nenet 313, 314, 315 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1., 320, 321 paragrafi 1, 330 paragrafi 1 dhe 332 i këtij Kodi kryhet ndaj personit të cilin kryesi e ka anëtar të familjes, procedura penale fillohet sipas propozimit kur shuma e përfshirë është më pak 250 Euro.

II. VEPRAT PENALE TË KËTIJ KAPITULLI

1. Vjedhja (neni 313)

Në KPRK, njihen disa lloje të vjedhjeve, si vjedhja (neni 313), vjedhja e rëndë (neni 315), vjedhja e shërbimeve (neni 314), vjedhja e pyllit (neni 349), vjedhja grabitqare (neni 316), etj.

Vepra penale e vjedhjes, nga neni 313 i KPRK, është njëra ndër veprat penale kryesore dhe më të rëndësishme të Kapitullit të veprave penale kundër pasurisë. Kjo formë e vjedhjes e paraparë në këtë nen, në shkencën e së drejtës penale ndryshe emërtohet si **“vjedhje e rëndomtë”**.

Vepra penale e vjedhjes njihet nga të gjitha ligjet penale të shteteve bashkëkohore. Këtë veprë penale e kanë njohur edhe ligjet më të vjetra penale të shteteve të ndryshme.

Gjithashtu, këtë veprë penale e ka paraparë edhe Kanuni i Lekë Dukagjinit, Kanuni i Skënderbeut dhe kanune tjera lokale, të cilat i kanë kushtuar rëndësi të veçantë.³⁴⁹

Sipas nenit 313 paragrafi 1 të KPRK, vepra penale e vjedhjes ekziston nëse ndokush personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej 50 Euro apo më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër.

Nga kjo dispozitë ligjore, rezulton se elementet e veprës penale të vjedhjes janë :

- a) marrja,
- b) pasurisë së huaj,
- c) pasuria duhet të vlerësohet në shumën prej 50 Euro apo më shumë dhe

³⁴⁹ ELEZI, ISMET: Mbrojtja juridike penale e pasurisë, f. 17-30.

d) me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër. Për dallim nga KPRK, në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, vepra penale e vjedhjes është përcaktuar me një formulim shumë të thjeshtë. Në nenin 134 të këtij Kodi, kjo veprë penale është përcaktuar në këtë mënyrë “Vjedhja e pasurisë dënohet me gjobë ose me burgim gjër në tre vjet”.

Veprimi i kryerjes së veprës penale të vjedhjes sipas paragrafit 1 të nenit të lartcekur është marrja e kundërligjshme e pasurisë së huaj që vlerësohet në shumën prej 50 Euro ose më shumë.

Marrja e pasurisë së luajtshme, si veprim i kryerjes së kësaj veprë penale realizohet në mënyra të ndryshme, por në praktikë më së shpeshti manifestohen vjedhjet nga xhepat, vjedhjet nëpër shitore dhe markete, vjedhjet e biçikletave, vjedhja e rrymës elektrike, vjedhja e bagëtime, vjedhjet nëpër automjete, vjedhja e kablove elektrike, vjedhjet nëpër shtëpi dhe banesa, etj.

Në shkencën e së drejtës penale ekzistojnë disa teori lidhur me atë se kur konsiderohet se është kryer vepra penale e vjedhjes.

Sipas **teorisë së kontrektacionit**, konsiderohet se është kryer vepra penale e vjedhjes në momentin kur kryerësi e prekë pasurinë, e cila është objekt i vjedhjes.

Sipas **teorisë së ablacionit**, vepra penale e vjedhjes është kryer në momentin kur pasuria është bartur, prej një vendi në vendin tjetër.

Sipas **teorisë së ilacionit**, vepra penale e vjedhjes konsiderohet se është kryer kur sendi i vjedhur është bartur (dërguar) në një vend të sigurt, përkatësisht kur sendi që është objekt i i kësaj veprë penale është fshehur.

Sipas **teorisë së aprehenzionit**, vepra penale e vjedhjes konsiderohet se është kryer në momentin kur sendi i vjedhur është vënë nën pushtetin faktik të kryerësit.

Në shkencën e së drejtës penale dhe praktikën gjyqësore, është përvetësuar në një masë të madhe teoria e aprehenzionit dhe vepra penale e vjedhjes konsiderohet se është kryer në momentin kur sendi i vjedhur është ndarë nga pronari i saj i ligjshëm dhe është vënë në posedim (nën pushtetin faktik) të kryerësit.

Pra, konsiderohet se ekziston marrja e pasurisë së huaj, në rastet kur ndërpritet posedimi i pronarit ndaj pasurisë dhe themelohet posedimi nga personi tjetër, përkatësisht nga kryerësi i veprës penale të vjedhjes.

Për të ekzistuar vepra penale e vjedhjes, marrja e pasurisë së huaj duhet të jetë e kundërligjshme përkatësisht pa bazë ligjore.

Objekt i veprës penale të vjedhjes mund të jetë vetëm pasuria e luajtshme. Me termin pasuri e luajtshme kuptojmë të gjitha sendet të cilat mund të barten prej një vendi në vendin tjetër, pa e humbur substancën dhe vlerën e tyre.

Objekt i kësaj veprë penale mund të jenë edhe disa sende, që sipas të drejtës civile konsiderohen si sende të paluajtshme, si p.sh. dyert, dritaret, tjegullat, vaska, etj. të cilat janë pjesë përbërëse e sendeve të paluajtshme (shtëpive, banesave, etj.). Të gjitha këto sende sipas të drejtës penale konsiderohen si sende të luajtshme dhe mund të jenë objekt i veprës penale të vjedhjes.

Objekt i veprës penale të vjedhjes mund të jenë edhe disa dokumente me të cilat realizohet ndonjë e drejtë, p.sh. kartela e bankës, bileta për teatër apo koncert, bileta e autobusit, e aeroplanit, trenit, etj. Gjithashtu, objekt i kësaj veprë penale mund të jenë edhe impulset telefonike, të internetit, të televizioneve kablllore, kartelat për mbushjen e telefonave mobil me kredi, energjia elektrike e prodhuar apo të grumbulluar për ndriçim, ngrohje, qarkullim, etj.

Në shkencën e së drejtës penale janë bërë përpjekje që të përcaktohen disa kritere, në bazë të të cilave disa sende nuk mund të jenë objekt i veprës penale të vjedhjes.

Në radhë të parë, është përvetësuar mendimi se objekt i veprës penale mund të jenë vetëm sendet që kanë ndonjë vlerë ekonomike dhe që shërbejnë për plotësimin e nevojave të qytetarëve. Pra, objekt i kësaj veprë penale nuk mund të jenë sendet që nuk kanë kurrfarë vlere ekonomike.

Objekt i veprës penale të vjedhjes nuk mund të jenë as këto sende :

- sendet e braktisura (res derelictus),
- sendet e paluajtshme (toka, shtëpia, ndërtesat, etj.),
- prona intelektuale,³⁵⁰
- sendet që nuk janë në posedim të askujt (ajri, rrezet e diellit, rrjeshjet e shiut, të borës, uji në detin e hapur, etj.),³⁵¹
- trupi i një njeriu të vdekur, përveç protezave apo pajisjeve tjera mjekësore, dhëmbëve të florinjte, të cilat mund të jenë objekt i veprës penale të vjedhjes, etj.

Duke u bazuar në nenin 313 paragrafi 1 të KPRK, objekt i veprës penale të vjedhjes duhet të jetë pasuria e huaj, pasuria e një personi tjetër. Personi tjetër (subjekti pasiv i veprës penale, viktima) mund të jetë person fizik apo person juridik. Nga kjo rezulton se personi nuk mund ta vjedhë pasurinë e vet, por vetëm pasurinë e një personi tjetër, pa marr parasysh nëse ky person e ka fituar atë send në mënyrë të ligjshme apo të paligjshme. Mund të vidhet edhe sendi i cili më parë ka qene i vjedhur. P.sh. personi A, e vjedh telefonin mobil nga personi B, të cilin telefon personi B e kishte vjedhur më parë nga personi C.

Disa shkencëtarë të së drejtës penale mendojnë se nuk duhet të konsiderohen si vepra penale të vjedhjes, as vjedhjen e “sendeve familjare” kur ato vidhen nga bashkëfamiljarët - midis të

³⁵⁰ ELEZI, ISMET: Mbrojtja juridike penale e pasurisë, f. 65.

³⁵¹ SHALA, AFRIM, Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, f. 230.

paralindurve dhe të paslindurve, midis vëllezërve dhe motrave, etj. dhe duhet përjashtuar nga përgjegjësia penale kryerësve të këtyre veprave.

Sipas të drejtës sonë penale, në këto raste nuk përjashtohet përgjegjësia penale, përkatësisht vjedhja e “sendeve familjare”, konsiderohet vepër penale e vjedhjes, nga neni 313 i KPRK. Në nenin 335 të KPRK, është parashikuar se nëse vepra penale e vjedhjes, nga neni 313 të KPRK, kryhet ndaj personit të cilin kryesi e ka anëtar të familjes, procedura penale fillohet sipas propozimit kur shumta e përfshirë është më pak 250 Euro. Këto vepra penale të vjedhjes së “sendeve familjare”, nga anëtarët e familjes, në shkencën e së drejtës penale ndryshe emërtohen si “**vjedhje të privileguara**”.

Kryerës i veprës penale të vjedhjes mund të jetë çdo person (*delicta communia*).

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje. Krahas dashjes, për t’u konsideruar se ekziston kjo vepër penale, duhet që marrja e sendit të huaj të bëhet me qëllim të përvetësimit të pasurisë për vete ose për personin tjetër. Vepra penale e vjedhjes ekziston, edhe në ato raste kur kryerësi në mënyrë të kundërligjshme e merr sendin me qëllim që atë send ta përvetësojë një person tjetër. P.sh. personi A e vjedhë kompjuterin e personit B, me qëllim që këtë kompjuter ta përvetësojë (t’ia japë) personi C. Nëse nuk ekziston qëllimi i përvetësimit të sendit, atëherë nuk mund të bëhet fjalë për veprën penale të vjedhjes, por mund eventualisht të shprehen elementet e ndonjë vepre tjetër penale, si p.sh. vepra penale marrja në posedim e pasurisë së luajtshme, nga neni 319 i KPRK.

Në paragrafin 2 të nenit 313 të KPRK, është parashikuar forma e lehtë e veprës penale të vjedhjes. Në këtë dispozitë ligjore, është parashikuar se nëse vlera e pasurisë së vjedhur është më pak 50 Euro, atëherë kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

2. Vjedhja e rëndë (neni 315)

Vepra penale vjedhja e rëndë, në shkencën e së drejtës penale ndryshe emërtohet edhe si “**vjedhje e cilësuar apo e kualifikuar**”.

Vepra penale e vjedhjes së rëndë, nga neni 315 i KPRK, kryhet në rastet kur vepra penale e vjedhjes së rëndomtë, nga neni 313 paragrafi 1 t KPRK, kryhet në rrethana të kualifikuara (cilësuar), të cilat i japin karakterin e vjedhjes së rëndë.

Në nenin 315 të KPRK, janë caktuar dy grupe të rrethanave të kualifikuara (të cilësuar), për shkak të të cilave vjedhja e rëndomtë konsiderohet vjedhje e rëndë.

- 1) **Grupi i parë** i rrethanave të kualifikuara janë të përcaktuara në nenin 315 paragrafi 1 të KPRK, në kuadër të të cilit bëjnë pjesë katër nëngrupe të këtyre rrethanave të kualifikuara dhe atë :
 - a) Nëse vepra është kryer duke thyer, kaluar apo depërtuar me forcë në veturat e mbyllura, ndërtesat, dhomat, arkat, sanduqet apo hapësirat tjera të mbyllura ose

duke hequr pengesat tjera me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme. Të mbyllura konsiderohen ato hapësira në të cilat personi nuk mund të hyj pa zotërimin paraprak të pengesave. Më së shpeshti këto pengesa qëndrojnë në vendosjen e bravës së derës, të drynit, rrethimi i ndonjë vendi me mure të larta, vendosja e rrethojave tjera, etj. Përveç këtyre, hapësira të mbyllura konsiderohen edhe valixhet e udhëtimit, arkat e dorës, automjetet, kampshtëpizat, etj. Për ekzistimin e kësaj forme të veprës penale të vjedhjes së rëndë, duhet që këto pengesa të jenë mënjeluar duke i thyer me forcë, apo me përdorimin e forcës. Thyerja me forcë do të ekzistonte në praktikë, kur kryerësi e thyen bravën e derës apo drynin, kur i rrëzon dyert, kur e thyen dritaren, etj. Heqja e pengesave tjera, do të ekzistonte nëse kryerësi e mbyllon kamerën vëzhguese e cila ka qenë e vendosur në hyrje të oborrit të shtëpisë apo duke i dhënë ushqim e fut në kurth (në ndonjë kafaz) qenin, i cili e ka ruajtur shtëpinë, etj.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin A.M., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë, sepse më datën 16.11.2008, rreth orës 21:30 minuta, në Gjilan, i akuzuari A.M. me qëllim që vetit t'i sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror ka kryer vjedhje në dëm të të dëmtuarit XH.K., në atë mënyrë që duke e shfrytëzuar mosprezencën e askujt në shtëpi, e hap me forcë derën e kësaj shtëpie, hyn brenda në të dhe merr një televizor të markës "Sony", ngjyrë hiri, në vlerë prej 300 €, një termo elektrike, në vlerë prej 150 € dhe nga një komodinë që ishte e mbyllur merr shumën e të hollave prej 9.000 €, ku me sendet e vjedhura largohet në drejtim të panjohur.³⁵²

Në një çështje tjetër penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin X.E., për shkak të kësaj vepre penale, sepse i akuzuari me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasuror për vete, duke e përdorur forcën përmes një mjete deri më tani të paidentifikuar, e ka hapur një derë të automjetit të llojit "Audi A4", me tabela të regjistrimit 111-KS-222, i cili ishte i parkuar, hyn brenda në të, ku më pastaj e ka aktivizuar këtë automjet dhe duke drejtuar automjetin është larguar nga vendi i ngjarjes.³⁵³

- b) Nëse vjedhja është kryer duke vepruar në mënyrë posaçërisht të rrezikshme ose të vrazhdë. Veprimi i kryerjes së kësaj forme të vjedhjes së rëndë është përcaktuar në mënyrë alternative : duke vepruar në mënyrë posaçërisht të rrezikshme, ose duke vepruar në mënyrë të vrazhdë. Mënyrë posaçërisht e rrezikshme konsiderohet nëse kryerësi gjatë kryerjes së vjedhjes vepron në atë mënyrë ose përdor mjete të atilla me të cilat rrezikohet jeta ose pasuria e të dëmtuarit apo ndonjë personit tjetër. P.sh. vjedhja e eksplozivit ose e ndonjë materie tjetër (gazit, derivateve, etj.) që ndizen lehtë, pa përdorur kurrfarë mase të sigurimit kundër zjarrit. Gjithashtu, mënyrë posaçërisht e rrezikshme ekziston nëse kryerësi vjedhjen e kryen duke e rrënuar murin me dinamit, duke i vënë zjarrin derës, etj. Mënyrë e vrazhdë ekziston nëse me rastin e kryerjes së vjedhjes, kryerësi

³⁵² Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, P.nr.145/2009, i datës 05.05.2009.

³⁵³ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, P.nr.210/2005, i datës 06.04.2006.

manifeston aso vrazhdësie e cila për nga intensiteti e tejkalon kufirin e vrazhdësisë që është e zakonshme apo mesatare me rastin e kryerjes së kësaj veprë penale. P.sh. nëse ndonjë personi në mënyrë të shpejtë i rëmbehet kuleta nga dora, pa e përdorur dhunën ose kanosjen; kur kryerësi mbetet në markete (vetëshërbime) dhe pasi të mbyllet, pas orarit të punës i vjedh artikujt e ndryshëm; vjedhja e kryer nga kryerësit të cilën kërcejnë në kamione deri sa kamioni është në lëvizje dhe prej tyre i hedhin sendet e vjedhura, etj. Në praktikën tonë gjyqësore, si vjedhje e kryer në mënyrë të vrazhdë është konsideruar edhe vjedhja nga xhepat e brendshëm, duke i prerë xhepat; pastaj duke u futur në shtëpi përmes oxhakut apo ollukëve, litarit, etj.

- c) Nëse vjedhja është kryer duke shfrytëzuar gjendjen e krijuar si rezultat i zjarrit, vërshimit, tërmetit apo fatkeqësive të tjera. Si fatkeqësi tjera mund të konsiderohen cunami, shembja e dheut, etj. Kjo formë e vjedhjes së rëndë, kryhet gjatë kohës së ekzistimit të këtyre fatkeqësive, ku njerëzit janë të koncentruar në evitim dhe pasojave të tyre. Kryerësi duhet të jetë i vetëdijshëm se duke e shfrytëzuar këtë gjendje kryen vjedhje. Lidhur me këtë formë, nuk është e domosdoshme që vjedhja të kryhet pikërisht në ndërtesën të cilën e ka kapluar zjarri. Kjo formë e vjedhjes së rëndë konsiderohet se ekziston nëse vjedhja është kryer në ndërtesën në afërsi të ndërtesës të cilën e ka kapluar zjarri apo vendit ku është gjendja e jashtëzakonshme.
- d) Nëse vjedhja është kryer duke shfrytëzuar paaftësinë ose gjendjen tjetër të rëndë të personit tjetër. Te kjo formë e vjedhjes së rëndë është fjala për gjendjen në të cilën gjendet i dëmtuari, i cili nuk ka mundësi fizike apo psikike që ta pengojë kryerjen e veprës penale të vjedhjes. Kjo formë e vjedhjes së rëndë do të ekzistonte, p.sh. nëse kryerësi ia vjedh sendet personit me të meta fizike (të hendikepuarit), apo nëse viktima është e sëmurë, nëse kryerësi e shfrytëzon fatkeqësinë në trafik dhe nga vetura e viktimës vjedh sende të ndryshme, etj.
- 2) Grupi i dytë** i rrethanave të kualifikuara, në bazë të të cilit një vjedhje, konsiderohet vjedhje e rëndë, i referohen cilësive të pasurisë që është objekt i vjedhjes apo rrethanave tjera. Këto rrethana janë të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 315 të KPRK.

Sipas kësaj dispozite ligjore, konsiderohet se ekziston vjedhja e rëndë, në këto raste :

- a) nëse pasuria e vjedhur është me vlerë që tejkalon 5.000 €;
- b) nëse pasuria e vjedhur shërben për qëllime fetare ose është vjedhur nga ndërtesa fetare apo nga ndërtesa të tjera që shërben për mbajtjen e ceremonive fetare;
- c) pasuria e vjedhur ka vlerë kulturore, fetare apo historike; ka rëndësi të posaçme shkencore, teknike apo artistike; është pjesë e koleksionit publik, koleksionit privat të mbrojtur apo e ekspozitës publike; ose është monument natyral apo objekt i natyrës nën mbrojtje;
- d) pasuria është vjedhur nga varri;

e) pasuria e vjedhur është armë;

f) kryesi ka pasur me vete armë apo mjet tjetër të rrezikshme. Sipas kësaj dispozite ligjore, si vjedhje e rëndë konsiderohet nëse kryerësi me vete pasur ndonjë armë apo mjet tjetër të rrezikshëm. Për ekzistimin e kësaj veprë penale, arma apo mjete të rrezikshëm të cilën e ka mbajtur kryerësi gjatë vjedhjes, nuk duhet që të përdoret. Nëse arma ose mjete tjetër të rrezikshëm gjatë vjedhjes përdoren, atëherë varësisht nga rrethanat e tjera, nuk do të konsiderohet se është kryer kjo veprë penale, por do të konsiderohet se është kryer vepra penale e grabitjes apo vjedhjes grabitqare. Mjet i rrezikshëm me qëllim sulmi mund të jetë p.sh. sopata, etj.

g) kryesi ka vepruar si anëtar i grupit ose

h) kryesi ka kryer veprën penale me qëllim të kryerjes së një veprë terrorizmi sipas nenit 128 të KPRK.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata i ka shpallur fajtor të akuzuarit L.A. dhe R.A., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë, sepse të akuzuarit, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të sendeve të huaja të luajtshme dhe duke e ditur vlerën e sendeve të vjedhura, gjatë muajit shkurt të vitit 2007, në Prishtinë, nga një depo e barnave kanë vjedhur barna të llojeve të ndryshme, në vlerë të përgjithshme prej 22.000 €, të cilat më vonë ja kanë shitur një personi të tretë.³⁵⁴

Të gjitha këto forma të veprës penale të vjedhjes së rëndë mund t'i kryejë çdo person.

Sa i përket formës së fajësisë, të gjitha këto forma të kësaj veprë penale mund të kryhen vetëm me dashje dhe me qëllim të përvetësimit të pasurisë për vete ose ndonjë person tjetër.

Për format e kësaj veprë penale të paraparë në paragrafin 1 të nenit 315 të KPRK, është parashikuar dënimi me gjob dhe me burgim prej tre deri në shtatë vjet, kurse për format e parapara në paragrafin 2 të këtij neni, është parashikuar dënimi me burgim prej tre deri në dhjetë vjet.

3. Vjedhja grabitqare (neni 316)

Sipas paragrafit 1 të nenit 316 të KPRK, formën themelore të veprës penale të vjedhjes grabitqare konsiderohet se e kryen kushdo që i zënë në befasi në kryerjen e aktit të vjedhjes dhe me qëllim që pasurinë e vjedhur ta mbajë, e përdor forcën apo kanosjen serioze për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër.

Pra, konsiderohet se kryhet vepra penale e vjedhjes grabitqare në rastet kur personi i cili është hasur duke vjedhur dhe me qëllim që pasurinë e vjedhur ta mbajë, e përdor forcën apo kanosjen se do ta sulmojë jetën apo trupin e personit tjetër.

³⁵⁴ Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Prishtinë, P.nr.383/2007, i datës 16.04.2007.

Vjedhja grabitqare është veprë penale e përbërë, ngase përbëhet nga vjedhja dhe përdorimi i dhuns (forcs) apo kanosjes. Vjedhja grabitqare fillon me vjedhje dhe pasi që kryerësi është hasur në vjedhje, me qëllim që pasurinë e vjedhur ta mbajë e përdor forcën apo kanosjen se do ta sulmojë jetën apo trupin e personit. Konsiderohet se kryerësi është hasur në vjedhje në rastet kur ka filluar kryerjen e vjedhjes, por ende nuk e ka përfunduar, apo kur ik me sendin e vjedhur, sepse edhe në këtë rast konsiderohet se nuk ka përfunduar vjedhjen.³⁵⁵

Dhuna (forca) apo kanosja mund të jenë të drejtuara kundër pronarit apo poseduesit të pasurisë, por mund të jenë edhe kundër çdo personi tjetër i cili vepron në mënyrë që ta pengoj vjedhjen e pasurisë.

Dhuna (forca) apo kanosja, duhet të përdorën në momentin kur kryerësi është hasur duke e kryer veprën penale të vjedhjes.

Dhuna (forca) dhe kanksja, duhet të jenë të drejtuara kundër jetës apo trupit të personit tjetër.

Vepra penale e vjedhjes grabitqare konsiderohet se është kryer prej momentit të përdorimit të dhunës apo kanosjes, edhe në rastet kur kryerësi nuk ka pasur sukses që ta mbajë sendin e vjedhur.

Kryerësi i kësaj forme të vjedhjes grabitqare mund të jetë çdo person.

Kjo formë e kësaj veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje dhe atë vetëm me dashje direkte.

Për këtë formë të kësaj veprë penale është parashikuar dënimi me gjob dhe me burgim prej tre deri në dhjetë vjet.

Forma e rëndë e kësaj veprë penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se ekziston në rastet kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga kryerësi i cili vepron si anëtar i grupit ose i cili ka me vete armën apo mjetin e rrezikshëm.

Për këtë formë të rëndë të kësaj veprë penale është parashikuar dënimi me gjob dhe me burgim prej pes deri në dymbëdhjetë vjet.

Formë edhe më e rëndë e kësaj veprë penale është parashikuar në paragrafin 3 të nenit 316 të KPRK, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit të armatosur ose kur vepra penale rezulton me lëndim të rëndë trupor, për të cilën është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej shtatë deri në dymbëdhjetë vjet.

4. Grabitja (neni 317)

³⁵⁵ SALIHU, ISMET: E drejta penale, Pjesa e posaçme, f. 470.

Konsiderohet se kryhet forma themelore e veprës penale të grabitjes, nga paragrafi 1 i nenit 317 të KPRK, në rastet kur ndokush me përdorim të forcës apo kanosjes serioze për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, e përvetëson pasurinë e luajtshme të personit të tillë me qëllim që t'i sjellë vetes apo personit tjetër dobi pasurore të kundërligjshme.

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale konsistojnë në përvetësimin e pasurisë së luajtshme të personit tjetër, duke e përdorur dhunën (forcën) apo kanosjen

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin H.R., për vepër penale të grabitjes, sepse i akuzuari H.R., më datën 03.04.2009, rreth orës 15:30 minuta, në Gjilan, me qëllim që vehtes t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, me dashje ka kryer grabitje ndaj të dëmtuarit M.H., nga Gjilani, ashtu që hyn në shitoren e të dëmtuarit kinse për të blerë torte, më pastaj duke përdorur dhunën dhe kanosjen se aty për aty do ta sulmojë jetën dhe trupin e tij, ia mbyll gojën dhe e godet me grushta në kokë, ku më pas e ka rrëzuar të dëmtuarin për dysheme dhe nga arka e shitorës ia merr shumën e të hollave prej 190 € dhe largohet në drejtim të rrugës kryesore.³⁵⁶

Kjo vepër penale, sikur edhe vepra penale vjedhja grabitqare, është vepër penale e përbërë, ngase përbëhet prej përdorimit të dhunës (forcës) apo kanosjes dhe vjedhjes.

Mjete të kryerjes së kësaj vepre penale janë dhuna (forca) apo kanosja.³⁵⁷ Duke u bazuar në dispozitën e lartcekur ligjore, dhuna (forca) ose kanosja duhet të jenë të drejtuara kundër personit, e jo edhe kundër pasurisë.

Vepra penale e grabitjes ka ngjashmëri me veprën penale të vjedhjes grabitqare, por edhe dallohet prej saj. Dallimi midis këtyre dy veprave penale qëndron në faktin se te vepra penale e grabitjes, dhuna (forca) apo kanosja janë mjete për marrjen e sendit të huaj, ndërsa te vepra penale e vjedhjes grabitqare, dhuna (forca) apo kanosja janë mjete për mbajtjen e sendit të vjedhur. Te vepra penale e grabitjes, dhuna (forca) apo kanosja përdoren (ushtrohen) para se të fillojë kryerja e vjedhjes, respektivisht dhuna (forca) apo kanosja i paraprijnë vjedhjes, kurse te vepra penale e vjedhjes grabitqare, dhuna (forca) apo kanosja përdoren (ushtrohen) gjatë kryerjes apo menjëherë pas kryerjes së vjedhjes.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje dhe me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme të personit tjetër.

Për formën themelore të veprës penale të grabitjes nga paragrafi 1 i këtij neni, është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej tre deri në dymbëdhjetë vjet.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se ekziston nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni ka të bëjë me sendin e vjedhur

³⁵⁶ Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr.91/2009, i datës 18.09.2009.

³⁵⁷ Kjo vepër penale është parashikuar në nenin 139 të KPRSH dhe emërtohet "Vjedhje me dhunë".

me vlerë që tejkalon 5.000 € dhe nëse kryerësi ka për qëllim ta përvetësojë sendin me vlerë të tillë. Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej pesë deri në dymbëdhjetë vjet.

Në paragrafin 3 të këtij neni, është parashikuar formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga kryerësi duke vepruar si anëtar i grupit ose i cili ka me vete armën apo mjetin e rrezikshëm, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej shtatë deri në dymbëdhjetë vjet.

Në paragrafin 2 të nenit të lartcekur, është parashikuar një formë tjetër e rëndë e veprës penale të grabitjes, e cila ekziston në rastet kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit të armatosur ose kur vepra penale rezulton me lëndim të rëndë trupor.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Ndërsa, në paragrafin 5, është parashikuar forma edhe më e rëndë e kësaj vepre penale, e cila ekziston në rastet kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekje, për të cilën është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej së paku dhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

5. Shpërdorimi i pasurisë së huaj (neni 318)

Formën themelore të kësaj vepre penale, sipas paragrafit 1 të nenit 318 të KPRK, e kryen kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo personit tjetër, e përvetëson pasurinë e cila i është besuar atij apo personit tjetër.

Veprimi i kryerjes së kësaj forme të veprës penale qëndron në përvetësimin e pasurisë së luajtshme të personit tjetër, e cila i është besuar kryesit apo personit tjetër.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin M.B., për shkak të kësaj vepre penale, sepse i akuzuari M.B., me qëllim që vetes t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme, nuk e kishte kthyer tek punëdhënësi kompjuterin - laptopin, i cili të akuzuarit i është besuar që të marrë në shtëpinë e tij për të kryer punë të caktuara.³⁵⁸

Kjo veprë penale ka ngjashmëri me veprën penale të vjedhjes, por edhe dallohet nga kjo. Element i përbashkët i këtyre dy veprave penale është ai se edhe te njëra, edhe te tjetra veprë penale, kryerësi e përvetëson sendin e huaj të luajtshëm me qëllim që vetes apo tjetrit t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme. Dallimi midis këtyre veprave penale, qëndron në faktin se te

³⁵⁸ Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Prishtinë, P.nr.175/2005, i datës 03.11.2008.

vepra penale e vjedhjes, sendi të cilin e përvetëson kryerësi gjendet në posedim të tjetrit, ndërsa te vepra penale e shpërdorimit të pasurisë së huaj, kryerësi e ka në posedim sendin dhe këtë në mënyrë të ligjshme, ngase i është besuar.

Kryerës i kësaj forme të veprës penale mund të jetë çdo person.

Kjo veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje. Përveç dashjes, për ekzistimin e kësaj vepre penale duhet që vepra të kryhet me qëllim të përvetësimit të pasurisë së huaj të luajtshme.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim deri në një vit.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se ekziston nëse veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni, e kryen kujdestari, avokati apo ndonjë person tjetër që ka detyrim ligjor ndaj pronarit të pasurisë, për të cilën është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim deri në tri vjet.

Në paragrafin 3 të këtij neni, është parashikuar një formë tjetër e rëndë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se ekziston nëse vlera e pasurisë së përvetësuar e tejkalon shumën prej 10.000 €.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë dhe burgim prej një deri në pesë vjet.

Formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 4 të këtij neni, e cila konsiderohet se ekziston nëse pasuria e përvetësuar ka vlerë kulturore, fetare apo historike; ka rëndësi të posaçme shkencore, teknike apo artistike; është pjesë e koleksionit publik, koleksionit privat të mbrojtur apo e ekspozitës publike; ose është monument natyral apo objekt i natyrës nën mbrojtje, për të cilën është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej një deri në tetë vjet.

Në paragrafin 5 të këtij neni, është parashikuar një formë e posaçme e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush në mënyrë të kundërligjshme përvetëson pasurinë e luajtshme të personit tjetër, të cilën ai e ka gjetur ose tek posedimi i së cilës ka arritur rastësisht, me qëllim që vetes ose personit tjetër t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme.

Për këtë formë të veçantë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim deri në një vit.

Nëse vlera e pasurisë së përvetësuar është më pak se 50 Euro, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

Sipas paragrafit 7 të këtij neni, procedura penale për veprën penale nga paragrafi 1 dhe 5 i këtij neni fillohet sipas propozimit.

6. Marrja në posedim e pasurisë së luajtshme (neni 319)

Këtë veprë penale sipas paragrafit 1 të nenit 319 të KPRK, e kryen kushdo që në mënyrë të kundërligjshme merr pasurinë e luajtshme të personit tjetër që ta mbajë në posedim të vetin pa qëllim të përvetësimit.

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale konsistojnë në marrjen e pasurisë së luajtshme të personit tjetër. Kjo veprë penale ka ngjashmëri me veprën penale të vjedhjes, nga neni 313 i KPRK, sa i përket veprimit të kryerjes. Dallohet nga vepra penale e vjedhjes, nga neni 313 të KPRK, për faktin se marrja e pasurisë së luajtshme të vepra penale e marrjes në posedim të pasurisë së luajtshme, nga neni 319 i KPRK, nuk bëhet me qëllim të përvetësimit, por vetëm me qëllim që ta mbajë në posedim.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Kështu, në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin D.V., për shkak të kësaj vepre penale, sepse i akuzuari D.V., gjatë muajit korrik të vitit 2005, në një fshat të Komunës së Gjilanit, në mënyrë të kundërligjshme e merr një cisternë në shtëpinë e F.L., që të njejtën ta mbajë në posedim të vetin, pa qëllim të përvetësimit.³⁵⁹

Kjo veprë penale konsiderohet se është kryer në momentin kur është marrë pasuria e huaj e luajtshme.

Sipas paragrafit 2 të këtij neni, tentimi i kryerjes së veprës penale nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet, nëse ka të bëjë me marrjen e automjetit nga personi tjetër.

Kjo veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje dhe me qëllim që pasurinë ta mbajë në posedim.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë apo me burgim deri në një vit.

Në paragrafin 3 të këtij neni, është parashikuar se për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni procedura penale sipas propozimit.

7. Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme (neni 320)

Sipas paragrafit 1 të neni 320 të KPRK, formën themelore të kësaj vepre penale e kryen kushdo që në mënyrë të kundërligjshme uzurpon pronën e paluajtshme të personit tjetër apo një pjesë të saj.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në uzurpimin e pronës së huaj të paluajtshme apo një pjesë të saj.

³⁵⁹ Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Gjilan, P.nr.939/2007, i datës 13.07.2009.

Pronë e paluajtshme në sensin e kësaj vepre penale duhet nënkuptuar sipërfaqen tokësore, pyjet, parqet, bregdetin, etj. Objekt i kësaj vepre penale mund të jetë si prona private, ashtu edhe prona publike.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin O.S., për shkak të kësaj vepre penale, sepse i akuzuari më datë të pavërtetuar të vitit 2005, në Kamenicë, në mënyrë të kundërligjshme ka pushtuar tokën, në sipërfaqe prej 30 m², e cila evidentohet si pronë publike, sipas çertifikatës së pronësisë nr.111, te vendi i quajtur “Risen”, me kulturë “rrugë e pakategorizuar”, në atë mënyrë që i akuzuari për rreth saj ka vendosur gurë dhe zhavor, duke pamundësuar kalimin e lirë të fqinjëve të tij.³⁶⁰

Për të ekzistuar kjo vepër penale, pushtimi duhet të jetë i kundërligjshëm apo i paligjshëm, përkatësisht pa bazë ligjore.

Për këtë formë të kësaj vepre penale, është parashikuar dënimi me gjobë apo me burgim deri në dy vjet.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se ekziston :

1. nëse prona e paluajtshme e uzurpuar është pjesë e pyllit të mbrojtur, parkut të mbrojtur apo pyllit tjetër me destinim të posaçëm, tokës ndërtimore ose rrugës;

2. nëse kryesi ka uzurpuar pronën e paluajtshme duke e ditur se pronë e tillë i është nënshtruar dëbimit me urdhër të gjykatës apo me urdhër ose vendim të ndonjë organi apo institucioni tjetër publik të themeluar në bazë të ligjit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

8. Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë së luajtshme (neni 321)

Këtë vepër penale, sipas nenit 321 paragrafi 1 të KPRK, e kryen kushdo që e asgjëson, dëmton apo e bën të papërdorshme pasurinë e personit tjetër në rrethana tjera nga ato të përcaktuara në nenin 322 të KPRK (zjarrvënia).

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë në asgjësimin, dëmtimin apo bërjen të papërdorshme të pasurisë së personit tjetër.

Shembuj nga praktika gjyqësore

³⁶⁰ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Kamenicë, P.nr.150/2005, i datës 17.08.2006.

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin H.J., për shkak të kësaj vepre penale, sepse më datën 11.10.2009, rreth orës 00:45 minuta, në Gjilan, për shkak të një mosmarrëveshje lidhur me kthimin e një borxhi me të dëmtuarin S.A., e godet me grushta veturën e të dëmtuarit, të markës “Reno”, me tabela të regjistrimit 111-KS-222, me ç’rast nga këto goditje dëmtohet (thyhet) parafangoja dhe xhami i mbrapëm i derës së djathtë të këtij automjeti dhe të dëmtuarit i shkakohet dëm i konsiderueshëm material në shumë të papërcaktuar.³⁶¹

Sendi, respektivisht pasuria e cila është objekt i kësaj vepre penale duhet të jetë e huaj. Në sensin e kësaj vepre penale, send apo pasuri e huaj, duhet të konsiderohet edhe ai send apo pasuri në të cilën kryerësi i kësaj vepre penale është bashkëpronar apo pronar i përbashkët.

Vepra penale konsiderohet se është kryer në rastet kur sendi apo pasuria e huaj është asgjësuar, dëmtuar apo është bërë e papërdorshme.

Për formën themelore të kësaj vepre penale nga paragrafi 1 i këtij neni, është parashikuar dënimi me gjobë apo me burgim deri në një vit.

Në paragrafin 2 të nenit 321 të KPRK, është parashikuar forma e rëndë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se është kryer nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton në dëm që tejkalon 5.000 Euro, për të cilën është parashikuar dënim me burgim prej një deri në tre vjet.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 3 të nenit të lartcekur, e cila ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni ka të bëjë me një send që ka vlerë kulturore, fetare apo historike; ka rëndësi të posaçme shkencore, teknike apo artistike; është pjesë e koleksionit publik, koleksionit privat të mbrojtur apo e ekspozitës publike; ose është monument natyral apo objekt i natyrës nën mbrojtje; ekspozohet në publik ose është send që shërben për përdorimin publik ose për dekorimin e sheshit, rrugës apo parkut.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim deri në tre vjet, pavarësisht dëmit të shkaktuar.

Një formë tjetër e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 4 të nenit në fjalë. Në këtë dispozitë ligjore, theksohet se nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni është kryer për shkak të motivimit në bazë të kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njëjërën nga këto karakteristika të mbrojtura, atëherë kryesi i veprës penale dënohet me burgim deri në tre vjet.

Forma themelore e kësaj vepre penale mund të kryhet vetëm me dashje, kurse për ekzistimin e formës së rëndë të kësaj vepre penale, sipas paragrafit 4, përveç dashjes, duhet që vepra penale të kryhet nga motivet lidhur me përkatësinë kombëtare, gjuhën, besimin betar, etj.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

³⁶¹ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, P.nr.1248/2009, i datës 16.06.2010.

9. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli

Përveç këtyre veprave penale, në Kapitullin e veprave penale kundër pasurisë, parashihen edhe këto vepra penale :

- Vjedhja e shërbimeve (neni 314),
- Zjarrvënia (neni 322),
- Mashtrimi (neni 323),
- Mashtrimi me subvencione (neni 324),
- Mashtrimi lidhur me pranimin e fondeve nga Komuniteti Ndërkombëtar (neni 325),
- Keqpërdorimi i besimit (neni 326),
- Hyrja në sistemet kompjuterike (neni 327),
- Detyrimi (neni 328),
- Shantazhi (neni 329),
- Keqpërdorimi i besimit (neni 330),
- Fajdeja (neni 331),
- Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër (neni 332),
- Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale (neni 333),
- Cenimi i paprekshmërisë së mjeteve motorike (neni 334),
- Vjedhja e identitetit dhe pajisja e qasjes (neni 336) dhe
- Kurdisja e ndeshjes ose e sportit (neni 337).

KAPITULLI XIV

VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT, KAFSHËVE, BIMËVE DHE OBJEKTEVE KULTURORE

SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME

Mbrojtjes së mjedisit nga ndotja në botën bashkëkohore i kushtohet një rëndësi e madhe. Për të arritur këtë synim, në shumë shtete bashkëkohore janë inkriminuar një mori veprimesh që kanë të bëjnë me ndotjen e mjedisit. Përveç, masave të karakterit juridiko-penal, me qëllim të mbrojtjes së mjedisit, janë ndërmarrë edhe masa tjera të karakterit edukativo-arsimor, ekonomik, social, etj. Gjithashtu, janë krijuar edhe organizata të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, parti politike, agjencione, ministri të posaçme, etj., me qëllim të mbrojtjes së mjedisit.³⁶²

Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore, janë parashikuar në një kapitull të posaçëm të KPRK, i cili emërtohet “Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore“. Në këtë Kapitull të KPRK, janë bërë disa ndryshime dhe plotësime, ku me këtë rast vlen të përmenden sa janë parashikuar disa vepra të reja penale të cilat nuk kanë ekzistuar më parë, siç janë : Dëmtimi i objekteve dhe i pajisjeve për mbrojtjen e mjedisit (Neni 341); Ushtrimi i kundërligjshëm i shërbimeve veterinarë (Neni 344) dhe Shitja ose nxerrja e të mirave natyrore, bimëve ose kafshëve posaçërisht të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës (Neni 352). Përveç kësaj, ky Kapitull i KPRK, ka pësuar ndryshime edhe në këto aspekte:

- te disa vepra penale është ndryshuar struktura e veprimeve të kryerjes;
- te disa vepra penale janë shtuar disa paragraf në të cilat janë parashikuar disa

forma të veprave penale përkatëse;

- për disa vepra penale është parashikuar që gjykata mund ta detyrojë kryesin që të ndërmerr masa të caktuara për mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor;

- për disa vepra penale krahas dënimit me burgim në mënyrë alternative është parashikuar edhe mundësia e shqiptimit të dënimit me gjobë;

- për disa vepra penale është parashikuar në mënyrë kumulative dënimi me gjobë dhe me burgim;

- te disa vepra penale është ndryshuar lartësia e dënimit, etj.

³⁶² SHALA, AFRIM, Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, f. 270.

Objekt mbrojtës i këtij Kapitulli të veprave penale është mjedisi, kafshët, bimët dhe objektet kulturore.

Pasojë e shumicës së veprave penale që janë të parashikuara në këtë Kapitull, është rrezikimi konkret dhe abstrakt i mjedisit. Mirëpo, për të ekzistuar disa forma të këtyre veprave penale duhet që të jetë bërë dëmtimi i të mirës juridike që është e mbrojtur me anë të këtyre veprave penale.

Shumica e veprave penale të këtij kapitulli janë të karakterit blanket, ngase lidhur me përcaktimin e tipareve të këtyre veprave penale, duhet aplikuar edhe ligjet dhe aktet tjera juridike.

Kryerës i veprave penale të këtij Kapitulli në të shumtën e rasteve mund të jetë çdo person.

Veprat penale të këtij Kapitulli, mund të kryhen me dashje, kurse format e lehta të disa veprave penale mund të kryhen edhe nga pakujdesia.

II. VEPRAT PENALE TË KËTIJ KAPITULLI

1. Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit (neni 338)

Formën themelore të kësaj vepre penale, sipas paragrafit 1 të nenit 338 të KPRK, e kryen kushdo që duke e shkelur ligjin, bën ndotjen, degradimin ose shkatërrimin e ajrit, ujit apo tokës ose shfrytëzon jashtë mase burimet natyrore.

Siç shihet, kjo vepër penale është e karakterit blanket, ngase me ligje të posaçme është rregulluar mbrojtja e ajrit, ujit, tokës dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me mjedisin. Dispozita ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, gjenden në disa ligje dhe akte nënligjore përkatësisht udhëzime administrative, por vlen të përmenden : Ligji për mbrojtjen e mjedisit,³⁶³ Ligji për parandalimin dhe kontrollimin e integruar të ndotjes,³⁶⁴ Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja,³⁶⁵ Ligji për mbrojtjen e natyrës,³⁶⁶ Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis,³⁶⁷ etj.

Veprimet e kryerjes së kësaj forme të veprës penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë në ndotjen ose degradimin e ajrit, ujit, tokës apo në shfrytëzimin jashtë mase të burimeve natyrore. Sipas nenit 4 të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, shprehja “mjedis” ka një domethënie të gjerë dhe të përgjithshme, që nënkupton rrethinën natyrore : ajrin, tokën, ujin, klimën, florën, faunën dhe trashëgiminë kulturore, si pjesë e rrethinës të cilën e ka krijuar njeriu. Andaj, edhe vepra penale ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit, nga neni 338 të KPRK, është vepër penale e përgjithshme, në raport me veprat tjera penale të këtij Kapitulli. Shprehja “ndotja e mjedisit”, sipas nenit 4 të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, nënkupton

³⁶³ Ligji Nr.03/L-025 Për Mbrojtjen e Mjedisit, i datës 26.02.2009.

³⁶⁴ Ligji Nr.03/L-043 Për Parandalimin dhe Kontrollimin e Integruar të Ndotjes, i datës 26.03.2009.

³⁶⁵ Ligji Nr.03/L-160 Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, i datës 25.02.2010.

³⁶⁶ Ligji Nr.03/L-233 Për Mbrojtjen e Natyrës, i datës 30.09.2010.

³⁶⁷ Ligji Nr.03/L-214 Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, i datës 23.09.2010.

ndikimin e drejtpërdrejtë ose e tërthortë të materieve ndotëse apo i energjisë në mjedis, e shkaktuar përmes aktiviteteve të njeriut ose përmes proceseve natyrore që kanë pasoja të dëmshme në cilësinë e mjedisit dhe në shëndetin e njeriut, kurse shprehja “degradim i mjedisit” është proces i cenimit të cilësisë së mjedisit i shkaktuar nga proceset natyrore dhe aktivitetet e njeriut. Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, veprimet e kryerjes së veprës penale ndotja ose shkatërrimi i mjedisit, konsistojnë në ndotjen e ajrit, tokës, ujit, klimës, florës, faunës dhe trashëgimisë kulturore. Ndotja ose degradimi i mjedisit mund të bëhet në mënyra të ndryshme, por më së shpeshti në praktikë bëhet duke ndezur materie të rrezikshme me të cilat ndotet ajri; derdhja në ujë, lumenj apo liqene e materieve kimike të rrezikshme, etj.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin A.D., për shkak të kësaj vepre penale, sepse më datën 21.05.2010, në orën e pacaktuar, në një fshat të Komunës së Gjakovës, në kundërshtim me ligjin, në furrat e gëlqeres ka bërë djegien e gomave të automjeteve nga të cilat lirohet tym i madh dhe në këtë mënyrë bën ndotjen e ambientit dhe shkakton rrezik për mjedisin, si dhe jetën dhe shëndetin e një numri të madh të njerëzve - banorë të këtij fshati.³⁶⁸

Për ekzistimin e kësaj vepre penale, duhet që ndotja të bëhet në përmasa të mëdha apo në sipërfaqe të gjera.

Pasoja e kësaj forme të veprës penale konsiston në shkaktimin e rrezikut për mjedisin dhe jetën apo shëndetin e një numri të madh të njerëzve.

Për formën themelore të kësaj vepre penale, sipas paragrafit 1 të nenit 338 të KPRK, është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Formë e lehtë e kësaj vepre penale, konsiderohet nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer nga pakujdesia, për të cilën është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një vit.³⁶⁹

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, e cila konsiderohet se ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton :

- me dëmtimin e shëndetit të një të numri të madh të njerëzve,
- me asgjësimin e plotë ose të pjesërishtëm të botës shtazore, bimore ose të rezervave të ujit të pijshëm apo me ndonjë dëmtim tjetër të mjedisit me pasoja të rënda, apo
- me shtimin e nivelit të ndotjes në shkallë kritike.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale të kryer me dashje është parashikuar dënimi me gjobë dhe burgim deri në pesë vjet, ndërsa për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale të kryer nga pakujdesia është parashikuar dënimi me gjobë dhe burgim deri në dy vjet.

³⁶⁸ Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Gjakovë, P.nr.248/2010, i datës 16.07.2010.

³⁶⁹ Neni 338 paragrafi 2 i KPRK.

Formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 5 dhe 6 të këtij neni, e cila konsiderohet se ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni, rezulton me dëmtim apo me shkatërrim të papërmirësueshëm të mjedisit ose me rrezikimin e pasurive të mbrojtura natyrore. Për këtë formë edhe më të rëndë të kësaj vepre penale të kryer me dashje është parashikuar dënimi me gjobë dhe burgim deri në tetë vjet, ndërsa për këtë formë edhe më të rëndë të kësaj vepre penale të kryer nga pakujdesia është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Në paragrafin 7 të nenit të lartcekur, është parashikuar forma tjetër e rëndë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 të këtij neni është kryer nga anëtari i grupit, për të cilën është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim deri në katër vjet.

Kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

2. Dëmtimi i objekteve dhe pajisjeve për mbrojtjen e mjedisit (neni 341)

Dëmtimi i objekteve dhe i pajisjeve për mbrojtjen e mjedisit është një vepër e re penale që është parashikuar në nenin 341 të KPRK. Sipas paragrafit 1 të këtij neni, formën themelore të kësaj vepre penale e kryen kushdo që i dëmton, shkatërron, heq apo në mënyrë tjetër i bënë të papërdorshme objektet apo pajisjet për mbrojtjen e mjedisit.

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë përcaktuar në mënyrë alternative dhe konsistojnë në dëmtimin, shkatërrimin, heqjen ose bërjen në ndonjë mënyrë tjetër të papërdorshme të objekteve ose pajisjeve për mbrojtjen e mjedisit. Sipas nenit 4 të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, shprehja “mjedis” ka një domethënie të gjerë dhe të përgjithshëm, që nënkupton rrethinën natyrore : ajrin, tokën, ujin, klimën, florën, faunën dhe trashëgiminë kulturore, si pjesë e rrethinës të cilën e ka krijuar njeriu.

Për këtë formë të kësaj vepre penale, është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në katër vjet.

Formë e lehtë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia dhe për këtë formë të lehtë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Në paragrafin 3 dhe 4 të nenit 350 të KPRK, është parashikuar formë e rëndë e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se kryhet, nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni, rezulton me ndotjen e ajrit, ujit apo tokës në shkallë të madhe apo territor të gjerë. Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale të kryer me dashje është parashikuar dënimi me gjobë dhe burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet, ndërsa për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale të kryer nga pakujdesia është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Ndërsa, formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 5 dhe 6 të këtij neni, e cila konsiderohet se është kryer nëse si rezultat i kësaj vepre penale është bërë asgjësimi i plotë ose i pjesërishtëm i botës shtazore, bimore ose ndotja³⁷⁰ është bërë në shkallë të madhe për të cilën nevojitet kohë e gjatë ose shpenzime të mëdha për ta sanuar. Për këtë formë edhe më të rëndë të kësaj vepre penale të kryer me dashje është parashikuar dënimi me gjobë dhe burgim prej një deri në tetë vjet, ndërsa për këtë formë edhe më të rëndë të kësaj vepre penale të kryer nga pakujdesia është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Në paragrafin 7 të këtij neni, është parashikuar se kur shqipton dënimin për vepër penale nga ky nen, gjykata mund ta detyrojë kryesin që të ndërmerr masa të caktuara për mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor.

3. Prodhimi, shitja dhe vënia në qarkullim e materieve të dëmshme për mjekimin e shtazëve (neni 342)

Formën themelore të kësaj vepre penale, sipas paragrafit 1 të nenit 342 të KPRK, e kryen kushdo që prodhon me qëllim që t'i shesë apo t'i vë në qarkullim materiet për mjekimin apo për parandalimin e sëmundjeve të shtazëve apo shpendëve, kur materiet e tilla janë të dëmshme për jetën apo për shëndetin e tyre.

Veprimet e kryerjes së kësaj forme të veprës penale konsistojnë në prodhimin me qëllim shitje ose vënie në qarkullim të materieve të dëmshme për mjekimin apo parandalimin e sëmundjeve të shtazëve apo shpendëve.

Me shprehjen “prodhimi i materieve për mjekimin apo për parandalimin e sëmundjeve të shtazëve apo shpendëve“ nënkuptohet tërë procesi apo një pjesë e procesit farmaceutik teknologjik të sajimit të barit apo të shtesave të barit, si dhe përpunimi teknologjik dhe verifikimi i cilësisë dhe depozitimi e dërgimi i tij tek konsumatori. Ndërsa, shprehja “vënia në qarkullim“ duhet nënkuptuar mundësimin e shfrytëzuesve që t'i blejnë materiet e këtilla, përkatësisht kur materiet e këtilla shiten me pakicë ose me shumicë.³⁷¹

Kjo formë e kësaj vepre penale është e karakterit të rrezikut abstrakt, ngase konsiderohet se është kryer me vetë faktin e prodhimit apo vënies në qarkullim të materieve të dëmshme për mjekimin e sëmundjeve të shtazëve apo shpendëve. Pra, forma themelore e kësaj vepre penale ekziston edhe pse nuk është dëmtuar shëndeti i kafshëve apo i shpendëve apo ngordhja e tyre.³⁷²

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një vit.

³⁷⁰ Shprehja “ndotja e mjedisit”, sipas nenit 4 të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, nënkupton ndikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të materieve ndotëse apo i energjisë në mjedis, e shkaktuar përmes aktiviteteve të njeriut ose përmes proceseve natyrore që kanë pasoja të dëmshme në cilësinë e mjedisit dhe në shëndetin e njeriut.

³⁷¹ SALIHU, ISMET, E drejta penale, Pjesa e posaçme, f. 362.

³⁷² Po aty.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me ngordhjen e një numri të madh të shtazëve apo të shpendëve. Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë dhe burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

Në paragrafin 3 të këtij neni është parashikuar se nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj, kurse në paragrafin 4 të këtij neni është parashikuar se nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

4. Ushtrimi i kundërligjshëm i shërbimeve veterinare (neni 344)

Ushtrimi i shërbimeve veterinare duhet të bëhet nga personat profesionist dhe që posedojnë përgatitje adekuate. Ushtrimi i kësaj veprimtarie nga persona të pakualifikuar dhe që nuk posedojnë përgatitje adekuate përbën rrezik për shëndetin e shtazëve. Për këtë arsye, ushtrimi i shërbimeve veterinare nga personat që nuk posedojnë përgatitje adekuate përbën vepër penale sipas KPRK.

Sipas nenit 344 të KPRK, këtë vepër penale e kryen kushdo që pa përgatitje adekuate profesionale merret me shërimin e shtazëve ose ofron shërbime tjera veterinare në kompensim të pagesës.

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale konsistojnë në marrjen me shërimin e shtazëve ose ofrimin e shërbimeve tjera veterinare nga personat pa përgatitje adekuate profesionale. Siç shihet, kjo vepër penale ka karakter blanket, ngase me Ligjin për veterinarinë³⁷³ është rregulluar në mënyrë më të hollësishme ushtrimi i veprimtarisë veterinare dhe kushtet të cilat duhet t'i përmbushin personat për ta ushtruar një veprimtari të tillë. Kështu, në nenin 32 paragrafi 2 të këtij Ligji, është parashikuar se profesionin e veterinarisë mund ta ushtrojnë personat të cilët posedojnë liçencën të lëshuar nga Ministria dhe të jenë të regjistruar në Regjistrin e Veterinerëve. Ndërsa, në nenin 32 paragrafi 3 të këtij Ligji, është parashikuar se liçensat u jepen vetëm aplikantëve të cilët kanë diplomuar në medicinën dhe kirurgjinë veterinare dhe kanë diplomën ose kualifikimin formal superior.

Për të ekzistuar kjo vepër penale, duhet që ushtrimi i shërbimeve të lartëcekura veterinare të bëhet në kompensim të pagesës.

Kjo vepër penale konsiderohet se është kryer me vetë faktin e ushtrimit të kësaj veprimtarie, edhe pse nuk është shkaktuar kurrfarë pasoje.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje dhe kryerës i saj mund të jetë çdo person.

³⁷³ Ligji Nr.2004/21 Për Veterinarinë, i datës 16.06.2004.

Për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

5. Moszbatimi i urdhrave për luftimin e sëmundjeve të shtazëve dhe të bimëve

(neni 345)

Vepra penale moszbatimi i urdhrave për luftimin e sëmundjeve të shtazëve dhe të bimëve, bën pjesë në grupin e veprave penale që kryhen me mosveprim, të cilat në teorinë e së drejtës penale ndryshe quhen edhe si “*delikte omisive*”.³⁷⁴ Te kjo vepër penale, kryesi nuk e ndërmerr veprimin të cilin ka qenë i obliguar që të ndërmerr.

Sipas paragrafit 1 të nenit 345 të KPRK, formën themelore të kësaj vepre penale e kryen kushdo që gjatë kohës së ndonjë epidemie e cila mund të rrezikojë blegtorinë, nuk respekton urdhrin apo vendimin e lëshuar nga organi kompetent në pajtim me ligjin me të cilin parashihen masat për luftimin apo parandalimin e sëmundjes.

Shprehja “blegtori”, sipas paragrafit 6 të këtij neni, do të thotë çdo gjedh, bricjap, kalë, zog, shpezë, shpendë, bletë mjalti, dele, derr apo peshk.

Veprimi i kryerjes së kësaj forme të veprës penale manifestohet në mosrespektimin e urdhërit apo vendimit të lëshuar nga organi kompetent në pajtim me ligjin me të cilin parashihen masat për luftimin apo parandalimin e sëmundjes.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Formë tjetër e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se ekziston në ndokush gjatë periudhës së rrezikut ndaj botës bimore nga sëmundja ose murtaja, nuk respekton urdhrin apo vendimin e organit kompetent me të cilin parashihen masat për luftimin apo parandalimin e sëmundjes ose të murtajës.

Edhe për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Nëse vepra penale nga ky paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, atëherë kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, e cila konsiderohet se ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me dëm të konsiderueshëm pasuror.

³⁷⁴ SHALA, AFRIM, Hyrje në të drejtën penale, f. 51.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet. Nëse kjo formë e rëndë e kësaj vepre penale është kryer nga pakujdesia, atëherë kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

6. Shkretërimi i pyjeve (neni 348)

Pyjet kanë një rëndësi të madhe për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit nga ndotja. Pyjet konsiderohen resurse kombëtare dhe gëzojnë mbrojtje të posaçme jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë. Sipas statistikave të disa organizatave, pyjet i mbulojnë afro 40% të mbarë territorit të Kosovës, ku prej tyre 60 % janë pronë publike, kurse 40% janë pronë private. Shkatërimi, dëmtimi dhe vjedhja e pyjeve në Kosovë është duke u bërë në përmasa të mëdha, sidomos këto vitet e fundit.³⁷⁵ Andaj, me qëllim të parandalimit të kësaj dukurie, si në legjislacionet penale të shteteve bashkëkohore, ashtu edhe në KPRK, janë parashikuar si vepra penale shkretërimi dhe vjedhja e pyjeve.

Kështu, sipas nenit 348 paragrafi 1 të KPRK, veprën penale të shkretërimit të pyjeve e kryen kushdo që në kundërshtim me ligjin ose me urdhrin e organit kompetent bën prerjen ose shkatërrimin e pyllit ose në ndonjë mënyrë tjetër shkretëron pyjet.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale është përcaktuar në mënyrë alternative dhe konsiston në prerjen e pyllit, shkretërimin e pyllit ose shkretërimin e pyjeve në ndonjë mënyrë tjetër.

Për ekzistimin e kësaj vepre penale duhet që veprimet e kryerjes të jenë ndërmarrë në kundërshtim me ligjin apo në kundërshtim me urdhrin e organit kompetent. Nga kjo shihet se kjo vepër penale është e karakterit blanket, ngase me ligje të posaçme janë rregulluar çështjet e mbrojtjes së pyjeve dhe kur konsiderohen se janë dëmtuar apo shkatërruar pyjet. Pyjet në Kosovë, janë të mbrojtura dhe të rregullura me Ligjin për pyjet i Kosovës,³⁷⁶ i cili është ndryshuar dhe plotësuar në vitin 2004³⁷⁷ dhe në vitin 2010.³⁷⁸

Organ kompetent në sensin e kësaj vepre penale, duke u bazuar në ligjet e lartpërmendura, konsiderohet Agjencioni Pyjor i Kosovës, i cili i ka zyret e saj në të gjitha regjionet e Kosovës.³⁷⁹

Objekt mbrojtës i kësaj vepre penale janë pyjet e Kosovës. Sipas nenit 1 të Ligjit Nr.03/L-153 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2003/3 Për Pyjet i Kosovës, shprehja “pyll” nënkupton sipërfaqen e tokës të mbuluar me druj pyjor, në formë të grumbullit pyjor që përfshinë edhe bashkësitë bioekologjike, me sipërfaqe më të madhe se 10 ari. Nëse mirret për bazë pronësia e pyjeve, pyjet në Kosovë ndahen në pyje publike dhe pyje private. Në këtë dispozitë ligjore, është parashikuar se pyjet publike janë pronë e Shtetit të Kosovës. Kurse,

³⁷⁵ SHALA, AFRIM, Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, f. 259.

³⁷⁶ Ligji Nr.2003/3 Për Pyjet e Kosovës, i datës 13.02.2003.

³⁷⁷ Ligji Nr.2004/29 Për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit Nr.2003/3 Për Pyjet i Kosovës, i datës 28.07.2004.

³⁷⁸ Ligji Nr.03/L-153 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2003/3 Për Pyjet i Kosovës, i datës 25.02.2010.

³⁷⁹ SHALA, AFRIM, Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, f. 259.

sipas nenit 3 paragrafi 6 të Ligjit për pyjet i Kosovës, pyjet ndahen në pyje të larta (trungishte) dhe pyje të ulëta (cungishte).

Vepra penale e shkreterimit të pyjeve mund të kryhet si në pyjet publike, ashtu edhe në pyjet private. Pra, këtë vepër penale mund ta kryejë edhe pronari në pyllin e vet, p.sh. nëse bën prerjen apo shkatërrimin e pyllit të tij, në kundërshtim me ligjin ose në kundërshtim me urdhrin e Agjencionit Pyjor të Kosovës, nëse bën hapjen e rraheve apo rrugëve, në kundërshtim me nenin 3 paragrafi 7 të Ligjit për pyjet i Kosovës, nëse bën zhveshjen e trungjeve, etj.

Vepra penale konsiderohet se është kryer në rastet kur është shkaktuar shkreterimi i pyjeve.

Për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni, është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në katër vjet.

Në paragrafin 2 të nenit 348 të KPRK, është parashikuar forma e rëndë e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet në pyllin e mbrojtur, në parkun e mbrojtur ose në pyje të tjera me destinim të posaçëm ose kur kryesi vepron si anëtar i grupit, për të cilën është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim deri në pesë vjet.

Vepra penale e shkreterimit të pyjeve, mund të kryhet vetëm me dashje dhe kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

7. Vjedhja e pyllit (neni 349)

Sipas paragrafit 1 të nenit 349 të KPRK, formën themelore të kësaj vepre penale e kryen kushdo që me qëllim të vjedhjes pret trungjet në pyll dhe sasia e drunjve të prerë tejkalon dy metra kub.

Për nga natyra e saj, vepra penale e vjedhjes së pyllit është formë e posaçme e vjedhjes dhe për këtë shkak nuk mund të bëhet fjalë për bashkimin ideal të kësaj vepre me veprën penale të vjedhjes.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në prerjen e trungjeve. Për ekzistimin e kësaj vepre penale, prerja e trungjeve duhet të bëhet me qëllim të vjedhjes së tyre, respektivisht me qëllim që vetes apo tjetrit t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme. Nga kjo rrjedh se kjo vepër penale mund të kryhet vetëm në pyllin e huaj. Në të kundërtën, nëse kryerësi bën prerjen e trungjeve në pyllin e vet në kundërshtim me ligjin ose urdhrin e organit kompetent, atëherë në këto raste mund të bëhet fjalë për veprën penale të shkreterimit të pyjeve, nga neni 348 të KPRK.

Gjithashtu, siç është cekur edhe në paragrafin 1 të nenit 358 të KPRK, për ekzistimin e kësaj vepre penale, duhet që sasia e drunjve të jetë mbi 2 m³ (dy metra kub). Nëse sasia e drunjve është më e vogël se 2 m³ (dy metra kub), atëherë mund të bëhet fjalë për kundërvajtje, nga neni 1 i Ligjit Nr.2004/29 Për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit Nr.2003/3 Për Pyjet i Kosovës.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin S.M., për shkak të kësaj vepre penale, sepse më datën 06.07.2007, në territorin e një fshati të Komunës së Gjilanit, në vendin e quajtur “Llaqinov”, me qëllim vjedhje në pyllin e pronësisë publike, me sharrë motorike ka prerë 20 trungje bingu, me diameter 20-25 cm, me lartësi 8 metra, me vëllim të përgjithshëm prej 3.82 m³, duke e dëmtuar me këtë Agjencionin e Pyjeve të Kosovës, në vlerë prej 153.80€. ³⁸⁰

Vepra penale konsiderohet se është kryer me vetë faktin e prerjes së trungjeve.

Për formën themelore të kësaj vepre penale, nga paragrafi 1 i këtij neni, është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Forma e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të nenit 358 të KPRK, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer në këto rrethana :

- me qëllim që drunjtë e prerë të shiten ose
- nëse sasia e drunjve të prerë është mbi pesë metra kub.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej tre muajve deri në katër vjet.

Në paragrafin 3 të nenit të lartcekur është parashikuar formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale e cila ekziston nëse vepra penale nga ky nen kryhet:

1. në pyllin e mbrojtur, në parkun e mbrojtur apo në pyllin tjetër me destinim të posaçëm;

2. me qëllim që drunjtë e prerë të shiten, pavarësisht sasisë së drurit të përfshirë.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi gjobë dhe me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje dhe me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë për vete ose për ndonjë person tjetër.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person. Sipas paragrafit 4 të nenit të lartcekur, tentativë për të kryer veprën penale nga paragrafi 1 I këtij neni është e dënueshme.

8. Gjuetia e kundërligjshme (neni 350)

³⁸⁰ Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Gjilan, P.nr.840/2007, i datës 18.08.2008.

Formën themelore të kësaj vepre penale, sipas paragrafit 1 të nenit 350 të KPRK, e kryen kushdo që gjuan kafshë të egra kur gjuetia është e ndaluar ose në territorin në të cilin gjuetia është e ndaluar.

Veprimet e kryerjes të kësaj forme të veprës penale konsistojnë në gjuajtjen e kafshëve të egra gjatë kohës kur gjuetia është e ndaluar ose në territorin në të cilin gjuetia është e ndaluar.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose më burgim deri në një vit.

Në paragrafin 2 të nenit 350 të KPRK, është parashikuar një formë tjetër e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush pa leje ose autorizim, gjuan ose mbyt një kafshë të egër ose e zë të gjallë.

Veprimet e kryerjes së kësaj forme të veprës penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë në :

- gjuajtjen e një kafshe të egër,
- mbytjen e një kafshe të egër ose
- zënja (kapja) për së gjalli e një kafshe të egër.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin H.M., për shkak të kësaj vepre penale, sepse më datën 29.10.2004, rreth orës 9:30 minuta, në pyllin afër një fshati në Gjilan, me pushkën e tij të gjuetisë, të prodhimit turk, me kalibër 12 mm, ka dalë në gjah dhe ka gjuajtur kafshë të egra, pa autorizim në kohën kur ka qenë ndalesa për gjuajtjen e kafshëve të egra, e cila është në kundërshtim me rregullat e gjuetisë.³⁸¹ Në një çështje tjetër penale, gjykata i ka shpallur fajtor të akuzuarit V.E. dhe S.O., për shkak të kësaj vepre penale, sepse të akuzuarit më datën 29.12.2007, në një fshat të Komunës së Kamenicës, pa leje kanë dalur në gjueti të kafshëve të egra, në atë mënyrë që paraprakisht i lëshojnë zagarët e tyre për t'i ndjekur kaprojtë, kurse të akuzuarit nga pozicionet që ishin vendosur më parë, me pushkët e tyre të gjuetisë arrijnë që t'i vrasin 2 kaproj.³⁸²

Objekt mbrojtës i kësaj vepre penale janë kafshët e egra. Sipas nenit 3 të Ligjit për gjuetinë,³⁸³ shprehja “**Kafshë të egra**” përfshinë kafshët dhe shpendët e egra të caktuara me ligj, që formojnë popullata në gjendje të lirë në natyrë ose në sipërfaqe të kufizuara të parapara për kultivim intensiv apo për shumim. Kafshë të egra sipas nenit 4 të këtij ligji, konsiderohen : dreri i rëndomtë, dreri lopatar, kaprolli, dhia e egër, derri i egër, ariu i murmë, lepuri i zakonshëm, ketri, dhelpra, ujku, çakalli, macja e egër, pula e egër e madhe, fazani, pëllumbi gungash, pëllumbi i zgavrave, pëllumbi i zi, pata e përhimtë, pata e murrizit, pata ballbardhë,

³⁸¹ Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr.191/2004, i datës 02.02.2005.

³⁸² Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Kamenicë, P.nr.18/2008, i datës 07.05.2008.

³⁸³ Ligji Nr.02/L-53 Për Gjuetinë, i datës 16.12.2005.

rosa shurdhake, rosa e përhimt, rosa, kukuvajka e bardhë, huti veshor i pyjeve, huti i maleve, sokoli pulngrënës, orli, etj.

Për ekzistimin e veprës penale sipas paragrafit 2 të nenit 350 të KPRK, duhet që gjuetia e kafshëve të egra të bëhet pa leje ose pa autorizim.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 3 të nenit 350 të KPRK. Sipas kësaj dispozite ligjore, kjo formë e rëndë e kësaj vepre penale konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet jashtë sezonës; në grup; ose ndaj gjahut në vlerë që tejkalon 2000 (dymijë) Euro ose me rëndësi sipas rregulloreve të gjuetisë, për të cilën është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Ndërsa, në paragrafin 4 dhe 5 të nenit 359 të KPRK, janë parashikuar forma edhe më të rënda të kësaj vepre penale, të cilat konsiderohet se kryhen nëse ndokush :

- gjuan lloje të rrezikuara ose të rralla të kafshëve, gjuetia e të cilave është e ndaluar;
- gjuan lloje të posaçme pa pasur lejen e veçantë për atë lloj gjahu;
- gjuan duke përdorur metoda të asgjësimit masiv;
- duke përdorur automjetin ose
- duke përdorur dritën e fortë.

Për këto forma të kësaj vepre penale, është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.

Në paragrafin 6 të këtij neni, është parashikuar se kafshët e egra dhe pajisjet e gjuetisë konfiskohen.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person dhe kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

9. Peshkimi i kundërligjshëm (neni 353)

Sipas paragrafit 1 të nenit 353 të KPRK, formën themelore të kësaj vepre penale e kryen kushdo që peshkon gjatë kohës kur peshkimi është i ndaluar apo në ujërat ku peshkimi është i ndaluar.

Veprimet e kryerjes së kësaj forme të veprës penale, konsistojnë në peshkimin gjatë kohës kur peshkimi është i ndaluar apo në ujërat ku peshkimi është i ndaluar.

Shprehja ”**peshkim**”, sipas nenit 3 të Ligjit për peshkatari dhe akuakulturë³⁸⁴ nënkupton çdo veprimtari për gjuajtjen e peshkut dhe organizmave tjerë ujorë duke përdorur mjete dhe pajisje të ndryshme.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të nenit 353 të KPRK, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush peshkon duke përdorur eksploziv, rrymë elektrike, helm ose mjete helmuese dhe me këtë shkakton ngordhjen e peshqve në mënyrë të tillë që të dëmtojë shumimin e peshqve.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale është përcaktuar në mënyrë alternative dhe konsiston në peshkimin duke përdorur eksploziv, rrymë elektrike, helm ose mjete helmuese.

Siç shihet, kjo vepër penale kryhet duke përdorur mjetet e caktuara ose duke peshkuar në mënyrë të dëmshme për shumimin e peshqve. Mjete të kryerjes së kësaj vepre penale janë eksplozivi, rryma elektrike, helmet ose mjetet helmuese.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm në ujërat e peshkimit. Sipas nenit 3 të Ligjit për peshkatari dhe akuakulturë, shprehja ”**ujërat e peshkimit**” nënkupton ujërat e lumenjve, prockave, liqeve natyralë dhe artificialë, kënetave, kanaleve dhe ujërave tjera në të cilat jetojnë peshqit.

Vepra penale e peshkimit të kundërligjshëm, mund të kryhet vetëm me dashje dhe kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

10. Dëmtimi, shkatërrimi dhe nxjerrja e paautorizuar e monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës (neni 354)

Objekt mbrojtës i kësaj vepre penale janë monumentet dhe objektet e mbrojtura kulturore, historike, fetare, shkencore apo natyrore.

Sipas paragrafit 5 të nenit 354 të KPRK, shprehja “monument ose objekt i mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror” do të thotë objekt nderimi i një komuniteti fetar i cili ndodhet në pronën e caktuar për shërbime fetare, gur varri, varr apo vend tjetër i varrimit, monument publik, monument natyror, objekt artistik, shkencor apo artizanat i cili ruhet në koleksione publike ose në ekspozita publike, objekt i cili shërben për ndonjë nevojë publike

³⁸⁴ Ligji Nr.02/L-85 Për Peshkatari dhe Akuakulturë, i datës 10.10.2006.

ose zbukuron rrugën publike, sheshin apo parkun, atraksion natyror apo një lloj të rrezikuar i kafshëve ose bimëve.

Formën themelore të kësaj vepre penale, nga paragrafi 1 i këtij neni, e kryen kushdo që e dëmton ose e shkatërron monumentin ose objektin e mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror.

Për nga natyra dhe përmbajtja e saj, edhe kjo vepër penale është e karakterit blanket, ngase me dispozita të posaçme është rregulluar pozita dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me monumentet dhe objektet e mbrojtura. Dispozita ligjore të kësaj natyre gjenden edhe në Ligjin për trashëgiminë kulturore³⁸⁵ dhe disa ligje tjera.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale është i përcaktuar në mënyrë alternative dhe konsiston në dëmtimin ose shkatërrimin e monumentit ose objektit të mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror.

Për formën themelore të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Në paragrafin 2 të këtij neni, është parashikuar formë e rëndë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet ndaj

monumentit ose objektit të mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror që kanë vlerë të posaçme ose nëse vepra penale rezulton me dëm të rëndë.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në tri vjet.

Formë e posaçme e kësaj vepre penale, është parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush pa autorizimin përkatës të organit kompetent nxjerrë jashtë Republikës së Kosovës monumentin ose objektin e mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror.

Veprimi i kryerjes së kësaj forme të veprës penale konsiston në nxjerrjen jashtë Republikës së Kosovës të monumentit, ose objektit të mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror.

Për ekzistimin e kësaj forme të veprës penale, duhet që veprimi i kryerjes të ndërmirret pa autorizimin përkatës të organit kompetent.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose burgim deri në një vit.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar edhe në paragrafin 4 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 3 i këtij neni ka të bëjë me monumentin

³⁸⁵ Ligjin Nr.02/L-88 Për Trashëgiminë Kulturore, i datës 09.10.2006.

ose objektin e mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror me vlerë të posaçme, për të cilën është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në tri vjet.

Në paragrafin 6 të këtij neni, është parashikuar se tentativa për të kryer veprë penale nga paragrafi 1 ose 3 i këtij neni është e dënueshme.

Kryerës i kësaj veprë penale mund të jetë çdo person dhe kjo veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje.

11. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli

Në Kapitullin e veprave penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore, janë parashikuar edhe këto vepra penale :

- Mbajtja e paligjshme e substancave dhe e mbeturinave të rrezikshme (neni 339);
- Lejimi i kundërligjshëm i ndërtimit apo drejtimit të fabrikave dhe instalimeve që ndotin mjedisin (neni 340);
- Dhënia e ndihmës veterinare në mënyrë të pandërgjegjshme (neni 343);
- Keqtrajtimi i kafshëve dhe ndotja e ushqimit dhe e ujit të shtazëve (neni 346);
- Shkatërrimi i botës bimore me materie të dëmshme (neni 347);
- Shitja ose nxjerrja e trofeve të kafshëve të egra jashtë Republikës së Kosovës (neni 351);
- Shitja ose nxjerrja e të mirave natyrore, bimëve ose kafshëve posaçërisht të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës (neni 352) dhe
- Punimet e paautorizuara dhe përvetësimi i monumenteve kulturore (neni 355).

KAPITULLI XV

VEPRAT PENALE KUNDËR SIGURISË SË PËRGJITHSHME TË NJERËZVE DHE PASURISË

I. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME

Mënyra e jetës bashkëkohore mbështetet në përdorimin dhe shfrytëzimin e të arriturave të shumta teknike dhe në ushtrimin e veprimtarive të rrezikshme, të cilat krahas dobisë shumë të madhe për shoqërinë, njëherit paraqesin edhe rrezik për jetën dhe shëndetin e qytetarëve, si dhe për pasuritë e tyre. Në këtë mënyrë, përdorimi masiv i mjeteve teknike, makinave, shfrytëzimi i përditëshëm i energjisë elektrike, shfrytëzimi i elektranave nukleare, në zhvillimin enorm të komunikacionit ajror, ujqor, hekurudhor, prodhimi i armëve, helmeve, eksplozivëve, pendave të ndryshme, etj. shoqërisë në përgjithësi i sjellin dobi të mëdha dhe pa përdorimin e tyre nuk mund të imagjinohet jeta në botën bashkëkohore. Mirëpo, shfrytëzimi i tyre në çdo moment shkakton rreziqe të mëdha dhe për parandalimin e rreziqeve të tilla, nga qytetarët kërkohet që të kenë kujdes të veçantë. Me qëllim të parandalimit të rreziqeve të tilla, shteti ndërmerr masa të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe masa të karakterit penalo-juridik. Në këtë drejtim, me Kapitullin e veprave penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe të pasurisë, janë paraparë disa vepra penale që kanë për qëllim mbrojtjen e sigurisë së përgjithshme të qytetarëve dhe pasurisë.

Pra, me veprat penale të këtij Kapitulli, siç mund të shihet edhe nga emërtimi, mbrohet siguria e përgjithshme e njerëzve (qytetarëve) dhe e pasurisë. Jeta dhe pasuria e qytetarëve mbrohet edhe me kapituj tjerë të KPRK, siç janë Kapitulli i veprave penale kundër jetës dhe trupit, Kapitulli i veprave penale kundër pasurisë, etj. Karakteristikë e Kapitullit të veprave penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë, është mbrojtja e jetës dhe pasurisë së personave që nuk janë të përcaktuar individualisht. Andaj, të gjitha veprat penale të këtij Kapitulli janë me një rrezikshmëri të përgjithshme për njerëzit dhe pasurinë.

Pasojë e përbashkët e vepra penale të këtij Kapitulli është shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm për personat individualisht të papërcaktuar ose për pasurinë e personave të pacaktuar. Në këtë mënyrë, personat apo pasuria e cila mund të rrezikohet me këto vepra penale nuk duhet të jetë përcaktuar individualisht, në të kundërtën nuk do të bëhet fjalë për veprat penale të këtij Kapitulli, por do të manifestohen eventualisht elementet e ndonjë vepre tjetër penale. Kështu p.sh. nëse shkaktimi i ndonjë eksplozimi ka qenë i drejtuar kundër personave A dhe B (personave të caktuar), atëherë nuk mund të bëhet fjalë për ndonjë vepër penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve apo pasurisë, por në këtë rast, varësisht nga mënyra, rrethanat dhe qëllimi i kryerësit bëhet fjalë për ndonjë vepër penale (kundër jetës dhe trupit, kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare, kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, etj.).

Siç është cekur edhe më lart, pasojë e përbashkët e veprave penale të këtij Kapitulli, është shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm ndaj njerëzve dhe pasurisë së personave të pacaktuar. Rreziku si pasojë e këtyre veprave penale mund të jetë : a) konkret (direkt) dhe b) abstrakt (indirekt).

a) Rreziku konkret (direkt) ekziston atëherë kur jetës së njerëzve dhe pasurisë së tyre i kanoset rrezikut direkt. Me fjalë tjera, rreziku është konkret (direkt), atëherë ai është i afërt, i drejtpërdrejtë, respektivisht në rastet kur vlera e mbrojtur është e rrezikuar, kështu me zhvillimin e mëtejshëm të rrezikut të tillë mund të bëhet dëmtimi apo asgjësimi i vlerës së mbrojtur. Rreziku i tillë është tipar i veprës penale dhe çdoherë është i inkorporuar në figurën e saj. Veprat penale të natyrës së rrezikut konkret që bëjnë pjesë në kuadër të këtij Kapitulli, janë p.sh. dëmtimi, asgjësimi dhe heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës (neni 358), punimet ndërtimore të kundërligjshme (neni 360), etj.

b) Rreziku abstrakt (indirekt) gjithashtu është mundësi e dëmtimit apo asgjësimit të vlerave të mbrojtura, por kjo mundësi nuk është e afërt dhe e drejtpërdrejtë, por e largët, është në distancë. Për konstatimin e këtij lloji të rrezikut nuk është e nevojshme të administrohen provat për vërtetimin e tij, ngase ky presupozohet. Rrjedhimisht, për shkak të natyrës së rrezikshmërisë abstrakte, ligji inkriminon veprimtaritë e caktuara të cilat janë të rrezikshme për jetën e njerëzve ose pasurisë. Për këtë arsye rreziku abstrakt nuk inkorporohet si tipar i posaçëm i figurës së veprës penale dhe për këtë nuk duhet të administrohen prova. Vepër penale e rrezikimit abstrakt është p.sh. vepra penale dërgimi apo transportimi i kundërligjshëm i lëndëve eksplozive ose lëndëve ndezëse (neni 361), etj.

Kryerës i shumicës së veprave penale të këtij Kapitulli mund të jetë çdo person, mirëpo disa vepra penale të këtij Kapitulli, mund t'i kryejnë vetëm personat që posedojnë veti të caktuara, p.sh. veprën penale punimet ndërtimore të kundërligjshme, nga neni 360 i KPRK, mund ta kryej vetëm personi përgjegjës, etj.

Sa i përket fajësisë, shumica e veprave penale të këtij Kapitulli, kryhen me dashje, e cila në vete përfshin vetëdijen se me ndërmarrjen e veprimit të caktuar do të shkaktohet rreziku për sigurinë e përgjithshme të njerëzve ose të pasurisë, respektivisht vetëdija se me ndërmarrjen e veprimit të caktuar do të mund të shkaktohet rreziku për sigurinë e përgjithshme të njerëzve ose pasurisë dhe dhënia e pëlqimit për shkaktimin e këtij rreziku. Mirëpo, disa vepra penale kryhen edhe nga pakujdesia, p.sh. vepra penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 356 i KPRK, e cila mund të kryhet me dashje dhe nga pakujdesia, etj.

II. VEPRAT PENALE TË KËTIJ KAPITULLI

1. Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm (neni 356)

Vepra penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 356 paragrafi 1 i KPRK, është veprë penale e përgjithshme kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve ose pasurisë, në krahasim me veprat tjera penale të këtij Kapitulli të cilat konsiderohen forma të posaçme të kësaj vepre penale. Prandaj, kjo veprë penale konsiderohet se është kryer vetëm në rastet kur nuk manifestohen elementet e ndonjë vepre tjetër penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë.

Në nenin 356 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar forma e parë e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush me anë të zjarrit, vërshimeve, armëve, eksplozivit, helmit ose gazit helmues, rrezatimit jonizues, forcës mekanike, me energji elektrike ose me ndonjë energji tjetër ose me ndonjë veprim tjetër të rrezikshëm apo mjete të rrezikshme, shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo dëm të konsiderueshëm pasuror.

Veprimi i kryerjes së formës së parë të kësaj vepre penale konsiston në ndërmarrjen e veprimit përgjithësisht të rrezikshëm apo në shfrytëzimin e mjeteve të cilat në përgjithësi janë të rrezikshme, me ç'rast shkaktohet rreziku për jetën apo pasurinë në vëllim të madh.

Veprime të rrezikshme në përgjithësi konsiderohen veprimet me të cilat lirohet aso energjie, të cilin kryerësi nuk mund ta mbajë nën kontroll, nuk mund të kontrollojë, siç janë shkaktimi i eksplozimit, i zjarrit, i vërshimeve, lënia e armës afër fëmijëve, duke e lënë pusin pa e siguruar me rrethojë, etj.

Mjetet në përgjithësi të rrezikshme, duhet nënkuptuar ato lloje të mjeteve, të cilat për shkak se nuk mund të kontrollohet zgjerimi dhe efekti i tyre, paraqesin rrezik për jetën apo pasurinë në përmasa të mëdha, siç janë energjia elektrike, helmet, gazi, armët, etj.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin D.O., për shkak të kësaj vepre penale, sepse më datën 08.06.2008, rreth orës 14:00 minuta, në një ndërtesë në Fushë-Kosovë, me anë të energjisë elektrike ka shkaktuar rrezik të madh për jetën e njerëzve dhe pasurinë në përmasa të mëdha, në atë mënyrë që me anë të një kaçavide ka tentuar që ta rregullojë prishjen e rrymës elektrike në korridorin e ndërtesës së lartcekur, me ç'rast ka shkaktuar një lidhje të shkurtër të energjisë elektrike dhe zjarr prej të cilit është lënduar vetë i akuzuari duke pësuar lëndime në dorën e djathtë dhe në fytyrë, ndërsa në instalimet elektrike është shkaktuar dëm i konsiderueshëm material dhe rrezik për jetën e njerëzve, derisa zjarri më vonë është lokalizuar nga ana e zjarrfikësve.³⁸⁶

Në nenin 356 paragrafi 1 të KPRK, janë përcaktuar veprimet dhe mjetet e kryerjes së kësaj vepre penale, veprime dhe mjete këto, të cilat paraqesin rrezik për sigurinë e njerëzve dhe të pasurisë. Veprimet dhe mjetet e tilla janë :

1) Zjarri - Shkaktimi i zjarrit nënkupton shkaktimin e stuhisë së zjarrit, e cila zgjerohet në mënyrë të pakontrolluar dhe mund të përfshijë një sipërfaqe të madhe apo pasuri të madhe. Zjarri mund të shkaktohet me veprimet e njeriut, por mund të shkaktohet edhe nga dukuritë

³⁸⁶ Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Prishtinë, P.nr.1043/2009, i datës 23.02.2010.

tjera, p.sh. nga rrezet e diellit. Në Ligjin Për Mbrojtjen Nga Zjarri,³⁸⁷ janë përcaktuar masat për mbrojtjen nga zjarri dhe çështjet tjera që ndërlidhen me zjarrin.

2) Vërshimi - Nënkupton depërtimin e sasisë së madhe të ujit që nuk mund të ndalet dhe përfshin sipërfaqe të mëdha të tokës dhe sendeve. Vërshimi do të thotë kur një masë e madhe e ujit del nga shtrati i një lumi, i një liqeni (natyror apo artificial), etj. dhe përmbyt sipërfaqe të mëdha të tokës apo objekteve.

3) Armët - Sipas nenit 113 paragrafi 40 të KPRK, shprehja “armë” do të thotë çdo send ose vegël e punuar me qëllim që nën presionin e gazrave, të cilat lirohen gjatë djegies së materieve shpërthyesë, elektrike, gazrave nën presion ose energjisë tjetër potenciale, hedhë predha në formë të një plumbi të vetëm, grumbulli prej saçmash, gazi, lëngu, shigjete ose përbërësish të tjerë, që krijohet dhe përdoret për të shkaktuar lëndime trupore ose dëm fizik, qoftë edhe psikologjik, si dhe secili send tjetër, qëllimi kryesor i të cilit është kryerja e sulmit fizik ndaj integritetit fizik të njerëzve ose ndaj pasurisë. Armë po ashtu përfshinë municionin, pjesët dhe përbërësit e armëve, si dhe armët nukleare, biologjike dhe kimike

4) Eksplodimi - Do të thotë pëlcitja e shpejtë dhe e fortë e ndonjë materie, siç është baruti apo dinamiti, me ç'rast shkaktohen rrënime apo shkatërrime të objekteve, lëndime apo vrasje e njerëzve.

5) Helmi - Është substancë joorganike apo organike, e cila kur të futen në organizëm nga jashtë shkakton çrregullime, nga të cilat mund të vie deri te dëmtimi i shëndetit apo vdekja.

Përveç këtyre, kjo veprë penale mund të kryhet edhe me anë të gazit helmues, rrezatimit jonizues, forcës mekanike, energjisë elektrike ose me ndonjë energji tjetër të çfarëdo lloji.

Pasoja e kësaj vepre penale është shkaktimi i rrezikut konkret për jetën e njerëzve apo pasurisë të një rëndësie thelbësore. Rreziku konsiderohet konkret në rastet ku për shkak të ndërmarrjes apo mos ndërmarrjes së veprimeve apo masave ka ekzisuar mundësia që në çdo moment të shkaktohet vdekja e një ose me shumë personave apo të dëmtohet pasuria e një rëndësie thelbësore.

Vepra penale konsiderohet se është kryer nëse për shkak të ndërmarrjes së veprimit që paraqet rrezik të përgjithshëm apo përdorimit të mjetit të rrezikshëm është shkaktuar rreziku për jetën e njerëzve apo pasurinë e një rëndësie thelbësore.

Kryerës i kësaj forme të veprës penale mund të jetë çdo person.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Në paragrafin 2 të nenit 356 të KPRK, është parashikuar forma tjetër e kësaj vepre penale. Sipas kësaj dispozite ligjore, këtë veprë penale e kryen kushdo që në kundërshtim me detyrimet

³⁸⁷ Ligji nr.02/L-41 Për Mbrojtjen Nga Zjarri, i datës 06.04.2006.

e përcaktuara me ligj nuk i vendos pajisjet për mbrojtjen nga zjarri, vërshimi, eksplozimi, helmimi ose për mbrojtjen nga gazrat helmuese, rrezatimi jonizues, forcat mekanike, energjia elektrike ose nga ndonjë lloj energjie tjetër, ose me ndonjë veprim tjetër të rrezikshëm apo mjete të rrezikshme, apo këto pajisje nuk i mirëmban në gjendje të rregullt apo nuk i vë në përdorim ose në përgjithësi nuk vepron sipas rregullave ose rregulloreve teknike mbi masat mbrojtëse dhe me këtë shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo dëm të konsiderueshëm pasuror.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në pesë vjet.

Në paragrafin 3 të këtij neni, është parashikuar forma e rëndë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni është kryer në vendin ku janë të pranishëm një numër i madh i njerëzve ose ku përdoret një eksploziv ose mjet tjetër vdekjeprurës në, brenda ose kundër një vendi për përdorim publik, një ndërtesë shtetërore ose qeveritare, një sistemi të transportit publik ose një infrastrukture ose me qëllim të shkakimit të vdekjes ose lëndimit të rëndë trupor ose me qëllim që të shkaktojë shkatërrim të gjerë të një vendi, objekti ose sistemi të tillë, kur një shkatërrim i tillë rezulton ose ka të ngjarë të rezultojë në humbje të mëdha ekonomike ose të detyrojë një qeveri ose një organizatë ndërkombëtare për të kryer ose për të mos kryer një vepër.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale, është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në tetë vjet.

Një formë tjetër e rëndë është parashikuar në paragrafin 4 të nenit të lartcekur, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëm substancial pasuror, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 5 të nenit të lartcekur, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 rezulton me vdekjen e një ose më shumë personave, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej tre deri në dymbëdhjetë vjet.

Kurse, në paragrafin 6 të këtij neni, është parashikuar forma e lehtë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, për të cilën është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin H.B., për shkak të veprës penale të lartcekur, sepse i akuzuari më datën 20.12.2007, në Gjilan, nga pakujdesia ka shkakuar rrezik të përgjithshëm për jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që me rastin e parkimit të automjetit të tij (kombi) në rrugë, nuk e ka aktivizuar frenin e dorës për të pasur një parkim të sigurt, në ndërkohë që pas parkimit, automjeti është nisur në drejtim të shtëpisë së të dëmtuarit XH.M. e cila ka qenë në një

largësi prej 60 m nga vendi i parkimit, ku është përplasur më murin e kësaj shtëpie, duke hapur një vrimë në të dhe duke dëmtuar kuzhinën që ka qenë brenda në dhomë, me ç'rast ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material, si dhe janë rrezikuar anëtarët e familjes së të dëmtuarit, të cilët në ato momente kanë qenë në shtëpi.³⁸⁸

Në paragrafët 7, 8 dhe 9 të nenit të lartcekur janë parashikuar format tjera të kësaj vepre penale nëse kryhen nga pakujdesia, për të cilat janë parashikuar dënime të ndryshme, varësisht nga rrethanat në të cilat janë kryer.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje tjetër penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin H.R., për shkak të kësaj vepre penale, sepse në një fshat të Komunës së Kamenicës, ka ndezur disa barishte të thata dhe nga pakujdesia ka shkaktuar rrezik të përgjithshëm për jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që nuk ka mundur që ta mbajë nën kontrollin zjarrin e ndezur, i cili është përhapur edhe në malin e të dëmtuarve H.P. dhe G.I., ku është dëmtuar sipërfaqja prej 1 ha me pyje të qarrit dhe në këtë të dëmtuarve i është shkaktuar dëm i konsiderueshëm material.³⁸⁹

2. Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike (neni 357)

Forma themelore e kësaj vepre penale, sipas paragrafit 1 të nenit 357 të KPRK, ekziston në rastet kur ndokush asgjëson, dëmton, i heq pajisjet apo instalimet e përçuesve elektrik, të gazit, të ujit, të ngrohjes, të pajisjeve telekomunikuese, të pajisjeve të kanalizimit, të pajisjeve për mbrojtjen e mjedisit ose të naftës-jellësve, të kabllove nënujore, të pendave ose të pajisjeve të tjera të ngjashme duke shkaktuar çrregullime në furnizimin e popullsisë apo të ekonomisë.

Veprimet e kryerjes së kësaj forme të veprës penale janë asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve apo instalimeve publike.

Për formën themelore të kësaj vepre penale, nga paragrafi 1 i këtij neni, është parashikuar dënimi me burgim deri në pesë vjet.

Formë e lehtë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se ekziston nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia.

Për këtë formë të lehtë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë apo me burgim deri në një vit.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin H.V., për shkak të veprës penale asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike, sepse me datën 05.09.2009, në rrugën "Avdulla

³⁸⁸ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, P.nr.1297/2007, i datës 22.01.2009.

³⁸⁹ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Kamenicë, P.nr.182/2007, i datës 21.05.2009.

Tahiri”, në Gjilan, duke e bartur një kioskë të cilën e ka pasur të vendosur në rimorkion e traktorit të tij, nga pakujdesia me pjesën e epërme të kësaj kioske i dëmton kabllot elektrike.³⁹⁰

Në paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, janë parashikuar format e rënda të kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të ndonjë personi apo me dëm subsancial pasuror, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në tetë vjet, e kur vepra e tillë penale rezulton me vdekjen e një apo të më tepër personave, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet.

Kurse, në paragrafët 4 dhe 5 të këtij neni, janë parashikuar format tjera të kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni (e kryer nga pakujdesia), rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëm substancial pasuror, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet, e kur vepra e tillë penale rezulton me vdekjen e një apo të më shumë personave, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

3. Punimet ndërtimore të kundërligjshme (neni 360)

Këtë vepër penale sipas paragrafit 1 të nenit 360 të KPRK, e kryen personi përgjegjës i cili me rastin e projektimit, mbikëqyrjes apo kryerjes së ndonjë ndërtimi apo të punëve ndërtimore ose përfundimit të punëve ndërtimore, vepron në shkelje të ligjit apo në kundërshtim me standardet profesionale përgjithësisht të pranuar ose në kundërshtim me kushtet e lejes së ndërtimit ose certifikatës së përdorimit .

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në veprimin kundërshtim me ligjin ose me standardet e përgjithshme profesionale të pranuar ose kundër kushteve të lejes për ndërtim ose certifikatës së përdorimit. Andaj, nga kjo shihet se kjo vepër penale është e karakterit blanket, nga i referohet ligjit apo standardeve të përgjithshme profesionale.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë vetëm personi përgjegjës.

Kjo vepër penale mund të kryhet me dashje ose nga pakujdesia. Për formën themelore të kësaj vepre penale të kryer me dashje, është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet, kurse për këtë formë të kësaj vepre penale të kryer nga pakujdesia, është parashikuar dënimi me burgim deri në tri vjet.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin N.A., për shkak të veprës penale punimet ndërtimore të kundërligjshme, në një fshat të Komunës së Kamenicës, në cilësinë e personit përgjegjës me rastin e kryerjes së punëve të ndërtimit të objektit të banimit, ka vepruar në kundërshtim me standardet e përgjithshme profesionale, ashtu që duke mihur bazamentin e objektit të cilin ka filluar që

³⁹⁰ Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Gjilan, P.nr.917/2009, i datës 28.04.2010.

ta ndërtojë afër murit të shtëpisë së dëmtuarit K.S., ku nga pakujdesia gjatë punimeve rrëshqet një pjesë e dheut dhe më pas rrënohet muri i shtëpisë dhe garazhës së të dëmtuarit, me ç'rast përveç që është shkaktuar dëm në vlerë të madhe, është rrezikuar edhe jeta e të dëmtuarit dhe anëtarëve të familjes së tij.³⁹¹

Në paragrafin 3 të këtij neni, është parashikuar një formë e rëndë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij ligji rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëm të konsiderueshëm pasuror apo më shumë, për të cilën kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet, e nëse vepra e tillë penale rezulton me vdekjen një apo të më shumë personave, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet (paragrafi 4).

Kurse, në paragrafin 5 të këtij neni, është parashikuar një formë e rëndë e kësaj vepre penale e cila kryhet nga pakujdesia. Sipas kësaj dispozite ligjore, nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëm thelbësor material, kryerësi do të dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet, e nëse vepra e tillë penale rezulton me vdekjen e një apo të më shumë personave, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet (paragrafi 6).

4. Mosevitimi i rrezikut (neni 362)

Sipas paragrafit 1 të nenit 362 të KPRK, formën themelore të kësaj vepre penale e kryen kushdo që nuk ndërmerr masa për evitimin e zjarrit, vërshimit, eksplozimit, fatkeqësisë në trafik apo të ndonjë rreziku tjetër për jetën ose sigurinë fizike të njerëzve apo të pasurisë në shkallë të madhe, ndonëse këtë ka mundur ta bëjë pa e rrezikuar veten apo ndonjë person tjetër .

Sa i përket mënyrës së kryerjes, kjo vepër penale mund të kryhet me mosveprim.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Formë e posaçme e kësaj vepre penale, është parashikuar në paragrafin 2 të nenit 362 të KPRK, e cila konsiderohet se ekziston në rastet kur ndokush e parandalon apo pengon

personin tjetër nga ndërmarrja e masave për evitimin e zjarrit, vërshimit, eksplozimit, fatkeqësisë së trafikut apo të ndonjë rreziku tjetër për jetën apo sigurinë fizike të njerëzve apo të pasurisë në shkallë të madhe .

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

³⁹¹ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Kamenicë, P.nr.158/2007, i datës 13.01.2010.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

5. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli

Në Kapitullin e veprave penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe të pasurisë bëjnë pjesë edhe dy vepra tjera penale :

- Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës (neni 358);
- Ndërtimi pa leje (neni 359);
- Dërgimi apo transportimi i kundërligjshëm i lëndëve eksplozive ose lëndëve ndezëse (neni 361) dhe
- Keqpërdorimi i sinjalit të fatkeqësisë apo të rrezikut (neni 363).

KAPITULLI XVI

VEPRAT PENALE KUNDËR SIGURISË SË TRAFIKUT PUBLIK

SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME

Trafiku publik në botën bashkëkohore konsiderohet njëra nga veprimtaritë më të rëndësishme dhe shumë të dobishme, ngase përmes tij bëhet transportimi i një numri të madh të njerëzve dhe mallrave. Prandaj, pa trafikun publik tani nuk mund të paramendohet jeta normale e njeriut dhe shoqërisë në përgjithësi. Mirëpo, për shkak të natyrës dhe llojeve të mjeteve me të cilat ushtrohet kjo veprimtari, për shkak të mosrespektimit apo shkeljes së dispozitave ligjore, me anë të mjeteve të trafikut publik në një numër të konsiderueshëm të rasteve rrezikohet jeta, siguria fizike njerëzve dhe pasuria në përmasa të mëdha. Madje në disa raste edhe shkaktohet vdekja, apo lëndimi trupor i një numri të madh të qytetarëve, si dhe dëmtohet pasuria në vëllim të madh. Për shkak të këtyre pasojave shumë të dëmshme, me dispozita ligjore janë përcaktuar rregullat të cilat duhet të respektohen nga pjesëmarrësit në trafikun publik me qëllim të mbrojtjes së jetës, integritetit trupor dhe pasurisë. Përveç këtyre dispozitave ligjore, kjo mbrojtje realizohet edhe me KPRK, ngase me këtë Kapitull janë parashikuar disa vepra penale në sferën e trafikut publik.

Trafiku publik është një term i përgjithshëm, që në vete përfshin trafikun rrugor, uJOR, hekurudhor, ajror, me tramvaje, me trolejbus, etj.

Objekt mbrojtës te këto vepra penale është siguria e njerëzve dhe e pasurisë në trafik. Me këto dispozitat ligjore të këtij Kapitulli inkrimohet sjellja kundërligjore apo kundër rregullave e subjekteve në trafik dhe sjellje e pandërgjegjshme e personave të tjerë lidhur me trafikun. Parashikimi i veprave penale në këtë Kapitull ka për qëllim të sigurojë ushtrimin normal të trafikut, respektimin e dispozitave dhe rregullave të caktuara, të cilat e rregullojnë trafikun.

Kryerës i këtyre veprave penale, në parim është pjesëmarrësi në trafikun publik, që në shumicën e rasteve është drejtuesi apo shoferi i automjetit, kurse mjet i kryerjes së këtyre veprave penale është automjeti apo mjeti tjetër i transportit.

Pasojë e këtyre veprave penale është shkaktimi i rrezikut për jetën, trupin apo pasurinë me vlerë të madhe. Gjithashtu, pasojë e këtyre veprave penale është edhe rrezikimi i trafikut publik. Shkaktimi i rrezikut mund të jetë konkret, siç është rasti me veprën penale ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur, nga neni 371 i KPRK, apo vepra penale e rrezikimit të trafikut publik me veprime apo mjete të rrezikshme, nga neni 372 i KPRK. Por në disa raste shkaktimi i rrezikut mund të jetë edhe abstrakt, siç është rasti

me veprën penale keqpërdorimi i sinjaleve ndërkombëtare të telekomunikacionit, nga neni 375 i KPRK.

Nëse me kryerjen e këtyre veprave penale shkaktohet lëndimi i rëndë trupor apo vdekja e një apo më shumë personave, apo dëmi material me përmasa të mëdha, atëherë ato konsiderohen forma të rënda (të cilësuar) të këtyre veprave. Lidhur me pasojën e rëndë që shkaktohet me kryerjen e veprave penale të këtij Kapitulli, kryerësi duhet të ketë vepruar çdoherë nga pakujdesia.

Shumica e veprave penale të këtij Kapitulli, mund të kryhen me dashje dhe nga pakujdesia. Mirëpo, duhet theksuar se në jetën e përditshme, në praktikë, më së shpeshti këto vepra penale kryhen nga pakujdesia, e cila është rezultat i moskujdesit të drejtuesve të automjeteve dhe të pjesëmarrësve tjerë në trafik. Në anën tjetër, disa vepra penale të këtij Kapitulli, siç janë vepra penale mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik, nga neni 374 i KPRK dhe vepra penale keqpërdorimi i sinjaleve ndërkombëtare të telekomunikacionit, nga neni 375 i KPRK, mund të kryhen vetëm me dashje.

II. VEPRAT PENALE TË KËTIJ KAPITULLI

Rrezikimi i trafikut publik (neni 370)

Në nenin 370 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar forma themelore e veprës penale të rrezikimit të trafikut publik. Sipas kësaj dispozite ligjore, kjo vepër penale ekziston nëse ndonjë person e shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt dëm të konsiderueshëm pasuror.

Kjo formë e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, është e karakterit të përgjithshëm, ngase i referohet trafikut publik në përgjithësi, pa përcaktuar forma specifike të trafikut publik.

Objekt mbrojtës i kësaj vepre penale është siguria në trafikun publik.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në mosrespektimin e dispozitave të cilat e rregullojnë trafikun publik.

Kjo vepër penale është e karakterit blanket, ngase veprimi i kryerjes duhet të konstatohet duke marrë parasysh dispozitat e ligjeve që e rregullojnë trafikun publik. Në këtë aspekt, dispozita me të cilat rregullohet trafiku publik, gjenden në Ligjin Për Rregullat e Trafikut Rrugor³⁹² dhe në disa ligje tjera të kësaj natyre.

Mosrespektimi i dispozitave të trafikut publik me të cilat kryhet kjo vepër penale mund të vie si rezultat i ndërmarrjes së veprimeve të ndryshme. Mënyrat më të shpeshta të kryerjes së kësaj vepre penale janë : vozitja e automjetit me shpejtësi më të madhe se sa është e lejuar, mosmbajtja e distancës midis automjeteve, vozitja e automjetit në gjendje jo të rregullt, vozitja e automjetit në gjendje të lodhur, ndalimi apo parkimi i kundërligjshëm, mosrespektimi i

³⁹² Ligji Nr.05/L-088 Për Rregullat e Trafikut Rrugor i datës 05.09.2016. (në tekstin e mëtejshëm LRTR).

shenjave të trafikut publik, tejkalimet dhe anashkalimet e kundërligjshme, mospërshtatja e shpejtësisë, gjendjes dhe kushteve në rrugë, etj.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin E.T, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, sepse më datën 12.04.2009, në një fshat të Komunës së Gjilanit, duke e drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës “Renault”, me tabela të regjistrimit 111-KS-222, ka rrezikuar trafikun publik aq sa ka vënë në rrezik jetën dhe trupin e njerëzve, si dhe pasurinë, në atë mënyrë që nuk ju përmbahet dispozitave të komunikacionit që kanë të bëjnë me përshtatjen e shpejtësisë gjendjes dhe kushteve në rrugë, ku me të arritur përballë shtëpisë së B.S., nga pakujdesia, gjatë ngasjes humb kontrollin e drejtimit të automjetit, kalon në shiritin e kundërt të rrugës dhe me pjesën e përparme të anës së majtë të automjetit të tij e godet në pjesën e përparme automjetin e markës “Opel Vectra”, me tabela të regjistrimit 222-KS-333, të cilën e drejtonte J.J. dhe këmbësorin O.M., me ç’rast përveç dëmeve materiale në të dy automjetet, lëndime të rënda trupore pëson edhe këmbësori O.M.³⁹³

Element konstitutiv i figurës së kësaj vepre penale është rrezikimi i sigurisë në trafikun publik. Lidhur me këtë, nuk do të konsiderohet se ekziston kjo vepër, nëse nuk është shkaktuar rreziku konkret për jetën apo trupin e ndonjë personi.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, mirëpo për shkak të natyrës së kësaj vepre penale kryerësi i kësaj vepre mund të jetë vetëm pjesëmarrësi në trafik apo komunikacion. Sipas nenit 1.62 të LRTR, pjesëmarrës në trafik nënkupton personin i cili në çfarëdo mënyre merr pjesë në trafikun rrugor. Në këtë drejtim, persona të tillë konsiderohen : personat që i drejtojnë automjetet, personat që gjenden në automjet, si dhe këmbësorët. Sipas këtij ligji, shprehja “këmbësor” nënkupton pjesëmarrësin në trafik që nuk drejton mjet rrugor, as që transportohet nga ndonjë mjet rrugor, apo person i cili me fuqinë e vet shtyn apo tërheq karrocë dore, qerre kafshësh apo ndonjë mjet me lëvizje me veprim motorik, ndonjë mjet transportues të fëmijëve, biçikletë apo karrocë lëvizëse për njerëz të paafhtë, apo person me karrige lëvizëse, i cili e lëviz mjetin me fuqinë e vet ose me fuqinë e motorit nëse lëviz me shpejtësi të njeriut që ec, apo person i cili rrëshqet me patina, me ski, me sajë apo me rrotëza, etj.

Për sa i përket fajësisë, kjo vepër penale mund të kryhet me dashje apo nga pakujdesia. Në rastet kur vepra penale kryhet me dashje, atëherë është paraparë dënimi me gjobë ose burgim deri në tre vjet. Ndërsa, sipas paragrafit 6 të nenit 370 të KPRK, nëse kjo formë e veprës penale kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit..

Në paragrafin 2 të këtij neni, janë parashikuar format e posaçme të rrezikimit të trafikut publik. Sipas këtij paragrafi, kjo formë e kësaj vepre penale kryhet në rastet kur ndonjë person e shkel cilindo ligj mbi trafikun rrugor apo transportin rrugor dhe me këtë rrezikon trafikun

³⁹³ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, P.nr.737/2009, i datës 04.03.2010.

hekurudhor, me tramvaj, me trolejbus, me autobus, me teleferik ose trafikun ujqor dhe në këtë mënyrë rrezikon jetën e njerëzve.

Edhe kjo formë e posaçme e kësaj veprë penale është e karakterit blanket, ngase mënyrat e veprimit me të cilat rrezikohet ky lloj i trafikut janë të përcaktuar me dispozitat e ligjeve përkatëse.

Gjithashtu, si formën themelore të kësaj veprë penale, edhe këtë formë të posaçme mund ta kryejë çdo person, mirëpo për shkak të natyrës së veprës, këtë vepër penale mund ta kryejnë pjesëmarrësit në këtë lloj të trafikut publik.

Veprimi i kryerjes së kësaj forme të veprës penale konsiston në mosrespektimin e dispozitave ligjore të këtyre llojeve të trafikut.

Pasojë e kësaj veprë penale është shkaktimi i rrezikut konkret për jetën ose trupin e njerëzve apo pasurinë me përmasa të mëdha. Këtu është fjala për rrezikun konkret për jetën apo sigurinë fizike të njerëzve apo pasurinë me përmasa të mëdha. Për ekzistimin e kësaj forme të veprës penale, nuk kërkohet që të jetë shkaktuar lëndimi trupor apo dëmtimi i pasurisë dhe se kjo formë e posaçme e kësaj veprë penale konsiderohet se kryhet me vetë faktin e shkaktimit të rrezikut konkret për jetën apo sigurinë fizike të njerëzve apo pasurisë në përmasa të mëdha.

Forma e posaçme e kësaj veprë penale, ashtu si forma themelore, mund të kryhet me dashje ose nga pakujdesia. Nëse vepra penale është kryer me dashje, atëherë është paraparë dënimi me burgim deri në pesë vjet, kurse nëse vepra penale është kryer nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

Sipas paragrafit 3 të nenit 370 të KPRK, nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2. i këtij neni rezulton me dëm pasuror në vlerë prej 15.000 Euro apo më shumë, atëherë kryesi dënohet me burgim prej 6 muaj deri në 5 vjet. Ndërsa, sipas paragrafit 4 të KPRK, nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të ndonjë personi ose dëm pasuror në vlerë prej 20.000 Euro apo më shumë, atëherë kryesi dënohet me burgim prej 1 deri në 8 vjet.

Në paragrafin 5 të nenit të lartcekur është parashikuar forma edhe më e rëndë e kësaj veprë penale ekziston në rastet kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni, rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej 3 deri në 12 vjet, kurse nëse kjo formë është kryer nga pakujdesia, atëherë dënim me burgim prej 1 deri në 8 vjet.

2. Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur (neni 371)

Vepra penale ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur, nga neni 371 i KPRK, në një mënyrë konsiderohet formë e posaçme e rrezikimit të trafikut publik, në raport me veprën penale nga neni 370 i KPRK.

Forma themelore e kësaj vepre penale e parashikuar në paragrafin 1 të nenit 371 të KPRK, kryhet në rastet kur personi e drejton automjetin në gjendje të paaftë apo nën ndikim të alkoolit nëse në gjak ka alkool mbi 0,5 g/kg respektivisht me sasi përkatëse në miligram për litër të ajrit të nxjerrë apo të substancave tjera dehëse nëse shkaktohet aksident.

Te një numër i konsiderueshëm i aksidenteve që ndodhin në trafikun publik, është konstatuar se shkaktar kryesor i këtyre aksidenteve, ka qenë gjendja e dehur e shoferëve të automjeteve me alkool apo me mjete tjera dehëse.

Për ekzistimin e formës themelore të kësaj vepre penale, mjafton që vetëm të konstatohet se kryerësi e ka drejtuar automjetin në gjendje të paaftë apo nën ndikim të alkoolit nëse në gjak ka alkool mbi 0,5 g/kg respektivisht me sasi përkatëse në miligram për litër të ajrit të nxjerrë apo të substancave tjera dehëse nëse shkaktohet aksident.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre është drejtimi i automjetit në gjendje të paaftë apo nën ndikim të alkoolit, nëse në gjak ka alkool mbi 0,5 g/kg respektivisht me sasi përkatëse në miligram për litër të ajrit të nxjerrë apo të substancave tjera dehëse nëse shkaktohet aksident.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin M.S, për veprën penale rrezikimi i trafikut publik për shkak të dehjes, nga neni 298 paragrafi 1 i KPRK, sepse i akuzuari M.S. më datën 03.12.2007, në një fshat të Komunës së Kamenicës, nën ndikimin e alkoolit në një përqindje të alkooltestit prej 2.00 promila, ka drejtuar automjetin e markës “Golf”, me tabela të regjistrimit 111-KS-222 dhe si rezultat i kësaj ka qenë i paaftë për vozitje të sigurt, me ç’rast ka vënë në rrezik jetën, sigurinë apo pasurinë në përmasa të mëdha, në atë mënyrë që me të arritur te shtëpia e të dëmtuarit V.J., e humb kontrollin mbi automjet dhe përplasat në dyert e shtëpisë së të dëmtuarit dhe me këtë të dëmtuarit i shkakton dëm material në një vlerë prej 380 €. ³⁹⁴

Vepra penale konsiderohet se është kryer, nëse shoferi në rrethanat e lartpërmendura ka filluar ta drejtojë automjetin, përkatësisht nëse automjeti ka lëvizur nga vendi dhe me këtë është rrezikuar trafiku publik, jeta e njeriut, siguria fizike apo pasuria në përmasa të mëdha.

Kryerës i veprës penale mund të jetë vetëm personi i cili e drejton automjetin (drejtuesi apo shoferi i automjetit), por jo edhe pjesëmarrësit e tjerë në trafikun publik. Personi i cili e drejton automjetin mund të jetë shofer profesionist apo amator, si dhe mund të jetë personi i cili ka patent shofer, si dhe ai që nuk ka patent shofer.

Vepra penale mund të kryhet me dashje ose nga pakujdesia. Vozitja në gjendje të dehur në praktikën gjyqësore të disa gjykatave, është trajtuar si vozitje e paskrupullt dhe në raste të tilla zakonisht është konstatuar se vepra penale është kryer me dashje eventuale. Konsiderohet se ekziston dashja eventuale nga fakti se personi ka qenë i vetëdijshëm se është duke vozitur në

³⁹⁴ Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Kamenicë, P.nr.432/ësor2007, i datës 03.02.2010.

gjendje të dehur dhe është pajtuar ose e ka dhënë pëlqimin që ta rrezikojë sigurinë e trafikut publik dhe kështu të shkaktojë rrezik për jetën dhe trupin apo pasurinë në përmasa të mëdha.

Në paragrafin 2 të nenit të lartcekur është parashikuar formë e rëndë e kësaj vepre penale, e cila ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të ndonjë personi ose dëm pasuror në vlerë prej 5.000 Euro apo më shumë, për të cilën është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim prej 6 muaj deri në 5 vjet.

Formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 3 të nenit të lartcekur, e cila ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të ndonjë personi ose dëm pasuror në vlerë prej 20.000 Euro apo më shumë, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej 1 deri në 8 vjet.

Kurse, forma më e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 4 të nenit të lartcekur, e cila ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej 3 deri në 12 vjet.

3. Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik (neni 301)

Dhënia e ndihmës personit i cili gjendet në rrezik në përgjithësi është obligim moral i çdo qytetari. Mosdhënia e ndihmës personave të caktuar, nën kushtet e caktuara konsiderohet edhe vepër penale nga neni 188 i KPRK, sipas të cilës kjo vepër penale kryhet në rastet kur ndonjë person nuk i ofron ndihmë personit tjetër jeta e të cilit ndodhet në rrezik të drejtpërdrejtë edhe pse këtë ka mundur ta bëjë pa e rrezikuar veten apo tjetrin.

Edhe me nenin 374 të KPRK është inkriminuar mosdhënia e ndihmës personit tjetër. Mirëpo, kjo vepër penale dallohet nga vepra penale e mosdhënia e ndihmës, nga neni 188 i KPRK, për faktin se te vepra penale nga neni 374 i KPRK, detyrimi për të ofruar ndihmë i bie atij personi i cili me automjetin e tij e ka lënduar personin tjetër, ndaj të cilit është dashur që të jepet ndihma.

Sipas paragrafit 1 të nenit 374 të KPRK, forma themelore e veprës penale mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik, kryhet në rastet kur ngasësi i automjetit ose i mjetit tjetër të transportit, i cili nuk i ofron ndihmë personit të lënduar me atë mjet të transportit.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në mosdhënien e ndihmës personit të lënduar në trafikun publik.

Me shprehjen mosdhënie e ndihmës në sensin e kësaj vepre penale duhet nënkuptuar të gjitha mënyrat e sjelljes së shoferit në kundërshtim me obligimin e tij që t'ia ofrojë këtë ndihmë personit të cilin e ka lënduar me automjetin e tij. Mosdhënia e ndihmës shprehet në mënyra të ndryshme, si p.sh. duke ikur nga vendi i aksidentit të trafikut, duke mos e ndalur automjetin, duke mos e dërguar të lënduarin në entin shëndetësor, duke mos i thirrur personat tjerë apo mjekun për t'i dhënë ndihmë të lënduarit, etj.

Qëllimi i këtij inkriminimi është që ta obligojë ngasësin (shoferin) për t'i dhënë ndihmë personit tjetër të lënduar në aksidentin e trafikut, cili aksident është shkaktuar me automjetin e shoferit.

Për ekzistimin e kësaj vepre penale, është esenciale që personi i lënduar të jetë gjallë.

Kjo vepër penale konsiderohet se ekziston edhe në rastet kur në vendin ku ka ndodhur aksidenti janë të pranishëm persona tjerë të cilët të lënduarit mund t'i japin ndihmë. Ofrimi i ndihmës nga personat tjerë, nuk e përjashton përgjegjësinë penale të shoferit i cili është larguar nga vendi i aksidentit.

Gjithashtu, kjo vepër penale ekziston edhe në rastin kur vetë i lënduari me sjelljet e tij ka kontribuar që të shkaktohet aksidenti, përkatësisht që të lëndohet. Andaj, konsiderohet se kjo vepër penale ekziston edhe në rastet kur shoferi nuk është fajtor për lëndimin e shkaktuar.

Vepra penale konsiderohet se është kryer me vetë faktin se shoferi me automjetin e të cilit është shkaktuar aksidenti, nuk i ka dhënë ndihmë të lënduarit.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë vetëm shoferi ose ngasësi i automjetit apo mjetit tjetër transportues, i cili e lë pa ndihmë personin që është lënduar me atë automjet apo mjet transportues. Pra, këtë vepër penale mund ta kryejë vetëm shoferi përkatësisht vozitësi apo drejtuesi i automjetit apo mjetit tjetër të transportit (*delicta propria*). Sipas nenit 1.82. të LRTR, shprehja “shofer” nënkupton pjesëmarrësin në trafik i cili e drejton mjetin rrugor, kurse sipas nenit 1.46. të këtij Ligji, shprehja “mjet rrugor” nënkupton çdo mjet transporti që lëviz nëpër rrugë, përveç karrocave lëvizëse pa motor për persona me aftësi të kufizuara dhe mjeteve transportuese të fëmijëve.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje. Kryerësi duhet të jetë i vetëdijshëm se me automjetin e tij e ka lënduar personin tjetër dhe se personin e tillë e lë pa ndihmë.

Për formën themelore të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim deri në një vit.

Në paragrafin 2 të nenit 374 të KPRK, është parashikuar forma e rëndë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se ekziston nëse për shkak të kryerjes së formës themelore nga paragrafi 1, është shkaktuar lëndim i rëndë trupor i personit tjetër. Rrethana kualifikuese të kësaj forme të veprës penale janë pasojat e rënda. Pasojat e rënda duhet të jenë rezultat i pakujdesisë së kryerësit, në të kundërtën nëse konstatohet se shoferi nuk i ka dhënë ndihmë personit të lënduar me qëllim që të shkaktoj lëndimin e rëndë trupor, atëherë bëhet fjalë për vepër penale të lëndimit të rëndë trupor.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.

Formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 3 të nenit të lartcekur, e cila ekziston në rastet vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me vdekjen

e personit të lënduar, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

4. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli

Në Kapitullin e veprave penale kundër sigurisë së trafikut publik, bëjnë pjesë edhe këto vepra penale :

- Rrezikimi i trafikut publik me veprime apo me mjete të rrezikshme (neni 372),
- Mbikëqyrja e pandërgjegjshme e trafikut publik (neni 373) dhe
- Keqpërdorimi i sinjaleve ndërkombëtare të telekomunikacionit (neni 375).

KAPITULLI XVII

VEPRAT PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE

I. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME

Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike, në legjislacionet penale të shteteve tjera emërtohen në mënyra të ndryshme, si vepra penale kundër drejtësisë, vepra penale kundër jurisprudencës, vepra penale kundër organeve të drejtësisë, etj.

Objekt mbrojtës i këtij Kapitulli të veprave penale është ushtrimi i rregullt i punës së organeve të drejtësisë dhe administratës publike. Organet e drejtësisë, apo si quhen ndryshe organet e jurisprudencës, mund të definohen në kuptimin e ngushtë dhe në kuptimin e gjerë. Me organe të drejtësisë në kuptimin e ngushtë nënkuptohen gjykatat në Kosovë, siç janë: Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Gjykata Supreme e Kosovës, Gjykata e Apelit e Kosovës dhe gjykatat themelore. Kurse, organe të drejtësisë në kuptimin e gjerë nënkuptojmë përveç gjykatave, edhe Prokurori i Shtetit, Policia e Kosovës, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Shërbimi Sprovues i Kosovës, etj.

Funksionimi i mirëfilltë i organeve të drejtësisë në mënyrën e parashikuar me ligj ka rëndësi të madhe për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Duhet theksuar se funksioni i rregullt i punës së organeve të drejtësisë nuk rrezikohet vetëm me veprat penale të këtij Kapitulli, por edhe me veprat penale të kapitujve tjerë të KPRK, si me Kapitullin e veprave penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut, me Kapitullin e veprave penale kundër detyrës zyrtare, etj.

Shumicën e veprave penale të këtij Kapitulli, mund t'i kryej çdo person, kurse disa vepra penale mund t'i kryejnë vetëm personat që posedojnë cilësi të caktuara, si p.sh. personi zyrtar, dëshmitari, eksperti, etj.

Sa i përket formës së fajit, veprat penale të këtij Kapitulli kryhen me dashje. Krahas kësaj, tek disa vepra penale kërkohet edhe ekzistimi i qëllimit të caktuar, siç është rasti i veprës penale pengimi i të provuarit apo procedurës zyrtare (neni 386), vepra penale rebelimi i personave të privuar nga liria (neni 396).

Vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike, mund të ndahen në 3 grupe :

1. Veprat penale me të cilat bëhet i pamundur ushtrimi i detyrave të organeve të drejtësisë;
2. Veprat penale me të cilat pengohet ose vështirësohet puna normale e organeve të drejtësisë dhe

3. Veprat penale të cilat janë të drejtuara kundër ekzekutimit të vendimeve të organeve të drejtësisë.

II. VEPRAT PENALE TË KËTIJ KAPITULLI

1. Moslajmërimi i përgatitjes së veprave penale (neni 377)

Kriminaliteti është një dukuri e dëmshme dhe e rrezikshme shoqërore, për luftimin dhe parandalimin e të cilit duhet të angazhohen jo vetëm organet shtetërore, por edhe qytetarët e Republikës së Kosovës. Në radhë të parë, është obligim moral i të gjithë qytetarëve që të kontribuojnë në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit, duke i njoftuar organet kompetente. Mirëpo, në disa raste të përcaktuara me ligj, qytetarët janë të obliguar që të lajmërojnë përgatitjen e disa veprave penale, përkatësisht, janë të obliguar që të lajmërojnë kryerjen e disa veprave penale dhe kryerësit e tyre. Moslajmërimi i përgatitjes së këtyre veprave penale dhe moslajmërimi i kryerjes së këtyre veprave penale dhe kryerësve të tyre, në legjislacionin penal konsiderohen si vepra penale. Kështu, në nenin 377 të KPRK, është parashikuar si vepër penale moslajmërimi i përgatitjes së veprave penale, kurse në nenin 378 të KPRK, është parashikuar si vepër penale moslajmërimi i veprave penale apo moslajmërimi i kryerësit të tyre.

Veprën penale moslajmërimi i përgatitjes së veprave penale, nga neni 377 paragrafi 1 të KPRK, e kryen kushdo që, duke qenë në dijeni për përgatitjen e kryerjes së ndonjë vepre penale, nuk e lajmëron këtë fakt në kohën kur kryerja e veprës penale ende ka mund të evitohet ndërsa vepra penale është kryer ose është tentuar.

Siç shihet, figura e kësaj vepre penale përbëhet prej këtyre elementeve :

- që kryerësi të jetë në dijeni për përgatitjen e kryerjes së ndonjë vepre penale;
- që kryerësi të mos e lajmëron këtë fakt në kohën kur kryerja e veprës penale ende ka mundur të evitohet dhe
- që kjo vepër penale të jetë kryer ose është tentuar që të kryhet.

Lajmërimi për përgatitjen e veprës penale duhet t'i bëhet organeve kompetente. Organe kompetente në sensin e kësaj vepre penale, konsiderohen Policia e Kosovës, Prokurori i Shtetit, gjykatat, etj.

Lajmërimi për përgatitjen e veprës penale mund të bëhet në mënyra të ndryshme, si p.sh. me shkrim, drejtpërdrejt me gojë duke u paraqitur në organet kompetente, me telefon, me faks, me e-mail, etj.

Sa i përket mënyrës së kryerjes, kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me mosveprim, duke mos e ndërmarrë veprimin të cilin ka qenë i obliguar që ta ndërmarrë kryerësi, respektivisht duke mos i lajmëruar organet kompetente se ndonjë person është duke e përgatitur kryerjen e veprës penale.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose burgim deri në një vit.

Në paragrafin 2 të këtij neni, është parashikuar forma e rëndë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush nuk lajmëron përgatitjen e kryerjes së një apo më shumë veprave penale në vijim :

1. vrasja e rëndë;
2. vrasja;
3. sulmi me lëndim të rëndë trupor;
4. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XIV – Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës;
5. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XV – Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare;
6. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XX – Veprat penale kundër integritetit seksual;
7. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXXIII – Veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare;
8. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXIII – Veprat penale të narkotikëve;
9. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXIX – Veprat penale të armëve;

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

Paragrafi 3 i këtij neni, është dispozitë ligjore e natyrës permisive, ngase e përjashton përgjegjësinë penale të disa personave që kanë marrëdhënie të caktuara me kryerësin e kësaj vepre penale. Kështu, sipas kësaj dispozite ligjore, me përjashtim të veprave penale që përfshijnë abuzimin e fëmijëve dhe dhunën në familje, personi nuk është penalisht përgjegjës sipas paragrafit 1. të këtij neni nëse është në lidhje familjare me kryesin e veprës penale si prind, fëmijë, bashkëshort ose bashkëshorte, vëlla ose motër, prind adoptues apo fëmijë i adoptuar ose person me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Kryerës i veprës penale nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të jetë çdo person, përveç personave të cilët janë përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, kurse kryerës i veprës penale nga paragrafi 2 të këtij neni, mund të jetë çdo person.

2. Moslajmërimi i veprave penale apo kryerësit të tyre (neni 378)

Formën themelore të kësaj vepre penale, sipas paragrafit 1 të nenit 304 të KPRK, e kryen kushdo që është në dijeni për identitetin e kryesit të një apo më shumë prej veprave penale në vijim dhe nuk e lajmëron faktin e tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet:

1. vrasja e rëndë;
2. vrasja;
3. sulmi me lëndim të rëndë trupor;
4. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XIV – Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës;
5. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XV – Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare;
6. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XX – Veprat penale kundër integritetit seksual;
7. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXXIII – Veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare;
8. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXIII – Veprat penale të narkotikëve;
9. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXIX – Veprat penale të armëve;

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me mosveprim, duke mos e ndërmarrë veprimin të cilin kryerësi ka qenë i obliguar që ta ndërmarrë, respektivisht duke mos i lajmëruar organet kompetente për identitetin e kryerësit të veprave penale.

Obligimi për të lajmëruar kryerësin e veprave penale të lartcekura, fillon prej momentit kur personi është njoftuar me kryerjen e veprës penale përkatëse.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin R.S., për shkak të veprës penale moslajmërimi i veprës penale apo kryerësve të tyre, sepse i akuzuari R.S., nuk e kishte lajmëruar në organet kompetente kryerësin e veprës penale të vrasjes së rëndë³⁹⁵.

Siç është theksuar edhe më lart, për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në tri vjet.

Formë e posaçme e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur personi zyrtar apo personi përgjegjës i cili nuk e lajmëron veprën penale të cilën e ka zbuluar gjatë ushtrimit të detyrës së tij, nëse vepra e tillë është e dënueshme me së paku tri vjet burgim.

³⁹⁵ Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr.77/2005, i datës 11.07.2005.

Kjo formë e posaçme e kësaj vepre penale nga paragrafi 2 i këtij neni, është e ngjashme me formën themelore, nga paragrafi 1 i këtij neni, por i ka edhe specifikat e veta dhe atë

- kryerësi i veprës penale nga paragrafi 2 i këtij neni, mund të jetë vetëm personi zyrtar ose personi përgjegjës;

- obligimi për t'i lajmëruar organet kompetente ka të bëjë vetëm me paraqitjen e veprës penale e jo edhe të kryerësit;

- personat zyrtarë janë të obliguar që t'i lajmërojnë veprat penale për të cilat është parashikuar dënimi me burgim prej së paku tri vjet dhe

- që këtë vepër penale ta kenë zbuluar gjatë ushtrimit të detyrës së tij zyrtare.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim deri në tri vjet.

Në paragrafin 3 të këtij neni, është parashikuar se me përjashtim të veprave penale që përfshijnë abuzimin e fëmijëve dhe dhunën në familje, personi nuk është penalisht përgjegjës sipas këtij neni nëse është në lidhje familjare me kryesin e veprës penale si prind, fëmijë, bashkëshort ose bashkëshorte, vëlla ose motër, prind adoptues apo fëmijë i adoptuar ose person me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Kryerës i veprës penale nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të jetë çdo person, kurse kryerës i veprës penale nga paragrafi 2 i këtij neni, mund të jetë vetëm personi zyrtar.

3. Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale (neni 380)

Formën themelore të kësaj vepre penale, nga paragrafi 1 i nenit 380 të KPRK, e kryen kushdo që strehon kryesin e ndonjë vepre penale, përveç veprave penale të parapara në paragrafin 2. të këtij neni, ose e ndihmon atë në shmangien e zbulimit ose arrestimit përmes fshehjes së mjeteve, provave apo në ndonjë mënyrë tjetër, ose kushdo që strehon personin e dënuar apo ndërmerr veprime për pengimin e arrestimit, ekzekutimit të dënimit apo urdhrimit për trajtim të detyrueshëm.

Dhënia e ndihmës kryerësit të veprës penale manifestohet në mënyra të ndryshme, si p.sh. duke e strehuar, duke e fshehur, duke e transferuar në një vend tjetër, duke i asgjësuar mjetet me të cilat është kryer vepra penale, duke i asgjësuar gjurmët, duke i fshehur mjetet ose gjurmët e veprës penale, duke e furnizuar kryerësin me ushqim, dokumente, barëra, para, etj.

Dhënia ndihmë personit të cilit i është shqiptuar dënimi ose masa e trajtimit të detyrueshëm, manifestohen në mënyra të ndryshme, si p.sh. duke e strehuar ose fshehur personin të cilit i është shqiptuar dënimi ose masa e trajtimit të detyrueshëm, duke e strehuar ose fshehur personin i cili ka ikur nga burgu ose enti për ekzekutimin e masave të trajtimit të detyrueshëm,

duke ndërmarr veprime tjera që kanë për qëllim pengimin e ekzekutimit të dënimit ose masës së trajtimit të detyrueshëm, etj. Siç shihet, kjo formë e kësaj vepre penale mund të kryhet para se kryerësi të fillojë të mbajë dënimin ose masën e trajtimit të detyrueshëm, ose pasi që i dënuari ka ikur, është arratisur gjatë mbajtjes së dënimit ose masës së trajtimit të detyrueshëm.

Vepra penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale, nga neni 380 i KPRK, dallohet ndihma (neni 25 i KPRK) si formë e bashkëpunimit, për faktin se në mes të kryesit të kësaj vepre penale dhe kryesit të veprës së kryer më parë nuk ka ekzistuar asnjë lloj lidhje në kuptim të marrëveshjes apo premtimit se kryerësit do t'i jepet ndihmë pas kryerjes së veprës penale. Në të kundërtën, nëse para se të jetë kryer vepra penale, personi i ka premtuar kryesit se do të ndërmarr veprime me të do të fshehë veprën apo kryesin, atëherë do të konsiderohet si bashkëpunëtor në kryerjen e veprës penale, përkatësisht do të konsiderohet si ndihmës (neni 25 i KPRK).

Për formën themelore të kësaj vepre penale, sipas paragrafit 1 të këtij neni, është parashikuar dënimi me burgim deri në një vit.

Në paragrafin 2 të këtij neni, është parashikuar formë e rëndë e kësaj vepre penale, nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni ka të bëjë me një apo më shumë prej veprave penale në vijim:

1. vrasja e rëndë;
2. vrasja;
3. sulmi me lëndim të rëndë trupor;
4. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XIV – Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës;
5. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XV – Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare;
6. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XX – Veprat penale kundër integritetit seksual;
7. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXXIII – Veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare;
8. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXIII – Veprat penale të narkotikëve ose
9. ndonjë vepër penale nga Kapitulli XXIX – Veprat penale të armëve.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale, është parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet nëse ndokush e ndihmon kryerësin e veprës penale të dënueshme me burgim të përjetshëm.

Për këtë formë edhe më të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Në paragrafin 4 të këtij neni, është parashikuar se dënimi për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të jetë më i ashpër as sipas llojit e as sipas lartësisë se dënimi i përcaktuar për vepër penale të kryer nga personi të cilit i jepet ndihma.

Kurse, në paragrafin 5 të këtij neni, është parashikuar se me përjashtim të veprave penale që përfshijnë abuzimin e fëmijëve dhe dhunën në familje, personi nuk është penalisht përgjegjës sipas këtij neni nëse është në lidhje familjare me kryesin e veprës penale si prind, fëmijë, bashkëshort ose bashkëshorte, vëlla ose motër, prind adoptues apo fëmijë i adoptuar ose person me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore.

Vepra penale dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale, mund të kryhet vetëm me dashje.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, përveç personave që janë cekur në paragrafin 5 të këtij neni.

4. Lajmërimi ose kallëzimi i rremë (neni 382)

Vepra penale lajmërimet e rrejshme, nga neni 382 i KPRK, i ka 4 forma të saj, të cilat janë të parashikuara në 4 paragrafe të këtij neni.

Forma e parë e kësaj vepre penale konsiderohet se kryhet në rastet personi bën lajmërim të rremë te personi zyrtar i ngarkuar me detyrën për të hetuar apo ndjekur, se personi i caktuar ka kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, duke e ditur se personi i tillë nuk është kryesi

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale konsistojnë në lajmërimin e rrejshëm se personi i caktuar ka kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare. Ky lajmërim i rrejshëm bëhet me qëllim të fillimit të procedurës penale ndaj personit të caktuar.

Lajmërimi i rrejshëm se personi i caktuar ka kryer vepër penale mund të bëhet në mënyra të ndryshme, si p.sh. me shkrim, drejtpërdrejt me gojë duke u paraqitur në organet kompetente, me telefon, me faks, me e-mail, etj.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpall të akuzuarin A.A., për shkak të kësaj vepre penale, sepse më datën 12.07.2007, në Stacionin Policor në Lipjan, e lajmëron rrejshëm se personi B.B., e ka kryer veprën

penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, edhe pse e ka ditur se kjo nuk është e vërtetë dhe se i dëmtuari B.B., nuk e ka kryer këtë veprë penale.³⁹⁶

Kurse, në një çështje tjetër penale, gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin S.F., për shkak të kësaj vepre penale, sepse i akuzuari në Stacionin Policor në Viti, e lajmëron rrejshëm se personi i caktuar, ia ka vjedhur veturën e tij, të markës “Mercedes”, me tabela të regjistrimit 111-KS-222 edhe pse e ka ditur se kjo nuk është e vërtetë, por këtë e ka bërë me qëllim të fshehjes së gjurmëve të një vepre tjetër penale.³⁹⁷

Kjo formë e kësaj vepre penale konsiderohet se ekziston në rastet kur fare nuk është kryer vepra penale ose vepra penale është kryer, mirëpo kryerës i kësaj vepre penale nuk është personi, për të cilin është lajmëruar rrejshëm, por ndonjë person tjetër.

Kjo veprë penale konsiderohet se ekziston vetëm nëse bëhet lajmërimi i rrejshëm për ndonjë veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare.

Gjithashtu, për të ekzistuar kjo veprë penale, duhet që kryerësi t’ a dijë përkatësisht duhet të jetë i vetëdijshëm se personi të cilin e lajmëron rrejshëm nuk është kryerës i veprës penale.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

Formën e dytë të kësaj vepre penale e kryen kushdo që ofron prova të rreme për veprën penale ose në ndonjë mënyre tjetër shkakton fillimin e procedurës penale për veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare kundër personit për të cilin ai e di se nuk e ka kryer veprën penale.

Veprimi i kryerjes së kësaj forme të veprës penale konsiston nënien e gjurmëve (provave) ose sendeve të veprës penale apo në ndonjë veprim tjetër me të cilin shkaktohet nisja e procedurës penale kundër një personi.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

Forma e tretë e kësaj vepre penale konsiderohet se është kryer në rastet kur ndokush e lajmëron veten se ka kryer veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, edhe pse nuk e ka kryer veprën e tillë.

Kjo formë e veprës penale konsiderohet se kryhet në rastet kur një person e lajmëron veten se ka kryer një veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, edhe pse nuk e ka kryer këtë veprë penale.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë apo me burgim deri në tre muaj.

³⁹⁶ Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Lipjan, P.nr.48/2008, i datës 06.05.2008.

³⁹⁷ Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr.8/2005, i datës 08.11.2005.

Forma e katërt e kësaj vepre penale ekziston në rastet kur ndokush e lajmëron te personi zyrtar i ngarkuar me detyrën për të hetuar apo ndjekur, se është kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, edhe pse ai e di se vepra nuk është kryer.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin G.N., për shkak të kësaj vepre penale, sepse me datën 11.12.2006, rreth orës 10:18, në numrin e telefonit 112 të Stacionit Policor në Gjilan, përmes numrit të tij të telefonit 0280-320-000 ka lajmëruar rrejshëm, se në oborrin e Shkollës Fillore “Ramiz Cërnica”, në Gjilan, ka vërejtë një bombë, ku më pastaj Policia e Kosovës, ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka konstatuar se lajmërimi ka qenë i rrejshëm.³⁹⁸

Kjo vepër penale konsiderohet se është kryer në momentin kur organet kompetente e kanë pranuar lajmërimin e rremë.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

5. Deklarimet e rreme (neni 384)

Deklaratat e dëshmitarëve, konstatimet e ekspertëve, përkthimet e përkthyesve dhe interpretimet e interpretëve, kanë një rëndësi shumë të madhe për nxjerrjen e vendimeve të drejta në procedurën gjyqësore, kundërvajtëse, administrative dhe në procedurat tjera. Deklarimet e rreme të këtyre personave e vënë në lajthim organin e cili vendos në këto procedura dhe si rezultat mund të nxjerren vendime të gabuara. Deklarimet e rreme të këtyre personave, veçmas janë shumë të dëmshme në procedurën penale, ngase si pasojë mund të ketë dënimin e personit të pafajshëm apo lirimin e personit i cili ka kryer vepër penale. Për këtë arsye, dhënia e deklaratës së rreme është parashikuar si vepër penale në legjislacionet penale të shteteve bashkëkohore. Dhënia e deklaratës së rreme, është parashikuar si vepër penale edhe në KPRK. Kështu, sipas paragrafit 1 të nenit 384 të KPRK, këtë vepër penale e kryen pala, dëshmitari, eksperti në cilësi të dëshmitarit, përkthyesi apo interpreti i cili në procedurën gjyqësore ose penale, procedurën paraprake, në procedurën për kundërvajtje, në procedurën administrative, në procedurën para noterit publik ose në procedurën disiplinore jep deklaratë, ekspertizë ose raport të rremë.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në dhënien e deklaratës së rreme në procedurat e lartcekura.

Deklarata, në sensin e kësaj vepre penale nënkupton deklaratën e pales, dëshmitarit, deklaratën dhe konstatimin e ekspertit, përkthimin nga përkthyesi dhe interpretimin nga ana e interpretit të ndonjë deklarate të personave tjerë, p.sh. personave shurdhmemecë.

³⁹⁸ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, P.nr.25/2007, i datës 27.09.2007.

Kjo veprë penale ekziston, vetëm nëse deklarata jepet lidhur me çështjen e cila është objekt i të provuarit dhe ajo çka pohohet ose mohohet duhet të jetë me ndikim për nxjerrjen e vendimit.

Nuk do të konsiderohet se ekziston kjo veprë penale nëse jepen të dhëna të pavërteta të cilat fare nuk janë objekt i vërtetimit në procedurën përkatëse, p.sh. deklarata e rreme e dëshmitarit lidhur me vendin e lindjes, etj.

Kjo veprë penale mund të kryhet në procedurën gjyqësore ose penale, në procedurën paraprake, në procedurën për kundërvajtje, në procedurën administrative, në procedurën para noterit publik ose në procedurën disiplinore.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin S.D., për shkak të veprës penale deklarimet e rreme, sepse i akuzuari S.D., në procedurën administrative, në cilësinë e dëshmitarit kishte dhënë deklaratë të rrejshme.³⁹⁹

Për këtë formë të kësaj veprë penale është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim deri në një vit.

Në paragrafin 2 të këtij neni, është parashikuar forma e rëndë e kësaj veprë penale, e cila konsiderohet se kryhet nëse deklarata e rreme merret si bazë për vendimin përfundimtar në procedurë.

Për këtë formë të rëndë të kësaj veprë penale është parashikuar dënimi me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

Formë edhe më e rëndë e kësaj veprë penale është parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me pasoja të rënda për personin e akuzuar.

Për këtë formë edhe më të rëndë të kësaj veprë penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në pesë vjet.

Në paragrafin 4 të këtij neni, është parashikuar se nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 1 i këtij neni, vullnetarisht e tërheq deklaratën e tij para marrjes së vendimit përfundimtar, gjykata mund ta zbusë dënimin.

Kryerës i kësaj veprë penale mund të jetë vetëm pala, dëshmitari, eksperti në cilësi të dëshmitarit, përkthyesi apo interpreti (*delicta propria*).

Kjo veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje.

6. Falsifikimi i dokumenteve (neni 390)

³⁹⁹ Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Gjilan, P.nr.1244/2007, i datës 10.03.2009.

Këtë veprë penale, sipas paragrafit 1 të nenit 390 të KPRK, e kryen kushdo që përpilon dokument të falsifikuar, ndryshon dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal ose me dije përdor dokumentin e falsifikuar apo të ndryshuar si origjinal.

Veprimet e kryerjes së kësaj veprë penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe manifestohen në tri mënyra :

- përpilimi i dokumentit të falsifikuar,
- ndryshimi i dokumentit origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal ose
- përdorimi me dije i dokumentit të falsifikuar ose të ndryshuar.

Përpilimi i dokumentit të falsifikuar duhet nënkuptuar krijimin ose mbarimin e dokumentit të rremë me qëllim që dokumenti i tillë të përdoret si i vërtetë. Me këtë formë të kësaj veprë penale krijohet një dokument që më parë nuk ka ekzistuar.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin U.R., për shkak të kësaj veprë penale, sepse i akuzuari me qëllim të përdorimit të dokumentit të falsifikuar si të vërtetë, e kishte falsifikuar lejen për të qëndruar në Francë, e cila pas ekzaminimit laboratorik është vërtetuar se është totalisht e falsifikuar.⁴⁰⁰

Ndryshimi i dokumentit origjinal manifestohet në rastet kur bëhen ndryshime në përmbajtjen e dokumentit. Për të ekzistuar kjo formë e kësaj veprë penale, duhet që ndryshimi i dokumentit origjinal të bëhet me qëllim që të shfrytëzohet apo përdoret si i vërtetë ky dokument.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin K.O., për shkak të kësaj forme të veprës penale, sepse i akuzuari e kishte ndryshuar dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të këtij dokumenti si origjinal, në atë mënyrë që në librezën e regjistrimit të automjetit të tij, me numër VRD 01123456, kishte bërë vazhdimin e regjistrimit të këtij automjeti edhe për një vit, deri më datën 21.02.2007, duke e vendosur në të vulën dhe nënshkrimin e falsifikuar.⁴⁰¹

Shfrytëzimi i dokumentit të falsifikuar ose të ndryshuar si të vërtetë nënkuptohet përdorimi i këtij dokumenti përkatësisht vënia e këtij dokumenti në qarkullimin juridik. Shfrytëzimi apo përdorimi i dokumentit të falsifikuar mund të bëhet si nga personi i cili e ka përpiluar apo ndryshuar këtë dokument, ashtu edhe nga personi tjetër. Për ekzistimin e kësaj forme të veprës penale, duhet që personi i cili e përdor këtë dokument, ta di apo të jetë i vetëdijshëm se ky dokument është i falsifikuar.

⁴⁰⁰ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, P.nr.2413/2006, i datës 02.04.2008.

⁴⁰¹ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Lipjan, P.nr.15/2008, i datës 04.02.2008.

Objekt i kësaj vepre penale janë dokumentet. Kuptimi juridiko-penal i dokumentit është mjaft i gjerë. Kështu, sipas nenit 113 paragrafi 8 të KPRK, shprehja **“dokument”** do të thotë çdo dokument apo send tjetër i përshtatshëm ose i caktuar që shërben si provë e ndonjë fakti përkatës për marrëdhëniet juridike. Në të shumtën e rasteve, si dokumente paraqiten letrat e shkruara në të cilat gjendet ndonjë deklaratë për ndonjë fakt juridik relevant, siç janë p.sh. kontratat, çertifikatat e ndryshme, diplomat e ndryshme, pasaporta, letërnjoftimi, patent shoferi, dokumentet e regjistrimit të automjeteve, etj. Përveç këtyre, si dokument mund të jetë edhe çdo send tjetër që është i përshtatshëm për të vërtetuar ndonjë fakt, p.sh. guri i mezhdës në arë, shënimet në dru, etj.

Në teorinë e së drejtës penale, dokumentet ndahen në mënyra të ndryshme, varësisht se cili kriter mirret për bazë. Kështu, kemi dokumente publike dhe private, dokumente në kuptimin e ngushtë dhe të gjerë, dokumente origjinale dhe të fotokopjuara, etj.

Vepra penale konsiderohet se është kryer nëse është ndërmarrë njëri nga veprimet e kryerjes të kësaj vepre penale.

Për formën themelore të kësaj vepre penale, nga paragrafi 1 i këtij neni, është parashikuar dënimi me gjobë apo burgim deri në katër vjet.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer në lidhje me dokumentin publik, testamentin, kambialin, regjistrin publik apo zyrtar ose ndonjë regjistri tjetër që ruhet në bazë të ligjit.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpall fajtor të akuzuaren XH.A., për shkak të kësaj vepre penale, sepse e akuzuara ka përdorur pasaportën jugosllave, si dokument publik, si të vërtetë edhe pse e ka ditur se nuk është i tillë, ashtu që më datën 08.07.2007, në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, me qëllim të kalimit të zonës kufitare dhe ardhjes nga Zvicra për në Kosovë, derisa ishte duke e kaluar zonën kufitare, kur policia kufitare ja kërkon dokumentin e udhëtimit, e akuzuara ja prezenton pasaportën nr.003045401, të lëshuar në emër të saj, për të cilin dokument pas ekzaminimit u vërtetua se faqja e parë e pasaportës ishte e falsifikuar.⁴⁰²

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale, nga paragrafi 2 i këtij neni, është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim deri në pesë vjet.

Ndërsa, në paragrafin 3 të nenit të lartcekur, është parashikuar forma edhe më e rëndë e kësaj vepre penale e cila ekziston në rastet kur vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 të këtij neni kryhet si anëtar i grupit të njerëzve, për të cilën është parashikuar dënim me gjobë dhe burgim prej një deri në tetë vjet.

⁴⁰² Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, P.nr.1761/2007, i datës 11.06.2008.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje dhe me qëllimin e lartpërmendur.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

7. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli

Përveç veprave penale të lartcekura, në Kapitullin e veprave penale kundër administrimit të drejtësisë bëjnë pjesë edhe këto vepra penale :

- Moslajmërimi i personit të akuzuar nga tribunali ndërkombëtar penal (neni 379);
- Dhënia e ndihmës personit të akuzuar nga tribunali ndërkombëtar penal (neni 381);
- Deklarimi i rremë nën betim (neni 383);
- Deklaratat e rreme të dëshmitarëve bashkëpunues (neni 385);
- Pengimi i të provuarit apo procedurës zyrtare (neni 386);
- Frikësimi gjatë procedurës penale (neni 387);
- Hakmarrja (388);
- Manipilimi me prova (nenni 389);
- Rastet e posaçme të falsifimit të dokumenteve (neni 391);
- Shkelja e fshehtësisë së procedurës (neni 392);
- Mospërfillja e gjykatës (neni 393);
- Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore (neni 394);
- Legalizimi i përmbajtjes së rreme (neni 395);
- Arratisja e personit të privuar nga liria (neni 397);
- Mundësimi i arratisjes së personave të privuar nga liria (neni 398);
- Lirimi i kundërligjshëm i personave të privuar nga liria (neni 399 dhe
- Mundësimi i kundërligjshëm i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (neni 400).

KAPITULLI XVIII

VEPRAT PENALE KUNDËR RENDIT PUBLIK

I. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME

Në Kapitullin e veprave penale kundër rendit publik janë të sistemuara veprat penale me të cilat mbrohen të mira juridike të natyrave të ndryshme. Në këtë Kapitull janë sistemuar veprat penale të ndryshme, të cilat sipas kriterëve të objektit mbrojtës, nuk kanë mundur të sistemohen në kapitujt e tjerë të KPRK. Sikur këto vepra penale të radhiteshin sipas objektit mbrojtës, atëherë do të krijoheshin një numër i madh i kapitujve të veprave penale në KPRK.

Kryerës i shumicës së veprave penale të këtij Kapitulli, mund të jetë çdo person.

Të gjitha veprat penale kundër rendit publik dhe veprimeve juridike mund të kryhen vetëm me dashje. Për asnjë vepër penale të këtij Kapitulli nuk është parashikuar në mënyrë shprehimore se mund të kryhet edhe nga pakujdesia.

II. VEPRAT PENALE TË KËTIJ KAPITULLI

1. Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare (neni 401)

Personat zyrtarë me qëllim të kryerjes sa më efikase të detyrave të tyre zyrtare, gëzojnë mbrojtje të posaçme nga legjislacioni penal i çdo shteti. Në pjesën e posaçme të legjislacioneve të shteteve bashkëkohore, janë parashikuar si forma të rënda apo të kualifikuara të veprave penale, rastet kur këto vepra penale kryhen kundër personave zyrtarë gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare. Përveç këtyre, në pjesën e posaçme të legjislacioneve penale të shteteve bashkëkohore janë parashikuar si vepra penale të posaçme, rastet kur pengohen personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare apo kur sulmohen personat zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare. Në këtë aspekt, edhe në KPRK janë parashikuar si vepra penale të posaçme, pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare (neni 401) dhe sulmi ndaj personit zyrtar (neni 402).

Sipas paragrafit 1 të nenit 401 të KPRK, formën themelore të vepër penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, e kryen kushdo që me forcë apo me kanosje serioze, pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare.

Siç shihet, kjo vepër penale sipas këtij paragrafi, mund të kryhet në 2 forma :

1. duke e penguar personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare dhe
2. duke e detyruar personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.

Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nënkupton situatat kur personit zyrtar i bëhet e pamundur apo i vështirësohet kryerja e detyrave zyrtare.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin J.N., sepse i akuzuari më datën 27.05.2005, në Lipjan, me kanosje për përdorim të atqasshëm të dhunës, e ka penguar personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, përkatësisht e ka penguar zyrtarin e ekzekutimeve të Gjykatës Komunale në Lipjan, për të ekzekutuar vendimin e formës së prerë në procedurën përmbarimore, që kishte të bënte me pagesën e borxhit nga ana e të akuzuarit.⁴⁰³

Për të ekzistuar kjo veprë penale, duhet që personi zyrtar të pengohet në kryerjen e detyrave zyrtare që janë në fushëveprimtarinë e kompetencave të tij.

Detyrimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nënkupton situatat kur personi zyrtar detyrohet që t'a kryejë një veprim zyrtar. P.sh. kjo veprë penale do të ekzistonte, nëse kryerësi me dhunë apo kanosje për përdorimin e atqasshëm të dhunës e detyron personin zyrtar që t'ia lëshojë ndonjë certifikatë, apo ndonjë leje të ndërtimit, leje për punë, licencë, etj.

Kjo veprë penale kryhet duke përdorur forcën apo kanosjen serioze.

Për formën themelore të kësaj vepre penale, sipas paragrafit 1 të këtij neni, është parashikuar dënimi me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

Formë tjetër e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se ekziston në rastet kur ndonjë person merr pjesë në një grup të personave që me veprim të përbashkët pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri tre vjet, ndërsa për organizatorin e grupit është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në pesë vjet.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 4 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni, përfshin kanosjen për përdorimin e armës apo mjetit të rrezikshëm ose rezulton me lëndim trupor.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Sipas paragrafit 5 të nenit të nenit të lartcekur, nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet ndaj gjyqtarit, prokurorit, zyrtarit të gjykatës, zyrtarit të prokurorisë apo personit të autorizuar nga gjykata dhe prokuroria zyrtarit policor, zyrtarit doganor, zyrtarit ushtarak apo zyrtarit të shërbimit korrektues gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare, atëherë kryesi dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

⁴⁰³ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Lipjan, P.nr.57/2008, i datës 21.04.2008.

Formë tjetër e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 6 të nenit të lartcekur, e cila ekziston në rastet kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në pesë vjet.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

2. Sulmi ndaj personit zyrtar (neni 402)

Këtë vepër penale, sipas paragrafit 1 të nenit 317 të KPRK, e kryen kushdo që e sulmon ose kanoset seriozisht se do ta sulmojë personin zyrtar ose personin i cili ndihmon në kryerjen e detyrave zyrtare, në lidhje me detyrat zyrtare.

Kjo vepër penale është e karakterit subsidiar, ngase në rastet kur sulmi bëhet me qëllim të pengimit apo detyrimit të ushtrimit të detyrës zyrtare, do të konsiderohet se ekziston vepra penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 401 i KPRK. Vepra penale sulmi ndaj personit zyrtar, nga neni 402 i KPRK, konsiderohet se ekziston me vetë faktin e sulmit ndaj këtyre personave.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale manifestohet në rastet kur ndokush e sulmon ose i kanoset seriozisht se do ta sulmojë personin zyrtar ose personin i cili ndihmon në kryerjen e detyrave zyrtare, në lidhje me detyrat zyrtare.

Me shprehjen “sulm” duhet nënkuptuar të gjitha ato veprime me të cilat rrezikohet ose dëmtohet integriteti trupor i personit zyrtar ose i ndihmësit të tij, por me kusht që mos të jetë shkaktuar lëndimi i lehtë trupor, ngase në paragrafin vijues të këtij neni, është parashikuar si formë e rëndë e kësaj vepre penale, rastet kur personit zyrtar apo ndihmësit të tij i është shkaktuar lëndimi i lehtë trupor. Andaj, si veprime të kryerjes së kësaj forme të veprës penale, duhet të konsiderohen rastet si : kapja për hunde, për

kapja për flokë, tërheqja për dore ose rroba, shtyerja, matja me dorë apo me këmbë se do t'i shkaktohet goditje, etj.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin L.A., për shkak të kësaj vepre penale, sepse i akuzuari, më datën 20.11.2007, në Lipjan, i kishte sulmuar personat zyrtarë (oficerët e Policisë së Kosovës), gjatë kryerjes së detyrave zyrtare të sigurimit publik, në atë mënyrë që njërin oficer të policisë e shyn me duar dhe e mbështet për veturën e të akuzuarit, kurse oficerit tjetër të policisë i matet me grusht për ta goditur.⁴⁰⁴

⁴⁰⁴ Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Lipjan, P.nr.56/2008, i datës 12.03.2008.

Vepra penale konsiderohet se është kryer me vetë faktin e kryerjes së sulmit ndaj personit zyrtar apo ndihmësit të tij dhe për ekzistimin e kësaj vepre penale nuk është e nevojshme që kryerja e detyrave zyrtare të jetë penguar apo vështirësuar.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

Sipas paragrafit 2 të nenit të laartcekur, nëse vepra penale nga paragrafi 1 përfshin gjyqtarin, prokurorin, policin, zyrtarin doganor, zyrtarin korrektues, në lidhje me detyrat zyrtare, sigurinë e përgjithshme, sigurinë e Republikës së Kosovës apo ruajtjen e rendit publik, atëherë kryesi do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 3 të nenit 402 të KPRK, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni, rezulton me lëndim të lehtë trupor të personit zyrtar apo të ndihmësit të tij ose përfshin kanosjen për përdorimin e armës apo mjetit të rrezikshëm.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, i akuzuari B.A., është shpall fajtor për shkak të kësaj vepre penale, sepse i akuzuari më datën 23.07.2009, në Gjilan, në restorantin “BB”, i ka sulmuar fizikisht personat zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare të sigurimit publik të Kosovës dhe atë të dëmtuarit B.SH. dhe N.I. oficerë të Policisë së Kosovës, duke i goditur të njejtit me karrige dhe duke i shtyer më duarë, me ç’rast të njejtëve ju ka shkakuar lëndime të lehta trupore, për çka edhe janë detyruar që të kërkojnë ndihmë mjekësore në Qendrën Emergjente të Spitalit Regjional në Gjilan.⁴⁰⁵

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Në paragrafin 4 të këtij neni, është parashikuar forma edhe më e rëndë e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni, rezulton me lëndim të lehtë trupor të gjyqtarit, prokurorit, policit, zyrtarit doganor, zyrtarit korrektues, ose përfshin kanosje për përdorimin e armës apo mjetit të rrezikshëm.

Për këtë formë edhe më të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në tetë vjet.

Ndërsa, nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të personit zyrtar apo ndihmësit të tij, atëherë është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në dhjetë vjet burgim (paragrafi 5).

Formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 6 të nenit të laartcekur, e cila ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni rezulton me lëndim të

⁴⁰⁵ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, P.nr.792/2009, i datës 10.09.2009.

rëndë trupor të gjyqtarit, prokurorit, policit, zyrtarit doganor apo zyrtarit korrektues, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej dy deri në dymbëdhjetë vjet.

Kurse, në paragrafin 7 të këtij neni, është parashikuar se nëse kryerësi i veprës penale nga ky nen neni është provokuar nga veprimi i kundërligjshëm apo vrazhdë i personit zyrtar, gjykata mund ta zbusë nga dënimi.

Subjekt pasiv i kësaj vepre penale mund të jenë vetëm personat zyrtar të lartcekur.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person dhe kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

3. Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave (neni 406)

Sipas paragrafit 1 të nenit 406 të KPRK, këtë vepër penale e kryen kushdo që heq ose dëmto vulën zyrtare apo shenjën e ngjitur nga zyrtari i autorizuar me qëllim të sigurimit të objektit ose të lokaleve, apo kushdo që hap objektet e siguruara ose hyn në lokalet e tilla pa e hequr ose pa e dëmtuar vulën apo shenjën apo shenjën, ose hap sendin në të cilin ka qenë e vendosur vula apo shenja e tillë.

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë në :

- a) heqjen ose dëmtimin e vulave zyrtare ose shenjave,
- b) hapjen e objekteve të siguruara pa e hequr ose pa e dëmtuar vulën ose shenjën;
- c) hyrjen në lokalet e siguruara pa e hequr ose pa e dëmtuar vulën ose shenjën ose
- d) hap sendin në të cilin ka qenë e vendosur vula apo shenja e tillë.

Vula apo shenja zyrtare janë simbole të caktuara të cilat vendosen në objekte apo lokale, me të cilat u bëhet me dije personave tjerë se në ato lokale nuk mund të hyjnë, përkatësisht që ato lokale nuk duhet të hapen.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin L.N., për shkak të kësaj vepre penale, sepse i akuzuari në një fshat të Komunës së Kamenicës, pikërisht në depon e ndërmarrjes së tij “X”, e ka hequr, duke e këputur zinxhirin dhe plumbën nga dera e lokalit dhe nga peshorja për matjen e peshës së kafshëve, të cilat i kishin vendosur më parë Inspektorët Sanitarë të Komunës së Kamenicës.⁴⁰⁶

Në sensin e kësaj vepre penale, edhe informatat me shkrim që vendosen në objekte apo lokale konsiderohen shenja zyrtare.

⁴⁰⁶ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Kamenicë, P.nr.238/2004, i datës 28.07.2005.

Në praktikën gjyqësore, vula apo shenja zyrtare konsiderohen edhe plombat dhe shiritat të cilat vendosen në orët e energjisë elektrike nga zyrtarët e autorizuar të KEK-ut.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje tjetër penale, gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin Z.F., për shkak të kësaj vepre penale, sepse i akuzuari në shtëpinë e tij, i ka hequr plombat nga ora e rrymës dhe është vetëkyqyr në rrjetin elektrik, plomba këto të cilat ishin vendosur nga zyrtarët e autorizuar të KEK-ut, për shkak të mospagesës së rrymës nga ana e të akuzuarit.⁴⁰⁷

Për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në tri vjet.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

4. Vetëgjyqësia (neni 410)

Sipas paragrafit 1 të nenit 410 të KPRK, formën themelore të kësaj vepre penale e kryen kushdo që ushtron në mënyrë arbitrare të drejtën që mendon se i takon në vend se t'i drejtohet organit kompetent.

Qëllimi i këtij inkriminimi është që t'i parandalojë qytetarët që në mënyrë arbitrare të realizojnë të drejtat e tyre. Me kryerjen e kësaj vepre penale anashkalohet ligji me të cilin parashihet procedura dhe organi kompetent për realizimin e një të drejte nga ana e qytetarëve. Me fjalë tjera, me këtë vepër penale injorohet rendi juridik ekzistues.⁴⁰⁸

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në realizimin në mënyrë arbitrare të një të drejte, për të cilën kryerësi mendon se i takon. Këto të drejta mund të jenë të drejta sendore, prindore, detyrimore, trashëgimore, etj.

Shembuj të kësaj vepre penale

Në praktikë, kjo vepër penale do të ekzistonte, p.sh. nëse personi A, sendin e tij në mënyrë arbitrare ja merr personit B; nëse prindi të cilit me vendim të formës së prerë i është besuar fëmija për përkujdesje, ja merr në mënyrë arbitrare këtë fëmijë ish bashkëshortes së tij, pa ju drejtuar organeve kompetente për ekzekutimin e këtij vendimi; nëse qiradhënësi ja merr në mënyrë arbitrare shumën e qirasë qiramarrësit; etj.

Nëse kryerësi e realizon një të drejtë për të cilën e di se nuk i takon, nuk do të konsiderohet se ekziston kjo vepër penale, por mund të bëhet fjalë për ndonjë vepër tjetër penale.

Vepra penale konsiderohet se është kryer në rastet kur kryerësi në mënyrë arbitrare e realizon të drejtën që mendon se i takon.

⁴⁰⁷ Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Gjilan, P.nr.1120/2005, i datës 15.10.2009.

⁴⁰⁸ SALIHU, ISMET, E drejta penale, Pjesa e posaçme, f. 603.

Për formën themelore të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë apo me burgim deri në gjashtë muaj.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush me anë të përdorimit të forcës apo kanosjes serioze ushtron një të drejtë të cilën personi mendon se i takon në vend se t'i drejtohet organit kompetent.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin F.S., për shkak të kësaj vepre penale, sepse më datën 04.02.2008, në Viti, i akuzuari ka ushtruar në mënyrë arbitrare të drejtat të cilat mendon se i takojnë, në atë mënyrë që me kanoje për përdorimin e dhunës, pa ju drejtuar organeve kompetente, e ka marrë kamionin e tij, nga depoja e Agjencionit Pyjor të Kosovës.⁴⁰⁹

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim deri në dy vjet.

Në paragrafin 3 të këtij neni, është parashikuar forma edhe më e rëndë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni, është kryer nga kryerësi i cili vepron si anëtar i grupit.

Për këtë formë më të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë muajve deri në tri vjet.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje dhe kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

5. Dëmtimi i varreve apo i kufomave (neni 413)

Varrezat dhe varret ku janë të varrosur të vdekurit, konsiderohen të shenjta për çdo person, pa marrë parasysh religjionin, kombësinë, gjuhën, racën, etj. Dëmtimi dhe rrënimi i varrezave, nga opiniononi i gjerë konsiderohen si veprime të paskrupullta dhe gjykohen shumë ashpër, ngase prek rëndë ndjenjat emocionale të anëtarëve të familjes së të vdekurve. Dëmtimi dhe rrënimi i varrezave, nuk lejohet jo vetëm me normat e moralit dhe të secilit religjion, por edhe me normat e së drejtës penale. Në këtë drejtim në nenin 413 të KPRK, është parashikuar si vepër penale dëmtimi i varreve ose i kufomave. Sipas paragrafit 1 të këtij neni, këtë vepër penale e kryen kushdo që pa autorizim gërmon, mih, rrënon, heq, dëmton, shkatërron ose përdhos varrin apo ndonjë vendvarrim tjetër.

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë gërmimi, mihja, rrënimi, heqja, dëmtimi, shkatërrimi ose përdhosja e varrit apo ndonjë vendvarrimi.

⁴⁰⁹ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Viti, P.nr.64/2008, i datës 22.12.2009.

Për ekzistimin e kësaj vepre penale, duhet që veprimet e kryerjes të ndërmerren pa autorizim. Andaj, nuk ekziston kjo vepër penale nëse është bërë hapja dhe gërmimi i varrit nga organet kompetente, sipas dispozitave ligjore të KPPK, me qëllim që të nxjerrin kufomën për të bërë autopsinë e saj.

Kjo vepër penale mund të kryhet si ndaj varreve që gjenden në varreza, ashtu edhe ndaj varreve që gjenden në ndonjë vend tjetër, p.sh. në kisha, në tyrbe, etj.

Shembuj nga praktika gjyqësore

Në një çështje penale, gjykata i ka shpall fajtorë S.A. dhe E.O., për shkak të kësaj vepre penale, sepse të akuzuarit më datën 28.05.2007, në një fshat të Komunës së Kamenicës, me mjete të forta e kanë dëmtuar varrin i cili gjendet në Tyrben e këtij fshati, ku më pas e marrin kapakun (mbulojën) e këtij varri dhe e vendosin para derës së hyrjes së kësaj Tyrbe.⁴¹⁰

Kjo vepër penale konsiderohet se është kryer nëse varri apo ndonjë vendvarrim është gërmuar, rrënuar, dëmtuar apo përdhosur.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Formë tjetër e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush nxjerr nga varri, zhvendos, dëmton, shkatërron ose fsheh kufomën, një pjesë të saj ose hirin e të vdekurit.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë apo me burgim deri në tri vjet.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

6. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli

Përveç veprave penale të lartcekura, në Kapitullin e veprave penale kundër rendit publik parashihen edhe këto vepra penale :

- Thirrja për rezistencë (neni 403),
- Pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizmi (neni 404),
- Mospjesëmarrja në mënjanimin e rrezikut të përgjithshëm (neni 405),
- Marrja apo asgjësimi i vulave zyrtare ose i shkresave zyrtare (neni 407),

⁴¹⁰ Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Kamenicë, P.nr.108/2007, i datës 02.02.2009.

- Asgjësimi apo fshehja e materialit arkivor (neni 408),
- Prezentimi i rremë si person zyrtar (neni 409),
- Dhënia e kundërligjshme e ndihmës juridike (neni 411) dhe
- Pengimi i ceremonive fetare (neni 412).

KAPITULLI XIX

VEPRAT PENALE KUNDËR DETYRËS ZYRTARE

I. Shqyrtime të përgjithshme

Veprat penale kundër detyrës zyrtare, në teorinë e së drejtës penale ndryshe emërtohen edhe si “**vepra penale zyrtare**” dhe kanë qenë të njohura qysh në të Drejtën romake.

Veprat penale kundër detyrës zyrtare kryhen duke u shkelur detyrat dhe autorizimet zyrtare. Personat e autorizuar zyrtarë, detyrën e tyre zyrtare duhet ta ushtrojnë duke u bazuar në ligj dhe duke i respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Ushtrimi i ndërgjegjshëm dhe në pajtim me ligjin i detyrave zyrtare, është kusht elementar për realizimin e demokracisë dhe sundimin e së drejtës. Keqpërdorimi i detyrës zyrtare, joefikasiteti dhe joprofesionalizmi i personave zyrtarë, shkaktojnë pasoja shumë të dëmshme, si për shtetin ashtu edhe për qytetarët. Për këtë arsye me KPRK, janë inkriminuar një numër i konsiderueshëm i sjelljeve dhe veprimeve të personave zyrtarë.

Mirëpo, në anën tjetër, nuk konsiderohet çdo shkelje e detyrës zyrtare si vepër penale kundër detyrës zyrtare. Vepra penale kundër detyrës zyrtare konsiderohen vetëm ato shkelje të cilat janë të përcaktuara me KPRK ose ligje tjera si vepra penale. Shkeljet më të lehta të detyrës zyrtare konsiderohen shkelje disiplinore. Andaj, shtrohet pyetja si duhet vepruar në rastet kur një veprim i ka elementet edhe të shkeljes disiplinore edhe të veprës penale, përkatësisht a e konsumon vepra penale shkeljen disiplinore të personit zyrtar. Lidhur me këtë, në teorinë e së drejtës penale dominon mendimi se këto vepra nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën, përkatësisht vepra penale nuk e konsumon shkeljen disiplinore, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj. Nëse një person zyrtar me të njëjtin veprim i ka realizuar tiparet edhe të veprës penale edhe të shkeljes disiplinore, ai do të përgjigjet edhe për vepër penale edhe për shkelje disiplinore.

Në të shumtën e rasteve, veprat penale kundër detyrës zyrtare kryhen gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare. Mirëpo, disa prej këtyre veprave kryhen vetëm lidhur me detyrën zyrtare, p.sh., vepra penale dhënia e ryshfetit (neni 422), vepra penale marrja e ryshfetit (neni 421), vepra penale zbulimi i fshehtësisë zyrtare, pasi personit përkatës t’i ketë pushuar detyra (neni 426 paragrafi 4), etj.

Kryerës i shumicës së veprave penale kundër detyrës zyrtare mund të jetë vetëm personi zyrtar (*delicta propria*). Shprehja person zyrtar, sipas nenit 113 paragrafi 2 të KPRK-së, do të thotë :

- personi i cili në organin shtetëror kryen punët zyrtare;
- personi i zgjedhur, i emëruar ose i caktuar në organin shtetëror, në organin e pushtetit lokal ose personi që përherë ose përkohësisht kryen detyrat zyrtare ose funksionet zyrtare në ato organe;

- personi në institucion, ndërmarrje ose në ndonjë subjekt tjetër, të cilit i janë besuar kryerja e autorizimeve publike, që vendos për të drejtat, obligimet ose interesat e personave fizik apo juridik ose për interesin publik;
- person zyrtar konsiderohet edhe personi të cilit i është besuar kryerja faktike e detyrave të caktuara zyrtare apo punëve;
- person ushtarak përpos kur janë në pyetje dispozitat e Kreut XXXIII (Veprat penale kundër detyrave zyrtare) të këtij Kodi.

Dilemat me të shpeshta në praktiken gjyqësore, janë për tu definuar cilësia se i dyshuari për veprën penale a e ka cilësinë e personit zyrtar apo nuk e ka atë cilësi që rrjedhimisht do të nënkuptonte se ai nuk mund të jete kryes i veprës penale.

Ne vijim do të trajtojmë cilësinë e personit zyrtare për të dhënë sa me shumë qartësim mbi cilësinë e personit zyrtar:

1. Personi i cili kryen punë në organet shtetërore⁴¹¹ – Kjo kategori është me e lehtë për tu definuar, pasi që organet shtetërore, kanë një bazë juridike mbi të cilën janë themeluar, qofte baza juridike në nivelin kushtetues, ligjor apo edhe me ndonjë udhëzim administrativ apo rregullore të organizimit të institucioneve të caktuara shtetërore. Për tu definuar se personi zyrtar nga kjo bazë ligjore a kryen punë në organet shtetërore është e mjaftueshme që të verifikohet organi i tillë a është organ shtetëror, dhe mbi çfarë raporti juridik personi i tillë është i punësuar në kuadër të atij institucioni.

2. Personi i zgjedhur i emëruar ose i caktuar në organin shtetëror, në organin e pushtetit lokal ose personi që përherë ose përkohësisht kryen detyra ose funksione zyrtare në ato organe⁴¹² – për këtë kategori të personave zyrtare, fillimisht duhet të definohet, se a kemi të bëjmë me organin shtetëror apo me organin e pushtetit lokal, organet e pushtetit lokal po ashtu mund të definohen sipas ligjit për vetëqeverisje lokale, statutit të komunës dhe rregulloreve që nxjerrën nga komuna në të cilat përcaktohen organet dhe funksioni i atyre organeve të pushtetit lokal, pasi që të definohet fakti se a kemi të bëjmë me organin shtetëror apo organin lokal, duhet definuar faktin se, personi zyrtar a është: a). I zgjedhur, I emëruar, apo c) I Caktuar, ç) apo që ai person kryen detyra përkohësisht apo përherë në ato organe qofte në nivelin e organeve shtetërore apo lokale.

a). Kategoria e të zgjedhurit janë personat që i nënshtrohen garës së caktuar në një proces për tu zgjedhur në një organ të caktuar.

⁴¹¹ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.2/2019 date. 14.01.2019, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr. 06/L-074, neni 113 paragrafi 2, nën paragrafi 2.1.

⁴¹² Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.2/2019 date. 14.01.2019, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr. 06/L-074, neni 113 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2.

b). Kategoria e te emëruarve janë kryesisht personat zyrtar qe emërohen nga niveli me i larte i institucionit te caktuar qofte ne nivel te organeve shtetërore apo ne nivel te organeve lokale, psh. Këshilltar, Drejtor drejtorie, etj,

c). Kategoria e personave zyrtar e te caktuarve, kjo kryesisht janë kategori qe caktohen për një fushë specifike te detyrave apo edhe për një periudhe te caktuar konkrete, psh. Caktimi si përfaqësues ligjor i institucionit etj.

ç) Kategoria e personave qe kryejnë pune te përkohshme apo te përhershme ne kuadër te organit shtetëror apo lokal, kjo kategori ka rëndësi pasi qe nuk është me rëndësi a është me funksion te përhershëm te personit zyrtar brenda institucionit apo është me funksion te përkohshëm rëndësi ka qe ai ka qene ne kuadër te atyre organeve qe dispozita ligjore e mvesh me cilësinë e personit zyrtar.

3. Personi në institucion, ndërmarrje ose në ndonjë subjekt tjetër, të cilit i janë besuar kryerja e autorizimeve publike, që vendos për të drejtat, obligimet ose interesat e personave fizik apo juridik ose për interesin publik⁴¹³ – për tu definuar personi zyrtar sipas kesaj kategorie, fillimisht duhet bere shkoqitja e kesaj dispozite pasi qe inkorporon shumë nivele te institucioneve.

Në radhë të parë duhet ta kemi të qartë faktin, se personi zyrtar: a është pjese ne institucion, a është pjese ne ndërmarrje, apo është pjese ne ndonjë subjekt tjetër, kjo duhet te jete qartësia fillestare, për personat zyrtar qe bien ne këtë kategori.

Se dyti duhet te definohet fakti, se këtyre kategorive te institucioneve, ndërmarrjes apo subjektit tjetër, a u janë besuar kryerja e autorizimeve publike. Duhet te kemi parasysh se autorizimet publike u besohen vetëm me akte ligjore (përjashtimisht munde te krijohet baza ligjore për organet shtetërore qe ato te përcaktojnë se cilat autorizime publike mund te barten tek subjektet tjera, dhe kjo pastaj mund te behet me akte te tjera juridike), çka do te thotë se organet shtetërore mund ti besojnë institucioneve te caktuara kryerjen e autorizimeve publike, (këtu duhet te kihet kujdes te shtuar nga se, ne praktike shpesh here licencimi konsiderohet se u janë besuar autorizimet publike, gjë qe nuk është e pranueshme pasi qe licencimi është certifikim për ushtrimin e aktivitetit apo funksionit te atij institucioni, sipas se cilit kërkohet plotësimi i kushteve te caktuara ligjore, ndërsa ushtrimi i autorizimeve publike behet ne mënyrë specifike kur i besohet duke u numëruar saktësisht se cilat autorizime munde te ushtrohen, psh. Gjeodetet privat, kanë autorizime publike për ta bërë matjen e parcelave, sipas ligjit mbi kadastrën, por nuk kanë autorizime publike për ta bërë regjistrimet ne librat e tokës, andaj bartja e autorizimeve publike bëhet ne mënyrë specifike dhe po ashtu kur barten autorizimet publike gjithnjë organi shtetëror ruan te drejtën e kontrollit ne raport me ushtruesit e atyre autorizimeve publike). Ne këtë kuptim duhet te vërtetohet fakti se institucioni i tille ka te drejte apo i është besuar ushtrimi i autorizimeve publike, dhe kjo duhet te konstatohet ne procedurën penale, dhe

⁴¹³ Gazeta zyrtare e Republikës se Kosovës, nr.2/2019 date. 14.01.2019, Kodi Penal i Republikës se Kosovës, nr. 06/L-074, neni 113 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3.

ne asnjë mënyrë nuk mund të supozohet se ekziston. Për shkak se kushti është që të konstatohet se kanë të drejte të ushtrojnë autorizime publike, rrjedhimisht konstatimi i tillë e përjashton edhe aplikimin e analogjisë në të drejtën penale.

Se tretë autorizimet publike duhet të jenë në raport për të vendosur, për të drejtat, obligimet, ose interesat e personave fizik apo juridik, apo për interesin publik. Në këtë kuptim, ka rëndësi që autorizimet publike të jenë të ndërlidhura, që nënkupton se ato autorizime duhet të kenë të bëjnë për të vendosur qoftë për të drejtat apo obligimet e qytetarëve, apo për interesat e personave fizik apo juridik apo për interesin publik, nëse autorizimet publike që janë të bartura për tu ushtruara nga institucionet, ndërmarrjet apo subjektet tjera nuk kanë të bëjnë me të drejtat dhe obligimet e qytetarëve apo me të interesat e personave fizik apo juridik apo interesin publik, nuk kemi të bëjmë me autorizime publike që bien në kategorinë e këtyre personave zyrtar.

4. Person zyrtar konsiderohet edhe personi të cilit i është besuar kryerja faktike e detyrave të caktuara zyrtare apo punëve - kjo kategori e personave zyrtare duhet të interpretohet në lidhshmëri me paragrafët 2.1, 2.2 dhe 2.3 dhe 2.5⁴¹⁴. Kuptimi i këtij përkufizime ka të bëjë me faktin se personi zyrtar sipas kësaj kategorie nuk i ka autorizimet brenda detyrës së tij zyrtare por i caktohen ato për të ushtruar në mënyrë faktike edhe kur juridikisht nuk i ka si autorizime dhe detyra brenda detyrës së tij zyrtare. Kjo është e kuptueshme, pasi që qëllimi i kësaj dispozite ligjore në kuptimin e interpretimit sistematik të paragrafit 2 të nenit 113 rezulton se ka qenë që edhe për faktin se personi zyrtar nuk është i emëruar, i zgjedhur apo i caktuar në detyrën e tillë zyrtare për veprimet e caktuara që do të binin në kompetencën e tij zyrtare, të mos mund të shmanget nga përgjegjësia e keqpërdorimit duke u thirrur në faktin se nuk ka qenë detyre e tij, në anën tjetër personat e tillë duhet të jenë të përgjegjshëm, sepse edhe kur nuk kanë një detyre specifike që juridikisht kanë autorizime dhe detyra brenda funksionit zyrtar, ata duhet që edhe në mënyrë faktike, kur i ushtrojnë detyrat zyrtare, të jenë me integritet dhe të mos e keqpërdorin atë funksion që e ushtrojnë në mënyrë faktike detyrën.

5. Person ushtarak përpos kur janë në pyetje dispozitat e Veprave penale kundër detyrave zyrtare⁴¹⁵ - kjo kategori e personave zyrtar ndërlidhet ekskluzivisht me personelin ushtarak dhe atë vetëm në raport me veprat penale kundër detyrës zyrtare.

Mirëpo, disa vepra penale kundër detyrës zyrtare mund t'i kryej edhe çdo person, si p.sh. vepra penale dhënia e ryshfetit (neni 421) dhe vepra penale ushtrimi i ndikimit (neni 422).

Përveç veprave penale të këtij Kapitulli, personat zyrtarë duke e keqpërdorur detyrën zyrtare mund të kryejnë edhe shumë vepra penale që gjenden në kapitujt tjerë të KPRK, si p.sh. keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrave (neni 195), kontrollimi i kundërligjshëm (neni 198),

⁴¹⁴ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.2/2019 date. 14.01.2019, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr. 06/L-074, neni 113 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4.

⁴¹⁵ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.2/2019 date. 14.01.2019, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr. 06/L-074, neni 113 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5.

mundësimi i lidhjes së martesës së kundërligjshme (neni 238), moslajmërimi i veprave penale apo moslajmërimi i kryerësit të saj (paragrafi 2 i nenit 378), etj.

Veprat penale kundër detyrës zyrtare, kryhen vetëm me dashje, përveç veprës penale zbulimi i fshehtësisë zyrtare, nga neni 426 paragrafi 3 i KPRK, e cila mund të kryhet edhe nga pakujdesia.

Krahas dashjes, në disa raste për ekzistimin e veprës penale, duhet që vepra të jetë kryer me qëllim të caktuar, përkatësisht me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për ndonjë person tjetër ose me qëllim të shkaktimit të dëmit personit tjetër, p.sh. vepra penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit (neni 414) ose vepra penale nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore (neni 425), etj.

Qe te dy këto cilësi, si dashja ashtu edhe qëllimi, duhet te rezultojnë nga rrethanat faktike qe duhet te provohen me prova ne procedure penale.

Në teorinë e së drejtës penale, veprat penale kundër detyrës zyrtare ndahen në grupe të ndryshme. Ndarja më e shpeshtë e këtyre veprave penale është : **në vepra penale të drejta kundër detyrës zyrtare**, të cilat mund t'i kryejnë vetëm personat zyrtarë dhe **në vepra penale jo të drejta kundër detyrës zyrtare**, të cilat krahas personave zyrtarë mund t'i kryejnë edhe personat tjerë, përkatësisht këto vepra penale mund t'i kryejë çdo person. Pastaj, veprat penale kundër detyrës zyrtare, ndahen edhe : **në vepra penale të përgjithshme kundër detyrës zyrtare** dhe **në vepra penale të veçanta kundër detyrës zyrtare**. Vepra penale të përgjithshme kundër detyrës zyrtare janë ato të cilat mund të kryhen gjatë ushtrimit të çdo detyre dhe të cilat mund t'i kryejë çdo person zyrtarë, kurse vepra penale të veçanta kundër detyrës zyrtare janë veprat penale të cilat mund të kryhen vetëm në ushtrimin e detyrave të caktuara zyrtare dhe të cilat mund t'i kryejnë vetëm personat e caktuar zyrtarë.

II. Veprat penale të këtij Kapitulli

1. Keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar (neni 414)

Veprën penale keqpërdorimit te pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 paragrafi 1 të KPRK,⁴¹⁶ e kryen personi zyrtar i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për tjetrin apo me qëllim te të shkaktimit të dëmit për personin tjetër, tejkalon kompetencat ose nuk i përmbush detyrat zyrtare.

Sipas kësaj dispozite ligjore, veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale konsiderohen :

3. keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, duke bere:

⁴¹⁶ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.2/2019 date. 14.01.2019, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr. 06/L-074, neni 414.

- | |
|-------------------------------------------------------------------------------------|
| <p>a). tejkalimin e kompetencave ose
b). mos përmbushjen e detyrave zyrtare</p> |
|-------------------------------------------------------------------------------------|

a). **Keqpërdorimi i pozitës** në kontekstin e kësaj vepre penale konsiderohet se ekziston nëse personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare kryen veprime në suaza të autorizimeve të veta (pra kemi te bëjmë me kryerjen e veprës me ane te veprimit), por ato veprime nuk i ndërmerr në interesin e detyrës, por me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për tjetrin ose për organizatën e biznesit apo të shkaktimit të dëmit për personin tjetër ose për atë organizatë të biznesit. Kjo formë e kryerjes së kësaj vepre penale në praktikë manifestohet më së shpeshti tek të ashtuquajturat “autorizime diskrecionale të personave zyrtarë”. Në këto raste personat zyrtarë me rastin e zgjidhjes së një rasti të caktuar, kanë autorizime që të zgjedhin atë zgjidhje të cilën mendojnë se është më e përshtatshme (oportune) për rastin konkret. Në rastet e tilla personat zyrtarë me qëllim të fitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme ose me qëllim të shkaktimit të dëmit, rastin e zgjidhin në mënyrë të caktuar duke e keqpërdorur detyrën zyrtare, edhe pse veprojnë në kuadër të autorizimeve të tyre.

b). **Tejkalimi i kompetencave** ekziston në rastet kur personat zyrtarë ose personat përgjegjës ndërmarrin veprimet zyrtare të cilat janë të lejuara me ligj, por nuk bëjnë pjesë në suazat e autorizimeve zyrtare, por janë në kompetencë të ndonjë personi tjetër zyrtar. Tejkalimi i kompetencave, ekziston edhe në rastet kur personi zyrtar e kryen veprimin e caktuar, pa marr leje paraprake ose pëlqim, nga ndonjë person tjetër zyrtar, edhe pse sipas ligjit është dashur që të merret kjo leje apo pëlqim.

Shembull nga praktika gjyqësore:

<p>Kështu, në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin B.V., për shkak të veprës penale shpërdorimi i pozitës ose i autorizimit, nga neni 339 paragrafi 1 të KPRK, sepse i akuzuari gjatë muajit korrik të vitit 2005, në Gjilan, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, e shpërdoron pozitën e tij zyrtare, si punëtor i ndërmarrjes publike “NN”, në Gjilan, në atë mënyrë që i tejkalon kompetencat e tij duke ja dhënë një cisternë personit H.B., pa lejen paraprake të drejtorit të kësaj kompanie.⁴¹⁷</p>

d). **Mospërmbushja e detyrave zyrtare** ekziston në rastet kur personat zyrtarë nuk i përmbushin detyrat e tyre zyrtare, me qëllim të fitimit të dobisë pasurore ose me qëllim të shkaktimit të dëmit. Nga praktika gjyqësor njihen edhe raste kur mospërmbushja e detyrës ka shkaktuar efekt ne tejkalim te kompetencave, ne raste te tilla personi zyrtar ka vepruar por ai veprim rezulton se nuk është ne përputhshmëri me kompetencën e tij dhe rrjedhimisht ka pasur

⁴¹⁷ Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Gjilan, P.nr.939/2007, i datës 13.07.2009.

një lloj te shkrirjes që me ane të veprimit njëkohësisht janë shfaqur edhe mospermbushja e detyrës

Dispozita nga neni 413.1, përdor togfjalëshin, “Personi zyrtar duke *shfrytëzuar* detyrën apo autoritetin zyrtar”.

Vepra penale keqpërdorimit të detyrës apo autoritetit, ekziston vetëm nëse ekziston **QËLLIMI** dhe atë:

- që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo
- që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose
- që t’i shkel të drejtat e personit tjetër

Ne këtë kuptim, qofte detyra zyrtare apo autoriteti duhet të shfrytëzohen për qëllim, të përfitimit të çfarëdo dobie ose për veten ose për tjetrin, apo të shkaktojë dëm tjetrit, ose të shkel të drejtat tjetrit, rrjedhimisht nëse nuk rezulton se detyra zyrtare apo autoriteti nuk është shfrytëzuar për cilindo nga këto qëllime atëherë nuk mund të ketë veprë penale.

Ndërsa si bëhet shfrytëzimi i detyrës apo i autoritetit për qëllimin e tillë, dispozitat kanë përcaktuar dy mënyra: ***Duke tejkuluar kompetencat apo duke mos i përmbushur detyrat zyrtare, andaj kjo edhe jap të kuptoj se kjo veprë penale kryhet vetëm në këto dy mënyra duke tejkuluar kompetencat apo duke mos përmbushur detyrat.***

Pasojë e kësaj vepre penale është përfitimi i kundërligjshëm i dobisë pasurore për vete, për një person tjetër, shkaktimi i dëmit personit tjetër apo cenimi i të drejtës së personit tjetër.

Për formën themelore të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej një deri në tetë vite.

Forma e rëndë e kësaj vepre penale konsiderohet se ekziston nëse ka rezultuar në ***përfitim apo është shkaktuar dëm i cili tejkulon shumën 5.000 €*** apo shkelje të drejtave të personit tjetër.

Karakteristikë e formës kualifikuese të kësaj vepre penale është se forma e kualifikuar është parapare vetëm në raport me lartësinë e përfitimit apo dëmit të shkaktuar, e që ndërlihet ekskluzivisht me aspektin financiar, mirëpo nuk është parapare si forme e kualifikuar vepra penale e keqpërdorimit të detyrës apo autoritetit zyrtar në raport me shkeljen e të drejtave të personit tjetër.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej tri vjet deri në dhjetë vite.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë vetëm personi zyrtar.

Vepra penale keqpërdorimi i detyrës apo autoritetit zyrtar kryhet vetëm me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për tjetrin apo të shkakimit të dëmit për personin tjetër ose shkeljes se te drejtave personit tjetër.

Shembull nga praktika gjyqësore te aktgjykimit lirues për shkak se nuk është provuar se është kryer vepra penale.

Në cilësinë e zyrtarit të terrenit në Doganën e Kosovës, duke shfrytëzuar detyrën zyrtare i tejkalon kompetencat e tij, me qëllim që vetit t'i sjellë dobi ashtu që:

1. Më datën 19.01.2015, me rastin e furnizimit të automjetit zyrtar të tipit “xxxxx” me targa zyrtare ..., në pompën e benzinës “E. P.” ne (xxxxx), pompë kjo kontraktor i autorizuar i kompanisë “xxxxx” – kontraktor i Doganës së Kosovës, nga punëtori i pompës së benzinës xxxxx, ka pranuar kundërvlerën prej “xxxxx” euro në vend të mbushjes së automjetit me derivat të naftës dhe nga i njëjti ka pranuar faturën me nr.”000000” me të dhëna fiktive lidhur me kilometrazhin e automjetit.

2. Më datën 28.11.2014, me rastin e furnizimit të automjetit zyrtar të tipit xxxxxxxx, me targa ..., në pompën e benzinës “E. P.” në (xxxxxx), pompë kjo nënkontraktor i autorizuar i kompanisë “xxxxxx” – kontraktor i Doganës së Kosovës, me 78 litra sipas faturës nr.xxxxxx, ka shënuar kilometra “000000” e që sipas librit për evidentimin e kilometrave të kësaj veture kilometrat e paraqitura në faturë janë kaluar dy ditë më herët dhe se kilometrat e paraqitur janë fiktive.

3. Më datën 09.12.2014, me rastin e furnizimit të automjetit zyrtar “xxxxxx” me targa ..., në pompën e benzinës “E. P.” në (xxxxxx), pompë kjo nënkontraktor i autorizuar i kompanisë “xxxxxx” – kontraktor i Doganës së Kosovës, me 47 litra, sipas faturës nr.”000000” ka shënuar kilometrat “000000” në mënyrë fiktive pasi që sipas librit për evidentimin e kilometrave të kësaj veture kilometrat e paraqitura kjo veturë i ka kaluar më datën 12.12.2014.

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale; Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 e lidhur me nenin 81 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.⁴¹⁸

Koment: “Ky dispozitivi i ndërtuar nuk ka te përshkruara elementet apo format e kryerjes se veprës penale, ne radhe te pare nuk përcaktohet se kryerësi, nuk i ka përmbushur detyrat zyrtare apo i ka tejkaluar detyrat e tij zyrtare nga se siç u theksua vetëm ne një rën nga këto forma konsumohet kjo vepër penale. Po ashtu nuk përcaktohej se a kishte përfituara vet apo kishte përfituara personi tjetër apo i ish in shkelur ndonjë e drejte ndonjë personi tjetër. Ne këtë kuptim duke pasur mangësitë e tilla te përshkrimit te rrethanave qe përbëjnë elementet e veprës

⁴¹⁸ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore ne Mitrovicë, P.nr.119/2019, datë 26.04.2021.

penale, rrjedhimisht rasti i tille i zgjidhur nga Gjykata e shkalles se pare me aktgjykim lirues nuk ka zgjidhje tjetër ligjore”.

2. Konflikti i interesit

Vepra penale e konfliktit te interesit është për nga natyra e saj si vepër e re penale e inkriminuar ne Kodin penal te Kosovës qe nga viti 2013. Përkundër faktit se kjo vepër penale nuk konsiderohet si vepër qe është inkriminuar me pare me legjislacionin penal, kjo vepër për nga grupimi i saj bene pjese ne kuadër te veprave penale kundër detyrës zyrtare. Ne këtë kuptim vet ligjdhënësi kur ka kategorizuar këtë vepër penale ne kuadër te grupimit te këtyre veprave penale e ku përmes kësaj vepre penale shmanget interesi privat i personit ne raport me gjendjen e tij ne detyre publike. Ligji për parandalimin e Konfliktit te interesit, ne nenin 6, ka parapare se, “ Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”.

Vepra penale e konfliktit te interesit munde te kryhet vetëm nga personi zyrtar, këtu kemi te bëjmë me cilësitë e kryerësit çka do te thotë se ne raste se personi qe gjendet ne konfliktin e interesit nuk e ka cilësinë e personit zyrtare nuk munde te jete kryerës i kësaj vepre penale.

Sipas kësaj dispozite veprimet e kryerjes se kësaj vepre penale janë:

Si person zyrtar:

- 1. merr pjesë personalisht ne ndonjë çështje zyrtare;**
- 2. se për çështjen e tille zyrtare ka interes financiar,**
 - **vet ai/ajo,**
 - **ndonjë anëtar i familjes, ose**
 - **ndonjë person juridik qe ka te beje me te**

Vepra penale për formën themelore nga paragrafi 1 ka parapare dënimin kumulativ si me gjobe dhe me burgim, e qe dënimi me burgim është deri ne tri vite.⁴¹⁹

Forma kualifikuese e kësaj vepre penale, parasheh si element kualifikues çështjen zyrtare se për çfarë natyre ka te beje ajo çështje zyrtare, dhe për formën kualifikuese është parapare vetëm dënim me burgim prej një viti deri ne pese vite.

Element kualifikues i veprës penale te Konfliktit te interesit nga paragrafi 2 i nenit 417.

⁴¹⁹ Gazeta zyrtare e Republikës se Kosovës, nr.2/2019 date. 14.01.2019, Kodi Penal i Republikës se Kosovës, nr. 06/L-074, neni 417.

- Kur çështja zyrtare ka të bëjë me veprimin e prokurimit;
- Kur çështja zyrtare ka të bëjë me veprimin e ankandit.

Për qëllime të veprës penale konflikti i interesit është përkufizuar kuptimi i shprehjes “merr pjesë” nënkupton ushtrimin e autoritetit zyrtar përmes vendimit, miratimit, mosmiratimit, rekomandimit, këshillimit, hetimit, mbikëqyrjes, administrimit, likuidimit, pagesës ose në ndonjë mënyrë tjetër të ushtrimit të ndikimit të padrejtë për një çështje zyrtare.

Për qëllime të veprës penale konflikti i interesit është përkufizuar kuptimi i, shprehjes “çështje zyrtare” e qe nënkupton procedurë gjyqësore ose procedurë tjetër zyrtare; aplikim, kërkesë për vendim ose përcaktim tjetër zyrtar; kontratë apo kërkesë; ankand publik ose veprim tjetër i prokurimit; ose ndonjë çështje tjetër e cila prek interesat financiare të personit zyrtar, anëtarit të familjes apo ndonjë personi juridik që ka të bëjë me të.

Për qëllime të veprës penale konflikti i interesit është përkufizuar shprehja “person juridik që ka të bëjë me të” e qe do të thotë, personin juridik në të cilin zyrtari apo anëtar i familjes ka marrëdhënie financiare aktuale apo të ardhshme, përfshirë marrëdhënien afariste ose të punës apo dobi financiare të çfarëdo natyre.

Për qëllimet e veprës penale të konfliktit të interesit është parapare shprehimisht se kush e përbën anëtarin e familjes, një anëtar i familjes do të thotë bashkëshorti ose bashkëshortja, prindi, prindi adoptues, fëmija, fëmija i adoptuar, vëllai ose motra, gjyshi ose gjyshja, nipat e mbesat nga vajza dhe djali, hallat dhe tezet, nipat e mbesat nga vëllai dhe motra, dajët dhe axhallarët, njerku/njerka, thjeshtri/thjeshtra, vëllai /motra nga njëri prind, i afërmi i gjakut që jeton në të njëjtën shtëpi ose personi me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore.

Duhet të kemi parasysh faktin, se jo çdo rrethanë qe mund të konsiderohet si konflikt i interesit sipas ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit mund të konsiderohet apriori edhe me përgjegjësi penale, nga se, ligji për parandalimin e konfliktit të interesit, paraqet një rrethanë që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare, rrjedhimisht shumë rrethana sipas kësaj norme kanë karakter të integritetit dhe të etikës, përderisa të përgjegjësia penale kërkohet në mënyrë specifike interesi financiar në çështjen ku personi zyrtar është i përfshirë drejtpërdrejt në atë çështje zyrtare.

Shembull nga praktika gjyqësore

Me datë 20.02.2018 në si person zyrtar në cilësisë, edhe pse e ka ditur se vajza e tij ka aplikuar në pozitën në, ka marr pjesë personalisht në çështjen zyrtare -administrative duke marr vendim me nr. “xxxxx” të datës “xxxxxxx” me të cilin ka formuar komisionin për zhvillimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës bazuar në konkursin e publikuar me

datë 02.02.2018, për pozitën ".....", në atë mënyrë që komisioni në fjalë e ka përzgjedh vajzën e të akuzurit si më të suksesshme duke e punësuar të njëjtën si

-me çka ka kryer veprë penale konflikt interesi nga neni 424 par. 1 të KPRK-se.⁴²⁰

3. Përvetësimi ne detyrë (neni 418)

Vepra penale përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës, neni 418 i KPRK, ka ngjashmëri me veprën penale të shpërdorimi i pasurisë së huaj, nga neni 318 i KPRK, ngase në të dyja këto vepra penale, kryerësi e përvetëson pasurinë e luajtshme që i është besuar, por midis këtyre veprave penal ka edhe dallime. Dallimi kryesor konsiston në faktin se veprën penale të përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës, mund ta kryej vetëm personi zyrtar, kurse veprën penale të shpërdorimit, si rregull mund ta kryejë çdo person, me përjashtim të formës nga paragrafi 2 i nenit 318 të KPRK, të cilën mund ta kryejë vetëm kujdestari, po ashtu dallimi tjetër është se për veprën penale të shpërdorimit të pasurisë së huaj kur kemi të bëjmë me formën themelore ajo ndiqet sipas propozimit përderisa vepra penale e përvetësimit ne detyrë ndiqet sipas detyrës zyrtare. Formën themelore të veprës penale përvetësimi ne detyrë, të parashikuar në paragrafin 1 të nenit 418 të KPRK, e kryen personi zyrtar që përvetëson pasurinë që i është besuar qoftë për shkak të detyrës së tij ose pozitës, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër.⁴²¹

Cilësia e kryerësit dhe elementet e veprës penale të përvetësimit ne detyrë janë:

Cilësia,

- kryhet vetëm nga personi Zyrtar.

Elementet,

- **Qëllimi i përfitimit të kundërligjshëm,**
- **Përfitimi qoftë për vete apo për personin tjetër,**
- **Pasuria që i është besuar lidhur me detyrën apo pozitën**

Vepra penale e përvetësimit ne detyrë kryhet vetëm me dashje. Ndërsa format e kryerjes sipas dispozitës ligjore për nga natyra e veprimit të kryerjes janë të papërcaktuara, çka do të thotë se mund të ekzistojnë lloje të ndryshme të formave të përvetësimit, por rëndësi ka që të plotësohen elementet e veprës penale për tu konsideruara se kemi të bëjmë me përvetësimin ne detyrë.

⁴²⁰ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Pkr.nr.67/2019, datë 29.12.2020.

⁴²¹ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.2/2019 date. 14.01.2019, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr. 06/L-074, neni 418.

Kjo vepër penale tani aktualisht me mënyrën e inkriminimit nuk ka përcaktuar llojin dhe natyrën e pasurisë që mund të jetë si objekt mbrojtës i veprës penale, por mjafton që ajo pasuri të jetë besuar personit zyrtar apo të jetë besuar për shkak të pozitës së tij, rrjedhimisht inkriminimi i veprës penale ka zgjeruar shumëfish objektin mbrojtës për nga natyra që mund të mbrohet përmes kësaj vepre penale në raport me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës.

Shembull nga praktika gjyqësore:

Në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin T.P., për shkak të veprës penale përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës, nga neni 340 paragrafi 1 të KPRK, sepse më datën 28.10.2005, në Gjilan, i akuzuari, në cilësinë e personit zyrtar, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore juridike, përvetëson sende të caktuara të luajtshme, të cilat i janë besuar për shkak të pozitës së tij.⁴²²

Për të ekzistuar kjo vepër penale pasuria duhet të jetë besuar, personit zyrtar në raport me detyrën e tij apo në raport me pozitën. Si shembull që mund të jetë besuar personit zyrtar për shkak të detyrës së tij, mund të jete një zyrtar financiar brenda një institucioni publik, ku të njëjtit për shkak të detyrimeve për pagesat e ndryshme i besohet edhe pasuria e institucionit që janë të hollat, ndërsa për shkak të pozitës së tij që nuk lidhet drejtpërdrejt me detyrat e punëve të tij, mund të besohet një pasuri e caktuar që mund të jetë vënia në dispozicion për shkak të pozitës automatike si pasuri e institucionit publik.

Objekt i kësaj vepre penale mund të jetë pasuria pa përjashtim për nga natyra e saj.

Vepra penale konsiderohet se është kryer në momentin kur kryerësi t'i ketë përvetësuar pasurinë që i është besuar.

Për formën themelore të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Në paragrafin 2 të nenit 418 të KPRK, është parashikuar forma e rëndë e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni, rezulton me dobi pasurore që e tejkalon shumën 5.000 €, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim një deri në tetë vjet.

Elementet e formës së kualifikuar sipas paragrafi 2 të nenit 418

- **Tejkalimi i vlerës prej 5.000 euro, qoftë në:**
 - **Dobi pasurore, apo**
 - **Dëmin e shkaktuar**

⁴²² Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Gjilan, P.nr.117/2006, i datës 12.03.2008.

Kurse, në paragrafin 3 të këtij neni, është parashikuar forma edhe më e rëndë e kësaj vepre penale, e cila ekziston nëse kryerja e formës themelore të kësaj vepre penale rezulton me dobi pasurore që tejkalon shumë prej 50.000 €, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim prej tri deri në dymbëdhjetë vjet.

Elementet e formës me te rëndë sipas paragrafi 3 te nenit 418

- **Tejkalimi i vlerës prej 50.000 euro, qoftë në:**
 - **Dobi pasurore, apo**
 - **Dëmin e shkaktuar**

4. Mashtrimi ne detyrë (neni 419)

Legjislacioni penal ne Kosove këtë vepër penale e njeh qysh herët dhe te njëjtën e ka inkriminuar, rëndësi ka qe kjo vepër penale nuk është e natyrës se tille te veprave penale qe për shkak te zhvillimeve te hovshme shoqërore ka krijuar nevojën për inkriminim, por se te njëjtën e hasim te inkriminuar edhe ne kodin e përkohshëm penale te Kosovës e edhe tani ne Kodin Penal te Republikës se Kosovës qe është ne fuqi nga viti 2019, me konkretisht ne nenin 419.

Kjo vepër penale munde te kryhet vetëm nga personi zyrtar, çka do te thotë se për kryerjen e kësaj vepre penale ka rëndësi cilësia e kryerësit, nga se kur kryerësi nuk e ka cilësinë e personit zyrtar nuk mund ete jete përgjegjës për këtë vepër penale, ai munde te përgjigjet për vepra tjera penale por jo për mashtrim ne detyre.

Kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje. Vepra penale e mashtrimit ne detyre nuk mund te kryhet nga pakujdesia, por vetëm me dashje. Po ashtu kjo vepër penale kryhet vetëm me veprim, çfarë nënkupton se kjo vepër penale nuk mund te kryhet me mosveprim.

Element te kësaj vepre penale janë, qëllimi i përfitimi i kundërligjshëm i dobisë pasurore, qoftë për vete apo për personin tjetër. Kjo do te thotë se për tu konsideruara se është kryer vepra penale e mashtrimit ne detyre duhet te ketë përfitim te kundërligjshëm te dobisë pasurore çka nënkupton se ajo dobi duhet te jete me kundërvlerë ekonomike si përfitim i kundërligjshëm, e qe njëkohësisht jo çfarëdo dobie munde te konsiderohet përfitim, nga se dispozita ligjore e njeh vetëm dobinë pasurore te përfituar kundërligjshëm, dhe po ashtu përfitimi i dobisë pasurore nuk ka rëndësi se a është bere për vete apo për personin tjetër, mjafton qe te shfaqet qëllimi i tille i përfitimit te dobisë pasurore si për veti apo edhe për personin tjetër.

Format e kryerjes se kësaj vepre penale, janë qoftë, duke e krijuar raportin e llogarive, duke e përdorur raportin e llogarive, duke e prezantuar raportin e llogarive, apo ne ndonjë mënyrë tjetër duke e vene ne lajthim ne ndonjë mënyrë tjetër personin e autorizuar qe për pasojë

kundërligjshëm (personi i autorizuar) kryen transfere te parave apo te pasurisë apo te drejtave tjera.

Cilësia e kryerësit.

- **Person zyrtar.**

Kryerja e veprës.

- **Me dashje.**

Elementet e veprës.

- **Qëllimi për përfitim te kundërligjshëm**
- **Dobia pasurore**
- **Përfitimi për vete apo personin tjetër**

Format e kryerjes.

- **Janë dy forma te kryerjes dhe atë:**
 - **Krijimi, përdorimi, apo prezantimi e rrem te raportit, për ta vënë në lajthim personin e autorizuar, apo**
 - **Çfarëdo forme tjetër e vënies ne lajthim ndaj personit te autorizuar.**

Kjo vepër penale konsiderohet se është kryer kur raporti i tille i rrem i llogarive, i prezantohet personit te autorizuar dhe për shkak se lajthimi nga ana e personit te autorizuar edhe bëhen transferet e te hollave, apo te pasurisë apo te drejtave tjera, dhe kjo është edhe shkaktimi i pasojës se veprës penale. Shembull i tille, personi qe është mbikëqyrës i zbatimit te kontratës se lidhur me ane te procedurës se prokurimit publik, kur parashtrohet raporti nga mbikëqyrësi i kontratës qoftë për specifikën e përmbushjes se kontratës apo për zbatimin ne tersi te kontratës, dhe si rrjedhojë raporti i tille mbi konstatimet e përmbushjes se kontratës qe është i rrem, i paraqitet ne procedure personit zyrtare – qe bene ekzekutimin e pagesave, ne raste te tilla rrjedhimisht personi zyrtar qe bene autorizimin e pagesave te tilla vihet ne lajthim te pamënjanueshëm dhe rrjedhimisht autorizon pagesat, ne situatën e tille munde te kemi vepër penale te mashtrimit ne detyre nga ana e zyrtarit qe ka qene i ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit te kontratës

Kjo vepër penale për formën themelore sipas paragrafit 1 te nenit 419 ka parapare dënimin kumulativ çka do te thotë se gjykata është e obliguar ti shqiptoj kryerësit dy dënime. Dënim me gjobe dhe me Burgim prej gjashtë muaj deri ne pesë vite burgim. Përderisa siç u theksua

veprën penale te mashtrimit ne detyre nga neni 419 paragrafi 1, si kryerës munde te jete vetëm personi zyrtar.⁴²³

Ne raport me paragrafin 2 te nenit 419 te veprës penale te mashtrimit ne detyre vepra penale mund te kryhet nga çdo person, pasi qe dispozita ligjore, ka shprehjen, “ kushdo qe”, çka do te thotë se kryes i veprës penale mund te jete personi zyrtar por edhe cilido person tjetër.

Kjo vepër penale kryhet me dashje dhe me qëllim për:

a). Fshehjen ose maskimin, e veprave penale:

- Pranimi i ryshfetit ne sektorin privat – neni 309;
- Dhënia e ryshfetit ne sektorin privat – neni 310;
- Marrja e ryshfetit – neni 421;
- Dhënia e ryshfetit – neni 422;
- Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik te huaj apo personave te huaj zyrtar – neni 423;
- Ushtrimi i ndikimit – neni 424.

Format e kryerjes janë te përcaktuara ne disa mënyra, qe janë:

- Krijimi apo përdorimi i ndonjë fature;
- Krijimi apo përdorimi i ndonjë elementi tjetër kontabël;
- Krijimi apo përdorimi e ndonjë regjistri qe përmban informata te rreme apo jo te plota,
- Heqja dorë nga regjistrimi i pagesës.

Vepra penale e mashtrimit ne detyre sipas paragrafit 2 nuk e ka qëllimin e përfitimit te kundërligjshëm te dobisë pasurore, por ka si qëllim te inkriminoj veprimin kur dokumentit jo te saktë qe përmes ati dokumenti synohet te maskohet apo te fshehët cilado vepër penale.

Inkriminimi sipas paragrafit 2 te nenit 419, po ashtu ka parapare dënimet kumulative. Dënimin me gjobe dhe dënimin me burgim nga një deri ne tetë vite.

Forma kualifikuese e parapare ne paragrafin 3 te nenit 419, ndërlidhet si forme e kualifikuar vetëm me formën themelore nga paragrafi 1. Për tu konsumuar kjo vepër penale si forme e kualifikuar, duhet te përmbushen elementet e figurës se veprës sipas paragrafit 1, mirëpo kur rezulton me dobi pasurore qe tejkalon 5.000 euro, atëherë dënimi është përcaktuar me gjobe dhe me burgim prej një viti deri ne tetë vite.

Elementet qe e bëjnë formë e kualifikuar, nga paragrafi 3 ndërlidhur me paragrafin 1 te nenit 419.

⁴²³ Gazeta zyrtare e Republikës se Kosovës, nr.2/2019 date. 14.01.2019, Kodi Penal i Republikës se Kosovës, nr. 06/L-074, neni 419

- **Dobia pasurore ne tejkalim prej 5.000 euro.**

Forma me e rende e kësaj vepre penale sipas paragrafit 4, po ashtu lidhet vetëm me formën themelore nga paragrafi 1 i nenit 419, qe do te thotë se përveç se duhet te plotësohen elementet e veprës penale nga paragrafi 1, për tu konsideruar se është kryer forma me e rende, kërkohet qe dobia pasurore te jete ne vlere qe tejkalon 50.000 euro, dhe dënimi po ashtu është parapare me gjobe dhe me burgim prej tri vite deri ne dymbëdhjetë vite.

Elementet qe e bëjnë formën me te rende te kësaj vepre penale, nga paragrafi 4 ndërlidhur me paragrafin 1 te nenit 419.

- **Dobia pasurore ne tejkalim prej 50.000 euro.**

5. Përdorimi i paautorizuar i pasurisë (neni 420)

Këtë vepër penale, sipas nenit 420 të KPRK, e kryen kushdo që pa autorizim përdor paratë, letrat me vlerë ose pasurinë tjetër të luajtshme të besuar personit në detyrë ose në përgjithësi në vendin e punës apo të cilat i janë vënë në disponim nga shërbimi, puna apo kushdo që jep pasurinë e këtillë për shfrytëzim të paautorizuar.⁴²⁴

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në përdorimin e paautorizuar të parasë, letrave me vlerë ose pasurisë tjetër të luajtshme, të cilat kryerësit i janë besuar në detyrë ose në përgjithësi në vendin e punës apo të cilat i janë vënë në disponim për shkak të detyrës apo punës. Gjithashtu, këtë vepër penale e kryen edhe personi i cili ia jep pasurinë e këtillë për shfrytëzim të paautorizuar personit tjetër. Këtë vepër penale e kryen, p.sh. shoferi i cili pa autorizim e merr automjetin, i cili i është besuar për shkak të punës dhe me të shkon në pushime në Shqipëri, apo shoferi këtë automjet, pa autorizim ia jep një personi tjetër për të shkuar në pushime në Shqipëri dhe për t'ia kthyer pas pushimeve, etj.

Përdorim, në kuptimin e kësaj vepre penale nënkupton marrjen e përkohshme e sendeve me vlerë me qëllim që ato të shfrytëzohen dhe më pas të kthehen.

Për ekzistimin e kësaj vepre penale, duhet që përdorimi i pasurisë së besuar, të bëhet pa autorizim, kjo nënkupton se pasuria nuk i është besuar atij për një veprim të tillë të autorizuar çka nënkupton se autorizimi për veprimin e tillë të përdorimit nuk ekziston te kryerësi i kësaj vepre penale.

⁴²⁴ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.2/2019 date. 14.01.2019, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr. 06/L-074, neni 420.

Objekt i kësaj vepre penale është paraja, letrat me vlerë ose pasuria tjetër e luajtshme, si p.sh. automjetet, mjetet e punës, etj.

Vepra penale konsiderohet se është kryer me ndërmarrjen e njërit prej veprimeve të kryerjes të cekura më lart.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë vetëm personi, të cilit paraja, letrat me vlerë ose pasuria tjetër e luajtshme i janë besuar në detyrë ose në përgjithësi në vendin e punës apo të cilat i janë vënë në dispozicion për shkak të detyrës apo punës.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje, e cila në vete përfshin vetëdijën dhe dëshirën për t'i përdorur pa autorizim paratë, letrat me vlerë ose pasurinë tjetër të luajtshme apo për t'ia dhënë këto sende në shfrytëzim personit tjetër pa autorizim.

Për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me gjobë apo me burgim deri në tri vjet.

Elementet e veprës.

- **Mungesa e autorizimit për veprimin e tillë me pasurinë,**

Format e kryerjes se veprës.

- **Duke e përdorur pasurin e besuar për shkak te detyrës apo punës,**
- **Duke ia vene ne dispozicion pasurin e besuar personit tjetër për shfrytëzim te paautorizuar.**

6. Marrja e ryshfetit (neni 421)

Kosova, si edhe shumë shtete të tjera të botës, është duke u përballur me fenomenin e korrupsionit, i cili si duket në një masë më të madhe apo më të vogël i ka përshkuar të gjitha strukturat e shtetit.

Korrupsioni, si dukuri kriminale tejet e rrezikshme shoqërore haset që në kohërat më të lashta të zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Megjithatë, problematika e korrupsionit, me të gjitha karakteristikat e tij, fillon të trajtohet shumë vonë dhe atë në kohët bashkëkohore. Korrupsioni si fenomen historik, politik, ekonomik, juridik, nacional, regjional, ndërkombëtar, etj., shkakton pasoja shoqërore, ekonomike, sociale, psikologjike e pasoja të tjera.⁴²⁵ Andaj, për këto arsye, korrupsioni duhet penguar dhe luftuar me masa përkatëse të natyrës preventive dhe represive.

⁴²⁵ Hajdari, Azem : Veptrat penale me natyrë korrupsioni me një vështrim të posaçëm në Kosovë, Prishtinë, 2003, faqe 16.

Fjala “korrupsion” rrjedh nga fjala latine “**corruptio**” që do të thotë **prishje, ryshfet, mitë, prishje morale.**

Korrupsioni, në kuptimin më të gjerë është keqpërdorim i detyrës zyrtare nga ana e personave zyrtarë për përfitime të caktuara.

Sipas nenit 2 të Ligjit kundër korrupsionit,⁴²⁶ shprehja “korrupsion” nënkupton çdo shkelje të detyrës së personave zyrtarë ose përgjegjës në subjektet juridike dhe çdo veprimtari e iniciatorëve apo përfituesve të kësaj sjelljeje, e drejtuar si përgjigje ndaj një shpërblimi që drejtpërdrejt ose indirekt është premtuar, ofruar, dhënë, kërkuar, pranuar apo është pritur për t’u marrë për veten apo për një person tjetër. Kurse, në nenin 2 të Ligjit për Agjencinë kundër korrupsionit,⁴²⁷ është parashikuar se korrupsioni nënkupton çdo keqpërdorim të pushtetit apo çdo sjellje tjetër të personit zyrtar, personit përgjegjës apo personit tjetër me qëllim të arritjes së një përparësie apo përftimi të kundërligjshëm për veten apo për tjetrin.

Përveç me akte juridike të shteteve, çështja e luftimit dhe e parandalimit të korrupsionit është trajtuar edhe me dokumente të ndryshme juridike ndërkombëtare. Në këtë drejtim vlen të përmendet Konventa kundër korrupsionit e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe Konventa juridike penale kundër korrupsionit, të cilën e ka nxjerr Këshilli i Evropës.

Me qëllim të pengimit dhe luftimit të korrupsionit, si në shtetet tjera të botës, ashtu edhe në Kosovë, zbatohen edhe masa të karakterit juridiko-penal. Kështu, në KPRK është parashikuar si vepër penale, si marrja ashtu edhe dhënia e ryshfetit.

Në nenin 421 të KPRK, është parashikuar si vepër penale marrja e ryshfetit, e cila në teorinë e së drejtës penale, ndryshe emërtohet edhe si “**korrupsion pasiv**”.

Në paragrafin 1 të këtij neni, është parashikuar forma themelore e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur personi zyrtar apo personi i huaj zyrtar apo zyrtari i huaj publik në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë, kërkon ose pranon dhuratë apo përfitim tjetër për vete ose personin tjetër, që ai të veproj apo të mos veproj në pajtim me detyrën e tij zyrtare.

428

Cilësia e kryerësit

- **Personi zyrtar**
- **Personi i huaj zyrtar**
- **Personi i huaj publik**

⁴²⁶ Ligji Nr.2004/34 Kundër Korrupsionit, i datës 12.05.2005.

⁴²⁷ Ligji Nr.03/L-159 Për Agjencinë Kundër Korrupsionit, i datës 29.12.2009.

⁴²⁸ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.2/2019 date. 14.01.2019, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr. 06/L-074, neni 421.

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë në :

Format alternative te kryerjes:

- **kërkimin e dhuratës,**
- **pranimin e dhuratës apo përftimin tjetër qofte për vete apo për personin tjetër,**
- **pranimin e e ofertës apo premtimit për ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër.**

Kjo formë e kësaj vepre penale ekziston nëse është ndërmarrë njëri nga këto veprime të kryerjes. Të tri këto veprime të kryerjes së kësaj vepre penale, personi zyrtar i ndërmerr për të kryer në kuadër të autorizimeve të tij një veprim zyrtar apo një veprim tjetër, të cilin ai nuk duhej ta kryejë ose të mos e kryejë një veprim zyrtar apo veprim tjetër të cilin ai duhet ose ka mundur ta kryejë. Kjo vepër penale për nga mënyra e kryerjes kryhet me veprim dhe me mosveprim, nga personi zyrtar.

Mënyra e kryerjes se veprës penale.

- **Veprimin ne pajtim me detyrën zyrtare**
- **Mos veprimi ne pajtim me detyrën zyrtare**

Dhuratë, në kuptimin e kësaj vepre penale konsiderohet çdo lloj vlere pasurore që i jepet një personi tjetër pa kompensim. Dhuratat mund të jenë të natyrave të ndryshme, si p.sh. të holla, automjete, telefona celularë, ora të dorës, banesa, shtëpia, trualli, etj. Kurse, përfitim tjetër në kuptimin e kësaj vepre penale, duhet nënkuptuar punësimin e ndonjë të afërmi të personit zyrtar, mundësimin e marrjes së ndonjë kredie me kushte më të favorshme, fitimin e ndonjë burse për ndonjë të afërm të personit zyrtar, mundësimi i pushimit pa pagesë ose me pagesë shumë më të vogël, etj.

Shembull nga praktika gjyqësore:

Kështu, në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin H.E., për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit, nga neni 343 paragrafi 1 të KPRK, sepse i akuzuari, në cilësinë e personit zyrtar, ka pranuar shumën e të hollave prej 100 €, nga një person tjetër, në mënyrë që në kuadër të autorizimeve të tij të kryej një veprim zyrtar që nuk është dashur për t'a kryer.⁴²⁹ Kurse, në një çështje tjetër penale, gjykata i ka shpallur fajtor të akuzuarit

⁴²⁹ Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Viti, P.nr.368/2004, i datës 23.05.2006.

E.R. dhe T.O., për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit, nga neni 343 paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPRK, sepse të akuzuarit, në cilësinë e personave zyrtarë, kanë pranuar shumën e të hollave prej 10.000 €, nga i dëmtuari U.Z., në mënyrë që të akuzuarit në kuadër të autorizimeve të tyre, të mos e kryejnë një veprim zyrtar që është dashur për ta kryer.⁴³⁰

Për ekzistimin e kësaj vepre penale, duhet që veprimi i kryerjes të jetë kryer në kuadër të kompetencave (autorizimeve) të personit zyrtar.

Kjo veprë penale konsiderohet se është kryer me vetë faktin se është kërkuar dhurata, kur është pranuar dhurata ose kur është pranuar premtimi se do t'i jepet dhurata apo ndonjë përfitim tjetër. Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi kumulativ me gjobe dhe me burgim prej një deri në tetë vjet.

Formë tjetër e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se ekziston nëse personi zyrtar, personi i huaj zyrtar apo personi i huaj publik drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë, kërkon ose pranon dhuratë apo përfitim tjetër për vete ose për personin tjetër, apo që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë të tilla, për të vepruar apo për të mos vepruar në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare. Rrjedhimisht edhe tek kjo formë e kryerjes se veprës mënyrat e kryerjes janë si me veprim apo me mosveprim.

Mënyra e kryerjes se veprës.

- **Veprimi në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare,**
- **Mosveprimi në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare.**

Kjo formë e kësaj vepre penale (paragrafi 2) dallohet nga forma e parë e kësaj vepre penale (paragrafi 1), për faktin se te forma e dytë personi zyrtar vepron në pajtim me detyrën e tij zyrtare dhe ndërmerr veprime të cilat ai nuk është dashur që të ndërmerr, apo nuk vepron në pajtim me detyrën e tij zyrtare e që ai është dashur që të veproj.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi kumulativ, me gjobe dhe me burgim prej tri deri në dymbëdhjetë vjet.

Në paragrafin 3 të këtij neni, është parashikuar forma kualifikuese e kësaj vepre penale në raport me veprën themelore. Megjithatë duke qene se dispozita ligjore ka dy forma themelore të veprës penale që janë parapare në paragrafin 1 dhe 2, pasi që në paragrafin 1 kërkohet që të veprohet apo mos veprohet nga personi zyrtar në pajtim me detyrën zyrtare, ndërsa në

⁴³⁰ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj, P.nr.346/2007, i datës 17.07.2007.

paragrafin 2 kërkohet që të veprohet apo mos veprohet në kundërshtim me detyrën zyrtare, paragrafi 3 ku parasheh formën e kualifikuar të kësaj veprë penale e ndërlidhë atë vetëm me paragrafin 1 të nenit 421, gjë që e përjashton si formë kualifikuese veprën penale të parapare në paragrafin 2 të nenit 421. Përkundër kësaj, forma kualifikuese e veprës penale sipas paragrafit 3 të nenit 421 ka dy elemente që e përbëjnë si formë të tillë të kualifikuar e që janë: Dobia materiale, dhe lartësia e dobisë materiale të jete e tejkaluar prej 15.000 euro.

Duke pasur parasysh faktin se për kryerjen e kësaj veprë penale, mund të jete dhurata apo oferta apo premtimi apo përfitimi tjetër, në këtë kuptim mund të jete problematike për të vërtetuar dobinë materiale, nga se jo çdo përfitim mund të shëndërrohet në lartësi të vlerës siq dispozita ka përcaktuar si element të formës kualifikuese, shumen me të lartë se 15.000 euro. Megjithatë ligjdhënësi ka pasur për qëllim që në çdo rrethane kur behet fjalë për dobi pasurore që mund të shëndërrohet në vlerë monetare si e tillë kur ka tejkalim të lartësisë mbi 15.000 euro, kryesi duhet të përgjigjet për një formë me të rende të kryerjes se kësaj veprë penale, andaj edhe është përcaktuar lartësia si element kualifikues i kësaj veprë penale.

Kryerës i kësaj veprë penale mund të jetë vetëm personi zyrtar, personi i huaj zyrtar apo personi i huaj publik.

Kjo veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje.

7. Dhënia e ryshfetit (neni 422)

Vepra penale dhënia e ryshfetit, nga neni 422 të KPRK, është organikisht e ndërlidhur me veprën penale marrja e ryshfetit, nga neni 421 të KPRK. Në të shumtën e rasteve në praktikë, me të njëjtin aktgjykim gjykata i ka shpallur fajtor personin zyrtar, për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit, nga neni 421 të KPRK dhe personin tjetër, për shkak të veprës penale dhënia e ryshfetit, nga neni 422 të KPRK. Megjithatë në praktiken gjyqësorë ka edhe raste që prokuroria e ka kërkuar lirim të akuzuarit për dhënien e ryshfetit duke qenë se i njëjti ka kontribuar në zbardhjen e rrethanave për veprën penale të marrjes së ryshfetit, kjo në praktiken gjyqësore është bërë kryesisht për faktin se me e rëndësishme është që të luftohet vepra penale e marrjes së ryshfetit nga se përmes ndëshkimit të kryerësit në këto vepra penale do të ruhej integriteti i pozitës zyrtare e rrjedhimisht luftimi i kriminalitetit në mënyrë të tërthortë behet edhe për dhënien e ryshfetit.

Sipas paragrafit 1 të nenit 422 të KPRK,⁴³¹ veprën penale dhënia e ryshfetit, e kryen kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë, i premtton dhuratë, i jep ose i ofron dhuratë apo përfitim tjetër personit zyrtar, që ai person të veproj apo të mos veproj në pajtim me detyrën e tij zyrtare.

⁴³¹ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.2/2019 date. 14.01.2019, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr. 06/L-074, neni 422.

Kjo veprë penale në konstruktimin e saj inkriminon qoftë dhënësin e drejtpërdrejt apo dhënësin e tërthortë apo ndërmjetësuesin e dhënies së ryshfetit, sepse vepra inkriminon veprimin në mënyrë të drejtpërdrejt por edhe veprimin e tërthortë.

Kush mund të jetë përgjegjës.

- **Dhënësi i drejtpërdrejt**
- **Dhënësi i tërthortë / ndërmjetësuesi**

Veprimet e kryerjes së kësaj veprë penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë në :

Format e kryerjes:

- **premtimin për dhënie dhe dhuratës ose përfitimit tjetër,**
- **dhënie dhe dhuratës apo përfitimit tjetër, apo**
- **ofrimin e dhuratës apo përfitimit tjetër personit zyrtar.**

Të gjitha veprimet e kryerjes së kësaj veprë penale duhet të ndërmerren me qëllim që personi zyrtar të kryej veprimin në pajtim me detyrën e tij zyrtare (çka do të thotë se kjo mënyrë e veprimit është në një formë që personi zyrtar e neglizhon veprimin që duhet ta kryej), ose të mos e kryej veprimin në pajtim me detyrën e tij.

Shembull nga praktika gjyqësore:

Kështu, në një çështje penale, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin G.I., për shkak të veprës penale dhënie dhe ryshfetit, nga neni 344 paragrafi 1 të KPRK, sepse i akuzuari, ia ka dhënë shumën e të hollave prej 100 € personit zyrtar, në mënyrë që personi zyrtar në kuadër të autorizimeve të tij të kryej një veprim zyrtar që nuk është dashur për t'a kryer.⁴³²

Kjo veprë penale konsiderohet se është kryer me vetë faktin e dhënies së dhuratës apo përfitimit tjetër, ose premtimit për dhënie dhe dhuratës apo përfitimit tjetër.

Për këtë formë të kësaj veprë penale është parashikuar dënimi kumulativ me gjobe dhe me burgim deri në pesë vite.

Formë tjetër e kësaj veprë penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se është kryer në rastet kur ndokush i premtim dhuratë, i ofron ose i jep ndonjë dhuratë të paarsyeshme, apo përfitim tjetër personit zyrtar, që ai person të veprojë apo të mos veprojë në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare.

⁴³² Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Viti, P.nr.368/2004, i datës 23.05.2006.

Edhe te kjo forme e inkriminimit te veprës penale te dhënies se ryshfetit, inkriminohet si dhënësi po ashtu edhe ndërmjetësuesi, nga se vepra penale përcakton kushdo, qe ne mënyrë te drejtpërdrejt apo ne mënyrë te tërthortë, premtion, ofron apo jep dhuratën. Kjo forme e inkriminimit te veprës, përcakton dy mënyrat e kryerjes e qe e përfshinë edhe ndërmjetësuesin.

Kush mund te jete përgjegjës.

- **Dhënësi i drejtpërdrejt**
- **Dhënësi i tërthortë/ ndërmjetësuesi**

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi ne mënyrë kumulative me gjobë dhe me burgim prej gjashte muajve deri ne pesë vite.

Paragrafi 3 i nenit 422, ka parapare formën kualifikuese te veprës penale te dhënies se ryshfetit, por serish reflekton se forma kualifikuese është vetëm ne raport me formën themelore nga paragrafi 1, ndërsa nuk është inkriminuar si forme e kualifikuar inkriminimi nga paragrafi 2 i kësaj vepre penale, gjë qe konsiderojmë se dispozita ligjore nuk e ka ndjekur ne esence qëllimin e inkriminimit adekuat te veprës penale dhe te formave me te renda, pavarësisht kësaj ne paragrafin 3, element kualifikues qe e ndërlidhë vetëm me paragrafin 1 te nenit 422, është lartësia e përfitimit qe ka rezultuar, e qe kërkesa ligjore është qe përfitimi te ketë rezultuar me vlere me te lartë se 15.000 euro.

Elementi i veprës për formën e kualifikuar

- **Kur përfitimi rezulton me vlerë qe tejkalon 15.000 euro**

Inkriminimi i formës se kualifikuar sipas paragrafit 3 te nenit 422, po ashtu ka parapare dënimin kumulativ, me gjobe dhe me burgim prej nje deri ne tetë vite.

Paragrafi 4 i nenit 422 të KPRK, është dispozitë e karakterit kriminalo-politike, ngase i stimulon kryerësit e kësaj vepre penale, që t'i njoftojnë organet kompetente për kryerjen e kësaj vepre penale, para se ajo të jetë zbuluar ose para se të ketë kuptuar se vepra penale është zbuluar. Sipas kësaj dispozite ligjore, nëse kryerësi i veprës penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni, e ka dhënë dhuratën e paarsyeshme apo përfitimin me kërkesën e personit zyrtar dhe ka njoftuar për veprën e kryer para se ajo të jetë zbuluar ose para se të ketë kuptuar se ka filluar procedura penale, gjykata mund ta lirojë nga dënimi.

8. Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore (neni 425)

Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore nga ana e gjyqtarit, me qëllim që vetes apo tjetrit t'i sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror ose tjetrit t'i shkaktojë dëm është një lloj

keqpërdorimi i detyrës zyrtare. Mirëpo, për shkak të rëndësisë së madhe të funksionit gjyqësor, KPRK e ka inkriminuar në mënyrë të veçantë këtë lloj të keqpërdorimit.⁴³³

Në nenin 425 të KPRK, është parashikuar kjo veprë penale, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur gjykatësi, gjykatësi laik ose gjykatësi për kundërvajtje i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër ose për t'i shkaktuar dëm personit tjetër nxjerr vendim të kundërligjshëm.⁴³⁴

Veprimi i kryerjes së kësaj veprë penale konsiston në nxjerrjen e vendimit të kundërligjshëm gjatë ushtrimit të kompetencave gjyqësore. Shprehja “vendim”, në kuptimin e kësaj veprë penale ka kuptim të gjerë dhe nënkupton : aktgjykimet, aktvendimet, urdhëresat dhe vendimet tjera.

Vendimi është i kundërligjshëm nëse është në kundërshtim me ligjin, përkatësisht nëse është në kundërshtim me ndonjë dispozitë ligjore. Në kuptimin e kësaj veprë penale, me shprehjen “ligj” duhet nënkuptuar, përveç dispozitave ligjore edhe dispozitat kushtetuese.

Nxjerrja e vendimeve të kundërligjshme nga ana e gjyqtarit, mund të bëhet në të gjitha procedurat gjyqësore, si dhe në të gjitha fazat e këtyre procedurave, si p.sh. në procedurën penale, konstestimore, jokontestimore, përmbarimore, kundërvajtëse, etj.

Vepra penale konsiderohet se është kryer me nxjerrjen e vendimit të kundërligjshëm.

Kryerës i kësaj veprë penale mund të jetë vetëm gjykatësi, gjykatësi laik ose gjykatësi për kundërvajtje. Në sensin e kësaj veprë penale, me shprehjen gjykatës, duhet nënkuptuar edhe kryetarët e gjykatave.

Kjo veprë penale kryhet vetëm me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër ose për t'i shkaktuar dëm personit tjetër. Andaj, për ekzistimin e kësaj veprë penale, duhet të konstatohet edhe qëllimi i përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër ose qëllimi për t'i shkaktuar dëm personit tjetër. Për këtë veprë penale është parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Te kjo veprë penale ka rëndësi qëllimi, nga se vendimet edhe për nga vlerësimi në procedurën e ankimimit munde të rezultojnë që janë të kundërligjshme, nga se çdo vendim që nuk gjen mbështetje ligjore rrjedhimisht është në kundërshtim me dispozitat e tilla ligjore dhe për pasojë është edhe i kundërligjshëm, çka do të thotë se rastet e anulimeve të vendimeve gjyqësore për shkak se ato janë në kundërshtim me dispozitat ligjore janë të shpeshta kur ushtrohet kontrolli sipas instancës me të lartë me ane të ankesës. Mirëpo në asnjë rast nuk mund të konsiderohet se kjo veprë penale është kryer nëse nuk provohet ekzistimi i qëllimit të kryerësit, e që ndërthen

⁴³³ Salihu, Ismet : vepra e cituar në fusnotën 7, faqe 532 dhe Srzentić, Nikolla, Stajić, Aleksader, Kraus, Božidar, Lazarević, Ljubiša dhe Đorđević, Miroslav : vepra e cituar në fusnotën 61, faqe 625.

⁴³⁴ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.2/2019 date. 14.01.2019, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr. 06/L-074, neni 425.

ne vete, si përfitimin e kundërligjshëm qofte ai për vete apo për personin tjetër, apo shkaktimin e demit personit tjetër.

Kjo forme e inkriminimit është ne kuptimin e respektimit te pavarësisë se gjyqësorit, qe nënkupton se gjyqtari nuk duhet te ketë presionin e inkriminimit për shkak se ne zbatim te dispozitave ligjore mund ti zbatoj gabimisht ato dispozita dhe te rezultojë një vendim i kundërligjshëm, rrjedhimisht përderisa nuk ka qëllim te përfitimit apo te dëmtimit te personit tjetër me ane te vendimit qe e nxjerr gjyqtari, kjo është edhe ne përputhshmëri me imunitetin e gjyqtarit, ndërsa kur shfaqet qëllimi i përfitimit me ane te vendimit qe e nxjerr ne mënyrë te kundërligjshme apo kur shfaqet qëllimi për ta dëmtuar personin tjetër, atëherë nuk munde te behet fjale, as për pavarësinë e gjyqtarit dhe as për imunitetin, por kemi te bëjmë me veprën penale te nxjerrjes se vendimit te kundërligjshëm gjyqësor.

Ne këtë kuptim dilema është, se dispozita e kushtetutës nga neni 107,⁴³⁵ parasheh imunitetin e gjyqtarit për vendimet e nxjerra dhe votën e dhënë, megjithatë neni 107 paragrafi 2 i kushtetutës parasheh se Gjyqtaret nuk gëzojnë imunitet kur te kenë shkelur ligjin me qëllim, andaj shtrohet pyetja se a duhet qe për qëllim te procedimit penal ndaj gjyqtarit kur ka dyshim se është nxjerr vendimi i kundërligjshëm te kërkohet heqja e imunitetit, gjer me tani ne praktiken gjyqësore nuk ka pasur një vendim te heqjes se imunitetit, pavarësisht faktit se mund te ketë pasur dyshim për qëllimin e përfitimit, megjithatë imuniteti është pengës procedurale, andaj edhe ekziston dilema e tille qe ne praktiken gjyqësore nuk është trajtuar ende.

9. Zbulimi i fshehtësisë zyrtare (neni 426)

Kjo vepër penale ka për qëllim ruajtjen e sigurisë kombëtare por njëkohësisht edhe ruajtjen e informacionit te konsideruara si konfidencial apo te fshehte. Ne Kosovë ekziston një ligj i veçantë për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë, megjithatë ka shume norma ligjore qe janë te kategorizuara brenda ligjeve sistemore qe mbrojnë vetëm një natyre apo një veprim te informacionit. Ne këtë kuptim informacioni munde te jete i kategorizuar si: *Tepër sekret, Sekret, Konfidencial, I kufizuar*⁴³⁶. Megjithatë legjislacioni ne fuqi ka norma edhe për kategorizimin e detyrimit për mos publikim, apo detyrim për tu përmbajtur nga publikimi, disa norma te tilla janë te rregulluara me udhëzimet administrative te prokurorit te shtetit qe i referohen, mos zbulimit te fshehtësisë se hetimeve. Pra varësisht nga fshehtësia zyrtare qe behet fjale ajo duhet te jete e parapërcaktuar me akte ligjore apo nënligjore si fshehtësi zyrtare dhe vetëm kur është e përcaktuar atëherë nëse cenohet informata e tille e fshehte zyrtare mund te flitet për vepër penale qe inkriminohet nga neni 426.

⁴³⁵ Kushtetuta e Republikës se Kosovës neni 107.

⁴³⁶ Gazeta zyrtare e Republikës se Kosovës, Viti V, nr. 76, 10 Gusht 2010, Ligji për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë, nr. 03/L-178, Neni 7.

Këtë veprë penale, sipas paragrafit 1 të nenit 426 të KPRK⁴³⁷, e kryen personi zyrtar i cili pa autorizim kumton, dërgon ose në ndonjë mënyrë tjetër i vë në dispozicion personit tjetër informacionin i cili përbën një fshehtësi zyrtare ose siguron informacionin e tillë me qëllim të përcjelljes te një person i paautorizuar.

Cilësia e kryerësit

- **Personi zyrtar qe nuk ka autorizim për kumtimin e informatës**

Objekt i kësaj veprë penale janë informatat (të dhënat), të cilat përbëjnë fshehtësi (sekret) zyrtar. Kjo nënkupton se fshehtësia e tillë zyrtare te jete e përcaktuar me legjislacionin ne fuqi si fshehtësi zyrtare.

Veprimi i kryerjes së kësaj veprë penale është kumtimi, dorëzimi apo bërja, në ndonjë mënyrë tjetër e mundshme personit të paautorizuar të njihet me këto të dhëna. Gjithashtu, si formë e kryerjes së kësaj veprë penale është edhe grumbullimi i këtyre të dhënave, me qëllim që t'i dorëzohen personit të paautorizuar.

Format e kryerjes

- **Vënia ne dispozicion apo komunikimi i fshehtësisë zyrtare drejtpërdrejt te personi**
- **Vënia ne dispozicion apo komunikimi për qëllim te dërgimit personit tjetër**

Forma themelore e inkriminimit te kësaj veprë penale konsiderohet se konsumohet me vet faktin se fshehtësia zyrtare i është vene ne dispozicion apo është përcjellë për t'iu vu ne dispozicion personit tjetër, pavarësisht qëllimit apo motivit te kryerësit. Kjo forme ka parapare dënimin me burgim prej gjashte muajve deri ne tri vite.

Forma e kualifikuar sipas paragrafit 2 te nenit 426, ka përcaktuar se kur vepra penale nga paragrafi 1, kryhet me qëllim përfitimi apo për shfrytëzim apo publikim jashtë republikës se Kosovës, dënimi është kumulativ, me gjobe dhe me burgim prej një deri ne dhjet vite.

Elementet e formës se kualifikuar

- **Qëllimi i përfitimit personal, apo**
- **Qëllimi i shfrytëzimit te informatës jashtë Republikës se Kosovës, apo**

⁴³⁷ Gazeta zyrtare e Republikës se Kosovës, nr.2/2019 date. 14.01.2019, Kodi Penal i Republikës se Kosovës, nr. 06/L-074, neni 426.

- **Qëllimi i publikimit jashtë Republikës së Kosovës.
Cilado nga këto elemente që plotësohet, konsumohet forma e
kualifikuar e kësaj vepre penale.**

Paragrafi 3 i nenit 426 inkriminon veprën e tillë të kryer edhe nga pakujdesia. Kjo nënkupton se personi zyrtar duhet të jetë vigjilent dhe në raport me të dhënat e fshehtësisë zyrtare që nuk janë të autorizuar për tu komunikuar, duhet të ketë kujdesin e shtuar nga se në të kundërtën përgjegjësia penale mund të ngarkohet për shkak të pakujdesisë së tillë të personit zyrtar.

Paragrafi 4 i nenit 426, ngarkon detyrimin ndaj personit zyrtar që edhe pas pushimit të funksionit të tillë të detyrës zyrtare ai ka detyrim që fshehtësinë zyrtare të mos e komunikoj. Në rast të komunikimit të fshehtësisë zyrtare pasi që ka pushuar funksioni i tillë i personit zyrtar, atëherë për qëllim të kësaj vepre penale ai përgjigjet penalisht edhe pse në atë kohë mund të mos e ketë cilësinë e personit zyrtar.

Në paragrafin 5 të nenit 426 të KPRK, është përcaktuar domethënia e “fshehtësisë zyrtare”. Sipas kësaj dispozite ligjore shprehja “fshehtësi zyrtare” do të thotë informata ose dokumente të shpallura me ligj, dispozita të tjera ose me vendim të organit kompetent të nxjerra në bazë të ligjit e që konsiderohen fshehtësi zyrtare, zbulimi i të cilave ka shkaktuar ose mund të shkaktojë pasoja të dëmshme.

Megjithatë sipas paragrafit 5, po ashtu janë përjashtuar si fshehtësi zyrtare edhe nëse ato janë të shpallura si të tilla kur kanë të bëjnë me informatat apo dokumentet të cilat janë të drejtuara në cenimin e rëndë të të drejtave themelore të njeriut ose mos zbulimi i të cilave do të mund të rrezikonte rendin kushtetues apo sigurinë e Republikës së Kosovës, apo kur informatat dhe dokumentet të cilat kanë për qëllim fshehjen e kryesit të veprës penale të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim.

10. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli

Përveç veprave penale të lartcekura, në Kapitullin e veprave penale kundër detyrës zyrtare bëjnë pjesë edhe këto vepra penale :

- Ushtrimi i ndikimit (neni 424),
- Falsifikimi i dokumenteve zyrtare (neni 427),
- Arkëtimi dhe pagesa e paligjshme (neni 428),
- Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor (neni 429).

Politika ndëshkimore për veprat penale kundër korrupsionit

1. Shqyrtime të përgjithshme

Duke qenë se sistemi gjyqësor ka qenë në piken e kritikës së vazhdueshme, për shkak të ndëshkueshmërisë së veprave penale kundër korrupsionit, e për pasojë duke qenë se përmes

ndëshkimeve që janë bërë nga gjykatat për këto vepra penale janë vërejtur një nivel i lartë i pabarazisë në procedurat gjyqësore për sa i përket dënimit ndaj kryerësve të këtyre veprave penale, ku në praktiken gjyqësore, ka ndodhur që brenda gjykatës së njëjtë për veprat penale psh, keqpërdorimi i detyrës zyrtare për formën themelore, një person është dënuara me dënim me kusht, ndërsa personi tjetër është dënuara me dënim me burgim, apo duke në nivele të gjykatave themelore të ndryshme po ashtu ka pasur një mos përcaktueshmëri të përafërt të dënimeve për kryerësit e veprave penale të natyrës së njëjtë, e tere kjo situatë ka përcaktuar deri diku një nevojë që sistemi gjyqësor të ketë parasysh dhe të reflektoj mbi këtë gjendje për shkak të disa arsyeve:

- Për të pasur një sistem gjyqësor të parashikueshëm mbi dënimin që mund ta godas kryerësin,
- Për të qenë trajtimi i barabartë para ligjit,
- Për të qenë një praktike me e unifikuar e dënimit,
- Për të arritur dënimin qëllimin e vet në preventiven speciale e posaçërisht në preventiven gjeneralë.

Këto kanë qenë disa nga shkaqet që, Gjykata Supreme e Kosovës, ka miratuar Udhëzuesin e veçantë për veprat penale kundër detyrës zyrtare. Në këtë kuptim udhëzuesi po ashtu ka inkorporuara edhe sqarime që do të mund të shërbenin në praktiken gjyqësore, posaçërisht në pjesën e dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal të Kosovës që lidhen me veprat penale kundër detyrës zyrtare. Ky udhëzues është munduar që të shtjelloj dhe të jap shembuj praktik gjyqësorë qoftë vendor apo të krahasueshëm në juridiksionet e tjera për ta bërë sa më të lehtë aplikimin e dispozitave ligjore specifikuat pjesën e përgjithshme e posaçërisht pjesën e dashjes. Në sistemin tonë juridik ka mbizotëruar në praktiken gjyqësore qëndrimi, por edhe në kuadër të komentareve ka mbizotëruara qëndrimi se psh. Vepra penale e keqpërdorimit të detyrës zyrtare apo autoritetit kryhet vetëm me dashjen direkte, përkundër se dashja direkte dhe dashja eventuale është kategori e përcaktuar në dispozitat e përgjithshme të Kodit Penal të Kosovës, në kuadër të inkriminimit të veprës penale të Keqpërdorimit të detyrës zyrtare apo autoritetit, nuk përcaktohet lloji i dashjes që mund të kryhet vepra penale, por nga praktika gjyqësore ka mbizotëruara një argument i tillë se vepra penale kryhet vetëm me dashje direkte/drejtëpërdrejt, Megjithatë legjislacionet e ndryshme posaçërisht legjislacionet e vendeve të Bashkimit Evropian i japin rëndësi, aspektit subjektiv – qëllimit si element i veprës penale, dhe fare nuk i japin rëndësi faktit se a kishte dashje direkte apo dashje eventuale kryerësi për të konstatuar fajësinë e tij. Në këtë kuptim udhëzuesi jap sqarime dhe shembuj se si mund të vërtetohet ekzistimi i dashjes së kryerësit të veprës penale në mënyrë rrethore pra nga faktet rrethore dhe provat rrethore që do ta vërtetonin ekzistimin e qëllimit, dhe kur vërtetohet qëllimi atëherë rezulton dashja e të akuzuarit, nga se këto janë të ndërlidhura subjektivisht dhe objektivisht në çdo rast sa që është e pamundur që të ndahen njëra nga tjetra, andaj udhëzuesi ka si qëllim zgjerimin e njohurive për gjyqtarët në mënyrë që jo vetëm të behet matja e dënimit në përputhje me demin dhe pozitën zyrtare të kryerësit si pasojë e veprës penale të kryer por njëkohësisht edhe me zbatimin praktik të dispozitave të përgjithshme të kodit penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata Supreme ne seancën e përgjithshme me date. 11.06.2021 ka miratuar udhëzuesin për veprat penale kundër detyrës zyrtare, ne te cilin udhëzues ka përcaktuar qartës dhe specifikisht pikënisjet e lartësisë se dënimit ne raport me secilën vepër penale ne kuadër te kapitullit kundër detyrës zyrtare por edhe ne raport me format themelore dhe te kualifikuara te secilës vepër penale, andaj ne këtë material do te synohet te jepen sqarime mbi kriteret qe duhet marr për baze ne çështjen penale, përcaktimi i pikënisjes se dënimit. \

2. Kriteret e kategorizimit

Udhëzuesi për te përcaktuar mënyrën dhe peshimin e rrethanave, ka marre për baze dy kritere⁴³⁸ thelbësore qe janë po ashtu ne kuadër te veprave penale kundër detyrës zyrtare:

a). Përgjegjësia; dhe

b). Dëmi i shkaktuar.

Përgjegjësia është ndërlidhur me funksionin e cilësisë se personit zyrtare, çka do te thotë se udhëzuesi ka pasur si synim qe te kategorizoj cilësinë e zyrtarit si kryerës te veprës penale, ne kuptimin e ndikimit dhe rolit brenda detyrës zyrtare qe e ka kryesi i veprës penale, duke përcaktuar se a është pozite me ndikim te larte apo është pozite e thjeshte përkatësisht pa ndikim e personit zyrtar, kjo ka qene e domosdoshme edhe për faktin se veprat penale kundër detyrës zyrtare shpesh here kryhen ne forma te bashkëpunimit kriminal andaj duke i definuar nivelet e përgjegjësisë vetëm për efekt te cilësisë se personit zyrtar si kryerës i veprave penale kundër detyrës zyrtare rrjedhimisht udhëzuesi nuk lejon trajtim te te gjithë kryerësve ne mënyrë te njëtrajtshëm, sepse edhe pozita më me ndikim ka rendësin e nivelit më të lartë të përgjegjësisë. Lidhur me përgjegjësin udhëzuesi jap tri kategori.

Dëmi si kriter që është marr për bazë sipas udhëzuesit, po ashtu është brenda kategorive te demit qe Kodi Penal ka përcaktuar lartësinë e demit, megjithatë demi jo domosdoshmërisht shfaqet vetëm ne forma monetare pasi qe munde te ketë dëm edhe në natyrë andaj kategorizimi i lartësisë së dëmit është inkorporuara brenda atyre lartësive qe kodi i ka përcaktuar si lartësi te demit por duke inkorporuara edhe rrethana te tjera qe ndikojnë ne lartësinë e demit te tille te shkaktuar. Lidhur me demin udhëzuesi jap katër kategori.

Kategoritë e përgjegjësisë sipas udhëzuesit:

Kategoria – I -

<i>A – Përgjegjësi e lartë</i>

Bërja e kërkesës

⁴³⁸ Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, Udhëzues i veçantë, faqe 46, 47 dhe 48, Qershor 2021, Gjykata Supreme.

Rol udhëheqës, kur kryerja e veprës penale është pjesë e veprimtarisë grupore
Përfshirja e të tjerëve përmes presionit, ndikimit
Keqpërdorimi i pozitës së fuqisë së konsiderueshme ose besimit ose përgjegjësisë
Personi zyrtar në pozitë të lartë lokale apo qendrore apo funksion të rëndësishëm (zyrtar i lartë, prokurorë, gjyqtarë, zbatues të ligjit etj)
Natyra e sofistikuar e veprës penale / shkalla e lartë e planifikimit/vepër transnacionale
Vepra penale e kryer gjatë një periudhe kohore të vazhdueshme
Përpjekja apo angazhimi për të fshehur apo shkatërruar provat
Vepra e kryer për ta lehtësuar aktivitetin tjetër kriminal

Kategoria – II –

<i>B – Përgjegjësia e mesme</i>
Rol i rëndësishëm kur kryerja e veprës penale është pjesë e veprimtarisë në grup
Përfshirja e të tjerëve përmes mashtrimit
Raste të tjera që bien midis kategorive A ose C sepse:
- Faktorët janë të pranishëm në A dhe C të cilët ekuilibrojnë njëri-tjetrin ose
- Përgjegjësia e kryesit të veprës penale bie midis faktorëve të përshkruar në A dhe C

Kategoria – III -

<i>C – Përgjegjësi e ulët</i>
Kryesi i veprës penale i përfshirë përmes shtrëngimit, frikësimit ose shfrytëzimit
Roli i vogël apo periferik në veprimtarinë e organizuar
Paraqitet si vepër e parë “oportuniste”;
- Personi zyrtar në pozitë shumë të ulët
- Nuk është motivuar nga përfitimi personal

- Shumë pak ose aspak planifikim

Kategoritë e dëmit sipas udhëzuesit:

Kategoria - I –

<i>Kategoria 1 (Dëm i lartë)</i>
Dëm, shkatërrim ose humbje në shkallë të madhe (>50.000€) dhe/ose
Efekt serioz dëmtues për individët (për shembull nga ofrimi i mallrave ose shërbimeve standarde që vijnë nga sjellja korruptive)
Ndikim serioz mjedisor, urban apo në shëndetin publik
Ndikimi më i gjerë në shoqëri
Ndikim në kategori të ndjeshme apo fondeve që ndërlidhen me këto kategori
Motivuar në masë të madhe nga fitimi financiar, politik, ekonomik apo avantazhi tregtar
Dëmi ka të bëjë me dokumente/çështje të rëndësishme madhore (psh, siguria nacionale, buxheti shtetëror etj).

Kategoria – II –

<i>Kategoria 2 (Dëm i mesëm)</i>
Dëm i madh, dëm substancial ose humbje substanciale (15.000-50.000€) dhe/ose
Efekt i konsiderueshëm dëmtues tregtar, biznesor, buxhetor apo tjetër tek individët, institucioni apo organizata
Ndikim i konsiderueshëm mjedisor dhe urban
Keqpërdorim i konsiderueshëm i funksionit të duhur të qeverisjes lokale apo qendrore
Fitimi i një avantazhi të konsiderueshëm tregtar/biznesor
Rrezik për dëm nga kategoria 1

Kategoria – III –

<i>Kategoria 3 (Dëm i ulët)</i>
Dëm i konsiderueshëm ose humbje e konsiderueshme (5000-15.000€) dhe/ose
Ndikim i kufizuar i dëmshëm për individët, mjedisin, qeverinë, biznesin ose shërbimet publike
Fitim i kufizuar financiar
Rrezik për shkaktim të dëmit nga kategoria 2

Kategoria – IV-

<i>Kategoria 4 (Dëm minimal)</i>
Dëm në vlerë të vogël apo maksimum deri në 5000€ dhe/ose
Ndikim minimal i dëmshëm për individët, mjedisin, qeverinë, biznesin ose shërbimet publike
Synim për fitim të kufizuar
Rrezik për shkaktim të dëmit nga kategoria 3

3. Mënyra e shqiptimit të dënimit për personat zyrtar

Udhëzuesi ka përcaktuar në mënyrë specifike këto dy kritere baze, dhe e tera çfarë duhet të përcaktohet është që fillimisht, të konstatohet se në cilin nivel të përgjegjësisë bene pjese personi zyrtar që akuzohet me për veprën penale si dhe të përcaktohet se në cilën kategori të dëmit është i përfshirë. Për tu konstatuar se në cilin nivel të kategorisë së përgjegjësisë bene pjese duhet të plotësohen ato kushte në kuadër të kategorisë së tillë, po ashtu duhet të plotësohen kushtet e dëmit në kuadër të kategorisë së caktuar. Për tu plotësuar kushtet e tilla ato duhet të reflektojnë të provuara në procesin gjyqësor, psh. Fakti se a kishte motiv për përfitim duhet të rezultojë nga rrethanat faktike, apo lartësia e dëmit duhet të rezultojë nga faktet që provohen në procedurë, në këtë kuptim udhëzuesi është ngushtësisht i ndërlidhur me rrethanat që duhet provuar, për të mundësuar zbatimin e tij, çka do të thotë se është tërësisht në kuadër të legjislacionit procedural dhe material, që aplikohet në rastin penal.

Kur përcaktohet kategoria e personit zyrtar dhe kur përcaktohet dëmi, atëherë këto dy kategori pra përgjegjësia dhe dëmi, ndërlidhen në raport me veprën penale që inkriminohen, dhe udhëzuesi ka specifikuar në tersi secilën vepër penale me kategori konkrete, qoftë për formën themelore të veprës apo për format e cilësuar të veprës penale.

Për ta pasur me te qarte se si ndërlidhen kategoritë e demit dhe përgjegjësia ne vijim sqarohet si bëhet matja e dënimit;

Vepra penale e Keqpërdorimit te detyrës zyrtare apo autoritetit, neni 414 paragrafi 1 (forma themelore).⁴³⁹

Neni	Përgjegjësia			
	Dëmi	Kategoria I (A)	Kategoria II (B)	Kategoria III (C)
	Kategoria 4, Minimal.	Shtrirja e dënimit	Shtrirja e dënimit	Shtrirja e dënimit
Paragrafi 1	Deri ne 1.000 euro	3- 5 vite	2- 3 vite	1-2 vite
(1–8 vite)	1.000 – 2.500 euro	5-7 vite	3-5 vite	2-3 vite
	2.500 – 5.000 euro	7-8 vite	5- 7 vite	3-5 vite

Ne këtë formë ndërlidhen demit i shkaktuar dhe po ashtu kategoria e përgjegjësise se personit zyrtare, çka do te thote se fillimisht jepen ne mënyrë narrative kriteret për përcaktimin e nivelit te përgjegjësise se personit zyrtare, pastaj kriteret për kategorizimin e demit, dhe po ashtu demit serish ri shkallëzohet kur bie brenda normës qe inkriminon veprën penale ne mënyrë qe te mos ketë një tretshmëri ne shqiptimin e dënimit, p.sh. Shihet qarte se lartësia e demit deri ne 5.000 euro ka pësuar tri shkallëzime, kjo për shkak se nuk është rrethana e njëjtë sikurse qe është shkaktuar demit ne lartësi 5.000 euro e po ashtu kur demit shkaktohet ne lartësi prej 1.000 euro, ndërsa po ashtu nuk është niveli i përgjegjësise se njëjtë sikurse një zyrtar qe nuk ka një nivel te tille te pushtetit te përqendruara si kompetenca njësoj sikurse një zyrtare ne kuadër te administratës shtetërore te trajtohet njësoj. Me ne detaje shih udhëzuesin ne mënyrë specifike trajton politiken ndëshkimore për veprat penale kundër detyrës zyrtare.

⁴³⁹ Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, udhëzues i veçantë faqe 60, Qershor 2021, Gjykata Supreme.

PJESA E TRETË

SISTEMI I DREJTËSISË PËR TË MITUR

1. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME

Sistemi i drejtësisë për të mitur është pjesë integrale e sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës dhe se i njëjti garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës⁴⁴⁰ si dhe me legjislacionin vendor të drejtësisë penale. Përveç këtyre, sistemi i drejtësisë për të mitur garantohet edhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, standarde këto të përfshira në akte juridike ndërkombëtare dhe të zbatueshme drejtpërdrejtë në sistemin e drejtësisë në shtetin tonë⁴⁴¹ si me: Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese, Konventën për të Drejtat e Fëmijës, Konventën për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Racor.

Republika e Kosovës ka krijuar një bazë të gjerë juridike me përfshirjen e instrumenteve juridike ndërkombëtare në legjislacionin vendor dhe me këtë mund të themi se kemi një mbulim të plotë të çështjeve të fëmijëve sipas standardeve më të mira ndërkombëtare për respektimin dhe sigurimin e të drejtave të fëmijëve.

Për shkak të specifikave që ka sistemi i drejtësisë për të mitur, ka një numër të madh pjesëmarrësve (institucioneve) që marrin pjesë në drejtësinë për të mitur, ngase duke u mbështetur në përvojat më të mira ndërkombëtare në trajtimin e të miturit dhe në administrimin e sistemit të drejtësisë për të mitur, pjesëmarrja e gjerë e institucioneve dhe personave të tjerë le për të kuptuar se kur është në pyetje fëmija, atëherë çdokush ka obligim për t'iu përgjigjur kërkesave dhe nevojave që kanë fëmijët, e posaçërisht kur ndaj tyre zhvillohet ndonjë procedurë.

Legjislacioni bazë i sistemit të drejtësisë për të mitur (*Ligj Organik*) është Kodi i Drejtësisë për të Mitur, i cili është nxjerr nga Kuvendi i Kosovës më 14 shtator 2018 si: Kodi Nr.06/L-006 I Drejtësisë për të Mitur dhe i njëjti është shpallur me dekretin e Presidentit Nr. DL-038-2018, të datës 04.10.2018 dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Viti 2018/nr. 17, me datën 18 tetor 2018, e i cili Kod ka hyrë në fuqi në muajin maj të vitit 2019.

⁴⁴⁰ Neni 50 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës [Të drejtat e Fëmijës];

⁴⁴¹ Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

KDM përmban dispozita të natyrës materiale, procedurale, të masave dhe dënimeve të zbatueshme ndaj të miturve, procedurën e ndërmjetësimit për të mitur, si dhe mbrojtjen e personave të mitur dhe fëmijëve të cilët janë viktimë dhe të dëmtuar.

KDM ka gjashtë pjesë në 141 nene me këtë përmbajtje :

- në pjesën e parë të këtij kodi janë parimet udhëzuese dhe dispozitat hyrëse nga neni 1 deri në nenin 7,
- në pjesën e dytë të këtij nenet 8-39 është përcaktuar veprimi me të miturin dhe fëmijën, si dhe janë përcaktuar masat, dënimet dhe masat e trajtimit të detyrueshëm me dënimet plotësuese,
- në pjesën e tretë dispozitat prej nenit 40-73 e rregullojnë procedurën ndaj të miturve,
- në pjesën e katërt nenet 74-107 është përcaktuar ekzekutimi i masave dhe dënimeve, pjesa e pestë nga neni 108-134 përfshin mbrojtjen e fëmijës si viktimë në procedurën penale dhe
- pjesa e gjashtë përfshin dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

KDM rregullon veprimin ndaj të miturit si kryes i veprës penale, fëmijëve dhe të miturve si pjesëmarrës në procedurë, organeve të cilat zbatojnë procedurën penale dhe ekzekutimin e masave dhe dënimeve ndaj kryesit të mitur të veprës penale, si dhe mbrojtjen e personave të mitur dhe fëmijëve të cilët janë viktimë dhe të dëmtuar nga vepra penale.

Për më tepër, ky Kod parasheh garantimin dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të tyre parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare në sistemin e drejtësisë, duke u bazuar në: respektimin e drejtave të njeriut dhe të lirive themelore; ndalimin e diskriminimit në çfarëdo baze; prezumimin e pafajësisë; respektimin e drejtave të fëmijës që në mënyrë të lirë të shprehin mendimin e vet; evitimin e kufizimit të lirisë personale të miturve në masë më të madhe të mundshme; nxitjen dhe dhënien e përparësisë zbatimit të masave edukuese kundrejt dënimit me burg; promovimit dhe respektimit të qasjes miqësore si dhe të mënyrës së veprimit ndaj të miturve duke i dhënë përparësi edukimit dhe risocializimit; dhënien e rëndësisë së veçantë aftësimit dhe specializimit nëpërmjet qasjes multidisiplinore dhe bashkëpunimit institucional.

Parimet e procedurës ndaj të miturve

Parimet që e përshkojnë procedurën ndaj të miturve janë të shumta, por disa nga më të rëndësishmet, janë:

1. Interesi më i mirë duhet të jetë konsiderata mbizotëruese gjatë gjithë procedurës dhe veprimeve që ndërmerren ndaj fëmijës dhe të miturit.
2. Fëmijës që merr pjesë në procedurë penale i ofrohet mundësia që të shprehet lirisht.

3. Çdo i mitur i privuar lirie trajtohet me humanizëm për hir të dinjitetit të personalitetit të tij njerëzor dhe me atë rast merren parasysh nevojat personale të moshës së tij.
4. Çdo i mitur i privuar lirie ka të drejtë në ndihmë të menjëhershme ligjore dhe ndihmë tjetër adekuate, si dhe të drejtën për të kundërshtuar ligjshmërinë e privimit të tij nga liria pranë një gjykate të pavarur dhe të paanshme, si dhe në procedurë të menjëhershme.
5. Për t'iu shmangur lëndimit për shkak të publicitetit të tepruar ose etiketimeve, e drejta e fëmijës për privatësi respektohet në të gjitha fazat. Në parim, nuk publikohet asnjë informacion që shpie në identifikimin e fëmijës në çfarëdo statusi që e ka.
6. Procedura ndaj të miturit dhe procedura në të cilën i mituri është i dëmtuar me vepër penale është urgjente. Organet të cilat marrin pjesë në procedurë ndaj të miturit, si dhe organet tjera dhe institucionet nga të cilat kërkohen njoftime, raporte ose mendime, janë të detyruar të veprojnë në mënyrë urgjente.
7. Mosveprimi në mënyrë urgjente, si dhe mosrespektimi i afateve të parapara me këtë kod, konsiderohet shkelje disiplinore, në pajtim me dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi.
8. Procedura ndaj fëmijëve dhe të miturve duhet të zhvillohet dhe zbatohet në pajtim me konceptin e qasjes miqësore.

Pra, Kodin e Drejtësisë për të Mitur, duhet kuptuar si një instrument mbrojtës ndaj një fëmije që ka ra ndesh me ligjin dhe fëmijëve të cilët janë viktima dhe të dëmtuar nga vepra penale e jo instrument ndëshkues.

Masat dhe dënimet ndaj të miturve

Sipas nenit 12 paragrafi 1 të KDM, ndaj të miturve mund të shqiptohen këto masa:

- 1) masat e diversitetit dhe
- 2) masat edukative.

Masat e diversitetit, sipas nenit 20 të KDM janë :

1. Pajtimi në mes të kryesit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë edhe kërkim faljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar;
2. Pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij;
3. Kompensimi i dëmit palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjellët ndërmjet të dëmtuarit, të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me situatën financiare të të miturit;
4. Vijimi i rregullt në shkollë;
5. Pranimi i punësimit apo aftësimit në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathtësitë e tij;

6. Kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme në pajtim me aftësinë e kryesit të mitur për kryerjen e punës së tillë. Kjo masë mund të shqiptohet me pëlqimin e të miturit në kohëzgjatje prej dhjetë (10) deri në gjashtëdhjetë (60) orë;
7. Edukimi në rregullat e trafikut;
8. Këshillimi psikologjik;
9. Angazhimi në aktivitete bamirësie
10. Pagesa e një shume të caktuar të të hollave të destinuara për qëllime bamirësie apo në programin për kompensim të viktimave në përputhje me situatën financiare të të miturit;
11. Angazhimi në aktivitete sportive dhe rekreative;
12. Këshillimi ndërmjet familjeve të të miturve;
13. Të përmbahet nga çfarëdo kontakti me individë të caktuar që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri;
14. Të mos vizitohet vende ose mjedise të caktuara që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri;
15. Të përmbahet nga përdorimi i drogës dhe i alkoolit dhe
16. Vërejtja policore.

Masat edukative, sipas nenit 23 të KDM, janë:

1. Qortimi gjyqësor,
2. Masat e mbikëqyrjes së shtuar dhe
3. Masat institucionale.

Qortimi gjyqësor shqiptohet ndaj të miturit, interesat e të cilit më së miri përfillen me një masë afatshkurtër, veçanërisht nëse vepra penale është kryer nga pamaturia apo pakujdesia⁴⁴².

Masat e mbikëqyrjes së shtuar janë:

1. Mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, nga prindi adoptues ose kujdestarit të të miturit,
2. Mbikëqyrja e shtuar nga familja tjetër dhe
3. Mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë.

Masat institucionale edukative janë:

1. Dërgimi i të miturit në institucion edukues korrektues dhe
2. Dërgimi i kryesit të mitur në institucionin e kujdesit të posaçëm⁴⁴³.

Sipas nenit 12 paragrafi 2 të KDM, dënimet që mund të shqiptohen ndaj të miturve janë

- gjoba,
- urdhri për punë në dobi të përgjithshme dhe

⁴⁴² Neni 23 paragrafi 2 i KDM.

⁴⁴³ Neni 23 paragrafët 3 dhe 4 të KDM.

- burgimi për të mitur.

Dënimi nuk mund t'i shqiptohet të miturit i cili ka qenë nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet në kohën e kryerjes së veprës penale.

Kohëzgjatja e çfarëdo mase apo dënimi të shqiptuar duhet të përcaktohet me vendim të gjykatës në pajtim me dispozitat ligjore të KDM.

Kur gjykata cakton dënimin me burgim për të mitur deri në dy vjet ose masën e dërgimit në institucionin edukativ apo edukativo-korrektues deri në dy vjet, mund të shqiptojë edhe dënimin me kusht në pajtim me dispozitat ligjore të KPRK.

Përveç masës apo dënimin, të miturit mund t'i shqiptohen edhe masat e trajtimit të detyrueshëm dhe dënimet plotësuese, në pajtim me Kapitullin VIII të KDM⁴⁴⁴.

Dënimi me gjobë - Gjykata mund të shqiptojë dënim me gjobë ndaj të miturit nëse i mituri ka mjete për ta paguar gjobën. Me rastin e shqiptimit të dënimin me gjobë, gjykata shqyrton gjendjen financiare të të miturit dhe në veçanti lartësinë e të ardhurave të tij personale, të ardhurat tjera, pasurinë dhe detyrimet. Gjykata nuk e cakton lartësinë e gjobës mbi lartësinë e mjeteve që posedon i mituri.

Dënimi me gjobë nuk mund të jetë më pak se njëzetepesë (25) Euro ose më shumë se pesëmijë (5.000) Euro⁴⁴⁵

Urdhri për punë dobi të përgjithshme - Sipas nenit 32 të KDM, gjykata mund të shqiptojë dënimin urdhër me punë në dobi të përgjithshme. Kur e shqipton urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, gjykata e urdhëron të miturin që të kryejë punë në dobi të përgjithshme pa pagesë për një afat të caktuar prej tridhjetë (30) deri në njëqindnjëzet (120) orëve. Me pajtimin e të miturit, gjykata mund ta zëvendësojë masën e shqiptuar edukative institucionale deri në tre (3) vjet, burgimin e të miturit deri në dy (2) vjet ose gjobën me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Në paragrafin 3 të nenit 32 të KDM, është parashikuar se shërbimi sprovues e përcakton llojin e punës në dobi të përgjithshme të cilën duhet ta kryejë personi i dënuar, cakton organizatën specifike për të cilën personi i dënuar do ta kryejë punën në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës kur do të kryhet puna dhe mbikëqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme. Gjithashtu, shërbimi sprovues përkujdeset që ekzekutimi i punës në dobi të përgjithshme mos të ndikoj në ndërprerjen e shkollimit apo të ndonjë punësimi të rregullt të të miturit. Është me rëndësi të theksohet se puna në dobi të përgjithshme e shqiptuar nga gjykata, duhet të ekzekutohet brenda një (1) viti.

Dënimi me burgim për të mitur - Sipas nenit 33 të KDM, qëllimi i burgimit për të mitur është që të kontribuohet në rehabilitimin, risocializimin dhe në zhvillimin e kryerësit të mitur, veçanërisht në edukimin e të miturit, edukimin e specializuar, aftësitë profesionale dhe në zhvillimin e duhur personal. Përveç kësaj, burgimi për të mitur duhet të ndikojë pozitivisht në

⁴⁴⁴ Neni 12 paragrafët 3, 4, 5 dhe 6 të KDM.

⁴⁴⁵ Neni 31 paragrafët 1 dhe 2 të KDM.

të miturin përmes mbrojtjes, ndihmës dhe mbikëqyrjes për ta parandaluar recidivizmin. Në nenin 34 të KDM, është parashikuar se gjykata mund të shqiptojë dënimin me burgim për të mitur ndaj kryerësit të mitur i cili në kohën e kryerjes së veprës penale i ka mbushë gjashtëmbëdhjetë (16) vjet dhe ka kryer veprë penale të dënueshme me mbi pesë (5) vite burgim, në rastet kur shqiptimi i masës edukative nuk do të ishte adekuate për shkak të peshës së veprës penale, pasojave të saj dhe shkallës së përgjegjësisë penale.

Kohëzgjatja e burgimit për të mitur nuk mund ta kalojë maksimumin e burgimit të paraparë për veprën penale por mund të jetë më i ulët se minimumi i burgimit të paraparë për veprën penale. Në anën tjetër, burgimi për të mitur nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më pak se **gjashtë (6) muaj** as më shumë se **pesë (5) vjet** dhe shqiptohet në muaj dhe vite të plota. Përfundimisht, maksimumi i burgimit për të mitur është **dhjetë (10) vjet** për vepra të rënda penale të dënueshme me burgim të përjetshëm, ose kur i mituri ka kryer së paku dy (2) vepra penale në bashkim, ku secila është e dënueshme me burgim prej më shumë se dhjetë (10) vjet.

KAPITULLI-I-

PARIMET, KOMPETENCA DHE PALET NE PROCEDUREN PENALE

PARIMET E PROCEDURËS PENALE

Procedura penale në veten e saj ka parimet mbi të cilat ndërtohet e të cilat mishërohen brenda dispozitave të kodit të procedurës penale. Ndër parimet të cilat ekzistojnë në procedurën penale janë: Parimi i ndjekjes zyrtare apo parimi i oficialitetit, Parimi i ligjshmërisë, Parimi akuzator, Parimi i gjykimit të drejt dhe në kohë të arsyeshme, Parimi i prezumimit të pafajësisë dhe interpretimit të rrethanave dyshuese në favor të të pandehurit (in Dubio pro Reo), Parimi i se vërtetës materiale, Parimi i kontradiktoritetit, parimi i drejtpërdrejt, parimi i barazisë para ligjit dhe parimi i publicitetit.

Parimet e tilla inkorporohen brenda tërësisë së kodit të procedurës penale për të mundësuar që cilido organ që merret me veprimin e procedimit penal të zbatoj parimet e procedurës penale e që në themel parimet janë garancione procedurale për të akuzuarin në radhë të parë por edhe për palët tjera në procedurën penale që në vetvete e bëjnë vendimin gjyqësor të jetë i pranueshëm për shoqërinë e në anën tjetër organet i bëjnë që me rastin e zbatimit të detyrave të tyre në procedurën penale të kenë parasysh faktin, se duke cenuar parimet që mishërohen në dispozita të Kodit të Procedurës penale, vendimi do të mund të rezultojë me shkelje për pasojë si i tillë juridikisht do të ishte i paqëndrueshëm.

Parimi i oficialitetit – ky parim nënkupton se ndjekja penale duhet të bëhet sipas detyrës zyrtare ⁴⁴⁶. Përkundër se ky parim në kuptimin formal juridik e mvëshë organin shtetëror me kompetencë për të bërë ndjekjen sipas detyrës zyrtare, duhet të kemi parasysh se, në disa rrethana duhet plotësuar edhe disa nën kushte specifike ligjore që të ketë kompetencën e plotë organi shtetëror për ta bërë ndjekjen penale. Nën kushtet e tillë do të nënkuptonin kur Prokurori për të fituar kompetencën e plotë duhet të disponoj me propozimin e të dëmtuarit, pasi që disa vepra specifike për tu ndjekur penalisht nga Prokurori në procedurën penale parashohin si kushte që të jepet propozimi i të dëmtuarit dhe vetëm atëherë parimi i oficialitetit merr formën e plotë në procedurën penale, apo në rrethana kur organi publik jep pëlqimin siç përcaktohet ne dispozita të procedurës penale, kur për veprën e caktuar penale kushti ligjor rezulton se është për të dhënë pëlqimin organi publik dhe kur prokurori e siguron atë pëlqim vetëm atëherë merr kuptimin e plotë parimi i oficialitetit.

Parimi i ligjshmërisë – nënkupton se të gjitha organet që marrin pjesë në procedurën penale duhet që në procedurën penale të zbatojnë dhe respektojnë në tërësi dispozitat ligjore⁴⁴⁷. Ky parim padyshim që është inkorporuar në vetë qëllimin e kodit të procedurës penale. Ky parim është i ndërlidhur edhe me apsketin e kontrollit gjyqësor që gjykata iu bënë veprimeve

⁴⁴⁶ Prof. Dr. Azem Hajdari, Hytje në Sistemin Ligjor ne Kosovë fq.312.

⁴⁴⁷ Prof. Dr. Azem Hajdari, Hytje në Sistemin Ligjor ne Kosovë fq.312.

procedurale, organeve shtetërore siç janë policia dhe prokuroria që kanë autorizime sipas kodit të procedurës penale, për shkak se Kodi ka përcaktuar detyrimisht që si policia edhe prokuroria me rastin e marrjes së veprimeve procedurale ata duhet që ato veprime t'i ndërmarrin në përputhje me dispozitat e Kodit të procedurës penale njëkohësisht veprimet e tillë në procedurën penale i nënshtrohen kontrollit nga ana e gjykatës, qoftë kur palët në procedurë kontestojnë një veprim të tillë apo edhe kur vetë gjykata sipas detyrës zyrtare ka detyrim për të vlerësuar veprimet e tillë se a janë në përputhje me dispozitat ligjore.

Parimi akuzator – nënkupton që procedura penale fillohet vetëm kur ekziston akuza e prokurorit të shtetit⁴⁴⁸. Në këtë kontekst ky parim jep tagrin ligjor që vetëm prokurori mund të akuzoj një të pandehur për veprën penale që pretendohet se ai e ka kryer dhe se gjykata është e kushtëzuar që në procedurën penale ta trajtoj vetëm aktakuzën që është ngritur nga ana e prokurorit të shtetit në të kundërtën gjykata s'ka kompetencë ligjore ta trajtoj një aktakuzë që prokurori nuk e ka ngritur. Përkundër se ky parim mishërohet pastaj edhe për nga përmbajtja në procedurën penale në këtë material nuk do të trajtohen thellësisht aspektet e këtij parimi ku ndërlidhet pastaj e drejta e gjykatës dhe në ?farë mundësie do të mund të shtrohet kjo e drejtë e gjykatës për të bërë ndryshime të aspektit të akuzës qoftë në kuptimin faktik apo edhe në cilësimin juridik.

Parimi i gjykimit te drejt dhe ne kohe te arsyeshme – ky parim është i inkorporuar në nenin 5 të Kodit të procedurës penale⁴⁴⁹, por në kuadër të dispozitave të kodit parimin e tillë e inkorporojnë shpesh herë dispozitatat specifike, siç janë p.sh. Afatet specifike për caktimin e seancave të shqyrtimeve gjyqësore apo fillestare, apo koha kur përcaktohet shpallja e vendimit apo edhe koha kur përcaktohet përpilimi i vendimit të gjitha këto dispozita kanë bazë në nenin 5 të KPP-es, pasi që përcaktojnë kohën e arsyeshme të gjykimit, përkundër se shpesh herë në praktikë mund të ndodh që të kemi shmangie nga dispozitat e tillë për gjykimin në kohë të arsyeshme. Gjykimi i drejt përveç se është parim në Kodin e Procedurës Penale njëkohësisht tashmë njihet edhe si parim ndërkombëtar që ka zënë vend në shumë dokumente të karakterit obligativ ndërkombëtar. Gjykimi i drejt përbëhet nga shumë komponent që inkorporon, pavarësinë dhe paanshmërinë, emërimin e gjyqtareve e deri tek ndarja e rastit, që të gjitha këto konsistojnë në përmbushjen e parimit të gjykimit të drejt.

Parimi i prezumimit të pafajësisë dhe interpretimit të rrethanave dyshuese (in dubio pro reo) – prezumimi i pafajësisë nënkupton se, çdo person i dyshuar apo i akuzuar, konsiderohet i pafajshëm derisa nuk vërtetohet fajësia e tij në procedurën penale me aktgjykim te formës së prerë⁴⁵⁰. Në këtë kontekst, gjykata por edhe policia e prokuroria kanë detyrim që të akuzuarin madje edhe kur fillohet hetimi e edhe kur sigurohen prova për ngritjen e akuzës ta trajtojnë si të pafajshëm. Ky parim e mbron të akuzuarin në procedurën penale gjë që përmes këtij parimi njëkohësisht në vetvete zbatohet edhe parimi i gjykimit të drejt. Në këtë kuptim ky parim madje ngërthen në vete edhe detyrimin e gjykatës që vetëm në raport me provat që shqyrtohen në

⁴⁴⁸ Prof. Dr. Azem Hajdari, Hyrje në Sistemin Ligjor ne Kosovë fq.312.

⁴⁴⁹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 5, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁴⁵⁰ Prof. Dr. Azem Hajdari, Hyrje në Sistemin Ligjor ne Kosovë fq.312.

gjykim duhet të vlerësohet fajësia e të akuzuarit dhe në asnjë mënyrë gjykata nuk mund të krijojë bindje për fajësinë e të akuzuarit nga informacionet e tjera që mund të jenë jashtë procedurës penale. Ndërsa interpretimi i rrethanave në favor të të akuzuarit kur ato mbesin si rrethana me dyshim, gjithsesi ka si qëllim që të akuzuarit në asnjë mënyrë të mos i rëndohet pozita procedurale dhe që fajësia të mbështetet në rrethana që nuk janë provuar mjaftueshëm por që si të tillë mbesin me dyshime, në këtë kontekst ky parim pra – in dubio pro reo⁴⁵¹ e bënë detyrimin e organeve të ndjekjes që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për sigurimin e provave që rrethanat të mos mbesin në nivel të dyshimit në të kundërtën rrethanat e tillë do të interpretohen në favor të të akuzuarit.

Parimi i të vërtetës materiale – ky parim nënkupton që zgjidhja e çështjes penale duhet që të vërtetohet të gjitha faktet relevante në çështjen penale që zhvillohet procedura penale⁴⁵². Se çfarë nënkupton fakte relevant kjo rezulton nga secili rast konkret që duhet trajtuar në çështjen penale që është shtruar për tu proceduar. Faktet duhet të vërtetohen nga provat që sigurohen sipas dispozitave të procedurës penale që nënkupton se faktet mund të provohen vetëm mbi bazën e provave të ligjshme në procedurën penale. Gjykata, prokurori i shtetit dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm.⁴⁵³

Parimi i kontradiktoritetit – kjo nënkupton që palët në procedurën penale për të ardhur deri tek qëllimi i të vërtetës materiale kanë të drejta të barabarta që të shfaqin kundërshtitë e tyre në raport me qëndrimet e palës tjetër në procedurën penale, duke shfaqur si qëndrimet për një çështje specifike në procedurën penale apo edhe duke shfaqur qëndrimet si tërësi për çështjen penale që është në procedim⁴⁵⁴. Në këtë kontekst qëndrimet e palëve shfaqen bazuar në tezat që ngrisin për çështjen që është në gjykim, duke pasur mbështetje teza e tillë në raport me interpretimin e, dispozitave, provave apo edhe fakteve, e në këtë mënyrë arrijnë që edhe gjykatën ta ndihmojnë që të vijë deri te e vërteta e plotë materialeve në procedurën gjyqësorë.

Parimi i drejtpërdrejt – ky parim nënkupton se të gjitha faktet që mund të shërbejnë për të vërtetuar dhe marr vendimin gjyqësor duhet të jenë objekte shqyrtimi në shqyrtim gjyqësor⁴⁵⁵, njëkohësisht ky parim konsiston edhe në shqyrtimin e drejtpërdrejt të të gjitha provave që mund të shërbejnë për marrjen e vendimit gjyqësor ato duhet të shqyrtohen drejtpërdrejt në shqyrtim gjyqësor. Ky parim ka një zbatim të lart në shqyrtimin gjyqësor pranë gjykatës së shkallës së parë, ndërsa në gjykatat ku vendoset sipas mjeteve juridike, përderisa çështja vendoset në seancë kolegji parimi i tillë ka një zbatueshmëri në nivel më të ulët, ndërsa kur hapet shqyrtimi gjyqësor pranë gjykatës që vendos sipas mjetit juridik parimi i drejtpërdrejt zbatohet po ashtu pjesërisht vetëm në raport me provat që konsiderohet se duhet rishqyrtuar apo marr ndonjë provë të re.

⁴⁵¹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 3, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁴⁵² Prof. Dr. Azem Hajdari, Hyrje në Sistemin Ligjor në Kosovë fq.313.

⁴⁵³ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 7, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁴⁵⁴ Prof. Dr. Azem Hajdari, Hyrje në Sistemin Ligjor në Kosovë fq.313

⁴⁵⁵ Prof. Dr. Azem Hajdari, Hyrje në Sistemin Ligjor në Kosovë fq.313

Parimi i barazisë para ligjit – ky parim ka dy funksione për sa i përket procedurës penale. Ky parim konsiston në detyrimin e organeve që secili qytetar në procedurën penale ta trajtojnë në mënyrë të barabartë kjo nënkupton se cilitdo qytetar të drejtat e përcaktuara ligjore iu njohën dhe i gëzojnë në procedurën penale⁴⁵⁶. Ndërsa në kuptimin e palëve që marrin pjesë drejtpërdrejt në procedurën penale kjo ngërthehet me të drejtat e barabarta të palëve në procedurë⁴⁵⁷, çka konsiston se palëve në procedurën penale iu njihet e drejta që të bëjnë propozimet për provat në mënyrë të barabarte qoftë, prokurorit, të akuzuarit apo mbrojtësit të tij apo viktimës dhe përfaqësuesit të viktimës, këta të gjithë kanë të drejte të barabarte në procedurën penale për të parashtruar kërkesat për çështjet penale dhe për të paraqitur propozime për marrjen e provave të caktuara.

Parimi i publicitetit – ky parim nënkupton që shqyrtimi gjyqësor dhe çështja penale duhet të shqyrtohen në prezencën e publikut⁴⁵⁸, çka nënkupton se publikut i jepet mundësia që drejtpërdrejt të marr pjesë në seancat gjyqësore për të dëgjuar në tersi çështjet që shtrihen për tu zgjidhur në procedurën penale para gjykatës. Parimi i tillë ka qëllimin që publiku të vlerësojë nga këndvështrimi i vet procesin e ndjekur nga gjykata e po ashtu mund të shërbejë si mënyrë e besueshmërisë në organet gjyqësore por jo vetëm. Parimi i publicitetit gjyqësor nënkupton po ashtu edhe mundësinë e pjesëmarrjes së shoqërisë në procedurë gjyqësore, njëkohësisht parimi i tillë për shkak të përcaktuara sipas ligjit i njëjti mund edhe të mos aplikohet. Megjithatë procedura të caktuara penale siç është procedura për të mitur gjithnjë përjashtojnë parimin e publicitetit gjyqësor, apo procedurat penale që zhvillohen për veprat konkrete penale siç janë veprat kundër integritetit seksual me rastin e shqyrtimit të tyre përjashtohet parimi i publicitetit. Ndërsa po ashtu gjykata kur gjen shkaqe të arsyeshme parimin e publicitetit mund ta kufizojë vetëm në marrjen e ndonjë veprimi procedural.

I. Kompetenca

Kompetenca nënkupton autorizim e organit për të ndërmarr veprimin e caktuar procedural, në të kundërtën do të konsiderohej se veprimi i ndërmarr nuk mund të jete i vlefshëm juridikisht për shkak të mungesës së autorizimit ligjor të organit shtetëror.

Kodi i procedurës penale ka përcaktuar kompetencën; Territoriale, Lëndore dhe Funksionale.

Kompetenca Territoriale – nënkupton kompetencën e territorit të cilën mbulon gjykata e caktuar. Kodi përcakton se kompetenca territoriale në parim është e gjykatës brenda territorit të se cilës është kryer vepra penale ose është tentuar të kryhet vepra penale apo në territorin e se cilës është shkaktuar pasoja⁴⁵⁹. Kompetenca territoriale kur kryhet në territorin e gjykatave që ushtrojnë kompetencën apo në kufijtë e territorit atëherë kompetente është gjykata që ka filluar procedurën se pari apo që i është përgjigjur kërkesës së caktuar të prokurorit apo gjykata

⁴⁵⁶ Prof. Dr. Azem Hajdari, Hytje në Sistemin Ligjor në Kosovë fq.313

⁴⁵⁷ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 9, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁴⁵⁸ Prof. Dr. Azem Hajdari, Hytje në Sistemin Ligjor në Kosovë fq.313

⁴⁵⁹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 29, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

ku me pare është dorëzuar kërkesa. Ne këtë kontekst dispozitat ligjore synojnë që të përjashtojnë çfarëdo mundësie të konfliktit të kompetencës ndërmjet gjykatave.

Kodi i procedure penale njih dy rrethane të kompetencës territoriale ekskluzive, një rrethane është kur vepra penale kryhet në aeroplan atëherë me kompetencë territoriale ekskluzive është Gjykata Themelore në Prishtinë. Po ashtu kodi ka përcaktuar se në raste të krijimit të ndonjë departamenti për trajtimin e veprave penale të caktuara atëherë është kompetent për ato vepra që të gjykojë departamenti që është krijuar. Në rastin konkret aktualisht me kompetencë territoriale ekskluzive është departamenti Special që është krijuar në kuadër të gjykatës Themelore në Prishtinë.

Po ashtu Kodi ka përcaktuar se kur vepra penale kryhet përmes mediave atëherë kompetente është gjykata në vendin ku media është shtypur, ndërsa kur nuk dihet vendi i shtypjes së medias atëherë kompetente mbetet gjykata në vendin ku shpërndahet informacioni i tillë. Ndërsa në raste se sipas ligjit përgjegjësi ka autori që ka publikuar informacionin atëherë është kompetente gjykata ku autori ka vendbanimin ose vendqëndrimin. Po ashtu përshtatshmërisht zbatohet kompetenca edhe kur është kryer vepra përmes radio apo televizionit apo mënyrë tjetër e publikimit të informacionit.

Kompetenca territoriale ka si kriter dytësor të përcaktimit të kompetencës në raste se nuk mund të dihet territori se ku është kryer vepra penale apo ku është tentuar apo se ku është shkaktuar pasoja, apo në qofte se vepra nuk është kryer në territorin e Kosovës, atëherë kompetente është gjykata në territorin ku i dyshuari ka vendbanimin apo vendqëndrimin. Kur kompetenca caktohet sipas vendbanimit apo vendqëndrimit atëherë edhe nëse është kuptuar territori ku është kryer vepra penale sërish kompetente mbetet gjykata që e ka filluar procedurën sipas kriterit të vendbanimit apo vendqëndrimit të të dyshuarit.

Po ashtu kur nuk dihet territori ku është kryer vepra penale dhe kur nuk dihet as vendbanimi apo vendqëndrimi i të dyshuarit, kompetente është gjykata ku i dyshuari është arrestuar.

Kompetenca territoriale për gjykimin e veprave ndërkufitare – në rrethanat kur një i dyshuar kryen veprë penale në Kosovës dhe jashtë sajë atëherë kompetente është gjykata për veprën penale që është kryer në Kosovë⁴⁶⁰.

Kompetenca territoriale e urdhëruar – kur nuk mund të kuptohet saktësisht se cila gjykate ka kompetencë për gjykimin e një çështje penale, atëherë Gjykata Supreme e urdhëron kompetencën territoriale të njëres nga gjykatat që çështjen penale ta trajtoj.

Kompetenca lëndore – është e ndare brenda nivelit të gjykatës në raport me departamentet që funksionojnë në gjykate⁴⁶¹. Dispozitat ligjore përcaktojnë dy akte ligjore për kompetencën lëndore të gjykatës. Kodi për Procedurën Penale ka të kategorizuara veprat penale që bien në

⁴⁶⁰ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 33, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁴⁶¹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 22,23,24,25, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

kuadër te kompetencës lëndore për Departamentin e Krimeve të Renda, por edhe ligji për Gjykatat përcakton në dispozitat e tij kompetencën lëndore të departamenteve brenda gjykatave themelore, por po ashtu kjo shtrirje e kompetencës lëndore behet edhe në nivel të gjykatës së Apelit si gjykate e shkalles së dytë. Po ashtu kompetenca lëndore për Departamentin Special është e përcaktuar vetëm në kuadër të dispozitave ligjore të ligjit për gjykatat.

Kompetenca funksionale – ka të bëjë me kompetencën e gjyqtarit për të vendosur, pra varësisht nga kompetenca lëndore njëkohësisht përcaktohet edhe kompetenca funksionale⁴⁶². Në departamentin për Krime të Renda vendoset në trup gjykues që përbërja është prej tre gjyqtareve që duhet të jenë nga Departamenti për Krime të Renda. Në departamentin e përgjithshëm vendoset nga gjyqtari i vetëm që duhet të jetë gjyqtarë nga departamenti i Përgjithshëm. Përkundër se dispozitat ligjore në mënyrë të qartë përcaktojnë se si caktohen gjyqtaret në kuadër të departamenteve, kur ndonjë gjyqtarë nga departamenti i përgjithshëm marr pjesë në kuadër të trupit gjykues të departamentit për krime të renda, kjo konsiderohet si delegim i gjyqtarit për çështjen e caktuar, andaj në këtë kontekst i takon Kryetarit të Gjykatës që të caktoj gjyqtaret brenda Departamenteve dhe kurdo që një gjyqtarë e cakton me vendim për të marr pjesë në trupa gjykues kjo konsiderohet si delegim për të marr pjesë në gjykimin e një çështje konkrete penale.

Delegimi i Kompetencës dhe Zgjidhja e Konfliktit të Kompetencës – delegimi i kompetencës nënkupton bartjen e çështjes penale në kompetence territoriale të një gjykate tjetër. Përkundër se Kompetenca territoriale asnjëherë delegimi nuk mund të behet për sa i përket kompetencës lëndore në kuptim të përbërjes së trupit gjykues për veprat që janë kompetent për të gjykuar. Ndërsa Konflikti i kompetencës shfaqet qoftë kur dy gjykata pretendojnë se janë me kompetencë territoriale e që në teori kjo kuptohet si konflikti pozitiv i kompetencës, apo edhe kur asnjëra nga gjykata pretendojnë se nuk kanë kompetence territoriale për ta trajtuar çështjen penale, në teori ky lloj i konfliktit të kompetencës konsiderohet si konflikt negativ i kompetencës.

Kodi ka përcaktuar se Gjykata kur konsideron se nuk ka kompetence territoriale atëherë, duhet të nxjerr aktvendim për in kompetencë dhe pastaj kur vendimi merr formën e prerë, çështjen penale ia kalon gjykatës me kompetence territoriale.

Kur për shkaqe faktike apo juridike nuk mund të trajtohet çështja penale brenda gjykatës me kompetence territoriale atëherë Kryetari i Gjykatës mund ta delegoj çështjen e tillë penale në kuadër të ndonjë dege të gjykatës themelore për ta trajtuar çështjen penale. Megjithatë në raste se çështja penale nuk mund të delegohet në ndonjë degë të gjykatës me kompetencë territoriale dhe kur për shkaqe faktike apo juridike nuk mund të trajtohet çështja penale, atëherë Kryetari i gjykatës i drejtohet cilësdo gjykate Themelore për ta pranuar trajtimin e çështjes penale. Këtu shfaqet një lloj delegimi i kompetencës sipas marrëveshjes së organeve gjyqësore. Në raste se nuk pranon asnjëra nga gjykatat atëherë brenda 10 ditëve, duhet të njoftohet Gjykata e Apelit,

⁴⁶² Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 22, 25 paragrafi 2 dhe 3, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

dhe Gjykata e Apelit me vendim cakton një gjykatë me kompetence për ta trajtuar çështjen penale⁴⁶³.

Para se te merret aktvendimi për konfliktin e kompetencës duhet te merret mendimi i prokurorit qe vepron pranë asaj gjykate, mendimi i te dëmtuarit, mendimi i te pandehurit apo mbrojtësit te tije. Kundër vendimit me te cilin është caktuar kompetenca nuk është e lejuar ankesa.

Një rrethanë qe duhet te kihet parasysh është se Kodi nuk lejon gjykatën qe te shpallet si jo kompetente për kompetencën territoriale kur aktakuza merr formën e prere. Përkundër se Kodi nuk ka ndonjë dispozite qe kur konsiderohet se aktakuza merr formën e prere kjo duhet kuptuar nga rrethanat se aktakuza merr formën e prerë ne momentin kur çështja penale mund te kaloj ne shqyrtim gjyqësor.

II Palët ne Procedurën penale

Kodi ka përcaktuar se palë ne procedurën penale është Prokurori i shtetit, I pandehuri dhe i dëmtuari. Përkundër cilësisë se palës kodi po ashtu ka përcaktuar se, I pandehuri nuk konsiderohet pale, për veprën penale “Deklarimet e rreme”⁴⁶⁴. Por njëkohësisht neni 218 i Kodit ka përcaktuar një kushte ndaj te dëmtuarit, se kur mund te kualifikohet si pale ne procedurën penale. Kjo dispozite e përcakton shprehimisht detyrimin e gjykatës qe i dëmtuari nuk konsiderohet pale kur nuk ka paraqitur deklaratën e dëmit, andaj ne këtë kuptim i dëmtuari kualifikohet si pale ne procedure vetëm kur paraqet deklaratën e dëmit. Ndërsa dispozitat ligjore po ashtu njohin Mbrojtësin si akter brenda procedurës penale, megjithatë ai nuk kualifikohet si pale ne procedurën penale por ai ka te drejtën e përfaqësimit te palës, qe nënkupton se te drejtat qe do ti ushtronte pala ne procedurën penale përmes te drejtës se përfaqësimit i ushtron mbrojtësi ne procedure.

a). *Prokurori i shtetit* – Prokuroria është e ndërtuara bazuar ne ligjin për Prokurorin e Shtetit⁴⁶⁵. Ne kuadër te prokurorisë ekziston Prokurori i shtetit, Prokuroria e Apelit, Prokuroria Speciale, dhe Prokurorit Themelore. Prokurori pranë prokurorisë Themelore vepron pranë territorit te caktuar qe mbulon gjykata themelore, ne kuadër te degëve te asaj gjykate dhe ne kuadër te departamenteve përkatëse te asaj gjykate. Prokuroria Speciale ka kompetence territoriale ne nivel vendi dhe te gjitha çështjet penale ka detyrim për ti përfaqësuar pranë Departamentit Special te Gjykatës Themelore ne Prishtine. Prokuroria e Apelit vepron pranë gjykatës se Apelit qe mbulon tere territorin e vendit. Ndërsa prokuroria e Shtetit vepron pranë gjykatës Supreme te Kosovës për çështjet qe shqyrton Gjykata Supreme e Kosovës.

Prokurori si pale ne Procedurën penale ka autorizime ligjore qe karakterizohen ekskluzivisht me ndjekjen penale te te pandehurve, ne këtë kontekst ai, ndërmer veprime për zbulimin e

⁴⁶³ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 37 dhe 38, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁴⁶⁴ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 19 paragrafi 1 nenparagrafi 15, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁴⁶⁵ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 46, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

veprave penale, mbledhjen e provave ne drejtim te veprës penale dhe ne drejtim te te pandehurit për te saktësuar se kush është kryerës i veprës penale, për te siguruar provat prokurori fillon procedurën e hetimit kur vlerëson se ka dyshim te arsyeshëm për veprën penale, po ashtu prokurori ngrit aktakuzën dhe e përfaqëson aktakuzën pranë gjykatës me kompetence territoriale dhe lëndore, ai po ashtu parashtron mjetet juridike për te vendosur gjykata qe është kompetente për shqyrtimin e mjeteve juridike. Pra prokurori duke qenë pale ne procedurën penale ai njëkohësisht detyrohet qe te respektoj me përpikëri dispozitat ligjore e njëkohësisht qe te aplikoj çdo dispozitë për te pasur ndjekje efektive te të pandehurve ne procedurën penale.

b) *I pandehuri* – si pale ne procedurën penale është subjekti qe ka filluar apo zhvillohet procedura penale⁴⁶⁶. Përkundër se ka një fillim apo zhvillim te procedurës penale kodi ka përcaktuar nje mori te drejtash ndaj te pandehurit varësisht ne cilën faze te procedurës penale, përkundër se disa te drejta themelore qe konsiderohen si minimumi i te drejtave ati i njihen gjate gjitha fazave te procedurës penale. Te pandehurit i njihet e drejta për tu informuar ne çdo faze te procedurës penale për akuzën qe ai dyshohet (duhet pasur parasysh se i pandehuri shpesh here merret si i dyshuar ne polici por qe ne atë faze nuk ka ndonjë akuze formale, prandaj kuptimi i njoftimit me akuzën ka te beje me rrethanat faktike qe ati i vihen ne barre si i dyshuar për thelbin e rrethanave qe dyshohet), ai ka te drejte te propozoj marrjen e provave për mbrojtjen e tij, duhet te informohet për te drejtën e tij qe te mund te hesht dhe te mos përgjigjet ne raport me veprën qe i vihet ne barre apo edhe te hesht nëse e vene veten apo te afërmit para ndonjë dëmi apo turpit te rende, te drejtën se ai mund te angazhoj mbrojtës ne procedurën penale e po ashtu te drejtën se nëse nuk ka mundësi për angazhimin e mbrojtësit nëse kualifikohet sipas kushteve ligjore atëherë mbrojtjen do ta gëzoj me shpenzime publike, por po ashtu edhe te drejtën dhe detyrimin e angazhimit te mbrojtjes kur mbrojtja është e detyruar. Ndërsa i pandehuri po ashtu gëzon te drejta te patjetërsueshme ne çdo faze te procedurës, se nuk mund te ndikohet apo te vihet ne gjendjen e tillë qe do te mund te ndikohet me rastin e marrjes ne pyetje përmes, drogës, hipnozës, keqtrajtimit, lodhjes, ndërhyrjes fizike apo formave te palejuara me ligj, qe ti premtohet për ndonjë përfitim qe nuk lejohet sipas ligjit, ti dobësohet kujtesa apo aftësia për te kujtuar. I pandehuri po ashtu ka te drejte qe te deklarohet, te beje propozime për marrjen ne pyetje te parashtror pyetje, te propozoj prova nga ai, te ushtroj mjetet juridike ndaj vendimeve gjyqësore apo kundërshtime ndaj vendimeve te prokurorit.

c) *I dëmtuari* – i dëmtuar ne procedurën penale është çdo person qe me veprën penale i është cenuar çfarëdo e drejte personale apo pasurore apo qe i është rrezikuar⁴⁶⁷. Ne këtë kuptim i dëmtuar mund te jetë edhe personi qe vetëm i është rrezikuar një e drejtë e tillë, e këtu kryesisht rreziku shkaktohet te veprat penale me rrezikshmëri abstrakte. I dëmtuari ne procedurën penale ka te drejtë qe, te trajtohet me respekt dhe dinjitet nga organet e ndjekjes, te informohet se ai konsiderohet si pale e dëmtuar me veprën penale, po ashtu ai ka te drejte qe te njoftohet se mund te paraqes deklaratën e dëmit dhe te kërkoj kompensimin e dëmit, kur vepra penale ndiqet sipas propozimit ai njoftohet se mund te jap propozimin për ndjekje penale. Po ashtu i dëmtuari

⁴⁶⁶ Prof. Dr. Azem Hajdari, Hytje në Sistemin Ligjor ne Kosovë fq.320

⁴⁶⁷ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 19 paragrafi 1 nënparagrafi 7, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

ka te drejte qe te kërkoj nga prokurori marrjen e provave te caktuara, ndërsa ne shqyrtim te propozoj prova, te propozoj dëshmitar, te shtroj pyetje dhe te kërkoj sqarime. I dëmtuari ka gjithashtu te drejte qe te angazhoj mbrojtës e ne raste se nuk angazhon mbrojtës ai njoftohet se ka te drejte qe mbrojtësi i viktimave ta përfaqësoj ne procedurën penale, por mund te përfaqësohet edhe vet. I dëmtuari po ashtu ka te drejte qe te kërkoj formalisht apo jo formalisht nga prokurori qe i njëjti te kërkoj vazhdimin e paraburgimit. I dëmtuari ka te drejte shikimin e shkresave te lendes dhe nëse nga Prokurori i mohohet kjo e drejte atëherë ai mund ta ankimoj vendimin e prokurorit te gjyqtari i procedurës paraprake.

d). *Mbrojtësi* – ne procedurën penale nuk konsiderohet pale, mirëpo mbrojtësi me rastin e angazhimit ka te gjitha te drejtat procedurale qe ka edhe vet i pandehuri përveç ndonjë te drejtë qe i rezervohet te pandehurit sipas dispozitave te kodit te procedurës penale. Më konkretisht mbrojtësi ndihmon te pandehurin ne procedurën penale me njohurit e tij profesionale te akseptit penal dhe procedural, për te mbrojtur pretendimet e te pandehurit ne procedure por njëkohësisht për te ruajtur çdo here qe ne procedure te mos i cenohet ndonjë e drejte ligjore e te pandehurit⁴⁶⁸. Ai ka te drejte qe te këtë komunikim te lirshëm me te pandehurin e po ashtu ka te drejte qe te njoftohet me kohe për veprimet procedurale qe do te ndërmerren për te marre pjese ne ato veprime, për ti marr dhe shikuar provat dhe shkresat e çështjes penale.

Format e angazhimit te mbrojtësit – Kodi njih tri forma te angazhimit te mbrojtësit, a). Përmes autorizimit qe e autorizon vet i pandehuri apo ndonjë i aferim i tij për ta mbrojtur ne procedurën penale qe ka filluar hetimi apo edhe gjatë tërë rrjedhës se procedurës penale, b). Mbrojtësi kur mbrojtja është e detyrueshme, dhe mbrojtja e detyrueshme është e parapare ne këto raste: 1. kur i pandehuri merret në pyetje për herë të parë dhe kur është, memec, shurdh, i verbër ose ka shenja të çrregullimeve apo paaftësisë mendore dhe kështu është i paaftë që të mbrohet vetë me sukses; 2. gjatë seancës për caktimin e paraburgimit dhe gjatë kohës derisa ai gjendet në paraburgim; 3. Kur është ngritur e aktakuzës për vepër penale të dënueshme me të paktën dhjetë vjet burgim (këtu nuk duhet kuptuar minimumin e dënimit 10 vite burgim); 4. në procedurë sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike kur i pandehuri është memec, shurdh ose shpreh shenja të çrregullimit apo të paaftësisë mendore ose është shqiptuar dënimi me burgim të përjetshëm; dhe 5. në të gjitha rastet kur i pandehuri kërkon të hyjë në marrëveshje për pranimin e fajësisë për vepër penale për të cilën parashihet dënim me së paku një (1) vit burgim, i pandehuri duhet të përfaqësohet nga mbrojtësi. Ne raste te mos angazhimit te mbrojtjes kur mbrojtja është e detyruara nga ana e vet te pandehurit atëherë organi qe zhvillon procedurën duhet te angazhoj mbrojtësin sipas detyrës zyrtare. Mos angazhimi i mbrojtësit kur mbrojtja është e detyruara, mund te rrezikoj ligjshmërinë e provave ne procedurën penale, si dhe, c). Mbrojtësi me shpenzime publike, e angazhimi sipas kësaj baze ligjore është se i pandehuri duhet ti plotësoj disa kushte ligjore për te pasur mundësi qe te përfitoj angazhimin e mbrojtësit me shpenzime publike. Mbrojtësi me shpenzime publike angazhohet ne dy situata,

⁴⁶⁸ Prof. Dr. Azem Hajdari, Hyrje në Sistemin Ligjor ne Kosovë fq.321

1. Kur nuk ka rrethana që mbrojtja është e detyruara dhe kur durueshmëria për veprën ndaj të pandehurit është me burgim deri në 8 vite, 2. Kur e kërkojnë interesat e drejtësisë për shkak të dënueshmërisë së paraparë për veprën penale dhe i pandehuri nuk ka mjete për angazhimin e mbrojtësit⁴⁶⁹.

- **Kualifikimet e angazhimit si mbrojtës në procedurë** - Mbrojtësi në procedurën penale mund të jetë avokati që është i regjistruara pranë Odes së Avokateve në Kosovë⁴⁷⁰. Megjithatë Praktikanti mund ta zëvendësojë avokatin në procedurën penale në rastin konkret për të dhënë ndihmën profesionale të pandehurit, ndërsa kur vepra penale parasheh dënimin deri në 5 vite burgim praktikanti duhet të ketë të përfunduar provimin e Judikaturës për të qenë legjitim në dhënie të ndihmës profesionale ndaj të pandehurit.

- **Heqja e dore nga mbrojtësi dhe angazhimi i me shumë mbrojtësve** – I pandehuri mund të heq dorë në angazhimin e mbrojtësit, përveç kur mbrojtja është e detyruara. I mituri ndaj të cilit ka filluar procedura përgatitore mund të heqë dorë nga mbrojtësi vetëm me pëlqimin e prindit apo kujdestarit. Nuk mund të heq dorë nga mbrojtësi i pandehuri që shfaq shenja të çrregullimit apo paaftësisë psikike. I pandehuri mund të angazhojë deri në tre mbrojtës, por vetëm njëri nga ta do të konsiderohet si mbrojtësi kryesor në kuadër të zhvillimit të seancave në procedurën penale⁴⁷¹.

- **Shkarkimi dhe tërheqja e mbrojtësit** – kur mbrojtësi është caktuar, e kur vet i pandehuri angazhon mbrojtës me autorizim atëherë mbrojtësi i caktuar konsiderohet i shkarkuar. Shkarkimi i mbrojtësit mund të bëhet edhe sipas kërkesës së vet mbrojtësit të caktuar kur ka shkaqe të arsyeshme. Kur i pandehuri konsideron se mbrojtësi nuk e kryen punën e tij atëherë mund të kërkojë shkarkimin e mbrojtësit, e që Kryetari i gjykatës me vendim që shkarkon mbrojtësin mund të caktoj mbrojtësin tjetër. Dallimi ndërmjet shkarkimit të mbrojtësit dhe revokimit të autorizimit është se i pandehuri kurdo dhe për çfarëdo arsye mund ta revokoj autorizimin për angazhimin e mbrojtësit, ndërsa shkarkimi i mbrojtësit që është caktuar kërkohet që të arsyetohet shkaku i shkarkimit. Megjithatë shkarkimi konsiderohet i pa efekt derisa ti caktohet një mbrojtës të pandehurit apo derisa ai të angazhojë mbrojtës tjetër pas shkarkimit. Tërheqja e mbrojtësit po ashtu mund të bëhet kur ai është caktuar, e kjo nënkupton se mbrojtësi kur nuk e pranon detyrën që i është caktuar nga organi që e ka caktuar si mbrojtës. Tërheqja duhet të konsiderohet vetëm kur mbrojtësi e komunikon mospranimin e detyrës si mbrojtës i caktuar, përkundër kësaj tërheqje edhe nëse komunikohet ai është i obliguar që të veprojë derisa që të angazhojë vet i pandehuri një mbrojtës apo derisa ti caktohet mbrojtësi tjetër sipas detyrës zyrtare, në të kundërtën tërheqja është e jo efektive ligjërisht⁴⁷²

⁴⁶⁹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 53,57 dhe 58, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁴⁷⁰ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 54, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁴⁷¹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 53 paragrafi 3 dhe 4, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁴⁷² Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 59 dhe 60, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

KAPITULLI – II –

VEPRIMET PARAPENALE DHE FAZAT E PROCEDURES PENALE

VEPRIMET FILLESTARE TË POLICISË

Para se te fillohet procedura penale sipas kuptimit te dispozitave te procedurës penale, kodi ka përcaktuar se disa veprime qe janë te autorizuar te ndërmerren nga ana e policisë konsiderohen si veprime parapenale, çka nënkupton se nuk hyjnë ne kategorinë e veprimeve hetimore qe autorizohen sipas dispozitave ligjore nga prokurori i shtetit. Përkundër se Policia ka autorizimet e tilla për ti ndërmarr veprimet e tilla parapenale ato detyrimisht duhet te respektojnë me përpikëri dispozitat ligjore si dhe standardet e përcaktuara ne kuadër te Kodit te procedurës penale, çoftë për sa i përket ruajtjes se rendit publik por edhe për sa i përket te drejtave te te dyshuarve qe mund te jene, e te cilat garantohen sipas Kodit te procedurës penale por ato te drejta shpesh here janë edhe standard i kategorisë se te drejtave kushtetuese, andaj policia përkundër se ne këtë fazë mund edhe te mos jene te autorizuar për veprime te caktuara procedurale nga ana e prokurorit, (pasi qe kur prokurori i autorizon njëkohësisht edhe i mbikëqyr zbatimin e atyre veprimeve) ata janë te detyruara qe veprimet e ndërmarra për te cilat kane autorizim ti ndërmarrin ne përputhje me dispozitat ligjore duke u kujdesur qe te mos cenohen te drejtat e te dyshuarit por as te te dëmtuarit dhe njëkohësisht te ruhet rendi publik me rastin e ndërmarrjes se atyre veprimeve.

a). *Veprimet e policisë qe autorizohen sipas kodit* – ne çdo rast kur policia pranon një informatë ndërmerr veprime për te konstatuar se ka dyshim te arsyeshëm për një vepër penale. Me këtë raste policia i ndërmerr veprimet e caktuara ligjore për qellim te zbulimit te kryerësit, ndalimin e kryerësit apo ndalimin për tu arratisur kryerësi i veprës penale, por po ashtu ndërmerr veprime për te siguruar gjurmët e veprës penale dhe ti ruaj ato gjurme si dhe ti gjej sendet e veprës penale qe mund te shërbejnë si prove, por edhe te mbledh informacione qe mund te përdoren ne procedure.

Kodi ka përcaktuar konkretisht autorizimet e policisë e qe ka përcaktuar ne nenin 70, se: a), ka te drejte te mbledh informata nga personat – kjo nënkupton çdo informacion qe mund te dërgoj ne zbulimin e veprës, provave apo kryerësit andaj informatat duhet te jene te rëndësishme për këto tri aspekte; b). ka te drejte te kryej kontroll te përkohshëm te personave, automjeteve dhe valigjeve – këtu duhet te kihet parasysh se policia nuk ka autorizim për te bere kontroll te imtësishëm dhe te vendeve qe nuk kanë dukje vizuale e qe konsiston ne faktin se nuk mund te cenohet privatësia e cilitdo person nga ana e policisë për te ndërmarr veprimin e tillë te kontrollit; c). mund te kufizoj lëvizjen e caktuar ne zona te caktuara kur konsideron se është me nevojë urgjente veprimi i tillë; ç). Ka te drejte qe te ndërmerr veprime për te vërtetuar identitetin e sendeve dhe njerëzve – kjo behet përmes një procedure te veçantë kur do te sqarohet te procedurat e veçanta sipas KPP-ës; d). ka te drejte te organizojë kontrollimin për të

zbuluar vendndodhjen e individit ose të sendit që kërkohet duke dërguar letë rreshtimin – ky veprim i policisë është i mundshëm në disa rrethana siç mund të jete veprimi i kontrollimit kur i dyshuari është hasur në flagrancë dhe në ndjekje e sipër mund edhe të bëhet kontrolli me qëllim për ta ndaluar kryerësin por letë rreshtimi në këtë fazë të procedurës mund të ketë kuptim vetëm për sa i përket letë rreshtimit ndërkombëtare që është lëshuar në kuadër të shteteve tjera dhe organizatave siç mund të jete Interpoli apo Europoli nga se nuk mund të ketë letë rreshtim në këtë fazë të procedurës sipas KPP-ës nëse nuk ka filluar procedura penale përveç në rastet kur letë rreshtimi urdhërohet për shkak se personi që kërkohet është në vuajtje të dënimit apo në masën e trajtimit të detyrueshëm që i kufizohet liria; dh). ka të drejtë që të kontrollojë nën praninë e personit përgjegjës objektet e caktuara dhe lokalet e organeve publike dhe të shqyrtojë dokumentet e caktuara që u përkasin atyre – pranë institucioneve publike policia ka të drejtë që të kontrollojë pasi që kjo nuk cenon ndonjë të drejtë të privatësisë andaj edhe zbatohet ky autorizim ligjor dhe po ashtu ka të drejtë të shqyrtoj ato dokumente; e). ka të drejtë të konfiskojë kontrabandën apo sendet të cilat mund të shërbejnë si prova në procedurë penale përveç kur për konfiskimin e tillë duhet urdhër – në çdo rast policia ka të drejtë që të konfiskojë sendet që janë kontrabandë apo sendet që mund të shërbejnë si prova por jo edhe kur kërkohet urdhër, e urdhër kërkohet kur ka ndërveprim të policisë sipas autorizimit të prokurorisë; ë). ka të drejtë që të sigurojë ekzaminimin fizik të të dëmtuarit përveç kur kërkohet urdhër për ekzaminimin e tillë – policia ka të drejtë që të gjithë dokumentacionin mjekësorë ta shfrytëzojë por edhe ta dërgoj të dëmtuarin në ekzaminim për të konstatuar lëndimet eventuale; f). Ka të drejtë që të sigurojë dhe mbledhë provat si dhe të dërgoj në ekzaminim laboratorik gjurmët e tillë që janë siguruar – gjurmët e tillë nga praktika konsiderohen me qëllim për të vërtetuar si p.sh., nxjerrjen e profilit të ADN-së nga gjurma e gjetur, apo konstatimin e gjurmës së a është gjurmë gjaku apo nuk është gjak, prandaj policia kur i dërgon gjurmët e tillë e bënë me qëllim të vërtetimit të disa fakteve që mund të shërbejnë në vazhdim të procedurës penale; g) policia ka të drejtë që të merr në pyetje të dyshuarit apo dëshmitarët- marrjen në pyetje mund ta bëjë lidhur me veprën dhe rrethanat e veprës, kryerësin apo në raport me ndonjë provë që është gjendur⁴⁷³.

b). **Kallëzimi penal** – në kuptimin formal procedural kallëzimi përbën shkresë me të cilën kallëzohet vepra penale apo edhe kryerësi i veprës penale. Dispozitat e Kodit të procedurës penale nuk përcaktojnë se çka duhet të përbëjë kallëzimi penal, megjithëse nga praktika kallëzimi penal duhet të ketë të paktën këto të dhëna. Parashtruesin e kallëzimit penal, organit që i drejtohet, rrjedhën e fakteve që konsiderohet se ka ndodhur vepra penale, arsyetimin mbi çka mbështeten ato fakte të ngjarjes. Kodi i procedurës penale ka parapare tri kategori të paraqitjes së kallëzimit penal, dhe atë: 1. Kallëzimi penal nga organet publike; 2. Kallëzimi penal nga personat tjerë; 3. Kallëzimi penal nga policia.

- **Kallëzimi penal nga organet publike** – sipas kodit të procedurës penale ky detyrim i organeve publike nuk është në diskrecion por është kërkesë imperative ligjore, pasi që dispozita thekson se organet publike duhet të paraqesin kallëzim penal kur kuptojnë se një veprë penale është

⁴⁷³ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 70, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

kryer. Po ashtu Organet Publike duhet qe te bashkëngjisin kallëzimit penal edhe provat dhe duhet te ndërmarrin veprimet për te ruajtur gjurmët e veprës penale. Kallëzimi i parashtruara nga organet Publike i drejtohet prokurorit, i cili ka mundësi qe te filloj hetimet kur konsideron se ka dyshim te arsyeshëm, apo qe te kërkoj mbledhjen e te dhënave shtesë për veprën qe pretendohet apo për kryerësin dhe pasi qe policia ti siguroj te dhënat e tillë sërish prokuroria duhet te vlerësoj se a ka dyshim te arsyeshëm për te filluar hetimet apo nuk ka dyshim te tillë⁴⁷⁴.

- **Kallëzimi penal nga personat** – Kallëzimi penal nga personat ka disa kategori sipas dispozitave te Kodit. Fillimisht çdo person ka te drejte te kallëzoj penalisht për veprën penale qe ndiqet sipas detyrës zyrtare. Por njëkohësisht çdo person ka detyrim qe te kallëzoj veprën penale kur mos kallëzimi i veprës penale përbën vepër penale⁴⁷⁵.

Për kategoritë e personave qe mund te janë punëtorët social, mësuesit edukatoret apo personat tjerë qe ushtrojnë detyra ne raport me te miturit, ne çdo rast kanë detyrim te paraqesin kallëzim penal kur dyshojnë arsyeshëm se fëmija – i mituri është viktime e ndonjë vepre penale e posaçërisht kur ka dyshim te arsyeshëm se fëmija është viktimë e veprave penale kundër integritetit seksual. Kur veprat penale ndiqen sipas propozimit te te dëmtuarit apo qe duhet marr leja nga organi publik, prokurori duhet qe ta kërkoj pëlqimin apo lejen e tillë. Megjithatë kur çështja është e natyrës urgjente prokurori mund te marr pëlqimin nga i dëmtuari apo nga organi publik atëherë mund te veproj por qe duhet brenda 48 orëve ta marr pëlqimin apo lejen e organit ne forme te shkruar.

- **Kallëzimi penal i policisë** – policia ka detyrim qe te paraqes kallëzim penal për te gjitha veprat penale qe ndiqen sipas detyrës zyrtare duke u bazuar ne te dhënat dhe provat qe ka mbledhur për ndonjë vepër penale qe ndiqet sipas detyrës zyrtare. Policia obligohet qe se bashku me kallëzimin penal te dorëzoj te gjitha provat skicat dhe gjurmët qe ka siguruar. Kallëzimin me te gjitha provat policia ia dorëzon prokurorit kompetent⁴⁷⁶.

C. Format e parashtrimit te kallëzimit penal – Kallëzimi penal duhet ti paraqitet prokurorit te shtetit qe është kompetent⁴⁷⁷. Kodi njuh format e paraqitjes te kallëzimit ne forme te shkruar, me mjete teknike te komunikimit apo edhe gojarisht. Kur kallëzimi penal paraqitet gojarisht prokurori mban procesverbal dhe ai konsiderohet kallëzim penal, ndërsa këtu paralajmërohet personi për kallëzimin e rrem penal qe përbën vepër penale, ndërsa kur kallëzimi behet ne mënyra te tjera te komunikimit siç është telefoni apo forma te tjera atëherë mbahet shënim zyrtar. Ne praktike ne vazhdimësi kallëzimi penal nga personat behet ne polici gjë qe është gabim i vazhdueshëm, pasi qe kallëzimin penal te personave, policia nuk duhet ta pranoj, nga se ai kallëzim duhet ti paraqitet Prokurorit te shtetit. Për shkak te kësaj praktike te gabueshme pastaj policia shpesh here ndërmerr veprime edhe duke marr ne pyetje qoftë dëshmitar apo persona te dyshuar ne atë faze, gjë qe sërish nuk janë veprime ne përputhje me Kodin e Procedurës nga se policia vetëm për veprat qe ndiqen sipas detyrës zyrtare dhe qe ka marr

⁴⁷⁴ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 78, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁴⁷⁵ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 79, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁴⁷⁶ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 81, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁴⁷⁷ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 80, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

informatë për veprën e tillë ndërmerr veprime sipas nenit 70 te Kodit te procedurës. Një problematik tjetër praktike qe shfaqet ne kallëzimet penale qe policia i dorëzon ne prokurori, përkundër se policia ne vazhdimësi ka komunikim me prokurorin dhe bashkërendon aktivitetet ne fazën kur policia vepron është edhe fakti i kualifikimit te veprës penale, gjë qe policia nuk ka kompetencë te përcaktoj kualifikim te veprës qe konsiderohet se ka kryer, pasi qe është e mjaftueshme sqarimi i ngjarjes faktike qe policia e bënë ne përshkrimi te kallëzimit dhe është prokuroria si organ i vetëm i autorizuar ne atë fazë qe te përcaktoj kualifikimin e veprës sipas rrethanave te fakteve dhe provave qe krijojnë dyshimin e arsyeshëm ne atë faze te procedurës.

D). Autorizimet e prokurorit kur pranon kallëzimin penal – prokurori ka disa mundësi procedurale për ti ndërmarr kur e pranon kallëzimin penal e qe si te tillë janë ne kompetencën e plote te prokurorit i cili pasi qe te vlerësoj te dhënat nga kallëzimi penal dhe pasi qe ti analizoj provat e paraqitura ne kallëzimin penal, dhe pasi ti vlerësoj ai me aktvendim mund qe ta:

Hedhë kallëzimin penal nëse vlerëson se nuk ekziston dyshim i arsyeshëm se është kryer veprë penale; nëse vlerëson se ka kaluar afati i parashkrimit për ndjekje penale; nëse vlerëson se vepra penale është përfshirë me amnisti ose me falje; nëse vlerëson se i dyshuari gëzon imunitet dhe heqja e tij nuk është e mundur ose nuk është miratuar nga organi kompetent; ose kur vlerëson se ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e përjashtojnë ndjekjen⁴⁷⁸.

Prokurori duhet qe Aktvendimin e nxjerr te ia dorëzoj te dëmtuarit ne afatin prej 8 ditëve, ky detyrim për prokurorin është obligim. Kjo e drejte e te dëmtuarit është e rëndësishme pasi qe ai mund te filloj procedurën gjyqësore për kërkesë pasurore juridike nëse vlerëson se ka pësuar dem.

Ne rastin kur prokurori konsideron se te dhënat nga kallëzimi dhe provat qe mbështesin kallëzimin nuk krijojnë dyshim te arsyeshëm, ai mund te kërkoj nga policia qe te siguroj te dhëna shtesë duke e autorizuar policinë ne forme te shkruar dhe duke përcaktuar veprimet konkrete qe policia duhet ti ndërmerr, nëse brenda 30 ditëve prokurori pas pranimit te te dhënave shtesë nuk fillon hetimin duhet ta hedh kallëzimin penal, kjo sipas nenit 83 paragrafi 5 i Kodit te Procedurës Penale.

Kur prokurori shqyrton kallëzimin dhe vlerëson se nuk ka nevojë për sigurimin e te dhënave shtesë, e kur konsideron se ka dyshim te arsyeshëm ai fillon hetimet me aktvendim. Por edhe kur ka kërkuar sigurimin e te dhënave shtesë dhe pasi qe siguron ato te dhëna e nëse vlerëson se me te dhënat shtesë ka baze te mjaftueshme për dyshimin e arsyeshëm atëherë me aktvendim fillon hetimin.

⁴⁷⁸ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 82, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

NËN KAPITULLI I

MASAT E FSHEHTA TEKNIKE TË HETIMIT DHE VËZHGIMIT NË PROCEDURË PENALE

NOCIONI DHE VEÇORITË E MASAVE TË FSHEHTA TEKNIKE TË VËZHGIMIT DHE HETIMIT NËPROCEDURËN PENALE

Në Kodin e Procedurës penale të Kosovës nuk është dhënë përkufizimi i nocionit të masave të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit, por ligjvënësi në këtë Kod, ka bërë përkufizimin në veçanti të masave duke përcaktuar shprehimisht se, masat e caktuara nga nën paragrafi 1 deri në nën paragrafin 12 të nenit 87 në Kodin e Procedurës Penale, konsiderohen si masa të fshehta ose teknike të hetimit dhe vëzhgimit. Këto masa emërtohen si të “fshehta” sepse aplikimi dhe zbatimi i tyre bëhet pa njohurinë e personave që janë subjekte të këtyre masave se ndaj tyre janë duke u zbatuar masat e fshehta.

Në literaturë këto masa quhen edhe si *masa speciale të hetimit*, kurse autorë tjerë i përshkruajnë edhe si mjete për kërkimin e provave me të cilat mund të arrihet në zbulimin e veprave penale dhe që duhet përdorur në rastet kur me to zbulohen veprat penale të cilat nga lloji i tyre është shumë e vështirë të zbulohen⁴⁷⁹.

Kodi procedurës penale me *masa të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit* përfshinë të gjitha masat e listuar si në nenin 87, pa bërë ndarjen e masave të cilave realizohen përmes aktiviteteve të komunikimit elektronik, të cilat masa në disa shtete përfshihen me ligj të veçantë si p.sh. Ligji mbi Përgjimet e Telekomunikimeve (Britani e Madhe) që për qëllim kryesorë ka udhëzimin mbi procedurat të cilat duhet ndjekur para se të fillojë përgjimi i komunikimeve, nga masat tjera të cilat zbatohen pa përfshirjen e ofruesve të shërbimeve të telekomunikimeve si p.sh. zbulim i të dhënave financiare, hetim i fshehtë, vëzhgim i fshehtë fotografik ose me video etj.⁴⁸⁰

Faktori kryesor që çon drejt një hutimi të përgjithshëm sa i përket çështjes së përgjimit ligjor të telekomunikimeve në Kosovë është mungesa e një përkufizimi standard në legjislationin që rregullon këtë çështje. Sipas Kodit të procedurës Penale hetimet që bëhen nga shërbimet e telekomunikimit ndahen në: (1) *regjistrimin e thirrjeve telefonike*, (2) *përgjimin e telekomunikimeve*, (3) *përgjimin e komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik*⁴⁸¹. Këto masa

⁴⁷⁹ Sina Darjel, Përgjimi dhe Shteti Ligjor: Aspekti kushtetues i këtij fenomeni, Tiranë, Mars, 2011, fq.1.

⁴⁸⁰ Home Office, Përgjimi i Telekomunikimeve, Udhëzues mbi Procedurat dhe Format, Rregullorja mbi Autorizimet Hetimore, Britani e Madhe, kapitulli 1.1.

⁴⁸¹ Kursani Shpend, Përgjimi Ligjor i Telekomunikimeve në Kosovë: Implikimet për Sigurinë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, fq.6.

apo ndryshe masat e hetimit të fshehta janë të njohura edhe si veprime të posaçme hetimi, teknika speciale, hetimi, parashihen në legjislacionet bashkëkohore të procedurës penale⁴⁸².

Por, masat teknike të hetimit dhe vëzhgimit bashkë me efikasitetin që sjellin në hetimin e veprave penale, me vete bartin edhe rrezikun e shkeljes së të drejtave të njeriut, e aq më keq, ato mund të keqpërdoren si mjet represiv në shoqëri. Duke ditur se aplikimi i këtyre masave paraqet ndërhyrje në jetën private, me arsytim se hetimi i veprës penale nuk do të kishte mundësi të merrej me masa tjera pa shkaktuar vështirësi ose rrezik potencial për të tjerët, Kodi i procedurës penale lidhur me këto masa ka paraparë në nenin 90.2 si dhe në nenin 97.1 se vetëm provat e siguruar në pajtim me masën e siguruar ligjërisht janë të pranueshme në shqyrtim gjyqësorë.

Parimet themelore:

Masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit mund të aplikohen dhe urdhërohen vetme nëse plotësohen disa nga parimet bazë të cilat e justifikojnë lëshimin dhe zbatimin në praktikë të masave të tillë. Si parime me kryesore janë ato në si vijim;

- *Parimi I ligjshmërisë*, që nënkupton se masat e fshehta duhet të urdhërohen dhe zbatohen vetëm në përputhje me dispozitat ligjore fuqi, pra dispozitat e [KPP]
- *Parimi i subsidiaritetit*, nënkupton se këto masa mund urdhërohen vetëm në rast se masat tjera të hetimit nuk janë të efektshme, dhe kur është e domosdoshme aplikimi i këtyre masave me qëllim të sigurimit të provave të cilat nuk do të mund të sigurohen në mënyrat tjera për parandalimit e veprave penale dhe zbulimit e kryesve të tyre.
- *Parimi i proporcionalitetit*, që do të thotë se duhet që niveli i përmasave të shkeljes së lirive të drejtave dhe lirive të njeriut gjatë zbatimit të masave të fshehta, duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës penale të kryer nga personi ndaj të cilit zbatohen këto masa.
- *Parimi i mbikëqyrjes gjyqësore*, nënkupton se vetëm gjykata është organ që aprovon zbatimin e këtyre masave, si dhe kontrollon ligjshmërinë e zbatimit të tyre. Pra, masat e fshehta zbatohen vetëm me urdhër të gjyqtar, apo me konfirmim të saj (në rastet kur urdhri lëshohet nga prokurori) si dhe zbatohen me mbikëqyrje të gjyqtar i procedurës paraprake në gjykatën kompetente.

Pra, prova të ndaluara në procedurën penale ose civile duhet të konsiderohen ato prova që kundërshtojnë rregullat ndaluese ose urdhëruese të së drejtës, veçanërisht kur ato cenojnë të drejtat individuale të garantuara me Kushtetutë, ndërsa nuk ka asnjë legjislacion tjetër që justifikon juridikisht këtë cenim⁴⁸³.

⁴⁸² Sijerçiq-Çoliq Hajrija, E drejta e Procedurës Penale me vështrim të Posaçëm në Procedurën Penale të Kosovës, fq. 134.

⁴⁸³ Sina, op.cit, fq.7.

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, ka përcaktuar format dhe mënyrat teknike të zbatimit të masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit në atë mënyrë që sa më pak të prekin në privatësinë e jetës së njeriut, e cila e drejtë është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me akte dhe instrumente ndërkombëtare.

Kushtetua e Republikës së Kosovës përcakton se marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të cilat garantojnë të drejtat e njeriut kanë përparësi ndaj ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve vendore⁴⁸⁴. Mes marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, bëjnë pjesë edhe këto të cilat bëjnë sanksionimin ndërkombëtarë të fshehtësisë dhe lirisë së korrespondencës:

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ),
Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ)
Pakti Ndërkombëtarë për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP)

- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KEDNJ i cili parasheh disa kufizime të cilave duhet përmbajtur shtetet nënshkruese të kësaj Konvente gjatë aktiviteteve të organeve të tyre të ndjekjes me qëllim të mbledhjes së provave për zbulimin e veprave penale të kryera, duke përfshirë njëherësh edhe masat teknike të vëzhgimit dhe hetimit:

1. *Çdo person ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.*
2. *Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve⁴⁸⁵.*

KEDNJ mbron të drejtat e njeriut në katër pika: jetën private të personit, familjes së tij, të banesës, si dhe të drejtën për korrespondencë.

“Korrespondenca” nënkupton komunikimet përmes telefonave, postës elektronike (e-mail) si dhe letërkëmbimit përmes letrave.

“Banesa” përveç vendbanimit, nënkupton edhe zyrat nëse me arsye pritet që të ketë elemente të privatësisë në to⁴⁸⁶.

⁴⁸⁴ Shih më gjerësisht: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 22, fq. 6,

⁴⁸⁵ Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut e vitit 1950, me protokollat shtesë, Neni 8.

⁴⁸⁶ Shih më gjerësisht: Rasti Niemetz vs Germany, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 16 dhjetor 1992, Strazburg.

“*Jeta private*” nuk është përcaktuar saktësisht kuptimi i saj në KEDNJ, por kjo e drejtë nënkupton kryesisht integritetin trupor, pavarësinë personale, identitetin personal, si dhe të dhënat personale

Të drejtat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, janë të drejta të kufizuara dhe si të tillë, mund ti nënshtrohen ndërhyrjes së shtetit në rrethana të përcaktuara me ligjet vendore. Me shprehjen “*në shkallën e parashikuar nga ligji*” në këtë nen, kërkohet që këto të drejta duhet të jenë të shkruara, përkatësisht, të parashikuara me ligje vendore, dhe se arsyetim për ndërhyrje në këto të drejta është siguria publike, mbrojtja e rendit publik, shëndetit ose moralit, si dhe të drejtat dhe liritë e të tjerëve. Çdo ndërhyrje në këto të drejta, përveç arsyeve të dhëna në paragrafin 2, konsiderohet si shkelje e nenit 8 (1). “*e parashikuar nga ligji*” - do të thotë se duhet të ekzistojë baza ligjore për ndërhyrje në këto të drejtat dhe se baza e tillë ligjore duhet të jetë e shkruar dhe e lexueshme.

Duke përcaktuar në nenin 8 të drejtën për respektimin e te drejtave të personit, e me këtë mbrojtjen e këtyre të nga ndërhyrja drejtave nga ndërhyrja e organeve shtetërore, KEDNJ në këtë mënyrë u vë obligim pozitiv shteteve që në rrethana të caktuara të veprojnë dhe të ndër marrin masa për të mbrojtur këto të drejta nga çfarëdo ndërhyrje .

Gjithashtu çështje shumë e rëndësishme e cila duhet të arsyetohet qartë në ligjet penale të shteteve nënshkruese është termi “*e nevojshme në një shoqëri*” që do të thotë se intervenimi nga organet shtetërore në të drejtat e personit nga neni 8(1) i KEDNJ mund të bëhet vetëm në masën sa është e nevojshme për të arritur qëllimin legjitim. Pra ndërhyrja e shtetit në këto të drejta, praktikisht zbatimi i masave të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit, duhet të jetë alternativë e fundit e cila ndërmerret vetëm atëherë kur nuk ka mënyra tjera më pak ndërhyrëse që do të shfrytëzoheshin për të arritur qëllimin e njëjtë.

Deklarata universale për të drejtat e njeriut

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, e cila është miratuar enkas për të definuar kuptimin e fjalëve “të drejtat themelore” si dhe “të drejtat e njeriut” të cilat ishin shfaqur në Kartën e Kombeve të Bashkuara. Kjo deklaratë përmban dispozita me të cilat njihet e drejta e personit për mbrojtje të jetës së tij private nga ndërhyrjet arbitrare në banesën, jetën, korrespondencën e tij dhe se ndërhyrjet arbitrare në këto të drejta duhet të ndëshkohen nga ligji:

Neni 12

1. Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet ndërhyrjes arbitrare në jetën, familjen, banesën ose korrespondencën vetjake, si dhe sulmeve kundër nderit dhe prestigjit personal.

2. Gjithkush ka të drejtën të mbrohet nga ligji kundër ndërhyrjeve ose sulmeve të tilla. Meqenëse Deklarata e përgjithshme për të Drejtat e Njeriut është miratuar në formë të

rezolutës, e jo në formë të traktatit ndërkombëtar, ajo nuk ka forcë detyruese por luan rol shtytës lidhur me njohjen e parimeve të saj.⁴⁸⁷

Mirëpo, rëndësia e DUDNJ është e madhe sepse shërbeu si bazë për themelimin e dy pakteve obliguese mbi të drejtat e njeriut prej të: pakti Ndërkombëtarë për të Drejtat Civile dhe Politike, si dhe Paktin Ndërkombëtarë për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

Pakti Ndërkombëtarë për të Drejtat Civile dhe Politike

Jeta private e individit, banesa si dhe korrespondenca, në të cila shteti ndërhyt gjatë zbatimit të masave të fshehta teknike, janë të mbrojtura me nenin 17 të këtij pakti ku përcaktohet se këto të drejta mund ti nënshtrohen ndërhyrjeve vetëm në suaza ligjore.

Neni 17

1. Askush nuk duhet të jetë objekt i ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën e tij private, në familje, në shtëpi, ose korrespondencën, e as duhet t'i shkelet nderi dhe reputacioni i tij në mënyrë të paligjshme.

2. Secili ka të drejtë të ketë mbrojtje ligjore kundër ndërhyrjeve dhe shkeljeve të tillë. Pakti është detyrues për shtetet nënshkruese të tij.

Llojet e masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit dhe kuptimi i tyre

Masat fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit dhe lloji i tyre janë të përcaktuara në nenin 87, paragrafi 1 i Kodit të procedurës penale. Sipas këtij neni janë listuar të gjitha masat e fshehta si më poshtë:

1. vëzhgim i fshehtë fotografik ose me video;
2. monitorim i fshehtë i bisedave;
3. kontrollim i dërgesave postare;
4. përgjimi i telekomunikimeve;
5. përgjim i komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik;
6. dërgim i kontrolluar i dërgesave postare;
7. shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes;
8. blerje e simuluar e ndonjë sendi;
9. stimulim i veprës së korrupsionit;
10. hetim i fshehtë;
11. regjistrim i thirrjeve telefonike; dhe
12. zbulim i të dhënave financiare.

⁴⁸⁷ Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut 1, Zejnullah Gruda, botimi i dytë, Prishtinë, 200, fq.37.

Vëzhgim i fshehtë fotografik ose me video

Përkufizimi;

Sipas nenit 87 paragrafi 2 i KPP-së, jep këtë përkufizim; “vëzhgim i fshehtë fotografik ose me video” do të thotë; monitorim, vëzhgim ose incizim i personave, i lëvizjeve të tyre ose i aktiviteteve të tjera nga zyrtari i autorizuar i policisë me anë të fotografimit ose me video mjete, pa dijeninë apo pëlqimin e së paku njërit prej personave që i shtrohen kësaj mase.

Vëzhgimi i fshehtë fotografik ose me video (më tutje “vëzhgimi”) mund të ambientet publike dhe private, apo në hapësirat e mbyllura dhe të hapura. Me rastin e zbatimit apo aplikimin në praktik të kësaj mase të fshehtë, mund të përdoren mjete teknike që janë të përshtatshme për sigurimin e dëshmive, sikurse janë aparatet për fotografim, telefonat celular, ose video kamera të sofistikuar të cilat nuk mund të identifikohen nga personat ndaj të cilëve zbatohet kjo masë. Mjete të tilla teknike janë gjësendet për përdorim të zakonshëm ditor, por që janë të modifikuara enkas për qëllime të hetimeve të fshehta sikurse që janë video kamerat e vogla të instaluar në orë të dorës, telefona celular, lapsa, shkrepsë (çakmak), pula, automjet, çelësa veturash simulime të objekteve të ndryshme apo kamuflim të objekteve apo sendeve.

Sipas [KPP] urdhri për këtë masë mund të lëshohet nga gjyqtari i procedurës paraprake me kërkesë të prokurorit të shtetit në prokurorinë kompetente. Përveç, gjyqtarit të procedurës paraprake, edhe prokurori i shtetit mund të urdhëroj përkohësisht këtë masë, në procedura urgjente ose në procedura penale të cilat janë duke u hetuar për krim të organizuar, për vepra penale në kuadër të kapitullit korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare të paraparë në Kodin Penal, si dhe për vepra penale të shpëlarjes së parasë, dhe i cili duhet të konfirmohet me shkrim nga gjyqtari i procedurës paraprake brenda tre ditëve nga lëshimi i tij. Kjo masë, mund të autorizohet kundër një personi apo vendi të caktuar në rastet kur ekziston dyshimi i bazuar se vendi është përdorur ose personi i tillë ka kryer vepra penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, ose në rastet kur tentativa e ndëshkueshme, ka tentuar të kryejë vepra penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare.

Në parim urdhri nuk mund të zgjas me shumë se gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e lëshimit dhe mund të zgjatet më së shumti deri në gjashtëdhjetë ditë tjera, i cili urdhër mund të ripërtërihet brenda afatit prej treqindgjashtëdhjetë (360) ditësh nga dita e lëshimit të urdhrin.

Me rastin e lëshimit të urdhrin për zbatimin e kësaj mase në vende private, gjyqtari mund ta autorizojë zyrtarin e autorizuar të policisë të hyjë në lokale private, nëse gjyqtari i procedurës paraprake vlerëson se hyrja e tillë është e domosdoshme për të aktivizuar ose pamundësuar mjetet teknike për zbatimin e masave të tillë. Kur zyrtarët e autorizuar të policisë hyjnë në lokale private në pajtim me urdhrin nga ky paragraf, veprimet e tyre në lokalet private duhet të kufizohen në veprimet e nevojshme për të aktivizuar apo çaktivizuar pajisjet teknike.

Përkufizimi;

Neni 87 paragrafi 3 i KPP-së, jep këtë përkufizim; “Monitorim i fshehtë i bisedave” do të thotë monitorimi, incizimi ose transkriptimi i bisedave nga zyrtari i autorizuar i policisë me anë të mjeteve teknike, pa dijeninë ose pëlqimin e së paku njërit prej personave që i shtrohen kësaj mase.

Në praktik kjo masë zbatohet duke bërë incizimet të bisedave të personave apo të pandehurve nga zyrtarit policor i cilët vepron si agjent i fshehur, përmes personave të caktuar që veprojnë apo bashkëpunojnë me policinë apo përmes vendosjes së kamerave apo aparateve për të siguruar audio-video incizimet në vendet publike apo edhe private.

Kjo masë e fshehtë mund të urdhërohet vetëm nëse ekziston dyshimi i bazuar se vendi është përdorur ose personi i tillë ka kryer veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, ose në rastet kur tentativa është e ndëshkueshme, ka tentuar të kryejë veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare⁴⁸⁸. Ndërsa në vende private kjo masë mund të urdhërohet nëse ekziston dyshim i bazuar se vendi apo sendi i tillë përdoret për kryerje të veprës penale ose personi i tillë ka kryer, apo në rastin kur tentimi ndëshkohet, ka tentuar të kryejë veprë penale nga neni 90 i Kodit të procedurës penale⁴⁸⁹

Si kusht tjetër cili duhet të përmbushet për zbatimin e kësaj mase, si në vendet publike apo private patjetër duhet që të rezultojë që informacioni i cili mund të merret nga masa e urdhëruar ka gjasë të ndihmojë në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me masa të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.

Gjyqtari i procedure paraprake sipas kërkesë se të prokurorit të shtetit e urdhëron lëshimin e kësaj mase. Përrjashtimisht edhe prokurori i shtetit mund të urdhëroj përkohësisht këtë masë, por duhet të plotësohen disa kushte specifike, siç janë; në procedura urgjente ose në procedura penale të cilat janë duke u hetuar për krim të organizuar, për vepra penale në kuadër të kapitullit korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, si dhe për veprë penale të shpëlarjes së parasë, mirëpo ky urdhër duhet të konfirmohet me shkrim nga gjyqtari i procedurës paraprake brenda tre ditëve nga lëshimi i tij.

Kur gjykata lëshon urdhrin për zbatimin e kësaj mase në vende private, gjyqtari i procedurës paraprake mund ta autorizoj zyrtarin e autorizuar të policisë të hyjë në lokale private, nëse gjyqtari vlerëson se hyrja e tillë është e domosdoshme për të aktivizuar ose pamundësuar mjetet teknike për zbatimin e masave të tilla. Kur zyrtarët e autorizuar të policisë hyjnë në lokale private në pajtim me urdhrin nga ky paragraf, veprimet e tyre në lokalet private duhet të kufizohen në veprimet e nevojshme për të aktivizuar apo çaktivizuar pajisjet teknike. Kjo përcaktohet me nenin 92 paragrafi 3 KPP.

⁴⁸⁸ Neni 88, paragrafi 1.1 i Kodi i Procedurës Penale të Kosovës.

⁴⁸⁹ Po aty: neni 88, paragrafi 3.1 Kodi i Procedurës Penale të Kosovës.

Urdhri për këtë masë të caktuar nuk mund ta kalojë periudhën prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e lëshimit të këtij urdhri dhe mund të zgjatet më së shumti deri në gjashtëdhjetë ditë, i cili urdhër mund të ripërtërihet brenda afatit prej treqindegjashtëdhjetë (360) ditësh nga dita e lëshimit të urdhrit.

Kontrollim i dërgesave postare

Përkufizimi;

Sipas nenit 87 paragrafi 4 i KPP-së, jepet ky përkufizim “Kontrollim i dërgesave postare është kontrollim i letrave dhe i dërgesave të tjera postare nga zyrtari i autorizuar i policisë, që mund të përfshijë edhe përdorimin e pajimeve rëntgen”.

Kjo masë e fshehtë mund të urdhërohet ndaj një personi, vendi apo sendi konkret, nëse ekziston dyshimi i bazuar se vendi apo sendi i tillë përdoret për kryerje të veprës penale ose personi i tillë ka kryer, apo në raste kur tentimi ndëshkohet, ka tentuar të kryej vepër penale nga neni 90 i kodit të procedurës penale. Përveç kësaj, kushteve të sipër cekuar është e domosdoshme që informacioni i cili mund të merret nga masa e urdhëruar ka gjasë të ndihmojë në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me masa të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.

Sipas KPP-ës, kjo masë mund të urdhërohet edhe ndaj personave të tjerë përpos të dyshuarit në të gjitha rastet kur personi i *tillë pranon ose transmeton komunikime që burojnë prej të duhurit ose që i dedikohen të dyshuarit*. Mund të kufizohet vetëm në raport me komunikimet ndërmjet të dyshuarit dhe mbrojtësit të tij, përveç nëse ekziston dyshimi i bazuar se i dyshuari dhe mbrojtësi i tij, janë përfshirë njëkohësisht dhe së bashku në aktivitetet kriminale që përbën bazën e urdhrit.

Gjyqtari i procedurës paraprake, sipas kërkesës me shkrim nga prokurori i shtetit e lëshon urdhrin për zbatimin e kësaj masë. Në raste urgjente edhe prokurori i shtetit, mund të urdhëroj secilën masë të cilën mund ta lëshojë edhe gjyqtari i procedurës paraprake, kur plotësohen disa kushte shtese dhe vetëm në procedura urgjente, ose në procedura penale të cilat janë duke u hetuar për krim të organizuar, për vepra penale në kuadër të kapitullit korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, si dhe për vepër penale të shpëlarjes së parasë, nëse pritja e lëshimit të urdhrit nga gjyqtari i procedurës paraprake do të rrezikonte sigurinë e hetimeve ose jetën dhe sigurinë e palës së dëmtuar, dëshmitarit, informatorit ose anëtarëve të familjes së tyre. Prokuroria mbanë regjistër të saktë për masat e urdhëruar dhe ato i ruan në përputhje me kohën siç përcaktohet me ligjit në fuqi.

Urdhri i lëshuar për këtë masë mund të zgjas deri në gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e lëshimit dhe mund të zgjatet më së shumti deri në gjashtëdhjetë ditë tjera si dhe mund të ripërtërihet edhe njëherë brenda afatit prej treqindegjashtëdhjetë (360) ditësh nga dita e lëshimit të urdhrit.

- *Përkufizimi;*

Neni 87 paragrafi 5 i KPP-së, jep këtë përkufizim; “Përgjim i telekomunikimeve” do të thotë përgjim i komunikimeve zanore, komunikimeve tekstuale ose komunikimeve tjera përmes rrjeteve të telefonive fikse apo mobile. Kjo përfshinë çfarëdo mjeti apo sistemi tjetër të ngjashëm teknologjik që bartë të dhëna që kryesisht kanë për qëllim të jenë private.

Kjo masë zbatohet kryesisht duke përdorur mjetet teknike të komunikim në largësi përmes përgjimit. Përgjimi i telekomunikimeve përfshinë mbikëqyrjen dhe regjistrimin teknik e të gjitha mjeteve për komunikim nga në largësi: telefoninë fikse dhe mobile, telefakset, mesazhet me celular SMS, dhe mjeteve të ngjashme.

Me rastin e lëshimit të urdhërimit për këtë masë në masa kufizohet apo mund të cenohet privatësia e personit të dyshuar por edhe të personave tjerë që komunikojnë me personin që i nënshtrohet përgjimit. Sepse përgjimi i bisedave regjistron gjithë bisedat ndërmjet të dyshuarit apo të pandehurit dhe personave tjerë që në shumë raste përmbajtje e bisedave janë tipike me karakter privat. Realizimi i kësaj mase bëhet edhe përmes pajisjes që në praktikë njihet “IMSI catcher” (marrës i IMSI-ve) me të cilën vërtetohet IMSI/ Identifikimi Ndërkombëtarë i Shfrytëzuesit Mobil të cilën e ka përdoruesi i telefonit celular. Numri i IMSI është i ruajtur në SIM kartelën e celularit dhe mund të identifikohet në gjithë botën.

Kjo masë mund të urdhërohet kundër një personi, vendi apo sendi konkret, nëse ekziston dyshim i bazuar se vendi apo sendi i tillë përdoret për kryerje të veprës penale ose personi i tillë ka kryer, apo në rastin kur tentimi ndëshkohet, ka tentuar të kryejë vepër penale nga neni 90 i këtij Kodi.

Një masë e tillë mund të urdhërohet edhe ndaj personit përpos të dyshuarit ekziston dyshim i bazuar se personi i tillë pranon ose transmeton komunikime që burojnë prej të dyshuarit. Nuk mund të zbatohet për komunikimet ndërmjet të dyshuarit dhe mbrojtësit të tij, përveç nëse ekziston dyshimi i bazuar se i dyshuari dhe mbrojtësi i tij janë angazhuar së bashku në veprimtari kriminale që përbën bazën e urdhrit.

Gjyqtari i procedurës paraprake, sipas kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar nga prokurori i shtetit mund ta lëshojë këtë masë të fshehtë. Përgjimisht edhe prokurori i shtetit, mund të lëshojë secilën masë të cilën mund ta lëshojë edhe gjyqtari i procedurës paraprake, por vetëm në procedura urgjente, ose në procedura penale të cilat janë duke u hetuar për krim të organizuar, për vepra penale në kuadër të kapitullit korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, si dhe për vepër penale të shpëlarjes së parasë, nëse pritja e lëshimit të urdhrit nga gjyqtari i procedurës paraprake do të rrezikonte sigurinë e hetimeve ose jetën dhe sigurinë e palës së dëmtuar, dëshmitarit, informatorit ose anëtarëve të familjes së tyre. Prokuroria, mban regjistër te sakte për gjitha masat e urdhëruar sipas kësaj baze, i ruan ato sipas ligjit në fuqi.

Me rastin e lëshimit të kësaj mase, sipas nevojës, gjyqtari i procedurës paraprake mund ta autorizojë zyrtarin e autorizuar të policisë që të hyjë në lokale private, nëse vlerëson se hyrja e tillë është e

domosdoshme për të aktivizuar ose pamundësuar mjetet teknike për zbatimin e masave të tilla. Kur zyrtarët e autorizuar të policisë hyjnë në lokale private në pajtim me urdhrin nga ky paragraf, veprimet e tyre në lokalet private duhet të kufizohen në veprimet e nevojshme për të aktivizuar apo çaktivizuar pajisjet teknike, siç përcaktohet me nenin 92 paragrafi 3 të KPP.

Kohëzgjatje urdhri për këtë masë nuk mund të kalojë periudhën prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e lëshimit, urdhri dhe mund të zgjatet më së shumti deri në gjashtëdhjetë ditë tjera, dhe mund të ripërtërihet brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditë të tjera.

Dërgim i kontrolluar i dërgesave postare

Përkufizimi;

Neni 87 paragrafi 6 i KPP-së, jep këtë përkufizim; “Dërgim i kontrolluar i dërgesave postare” do të thotë dërgim i letrave dhe i materialeve të tjera postare nga zyrtari i autorizuar i policisë.

Si e tillë kjo masë, zbatohet sipas urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake kur ka dyshim të bazuar se dërgesat e kundërligjshme dhe të dyshimta të qarkullojnë në mënyrë të kontrolluar brenda vendit, por edhe të kalojnë, hyjnë apo të dalin nëpër shtete tjera. Nevoja për këtë masë paraqitet atëherë kur policia apo organet tjera hasin përmbajtje të ndaluar nëpër dërgesa postare dhe në ato raste, policia do të kërkojë prokurorit që të kërkojë urdhër që dërgesa postare me përmbajtje të dyshimtë të hapet dhe pastaj të vazhdojë drejt vendit të caktuar, por në mënyrë të kontrolluar nga policia. Kjo masë mundëson që të zbulohen jo vetëm kryerësit e njohur të veprës penale, por edhe dërguesit, pranuesit dhe dorëzuesit e ngarkesave apo dërgesave postare me përmbajtje të kundërligjshme.

E drejta për pranimin e letrave dhe materialeve tjera përmes postës pa ju nënshtuara kontrollimit apo hapjes së atyre dokumenteve është e garantuar mirëpo, ka raste që kjo e drejtë kufizohet. Kjo masë mund të urdhërohet ndaj një personi, vendi apo sendi konkret, nëse: ekziston dyshim i bazuar se vendi apo sendi i tillë përdoret për kryerje të veprës penale ose personi i tillë ka kryer, apo në rastin kur tentimi ndëshkohet, ka tentuar të kryejë vepër penale nga neni 90 i Kodit të procedurës penale, si dhe kur informacioni i cili mund të merrej nga masat e urdhëruara me gjasë do të ndihmonte në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me veprime të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.

Përveç të dyshuarit kjo masë urdhërohet edhe ndaj personit tjetër nëse personi i tillë pranon ose transmeton komunikime që burojnë prej të dyshuarit ose që i dedikohen të dyshuarit si dhe kur nëse përmbushen kushtet e parapara për të dyshuarin.

Gjyqtari i procedurës paraprake, sipas kërkesës me shkrim të prokurorit të shtetit e lëshon apo e urdhëron këtë masë. Nga kjo rregull ka një përjashtim, sepse edhe prokurori i shtetit, mund të lëshojë secilën masë të cilën mund ta lëshojë edhe gjyqtari i procedurës paraprake, por vetëm në procedura urgjente, ose në procedura penale të cilat janë duke u hetuar për krim të organizuar, për vepra penale në kuadër të kapitullit korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, si dhe për vepër penale të shpëlarjes së parasë, nëse pritja e lëshimit të urdhrin nga gjyqtari i procedurës paraprake do të rrezikonte sigurinë e hetimeve ose jetën dhe sigurinë e palës së dëmtuar, dëshmitarit, informatorit ose anëtarëve të familjes së tyre.

Urdhri për këtë masë të vlen dhe nuk mund ta kalojë periudhën prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e lëshimit dhe mund të zgjatet më së shumti deri në gjashtëdhjetë ditë, si dhe mund të ripërtërihet brenda afatit prej treqindgjashtëdhjetë (360) ditësh nga dita e lëshimit të urdhrin.

Përgjimi komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik

Përgjimi i komunikimeve përmes rrjetit kompjuterik cilësohet një veprim hetimor që ndërmerret përmes sistemit të komunikimeve elektronike përmes rrjetit kompjuterik. Për zbatimin e kësaj mase kërkohen ekspert të cilët posedojnë njohuritë posaçme profesionale nga fusha e teknologjisë informative dhe komunikimit elektronik. Zhvillimi i teknologjisë dhe komunikimeve ndryshme elektronike krahas kësaj ka mundësuar edhe paraqitjen e veprave të reja penale të cilat më herët nuk kanë qenë të njohura. Forma më të shpeshta të kryerjes së veprave penale përmes kompjuterëve janë vjedhja e informatave personale/vjedhje e identitetit, vjedhja e programeve, futja e “viruseve” që shkatërrojnë sistemin e programit apo të kompjuterit, vjedhja e bankave dhe klientëve të tyre, depërtimi nëpër kompjuter përmes programeve të ndryshme për qëllime përfitimi material që njihet si “hacking”, pornografia me fëmijë, kanosjet, nxitja e terrorizmit etj.

Përmes urdhrin për përgjim të telekomunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik mund të autorizohet zyrtari i policisë të hyjë në lokale private, nëse gjyqtari i procedurës paraprake vendos se hyrja e tillë është e domosdoshme për të aktivizuar ose pamundësuar mjetet teknike për zbatimin e masave të tilla. Kur zyrtarët e autorizuar të policisë hyjnë në lokale private në pajtim me urdhrin nga ky paragraf, veprimet e tyre në lokalet private duhet të kufizohen në veprimet e nevojshme për të aktivizuar dhe deaktivizuar pajisjet teknike.⁴⁹⁰

Kjo masë mund të urdhërohet kundër një personi, vendi apo sendi konkret, nëse: ekziston dyshim i bazuar se vendi apo sendi i tillë përdoret për kryerje të veprës penale ose personi i tillë ka kryer, apo në rastin kur tentimi ndëshkohet, ka tentuar të kryejë vepër penale sikurse në nenin 90 të përshkruar në kodin e procedurës penale. Kjo masë mund të urdhërohet kundër personit, përpos të dyshuarit, në rast se plotësohen kushtet që parashihen për përgjimin e të dyshuarit, kur ekziston dyshim i bazuar se: personi i tillë pranon ose transmeton komunikime që burojnë prej të dyshuarit ose që i dedikohen të dyshuarit; ose i dyshuari përdor telefonin e personit të tillë ose ka qasje në sistem kompjuterik⁴⁹¹.

Kjo masë lëshohet kur gjykata\gjyqtari i çështjes kur bindet se informacioni i cili mund të merret nga masat e urdhëruara me gjasë do të ndihmonte në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merret me veprime të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët. Nuk mund të aplikohet si masë e vetme apo primare gjatë hetimeve.

Kompetent për lëshimin e urdhrin të tillë për këtë masë është gjyqtari i procedurës paraprake sipas kërkesë së prokurorisë me shkrim me shkrim dhe të arsyetuar nga prokurori i shtetit, por në raste urgjente edhe prokurori i shtetit, mirëpo urdhri duhet të ri konfirmohet nga gjykata.

Sipas nenit 94 të KPP urdhri për këtë masë të caktuar nuk duhet ta kalojë periudhën prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e lëshimit të këtij urdhri dhe mund të zgjatet më së shumti deri në gjashtëdhjetë

⁴⁹⁰ Kodi Nr.04/L-123 i Procedurës Penale të Kosovës, Neni 92.3.

⁴⁹¹ Po aty: neni 4, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës.

ditë, dhe mund të ripërtërihet brenda afatit prej treqindegjashtëdhjetë (360) ditësh nga dita e lëshimit të urdhrin.

Shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes

- *Përkufizimi;*

Sipas nenit 87 paragrafi 7 i KPP-së, jep këtë përkufizim, Shprehja “shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes” do të thotë shfrytëzim nga zyrtari i autorizuar i policisë i mjeteve të cilat identifikojnë vendndodhjen e personit ose të objektit në të cilin është ngjitur.

- *Zbatimi praktik:*

Policia shfrytëzon mjetet teknike të teknologjisë me qëllim të përcjelljes së lëvizjeve të personave dhe sendeve apo gjetjen e vendndodhjes së tyre. Përmes kësaj mase mundësohet që hetimi i fshehët të ndihmon organet e ndjekjes në punën e tyre gjatë hetimit të veprave penale. Kjo masë shfrytëzohet për përcjelljen e personave dhe sendeve që konsiston në vendosjen e mjeteve apo pajisjeve sinjalizuese në objektet të cilat personat e dyshimtë i vizitojnë ose i përdorin, si p.sh. automjetet, motorët, motoçikletat apo vendosja e pajisjeve përcjellëse në rrobat e personave që i nënshtrohen kësaj mase të fshehtë. Për shembull, pas autorizimit të kësaj mase, policia mundet që pajisja e tillë mund të vihet apo ngjitet në veturën e personit që hetohet për vepra penale me narkotik dhe në këtë mënyrë të përcjellën lëvizjet e tij në vende të ndryshme të ndryshme. Kjo masë mund të urdhërohet vetëm me urdhëresë të gjyqtarit të procedurës paraprake. Prokurori i shtetit e parashtron kërkesën me shkrim, japë arsye të mjaftueshme dhe duhet të arsyetoi se janë plotësuar kushtet e domosdoshme për aplikimin e kësaj mase. Nëse gjyqtari i procedurës paraprake bindet se janë plotësuar kushtet e domosdoshme lëshon urdhëresë me të cilën lejohet aplikimi i kësaj mase.

Si rregull një masë e tillë mund të urdhërohet kundër një personi, vendi apo sendi konkret, nëse, kur provohet dhe argumentohet se ekziston dyshim i bazuar se vendi apo sendi i tillë përdoret për kryerje të veprës penale ose personi i tillë ka kryer, apo në rastin kur tentimi ndëshkohet, ka tentuar të kryejë vepër penale të paraparë me nenin 90 të këtij ligji, gjithashtu të dëshmohet se informacioni i cili mund të merrej nga masat e urdhëruara me gjasë do të ndihmonte në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me veprime të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.

Në urdhër e lëshuar mund të autorizohet zyrtarin e autorizuar të policisë që të hyjë në lokale private, nëse gjyqtari i procedurës paraprake vlerëson se hyrja e tillë është e domosdoshme për të aktivizuar ose pamundësuar mjetet teknike për zbatimin e masave të tilla. Kur zyrtarët e autorizuar të policisë hyjnë në lokale private në pajtim me urdhrin nga ky paragraf, veprimet e tyre në lokalet private duhet të kufizohen në veprimet e nevojshme për të aktivizuar dhe de aktivizuar pajisjet teknike.

Blerje e simuluar e ndonjë sendi

Sipas nenit 87 paragrafi 8 i KPP-së, jepet përkufizimi i shprehjes “Blerje e simuluar e ndonjë sendi” do të thotë akt i blerjes së ndonjë sendi nga një person i dyshuar se ka kryer veprë penale që mund të shërbejë si provë në procedurën penale, ose nga personi për të cilin dyshohet të jetë viktimë e veprës penale të “Trafikimit me njerëz”, siç përcaktohet në nenin 170 të Kodit Penal.

Aplikimi i kësaj mase të fshehtë nënkupton që zyrtari i autorizuar policisë i cili është i ngarkuar sipas urdhrimit për zbatimin e kësaj mase simulon një blerjen e ndonjë sendi apo shërbimi dhe paraqitet si një blerës i zakonshme apo i thjeshtë, blerja e të cilit në të kundërtën do të ishte veprë penale. Blerja e simuluar e ndonjë sendi mund të bëhet ndaj të gjitha sendeve të cilat mund të jenë lëndë e veprës penale të dënueshme, apo edhe ndaj shërbimeve që ofrohen të cilat shërbime mund të jenë të ndaluara me ligj, apo të sanksionuara si vepra penale. Qëllimi i kësaj mase konsiston në identifikimin e personave dhe të dyshuarve që marrin pjesë në shitjen e sendeve dhe shërbimeve të ndaluar në baze të ligjit, apo sendeve që janë jashtë qarkullimit, apo me qarkullim të kufizuar që pjesëmarrja në këto transaksione është e sanksionuar si vepra penale. Gjithashtu përmes kësaj mase synohet që të sigurohen prova të drejtpërdrejta për veprën penale, kryesin e saj dhe bashkëpunëtorët në këto krime. Kjo masë zbatohet nga zyrtari i autorizuar i policisë i cili bie në kontakt me personin e dyshuar i cili dyshohet se është duke kryer vepra penale. Zyrtari i autorizuar i policisë para shitësit të të dyshuarit paraqitet si një blerës i vërtetë duke i ofruar atij shumën e caktuar të hollave në këmbim të blerjes së sendit që në rrethana tjera do të ishte veprë penale edhe për vet zyrtarin e autorizuar policor. Zbatimi në praktik i kësaj mase ngërthen në vete mjaftë rreziqe, siç mund të jetë identifikimi i zyrtarit policor apo agjenti, në këtë mënyrë ai i ekspozohet një rreziku real për jetën dhe sigurinë e tij nga personat e caktuar apo të dyshuarit. Andaj planifikimi i mirë dhe përgatitjet paraprake ka rendësi vendimtare për zbatimin e një mase të tillë duke punuar në konfidencialitet të plotë me qëllim që të mos zbulohet plani, dhe identiteti i zyrtarit policor, dhe nën mbështetjen e vazhdueshme nga njësit tjera policore nga distanca me qëllim që të ruhet jeta dhe siguria e zyrtarit që simulon blerjen.

Gjatë zbatimit në praktik të kësaj mase, zyrtari i autorizuar policor nuk është i kufizuar vetëm në rolin pasiv të tij, por në veprimet konkrete të nxitjes në dëshirën e të pandehurit që të kryej veprë penale. Zyrtari i autorizuar policor mund të fton të pandehurin përmes telefonit, e cakton vendin, kohën e takimit, kërkon që i pandehuri të sjell llojin e narkotikëve me qëllim të provimit të cilësisë.

Kjo masë mund të urdhërohet kundër një personi, vendi apo sendi konkret, nëse ekziston dyshim i bazuar se vendi apo sendi i tillë përdoret për kryerje të veprës penale ose personi i tillë ka kryer, apo në rastin kur tentimi ndëshkohet, ka tentuar të kryej veprë penale nga neni 90 i këtij Kodi, me kushte që informacioni i cili mund të merrej nga masat e urdhëruara me gjasë do të ndihmonte në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me

veprime të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët⁴⁹².

Gjyqtari i procedure paraprake pranë gjykatës kompetente është përgjegjës që të lëshojë urdhëroi këtë masë të fshehtë, sipas kërkesës me shkrim të arsyetuar nga prokurori i shtetit.

Simulim i veprës së korrupsionit

- *Përkufizimi;*

Sipas nenit 87 paragrafi 9 i KPP-së, jepet ky përkufizim, Shprehja “Simulim i veprës së korrupsionit” do të thotë një veprim që është i njëjtë me veprën penale të ndërlidhur me korrupsion, por që ndryshon për shkak se kryhet me qëllim të mbledhjes së informacionit dhe provave gjatë hetimit penal.

- *Kushtet dhe kriteret ligjore për lëshimin e kësaj mase:*

Kjo masë e fshehtë mund urdhërohet kundër një personi, vendi apo sendi konkret, kur: ekziston dyshim i bazuar se vendi apo sendi i tillë përdoret për kryerje të veprës penale ose personi i tillë ka kryer, apo në rastin kur tentimi ndëshkohet, ka tentuar të kryejë vepër penale për të cilat është e paraparë me këtë ligj se mund të zbatohen masat, si dhe kur informacioni i cili mund të merrej nga masat e urdhëruara me gjasë do të ndihmonte në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me veprime të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët⁴⁹³.

Kompetente për lëshimin e kësaj mase është gjyqtari i procedure paraprake në gjykatën kompetente sipas kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar nga prokurori i shtetit, përjashtimisht në rastet urgjente edhe prokurori i shtetit. Gjatë zbatimit në praktik të kësaj mase, zyrtari i policisë apo personi i cili zbaton masën nuk guxon të nxisë personin tjetër të kryej vepër penale të cilën personi nuk do ta kryente sikur të mos ishte nxitja apo joshja e personit që zbaton urdhrin. Andaj, sugjerohet që me rastin e aplikimit të kësaj mase personi i autorizuar për zbatimin e urdhrin e tillë duhet që tu përmbahet dispozitave të Kodit të procedurës penale në të kundërtën ekziston rreziku real që dëshmitë e mbledhura përmes kësaj mase të shpallen të papranueshme para dhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë.

Për këtë arsye, njëjtë sikurse te masa blerje e simuluar e sendit, për shkak të natyrës së zbatimit të kësaj mase, urdhri për blerje të simuluar të sendit autorizohet vetëm për një blerje të sendit. Po ashtu e veçantë tjetër te kjo masë është se meqenëse zgjatja e urdhrin nuk mund të bëhet, atëherë zyrtari i autorizuar gjyqësorë mund të lëshojë urdhër tjetër për personin e njëjtë kur parakushtet për urdhërimin e masës vazhdojnë të zbatohen dhe ka shpjegim të arsyeshëm për dështimin në sigurimin e ndonjë apo të gjitha të dhënave të kërkuara me urdhrin e mëparshëm.

⁴⁹² Shih më gjerësisht: neni 88, paragrafi 3.1 dhe 3.2 i Kodi i Procedurës Penale të Kosovës.

⁴⁹³ Më gjerësisht: neni 88, paragrafet 3.1 dhe 3.3 i Kodi i Procedurës Penale të Kosovës.

- Përkufizimi

Sipas nenit 87 paragrafi 10 i KPP-së jepet ky përkufizim, Shprehja “hetim i fshehtë” do të thotë një ndërveprim i planifikuar i zyrtarit të autorizuar të policisë ose agjentit bashkëpunues të prokurorisë, i cili nuk është i identifikueshëm si zyrtar i autorizuar i policisë, ose i personit i cili vepron nën mbikëqyrjen e zyrtarit të autorizuar të policisë me personat e dyshuar se kanë kryer vepër penale.

- Zbatimi praktik:

Si e tillë në praktik kjo masë zbatohet përmes zyrtarëve policor apo nga agjent të infiltruar (bashkëpunues) të prokurorisë të cilët paraqiten me identitet të fshehur për një periudhë të caktuar kohore në mënyrë që të bëjë zbulimin, sqarimin dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale kryesisht krimin e organizuar përmes pranisë së drejtpërdrejtë ose tërthorazi në vendin ku ka ndodhur, ndodhë apo ku pritet të ndodh një vepër penale. Zyrtari policor apo agjenti infiltrohen në grupin kriminal në fshehtësi të identitetit dhe qëllimit në këtë mënyrë ai është në gjendje të vërej personat të cilët janë të kyçur në kryerjen e asaj veprave penale, si dhe mjetet dhe mënyrën të cilën ata dëshirojnë të përdorin për kryerjen e asaj veprave. Pastaj nuk përjashtohet mundësia që kjo masë të kombinohet edhe me masa tjera të fshehta, siç janë; monitorimi i bisedave, përcjellja dhe vëzhgimi me foto dhe incizimi etje, krejt me qëllim të mbledhjen dhe grumbullimin e drejtpërdrejtë të dëshmive për veprën penale dhe kryesin e saj. Natyra e kësaj mase është e karakterit informativ sepse personi zyrtar i cili zbaton këtë masë, ka për detyrë që të bëjë mbledhjen e dëshmive lidhur me veprimtarinë e kriminale të personave të dyshuar ndaj të cilëve zbatohet kjo masë.

Gjatë zbatimit të kësaj mase sipas urdhrin gjyqësor për hetim të fshehtë, personi i cili zbaton urdhrin (zyrtaret policor) nuk mund të nxisë personin tjetër të kryej vepër penale të cilën personi nuk do ta kryente sikur të mos ishte intervenimi i personit që zbaton urdhrin. Personi i cili në pajtim me dispozitat e Kodit të procedurës penale zbaton urdhrin nuk kryen vepër penale⁴⁹⁴.

Kur zyrtari, apo agjenti bashkëpunues i prokurorisë, drejtpërdrejtë dhe pa u hetuar vëzhgon secilin detaj të përgatitjes apo kryerjes së veprës penale, hetuesi i fshehtë ka shumë të lehtë të dokumentoj dhe të ofroj prova të rëndësishme për procedurën penale. Zyrtaret e autorizuar policor të cilët zbatojnë hetimin e fshehtë, punën e tyre e kryejnë në rroba civile duke mos u identifikuar si zyrtar policor. Në rastet kur hetimi i fshehtë kryhet nga zyrtarët e policisë, Kodi i Procedurës Penale në nenin 73.1 ka paraparë që gjatë zhvillimit të bisedave me dëshmitarë apo persona të dyshuar zyrtari policor mund të bëjë pyetje në lidhje me veprën penale, dhe se këto pyetje duhet regjistruar. Nëse këto pyetje nuk regjistrohen, atëherë zyrtari policor duhet

⁴⁹⁴ Kodi Nr.04/L-123 i Procedurës Penale të Kosovës, Neni 93.8.

sa më parë të përgatis një raport ku duhet të përmbledhë saktë bisedat dhe të shpjegojë arsyen përse bisedat nuk janë regjistruar.

Për zbatimin e kësaj mase në praktike hasen shumë vështirësi, përveç kësaj zbatimi i kësaj mase mund të jetë edhe rrezik për vete për personin që e zbaton këtë masë. Po ashtu, e metë tjetër e kësaj mase është se mbrojtja e identitetit të këtij personi do të jetë objektiv gjatë gjithë fazave të procedurës penale, ekziston rreziku i përplasjes me parimin e “*procesit gjyqësor të ndershëm*” dhe veçanërisht me dispozitën që përcakton se *i dyshuari ose i akuzuari ka të drejtën e marrjes në pyetje të dëshmitarëve të sjellë për të dëshmuar kundër tij* (KNDCP, neni 14.3 (e)). Pra kjo e drejtë mund të rrezikohet në situatat kur, për arsye sigurie, identiteti i informatorëve nuk mund të bëhet publik.⁴⁹⁵

Kjo masë si e tillë mund të urdhërohet kundër një personi, vendi apo sendi konkret, nëse: ekziston dyshim i bazuar se vendi apo sendi i tillë përdoret për kryerje të veprës penale ose personi i tillë ka kryer, apo në rastin kur tentimi ndëshkohet, ka tentuar të kryejë veprë penale nga neni 90 i KPPPK, si dhe kur informacioni i cili mund të merrej nga masat e urdhëruara me gjasë do të ndihmonte në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me veprime të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.

Për lëshimin e kësaj mase është kompetent gjyqtari i procedurës paraprake, sipas kërkesë me shkrim të prokurori i shtetit ne prokurorin kompetente. Përfundimisht, në raste urgjente edhe prokurori i shtetit, mund të lëshojë secilën masë të cilën mund ta lëshojë edhe gjyqtari i procedurës paraprake, por vetëm në procedura urgjente, ose në procedura penale të cilat janë duke u hetuar për krim të organizuar, për vepra penale në kuadër të kapitullit korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, si dhe për veprë penale të shpëlarjes së parasë, nëse pritja e lëshimit të urdhrit nga gjyqtari i procedurës paraprake do të rrezikonte sigurinë e hetimeve ose jetën dhe sigurinë e palës së dëmtuar, dëshmitarit, informatorit ose anëtarëve të familjes së tyre.

Zbulim i të dhënave financiare

- Përkufizimi:

Sipas nenit 87 paragrafi 12 i KPP-së, jepet ky përkufizim Shprehja “zbulim i të dhënave financiare” do të thotë sigurim i informacionit nga banka apo ndonjë institucion tjetër financiar mbi depozitat, llogaritë ose transaksionet financiare. Veprat penale për të cilat mund të lëshohen urdhrat për zbatim të masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit. Kjo mase

⁴⁹⁵ Të shërbesh dhe të mbrosh, Të drejtat e njeriut dhe e drejta humanitare për forcat e policisë dhe sigurisë, Komiteti Ndërkombëtarë i Kryqit të Kuq, Gjenevë 1998, fq.179.

zakonisht zbatohet në llogarit bankare, në librat e kontabilitetit si dhe në çdo të dhanë që mund të zbulohen të dhënat financiare.

Në praktikën përdoren dy mënyra të caktimit veprave penale për të cilat mund të urdhërohen masat:

- mënyra e enumeracionit (katalogut) ku në ligj në mënyrë eksplicite përmenden veprat penale për të cilat mund të caktohen masat e fshehta, si dhe

- mënyra ku si kriter përdoret lartësia e dënimit me burgim të paraparë për veprën penale (veprat penale të dënueshme me pesë (5) ose më shumë vjet burgim).

Në praktikë ekziston mundësia e kombinimit të këtyre dy mënyrave. Kodi procedurës penale të Kosovës zbaton pikërisht mënyrën e kombinuar me rastin e caktimit të veprave penale për të cilat mund të lëshohen urdhrat për masa. Si për ilustrim mënyra ku si kriter përdoret lartësia e dënimit me burgim, në kodin e procedurës penale të Kosovës përdoret në nenin 90 paragrafi 1.1 ku thuhet se urdhrat mund të përdoren për hetim të veprave penale të dënueshme me pesë (5) ose më shumë vjet burgim. Ndërsa sistemi i enumeracionit përdoret në paragrafin tjetër, pra 1.2 ku në mënyrë eksplicite përmenden veprat penale për të cilat urdhërohen masat.

- Rregullat procedurale që ndiqen me rastin e lëshimit të masave të fshehta

Me qëllim të aplikimit dhe zbatimit të masave të fshehta, përveç arsyeshmërisë ligjore e cila duhet të paraqitet në çdo kërkesë, Kodi i Procedurës Penale si kusht për fillimin e zbatimit të ndonjëres nga masat e fshehta ka rregulluar edhe procedurën dhe formën e cila duhet respektuar gjatë gjithë procedurës. Shkelja e këtyre rregullave ligjore sa i përket procedurës formale lidhur me zbatimin e masave të fshehta, ka pasoja procedurale në procesin gjyqësor sepse provat e siguruar në kundërshtim me procedurat e tilla konsiderohen të papranueshme.

Kodi i procedurës penale ka paraparë procedurën për fillimin dhe zbatimin e masave të fshehta, në të cilën procedurë janë parapa subjektet të cilat janë kompetente për lëshimin, monitorimin dhe zbatimin e masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit, si dhe përmbajtjen e kërkesave formale me të cilat fillohet kjo procedurë.

Në të gjitha rastet e mosrespektimit të procedurës për lëshimin dhe zbatimin e urdhrave gjyqësor ka pasoja ligjore procedural. Në rast se nuk është respektuar procedura për lëshimin e urdhrave apo në rast se gjatë zbatimit të urdhrave është tejkaluar apo nuk janë respektuar kushte dhe afatet sipas urdhrit kjo bënë që provat e siguruar përmes masave të tilla të jenë të pavlefshme dhe të papranueshme në procedurën gjyqësore.

- *Procedura lidhur me masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit*

Me qëllim të zbatimit të masave të fshehta, përveç arsyeshmërisë ligjore e cila duhet të paraqitet në çdo kërkesë, Kodi i Procedurës Penale si kusht për fillimin e zbatimit të ndonjëres nga masat e fshehta ka paraparë edhe procedurën formale e cila duhet respektuar gjatë gjithë procedurës. Mosrespektimi, apo tejkalimi i kushteve dhe kriterëve ligjore, lidhur me lëshimin, monitorimi

dhe zbatimin në praktik të masave të fshehta, krijon pasoja të pariparueshme meqenëse në procedurën gjyqësore, provat e siguruar në mënyrë të tillë konsiderohen të papranueshme.

Kodi i procedurës penale në masë të madhe ka rregulluar procedurën për lëshimin e masa të fshehta si dhe procedurat që duhet të ndiqen nga momenti i paraqitjes së kërkesës për një masë të tillë, gjithashtu është përcaktuar organi kompetente për lëshimin e masave, monitorimin dhe zbatimin e tyre. Përveç kësaj, me këto procedura është përcaktuar edhe forma dhe përmbajtja e kërkesës dhe vendimit me të cilin urdhërohet ndonjë nga masat e fshehta. Kërkesat e tilla që mund të parashtrihen janë si vijon:

- kërkesat për zbatimin e masave të fshehta, të cilat parashtrihen nga policia për prokurorin e shtetit, ose nga prokurori i shtetit drejtuar gjyqtarit të procedurës paraprake.
- urdhëresat për zbatimin e masave të fshehta, të lëshuara nga gjyqtari i procedurës paraprake, kurse në raste tjera të përcaktuara me ligj të lëshuara nga prokurori i shtetit.
- raporti mbi ecurinë e zbatimit të masave.

- *Paraqitja e kërkesës nga ana e policisë*

Nëse policia konsideron se është e nevojshme, atëherë mund të paraqesin kërkesë me shkrim drejtuar prokurorit të shtetit për të lëshuar ndonjë nga masat e fshehta të parapara me këtë kod. Kërkesa me shkrim, e cila është formë standarde administrative e policisë që përdoret për kërkesa dhe informata zyrtare, i drejtohet prokurorit përgjegjës që zbaton procedurën në lëndën konkrete, duke argumentuar se e vetmja mënyrë për të siguruar prova është zbatimi i masave të fshehta. Në kërkesën e parashtruar, policia njofton për veprimet të cilat nevojiten të ndërmerren, si dhe arsyetohet duke argumentuar se veprimet e ndërmarra deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për masa të fshehta nuk kanë qenë të mjaftueshme për të kryer hetimin e veprës penale.

Kërkesa për marrjen e urdhrit për ndonjë nga masat e fshehta përveç se bëhet me shkrim, ajo duhet të përfshijë edhe këto të dhëna:

- identitetin e zyrtarit të autorizuar policor,

- arsyet dhe faktet që mbështesin kërkesën dhe përmbushin kushtet e parapara që duhet të jenë përmbushur për lëshimin e secilës masë në veçanti;

- të dhënat lidhur me çfarëdo kërkesë paraprake të njohur për paraqitësin e kërkesës që ka të bëjë me personin e njëjtë dhe veprimet e ndërmarra nga zyrtari i autorizuar gjyqësorë lidhur me kërkesën e tillë⁴⁹⁶.

- *Paraqitja e kërkesës nga prokurori i shtetit*

⁴⁹⁶ Kodi Nr.04/L-123 i Procedurës Penale të Kosovës, Neni 91.3.

Nëse prokurori i shtetit ka dyshim të bazuar se është kryer ndonjë veprë penale për të cilat sipas kodit të procedurës penale mund të zbatohen masat e fshehta, është duke u kryer apo se së shpejti do të kryhet, prokurori i shtetit mund të autorizoj masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit. Autorizimi për masa të fshehta, mund të kërkohet apo të autorizohet nga prokurori i shtetit edhe atëherë kur nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm për identitetin e të dyshuarit/dyshuarve të cilët kanë kryer, janë duke kryer apo së shpejti do të kryejnë veprë penale.

Zakonisht, prokurori i shtetit i paraqet gjyqtarit të procedurës paraprake kërkesë për lëshim të urdhrave për masa të fshehta, përveç rasteve kur kodi i procedurës penale parasheh se prokurori mund të lëshojë urdhër të përkohshëm për zbatim të masave të fshehta. Raste të tilla janë rastet e procedurave urgjente, ose procedurat penale për krim të organizuar, për korrupsion zyrtar dhe vepra penale kundër detyrës zyrtare, si dhe në raste të shpëlarjes së parave nëse pritja e urdhërësës nga gjyqtari i procedurës paraprake do të rrezikonte sigurinë e hetimeve ose jetën dhe sigurinë e palës së dëmtuar, dëshmitarit, informatorit ose anëtarëve të familjes së tyre⁴⁹⁷.

Në raste të tilla, gjykata sipas detyrës zyrtare, mund të konfirmojë urdhrin e përkohshëm brenda tre ditëve duke e përcaktuar me shkrim ligjshmërinë e tij. Kërkesa e prokurorit të shtetit duhet të përmbledhë arsyet dhe faktet që duhet të plotësohen për zbatimin e masës së fshehtë. Atëherë kur kërkesa të jetë pranuar nga policia, prokurori i shtetit vlerëson arsyeshmërinë e kërkesës dhe përputhshmërinë e saj me dispozitat ligjore.

Kërkesa e prokurorit duhet të përmbajë edhe këto të dhëna:

- identitetin e prokurorit të shtetit;
 - identitetin e zyrtarit policor për zbatimin e masës
 - kushtet siç parashihen me nenin 88 të KPP, që nënkupton identifikimin e personit/të dyshuarit, sendit apo objektit, arsyet mbi dyshimin e bazuar, gjasën reale dhe kushte tjera.
 - arsyet dhe faktet që mbështesin kërkesën dhe përmbushin kushtet e parapara që duhet të mjaftueshme për lëshimin e secilës masë në veçanti;
 - llojin e masës që kërkohet të lëshohet
 - të dhënat lidhur me çfarëdo kërkesë paraprake të njohur për paraqitësin e kërkesës që ka të bëjë me personin e njëjtë dhe veprimet e ndërmarra nga zyrtari i autorizuar gjyqësorë lidhur me kërkesën e tillë.
- *Urdhrat e gjyqtarit të procedurës paraprake lidhur me masat e fshehta*

Secili nga masat e fshehta mund të urdhërohet nga gjyqtari i procedurës paraprake sipas kërkesës se prokurorisë së shtetit. Urdhrat e tillë lëshohen në formë të shkruar, duke respektuar standardet dhe kërkesat ligjore për nga përmbajtja, arsyzhmëria dhe kohëzgjatje e urdhrave të tillë.

⁴⁹⁷ Po aty: Neni 91.1.

Zbatimi i masave të fshehta në kundërshtim me dispozitat ligjore, për shumë gjyqtar, prokuror dhe mbrojtës, paraqet fushën ku të drejtat e njeriut mund të cenohen në afate më të gjata kohore dhe të sjellin pasoja rënda se sa veprimet tjera procedurale. Një pohim i tillë, argumentohet me faktin se masat e fshehta kërkohen, urdhërohen dhe zbatohen në mënyrë të fshehtë, pa dijeninë e të dyshuarit dhe mbrojtësit të tijë, të cilët nuk kanë mundësi që të kundërshtojnë ligjshmërinë e një urdhri të tillë, i cili urdhër jo vetëm që prekë privatësinë e të dyshuarit, por prekë edhe privatësinë e shumë personave tjerë që nuk janë të dyshuar, por që rastisin të pranojnë komunikime apo të kenë raporte me personin e dyshuar. Pikërisht për shkak të kësaj natyre të ndjeshme të zbatimit të masave të fshehta, gjyqtari procedurë paraprake obligohet që me kujdes të shqyrtojë kushtet që duhet plotësuar për lëshimin e urdhëresës për ndonjërin nga masat e fshehta, si dhe që në periudhë të caktuar kohore prej 15 ditësh nga data e lëshimit të urdhrit, zyrtari i autorizuar policor ti paraqes raport me shkrim në mënyrë që gjyqtarit, përndryshe ky obligim i gjyqtarit në përgjithësi gjatë të gjitha fazave të procedurës penale është përcaktuar me Kodin e procedurës penale, ku roli i gjyqtarit përshkruhet më së miri si garantues i të drejtave të cilin mes tjerash ka të detyrime eksplicite mbrojtjen e të drejtave të palëve, pra edhe të drejtave të cilat i përkasin të pandehurit.

Urdhëresa e gjyqtarit të procedurës paraprake për ndonjë masë të fshehtë bëhet me shkrim dhe përmban:

- emrin dhe adresën e personit/personave që i nënshtrohen urdhrit, nëse dihet numri i personave të prekur nga të dhënat dhe vendi i ngjarjes;
 - emërtimi zyrtar i masës dhe baza ligjore e saktë e saj;
 - në veçanti gjetjet e tanishme dhe gjasat reale⁴⁹⁸;
 - masa dhe koha e saktë e fillimit dhe përfundimit të saj nëse zbatohet, dhe
 - personin e autorizuar për zbatimin e masës dhe zyrtarin përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të tillë.
- *Raporti mbi zbatimin e urdhrit gjyqësor*

Me qëllim të përcjelljes së zbatimit të ligjshmërisë dhe arsyeshmërisë të zbatimit të masës së fshehtë, Kodi i Procedurës Penale ka parapa detyrimin për zyrtarin e autorizuar të policisë që ti paraqes raport me shkrim gjyqtarit të procedurës paraprake i cili e ka urdhëruar masën e fshehtë.

Raporti i tillë duhet ti paraqitet gjyqtarit të procedurës paraprake në intervale kohore 15 ditore që nga dita e lëshimit të urdhrit, policia raporton për rezultatet e arritura nga zbatimi i masës

⁴⁹⁸ Kodi i procedurës penale të Kosovës, në nenin 19, nën paragrafi 1.11 me “Gjasa reale” e përcakton bazën për urdhër për kontroll ose për të justifikuar ndërhyrjen e qeverisë në privatësinë e ndonjë personi. Posedimi i provave të pranueshme që do të bindte një vëzhgues objektiv që një veprë penale ka ndodhur, është duke ndodhur ose ka mundësi të konsiderueshme që do të ndodhë dhe se personi në fjalë ka gjasë të konsiderueshme të ketë kryer veprën penale.

së fshehtë, si dhe propozon mënyra tjera të cilat do të ndihmonin zbatimin e urdhrin në mënyrë sa më efikase.

Në çdo paqartësi, pamundësi për zbatimin e urdhrin apo ndryshimi i kushteve mbi të cilat është lëshuar urdhri, parqet detyrim për zyrtari i policisë që menjëherë të njoftoj gjyqtarin kompetent për rrethana të tilla. Në fund të gjitha materialet e siguruarra i dorëzohen prokurorit kompetent, pastaj ky i fundit ai dorëzon gjykatës për dosjen e hapur.

- *Zgjatja e urdhrin për masat e fshehta dhe teknike të hetimit dhe vëzhgimit*

Gjyqtari i procedurës paraprake lëshon urdhër për ndonjë masë të fshehtë i cili duhet të zbatohet për periudhën kohore prej 60 ditësh nga data e lëshimit të urdhrin. Por në rastet kur zbatimi i urdhëresës rezulton pa të dhëna apo me të dhëna të cilat janë të pamjaftueshme për hetimin veprës penale, si dhe njëkohësisht kushtet e parapara për lëshimin e urdhrin për masa të fshehta ende vazhdojnë të vlejnjë, atëherë zyrtari gjyqësorë mund të ripërtërijë urdhrin në mënyrë që procedura të vazhdojë edhe për një afat shtesë. Zgjatja e afatit të dhënë me urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake mund të zgjatet vetëm me propozim të prokurorit të shtetit.

Varësisht nga masa për të cilën kërkohet zgjatja e afatit, ripërtërija e urdhrin do të bëhet për afate shtesë të ndryshme:

Urdhri për vëzhgim të fshehte fotografik ose me video në vende publike, monitorim të fshehtë të bisedave, kontroll të dërgesave postare, përgjim të komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik, dërgim i kontrolluar i dërgesave postare, shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, hetim të fshehtë, regjistrim të thirrjeve telefonike ose zbulim të dhënave financiare mund të zgjatet më së shumti deri në gjashtëdhjetë ditë, i cili urdhër mund të ripërtërihet brenda afatit prej treqindgjashtëdhjetë (360) ditësh nga dita e lëshimit të urdhrin.

Urdhri për vëzhgim të fshehte fotografik ose me video në vende private apo përgjimi i telekomunikimeve mund të zgjatet deri në gjashtëdhjetë (60) ditë shtesë, por mund të ripërtërihet edhe për gjashtëdhjetë (60) ditë tjera shtesë.

Urdhri për blerje të simuluar të sendit ose për simulim të veprës së korrupsionit autorizohet vetëm për një blerje të sendit ose për një vepër të simuluar të korrupsionit. Zyrtari i autorizuar gjyqësor mund të lëshojë urdhër tjetër për personin e njëjtë kur parakushtet për urdhërimin e masës vazhdojnë të zbatohen dhe ka shpjegim të arsyeshëm për dështimin në sigurimin e ndonjë ose të gjitha të dhënave të kërkuara me urdhrin e mëparshëm.

- *Veprimet e policisë pas zbatimit të urdhrin për masën e fshehtë*

Pasi të përfundojë zbatimi i masës konkrete, zyrtari i autorizuar policor duhet t'ia dërgojë prokurori të shtetit të gjitha materialet e mbledhura-shkresat, shiritat dhe sendet tjera lidhur me urdhrin dhe zbatimin e tij, të cilat ai i ruan në vend të sigurt. Me atë rast dërgesat postare që

nuk përmbajnë të dhëna që do ta ndihmonin hetimin e veprës penale menjëherë duhet dërguar marrësit⁴⁹⁹.

- *Të drejtat e personave ndaj të cilëve zbatohet urdhrit*

Pas përfundimit të zbatimit të urdhrit të fshehtë, prokurori i shtetit ka obligim që çdo person i cili ka qenë subjekt i urdhrit të fshehtë, të informohet se ai ka qenë subjekt i atij dhe se ndaj tij janë zbatuar masat e fshehta. Njoftimi i cili bëhet me shkrim përmes postës rekomande, informon subjektin se ai ka të drejtë të parashtojë padi në gjykatë brenda 6 muajsh nga data e pranimit të njoftimit. Lidhur me obligimin që të bëhet njoftimi i personave të cilët i janë nënshtruar urdhrave për masa të fshehta, prokurori i shtetit, në përputhje me nenin 96.4 të Kodit të Procedurës Penale, ka obligim që lidhur me këtë ti njoftojë personat si në vijim:

Personat e synuar si dhe personat tjerë që janë prekur ndjeshëm gjatë zbatimit të urdhrit për vëzhgim të fshehtë fotografik ose me video, si dhe për shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes.

Në rast se është zbatuar urdhri për masën e fshehtë monitorim i fshehtë i bisedave në vende publike⁵⁰⁰, prokurori do ta njoftojë personat e synuar si dhe personat tjerë që janë prekur ndjeshëm gjatë zbatimit të urdhrit.

Për masën e fshehtë monitorim i bisedave në vende publike, prokurori i shtetit do të njoftojë: personin e akuzuar kundër të cilit është drejtuar masa, personat tjerë nën vëzhgim, si dhe personat që kanë poseduar ose jetuar në lokale nën vëzhgim në kohën kur masat kanë hyrë në fuqi.

Dërguesi dhe i adresuari i adresave postare do të njoftohen kur ndaj tyre të jetë zbatuar urdhri për masën kontrollim i dërgesave postare. Pjesëmarrësit në telekomunikime nën vëzhgim, si dhe në rastet kur është përdorur lexuesi IMSI, atëherë informohet edhe personi i synuar.

Prokurori i shtetit do të informojë pjesëmarrësit në telekomunikacionin përkatës se ata i janë nënshtruar masës regjistrim i thirrjeve telefonike.

Për urdhrin mbi masën hetim i fshehtë, prokurori i shtetit njofton personin e synuar, personat të prekur ndjeshëm në këtë mënyrë, si dhe personat në lokalet private të të cilëve nuk kanë qasje qytetarët dhe në të cilat ka hyrë hetuesi i fshehtë.

- *Pranueshmëria e provave të siguruar me masën e fshehtë*

Kodi i procedurës penale, parashihet pasojat juridike apo ligjore nëse maste fshehta janë lëshuar kundërshtim me këtë kod, apo zbatimi i tyre është bërë në kundërshtim me urdhrin gjyqësor lidhur me masën konkrete. Sa i përket zbatimit të urdhrit për masa të fshehta, kodi i procedurës

⁴⁹⁹ E drejta e procedurës penale, Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Prishtinë, 2013, fq.213.

⁵⁰⁰ Në botimin shqip të Kodit të Procedurës Penale është lëshuar gabim teknik në nenin 96 paragraf 4, nën paragrafi 4.2 ku fjala “private” duhet të jetë “publike” sikurse në versionin anglisht.

penale sipas nenit 97 ka paraparë se prova e siguruara nëpërmjet këtyre masave janë të papranueshme nëse urdhri për masën dhe zbatimin e saj është i kundërligjshëm.

Prova e cila është marrë nga monitorimi i fshehtë i bisedave në vende private, kontrollimi i dërgesave postare, përgjimi i telekomunikimeve, përgjimi i komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik, dërgimi i kontrolluar i dërgesave postare, shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, simulimi i blerjes së ndonjë sendi, simulimi i një veprë të korrupsionit ose hetimi i fshehtë lejohen vetëm në procedurë penale lidhur me veprën penale të përcaktuar me kodin procedurës penale ⁵⁰¹ për të cilën mund të lëshohet urdhri nga gjyqtari i procedurës paraprake.

Pas ngritjes së aktakuzës, para shqyrtimit të dytë i pandehuri dhe mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim ndaj provave të cekura në aktakuzë, mes tjerash, bazuar edhe në arsyen se provat nuk janë marrë në mënyrë të ligjshme nga policia, prokurori i shtetit ose nga organi tjetër qeveritar. Nëse i pandehuri ose mbrojtësi i tij paraqesin një kundërshtim të tillë, atëherë gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues vlerëson pranueshmërinë materialeve të mbledhura. Lidhur me vlerësimin e kundërshtimit, gjyqtari lëshon vendi ndaj të cilit mund të paraqitet ankesë. Por nuk është kjo faza e vetme pas ngritjes së aktakuzës kur vlerësohet pranueshmëria e provave të marra me masa të fshehta.

Pasi që aktvendimi mbi paligjshmërinë e urdhrimit merr formën e prerë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i cili drejton procedurën heq tërë materialin e mbledhur nga procesverbali dhe materialet e tilla ia dërgon Panelit për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit nëpërmjet kryetarit të gjyqtar themelore.

- *Paneli për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit*

Kodi i procedurës penale në kuadër të përcaktimeve të cilat kanë funksion mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ka paraparë edhe mekanizmin e Panelit për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit i cili ka këto autorizime ligjore:

- merr vendim mbi ankesën e ushtruar, fillimisht te kryetari i gjyqtar themelore, nga personat që konsiderojnë se i janë nënshtruar një mase të paligjshme apo një urdhri të paligjshëm për masat e fshehta, si dhe vendosë mbi kompensimin përkatës;

- vendos mbi kompensimin për personat ose personin që i nënshtrohen urdhrimit mbi zbatimin e masave të fshehta kur gjyqtari ka marrë aktvendim të formës së prerë se urdhri ose zbatimi i tija është i kundërligjshëm⁵⁰².

⁵⁰¹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 88, paragrafi 3.

⁵⁰² Aktvendimin tillë gjyqtari e merr në bazë të kundërshtimit të paraqitur nga i pandehuri ose mbrojtësi i tija para shqyrtimit të dytë, duke kundërshtuar pranueshmërinë e provave të marra në bazë të urdhrimit për masa të fshehta, Neni 97.3 i Kodi i Procedurës Penale të Kosovës.

Paneli për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit përbëhet nga tre gjyqtarë të cilët emërohen nga kryetari i gjyqtar themelore për të vendosur mbi ankimin konkret ose kompensimin ndaj aktvendimit konkret nga Neni 97.3 i Kodit të Procedurës Penale. Për kryerjen e funksioneve të saj, Paneli për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit mund të kërkoj nga zyrtarët e autorizuar të policisë dhe prokurorët e shtetit që ti sigurojnë dokumentet si dhe deklaratimet gojore.

Kur merr formën e prerë aktvendimi i gjyqtarit sipas të cilit urdhri për masën e fshehtë apo zbatimin e saj, aktvendimi i tillë është detyrues për Panelin për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit.

Ankesat e personave konsiderojnë se i janë nënshtruar urdhrit të paligjshëm për masat e fshehta i paraqiten kryetarit të gjyqtar themelore , i cili për ankesa ku pretendohet se është shkelur ligji emëron Panelin për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit. Gjatë vendosjes lidhur me këtë ankesë, nëse Paneli konstaton se masa apo urdhri për masën është i kundërligjshëm atëherë vendoset që të bëhet pushimi i urdhrit nëse është ende në fuqi, asgjësimi i materialeve të mbledhura, si dhe kompensimi i personit i cili i është nënshtruar urdhrit.

NËNKAPITULLI II

FAZAT E PROCEDURES PENALE

1. FAZAT E PROCEDURËS PENALE –

Procedura penale sipas kodit ndahet ne faza te caktuara. Kjo ndarje e fazave te caktuara ka disa qëllime. Ne radhe te pare përmes fazave ndahet kompetenca funksionale e gjyqtareve qe vepronë ne një çështje penale. Po ashtu përmes fazave krijohet zbatimi i ruajtjes se te drejtave te te akuzuarit ne procedure siç janë afatet qe nuk lejojnë tejkalimin e tyre ne faze te mëvonshme ndërmarrjen e veprimeve, nga se do te konsideroheshin si veprime jo te ligjshme tejkalimet e afateve. Po ashtu përmes ndarjes se fazave dhe ne ndërlidhje te afateve ligjore krijohet edhe standardi i një gjykimit te drejte dhe ne kohe te arsyeshme. Kodi ka përcaktuar katër faza te procedurës penale: **a).** Faza e hetimeve – e cila faze fillon me nxjerrjen e aktvendimit për fillimin e hetimeve; **b).** Faza e ngritjes se aktakuzës dhe deklarimit – kjo faze përbën veprimin e prokurorit kur ngritet aktakuza dhe deponimin e saj ne gjykate si dhe momentin kur i akuzuari deklarohet para gjykatës lidhur me akuzën; **c).** Faza e shqyrtimit – ne këtë faze çështja penale trajtohet ne proces ne raport me pretendimet e palëve dhe provave qe gjykata i administron ne shqyrtimin gjyqësor; **d).** Faza e mjeteve juridike – ne këtë faze trajtohen mjetet juridike ne nivel te shkalles se dytë⁵⁰³.

2. Parimet e fazës se hetimit – Hetimi ka disa qëllime parimore për te cilat zhvillohet e qe janë:

- a) Hetimi fillohet vetëm kur ka dyshim te arsyeshëm për veprën penale.
- b) Hetimi fillohet me qellim për te vlerësuar te gjitha rrethanat dhe provat si ato qe janë ne favor apo jo, për te pandehurit,
- c) Hetimi fillohet për te siguruar prova ne raport me veprën, dhe kryerësin e veprës penale.
- d) Hetimi ka si qellim qe pasi te mbledhë provat te vendose se a duhet te ngritet aktakuza apo duhet te pushohet hetimi⁵⁰⁴.

Hetimi duhet te zbatohet gjithnjë sipas këtyre parimeve ne te kundërtën shmangia nga parimet e hetimit munde te rezultojë me cenimin e dispozitave ligjore dhe për pasoj çështja penale te rrezikohet tërësisht qe te pushohet nga gjykata, e situata e tillë munde te vije qofte duke konstatuar se provat janë te kundërligjshme apo qofte duhet konstatuar se për shkak te provave te kundërligjshme nuk munde te rezultojë dyshimi për te dyshuarin se ka kryer vepra penale.

3. Hetimi apo ngritja e aktakuzës – Kur prokurori pranon kallëzimin penale dhe provat qe mbështesin kallëzimin penal, prokurori kur bindet se ka dyshim te arsyeshëm mund te filloj hetimin, e kur prokurori bindet prokurori se kallëzimi penal qe është ngritur ka prova te

⁵⁰³ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 68, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁵⁰⁴ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 103, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

mjaftueshme qe krijojnë dyshimin e bazuar te mire për veprën penale si dhe kur vepra qe konsiderohet se është kryer është e dënueshme me burgim jo me shumë se tri vite, atëherë mund te ngritet aktakuze e drejtpërdrejt.

4. Aktvendimi për Fillimin e Hetimit – Aktvendimi për fillimin e hetimeve është akti qe e nxjerr prokurori, dhe ne te cilin duhet te përmbaj te dhënat: 1. Te dhënat personale te te dyshuarit janë te dhënat gjenerale siç janë, emri, emri i prindit, mbiemri, data dhe vendi i lindjes, përgatitja shkollore, gjendja ekonomike, statusi shoqëror). Po ashtu duhet te konstatohet fakti se i dyshuari a është i ndaluar dhe prej cilës kohe si dhe po ashtu duhet te konstatohet nëse ka pasur masa te fshehta teknike te hetimit dhe vëzhgimit. 2. Gjendja faktike dhe kualifikimi juridik i veprës penale, (ne gjendjen faktike përshkruhen faktet qe konsiderohet qe kanë ndodhur e te cilat fakte përbëjnë elementet e figurës se veprës penale konkrete, ndërsa kualifikimi juridik është norma ligjore qe i nënshtrohet ajo gjendje faktike). 3. Koha e fillimit te hetimeve – koha e fillimit te hetimeve duhet te përshkruhet ne dispozitiv te aktvendimit qe nxjerrët dhe konstatohet dita, muaji dhe viti kur ka filluar hetimet prokurori i shtetit. 4. Arsyetimi i aktvendimit – ne arsyet e aktvendimit prokurori duhet te theksoj shkaqet qe kane quar ne fillimin e hetimeve pas vlerësimit dhe çmuarjes se bazës se kallëzimit penal dhe provave qe ka disponuar, se cilat prova konsideron se duhet te sigurohen dhe çfarë konsideron se ne zhvillimin e hetimeve do te synohet qe te sigurohet për tu vërtetuar ne raport me cilat fakte⁵⁰⁵.

Me fillimin e hetimeve çdo veprim hetimor zbatohet dhe mbikëqyret nga prokurori, dhe një kopje te aktvendimit duhet ta dorëzoj ne gjykate prokurori. Aktvendimi për fillimin e hetimeve mund ti bashkëngjitet kërkesave qe i parashtron prokurori lidhur me kontrollin, lidhur me masat për sigurimin e prezencës se te dyshuarit ne procedure apo edhe lidhur me masat e fshehta teknike te hetimit dhe vëzhgimit.

Hetimi i filluar sipas aktvendimit mund te behet vetëm për te dyshuarin qe është nxjerr aktvendimi dhe vetëm për veprën penale qe është filluar hetimi. Megjithatë aktvendimi për fillimin e hetimeve mund te pësoj ndryshime ne raport edhe me te dyshuar tjerë apo edhe me vepra tjera për te dyshuarit qe ka filluar hetimi, dhe se veprimet hetimor qe zbatohen bëhen edhe ne raport me veprat apo te dyshuarit qe është ndryshuar aktvendimi për fillimin e hetimeve.

5. Kontrolli si veprim hetimor - Urdhër kontrolli mund të bëhet, kur ka gjasa reale dhe shkak të bazuar se me kontrollin e objekteve apo lokaleve mund të sigurohen provat në procedurën penale, e që sipas kodit të procedurës penale⁵⁰⁶, mund të bëhet në dy baza:

1. Me pëlqimin që i pandehuri jep për kontroll; dhe
2. Me urdhrin për kontroll të lëshuar nga gjykata.

⁵⁰⁵ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 104, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁵⁰⁶ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 110, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

Baza e parë kur i pandehuri jep pëlqim për kontrollin e tillë, sendet që rezultojnë se gjinden me rastin e kontrollit mund të sekuestrohen dhe ato shërbejnë si prova të pranueshme.

Ndërsa nëse i pandehuri nuk jep pëlqimin sendet e gjetura gjatë kontrollit nuk mund të sekuestrohen dhe ato prova janë të papranueshme, përveç kur ndryshe përcaktojnë dispozitata specifike të Kodit.

Urdhër kontrolli sipas urdhrit të gjykatës, mund të bëhet vetëm po qesë ka parashtruar kërkesë prokurori në çdo fazë gjatë kohës së hetimit. Me urdhrin e tillë mund të urdhërohet kontrolli i shtëpisë, lokaleve, dhe pronës së të pandehurit kur ekziston dyshimi i bazuar se personi i tillë ka kryer veprë penale dhe ka shkak të bazuar se do të mundë të arrestohet kryerësi apo do të sigurohen prova të rëndësishme për procedurën penale.

Përfundimisht gjykata mund të lëshoj urdhër për kontroll edhe ndaj personit që nuk dyshohet se ka kryer veprë penale dhe atë në dy rrethana:

1. Kur ka gjasa se me urdhër kontroll do të arrihet të arrestohet i pandehuri, ose
2. Është e nevojshme të ruhen provat e veprës penale apo të konfiskohen sendet përkatëse të cilat nuk mund të ruhen apo të sigurohen pa zbatimin e kontrollit, dhe kur ka gjasa se provat apo sendet ndodhen në pasurinë që do të nënshtrohet kontrollit.

Urdhër për kontroll gjyqtari mund të urdhëroj edhe ndaj personit të caktuar, kur ka gjasa se do të rezultojë me sigurimin e gjurmëve ose në konfiskimin e provave të një veprë penale.

Urdhri për kontroll duhet të përmbajë:

- Identitetin e vendit apo personit ndaj të cilit lëshohet urdhrin,
- Përshkrimin e veprës penale për të cilën lëshohet urdhri,
- Shpjegimin e arsyeve për shkakun e bazuar,
- Përshkrimin e sendeve të kërkuara me kontroll,
- Përshkrimin e veçantë të personit apo vendit ku zbatohet kontrolli dhe të dhënat tjera të rëndësishme,
- Kur ka shkak të bazuar që të kontrollohen pajisje elektronike, ato duhet të përshkruhen me saktësi dhe ato sekuestrohen përkohësisht të cilat mund të kontrollojë zyrtari i autorizuar policor dhe të kopjoj,

Kushtet e njëjta duhet të zbatohen për kontroll në vetura në pjesët e vendeve të fshehta ose në mjete tjera të transportit.

Urdhër kontrolli duhet të zbatohet brenda afatit prej 48 orëve nga momenti i lëshimit, dhe në parim duhet të fillojë kontrolli në ora 06:00 dhe gjer në ora 22:00, por kontrolli mund të vazhdojë kur nuk është arritur të përfundohet deri në ora 22:00 ose kur ka arsye për kontroll pa urdhër të gjykatës.

Urdhri i cili nuk është i ligjshëm konsiderohet se mund të shpallen të gjitha provat e papranueshme pasi që rezultojnë se janë siguruar mbi një bazë të aktit të paligjshëm.

Përkundër se duhet të ekzistoj urdhri për kontroll, njëkohësisht dispozitat e kodit të procedurës penale obligojnë që edhe me rastin e zbatimit të urdhër kontrollit të respektohen kërkesat ligjore në zbatim nga se për shkak të zbatimit në kundërshtim me dispozitat ligjore mundë të shpallen të gjitha gjetjet si prova të papranueshme.

Para se të fillohet kontrolli personit ndaj të cilit është urdhëruar, i prezantohet urdhri dhe duhet të njoftohet se ka të drejtë të njoftoj avokatin e tij.

Kur personi kërkon të shfrytëzoj të drejtën për njoftimin e avokatit atëherë kontrolli nuk mundë të filloj, pa pritur në kohëzgjatje prej 2 ore, përveç në raste të ngutshme mund të fillohet kontrolli pa përfunduar afati prej 2 orësh.

Para fillimit të kontrollit personit i kërkohet që vullnetarisht të dorëzoj sendet që kërkohen apo personin që kërkohet.

Përyjashtimisht kontrolli mund të filloj pa prezantimin e urdhrit apo pa kërkesë për dorëzimin e sendeve kur pritet që të ketë rezistencë të armatosur ose kur ka mundësi të dështoj efekti i kontrollit poqëse nuk zbatohet menjëherë.

Dispozitat përcaktojnë se për çdo veprim të kontrollit, duhet të ketë kufizime të caktuara dhe se gjatë kontrollit duhet të ekzistojnë dy dëshmitar prezent. Normalisht kontrolli ndaj personit zbatohet nga zyrtari i policisë së gjinisë së njëjtë. Kur behet kontrolli i shtëpisë apo lokaleve, ato duhet të kihet kujdes për të mos u dëmtuar çoftë hyrjet apo edhe mobilet, dhe vetëm kur ka refuzim për ti hapur, ato mundë të hapen me forcë, apo kur pronari i tyre nuk është i pranishëm po ashtu mund të hapen me forcë.

Për kontrollin që zbatohet duhet të përpilohet procesverbali, në të cilën konstatohen të dhënat se kur ka filluar dhe kur ka përfunduar kontrolli, kush ka udhëhequr kontrollin, identitetin e dëshmitarit, prezencën e pronarit nëse është prezent apo nuk është, konstatimin e sakte se çfarë dhe ku është gjetur, regjistrimin e saktë të sendeve që sekuestrohen përkohësisht duke bërë fiksimin e tyre dhe shënjimin e gjurmës, ku vendoset në qese të dukshme, për tu ekzaminuar më tutje.

Gjate zbatimit të kontrollit duhet të sekuestrohen përkohësisht vetëm sendet dhe shkresat që janë specifikuar në kontroll, megjithatë poqë se haset në sende që kanë të bëjnë me ndonjë vepër tjetër penale ato sekuestrohen sipas nenit 109 dhe 112 te kodit të procedurës penale, ku prokurori njoftohet për sendet e gjetura dhe mund të filloj procedurën penale për vepër që ndërlihet me sendet e gjetura e për të cilat nuk është lëshuar urdhri për kontroll.

Neni 111 i kodit ka paraparë në mënyrë shprehimore, se kur provat e siguruar përmes kontrollit konsiderohen të papranueshme⁵⁰⁷ e që janë:

1. Provat që janë marre gjatë kontrollit pa urdhër të gjykatës nëse kontrolli nuk merr aprovim të gjykatës sipas dispozitave të kushtetutës,
2. Kur kontrolli është zbatuar pa urdhër të gjyqtarit kompetent në kundërshtim me dispozitat e kodit;
3. Urdhri për kontroll është lëshuar në kundërshtim me procedurën e paraparë në kod;
4. Përmbajtja e urdhrin të gjyqtarit është në kundërshtim me kushtet e parapara me kod,
5. Kontrolli është zbatuar në kundërshtim me urdhrin e gjyqtarit;
6. Personat prania e të cilëve është e detyrueshme nuk kanë qenë gjate zbatimit të kontrollit;
7. Dhe kur kontrolli është zbatuar në kundërshtim me dispozitat e kufizimit të kontrollit.

Të gjitha këto rrethana rezultojnë në papranueshmërinë e provave që janë siguruar me anë të urdhër kontrollit, çoftë kur kontrolli është zbatuar me urdhër apo kur kontrolli është bërë pa urdhër të gjykatës, pra varësisht nga rrethanat provat e tilla mundë të shpallen si prova të papranueshme.

Ekspertimi

Kodi i procedurës penale ka përcaktuar një mori të llojeve të ekspertimit që mundë të sigurohen në procedurën penale⁵⁰⁸, po ashtu ka përcaktuar edhe kushtet dhe mënyrën e sigurimit të ekspertimit.

Si kushte që janë paraparë për marrjen e ekspertimit si prove kodi i ka përcaktuar që janë:

- Duhet të jetë në pyetje fajësia apo pafajësia e të pandehurit ose shkalla e dëmit të shkaktuar me vepër penale dhe se kjo mund të dihet vetëm me angazhimin e ekspertit të fushës;
- Eksperti duhet të ketë përvojë dhe trajnime të specializuara që relevante dhe aktual;
- Eksperti duhet t'i ketë shqyrtuar provat e siguruar në mënyrë të ligjshme;
- Ekspertimi bazohet në praktika të pranuar te asaj fushe apo në bazat shkencore dhe teknike të fushës;
- Ekspertiza duhet të përmbaj metodat e përdorura te analizimit dhe konkluzionin;
- Eksperti nuk mund të shfaq mendimin e tij për fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit;
- I pandehuri mund të kërkoj nga prokurori që të marr deklaratë nga eksperti;
- Viktima po ashtu mund të kërkoj nga prokurori që të marr deklaratë nga eksperti.

⁵⁰⁷ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 111, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁵⁰⁸ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 136, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

Si lloj të ekspertimit që Kodi ka përcaktuar se zbatohen dispozitat e njëjta për çdo lloj ekspertize/analize, janë paraparë:

- Analizat toksikologjike;
- Ekzaminimet e lëndimeve trupore dhe fizike;
- Analiza molekulare dhe gjenetike e ADN-së;
- Analiza psikologjike;
- Analiza kompjuterike;
- Analiza financiare;
- Ekzaminimi psikiatrik.

Analiza Toksikologjike – kur dyshohet se ne kryerjen e veprës penale është përdorur veprimi me helmim, Prokurori mund të urdhëroj që materialet e dyshimta të gjetura në kufomë apo në vende tjetër të dërgohen në institutin për hulumtimin toksikologjik. Gjer më tani këto analiza janë kryer nga ana e institutit mjekoligjorë ku ka edhe departamentin për toksikologji. Sipas ligjit për mjekësinë ligjore afati për përfundimin e analizës toksikologjike është 30 ditë e me se largu 60 ditë nga dita e pranimit të kërkesës për analizën e tillë. Ky afat sipas këtij ligji mund të zgjatet me miratimin me shkrim të drejtorit të institutit mjekoligjor⁵⁰⁹.

Ekzaminimi i lëndimeve trupore – kodi parasheh në realitet dy mënyra⁵¹⁰ të ekzaminimit të lëndimeve trupore që janë:

1. Ekzaminimi i lëndimeve sipas raporteve dhe shkresave të tjera të lëndës, dhe
2. Ekzaminimi fizik trupor në mënyrë të drejtpërdrejt me urdhëresën e gjykatës.

Kur kemi të bëjmë me ekzaminimet e lëndimeve bazuar në dokumentacione mjekësore apo sipas fotografive që policia ka siguruar lidhur me lëndimet trupore, në këto rrethana mund të kërkohet nga mjeku dhënia e deklaratës lidhur me lëndimet apo edhe mund të bëhet raport me shkrim lidhur me të gjeturat me rastin e trajtimit nga ana e mjekut.

Në rastet kur mjeku që ka trajtuar personin dhe për raste nuk ka të dhëna të plota apo nuk janë trajtuar, Prokurori mund të kërkojë që të urdhërohet nga gjykata një ekzaminim fizik.

Nga kjo na rezulton se në të vërtetë vetëm kur është e nevojshme që të ketë ekzaminim fizik të lëndimeve trupore atëherë ai ekzaminim urdhërohet.

Ligji për mjekësinë ligjore në mënyrë specifike ka përcaktuar se çfarë ekzaminohet tek aspekti fizik e që ka paraparë:

1.1. përcaktimin e mjetit, shkallën e lëndimeve trupore, humbjen e aftësisë për punë, gjendjen shëndetësore, simulimin, vetëdëmtimin;

⁵⁰⁹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 143, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁵¹⁰ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 144, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

1.2. rastet e veprave penale kundër integritetit seksual të përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi;

1.3. rastet e përcaktimit të moshës dhe identitetit të një personi, të shkallës së dehjes alkoolike dhe intoksikimit me lëndë narkotike;

1.4. rastet e transplantimit të kundërligjshëm të organeve, indeve dhe qelizave njerëzore.

Kur ekzaminimi fizik i lëndimeve trupore bëhet, sipas urdhëresës së gjykatës, atëherë gjykata mund të urdhëroj marrjen e mostrave të gjakut apo të indeve apo mostra të tjera, vetëm kur ka gjasa reale për të besuar se i pandehuri ka kryer veprën penale apo ka shkak të bazuar, se me marrjen e mostrave do të sigurohen prova të veprave penale ose identitetin e kryerësit, apo që mostrat e marra do të mund të krahasohen me mostra të tjera që ekzistojnë.

Megjithatë marrja e mostrave të, flokut, pështymës, urinës, sekretit të hundës, pjesës sipërfaqësore të lëkurës, thonjve, si dhe mostra të tjera të ngjashme që nuk përbëjnë ndërhyrje trupore, ato mund të bëhen gjatë ekzaminimit fizik pa urdhër të veçantë të gjykatës.

Ndërsa marrja e mostrave që përbëjnë ndërhyrje trupore ato mund të merren vetëm me urdhër të gjykatës apo me pëlqimin e personit që ekzaminohet.

Ekzaminimi fizik duhet të bëhet vetëm nga mjeku, infermieri apo tekniku i kualifikuar dhe trajtimi bëhet në përputhje me shkencën mjekësore, dhe me respekt e dinjitet dhe konsideratën e trajtimit të tillë.

Analizat molekulare e gjenetike dhe analizat e ADN-ës – kjo analizë kryhet vetëm me urdhër të gjykatës, për mostrat e marra me qëllim të ekzaminimit, kur është e nevojshme për të përcaktuar prejardhjen ose për të vërtetuar se gjurma e marrë i përket të pandehurit apo të dëmtuarit.

Indi qelizorë i marrë si mostër, posa të përdoret për identifikim të ADN-ës, duhet të shkatërrohet pa vonesë, ndërsa çdo informacion i siguruar nga indi i tillë nuk është i pranueshëm përveç ADN-ës.

Kur provat/gjurmët e gjetura në vendin e kryerjes së veprës penale që sigurohen pa ndonjë ndërhyrje, ato mund të urdhërohen për analizën molekulare dhe gjenetike, vetëm me urdhër të prokurorit. Kur këto rezultate nuk përputhen me të pandehurin ato mund të ruhen derisa të këtë përputhshmëri me të pandehurin apo deri sa i pandehuri të lirohet apo shpallet fajtor.

Analiza psikologjike – kjo formë e analizës psikologjike rregullohet brenda dispozitës së nenit 146 të Kodit të procedurës penale⁵¹¹, mund të bëhet në dy rrethana:

1. Kur i pandehuri ka qenë në trajtim te psikologu;
2. Dhe kur i pandehuri nuk ka qenë në trajtim te psikologu:

⁵¹¹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 146, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

Në rrethanën e parë kur i pandehuri ka qenë në trajtim te psikologu dhe kur gjendja psikologjike lidhet me veprën penale ai psikolog apo mjek mund të thirret nga prokurori për të dhënë deklaratë në procedurë paraprake lidhur me të dhënat e marra në trajtimin e të pandehurit (që trajtimi ka qenë në rrjedhe normale – pra jo për shkak të ndonjë vepre penale). Të dhënat e tillë mund të merren me urdhër të gjykatës apo me pëlqim nga psikologu, dhe po ashtu psikologu mund të përpiloj raport mbi të dhënat e gjetura në analizën psikologjike.

Në rrethanën tjetër kur gjendja psikologjike e një personi nuk është trajtuar më parë nga ndonjë psikolog apo mjek, atëherë mund të kërkoj prokurori nga gjyqtari i procedurës paraprake të urdhëroj që të bëhet vlerësimi psikologjik. Vlerësimi psikologjik mund të urdhërohet nga gjyqtari i procedurës paraprake, vetëm nëse gjen se vlerësimi psikologjik ka shkak të bazuar për të rezultuar me prova relevante për procedurën penale. Megjithatë personi që duhet të vlerësohet ka të drejtë që të japë pëlqim për vlerësim psikologjik dhe atëherë vlerësimi bëhet pa urdhër të gjykatës.

Në analizën psikologjike kërkohet që të vlerësohet gjendja psikologjike e të pandehurit për të konstatuar se gjendja psikologjike e të pandehurit është paaftësuar ose ka qenë e paaftësuar në kohën e kryerjes së veprës penale. Kjo ka rëndësi pasi që determinon edhe zhvillimin e procedurës penale e po ashtu edhe gjykimin e drejt, natyrën e sanksionit penal që mund të caktohet.

Ekzaminimi psikologjik bëhet nga psikologu, mjeku profesionist apo i trajnuar për psikologji apo psikiatri. Ekzaminimet duhet të kryhen në atë mënyrë që respektohet privatësia e të pandehurit.

Analiza kompjuterike – kodi ka përcaktuar se çdo lloj i pajisjes teknike që mund të mbaj të dhëna e që mund të siguroj informacione apo prova në procedurën penale, mund të nënshtrohet analizës kompjuterike⁵¹². Më saktësisht pajisjet kompjuterike, teknologjike apo pajisjet tjera të ruajtjes apo të ngjashme e të cilat janë marrë në mënyrë të ligjshme përmes urdhrin të gjykatës ose me pëlqim, prokurori mund të urdhëroj ekspertin apo zyrtarin e autorizuar policor për të shqyrtuar, analizuar dhe kërkuar informata në atë pajisje.

Megjithatë Kushtetuta ka përcaktuar në nenin 36 “të Drejtën e Privatësisë” ku në paragrafin 3 është paraparë, “Fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimit tjetër, është e drejtë e pacenueshme. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm përkohësisht, në bazë të vendimit gjyqësor, nëse është e domosdoshme për ecurinë e procedurës penale ose për mbrojtjen e vendit, në mënyrën e parashikuar me ligj”.

Në këtë standard kushtetues është përcaktuar se kufizimi mund të bëhet vetëm me anë të urdhëresës gjyqësore, ndërsa dispozita nga neni 147, ka përcaktuar se prokurori i shtetit mund të autorizoj ekspertin apo zyrtarin e autorizuar të policisë, çka nënkupton se dispozita ligjore e ulë standardin kushtetues, nga se urdhri i gjykatës shpeshherë mund të ekzistoj për marrjen e sendit si provë në procedurë penale p.sh. Telefonin, mirëpo ekzaminimi domosdo duhet të

⁵¹² Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 147, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

urdhërohet nga gjykata pasi që është standard kushtetues që vetëm gjykata mund të kufizoj të drejtën e privatësisë, ndërsa kur ka dhënie të pëlqimit atëherë prokurori mund të kërkoj nga eksperti apo zyrtari i autorizuar i policisë analizën kompjuterike.

Me rastin e raportit të analizës kompjuterike, duhet të specifikohet mjeti kompjuterik që analizohet, çfarë saktësisht është autorizuar që të kërkohet, duhet të përmbaj të dhëna për mënyrën e marrjes së pajisjes së tillë për analizën kompjuterike, tregohen hapat që janë ndërmarr për analizën kompjuterike të ndjekur sipas praktikës së forenzikës duke përfshirë hapa të sigurt dhe të cilët nuk mundësojnë humbjen e të dhënave që kërkohen, deshifrim të dosjeve rikthim të dosjeve të fshira e kështu me radhë. Përveç raportit duhet dorëzuar edhe kopja elektronike që përfshinë procesin e analizës kompjuterike.

Analiza Financiare – kodin ka përcaktuar po ashtu dy mundësi të analizës financiare⁵¹³, për qëllim të sigurimit të provave në procedurën penale, e që janë:

1. Analizën e të dhënave financiare të siguruar me urdhër gjyqësor;
2. Auditimin e të dhënave financiare përmes urdhrit gjyqësor.

Në situatën e parë, kur të dhënat financiare janë siguruar përmes urdhrit gjyqësor ose me pëlqim, prokurori mund të kërkoj nga eksperti apo nga zyrtari i autorizuar i policisë, që ti shqyrtoj dhe ti analizoj duke i përmbledhur të dhënat financiare.

Prokurori ka të drejtë që të kërkoj analizën se:

1. Mjetet financiare a janë dobi e veprës penale të supozuar se është kryer apo janë përdorur në kryerjen e veprës penale;
2. Cilat janë lëvizjet e mjeteve financiare e që mund të jenë dobi e veprave penale apo që janë përdorur në kryerjen e veprave penale;
3. Nëse mjetet financiare mungojnë për shkak të veprave penale dhe çfarë mjeteve dhe metoda janë përdorur;
4. Dëmin material të shkaktuar, përfitimin material të shkaktuar; shumën e tatimeve apo doganave si detyrim që janë, apo çështje tjera relevante për procedurën penale.

Në situatën e dytë kur bëhet auditimi i të dhënave financiare, kjo zakonisht bëhet kur ka material vëllimor mbi veprat e kryera financiare, apo kur ka ndërlikime të të dhënave financiare, atëherë prokurori mund të kërkoj nga gjykata që të urdhëroj auditimin e të dhënave financiare.

Gjykata në urdhër saktëson qëllimet dhe fushëveprimin e auditimit dhe faktet e rrethanat tjera që duhet të konstatohen nga auditimi.

⁵¹³ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 148, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

Duhet të kemi parasysh se shpenzimet këtu duhet të mbulohen nga ndërmarrja që urdhërohet auditimi. Aktvendimi mbi shpenzimet mund të atakohet dhe kundër këtij aktvendimi vendos kolegji prej tre gjyqtarësh.

Ekzaminimi psikiatrik – Ekzaminimi psikiatrik mundë të bëhet me propozimin e prokurorit në fazën e hetimeve apo edhe zyrtarisht në shqyrtimin gjyqësor⁵¹⁴. Ekzaminimi psikiatrik bëhet ndaj të pandehurit që dyshohet se ka ndonjë çrregullim psikik. Ekzaminimi psikiatrik nuk mund të bëhet ndryshe përveç me urdhër gjyqësor, çdo ekzaminim tjetër pa urdhër gjyqësor është provë e papranueshme. Me ekzaminimin psikiatrik, gjykata kërkon që të përcaktohet, gjendja e aftësisë së të pandehurit, dhe po ashtu gjendja e tij për t'iu nënshtruar gjykimit.

Ekzaminimin psikiatrik e kryen grupi i ekspertëve pranë institutit të psikiatrisë forenzike, e që janë neuropsikiatri dhe psikiatri apo edhe psikolog.

Gjendja psikike e të pandehurit, kur konstatohet nga ekspertët ajo duhet që të saktësohet, se i pandehuri a vuan nga ndonjë çrregullim psikik dhe gjendje psikike që ka vepruar në kohën e kryerjes së veprës penale, a është në gjendje të paaftësisë së plotë mendore apo në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore. Po ashtu konstatohet nëse ka ndonjë çrregullim të përhershëm apo të përkohshëm psikik.

Ndërsa gjendja e aftësisë për të iu nënshtruara gjykimin nënkupton paaftësinë e të pandehurit për të kuptuar procedurën penale dhe për tu konsultuar me mbrojtjen e tij, për pasoj një gjendje e tillë e bënë të paaftë për t'iu nënshtruar gjykimit në procedurën penale.

Edhe këtu ekspertët duhet të kenë përvojën në fushat e tilla dhe të zbatojnë me dinjitet dhe respekt procedurën e ekzaminimit psikiatrik ndaj të pandehurit, duke aplikuar praktikat më të mira mjekësore dhe të bazuara në shkencën e mjekësisë.

Vendimet për angazhimin e ekspertit

Prokurori i shtetit para angazhimit të ekspertit, nxjerr vendim në të cilin i paraqet ekspertit çështjet e rëndësishme për ekspertim që janë:

1. Pyetjet specifike të shkruara që janë të rëndësishme për fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e dëmit të shkaktuar me vepër penale;
2. Përcakton emrin e ekspertit dhe paraqet bazën për ekspertim të specializuar dhe shkollimin dhe përvojën e tij;
3. Po ashtu i siguron ekspertit qasje të duhur në shkresa për ekspertim specialistik.

Në parim duhet të angazhohet eksperti nga institucionet profesionale apo organet publike që ofrojnë ekspertizën e tillë në institucionet publike, nëse nuk krijohet konflikt i interesit. Kur nuk ka institucion profesional apo organ publik me ekspert të fushës së tillë atëherë angazhohet

⁵¹⁴ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 508, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

eksperti që shpenzimet mbulohen me fondet publike dhe në fund shpenzimet përbëhen pjesë të procedurës penale.⁵¹⁵

Kur prokurori angazhon ekspertin atëherë, viktimata apo mbrojtësi i viktimave, i pandehuri apo mbrojtësi i të pandehurit, mund të kundërshtojnë përzgjedhjen e ekspertit të tillë, dhe lidhur me kundërshtimin vendos gjyqtari i procedurës parapake në afat prej 10 ditëve. Baza për kundërshtim mund të jetë në kualifikimin e ekspertit apo për shkak të konfliktit të interesit. Ekspertizat e caktuara mund të kryhen vetëm me urdhër gjyqësor, zakonisht të tillë urdhra janë ata që kanë një ndërhyrje në të drejtat dhe lirit e njeriut, megjithatë kodi specifikon për secilën ekspertizë se kush e urdhëron.

Angazhimi i ekspertit nga i pandehuri

I pandehuri mund të kërkojë nga prokurori i shtetit angazhimin e ekspertit të caktuar për të kryer ekspertizën që konsideron se është relevante për mbrojtjen e tij. Në rast se prokurori refuzon atëherë i pandehuri mund të kundërshtoj këtë refuzim tek gjyqtari i procedurës parapake. Dispozita e nenit 141 paragrafi 2 i japë të drejtë të pandehurit që vet të angazhojë ekspert⁵¹⁶ dhe të paguaj atë, e cila dispozitë detyron ekspertin që të veproj në pajtim me nenin 138 – që nënkupton detyrimin e ekspertit dhe përpilimin e raportit sipas kësaj dispozite. Një kopje e ekspertizës duhet të dërgohet prokurorit në afat prej 14 ditësh nga përfundimi i aktekspertimit.

Konsiderojmë se këto dy dispozita janë paksa kontradiktore ndërmjet tyre, pasi që kur ka mundësi sipas paragrafit 2 të angazhojë vetë ekspert atëherë cila është arsyeshmëria që të varet kërkesa e të pandehurit te prokurori për angazhimin e ekspertit, sipas paragrafit 1 të nenit 141 të Kodit të Procedurës Penale.

Përmbajtja e raportit të akt ekspertimit

Pas angazhimit të ekspertit qoftë sipas vendimit të prokurorit apo urdhëresës gjyqësore, eksperti ka detyrim që të përpilojë raportin e ekspertimit mbi ekspertizën e kryer⁵¹⁷. Raporti i akt ekspertimit duhet të përmbajë: Të dhënat mbi identitetin e ekspertit, përvojën dhe trajnimet e specializuara arsyet mbi relevancën e trajnimeve dhe aktualitetin e tyre, të dhënat mbi hetimin e çështjes, pyetje që ndërlidhen me fajësinë apo pafajësinë dhe shkallën e dëmit, përshkrimin e provave që janë analizuar, përshkrimi i ekspertizës si fotografi, imazhe, analiza laboratorike, tabela ose të dhëna të tjera shkencore apo teknike të rëndësishme. Shpjegimet se teknikat e tilla analitike janë të pranueshme në këtë fushë të ekspertimit dhe kanë bazë

⁵¹⁵ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 137, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁵¹⁶ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 141, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁵¹⁷ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 138, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

shkencore. Përfundimet e ekspertit në lidhje me pyetjet e parashtruara për çështjen e ekspertimit.

Raporti i ekspertit duhet ti bashkëngjitet shkresave të lëndës, dhe i zbulohet të pandehurit dhe mbrojtësit jo më vonë se 5 ditë kur eksperti do të japë deklaratë në procedurën paraprake apo jo më vonë se 10 ditë pasi që prokurori i shtetit ta ketë pranuar raportin.

Raporti i ekspertit nuk mund të përfshij mendim të tij lidhur me fajësinë e të pandehurit apo pafajësinë e tij.

Cilido raport që nuk përmban këto të dhëna është i papranueshëm si provë.

Këqyrja dhe rikonstruksioni

Këqyrja dhe rikonstruksioni i vendit të ngjarjes sipas dispozitave të kodit të procedurës penale ka rëndësi për të vlerësuar provat e mbledhura dhe po ashtu për të shqyrtuar faktet e rëndësishme për procedurën penale⁵¹⁸.

Këqyrja dhe rikonstruksioni mund të bëhet nga policia apo edhe nga prokurori, e kjo bëhet me qëllim që të njoftohen personalisht me gjendjen e fakteve të rëndësishme për procedurën penale, mirëpo as këqyrja dhe as rikonstruksioni nuk konsiderohen si rezultate të pranueshme për gjykatën nëse:

Nuk është njoftuar i pandehuri kur identiteti i tij është i njohur e ku ka të drejt edhe mbrojtësi që të jetë prezent në këqyrje dhe rikonstruksion, apo

Kur nuk dihet identiteti i të pandehurit atëherë në këqyrje dhe rikonstruksion merr pjesë gjyqtari i procedurës paraprake dhe mbikëqyr veprimet e këqyrjes dhe rikonstruksionit të vendit të ngjarjes.

Këqyrja nënkupton këqyrjen e ngjarjes konkrete të vendit ku ka ndodhur vepra penale.

Rikonstruksioni nënkupton riprodhimin e fakteve të sakta sikurse ka ndodhur ngjarja në të kaluarën. Kjo bëhet bazuar në provat e mbledhura për veprën penale, mirëpo kur nga deklaratimet e dëshmitarëve dhe provat tjera rezulton një gjendje tjetër atëherë, zbatohet rikonstruksioni me secilin dëshmitar veç e veç.

Rikonstruksioni i vendit të ngjarjes ka për qëllim që të analizohen faktet në raport me provat e mbledhura për të ardhur deri te konkludimet sa më të pranueshme të saktësisë së ngjarjes, mirëpo duhet pasur kujdes që të mos cenohet rendi dhe ligji, të mos fyhet morali publik apo të mos vihet në rrezik jeta ose shëndeti i njerëzve.

Këqyrjen dhe rikonstruksionin e vendit të ngjarjes mund ta ndihmojnë ekspertët e ndryshëm që lidhen me fushën e natyrës së veprës penale. Megjithatë këqyrja dhe rikonstruksioni nuk

⁵¹⁸ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 158, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

nënkuptojnë absorbim të kompetencave të policisë për të bërë shikimin e vendit të ngjarjes fillestare, matjet dhe marrjen e informatave.

Karakteristikë është fakti se kur bëhet këqyrja fillestare nga policia, mundë të rezultojnë ato të dhëna edhe në raportin e ekspertit të fushës së caktuar në raport me veprimet fillestare të policisë. Në këto rrethana gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhëroj një këqyrje dhe rikonstruim minimal të vendit të ngjarjes për të vërtetuar gjetjet e raportit të ekspertit, dhe gjyqtari mund ta konsideroj si të pranueshëm raportin e ekspertit, që është përpiluar sipas nenit 138 të kodit të procedurës penale.

Eksperti po ashtu mund të thirret në këqyrje dhe rikonstruim kur vlerësohet nga prokurori apo nga gjykata se prania e tij është e dobishme.

Pas ngritjes së aktakuzës, rikonstruimin e vendit të ngjarjes mund ta urdhëroj kryetari i trupit gjykues. Rikonstruimi urdhërohet vetëm kur varet për fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit dhe kjo mundëson që trupi gjykues të vlerësoj drejtpërdrejt nga rikonstruksioni apo nga vizita e drejtpërdrejt në vendin e ngjarjes. Edhe këtu mundë të kërkohet që eksperti të jetë i pranishëm me rastin e rikonstruimit të vendit të ngjarjes.

Kërkesat ndërkombëtare apo provat e siguruara jashtë vendit

Provat në përputhje me dispozitat e kodit të procedurës penale mund të sigurohen edhe duke u bazuar në nenin 219 që ka të bëjë me kërkesat ndërkombëtare dhe ligjin për bashkëpunimin juridik në çështjet penale⁵¹⁹. Provat e tilla mund të sigurohen nga prokurori apo nga gjyqtari i procedurës paraprake me kërkesën e parashtruar të prokurorit.

Varësisht nga natyra e çështjes penale që hetohet mund të parashtrohen edhe kërkesat e ndryshme për çfarëdo prove që mund të lidhet me veprën penale.

Kur provat sigurohen përmes bashkëpunimit juridik ndërkombëtar me shtetin përkatës ato prova konsiderohen të ligjshme, dhe mund të administrohen në shqyrtimin gjyqësorë nga se janë të pranueshme.

Kur provat sigurohen në rrugë jo formale pa u zbatuar kërkesat sipas ligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar, atëherë për tu konsideruara të pranueshme provat e tilla në procedurën penale duhet që shteti ku janë siguruara ato të lëshoj deklaratë mbështetëse që konfirmon se provat e tilla janë marrë në përputhje me dispozitat ligjore në shtetin përkatës.

⁵¹⁹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 219, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

Provat e pranueshme dhe vlerësimi i tyre

Provat e pranueshme janë të gjitha ato që janë siguruar në përputhje me dispozitat e kodit të procedurës penale. Cilado provë që është siguruar në kundërshtim me ndonjë dispozitë të kodit të procedurës penale ajo si e tillë mund të shpallet si provë e papranueshme.

Pranueshmëria e provave mund të shqyrtohet në çdo fazë të procedurës penale, çka nënkupton se pranueshmëria e provave mund të shqyrtohet që nga momenti i shqyrtimit fillestar e deri kur vendimi të merr formën e prerë.

Kur provat shqyrtohen për pranueshmërin e tyre në fazën e shqyrtimit fillestar dhe pas mbajtjes së shqyrtimit të dytë, ato mund të shqyrtohen bazuar në kundërshtimin e parashtruar nga i pandehuri. Ndërsa po ashtu gjykata detyrohet zyrtarisht të vlerësoj pranueshmërin e provave gjatë gjithë fazës së procedurës së shqyrtimit gjyqësor.

Në fazën e shqyrtimit të dytë kur vlerësohet pranueshmëria e provave duhet të kemi parasysh se provat vlerësohen në dy aspekte paralele:

1. Pranueshmëria e tyre;
2. Provueshmëria e tyre vetëm për sa i përket ekzistimit të dyshimit të bazuar të mirë;

Dilemat në praktik kanë qenë se në fazën e shqyrtimit të dytë nuk duhet të ketë vlerësim të provave, megjithatë konsideroj se vlerësimi i provave duhet gjithsesi të ekzistoj edhe për sa i përket provueshmërisë, pasi që kemi të bëjmë me vërtetimin e faktit se a bindet një vëzhgues objektiv se aktakuza mbështete në prova për rrethanat që pretendohet se është kryer vepra penale, nga të cilat prova rezulton dyshimi i bazuar i mirë.

Në të kundërtën në këtë fazë të procedurës nuk mund të ketë vlerësim të provave për sa i përket rrethanave për aspektin e fajësisë, në këtë fazë të procedurës.

Kodi po ashtu përcakton në nenin 262 kufizimet në vlerësim të provave për përcaktimin e fajësisë, që sipas kësaj dispozite, nuk duhet të shpallet i akuzuari fajtor duke u mbështetur në një dëshmi apo duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi në ndonjë fazë të procedurës, apo në një deklaratë apo duke i dhënë rëndësi vendimtare deklaratimit të dhënë nga i pandehuri në polici apo para prokurorit, apo duke u bazuar në një deklaratë apo duke i dhënë rëndësi vendimtare deklaratës së një dëshmitari identiteti i të cilit është i panjohur për mbrojtësin dhe të akuzuarin, apo duke i dhënë rëndësi vendimtare një deklaratë apo një dëshmie të dëshmitarit bashkëpunues.

Marrja në pyetje në procedurë paraprake

Prokurori ka te drejtë që të thërret për marrje në pyetje në procedurë paraprake çdo person që mund të ketë informacione që mund të jetë i vlefshëm për veprën penale që zhvillon hetimet, apo edhe për kryerësin. Marrjen në pyetje në procedurë paraprake e bënë prokurori gjatë fazës

së hetimit, dhe mund ta bëjë ndaj dëshmitarëve, ekspertëve, viktimës, dëshmitarit bashkëpunues apo dëshmitarit anonim⁵²⁰.

Gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake, prokurori mund të lejoj pjesëmarrjen e mbrojtësit, viktimën apo mbrojtësin e viktimave që të merr pjesë në marrjen në pyetje.

Gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake duhet të mbahet audio incizim apo të transkribohet fjalë për fjalë.

Para marrjes në pyetje në procedurë paraprake, varësisht se a kemi të bëjmë me dëshmitar, apo ekspertin, prokuroria obligohet që t'i bëjë me dije pasojat ndaj dëshmitarit apo ekspertit:

Për dëshmitarin duhet lexuar ky paralajmërim: "Ky është një hetim penal. Ju jeni i detyruar të dëshmoni. Ju jeni i detyruar të tregoni të vërtetën. Nëse ju nuk tregoni të vërtetën, mund të ndiqeni sipas nenit 390 ose 391 të Kodit Penal. Nëse besoni se ju mund të fajësoni veten si rezultat i përgjigjeve në pyetje, ju mund të refuzoni të përgjigjeni. Nëse besoni se keni nevojë për ndihmën e avokatit si rezultat i përgjigjes në një pyetje, ju mund të angazhoni dhe të këshilloheni me një avokat. Ky hetim penal kërkon të gjejë të vërtetën dhe kujtesën sa më të saktë të fakteve që ju mund të ofroni. Nëse ju nuk e kuptoni pyetjen që u është bërë, ju duhet të kërkonti që pyetja t'iu bëhet ndryshe. Nëse besoni se ka një dokument ose prova të tjera që mund t'ju ndihmojnë për t'iu përgjigjur në pyetje sa më saktë apo t'iu kujtohen faktet më qartë, ju jeni të detyruar të na tregoni. Nëse keni nevojë për ndihmë, përkthim, apo pushim të shkurtër dhe të arsyeshëm nga kjo seancë, ju duhet të kërkonti atë. A i kuptoni këto të drejta".

Për ekspertin duhet lexuar ky paralajmërim: "Ky është një hetim penal mbi veprimet për të cilat ju keni njohuri të specializuara. Ju jeni të detyruar të dëshmoni. Ju jeni të detyruar të tregoni të vërtetën. Nëse ju nuk tregoni të vërtetën, mund të ndiqeni sipas nenit 390 ose 391 të Kodit Penal. Ju jeni të detyruar të shpjegoni hapat që keni ndërmarrë për sigurimin e njohurive të specializuara që keni në këtë rast. Ky hetim penal kërkon të gjejë të vërtetën dhe kujtesën sa më të saktë të fakteve që ju mund të ofroni. Nëse ju nuk e kuptoni pyetjen që u është bërë, ju duhet të kërkonti që pyetja t'ju bëhet ndryshe. Nëse besoni se ka një dokument ose prova të tjera që mund t'ju ndihmojnë për tu përgjigjur në pyetje sa më saktë apo t'iu kujtohen faktet më qartë, ju jeni të detyruar të na tregoni. Nëse keni nevojë për ndihmë, përkthim, apo pushim të shkurtër dhe të arsyeshëm nga kjo seancë, ju duhet të kërkonti atë. A i kuptoni këto të drejta.

Për dëshmitarët bashkëpunues lexohet ky paralajmërim: "Ky është një hetim penal i veprave për të cilat ju mund të keni njohuri të drejtpërdrejtë. Ju jeni pajtuar të bashkëpunoni në këtë hetim. Nëse shfrytëzoni të drejtën tuaj për të heshtur, ju nuk do të jeni më dëshmitarë bashkëpunues. Nëse ju nuk thoni të vërtetën, kjo mund të merret parasysh gjatë përcaktimit të dënimit tuaj dhe ju mund të ndiqeni sipas nenit 392 të Kodit Penal. Mbrojtësi juaj është i pranishëm. Nëse besoni se keni nevojë të këshilloheni me mbrojtësin tuaj, ju mund ta bëni këtë.

⁵²⁰ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 123 dhe 131, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

Ky hetim penal kërkon të gjejë të vërtetën dhe kujtesën sa më të saktë të fakteve që ju mund të ofroni. Nëse ju nuk e kuptoni pyetjen që u është bërë, ju duhet të kërkonit që pyetja të ju bëhet ndryshe. Nëse besoni se ka një dokument ose prova të tjera që mund t'iu ndihmojë për tu përgjigjur në pyetje sa më saktë apo të ju kujtohen faktet më shumë, ju duhet të na tregoni. Nëse keni nevojë për ndihmë, përkthim, apo pushim të shkurtër dhe të arsyeshëm nga kjo seancë, ju duhet të kërkonit atë. A i kuptoni këto të drejta?”

Për tu konsideruara veprime të ligjshme dhe prova të pranueshme në procedurën penale, secili paralajmërim duhet të shënohet në procesverbal, dhe ka rëndësi edhe nënshkrimi i subjektit pasi që përmes nënshkrimit ai konfirmon se i ka kuptuar detyrimet e tilla procedurale.

Kushtet për marrjen në pyetje në procedurë paraprake: Dëshmitari pyetet ndaras dhe pa praninë e dëshmitarëve të tjerë, po ashtu përgjigjet i jap gojarisht. Fillimisht ndaj dëshmitarit kërkohen të dhënat personale, dhe po ashtu i bëhet me dije detyrimi që ai të njoftoj organet për çdo ndryshim të adresës. Kur dëshmitarët janë zyrtarë policore, ata informohen që në vend të adresës së banimit që duhet ta japin ata mund ta japin adresën e stacionit ku janë në marrëdhënie pune. Kur marrja në pyetje në procedurën paraprake bëhet për personat nën moshën 18 vjeçar duhet të shtrohen pyetjet me kujdes që të mos ketë ndikim psikologjik negativ tek personi i tillë e po ashtu kur është viktimë e veprës penale duhet të shtrohen pyetjet me shumë kujdes për të mos cenuar aspektin psikologjik të tij dhe kur është e nevojshme ai pyetet me anë të psikologut të fëmijëve apo ekspertit tjetër të fushës.

Marrja e deklaratës në procedurën paraprake.

Marrja e deklaratës në procedurën paraprake ndryshon, për nga aspekti i veprimit procedural, pasi që marrja e deklaratës bëhet në seancë të cilën e hap prokurori i shtetit që zhvillon hetimet⁵²¹.

Seanca mbahet dhe mbahet po ashtu procesverbali mbi veprimet procedurale në seancën e tillë. Këtu për mbajtjen e seancës, prokurori thërret palët:

1. Të akuzuarin dhe mbrojtësin,
2. Viktimën apo mbrojtësin e viktimave përkatësisht përfaqësuesin e të dëmtuarit,
3. Dëshmitari i cili merret në pyetje.
4. Dëshmitari bashkëpunues apo dëshmitari i anonimizuar.

Ftesa për të pandehurin, mbrojtësin, të dëmtuarin dhe mbrojtësin e të dëmtuarit duhet dërguar 5 ditë më herët për tu njoftuar se ku do mbahet seanca.

⁵²¹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 123 dhe 132, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

Në procedurën paraprake mund të bëhet marrja e deklaratës ndaj, të dëmtuarit si dëshmitar, dëshmitarit që mund të ketë njohuri për veprën apo kryerësin, ekspertin, dëshmitarin bashkëpunues apo dëshmitarin anonim. Cilido nga ta që bëhet marrja e deklaratës në procedurë, ftohet me ftesën me shkrim, e cila përmban, emrin, datën, vendin dhe kohën kur do të bëhet marrja e deklaratës, dhe pasojat e mos ardhjes se tyre, lidhur me pranueshmërin e deklaratës së tillë.

Kur bëhet marrja e deklaratës së personit që nuk ka mbushur moshën 16 vjeçar si dëshmitar, thirrja duhet të i dërgohet nëpërmjet prindërve apo përfaqësuesit ligjor, përveç kur ka rrethana të ngutshme dhe nuk mund të arrihet.

Në seancën e marrjes së deklaratës në procedurë paraprake, fillimisht pyetjet i parashtron prokurori nëse ai ka ftuar dëshmitarin përkatës për marrjen e deklaratës në procedurë paraprake, ndërsa kur mbrojtësi i të pandehurit ka propozuar marrjen e deklaratës në procedurë paraprake dhe merret deklarata e tillë, fillimisht pyetjet i parashtron mbrojtësi i të pandehurit.

Po ashtu nëse viktima apo mbrojtësi i viktimave kanë propozuar marrjen e deklaratës në procedurë paraprake fillimisht pyetjet i parashtron viktima përkatësisht mbrojtësi i viktimave. Detyrimisht secilës palë duhet dhënë mundësia që të parashtror pyetje me rastin e marrjes së deklaratës në procedurë paraprake.

Gjatë parashtrimit të pyetjeve, dëshmitari mund të ballafaqohet me pyetje të tërthorta, por ai po ashtu mund të pyetet edhe për provat materiale në çështjen penale që disponohen. Kur bëhet marrja e deklaratës në procedurë paraprake ndaj të dëmtuarit ai po ashtu pyetet edhe për kërkesën pasurore juridike. Po ashtu marrja e deklaratës në procedurë paraprake mund të bëhet edhe ndaj të pandehurit dhe në atë raste zbatohen dispozitat nga neni 154, që fillimisht duhet të merren të dhënat personale, shkollimin e tij, a dinë shkrim dhe lexim, a ka të ardhura personale dhe gjendja materiale e tij, a ka procedurë tjetër ndaj tij, nëse është i mitur identitetin e përfaqësuesit ligjor, informohet për detyrimin e njoftimit për ndryshim të adresës.

Gjatë marrjes së deklaratës ndaj të pandehurit, pyetjet parashtrohen gojarisht, dhe ai mund të mbaj shënime. Ai duhet të trajtohet me dinjitet dhe pyetjet duhet formuluar qartë dhe të përpikta, nuk lejohet parashtrimi i pyetjeve bazuar në supozim që ai ka pranuar diçka e që ai realisht nuk e ka pranuar. Pyetjet parashtrohen duke kërkuar nga i pandehuri pohimin apo mohimin e ndonjë fakti, mirëpo asgjë nuk e ndalon të pandehurin që të jap sqarime lidhur me mohimin apo pohimin që e jap. Pyetje mund ti bëhen edhe lidhur me provat dhe shkresat e lëndës penale, dhe kur parashtrohen pyetje të natyrës së tillë duhet që t'i paraqitet fizikisht prova ose shkresa relevante, këto prova apo dokumente theksohen saktësisht në procesverbal se cilat janë dhe fare përmbajnë. Kur pyetje shtrohen në raport me sendet që janë sekuestruar apo që mund të shërbejnë si provë atij i prezantohen për njohje e nëse nuk mund të prezantohen për shkak të sasisë dërgohet i pandehuri tek vendi ku gjinden sendet e tilla.

Në këtë faqe të pandehurit duhet ti jepet mundësia që të shpreh kundërshtimet ndaj dyshimit për të dhe po ashtu të paraqes fakte që e rrëzojnë dyshimin ndaj tij. Të gjitha këto kushte zbatohen përshtatshmërisht kur merret në pyetje dëshmitari, pra që nënkupton se i pandehuri i ka të njëjtat të drejta edhe ndaj dëshmitarit.

Kur bëhet marrja e deklaratës ndaj dëshmitarëve bashkëpunues apo dëshmitarëve anonim, prokurori në seancën që e zhvillon duhet të zbatoj me saktësi detyrimet për ruajtjen e dëshmitarëve dhe anonimitetin e tyre.

Kur bëhet marrja në pyetje e dëshmitarëve që janë shurdh apo memec, ata merren në pyetje, sipas interpretit që bënë përkthimin e gjuhës së shenjave.

➤ Rrethanat që e bëjnë të papranueshme deklaratën e marrjes në pyetje:

Kodi i procedurës ka përcaktuar saktësisht se kur deklarata është e papranueshme e që janë:

1. Personi nuk mund të pyetet si dëshmitar;
2. personi është liruar nga dëshmimi por nuk është vënë në dijeni për këtë të drejtë ligjore apo nuk është deklaruar shprehimisht, apo kur udhëzimi i kësaj të drejtë nuk është konstatuar në procesverbal,
3. personi është fëmijë që nuk kupton të drejtën e tij për refuzimin e dëshmisë;
4. dëshmia e dëshmitarit është marrë me forcë, kanosje apo ndonjë mënyrë tjetër të ndaluar⁵²².

Personi që nuk mund të pyetet si dëshmitar - kategorinë e personave të tillë e përcakton neni 126 që janë dëshmitarët e privilegjuar, çka nënkupton se këta fare nuk mund të merren në pyetje, e te cilët posa kuptohet se janë në rrethana të tillë atëherë çfarëdo veprimi procedural i marrjes në pyetje nuk mund të jetë i dobishëm pasi që prova e tillë – deklarata nuk mund të konsiderohet e pranueshme⁵²³, personat e tillë janë:

- a). Kur personi me deklaram e shkel fshehtësinë e detyrës zyrtare apo ushtarake, përderisa organi nuk e liron nga detyrimi i tillë i ruajtjes së fshehtësisë;
- b). Mbrojtësi i të pandehurit për raste çfarë i ka besuar atij si mbrojtës, përveç kur vetë i pandehuri kërkon dëshminë e mbrojtësit; dhe
- c). I bashkëpandehuri derisa zbatohet procedurë e përbashkët.

Për sa i përket të bashkëpandehurit praktika ka trajtuar këtë rrethanë me standarde të ndryshme, megjithatë tek pranueshmëria e provave më në detaje do të sqarohet papranueshmëria si provë e të bashkëpandehurit, përderisa është procedura ndaj tyre.

Dëshmitarët e liruar nga dëshmia – dëshmitarët e liruar nga dëshmimi janë kategori tjetër që gjithë varet se a ekzistojnë ato rrethana të caktuara në dispozita ligjore. Megjithatë dëshmitarët e liruar nga dëshmimi janë po ashtu të përcaktuar në dy kategori, në njërin kategori janë personat që për shkak të ekzistimit të një rrethane të caktuar ata lirohen nga detyrimi për të dëshmuar, dhe po ashtu kategoria tjetër që varet nga vlerësimi i organit shtetëror – gjykata.

⁵²² Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 128, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁵²³ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 126, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

Në dispozitën e nenit 127⁵²⁴ janë paraparë rrethanat dhe kush është i liruar nga detyrimi për të dëshmuar e që janë:

- bashkëshorti ose bashkëshorti jashtëmartesor i të pandehurit, përveç kur procedura zbatohet për veprë penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me të paktën pesë (5) vjet burgim dhe ai është i dëmtuar me atë veprë penale;
- personi i gjinisë së gjakut në vijë të drejtë me të pandehurin, bashkëshorti ose bashkëshorti jashtëmartesor: paraardhësit, pasardhësit, motrat, vëllezërit, axhët, dajët, tezet, hallat, fëmijët e motrave dhe vëllezërve; ose të afërmit: vjehrra, vjehri, dhëndri, nusja, motra e burrit/gruas, vëllai i burrit/gruas, kumbari, kumbara, njerka, njerku; përveç kur procedura zbatohet për veprë penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me të paktën dhjetë (10) vjet burgim apo nëse është dëshmitar i veprës penale kundër fëmijës i cili bashkëjeton apo është i afërm me të apo me të pandehurin;
- prindi adoptues ose fëmija i adoptuar i të pandehurit, përveç kur procedura zbatohet për veprë penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me të paktën dhjetë (10) vjet burgim, ose ai është dëshmitar i veprës penale kundër fëmijës që bashkëjeton ose është i afërt me të apo me të pandehurin;
- personi fetar për atë çka i pandehuri apo një person tjetër i është rrëfyer; mbrojtësi, mbrojtësi i viktimave, mjeku, punëtori social, psikologu ose ndonjë person tjetër për faktet që i kanë mësuar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre kur detyrohen ta ruajnë si fshehtësi atë që e kanë mësuar me rastin e ushtrimit të profesionit; dhe gazetari apo botuesi, i cili punon në media apo një ose më shumë nga bashkëpunëtorët e tij në pajtim me ligjin e zbatueshëm.
- Personat si, personi fetar për rrëfimin nga i pandehuri apo personi tjetër që ka rrëfyer, mbrojtësi, mbrojtësi i viktimave, psikologu, mjeku punëtori social, ose ndonjë personit tjetër profesionist për faktet që i kanë mësuar gjatë ushtrimit të profesionit, gazetari apo botuesi në vendin e tyre të profesionit apo bashkëpunëtorët e tyre, nuk mund të refuzojë dëshmimin kur ekziston bazë ligjore për ta liruar nga detyrimi i mbajtjes së fshehtësisë.

Ndërsa kategoritë e personave që janë të liruar nga detyrimi për të dëshmuar e që varet lirimi nga vlerësimi i gjykatës janë:

Fëmijët të cilët, duke pasur parasysh moshën dhe zhvillimin intelektual, nuk janë të aftë të kuptojnë domethënien e të drejtës për të refuzuar dëshmimin, nuk mund të pyetet si dëshmitar, përveç kur gjykata çmon se ata janë të aftë për të kuptuar se i nënshtrohen detyrimit për të treguar të vërtetën.

⁵²⁴ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 127, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

Karakteristik është se në rrethanat kur kemi të bashkakuzuar, pasiqë dëshmitari në cilëndo rrethanë është i liruar për të dëshmuar ndaj një të akuzuari ai lirohet ndaj të gjithë të akuzuarve për të dëshmuar.

Policia, prokuroria apo gjykata detyrimisht duhet të informojnë dëshmitarët që janë të lirë për të dëshmuar e në rast se rrethana e tillë nuk është e njohur ata detyrimisht duhet të informojnë personat e tillë që në momentin kur vihen në dijeni se ekzistojnë rrethanat që dëshmitari është i lirë për të dëshmuar.

Mundësia hetuese e veçantë

Mundësia hetuese e veçantë është veprim procedural që e zbaton gjyqtari i procedurës paraprake, dhe atë në fazat e hershme të procedurës së hetimit, me qëllim sigurimin e provës që mundë të jetë e vështirë apo e pamundshme për tu siguruar në shqyrtim gjyqësor.

Mundësia hetuese e veçantë nuk mundë të ndërmerret si veprim zyrtarisht nga gjyqtari i procedurës paraprake, por vetëm bazuar në kërkesën e, prokurorit, viktimës, mbrojtësit të viktimave të pandehurit, ose mbrojtësit të tij.

Mundësia hetuese e veçantë si veprim procedural, është e lejueshme që të bëhet nga gjyqtari i procedurës paraprake vetëm për veprat penale që janë të parapara në nenin 90 të Kodit të procedurës penale. Kushti i vetëm që duhet të plotësohet është që vepra të jetë e përcaktuar në nenin 90, e kur ky kusht plotësohet atëherë gjyqtari detyrimisht aprovon propozimin, pasi që paragrafi 2 i nenit 149 që rregullon mundësinë hetuese të veçantë, përdor shprehjen, “ gjyqtari i procedurës paraprake aprovon kërkesën”, kjo dispozitë kur përcakton shprehjen aprovon nuk lë diskrecion vlerësues të gjyqtarit por që në momentin kur përmbushet kushti ligjor kërkesa detyrimisht duhet të aprovohet. Por nëse gjyqtari për çfarëdo rrethane nuk e aprovon kërkesën e tillë mundë të parashtrahet ankesë në kolegjin shqyrtues të të njëjtës gjykatë.

Mundësia hetuese e veçantë zbatohet në seancë, ku ftohet pala që ka paraqitur kërkesën, dhe po ashtu palët tjera, me konkretisht në seancën e tillë të mundësisë hetuese të veçantë merr pjesë, prokurori, viktimja mbrojtësi i viktimave mundë të marrin pjesë, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, si dhe dëshmitari që merret në pyetje⁵²⁵. Pyetjet fillimisht shtrohen nga pala që ka parashtruar kërkesën, e pastaj pyetjet parashtrohen nga palët tjera. Këtu zbatohen rregullat e marrjes së drejtpërdrejt në pyetje, marrjes së tërthortë në pyetje dhe rimarrja në pyetje, pasi që paragrafi 6 parasheh se zbatohen rregullat e marrjes në pyetje të dëshmitarit sikurse në shqyrtim gjyqësor. Po ashtu nuk ka ndonjë pengesë që dëshmitari që merret në pyetje në mundësinë hetuese të veçantë ti kërkohet të bëjë identifikimin e sendeve apo provave të tjera

⁵²⁵ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 149, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

përkatësisht të i parashtrihen pyetje edhe për sa i përket provave që janë pjesë e shkresave të lëndës.

Gjyqtari i procedurës paraprake nuk e zbaton i vetëm seancën por krijohet kolegji edhe me dy gjyqtar të tjerë.

Si rregull dëshmia e marrë në procedurën e marrjes së deklaratës me hetuesi të veçantë duhet të incizohet seanca dhe incizimi i bashkëngjitet shkresave të lëndës, përkundër se në praktikë për shkaqe teknike nuk zbatohet por mbahet procesverbal, ku konstatohen me saktësi pyetjet dhe përgjigjet në seancë.

Mundësia hetuese e veçantë po ashtu mundë të zbatohet edhe me anë të mjeteve teknologjike kur dëshmitari nuk gjendet në Kosovë.

Njeri nga anëtarët e kolegjit që merr pjesë në mundësin hetuese të veçantë duhet të jetë pjesë e trupit gjykues qoftë, si kryetar apo si anëtarë i trupit gjykues.

Marrja ne pyetje e te pandehurit – I pandehuri ne procedurën penale mund te merret ne pyetje ne dy forma. Forma baze dhe e cila kryesisht zbatohet ne procedurën penale është marrja ne pyetje nga prokurori, por kur vepra penale nuk është e dënueshme me shumë se tri vite burgim mjafton qe ti jepet mundësia qe te përgjigjet me shkrim te pandehurit për rrethanat qe prokurori konsideron se duhet te sqarohen. Dispozitat ligjore përcaktojnë qarte se te pandehurin para ngritjes se aktakuzës e merr ne pyetje prokurori, por një përjashtim ekziston qe prokurori mund t’ia barte këtë veprim policisë – që policia ta marr në pyetje. Në praktikën gjyqësore shpesh herë ka raste qe ngritët aktakuza dhe i pandehuri fare nuk merret në pyetje, rrethanat e tilla paraqesin të meta thelbësore procedurale për ngritjen e aktakuzës, e ngritja e aktakuzës pa u marr në pyetje i pandehuri përbën cenim të të drejtave të të pandehurit pasi qe nuk i është dhënë mundësia qe ai te deklarohet për dyshimet qe e rendojnë për veprën qe pretendohet që ta këtë kryer i pandehuri. Këtu ka rendësi shume te madhe veprimi i Gjykatës qe kur pranon aktakuzën te vlerësoj se Prokurori a e ka cenuar ndonjë dispozite pra a ka ngritur aktakuze pa u zbatuar dispozitat ligjore te marrjes ne pyetje dhe nëse gjykata konstaton se veprimi i prokurorit nuk është zbatuar duhet te ia kthej aktakuzën për ti dhënë mundësi qe te merret ne pyetje i pandehuri. Kontrollin e akuzës Gjykata duhet ta ndërlihdë në raport me nenin 242 par 1 te KPP-së. Në këtë kontekst bashkëpunëtori profesional ka rol te rëndësishëm qe kur pranohet lënda tek gjyqtari ta trajtoj se cilat janë shmangiet dhe ato të ia referoj gjyqtarit te ngarkuar më lenden për të vendosur gjyqtari tutje qe të ia kthej aktakuzën, e aktakuza duhet ti kthehet ne baze te nenit 442 lidhur me nenin 242 te KPP-së. Arsyet e shpeshta qe aktakuza ngritët pa u marr në pyetje i pandehuri, janë qe rezultojnë nga rrethanat praktike e me se shpeshti janë se nuk po gjendet i pandehuri, megjithatë edhe në raste se nuk gjendet prokurori ka baza te mjaftueshme qe te paraqes pran gjykatës kërkesë për urdhër arrest apo letë rreshtim ndërkombëtare dhe gjate kësaj faze ti pezulloj hetimet për të mos rrjedhur afati, por ne asnjë mënyrë nuk mund ete jete argumenti i tillë për tu ngritur akuza pa u marr ne pyetej i pandehuri, sepse kjo do ti pamundësonte te pandehurit qe te jap mbrojtjen e vet qe mundet me probabilitet ta rrezoj tërësisht arsyeshmërin e ngritjes se akuzës, por njëkohësisht këtu kufizohet e drejta e

të pandehurit edhe për të kërkuar nga prokurori marrjen e provës, andaj të gjitha këto e bëjnë ngritjen e akuzës si proceduralisht jo të rregullt dhe në pamundësi për të vepruar gjykata nga se do te legjitimohej shkelja e të drejtave të të pandehurit në një fazë te procedurës penale qe është faza e hetimit dhe ngritjes se akuzës.

I pandehuri me rastin e marrjes ne pyetje ftohet nga prokurori, por ati i garantohet e drejta për të kontestuar ligjshmërinë e thirrjes për tu marr në pyetje para gjyqtarit të procedurës paraprake, kontestimi për ligjshmërinë mund të jetë i ndryshëm, qoftë për faktin se gëzon imunitet, për faktin se s'ka propozim të të dëmtuarit, për faktin se s'ka leje të organit që duhet të jepet, apo për rrethana te tjera qe i pandehuri mund ete pretendoj se thirrja për tu marr në pyetje në cilësi të të pandehurit është e kundërligjshme.

I pandehuri para se të merret në pyetje duhet të njoftohet për të drejtat e tij në cilësinë e të pandehurit, e posaçërisht për veprën penale që ngarkohet, dhe të drejtën e ti për të marr provat që konsideron se do të shërbejnë për mbrojtjen e tij, por edhe për të drejtën e mbrojtjes.

Dilema më e shpeshtë që lind në praktikë është, a ka të drejtë i pandehuri që të konsultohet me mbrojtësin në pyetjen konkrete para se të përgjigjet?. Këtë dilemë dispozita e nenit 152 paragrafi 4 e qartëson, e qe parashihet se i pandehuri ka të drejtë që të këshillohet me mbrojtësin para dhe gjatë marrjes në pyetje. Kjo është e nënkuptueshme për tri arsye. Fillimisht prokuroria nuk duhet të konsideroj ngritjen e provueshmërisë së fakteve bazuar në përgjigjet qe i jap vetë i pandehuri, dhe e dyta për faktin se me përgjigje të caktuar i pandehuri mund ta inkriminoj ne mënyrë indirekte veten apo te afërmit dhe këshillimi i mbrojtës do ta ruaj nga një rrezik i tillë, por edhe për faktin se në raste se mbrojtësi nuk lejohet që të këshillohet qoftë edhe për përgjigjet e caktuara me të pandehurin, roli i tij do të ishte në mbrojtje joaktive për procedurën penale, e qe pikërisht roli i mbrojtjes është për mbrojtje aktive ne procedurën penale.

Zhvillimi i marrjes ne pyetje – Gjate marrjes ne pyetje i pandehuri duhet te deklarohet për të dhënat e tij personale, këto të dhëna ka detyrim që i pandehuri ti jep, dhe po ashtu duhet të informohet për detyrimin e ndryshimit të adresës së tij në të ardhmen.

Gjatë marrjes në pyetje i pandehuri lejohet që të mbaj shënime që vlerëson se do ti duhen në zhvillim të mëtejshme në procedurë. Dinjiteti i të pandehurit duhet të respektohet në maksimum, qe nënkupton se asnjë rrethanë nuk duhet të qoj në perceptimin që të konsiderohet fajtores, asnjë rrethanë nuk duhet të qoj në perceptimin e të pandehurit që të konsiderohet se nuk po e tregon të vërtetën apo që nuk po jep përgjigjet që vlerësohen të drejta, apo duke e konsideruara si njeri pa vlerë në proces apo duke i dhënë çfarëdo rrethane që do ta perceptoj se ai s'ka rëndësi në çështjen penale që është në zhvillim procedura.

Natyra e pyetjeve – Pyetjet që mund ti parashtrohen të pandehurit i parashtrohen në raport me provat dhe shkresat që kanë rëndësi për procedurën penale, kur pyetja parashtrohet në raport me ndonjë provë ajo provë identifikohet qartë dhe theksohet në procesverbal, po ashtu pyetjet i parashtrohen edhe në raport me sendet që mund të shërbejnë si provë duke ia prezantuar sendet e tilla të pandehurit e kur nuk mund t'i prezantohen atëherë ai dërgohet për t'i shikuar

sendet e tilla që shërbejnë si provë në raport me pyetjet që i parashtrahet për të dhënë përgjigje, këto detyrime rrjedhin nga neni 154 paragrafi 6 dhe 7 i KPP-së.

Marrja në pyetje e të pandehurit është provë e pranueshme në procedurën penale vetëm nëse, është paralajmëruar për të drejtat dhe detyrimet e tij para marrjes në pyetje, nëse gjatë marrjes në pyetje është respektuar liria e të pandehurit për të formuluar dhe shprehur mendimin e tij të ndikohet nëpërmjet keqtrajtimit, lodhjes së shkaktuar, ndërhyrjes fizike, përdorimit të drogës, torturës, shtrëngimit ose hipnotizimit; i pandehuri nuk është kanosur me masa të ndaluara me ligj; të pandehurit nuk i është premtuar ndonjë përfitim që nuk parashihet me ligj; dhe ndaj të pandehurit nuk është ndërmarr ndonjë veprim, që të dobësohet kujtesa ose aftësia e tij për të kuptuar. Se si mund të vërtetohet cilado nga kjo rrethane është aspekt i vlerësimit në çdo raste konkret, si. P.sh. Nëse i pandehuri është zgjuar nga gjumi në mesnate dhe është marr në pyetje kjo do të konsistonte në veprimin që ka shfaqur një lloj keqtrajtimi për të mundësuar formulimin e tij, prandaj secili rast duhet të kihet parasysh kur pretendohet se të pandehurit i është cenuar e drejta gjatë marrjes në pyetje dhe të vlerësohet pranueshmëria e provës.

Sekuestrimi i përkohshëm – Dispozitat ligjore të Kodit të procedurës penale kanë mundësuar që çdo send që mund të shërbejë si provë apo që është sende me të cilin është mundësuar kryerja e veprës penale apo sendet që janë dobi pasurore e veprës penale të kryer mund të sekuestrohen⁵²⁶. Megjithatë për tu sekuestruar duhet ndjekur strikt zbatimimi i dispozitave të Kodit të Procedurës penale.

Gjatë kontrollit që zbatohet apo gjatë arrestimit të ligjshëm nga policia, kur gjenden sendet që mund të jenë prova në procedurë, apo që kanë mundësuar kryerjen e veprës penale apo që janë dobi pasurore e kryerjes së veprës penale, prokurori mund të

urdhëroj sekuestrimin e përkohshëm – ky urdhër i prokurorit ka afat të përkohshëm dhe jo me të gjatë se 5 ditë. Në këtë kuptim për të mundësuar zbatimin e ligjshëm të sekuestrimit, prokurori para se të skadojë afati prej 5 ditësh të urdhrit që e ka lëshuar ka vetëm dy mundësi: T’ia kthejë sendet pronarit që i janë sekuestruar përkohësisht, apo të kërkojë me kërkesë pranë gjyqtarit të procedurës paraprake që të lëshoj urdhër për sekuestrimin e sendit.

Kur prokurori parashtron kërkesë pranë gjykatës për lëshimin e urdhrit për sekuestrim, ajo kërkesë duhet të përshkruaj me saktësi llojin dhe cilësitë e atij sendi që kërkohet urdhri, dhe po ashtu duhet të argumentoj se si ai send do të mund të shërbente si provë, si do të mund të shërbente si send për kryerjen apo që ka mundësuar kryerjen e veprës penale apo se ai send rezulton që është dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale. Në mungesë të këtyre arsyeve në kërkesë gjykata do ta refuzonte kërkesën për lëshimin e urdhrit.

Dispozitat ligjore detyrojnë që sendet që janë sekuestruar përkohësisht të fotografohen dhe të mbahen të mbyllura në qese plastike të dukshme në vend të sigurt, për ato sende mbahet

⁵²⁶ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 105 dhe 112, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

procesverbal kur regjistrohen në mbajtjen e vendit të sigurte. Ndërsa sendet që për nga natyra janë të mëdha ato fotografohen dhe mbahet procesverbal dhe ruhen në vend të sigurt. Ndërsa mjetet monetare që sekuestrohen ato mbahen në kasafortë. Mjetet monetare në llogari bankare që sekuestrohen përkohësisht mbahen në një llogari bankare që administron gjykata. Ky detyrim ligjor është plotësisht i arsyeshëm, pasi që ka qëllimin kryesor ruajtjen e sendit të tillë që të mos kontaminohet si provë në procedurën e vërtetimit të fakteve në çështjen penale, dhe mos ruajtja e sendeve konform dispozitave ligjore do të mund të humbte cilësinë e të provuarit të ndonjë fakti relevant në procedurë. Prokurori disa nga veprimet e detyrimit që i ka për ruajtje mund të ia besoj zyrtarit të autorizuar të policisë, siç janë sendet që janë të mëdha për nga natyra (si automjete etj.) apo pasuritë e paluajtshme. Sendet që sekuestrohen derisa nuk lëshohet urdhri i përkohshëm nga Prokurori apo derisa nuk lëshohet urdhri i gjykatës sipas kërkesës se prokurorit, ndaj pronarit duhet të lëshohet vërtetimi për konfiskim, vërtetimi i tillë lëshohet nga policia pasi që policia është organi që merr fillimisht sendet e tilla.

Kur lëshohet urdhri për sekuestrim ndaj personit apo ndaj organit të caktuar, dhe nëse refuzohet dorëzimi i sendit të tillë që përshkruhet në urdhër, gjyqtari i procedurës paraprake mund të shqiptoj gjobë ndaj atij që refuzon deri në vlerën e 50% të sendit që përcaktohet në urdhër për sekuestrim. Personi që gjohet ka vetëm dy mundësi, që të bëjë ankese ndaj shqiptimit të gjobës apo që të shmang pagesën e gjobës duke dorëzuar sendet që përcaktohen në urdhër.

Sendet që lejohet të sekuestrohen dhe ato që nuk mund të sekuestrim – Në parim Kodi ka përcaktuar kriteret baze se cilat sende mund të sekuestrohen përkohësisht. Kriteret e tilla u theksuan që janë kur sendi mund të jete prove në procedurën penale, kur ato sende kanë mundësi apo mundësojnë kryerjen e veprës penale, por edhe sendet që janë dobi pasurore e kryerjes së veprës penale. Në këtë kuptim sendet që mund të hyjnë në këto tri kategori janë të shumta dhe të llojllojshme që është e pamundur të përcaktohen duke i numëruar. Përkundër kriterëve kodi ka përcaktuar që disa sende nuk mund të sekuestrohen, si të tilla janë: Sendet – komunikimet e të pandehurit me personat që janë të kategorizuar në nenet 126 dhe 127 që janë personat e liruar nga dëshmia dhe personat - dëshmitarët e privilegjuar nga dëshmia. Po ashtu komunikimet e të pandehurit me personat që janë dëshmitarë të privilegjuar sipas nenit 126. Sendet tjera që janë të mbrojtura për dëshmitarët e privilegjuar dhe të liruar nga dëshmia. Duhet të kemi parasysh se këtu qëllimi kryesisht është në raport me sendet që mund të shërbejnë si prove por me përjashtime edhe më sendet që mund të shërbejnë për kryerje të veprës penale. Ndërsa kjo dispozite nga neni 113, fare nuk e kufizon që sekuestrimi i përkohshëm i sendeve të bëhet kur është përfitim më kryerjen e veprës penale, që nënkupton se në raste të tilla personat që kategorizohen si të privilegjuar dhe dëshmitar të liruar nga dëshmia mund të konsiderohen persona të tretë në procedurën penale, në raport më sendet e tilla që sekuestrohen përkohësisht prandaj ato sende nuk gëzojnë kufizim të sekuestrimit të përkohshëm.

Konfiskimi i përhershëm i sendeve dhe kthimi i sendeve – Dispozitat e kodit të procedurës penale kanë përcaktuar në nenin 115 paragrafi 1⁵²⁷, që sendet që sekuestrohen përkohësisht duhet të kthehen pronarit që i janë sekuestruara, përveç në rastet kur:

Gjyqtari i vetëm apo trupi gjykues, urdhëron konfiskimin e përhershëm të sendeve që janë urdhëruara të sekuestrohen përkohësisht. E për tu urdhëruara konfiskimi i përhershëm nga gjyqtari i vetëm apo trupi gjykues. Duhet që paraprakisht të përmbushen disa kushte ligjore që janë:

- Sendet e tilla të cilat janë sekuestruar përkohësisht duhet të përcaktohen në aktakuzë nga prokurori si propozim për konfiskimin e përhershëm të tyre;
- Nëse në shqyrtim gjyqësor vërtetohet se sendet kanë mundur kryerjen e veprës penale apo janë dobi pasurore e kryerjes së veprës penale; dhe
- Ligji lejon konfiskimin e tyre.

Këto kushte duhet plotësuar kumulativisht pra që të gjitha njëherësh dhe cilado nga këto kushte që nuk plotësohet sendi i tillë nuk mund të konfiskohet përherë.

Kur urdhërohet konfiskimi i sendeve që mund të kthehen në konvertim të mjeteve monetare më shitjen e tyre, atëherë nga ato mjete mund të destinohen dy përmbushje: 1. Mund të kompensohen të dëmtuarit me veprën e tillë penale dhe kjo përmbushje gëzon prioritet, ndërsa pjesa e mbetur, 2. Derdhen në buxhetin e shtetit. Ndërsa kur ka mjete monetare të konfiskuara nga ato mjete kompensohen të dëmtuarit e të mbeturat derdhen në buxhetin e vendit.

Sendet që i janë nënshtruar konfiskimit të përhershëm e të cilat sipas rregullave nuk janë të lejueshme në qarkullim të lire në mënyrë të plote, ato shkatërrohen, si të tilla janë: Armët, substancat narkotike, kimikatet e ndryshme etj. Megjithatë sendet e tilla që mund të jene sende të kontrabanduara e që janë konfiskuar përherë, poqë së mund të shfrytëzohen nga shoqëria ato mund të lejohen që të shfrytëzohen.

Kur si sende të konfiskuara përherë janë automjetet apo aeroplanët, ato më kërkesë të prokurorit i barten në shfrytëzim të qeverisë, megjithatë kjo është e mundshme vetëm nëse nuk zbehet mundësia e të dëmtuarit për tu kompensuar. Nga kjo dispozite është e qarte se rrjedh e drejta e të dëmtuarve nga vepra penale si prioritet në kompensimin e dëmit të pësuar nga sendet e konfiskuara përherë, dhe madje edhe sendet që mund të jene të domosdoshme për shfrytëzim nga Qeveria gjykata ka detyrim që ta vlerësojë se bartja në pronësi të qeverisë e sendeve të tilla a e ulë mundësinë e të dëmtuarit për tu kompensuar, se cilat janë rrethanat e tilla të uljes së mundësisë rezultojnë nga rrethanat konkrete të rastit, por një rregull në këto raste do të ishte vendimtare, se i dëmtuari a do ta realizonte më lehtë të drejtën e tij në kompensim përmes sendeve që janë konfiskuar përherë të cilat duhet të shiten apo duke e detyruara të akuzuarin që t'ia kompensojë dëmin e pësuar të dëmtuarit, më pastaj i akuzuari a është në gjendje që ta përmbush një detyrim të tillë në kuptimin efektiv të kompensimit apo i dëmtuari do të duhej të

⁵²⁷ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 115, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

rivazhdonte procedurat gjyqësore për ta realizuar të drejtën e tij, duke analizuar në këtë mënyrë gjykata duhet të vijë në konkluzionin se a zbehet mundësia e të dëmtuarit për tu kompensuar.

Kthimi i sendeve të sekuestruara përkohësisht po ashtu është përcaktuar sipas dispozitave të KPP-së. Janë tri baza për kthimin e sendeve të personi që janë sekuestruara, ato janë: Kur procedura penale është pezulluar, Kur procedura penale është pushuar; Kur nuk ka baze ligjore për konfiskimin e tyre.

Çështja me sfiduese është se dispozita nga neni 116⁵²⁸ ka përcaktuar si baze ligjore kthimin e sendeve edhe kur pezullohet procedura, kjo krijon probleme praktike pasi që, pezullimi i procedurës bëhet për shkaqe specifike dhe pritet të rivazhdojë kur eliminohen shkaqet që kanë shkaktuar pezullimin. Megjithatë konsiderojmë se në rastet kur ka pezullim të hetimit Gjyqtari që vendose lidhur me sendin duhet të këtë parasysh arsyet që qojnë në kthimin e sendeve, nga fakti se do të nënkuptonte që i pandehuri mund të disponojë me sendin e tillë që i nënshtrohet konfiskimit vetëm për shkak të shfaqjes së rrethanave që kanë dërguar në pezullimin e procedurës penale. Përkundër se dispozita ligjore nga neni 116 paragrafi 2 i mundëson prokurorit që të kërkojë të gjyqtari afat shtesë të sekuestrimit kur procedura penale duhet të pezullohet, në këto rrethana kërkesa ligjore për gjykatën është se duhet të këtë arsye të forta që të lejojë kthimin e sendit. Se cilat janë arsyet e tilla të forta do të mbetet për tu vlerësuar sipas rastit konkret.

Shembull: I akuzuari ka përfituar nga kryerja e veprës penale që ka investuar në shtëpinë që e gëzojnë të gjithë familjarët, vlera e investimit është 60% të tërësisë së vlerës së shtëpisë, në atë shtëpi jetojnë bashkëshortja dhe fëmijët e mitur si dhe prindërit e moshuar. I akuzuari në procedurën penale që zhvillohet pëson çrregullime psikike që konstatohen pamundësinë e zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor. Ky do të ishte një rast kur do të mund të vlerësohej arsye e forte e kthimit të sendeve që përkohësisht janë sekuestruar.

Sendet që nuk u dihet pronësia – sendet e tilla kur sekuestrohen përkohësisht e të cilave nuk u dihet pronësia ato si të tilla duhet që të kërkohen pronari i tyre⁵²⁹. Për tu gjetur pronari policia mund të bëjë përshkrimin e sendeve të tilla dhe atë përshkrim e bën në tabelën e shpalljeve në territorin ku i pandehuri ka vendbanimin, ndërsa kur sendet e tilla kanë vlerë të lartë atëherë njoftimi bëhet edhe në shtyp. Nëse sendet e tilla kanë rrezik të dëmtimit dhe kur kostoja për mirëmbajtje është e lartë atëherë ato sende shiten në procedurën e përmbarimit, dhe parat nga shitja ruhen në një llogari bankare të veçantë që e mbikëqyrë gjykata. Edhe kur i pandehuri është arratisur apo kryerësi i veprës nuk dihet, dhe kur sendet e sekuestruara janë të pandehurit edhe për to zbatohet procedura e njëjtë e shitjes së atyre sendeve kur rrezikohen nga dëmtimi dhe kostoja e shpenzimeve është e lartë.

Sendet që nuk kërkohen për tu kthyer – kur sendet gjinden tek i pandehuri e të cilave nuk u dihet pronësia pasi që të bëhet shpallja e tyre sipas përshkrimit, apo kur ato shiten për shkak të

⁵²⁸ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 116, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁵²⁹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 117, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

kostos së mirëmbajtjes, nëse nuk kërkohen brenda 1 viti atëherë me aktvendim të gjykatës kalojnë në pronësi të organeve shtetërore ndërmjetet monetare nga shitja kalojnë në buxhet të shtetit⁵³⁰. Megjithatë nëse pronari kupton se sendet e tilla apo mjetet buxhetore kanë kaluar në organet shtetërore atëherë ka të drejtë në procedurën civile të kërkojë të drejtën e tij, dhe parashkrimi fillon të rrjedhë nga dita e shpalljes së njoftimit. Këtu duhet pasur parasysh se e drejta e tij në kuptim të parashkrimit i referohet afatit të parashkrimit në raportin juridiko civil që rregullohet afati sipas Ligjit për Marrëdhënien e Detyrimeve.

Pezullimi i hetimit – Pezullimi i hetimeve nënkupton ndaljen e veprimeve procedurale për sigurimin e provave por edhe ndaljen e rrjedhës së mëtejme të afatit të hetimeve⁵³¹. Pezullimin e hetimeve e bënë vetëm prokurori me aktvendim për pezullimin e hetimeve. Kushtet për pezullimin e hetimeve janë, kur i pandehuri pëson çrregullime ose paaftësi të përkohshëm mendore ose sëmundje tjetër të rënde, kur është arratisur, apo kur ekzistojnë rrethana të tjera që mund ta pengojnë përkohësisht ndjekjen, rrethanat e tilla mund të jenë specifike për rastin konkret e që në esencë rezultojnë se nuk mund të bëhet sipas dispozitave ligjore të sigurohen provat në hetime nga ana e prokurorit. Megjithatë është detyrim i prokurorit që para se të pezullojë hetimin të ndërmerret të gjitha veprimet e mundshme për të mbledhur të gjitha provat e mundshme për veprën dhe përgjegjësin penale ndaj të pandehurit. Po ashtu prokurori i shtetit duhet të rifillojë hetimin që në momentin kur janë eliminuar pengesat e shkaktuara për pezullim, rifillimi i hetimeve bëhet duke konstatuar në procesverbal kohën kur është pezulluar hetimi dhe po ashtu kohën kur është rifilluar hetimi dhe për këtë e njofton gjyqtarin e procedurës paraprake. Gjatë pezullimit ndërpritet rrjedha e afatit të hetimeve dhe e parashkrimit të ndjekjes penale.

Pushimi i hetimit – nënkupton konstatimin e rrethanave mbi të cilat prokurori ka vlerësuar apo rrethana që shfaqen sipas shkaqeve ligjore dhe prokurori e mbyllë çështjen e procedurës së zhvillimit të hetimit të mëtejme⁵³². Për të mundur që të bëhet pushimi i hetimit, kodi i njëjtit vetëm këto rrethana:

- Nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm që personi ndaj të cilit zhvillohet hetimi ta ke kryer veprën penale;
- Vepra nuk është vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare;
- Ka kaluar afati i parashkrimit;
- Kur vepra penale për të cilën zhvillohet hetimi ajo vepër është përfshirë në falje, amnisti;
- Kur ka rrethana të tjera të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale.

Shkaku i pare që ka të bëjë me mungesën e dyshimit të arsyeshëm, është aspekt i vlerësimit diskrecional të provave që prokurori i ka mbledhur gjatë fazës së hetimit e që kur konsideron

⁵³⁰ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 118, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁵³¹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 157, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁵³² Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 158, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

se provat e tilla nuk krijojnë dyshim të arsyeshëm për te pandehurin për veprën e tillë atëherë me aktvendim prokurori i pushon hetimet ndaj te pandehurit.

Sa i përket bazës kur vepra penale nuk është vepër që ndiqet sipas detyrës zyrtare, këtu duhet të kemi parasysh faktin se tanimë sipas dispozitave ligjore në fuqi thuajse të tera veprat penale ndiqen sipas detyrës zyrtare, por ka dy përjashtime thelbësore që për vepra të caktuara duhet propozimi i palës së dëmtuar, apo dhënia e lejes nga organi kompetent. Në këtë kuptim kur veprat e tilla kanë parakushte dhënien e propozimit apo të lejes, kjo nuk nënkupton se veprat nuk ndiqen sipas detyrës zyrtare por se ndjekja e atyre veprave nga prokurori sipas detyrës zyrtare në mungesë të pëlqimit apo lejes e bënë ndjekjen me të meta procedurale. Ndërsa në të kaluarën legjislacioni ka njohur disa vepra penale që janë ndjekur sipas paditësit privat përkatësisht paditësit subsidiar, dhe ato vepra penale që janë ndjekur sipas paditësit privat kanë nënkuptuar se nuk ndiqen sipas detyrës zyrtare.

Shkaku i kalimit të afatit të parashkrimit, lidhet me parashkrimin e ndjekjes penale dhe kjo konsiderohet si ndalës e veprimeve të organeve shtetërore për vazhdimin e procedurave penale nëse nuk ka përfunduar procedura deri në kohën kur ka pasur afat të ndjekjes penale. Kjo bëhet për qëllim të sigurisë juridike dhe të mos cenimit të të drejtave dhe lirive të njeriut që pafundësisht organet shtetërore ti mbajnë në procedura të pandehurit.

Falja apo amnistia është baze e veçantë që kur janë vendosur nga organet shtetërore që veprat e caktuara të falen apo për veprat e caktuara të këtë amnisti, atëherë për shkak të vendimeve të organeve shtetërore mbi faljen apo për shkak të ligjit që përfshin amnistinë e veprave penale prokurorit nuk i mundësohet ndjekja e mëtejshme penale dhe duhet që hetimet ti pushoj.

Baza tjetër kur ka rrethana të tjera që përjashtojnë ndjekjen penale, si të tilla këto rrethana nuk janë të specifikuar megjithatë si rrethana të tilla, mund të jenë: Vdekja e të pandehurit, çrregullimi ose paaftësia e përhershme mendore në paftësi për t'iu nënshtruar gjykimit, apo ndonjë rrethanë tjetër specifike që mund të rezultojë si përjashtim i ndjekjes penale.

Afatet kohore të hetimit – Afatet kohore të hetimeve janë afate ligjore⁵³³ të përcaktuara specifikisht e që prokurori ka detyrim ti respektoj me rigorozitet. Afatet për hetime në vetvete kanë shumë qëllime, në radhë të parë krijohet një para shikueshmëri e procesit të hetimeve se sa do të zgjas hetimi, po ashtu krijon një siguri që të pandehurit në procedurën penale të kenë një mundësi për të ditur në mënyrë optimale se sa mund të zgjas rrjedha e hetimeve, po ashtu përcaktimi i afateve të hetimit krijon një mundësi për përcaktimin më të sakte të gjykimit në kohë të arsyeshme, të gjithë këta faktorë bëjnë që prokurori duhet ti përmbahet maksimalisht afateve për të mundur që të zbatoj me përpikëri procedurën penale ndaj të pandehurit. Si rregull afati i hetimit është 2 vite i cili fillon të rrjedh nga momenti i nxjerrjes së aktvendimit për fillimin e hetimeve, kjo për shkak se fillimi i hetimeve sipas Kodit është formal andaj edhe rrjedh nga momenti i nxjerrjes së aktvendimit për fillimin e hetimeve. Përjashtimisht prokurori mund të kërkoj zgjatjen e hetimeve nga gjyqtari i procedurës paraprake edhe për gjashtë (6)

⁵³³ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 159, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

muaj sipas kërkesës se arsyetuar më shkrim, dhe po qese ka ndonjë rrethanë të jashtëzakonshme, apo kur është bërë kërkesa për ndihme juridike ndërkombëtare, apo kur rasti është i komplikuar, kur ka me shumë të akuzuar. Duhet të kihet parasysh se zgjatja e afatit të hetimeve është përjashtim dhe jo rregull pasi që për tu lejuar kërkohet provueshmëria e shkaqeve që determinojnë zgjatjen e hetimeve. Sido qofte kur Gjyqtari i procedurës paraprake lejon vazhdimin e hetimeve dhe nëse është arrestuar i pandehuri dhe mbahet nen paraburgim, ai nuk vazhdon masën e paraburgimit ndaj të pandehurit, përveç kur Prokurori arsyeton se zhvillimi efikas i hetimeve është jashtë kontrollit të Prokurorit. Kjo është një rrethanë që përkundër mundësisë se vazhdimin të hetimeve nga aspekti ligjore kufizon gjykatën që për shkak të tejkalimit të afateve baze të hetimeve i pandehuri të pësoj edhe me kufizimin e lirisë se tij që nënkupton masën e paraburgimit.

Pushimi i hetimit për shkak të vdekjes se të dyshuarit – Pushimi i hetimit si pasojë e vdekjes së të pandehurit është në raport më të pandehurit për sa i përket veprës penale përkatësisht përgjegjësisë penale⁵³⁴. Megjithatë kur kemi të bëjmë me pasurinë që mund ti nënshtrohet konfiskimit ligji për kompetencat e zgjeruara të konfiskimit të pasurisë, mundëson zhvillimin e procedurës penale (e që nënkupton edhe zhvillimin e fazës kur çështja është në fazën e hetimeve) edhe kur i pandehuri vdes, dhe procedura vazhdohet vetëm për sa i përket pasurisë se të pandehurit që ka vdekur.

Arrestimi gjate fazës se hetimit – përkundër se dispozitat ligjore rregullojnë arrestimin gjate fazës se hetimit, njëkohësisht arrestimi mund të bëhet edhe kur fare nuk ka filluar hetimi, dhe arrestimi i tillë behet në dy rrethana: Kur kryerësi gjendet në flagrante si dhe kur ai është duke u ndjekur për veprën e kryer penale. Në këto situata policia por edhe çdo person tjetër ka të drejtë të bëj arrestimin e të dyshuarit. Megjithatë kur bëhet arrestimi i të dyshuarit nga personat civil atëherë ata detyrohen që menjëherë të njoftojnë policinë për arrestimin e tillë.

Arrestimi kur hetimi ka filluar behet vetëm sipas autorizimit të Prokurorit të cilin autorizim e ekzekuton policia⁵³⁵. Përkundër se arrestimin e tillë e autorizon prokurori vetëm pas fillimit të hetimit arrestimi, prokurori duhet që të këtë parasysh se arrestimi duhet të bëhet kur: a). Ka dyshim të bazuar se vepra penale është kryer e cila vepër ndiqet sipas detyrës zyrtare, b). Ka baza te artikuleshme për të besuar se: 1. Ka rrezik për tu arratisur, 2. Mund të fsheh apo asgjësoj gjurmët apo falsifikoj provat apo se rrethanat tregojnë se ai mund ta pengoj procedurën penale dhe atë qoftë duke ndikuar në dëshmitarë në të dëmtuar apo në bashkëpjesëmarrës. 3. Kur rrethanat personale apo kushtet nen të cilat jeton, apo karakteristikat e të dyshuarit si dhe sjellja e mëparshme si dhe pesha apo mënyra e kryerjes se veprës penale, tregojnë rrezikun se mund të përsëritet vepra penale apo se mund të përfundohet vepra që është tentuar.

Kushtet e tilla duhet të jenë konkrete dhe të specifikuara duke argumentuar probabilitetin e mundësisë për të ndikuar i dyshuari qoftë në dëshmitarë apo në të dëmtuar, ndërsa në raport me bashkëpjesëmarrësit, duhet të kihet parasysh se, janë dy dispozita paksa kontradiktore dhe

⁵³⁴ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 160, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁵³⁵ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 164, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

atë neni 123 paragrafi 5 që përcakton se deklarata e të bashkëkuzuarit nuk mund të shërbej si prove në procedurën penale kundër të akuzuarit, por edhe dispozita nga neni 127 paragrafi 3 nën paragrafi 1.3 që e kategorizon të bashkëpandehurin si dëshmitar të privilegjuar. Mbështetur në këto dy dispozita atëherë rrjedh pyetja logjike, se si është e mundur që të krijohet baze ligjore për arrestimin e të pandehurit me bazën për të ndikuar në të bashkëpandehur.

Sipas bazës së rrezikut për përsëritje të veprës apo të kryerjes së veprës që ka tentuar, ato duhet të jene konkrete të argumentuara se perse rrethanat e tillë e krijojnë një rrezik të tillë, madje pesha e veprës penale përkundër se përcaktohet nëse nuk ndërlihet me cilëndo rrethane tjetër të veçantë qofte personalitetin e të dyshuarit, mund të rezultojë si e vështirë vetëm për shkak të peshës të përcaktohet arrestimi i të dyshuarit. Pra rendësi ka që rrethanat e tilla duhet të jene specifike dhe konkrete për të arsyetuar ekzistimin e rrezikut të tillë. Kur behet ndalimi për të arrestuarin maksimumi i afatit të ndalimit është 48 ore. Është obligim që me rastin e ndalimit personi i ndaluar të njoftohet për të drejtat e tij por edhe për të drejtat e tij sipas Kodit të procedurës penale dhe njoftimi duhet të behet me shkrim. Nëse prokurori me rastin e ndalimit ka vlerësuar që ka baze për caktimin e ndonjë mase për sigurimin e prezencës së të pandehurit, atëherë duhet ta këtë parasysh që kërkesa duhet të parashtrahet në gjykate në afat prej 24 orësh. Çdo kërkesë që parashtrahet përtej afatit prej 24 orësh konsiderohet e pasafatshme dhe si e tillë formalisht nuk mund të procedohet, dhe se Gjykata në praktiken e ndërtuar kërkesat e tilla i ka hedhur si të pasafatshme, përkundër kësaj konsiderohet se afati i tillë nuk konsiderohet si cenim i drejtpërdrejt i ndonjë të drejte të të ndaluar me arsyetimin se ndalimi është në zgjatje prej 48 orësh, vlerësojmë se gjykata ka krijuar praktiken e tillë pikërisht për të ndaluar mundësit e tilla nga organi akuzës që të krijoj pasiguri juridike për personat e ndaluar. Gjykata për të vendosur për kërkesën e prokurorit duhet të mbaj seancën brenda 48 orëve afat ky që fillon të rrjedh nga momenti i ndalimit, ndërsa gjykata ka 48 ore për të nxjerr aktvendimin lidhur me kërkesën e prokurorit, ky afat fillon të rrjedh nga momenti i mbajtjes së seancës, sepse kodi përcakton, “por jo më vonë se brenda 48 orëve nga seanca dëgjimore”, andaj konsiderojmë se afati për nxjerrjen e vendimit është 48 ore nga mbajtja e seancës dëgjimore, përkundër se në praktike gjykata gjithnjë kanë vlerësuar se afati prej 48 orëve është i tërësishëm nga momenti i ndalimit.

Personi i ndaluar duhet ti jepet vendimi mbi ndalimin i cili vendim duhet të përmbaj, të dhënat personale, veprën për të cilën ka dyshim dhe bazën juridike të ndalimit.

Te drejtat e të arrestuarit – i arrestuari ka të drejt që të këtë ndihmën e mbrojtësit menjëherë që nga momenti i arrestimit dhe atë sipas zgjedhjes së tij që e bënë për mbrojtësin, gjithnjë kur mbrojtësi nuk zgjidhet nga i arrestuari atëherë tek mbrojtja e detyrueshme gjithnjë ka të drejte në mbrojtës, por edhe tek mbrojtja me shpenzime publike atë i caktohet mbrojtës kur nuk angazhon vet mbrojtës. Komunikimi i të arrestuarit mund të bëhet me mbrojtësin dhe atë në mënyrë konfidenciale, ky komunikim mund mu vëzhgua vizuelisht por në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk lejohet dëgjimi i këtij komunikimi nga zyrtaret policor⁵³⁶.

⁵³⁶ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 166 dhe 167, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

Përkundër këtyre të drejtave që i ka i arrestuari për mbrojtës, kur ai dyshohet për vepra të terrorizmit apo të krimit të organizuar dhe ka dyshim që edhe mbrojtësi mund të jetë i përfshirë apo dyshimet qojnë në konkluzionin se mund mbrojtësi me pengu zhvillimin e procedurës penale, sipas kërkesës së prokurorit dhe me vendim të gjyqtarit të procedurës paraprake mund që të caktohet një mbrojtës tjetër për ta përfaqësuar të arrestuarin deri në afatin prej 72 orëve. Ky është kufizimi i vetëm që të arrestuarit i ndalohet përzgjedhja e mbrojtësit përkundër se ai mund ta angazhojë vetë atë mbrojtës me qëllim që të krijohet zhvillim pa pengesa i procedurës penale kodi ka ngushtuar të drejtën e të arrestuarit vetëm në këtë rrethanë për angazhimin e mbrojtësit.

Po ashtu të arrestuarit i njihen të drejtat e tij – që të njoftohet për shkaqet që kanë dërguar në arrestimin e tij dhe ky informim duhet të bëhet në gjuhën që e kupton, shkaqet e arrestimit përbej sqarimet që duhet ti jepen të arrestuarit si arsye që është arrestuar. Të arrestuarit i bëhet me dije se ai ka të drejtën e heshtjes dhe të mos përgjigjet përveç të dhënave mbi identitetin e tij – këto përshijnë të dhënat gjenerale për të mundësuar identitetin e sakte. Gjithashtu njoftohet për të drejtat e tij për të informuar anëtarët e familjes për arrestimin e tij ose të kërkojë nga policia që ta bejë atë informim, dhe se vet i arrestuari e përcakton se kush saktësisht duhet të informohet. I bëhet me dije se ai ka të drejtë që të këtë kontroll mjekësorë por edhe trajtim psikiatrik nëse ka nevojë të tillë. Të gjitha këto të drejta janë si standard i njohur ndërkombëtare që shumica e legjislacioneve por edhe i akteve ndërkombëtare i njohin për të arrestuarit. Nëse i arrestuari është me shtetësi të huaj ai duhet që njoftohet për të drejtën që mund të këtë komunikim gojor apo me shkrim me ambasadën e shtetit që ai ka shtetësinë apo me përfaqësuesin e organizatës ndërkombëtare kur ai është kategori e refugjatit apo gëzon mbrojtje të organizatave ndërkombëtare. I arrestuari po ashtu ka të drejtë që të bëjë pushime të shkurtra gjatë marrjes në pyetje e me se shumti nga 2 ore mund të vazhdojë marrja në pyetje, mirëpo pushimi mund që të shtyhet për shkak: 1. rrezikut për dëmin që mund ta pësojnë personat tjerë, kur është rreziku që pushimi do të përcaktonte ndalimin me të gjatë të të arrestuarit pa nevojë si dhe kur mund të prejudikohet rezultati i hetimit.

Kërkesa për caktimin e masës për sigurimin e të pandehurit në procedure – në procedurën penale nuk mund të këtë caktim të masave pa parashtrimin e kërkesës nga ana e prokurorit drejtuar gjykatës për caktimin e masës për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedure. Kërkesa e prokurorit⁵³⁷ përveç pjesëve teknike duhet të përmbaj:

- Emërtimin e institucionit të prokurorisë dhe departamentin – kjo bëhet për të përcaktuar kompetencën territoriale dhe lëndore të prokurorisë që ka filluar procedurën penale.
- Emërtimin e gjykatës dhe departamentit që i drejtohet kërkesa – edhe kjo bëhet po ashtu që kërkesa duhet të drejtohet gjykatës kompetente dhe departamentit kompetent për vendosjen në kuadër të kompetencës lëndore dhe territoriale.

⁵³⁷ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 165, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

- Po ashtu duhet të përfshihen të dhënat, si: Emri dhe Mbiemri, datën e lindjes dhe vendin e lindjes, vendin e arrestimit datën dhe kohën e saktë të arrestimit, veprën penale që dyshohet ta këtë kryer personi, përshkrimin e provave që mbështesin ekzistimin e dyshimit të bazuar së personi dyshohet që ka kryer veprën penale, përshkrimin e provave që mbështesin bazat e artikuleshme për të krijuar besueshmërinë që:
 1. Ekziston rreziku i arratisjes;
 2. Do ti asgjësoj provat, ose fsheh, falsifikoj provat që mund të sigurohen në procedurën penale. Apo kur ka rrethana të posaçme që arsyetojnë se do ta pengoj rrjedhën normale të procedurës që ndërlidhen me ndikimin në dëshmitarë, të dëmtuar apo në bashkëpjesëmarrës;
 3. Rrethana tjetër po ashtu është kur, për shkak të peshës së veprës penale, mënyra apo rrethana në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti në të cilat jeton apo rrethanë tjetër e veçantë do të mund të përcaktojnë ekzistimin e rrezikut se mund që të përsëritet vepra penale apo do të kryhet vepra penale që ka mbetur në tentative.

Ne kërkesën për caktimin e paraburgimit prokurori ka obligim që të përshkruaj në mënyra të aritkulueshme mbi çfarë baze konsideron se masat me të buta që parashihen nuk do të mund të parandalonin rrezikun e tillë që pretendohet se ekziston.

Cilado nga kushte që nuk i përmban kërkesa e prokurorit ajo kërkesë konsiderohet formalisht e mangët që gjykata nuk do të mund të konsideronte kërkesën e tillë si të rregullt proceduralisht.

Dispozitat ligjore përcaktojnë dy kritere aspekti i përmbajtjes formale të kërkesës dhe aspekti i detyrimit të prokurorit që në kuadër të kërkesë në kuptimin përmbajtësor. Kërkesa në kuptimin përmbajtësor që lidhet me detyrimin e prokurorit për të argumentuar vërtetimin e dyshimit të bazuar në dy drejtime, a). Për veprën penale dhe b). Se dyshimi i tillë bie ndaj personit të arrestuar. Në rast se prokurori nuk arrin që të argumentoj vërtetësinë e këtyre dy rrethanave të dyshimit dhe të arrestuarit gjyqtari i procedurës paraprake duhet ta liroj të pandehurin.

Po ashtu kur prokurori nuk arrin në kërkesën e parashtruar që të argumentoj ekzistimin e rrezikut të arratisjes apo rrethanat e veçanta tjera që parashohin mundësinë e zhvillimit të procedure apo rrezikun e kryerjes përkatësisht përsëritjes së procedurës, mirëpo megjithatë ka arsyetuar ekzistimin e dyshimit për veprën dhe lidhshmërinë e atij dyshimi për të pandehurin, atëherë gjyqtari i procedurës paraprake mund të caktoj cilëndo masë tjetër me të butë që parashihet me dispozitat e kodit të procedurës penale. Këtu gjyqtari duhet të lidhet vetëm me nivelin e matjes së ekzistimit të rrezikut si kushte të veçanta për caktimin e masës për të vlerësuar masën adekuate që njëkohësisht të shmangët ai rrezik dhe procedura penale të mund të zhvillohet normalisht.

Masat për sigurimit e të pandehurit në procedurë – masat për sigurimin e të pandehurit në procedurën penale janë të përcaktuara në dispozitat e Kodit të procedurës penale⁵³⁸. Këto masa kanë qëllimin e tillë që të mundësohet zhvillimi i papenguar i procedurës penale në raport me rrezikun që konsiderohet se mund të cenohet procedura nga një i pandehur në procedurë, andaj masat janë ngushtësisht të lidhura me bazat e veçanta që përcaktohen për caktimin e ndonjë mase për këto arsye masat edhe janë të renditura nga ajo me efekt të kufizimit sa me të ulet të ndonjë të drejte të të pandehurit e deri te ajo si më e rendë që mund të kufizohet liria e lëvizjes, në këtë kontekst masat kanë qëllimin që të vlerësohet niveli i lartësisë së rrezikut për pengimin e procedurës penale dhe rrezikun për kryerjen e veprës tjetër apo të përsëritjes së veprës dhe karshi ekzistimit të atij rreziku njëkohësisht edhe mund të caktohet masa për të shmangur rrezikun e tillë. Masat po ashtu kanë edhe kushtet ligjore se, nga kush urdhërohen, sa kanë efekt si caktohen dhe si hiqen ato, andaj dispozitat që rregullojnë masat e sigurisë së të pandehurit në procedurë duhet të zbatohen me rigorozitet për të shmangur çfarëdo shkelje ligjore. Masat që njihen sipas Kodit të procedurës penale janë:

Thirrja – është komunikimi i thjesht shkresor ndërmjet gjykatës dhe të pandehurit, ajo i drejtohet të pandehurit në vendbanimin apo vendqëndrimin që ai e ka. Thirrja duhet të përmbajë: Emrin dhe mbiemrin, veprën penale që dyshohet apo akuzohet, vendin ditën dhe orën që duhet të paraqitet, konstatimin se thirret në cilësinë e të pandehurit, paralajmërimin se nëse nuk paraqitet do të urdhërohet arrestimi e që përmes urdhëror arrestimit do të shoqërohet forcërisht, emrin e gjyqtarit si dhe aspektet teknike të vulës zyrtare. Kur thirrja dërgohet për herë të parë, ajo duhet të ketë informacionin se i pandehuri ka të drejtë të angazhojë mbrojtës. Gjithnjë i pandehuri ka obligim që ta njoftoj gjykatën për ndryshimin e adresës së vendbanimit apo vendqëndrimit të tij. Kur për shkaqe objektive nuk mund të përgjigjet në thirrjen e gjykatës e që shkaqe objektive do të mund të konsideroheshin sëmundjet apo pamundësia objektive e të pandehurit për tu paraqitur në gjykatë atëherë mund të merret në pyetje i pandehuri në vendin ku gjendet pa prezantuar në gjykatë, e në raste se as kjo nuk është e mundshme atëherë shtyhet veprimi i tillë procedural. Duhet të kihet parasysh fakti se kryesisht veprimet e dërgimit të thirrjeve behën nga administrata – zyrtaret ligjore andaj ata duhet ti plotësojnë tërësisht kërkesat e ligjit nga se këto janë paraparë për dy qëllime thelbësore, që të mos ketë zvarritje të procedimit penal si dhe fakti se përmes thirrjes i pandehuri njoftohet me disa të drejta thelbësore në procedurë siç është fakti se ai njoftohet për të drejtën për angazhim të mbrojtësit, në të kundërtën mungesa e të metave në ftesa kem rastin e dërgimit, mund të rezultojë me shtyrje të veprimit procedural dhe për pasoj me efekt afatgjatë zvarritjen e procedimit të çështjes penale⁵³⁹.

Urdhër arresti – është akt që mund të lëshohet vetëm nga gjykata. Urdhër arresti varësisht nga faza e procedurës penale, urdhërohet nga: Gjyqtari i Procedurës paraprake, Gjyqtari i vetëm Gjykues apo Kryetari i Trupit Gjykues⁵⁴⁰.

⁵³⁸ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 173, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁵³⁹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 174, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁵⁴⁰ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 175, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

Kush mund të parashtrij kërkesë për urdhër arrest: a) kërkesa mund të parashtrihet nga prokurori pranë gjykatës për lëshimin e urdhër arrestit si dhe, b) kërkesa mund të parashtrihet edhe nga policia kur ka dyshim të bazuar sipas nenit 187.1 por vetëm nëse janë rrethanat e veçanta, se cilat mund të jenë ato rrethana duhet të vlerësohen varësisht nga rasti.

Urdhër arresti lëshohet edhe sipas detyrës zyrtare nga gjykata pa pasur kërkesë të prokurorit kur faza e veprimit procedural të ndërmarr është veprim zyrtar nga gjykata dhe për qëllim të procedimit të çështjes penale në gjykatë.

Cilat janë kushtet për lëshimin e urdhër arrestit: asnjëherë urdhër arresti nuk mund të lëshohet pa qenë paraprakisht të plotësuar disa kushte dhe atë, a). Që fillimisht të jetë dërguar thirrja ndaj të pandehurit dhe që i pandehuri të: - të mos paraqitet sipas thirrjes dhe të mos arsyetoj mungesën e tij, - kur nuk ka qenë e mundur dërgimi i thirrjes sipas rregullit dhe kur rrethanat e bëjnë të qartë që i pandehuri i shmanget pranimit të thirrjes. Kur këto kushte plotësohen atëherë mund të urdhërohet arrestimi.

Çfarë duhet të përmbaj urdhër arresti: Emrin dhe mbiemrin ndaj të pandehurit, emrin dhe mbiemrin e të pandehurit dhe të dhëna të tjera personale të njohura për gjyqtarin, përcaktimin e veprës penale me të cilën ngarkohet duke iu referuar dispozitës përkatëse të Kodit Penal, bazën mbi të cilën lëshohet urdhri dhe vulën zyrtare dhe nënshkrimin e gjyqtarit që lëshon urdhër arrestin. Po ashtu urdhër arresti duhet të përbëjë afatin e vlefshmërisë, por vetëm kur gjykata që ka lëshuar dëshiron ta përcaktoj afatin, nga se në raste të mos përcaktimit të afatit se sa kohe është i vlefshëm atëherë urdhër arresti ligjërisht ka afat 365 dite – 1 vite. Këto janë kërkesat ligjore që duhet të përmbaj urdhër arresti. Megjithatë rekomandohet që urdhër arresti të përmbaj tri pjesë standarde të urdhrit gjyqësor, që është: hyrja në të cilën përshkruhet, organi që e lëshon gjyqtarin që e urdhëron, të pandehurin ndaj të cilit është duke u ndërmarr veprimi, datën e lëshimit të urdhër arrestit dhe bazën ligjore, ndërsa në dispozitiv të përcaktohet. Vepra penale për të cilën është duke u ndërmarr veprimi procedural, faktin se kush do ta ekzekutoj urdhër arrestin, dhe kohën e vlefshmërisë së urdhër arrestit, si dhe pjesën arsyetuese duke argumentuar plotësimin e kushteve ligjore që janë përmbushur për lëshimin e urdhër arrestit, si dhe pjesët teknike nënshkrimin dhe vulën zyrtare të gjykatës.

Shabull nga praktika gjyqësore e pjesës së dispozitivit të urdherarrestit:

URDHËRARREST

I. Urdhërohet arrestimi i të pandehurit: N/N, nga i ati N/N, e ëma N/N, e vajzërisë N/N, i lindur me dt.----- në fsh.T/T, ku edhe jeton - Komuna e Drenasit, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal.0000000000.

II. Pas arrestimit i pandehuri i shoqëruar nga zyrtarët policor të sillet te Gjyqtari i çështjes në Gjykatën Themelore në Mitrovicë -Veri - Departamenti për Krimeve të Rënda.

III. Policia duhet të njoftoj gjyqtarin që ka lëshuar urdhrin dhe t' i dorëzoj raport me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me urdherarrestin ndaj të pandehurit N/N.

IV. Urdhërarrestin do ta ekzekutoje Policia e Kosovës Stacioni Policor në Drenas - Njësia për Zbatimin e Urdhëresave Gjyqësore.

V. Efekti juridik i këtij urdhërarresti do të vazhdoj të vlejë deri në momentin e arrestimit të pandehurit Vehbi Bajrami apo deri në tërheqjen e tij nga kjo Gjykatë.

Kush e ekzekuton urdhër arrestin: Ndaj çdo të pandehuri urdhër arresti ekzekutohet nga policia, dhe ai njoftohet se ndaj ti ekziston një urdhër arrest dhe duhet ti kërkohet që të shoqërohet deri në gjykatën në të cilën e ka lëshuar urdhër arrestin, e në raste se refuzon atëherë forcërisht shoqërohet dhe dërgohet menjëherë para gjyqtarit që ka lëshuar urdhër arrestin. Përgjithësisht ndaj zyrtareve policore dhe personave që bëjnë rojën e institucioneve korrektuese urdhër arresti ekzekutohet nëpërmjet komandës së tyre por edhe ata njoftohen për faktin e urdhër arrestit ndaj tyre që është lëshuar dhe dërgohen para gjyqtarit që ka lëshuar urdhrin. Me rastin e zbatimit të urdhër arrestit gjithnjë i pandehuri njoftohet për të drejtat e tyre.

Premtimi se nuk do ta braktis vendqëndrimin – Premtimi i tillë është një nga masat e lehta që konsiderohet në procedurën penale përkundër se në esencë kufizon të drejtën e të pandehurit që lirshëm të lëvizë pa kufizime, megjithatë kjo konsiderohet si mase e bute në raport me masat tjera që kufizojnë më shumë të drejtat dhe lirit e njeriut e në raste të masave ndaj të pandehurit⁵⁴¹.

Kush e lëshon masën e tillë: Gjykata gjatë procedurës mund të kërkojë nga i pandehuri premtimin se nuk do të fshihet ose largohet nga vendqëndrimi pa lejen e gjykatës.

Cilat janë kushtet për shqiptimin e masës së tillë: Kur ekziston dyshim i bazuar se ai ka kryer veprë penale dhe ka arsye për dyshim se i pandehuri mund të fshihet, të shkojë në vend të panjohur ose të largohet nga Kosova.

Cilat janë kufizimet shtesë që mund të shqiptohen krahas masës së tillë: Të pandehurit i merret përkohësisht dokumenti i udhëtimit, i cili detyrohet me premtimin e dhënë se nuk do ta braktisë vendqëndrimin dhe nuk do të fshihet.

Cilat janë detyrimet me rastin e caktimit të masës: Me rastin e dhënies së premtimit, i pandehuri paralajmërohet se ndaj tij mund të caktohet paraburgim po që se e shkel këtë premtim.

Si konstatohet shqiptimi i masës së tillë: Premtimi i dhënë nga i pandehuri shënohet në procesverbal. Ankesa kundër aktvendimit për konfiskimin e dokumentit të udhëtimit nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.

Duke qenë se masa e tillë konstatohet në procesverbal, rrjedhimisht ka mëdyshje nga praktika se a duhet të lëshohet aktvendim për masën e tillë. Vlerësojmë se përkundër faktit se duhet të konstatohet në procesverbal megjithatë duhet të lëshohet aktvendim, kjo për shkak se përderisa

⁵⁴¹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 176, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

ka dy specifika shtesë ndaj te pandehurit, fakti se ati i tërhiqet vërejtja qe nëse nuk respekton masën e tillë do të mund ti caktohet paraburgimi si masa ma e rëndë dhe fakti se i merret dokumenti i udhëtimit përkohësisht po ashtu ai mund ete parashtroj ankese, dhe konstatimi vetëm në procesverbal i masës se tillë atëherë do të krijohen probleme për mundësin e shfrytëzimit të të drejtës se ankesës se tij.

Ndalimi për t'iu afruar vendit apo personit – qëllimi i kësaj mase është vetëm për sa i përket rrezikut për dëmtimin e provave apo ndikimin në dëshmitarë, të dëmtuar apo bashke të pandehur, si dhe kur ekziston rreziku për shkak kryerjes se veprës penale apo përfundimit te veprës që ka mbetur në tentative, por gjithnjë kushti kryesor është ekzistimi i dyshimit të bazuar⁵⁴². Megjithatë kjo mase nuk mund të caktohet për rrezikun e ikjes apo arratisjes së të pandehurit, nga se në realitet kjo mase nuk mund ta parandaloj atë rrezik prandaj edhe nuk parashihet si baze ligjore caktimi i kësaj mase për rrezikun e ikjes apo fshehjes.

Cilat janë kushtet për caktimin e masës se tillë: Kushti kryesor është ekzistimi i dyshimit të bazuar për veprën penale dhe se ai dyshim duhet te rendoj ndaj të pandehurit që kërkohet caktimi i masës. Kushti tjetër është, rreziku i dëmtimit te provave dhe rreziku i përsëritjes se veprës apo kryerjes se veprës penale.

Si vendoset: Kjo mase vendoset me aktvendim që duhet të përmbaj hyrjen dispozitivin dhe arsyetimin, në hyrje përshkruhet, organi – gjykata që vendose për kërkesën e tillë, kërkesa nga cila prokurori është parashtruara, emri dhe mbiemri i të pandehurit, vepra penale për të cilën zhvillohet procedura penale, data e marrjes se vendimit. Në dispozitiv përcaktohen të dhënat personale të te pandehurit, si dhe fakti se i ndalohet që ti afrohet qofte personit apo vendit duke përcaktuar kriter të afërsisë që mund të i afrohet si vendit edhe personit të caktuar dhe po ashtu konstatimin e faktit se nëse cenohet distanca e tillë me qellim, distance që i pandehuri duhet ta respektoj që të mos afrohet të vendi apo personi atëherë ndaj tij do të caktohet masa e paraburgimit. Në arsyetim duhet të arsyetohet baza e dyshimit, duhet të arsyetohet rrethana – kushti i veçantë se a caktohet masa e tillë për shkak të rrezikut të dëmtimit të provave apo të rrezikut te përsëritjes apo kryerjes se veprës penale, provat qe arsyetojnë ekzistimin e dyshimit te bazuar dhe faktin se si ndërlidhen ato prova me atë dyshim në raport me të pandehurin si dhe artikulueshmeria e rrethanave të tilla të rrezikut që ekziston. Po ashtu aktvendimi duhet të përmbaj këshillën juridike që mund te atakohet me ankese në afat prej 24 orësh, ku duhet të parashtrohet ankesa dhe kujt i drejtohet, si dhe aspektet teknike të nënshkrimit dhe emrit të gjyqtarit dhe vula zyrtare e gjykatës.

Kujt i dorëzohet aktvendimi: aktvendimi për masën e tillë i dërgohet të pandehurit si dhe personit që është konstatuar se i pandehuri nuk duhet ti afrohet, ai mund të jete qoftë i dëmtuari dëshmitari apo i bashkëpandehuri.

Kërkesa për masën e tillë: Masa e tillë caktohet sipas kërkesës se prokurorisë apo sipas detyrës zyrtare kur gjykata vlerëson se rreziku shmanget mjaftueshëm edhe me masën e tillë nëse

⁵⁴² Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 177, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

kërkesa e prokurorit ka pretenduar për një mase me të rëndë, ndërsa vazhdimi i masës se tillë bëhet qoftë sipas propozimit të prokurorit apo edhe sipas detyrës zyrtare.

Efektet shitesë që lindin nga kjo mase: Kjo mase mund të krijoj efekte shitesë poqë se personi që mbrohet cenon distancën me qellim që është përcaktuar për të pandehurin dhe i afrohet të pandehurit, atëherë gjykata mund të shqiptoj dënim me gjobe, ky dënim mund të shqiptohet deri në shumën prej 250 euro. Ky efekt shitesë mund ta godas personin që i pandehurit ndalohet për t'iu ofruara sepse, në radhë të parë personi nuk merr pjesë në seance kur komunikohet masa e tillë, fakti tjetër është se ati i dërgohet vendimi, mirëpo për ta ditur detyrimin e tij personi dhe që të mos ndëshkohet për afrimin tek i pandehuri duhet të konstatohet në vendim detyrimi i tij që ai nuk duhet të afrohet të pandehurit me qellim në distancën që të pandehurit i është ndaluar të afrohet personit të tillë.

Paraqitja në stacion policor – masa e tillë është e mundur që të shqiptohet vetëm kur plotësohet kushti kryesor që është ekzistimi i dyshimit të bazuar për veprën penale dhe ai dyshim ndërlidhet me të pandehurin, si dhe plotësimin e kushtit të veçantë kur ka rrezik që i pandehuri mund të fshihet apo të arratiset⁵⁴³.

Kush e cakton dhe si vazhdohet masa: Masa e tillë caktohet sipas kërkesës së prokurorit nga gjykata që është me kompetencë për të vendosur lidhur me atë kërkesë. Në rastet kur ende nuk është ngritur aktakuza masën e tillë mund ta vazhdojë gjyqtari i procedurës paraprake qoftë sipas propozimit të prokurorit apo edhe zyrtarisht kur gjykata vlerëson se masa e tillë është e nevojshme për të shmangur rrezikun e fshehjes apo të arratisjes.

Çka përmban aktvendimi për masën: Aktvendimi për caktimin e masës së paraqitjes në stacionin policor përbehet nga tri pjesë, Hyrja në të cilën përshkruhet gjykata që vendos gjyqtari dhe procesmbajtësi, kërkesa e prokurorisë dhe data e prokurorisë, lidhur me çka vendoset, të dhënat e të pandehurit si emri dhe mbiemri dhe vendbanimi apo vendqëndrimi, datën e vendosjes. Në pjesën e dispozitivit shënohen të dhënat e të pandehurit në gjeneralë, si dhe shqiptohet masa duke i përcaktuar detyrimin e paraqitjes në polici të pandehurit në kohe dhe dite të caktuar (është në diskrecionin e gjykatës për ta përcaktuar se sa shpesh duhet të paraqitet i pandehuri në polici e kjo duhet të kihet parasysh në raport me shmangien e rrezikut për arratisje apo fshehje), po ashtu në dispozitiv konstatohet fakti se në raste të mos respektimit të masës ndaj të pandehurit do të caktohet masa e paraburgimit dhe të pandehurit i behet e njohur kjo pasojë eventuale, në dispozitiv po ashtu konstatohet se në cilin stacion policor duhet të paraqitet e që duhet të paraqitet në stacionin që ka vendbanimin apo vendqëndrimin apo në territorin e stacionit ku i pandehuri është ndodhur në momentin që është urdhëruar masa, po ashtu në dispozitiv duhet të përcaktohet detyrimi i policisë për mbikëqyrjen e zbatimit të masës si dhe detyrimin për raportim të zbatimit të masës që policia duhet të raportojë gjykatës për zbatueshmërinë e masës së tillë. Në arsyetim gjykata duhet të arsyetojë kushtet që janë plotësuar ligjërisht dhe arsyeshmëria e nevojës së caktimit të kësaj mase që do të nënkuptonte se masa e

⁵⁴³ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 178, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

tillë është e nevojshme për të shmangur rrezikun e fshehjes apo arratisjes. Po ashtu aktvendimi duhet të përmbaj këshillën për të drejtën e ankimit dhe aspektet teknike si vula zyrtare, emri dhe nënshkrimi i gjyqtarit që e ka lëshuar. Në raste së gjykata vlerëson se për qellim të shmangies se rrezikut të arratisjes apo fshehjes duhet ti konfiskohet përkohësisht dokumenti i udhëtimit të pandehurit, ajo mund të vendos edhe konfiskimin me rastin e shqiptimit të masës, megjithatë kjo duhet të konstatohet po ashtu në dispozitivin e aktvendimit se dokumenti i është konfiskuar dhe se i njëjti do të mbahet në gjykatë derisa të jete e vlefshme masa e paraqitjes në polici.

Efekt i pezullimit të ekzekutimit sipas mjetit juridik: Edhe kur aktvendimi i gjykatës që ka urdhëruara masën e tillë, goditet me ankesë, ankesa nuk pezullon zbatimin e masës se tillë ankesa, andaj masa fillon të ekzekutohet menjëherë posa aktvendimi të lëshohet nga gjykata.

Dorëzania – dorëzania është masa përmes së cilës synohet që duke i kufizuar qasjen e plote në pasurinë e të pandehurit ai për shkak të këtij kufizimi dhe rrezikut që të mos e humb atë pasuri do të sigurohet në procedurën penale. Në thelb dorëzania është masa me anë të së cilës gjykata i përcakton shumën e pasurie – mjeteve monetare që ta deponoj apo pasurin e paluajtshme që të regjistrohet si dorëzani gjera procedura penale të përfundoj e kjo me qëllim të sigurimit të prezencës së të pandehurit⁵⁴⁴.

Kushtet për shqiptimin e dorëzanisë: Për tu caktuar masa e dorëzanisë gjykata ka detyrim që të vlerësoj kushtet ligjore, e si kusht ligjor kryesor është ekzistimi i dyshimit të bazuar për veprën penale si dhe lidhshmëria e atij dyshimi me të pandehurin si kryes i asaj veprë penale. Kushtet e veçanta janë kur ka rrezik se i pandehuri do të arratiset dhe ai premtion se nuk do të qaset arratisjes dhe fshehjes.

Po ashtu dorëzania mund të caktohet nga gjykata kur ekziston dyshimi i bazuar për veprën penale si kushte i përgjithshëm dhe kur ekziston rreziku i përsëritjes së veprës së tentuar apo rreziku i kryerjes së veprës penale tjetër por se ai premtion se nuk do ta përsëris veprën penale, dhe po ashtu kur vepra penale është e parapare me dënim me të paktën 5 vite burgim, për kapitujt e veprave që përcaktohen specifikisht me dispozitën ligjore në Kodin e Procedurës Penale. Kjo tregon se janë dy baza specifike apo të veçanta që gjykata duhet të vlerësoj për caktimin e masës së dorëzanisë, dhe atë rreziku i arratisjes dhe rreziku i përsëritjes apo përfundimit të veprës që ka mbetur në tentative.

Kush mund ta jap dorëzanin: Dorëzania përveç se mund të jepet nga i pandehuri kodi ka lejuar që dorëzanin në llojin dhe lartësinë mund ta jap çdo person tjetër, pra kodi nuk ka kufizuar vetëm të pandehurin apo të afërmit e tij që ta japin dorëzanin e caktuar por mund ta jap kushdo qofte. Kjo është e arsyeshme nga fakti se gjykata ka vetëm një qëllim përmes caktimit të masës së tillë dhe ai qëllim është siguri i prezencës së të pandehurit në procedure, andaj edhe dhënia e dorëzanisë nuk është kufizuar vetëm në raport me të pandehurin si pale në procedure.

⁵⁴⁴ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 179, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

Aktvendimi për dorëzanimë: Aktvendimi për dorëzanimë Merret nga gjyqtari i procedurës paraprake para ngritjes së aktakuzës, ndërsa pas ngritjes së aktakuzës aktvendimi merret nga gjyqtari i vetëm apo kryetari i trupit gjykues. Aktvendimi po ashtu përmban hyrjen, dispozitivin dhe arsyetimin, në hyrje duhet të jetë pjesa që tregon gjykatën, departamentin dhe gjyqtarin e zyrtarë dhe gjykatës që ka asistuar, kërkesën e prokurorit që është parashtruar, veprën penale që zhvillohet procedura, të dhënat e të pandehurit dhe të mbrojtësit të tij, datën e nxjerrjes së aktvendimit. Në dispozitiv shënohen të dhënat e identitetit të të pandehurit, faktin se është caktuar masa e dorëzimit dhe detyrimin për çfarë pasurie detyrohet që ta jap si dorëzani i pandehuri apo personi tjetër që do ta jap pasurin për të pandehurin, po ashtu konfiskohet për kohësisht edhe dokumentin e udhëtimit, përveç nëse gjykata ka vlerësuar se ka arsye bindëse që dokumenti të mos konfiskohet, dhe nëse konfiskohet dokumenti ajo konstatohet në dispozitiv të aktvendimit. Po ashtu në pjesën e arsyeve gjykata duhet të arsyetoj ekzistimin e dyshimit të bazuar dhe faktin e nevojës së caktimit të masës së tillë për efekt të shmangies së rrezikut të arratisjes apo kryerjes përkatësisht përsëritjes së veprës penale.

Arresti shtëpiak – masa e arrestit shtëpiak është masa e cila kufizon lirin e lëvizjes së të akuzuarit sipas kushteve dhe rregullave të kodit të procedurës penale⁵⁴⁵. Kjo masa për të caktuar fillimisht duhet të argumentohet ekzistimi i dyshimit të bazuar në raport me veprën penale dhe në raport me lidhshmërinë e asaj veprë penale me të pandehurin, pra dyshimi i bazuar është kushti kryesor që duhet plotësuar, ndërsa po ashtu kushtet e veçanta që duhet të plotësohen për caktimin e kësaj mase janë, Ekzistimi i rrezikut të ikjes së të pandehurit, rreziku që i pandehuri do të mund të ndikoj në dëshmitar, bashkëpandehur apo të dëmtuar apo që do të dëmtoj ndryshoj apo falsifikoj provat, si dhe kur për shkak të peshës së veprës, për shkak të rrethanave në të cilat dyshohet se është kryer vepra penale, cilësitë e të pandehurit dhe rrethanat në të cilat jeton i pandehuri apo rrethanat tjera të veçanta tregojnë për rrezikun se mund të përsëritet apo të përfundohet vepra penale e cila është tentuar që të kryhet. Duhet të kihet parasysh fakti se, nuk është kusht ligjor përmbushja e të gjitha kushteve të veçanta për të caktuar masën e arrestit shtëpiak, por mjafton që njëri nga kushtet e veçantë të plotësohet së bashku me kushtin kryesor pra dyshimin e bazuar.

Çka përmban masa e arrestit: Arresti shtëpiak është masa që i pandehuri ka për obligim që të qëndroj në vendin e banimit apo të vendqëndrimit të tij që të mos largohet në asnjë rrethë pa ndonjë leje të veçantë të gjykatës. Arresti shtëpiak ka në vetvete qëllimin që të shmange ekzistimin e rrezikut që arsyetohet se ekziston poqë së vazhdon që të mbetet në liri i pandehuri. Me rastin e caktimit të kësaj mase gjykata kur vlerëson të arsyeshme mund të ndaloj edhe çfarëdo komunikimi me të pandehurin me cilindo person që nuk kanë ndonjë lidhje përkatësisht që personat e tillë nuk jetojnë së bashku apo që ata persona nuk janë të varur nga i pandehuri.

Përmbajtja e aktvendimit: Masa e arrestit shtëpiak caktohet vetëm me aktvendim të gjykatës e cila ka shqyrtuar kërkesën e prokurorit. Aktvendimi përbehet nga pjesët arsyetuese, dispozitivi dhe arsyetimi. Pjesa arsyetuese përmban gjykatën, departamentin, gjyqtarin dhe zyrtarin e

⁵⁴⁵ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 183, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

gjykatës, çështjen penale përkatësisht kërkesën e prokurorit që është kërkuar masa e caktuar dhe veprën që dyshohet, të dhënat e të pandehurit, faktin e mbajtjes se seancës së dëgjimit, mbrojtësin e të pandehurit dhe datën kur është marre aktvendimi. Në pjesën e dispozitivit jepen të dhënat gjeneralë të të pandehurit, konstatimin e caktimit të masës së arrestit shtëpiak, që duhet të jetë data kur është caktuar dhe sa zgjat, si dhe vendin ku i pandehuri do të qëndroj adresën e sakte të vendbanimit apo vendqëndrimit, detyrimin e policisë për mbikëqyrje të kësaj mase, faktin se a i ndalohej të pandehurit komunikimi me personat e caktuar, konstatimin se nëse i pandehuri cenon masën dhe nuk i përmbahet ndaj te njëjtit do të caktohet masa e paraburgimit, po ashtu nëse gjykata ka vlerësuar se duhet konfiskuar për kohësisht dokumenti i udhëtimit atëherë në dispozitiv konstatohet se i është konfiskuar dokumenti duke përfshirë llojin e atij dokumenti.. Në pjesën e arsytimit aktvendimi duhet të përmbaj pjesën e rrethanave të procedurës, arsyeshmërinë e dyshimit të bazuar për veprën, faktin se ekziston rreziku në raport me plotësimin e kushteve të veçante si dhe faktin se përse është konsideruara se masa me e bute nuk do ta evitonte rrezikun e tillë që është vlerësuar se ekziston. Po ashtu aktvendimi përmban këshillën juridike, dhe pjesën teknike të nënshkrimit dhe emrin e gjyqtarit si dhe vulën zyrtare.

Karakteristika e masës së arrestit shtëpiak: Masa e arrestit shtëpiak është karakteristike pasi që e njëjta në asnjë fazë të procedurës nuk mund të vazhdohet sipas detyrës zyrtare nga vetë gjykata, nga fakti se, dispozitat ligjore para ngritjes së aktakuzës kanë parapare se masa caktohet nga Gjyqtari i procedurës paraprake sipas kërkesës së prokurorit, mirëpo edhe pas ngritjes së aktakuzës është përcaktuar se masa e tillë, caktohet, vazhdohet vetëm sipas kërkesës së prokurorit për caktimin apo vazhdimin e masës së arrestit shtëpiak. Ky standard nuk ekziston në raport me masat e tjera të sigurisë së të pandehurit përveç me masën e arrestit shtëpiak.

Aktvendimi mbi caktimin e masës i dorëzohet të pandehurit si dhe stacionit policor që e mbikëqyrë masën e tillë e kjo bëhet për shkak se policia ka detyrim që ta njoftoj gjykatën me raporte se si po zbatohet masa e tillë në periudha të caktuara kohore apo sipas vetë kërkesës së gjykatës për dorëzimin e raporteve të mbikëqyrjes së zbatimit. Ankesa kundër masës së tillë gjithnjë është në afat prej 24 orësh nga momenti i pranimit të aktvendimit nga i pandehuri, por ankesa nuk e pezullon fillimin e ekzekutimit të masës.

Shembull nga praktika gjyqësore e aktvendimit për caktimin e masës së arrestit shtëpiak:

PPR.NR. XX/XXXX

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtari i procedurës paraprake x.x, procesmbajtëse _____, në lëndën penale ndaj të pandehurit B.B. nga fsh.Xxxxx komuna e Xxxxx, për shkak të dyshimit të bazuar për veprën penale: Rrezikim i trafikut publik nga neni. 378 par.9 lidhur me par.8 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke vendosur sipas kërkesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë Departamenti i përgjithshëm për caktimin e masës së arrestit shtëpiak, kërkesa PP.II.nr.xxx/xxxx, dt.xx.xx.xxxx, pas mbajtjes së seancës dëgjimore me datën xx.xx.xxxx, nxjerr këtë:

AKTVENDIM

Ndaj të pandehurit;

B.B. , nga i ati I e ëma R , e gjinisë S , i lindur me xx.xx.xxxx , në xxxx, me banim në fsh.Xxxxx komuna e Xxxxx ,Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme ,i martuar ,me profesion vozitës, i gjendjes së mesme ekonomike, gjendet në arrest që nga dt.xx.xx.xxxx, nga ora xx.xx min.

CAKTOHET

MASA E ARRESTIT SHTËPIAK

Masa e arrestit shtëpiak të pandehurit B.B. , i caktohet në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji e cila masë do të llogaritet që nga dt.24.08.2013, deri me dt.24.09.2013, në ora 17.50 min.

I pandehuri B.B. Obligohet të qëndroj në shtëpinë e tij dhe që në asnjë mënyrë pa leje të gjykatës nuk guxon të largohet nga shtëpia ku ai e ka vendbanimin.

Të pandehurit i ndalohet kontakti me çdo person me të cilët ai nuk jeton apo të cilët nuk janë të varur nga i pandehuri, ndërsa në çdo mënyrë dhe formë i ndalohet kontakti me dëshmitar dhe personat e tjerë që mund të jenë pjese e kësaj procedure penale.

Detyrohet Stacioni Policor në xxxxxxx, të verifikoj zbatimin e kësaj mase dhe në rast të mosrespektimit të masës nga ana e të pandehurit ta informoj gjyqtarin e procedurës paraprake pranë kësaj gjykate.

Policia ka të drejtën që në çdo kohe të verifikoj zbatimin e masës së arrestit shtëpiak ndaj të pandehurit.

Në rast të mos respektimit të masës së arrestit shtëpiak dhe obligimeve të theksuara të pandehurit njoftohen se masa e arrestit shtëpiak do të zëvendësohet me masën e paraburgimit.

Masa e arrestit shtëpiak i caktohet në bazë të nenit 183 par.1 nenpar.1.1 e 1.2 lidhur me nenin 187 par.1 nën par. 1.1, e 1.2 pika 1.2.2, të KPP-se.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, Departamenti i përgjithshëm, ka filluar hetimet penale sipas aktvendimit PP.II.nr: xxx/xxxxx, të datës xx.xx.xxxx ndaj të pandehurit B.B. , në drejtim të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni .378 par.9 lidhur me par.8 dhe .1 të Kodit Penal të Kosovës. Gjithashtu kjo prokurori ka parashtruar kërkesë me datë:xx.xx.xxxx, për caktimin e masës së arrestit shtëpiak ndaj të pandehurit B.B. .

Gjyqtari i Procedurës paraprake, ka caktuar seancën e dëgjimit konform nenit 188 par.7 të KPP-ës, në të cilën kanë qenë prezent Prokurori i Shtetit në PTH-Mitrovicë – X.X, i pandehuri B.B. , dhe mbrojtësi i tij av.N.N .

Në seancën dëgjimore Prokurori i Shtetit në Prokurorin Themelore në Mitrovicë, X.x , ka mbetur pranë kërkesës për caktim e masës së arrestit shtëpiak ndaj të pandehurit, kërkesën e ka elaboruar në mënyrë të hollësishme, duke konsideruar se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri B.B. ,e ka kryer veprën penale dhe se është plotësuar kushti i veçantë ligjorë për caktimin e arrestit shtëpiak. Gjithashtu ka theksuar se po të lehet i pandehuri në liri ekziston dyshimi se i njëjti mund të ndikoi tek dëshmitarët - të dëmtuarit : B.M, M.S, Sh.M, L.R, B.L dhe Sh.B të cilët kanë marrë lëndime të natyrave të ndryshme trupore dhe të cilët do të dëgjohen në prokurori në cilësi të dëshmitarëve, e në këtë mënyrë pengohet zhvillimi me sukses i procedurës penale.

Mbrojtësi i të pandehurit B.B. av.N.N , gjatë seancës dëgjimore e ka kundërshtuar kërkesën e prokurorisë për paraburgim. Më tej, ka theksuar se nuk e konteston kushtin e përgjithshëm dyshimin e bazuar, kjo për faktin se ka mjaft prova që e dëshmojnë këtë, mirëpo e kundërshton bazën e posaçme

për caktimin e paraburgimit-të ndikimit në dëshmitar. Sipas tij te vepra penale Rrezikim i trafikut publik, ndikimit të dëshmitareve është aq i vogël apo i parëndësishëm, sepse te kjo vepër prova tjera e dëshmojnë dyshimin siç janë : foto dokumentacioni, dëmtimet e automjetit, lëndimet e te ndjerit, lëndimet e të lënduarve , prova këto te cilat nuk mund te ndryshohen e as te falsifikohen. Më tej ka theksuar se i mbrojturi i tij veprën penale e ka kryer nga pakujdesia.

I pandehuri B.B. , e ka kundërshtuar kërkesën për caktimin e masës së arrestit shtëpiak , njëkohësisht ka theksuar se ndihet shumë keq në lidhje me rastin që ka ndodhur, sipas tij rasti ka ndodhur pa dashje.

Gjyqtari i procedurës paraprake duke shqyrtuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, për caktimin e masës së arrestit shtëpiak , kundërshtimet dhe argumentet e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, gjitha shkresave të lëndës, vlerëson se kërkesa e prokurorisë për caktim arrestit shtëpiak është e bazuar, ngase mbi bazën e provave të ofruar në këtë fazë të procedurës gjyqtari i procedurës paraprake konsideron se ndaj të pandehurit janë plotësuar kushtet ligjore për të urdhëruar masën e arrestit shtëpiak konform nenit. 183, të Kodit të Procedurës Penale.

Gjyqtari i procedurës paraprake pasi ka shqyrtuar me kujdes të gjitha provat në këtë çështje penale konsideron se pa mëdyshje ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri B.B. , ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik neni .378 par.9 lidhur me par.8 dhe .1 të Kodit Penal të Kosovës, ku nga ky aksident nga plagët e marra ka ndërruar jetë , viktimat tani i ndjeri A.M, kurse lëndime të rënda trupore kanë marrë edhe B.M, M.F, Sh.M, L.R., B.L, E.R dhe Sh.B, e cila ka pësuar lëndime të lehta trupore.

Gjykata dyshimin e bazuar e vërteton në bazë të provave të ofruara nga prokuroria themelore në Mitrovicë: Nga deklaratat e të pandehurit B.B. dhënë në polici me dt.24 dhe 25.08.2013, nga procesverbali i shqimit të vendit të ngjarjes, skica e vendit të ngjarjes, raportet e aksidentit, dokumentet e automjetit-Libreza e qarkullimit, Polisa e sigurimit, foto dokumentacioni i automjetit në emër të N.N “X.X’ , fotoalbumi i vendit të ngjarjes /gjithsejt 26 fotografi/, fotot-dokumentacioni i viktimës tani të ndjerit A.M. Të gjitha këto prova e argumentojnë dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën edhe ka filluar hetimi penal ndaj tij, në këtë drejtim konsiderojmë se është plotësuar kushti ligjor-dyshimi i bazuar sipas nenit 183, par.1 nënpar.1.1 te KPP-ës.

Gjyqtari i procedurës paraprake duke shqyrtuar kushtet e veçanta për caktimin e masës së arrestit shtëpiak ,në kuptim të nenit 183 par.1.nënp.1.2 lidhur me nenin 187 par.1.nënp.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.2 të KPP-së, konsideron se në këtë çështje penale në procedurën paraprake pranë prokurorisë themelore ne Mitrovicë, do të dëgjohen në cilësi të dëshmitarëve edhe të dëmtuarit: B.M, M.F, Sh.M, L.R., B.L, E.R dhe Sh.B, të cilët ende nuk janë dëgjuar dhe eventualisht edhe dëshmitare tjerë të mundshëm. Gjithashtu duke marrë parasysh faktin se kjo çështje penale gjendet në fazën e hetimit penal në prokurori, ndjeshmërinë e rastit gjithashtu faktin se në këtë çështje duhet të sigurohen edhe prova tjera si dhe duhet të urdhërohen ekspertiza e komunikacionit, si dhe ekspertizat mbi natyrën e lëndimeve të të dëmtuarve në këtë aksident, e mbi bazën e këtyre arsyeve gjyqtari i procedurës paraprake konsideron se masa e arrestit shtëpiak është e domosdoshme ndaj të pandehurit për faktin se nëse i pandehuri do të gjendet në liri, mundë të ndikoi tek këta dëshmitarë .Gjithashtu, gjyqtari konsideron se këta dëshmitarë mundë të kenë rëndësi të madhe për vërtetimin e përgjegjësisë penale për të pandehurin përveç provave të cilat tani me janë të siguruara nga ana e prokurorisë në Mitrovicë. Gjykata, rëndësin e dëshmitarëve e shef edhe në faktin se në këtë rast ende nuk është siguruar ekspertiza e komunikacionit, si dhe ekspertizat mjeko-ligjore dhe deklaratat e dëshmitarëve- të dëmtuarve, mundë të kenë peshën e tyre për vërtetim e shume fakteve në këtë rast penal. Nga këto arsye konsiderojmë se është përmbushur kushti ligjor për arrest shtëpiak ne përputhje me nenin 183, par.1 nënp.1.1 e 1.2 pika e lidhur me nenin 187 par.1.2 pika 1.2.2 të KPP-ës.

Gjyqtari i procedurës paraprake vlerëson se ne rastin konkret masat tjera alternative (më të buta) nuk do ta arrinin qëllimin e masave, andaj nga kjo arsye vendosi që ta caktoj masën e arrestit shtëpiak si një masë e cila tani për tani është e domosdoshme dhe efektive me qëllim që në këtë rast të sigurohen të gjitha provat nga ana e prokurorisë dhe kjo procedure penale të zhvillohet me sukses dhe pa asnjë pengesë.

Nga të cekurat më lartë e konform nenit 183 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 lidhur me nenin 187 par.1 nënpar.1.2 ,pika 1.2.2, të KPP-es, është vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal

PPR.nr.xx/xxxx,dt.xx.xx.xxxx

Gjyqtari i procedurës paraprake

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta në ankesë, në afat prej /24/ore, nga momenti i pranimit të aktvendimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme.

Diversioni – masa e tillë është kategori e masave që më tepër i përket procedurave alternative të zgjidhjes së rasteve penale, e kjo vetëm duke u bazuar në dy kritere, nga ajo se çfarë përmban kjo masa dhe nga fakti se si vendoset dhe si zbatohet⁵⁴⁶.

Kush mund ta kërkojë masën e tillë: Masën e diversionit mund ta kërkojë qoftë prokurori apo qoftë i pandehuri, dhe kërkesa parashtrohet pran gjyqtarit të procedurës paraprake.

Cilat janë kushtet për caktimin e masës: Kushtet për caktimin e masës së diversionit janë: që i pandehuri të jetë arrestuar, që vepra që ai është arrestuar të jete deri në 1 vit burgim e dënueshme si dënim maksimal i veçante, të mos ketë dënime të mëparshme për veprat penale, dhe të mos i jetë caktuar me pare masa e diversionit. Duhet të kemi parasysh se dyshimet e tilla duhet të plotësohen në mënyrë kumulative.

Çfarë mund të përmbaj masa e diversionit: Në raste se gjyqtari aprovon kërkesën e prokurorit apo të të pandehurit për masën e tillë, atëherë gjyqtari, e liron të pandehurin që është i arrestuar, dhe po ashtu mund të caktoj përmbushjen e kushteve: a). Kompensimin e arsyeshëm ndaj viktimës siç përcaktohet nga gjyqtari, b). Lajmërimin e rregullt në stacionin policor me të afërm me vendbanimin e tij sipas kohës që cakton gjyqtari, c).detyrimin për të marrë pjesë në këshillimin apo trajtimin psikologjik, trajtimin nga abuzimi me substanca narkotike apo arsimimin apo ndonjë veprim tjetër që konsiderohet i arsyeshëm nga gjyqtari.

Si përfundon masa e diversionit: Masa e diversionit caktohet për periudhën kohore 12 muajsh. Vetëm kur konstatohet gjyqtari se kushtet e caktuara me masën e diversionit janë përmbushur nga i pandehuri atëherë gjyqtari pushon procedurën penale ndaj të pandehurit, çka nënkupton se procedura penale është në zbatim e sipër varësisht se a përmbushen kushtet e caktuara ndaj të pandehurit apo nuk përmbushen. Gjate kohës së mbikëqyrjes së përmbushjes së kushteve ndaj të pandehurit që janë caktuar nga gjykata dhe kur konstatohet se masa e tillë nuk është

⁵⁴⁶ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 184, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

duke u zbatuar përkatësisht se kushtet e caktuara janë duke u shkelur atëherë procedura penale rifillohet ndaj te pandehurit.

Paraburgimi dhe afatet kohore – Paraburgimi është nder masat me te renda për sigurimin e prezencës se te pandehurit ne procedure. Paraburgimi ne esence kufizon lirin e lëvizjes se te akuzuarit. Paraburgimi përveç se kufizon lirin e lëvizjes se te akuzuarit ne esencë për nga mënyra se si ekzekutohet është mase edhe me e rende se sa vet vuajtja e dënimit me burgim. Duke qenë se është masa me e rende gjithnjë gjykata me rastin e shqyrtimit te arsyeshmërisë se caktimit te masave për sigurimin e prezencës se te pandehurit duhet qe ti vlerësoj detyrimisht dhe te argumentoj se perse masat me te buta për te pandehurin nuk shmangin rrezikun ne raport me te pandehurin. Duke arsyetuar pamjaftueshmërinë e masave ne te buta ne secilin rast konkret atëherë, përkundër se është masa me e rende arsyetohet masa e tillë me qëllimin për te cilin caktohet.

Maksimumi i zgjatjes se afateve te paraburgimit: Paraburgimi pas ngritjes se aktakuzës nuk ka ndonjë afat ligjor se sa mund te zgjasë, megjithatë çështjet penale ne te cilat te pandehurit gjinden nene masën e paraburgimit ligjërisht trajtohen me prioritet, andaj ligjdhënësi nuk ka kufizuar kohen se sa zgjat masa pas ngritjes se aktakuzës por ne esence ka detyruara organet gjyqësore qe aktakuzën ta trajtojnë me prioritet, rrjedhimisht trajtimi me prioritet duhet nënkuptuar qëllimin e ligjshëm pra marrjen e vendimit dhe jo caktimin e seancave gjyqësore te cilat nuk dërgojnë ne përfundimin e çështjeve çka nënkupton se gjykata duhet detyrimisht te kujdeset maksimalisht qe çështja te trajtohet me prioritet ne kuptim te marrjes se vendimit dhe jo vetëm caktimin e seancave gjyqësore dhe përmes seancave gjyqësore te stërzgjatet qëllimi final pra qe është vendosja lidhur me akuzën.

Ndërsa para ngritjes se aktakuzës, paraburgimi mund te zgjasë varësisht nga fakti se për çfarë vepra penale është ngritur dyshimi i bazuar, dhe varësisht se vepra penale çfarë dënimi parasheh. Po qesë vepra penale është parapare me dënimi me pak se 5 vite burgim atëherë paraburgimi mund te zgjasë me se shumti 4 muaj para ngritjes se aktakuzës, ndërsa kur për veprën penale qe dyshohet i pandehuri është parapare dënimi me më shume se 5 vite burgim paraburgimi mund te zgjasë me se shumti 8 muaj. Dilemat nga praktika janë shfaqur se vepra penale kur ka përcaktuar dënimin maksimal 5 vite a mund te zgjas masa e paraburgimit me shumë se 4 muaj apo jo, ne kuptim te interpretimit sistematik te nenit 190 par 2 nën par 1.2 dhe 2.2 rrjedhe se ne çdo raste kur dënimi është deri ne 5 vite burgim i përcaktuar për veprën penale nuk mund te vazhdohet masa e paraburgimit me tepër se 4 muaj, kjo për shkakun se nën paragrafi 2.1 përdor shprehjen “kur është e dënueshme me më shumë se 5 vite burgim” atëherë ne lidhshmëri sistematike kjo dispozite japë te kuptoj se deri ne 4 muaj vazhdohet masa e paraburgimit për veprat penale qe kanë dënueshmëri deri ne 5 vite, ndërsa mbi 5 vite dënimi i veprës penale, masa e paraburgimit vazhdohet me se shumti deri ne 8 muaj.

Përkundër këtyre kushteve, kur vepra penale ka parapare dënimin deri ne 5 vite burgim dhe kur vepra është e ndërlikuar përkatësisht vonesat ne procedimin e çështjes për nga natyra e rastit nuk mund ti atribuohen prokurorit atëherë afatet e paraburgimit mund te jene me se shumti 12 muaj. Ndërsa kur ka shkak te bazuar se i paraburgosuri mund te përdorë dhunë dhe për shkak

te rrezikut te përgjithshëm, atëherë zgjatja e afateve te paraburgimit mund te jete maksimalisht 18 muaj. Këto janë afatet maksimale te lejueshme ligjore qe një i akuzuar mund te mbetet nen masën e paraburgimit para ngritjes se aktakuzës, dhe gjykata ka detyrim ne çdo raste te ketë parasysh këto afat për te mos i tejkaluar ne te kundërtën vendimet gjyqësore do te konsiderohen juridikisht te paqëndrueshme dhe për pasojë do te rezultojnë ne anulimin e te njëjtave ne procedurën e ankimit, dhe për pasojë nëse prokurori nuk gritë aktakuzën dhe tejkalon afatet e tilla siç përcaktohen me kohëzgjatjen e paraburgimit atëherë gjykata detyrohet qe ta liroj te akuzuarin nga paraburgimi⁵⁴⁷.

Kushtet për caktimin e paraburgimit: Kodi ka përcaktuar edhe tek masa e paraburgimit kushtin e përgjithshëm qe është dyshimi i bazuar, e qe nënkupton se dyshimi ndërlidhet me veprën penale qe pretendohet se është kryer dyshim ky qe mbështet me provat qe i siguron prokuroria, ndërsa provat e tilla e ndërlidhin vetëm te pandehurin me atë vepër penale, ne këtë kontekst dyshimi i bazuara është kusht te cilin ne asnjë mënyrë gjykata nuk mund ta tejkaloj pra ne mungesë se dyshimit te bazuar nuk mund te ketë masë te paraburgimit por te asnjë mase tjetër. Ndërsa po ashtu kushtet e veçanta për caktimin e paraburgimit janë: a) kur i dyshuari fshihet, kur nuk mund te vërtetohet identiteti i tije ose kur ekzistojnë rrethana te tjera qe tregojnë se ekziston rreziku i ikjes, këto rrethanat e tjera duhet te kihen parasysh varësisht nga rasti konkret qe te çmohen dhe vlerësohen nga gjykata se vërtet ajo rrethanë, a e përbën rrezikun e ikjes se te pandehurit; b). Kushti tjetër i veçantë është kur ka arsye te besohet se mund ti asgjësoj, fsheh ndryshoj apo falsifikoj provat apo qe rrethana te posaçme tregojnë se ai do te ndikoj ne dëshmitarë, te dëmtuar apo bashkëpandehur dhe për pasojë do te ndikoj ne rrjedhën e procedurës penale, duhet te kemi parasysh se këtu kërkohen rrethana te posaçme dhe jo çdo raste mund te argumentohet kushti i tillë se i pandehuri mund te ndikoj ne dëshmitarë por duhet te ekzistoj një rrethanë posaçërisht specifike qe argumenton mundësin qe i pandehuri do te mund ete ndikonte ne dëshmitarë, po ashtu edhe ne raport me dëmtimin e provave, ndryshimin dhe falsifikimin e provave duhet te ekzistoj arsyeshmëria se bashku me rrethanën e mundësisë qe i pandehuri te ketë mundësin e tillë qe te dëmtoj provat ne raste se nuk caktohet masa e paraburgimit, prandaj gjykata duhet specifikisht ti kushtoj rëndësi arsyetimeve ne vendimin se cilat janë ato arsye te besueshme dhe cilat janë ato rrethana te posaçme qe mbi këtë kusht te veçantë argumentohet caktimi i masës se paraburgimit. c). Kushti tjetër i veçantë është ekzistimi i rrezikut qe te përsëritet vepra penale apo qe te kryhet vepra penale qe ka mbetur ne tentative, por ky rrezik duhet te ndërlidhet me rrethanat si, Pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat nene te cilat është kryer kjo vepër penale, karakteristikat dhe sjellja personale e te pandehurit, krijojnë rrezikun e tillë, këtu duhet te kemi parasysh se jo çdo peshë e veprës penale apo jo çdo mënyrë e kryerjes se veprës penale arsyeton rrezikun e tillë te përsëritjes apo kryerjes se veprës penale⁵⁴⁸.

Duhet po ashtu te kihet parasysh se masa e paraburgimit duhet te reduktohet maksimalisht e njëkohësisht sipas parimit te prezumimit me te favorshëm te te pandehurit për te qenë ne liri se

⁵⁴⁷ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 190, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁵⁴⁸ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 187, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

sa për t'iu kufizuar liria me masën e paraburgimit, gjykata në çdo rastë ka obligim që të argumentoj se përse shmangia e rrezikut nuk do të mund të arrihej me masa më të buta.

Kur masa e paraburgimit caktohet për shkak të mos vërtetimit të identitetit, duhet të kihet parasysh se kjo masë detyrimisht hiqet posa të vërtetohet identiteti i të pandehurit. Ndërsa kur shtrohet çështja e caktimit të masës së paraburgimit për shkak se i pandehuri ka cenuar masën më të butë, duhet të kemi parasysh faktin se është obligim i gjykatës që jo në çdo rastë duhet të zëvendësoj masën e tillë por duhet të vërtetohet fakti se cenimi i masës a është bërë me shkak për të cenuar nivelin e ekzistimit të rrezikut sipas të cilit rrezik gjykata ka vlerësuar se me masën më të butë arrihet shmangia e rrezikut.

Përmbajtja e aktvendimit për caktimin e masës së paraburgimit: Aktvendimi për caktimin e masës së paraburgimit po ashtu duhet që të përmbaj pjesën hyrëse, dispozitivin dhe arsyetimin, në pjesën hyrëse gjithnjë përmbahet, emërtimi i gjykatës dhe departamentit e gjyqtarit dhe zyrtarës që kanë marrë pjesë në seancë, po ashtu çështjen penale përkatësisht vepra penale që dyshohet, kërkesën e parashtruar nga prokuroria, të dhënat e të pandehurit dhe mbrojtësin e tij, si dhe datën e nxjerrjes së aktvendimit. Në pjesën e dispozitivit konstatohen të dhënat ndaj të pandehurit, faktin se ndaj ti caktohet masa e paraburgimit dhe kohëzgjatja duhet përcaktuar datën e caktimit dhe datën se sa do të zgjas. Në pjesën e arsyetimit duhet që të jete pjesa e përshkrimit të zhvillimit të seancës dëgjimore, mbi pretendimet e palëve në atë seancë që ka dëgjuar gjyqtari, vlerësimet mbi dyshimin e bazuar në raport me veprën penale që pretendohet se është kryer dhe provat që e ndërlidhin të pandehurin me atë veprë penale, po ashtu duhet të arsyetohet edhe cilido nga kushtet që është vlerësuar nga gjykata që ka arsyeshmëri për caktimin e masës së paraburgimit duke arsyetuar rrethanat specifike mbi rrezikun që ekziston e për shkakun e atij rreziku duhet edhe të caktohet masa e paraburgimit, e rreziku mund të jete qoftë arratisja, qoftë dëmtimi i provave apo qoftë përsëritja apo kryerja e veprës penale të mbetur në tentativë. Gjkata duhet të arsyetoj gjithsesi shkakun se përse me masa më të buta nuk shmanget rreziku i tillë. Ndërsa aktvendimi duhet të përmbaj këshillën juridike mbi të cilën qartësohet se cilës gjykata i parashtrohet ankesa dhe përmes cilës gjykatë behet dorëzimi, afatin brenda të cilit duhet të paraqitet ankesa, e që është 24 ore nga momenti i pranimit nga i pandehuri, gjithsesi aktvendimi ka emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit dhe nënshkrimin si dhe vulën zyrtare⁵⁴⁹.

⁵⁴⁹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 189, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

Shembull i praktikës gjyqësore të dispozitivit të aktvendimit për caktimin e masës së paraburgimit:

A K T V E N D I M

Ndaj të pandehurit:

S G, nga i ati M, e ëma S, e gjinisë S, i lindur me dt.12.02.1967, në Mitrovicë, ku edhe tani jeton Rr” XN” blloku i dytë, me nr.16-T, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me numër personal të ID, i martuar, baba i 3 fëmijëve, i pa punë, ka të kryer shkollën e mesme elektronikën, gjendet në ndalim policor që nga data 26.06.2021 në ora 17,00.

CAKTOHET PARABURGIMI

- Në kohëzgjatje prej një (1) muaj.
- Paraburgimi sipas këtij aktvendimi, të pandehurit S G llogaritet prej dt:26.06.202021 dhe do të zgjasë deri me dt.26.07.2021.
- I pandehuri është sjellë të gjyqtari me dt.27.06.2015, në ora 13,45 minuta.
- I pandehuri dyshohet se ka kryer veprën penale; Sulm nga nenin 187 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.
- Masa e paraburgimit të pandehurit S G i caktohet në bazë të nenit .187 par.1 nenpar. 1.1, e 1.2 dhe pika 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP-së.

Procedura për caktimin e masës së paraburgimit: Për tu caktuar masa e paraburgimit duhet që të ndiqet detyrimisht zhvillimi i procedurës në përputhje me dispozitat e kodit të procedurës penale. Në këtë kuptim, kur prokurori parashton kërkesë për caktimin e paraburgimit atë duhet ta bëjë pranë gjykatës kompetente. Kërkesa e tillë duhet të përmbajë të dhënat e prokurorisë të dhënat e gjykatës që i drejtohet, të dhënat e të pandehurit të dhënat për dyshimin për veprën penale, provat që mbështesin dyshimin e tillë dhe si ato prova e ndërlidhin të pandehurin me atë veprë penale, po ashtu duhet të argumentoj arsyeshmërinë e bazës së veçantë për caktimin e masës së paraburgimit, qoftë të rrezikut të ikjes apo fshehjes, të dëmtimit të provave apo edhe të rrezikut të përsëritjes së veprës përkatësisht rrezikut të kryerjes së veprës që ka mbetur në tentative.

Masa e paraburgimit caktohet nga gjykata vetëm kur ka kërkesë me shkrim nga prokurori, dhe masën e tillë e cakton gjyqtari i procedurës paraprake që ka kompetencë për të vendosur në raport me kërkesën e prokurorit, si dhe vetëm pas mbajtjes së seancës dëgjimore, në të cilën seance gjyqtari i dëgjon pretendimet e palëve si prokurorin që e elaboron kërkesën e tillë ashtu edhe mbrojtësin e të pandehurit lidhur me kërkesën e prokurorit si dhe deklarin e të pandehurit që bëhet në raport me kërkesën e prokurorit.

Kur i pandehuri sillet para gjyqtarit të procedurës paraprake, duhet të informohet për të drejtat e tij, që janë: arsyet e arrestimit të tij që duhet të komunikohet arsyeja në gjuhën që e kupton,

mundësin e ti që të heshtë dhe të mos deklarohet fare përveç identitetit të tij, mundësin që të njoftoj ndonjë anëtarë të familjes për arrestimin e tij, se ai mund të shfrytëzoj kontroll mjekësor dhe psikiatrik nëse ka nevojë, se ka të drejtë të përkthyes të gjuhës që e flet dhe e kupton, dhe se ka të drejtë që të beje zgjedhjen e mbrojtësit vet e në rast se nuk bën zgjedhje ai vet i caktohet sipas detyrës zyrtare një mbrojtës. Duhet të kihet parasysh se të gjitha këto të drejta konstatohen në procesverbal me qëllim që ai të deklarohet se i ka kuptuar dhe po ashtu konstatohet deklarimi i të pandehurit lidhur me atë se a i ka kuptuar të drejtat. Po ashtu në procesverbal konstatohet koha e sakte se kur është sjellë në gjykatë dhe koha e sakte se kur është bërë arrestimi i të pandehurit. Kjo bëhet për të mbikëqyrur dhe vlerësuar gjykatën se a janë respektuar procedurat nga ana e prokurorit me rastin e arrestimit dhe ndalimit si dhe procedimit të kërkesës nga se të gjitha këto veprime janë të përcaktuara me afate strikte në kodin e procedurës penale. Fillimisht në seance i jepet fjala prokurorit për të dhënë arsytet për kërkesën për masën e paraburgimit, pas paraqitjes së arsyeve nga prokurori atëherë mbrojtja përgjigjet në kërkesën e prokurorit duke parashtruar argumentet e mbrojtjes ndaj kërkesës së prokurorit, e pastaj përgjigjet edhe i pandehuri lidhur me kërkesën e prokurorit në raport me argumentet e mbrojtjes që janë shtruar, këtu duhet të kihet parasysh se i pandehuri gjithnjë ka të drejtë të heshtë⁵⁵⁰.

Procesverbalet në procedurë – Në procedurën penale çdo veprim i ndërmarr nga të gjitha organet qoftë policia, prokurori apo gjykata duhet që veprimet e tilla të formalizohen dhe ato formalizohen edhe përmes mbajtjes së procesverbalit. Procesverbali është në thelb konstatimi mbi veprimin dhe mënyrën e zbatimit të veprimit procedural. Varësisht se veprimet a ndërmerren në gjykatë apo në prokurori, në procesverbal duhet të konstatohet koha e saktë e ndërmarrjes së veprimit si dhe veprimi që ndërmerret, e kur nuk është e mundur atëherë kjo bëhet menjëherë kur krijohet mundësia. Kur veprimi ndërmerret nga gjykata atëherë procesverbalin e mban zyrtari i gjykatës e kur ndërmerret nga prokurori procesverbalin e mban zyrtari i prokurorit. Procesverbalin mund ta mbaj zyrtari që e ndërmerr veprimin vetëm kur veprimi procedural bëhet jashtë organit publik përkatësisht jashtë gjykatës dhe prokurorisë. Kur bëhet marrja në pyetje atëherë personi që përgjigjet i jep personalisht në procesverbal, çka nënkupton se ato konstatohen ashtu siç i jep përgjigjet vet personi që merret në pyetje. Veprimet procedurale që zhvillohen me incizim qoftë audio apo video atëherë incizimi i tillë i bashkëngjitet procesverbalit, por kjo zbatohet me rastin e marrjes në pyetje, apo me rastin e marrjes së deklaratës apo me rastin e mundësisë hetuese të veçantë⁵⁵¹.

Çka përmban procesverbali: fillimisht në procesverbal përcaktohet emri i organit që zbaton veprimin e që është kompetent për veprim, pastaj vendin ku ushtrohet ai veprim, data dhe ora kur fillon ndërmarrja e veprimit pastaj kohen kur ka përfunduar zbatimi i veprimit të tillë procedural, po ashtu në procesverbal konstatohen emrat dhe mbiemrat që janë të pranishëm me rastin e zbatimit të veprimit procedural, si dhe cilësia e tyre që marrin pjesë në atë veprim të ndërmarr procedural, si dhe numri i lëndes për çështjen penale që ndërmerret veprimi

⁵⁵⁰ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 188, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁵⁵¹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 204, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

procedural. Për një të drejte palës që i takon me ligj atij duhet të komunikohet e drejta e tillë dhe po ashtu duhet të konstatohet komunikimi i tillë si dhe faktin se a e ka shfrytëzuar të drejtën e tillë ligjore, e nënshkrimi i procesverbalit konfirmon faktin se edhe është njoftuar por edhe nëse e ka shfrytëzuar apo nuk e ka shfrytëzuar varësisht nga konstatimi që është bërë. Duhet të kemi parasysh se në procesverbal nuk është e domosdoshme që të përshkruhet çdo çështje që nuk do të konsiderohet me rëndësi për veprimin procedural por duhet të shënohen çështjet thelbësore për zbatimin e veprimit të caktuar procedural. Kur ka sende të sekuestruara ose shkresa në procesverbal duhet saktësisht të konstatohet se janë sekuestruara dhe të përshkruhen ato shkresa, gjithashtu në procesverbal konstatohet fakti se janë ndërmarr veprimet si zbatimi i skicave apo incizimeve e tjera veprime qofshin ato por edhe me rastin e kontrollit të banesave dhe shtëpive konstatohen identiteti i sendit që behet kontrolli duke përshkruar të dhëna të mjaftueshme të identifikimit të banesës dhe po ashtu behet përshkrimi i gjurmëve dhe etiketave që janë në objekte që kontrollohen. Shkresat ose sendet me rastin e marrjes në pyetje në procesverbal duhet të cekën sipas numrit të provave, që janë evidentuar kur janë sekuestruar.

Provat nga i pandehuri në procedurë – I pandehuri konsiderohet palë e barabartë në procedurën penale, në këtë kuptim i pandehuri ka të drejtë që të propozoj prova që vlerëson se përmes atyre provave do ta rrezojnë dyshimin që rëndon ndaj tij për veprën penale. I pandehuri në fazën e hetimeve mund të propozoj prova të prokurorit, që mund të kërkojë përmes prokurorit marrjen e provës së caktuar që ai vlerëson që përmes asaj apo atyre provave do të hiqet dyshimi në raport me të në cilësinë e të dyshuarit, por i pandehuri përveç se ka të drejtë që të kërkojë të prokurorit marrjen e provës së caktuar apo marrjen e provave të caktuara ai ka të drejtë që edhe provat që i disponon të ia prezantojë prokurorit e që ka qëllimin e heqjes përkatësisht rrëzimit të dyshimit që është ngritur ndaj tij si i dyshuar.

Duhet të kemi parasysh se detyrimi i prokurorit është që të mbledh edhe provat shfajësuese ndaj të pandehurit, andaj për këtë arsye meqë dispozitat ligjore ia atribuojnë si detyrim prokurorit mbledhjen edhe të provave shfajësuese, kodi përcakton specifikisht se kur prokurori duhet të marr provën që i pandehuri e ka propozuar marrjen e provës së tillë. Prokurori duhet ta marr provën e tillë kur: a). rrezikohet humbja e provës apo dëshmisë ose kur ka gjasa që të mos jetë e mundshme marrja e provës së tillë për shqyrtim gjyqësor; b). prova e tillë arsyeton lirimin e të pandehurit nga paraburgimi; c). ka gjasa të arsyeshme që prova apo dëshmia që kërkohet të merret të jetë shfajësuese; ose ç). ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për marrjen e provës apo dëshmisë së tillë. Në të gjitha këto situata kur cilado nga këto shkaqe prokurori duhet të marr provën e propozuar nga i pandehuri, e në raste se prokurori konsideron se prova e tillë nuk hynë në kategorinë e rrethanave të tilla atëherë duhet që të lëshoj aktvendim të arsyetuar me shkrim me të cilin aktvendim refuzon propozimin e të pandehurit për marrjen e provës së tillë. Aktvendimi me të cilin refuzohet propozimi i të pandehurit për marrjen e provës mund të ankimohet para gjyqtarit të procedurës paraprake. Gjyqtari i procedurës paraprake poqë se e vlerëson të bazuar ankesën nxjerr aktvendim me të cilin obligon marrjen e provës së tillë, përkundër se kodi nuk përcakton efektin e aktvendimit të gjyqtarit që parashtrahet ankesa e të pandehurit apo mbrojtësit të tij për refuzimin e marrjes së provës kjo vetvetiu rrjedhë nga dispozita ligjore që gjyqtari i procedurës

paraprake mund te urdhëroj marrjen e provës se propozuar në të kundërtën ankimimi i të pandehurit do të ishte pa efekt për qëllimin legjitim te ankimimit⁵⁵².

I pandehuri gjithnjë por edhe mbrojtësi i tij mund te propozojnë para prokurorit marrjen e provave qe e zhbëjnë dyshimin qe i ngarkohet te pandehurit, edhe poqë se provat e tilla gjinden jashtë juridiksionit te vendit, ne këto raste prokurori mund te siguroj provat ne procedurën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtare me shtetin qe provat e tilla duhet te sigurohen, e qe behet përmes ministrisë se drejtësisë – departamenti për bashkëpunim juridik ndërkombëtarë. Nëse prokurori refuzon marrjen e provës se tillë ne shtetin e huaj sërish i pandehuri mund ta atakoj vendimin e prokurorit para gjyqtarit te procedurës paraprake dhe po qesë gjyqtari e vlerëson ankesën si te bazuar mund te urdhëroj marrjen e provës, me te cilin vendim e detyron prokurorin qe te ndërmarr veprimet për marrjen e provës.

Provat nga i dëmtuari në procedurë dhe deklarata e dëmit – I dëmtuari si pale në procedurën penale sipas kodit të procedurës, është karakteristikë se ka një kusht për tu konsideruara palë ne procedurën penale. Për tu konsideruara palë në procedurën penale i dëmtuari, kushti është qe ta parashtoj deklaratën mbi dëmin, ne te kundërtën nëse i dëmtuari heq dore nga deklarata e dëmit përkatësisht nëse nuk e paraqet deklaratën e tillë sipas nenit 218 paragrafi 6 i dëmtuari nuk konsiderohet pale ne procedure, (kushti i tillë ligjore qe i dëmtuari te konsiderohet pale vetëm kur parashtron deklarate te dëmit konsiderojmë se e ulë maksimalisht rolin e te dëmtuarit ne tërësinë e procedurës penale, nga se ne esencë e zhbën edhe vet satisfaksionin e të dëmtuarit ne raport me fajësinë e të pandehurit, qe përkundër se ai mund te mos ketë arsye te paraqes deklarata të dëmit mund te ketë interes për satisfaksionin e tij në fajësinë e të pandehurit).

Përkundër se dispozitat e kodit te procedurës penale e lidhin me kushtin e parashtrimit te deklaratës se dëmit për ta fituar cilësinë e palës ne procedurën penale, i dëmtuari ne parim ka te drejt që të parashtoj propozim pranë prokurorit për marrjen e provës, që i dëmtuari konsideron të rëndësishme qoftë për rrethanat faktike apo edhe për kërkesën e dëmit nëse parashtrohet kërkesë për kompensimin e dëmit përkatësisht kërkesë pasurore juridike. Prokurori i shtetit duhet qe ta marr provën e propozuar nga i dëmtuari, dhe ne këto rrethana prokurori urdhëron marrjen e provës, e rrethanat e tilla janë: a). ekziston rrezik për humbjen e provës apo dëshmisë ose kur ka gjasa që të mos jetë e mundshme marrja e provës se tillë për shqyrtim gjyqësor; b). prova e tillë mund të jetë me efekt për t’u marrë së bashku me prova tjera nga prokurori i shtetit – kjo nënkupton kur ka rëndësi prova e tillë në lidhshmëri me provat tjera që prokurori i siguron; c). Kur prova e propozuar është drejtpërdrejt e rëndësishme për kërkesën e paraqitur nga i dëmtuari në procedurë penale – kjo përfshinë si provën ne raport me rrethanat e fakteve por edhe provat që mund të ndikojnë në kërkesën pasurore juridike qoftë për bazën apo për lartësinë e kërkesës por edhe prova te tjera qe mund te ketë i dëmtuari një kërkesë specifike që ndërlidhet me procedurën penale që zhvillohet. I dëmtuari po ashtu mund te propozoj para prokurorit marrjen e provës ne juridiksionin e vendit te huaj, dhe prokurori

⁵⁵² Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 216, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

mund të marr provën e tillë kur vlerëson se ka rëndësi për procedurën penale si tersi apo me kërkesat specifike të të dëmtuarit ne procedure që mund të parashtrihen, dhe prokurori ne këtë raste mund ta siguroj provën e tillë ne bashkëpunim juridik ndërkombëtare përmes Ministrisë se Drejtësisë. Kur prokurori refuzon marrjen e provës qe e ka propozuar i dëmtuari atëherë prokurori refuzimin e tillë duhet ta beje me aktvendim i cili aktvendim duhet te këtë arsyetim për shkaqet e refuzimit të tillë të parashtruara nga i dëmtuari. Kundër aktvendimit që lëshon prokurori me të cilin ka refuzuar propozimin e të dëmtuarit, i dëmtuari mund të parashtrij ankesë para gjyqtarit të procedurës paraprake, dhe kur gjyqtari i procedurës paraprake vlerëson se ankesa është e bazuar, atëherë gjyqtari mund të urdhëroj marrjen e provës qe e ka propozuar i dëmtuari. Karakteristike është se nuk përcaktohet afati i ankimimit, mirëpo meqenëse nuk ka një afat specifik atëherë duhet zbatuar afati i përgjithshëm kundër aktvendimit qe është afati tre ditor për parashtrimin e ankesës e qe fillon te rrjedh nga momenti kur i dëmtuari e pranon aktvendimin e prokurorit me te cilin i është refuzuar propozimi për marrjen e provës⁵⁵³.

Deklarata e dëmit – është ne esence vet kërkesa për kompensimin e dëmit qe është shkaktuar ndaj te dëmtuarit nga vepra penale⁵⁵⁴. Kjo deklarate mund ete parashtrihet gjate fazës se hetimit apo ne afat prej 60 ditëve nga ngritja e aktakuzës. Deklarata mund te paraqitet qoftë nga i dëmtuari apo përfaqësuesi i tij apo nga mbrojtësi i viktimave. Deklarimi i dëmit sipas dispozitave te kodit te procedurës penale është karakteristikë që mund të paraqitet në mënyrë anonime, nen dy kushte, qoftë kur gjykata lejon parashtrimin e deklaratës se dëmit dhe kur gjykata është ne dijeni te parashtruesit. Kjo nënkupton faktin se deklarata e dëmit nuk është e njohur se nga kush parashtrihet për palët tjera dhe publikun e gjere por vetëm për gjykatën. Kjo konsiderojmë se përkundër qe është lejuar sipas kodit te procedurës penale, do te kishte probleme me rastin e ekzekutimit te përmbushjes se dëmit kur deklarata është anonime.

Deklarata e dëmit përmban te dhënat e personit qe ka shkaktuar dëmin, Emrin, mbiemrin, te dhënat se si ka ardhur deri te shkaktimi i dëmit, si ka rezultuar shkaktimi i dëmit nga vepra penale, a ka pasur shpenzime dhe cilat shpenzimesh janë krijuar pas kryerjes se veprës penale për te sanuar dëmin e shkaktuar me vepër penale, cilat kanë qenë humbjet qe janë shkaktuar si pasoj e dëmit.

Ne rast se kërkesa e dëmit nuk parashtrihet saktësisht dhe ne mënyrë te qarte gjykata mund te mos urdhëroj kompensimin e dëmit. Kjo është plotësisht e arsyeshme sepse gjykata kërkesat qe nuk përcaktojnë bazën e kompensimit dhe nuk mbështesin lartësinë e dëmit për kompensim nuk mund ti urdhëroj kompensimin e dëmit, nga se kërkesa do te mbetej e papranuar ne gjykatë, në mungesë të saktësisë së kërkesës.

⁵⁵³ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 217, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁵⁵⁴ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 218, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

NËNKAPITULLI III

AKTAKUZA DHE DELARIMI

AKTAKUZA

është akti formal me të cilin prokurori i shtetit pas zhvillimit të hetimit apo për veprat penale për të cilat lejohet ngritja e aktakuzës pa zhvillim të hetimit, vjen në konkluzionin se provat e ligjshme që ka siguruar krijojnë dyshimin e bazuar në të mirë se vepra penale është kryer dhe kryerësi i asaj veprë penale është vetëm i pandehuri. Aktakuza ka cilësinë objektive dhe cilësinë subjektive – në kuptim të cilësisë objektive aktakuza nënkupton veprën penale pra rrethanat faktike që pretendohet se kanë ngjarë e cila ngjarje i nënshtrohet normës ligjore e që është cilësimi juridik, ndërsa në kuptim të cilësisë subjektive nënkupton se vepra penale e kryer ka të bëjë vetëm me të pandehurin konkret dhe se të gjitha provat e ligjshme që janë mbledhur krijojnë vetëm një konkluzion se ndaj të pandehurit rëndon dyshimi për veprën penale dhe jo ndaj asnjë personi tjetër. Përmes aktakuzës prokurori i kërkon gjykatës caktimin e shqyrtimit gjyqësor dhe shqyrtimin e aktakuzës për të konstatuar fajësinë për veprën penale të kryer.

Çfarë përmban aktakuza: Aktakuza përmban pjesën hyrëse, në të cilën përshkruhet prokuroria që ka ngritur dhe departamentin e asaj prokuroritë, pastaj përmban gjykatën që i drejtohet dhe departamentin që i drejtohet aktakuza e tillë. Në aktakuzë përshkruhen të dhënat gjenerale të të akuzuarit, me saktësi duhet të përshkruhen: Emri, emri i prindit, mbiemri, datëlindja dhe vendlindja, vendbanimi me adresën e sakte të të akuzuarit, të dhënat tjera që përfshijnë, Shkollimin e të akuzuarit, punësimin e të akuzuarit, realizimin e të ardhurave dhe lartësinë e tyre nga i akuzuari, gjendjen pasurore që e gëzon i akuzuari. Po ashtu aktakuza përmban të dhënat shtesë nëse, është mbajtur nën masën e paraburgimit i akuzuari duhet të përcaktohet koha kur është caktuar dhe kur ka mbaruara masa e paraburgimit apo fakti se i njëjti ende gjendet nën masën e paraburgimit, të dhënat e tilla shënohen në aktakuzë edhe kur është fjala për ndonjë masë tjetër për sigurimin e të pandehurit në procedurë.

Po ashtu në aktakuzë përshkruhen të dhënat lidhur me veprën penale: a). kohën e kryerjes së veprës penale, b). Objektin në të cilën është kryer vepra penale, c). Mjetin me të cilin është kryer vepra penale, d). si dhe rrethanat tjera me rëndësi për të përcaktuar me saktësi veprën penale. Problematika nga praktika është se aktakuza normalizohet deri në masën që shkakton shpesh here pamundësi për të u provuar çdo detaj i tillë në procedurën gjyqësore, andaj jo rralla edhe dështojnë çështjet penale për të u provuar, kryesisht problematika e tillë ndërlikohet me kushtin e tillë, “ rrethanat tjera me rëndësi për të përcaktuar me saktësi veprën penale” e që praktika këtu e ka konsideruar të nevojshme çdo detaj që të përshkruhet në aktakuzë. Konsiderojmë se rrethanat tjera që janë të nevojshme për të u përcaktuar me saktësi kryerjen e veprës penale duhet të shikohen ato rrethana që janë si fakte relevante në raport me elementet e veprës penale për të cilën konsiderohet se është kryer, kjo do ta thjeshtëzonte procedurën e provueshmërisë por pa e cenuar përmbajtjen thelbësore, nga se në procedurën penale ka rëndësi që aktakuza ta ketë të përshkruara faktin që është relevant e që ndërlikohet me elementin e veprës

penale, por po ashtu fakti relevant jo gjithnjë është i drejte për drejtë por mund të jete edhe fakte rrethanor që mund të ndërlidhet me elementin e veprës penale.

Ne aktakuze përshkruhet emërtimi ligjor i veprës penale duke iu referuara dispozitave te kodit penal. Me emërtimin ligjore duhet te kuptojmë qe ajo gjendje faktike duhet ti nënshtrohet asaj norme juridike, këtu duhet te kemi parasysh se mund te kemi cilësime te nënkategorive ligjore, që ndërlidhet me paragrafët ligjore dhe nen paragrafët deri tek një pike ligjore, ne këtë kuptim duhet të kemi parasysh se mund të kemi kryerjen bazë të asaj vepre penale që nënkupton se nuk është forme e kualifikuar, që zakonisht elementet e veçanta te figurës se veprës penale e përbejnë kualifikimin specifik, por mund te kemi edhe forma te privileguara te veprës, andaj varësisht nga gjendja faktike ajo gjendje duhet ti nënshtrohet normës konkrete juridike te veprës penale qe e përben figurën e asaj vepre penale e qe konsiderohet cilësimi juridik i veprës penale.

Rekomandimin për provat qe duhet te administruara ne shqyrtimin gjyqësor – kjo pjese e aktakuzës është pjesa ku prokurori i bene me dije gjykatës se mbi cilat prova pretendon qe te vërtetoj fajësinë e te akuzuarit ne procedurën e shqyrtimit gjyqësor. Rrjedhimisht kjo pjese përfshinë te dhënat për dëshmitaret qe duhet te ftohen ne shqyrtimin gjyqësor, ekspertet qe duhet te ftohen ne shqyrtimin gjyqësor, po ashtu provat materiale qe duhet lexuar si prova si dhe sendet e tjera apo dëshmitë qe duhet marre si prove ne shqyrtimin gjyqësor.

Shpjegimin e arsyeve qe kanë qar ne ngritjen e aktakuzës dhe po ashtu provat qe konsiderohet se vërtetojnë faktet kryesore. Shpjegimi i arsyeve nënkupton arsyetimin e rrjedhës se veprimeve qe janë zhvilluar hetimet dhe provat qe janë ndërmarr si dhe faktet që kanë rezultuara se janë zbuluar gjate fazës se hetimeve e po ashtu ato prova qe pretendohet se do te vërtetojnë ato fakte kryesore, ne këtë kuptim arsyet e aktakuzës se ngritur e bëjnë të qëndrueshme shkakun e ngritjes se aktakuzës ne te kundërtën aktakuza do te konsiderohej si e mangët pa arsyet qe kanë dërguar deri ne ngritjen e saj.

Ne raste se është zbatuar mundësia hetuese e veçantë në aktakuze duhet te konstatohen edhe emrat e gjyqtareve qe kane përberë kolegjin e mundësisë hetuese te veçantë, kjo është e arsyeshme ne kuptimin se dispozitat ligjore kërkojnë qe me rastin e mundësisë hetuese te veçantë njeri nga anëtarët e kolegjit duhet te jete pjese e trupit gjykues kur ngritet aktakuza, andaj edhe konstatimi i tillë ne aktakuze është për te mos lejuar lëshimet eventuale te rrjedhës se gjykimit ne përbërje jo te ligjshme te trupit gjykues kur shqyrtohet në shqyrtimin gjyqësor aktakuza.

Aktakuza po ashtu përmban saktësisht pasurin qe propozohet nga gjykata qe te konfiskohet. Në këtë kuptim dispozitat ligjore kërkojnë qe përveç saktësimi të pasurisë qe kërkohet për konfiskim njëkohësisht duhet qe te argumentohet se mbi bazën e cilave prova mbështetë baza e konfiskimit, sepse kur kemi parasysh qe pasuria mund te konfiskohet për tri baza kryesore ligjore, e që janë: a) pasuria apo sendi ka shërbyer ne kryerjen e veprës penale, b) pasuria apo sendi është produkt i veprës penale, c) pasuria apo sendi është përfitim nga vepra penale e kryer, kjo padyshim që determinon edhe provat që mund të jene te ndryshme qe mbështetin

njërën nga këto baza të konfiskimit andaj edhe është e nevojshme që të arsyetohet me prova mbështetja e bazës ligjore për konfiskimin e pasurisë së propozuar në aktakuze. Praktika e deritashme ka treguar që ka shumë të meta të arsyesh mërisë së konfiskimit të pasurisë apo të sendit, madje nga praktika nuk specifikohet as propozimi se mbi cilën bazë pretendohet konfiskimi i pasurisë apo sendit por vetëm theksohen në aktakuze propozimi që sendi të konfiskohet, andaj kjo praktike duhet të ndryshoj në mënyrë që aktakuza të jete me përmbajtje të plote ligjore e që do të jepte edhe për palën e kundërt por edhe për gjykatën një bazë me të qëndrueshme të shqyrtimit të pasurisë për konfiskimin në procedurën gjyqësore kur shqyrtohet aktakuza e rrjedhimisht edhe pasuria që është propozuar në aktakuze.

Aktakuza përveç të dhënave të theksuara me lartë po ashtu mund të përmbaj propozimin e prokurorit për dhënien e urdhrin për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të akuzuarit kur ai gjendet në liri apo edhe lirimin nga paraburgimi kur i akuzuari gjendet në paraburgim. Përkundër se një propozim i tillë⁵⁵⁵.

Procedura e ngritjes së aktakuzës – Aktakuza sipas dispozitave ligjore duhet të dërgohet, gjykatës e cila është kompetente për gjykimin e çështjes penale. Kjo nënkupton se në aktakuze duhet të përshkruhet saktësisht se cila gjykatë në cilin departament drejtohet aktakuza, nga se duke përcaktuar në aktakuze si e tillë ajo regjistrohet në referatin konkret të gjykatës dhe hynë në radhën e procedimit të gjyqtari. Po ashtu aktakuza dërgohet në kopje të mjaftueshme aq sa janë të pandehuri që përfshihen në aktakuze, por edhe aq kopje sa janë mbrojtësit e të pandehurit çka do të thotë se prokuroria ka detyrim që të dërgoj në gjykatë gjithnjë kopje edhe për të pandehurit por edhe për mbrojtësit e tyre, ndërsa gjykatës gjithsesi përveç aktakuzën është e obliguar që të ia dërgoj edhe të gjithë materialin e çështjes penale, që nënkupton se duhet dërguar shkresat e lëndës së procedurës hetimore të asaj çështjes penale për të cilën ka rezultuar me ngritjen e aktakuzës.

Si veprohet tutje me aktakuzën: Tutje për tu procedura aktakuza, sipas dispozitave ligjore përcaktohet se gjykata cakton gjyqtarin e vetëm gjykues apo trupin gjykues me kryetarin e tij, dhe kjo duhet të bëhet nëpërmjet një procesi transparent për caktimin e çështjeve. Lidhur me këtë duhet të kemi parasysh dy situata: a) fillimisht se trupat gjykues caktohen nga kryetari i gjykatës, (kjo bëhet për shkak të termit të përdorur "gjykata" e që në interpretim konsiston me kryetarin e gjykatës, dhe b) lëndet ndahen sipas shortit që tërhiqen nga secili gjyqtar që rregullohet me rregulloren e punës së gjykatave, tanimë ka filluar edhe sistemi i SMIL për ndarjen e lendeve. Duhet që të kemi parasysh dy fakte me rastin e përbërjes së trupave gjykuese kur ka pasur mundësi hetuese të veçantë, e që janë: a) kur çështja penale gjykohet nga trupi gjykues gjithsesi në trupin gjykues duhet të caktohet njeri nga gjyqtaret e kolegjit që ka marrë pjesë në mundësin hetuese të veçantë, e nëse aktakuzën do ta trajtoj gjyqtari i vetëm gjykues sipas kompetencës atëherë gjyqtari i vetëm gjykues për shqyrtimin e aktakuzës, duhet të jete njeri nga gjyqtaret që ka marrë pjesë në kolegjin shqyrtues.

⁵⁵⁵ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 241, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

Veprimi në raport me aktakuzën: Gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues është i obliguar që ta shqyrtoj kompetencën me rastin e pranimit të aktakuzës. Dispozita ligjore detyron gjyqtarin apo kryetarin që ta shqyrtoj kompetencën e që, këtu duhet të kemi parasysh që kryesisht shqyrtohet kompetenca lëndore dhe funksionale, por edhe për kompetencën territoriale nga se kompetenca territoriale duhet që të shqyrtohet deri kur aktakuza të marr formën e prerë dhe konsiderohet se aktakuza ka marr formën e prerë kur çështja mund të kalojë në shqyrtimin gjyqësor pra që aktakuza kalon fazën e kontrollit lidhur me ligjshmërinë e ngritjes, përmbajtjen sipas dispozitave, bazueshmerin e dyshimit dhe ligjshmërinë e provave.

Cilat janë afatet për veprim procedural: Dispozitat ligjore përcaktojnë se gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues pas shqyrtimit të kompetencës, duhet që në afat prej 30 ditësh të caktojë shqyrtimin fillestar. Ndërsa kur i akuzuari gjendet nën masën e paraburgimit atëherë caktimi i shqyrtimit fillestar duhet të bëhet në afat prej 15 ditësh. Shqyrtimi fillestar caktohet dhe njoftohen për seance, Prokurori, i pandehuri apo të pandehurit dhe mbrojtësi apo mbrojtësit e të pandehurit.

Për sa i përket faktit se a duhet njoftuar i dëmtuari në shqyrtimin fillestar, nga praktika është trajtuar se përderisa është pale në procedurën gjyqësore, andaj ka mendime se edhe i dëmtuari duhet të ftohet. Duke pas për bazë se për çfarë arsye thelbësore mbahet seanca e shqyrtimit fillestar e që ka të bëjë me deklarin e të pandehurit lidhur me fajësinë, dhe faktin se çfarë roli të zvogëluar ka i dëmtuari në procedurën penale pasi që kryesisht rolin aktiv e ka prokurori dhe i pandehuri si pale në procedure, e duke qenë se deklarata e dëmit për realizimin e kërkesës pasurore juridike mund të bëhet që në fazën e hetimit, konsiderojmë se përveç se dispozitat ligjore nuk kërkojnë që i dëmtuari të ftohet në shqyrtimin fillestar, njëkohësisht fakti se paraqitet deklarata e dëmit dhe fakti se kur pranohet fajësia në shqyrtimin fillestar mund të gjykohej edhe dëmi, atëherë konsiderojmë se nuk cenohet ndonjë e drejtë e të dëmtuarit⁵⁵⁶.

Materiali që i dorëzohet të pandehurit – Për tu arritur barazia e palëve dhe për të mundësuar një mbrojtje efektive në raport me dyshimin e bazuar të mirë kur ngritet aktakuza, prokurori ka detyrim që me rastin e ngritjes së aktakuzës të i dorëzojë mbrojtësit të të pandehurit apo vet të pandehurit shkresat e hetimit që janë në kontroll apo posedim të prokurorit.

Cilat janë materialet që detyrimisht i dorëzohen mbrojtjes: dispozitat ligjore, konkretisht detyron që të pandehurit apo mbrojtësit të dorëzohen: a). procesverbalet mbi deklarin e ose pohimet, të nënshkruara apo të panënshkruara nga i pandehuri; b). emrat e dëshmitarëve të cilët prokurori i shtetit ka ndërmend t'i thërret për dëshim dhe çdo deklarin të mëhershëm të dhënë nga dëshmitarët e tillë; c). të dhënat mbi identifikimin e personave për të cilët prokurori i shtetit e di se posedojnë prova të pranueshme dhe shfajësuese ose informata lidhur me çështjen dhe çdo procesverbal të deklarinëve, të nënshkruar apo të panënshkruar nga personat e tillë për këtë çështje; ç). rezultatet e ekzaminimit fizik dhe mendorë, testet shkencore ose eksperimentet

⁵⁵⁶ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 241, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

e bëra lidhur me çështjen; d). kallëzimet penale dhe raportet e policisë; dhe dh). përmbledhjet ose referencat për provat materiale të mbledhura gjatë hetimit⁵⁵⁷.

Cilat janë kushtet e dorëzimit të këtyre materialeve: Deklarata e dëshmitareve të pandehurit i jepen në gjuhën që ai e kupton. Megjithatë edhe pas dorëzimit të këtyre materialeve pas ngritjes së aktakuzës, prokurori ka obligim që mbrojtjes të dorëzojë çfarëdo material të ri që ndërlidhet me materialet si me lartë që është i obliguar për t'ia dorëzuar mbrojtjes. Materialet e dorëzuar mbrojtjes, janë të mbrojtura në raport me kufizimet ligjore për mbrojtjen e të dëmtuarve dhe dëshmitareve por edhe në detyrimet konfidenciale që materialet mund të kenë, kjo nënkupton se mbrojtja edhe kur i pranon materialet e tilla mund të dorëzohen me kufizimet e tilla për konfidencialitet dhe me kufizimet për mbrojtjen e dëshmitareve dhe të dëmtuarve.

SHQYRTIMI FILLESTAR

Si rregull, procedura para gjykatës mund të zbatohet vetëm në bazë të aktakuzës së ngritur nga prokurori i shtetit. Në momentin e ngritjes së aktakuzës, prokuroria obligohet që aktakuzën ta dorëzojë me shkrim në gjykatën kompetente në pikëpamje lëndore dhe territoriale. Aktakuza i paraqitet gjykatës në kopje të mjaftueshme për palët, të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre si dhe një kopje shtesë për gjykatën. Përveç aktakuzës, dërgohet edhe komplet lënda e hetimit që është zhvilluara nga prokurori i shtetit.

- **Caktimi i gjyqtarit të çështjes**

Pas pranimi të aktakuzës në gjykatë, lënda i ndahet në punë gjyqtarit -kryetarit të trupit gjykues apo gjyqtarit të vetëm gjykues, varësisht prej kompetencës lëndore që lidhet me objektin i aktakuzës. Caktimi dhe shpërndarje e lëndëve të gjyqtarët, si rregull, bëhet përmes Sistemit elektronik për menaxhimin të lëndëve (SMIL) në mënyrë rastësore, sipas radhës dhe ngarkesës me lëndë.

- **Kontrolli i aktakuzës**

Kryetari i trupit gjykues apo gjyqtarit të vetëm gjykues, pas pranimi të lëndës (aktakuzës) ushtron një kontroll paraprak lidhur me aktakuzën e ngritur, *për të vërtetuar, nëse:*

- Ka kompetencë lëndore dhe territoriale në raport me çështjen e ngritur me aktakuzë
- Aktakuza është ngritur sipas ligjit, përkatësisht, nenit 241 të KPP-ës
- Aktakuza përmban të gjitha elementet e nevojshme për të vepruar sipas saj.
- Ka propozim për caktimin, vazhdimin apo ndërprerjen ndonjë nga masat për sigurinë e të pandehurit në procedurën penale.

Nëse, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, konstaton se i mungon kompetenca lëndore apo territoriale, atëherë ai nxjerr aktvendim me të cilin shpallet jo kompetent për atë

⁵⁵⁷ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 244, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

lëndë dhe sapo aktvendimi ta marr formën e prerë lënda i dorëzohet gjykatës kompetente për trajtim të mëtejme. Në rastin tjetër, kur akuza nuk përmban atë që është e nevojshme që të mund të veprohet në bazë të saj, që ta korrigjojë apo ta plotësojë aktakuzën, e nëse ai nuk e bën këtë brenda afatit të caktuar, gjyqtari i vetëm gjykues ose nga kryetari i trupit gjykues e hedh poshtë aktakuzën. Në thirrjen për korrigjimin apo plotësimin e aktakuzës, prokurorit të shtetit i tërhiqet vërejtja për pasojat e mosveprimit.

- Caktimi dhe mbajta e shqyrtimit fillestar

Pas kontrollit të parë të aktakuzës, dhe pasi që konstatohet se aktakuza është ngritur sipas ligjit, se përmban të gjitha elemente e mjaftueshme për të vepruar sipas saj, dhe gjykata ka kompetencë për të vepruar, atëherë kryetari i trupit gjykues obligohet që brenda afateve kohore të përcaktuara sipas Kodit të procedurës penale të caktoj shqyrtimin fillestar. Koha për caktimin e shqyrtimit fillestar varet prej rrethanave nëse i pandehuri gjendet në paraburgim apo jo. Nëse i pandehuri gjendet në paraburgim, shqyrtimi fillestar duhet të mbahet jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë, pas ngritjes së aktakuzës.⁵⁵⁸ Nëse i pandehuri nuk është në paraburgim, atëherë shqyrtimi fillestar duhet të mbahet brenda tridhjetë ditëve pas ngritjes së aktakuzës.⁵⁵⁹

- Personat që ftohen në shqyrtimin fillestar

Në shqyrtimin fillestar duhet të ftohet prokurori i shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Prokurorit të shtetit ftesa i dërgohet përmes zyrës së prokurorisë. Ndërsa, të pandehurit ftesa për shqyrtim fillestar i dërgohet së paku (8) ditë para mbajtjes së shqyrtimit fillestar. Së bashku me ftesën për shqyrtimin fillestar të pandehuri i dërgohet edhe kopja e aktakuzë që është ngritur kundër tij. Ftesa për të pandehurin duhet të përmbajë së paku këto të dhëna; emrin dhe mbiemrin e tij, adresën ku jeton, datën, vendin dhe orën e mbajtjes së shqyrtimit fillestar, veprën penale për të cilën akuzohet. Në ftesë ai, paralajmërohet për pasojat e mungesës pa arsye në shqyrtim fillestar, njoftohet me të drejtën për angazhimin e mbrojtësit në rast se nuk ka angazhuar mbrojtës deri në atë kohë.

Në rast se i pandehuri nuk e ka pranuar kopjen e aktakuzës, kryetari i trupit gjykues apo gjyqtari i vetëm gjykues, gjatë seancës fillestar i jep të pandehurit një kopje të aktakuzës.

- Mbajtja e shqyrtimit fillestar

Shqyrtimi fillestar mbahet në prezencën e prokurorit të shtetit të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.

Në shqyrtimin fillestar nuk administrohen provat, nuk dëgjohen dëshmitarët, ekspertet siç nuk shqyrtohen provat materiale. Në shqyrtimin fillestar për çështjet që nuk janë të rregulluara me këtë Kod, aplikohen rregullat që kanë të bëjnë me shqyrtimin gjyqësor. Gjatë shqyrtimit fillestar i pandehuri pajiset me aktakuzën dhe të gjitha provat që përmban lënda penale. Provat dhe gjitha shkesat e lëndës i jepen të pandehurit nga prokurori i shtetit pas përfundimit të

⁵⁵⁸ Neni 242 paragrafi 5 i KPP

⁵⁵⁹ Neni 242 paragrafi 4 i KPP

hetimeve dhe jo me larg se nga ngritja e aktakuzës. Pastaj, i pandehuri njoftohet dhe udhëzohet për këto të drejta: drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaron për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë; të drejtën të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij; të drejtën që ta kundërshtojë aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë

- Leximi i aktakuzës nga prokurori i shtetit

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar në secilin rast obligohet ta lexoj aktakuzë. Aktakuza nuk mund të konsiderohet e lexuar, pasi që kemi të bëjmë me seancën fillestar dhe i pandehuri përherë të parë njoftohet drejtpërdrejtë me aktakuzën e ngritur kundër tij. Andaj në çdo rast aktakuza duhet lexuar nga prokurori në prezencën e gjitha palëve. Pasi që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues bindet se pandehuri e kupton aktakuzën, të pandehurit i ofron mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm. Nëse i pandehuri nuk e ka kuptuar aktakuzën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues thërret prokurorin e shtetit që t'ia shpjegojë aktakuzën të pandehurit në mënyrë që ai ta kuptojë pa vështirësi. Nëse i pandehuri nuk dëshiron të bëjë ndonjë deklaram lidhur me fajësinë e tij, konsiderohet se ai nuk e pranon fajësinë.

- Pranimi i fajësisë nga i pandehuri

Kur i pandehuri e pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, gjykata e fton mbrojtësin e të pandehurit dhe prokurorin e shtetit që të deklarohen lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri. Të cilët mund t'i propozojnë gjykatës ta pranoj apo refuzoj pranimin e fajësisë. Gjykata në shqyrtimin fillestar e shqyrton pranimin e fajësisë nga i pandehuri si dhe vlerëson propozimet e paraqitur nga prokurori i shtetit dhe mbrojtësi i të pandehurit. Në këtë drejtim gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, para se të marr vendimin për pranimin apo refuzimin e pranimin të fajësisë, përcakton nëse:

- I pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit;
- Pranimi bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin, nëse i pandehuri ka mbrojtës;
- Pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza
- Aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues bindet se janë vërtetuar faktet nga paragrafi 1 i nenit 248 , ai merr aktvendim me të cilin pranon pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe vazhdon me shqyrtimin e dënimit, caktimin e seancës për vërtetimin e ndonjë fakti relevant për dënimin ose pezullon dënimin deri në përfundimin e bashkëpunimit të të pandehurit me prokurorin e shtetit.⁵⁶⁰

⁵⁶⁰ Neni 248 paragrafi 4 i KPP

Ku aprovet pranimi i fajësisë, gjykata vazhdon me shqiptimin e dënimit për të pandehurin. Nëse vlerësohet e nevojshme mund të caktohet një seancë për shqyrtimin rrethanave për matjen e dënimit ku palët mund të paraqesin të dhëna dhe dëshmi vetëm për këtë rrethanë. Pastaj gjykata e shpall vendimin dhe me aktgjykim e përfundon çështjen penale në tërësi.

Kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nuk bindet se janë vërtetuar faktet nga paragrafi 1 i nenit 248, ai merr aktvendim me të cilin refuzon pranimin e fajësisë dhe procedon shqyrtimin fillestar sikur pranimi i fajësisë të mos ishte bërë.⁵⁶¹

Shembull i praktikës gjyqësore të procesverbalit të shqyrtimit fillestar me pranim të fajësisë:

P.nr.//////

PROCESVERBAL I SHQYRTIMIT FILLESTAR

Mbajtur më dt.//////, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Krimeve të Rënda, (në Objektivin e Gjykatës Mitrovicë-Veri), Kryetari i trupit gjykues A.M, procesmbajtësja E.K, në çështjen penale kundër të pandehurit: E.M, për shkak të veprave penale: Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga nenin 366 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës II. Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.I.nr.////// dt.//////.

P r e z e n t

Prokurori i Shtetit në PTH-Mitrovicë: F.B.

I pandehuri: E.M

Seanca e shqyrtimit fillestar u hap në ora 00:00.

Kryetari i trupit gjykues e hap seancën fillestare dhe konstaton se prezentë janë: Prokurori i Shtetit në PTH në Mitrovicë F.B dhe i pandehuri E.M.

Gjykata konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

Nga këto arsye gjykata nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

⁵⁶¹ Neni 248 paragrafi 3 i KPP

MBAHET seanca e shqyrtimit fillestar në çështjen penale ndaj të pandehurit E.M, për shkak të veprave penale: Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga nenin 366 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës II. Përdorimi ia armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.I.nr./////// dt.///////.

Çështja penale ndaj të pandehurve si më lart, do te udhëhiqet nga Kryetari i trupit gjykues A.M, me procesmbajtësen E.K, Prokurori që e përfaqëson akuzën F.B.

Pyeten palët se a kanë vërejtje në drejtim të gjyqtarit apo procesmbajtëses.

Palët pa vërejtje.

Paraprakisht, gjykata konstaton dhe i njofton palët se rrjedha e seancës se shqyrtimit fillestar do te regjistrohet ne procesverbal me shkrim, seanca nuk regjistrohet me audio apo video-incizim, pasi qe nuk ekzistojnë kushtet teknike për një lloj te incizimi të tillë.

Seanca e shqyrtimit fillestar mbahet në gjuhën shqipe.

Seanca e shqyrtimit gjyqësor është e mbyllur për publikun, sipas vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik të palëve dhe publikut në përgjithësi, dhe mbrojtjes nga pandemia Covid 19, në përjashtim të mediave të cilat janë prezent.

Gjykata konstaton edhe një herë të dhënat për të pandehurin:

E.M, të dhënat personale janë identike me të dhënat siç janë cekur në aktakuzë.

Gjykata e njofton te pandehurin për të drejtat e tyre në këtë fazë të procedurës penale në procedure dhe atë:

I pandehur në këtë cilësi njoftoheni: se keni të drejte që të mos deklaroheni lidhur me çështjen dhe të mos përgjigjeni në asnjë pyetje, dhe nëse deklaroheni për çështjen, atëherë nuk jeni të detyruar që ta inkriminoni vetën apo të afërmit tuaj, e as ta pranoni fajësinë, se keni te drejtë te mbroheni vet, ose nëpërmjet ndihmës –avokatit.

I pandehuri, deklaron se i ka kuptuar të drejtat që i janë komunikuar nga gjykata. I pandehuri deklaron se dëshironë të deklarohen kur të u ipet mundësia nga ana e gjykatës, ndërsa për mbrojtës nuk ka angazhuar askënd, mbrojtjen do ta paraqes vet.

Gjykata fton Prokurorin e Shtetit në PTH Mitrovicë F.B që të deklarohet lidhur me detyrimin e tij për zbulimin e provave nga neni 244 të KPP-së.

Ftohet Prokurori i Shtetit në PTH në Mitrovicë F.B, që ta lexoj aktakuzën PP.I.nr.//////// dt.////////.

Lexohet aktakuza.

Ftohen i pandehuri E.M që të deklarohet se a e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale që i vihet në barrë.

I pandehuri deklaron se e ka kuptuar Aktakuzën.

Gjykata fillimisht i njoftoj te pandehurit për favoret dhe pasojat e pranimit te fajësisë. Duke i njoftuar te pandehurit se nëse e pranon fajësinë kjo gjykate nuk shqyrton prova ne këtë çështje penale, se nëse e pranoni fajësinë nuk keni te drejte te ushtroni ankese ne shkalle të dyte për shkak te konstatimit te gabuar te gjendjes faktike, por ankesë mund te ushtroni vetëm nëse nuk pajtoheni me llojin dhe lartësinë e dënimit se për veprat penale për të cilat akuzoheni është paraparë dënim me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri ne 5 vite ndërsa për pikën II. dënim me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vite. Se pranimi i fajësisë është rrethanë lehtësuese sipas Kodit Penal te Kosovës që gjykata me rastin e matjes se dënimit mund te vendosë deri në minimum të dënimit që ka paraparë ligji.

Ftohet i pandehuri **E.M**, që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë e tij.

I pandehuri E.M në lidhje me fajësinë apo pafajësinë e tij deklaron: E pranoj fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohem.

Ftohet prokurori i shtetit në PTH në Mitrovicë F.B që të deklarohet në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit E.M

Prokurori F.B:

Gjykata në mbështetje të nenit 248 par.4 të KPP-së, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET pranimi i fajësisë i deklaruar nga i pandehuri **E.M**, për shkak të veprave penale: Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga nenin 366 par.1 të

Kodit Penal të Republikës së Kosovës II. Përdorimi ia armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.I.nr./// dt.////.

Gjykata konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore që të pranohet pranimi i fajësisë, pasi që i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë. Pranimi i fajësisë mbështetet në provat që ka kjo lëndë penale, pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, pa ndonjë premtim paraprak, dhe se akuza nuk përmban ndonjë shkelje apo gabim faktik, dhe nuk ka vend për hedhjen e akuzës.

Ftohet prokurori që të paraqes të dhënat për të kaluarën e të pandehurit.

Prokurori: Nuk posedojmë ndonjë të dhënë për të kaluarën.

Ftohet palët që të deklarohen nëse kanë diçka për të shtuar në raport me rrethanat e matjes së dënimit.

Prokurori: Nuk kemi diçka për të shtuar.

I pandehuri: Nuk kemi diçka për të shtuar.

Gjykata konstaton se me kaq përfundoj shqyrtimi fillestar dhe çështja penale në tërësi.

I njoftojmë palët se shpallja publike e aktgjykimit do të bëhet më dt.///// prej orës 00:00, në të njëjtin vend.

Palëve prezent ky njoftim ju shërben si njoftim i rregullt, nuk ftohen me ftesa tjera të veçanta.

Meqenëse palët nuk kanë propozime tjera gjykata e shpallë të përfunduare këtë seancë të shqyrtimit fillestar dhe çështjen penale në tërësi.

Përfundoj në orën //////////////

Procesverbali u lexua me zë dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ana e palëve.

PROCEVERBALIN E NËNSHKRUAJNË:

Prokurori i Shtetit në PTH në Mitrovicë:

I pandehuri:

E V Ë R T E T O J N Ë:

Kryetari i trupit gjykues:

Procesmbajtësja:

- **Caktimi i shqyrtimit të dytë nëse i pandehuri nuk e pranon fajësinë**

Nëse i pandehuri nuk e pranon fajësinë apo nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues me aktvendim e refuzon pranimin e fajësisë, atëherë gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues ka këto dy mundësi:

Që të caktojë shqyrtimin e dytë jo më herët se tridhjetë ditë pas shqyrtimit

fillestar dhe jo më vonë se dyzet ditë pas shqyrtimit fillestar ose të kërkojë vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë ditë nga shqyrtimi fillestar.

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet që ta njoftojë të pandehurin dhe mbrojtësin se para shqyrtimit të dytë, mund të paraqesin kundërshtimet e tyre:

- Lidhur me provat e cekura (propozuara) në aktakuzë;
- Të paraqesin kërkesat për hedhjen e aktakuzës nëse është e ndalur ligjërisht Dhe
- Të paraqesin kërkesat për hedhjen aktakuzës për shkak të mos përshkrimit të veprës penale sipas ligjit.

- **Paraqitja e kundërshtimeve lidhur me provat e propozuara në aktakuzë**

Nëse i pandehuri, paraqet kundërshtim ndaj provave të propozuara në aktakuzë, në këto raste prokurorit të shtetit duhet ti jepet mundësia që të përgjigjet gojarisht ose me shkrim ndaj kundërshtimit të lartcekur.⁵⁶² Prokurori i shtetit ka të drejtë që brenda afatit kohë prej 1 (një) javë të paraqes përgjigje gojarisht nëse mbahet shqyrtimi i dytë, apo përgjigje me shkrim nëse është vendosur të mos mbahet shqyrtimi i dytë por vetëm paraqitja e kundërshtimeve me shkrim.

- **Vendimet e gjykatës lidhur me kundërshtimin e provave në aktakuzë**

Pasi të pranohen kundërshtimet dhe përgjigja në kundërshtime, kryetari i trupit gjykues apo gjyqtari i vetëm gjykues vendos për pranimin apo refuzimin e kundërshtimit.

Për të gjitha provat për të cilat është paraqitur kundërshtimi, kryetari i trupit gjykues apo gjyqtari i vetëm gjykues merr aktvendim të arsyetuar për lejimin apo përjashtimin e provës.⁵⁶³ Provat e lejueshme konsiderohen të gjitha ato prova të cilat janë marr apo siguruar duke respektuar në tërësi rregullat mbi provat që parashihen me KPP. Ndërsa provat e papranueshme janë provat të cilat janë marr në kundërshtim me dispozitat e Kodit të procedurës penale. Provat që shpallen të papranueshme duhet të ndahen dhe veçohen nga shkesat e lëndës. Gjykata në asnjë rast dhe në asnjë rrethane nuk mund të mbështes vendimin e saj në provat e papranueshme.

⁵⁶² Neni 249 paragrafi 2 i KPP.

⁵⁶³ Neni 249 paragrafi 3 i KPP.

- **Paraqitja e kundërshtimit me kërkesë për hedhjen e aktakuzës**

I pandehuri mund të praqes kundërshtimin me kërkesë për hedhjen e aktakuzës. Edhe lidhur me këtë kundërshtim duhet ti jepet mundësi prokurorit të praqes përgjigjen në kundërshtim brenda afatit për një javë.

- **Vendimet e gjykatës lidhur me kundërshtimin/kërkesën për hedhjen e aktakuzës**

Kryetari i trupit gjykues në të gjitha rastet me aktvendim vendos lidhur me kundërshtimin, ku mund të refuzon kundërshtimin apo të pranoj kundërshtimin të hedh aktakuzën si dhe të pushojë procedurën penale ndaj të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e refuzon kundërshtimin/ kërkesën për hedhjen e aktakuzës, nëse çmon se nuk ka arsye ligjore për hedhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale.

Në të gjitha rastet, Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues me aktvendim e hedh aktakuzën dhe pushon procedurën penale, kur çmon se;

- Vepra për të cilën akuzohet i pandehuri nuk përbën veprë penale;
- Ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale;
- Ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra është përfshirë me amnisti apo falje, ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen ose
- Nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë.⁵⁶⁴

Shembull nga praktika gjyqesore e aktvendimit lidhur me kundërshtimet, për shpalljen e provave të papranueshme dhe hedhjen e aktakuzës.

P.nr.xx/xxxx

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Krimeve të Renda, (në objektin e gjykatës në Vushtrri), Kryetari i trupit gjykues X.X me procesmbajtësen X.X, në çështjen penale ndaj të pandehurve X.X eB.B. I akuzuari X.X me dyshimin e bazuar për pika I,II, IV, V e akuzës -për veprat penale; Marrja e ryshfetit nga neni 343 par 1 të KPK-ës, për veprën penale Dhënia e ryshfeti nga neni 344 par 1 të KPK-ës, pika III e akuzës. I akuzuari B.B, për veprën penale Marrja ryshfeti nga neni 343 par 1. të KPK-ës, sipas akuzës së Prokurorisë Komonale në Mitrovicë PP.nr.xx/xxxx e dt.xx.xx.xxxx. Duke vendosur në lidhje me kundërshtimet që kanë paraqitur av.Z, për të pandehurin B.B, dhe av.V për të pandehurin X.X, kundërshtimet e paraqitura me dt.xx.xx.xxxx, Gjykata, jashtë seancës e në mbështetje të nenit 249 par.3, 250 par 1 e par 3, 253 par 1, pika 1.3 të Kodit të Procedurës Penale, me dt.xx.xx.xxxx nxjerre këtë:

A K T V E N D I M

⁵⁶⁴ Neni 253 paragrafi 1 i KPP

- I. Aprovohen pjesërisht kundërshtimet e paraqitura me dt.xx.xx.xxxx nga mbrojtësi i te pandehurit X.X, av. V, mbi provat dhe kërkesa për hudhje të aktakuzës ashtu që:
Shpallen prova të papranueshme:
-Të gjitha transkriptet dhe CD-ja me incizim të zërit te siguruara me masa te fshehta teknike te hetimit nga përgjimi i bisedave telefonike përmes telefonit celular me nr.04X-xxx - xxx, për te pandehurin X.X, të nxjerra për periudhën kohore xx.xx.xxxx e deri me xx.xx.xxxx.
- II. HUDHET akuzat e Prokurorisë Komunale në Mitrovicë PP.nr.xx/xxxx te dt.xx.xx.xxxx dhe Pushohet procedura penale për te pandehurin X.X nga i ati R, e ëma xx, i lindur me dt. xx.xx.xxxx ne fsh.xxx, Komuna e Mitrovicës, me vendbanim ne xxxxx, ne Rrugën “xxxxxxxx”, për piken III të akuzës-për veprën penale Dhënia e ryshfetit nga neni 344 par 1 të Kodit Penal te Kosovës.
- III. Kërkesë pasurore juridike për këtë pjesë nuk pati.
- IV. Shpenzimet e procedurës penale për këto pjesë te vendimit mbulohen nga mjetet buxhetore te kësaj gjykate.
- V. Ndërsa, refuzohet si i pabazuar kundërshtimi i paraqitur nga av.V ne lidhje me:
- a) Provat tjera në akuzë
 - b) Kërkesa për hedhje të akuzës
- I. Aprovohet pjesërisht kundërshtimi mbi provat, paraqitur me dt.xx.xx.xxxx nga mbrojtësi i te pandehurit B.B, av.Z ashtu qe:
Shpallen prova të papranueshme:
-Të gjitha transkriptet dhe CD-ja me incizim të zërit te siguruara me masa te fshehta teknike te hetimit nga përgjimi i bisedave telefonike përmes telefonit celular me nr.04X-xxx-xxx, për te pandehurin B.B, të nxjerra për periudhën kohore xx.xx.xxxx.
- II. Ndërsa, refuzohet si i pabazuar kundërshtimi i paraqitur nga av.Z ne lidhje me:
- a) Provat tjera në akuzë
 - b) Kërkesa për hedhje të akuzës

A r s y e t i m

Prokuroria Komunale Themelore në Mitrovicë, ka ngritur akuzë PP.nr.xx/xxxx e dt.xx.xx.xxxx ndaj të pandehurve X.X e B.B. I pandehuri X.X me dyshimin e bazuar per piken I,II, IV, V te akuzës për veprat penale Marrja e ryshfetit nga neni 343 par 1 te KPK-ës, për veprën penale Dhënie ryshfeti nga neni 344 par 1 te KPK-ës pika III e akuzës, i pandehuri B.B, për veprën penale Marrje ryshfeti nga neni 343 par 1. te KPK-ës.

Me 11 nëntor 2016, Kryetari i trupit gjykues, pranë kësaj gjykate në këtë çështje penale ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar. Seanca, ishte mbajtur në prezencën e prokurorit të Shteti në PTH-Mitrovicë X.X, të pandehurit B.B, dhe mbrojtësit të tij av.Z te pandehurit X.X, mbrojtësi i tij av.V.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të pandehurit janë njoftuar me akuzën, gjykata ka vërtetuar se të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre, janë pajisur në mënyrë të rregullt me të gjitha provat që gjenden në shkresat e lendes e qe janë pjesë e kësaj lende penale.

Gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, te pandehurit X.X dhe B.B, janë deklaruar në lidhje me fajësinë dhe kanë mohuar në tërësi fajësinë për veprat penale për të cilat ngarkohen, sipas akuzës së prokurorisë.

Gjykata, në këtë rast nuk ka mbajtur seancën e shqyrtimit të dytë, mirëpo palëve i 'u ka japë mundësi që të parashtojnë kundërshtimet e tyre, brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga dita kur është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar.

Mbrojtësi i te pandehurit B.B, av.Z në afatin ligjor me dt.xx.xx.xxxx ka parashtruar kundërshtim kundër akuzës, provave në akuzë dhe kërkesë për hudhje të akuzës në mungesë të provave.

Mbrojtësi i te pandehurit X.X, av.V në afatin ligjor me dt.xx.xx.xxxx ka parashtruar kundërshtim; kundër akuzës-provave në akuzë me kërkesën për shpalljen e provave të papranueshme, kërkesë për hedhjen e aktakuzës sipas nenit 250 par 1 pika 1.3 të KPP-ës, kërkesë për hedhje të aktakuzës sipas nenit 250 par 1. pika 1.4 të KPP-ës, në mungesë të provave.

Gjykata, me dt.xx.xx.xxxx nga një kopje të kundërshtimit e ka dorëzuar në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë me qëllim që të japin përgjigjen në kundërshtime e paraqitura. Prokuroria Themelore në Mitrovicë edhe për kundër njoftimit të rregullt nuk ka paraqitur përgjigje në kundërshtim.

Mbrojtësi i te pandehurit B.B, av.Z me kundërshtimin e paraqitur ka theksuar "se kundërshtimi i akuzës behët për shkak të shkeljeve esenciale neni 241 par 1. pika 1.4 të KPP-ës, duke theksuar se në rastin konkret nuk ka prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar për akuzën e ngritur. Gjithashtu në arsyetimin e kundërshtimit, mbrojtësi ka theksuar "se hetimet në këtë rast kane filluar në vitin 2009 e deri në fillim të vitit 2010, ndërsa aktvendimi mbi fillimin e hetimeve nuk është nxjerrë gjatë kësaj kohe. Sipas mbrojtësit, neni 104 i KPP-ës përcakton "se hetimi fillon me aktvendim të Prokurorit të Shtetit", sipas tij në rastin konkret veprimet e ndërmarra nga prokurori janë pa mbulesë dhe të tilla konsiderohen si prova të pa pranueshme. Sipas mbrojtësit, prokuroria nuk i ka respektuar afatet për fillim të hetimeve siç përcaktohet në nenin 221 dhe 225 të KPP-ës.

Mbrojtësi av.Z me tej ka theksuar "se prokuroria në këtë rast aktakuzën e ka ngritur ndaj te pandehurit B.B, vetëm në bazën e dëshmisë së L.L, deklaratë kjo e cila nuk i'u është dhënë mundësia palëve që ta kundërshtojnë. Mbrojtësi i ka propozuar gjykatës që të gjitha dëshmitë, deklaratat dhe provat materiale të siguruar pa aktvendim mbi fillimin e hetimeve të shpallen prova të papranueshme dhe të veçohen në shkresat e lendes. Ndërsa në mbështetje të nenit 250 par 1 pika 1.4. të KPP-ës të hedhet akuza në mungesë të provave, ndaj te pandehurit B.B, si dhe të pushohet procedura penale për veprën penale për të cilën akuzohet.

Mbrojtësi i te pandehurit X.X av.V në kundërshtimin e paraqitur ka kërkuar që të gjitha dëshmitë, deklaratat dhe provat materiale të siguruar pa aktvendim për fillimin e hetimeve të shpallen prova të papranueshme dhe të veçohen në shkresat e lendes. Me arsyetimin se të gjitha provat janë siguruar në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, sepse prokuroria i kishte siguruar këto prova pa filluar hetimet ndaj te pandehurit X.X në mungesë të aktvendimit për fillim të hetimeve. Sipas mbrojtësit, hetimet në këtë rast i përkasin vitit 2009-2010 ndërsa gjatë kësaj kohe aktvendimi për fillim të hetimeve nuk është nxjerrë dhe neni 104 të KPP-ës nuk është respektuar sepse kjo dispozite ligjore

përcakton “hetimi fillon me aktvendim të prokurorit të shtetit” në rastin konkret veprimet hetimore janë ndërmarr nga prokuroria pa mbulëse të aktvendimit mbi hetimet.

Mbrojtësi i të pandehurit X.X av.V ka propozuar që të hidhet pika III e akuzës, në mbështetje të nenit 106 të KPRK-ës dhe në mbështetje të nenit 250 par.1 nenpar.1.3 të KPP-ës. Me arsyetimin se ka arritur parashkrimi i ndjekjes penale në përputhje me nenin 106 të KPRK-ës.

Mbrojtësi i të pandehurit X.X av.V ka propozuar të hedhet akuzë në mbështetje të nenit 250 par.1 pika 1.4 të KPP-ës, dhe të pushohet procedura ndaj X.X në drejtim të veprave penale për të cilën akuzohet në mungesë të provave. Me arsyetimin se aktakuzë e ngritur nga ana e prokurorisë për piken I ndaj të pandehurit X.X nuk mbështetet në provat e besuara. Sipas mbrojtësit kjo akuzë është ngritur vetëm në bazë të dëshmisë së N.N, dëshmi kjo e cila nuk i’u është dhënë mundësia mbrojtësit dhe të pandehurit ta sfidoi atë, si dhe ka kundërshtuar kredibilitetin e kësaj dëshmie.

Mbrojtësi i të pandehurit X.X av.V e ka kundërshtuar piken II të akuzës duke vlerësuar se edhe kjo pikë e akuzës nuk mbështetet në provat e besueshme sipas tij kjo pikë e akuzës mbështetet vetëm në deklaratën e M.N. dhënë në polici. Të cilën deklaratë e sfidon deklarimi i ekzaminertit Z.Z, e i cili edhe është liruar nga akuzë në lidhje me këtë rast. Sipas mbrojtësit edhe X.X e mohon një deklaram të tillë të dëshmitarit. Gjithashtu mbrojtësi i ka kontestuar edhe provat në akuzë për piken IV dhe V të akuzës, duke konsideruar se edhe këto pika të akuzës ndaj X.X, nuk mbështeten në prova të besueshme, por vetëm në një deklaratë.

Gjykata me 09 shkurt 2016 i ka dërguar një kopje të kundërshtimeve Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, mirëpo deri me tani, prokuroria nuk ka dorëzuar ndonjë përgjigje në kundërshtimet e paraqitura në aktakuzë nga mbrojtësit av.Z dhe av.V.

Vlerësimi i gjykatës në lidhje me provat e papranuara

Gjykata, duke shqyrtuar kundërshtimet e mbrojtësit av.Z av.V, në lidhje me provat, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lendes penale, gjene se në rastin konkret Prokuroria Publike Komunale në Mitrovicë, kishte siguruar provat materiale –me masa të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit-transkriptet dhe CD-ën me incizimit nga përgjimi i bisedave telefonike, sipas masës së fshehte, përgjim i bisedave telefonike për të pandehurin X.X dhe B.B.

Gjykata, gjene se prokuroria në rastin konkret kishte ndërmarrë veprime hetimore ndaj X.X dhe B.B të cilat konsistojnë në sigurimin dhe grumbullimin e provave përmes masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit gjegjësisht përmes dy masave specifike; përgjimin e bisedave telefonike dhe simulimin e veprës penale të korrupsionit. Këto veprime hetimore Prokuroria Komunale në Mitrovicë ndaj të pandehurve i kishte ndërmarrë gjatë periudhës kohore duke filluar nga 03 janar 2009 e deri me 18 janar 2010. Brenda kësaj periudhe kohore sipas kërkesës së prokurorisë, gjykata kishte lëshuar urdhrin GJPP.nr.xx/xx, dt.xx.xx.xxxx për masën e fshehtë –përgjimin e bisedave telefonike ndaj të dyshuarit X.X.

Gjykata, gjen se të gjitha veprimet hetimore si dhe të gjitha provat që janë siguruar përmes masave të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit ndaj të pandehurit X.X dhe B.B, gjatë periudhës kohore 03

janar 2009 e deri me 18 janar 2010 ishin ndërmarr dhe siguruar pa filluar procedurën penale zyrtare nga ana e prokurorisë, gjegjësisht pa filluar hetimet dhe në mungesë të aktvendimit mbi fillimin e hetimeve. Gjykata, ka vërtetuar se në rastin konkret prokuroria fillimisht i kishte siguruar të gjitha provat me masa të fshehta të hetimit siç ishin -përgjimin e bisedave telefonike dhe masave tjera si me larte dhe vetëm me pas me 28 janar 2010 kishte filluare hetimet penale kundër te pandehurit X.X e B.B, dhe personave tjerë, çka nënkupton se provat e siguruara përmes përgjimit të bisedave telefonike-transkriptet e bisedave dhe CD-ja me incizimi nga përgjimi i bisedave telefonike ishin siguruar pa aktvendim mbi fillimin e hetimeve (pa filluare zyrtarisht hetimet penale ndaj të pandehurve).

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, provat e siguruara përmes masave të fshehta teknike të hetimit; përgjimet e bisedave telefonike për të pandehurin B.B dhe X.X janë mbledhur në kundërshtim të plotë me frymën dhe kërkesat ligjore për urdhërimin e këtyre masave. Gjykata rikujton standardin ligjor që parashihet me nenin 86 par.2 i KPP-ës i cili përcaktohet “pas fillimit të procedurës penale ose të njëjtën kohë me aktvendimin e prokurorit të shtetit për të filluar procedurën paraprake, prokurori i shtetit mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake që ta autorizojë masat e fshehta teknike të hetimit në pajtim të nenit 86 dhe 100 të këtij Kodi. Sipas këtij përkufizimi ligjor rrjedhë se masat e fshehta teknike të hetimit mund të autorizohen vetëm pasi të fillojë procedura penale-pasi të fillojë hetimi zyrtar me aktvendim nga ana e prokurorit të shtetit. Sipas vlerësimit tonë, nga kjo rregull ka vetëm një përjashtim, që përcaktohet me nenin 84 të KPP-ës, i cili e lejon urdhërimin e masave të fshehta teknike të hetimit edhe pa filluar procedura penale por me të vetmin përjashtim në mungesë të identitetit të të pandehurit. Ndërsa neni 84 par.4 i KPP-ës, përcakton “procedura penale nuk kërkohet të jetë filluar për autorizimin nga prokurori i shtetit apo gjyqtari i procedurës paraprake të masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit nga par.1 (sëparmi i gjykatës i referohet nenit 84 par.1 të KPP-ës), sidoqoftë, procedura penale fillohet posa prokurori i shtetit të ketë dyshim të arsyeshëm për identitetin e të dyshuarit apo dyshuarve që kanë kryer veprat penale.

Gjykata, gjen se masa e fshehte teknike e hetimit -simulimin e veprës së korrupsionit e cila ishte lëshuar ndaj të pandehurit X.X sipas urdhrit GJPP.nr.xx/xxxx, dt.xx.xx.xxxx, edhe kjo masa e fshehtë ishte urdhëruar pa filluar procedura penale ndaj të pandehurit. Në këtë drejtim provat e sigurua përmes kësaj mase për këtë gjykatë janë të papranueshme.

Vlerësimi i gjykatës në lidhje me provat –transkriptet dhe incizimet -CD e siguruara përmes masave të fshehta nga përgjimi i bisedave telefonike për të pandehurin B.B, provat e tilla të siguruara përmes këtyre masave janë provat plotësisht të papranuara, sepse janë siguruar në kundërshtim të plotë me nenin 86 par.2 i KPP-ës, sepse ishin siguruar në mungesë të aktvendimit mbi fillimin e hetimeve. Gjithashtu provat e tilla të siguruar përmes këtyre masave janë marrë në kundërshtim me nenin 92 të KPP-se, si të tilla janë marrë në mungesë të urdhrit të gjykatës. Në shkresat e lëndës nuk kemi gjetur ndonjë urdhër të Gjykatës, për masa të fshehta ndaj të pandehurit B.B, përveç se në transkriptet nga përgjimi i bisedave telefonike

Kemi hasur material nga ky përgjim. Në transkriptet e përgjimeve të bisedave telefonike shkruhet përgjimet “B”, që i referohet të pandehurit B.B. Për në mbetet e paqartë dhe i pakuptueshme fakti se si

janë siguruar me masa të fshehta - përgjimi i bisedave telefonike për të pandehurin B.B, në mungesë të urdhrimit gjyqësor.

Gjykata, në përputhje me nenin 97 par.1, 2, 3 të KPP-ës, e në mbështetje të nenit 249 dhe nenit 257 par.1,2,3 të KPP-ës, konsideron se provat e siguruar përmes përgjimeve të bisedave telefonike dhe simulimit të veprës penale të korrupsionit për të pandehurin X.X dhe B.B, janë siguruar-marrë në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi, andaj si të tilla i ka shpallur si prova të papranueshme dhe të njëjtat i ka veçuar nga shkresat e lëndës. Gjykata, ka vlerësuar sigurimin e provave sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (Kodit të ri-01 Janar 2013). Ngase, duke u mbështetur në dispozitat përfundimtare të KPP-ës, neni 539 udhëzon gjykatën që në çdo procedurë penale të zbatohen dispozitat e këtij Kodi.

Arsyet sa i përket pikës III të akuzës

Gjykata, ka aprovuar propozimin e mbrojtësi të të pandehurit X.X av.V për hedhjen e pikës III të akuzës ndaj të pandehurit X.X për shaka të parashkrimit.

Gjykata, rikujton se i pandehuri X.X në piken III të akuzës së Prokurorisë Komunale në Mitrovicë, PP.xx/xxxx, dt.xx.xx.xxxx, akuzohet për veprën penale Dhënie e ryshfetit nga neni 344 par.1 të KPK-ës, për të cilën veprën është paraparë dënimi me burgim deri tri/3/ vjet. Në mbështetje të nenit 90 par. 1 pika 5 të KPK-së, është përcaktuar se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar tri (3) vite, nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në tri/3/ vite burgim. Ndërkaq neni 91 par.6 të KPK-ës, përcakton se “ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të këtë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit”. Në rastin konkret nga koha kur dyshohet të jetë kryer vepra penale me 18 janar 2010 e deri me tani kanë kaluar më tepër se / 6 / gjashtë (gjashtë vjet) si kohë të cilën ligji e përcakton arritjen e parashkrimit absolut të ndjekjes penale. Nga shkresat e lëndës vërtetohet se parashkrimi absolut i ndjekjes penale në këtë rast ka arritur më 18 janar 2016. Gjykata, rikujton se arritja e afatit të parashkrimit absolut është një rrethanë që e pengon ndjekjen penale në çdo rast dhe gjykata posa të konstatojë se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale sipas nenit 91 par.6 të KPK-ës, obligohet të hedh akuzën dhe pushoj procedurën penale në çdo rast.

Sa i përket vendimit për hedhjen e kundërshtimit në lidhje me provat tjera.

Gjykata, ka vendosur që ta refuzoi si të pabazuara kundërshtimet për shpalljen e papranueshme të provave tjera në këtë rast penale të paraqitur nga avokatet av.Z dhe av.V, Gjykata, ka vendosur që t'i refuzoi këto kundërshtime me arsyetimin se provat e siguruar gjegjësisht marrja e deklaratave nga dëshmitarët, gjithsejtë dymbëdhjetë dëshmitarë, xx, xx, xx, xx, xx, xx, xx, xx, xx, xx, xx, janë bërë në mbështetje të plotë me ligjin. Gjykata, konsideron se sigurimi i këtyre provave është bërë në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Gjykata, rikujton se neni 68 i KPP-es, përcakton se procedurës penale mund t'i paraprijë veprimet fillestare policisë sipas nenit 70, 71, 73 të KPP-es. Gjykata, vlerëson se policia kishte vepruar drejtë me rastin e marrjes së deklaratave nga ana e dëshmitareve dhe me sigurimit-marrjen e testeve me shkrim në lidhje me rastin konkret. Kjo mundësi lejohet me neni 73 par.2 i KPP-es, i cili përcakton “se policia ka të drejtë të marrë në pyetje personat të cilët mund të jenë dëshmitar të një veprë penale dhe për këtë të përpilon raport policor i cili duhet të

përmbajë të gjitha të dhënat e nevojshme që përmbana një deklaratë mbi marrjen në pyetje të dëshmitareve”. Si dhe të sigurojë (grumbullojë) provat e mundshme që mund të vërtetojnë elementet e veprës penale. Autorizimit të tilla të policisë në këtë fazë konsistojnë në detyrat dhe autorizimit policore dhe në momentin e sigurimit të dyshimit të arsyeshme për veprën penale mund të parashtrijnë - kallëzimin policor para prokurorit të shtetit. Gjykata, vlerëson se marrja në pyetje e dëshmitarëve të lartcekur nga ana e policisë është bërë në përputhje me nenin 73 par.2 të KPP-es. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pasi janë vështruar shkresave të kësaj lënde penale, vërtetohet se marrja në pyetje e këtyre dëshmitarëve është bërë në përputhje të plotë në frymën e ligjit. Vërtetohet se këta dëshmitar para marrjes në pyetje, ishin njoftuar për detyrimin për të dëshmuar, i ‘u ishte tërheq vërejtja se dëshmia e rrem paraqet vepër penale sipas KPRK-së, të njëjtit deklaratat i kishin nënshkruar në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë vërejtje. E nga këto arsye gjykata konsideron se nuk ka bazë ligjore që deklaratat e tilla të shpallen si prova të papranueshme, sepse të njëjtat nuk janë marr në kundërshtim me dispozitat e KPP-së. Ndërsa edhe provat tjera teste me shkrim për patën ishin marr në kuadër të autorizimeve policore në procedurën parapenale. Gjykata, rikujton se vlera provuese, provueshmëria, besueshmëria e këtyre deklaratave do të bëhet pasi që gjykata t’i dëgjojë këta dëshmitar në shqyrtimin gjyqësor dhe në fund të procesit penal do të jap mendimin përfundimtar në aktgjykim për secilën nga provat veç e veç. Është e kuptueshme se në këtë fazë të procedurës, sipas ligjit nuk administrohen provat, por administrimi i provave bëhet në shqyrtimin gjyqësor

Vlerësimi i gjykatës sa i përket kërkesës për hedhjen e akuzës:

Gjykata, padashur të prejudikojë vendimin përfundimtar në çështjen, vlerëson se akuza e ngritur nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ndaj të pandehurve X.X dhe B.B, është mbështetur në prova të mjaftueshme, të cilat provojnë në masë të madhe dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer vepër penale për të cilat edhe akuzohen.

Dyshimi i bazuar mirë, vërtetohet nga provat që i ka deponuar prokuroria në këtë gjykatë, provat si vijojnë- Deklaratat e dëshmitarëve; x.x, x.x, x.x, x.x, nga testet me shkrim në origjinal për patentë shofer për x.x, x.x, x.x, x.x, si dhe të gjitha raportet policore në lidhje me rastin konkret penal. Gjykata vlerëson se këto prova janë të mjaftueshme për të kaluar në fazën tjetër të procedurës penale- në shqyrtimin kryesor ku i pandehuri dhe mbrojtja e tij, në mënyrë të drejtpërdrejtë do kenë mundësi të parashtrijë provat që vlerësojnë se i shkojnë në favor të pandehurit si dhe do të ketë mundësi t’i kundërshtoj apo pohojnë provat e paraqitura nga prokuroria. Ndërsa mbi bazën e tyre gjykata do të nxjerr vendimin përfundimtar.

Kryetari i trupit gjykues është i bindur se kjo akuzë i plotëson të gjitha kushtet nga aspekti ligjor që të procedohet më tutje në fazën e shqyrtimit gjyqësor, si mundësi që parasheh ligji që në mënyrë të drejtpërdrejtë t’i administrojë gjitha provat në këtë rast penal e mbi bazën e tyre të vendos përfundimisht në këtë qeshje penale.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në diapozitiv të këtij aktvendimi në mbështetje të nenit 249 par.3, 250 par 1 e par 3, 253 par 1, pika 1.3 të Kodit të Procedurës Penale.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Krimeve të Renda

P.nr.xx/xxxx, me dt.xx.xx.xxxx

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari:

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 5 ditësh. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët.

NËNKAPITULLI IV

SHQYRTIMI GJYQESOR DHE AKTGJYKIMI

SHQYRTIMI GJYQËSOR

Hyrje:

Shqyrtimi gjyqësor konsiderohet një nderë fazat me të rëndësishme të procedurës penale, ngase është faza qendrore ku gjykata në mënyrë të tërësishme i administron të gjitha provat qofshin ato materiale apo personale dhe mbi bazën e tyre nxjerr aktgjykim përfundimtar.

Kapitullin XIX i Kodit të Procedurës Penale, rregullon tërësinë e veprimeve procedurale, gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor.

Shqyrtimi gjyqësor përfshinë dispozitat e përgjithshme ligjore, që kanë të bëjnë me përgatitjen e shqyrtimit gjyqësor, drejtimin e shqyrtimit gjyqësor, kushtet për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, si dhe veprimet procedurale deri ne nxjerrjen e aktgjykimit përfundimtar.

Shqyrtimi gjyqësor mund të ndahet në disa faza

- Përgatitjet për shqyrtimin gjyqësor
- Fillimi i shqyrtimit gjyqësor
- Fjala hyrëse
- Paraqitja e provave
- Fjala përfundimtare e palëve

Përgatitja për shqyrtimin gjyqësor

Përgatitja e shqyrtimit gjyqësor përfshinë: caktimin e ditës, orës dhe vendit të shqyrtimit gjyqësor. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, brenda (1) një muaji nga shqyrtimi i dytë ose nga vendimi i lëshuar që ka të bëjë me kundërshtimin e provave në akuzë duhet të caktoj shqyrtimin gjyqësor. Shqyrtimi gjyqësor caktohet me urdhër të kryetarit të trupit gjykues ose gjyqtarit të vetëm, në urdhër përcaktohet koha, vendi, palët që do të ftohen në shqyrtim gjyqësor.

Nëse kryetari i trupit gjykues nuk mund të caktoj shqyrtimin gjyqësor brenda afatit prej (1) një muaj siç parashihet me nenin 285 par.2 i KPP-ës, gjyqtari i vetëm ose kryetari i trupit gjykues mund të nxjerr aktvendim për shtyrjen e shqyrtimit gjyqësor deri në datën e parë të mundshme.

Në rast se mungon i pandehuri në shqyrtimin gjyqësor, kryetari i trupit gjykues lëshon urdhër arrest për të pandehurin dhe nxjerre aktvendim për pezullimin e shqyrtimit gjyqësor.

a) Vendi i mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor.

Në parim seancat e shqyrtimit gjyqësor mbahen në objektin e gjykatës. Përfundimisht, seancat mund të mbahen jashtë objektit të gjykatës në një vend tjetër. Shkaqet për mbajtje e seancës jashtë objektit të gjykatës mund të jenë, që lokalet e ndërtesës së gjykatës të jenë të papërshtatshme për mbajtjen e seancës së shqyrtimit gjyqësor, për shkak të madhësisë të dëshmitarëve dhe hapësirave janë të pamjaftueshme, nëse lokalet e ndërtesës ku punon gjykata rinovohen apo kryhen çfarëdo punimesh që ta pamundësojnë zhvillimin normal dhe papengesë të shqyrtimit gjyqësor. Kryetari i gjykatës vendos që për shkaqe të caktuara shqyrtimi gjyqësor mund të mbahet jashtë objektit të gjykatës.

b) Personat që duhet të thirren në shqyrtimin gjyqësor

Në kuadër të përgatitjes së shqyrtimit gjyqësor veprim i rëndësishëm paraqesin thirrja e palëve për shqyrtimin gjyqësor. Prania e palëve në procedurë penale është e detyrueshme sipas nenit 57 të KPP-së. Në shqyrtimin gjyqësor duhet të ftohen, prokurori i shtetit, i pandehuri, mbrojtësi i tij, i dëmtuari, dëshmitarët, ekspertet, përkthyesit sipas nevojës. Prokurorit të shtetit ftesa i dërgohet përmes zyrës së prokurorisë. Ndërsa, të pandehurit ftesa për shqyrtim gjyqësor i dërgohet së paku (8) ditë para mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor. Në ftesë ai, paralajmërohet për pasojat e mungesës në shqyrtim gjyqësor, njoftohet me të drejtën për angazhimin e mbrojtësit në rast se nuk ka angazhuar mbrojtës deri në atë fazë. I dëmtuari për seancën e shqyrtimit gjyqësor ftohet me kohe dhe në mënyrë të rregullt, gjithashtu paralajmërohet për të drejtën e parashtrimit të kërkesës pasurore juridike si dhe faktin se shqyrtimi gjyqësor mund të mbahet edhe pa prezencën e tij. Në rast se i dëmtuara nuk parashtron kërkesën pasurore-juridike ai e humb cilësinë e palës në procedurë.

c) Dorëzimi i thirrjeve për shqyrtimin gjyqësor

Në parim thirrja për të marr pjesë në shqyrtim gjyqësor duhet t'i dorëzohet personalisht personit të cilit i është adresuar. Pastaj, marrësi dhe dorëzuesi duhet ta nënshkruajnë dhe ta shënojnë datën e pranimit përkatësisht dorëzimit të thirrjes për shqyrtimin gjyqësor. Në rast se marrësi refuzon pranimin e thirrjes apo nënshkrimin e fletë dorëzimit, në këto raste dorëzimi konsiderohet si valid, që nënkupton se thirrja është dorëzuar në mënyrë të rregullt dhe nëse personi mungon pa arsye në shqyrtim gjyqësor, mund të këtë pasoja ligjore. Në rast se personi, të cilit shkresa duhet t'i dorëzohet nuk gjendet në vendin ku duhet bërë dorëzimi, dhe dorëzuesi mëson se ku gjendet ai person, atëherë e njofton atë me shkrim, përmes familjarëve të tij apo personave të afërt për kohën dhe vendin se ku dhe kur mund t'i dorëzohet thirrja personalisht. Në rast dështon përpjekja për dorëzimin personal të thirrjes për shkak se nuk dihet adresa e personit apo ai nuk gjendet në adresën që ka dhënë me herët, atëherë dorëzimi i thirrje mund të bëhet përmes anëtarëve të tij të familjes, fqinjëve, kujdestarit apo në vendin e tij të punës.

Thirrja për shqyrtim gjyqësor për të akuzuarin duhet të përmbajë; emrin, mbiemrin të akuzuarit, cilësinë në të cilën ai ftohet, veprën penale për të cilin akuzohet, vendin, data dhe orën në të cilën duhet të paraqitet, si dhe paralajmërimin për pasojat e mungese në seancë. Në ftesën që i dërgohet të akuzuarit patjetër duhet të shënohet paralajmërimi me shkrim; se në rast se mungon pa arsye në shqyrtimin gjyqësor, gjykata mund të lëshojë urdhër arresti apo sjellja me forcë.

Publiciteti i shqyrtimit gjyqësor

Në parim seancat e shqyrtimit gjyqësor janë publike, të hapura. Përjashtimisht seancat e shqyrtimit gjyqësor mund të mbahen me dyer të mbyllura (të përjashtohet publiku). Publiciteti në procedure penale nënkupton në mundësinë që qytetarët e interesuar të prezantojnë dhe t'i ndjekin seancat gjyqësore. Karakteri publik i shqyrtimit gjyqësor gjithashtu parashihet edhe me nenin 14 par.1 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Politike dhe Civile si dhe nenit 6 të KEDNJ.

a) Përjashtimi i publikut

Nga fillimi e deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues me propozim të palëve apo sipas detyrës zyrtare mund të përjashtoi publikun gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor apo në një pjesë të shqyrtimit gjyqësor. Publiku përjashtohet kur është e nevojshme për:⁵⁶⁵

- Ruajtjen e fshehtësisë zyrtare,
- Ruajtjen e informacioneve të fshehta që do të rrezikonin shqyrtimin e hapur
- Ruajtjen e rendit dhe respektimin e ligjit
- Mbrojtjen e jetës personale apo familjare të të akuzuarit
- Mbrojtjen e interesave të dëmtarëve, dëshmitarëve bashkëpunues ose dëshmitarëve të mbrojtur.

Gjykata, me aktvendim vendos për mbajtjen e seancës të mbyllur i cili aktvendim duhet të arsyetohet dhe të shpallet publikisht. Aktvendimi për mbajtjen e seancës të mbyllur mund të atakohet vetëm me ankesë kundër aktgjykimit.⁵⁶⁶

b) Personat që nuk përjashtohen nga gjykimi

Vendimi për përjashtimin e publikut nuk vlen për palët dhe disa pjesëmarrës në procedurën penale. Kjo nënkupton se me rastin e përjashtimit të publikut nuk zbatohet për palët, të dëmtuarin, përfaqësuesin e tyre dhe mbrojtësin, përveç rasteve kur zbatohen kushte për mbrojtjen dëmtuarve dhe dëshmitarëve bashkëpunues.

Në seancat që është përjashtuar publiku, me vendim të kryetarit të trupit gjykues mund të lejohen që të marrin pjesë personat e caktuar, siç mund të jenë, personat që janë të angazhuar në çështjet shkencore dhe akademike, figurat publike, dhe me kërkesën e të akuzuar edhe

⁵⁶⁵ Neni 241 i KPP-së

⁵⁶⁶ Neni 296 te KPP

familjarët e tij bashkëshorti apo të afërmit e tij. Në rastet kur gjykata vendos ta përjashtoi publikun, gjithmonë i paralajmëron të pranishmit në shqyrtimin gjyqësor për ruajtjen dhe mos zbulimin e të dhënave dhe informacioneve që ka dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor. Gjkata i paralajmëron personat e pranishëm se në rast se zbulojnë informacionet të tilla ajo paraqet vepër penale. Kur gjykata lejon personat e caktuar që të marrin pjesë në shqyrtimin e mbyllur për publikun, duhet që kjo të shënohet në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor si dhe paralajmërimi për personat e tillë lidhur me pasojat që mund të kenë në rast se zbuloj ndonjë nga informatat që kanë mësuar gjatë gjykimit të tillë.

Gjkata/kryetari i trupit gjykues duhet të kujdeset vazhdimisht për të garantuar publicitetin e shqyrtimit gjyqësor. Nëse seanca mbyllet dhe përjashtohet publiku pa u plotësuar kushtet ligjore atëherë kjo konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384 paragrafi 1 nën par 1.1 të KPP.

Zbatimi i shqyrtimit gjyqësor

Kryetari i trupit gjykues-anëtarët e trupit gjykues, procesmbajtësja, gjyqtari zëvendësues, duhet të jenë vazhdimisht të pranishëm në shqyrtimin gjyqësor.⁵⁶⁷ Në rast se kryetari i trupit gjykues ose ndonjëri nga anëtarët e trupit gjykues, ka munguar në seancën e shqyrtimit gjyqësor apo përkohësisht ka munguar gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor, në këto raste kjo konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384 par.1 nënpar.1.1 të KPP-ës.

a) Detyrat e kryetarit të trupit gjykues

Në rend të parë është detyrë e kryetarit të trupit gjykues të vërtetojë nëse trupi gjykues është i përbërë në përputhje me ligjin, kryetari i trupit gjykues duhet të kujdeset nëse ka ndonjë arsye për përjashtimin e anëtarit të trupit gjykues ose procesmbajtësës, gjithashtu të vërtetojë nëse ekzistojnë shkaqet për përjashtimin e cilitdo anëtarë të trupit gjykues.

b) Detyre tjetër të kryetarit të trupit gjykues/gjatë shqyrtimit gjyqësor

- Drejton shqyrtimin gjyqësor
- Konstaton identitetin e të gjitha palëve, mund të shtroje pyetje cilitdo dëshmitar ose ekspert, apo të pandehurit kur ai paraqet mbrojtjen e tij në shqyrtim gjyqësor.
- Detyrohet të kujdeset për shqyrtimin e gjithanshëm e të drejte të çështjes në pajtim me administrimin e provave siç parashihet me KPP-ë
- Vendos për propozimin e palëve në konsultim me anëtarët e trupit gjykues
- Kujdeset për mbajtjen e disiplinës dhe rendit në sh. Gjyqësor
- Siguron që provat të merren në pajtim me dispozitat e KPP-ës⁵⁶⁸

⁵⁶⁷ Neni 298 te KPP

⁵⁶⁸ Neni 299 te KPP

Kryesimi dhe drejtimi i shqyrtimit gjyqësor nënkupton edhe një varg autorizimesh të gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues, si p.sh: mbajtja e rendit në shqyrtimin gjyqësor, marrja e vendimeve lidhur me propozimin e palëve- kjo bashkërisht me anëtarët e trupit gjykues, mbajtja e disiplinës procedurale, përcaktimi i radhës së paraqitjes së provave, kujdeset për procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, ndalimi i përgjigjes në pyetje të palejuara, shpalljes së administrimit të provave, dhënia e fjalës palëve në fjalën përfundimtare, dhe shkurtimi i saj nëse është e nevojshme, si dhe shpallja e shqyrtimit gjyqësor ka përfunduar.⁵⁶⁹

c) Mbajtja e rendit në gjykatore

Sipas nenit 301 të KPP-ës, përcakton se kryetari i trupit gjykues ose gjyqtari i vetëm detyrohet të kujdeset për mbajtjen e rendit në gjykatore dhe dinjitetin e gjykatës.

Pas hapjes së seancës së shqyrtimit, kryetari i trupit gjykues i paralajmëron palët që të sillen si duhet në gjykatore dhe të mos e pengojnë punën e gjykatës në të kundërtën i paralajmëron për pasojat ligjore. Me qëllim të sigurisë, rendit dhe qetësisë, kryetari i trupit gjykues mund të urdhëroj kontrollimin personave pjesëmarrës në shqyrtimin gjyqësor. Ky lloj i kontrollit ka karakterin e kontrollit për siguri të pjesëmarrësve në shqyrtim gjyqësor që nuk mund të kundërshtohet nga pjesëmarrësit.

Sipas nenit 301 të KPP, fotografimi, filmimi, regjistrimi televiziv dhe regjistrime të tjera përpos regjistrimit zyrtar të shqyrtimit gjyqësor lejohen, përveç nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues kufizon fotografimin, filmimin, regjistrimin televiziv ose regjistrimet tjera me aktvendim të arsyetuar me shkrim. Në rast se nuk lejohen regjistrimet televizive apo filmimi i seancave gjyqësor, kryetari i trupit gjykues vendos për këtë me aktvendim të veçantë me shkrim i cili mund të atakohet sipas ankese kundër aktgjykimit.

d) Prishja e rendit në gjykatore

Kur i akuzuari, mbrojtësi, i dëmtuari, përfaqësuesi ligjor ose përfaqësuesi i autorizuar, dëshmitari, eksperti, përkthyesi ose personat tjerë që marrin pjesë në shqyrtim gjyqësor e prishin rendin dhe nuk i binden urdhrave të gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit, ndaj tyre mund të merren masa siç përcaktojnë dispozitat e KPP-ës.

Tërheqja e vërejtjes-kryetari i trupit gjykues apo gjyqtari i vetëm palëve dhe pjesëmarrësve të cilat e cenojnë rendin në gjykatore u 'a tërheq vërejtjen dhe i paralajmëron me masat që mund të marre gjykata sipas ligjit. Në rast se edhe pas tërheqjes së vërejtje të pranishmit në seancë vazhdojmë me prishë rendin apo nuk i binden urdhrave të ligjshme të kryetarit të trupit gjykues atëherë mund të pasojnë masat ndëshkues siç janë; dënimi me gjobë, largimi nga salla e gjykimit apo njoftimi i mbikëqyrësit. Masat që mund të ndërmerren dallojnë varësisht prej nivelit të prishjes së rendit apo edhe cilësisë së pjesëmarrësit në gjykim.

⁵⁶⁹ Petriq 2, fq.50

Largimi nga gjykatorja-kryetari i trupit gjykues mund të urdhëroi largimin e palëve nga gjykatorja përveç prokurorit të shtetit. I pandehuri mund të largohet nga gjykatorja përkohësisht apo gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor, nëse edhe përkundër vërejtjes se tërhequr nga kryetari i trupit gjykues, ai vazhdon të prish rendin, apo fyen gjykatën apo vazhdon t'i përsërisë sjelljet e njëjta, ai mund të largohet nga seanca gjatë gjithë procesit penal nëse është marr në pyetje gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Shqiptimi i gjobës- në rast se rendin apo qetësinë në gjykatore nuk e respektojnë mbrojtësi, i dëmtuari, përfaqësuesi ligjor, përfaqësuesi me autorizim, dëshmitaret, ekspertet, atëherë gjykata pas vërejtjes se tërhequr ndaj tyre mund të urdhëroi largimin nga gjykatorja por edhe shqiptimin e gjobës deri në (1000) njëmijë euro. Për largimin e mbrojtësit nga gjykatorja apo shqiptimin e gjobës, gjykata e njofton Oden e Avokateve. Ndërsa për sjelljet e prokurorit në seancë gjyqësore kryetari i trupit gjykues e njofton kryeprokurorin e shtetit.

Masat dhe dënimi disiplinor nuk mund të shqiptohen ndaj prokurorit të shtetit, ndërsa ndaj të pandehurit nuk mund të shqiptohet gjoba.⁵⁷⁰

Shembull i dispozitivit të dënimit të mbrojtësit nga praktika gjyqësore

A K T V E N D I M

Avokati B B, me adresë në Rr "F A", nr.23/7, Prishtinë, DËNOHET ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej; 500 € (pesëqind euro), të cilën shumë obligohet ta paguaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Avokatit B B, i shqiptohet gjoba sipas nenit 302 par 1 Kodit të Procedurës Penale [KPP-ë], për prishjen e rendit në Gjykatë, mosbindje ndaj urdhrave të gjykatës dhe largimin nga salla e gjykimit, pa arsye dhe pa lejen e gjykatës.

Lidhur me këtë vendim do të njoftohet menjëherë Oda e Avokatëve të Kosovës në Prishtinë.

Parakushtet për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor

a) Hapja e shqyrtimit gjyqësor

Kryetari i trupit gjykues e hap seancën e shqyrtimit gjyqësor, e shpall çështjen për gjykim, e komunikon përbërjen e trupit gjykues nëse seanca mbahet para trupit gjykues. Pastaj konstaton nëse kanë ardhur të gjithë personat e thirrur dhe kur nuk kanë ardhur verifikon se a u janë dorëzuar thirrjet dhe a i kanë arsyetuar mungesën.⁵⁷¹

⁵⁷⁰ Sahiti, fq.766 Komentari i KPP

⁵⁷¹ Neni 305 i KPP

Për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor është e domosdoshme prania e palëve në seancë gjyqësore me qëllim që të plotësohen kushtet për mbajtjen me sukses të shqyrtimit gjyqësor. Në këtë drejtim është e domosdoshme që gjykata vazhdimisht gjatë përgatitjes së shqyrtimit gjyqësor të kujdeset që thirrja e palëve në shqyrtim gjyqësor t'i dorëzohen në kohë dhe në mënyrë të rregullt para shqyrtimit gjyqësor. Ndërsa, në thirrje gjithmonë të paralajmërohen palët për pasojat e mungesës në shqyrtimin gjyqësor. Kodi i Procedurës Penale, ka përcaktuar pasojat juridike për mungesën e pa arsye të palëve në procedurë penale, përkatësisht në shqyrtimit gjyqësor. Mungesa e palëve në shqyrtimin gjyqësor vetvetiu prodhon efekte dhe pasoja për procesin gjyqësor. Në rast se mungojnë palët, shqyrtimin gjyqësor nuk mund të mbahet sepse mbajta e shqyrtimit pa prezencën e palëve, konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale kjo sipas nenit 384 të KPP.

a) Mosparaqitja e të akuzuarit në shqyrtim gjyqësor

I akuzuari ka cilësinë e palës në procedurë. Prania e tij në shqyrtimin gjyqësor është e domosdoshme sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale. Mbajtja e seancës së shqyrtimit gjyqësor pa pranimin e të pandehurit nuk është e lejuar sipas zgjedhjes dhe rregullativës ligjore. Mbajtja eventuale e shqyrtimit gjyqësor, pa prezencën e të pandehurit ka pasoja procedurale sepse paraqet bazë për prishjen e aktgjykimit si rezultat i shkeljes absolutë të dispozitave të procedurës penale.

Në rast se i pandehuri mungon në shqyrtimin gjyqësor, përkundër thirrjes së rregullt, kryetari i trupit gjykues apo gjyqtari i vetëm ndaj të pandehurit mund të marrë disa masa për sigurimin e tij në shqyrtim gjyqësor, masat si vijojnë:

- të lëshojë urdhër arrest
- të urdhërojë masën e paraburgimit

Kryetari i trupit gjykues ndaj të akuzuarit në rast se mungon pa arsye mund të lëshoi urdhër arrest sipas nenit 175 të KPP. Gjithashtu një masë të tillë mund ta urdhëroi edhe në rastet kur pandehuri përkundër thirrjes së rregullt i shmanget paraqitjes së tij në shqyrtimin gjyqësor, në këso raste kryetari i trupit gjykues mund të urdhëroi edhe masën e paraburgimit e cila masë nuk mund të zgjasë më tepër se një (1) muaj. Kjo imponon që kryetari i trupit gjykues apo gjyqtari i vetëm të bëjë përpjekje maksimale që brenda kësaj kohë të përfundoi shqyrtimin gjyqësor, në të kundërtën obligohet ta liroi të pandehurin nga masa e paraburgimit.

b) Mosparaqitja e mbrojtësit në shqyrtim gjyqësor

Kur në shqyrtimin gjyqësor nuk paraqitet mbrojtësi i thirrur me rregull dhe për arsye të mosardhjes nuk e njofton gjykatën, posa ta këtë mësuar atë ose nëse mbrojtësi lëshon shqyrtimin gjyqësor pa lejen e kryetarit të trupit gjykues gjykata kërkon menjëherë nga i akuzuari që të angazhoi një mbrojtës tjetër. Nëse i akuzuari nuk angazhon mbrojtës apo kur caktimi i mbrojtësit nuk mund të bëhet pa e dëmtuar mbrojtjen shqyrtimi gjyqësor shtyhet.⁵⁷²

⁵⁷² Neni 308 të KPP

Nëse vërtetohet se mbrojtësi qëllimisht nuk paraqitet në seancë me qëllim të zvarritjes së procedurës ai mund të gjobet. Gjithashtu mund të njoftohet edhe Oda e Avokateve për veprimet e mbrojtësit. Kryetari i trupit gjykues apo gjyqtari i vetëm duhet kujdesen që të mos cenohet e drejta e të pandehurit për tu përfaqësuar nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, sepse kjo e drejte është e garantuar me ligje dhe me Konventën Ndërkombëtare.

Sipas nenit 64 të KPP, parashihet që Gjykata gjatë rrjedhës së procedurës mund t'i shqiptojë gjobë deri në dyqindpesëdhjetë (250) Euro mbrojtësit, përfaqësuesit të autorizuar ose përfaqësuesit ligjor, të dëmtuarit ose mbrojtësit të viktimave, kur veprimet e tij janë të drejtuara qartë në zvarritjen e procedurës penale. Gjyba mund të caktohet për çdo veprim që ka për qëllim zvarritjen e procedurës sipas këtij paragrafi.

c) Mosparaqitja e dëshmitarëve ose e ekspertit

Kur dëshmitari ose eksperti i thirrur me rregull nuk paraqiten në shqyrtimin gjyqësor pa arsye kryetari i trupit gjykues ose gjyqtari i vetëm gjykues mund të urdhëroi menjëherë sjelljen e tyre me force.⁵⁷³ Dëshmitari përveç se mund të sjellët me detyrim në shqyrtim gjyqësor, mund të detyrohet edhe t'i mbuloj gjitha shpenzimet e shkaktuar për sjelljen e tij në gjykata.

Shqyrtimi gjyqësor mund të mbahet edhe pa praninë e dëshmitarit apo ekspertit, kjo varet prej vendimit të kryetarit të trupit gjykues apo gjyqtarit të vetëm nëse vendos që shqyrtimi të vazhdojë apo të shtyhet në mungesë të dëshmitareve.

Shqyrtimi gjyqësor mund të mbahet edhe pa praninë e dëshmitarit apo ekspertit në ato raste kur gjykata ka material për vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor, si p.sh., të pranishëm janë dëshmitarët apo eksperte tjerë që mund të dëgjohen, apo mund të administrohen provat tjera materiale gjatë asaj seancë dhe që e bëjnë të panevojshme vendimin për shtyrjen e seancës gjyqësor.

d) Mungesa e prokurorit të shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor

Kur prokurori i shtetit nuk paraqitet në shqyrtim gjyqësor të caktuar në bazë të aktakuzës së prokurorit të shtetit, shqyrtimi shtyhet dhe për këtë gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e njofton kryeprokurorin e shtetit.⁵⁷⁴

Prania e prokurorit të shtetit në shqyrtimin gjyqësor të caktuar në bazë të akuzës së tij është parakusht për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor. Në rast të mosparaqitjes së prokurorit të shtetit në seancë, mbajtja e shqyrtimit gjyqësor detyrimisht shtyhet.

Përfundimi, shtyrja dhe ndërprerja e shqyrtimit gjyqësor

Në parim shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundojë brenda afateve ligjore të parapara me neni 314 pra1 të KPP-se. Përfundimi në kohë i shqyrtimit gjyqësor është me rëndësi nga fakti se

⁵⁷³ Neni 309 të KPP

⁵⁷⁴ Neni 306 të KPP

efikasiteti i procedurës penale është një nder parimet me të rëndësishme të shqyrtimit gjyqësor. Jo gjithherë shqyrtimi gjyqësor përfundon brenda afateve ligjore. Kjo nga fakti se gjatë shqyrtimit gjyqësor mund të paraqiten disa rrethana apo shkaqe apo rrethana të cilat e diktojnë shtyrjen apo ndërprerjen e shqyrtimit gjyqësor.

a) Ndërprerja e shqyrtimit gjyqësor

Sipas nenit 312 par1 të KPK-së shqyrtimi gjyqësor mund të ndërpritet në këto raste:

- për shkak të kalimit të orarit të punës
- për të lejuar një kohe mbrojtësit për përgatitjen në lidhje me akuzën e re apo
- për sigurimin e ndonjë provë të caktuar

Kur shqyrtimi gjyqësor nuk mund të vazhdojë para të njëjtit trup gjykues, apo kur ndërprerja e shqyrtimit gjyqësor ka zgjatur me shumë se (8) ditë, atëherë shqyrtimi gjyqësor fillon nga fillimi.

b) Shtyrja e shqyrtimit gjyqësor

Shqyrtimi gjyqësor mund të shtyhet për shkaqet dhe arsyet e caktuara si vijojnë

- kur duhet të mbledhur prova të reja
- kur gjata shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se tek i akuzuari është paraqitur ndonjë çrregullim mendor ose kur ekzistojnë pengesa tjera të cilat pengojnë vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor.

Në rast se paraqitet rregullimi apo paaftësia mendor tek i pandehuri atëherë pa tjetër që për këtë kërkohet një mendimi i ekspertit të psikiatrisë forenzike. Pengesat tjera të cilat mund të qojnë deri të shtyrja e shqyrtimit gjyqësor mund të jenë të ndryshme p.sh dëshmitari është i sëmur dhe nuk mund të paraqitet në shqyrtim gjyqësor, kur ka kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit deri sa të vendoset në lidhje me kërkesën dhe rrethanat tjera.

Koha për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor

Shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundojë brenda afateve siç përcaktohen në nenin 314 par 1 të KPP-se, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundojë;

- a) 90 ditë kur shqyrtimi gjyqësor mbahet para gjyqtarit të vetëm gjykues
- b) 120 ditë kur shqyrtimi mbahet para kryetarit të trupit gjykues

Shqyrtimi gjyqësor mund të vazhdojë me aktvendim të kryetarit të trupit gjykues kur nuk mund të përfundojë brenda afateve të lartcekura, përafriht në këto raste;

- a) Kur ka numër të madhe të dëshmitareve
- b) Dëshmia e një apo me shumë dëshmitareve janë tepër të gjata
- c) Numri i provave që duhet shqyrtohen është jashtëzakonisht i madh

Me kufizimin kohor të përfundimit gjyqësor ligjdhënësi ka pasur qëllim që shqyrtimi gjyqësor të përfundojë në një kohë të caktuar, krejt me qëllim që të respektohen parim i procedurës penale-parimi i gjykimit në kohe të arsyeshme.

Fillimi i shqyrtimit gjyqësor

Shqyrtimi gjyqësor në parim nënkupton nga fillimi i leximit të akuzës nga prokurori i shtetit dhe përfundon me fjalën përfundimtare të palëve. Shqyrtimi gjyqësor hapet nga kryetari i trupit gjykues, konstatohet përbërja e trupit gjykues, konstatohet prezenca e palëve dhe prania e tyre në shqyrtim gjyqësor .

Kryetari i trupit gjykues apo gjyqtari i vetëm pasi të konstatoj se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor në rastet kur gjitha palët janë prezentë dhe nuk ka ndonjë pengës për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, atëherë vendos që ta mbaj shqyrtimin gjyqësor.

a) Veprimet e kryetarit të trupit gjykues, pas hapjes së shqyrtimit gjyqësor

- Komunikon përbërjen e trupit gjykues
- Konstaton pjesëmarrjen e palëve në seanca gjyqësore
- I njofton palët për çështjen objektin e gjykimit
- Vendos për seancën për gjuhën e udhëheqjen së seancës
- për publicitetin apo jo të shqyrtimit gjyqësor .
- Vendos për mënyrën e regjistrimit të shqyrtimit gjyqësor
- Konstaton identitetin e të pandehurit në procedurë
- Udhëzon të pandehurin për të drejtat e tij në procedurë penale, sipas nenit 323 të KPP-së
- Udhëzon të dëmtuarin për të drejtat e tij në shqyrtimin gjyqësor sipas nenit 62 dhe 63 të KPP-se
-

b) Udhëzimet për të akuzuarin

I akuzuari është subjekt themelor në procedurën penale, dhe njëherazi është palë procedurale me rolin e palës aktive.⁵⁷⁵

I pandehuri në shqyrtimin gjyqësor disponon me disa të drejta specifike të cilat të drejta ia garanton Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, për mundësinë e shfrytëzimit të këtyre të drejtave duhet të udhëzohet nga gjyqtari i vetëm gjykues ose nga kryetari i trupit gjykues.

Gjykata e njofton të akuzuarin për të drejta e tij në procedurën penale sipas nenit 323 të KPP-se, për të drejtën për ta përcjell me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor dhe e udhëzon se mund të paraqes fakte, t`u parashtroi pyetje të bashkakuzuarve, dëshmitarëve dhe eksperteve, të bëjë vërejtje, të jep shpjegime rreth deklarimit të tyre.⁵⁷⁶

Kryetari i trupit gjykues e udhëzon të akuzuarin se:

⁵⁷⁵ Sahiti, fq.790 Komentari i KPP

⁵⁷⁶ Neni 323 I KPP

- Ka të drejtë të mos deklarohet në lidhje me çështjen e tij ose të mos përgjigjet në asnjë pyetje.
- Nëse deklarohet lidhur me çështjen ai nuk detyrohet ta inkriminoi vetveten ose të afërmit e tij, e as ta pranoi fajësinë dhe
- Ai mund të mbrohet personalisht ose nëpërmjet ndihmësit juridik të mbrojtësit sipas zgjedhjes se tij.

c) Leximi i akuzës

Leximi i akuzës paraqet fillimin e shqyrtimit gjyqësor. Prokurori i Shtetit i cili e përfaqëson akuzën në shqyrtimin gjyqësor ftohet nga kryetari i trupit gjykues që ta lexoi akuzën që ka ngritur.

I pandehuri ka mundësi që të heq dorë nga leximi i akuzës kundër tij.

Mundësia që i pandehuri të heq dorë nga leximi i akuzës paraqet një risi në procedurën penale në krahasim me dispozitat e Kodit të mëparshëm të procedurës penale. Duhet ta kemi parasysh se në shqyrtimin gjyqësor prezantohen të gjitha palët e në rastet kur seanca është publike, prezent mund të ketë edhe publik të nivelit të ndryshëm apo edhe përfaqësues të mediave.

Nisur nga këto arsye, do të ishte me e arsyeshme që në çdo rast të lexohet akuza, që gjithë pjesëmarrësit në shqyrtim gjyqësor të kuptojnë objektin e çështjes penale që është duke u shqyrtuar.

d) Deklarimi i të pandehurit lidhur me aktakuzën

Kryetari i trupit gjykues apo gjyqtari i vetëm gjykues bindet se i akuzuari e ka kuptuar akuzën dhe të akuzuarit i jep mundësi ta pranoi ose të mos e pranoi fajësinë. Kur i akuzuari nuk e kupton akuzën kryetari i trupit gjykues kërkon nga prokurori që të shpjegojë atë që i akuzuari mund ta kuptojë pa vështirësi. Kur i akuzuari nuk dëshiron të deklarohet mbi fajësinë konsiderohet se nuk e pranon fajësinë.

e) Pranimi i fajësisë nga i pandehuri në shqyrtim gjyqësor

Kur i pandehuri e pranon fajësinë në të gjitha pikat e akuzës në shqyrtimin gjyqësor trupi gjykues vendos nëse janë përmbushur kërkesat nga neni 248 par.1 i KPRK-ës.⁵⁷⁷

Kryetari i trupit gjykues në këtë situatë, përcakton nëse:

- I pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit
- Pranimi behët vullnetar nga i pandehuri pas këshillimit të mjaftueshëm me mbrojtësin nëse i pandehuri ka mbrojtës.
- Pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza, provat e prezantuar nga prokurori në akuzë.
- Aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik.

⁵⁷⁷ Neni 325 i KPP

Kur i akuzuari e pranon fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, kryetari i trupit gjykues pasi të bindet se janë plotësuar kushtet ligjore siç u ceken me lart, mund të kërkojë mendimin e prokurorit dhe palës së dëmtuar në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit. Pastaj, kryetari i trupit gjykues mund të vendosë të pranoi pranimin e fajësisë nëse janë plotësuar kushtet nga neni 248 par.1 të KPP-ës, apo të refuzoi pranimin e fajësisë nëse konsideron se nuk janë përmbushur kërkesat nga kjo dispozitë ligjore. Ku i pandehuri gjatë shqyrtimit gjyqësor e pranon fajësinë dhe gjykata a'i pranon pranimin e fajësisë, shqyrtimin gjyqësor nuk vazhdon me tej, nuk administrohen provat dhe i pandehuri nuk merret në pyetje. Mirëpo rrjedha e shqyrtimit gjyqësor vazhdon me paraqitjen e fjalës përfundimtare të palëve dhe me shqiptimin e dënimit. Sipas nenit 248 të KPP, në këto raste gjykata mund ta caktojë një seancë të veçantë për të vërtetuar faktet që lidhen me caktimin dhe matjen e dënimit. Kjo seancë mund të caktohet në të gjitha rastet kur palët kërkojnë caktimin e saj, apo kur është nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant që do të kishte ndikim në matjen apo caktimin e dënimit. P.sh. pranimin e ndonjë raportit të veçantë nga shërbimi sprovues, lidhur me gjendjen ekonomike të të pandehurit, gjendjen e përgjithshme familjare, përbërjen dhe rolin e tij në familje, apo ndonjë rrethane tjetër në raport me të kaluarën e të pandehurit. Të gjitha palët mund të paraqesin të dhëna apo pretendimet e tyre në seancën për vërtetimin e fakteve në raport me matjen e dënimit. Nëse i pandehuri nuk e pranon fajësinë në shqyrtimin gjyqësor, atëherë rrjedha e shqyrtimit vazhdon normalisht me administrimin e gjitha provave të propozuara nga palët apo provat që mund t'i nxjerr gjykata, sipas detyrës zyrtare në përputhje me nenin 329 paragrafi 4 të KPP.

Rendi i paraqitjes së provave në shqyrtimin gjyqësor

a) Fjala hyrëse:

Fjala hyrëse në njëfarë mënyre është udhërrëfyes në procedurën e provave në shqyrtimin gjyqësor. Fjala hyrëse paraqet një risi në procedurën penale me hyrjen në fuqi të KPP-ës.

Nëse i pandehuri nuk e pranon fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjykata i fton palët që të paraqesin fjalën hyrëse. Palët që paraqesin fjalën hyrëse mund t'i referohen provave të pranueshme, përmbledhjen dhe krahasimin e provave, mund t'i ilustrojnë ato apo të thirren edhe në ligjin në fuqi. Në parim fjala hyrëse nuk është e kufizuar në kohe, mirëpo kryetari i trupit gjykues, në rastet kur ka numër të madhe të palëve, ka mundësi që ta kufizoi në kohe paraqitjen e fjalës hyrëse për secilën palë.

Palët në fjalën hyrëse nuk duhet të deklarohen për provat e palës kundërshtarë.⁵⁷⁸

Radha e paraqitjes së provave

Kryetari i trupit gjykues gjatë shqyrtimit gjyqësor kujdeset që shqyrtimi gjyqësor të rrjedhë sipas rregullativës që ka përcaktuar KPP-ë.

⁵⁷⁸ Pavisic 1, fq.866

b) Në shqyrtimin gjyqësor provat paraqiten sipas radhës.

- Provat e paraqitura nga prokurori i shtetit
- Provat e paraqitura nga i dëmtuari nëse ka të dëmtuar-apo përfaqësuesi ligjor apo me autorizim.
- Provat e paraqitura nga mbrojtja dhe i pandehuri.

c) Marrja në pyetje e dëshmitarëve

Kryetari i trupit gjykues cakton sipas radhës marrjen në pyetje të dëshmitarëve, në përputhje me radhën e paraqitjes së provave.

Sipas nenit 331 të KPP-ës, së pari merren në pyetje dëshmitarët e propozuar nga prokurori i shtetit, pastaj dëshmitarët e propozuar nga i dëmtuari apo mbrojtësi i viktimave dhe në fund pyeten dëshmitarët e propozuar nga mbrojtja dhe i pandehuri. Dëshmitarin e merre në pyetje se pari pala e cila e ka propozuar (shtron pyetje të drejtpërdrejta). Ndërsa pala kundërshtarë mund ta marr dëshmitarin në pyetje në mënyrë të tërthortë. Kryetari i trupit gjykues me rastin e marrjes në pyetje të dëshmitarit fillimisht;

- Konstaton identitetin e dëshmitarit
- Sigurohet që dëshmitari nuk është i liruar nga dëshmia apo nuk është dëshmitar i privilegjuare, në të kundërtën mund të ketë pasoja procedurale ligjore.
- E njofton dëshmitarin me të drejtat dhe detyrimet në cilësi të dëshmitarit, mund të kërkojë edhe betimin e dëshmitarit.

Kryetari i trupit gjykues vazhdon me marrjen në pyetje të dëshmitarëve sipas radhës. Gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit, dëshmitarët tjerë nuk mund të jenë në gjykatore.

Ka disa rregulla në marrje në pyetje të dëshmitarit: - ndalimi i pyetjes sugjестive,-kufizimi i mundësisë që të “freskohet” memoria e dëshmitarit dhe ndalimi i marrjes së tërthortë në pyetje të dëshmitarit të vet me qellim diskreditimit.⁵⁷⁹

d) Provat të cilat administrohen në shqyrtimin gjyqësor

Përveç dëshmitarëve në shqyrtimin gjyqësor mund të administrohen edhe provat tjera të propozuara nga palët, siç mund të jenë p.sh.

- dëgjimi i ekspertëve
- administrimi i provave materiale (dokumente të ndryshme)
- rikonstruimi i vendit të ngjarjes

⁵⁷⁹ Krapac, op.cit, fq.82,83

Palët gjatë administrimit të provave kanë të drejtë të kundërshtojnë provat e administruara, të bëjnë vërejtje gjatë deklarimeve të dëshmitarëve apo eksperteve, gjithashtu mund të i shtojnë pyetje dëshmitarëve derisa vazhdon marrja në pyetje e tyre.

e) Marrja në pyetje e të pandehurit

Pas përfundimit të administrimit të provave nëse palët nuk propozojnë prova të reja apo nëse gjykata ka refuzuar nxjerrjen e provave tjera, kryetari i trupit gjykues vendos të kalojë në fazën tjetër të procedurës-në marrjen në pyetje të akuzuarit.

I akuzuari para se të merret në pyetje, kryetari i trupit gjykues ia rikujton të drejtat që ligji ia garanton sipas nenit 323 të KPP-ës. I akuzuari mund të shfrytëzojë të drejtën që të mbrohet në heshtje –të mos e paraqes mbrojtjen. Në këtë situatë kryetari i trupit gjykues i rikujton të pandehurit deklaratat dhënë me herët para organeve të ndjekjes.

Nëse i akuzuari zgjedhe që të deklarohet atëherë marrja e tij në pyetje duhet të bëhet në përputhje me nenin 346 të KPP-ës.

f) Fjala përfundimtare e palëve

Sipas nenit 353, 354, 355, dhe 356 të KPP-ës, përcaktohen palët që kanë të drejtë të paraqesin fjalën përfundimtare;

- Fjala përfundimtare e prokurorit të shtetit

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare paraqet vlerësimin e tij për provat e shqyrtuara në shqyrtim gjyqësor, shpjegon konkluzionet e tij, mbi faktet e rëndësishme për marrjen e vendimit, paraqet dhe arsyeton vlerësimin e tij për përgjegjësinë penale të akuzuarit, për dispozitat e Kodit Penal të cilat duhet të zbatohen si dhe për rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese që duhet të merr parasysh me rastin e caktimit të dënimit.⁵⁸⁰

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit bënë analizimin dhe çmuarjen e provave sipas pikëpamjes së tij mbi provat e administruara, mbi besueshmërinë e provave, fuqinë provuese të provave për fakte të rëndësishme.

Varësisht nga rezultatet e procedurës provuese prokurori i shtetit mund të tërhiqet nga akuza, të bëjë zgjerimin apo ndryshimin e akuzës në sa i përket kualifikimit ligjor të veprës penale apo në lidhje me përshkrimin tjetër të gjendjes faktike.

- Fjala përfundimtare nga i dëmtuari apo përfaqësuesi i tij.

⁵⁸⁰ Neni 353 i KPP

I dëmtuari apo përfaqësuesi i tij mund të parashtrojnë fjalën përfundimtare, ta arsyetojnë kërkesën pasurore juridike ta argumentojnë atë, si dhe të potencojnë provat që lidhet me përgjegjësinë penale të akuzuarit.

- **Fjala përfundimtare e paraqitur nga mbrojtësi**

Mbrojtësi i të pandehurit paraqet fjalën përfundimtare duke dhënë argumentet në favor të mbrojtjes si dhe mund të komentojë pretendimet e prokurorit ose të dëmtuarit. Nga praktika gjyqësore në shumicën e rasteve mbrojtësi fjalën përfundimtare e shfrytëzon për të dhënë vlerësimin e përgjithshëm mbi provat, mënyrën e sigurimit të provave, kredibilitetin e dëshmitarëve si dhe fuqinë provuese të provave. Gjithmonë, duke i venë në pah provat të cilat sipas bindjes së mbrojtësit i shkojnë në favor të akuzuarit, ndërsa duke tentuar që t'i minimizojë vlerën provuese të cilat i ka propozuar prokurori për ta vërtetuar çështjen penale. Mbrojtësi ka të drejtë që të hesht faktet të cilat i shkojnë në dëm të akuzuarit.⁵⁸¹

Për dallim nga prokurori i shtetit mbrojtësi në fjalën përfundimtare mund të propozojë dy ose më tepër alternative për cilësimin e veprës penale, duke i lënë përzgjedhjen e fundit gjykatës. Ai gjithmonë mund të propozojë alternative edhe llojin e aktgjykimit si dhe llojin dhe lartësinë e dënimit.⁵⁸²

- **Fjala përfundimtare e të akuzuarit**

I akuzuari gjithmonë i fundit paraqet fjalën përfundimtare. I akuzuari në fjalën përfundimtare deklarohet se a pajtohet me fjalën përfundimtare që ka paraqitur mbrojtësi i tij.

I akuzuari në fjalën përfundimtare sikurse edhe palët tjera mund të jap vlerësimet e tij mbi provat e administruara, mund të potencojë rëndësinë konkrete të ndonjë prove që vlerëson se i shkon në favor atij, të jap vlerësimin në përgjithësi në procesin e të provuarit të çështjes penale.

Përfundimi i shqyrtimit gjyqësor

Pasi që gjykata të bindet se çështja penale është sqaruar mjaftueshëm e kur palët nuk kanë propozime tjera për nxjerrjen e ndonjë prove tjetër shtesë, apo kur gjykata ka refuzuar nxjerrjen e provave tjera, kryetari i trupit gjykues vendos ta shpall të përfunduar shqyrtimin gjyqësor.

Kur përfundon shqyrtimi gjyqësor në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, kryetari i trupit gjykues i njofton palët për kohën dhe vendin e shpalljes publike të aktgjykimit.

Shëmbull nga praktika gjyqësore i procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor:

⁵⁸¹ Sahiti, cit. fq.385 Komentari i KPP

⁵⁸² Marina, op,cit. fq.305

PROCESVERBAL I SHQYRTIMIT GJYQËSOR

Mbajtur më dt./////// në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Krimeve të Rënda,(në Objektivin e Gjykatës Mitrovicë-Veri), Kryetari i trupit gjykues A.M, anëtarët e trupit gjykues-gjyqtarët: A.A dhe M.H, procesmbajtësja E.K, në çështjen penale kundër të pandehurit S.GJ, i akuzuar për shkak të veprës penale Mbajtje në pronës, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1të Kodit Penal të Republikës së Kosovës [më tej KPRK], sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr./////// dt.///////.

P r e z e n t

PROKURORI I SHQYRTIMIT NË PTH-MITROVICË: F.B

I pandehuri : S.GJ

Dëshmitarët: Sh.S; S.H

Shqyrtimi gjyqësor filloj në ora 13:40 minuta

Kryetari i trupit gjykues e hap seancën, shpallë çështjen për gjykim në shqyrtimin gjyqësor në çështjen penale kundër të pandehurit: S.K.

Konstaton se prezentë në seance janë: Prokurori i Shtetit në PTH në Mitrovicë F.B, i pandehuri S.GJ, dëshmitarët SH.S dhe S.H.

Nga arsyet e cekura më lartë gjykata konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore që të mbahet shqyrtimi gjyqësor ndaj të pandehurit S.GJ.

Andaj gjykata nga këto arsye nxjerrë:

A K T V E N D I M

MBAHET SHQYRTIMI GJYQËSOR në këtë çështje penale kundër të pandehurit S.GJ, i akuzuar për shkak të veprës penale Mbajtje në pronës, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1të Kodit Penal të Republikës së Kosovës [më tej KPRK], sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr./////// dt.///////.

Palët njoftohen se seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe çështjen e udhëheq kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Avni Mehmeti, me anëtarët e trupit gjykues-gjyqtarët: A.A dhe M.H, me procesmbajtësen E.K.

PALËT NUK E KUNDËRSHTOJNË PËRBËRJEN E TRUPIT GJYKUES, E AS PROCESMBAJTËSEN.

Kryetari i trupit gjykues vërteton se gjykata është përbërë të plotë dhe në pajtim me ligjin dhe nuk ka arsye për përjashtim.

Gjykata konstaton se rrjedha e seancës së shqyrtimit gjyqësor, esenca/përmbajtja do të regjistrohet në procesverbal, ndërsa nuk mund të regjistrohet me audio dhe video, ngase nuk ka mundësi të regjistrohet me këtë lloj të incizimit ngase mungojnë pajisjet për këtë mënyrë të incizimit.

Seanca e shqyrtimit gjyqësor është e mbyllur për publikun, sipas vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik të palëve dhe publikut në përgjithësi, dhe mbrojtjes nga pandemia Covid 19, në përjashtim të mediave të cilat janë prezent.

Seanca mbahet në gjuhën shqipe.

Kryetari i trupit gjykues i paralajmëron personat e pranishëm në shqyrtim gjyqësor që të sillen si duhet dhe të mos e pengojnë punën e gjykatës.

Të dhënat personale për te akuzuarin:

Ftohet i akuzuari S.GJ që t'i merren të dhënat mbi identitetin e tij me shënime si në aktakuzë.

Informohen të akuzuarit për detyrimin e tyre për të njoftuar gjykatën për çdo ndryshim adresë ose për çdo qëllim ndryshimi të vendqëndrimit.

-Udhëzimi për të akuzuarin neni 323 të KPPK-së:

Kryetari i trupit gjykues i fton të akuzuarit të përcjellin me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor si dhe i udhëzon se mund të paraqesin fakte, t'iu shtrojnë pyetje të bashkakuzuarve, dëshmitarëve dhe ekspertëve, të bëjnë vërejtje dhe të japin shpjegime rreth deklarimeve të tyre, po se kanë të drejtë:

Të mos deklarohen lidhur me çështjen e tyre ose të mos përgjigjen në asnjë pyetje,
Nëse deklarohen lidhur me çështjen, nuk detyrohen të inkriminojnë vetveten ose të afërmit e tyre, e as ta pranojnë fajin dhe

Mund të mbrohen personalisht ose nëpërmjet ndihmës juridike të mbrojtësve sipas zgjedhjes së tyre.
I pandehuri S.GJ, deklaron se i ka kuptuar udhëzimet e gjykatës, se dëshiron të deklarohet në lidhje me çështjen, ndërsa për mbrojtës nuk ka angazhuar askënd, mbrojtjen do ta paraqes vet.

Leximi i aktakuzës neni 324 KPPK-së:

Ftohet prokurori i shtetit ne PTH ne Mitrovicë, F.B të lexoj aktakuzën.

Aktakuza është lexuar publikisht në prezencën e gjitha palëve.

Deklarimi i te pandehurit për aktakuzën neni 325 KPPK-së:

Pasi që Kryetari i trupit gjykues bindet se i pandehuri e kupton akuzën, gjykata, të pandehurin e njofton me pasojat e pranimit të fajësisë.

Ftohet i pandehuri S.GJ, të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë në këtë çështje penale:

I pandehuri S.GJ deklaron: Nuk e ndjejë vetën fajtor për veprën penale për të cilën akuzohem.

Meqenëse i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë atëherë sipas rregullit kalohet me paraqitjen e fjalës hyrëse.

Fjala hyrëse:

Prokurori i shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë F.B në fjalën hyrëse deklaron:

Palët tjera me radhe paraqesin fjalën hyrëse

Sipas rregullit gjykata kalon në fazë tjetër të procedurës:

I. Paraqitja e provave:

a) Marrja në pyetje e dëshmitarit SH.S

Dëshmitarit i merren shënimet personale: SH.S, nga i ati, nga e ëma, i lindur më dt.....,

Paralajmërimet për dëshmitarin:

Ky është një rast penal. Ju jeni të detyruar të dëshmoni. Ju jeni detyruar të tregoni të vërtetën. Nëse ju nuk e tregoni të vërtetën, mund të ndiqeni penalisht për veprën penale Lajmërim apo kallëzim i rrem nga neni 390 dhe veprën penale Deklarim i rrem në betim nga neni 371 i KPK-se, që parashihet dënim me gjobe ose me burgim deri në 5 vite. Nëse besoni se mund të fajësoni veten si rezultat i përgjigjes në pyetje ju mund të refuzoni të përgjigjeni. Nëse besoni se keni nevojë për ndihmën e avokatit si rezultat i përgjigjes në një pyetje ju mund të angazhoheni dhe të këshilloheni me një avokat. Ky rast penal kërkon të gjej të vërtetën dhe kujtesën sa më të saktë të fakteve që ju mund të ofroheni. Nëse ju nuk e kuptoni pyetjen që ju është bërë ju duhet të kërkonit që pyetja të ju bëhet ndryshe. Nëse besoni si ka ndonjë dokument ose prova të tjera që mund t'ju ndihmojnë për tu përgjigjur në pyetje sa më saktë apo t'ju kujtohen faktet me çart ju jeni detyruar të na tregoni. Nëse keni nevojë për ndihmë për përkthim apo pushim të shkurtër dhe të arsyeshëm nga kjo seancë ju duhet të kërkonit atë.

A i kupton këto të drejta:

Dëshmitari përgjigjet: Po i kuptoj.

Ftohet prokurori i shtetit në PTH-në Mitrovicë, që ta marr në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejta dëshmitarin.

PTH:

Dëshmitari përgjigjet:

b) Marrja në pyetje e dëshmitarit S.H

Dëshmitarit i merren shënimet personale: S.H, nga i ati..., nga e ëma..., i lindur

Paralajmërimet për dëshmitarin:

Ky është një rast penal. Ju jeni te detyruar te dëshmoni. Ju jeni detyruar te tregoni te vërtetën. Nëse ju nuk e tregoni te vërtetën, mund te ndiqeni penalisht për vepër penale Lajmërim apo kallëzim i rrem nga neni 390 dhe vepër penale Deklarim i rrem nen betim nga neni 371 i KPK-se, qe parashihet dënim me gjobe ose me burgim deri ne 5 vite. Nëse besoni se mund te fajësoni veten si rezultat i përgjigjes ne pyetje ju mund te refuzoni te përgjigjeni. Nëse besoni se keni nevojë për ndihmën e avokatit si rezultat i përgjigjes ne një pyetje ju mund te angazhoheni dhe te këshilloheni me një avokat. Ky rast penal kërkon te gjej te vërtetën dhe kujtesën sa me te saktë te fakteve qe ju mund te ofroheni. Nëse ju nuk e kuptoni pyetjen qe ju është bere ju duhet te kërkonte qe pyetja te ju behet ndryshe. Nëse besoni si ka ndonjë dokument ose prova te tjera qe mund t'ju ndihmojnë për tu përgjigjur ne pyetje sa me saktë apo t'ju kujtohen faktet me çart ju jeni detyruar te na tregoni. Nëse keni nevojë për ndihmë për përkthim apo pushim te shkurtër dhe te arsyeshëm nga kjo seancë ju duhet te kërkonte atë.

A i kupton këto të drejta:

Dëshmitari përgjigjet: Po i kuptoj.

Ftohet prokurori i shtetit në PTH-në Mitrovicë F.B, qe t'i shtrojë pyetje te drejtpërdrejta dëshmitarit .

PTH:

Dëshmitari përgjigjet:

Procedura e shqyrtimit te provave materiale:

-Vështrohet dhe lexohet kallximi penal me nr.000-BF-0000 dt. 00.00.0000

Pa vërejtje pa kundërshtime nga ana e palëve

-Vështrohet foto dokumentacioni dhe shkresat tjera të lëndës.

Pa vërejtje pa kundërshtime nga ana e palëve

-Vështrohet dhe lexohet mendimi balistikës pranë Agjencisë së ForezNIKës në Prishtinë dt.00.00.0000 si dhe shkresat tjera të lëndë.

Pa vërejtje pa kundërshtime nga ana e palëve

Palët nuk kane propozime tjera në lidhje me provat, atëherë sipas rregullit gjykata vazhdon me marrjen në pyetje të të pandehurit: S.GJ

Marrja ne pyetje e te akuzuarit: S.GJ

I akuzuari S.GJ me shënime personale sikur në shkresat e lëndës pa asnjë ndryshim tjetër.

Neni -323, udhëzimet për të akuzuarin para marrjes në pyetje në shqyrtim gjyqësor:

Ftohet i akuzuari qe te përcjell me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor, dhe udhëzohet se mund te paraqes fakte, t'u shtroj pyetje të bashkë akuzuarve, dëshmitareve, eksperteve, të bëjë vërejtje dhe te japë shpjegime

- I pandehuri ka te drejt qe te mos deklarohet për çështjen penale te tij ose te mos përgjigjet ne asnjë pyetje,
- Nëse deklarohet ne lidhje me çështjen, ai nuk detyrohet te inkriminojë veten apo te afërmit e tije ase te pranoje fajësinë dhe
- Ai mund te mbrohet personalisht apo nëpërmjet ndihmësit juridik te mbrojtësit sipas zgjedhjes se tij.

I pandehuri deklaron se i ka kuptuar te gjitha udhëzimet dhe te drejtat ne këtë faze te procedure penale.

I pandehuri zgjedh që te deklarohet për çështje penale qe akuzohet.

Për mbrojtës nuk ka angazhuar askënd.

Ftohet Prokurori në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë F.B, që t'i shtroj pyetje te tërthorta te pandehurit S.GJ.

PTH:

I pandehuri përgjigjet:

Propozimet për plotësimin e procedurës se provave

Kryetari i trupit gjykues i pyet palët nëse kane propozime për plotësimin e procedurës penale.

Nëse askush nuk ka propozime për plotësimin e procedurës se provave dhe gjykata çmon se çështja është sqaruar, kryetari i trupit gjykues shpallë të përfunduar procedurën e provave.

Lexohen te dhënat penale të të pandehurit.

Fjala përfundimtare e palëve:

Prokurori i Shtetit në PTH në Mitrovicë F.B, në fjalën përfundimtare deklaron:

I pandehuri S.GJ në fjalën përfundimtare deklaron:

Procesverbali u lexua me zë dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ana e palëve

Shqyrtimi gjyqësor përfundoj në ora 00:00.

V ë r t e t o j n ë:

Kryetari i trupit gjykues:

Prokurori i shtetit në PTH-Mitrovicë:

Anëtarët e trupit gjykues:

I akuzuari:

1.

2.

Procesmbajtësja:

Vendimet e gjykatës pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor

Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor gjykata në lidhje me çështjen penale mund të nxjerre këto vendime;

- aktgjykim refuzues;
- aktgjykim lirues
- aktgjykimi dënues

Marrja e aktgjykimit – Aktgjykimin gjykata e merr pasi të ketë përfunduar shqyrtimin gjyqësor dhe kor konsideron se çështjet janë shqyrtuar mjaftueshëm nga gjykata dhe janë sqaruara mjaftueshëm pretendimet e palëve andaj edhe mund të kalohet në fazën e vendosjes ndaj aktakuzës që shqyrtuar. Marrja e aktgjykimit nga gjykata kalon neper disa faze të veprimit procedural. Fillimisht gjykata me konstatimin se shqyrtimi gjyqësor ka përfunduar kalon në këshillimin dhe votim në çështjen për të vendosur⁵⁸³. Gjate këshillimit dhe votimit gjykata fillimisht çmon një rrethane duke vlerësuar, se: A ka nevojë për rihapjen e shqyrtimit gjyqësor e rihapja mund të bëhet për dy qëllime: a). Për plotësimin e procedurës – kjo nënkupton kryesisht ndonjë veprim procedural që konsiderohet i nevojshëm për të ardhur deri te qartësimi i çfarëdo rrethane që konsiderohet se mund të jetë pengese në vendosjen meritore, b). Sqarimin e ndonjë Çështje konkrete – kjo mund të kuptohet qoftë sqarimin e ndonjë Çështje në raport me palët në procedure apo sqarimin e ndonjë Çështje që raport me faktet apo provat, megjithatë kjo nuk e përjashton marrjen e ndonjë prove konkrete që mund të ndikoj në sqarimin e Çështjes që konsiderohet nga gjykata se nuk është sqaruar mjaftueshëm.

⁵⁸³ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 359, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

Kur gjykata vlerëson se nuk ka nevojë për rihapjen e shqyrtimit gjyqësor atëherë kalon në marrjen e aktgjykimit.

Procesverbali i marrjes së aktgjykimit: Vendosja nga gjykata lidhur me aktakuzën që është shqyrtuar kur kalon në marrjen e aktgjykimit, duhet të mbahet procesverbal për

këshillimin dhe votimin, ky procesverbal pasqyron veprimet e trupit gjykues me rastin e marrjes së aktgjykimit, për çdo çështje duhet të votohet nga trupi gjykues. Këshillimi nga gjykata për çështjet që shtrohen për votim me rastin e marrjes së aktgjykimit behën gojarisht, dhe votohet për çështjet që është shqyrtuar. Konstatimet e tilla mbahen të shënuara në procesverbal.

Çështjet që shtrohen për këshillim dhe votim: për të marr aktgjykimin lidhur me aktakuzën e shqyrtuara nga gjykata në shqyrtim gjyqësor siç u theksua pasi të përfundoj shqyrtimi gjyqësor dhe pasi të konstatohet se nuk ka nevojë për rihapje të shqyrtimit, kryetari i trupit gjykues shtron çështjet për këshillim ku për secilën çështje që shtrohet për këshillim njëkohësisht edhe votohet nga anëtarët e trupit gjykues⁵⁸⁴. Çështjet që shtrohen për këshillim dhe votim janë: a) fillimisht shqyrtohet kompetenca e gjykatës për të vendosur lidhur me aktakuzën – kompetenca dhe të shikohet kryesisht në aspektin e kompetencës funksionale dhe lëndore nga se kompetenca territoriale pas marrjes së formës së prerë të aktakuzës nuk mund të ri konsiderohet nga gjykata, b) po ashtu shqyrtohet Çështja e nevojës së rihapjes së shqyrtimit – mund të këtë situata që nuk është qartësuar mjaftueshëm andaj rrethanat e tilla mund të dërgojnë në arsye të mjaftueshme për ta rihapur shqyrtimin gjyqësor, po ashtu shqyrtohen edhe Çështje të tjera paraprake – shqyrtimi i çështjeve paraprake konsiston në këshillim dhe votim lidhur me çfarëdo rrethane që nuk prek këshillimin dhe votimin në merito të rastit konkret por që janë kryesisht qofte të natyrës procedurale apo të natyrës tjetër lidhur me ndonjë Çështje që palët kanë pretenduar në shqyrtim, por që nuk ndërlidhet me çështjen e përgjegjësive dhe dënimit. Pasi që të këshillohet për këto Çështje trupi gjykues dhe pasi që të votohet për këto Çështje nga trupi gjykues. Trupit gjykues pasi që të këshillohet dhe voton për çështjet e tilla të theksuara si më lartë, pastaj këshillohet dhe vendose për:

a). Fillimisht votohet se a e ka kryer i akuzuari veprën penale – këtu çështjet që shtrohen janë provat që e ndërlidhin të akuzuarin me veprën penale, pra duke konstatuar faktin se a është i akuzuari kryerës i veprës penale, e kjo nënkupton

duke konstatuar se i akuzuari ka kryer veprën penale atëherë përjashtohet çdo mundësi që dikush tjetër të jete kryerës i veprës penale, e kjo nënkupton se gjykata konstaton përtej çdo dyshimi se i akuzuari është kryerës i veprës penale që është akuzuar po ashtu votohet edhe për përgjegjësin penale pra që nënkupton se a është penalisht përgjegjës i akuzuari për veprën penale që e ka kryer,

⁵⁸⁴ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 472, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

b). Pas kësaj votohet për dënimin që konsiderohet se duhet shqiptuar e që kjo ka të bëjë me këshillimin për rrethanat që mund të ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit,

c) pastaj votohet për sanksionet tjera penale që mund të jenë qofte shqiptimi i sanksioneve plotësuese apo shqiptimi i ndonjë mase për trajtim kur vlerësohet se përveç dënimit duhet shqiptuar edhe ndonjë mase për trajtim,

ç). Pastaj votohet për shpenzimet e procedurës penale gjë që gjykata përcakton lartësinë dhe specifikimin e atyre shpenzimeve që duhet të akuzuari të paguaj përkatësisht nëse shpenzimet i janë ngarkuar apo nëse është liruar nga shpenzimet e procedurës penale, d). pastaj votohet lidhur me kërkesën pasurore juridike – këtu çështja shtrohet nëse është aprovuar kërkesa pasurore juridike e pastaj shtrohet Çështja se në çfarë lartësie nëse kërkesa është aprovuar tërësisht apo pjesërisht, e kur kemi aprovim të pjesshëm të kërkesës pasurore juridike atëherë për pjesën tjetër gjykata duhet të vendosë që të udhëzohet i dëmtuari në procedurën civile kontestimore.

Si votohet nga trupi gjykues: Gjithnjë trupi gjykues voton për secilën çështje që shtrohet pasi që të këtë këshillim dhe diskutim të mjaftueshëm për çështjen që është shtruar për tu diskutuar e që gjithnjë çështjet për votim i vë sipas radhës ligjore kryetari i trupit gjykues⁵⁸⁵. Fillimisht voton gjyqtari që për nga mosha është më i ri në trupin gjykues, pastaj voton anëtari tjetër i trupit gjykues e pastaj voton kryetari i trupit gjykues. Vendimi konsiderohet i marre kur ka shumicë të votave nga anëtarët e trupit gjykues për secilën çështje që shtrohet për votim. Nëse nuk ka shumicë të votave atëherë çështjet shtrohen për votim derisa të arrihet shumica e votave, e nëse nuk arrihet shumica në asnjë rrethane, atëherë votat e anëtarëve që janë më të pafavorshme i shtohen votave që janë më pak të favorshme për të akuzuarin. Anëtarët e trupit gjykues kanë detyrim që të votojnë për çështjet që shtrohen për votim nga kryetari i trupit gjykues, mirëpo ekziston një përjashtim kur anëtari i trupit gjykues, nuk detyrohet për të votuar, e rasti i tillë është kur anëtari i trupit gjykues ka votuar për lirimin e të akuzuarit apo kur ka votuar për revokimin e vendimit, atëherë lidhur me dënimin ai anëtar i trupit gjykues nuk detyrohet që të votoj, po ashtu mund të shtrohet votimi edhe për ndonjë mase lidhur me sigurimin e prezencës se të pandehurit që kryesisht ka të bëjë me masën e paraburgimit pas marrjes së aktgjykimit.

Kush merr pjesë në seancën për këshillim dhe votim: Seanca për këshillim dhe votim është seance e mbyllur, çfarë nënkupton se në atë seance marrin pjesë vetëm anëtarët e trupit gjykues si dhe procesmbajtësi⁵⁸⁶. Votimi konsiderohet si konfidencial andaj nuk lejohet që në asnjë mënyrë të ketë çfarëdo komunikimi apo të bëhet çfarëdo rrethane e ditur për askënd se si është votuar dhe si ka votuar një anëtarë konkret në cilëndo çështje që është shtruar për votim.

Çfarë veprohet tutje: Pasi që trupi gjykues të ketë zbatuar seancën e këshillimit dhe votimit dhe të ketë vendosur për çështjen e akuzës, duhet të përpilohet procesverbali i shpalljes publike

⁵⁸⁵ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 472 paragrafi 2, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁵⁸⁶ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 473, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

te aktgjykimit⁵⁸⁷. Ky procesverbal duhet të përmbajë të dhënat se cila gjykatë bene shpalljen e aktgjykimit, kush është prezent nga palët me rastin e shpalljes, në çfarë ore fillon shpallja e aktgjykimit, po ashtu në procesverbal përshkruhen çështjet e vendosjes kryesore, fakti se gjykata a ka konstatuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale, fakti se a ishte penalisht përgjegjës për veprën penale, konstatimin se shpallet fajtor për veprën penale, dënimin e shqiptuar ndaj të akzuarit, shpenzimet procedurale çfarë është vendosur, kërkesën pasurore juridike ndaj të akzuarit. Procesverbali po ashtu duhet të përmbajë disa arsye thelbësore që kanë qarë gjykatën në marrjen e vendimit të tillë, ku palëve me rastin e shpalljes së aktgjykimit iu bëhen me dije ato arsye, po ashtu konstatohet edhe fakti se palët janë njoftuar për të drejtën e ankesës ndaj aktgjykimit të marre.

Veprimi pas shpalljes publike të aktgjykimit: Pas shpalljes publike të aktgjykimit, gjykata ka obligim që të përpilojë aktgjykimin me shkrim, në aktgjykimin me shkrim duhet gjykata që të përmbahet afateve ligjore që përcaktojnë detyrimin për përpilimin e aktgjykimit. Afati ligjor për përpilimin e aktgjykimit kur i akuzuari nuk është në masën e paraburgimit është në kohëzgjatje prej 30 ditësh, ky afat fillon të rrjedhë nga dita e shpalljes së aktgjykimit, ndërsa kur i akuzuari gjendet në masën e paraburgimit afati i tillë është 15 ditë dhe që po ashtu fillon të rrjedhë prej momentin që është shpallur aktgjykimi. Përkundër këtyre afateve, kur rasti është i ndërlikuar gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë zgjatjen e afatit deri në 60 ditë, duhet të kemi parasysh se afati maksimal i zgjatjes është tërësisht 60 ditë, dhe jo shtimi i afatit edhe për 60 ditë, nga se dispozitat ligjore përdorin shprehjen, “ që të zgjas afatin për përpilimin me shkrim të aktgjykimit **deri** në 60 ditë”, andaj kjo nënkupton se maksimumi i zgjatjes së tërësishme të aktgjykimit është afati 60 ditore nga dita kur është shpallur aktgjykimi por me kushtin që kryetari i gjykatës ka lejuar zgjatjen e afatit të tillë përtej afateve fillestare.

Llojet e aktgjykimit – Kodi i procedurës penale njihë tri lloje të aktgjykimit, si të tillë njihen si: aktgjykimi refuzues, aktgjykimi lirues dhe aktgjykimi dënues⁵⁸⁸.

Aktgjykimi Refuzues – ka të bëjë me refuzimin e aktakuzës që gjykata për shkaqe të parapara ligjore, detyrohet që aktakuzën e ngritur nga ana e prokurorit të shtetit ta refuzojë. Bazat ligjore për aktgjykimin refuzues, janë: a). Kur prokurori i shtetit tërhiqet nga aktakuza nga hapja e shqyrtimit gjyqësor e deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor; b). Kur i akuzuari për të njëjtën veprë penale është gjykuar me aktgjykim të formës së prere ose procedura penale kundër tij është pushuar me aktvendim të formës së prere; ç). Kur ka kaluar afati i parashkrimit, apo vepra penale përfshihet në amnisti ose falje; ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që e përjashtojnë ndjekjen penale.

Baza ligjore kur prokurori i shtetit është tërhequr nga aktakuza – baza e tillë ligjore është rrethanë e mungesës së mëtejme të aktakuzës për të shqyrtuar në shqyrtimin gjyqësor, në këtë

⁵⁸⁷ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 366, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁵⁸⁸ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 362 paragrafi 1, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

kuptim dispozitat ligjore nuk e kufizojnë prokurorin ne asnjë faze te procedurës penale për tu tërhequr nga aktakuza, dhe përderisa prokurori është organi shtetëror qe bene ndjekjen penale dhe ngrit aktakuzën dhe përfaqëson te njëjtën para gjykatës atëherë është rrjedhojë logjike qe ai mund edhe te tërhiqet nga ndjekja penale. Karakteristikë e kësaj baze ligjore është se gjykata kurrë merr aktgjykimin e tillë për ta refuzuar aktakuzën, nuk mund te lëshohet ne rrethana te aspektit përmbajtjesor te shkaqeve qe kanë qar prokurorin te heqë dore nga aktakuza, rrjedhimisht gjykata vetëm vlerëson aspektet ligjore te heqjes dore nga aktakuza e prokuroi pra duke konstatuar mbi cilën baze ligjore prokurori ka deklaruar se është hequr dore nga aktakuza⁵⁸⁹.

Baza ligjore kur i akuzuari për te njëjtën veprë penale është gjykuar me aktgjykim te formës se prere ose procedura penale është pushuar me aktvendim te formës se prere – kjo baze ligjore ne vetvete përmban dy aspekte te ruajtjes se parimeve te procedurës penale, mbi këtë baze ligjore ruhet parimi Ne bis in idem (ndalimi i rishqyrtimit te vendimeve te formës se prere) si dhe po ashtu parimi i Res Judicata (parimi i çështjes se gjykuar). Kjo baze ligjore ne realitet trajton detyrimin e gjykatës qe ne rrethanën kur ekziston aktakuza e qe me pare është gjykuar për veprën e njëjti penale me aktgjykim te formës se prere ajo aktakuze detyrimisht duhet refuzuar, nga se ne çfarëdo rrethane

qofte qe është vendosur me aktgjykimin e formës se prerë për veprën e njëjtë penale nuk mund ete ri procedohet një aktakuze qe tashme për atë veprë penale është gjykuar. Rrjedhimisht këtu kemi te bëjmë me faktet e njëjta dhe kohen e njëjtë te gjykimit, pra nëse ne aktakuze për faktet relevante qe është ngritur para gjykatës për shqyrtim te njëjtat fakte relevante janë shqyrtuar me aktgjykim te formës se prere atëherë ajo aktakuze duhet te refuzohet. Po ashtu edhe kur procedura penale është pushuar me aktvendim te formës se prere rrjedh se çështja penale është shqyrtuar dhe aktakuza duhet refuzuar. Dilema këtu shfaqet te aktvendimi pasi qe aktvendimi shpesh here nuk shqyrton meritat e rastit. Rrjedhimisht kurdo qe çështja penale është vendosur me aktvendim dhe kur si pasoj e aktvendimit te formës se prere sërish parashtrohet aktakuza nga prokurori për veprën e njëjtë penale, atëherë detyrimisht gjykata aktakuzën e tillë duhet ta refuzoj. Por se tek disa rrethana qe është vendosur me aktvendim dhe kur ka rezultuar pushimi i procedurës penale prokurori ka mundësi qe te kërkoj rishikimin e procedurës penale te pushuar me aktvendim te formës se prere. Kjo mundësi ligjore për hedhjen e aktakuzës krijon sigurinë juridike për te pandehurin, ndërsa përkundër faktit qe çështja e tillë është vendosur vetëm me aktvendim njëkohësisht dispozitat ligjore i japin mundësi qe kur vlerëson te arsyeshme te parashtroj kërkesë për rishikimin e procedurës penale, por gjithnjë duke pasur parasysh kushtet ligjore⁵⁹⁰.

Baza ligjore kur ka kaluar afati i parashkrimit, apo kur vepra penale është përfshirë ne amnisti apo falje – Kur rezulton parashkrimi i ndjekjes penale për veprën penale qe është

⁵⁸⁹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 363 paragrafi 1 nenparagrafi 1.1, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁵⁹⁰ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 363 paragrafi 1 nenparagrafi 1.2, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

ngritur aktakuza, e qe konstatohet duke vlerësuar rrjedhën e kalimit te afatit për parashkrimin e ndjekjes, dhe ne rrethana kur ka parashkrim, duhet qe aktakuza te refuzohet me marrjen e aktgjykimit refuzues, pasi qe parashkrimi nënkupton humbjen e autorizimit ligjore për ta proceduar një te pandehur kur është lejuar qe te kalohen afatet ligjore nga organet e ndjekjes penale. Po ashtu kur ligji për amnistinë përfshinë veprat e caktuara penale qe amnistohen kemi te bëjmë me amnistinë e ndjekjes penale dhe rrjedhimisht rezulton qe sipas kësaj baze ligjore duhet te merret aktgjykimi refuzues për shkak se vepra penale ndalohet qe te ndjekë me tutje për shkak te përfshirjes se asaj vepre penale ne ligjin për amnistinë. Po ashtu edhe kur vepra penale është përfshirë ne faljen qe behet sipas ligjit ne fuqi gjykata duhet qe te merr aktgjykim refuzues, përkundër se aktualisht ligji për faljen njeh vetëm faljen e te dënuarve jo edhe faljen për veprat penale qe nuk është konstatuar fajësia prandaj ne praktike falja nuk është se është zbatuar ndonjëherë për te marr aktgjykimin refuzues mbi këtë baze ligjore⁵⁹¹.

Shembull nga praktika gjyqesore e aktgjykimit refuzues

NË EMER TË POPULLIT

P.nr.xxx/xxxx

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË,-Departamenti i Krimeve të Renda (në objektin e gjykatës-degës në Vushtrri), Kryetari i trupit gjykues X.x-me bashkëpunëtorin profesional X.x, në çështjen penale kundër të pandehurit/ës X.x me dyshimin për veprën penale Keqpërdorim i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 te KPK-ës, sipas akuzës se Prokurorisë Themelore ne Mitrovicë, PP.I.nr.xxx/xxx, dt.xx.xx.xxxx. Pas mbajtjes se seancës se shqyrtimit gjyqësor, në prezencën e Prokurorit të Shtetit në PTH në Mitrovicë X.X, të pandehurit X.x. Seanca e shqyrtimit gjyqësor, ka qenë publike, është udhëhequr në mënyrë verbale, ku rrjedhja e shqyrtimit është regjistruar në procesverbal, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor te njëjtën ditë me dt.xx.xx.xxxx është shpallur publikisht aktgjykimi, ndërsa me dt.xx.xx. xxxx e ka përpiluar me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari/a:

X.X, nga i ati X e ëma H, e gjinisë M, e lindur më xx.xx.xxxx, ne fsh.xxx, Komuna e xxxxx, ku edhe banon me numër personal të identifikimit:1000000000, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të përfunduar masterin ne kuadër të Fakultetit te xxxxxxxx, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me parë i pagjykuar, për ketë rast mbrohet në liri.

Gjykata në mbështetje të nenit 363 par.1 nenpar.1.1 te Kodit të Procedurës Penale te Kosovës(KPP-ës) ndaj të pandehurit X.x.

⁵⁹¹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 363 paragrafi 1 nenparagrafi 1.3, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

REFUZOHET AKUZA

SEPSE:

Me dt. 8 Qershor 2014, ne fshatin K, ne shkollën fillore “xxxxxx”, ne komunën e xxxxxxxx, ne vendvotimin nr. 00020/0x0, ka votuar si votues me kusht edhe pse me parë ka votuar si votues i rregullt.

-Me këtë kishte për të kryer veprën penale; Keqpërdorim i drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të KPRK-së.

-Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë buxhetore të kësaj gjykate.

-Kërkesë pasuroro-juridike nuk pati.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë–Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër te pandehurës X.x me dyshimin për veprën penale Keqpërdorim i te drejtës se votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të KPPK-ës.

Me 10 Shtator 2016, Prokuroria Themelore në Mitrovicë, aktakuzën PP-I.nr:xxx/xxx dt.xx.xx.xxxx, kundër të pandehurit/ës: X.x, e kishte dorëzuar në këtë Gjykatë.

Kompetenca e gjykatës: Gjykata, pas pranimit të lëndës ka vërtetuar se në këtë çështje penale ka kompetencë lëndore dhe territoriale për ta shqyrtuar dhe për të vendosur në lidhje me këtë çështje. Gjykata, rikujton se kompetenca lëndore në këtë çështje penale rrjedhe nga fakti se vepra penale për të cilën është akuzuar i/e pandehuri/a: X.x- Keqpërdorim i te drejtës se votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të KPRK-së, përcaktohet se hyn në kompetencë lëndore në Departamentin e Krimeve të Rënda, sipas Ligjit për gjykatat dhe nenit 22 Kodit Procedurës Penale të Kosovës. Ndërsa, kompetenca territoriale për këtë Gjykate, rrjedhe nga fakti se vepra penale për të cilën ishte ngarkuar i/e pandehuri/a: X.x dyshohet se është kryer në territorin e komunës se xxxxxxxxxx të cilin e mbulon Gjykata Themelore në Mitrovicë.

Gjykata, në bazë të provave ka vërtetuar se në lidhje me këtë çështje penale, kundër të pandehurit/ës: X.x nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ishte ngritur kallëzimi penal i dt. xx.xx.xxxx.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, në këtë çështje penale ka mbajtur, gjithsejtë dy seanca të shqyrtimit gjyqësor. Seancat, janë mbajtur me dt.xx.xx.xxxx, dhe xx.xx.xxxx. Seancat, kanë qenë publike, janë regjistruar në procesverbal, janë mbajtur në prezencën e palëve; Prokurorit të Shtetit në PTH në Mitrovicë, X.X, të pandehurit/ës X.x.

Më 15 shtator 2016, Gjykata e ka shpallur publikisht aktgjykimin në këtë çështje penale. Aktgjykimi është shpallur publikisht në prezencën e të pandehurit/ës X.x e në mungesë të Prokurorit të Shtetit në PTH- në Mitrovicë X.X.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës xx.xx.xxxx, prokurori i shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë X.X. ka hequr dorë nga ndjekja penale dhe nga aktakuza PP-I.nr.xxx/xxx, e dt.xx.xx.xxxx, ndaj të pandehurit/ës X.x, për veprën penale: Keqpërdorim i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të KPRK-së, me arsyetimin se në baze të Raportit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, i datës xx.xx.xxxx, me numër të referencës AKF/xxxx-xxxx/xxxx-xxxx është konstatuar se nënshkrimi në listën e votuesve të rregullt nuk i përket të pandehurit X.x.

Gjykata, pasi ka pranuar tërheqjen e akuzës PP-I.nr.xxx/xxx, dt.xx.xx.xxxx, nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë - prokurori i rastit X.X ndaj të pandehurit X.x, kjo gjykate vlerëson se, prokuroria ka të drejtë ligjore në çdo kohë të tërhiqet nga ndjekja penale, deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor, andaj nga këto arsye, kryetari i trupit gjykues konsideron se në tërësi janë plotësuar kushtet ligjore për refuzimin e akuzës dhe nxjerrjen e aktgjykimit refuzues në mbështetje me nenin 363 par.1 nën par 1.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e maur komfor nënve 454 par.1. të KPP-ës.

Nga të cekurat më lartë, e bazuar në nenin 363 par 1. nën par 1.1 të KPPK-së, u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Krimeve të Renda

P.nr.xxx/xxxx, dt.xx.xx.xxxx

Procesmbajtësja
gjyqtari:

Kryetari i trupit gjykues-

KËSHILLË JURIDIKË: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Aktgjykimi lirues – Aktgjykimi lirues është aktgjykimi me të cilin gjykata e liron të akuzuarin nga aktakuza sipas bazave që parashihen në dispozitën ligjore që e rregullon aktgjykimin lirues. Vlerësojmë se në aspektin gjuhësorë dispozita ligjore, që parasheh marrjen e aktgjykimit lirues, nuk është e drejte pasi që është jo logjike që të theksohet se, “ merr aktgjykim me të cilin lirohet i akuzuari nga akuza”, si është e mundur që të ketë aktgjykim për lirimin e të akuzuarit nga akuza, prandaj konsiderojmë se nuk është përdorur drejte në gjuhën shqipe të kuptimit juridik formulimi i kësaj dispozite, andaj do të kishte qenë shumë më e drejte që të ishte, “Gjykata me

aktgjykim lirues konstaton pafajësinë e te akuzuarit për aktakuzën e ngritur” dhe do te ishte kuptim i drejte gjuhësor ne aspektin juridik. Sidoqoftë dispozita ligjore nga neni 364 ka përcaktuar tri baza ligjore kur i akuzuari lirohet nga aktakuza përmes marrjes se aktgjykimit lirues dhe atë: a) kur vepra penale me te cilën i akuzuari është akuzuar nuk përbën veprë penale; b). Kur ka rrethana qe e përjashtojnë përgjegjësinë penale; c). Kur nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për te cilën është akuzuar.

Baza ligjore për aktgjykim lirues kur vepra penale nuk përbën veprë penale – marrja e aktgjykimit lirues mbi këtë baze ligjore, rrjedh për shkak se veprimet e pretenduara ne aktakuze nuk rezultojnë se janë përmbushur elementet e veprës penale qofshin elementet e përgjithshme apo elementet e veçanta te cilat e përbëjnë figurën e veprës penale. Ne rrethana kur gjykata vërteton se me veprimet qe i akuzuari ka ndërmarr nuk përmbushen qofte elementet e përgjithshme te veprës penale apo elementet e veçanta atëherë merr aktgjykim lirues duke konstatuar se i akuzuari duhet te lirohet pasi veprimi i tillë nuk përbën veprë penale, ne këtë kuptim duhet pasur parasysh faktin se ne raport me elementet e veçanta vepra mund te jete mbetur ne tentative. Pra gjithnjë duhet pasur kujdes ne raport me elementet e veprës penale për te marr aktgjykimin lirues mbi këtë baze ligjore⁵⁹².

Baza ligjore për aktgjykim lirues kur ka rrethana qe e përjashtojnë përgjegjësinë penale – rrethanat qe përcaktojnë përjashtimin e përgjegjësisë penale, përcaktojnë bazën kur gjykata duhet te nxjerr aktgjykim lirues, për shkak se mungesa e përgjegjësisë penale e shkakton pamundësinë e shpalljes fajtores, ne këtë kontekst gjykata ne çdo raste kur konstaton se ka rrethane qe përjashton përgjegjësin penale duhet qe te marr aktgjykim lirues për aktakuzën dhe veprën penale qe ngarkon te akuzuarin. Si rrethana qe përjashtojnë përgjegjësinë penale mund te rezultojë paaftësia mendore e te akuzuarit për te kuptuar sjelljet dhe veprimet e tije, ne këtë kontekst gjykata përderisa një person te paaftë nuk mund ta konsideroj penalisht përgjegjës për ta shpallur fajtores te akuzuarin, rrjedhimisht duhet qe ta liroj nga akuza, por rrethane qe përjashton përgjegjësinë penale mund te jete edhe mosha qe konsiderohet se legjislacioni i vendit penalisht përgjegjës i konsideron vetëm personat qe arrijnë moshën 14 vjet, pra çdo person qe është nen këtë moshe do te konsiderohej se për te përjashtohet përgjegjësia penale⁵⁹³.

Baza ligjore për aktgjykimin lirues për shkak se nuk provohet se i akuzuari ka kryer veprën penale – kjo baze ligjore përcakton se gjykata kur konstaton se nuk provohet se i akuzuari është kryerës i veprës penale e për te ardhur deri ne këtë përfundim gjykata duhet qe te ndjek një proces te vlerësimit te drejte dhe te ndërgjegjësohem te provave ne mënyrë qe te vlerësoj, provat një nga një dhe ne lidhshmërinë e tyre. Rrjedhimisht rëndësi ka te kuptohet, ne këtë baze ligjore se nuk kontestohet ekzistimi se një veprë penale është kryer dhe faktet se vepra penale është kryer edhe mund te provohen me provat qe administrohen dhe vlerësohen nga gjykata për marrjen e aktgjykimit, mirëpo këtu gjykata nuk provon mbi bazën e provave qe ato fakte

⁵⁹² Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 364 paragrafi 1 nenparagrafi 1.1, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁵⁹³ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 364 paragrafi 1 nenparagrafi 1.2, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

qe pretendohet se vepra është kryer nuk mund te provohen për t'iu m'veshur se janë veprime apo mosveprime te te akuzuarit andaj edhe rezulton aktgjykimi lirues se nuk provohet se vepra penale është kryer nga i akuzuari⁵⁹⁴.

Shembull i aktgjykimit lirues nga praktika gjyqesore:

P.nr.xx/xxx

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal,(në objektin e degës së gjykatës në Vushtrri) gjyqtari i vetëm gjykues x.x., me procesmbajtësen x.x., në lëndën penale kundër te pandehurit B.B., për shkak të veprës penale Pengimi i të provuarit sipas nenit 309 par 2 te KPK-së, sipas aktakuzës se Prokurorisë Publike Komunale në Mitrovice, PP.nr.xxx/xxx, dt:xx.xx.xxxx, pas mbajtjes se seancës se shqyrtimit gjyqësor e publik më dt.xx.xx.xxxx, në prezencën e prokurorit pranë PTH-së në Mitrovicë x.x, të pandehurit B.B, te dëmtuarit L.L, dhe të njëjtën ditë e ka shpallur aktgjykimin ndërsa me dt:22.04.2014, ka përpiluar këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari:

B.B, nga i ati xxx, e ema xxx, e gjinisë xxxx, i lindur me xx.xx.xxxx, ne fsh.. xxxx, tani me vendbanim ne fsh.xxxx, kom. Mitrovicës, pensionist xxxx, me numër te identifikimit:1000000000, ka te përfunduar shkollën e mesme, i martuare, baba i x fëmijëve, i papune, ndaj tij zhvillohen edhe procedura tjera penale, për këtë rast mbrohet ne liri,

Gjykata ne përputhje me nenin 364 par.1 nenpar.1.3 te Kodit te Procedurës Penale te Kosovës, i njëjti

LIROHET NGA AKUZA

Sepse:

Me dt.08.05.2008, i pandehuri me qellim te parandalimit dhe vështirësimit te mbledhjes se provave ne procedure gjyqësore ka fshehe-asgjësuar apo dëmtuar ne tërësi apo pjesërisht pronën e personit tjetër qe mund te përdoret si prove ne procedure gjyqësore ashtu që traktori i markës "xxxxxx" XXXX me ngjyre te kuqe pa rimorkio dhe pa kabine, prone e te dëmtuarit L.L., te njëjtin edhe përkundër urdhëresës se prokurorit dhe policisë gjyqësore qe traktori te mos shitet, asgjësohet dhe dëmtohet, ai e ka asgjësuar traktorin si objekt i çështjes penale duke shkaktuar kështu vështirësi dhe pengesa ne drejtim te sigurimit te provave për procedurën penale e cila zhvillohet para prokurorit publik.

⁵⁹⁴ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 364 paragrafi 1 nenparagrafi 1.3, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

-Me këtë kishte për të kryer veprë penale Pengim i të provuarit nga neni 309 par.2 të Kodit Penal të Kosovës.

-Shpenzimet e procedurës penale në këtë rast do të mbulojnë nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

-I dëmtuari L.L. nga fsh. xxx, kom. xxxxxxxx, udhëzohet që kërkesën pasurore-juridike mund ta ushtroi në procedure civile.

A r s y e t i m

Prokuroria Publike Komunale në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën, PP.nr.xxx/xxxx, dt:xx.xx.xx,kundër të pandehurit B.B., për shkak të veprës penale Pengimi i të provuarit sipas nenit 309 par 2 të Kodit Penal të Kosovës.

Gjykata, konsideron se në rastin konkret ka kompetencë në pikëpamje lëndore dhe territoriale për të gjykuar këtë çështje penale, ndërsa kompetenca lëndore e gjykatës rrjedhë nga fakti se i akuzuari, ishte akuzuar për veprë penale të Pengimi i të provuarit sipas nenit 309 par 2 të

KPK-së, veprë penale kjo që sipas ligjit bien në kompetencë lëndore të departamentit të përgjithshëm-divizionit penal, ngase përcaktohet dënimi me burgim deri në /3 /tri/ vite. Ndërkaq, kompetenca territoriale rrjedhë nga fakti se vepra penale dyshohet se është kryer në territorin e kësaj gjykate.

Gjykata, në këtë çështje penale me dt.xx.xx.xxxx, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor në prezencën e prokurorit pranë PTH-së në Mitrovicë xx, të pandehurit B.B., të dëmtarit L.L.

Gjykata, në këtë çështje penale ka shqyrtuar provat personale dhe materiale. Jane degjuar në cilesi të deshmitarve I.I., G.H, ndërsa me pelqimin e paleve janë lexuar deklaratat e F.I, dhe H.M dhanë në procedurat e mëhershme-paraprake. Ndërsa, në cilësi të provave materiale janë administruara; urdhëresa e Prokurorisë Publike Komunale e dt.xx.xx.xxxx, shënimi zyrtar Policia e Kosovës-Stacioni Policor Jugu-njësia e hetimeve, i dt.xx.xx.xxxx, raporti i Policisë së Kosovës i dt.xx.xx.xxxx, njësia jugu-ekipi 1,raporti i veçant i Policisë së Kosovës Njësia e hetimeve Stacioni Policor Jugu i dt. xx.xx.xxxx, shënimin zyrtar i policisë së Kosovës i dt.xx.xx.xxxx, shënimet mbi regjistrimin e traktorit, nga regjistrimet paraprake me nr.xxx, vërtetimi i Policisë së Kosovës-Stacioni Policor në Mitrovicë i dt.xx.xx.xxxx, janë vështruar dhe administruar/ 4/katër/ fotografi të traktorit, shënimi zyrtar i dt.xx.xx.xxxx, Policia e Kosovës-Stacioni Policor-Jugu në Mitrovicë, shënimin zyrtar i Policisë së Kosovës i dt.xx.xx.xxxx, Stacioni Policor Jugu Njësia e Hetimeve-lënda njoftim për Prokurorin.

Prokurori i shtetit në PTH-Mitrovicë, në fjalën përfundimtare ka mbështetur në tërësi akuzën e ngritur, ndaj të pandehurit B.B. për veprën penale Pengim i të provuarit nga neni 309 par.2 i Kodit Penal të Kosovës. Duke konsideruar se nga shkresat e lëndës deklarata e deshmitarit, dëshmia e të dëmtuarit si dhe pjesërisht deklarata e të pandehurit vërtetohet akuzat. Duke i propozuar gjykatës që të pandehurin

ta shpall fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit ndërsa me rastin e matjes se llojit dhe lartësisë se dënimit ti mare parasysh rrethanat lehtësuese dhe renduese ne drejtim te pandehurit.

I dëmtuari L.L. ne fjalën përfundimtare, ka kërkuare nga gjykata qe te pandehurin ta dënoi duke vlerësuar se janë plotësuar kushtet qe i pandehuri te shpallet fajtor.

I pandehuri B.B. ne fjalën përfundimtare e ka mohuare fajësinë ne tërësi për veprën penale duke kërkuare nga gjykata qe te liroi tërësisht nga kjo akuzë.

Gjykata duke vlerësuar gjitha provat një nga një dhe gjitha së bashku, ne përputhje me nenin 361 te KPPK-së, ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri B.B. me dt.xx.xx.xxxx, sipas marrëveshjes gojore kishte blerë traktorin xxxxxxxx, me çmim prej x,000€ nga H.M. I pandehuri B.B., traktorin ne fjalë nuk e kishte paguar me para ne dorë, mirëpo te njëjtin e kishte marr nga H.M, si kompensim për borxh qe H.M e kishte ndaj te pandehurit B.B.

Gjykata, këtë gjendje faktike e ka vërtetuar nga deklarata e H.M. dhënë në Policinë e Kosovës,dt:xx.xx.xxxx, e cila deklarata është lexuar ne shqyrtimin gjyqësor me pëlqimin e palëve, ngase i njëjti kishte vdekur. H.M, kishte pranuar se traktorin të cilin e kishte marr nga L.L., ia kishte shitur të pandehurit B.B.. Gjithashtu nga deklarata e dëshmitarit G.H vërtetohet se i pandehuri B.B. me dt.xx.xx.xxxx, e kishte ftuar nëpërmjet telefonit me qellim që ta kontrolloi ne aspektin teknik traktorin xxx/xxxx te cilin dëshironte të blinte. Dëshmitari pranon faktin se i pandehuri B.B e kishte blerë-marr ne kompensim nga H.M. traktorin e lartcekur, si dhe ka qenë prezentë ditën kur B.B. e kishte marr këtë traktor. Me tej dëshmitari ka deklaruar se sipas kërkesë se B.B. kishte kontrolluar traktorin ne aspektin teknik dhe e kishte njoftuar ata se traktori nuk ka me tepër se x.000€, vlere. I pandehuri B.B, në mbrojtjen e tij e ka mohuar veprën penale për te cilën akuzohet, ndërsa ka deklaruar se traktorin e ka blerë me datën xx.xx.xxxx, nga H.M, gjegjësisht e ka marr për një borxh për vlerën prej x.000€. Me te gjitha këto prova vërtetohet se i pandehuri B.B, traktorin xxx-xxxx e kishte marr si kompensim nga H.M, për vlerën prej x.000€.

Gjykata, duke u bazuara në shkresën-vërtetimin e Policisë se Kosovës, dt.x.xx.xxxx, ka vërtetuara se prokuroria/prokurori i rastit i'u kishte dhënë udhëzime policisë që të lokalizojnë (gjeje traktorin) si dhe pronarit momental t'i bëhet me dije që te mos e shesë traktorin, derisa të përfundoj procedura penale ne këtë rast. Mirëpo, gjykata nuk ka arrite të provojë këtë fakt, ngase nuk ka ndonjë njoftim me shkrim përveç njoftimit verbal, qe nuk u provua se ishte bërë, ndërkaq i pandehuri ne shqyrtimin gjyqësor e mohon ne mënyrë kategorike se është njoftuar ndonjëherë për këtë gjë nga ana e policisë. Sipas, vërtetimit të Policisë se Kosovës, dt.xx.xx.xxxx, vërtetohet se policia sipas udhëzimeve te prokurorisë e kishte marr te gjitha shënimet ne lidhje me traktorin në fjale, ne këtë drejtim policia kishte identifikuar dhe konstatuar se traktori gjendet tek i pandehuri B.B, ishte fotografuar traktori në katër foto dhe nga të gjitha këndet, ky fakt vërtetohet në bazë të fotografive që gjinden në shkresat e kësaj lende penale.

Gjykata, duke u bazuar në raportet e Policisë së Kosovës, raporti i dt.xx.xx.xxxx, dhe raporti i njësisë se hetimeve stacioni policor Jugu në Mitrovicë i dt.xx.xx.xxxx, ka vërtetuar se i dëmtuari L.L, ishte ankuar në polici se ishte mashtruar nga H.M, në lidhje me traktorin. Gjykata, nga deklarata e të dëmtuarit ka vërtetuara se L.L. të dyshuarin H.M, e kishte baballak të djalit të të dëmtuarit. Gjykata, ka vërtetuara se Prokuroria, kishte filluar hetimet në një rast ndaj të pandehurit H.M, nga policia ishte intervistuar ai në cilësi të të dyshuarit, për veprën penale të mashtrimit. Mirëpo, procedura ndaj tij nuk kishte përfunduar ngase i njëjti kishte vdekur. Gjykata, bazuar në shënimi zyrtar të Policisë së Kosovës- Stacioni Policor Jugu-njësia e hetimeve dt. xx. xx.xxxx, ka vërtetuar se prokuroria i kishte dhënë udhëzimin policisë së Kosovës-njësisë së hetimeve, që në lidhje me traktorin e lartë përmendur, udhëzimi për policin që mjete-traktori të mbetet tek personi ku gjendet momentalisht gjegjësisht të i pandehuri B.B, sepse në atë kohë ky send ka qenë në posedim tek i pandehurit.

Gjykata, duke u bazuar në shënimin zyrtar të Policisë së Kosovës njësia e hetimeve në Mitrovicë,dt.xx.xx.xxxx, dhe nga deklarata e të pandehurit B.B, dhënë në Policinë e Kosovës, me dt.xx.xx.xxxx, vërtetohet se i pandehuri B.B, e kishte shitur traktorin xxx-xxx. Sipas të pandehurit traktorin e kishte shitur në Mxxxxxx, tre muaj pasi e kishte blerë/marr atë në kompensim, ndërkaq nuk e njihnte personin të cilit ia kishte shitur këtë mjete.

Gjykata, duke u bazuar në urdhëresën e Prokurorit, PP.nr.xxx/xxxx, dt.xx.xx.xxxx, vërtetoi se prokuroria kishte urdhëruar njësinë e hetimeve të konfiskoi traktorin xxx-xxx, tek i pandehuri B.B, me urdhër që të njëjtin t'ia kthej të dëmtuarit L.L. Mirëpo mjete s'ishte konfiskuar e as nuk ishte arritur kthimi i tij tek i dëmtuarit, sepse para lëshimit të urdhrit nga prokuroria i pandehuri e kishte shitur traktorin.

Gjyqtari i vetëm gjykues pranë kësaj gjykate, nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor e të cekura si më lartë në asnjë mënyrë nuk arriti të vërtetojë se i pandehuri B.B, të këtë kryer veprën penale Pengim i të provuarit nga neni 309 par.2 të Kodit Penal të Kosovës ashtu siç akuzohet me aktakuzën e Prokurorisë Komonale në Mitrovicë, PP.nr.xxxx/xx.

Gjykata rikujton se Prokuroria, e kishte akuzuar të pandehurin B.B, për veprën penale Pengim i të provuarit sipas nenit 309 par 2 të KPK-se. Ndërkaq nëse i referohemi kualifikimit ligjor të kësaj vepër penale paragrafit 2, rrjedh se veprimi i kryerjes së kësaj vepër penale është kur kryesi i veprës penale me qëllim parandalimit apo vështirësimit në mbledhjen e provave në procedure penale apo procedurat tjera penale, fsheh, asgjëson apo e benë të pa përdorshëm në tërësi apo pjesërisht sendin, pronën e personit tjetër, apo dokumentit që shërben si prove në procedure penale.

Gjykata, vlerëson se në rastin konkrete mjetit/traktori xxx-xxx, nuk mund të trajtohet si objekt që provon ndonjë fakt në procedure penale. Kjo nga fakti se policia e Kosovës Stacioni Policor në Mitrovicë, sipas udhëzimeve të prokurorisë në Mitrovicë, me dt.xx.xx.xxxx, kishte siguruar provat në lidhje me këtë mjete/traktor. Sipas vërtetimit të policisë dt.xx.xx.xxxx, vërtetohet se policia e Kosovës, ka lokalizuar traktorin, ka fotografuar të njëjtin në 4/katër fotografi, si dhe ka evidentuar të gjitha shënimet

mbi karakteristikat e mjetit e që nga fotografit e mjetit shihen dhe vërehen edhe targat e regjistrimit paraprak e këtij mjete-traktorit që kanë qenë; xxxx- xx: xxxx. Shënimet e lartë cekuar vërtetohen edhe nga dokumenti mbi regjistrimin paraprak të traktorit. Për gjykatën pikërisht këto shënime dhe këto fotografi mbi mjetin-traktorin shërbejnë dhe mund të jenë provë që mund të provojnë cilindo fakt në drejtim të këtij mjete-traktorit në procedurën penale. Të cilat shënime/prova të cekura Policia dhe Prokuroria, i kishin siguruar në kohë, para se automjeti të shitet nga ana e të pandehurit B.B, dhe në asnjë mënyrë i pandehuri nuk i kishte penguar policinë që t'i siguroi këto prova e të cilat kanë qenë në dispozicion tek organet e ndjekjes që nga dt.xx.xx.xxxx. Siç u tha edhe me larët element i veçantë i kësaj veprë penale, sipas kodit penal është që sendi i cili fshehët ose asgjësohet duhet t'i përket personit tjetër, të mos jetë send apo pronë e të pandehurit, ndërsa në rastin konkret gjykata nga provat ka vërtetuar se i pandehuri B.B, mjetin-traktorin xxx-xxx, e kishte blerë (marr në kompensim për borxh) me mirëbesim nga H.M. Në akuzën e prokurorisë, gjegjësisht në përshkrimin faktik të saj thuhet se i pandehuri edhe përkundër urdhërësës së Prokurorisë dhe Policisë gjyqësore që traktorin të mos e shes, asgjëson ose dëmton, ai ka asgjësuar traktorin si objekt i çështjes penale.

Gjykata, vlerëson se nuk mund të qëndroi ky konstatim i prokurorisë në aktakuzë, sepse deri më dt:xx.xx.xxxx, nuk ka asnjë provë që e provon se prokuroria apo gjykata të këtë lëshuar ndonjë urdhër për konfiskim të mjetit /traktorit në fjalë. Gjykata, rikujton se sipas udhëzimit të Prokurorisë, Policia e Kosovës ishte udhëzuar që sendi të mbetet tek pronari aktual (fjala ishte për të pandehurin B.B.), deri në përfundimin e procedurës penale. Ky fakt vërtetohet në shënimin zyrtar të Policisë së Kosovës- Stacioni Policor Jugu në Mitrovicë, njësia e hetimeve, dt.xx.xx.xxxx. Ndërkaq, sipas shënimit zyrtar të policisë së Kosovës dt:xx.xx.xxxx, rrjedh se prokuroria e kishte udhëzuar policinë që të lokalizojë traktorin, si dhe të njoftojë pronarin momental që mjetin traktorin të mos e shesë derisa të përfundojë procedura penale. Ndërsa, prokuroria nuk ka arritur që në shqyrtim gjyqësor të provojë se ishte lëshuar ndonjë urdhër me shkrim, që ia ndalonte B.B, shitjen, tjetërsimi apo ngarkimi i mjetit në fjalë. Ndërsa, vetëm pasi i pandehuri e kishte shitur mjetin-traktorin, afërsisht dhjetë muaj pasi ishte lëshuar urdhri i prokurorisë me shkrim për konfiskimin e mjetit/traktorit, urdhri mbante dt:xx.xx.xxxx. Sipas këtij urdhrit prokuroria urdhëronte konfiskimin e mjetit –traktorit, me urdhër që sendin/traktorin t'i kthehet të dëmtuarit L.L. Gjykata, nga ky urdhër vërtetojë se urdhri i prokurorisë për konfiskim nuk ishte lëshuar me qëllim që traktori të shërbejë si provë në procedurë penale, ashtu siç pretendon prokuroria në akuze, por urdhri kishte për qëllim që sendi/traktori t'i kthehet të dëmtuarit. Sepse prokuroria pretendonte se i dëmtuari ishte mashtruar nga H.M, dhe traktorin e trajtonin si objekt i veprës penale. Pikërisht ky urdhër i prokurorisë e zbehet tej mase pretendimin e prokurorisë në akuze “ku thuhet se i pandehuri e ka tjetërsuar mjetin/traktorin, në këtë mënyrë ka vështirësuar mbledhje e provave në procedurë penale”. Mirëpo nuk ka precizuar se cilin fakt nuk ka arritur t'i provojë, si rezultat i shitjes së mjete/traktorit. Sepse ky fakt është qenësor në drejtim të veprës penale. Gjithashtu nga ana e prokurorisë nuk janë çmuar edhe faktet shfajësuese në drejtim të të pandehurit, sepse me rastin e ngritjes së akuzës

nuk janë shqyrtuar dhe vlerësuar provat që prokuroria i kishte siguruar në lidhje me këtë mjet/traktorit (fotografit, dhe gjitha shënimet në lidhje me te).

Për gjykatën janë të rëndësishme disa fakte në raport me të pandehurin B.B që në mënyrë absolute e shfaqëson të njëjtin nga kjo vepër penale, fakti se nga dt:xx.xx.xxxx e deri me dt:xx.xx.xxxx, nuk u provua se i pandehuri kishte pranuar ndonjë urdhër të gjykatës apo prokurorisë për konfiskimin e traktorit, s'kishte papranuar ndonjë urdhër që ia ndalonte shitjen apo tjetërsimin e sendit. I pandehuri brenda kësaj kohe, kishte shitur mjetin/traktorin sepse ai ishte pronar legjitim, e kishte blerë sendi me mirëbesim. Ndërsa, duke vështuar të drejtën e tij në aspektin civil mbi këtë send kishte të gjitha të drejtat; të drejtën e posedimit, shfrytëzimit si dhe të drejtën për tjetërsim. Ndërkaq, në kohën kur prokuroria kishte lëshuar urdhrin për konfiskim, traktori, mjete traktori nuk ka qene në posedim tek i pandehuri B.B.

Gjykata, vlerëson se në rastin konkretë prokuroria nuk ka vepruar sipas dispozitave ligjore në fuqi, sepse nëse prokuroria posedonte prova se i dëmtuari L.L, ka qene i mashtruar nga H.M, në lidhje me këtë traktor, atëherë kjo prokurori ka qene e obliguar që sipas nenit 247 para 3 dhe nenit 251 të Kodit të Procedure Penale (i cili ka qene në fuqi në atë kohë), të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprakë për të lëshuar urdhër për konfiskim, urdhër për masa siguruese apo kthimin e sendeve tek i dëmtua, cilën do nga këto masa. Mirëpo prokuroria në këtë rast ka dështuar të veproje sipas dispozitave të lartcekura. Nga kjo rrjedhë përfundimi se vetëm gjykata, kishte kompetenca të lëshojë urdhër të tillë, e që prokuroria asnjëherë nuk e kishte kërkuar një urdhër të ligjshëm gjyqësor. Për më tepër urdhri gojor që kishte dhënë policia të pandehurit të mos e shesë sendin, i cili urdhër edhe nuk mund të vërtetohet se ka ekzistuar, si i tillë nuk mund të prodhon asnjë efekt juridik në raport me të pandehurin B.B, sepse në rast e tillë sipas ligjit (KPPK-se) kërkohej urdhër gjyqësor.

Gjykata, vlerëson se edhe urdhri i Prokurorisë i dt:xx.xx.xxxx, nuk kishte mbështetje ligjore sepse siç u tha edhe më lartë sipas neneve 247,251 vetëm gjykata mund të lëshojë urdhër të tillë. Gjithashtu, prokuroria e trajtonte H.M, si të dyshuar për vepër penale të mashtrimit në raport me të dëmtuarin Ibrahim Ibrahim, në lidhje me sendin që është objekt kësaj vepër penale. Mirëpo, gjykata rikujton se procedura penale ndaj H.M, nuk ka përfunduar nuk është dhënë ndonjë aktgjykim përfundimtar. Nga kjo apriori nuk mund të thuhet se automjeti-traktori ka qene objekt i veprës penale, të cilën gjë e kishte konstatuar prokuroria në urdhëresën e lartcekur dhe mbi këtë bazë kishte urdhëruar kthimin e sendit të i dëmtuari.

Gjykata, ka shqyrtuar edhe dëshmitë e të dëmtuarit L.L, dhënë në shqyrtimin gjyqësor dhe dëshmitë e mëhershme të tij, si dhe dëshminë e dëshmitarit x.x.dhe nga deklaratat e tyre kjo gjykata nuk ka arritur të provojë asnjë fakt në drejtim të të pandehurit B.B, dhe veprës penale pengim i të provuarit. Dëshmitë e tyre kryesisht janë të orientuar në drejtim të veprës penale të mashtrimit ndaj të dyshuarit H.M, procedura penale ndaj të cilit nuk ka përfunduar asnjëherë. Gjykata rikujton se para kësaj gjykate është

shtruar qeshja e te pandehurit B.B, për veprën penale pengim i te provuarit sipas nenit 309 par 2 te KPK-se, vepër penale qe nuk u provua.

Andaj në bazë te arsyeve dhe provave gjykata nuk arriti te vërtetojë elementët e veçanta veprës penale pengim i te provuarit tek i pandehuri B.B, nuk u provua se ai kishte ndonjë qellim vështirësoj apo te beje te pamundur mbudhje e ndonjë prove për procedurën penale, sepse siç kemi thënë edhe me larte policia kishte shkuar ne oborin e shtëpisë se tij, ne fshatin xxxx komuna e Mitrovicës, kishte fotografuar traktorin, i kishte marr gjitha te dhënat ne lidhje me këtë mjete, askush nga familja e tij, e as i pandehuri nuk kishte penguar sigurimin e këtyre provave. Pikërisht provat e siguruar nga policia ne lidhje me ketë mjete mund te shërbejnë si prove ne cilën do procedure për te vërtetuar çfarëdo fakti ne drejtim te këtij traktori. I pandehuri kishte mbajtur një kohe te gjate ketë sende, meqenëse s'kishte ndonjë urdhër ndalues te ligjshme kishte vendosur ta shesë traktorin e tij, dhe ne asnjë mënyrë sendin e huaj.

Gjykata, rikujton se sipas nenit 48 te KPP-se, prokurori i shtetit ka për obligim qe gjate hetimit te veprave penale te analizojë provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese dhe te siguroj qe një hetim te kryhet duke respektuar në tërësi te drejtat e te pandehurit dhe qe mbledhja e provave te mos behet ne kundërshtim me Kapitullin XVI te këtij kod. Gjithashtu, duke u bazuar ne nenin 242 te KPP-se, përcaktohet se ne akuzë duhet te jepen shpjegimet e arsyeve për ngritjen e akuzës , bazuar ne rezultatin e hetimeve dhe provave qe i vërtetojnë faktet kryesore, ndërsa rastin konkret prokuroria, nuk kishte siguruar prova, pothuajse asnjë prove te vetme qe ne mënyrë te drejtpërdrejtë apo indirekte qe do te mund te vërtetohej se i pandehuri B.B, të ketë kryer veprën penale te pengim i te provuarit sipas nenit 309 par 2 te KPK-se.

Gjykata, rikujton një nder parimet kryesore te procedurës penale „In dubio pro reo”, përcaktuar ne nenin 3 te Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës i cili përcakton se “Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve te rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë ldispozite te ligjit penal interpretohen ne favor te të pandehurit dhe te drejtave të tij”. Gjykata, bazuar arsyet dhe faktet e cekura si me larte vendosi qe te pandehurin B.B, të liroje nga akuza- PP.nr. xxx/xxxx, dt:xx.xx.xxxx, ngase nuk është provuar qe i pandehuri ka kryer veprën penale të Pengim i te provuarit sipas nenit 309 par 2 te KPK-se.

Gjykata nga arsyet e cekura si me lart e bazuare ne nenin 364, te KPP-ës ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendimin e mori në bazë të nenit 454 të KPP-së. Nga sa u tha me larte u vendos si në dispozitiv te këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal

Procesmbajtësja

Gjyqtari i vetëm gjykues:

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuare e drejta në ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa, i drejtohet gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën.

Aktgjykimi dënues – Aktgjykimi fajësues është vendimi gjyqësor i cili përfundimisht rrezon prezumimin e pafajësisë se te akuzuarit, çka do të thotë se gjykata kur vërteton fajësinë ne procedurën penale e shpall te akuzuarin fajtorë dhe e gjykon me aktgjykim i cili përmes shpalljes fajtorë rrezohet edhe prezumimi ligjorë i pafajësisë. Ne aktgjykimin fajësues gjykata e konstaton veprën penale për te cilën shpallet fajtor i akuzuari, po ashtu konstaton faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga te cilat varet zbatimi i dispozitës konkrete te kodit penal. Ne aktgjykim po ashtu konstatohet emërtimi ligjor i veprës penale dhe dispozitat e ligjit që janë zbatuar gjate marrjes se aktgjykimit. Konstatohet njekohesishte dënimi i shqiptuar, apo urdhri për trajtimin e detyrueshëm nga droga apo alkooli për kryerësit e varur nga to, ose për konfiskimin e dobisë pasurore, vendimi për llogaritjen e paraburgimit ose dënimit te mëparshëm ne lartësinë e dënimit, vendimin për shpenzimet e procedurës për kërkesën pasurore juridike, apo shpalljen publike te aktgjykimit ne shtyp. Ndërsa kur ne aktgjykimin fajësues është shqiptuar dënimi me gjobe atëherë përcaktohet koha kur duhet te paguhet gjoba si dhe mënyra e zëvendësimit te gjobës kur ajo nuk mund ete arkëtohet forcërisht.

Duhet te kemi parasysh se faktet dhe rrethanat që përbëjnë veprën penale, i nënshtrohen normës konkrete juridiko penale që është vet cilësimi juridik i veprës penale. Ne këtë kuptim çështja e aktgjykimit fajësues, ne praktiken gjyqësore me se shpeshti shtron dilemat kur gjykata vlerëson se gjate shqyrtimit gjyqësore rezulton një gjendje tjetër e rrethanave faktike e vërtetuar nga ato që janë pretenduar ne aktakuze, e që duhet te përshkruhen ne aktgjykim siç përcaktohet ne dispozitën e nenit 365. Ndërsa dispozita ligjore nga neni 361 parasheh se gjykata nuk kufizohet me cilësimin juridik te veprës penale te parashtruar nga prokurori, atëherë rrjedh logjikisht pyetja: Nëse gjykata konstaton një gjendje tjetër te fakteve dhe rrethanave nga ato te pretenduara ne aktakuze, deri ne çfarë mase mund te lëshohet gjykata për te marr aktgjykimin fajësues ndaj te akuzuarit për ato rrethana dhe fakte që i ka vërtetuar ndryshe prej atyre ne aktakuze. Praktika gjyqësore është munduar që te zgjidhë çështjen e tillë, duke ardhur ne përfundim se, gjykata nuk mund ete ndryshoj gjendjen faktike për faktet vendimtare që do te mund te kalonin ne një cilësim juridik tjetër që do te vështirësonte pozitën e te akuzuarit, rrjedhimisht faktet që do te ishin relevante e që do te dërgonin ne një cilësim tjetër te veprës penale, do te mundtë lehtësisht te konstatoheshin se përbëjnë tejkallim te aktakuzës se paraqitur nga prokurori, që do te rezultonte me shkelje nga neni 384 paragrafi 1 nën paragrafi 1. 10 te

kodit te procedurës penale. Andaj gjithnjë duhet pasur parasysh qe gjykata me rastin e konstatimit te rrethanave dhe fakteve ne aktgjykimin fajësues te mos e tejkaloj aktakuzën⁵⁹⁵.

Shembull nga praktika gjyqesore i dispozitivit te aktgjykimit dënues:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit: A.S nga i ati R., e ëma A., i vajzërisë R., i lindur me dt...., në Mitrovicë, me vendbanim në Rr.”...”- nr...., me nr. personal të identifikimit;..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, punëtor fizik në ndërtimtari, i pamartuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, ndaj tij zhvillohen procedura për vepër tjetër penale, i njëjti;

SHPALLET FAJTOR

SEPSE: Më dt.26.03.2012 rreth orës 12:45 minuta në Mitrovicë në Rr “Marin Barleti”, në parkun e muzeut të qytetit, pa autorizim ka shitur substanca narkotike të cilat janë të shpallur të rrezikshme, në atë mënyrë që i pandehuri A.S në kazioni të “P.” është takuar me B. e M. M. dhe janë marrë vesh që A. t’iu sjellë një qese me substanca narkotike të llojit marihuan te parku i muzeut duke ia paguar me para me çmimin prej 4.5 euro, e pas një kohe të shkurtër A. ua sjellë substancën narkotike-marihuan e duke e nxjerrë për t’iu jap vëren policinë me ç „rast hedhe në tokë qesen plastike në të cilën ishin pesë qese me substanca narkotike të llojit marihuan në peshë të përgjithshme prej 10.66 gram

-Me këtë ka kryer veprën penale; Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike dhe analoge nga neni 229 par. 2 të Kodit Penal të Kosovës [KPK]. Andaj gjykata në mbështetje të nenit 1, 3, 6, 11, 15, 32, 36, 38, 39, 54, 64, 66, 73 si dhe neni 229 par.2 të KPK-së, të akuzuarit A.S i shqipton;

S H Q I P T O N

I.DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 172 ditë (njëqind e shtatëdhjetë e dy ditë), në këtë dënim të shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak për këtë rast nga dt.26.03.2012 e deri më dt.13.09.2012. DHE

II. DËNIM ME GJOBË në shumën prej 500 € (pesëqind euro) të cilin i akuzuari është i obliguar që të paguaj brenda afatit prej tre (3) muaj nga koha e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Dështimi në pagesën e dënimit me gjobë, Gjykata menjëherë do të zëvendësoi dënimin me gjobë në dënim me burg, për shumën e mbetur të papaguar të gjobës.

III. OBLIGOHET i pandehuri A.S, që të paguaj paushallin gjyqësor në shume prej 20 euro, si dhe shumën prej 50 euro në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, në tërësi shumën prej 70€ (shtatëdhjetë euro), të gjitha t’i paguaj në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

DËNIM PLOTËSUES- Marrjen e sendeve

Gjykata, në mbështetje 60 te KPK, dhe nenit 282 par.2 të te KPP-së, të pandehurit A.S i shqipton edhe dënimin plotësues, ashtu që Gjykata nxjerrë këtë: URDHËR-

URDHEROHET konfiskimi i përhershëm;

Substancës narkotike kanabis (mariuhan) që përmban tetrahidrokarabinol (THC), pesha neto e përgjithshme 10.66 gram, e sekuestruar nga i pandehuri më 26.03.2012.

⁵⁹⁵ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 365, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

V. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, kjo sasi e narkotikëve si në pikën IV të këtij aktgjykimi duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me Prokurorinë Themelore në Mitrovicë.

VI. Kërkesë pasurore-juridike nuk kishte.

Përmbajtja e aktgjykimit dhe dërgimi për palët – Fillimisht aktgjykimi i përpiluar ne formën e shkruare duhet që të jete ne përputhje te plote me aktgjykimin e shpallur. Kjo ka rëndësi pasi që kur aktgjykimi i shpallur publikisht nuk është ne përputhje me aktgjykimin e përpiluar ne forme te shkruar, mund te rezultojë me shkelje te procedurës penale, andaj dispozitat ligjore përcaktojnë përputhshmëri për te evituar shkeljen e dispozitave te procedurës penale. Aktgjykimi i përpiluar ne formën e shkruara përbëhet nga tri pjese që janë, *hyrja, dispozitivi dhe arsyetimi*.

Çfarë përmban hyrja e aktgjykimit: Shënimin se aktgjykimi merret ne emër te popullit, emrin e gjykatës, emrin e gjyqtarit te vetëm/ kryetarit te trupit gjykues dhe anëtarëve te trupit gjykues dhe te procesmbajtësit, emrin dhe mbiemrin e te akuzuarit, veprën penale që akuzohet i akuzuari, datën e mbajtjes se shqyrtimit gjyqësor, faktin se shqyrtimi gjyqësor ka qenë i hapur apo i mbyllur, emrin dhe mbiemrin e Prokurorit, mbrojtësit te te akuzuarit, përfaqësuesit ligjore apo përfaqësuesit te autorizuar që kane qenë te pranishëm ne shqyrtimin gjyqësore, datën e shpalljes se aktgjykimit dhe datën e përpilimit te aktgjykimit.

Qfare përmban dispozitivi: Dispozitivi ne kuptimin e përgjithshëm përmban te dhënat personale te te akuzuarit si dhe vendimin e marr lidhur me aktakuzën, ndërsa varësisht se çfarë aktgjykimi është marr, kur ka aktgjykim fajësues ndaj te akuzuarit atëherë dispozitivi i aktgjykimit duhet te përmbaj te gjitha siç kërkohen nga neni 365 i Kodit te procedurës penale që janë sqaruar si me sipër, ndërsa kur merret aktgjykim për disa vepra penale atëherë dispozitivi duhet te përmbaj po ashtu dënimet e shqiptuara veç e veç dhe caktimin e dënimit unik. Ndërsa kur është marre aktgjykim lirues apo aktgjykim refuzues, dispozitivi duhet te përmbaj përshkrimin e veprës për te cilën është akuzuar si dhe vendimin për shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike nëse ka pasur kërkesë pasurore juridike.

Çfarë përmban arsyetimi: Arsyet e aktgjykimit duhet te jepen për çdo pjese te vendosjes si dispozitiv te aktgjykimit, çka nënkupton se duhet te përmbaj arsyet për rrethanat dhe faktet kur kemi te bëjmë me aktgjykim fajësues duhet te arsyetohet po ashtu për dënimin, për konfiskimin, për shpenzimet e procedurës, për kërkesën pasurore juridike çka do te thotë se arsyet e aktgjykimit duhet te jene konkrete dhe te mjaftueshme për çdo pjese te vendimmarrjes. *Gjithnjë kur kemi te bëjmë me aktgjykimin fajësues gjykata ne arsyetim është e obliguar që, te paraqet ne mënyrë te qarte dhe te plote se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh konsideron se janë vërtetuar apo nuk janë vërtetuar, po ashtu ne mënyrë te qarte duhet te vlerësoj saktësinë e provave kundërthënëse (kjo nënkupton vlerësimin e kundërthënieve te provave lidhur me faktet duke konstatuar se cilave ua fale besimin dhe për çfarë arsyesh dhe si e ka vlerësuar provën tjetër që kishte kundërthënie e që nuk i ka dhënë besim provës se tillë dhe për çfarë*

arsyesh), gjithnjë duhet te jepen arsye lidhur me propozimin e palëve që gjykata i ka refuzuar (kjo nënkupton se arsyet si propozime që palëve që gjykata i ka refuzuar duhet te jepen në mënyrë të qartë nga se mos dhënia e arsyeve konsiston në arbitraritet të procesit nga gjykata andaj për këtë arsye edhe duhet te jepen arsye në arsyetim se perse nuk është aprovuar një propozim konkret i palëve në shqyrtim gjyqësor), po ashtu në arsyet e aktgjykimit duhet të përfshihen se si gjykata është bazuar në ato arsye për zgjidhjen e çështjeve juridike e veçanërisht lidhur me ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale dhe zbatimin e dispozitave të caktuara ndaj të akuzuarit (këtu përfshihet arsye që gjykata duhet të jep qofte për aspektin procedural apo material ligjore që nga palët janë ngritur në shqyrtimin gjyqësor, kur ka të bëjë me interpretimet e ndryshme që mund të lidhen me çështjet e fakteve apo provave qoftë në raport me dispozitat procedurale apo materiale). Po ashtu aktgjykimi duhet të përfshijë rrethanat që janë marre parasysh me rastin e caktimit të dënimit, rrethanat gjithnjë ato renduese janë shteruese (çka nënkupton se rrethanat renduese janë ato rrethana që kodi penal i ka përcaktuar), ndërsa rrethana lehtësuese nuk konsiderohen shteruese (çka nënkupton se mund të ketë rrethana që në një rast konkret mund të merren parasysh edhe kur nuk janë të cekura në dispozitat ligjore brenda kodit penal).

Duhet të kemi parasysh se gjykata mund të shqiptojë dënim me të rende se sa dënimi i parapare për veprën penale, dhe dënimi i tillë me i lartë mund të shqiptohet kur gjykata gjene se ka të bëjë me raste veçanërisht të rende si p.sh. (Recidivizmi i shumëfishtë), andaj gjykata duhet të arsyetojë se perse ka konsideruara si raste veqanarishte të rende, por njëkohësisht gjykata duhet veqanarishte të arsyetojë kur vlerëson se të akuzuarit duhet ulur dënimi në minimum apo të liroj të akuzuarin nga dënimi, apo të shqiptojë dënimin alternativ apo kur masën e trajtimit të detyrueshëm rehabilitues apo të konfiskimit të pasurisë (në të gjitha këto rrethana gjykata duhet të jep arsye të veçanta qëfarë nënkupton se arsyet e tillë kur jepen nuk mund të konsiderohen si arsye të përgjithësuar në aktgjykimin e gjykatës por duhet të arsyetohet se perse konsideron se ka arsye të veçanta për shqiptimin e dënimit të tillë.

Arsyet për konfiskimin e pasurisë: Në aktgjykim gjykata është e obliguar që çdo pasuri veç e veç të cilën e ka konfiskuar me aktgjykim duhet që të arsyetojë, shkaqet e konfiskimit duke i argumentuar ato me prova konkrete dhe rrethana që kanë qar në konfiskimin e pasurisë. Por gjykata është e obliguar që gjithsesi të jap arsye edhe për çdo pasuri që nuk e ka urdhëruara konfiskimin, çka do të thotë se gjykata duhet të arsyetojë kur një pasuri është propozuar në aktakuzë që të konfiskohet në raste se nuk ka urdhëruara konfiskimin e asaj pasurie duhet të jap arsye për shkaqet që nuk ka urdhëruara konfiskimin e pasurisë.

Arsyet e aktgjykimit me të cilin i akuzuari lirohet nga akuza: Arsyet e aktgjykimit të tillë duhet posaçërisht të jepen lidhur me bazën ligjore mbi të cilin i akuzuari është liruar nga akuza, pra arsyet lidhen varësisht nga fakti se a është liruar i akuzuari, për shkak se vepra penale nuk përbën vepër penale (e këtu veqanarishte duhet të argumentohet se mbi cilat fakte dhe rrethana gjykata ka konstatuar se vepra nuk përbën vepër penale, nëse aktgjykimi lirues merret mbi bazën se ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale atëherë gjykata veqanarishte arsyeton se mbi cilat fakte dhe rrethana në qfarë provash është mbështetur kur ka konstatuar se

ka rrethana qe përjashtojnë përgjegjësinë penale, ndërsa nëse është marr aktgjykim lirues për shkak se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale atëherë gjykata ne arsyetim te aktgjykimit paraqet se mbi cilat fakte dhe rrethane te mbështetura ne prova ka konstatuar se ato nuk provojnë qe i akuzuari ka kryer veprën penale.

Arsyet e aktgjykimit me te cilin refuzohet akuzat: Aktgjykimi refuzues nuk duhet te përmbaj asnjë rrethanë te arsyetimit qe do te nënkuptonte vlerësimin e çështjes kryesore çka do te thotë se aktgjykimi refuzues nuk lëshohet ne meritat e rastit lidhur me faktet dhe rrethanat qe pretendohet për veprën penale, por arsyet e aktgjykimit refuzues kufizohen vetëm ne arsyet e refuzimit te aktakuzës, çka nënkupton se nëse është tërhequr prokurori nga aktakuza, arsyet e refuzimit te aktakuzës duhet te jepen vetëm për faktin e tërheqjes qe mund te ndërliiden me parashtrësën e prokurorit qe ka njoftuar gjykatën se tërheqja nga akuzat apo me procesverbalin kur është konstatuar deklarimi i prokurorit mbi tërheqjen e akuzës, apo ne raste se kemi te bëjmë me çështjen e gjykuar me aktgjykim te formës se prerë për veprën penale përkatësisht kur kemi te bëjmë me aktvendim te formës se prerë me te cilin është pushuar aktakuza atëherë gjykata kufizohet vetëm ne faktin e arsyeve se ka te beje me veprën e njëjtë qe është gjykuar me aktgjykim te formës se prerë duke arsyetuar kohen e marrjes se aktgjykimit faktin se behet fjale rrethanat e njëjta për veprën e njëjtë penale dhe faktin se aktgjykimi i tillë është i formës se prerë përkatësisht se aktvendimi për pushimin e procedurës penale ka te beje me rrethanat e fakteve për veprën e njëjtë penale dhe se ai aktvendim është i formës se prerë. Po ashtu kur aktgjykimi refuzues është marr për shkak te parashkrimit te ndjekjes penale apo për shkak se vepra përfshihet ne amnistit apo falje gjykata ne arsyetim vetëm thekson rrethanat e parashkrimit duke arsyetuar afatin ligjore qe është parapare për rrjedhën e parashkrimit pe rate vepër penale si dhe duke konstatuar se kur ka arritur koha qe ka rrjedh afati i parashkrimit, përkatësisht faktin se vepra është amnistuar apo është falur apo rrethanat qe përjashtojnë ndjekjen penale duke arsyetuar shkaqet e tilla se çfarë janë ato rrethana.

Dërgimi i palëve: Aktgjykimi i cili shpallet publikisht, siç është theksuar me larte duhet qe te përpilohet brenda afateve ligjore. Kur aktgjykimi përpilohet duhet te nënshkruhet nga gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues dhe procesmbajtësi. Palëve nuk u dërgohet aktgjykimi i nënshkruara por i dërgohet kopja e vërtetuar e aktgjykimit e ne te cilën kopje është edhe udhëzimi për te drejtën ne ankesën e palëve. Po ashtu aktgjykimi duhet ti dërgohet edhe te dëmtuarit, dhe personit te cilit i është konfiskuar sendi. Përveç palëve me te drejte ankese dhe te dëmtuarit e personit qe i është konfiskuar sendi, gjykata kur shqipton dënimin unik bazuar edhe ne aktgjykimet e shqiptuara me aktgjykime te veçanta për veprat e caktuara penale ndaj te akuzuarit, atëherë aktgjykimin me te cilin shqiptohet dënimi unik duhet ti dërgohet edhe gjykatave qe sipas atyre aktgjykimeve individuale⁵⁹⁶.

⁵⁹⁶ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 370, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

NËNKAPITULLI V

MJETET JURIDIKE

Mjetet juridike janë mundësia e parashtrimit të palëve për të kërkuar kontrollin e procesit gjyqësor në shkallshmerite të gjykatës por jo domosdoshmërishtë vetëm procesin e tërësishëm mirëpo qofte edhe veprimin e caktuar që ka rezultuar me vendim për atë veprim procedural kur është nxjerrë vendimi. Çështjet e mjeteve juridike kanë si standard mundësinë e parashtrimit të tyre në dy forma, forma e parë është kur dispozitat ligjore lejojnë ankese të veçantë, kjo nënkupton se kur dispozita ligjore lidhur me një vendim lejojnë parashtrimin e mjetit juridik atëherë ai vendim mund të atakohet në procesin e vazhdueshëm të çështjes gjyqësore, ndërsa forma tjetër kur mund të parashtrohet mjeti juridik është kur parashtrohet mjeti juridik kundër vendimit me të cilin ka përfunduar çështja penale në gjykatën brenda shkallës së caktuar, çka nënkupton se kur merret një vendim me të cilin çështja penale përfundon në gjykatën e shkallës së parë, atëherë mjeti juridik kur parashtrohet nga palët mund të godet edhe çdo vendim që është marrë gjatë fazës së procedimit e për të cilat vendime nuk është lejuar ankesa e veçantë.

Mjetet juridike po ashtu shkaktojnë disa efekte, efektin suspensiv, efektin remonstrativ dhe efektin devolutiv: Efekti suspensiv nënkupton se vendimi i cili atakohet me mjetin juridik të caktuar mund të ketë shtyrje të fillimit të zbatimit të efektit të vendimit, ndërsa ky efekt shtrohet vetëm kur dispozita ligjore ka përcaktuar specifikisht se ankesa nuk krijon shtyrjen e zbatimit të vendimit. Pra efekti suspensiv nënkupton në thelb zbatimin e vendimit përkundër se vendimi i tillë është atakuar dhe përkundër se vendimi i tillë ende nuk ka marrë formën e prerë, nga se në parim vetëm vendimet e formës së prerë bëhen edhe të zbatueshme, andaj në procedurën penale ka përjashtime që një vendim fillon të zbatohet përkundër faktit se nuk është i formës së prerë e përkundër faktit se vendimi është atakuar me ankese. Efekti remonstrativ nënkupton kur në raport me mjetin e juridik të parashtruar nga palët vendos për nga shkallshmeria organi i njëjti i cili e ka nxjerrë vendimin, psh. Kundër një vendimi të nxjerrë nga gjyqtari i procedurës paraprake ai mund të atakohet me ane të kundërshtimit pranë gjykatës së njëjtë por të kolegji shqyrtues. Ndërsa efekti devolutiv i mjetit juridik nënkupton kur mjeti juridik i parashtruar nga palët duhet të vendoset në nivel tjetër të organit dhe jo brenda atij organi që e ka nxjerrë vendimin, kjo nënkupton që vendimet e tillë shqyrtohen në procedurën penale brenda gjykatës së shkallës së dytë si gjykate me kompetence, prandaj mjeti juridik krijon efektin e tillë devolutiv.

Llojet e mjeteve juridike – Llojet e mjeteve juridike që sipas dispozitave të kodit të procedurës penale të lejuara janë: Kundërshtimi që mund të parashtrohet kundër urdhrave të gjyqtarit të procedurës paraprake, Ankesa që për nga llojet e vendimeve mund të parashtrohet kundër Aktvendimit dhe kundër Aktgjykimit, Mjetet e jashtëzakonshme juridike të cilat janë - a). Kërkesa për rishikimin e procedurës penale, b). Kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, c). Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Përmbajtja e mjeteve juridike – mjetet juridike për tu konsideruara te rregullta, kanë disa elemente që domosdoshmerishte duhet ti përmbajnë. Ato duhet të kenë të dhënat e palës që e parashtron apo të mbrojtësit nëse mjete juridik parashtronet nga mbrojtësi qoftë i të akuzuarit apo përfaqësuesi i të dëmtuarit. Po ashtu duhet të evidentohet akti përkatësisht vendimi ndaj të cilit parashtronet mjete juridik – kjo zakonisht bëhet duke përcaktuar shenjen e aktit ndaj të cilit parashtronet mjete juridik, po ashtu duhet të përmbajë bazën ligjore për të cilat parashtronet mjete juridik, po ashtu duhet të përmbajë pjesën e arsytimit apo të narratives së fakteve që pretendohet të argumentohet se mjete juridik është juridikisht i paqëndrueshëm, po ashtu mjete juridik duhet të përmbajë pjesën e propozimit që pala kërkon nga organi që shqyrton mjetin juridik, gjithsesi mjete juridik duhet të përmbajë edhe elementet teknike e që janë nënshkrimi dhe data e parashtruesit të mjetit juridik. Mungesa e këtyre elementeve të mjetit juridike do të nënkuptonte që mjetet e parashtruara janë jo të rregullta dhe do të mund të kërkohej nga pala që të plotësohet mjete juridik brenda afatit gjyqësor që gjykata i kërkon palës.

Kundërshtimit si mjet juridik: Kundërshtimi si mjet juridik me anë të se cilit goditet vendimi në procedurën penale, duhet të përmbajë, Numrin e lendes, emrin e të pandehurit, përshkrimin e statusit ligjor të lendes (kjo nënkupton që duhet përshkrimi i statusit mbi të cilin ka rezultuar aktvendimi i cili goditet me anë të kundërshtimit), përshkrimin e fakteve të rëndësishme që janë të përfshira në procesverbal (duhet të kemi parasysh se faktet e rëndësishme jo gjithnjë janë në procesverbal të theksuara andaj këtu duhet pasur parasysh që kjo pjesë konsiston në faktet e rëndësishme të çështjes penale në raport me vendimin e ankimuar e që pala konsideron se faktet e rëndësishme janë ndryshe apo faktet e rëndësishme nuk janë vetëm ato çfarë janë arsyetuar në vendimin i cili atakohet këtu hynë po ashtu edhe rrethana e faktit se kundërshtimi është brenda afatit ligjor), përshkrimin e bazës ligjore (këtu duhet nënkuptuar bazën ligjore që pretendohet se vendimi ka cenuar qoftë ajo materiale apo procedurale apo të ndërlidhura së bashku në raport me procedurën e ndjekur dhe rrethanat e fakteve) përshkrimin e vendimit që kërkohej (kjo ndërlidhet me propozimin që pala e parashtron dhe që kërkon nga organi që shqyrton mjetin juridik që ta marrë vendimin e propozuar bazuar në pretendimet e kundërshtimit). Kundërshtimi i cili është i plotë duhet të parashtronet në gjykatën themelore e cila duhet të ia dërgoj palës së kundërt kundërshtimin e tillë⁵⁹⁷.

Ankesa kundër aktvendimit – ankesa kundër aktvendimit duhet të përmbajë, numrin e lendes, të dhënat e palës që parashtron ankesën, aktvendimin i cili kundërshtohet, bazën ligjore për pretendimet që janë se cilat dispozita ligjore janë cenuar, qofshin ato të aspektit material apo të aspektit procedural në raport me rrethanat e rastit dhe provat që ndërlidhen me ato rrethana. Elaborimin e arsyeve që pretendohet se vendimi është juridikisht i paqëndrueshëm që konsiston në sqarimet që pala konsideron se vlerësimi i gjykatës që ka marrë aktvendimin nuk gjene mbështetje në provat e çështjes penale për rrethanat që pretendohet se ekzistojnë, propozimin që pala e parashtron për vendimin e caktuar në kuadër të ankesës.

⁵⁹⁷ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 376, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

Ankesa kundër aktvendimit ne parim gjithnjë kur ushtrohet vendoset nga gjykata e shkalles se dyte pra nga gjykata e apelit përjashtimisht kur kodi i procedurës penale

përcakton se ndaj aktvendimit është kompetente për te vendosur kolegji shqyrtues i te njëjtës gjykate.

Afatet e ankesës kundër aktvendimit: Afati i përgjithshëm i ankesës kundër aktvendimit është 3 dite ky konsiderohet edhe afat i përgjithshëm i ankesës kundër aktvendimit, ndërsa afatet e veçanta kundër aktvendimit janë te ndryshme, e qe janë: a), afati i ankesës kundër aktvendimit për caktimin e masës se sigurisë se te pandehurit ne procedure është 24 ore, b). Afati i ankesës kundër aktvendimit me te cilin gjykata ka vendosur lidhur me kundërshtimet e aktakuzës apo provave është 5 dite, c) afati i ankesës kundër aktvendimit te gjyqtarit te procedurës paraprake dhe aktvendimit te kolegjit shqyrtues kur janë te lejueshme paraqiten ne afat prej 5 ditësh. Duhet te kemi parasysh se afatet e veçanta për parashtrimin e ankesës gjithnjë rregullojnë një situatë specifike te ankimimit te vendimit qe goditet, dhe ne çdo raste kur nuk është parapare afat i veçantë për ankesën qe mund te paraqitet kundër një aktvendimi atëherë duhet gjithnjë te vlerësohet se a është parashtruara ankesa brenda afatit te lejuar sipas afatit te përgjithshëm⁵⁹⁸.

Procedura e paraqitjes se ankesës: Ankesa e paraqitur nga pala e autorizuar qe paraqitet kundër aktvendimit duhet te paraqitet ne gjykatën themelore qe është marr aktvendimi, këtë ankese pasi qe gjykata e pranon duhet qe ta regjistroj dhe te njëjtën një kopje ia dërgon palës se kundërt, pas pranimit te përgjigjes se palës se kundërt atëherë gjykata e dërgon ankesën dhe te gjitha shkresat e lendes për te vendosur, qoftë brenda kolegjit shqyrtues kur është kompetent qe te vendos kolegji apo edhe ne gjykatën e shkalles se dyte/gjykatën e apelit pre te vendosur nga gjykata kompetente lidhur me ankesën e tillë⁵⁹⁹.

Ankesa kundër aktgjykimit – ankesa kundër aktgjykimit fillimisht shkakton gjithmonë efektin suspensiv te aktgjykimit te ankimuar. Ankesa është mjete juridik i rregullt me ane te se cilit pala qe ka te drejtë për te parashtruar ankesën e ushtron atë te drejtë duke qenë se nuk pajtohet me aktgjykimin e marr dhe pajtueshmëria e tij konsiston ne pretendimet qe pala i vlerëson se ne marrjen e aktgjykimit ka te meta juridike qe janë lëshuar nga gjykata.

Afati i ankesës është përcaktuar 15 dite i cili afat rrjedh nga dita kur pala e pranon aktgjykimin kjo është parapare sipas nenit 380 te KPP-es⁶⁰⁰, ndërsa palët e autorizuara qe mund te parashtrojnë ankese kundër aktgjykimit janë: a). Prokurori i shtetit – i cili mund ete paraqes ankese si ne dëme ashtu edhe ne dobi te te akuzuarit, b). I akuzuari përkatësisht përfaqësuesi ligjor i tije dhe mbrojtësi i tije – asnjeri nga këta nuk kane ndonjë kufizim shprehimorë për te drejtën e ankimimit, c). I dëmtuari – ka kufizime shprehimorë se mbi cilat rrethana mund te parashtroj ankese vetëm për sa i përket sanksionit penal dhe atë vetëm për tri kategori te veprave - 1, veprat penale kundër jetës dhe trupit, 2, veprat penale kundër integritetit seksual dhe 3, veprat penale kundër sigurisë se trafikut publik. Ndërsa te drejte ankese ka po ashtu

⁵⁹⁸ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 409, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁵⁹⁹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 411, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

⁶⁰⁰ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 380, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

personi fizik apo juridike pasuria e te cilit është konfiskuar, e drejta e këtyre personave shtrohet vetëm ne raport me vendimin për konfiskimin e pasurisë qe nënkupton edhe aspektet procedurale për konfiskimin dhe nuk mund te ushtrohet e drejta e ankesës për aspekte te tjera kundër aktgjykimit.

Ankesa kundër aktgjykimit duhet te përmbaj, te dhënat e aktgjykimit kundër te cilit parashtrohet ankesa, arsyet për kundërshtimin e aktgjykimit – kjo nënkupton aspektet e bazave ligjore qe pretendohet nga pala se janë si arsye për ankimimin e aktgjykimit, propozimin lidhur me aktgjykimin e ankimuar qe nënkupton qoftë propozimin për anulimin e aktgjykimit apo për ndryshimin e aktgjykimit te ankimuar, si dhe nënshkrimin e palës qe parashtron ankesën. Ankesës po ashtu i bashkëngjiten edhe prova te reja dhe fakte te reja qe mund te konsiderohen se janë te rëndësishme për rrethanat e çështjes penale, ne këtë kuptim bashkëngjitja e provave te reja dhe paraqitja e fakteve te reja ne ankesë mbart një detyrim qe ne ankesë te behet te ditura shkaqet se perse provat e tilla dhe faktet e reja nuk janë paraqitur me pare – arsyeja e mundësimit te paraqitjes se fakteve te reja ne ankesë është ne përputhje edhe me detyrimet e gjykatës për te vërtetuar drejte dhe ne mënyrë te plote gjendjen e fakteve por parashtruesi i ankesës qe paraqet faktet e tilla te reja duhet ti paraqet edhe provat me te cilat konsideron se provohen faktet e tilla, ndërsa kur paraqet prova te reja atëherë ka detyrim qe te arsyetoj se cilat fakte pretendon ti provoj me provat e reja, ne këtë kuptim kur kemi paraqitje te fakteve shitesë dhe provave te reja ankesa detyrimisht duhet te ketë ne pjesën e arsyetimit te saj aspektet e se cilave elaborojne faktet e reja dhe provat me te cilat pretendohet qe te provohen ato fakte si dhe elaborimet e provave te reja se ne raport me cilat fakte pretendohet qe ato provojnë faktin konkret.

Gjithsesi ankesa ka një kufizim se mbi çfarë bazash mund te parashtrohet ankimimi i ankuesit, e kjo ndërlidhet me rrethanën se pretendimi i tillë a është ngritur me pare nga ana e ankuesit (qofte ne shqyrtim fillestar, shqyrtim te dyte apo shqyrtim gjyqësor), ne ankesë arsyetimet e tillë kur nuk janë paraqitur me herët mund te paraqiten vetëm nëse për shkaqe te jashtëzakonshme argumentohet se nuk është mundur qe te paraqiten apo për shkaqe kur rezultojnë se ka fakte dhe provat e reja qe domosdoshmërisht ato arsyetojnë paraqitjen e pretendimeve te cilat nuk janë paraqitur me pare.

Gjykata duhet te ketë parasysh se kur parashtrohet ankesë nga i pandehuri apo i dëmtuari qe nuk përfaqësohen nga mbrojtësi, dhe kur ankesa ka te meta te tilla qe nuk mund te identifikohet aktgjykimi apo te dhënat lidhur me çështjen penale mungojnë apo te dhënat lidhur me palën apo nuk mund te identifikohen pretendimet qe parashtrohen ne ankesë, atëherë gjykata ka për detyrim qe ta thërras parashtruesin e ankesës qe ta plotësoj ankesën me te dhënat e munguara, ne raste se ankesa nuk plotësohet atëherë gjykata e hedhe ankesën nëse nuk mund te kuptoj nga ankesa e tillë për te dhënat lidhur me aktgjykimin për bazat e ankimimit për pretendimet e palës. Këtu dispozitat ligjore nuk përcaktojnë se hedhja a behet me baze te parregullsisë se mjetit juridik, apo me ndonjë baze tjetër, megjithatë konsiderojmë se duhet te hedhet si e parregullt nga se ne kuptimin e interpretimit sistematik te dispozitave te ankesës ku krijohet

baza ligjore për hedhjen e ankesës që nuk plotësohet sipas kërkesës së gjykatës atëherë rezulton se ajo hedhet pikërisht për shkak se si e tillë është e parregullt.

Bazat ankimore kundër aktgjykimit – Bazat ankimore të aktgjykimit apo thënë ndryshe arsytet për ankesën kundër aktgjykimit janë të përcaktuara në kuadër të dispozitave ligjore të KPP-ës. Sipas nenit 383 parashihen katër baza apo arsye për aktgjykimin e që janë: a). Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, b). Shkeljet e ligjit penal, c). Vërtetim të gabuar ose jo të plote të gjendjes faktike, d). vendimit mbi sanksionin, konfiskimin, shpenzimet e procedurës penale, kërkesave pasurore juridike dhe vendimit për publikimin e aktgjykimit⁶⁰¹.

Shkeljet e dispozitave të procedurës penale: shkeljet e dispozitave të procedurës penale nënkuptojnë cenimin e dispozitave mbi të cilat duhet zhvilluar procedura penale dhe për pasojë për shkak të cenimit të atyre dispozitave atëherë vendimi nuk mund të qëndrojë juridikisht. Në këtë kuptim shkeljet e dispozitave të procedurës penale, në esencë mund të ndahen në dy kategori kryesore, a). Shkeljet e dispozitave të procedurës penale me karakter absolut dhe b). Shkeljet e dispozitave të procedurës penale me karakter relativ.

Shkelja e dispozitave të procedurës penale me karakter absolut – cenimi i dispozitave të tilla nënkuptojnë që aktgjykimi i ankimuar nuk mund të jetë i qëndrueshëm juridikisht nga fakti se dispozitat ligjore të cilat numërojnë natyrën e shkeljeve me karakter absolut mbështeten në prezumimin ligjorë të pa - rrëzueshëm çka nënkupton se kur është cenuar ndonjë dispozite ligjore që është e karakterit të shkeljes me natyrë absolute është e mjaftueshme për palën që ta theksojë në ankesën e parashtruar në aktgjykim dhe nëse ekziston një shkelje e tillë prezumimi ligjorë është se shkelja e tillë vetvetiu nuk e lejon aktgjykimin e ankimuar të jetë i qëndrueshëm nga fakti se për shkak të asaj shkelje vendimi është me efekt negativ në procedurë për garancitë procedurale që i krijon kodi i procedurës penale, madje për shkak të rëndësisë që kanë dispozitat ligjore që përcaktojnë se kur veprohet në kundërshtim me ato dispozita ajo përbën shkelje me karakter absolut e për shkak të krijimit të garancive procedurale kodi ka përcaktuar që për disa nga këto shkelje sipas detyrës zyrtare ka obligim që të vlerësojë gjykata e shkalles së dytë me rastin e shqyrtimit të ankimit të parashtruar kundër aktgjykimit Shkeljet e dispozitave të procedurës penale me karakter absolut janë në mënyrë taksative të numëruara në kuadër të nenit 384 paragrafi 1 i Kodit të Procedurës penale, ndërsa shkeljet që detyrimisht sipas detyrës zyrtare duhet të shqyrtojë gjykata e shkalles së dytë kur shqyrton ankesën kundër aktgjykimit janë të parapara në nenin 394 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i kodit të procedurës penale.

Shkelja e dispozitave të procedurës penale me karakter relativ – cenimi i dispozitave të tilla nuk kanë karakterin e prezumimit ligjorë se me rastin e cenimit të rezultojë aktgjykimi i paqëndrueshëm juridikisht, kjo nënkupton se me rastin e parashtrimit të ankesës me bazën e arsytet se shkeljes së dispozitave të procedurës penale kur ato konsistojnë në shkelje të karakterit relativ, atëherë pala duhet të argumentojë se shkelja e tillë ka konsistuar në marrjen e

⁶⁰¹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 383, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

aktgjykimit qe nuk mund te qëndroj juridikisht. Ne kuptim te shkeljes se dispozitave te kodit te procedurës penale me karakter relativ ne çdo raste pretendimi i shkeljes duhet te vërtetohet, dhe barra e argumentimit te shkeljes se tillë i bie palës qe ka ngritur pretendimet e tillë ne ankesë, rrjedhimisht shkeljet e dispozitave te procedurës penale mund te konsiderohen shkeljet e dispozitave qe konstatohet se për shkak te masës dhe natyrës se shkeljes mund te rezultojë se kanë ndikuar apo kane mundur te ndikojnë ne aktgjykimin e marr.

Me konkretisht dispozita nga neni 384 paragrafi 1, përcakton kuptimin e kategorive te shkeljes procedurale qe kanë efekt relativ si te tilla, ndërsa duke qenë se shkeljet me karakter relativ nuk konsiderohen te prezumuara ligjërisht për te konstatuar se aktgjykimi për ato shkelje nuk mund te jete i qëndrueshëm atëherë, shkeljet me karakter relativ gjithnjë duhet te jene objekt i ankesës dhe se gjykata nuk detyrohet qe te shqyrtoj zyrtarisht shkeljet me karakter relativ.

Shkelja e ligjit penal: nënkupton shkeljen e dispozitave te karakterit material qofshin ato dispozita te kodit penal apo dispozita qe me ligjet e veçanta është inkriminuar veprimi apo mosveprimi i caktuar si vepër penale. Shkelja e ligjit penal konsiston ne mos zbatimin e dispozitave materiale apo zbatimin e gabuar te dispozitave materiale ne çështjen penale konkrete e cila shqyrtohet nga gjykata. Shkelja e ligjit penal nuk duhet nënkuptuar se ekziston vetëm kur është cenuar konkretisht norma ligjore qe inkriminon veprën e caktuar penale por se shkelja e ligjit penal është ne kuptimin me te gjere kur gjykata edhe dispozitat e pjesës se përgjithshme te kodit penal i zbaton gabimisht apo nuk i zbaton fare ne rastin konkret. Se çfarë konsiderohet shkelje e ligjit penale dispozita nga neni 385 ka parapare gjashte rrethana qe mund te rezultojë shkelja e ligjit penal, e te tillë janë:

- a) Vepra për te cilin i akuzuari ndiqet nuk përbën vepër penale,
- b) Ekzistojnë rrethana qe përjashtojnë përgjegjësinë penale,
- c) Kur ekzistojnë rrethana qe përjashtojnë ndjekjen penale siç mund te jene parashkrimi, amnistia, falja ose vepra penale është e gjykuar,
- d) Kur për veprën penale te gjykuar është zbatuar ligji i cili nuk mund te zbatohet,
- e) Kur për marrjen e vendimit mbi dënimin ose dënimin alternativ, vërejtjen gjyqësore, ose masën e trajtimit te detyrueshëm për rehabilitim apo konfiskimin e dobisë gjykata ka tejkualuar kompetencat ligjore,
- f) Janë shkelur dispozitat mbi llogaritjen e paraburgimit dhe dënimin te mbajtur. Duhet te kemi parasysh se shkelja e ligjit penal ne kuptim te shqyrtimit te ankimimit nga gjykata e shkalles se dytë është shqyrtim sipas detyrës zyrtare kur zbatimi është ne dem te te akuzuarit, ndërsa evitimi i kësaj shkelje kur është ne favor te te akuzuarit mund te behet vetëm me ane te pretendimeve ankimore, ne te kundërtën nëse nuk ka pretendime te tilla ankimore dhe shkelja e ligjit penal për gjykatën e shkalles se dyte rezulton se është ne favor te te akuzuarit atëherë gjykata vetëm konstaton dhe nuk mund ta ndryshoj vendimin ne dem te te akuzuarit ne mungesë se ankesës, por edhe gjykata supreme sipas mjeteve juridike kur konstaton zbatim te ligjit penal ne dem te te akuzuarit vetëm konstaton dhe nuk krijon efekt negativ me pasoja për te akuzuarin.

Vërtetimi i gabueshëm apo jo i plote i gjendjes faktike: për te kuptuar me saktësi këtë bazë ankimore duhet që të kuptojmë në esencë faktin e fakti nënkupton çdo ngjarje çdo rrethanë që pretendohet se ka ndodhur, ndërsa në kuptimin juridik dallojmë faktet relevante dhe faktet e tërthorta. Në këtë kuptim për çështjen e ankimit nga kjo bazë ligjore, duhet të kemi parasysh se rëndësi kanë të bëjnë faktet e çështjes mbi bazën e të cilave konstituohen elementet e veprës penale dhe si të tilla ato konsiderohen faktet relevante përkatësisht faktet e drejtpërdrejta, ndërsa faktet e tërthorta mund të jenë të rëndësishme qoftë për të vërtetuar aspektet që mund të ndërliken me çështjen e fakteve relevante të drejtpërdrejta në kuptimin e formësimit të tërësishëm të elementeve të veprës penale apo në raport me çështjen penale që mund të ketë ndikim fakti i tillë i tërthortë për marrjen e vendimit të drejt nga gjykata.

Në këtë kuptim vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike nënkupton kur gjykata nuk e ka vërtetuar ndonjë fakt të rëndësishëm, (kjo duhet kuptuar se jo për çdo fakt duhet konsideruara vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike por vetëm për faktet e rëndësishme çka nënkupton se faktet e rëndësishme janë qofshin të tilla të theksuara relevante por faktet e rëndësishme mund të jenë edhe faktet e tërthorta), por vërtetimi i gabuar konsiderohet edhe kur nga përmbajtja e dokumentit apo procesverbalit mbi provat e shqyrtuara mund të vihet në mëdyshje saktësia ose bazueshmëria për vërtetimin e faktit të caktuar, (mëdyshja mbi saktësinë për vërtetimin e faktit gjithmonë konsiston në dokumentin që nuk mund të konsiderohet i plotë në kuptim të vërtetimit të atij fakti pikërisht për shkak të mëdyshjeve mbi saktësinë e atij dokumenti, ndërsa bazueshmëria mund të ndërliket me dyshimin e saktësisë por mund të konsiderohet edhe si rrethanë e vetme në kuptim që dokumenti apo procesverbali mbi shqyrtimin e provave nuk krijon mbështetje të bazueshme për vërtetimin e faktit të rëndësishëm.

Përderisa vërtetimi i gabuar siç u theksua rezultoi kur gjykata ka vërtetuar gabimisht një fakt të relevant apo të tërthortë, është tërësisht e kundërta rrethana kur gjykata nuk ka vërtetuar ndonjë fakt të rëndësishëm, në këtë kuptim mos vërtetimi i faktit të rëndësishëm është shkallë më e lartë e të metës faktike nga se këtu gjykatës lëshimi i rezultoi se fakti i tillë nuk është vërtetuar fare dhe jo se ka ndonjë gabim të vërtetimit të faktit, në këtë kuptim mos vërtetimi i ndonjë fakti të rëndësishëm rrjedh kur ato si të tilla kanë ekzistuar por gjykata si ka marrë parasysh apo i ka anashkaluar përkundër se kanë pasur relevancë për çështjen konkrete penale. Megjithatë jo gjithmonë vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike rezultoi si e metë apo lëshim nga gjykata nga se gjykata shpesh herë mund të mos jetë fare në dijeni se faktet e tilla kanë ekzistuar apo provat në raport me faktet e tilla për tu vërtetuar të kenë ekzistuar, rrjedhimisht kodi ka parapare institutin e njohur “beneficium novorum” në kuptim të paraqitjes së provave dhe fakteve të reja në ankese, i jep mundësinë gjykatës së shkallshmerise, që në rrjedhën e vendosjes së çështjes sipas ankesës të merret për bazë edhe faktet apo provat që gjykata e shkallës së parë fare mund të mos ketë qenë në dijeni se ato ekzistojnë.

Bazat ankimore kundër aktvendimit – Aktvendimi po ashtu mund të ankimohet me ankese, qoftë aktvendimi që është marrë nga gjyqtari i procedurës paraprake, apo kolegji shqyrtues kur dispozitat ligjore parashohin se aktvendimi mund të ankimohet, si dhe aktvendimet që merren nga gjyqtari i vetëm gjykues apo trupi gjykues, dhe për këto aktvendime vendose gjykata e

apelit. Bazat për ankimimin kundër aktvendimit, mund të thuhet se janë me të zgjeruara në kuptimin juridike se sa edhe vet bazat e ankimimit kundër aktgjykimit. Me saktësisht dispozita nga neni 415 i kodit të procedurës penale, ka përcaktuar se bazat ligjore për ankimim janë:

a). Shkelja e të drejtës me të cilën është njohur si e drejte me kushtetutën e Kosovës (kjo bazë ligjore është shumë e gjere nga se dispozitata kushtetuese kanë një mori të drejtash që kanë efekt në kuptimin e të drejtës së palës në procedurën penale por jo vetëm pasi që vet kushtetuta ka një mori konventash që janë të zbatueshme drejtpërdrejt dhe se normat e atyre konventave janë për të drejtat e njeriut që ngërthejnë edhe të drejtën e palëve në procedurën penale e që mund të thirren në cenimin e të drejtave të tilla megjithatë gjykata kur vlerëson se është cenuar ndonjë e drejte kushtetuese e palës nuk lëshohet në kuptimin e interpretimit të asaj dispozite kushtetuese pasi që nuk ka kompetence të bëjë një veprime të tillë por vetëm vlerëson se e drejta e tillë a është cenuar në raport me normën kushtetuese që e njeh si të drejte),

b). Shkeljen e të drejtës së palës të parapare me kodin e procedurës penale (këtu duhet pasur parasysh se baza ligjore për kundërshtimin e aktvendimit në kuptimin procedural është shumë e gjere, e që hyjnë edhe bazat specifike që janë parapare vetëm për aktgjykimin, por që njëkohësisht edhe për cenimin e cilësdo të drejte që palës i njihet sipas kodit të procedurës penale, kjo nënkupton se baza nga aspekti i kodit të procedurës penale është shumë me e gjere),

c). Shkeljen thelbësore të palës që është parapare me ndonjë ligje në fuqi (edhe kjo bazë ligjore përfshinë legjisllacionin në tersin e sistemit juridik të vendit e që është shumë e gjere si në kuptimin juridik, dhe ligjet e tilla mund të jene qofte materiale/procedurale, nga se disa ligje të veçanta kanë rregullimin material dhe procedural),

ç). Shkeljen e të drejtës procedurale që ka për qëllim garantimin e të drejtës nga bazat e theksuara, (kryesisht kjo bazë ligjore ka të bëjë me cenimin e ndonjë të drejte që është e garantuar proceduralisht e që si e drejte e tillë garantohet në procedure por për efekt të realizimit të të drejtës që është e drejta që i njihet me Kushtetutë, e drejta që i njihet me kodin e procedurës penale dhe e drejta që i njihet me cilindo ligj që është në fuqi raste që do të mund të konsiderohej p.sh. Propozimi i të pandehurit për marrjen e provës jashtë vendit, kur prokurori refuzon një propozim të tillë të të pandehurit atëherë ai mund të ketë cenuar këtë bazë ligjore si e drejte procedurale e palës për të realizuar të drejtën e tij ligjore për marrjen e provës).

Kur parashtrohet ankesa nga cilado bazë e tillë ligjore por edhe kur parashtrohet nga të gjitha bazat ligjore, pala që e parashtron ankesën ka detyrim që të argumentoj në ankese se shkelja e të drejtës së tij do të shkaktoj dëm të pariparueshëm⁶⁰².

Menyrat e vendosjes sipas mjeteve juridike të rregullta

Gjykata në nivel të shkallëshmerise së dyte dhe të shkallëshmerise së tret kur është e lejuar ankesa në nivel të gjykatës Supreme, vendoin në dy forma,

⁶⁰² Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 415, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

a). ne seance kolegji dhe

b).ne seance te shqyrtimit.

Seanca e kolegjit – Seanca e kolegjit mbahet vetëm ne gjykatën e shkalles se dyte dhe gjykatën e shkalles se tret kur lejohet ankesa si mjet i rregullt juridik, rrjedhimisht seanca e kolegjit ne raport me vendosjen e ankesës kundër aktvendimit, ne parim mbahet pa prezencën e palëve, ndërsa seanca e kolegjit por jo gjithherë mbahet me prezencën e palëve, dhe kjo seance ka synimin qe te dëgjohen drejtpërdrejt pretendimet ankimore te palëve nga kolegji i gjykatës. Seanca e kolegjit me prezencën e palëve mbahet kur kemi te bëjmë me dënimin me burgim sipas dispozitës nga neni 390 i KPP-ës, ndërsa sipas standardit kushtetues qe është krijuar me aktgjykimin e gjykatës kushtetuese KII04/16 i datës 04.gusht.2017, palët po ashtu duhet njoftuar për seancën e kolegjit edhe ne çdo raste kur ne ankesë ngritën rrethana për çështjen e fajësisë, qfarë nënkupton se aktgjykimi i gjykatës kushtetuese ka zgjeruara te drejtën e palëve për te marre pjese ne seancën e kolegjit jo vetëm kur ka aktgjykim me te cilin është shqiptuar dënimi me burgim por edhe ne çdo raste kur pretendohet ne ankesë çështja e fajësisë, dhe rrjedhimisht gjykata ne çdo raste te tillë duhet te njoftoj palët për seancën e kolegjit.

Përkundër faktit se palët njoftohen, dhe atë Prokurori, i pandehuri, mbrojtësi i te pandehurit, i dëmtuari apo përfaqësuesi i tije, përkundër se palët njoftohen mungesa e te gjitha palëve apo mungesa e ndonjërit nga ta nuk është pengesë për gjykatën qe te mbaj seancën e kolegjit por kushti për mbajtjen e seancës është qe te jene njoftuar ne mënyrë te rregullt për seance. Seanca e kolegjit mbahet duke konstatuar prezencën e palëve, duke njoftuar çështjen qe është objekt shqyrtimi (dhe objekt shqyrtimi është gjithnjë vendimi qe është goditur me ankesë), duke konstatuar përbërjen e kolegjit dhe njoftimin e kolegjit para palëve, konstatohet nëse palët kanë vërejtje apo kërkesa për përjashtim. Seanca fillon duke e referuara çështjen penale nga gjyqtari referues, i cili referon mbi faktet e çështjes dhe po ashtu mund te kërkohet qe ne raport me ato fakte te lexohet ndonjë nga shkresat e lendes qe ndërlidhet me ato fakte për te dhënë shpjegime te nevojshme lidhur me ato fakte.

Pasi te përfundoj referimi i çështjes nga gjyqtari palët mund te elaborojn pretendimet por edhe mund te kërkohet nga palët sqarimi i ndonjë pretendimi ankimor. Per tere seancën mbahet procesverbal, ku konstatohen te gjitha këto veprime procedurale ne seancën e kolegjit. Ne seancën e kolegjit po ashtu kolegji mund te marr vendim për hapjen e shqyrtimit gjyqësor, e nëse nuk merr vendim te tillë pas paraqitjes se pretendimeve dhe elaborimeve te palëve, kolegji konstaton se seanca ka përfunduar dhe pastaj tërhiqet për vendosje, dhe me rastin e marrjes se vendimit ne raport me ankesën lënda i dërgohet gjykatës se shkalles se pare e cila ka komunikimin shkresore me palët duke dërguar vendimin e gjykatës tek palët⁶⁰³.

Seanca e shqyrtimit – Kolegji ne çdo rast kur konsideron se aktgjykimi i ankimuar rezulton vërtetim i gabuar apo jo i plote i gjendjes faktike, dhe mbi bazën e provave qe ekzistojnë ne shkresat e lendes apo mbi bazën e marrjes se ndonjë prove qe konsideron se është e nevojshme

⁶⁰³ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 414, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

apo duke disponuar me provën që i është bashkangjitur ankesës, atëherë mund të hapet seancën e shqyrtimit.

Ne seancën e shqyrtimit gjyqtari referues referon rrethanat e fakteve duke mos dhënë mendimin e tij mbi besueshmërinë e ankesës. Por në seancën e shqyrtimit mund edhe të lexohet i tere aktgjykimi i ankimuar dhe procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, dhe kjo bëhet qoftë sipas detyrës zyrtare apo sipas propozimit të palëve, kjo bëhet me qëllim që të trajtohet çdo aspekt i bazës ligjore të ankimit që është pretenduar nga palët. Pas referimit të palëve arsyetojnë pretendimet ankimore para kolegjit – kjo konsiston në argumentet e bazuara në ankesën e parashtruar në raport me rrethanat e çështjes dhe provat që janë administruar, po ashtu palët mund të paraqesin edhe prova të reja kur hapet seanca e shqyrtimit të cilat prova duhet administruara, duke mundësuar palëve të kundërta që të japin qëndrimin lidhur me provat e marra, kjo nuk e pengon gjykatën që të thërret edhe dëshmitar për të dëgjuar dhe në rast të tilla zbatohen dispozitat ligjore të marrjes në pyetje të dëshmitarëve nëse paraqitet nevoja që në seancën e shqyrtimit të dëgjohen dëshmitarë. Karakteristikë është se prokurori pas që vlerëson rezultatet në seancën e shqyrtimit ai mund të tërhiqet në tersi nga aktakuza, apo ta ndryshoj atë në dobi të të akuzuarit, në situatë të tillë kur prokurori tërhiqet nga aktakuza atëherë gjykata detyrimisht duhet ta refuzoj aktakuzën e tillë, duke e ndryshuar aktgjykimin e ankimuar.

Çështja e tërheqjes nga aktakuza rezulton që, prokurori ka mundësi të tërhiqet nga aktakuza vetëm kur hapet seance e shqyrtimit, pasi që dispozita nga neni 52 parasheh që në gjykatën e shkallës së parë mund të tërhiqet prokurori nga ndjekja penale vetëm kur kodi i procedurës penale e parasheh shprehimisht, dhe neni 393 paragrafi 5, ka përcaktuar se prokurori mund të tërhiqet nga aktakuza e kjo rezulton vetëm pas vlerësimit që rezulton në seancën e shqyrtimit, ndërsa në praktiken gjyqësore njihen edhe rastet kur fare gjykata e apelit nuk ka hapur seance të shqyrtimit dhe prokurori përmes parashtrësës është tërhequr nga aktakuza, gjë që vlerësojmë se një veprim i tillë nuk është i mbështetur në dispozitat ligjore⁶⁰⁴.

Vendimi që mund të merret nga gjykata e shkallës së dytë lidhur me ankesën ndaj aktvendimit – siç u theksua më parë ankesa kundër aktvendimeve vendoset nga gjykata e shkallës së dytë në seancën e kolegjit, rrjedhimisht aty në parim nuk marrin njoftim të palëve për seancën e kolegjit, pra këtu gjykata vendos vetëm duke zbatuar parimin shkresor, duke i vlerësuar dhe analizuar vendimin që është objekt i ankesës si dhe pretendimet ankimore dhe përgjigjet e ankesës. Me rastin e vendosjes gjykata ndaj ankesës varësisht nga rrethanat çështjes, ajo mund të nxjerr:

Aktvendim me të cilin hedhet ankesa si e pas afatëshme – këtu fokusi kryesor i çështjes është se a janë cenuar dispozitat nga pala duke mos parashtruar ankese brenda afatit ligjor që parashihet, e për të vlerësuar drejtë këtë rrethanë duhet të kemi parasysh faktin e llogaritjes së afateve që rregullohet me dispozitat ligjore, dhe duhet të konstatohet mbi bazën e shkresave – flet dorëzimit se ajo ankese është jashtë afatit ligjor, dhe gjykata nuk lëshohet kur e hedhë

⁶⁰⁴ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, NR.04/L-123, Neni 393, Gazeta zyrtare nr. 37/2012, dt.28.12.2012.

ankesën si te pasafatshme ne asnjë rrethane tjetër përveç se duhet te arsyetoj faktin e tillë te kalimit te afatit te palës për te parashtruar ankese.

Aktvendimi me te cilin hedhet ankesa si e papranueshme – dispozita ligjore nga neni 416 ku përcakton se gjykata me aktvendim mund te hedhë ankësën si te papranueshme, rrjedhimisht papranueshmëria si baze nuk ka ndonjë përcaktim ligjore, se çfare mund te rezultojë si rrethane e papranueshme varet nga rasti konkret qe shqyrtohet ankimimi, por e papranueshme do te mund ete konsiderohej rrethana kur vendimi qe pritet te merret ende nuk është nxjerr sipas një propozimi te palës rrjedhimisht papranueshmëria do te rezultonte kur rrethanat e bëjnë te papranueshme ankësën.

Aktvendimi me te cilin refuzohet si e pabazuar ankesa – ne aktvendimin me te cilin gjykata vendose lidhur me bazën ankimore gjykata ka detyrim qe te lëshohet dhe te vlerësoj ne merita qdo pretendim ankimore te palës, rrjedhimisht gjykata duhet te arsyetoj çdo pretendim te palës se perse ato pretendime ankimore i gjene si te pabazuara dhe rrjedhimisht edhe ankësën e refuzon sipas kësaj baze. Ne raste te mos arsyetimit te çdo pretendimi te palës aktvendimi do te mund te konsiderohet si juridikisht i paqëndrueshëm për te mos u konsideruara si arbitraritet ne vendosje nga ana e gjykatës kur ka mungesa te arsyeve lidhur me te gjitha pretendimet e palëve ne ankese. Te kjo baze e vendosjes thelbi i çështjes është se gjykata vlerëson ne merita pretendimet.

Aktvendimi me te cilin aprovohet ankesa dhe ndryshohet ose anulohet aktvendimi i ankimuar – ne këtë baze te vendosjes lidhur me ankësën duhet te kemi parasysh se gjykata fillimisht konstaton faktin se ankesa është e bazuar andaj për shkak se qëndrojnë pretendimet e parashtruara ne ankese nga palët për shkeljet qe theksohen edhe gjykata fillimisht konstaton se ankesa aprovohet si e bazuar, ne rrethana te tilla gjykata ka dy mundësi kur konstaton se ankesa është e bazuara,

a). Mund ta ndryshoj aktvendimin dhe te merr aktvendim meritor mbi çështjen qe shtohet sipas ankësës, dhe

b). Mund ta anuloj aktvendimin dhe çështjen ta kthej ne rivendosje. Kur gjykata anulon aktvendimin dhe çështjen e kthen ne rivendosje atëherë ka obligim qe ta udhëzoj gjykatën e shkalles se pare qe me rastin e rivendosjes te shmange shkeljet qe janë konstatuar sipas ankësës.

Aktvendimi me te cilin anulohet aktvendimi – siç u theksua me larte kur aktvendimi anulohet gjykata mund te ketë dy zgjidhje,

a). Me rastin e anulimit gjykata mund ta refuzoj tërësisht kërkesën apo propozimin e palës, kjo behet kur gjene se aktvendimi i cili është atakuar nuk ka baze ligjore për te qëndruar dhe se kërkesa apo propozimi i palës qe ka rezultuar me nxjerrjen e aktvendimit te ankimuar duhet te refuzohet tërësisht, atëherë kur e anulon aktvendimin njëkohësisht mund edhe ta refuzoj ankësën ne tersi.

b). Kur gjykata e anulon aktvendimin po ashtu mund qe çështjen ka kthej ne rivendosje pranë gjykatës se shkalles se pare, rrjedhimisht kur kthehet ne rivendosje për shkak te anulimit te aktvendimit te ankimuar konsiderohet se aktvendimi i tillë nuk ka prodhuar fare efekt juridike andaj kërkesa përkatësisht propozimi qe ka dërguar ne nxjerrjen e aktvendimit te tillë ri-konsiderohet dhe sërish vendoset nga gjykata e shkalles se pare, bazuar edhe ne gjetjet e gjykatës dhe udhëzimet qe janë dhënë nga gjykata e shkalles se dyte për te mos ripërsëritur shkeljet e konstatuara. Me rastin e rivendosjes sërish palët kane te drejtë ankese kundër aktvendimit te marr, e kjo është plotësisht e arsyeshme nga se aktvendimi i cili është anuluar nuk shkakton asnjë efekt juridik.

Vendosja me aktgjykim kur është ankimuar aktvendimi – dispozitat e kodit te procedurës penale kane parapare je rrethane qe gjykata edhe kur shqyrton ankesën kundër aktvendimit, duke qenë se shumë çështje ne procedure vendosen me aktvendim e ndonjëherë edhe për shkak se çështja penale zgjidhet përfundimisht me aktvendim, ne rrethana te tilla, kodi ka përcaktuar ne nenin 416 paragrafi 3, se gjykata mund te vendose me aktgjykim ndaj ankesës kundër aktvendimit kur gjen se ka baze për vendosjen e tillë. Rrjedhimisht rastet e tilla praktike janë te rralla por kjo ka efekt për palën pasi qe çështja me aktgjykim merr zgjidhje ne merita te rastit, rasti i tillë mund te jete p.sh. Kur aktakuza e prokurorit ne shqyrtim gjyqësor gabimisht është hedhur për shkak se vepra penale është parashkruara, ne rrethana te tillë kur ka ankese nga baza te ndryshme ankimore, gjykata e shkalles se dyte kur vendos ndaj ankesës kundër aktvendimit, dhe kur konstaton se vendosja është bere gabimisht dhe ka arsye për marrjen e aktgjykimit, atëherë gjykata nxjerr aktgjykim, duke konstatuar po ashtu faktin e rrjedhës se parashkrimit te ndjekjes penale por nga ana tjetër duke konstatuar se janë shkelur dispozitat e procedurës penale pasi qe nuk mund te hedhet aktakuza kur ka filluar shqyrtimi gjyqësore edhe kur ka rezultuara rrjedha e afatit te parashkrimit por se aktakuza duhet te refuzohet për shkak te ka kaluar afati i parashkrimit andaj edhe duhet te merret aktgjykimi bazuar ne nenin 363 paragrafi 11 nën paragrafi 1.3 te KPP-ës.

Vendimet qe mund te merren nga gjykata e shkalles se dyte lidhur me ankesën ndaj aktgjykimit – kodi i procedurës penale njih katër forma te vendim marrjes lidhur me ankesën kundër aktgjykimit te cilat vendime mund ti marr gjykata e shkalles se dyte përkatësisht gjykata e shkalles se tret kur ankesa mund te ushtrohet si mjet i rregullt juridik. Kodi i procedurës penale ne nenin 398 paragrafi 1, ka parapare se me rastin e ankesës kundër aktgjykimit gjykata mund qe te:

- a) Hedhë ankesën si te pasafatshme apo te palejuar,
- b) Mund ta refuzoj ankesën si te pabazuara dhe ta vërtetoj aktgjykimin,
- c) Mund ta anuloj aktgjykimin dhe çështjen penale ta kthej ne rigjykim dhe vendim,
- d) Mund ta ndryshoj aktgjykimin e gjykatës themelore.

Hedhja e ankesës si e pasafatshme apo e palejueshme – vendimet e tilla janë procedurale ne kuptim qe vlerësohet vetëm ne aspekti procedural se a janë përmbushur kushtet formale procedurale dhe ne mungesë te përmbushjes se kushteve te tilla ligjore gjykata mund te hedhë si te pasafatshme apo si te palejueshme. Hedhja si e pasafatshme, sipas kodit te procedurës

penale behet kur ka kaluar e drejta e palës sipas afatit ligjore për të parashtruar ankesën çka nënkupton se pala ka parashtruar ankesën pas kalimit të afatit, e afati ligjor për të parashtruar ankesën kundër aktgjykimit është 15 dite që llogaritet nga data e pranimit nga pala. Ndërsa hudhja e ankesës si e palejueshme sipas kodit të procedurës penale, rezulton kur ankesën e ka parashtruar personi që nuk ka të drejte ankese dhe se kush ka të drejte ankese është specifikuar me lartë tek palët me të drejte ankese kundër aktgjykimit, nga se jo të gjitha palët kanë të drejta në ankese në mënyrë të barabartë për bazat ligjore, po ashtu gjykata e hedhë si të palejueshme ankesën edhe kur ankesa është përhequr nga pala që është parashtruar fillimisht apo kur pala ka hequr dorë nga e drejta e ankesës.

Gjykata e hedhë si të palejueshme edhe ankesën kur ankesa që është tërhequr paraqitet serish – vendosja e tillë për ta hedhur poshtë konsiston në eliminimin e palëve që të keqpërdorin të drejtat e tyre andaj edhe parashihet kjo baze ligjore si e tillë. Po ashtu ankesa kur nuk është e lejuar sipas ligjit edhe në këtë rast gjykata duhet ta hedhë poshtë ankesën – kryesisht ka të bëjë me rastet e bazave të drejtave të palëve për të parashtruar ankesën, çka konsiston në faktin se jo të gjitha palët i kanë bazat e njëjta ligjore për ta parashtruar ankesën andaj kjo baze ligjore ndërlidhet me specifikat e arsyeve ligjore që palët kanë të drejte të parashtrorin ankese. Për këto baza ligjore gjithnjë vendoset me aktvendim për ankesën kundër aktgjykimit.

Refuzimi i ankesës si e pabazuar – në rastin e vendosjes nga gjykata për ankesën me të cilën konstaton se ankesa është e pabazuar, gjykata merr aktgjykim. Këtë aktgjykim gjykata e merr kur konstaton se pretendimet ankimore të palës janë të pabazuara për shkaqet që ka theksuar në ankese. Rrjedhimisht gjykata kur vendose mund të gjeje po ashtu shkaqe që për disa rrethana ankesa është e bazuar në ato raste kemi të bëjmë me refuzimin e pjesë të ankesës por atëherë rezulton edhe aktgjykimi i gjykatës që shqyrton ankesën me të cilin ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkalles së parë. Rëndësi ka që aktgjykimi me të cilin refuzohet ankesa e palës si e pabazuar, ai duhet të përmbajë përveç pjesës hyrëse dhe dispozitivit, shumë me rëndësi është arsyetimi në raport me pretendimet ankimore, këtu gjykata duhet të jap arsye në raport me çdo rrethanë që pretendohet dhe në raport me çdo provë që pretendohet apo edhe pretendimet në raport me dispozitat procedurale dhe materiale, në këtë kuptim aktgjykimi duhet të adresojë në mënyrë specifike arsyet se përse një argument në ankese është i pabazuar sipas gjykatës që e shqyrton ankesën.

Aprovimi i ankesës dhe anulimi i aktgjykimit si dhe kthimi në rigjykim dhe vendosje – të marrja e aktgjykimit sipas kësaj baze ligjore, kur konstaton se ankesa është e bazuar atëherë aktgjykimin e ankimit dhe anulon dhe çështjen duhet ta kthejë në rigjykim dhe vendim. Në rastin e anulimit gjykata duhet të ketë kujdes nga se anulimi i aktgjykimit mund të bëhet vetëm kur nuk mund të veprojë sipas nenit 403, çka nënkupton kur nuk mund të procedojë me hapjen e seancës dhe vlerësimin e provave apo marrjen e provave të reja, vetëm kur ka një gjendje të tillë që shkeljet e konstatuara nuk do të mund të eliminoheshin edhe në hapje të seancës së shqyrtimit atëherë mund të anulohet aktgjykimi dhe kthimi i të njëjtit në rigjykim. Kjo është e kuptueshme nga se procesi gjyqësor për palët ka efekt të rëndësishëm dhe duhet të arrihet përfundimi i gjykimit dhe jo të rikthehet çështja për shkaqe të shkeljeve të konstatuara ligjore

e qe do te mund te eliminoreshin ato shkelje ligjore, përkundër kësaj dispozite ligjore praktika gjyqësore ka treguar se shpesh here ky standard ligjor nga neni 403, nuk është respektuar mjaftueshëm. Dilema këtu rezulton se a mund te konsiderohet se me hapjen e seancës për shqyrtimin gjyqësor do te mund ete eliminoreshin edhe shkeljet e dispozitave te procedurës ligjore me karakter absolut, qe konsiderojmë se disa nga shkeljet e tilla edhe me hapjen e seancës se shqyrtimit nuk do te mund ete eliminoreshin andaj ne ato raste detyrimisht anulimi është vendimi i vetëm i bazuar ligjërisht, siç mund te jete. P.sh. Shkelja e dispozitave te procedurës penale me karakter absolut kur ne marrjen e vendimit ka marr pjese gjyqtari qe duhet te përjashtohet, prandaj te shkeljet e dispozitave te procedurës penale me karakter absolut edhe gjykata e shkalles se dyte përkundër se mund te hap seancën e shqyrtimit do te mund te ishte e pamundur qe shkeljet e tilla te rikuperoheshin. Përkundër te gjitha këtyre rrethanave kur gjykata e anulon aktgjykimin duhet qe te konstatoj me saktësi te metat e aktgjykimit qe i ka gjetur dhe mbi te cilat te meta edhe ka konstatuar se aktgjykimi nuk mund te jete juridikisht i qëndrueshëm, me këtë rast gjykata kur vendos qe ta anuloj aktgjykimin duhet saktësisht te udhëzoj se cilat veprime duhet te ndërmerren nga gjykata e shkalles se pare për te eliminuar shkeljet e konstatuara, ne këtë kuptim udhëzimet nuk duhet te jene te përgjithësuara por duhet te jen specifike nga se ne te kundërtën udhëzimet e përgjithësuara do te mund te dërgonin ne ripërtëritjet e shkeljeve. Praktika gjyqësore njeh shpesh here shkaqet e anulimit te aktgjykimit për arsytet e dhëna, vlerësojmë se arsytet e dhëna vetëm kur ato janë tërësisht arbitrare do te mund te konsistonin ne shkaqe te anulimit te aktgjykimit por kur arsytimet e gjykatës qe ka marr aktgjykimin e ankimuar rezultojnë mbi bazën e vlerësimit te provave, atëherë arsyetimi i dhënë nga gjykata e shkalles se pare mund ete mos jete i pranueshëm për gjykatën e shkalles qe shqyrton ankesën por ato nuk duhet te jene baze për anulim, nga se kjo do te nënkuptonte qe arsyetimit te gjykatës se shkalles se dyte ti nënshtrohet gjykata e shkalles se pare, prandaj kurdo qe arsyet nuk janë dhënë ne mënyrë arbitrare por kanë rezultuar nga vlerësimi i fakteve dhe provave gjykata e shkalles se dyte poqë se konsideron se janë arsye te paqëndrueshme duhet qe te mos i pranoj dhe te jap arsye perse nuk janë te pranueshme e te shfaq arsytet qe ne raport me faktet dhe provat ajo gjykate i ka gjetur edhe te vendose për aktgjykimin e ankimuar.

Anulimi i aktgjykimit te ankimuar gjithnjë behet me aktvendim nga gjykata e shkalles se dyte apo gjykata supreme kur vendos sipas ankesës si mjeti i rregullt juridik, por gjithsesi gjykata me aktvendim duhet ta anuloj aktgjykimin edhe kur gjene baza ligjore nga neni 358 pra kur hedhet aktakuza sipas kësaj baze ligjore nga se dispozita ligjore nga neni 402 paragrafi 3, ia jep këtë shtrirje te bazës ligjore qe me aktvendim e hedhe aktakuzën kur ka bazë te tillë ligjore për hedhje te akuzës. Gjithnjë gjykata kur e anulon aktgjykimin e ankimuar mund ta anuloj vetëm pjesërisht por duhet te kujdeset qe pjesa e anuluar nuk cenon tërësinë e aktgjykimit.

Me rastin e anulimit gjykata duhet te ketë parasysh faktin nëse i akuzuari gjendet ne paraburgim, dhe ne këtë suate gjykata ka detyrim qe te shqyrtoj kushtet ligjore nëse ka baze te mëtejshme për te vazhduar apo ndërprerë paraburgimin, ne këtë situatë duhet te vendoste me aktvendim te veçantë nga gjykata qe ka vendosur për anulimin e aktgjykimit, për faktin se aktvendimi për vazhdimin e paraburgimit krijon efekte juridike dhe vazhdon te zbatohet.

Aprovimi i ankesës dhe ndryshimi i aktgjykimit – gjykata kur shqyrton ankesën mbi këtë baze ligjore mund ta aprovoj ankesën qoftë pjesërisht apo tërësisht, dhe ankesa mund të aprovohet qoftë për veprën penale qoftë për vendimin mbi dënimin, apo për të gjitha çështjet që është vendosur me aktgjykimin e ankimuar, pra aprovimi mund të jete ne tersi dhe pjesërisht, dhe kur aprovohet ne tersi apo pjesërisht ankesa atëherë gjykata mund ta ndryshoj aktgjykimin.

Ne këtë kuptim dilemat ne praktike shtrohen se, a ka gjykata kompetence që të ndryshoj aktgjykimin e ankimuar kur konstaton se aktgjykimi i ankimuar përmban vërtetim të gabuar apo jo të plote të gjendjes faktike, dhe a mund të bëjë ndryshim të aktgjykimit pa hapeje të seancës së shqyrtimit apo për të ndryshuar aktgjykimin detyrimisht duhet ta hap seancën e shqyrtimit. Neni 403 paragrafi 1 jap dy baza ligjore për ndryshimin e aktgjykimit, “ 1.1. në bazë të kërkesës së palëve ose sipas detyrës zyrtare, zbaton shqyrtim për të marrë prova të reja apo për të përsëritur shqyrtimin e provave në mënyrë që të vlerësojë drejtë dhe të çmojë provat materiale; ose 1.2. mund të vërtetojë dhe të çmojë provat materiale pa mbajtur shqyrtim, nëse nuk ka nevojë për të marrë prova të reja apo për të përsëritur shqyrtimin e provave”. Dilema praktike shfaqet duke u argumentuar se gjykata e shkallës së dytë nuk është tipike gjykate e faktit për të mundësuar ndryshimin e aktgjykimit,

Ne raste se shikohet me kujdes nën paragrafi 1.2, i jap bazën ligjore gjykatës që me rastin e vendosjes për ankesën mund të vërtetojë dhe çmojë provat pa mbajtur shqyrtim, me rastin e çmuarjes së provave dhe vërtetimit pa mbajtur shqyrtim për gjykatën që shqyrton ankesën mund të rezultojë që fakti i caktuar apo rrethanat e caktuara të fakteve janë vërtetuar gabimisht përkundër kësaj gjykata duhet të ketë kujdes që të mos tejkaloj akuzën në kuptimin objektiv qoftë për faktet apo për cilësimin juridik. Andaj konsiderojmë se mbi këtë baze ligjore asgjë nuk e ndalon gjykatën e apelit që ndryshoj aktgjykimin për shkak të vërtetimit të gabuar apo jo të plote të gjendjes faktike edhe pa hapur seancën e shqyrtimit, vlerësojmë se dispozitat ligjore në Kodin e procedurës penale ka zgjeruara të drejtën diskrecionale të gjykatës për të vendosur për ndryshimin e aktgjykimit, nga se kodet e mëparshme nuk kanë lejuar dhe praktika e tillë gjyqësore është me tepër shfaqje e rregullativës ligjore në të kaluarën se sa e rregullativës aktuale ligjore. Gjithnjë gjykata duhet të kujdeset nëse i akuzuari është nën masën e paraburgimit atëherë duhet të vendose lidhur me masën e tillë dhe vlerëson se a ka arsye për caktimin apo heqjen e masës së paraburgimit në rrethana të ndryshimit të aktgjykimit që ka rezultuar si pasoje e ankesës, këtu duhet shikuar aspektin e ndryshimit të aktgjykimit në raport me kushtet për caktimin e masës së paraburgimit qoftë për të vlerësuar nëse ato kushte ekzistojnë apo për të vlerësuar se kushtet që kanë ekzistuar tani për shkak të ndryshimit të aktgjykimit të njëjtat nuk ekzistojnë dhe duhet hequr masa e paraburgimit. Masa e tillë duhet të vendoset me aktvendim të veçantë.

Parimi i reformatio in peius – dispozitat e kodit të procedurës penale kanë inkorporuar parimin e Reformatio in Peius në nenin 395, parim ky që ka në thelb mbrojtjen e të pandehurit në procedurën penale. Ky parim vlen në rastet e parashtrimit të ankesës në dobi të të akuzuarit, çka nënkupton se parimi i tillë mund të zbatohet në dy situata, qoftë kur i pandehuri apo

mbrojtësi parashtron ankese, por edhe kur prokurori parashtron ankese ne favor te te akuzuarit. Parimi i reformatio in peius e ruan te pandehurin nga dy rrethana:

a). Ne raport me cilësimin juridike te veprës penale kundër te akuzuarit kur ka ankese ne dobi te tije atëherë aktgjykimi nuk mund te ndryshohet ne dem te te pandehurit, si dhe

b). ne raport me sanksionin penal aktgjykimi ne dobi te te pandehurit nuk mund te ndryshohet ne dem te te pandehurit kur ankesa është parashtruara ne dobi te te pandehurit. Ky parim i jap mundësi te akuzuarit qe ankesën ta parashtroj pa frike te përdorimit te te drejtës se tij procedurale duke qene i mbrojtur nga ky parim i pandehuri nuk do te ketë arsye qe ti shfaqet ndonjë rreziku për tu dëmtuar me shume ne procedurën penale qoftë për cilësimin juridik apo edhe për sanksionin. Megjithatë ka diskutime te shumta nga autoret se parimi i reformatio in peius shmange detyrimin e dhënies se drejtësisë ne kuptimin thelbësor, megjithatë dispozita ligjore kanë qëllimin qe te akuzuarit ti mundësohet e drejta e ankesës ne mënyrë me te lehte dhe pa u kanosur nga ndonjë vendim me i dëmshëm ne procedurën penale qe parashtrohet ankesa ne favor te ankesës.

Beneficium koheziones – parimi i beneficium kohezionit është inkorporuara ne kuadër te dispozitave te kodit te procedurës penale ne nenin 397, rrjedhimisht ky parim ndërlidhet ekskluzivisht me te bashkakuzuarit. Ky parim krijon një mundësi qe i bashkakuzuari te mund te ketë një dobi përkundër se nuk ka paraqitur ankese fare apo përkundër se ankese nuk ka paraqitur ne drejtimin e tillë, por se i akuzuari tjetër qe ka paraqitur ankesën e tillë dhe gjykata ankesën e tillë e aprovon e qe rrethanat e tilla nuk lidhen me aspektet personale te te akuzuarit qe i aprovet ankesa, atëherë gjykata detyrohet zyrtarisht te trajtoj rrethanat e tilla për te akuzuarin qe nuk ka paraqitur ankese apo nuk ka paraqitur ankesë ne drejtimin e tillë qe gjykata ka gjetur si baze për ndryshimin e aktgjykimit te ankimuar, dhe aktgjykimin ta ndryshoj edhe ne raport me te akuzuarin e tillë qe nuk ka ankese për rrethanat e tilla, megjithatë kushti është qe ankesa te mos ndërlidhet me aspektin e rrethanës personale, p.sh.

Gjykata me rastin e ndryshimit te vendimit lidhur me sanksionin penal, nuk do te mund te aplikoj parimin e beneficium kohezionis kur gjen rrethana personale qe ndikojnë ne dënimin e te akuzuarit qe ka paraqitur ankese e ta aplikoj ndryshimin e aktgjykimit për dënimin edhe për te akuzuarin qe nuk ka parashtruara ankese apo nuk ka parashtruara ankese ne atë drejtim, nga se rrethanat personale nuk mund te shërbejnë qe gjykata mbi bazën e këtij parimi ta aplikoj ndryshimin edhe për te akuzuarin e tillë, por ne rrethana te vërtetimit te gabuar apo jo te plote te gjendjes faktike apo edhe te cilësimit juridik apo edhe te rrethanave qe ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimin gjykata mund ta aplikoj këtë parim me përjashtim nëse rrethana nuk është personale qe lidhet vetëm me te akuzuarin konkret, rrjedhimisht ky parim nuk mund ete aplikohet ne asnjë mënyrë ne dem te te akuzuarit qe nuk ka paraqitur ankese apo qe ankesën nuk e ka parashtruara ne drejtimin e tillë, por vetëm kur gjykata merr aktgjykim ne dobi te te akuzuarit qe ka parashtruara ankesën atëherë rrethanat e tilla qe kane ndikuar ne vendimin me te favorshëm e qe nuk janë personale, duhet ti vlerësoj zyrtarisht dhe te vendose qe vendimin ta ndryshoj edhe ne dobi te te akuzuarit qe nuk ka paraqitur ankese.

Efekti shtesë i ankesës ndaj te pandehurve tjerë – dispozitat e kodit te procedurës penale ne nenin 396, kanë inkorporuara këtë institut procedural. Thelbi i këtij instituti pra te efektit shtese te ankesës është qe gjykata kur ekzistojnë kushtet ligjore sipas nenit 396, ne një mënyrë e shtron efektin e ankesës dhe duhet te vendoset edhe kur pala nuk ka pretendim me bazën e tillë specifike ligjore. Fillimisht ky institut aplikohet vetëm kur ka ankese ne dobi te te akuzuarit dhe atë për dy baza:

a). Vërtetimin e gabuar apo jo te plote te gjendjes faktike, dhe

b). shkeljen e ligjit penal. Kur ankesa ne dobi te te akuzuarit parashtrohet për këto dy baza apo për cilëndo nga këto dy baza, dhe kur ankesa nuk është parashtruara për ndonjë baze lidhur me sanksionin penal apo masën e trajtimit te detyrueshëm apo për konfiskimin, gjykata për shkak te dy bazave nen a) dhe b), duhet qe zyrtarisht ta shikoj çështjen për bazat tjera ligjore sa i përket dënimit, masës për trajtimin e detyrueshëm apo konfiskimit. Ky institut ne esence lehtëson pozitën e te pandehurit ne procedure duke mos e obliguar qe te argumentoj për bazat e tillë qe nuk i ka paraqitur ne ankese por kur gjykata gjene se baza e vërtetimit te gabuar apo jo te plote te gjendjes faktike apo te shkeljes se ligjit penal është e qëndrueshme edhe pse nuk ka ankese specifike për bazat tjera ankese e tillë sipas këtij instituti e detyron gjykatën qe për bazat tjera ti trajtoj sipas këtij instituti dhe te vendose edhe për sa i përket çështjes se dënimit, masës për trajtimin e detyrueshëm apo konfiskimit.

Rastet e veçanta te ankesës kundër vendimit te gjykatës se shkalles se dyte – kodi i procedurës penale ka përcaktuar disa rrethana specifike kur çështja penale, mund ete kaloj ne sipas ankesës si mjet juridik edhe ne gjykatën Supreme, përkundër se ne parim gjykata supreme vendos vetëm sipas mjeteve te jashtëzakonshme dispozita nga neni 407 e kodit te procedurës penale ka përcaktuar dy rrethana ligjore kur mund te parashtrohet ankese pranë gjykatës supreme te Kosovës. Rrethanat për te cilat lejohet ankese ne gjykatën supreme janë:

a). Kur me rastin e aktgjykimit nga aktgjykimi lirues qe është ankimuar rezulton ne aktgjykim dënues qe merr gjykata e shkalles se dyte, si dhe

b). kur gjykata e shkalles se pare ose gjykata e shkalles se dyte ka shqiptuar dënim me burgim te përjetshëm. Rrethana e pare, mundëson te pandehurit qe përderisa ne aktgjykimin e gjykatës se shkalles se pare me te cilin është liruara dhe si pasoje e ankesës gjykata e shkalles se dyte ka gjetur se aktgjykimi duhet te jete dënues dhe me atë raste gjykata e shkalles se dyte e anulon aktgjykimin nga liruesi ne aktgjykim dënues, atëherë gjykata e shkalles se dyte duhet qe ti jap te drejte ankese ne aktgjykimin qe ka rezultuar me dënimit, duhet te kemi parasysh se aktgjykimi i gjykatës se shkalles se pare kur ka trajtuar disa vepra penale dhe kur është marr aktgjykim dënues dhe aktgjykim lirues, baza ankimore gjithnjë ndërlihet me pjesën qe ka te beje me lirimin për veprën penale nga gjykata e shkalles se pare e qe pe rate vepër penale gjykata e shkalles se dyte e ndryshon aktgjykimin dhe e dënon te akuzuarin, pra thelbi i çështjes këtu është se nuk duhet nënkuptuar si tersi aktgjykimi për te vlerësuar se a duhet te jepet e drejta e ankesës ne aktgjykim por me pjesët e aktgjykimit se a është ndryshuar për ndonjë vepër penale aktgjykimi i ankimuar nga aktgjykimi lirues ne aktgjykim dënues.

Rrethana tjetër kur mund te ushtrohet e drejta e ankesës është kur është shqiptuar dënimi me burgim te përjetshëm, kjo rrethanë e te drejtës se ankimit ndërlidhet ekskluzivisht me dënimin pasi qe dënimi me burgim te përjetshëm është dënimi si forma me e rende ne kodin penale te Kosovës, andaj për qellim qe procesi gjyqësor te ketë kontroll sa me te mire dhe lëshimet ligjore te eliminohen maksimalisht është parapare qe e drejta e ankesës te parashtrohet edhe ne gjykatën supreme si mjet i rregullt juridik, rrjedhimisht kjo nënkupton ne trishkallshmeri te vendosjes, pasi qe edhe vendimi qe rezulton nga gjykata supreme mund te goditet me mjetet e jashtëzakonshme juridike, nëse gjykata supreme vërteton aktgjykimet e gjykatës se shkalles se pare dhe gjykatës se shkalles se dyte.

Përkundër se dispozitat ligjore nuk kanë përcaktuar ankesën ne gjykatën supreme, kundër aktvendimit, ne praktiken gjyqësore është ndërtuar tashme një praktike e mirëfilltë nga gjykata supreme, qe ka mbështetjen pjesërisht ne bazën kushtetuese te te drejtës se ankesës, pjesërisht ne analogjinë procedurale (kur lejohet ankesa kundër aktgjykimit), dhe po ashtu praktika e tillë gjene mbështetje edhe ne parimin in dubio pro reo – interpretimi ne favor te te pandehurit, situata e tillë qe ka rezultuar nga praktika, ka te beje me rrethanën e caktimit te masës për sigurimin e te pandehurit ne procedure dhe atë; Kur gjykata e shkalles se pare ka refuzuar kërkesën e prokurorit për caktimin e masës se paraburgimit, dhe me atë raste gjykata ka refuzuar ne tersi apo kur ka caktuar ndonjë mase tjetër me te bute, dhe si pasoje e ankesës se prokurorit gjykata e shkalles se dyte e ndryshon aktvendimin dhe cakton masën e paraburgimit, atëherë kundër vendimit te gjykatës se shkalles se dyte duhet te ketë te drejte te ankesës, pasi qe te dyshuarit apo te akuzuarit qe i caktohet masa e paraburgimit poqese nuk i lejohet e drejta ne ankese do ti cenoheshin te drejtat kushtetuese, andaj praktika e tillë e krijuar nga gjykata supreme është plotësisht e qëndrueshme juridikisht dhe e arsyeshme ne raport me sigurinë juridike te te akuzuarit.

KAPITULLI III

ADMINISTRIMI I PROCEDURES

Administrimi i procedurës është çështje me komplekse që nuk involvon vetëm gjyqtarin që është i ngarkuar me lenden për shqyrtim, por se administrimi i procedurës konsiston në involvimin e një mori faktorëve të tjerë për të pasur efekt të mirëfilltë dhe zbatim të drejte e në kohe të veprimeve procedurale, administrimi i procedurës në realitet, është tërësia e një rrethi të sistemit brenda gjykatës, duke filluar nga administrata gjyqësore, gjyqtari i ngarkuar me lende apo trupi gjykues përkatësisht kolegji, zyrtaret ligjore të gjykatës, bashkëpunëtorët profesional, dorëzuesit e gjykatës por edhe me institucionet jashtë gjyqësore. Përkundër faktit se në administrim të procedurës ka impakt edhe nga faktor të jashtëm të gjykatës njëkohësisht rëndësi ka që administrimi i procedurës të funksionoj brenda tërësisë së faktorëve të brendshëm të gjykatës në mënyrë që veprimet procedurale të mos dështojnë si pasoje e mos funksionimit të atij rrethi të brendshëm të gjykatës. Shkaku që involvohen faktorë me të shumtë në administrimin e procedurës ka të bëjë me faktin se në administrim të procedurës zbatohet ekskluzivisht parimi i komunikimit shkresorë ndërmjet gjykatës dhe palëve, e kjo ka të bëjë, me pranimin dhe dërgimin e parashtrësave, regjistrimin e tyre, dërgimin e palëve qofte parashtrësat që pranohen apo vendimet që rezultojnë nga ato parashtrësa, apo dërgimin e ftesave dhe impaktin në administrimin e procedurës me efekt nëse dërgimi nuk rezulton i rregullt. Efekti i mos funksionimit të mirëfilltë të administrimit të procedurës ka të bëjë po ashtu edhe me palët kur rezultojnë që gjykatës nuk i janë prezantuar të dhënat e sakta për të komunikuar me palët përmes shkresave.

Te gjitha këto në esencë cenojnë rëndë zbatimin e veprimeve procedurale, e që për pasoje mund të rezultojnë me lëshime apo cenime të dispozitave të caktuara të kodit të procedurës penale e që si të tilla mund të dërgojnë deri në konstatimet e shkeljeve nga gjykata kur shqyrtojnë ankesat e palëve dhe të konstatojnë se ka pasur shkelje të dispozitave të procedurës penale e për pasojë çështja penale mund të rezultojë me anulim të vendimit gjyqësor dhe rikthim të çështjes penale nga fillimi. Duhet të kemi parasysh se detyrimi kryesor për të administruara procedurën i takon gjyqtarit megjithatë faktorët e theksuar kanë rëndësinë e madhe për administrim të drejte dhe të ligjshëm e po ashtu edhe efektiv, andaj administrimi i procedurës ka rëndësi të madhe për të gjithë faktorët e brendshëm në gjykatë por edhe për faktorët e jashtëm gjyqësor.

Parashtrësat – në kuptimin procedural parashtrësata inkorporojnë që si e tillë parashtrësa ta ketë formën e caktuar specifike, ndërsa në kuptimin e përgjithshëm parashtrësa nënkupton çfarëdo kerkese, lutje, propozimi, komunikimi dhe të tjera. Dispozitat e kodit të procedurës penale në nenin 442 kanë përcaktuar se disa nga parashtrësata në kuptimin e përgjithshëm mund të paraqiten vetëm në formën e caktuar ligjore, rrjedhimisht në këtë dispozitë përcaktohet, që: aktakuza, propozimi për ndjekje, aktvendimet e prokurorit, mjetet juridike, dhe deklaratat e njoftimit të tjera paraqiten, *se shkrim apo gojarisht në procesverbal*. Mbështetur në dispozitat ligjore që rregullojnë me dispozita specifike, siç është neni 241 i kodit të procedurës penale që

përcakton saktësisht se aktakuza paraqitet ne formën e shkruar, kur kihet parasysh neni 442 rezulton se krijohet një dykuptimësi se si aktakuza mund te paraqitet edhe ne procesverbal, megjithatë kjo dispozite është dispozite subsidiare për sa i përket mënyrë se paraqitjes se parashtrësia përkatësisht aktakuzës, pasi qe nga dispozitat e kodit te procedurës penale ne nenin 350 i jap kompetence prokurorit qe te paraqes gojarisht ndryshimin e aktakuzës, ne këtë kuptim dispozita nga neni 442 vetëm sa e rregullon mënyrën dhe formën e parashtrimit te parashtrësive qofte me shkrim apo gojarisht ne procesverbal, andaj dispozitat gjithnjë duhet shikuar ne kuptimin e plotësimit te njëra tjetrës kur ka dispozita specifike qe rregullojnë paraqitjen e një parashtrësie konkrete dhe rregullimin e përgjithshëm sipas nenit 442. Kur paraqitet parashtrësia kane rëndësi dy kriteret baze te asaj parashtrësie:

a). Ajo parashtrësia duhet te jete e kuptueshme,

b) parashtrësia duhet te përmbaj çdo gjë qe është e nevojshme për te mundësuar veprimin sipas asaj parashtrësie. Ne mungesë te plotësimit te këtyre dy kriterëve pala qe ka parashtruar parashtrësien mund te thirret nga gjykata qe ta plotësoj parashtrësien qofte ne rrethanat e pakuptueshmërisë se parashtrësës qofte ne rrethanat qe nuk përmban te dhënat e mjaftueshme qe do te mund te veprohej sipas saj. Mos veprimi sipas kërkesës se gjykatës për ta plotësuar parashtrësien ka për pasoj hedhjen e parashtrësës se tillë nga gjykata, dhe hedhja behet me aktvendim. Rëndësi ka qe këtu përcaktohet afati gjyqësor për te vepruar pala ne plotësim te parashtrësës, dhe për te mundur qe te hedhet parashtrësia gjykata duhet te pres kalimin e afatit qe ka përcaktuar për plotësimin e parashtrësës. Duhet po ashtu te kihet parasysh si fakt me rëndësi kur veprohet ne raport me parashtrësiet e palëve, qe kur ftohet pala për ta plotësuar parashtrësien e tillë te pakuptueshme apo qe nuk përmban te dhënat qe janë te nevojshme qe te mund te veprohet ne kërkesën e tillë për plotësim palës i tërhiqet vërejtja për pasojat e mosveprimit, e qe saktësisht i behet me dije palës se ne raste te mos veprimit sipas afatit te përcaktuar për plotësimin e parashtrësës atëherë ajo parashtrësia hedhet si e palejuar.

Ne kuptim te kriterit qe parashtrësia nuk ka te dhënat e mjaftueshme sipas se cilave duhet te veprohet, konsiderojmë se parashtrësia e tillë varësisht nga natyra e saj qe është dhe efekti qe krijon ne procedurën penale, parashtrësia duhet te jete me te dhënat e tilla për te mundësuar efektivisht gjykatën qe te mund te ndër marr veprimin procedural sipas asaj parashtrësie, çka nënkupton se parashtrësia duhet te përmbaj ato te dhëna te nevojshme pa mangësi te tillë qe te ketë efekt ajo parashtrësia mbi te cilën duhet ndër marr veprimi procedural.

Dërgimi i parashtrësive – dispozitat procedurale rregullojnë komunikimin shkresor qofte ndër mjet palëve dhe gjykatës apo edhe komunikimin ndër mjet palëve ne kuptim te dërgimit te parashtrësive qe ngritën ndër mjet tyre. Pra dispozitat e kodit te procedurës ne nenin 443 nuk lejojnë komunikimin e drejtpërdrejt dhe dërgimin e parashtrësive ndër mjet palëve reciproke ne procedurën penale çështja këtu është për parashtrësiet qe inkorporojnë veprimin e caktuar procedural qe duhet zbatuar nga gjykata varësisht nga parashtrësia qe paraqitet ne procedure, andaj kur parashtrësia i paraqitet gjykatës ajo duhet paraqitur ne kopje te mjaftueshme për te gjitha palët dhe gjykatën, ne raste se nuk është paraqitur ne kopje te mjaftueshme pala mund ete thirret për te sjellë kopje te mjaftueshme e ne raste se kopjet e mjaftueshme nuk paraqiten

atëherë mund ete kopjohen parashtrësas dhe paraqitësit te parashtrësës i ngarkohen shpenzimet e nevojshme, këto mund te mbesin edhe ne kategorinë e shpenzimeve te procedurës penale për palët.

Përmbajtja e parashtrësave me gjuhë ofenduese – ne procedurën penale palët kane detyrim qe te kujdesen dhe te mos paraqesin gjuhë te papërshtatshme qe mund ete konsiderohet si fyerje qoftë ku ajo do te mund ete drejtohej ne raport me gjykatën apo ne raport me palën tjetër, prandaj me rastin e pranimit te parashtrësave ne forme te shkruara po edhe kur parashtrësia paraqitet gojarisht ne procesverbal gjithnjë gjykata duhet te kujdeset me gjuhen qe palët kanë përdorur dhe te mos lejoj qe gjuha ofenduese e theksuar ne parashtrëse te kaloj ne heshtje. Sipas nenit 444 te kodit te procedurës penale është parapare qe kur me parashtrësë fyhet gjykata apo personin qe merr pjese ne procedure pala qe ka paraqitur parashtrësën mund te dënohet me dënim me gjobe deri ne 250 euro, megjithatë duhet te kihet parasysh qe vetëm kur parashtrësia me përmbajtje ofenduese paraqitet nga mbrojtësi apo i dëmtuari mund ete shqiptohet dënimi me gjobe nga se dispozita ka përcaktuar ne mënyrë eksplicite dënimin vetëm ndaj mbrojtësit dhe te dëmtuarit por jo edhe palëve tjera ne procedure, ne raport me parashtrësas e prokurorit nëse ato përmbaj gjuhë te ofendimit ndaj ti mund te dërgohet parashtrësia për iniciimin e procedurës disiplinore, ndërsa ne raport me te pandehurin dispozita ligjore nuk lejon ndonjë ndëshkim te çfarëdo natyre.

Kur gjykata merr aktvendim me te cilin i shqipton dënim me gjobe mbrojtësit detyrohet qe ta njoftoj edhe Oden e Avokateve për dënimin e tillë, pasi qe oda mund po ashtu te inicioj procedure disiplinore për shkelje etike nga ana e avokatit. Aktvendimin për dënimin me gjobe e merr gjyqtari apo kolegji pran qe cilit është paraqitur parashtrësia, ndërsa kur gjuha ofenduese është përdorur ne ankese aktvendimin për dënim e merr gjykata qe vendose lidhur me ankesën, ndërsa kur ka te beje me gjuhen qe është përdorur ne parashtrësia te tjera aktvendimin për dënim e merr gjykata qe vendose lidhur me parashtrësën e tillë. Kundër aktvendimit me te cilin shqiptohet dënimi me gjobe pala ka te drejte ankese.

Ne kuptimin praktik çështja e gjuhës ofenduese shpesh here është aspekt i vlerësimit se ne te vërtet aspekti i tillë a nënkupton ofendim apo nuk hynë ne kategorinë e tillë, nga se kjo dispozite m'vishet me aspektin e rregullave te moralit ne këtë kuptim aspekti i interpretimit te çështjes se a është ofendim apo nuk është gjuha ne një parashtrëse, nuk ka diçka specifike, megjithatë çdo ofendim mund ete konsiderohet qe deri ne një mase gjuha e përdorur dërgon ne cilësitë nënçmuese, ndërsa për disa kuptime te fjalive kur kategorizohen me fyerje ato lehtësisht mund ete konsiderohen si ofenduese, megjithatë kjo çështje duhet ne çdo rast konkret te vlerësohet se a përbën gjuha e tillë ofendim ne parashtrësë apo jo.

Afatet kuptimi dhe rëndësia – Afatet ne procedurën penale nënkuptojnë rrjedhën e periudhës kohore brenda te cilës, palët mund ete realizojnë te drejtat dhe detyrimet për çështjen penale, por afatet rezultojnë edhe për gjykatën përkundër se nuk parashohin ndonjë pasoj ne raport me afatet qe kushtëzojnë veprimet për gjykatën, ndërsa për palët lëshimi i afatit nënkupton humbjen e mundësisë ligjrisht për te kërkuar te drejtën. Afatet kane rëndësi kane rëndësi te veçantë nga se varësisht nga afatet qe përcaktohen mundësohet realizimi i te drejtave ne

procedurën penale dhe pikërisht përmes përcaktimit të afateve rezultojnë si efektiviteti procedural por edhe efektiviteti i realizimit të drejtave të rasteve të lëshimit pasojat konsistojnë në humbjen e mundësisë ligjore për realizim të drejtash.

Afatet sipas nenit 445 të kodit të procedurës penale, llogariten në katër mënyra: - në ore, - në ditë, - në muaj, - në vite. Rregulli bazë i llogaritjes së afateve është që dita e ngjarjes nuk duhet të fillojë llogaritjen e afatit, por merret dita e nesërme kur fillon të rrjedh afati, p.sh. Në raste se kemi një vendim ndaj të cilit lejohet e drejta në ankese brenda afatit në ore, atëherë llogaritja bëhet, jo nga ora që dorëzohet, por nga ora e ardhshme, po ashtu nëse kemi afatin e të drejtës së ankesës në ditë, atëherë llogaritja bëhet jo në ditën që dorëzohet por nga dita e ardhshme llogaritet rrjedha e afatit. Po ashtu për të konsideruara se kemi veprimin e palës brenda afatit, llogaritja bëhet në orën apo ditën e fundit që ka kaluar afati, p.sh. Në raste se kemi afatin që e drejta e ankesës të ushtrohet brenda afatit me ditë, atëherë dita e fundit llogaritet se ka kaluar afati, mirëpo në raste se dita e fundit është ditë vikendi apo festë atëherë afati llogaritet se nuk ka përfunduar deri në ditën e parë të punës pas vikendit, po ashtu llogaritja e afatit për afatet që janë mujore duhet të llogariten sipas kalendarit. Të gjitha këto kanë rëndësinë për shkak se duke vlerësuar se a është pretenduar e drejta brenda afatit pala mund të pësojë dhe për pasojë mund të humbë të drejtën e tij ligjore për shkak të kalimit të afatit nëse veprimi i palës nuk është ndërmarr brenda afatit.

Në kuptimin teorik afatet ndahen:

- a) afatet materiale që lidhen me aspektet e instituteve të së drejtës materiale, b) afatet procedurale që janë afate që determinojnë ndërmarrjen e veprimeve procedurale dhe kanë efekte procedurale.
- a) afatet prekluzive që janë kategori ligjore dhe nuk lejojnë në asnjë mënyrë shtyrje dhe kanë efekte dhe pasojë kur ato nuk respektohen, megjithatë instituti i kthimit në gjendjen e mëparshme për shkak të bazuar mundëson rikthimin e afatit nga se rikthen në gjendjen e mëparshme gjendjen për shkak të bazuar dhe objektive b). afatet jo prekluzive që nuk kanë për pasojë ndonjë humbje të të drejtës së palëve dhe po ashtu mund të zgjaten si të tilla janë afatet gjyqësore.
- a) afatet objektive që kanë në esencë rregullimin e fillimit sikur fillojnë të ecin afatet e që sipas afateve objektive rrjedhin nga koha kur paraqitet ngjarja, dhe b). afatet subjektive fillojnë që të rrjedhin që kur pala merr dijeni për ngjarjen.

Kërkesat për kthim në gjendje të mëparshme dhe aktvendimi lidhur me kërkesën – instituti i tillë procedural i jap mundësi të pandehurit që të kërkojë rikthimin e gjendjes së mëparshme, ky institut ka rëndësi në procedurë nga se i mundësohet të pandehurit që kur humbë të drejtën si pasojë e lëshimit të ndonjë afati të kërkojë kthimin në gjendje të mëparshme. Për të mundësuar këtë të drejtë të pandehuri duhet të plotësojë disa kushte: Fillimisht i pandehuri duhet ta ketë lëshuar afatin e tillë dhe të mos ketë vepruar brenda afatit ligjor/prekluziv, dhe po ashtu humbja e të drejtës së tillë të afatit të jetë bërë për shkak të arsyeshme, të paraqes kërkesë për kthimin e gjendjes së mëparshme, dhe se humbja e të drejtës për shkak të kalimit të afatit të

ketë të beje me të drejtën për ankesën kundër aktgjykimit, aktvendimit apo konfiskimit të dobisë pasurore.

Kur paraqitet kërkesa për kthimin në gjendje të mëparshme, i pandehuri duhet po ashtu që të paraqes kërkesën e tillë brenda afatit 8 ditor, dhe ky afat rrjedh nga dita kur kanë pushuar shkaqet e tillë të arsyeshme, se çka konsiderohet shkak i arsyeshëm është aspekti faktit që gjykata duhet të vlerësojë se vërtet arsyeja e paraqitur në kërkesë për kthimin e gjendjes së mëparshme a përbën arsye që është lëshuar afati nga i pandehuri apo vërtet ajo rrethanë nuk përbën shkak të arsyeshëm për ta rikthyer gjendjen e mëparshme. Se bashku me kërkesën për kthimin e gjendjes së mëparshme i pandehuri mund të bashkëngjis edhe ankesën apo paralajmërimin se do të parashtrij ankesë nëse kërkesa e tij aprovohet dhe kthehet gjendja e mëparshme.

Gjykata nëse aprovon kërkesën për kthimin në gjendje të mëparshme me aktvendim konstaton se e aprovon kërkesën, dhe kthehet gjendja e mëparshme. Dispozita ligjore nga neni 447 ka parapare po ashtu kufizim ligjor të afatit për kërkesën për kthimin në gjendje të mëparshme dhe sipas kësaj dispozite nuk lejohet paraqitja e kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme kur kanë kaluar 3 muaj nga dita e kalimit të afatit që i pandehuri e ka humbur për shkak të mosveprimit. Për efekt kthimi në gjendjen e mëparshme apo restitutio in integrum ka efektin e kthimit të afatit të humbur nga i pandehuri me qëllim të shfrytëzimit të të drejtës së ankimit, në këtë kuptim konsiderojmë se kërkesa e tillë është një lloj mjeti i ndërmjetëm që ka efekt vetëm me një të drejtë procedurale të palës e që në rast se kërkesa e tillë aprovohet atëherë pala mund ta shfrytëzojë të drejtën procedurale për të kërkuar mbrojtjen gjyqësore në nivel të shkallshmerive gjyqësore për aktgjykimin dhe aktvendimin por edhe për konfiskimin e pasurisë për ta goditur vendimin e tillë me ankesë.

Aktvendimin për sipas kërkesës për kthimin në gjendje të mëparshme mund ta marr gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues, dhe me aktvendim mund të aprovoj kërkesën e tillë apo mund ta refuzoj kërkesën e tillë për kthim në gjendje të mëparshme. Kundër këtij aktvendimi ka dy momente varësisht nga vendosja që të mund të goditet me mjet juridik: a) aktvendimi me të cilin është aprovuar kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme nuk mund të ankimohet pasi që ndaj aktvendimit të tillë nuk lejohet e drejta e ankesës, dhe b). me aktvendimin me të cilin refuzohet kërkesa për kthimin në gjendje të mëparshme mund të goditet me mjet juridik pasi që ndaj atij aktvendimi lejohet e drejta në ankesë. Karakteristikë është se ky përbën një natyrë të tillë të aktvendimit që e drejta e ankesës varet nga mënyra si është vendosur nga gjykata. Kur lejohet e drejta e ankesës për ankesën duhet të vendos gjykata e apelit që pranon të gjitha shkresat e lëndës për të vendosur ndaj ankesës.

Kur parashtrihet kërkesa për kthimin në gjendjen e mëparshme ajo kërkesë nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit apo aktgjykimit, por gjykata mund të vendosë që derisa të vendoset lidhur me kërkesën e tillë, të mos zbatohet ekzekutimi i aktvendimit apo aktgjykimit, kjo është një efekt shtesë që mund ta prodhojë kërkesa e tillë për të pandehurin në mënyrë që të mos krijohen pasiguri juridike me procedurën e ankimit nëse fillon ekzekutimi i aktvendimit apo aktgjykimit.

Shpenzimet e procedurës dhe vendimet lidhur me shpenzimet e procedurës– shpenzimet e procedurës penale janë ato shpenzime që shkaktohen në procedurën penale dhe lidhur me procedurën penale, kjo nënkupton se jo vetëm shpenzimet e drejtpërdrejta që krijohen në procedurën penale hyjnë në shpenzime të procedurës por edhe ato shpenzime të tërthorta që mund të krijohen për qëllim të procedurës penale që duhet të ndërmerren. Sipas nenin 450 janë parapare rregullat se si përcaktohen shpenzimet e procedurës penale. Si kategori e njohur e shpenzimeve të procedurës, janë:

- a) paushalli gjyqësore – kjo përcaktohet sipas urdhëresave të këshillit gjyqësor e që duhet të kihet parasysh kohëzgjatja e procedurës si dhe komplikueshmeria e procedurës dhe gjendja financiare e personit që i ngarkohen,
- b) shpenzimet lidhur me dëshmitarët ekspertet përkthyesit specialistet – po ashtu këto shpenzime shpenzimet variojnë varësisht nga urdhëresat që këshilli gjyqësor i përcakton pasi që këshilli gjyqësor rregullon lartësinë e shpenzimeve të procedurës për dëshmitarë dhe eksperte,
- c) Shpenzimet e transportit dhe shoqërimit e të pandehurit apo të paraburgosurit,
- d) Shpenzimet e mjekimit në kohën e paraburgimit apo mjekimi jashtë qendrës së paraburgimit sipas urdhëresës së gjykatës kur duhet të bëhet për të pandehurin si dhe shpenzimet për lindjen e fëmijës kur e paraburgosura gjatë kohës së paraburgimit duhet të lindë fëmijën,
- e) shpërblimet dhe shpenzimet për mbrojtësin,
- f) shpenzimet e nevojshme për të dëmtuarin dhe përfaqësuesin e të dëmtuarit.

Në praktiken gjyqësore nuk është i njohur ndonjë rastë që organet të cilat bëjnë shpenzimet e tilla që kategorizohen ligjërisht të kënd deponuar listën e shpenzimeve në gjykate, në mënyrë që të mund të përmbusheshin shpenzimet e tilla në përfundim të procedurës penale. Si rregull çdo organ që ndërmerr veprimet e tilla që mund të kategorizohen si shpenzime duhet të dërgoj listën që janë krijuar lidhur me atë rastë. Prokuroria duhet që gjatë fazës së hetimeve të mbaj faturat që shkaktohen si shpenzime të procedurës penale dhe gjykatës të ia dërgoj listën e lartësisë së shpenzimeve, në mënyrë që në procedurën gjyqësore të vendoset nga gjykata, në praktike një veprim i tillë prokuroria nuk e zbaton asnjëherë, përkundër se dispozita nga neni 450 paragrafi 4 detyron për veprimin e tillë procedural.

Po ashtu institucionet korrektuese dhe policia duhet të dërgojnë listën e shpenzimeve kur shoqërojnë të pandehurin për në gjykate me shpenzimet e shkaktuara në mënyrë që gjykata të ketë bazën ligjore për lartësinë dhe të marr vendim për shpenzimet e tilla të procedurës. Për çdo institucion duhet që të dërgoj pranë gjykatës listën e shpenzimeve kur është vepruara në raport me të pandehurit që janë në procedurën penale në të cilën liste përcaktohet lartësia e shpenzimeve dhe gjykata pastaj duhet të vendosë për shpenzimet e tilla. Praktika gjer me tani kryesisht vendosë për shpenzimet e paushallit gjyqësor, dhe për shpenzimet e tjera shumë rralla, vetëm kur ka ndonjë angazhim të ekspertit.

Duhet të kemi parasysh se të akuzuarit në asnjë mënyrë nuk mund të ngarkohen shpenzimet e procedurës penale për mbrojtjen kur mbrojtja është sipas mbrojtjes së detyrueshme apo me

shpenzime publike pasi qe i akuzuari nuk lejohet qe te ngarkohet me shpenzimet e tilla por as me shpenzimet e përkthimit nga se standardet procedurale inkorporojnë mbrojtjen e detyrueshme për shkak te rrezikut nga dënimi ndaj te akuzuarit dhe qofte edhe kundër vullnetit te te akuzuarit andaj nuk mund ti ngarkohen shpenzimet e mbrojtjes se detyruara por as shpenzimet me pagesë publike, njëkohësisht nuk mund ti ngarkohen te akuzuarit shpenzimet e procedurës për përkthyes nga se standardi procedural garanton qe i akuzuari ka te drejtën e tillë ne përkthim për shkak se nuk e kupton gjuhen ne te cilën zhvillohet procedura penale.

Është detyrim ligjore qe ne kur përfundon procedura penale qoftë me aktvendim apo me aktgjykim te vendoset edhe për shpenzimet e procedurës penale, por nëse me rastin e përfundimit te procedurës mungojnë te dhënat atëherë gjykata mund te vendose me aktvendim te veçantë për shumen e shpenzimeve, por karakteristike është se këtë aktvendim e merr procesmbajtësi/zyrtari ligjor dhe gjyqtari vetëm e aprovon. Kërkesa për shpenzimet e procedurës penale duhet te paraqitet brenda tre muajsh, dhe gjykata duhet te vendose për shpenzimet e tilla te procedurës, për ankesën kundër këtij aktvendimi është kompetent për te vendosur kolegji shqyrtues.

Kur vendoste për shpenzimet e procedurës penale ato vendosen duke u bazuara ne parimin sipas fajit qe janë shkaktuar, pra ne raste se i dëmtuari për shkak te veprimeve te tije ka shkaktuar shpenzime me fajin e tije atëherë shpenzimet i ngarkohen te dëmtuarit, po ashtu njësoj mbrojtësit, dhe cilitdo person qe me fajin e tije ka shkaktuar shpenzimet e procedurës penale, (kjo nënkupton se kur për shkak te mungesës se një mbrojtësi duhet te shtyhet seanca gjyqësore dhe ne atë seance janë shkaktuar shpenzime te gjitha ato shpenzime do ti ngarkohen mbrojtësit nëse ai ka qene i ftuar ne mënyrë te rregullt dhe nuk ka ardhur ne gjykate e seanca nuk mundë te procedoj ne mungesën e mbrojtësit), shpenzimet e tilla bazuar ne parimin e fajësisë se shkaktuar i ngarkohen cilitdo person pavarësisht se si ka përfunduar procedura penale.

Ndërsa kur te pandehurit i ngarkohen shpenzimet e procedurës penale atij i ngarkohen vetëm kur është gjetur fajtores për veprën penale qe është akuzuar, ne te kundërtën kur gjykata e ka liruar nga akuza apo kur është refuzuar akuza apo kur është marr aktvendim me te cilin është hedhur aktakuza atëherë, shpenzimet e procedurës mbesin ne barrën e buxhetit te gjykatës, përkundër kësaj shpenzimet qe shkaktohen me fajin e cilitdo person gjithsesi i ngarkohen atij personi sepse janë shkaktuar me fajin e tije.

Kur shpenzimet e procedurës për shkak te aktgjykimit fajësues ku përfshihen disa te pandehur nuk mund ete ndahen ne raport me secilin prej te pandehurve atëherë te pandehurve iu ngarkohen secilit ne mënyrë solidare shpenzimet e procedurës.

Megjithatë gjykata kur konstaton se vënia ne barre e shpenzimeve te procedurës ndaj te pandehurit qe është shpallur fajtores do te mund te rrezikonte gjendjen materiale te te pandehurit apo personave qe detyrohet ti mbaje materialisht atëherë gjykata mund ta liroj nga pagesa e shpenzimeve te tilla te pandehurin.

Ne dy situata kur paraqitet kallëzimi penal me vetëdije dhe kur propozuesi për ndjekje penale e tërheq propozimin gjykata shpenzimet e procedurës penale ua ngarkon këtyre personave, përkundër faktit se aktakuza mund të pushohet, apo mund të rezultojë aktgjykim lirues apo mund të rezultojë me refuzimin e aktakuzës.

Duhet të kemi parasysh se shpenzimet e procedurës penale ndryshojnë varësisht se në cilën fazë janë shkaktuar, dhe për shpenzimet e procedurës në shkallë të parë vendose gjyqtari i vetëm gjykues apo trupi gjykues, në gjykatën e apelit vendoset nga kryetari i kolegjit, edhe në gjykatën supreme vendoset nga kryetari i kolegjit për shpenzimet e shkaktuara vendoset varësisht nga gjykata që shqyrton çështjen penale.

Kërkesat pasurore juridike dhe palët që kanë të drejtë në parashtrim - duhet të vendoset gjithnjë nga gjykata kur gjykohet çështja penale që nënkupton që kërkesa e tillë mund të vendoset vetëm me aktgjykim. Për tu vendosur kërkesa e tillë duhet që gjykata të ketë parasysh të mos e zvarrit procedurën penale në raport me çështjen penale e kriteri i mos zvarritjes është që të mos zvarritet në mënyrë të konsiderueshme. Sipas nenit 458 njihen tri baza të kërkesës pasurore juridike dhe atë: a).kompensimin e dëmit për të dëmtuarin, b).kthimin e sendit ,c). anulimin e veprimit juridik.

Vendosja për sa i përket bazës ligjore për kompensimin e dëmit ndaj të dëmtuarit është e ndërlidhur me deklaratën e dëmit që e paraqet i dëmtuari në procedurën penale, vetëm kur deklaratën e tillë e paraqet i dëmtuari dhe kur konstatohet fajësia e të akuzuarit atëherë gjykata mund ta urdhëroj të akuzuarin që ta kompensojë dëmin ndaj të dëmtuarit, dëmi duhet nënkuptuar qofte dëmi material apo jo material por edhe fitimin e humbur që si pasojë e veprës penale i është shkaktuar të dëmtuarit.

Për të vendosur lidhur me kërkesën pasurore juridike sipas bazës ligjore të kthimit të sendit kur gjykata konstaton në procedurën penale se sendi i cili gjendet të i akuzuari i takon të dëmtuarit e urdhëron kthimin e atij sendi tek i dëmtuari. Në rast se i dënuari ja ka dhënë sendin për ta ruajtur të akuzuarit siç mund të jetë rasti me veprën penale të shpërdorimit të besimit edhe në atë rast gjykata urdhëron kthimin e sendit.

Vendosja për kërkesën pasurore juridike sipas bazës ligjore të anulimit të veprimit juridik ka të bëjë me të drejtën e të dëmtuarit që të parashtrij një kërkesë të tillë kur vlerëson se veprimi i caktuar juridik i krijuar si pasojë e veprës penale mund të jetë i dëmshëm për të akuzuarin atëherë edhe gjykata mund të urdhëroj anulimin e caktuar të veprimit juridik, për kundër se nuk ka një përkufizim brenda kodit se çfarë është veprimi juridik, kjo mund të kuptohet në kontekst me të gjer të të drejtës qofte nga e drejta e fushës civile apo nga e drejta e fushës administrative apo nga degët e tjera të së drejtës.

Personat që kanë të drejtë të parashtrij kërkesën pasurore juridike janë ata persona të cilët janë të autorizuar për të parashtruar kërkesën e tillë në procedurë civile, në këtë kuptim rrjedhë se kërkesën pasurore juridike mund të parashtrij pasardhësi ose paraardhësi që në esencë është vet i dëmtuari me veprën penale, por po ashtu mund të parashtrij përfaqësuesi apo kujdestari.

Përveç parashtrimit të kërkesës personi që ka parashtruar atë mund të tërhiqet nga kërkesa pasurore juridike dhe mund të mos e parashtrij fare pala, qka nënkupton se është në diskrecionin e vet palës përkatësisht parashtruesit të kërkesës.

Për qëllim të realizimit të kërkesave pasurore juridike bazuar në nenin 467 mund të urdhërohen masat e përkohshme për sigurimin e kërkesës pasurore juridike, për kundër se kjo dispozitë nuk përcakton llojet e masave që mbetet në propozimet e palëve dhe në vendimin e gjykatës se çfarë mase do të ishte adekuate për sigurimin e kërkesës pasurore juridike, vendimin e tillë për të urdhëruar masë të përkohshme e merr gjyqtari i procedurës paraprake ara ngritjes së aktakuzës ndërsa pas ngritjes së aktakuzës e merr gjykatësi i vetëm apo trupi gjykues, e nëse propozimi për masë të përkohshme parashtrohet në shqyrtimin gjyqësor vendimin e tillë e merr i tër trupi gjykues. Ndaj aktvendimit me të cilin urdhërohet masë e përkohshme nuk është lejuar e drejta e ankesës.

Dërgimi i shkresave dhe mënyrat e dërgimit – gjykata për të komunikuar me palët në procedurën penale po edhe me organet tjera e zhvillon komunikimin vetëm me bazë të shkresave, kjo nënkupton se qoftë shkresat që paraqiten nga njëra palë kur duhet dërguar palës tjetër apo vendimit që i merr gjykata dhe kur ato duhet që të dërgohen tek palët, këtë komunikim mund ta zhvillojë në disa forma dhe atë :a) përmes postës, b)përmes organit kompetent komunal, c)përmes zyrtarit të gjykatës apo të prokurorisë, dhe q)përmes dërgimit të drejt për drejt në organin publik.

Disa nga parashtruesit siç janë thirrja për të marr pjesë në shqyrtim gjyqësor kur pala gjendet në gjykata mund të komunikohet thirrja edhe drejt për drejt. Po ashtu gjykata mund të urdhëroj policin që të dërgoj shkresat kur nuk ka të dhëna të mjaftueshme për adresën që duhet dërguar, kjo bëhet se policia ka të dhëna me të shumta se si mund të arrihet gjetja e personit për të dërguar thirrjen. Disa nga parashtruesit siç janë thirrja për të marr pjesë në pyetje dhe për të marr pjesë në shqyrtim gjyqësor duhet të dërgohen personalisht tek i pandehuri ndërsa aktakuza aktvendimit dhe aktgjykimet për të cilat rrjedh afati i ankesës duhet të dërgohen tek i pandehuri personalisht kur ai nuk ka mbrojtës, e nëse nuk dihet adresa e tij apo ka ndryshuar dhe dërgimi nuk mund të bëhet personalisht tek i pandehuri gjykata duhet të caktoj një mbrojtës në mënyrë që mbrojtësi të ushtroj të drejtën e tillë për të cilën rrjedh afati, në situatat kur i pandehuri ka mbrojtës dhe ka me shumë se një mbrojtës është e mjaftueshme që parashtruesi të dërgohet tek njëri ndaj mbrojtësit.

Shkresa që dërgohet personalisht duhet të dërgohet vetëm personit që i adresohet e kur ai nuk gjendet në adresën e tillë i lihet njoftimi me shkrim tek të afërmit e të moshës madhore që personalisht ai të vij të pranojë shkresën që i adresohet, e kur nuk arrihet që të dërgohet parashtruesi edhe pas njoftimit që i është lënë atëherë parashtruesi e tillë i dorëzohet në adresën e tij ndonjë të anëtarit të familjes se të moshës madhore, e kur nuk mund të dërgohet anëtarëve të familjes i lejohet afati në njoftim se deri kur mund ta pranojë parashtruesin dhe në cilin vend mund ta pranojë parashtruesin, vetëm në këtë mënyrë mund të konsiderohet dërgimi i rregullt i parashtruesit.

KAPITULLI IV

PROCEDURAT E VEÇANTA

PJESA E PARË

PROCEDURA PËR DHËNIEN E URDHRI T N DËSHKIMORË SI PROCEDURE E VEÇANTË.

Dhënia e urdhrin ndëshkimor – urdhri ndëshkimor ne esencë nënkupton gjykimin e te akuzuarit përkatësisht konstatimin e fajësisë dhe ndëshkimin ndaj te akuzuarit pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor procedura e tillë penale qe është procedurë e veçantë shmang shumë nga parimet qe njihen ne procedurën penale, por ne anën tjetër si e tillë kjo procedurë është arsyeshme për dy shkaqe, a).sepse urdhri ndëshkimor si sanksion te vetëm mund ta ketë dënimin me gjobë qe nënkupton se dënimi është i aspektit me karakter pasuror për kundër se shqiptohet ne procedurën penale, si dhe b).shmang shpenzimet e procedurës dhe efikasitetin e procedurës.

Për te zbatuar procedurën tillë te dhënies se urdhrin ndëshkimor sipas nenit 493 te KPP-se duhet te plotësohen disa kushte, a).kërkesa e bashkangjitur e prokurorit ne aktakuza për dhënie e urdhrin ndëshkimor - qe duhet te jetë e mbështetur ne provat e besueshme qe kanë mbështetur kallëzimin penal, b).qe veprat penale te ketë te përcaktuar si dënim gjobën ose burgimin deri ne tri vite.

Dilemat ne praktiken gjyqësore janë shtruar se a mund te shqiptohet urdhri ndëshkimor kur për veprën penale janë paraparë dënimet kumulative me gjobë dhe burgim deri ne tri vite, këto dilema janë qartësuar nga praktika gjyqësore e gjykatës supreme ku kjo gjykatë ka vendosur se kur parashihen dënime kumulative nuk mund te shqiptohet urdhër ndëshkimor, kjo është kuptueshme nga se po te lejohej shqiptimi i urdhrin ndëshkimor tek dënimet kumulative ne esencë akte gjykimi i tillë do te shmangte dënimin me burgim, qe do te rezultonte ne shkelje te ligjit penal, por gjithsesi për veprat penale qe parashohin dënimin alternativ me gjobë apo me burgim deri ne tri vite urdhri ndëshkimor mund te shqiptohet.

Ne propozimin e prokurorit për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor prokurori mund te propozoj gofte dënimin me gjobë apo edhe dënimet plotësuese siç ja ndalimin e drejtimit te automjetit, urdhrin për publikimin e aktgjykimit apo konfiskimin e sendit, por po ashtu mund te propozoj shqyrtimin vërejtjes gjyqësore apo konfiskimin e dobisë pasurore te fituar me vepër penale.

Ne rast se gjykata e pranon kërkesën e prokurorit atëherë gjykata nxjerr aktgjykim për urdhër ndëshkimor. Aktgjykimi duhet te përmbaj pjesën hyrëse pjesën dispozitive dhe arsetimin.ne pjesën hyrëse shënohen te dhënat e gjykatës - departamentit, emrin e gjyqtarit te vetëm dhe procesmbajtësit, emrin e te pandehurit dhe veprën penale për te cilën akuzohet, aktakuzën dhe kërkesën e prokurorit për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor, emrin e prokurorit dhe datën e marrjes se urdhrin ndëshkimor. Ne dispozitiv duhet te konstatohet se kërkesa e prokurorit është

aprovuar ndërsa pjesa tjetër e aktgjykimit në dispozitiv përmban të dhënat sikurse aktgjykimit dënues. Në arsyetim duhet të theksohen provat që argumentojnë mjaftueshëm se ato janë të bazuara dhe mbij bazën e tyre është i arsyeshëm shqiptimi i urdhrit ndëshkimor, po ashtu aktgjykimi duhet të përmbajë këshillën juridike për të drejtën e kundërshtimit që është në afat prej tete ditëve si dhe faktin se në rast se nuk përjashtohet kundërshtimi i urdhrit në fillim të dënimit merr formë të prerë dhe fillon ekzekutimi për dënimin e shqiptuar.

Aktgjykimi për dhënien e urdhrit ndëshkimor i i dërgohet të pandehurit dhe prokurorit por edhe mbrojtësit në qoftë se ka mbrojtës të angazhuar. Praktika ka treguar se të pandehurit shqepesh herë kanë përmbushur dënimin me gjobë të shqiptuar sipas urdhrit ndëshkimor e pastaj brenda afatit kanë parashtruar kundërshtimin ndaj urdhrit

ndëshkimor, kundërshtimi i tillë duhet detyrimisht të shqyrtohet nga kolegji shqyrtues nga se nuk konsiderohet se është hequr dorë nga e drejta e kundërshtimit edhe nëse i pandehuri e ka përmbushur pagesën e gjobës sipas urdhrit ndëshkimor.

Kur parashtrohet propozimi nga prokurori për shqyrtimin e urdhrit ndëshkimor, gjyqtari i vetëm gjykues mund të hedhë kërkesë të tillë me aktvendim për dy shkaqe dhe atë: a). kërkesa e tillë nuk mund të paraqitet nga prokurori për shkak të veprës penale në aktakuzë si dhe b). kur prokurori ka propozuar shqyrtimin e ndonjë dënimi që nuk është i lejueshëm për urdhrit ndëshkimor.

Kur gjyqtari hedh kërkesën e prokurorit, prokurori ka të drejtë që të paraqet ankesë kundër aktvendimit për hedhjen e propozimit dhe kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e prokurorit është kolegji shqyrtues i cili duhet të vendosë në afat prej dyzet e tete orësh.

Në situatë kur gjyqtari konsideron se të dhënat në propozimin e prokurorit për shqyrtimin e urdhrit ndëshkimor nuk kanë bazë të mjaftueshme që nënkupton që nuk janë provat mjaftueshëm me besueshmëri për shqiptimin e dënimit, apo nga rrethanat e fakteve dhe provat që mbështesin propozimin e prokurorit mund të pritet ndonjë dënim me i rëndë atëherë gjyqtari cakton pas pranimit të aktakuzës shqyrtimin gjyqësor, dilema këtu shfaqet në faktin se a duhet të caktohet shqyrtimi gjyqësor apo duhet të caktohet shqyrtimi fillestar, për derisa nën 494 paragrafi 2 parasheh caktimin e shqyrtimit gjyqësor, ky veprim do të nënkuptonte pohimin disa të drejtave procedurale ndaj të akuzuarit për të kundërshtuar aktakuzën dhe provat, me gjithat gjykata ka detyrim që për pranueshmërinë e provave të kujdeset gjatë gjithë fazës së procedurës, dhe rrjedhimisht ky kujdesi gjykatës sipas detyrës zyrtare e minimizon cenimin e të drejtave të të akuzuarit.

PJESA E DYTË.

PROCEDURA NDAJ PERSONAVE ME ÇRREGULLIME MENDORE

- *Përgjegjësia penale e personit fizik;*

Një person konsiderohet penalisht përgjegjës nëse në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm dhe i fajtor. Sipas këtij përkufizimi, rrjedh se për t'u konsideruar një person i përgjegjës për veprën penale, kërkohet të plotësohen dy kushte themelore, që personi të jetë *mendërisht i aftë* dhe veprën penale ta kryejë *në formën e dashjes apo të pakujdesisë*.

Kodi Penal i Kosovës jep përkufizimin e nocioni e përgjegjësisë penale, që sipas nenit 17 parashihet se *“Kryerësi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia”*⁶⁰⁵.

Një person konsiderohet mendërisht i aftë nëse në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka lënguar nga ndonjë sëmundje, çrregullim apo ngecje në zhvillimin mendor, si rezultat ka qenë në gjendje t'i kuptojë sjelljet, veprimet dhe pasojat eventuale të sjellës së tij.

Nëse i referohemi çështjes së përgjegjësisë penale, shohim se kemi tri nivele të klasifikimit të shkallës së përgjegjësi penale, dhe atë;

- Përgjegjësia e plotë
- Përgjegjësia esencialisht e zvogëluar dhe
- Papërgjegjshmëria
- *Përgjegjësia e plotë penale*

Niveli i përgjegjësisë së plotë penale, konsiderohet shkalla më e lartë e përgjegjësisë të një personi fizik. Përgjegjësia penale –përbëhet nga këto dy elemente: nga përgjegjësia dhe nga fajësia. Një person konsiderohet i përgjegjshëm atëherë kur posedon aso veti psikike që i bëjnë të mundshme të kuptojë rëndësinë e veprës dhe t'i kontrollojë sjelljet e veta. Dhe i fajtor konsiderohet personi atëherë kur ndaj veprës së kryer ka pasur asi qëndrimi apo raporti i cili bën të mundshme që t'i ngarkohet vepra, përkatësisht kur veprën e konsideron si të vetën, dmth., kryerësi duhet të jetë i përgjegjshëm dhe i fajtor. Këto dyja janë të lidhura ngushtë në mes veti. Nëse një person nuk është i përgjegjshëm, nuk është i aftë që të kuptojë rëndësinë e veprës dhe t'i kontrollojë sjelljet e veta, atëherë nuk mund të konsiderohet fajtor. Në anën tjetër një person mund të jetë i përgjegjshëm, por të mos jetë fajtor për veprën e kryer.

Përgjegjësia penale, varësisht prej intensitetit të saj, mund të shkallëzohet. Kjo ka rëndësi të madhe sepse në të dr. penale nga shkalla e përgjegjësisë penale varet jo vetëm lloji dhe lartësia e dënimit, por në disa raste varet a do të mundet kryerësi të ndëshkohet, apo edhe të ekzistojë vepra penale. Një person konsiderohet i përgjegjshëm kur është në gjendje psikike që të

⁶⁰⁵ Neni 17 Kodit Penal të Republikës së Kosovës

kuptojë, është i vetëdijshëm për rëndësinë dhe pasojën e veprës që kryen dhe është në gjendje që t'i kontrollojë sjelljet e tij.

Pra, përgjegjshmëria përbëhet prej dy elementeve: elementit intelektual apo aftësia intelektuale (mendore) dhe elementit volitiv apo të dëshirës-vullnetit. Përgjegjshmëria është bazë, themel i fajësisë, sepse një person nuk mund të konsiderohet fajtor po që se nuk është i përgjegjshëm. Sikundër shumë kode penale të shteteve tjera, edhe kodi ynë penal, nuk përcakton nocionin e përgjegjshmërisë, por e përcakton papërgjegjshmërinë, përkatësisht bën fjalë se kur kryerësi i veprës penale konsiderohet i papërgjegjshëm.

Andaj në procedurën penale administrohen provat se a ka qenë një person i përgjegjshëm apo jo vetëm në rastet kur lind dyshimi i bazuar se kryerësi i veprës penale ka qenë i papërgjegjshëm.

- ***Papërgjegjshmëria;***

Kryerësi i veprës penale i cili nuk posedon aftësinë për të kuptuar rëndësinë e veprës penale dhe aftësinë për t'i kontrolluar sjelljet e veta, konsiderohet i papërgjegjshëm, përkatësisht me paaftësi mendore.

Kodi penal parasheh tri lloje apo grupe të sëmundjeve apo çrregullimeve psikike që mund të bëjnë një person të papërgjegjshëm.⁶⁰⁶

Papërgjegjshmëria, shkaqet;

- sëmundjet mendore të përhershme
- sëmundjet mendore të përkohshme
- çrregullimi mendor i përkohshëm
- ngecje në zhvillimin mendor (prapambetje mendore).

a) Sëmundjet psikike kronike të përhershëm janë ato të cilat zgjasin për një kohe të gjatë dhe në parim janë të pashërueshme. Sëmundjet e tilla klasifikohen me intensitete të rëndë si për nga mënyrat e shfaqjes, kohëzgjatjes dhe manifestimit të simptomave në jetën reale. Si sëmundje të tilla njihen: epilepsia, paraliza progresive, skizofrenia, paranoja, psikoza encefalike etj.

b) Sëmundjet psikike të përkohshme janë ato të cilat e bëjnë personin plotësisht të papërgjegjshëm. Si të tilla kanë karakterin e përkohshme, mund të shërohen dhe simptomat dhe paraqitja e tyre shfaqen kohë pas kohe.

c) Çrregullimi i përkohshëm është lloj çrregullimi momental i cili shkaktohet nga faktor të ndryshëm qoftë të brendshëm qoftë të jashtëm, siç mund jenë: çrregullime bipolare dhe të

⁶⁰⁶ Neni 18 paragrafi 1 i Kodit Penal së Republikës së Kosovës.

ngjashme, çrregullime depressive, çrregullime ankthi, çrregullime obsesive-kompulsive dhe të ngjashme, çrregullime të traumave dhe çrregullimeve të stresit

d) Ngecja në zhvillimin mendor, prapambetja apo dementia është një ngecje e zhvillimit mendor e shkaktuar nga atrofia e sistemit nervor qendror dhe në këto raste personi nuk është i vetëdijshëm për sjelljet dhe veprimet e tij. Te ngecja e zhvillimit mendor, zhvillimi fizik nuk përputhet me zhvillimin mendor, ku gjendja psikike e një personi nuk përkon me moshën dhe zhvillimin fizik si rezultat i prapambetjes psikike.

- ***Përgjegjësia e zvogëluar në shkallën esenciale;***

Personi i cili ka kryer veprë penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimeve ose mosveprimeve të tij ka qenë esencialisht e zvogëluar për shkaqet e mësipërme. *Personi i tillë konsiderohet penalisht përgjegjës, por këto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masës së trajtimit të detyrueshëm.*

Përgjegjshmëria esencialisht e zvogëluar është gjendje e tillë e personit në kohën e kryerjes së veprës penale, nëse për shkak të sëmundjes mendore kronike apo të përkohshme, çrregullimit mendor apo ngecjes në zhvillimin mendor, aftësia e kryerësit që të kuptojë rëndësinë e veprës apo aftësia e tij që t'i kontrollojë sjelljet e veta ka qenë dukshëm, esencialisht e zvogëluar.

Sipas KPK, çrregullim mendor do të thotë: *“çdo paaftësi apo çrregullim i mendjes apo trurit qoftë i përhershëm apo i përkohshëm që rezulton me dëmtim apo çrregullim të funksionimit mendor”*⁶⁰⁷.

Këtë shkallë të përgjegjësi penale mund ta shkaktojnë sëmundjet psikike kronike të përkohshme dhe të përhershme, çrregullimet psikike dhe të metat mendore.

Po ashtu këtu mund të hyjnë edhe çrregullimet e ndryshme organike si shtatzënia, lindja, helmimet e ndryshme, sëmundjet infektive, etj.

Sipas ligjit, personat të cilët në këtë gjendje kryejnë veprë penale, mund të dënohen me butë. Pra përgjegjësia esencialit e zvogëluar është rrethane fakultative e zbutjes së dënimit.

- ***Masat që mund të shqiptohen ndaj të pandehurve me çrregullime mendore***

Kodi Penal i Kosovës, ka paraparë tri lloje masa të trajtimit të detyrueshëm të cilat mund t'i shqiptohen kryerësit i cili nuk është penalisht përgjegjës, ka aftësi të zvogëluar mendore apo është i varur nga alkooli dhe droga (neni 84).⁶⁰⁸

⁶⁰⁷ Neni 506 parag.1 i Kodit të Procedurës Penale, viti 2013

⁶⁰⁸ Neni 84 Kodi Penal i Republikës së Kosovës

- Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor;
- trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri; dhe
- trajtimi me anë të rehabilitimit të detyrueshëm të personave të varur nga droga ose alkooli

- ***Ekzaminimi psikiatri i kryerësve me çrregullime mendore***

Në çdo kohë gjatë procedurës penale mund të urdhërohet ekzaminimi psikiatrik ndaj të pandehurit. Ekzaminimi psikiatrik mund të urdhërohet sipas detyrës zyrtare apo me propozimin e palëve; të pandehurit, mbrojtësit të tij, apo prokurorit të shtetit.

Në secilin fazë të procedurës penale apo deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor, palët mund të propozojnë ekzaminimin psikiatrik të të pandehurit. Gjykata mund të urdhërojë një ekzaminim të tillë nëse ekziston dyshimi se, i pandehuri ka qenë në gjendje të *paaftësisë mendore ose në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale apo nëse ka ndonjë çrregullim mendor.*

Kodi i procedurës penale ka parapë mundësin që në çdo fazë të procedurës penale mund të urdhërohet ekzaminimi psikiatrik.⁶⁰⁹ Megjithatë do të ishte mirë që ekzaminimi të urdhërohet në fazat fillestare apo gjatë procedurës paraprake në rastet kur ka dyshime të mbështetura në dëshmi që tregojnë se i pandehuri në kohën e kryerjes së veprës penale ka vepruar në gjendje të paaftësisë mendore apo aftësisë së zvogëluar mendore, si rezultat i ndonjë sëmundje të përhershëm apo të përkohshme mendore, çrregullim mendor apo ngecje në zhvillimin mendor. Ekzaminimin psikiatrik mund ta urdhërojë gjyqtari i procedurës paraprake, ndërsa gjatë kohës së shqyrtimit gjyqësor, kryetari i trupit gjykues apo gjyqtari i vetëm gjykues.

Në secilin rast, para se të lëshohet urdhri për ekzaminim apo ekspertizë psikiatrike apo para se të caktohet një eksperti i psikiatrisë është detyrë e gjyqtarit të çështjes të shqyrtojë dhe vlerësojë nevojën për një ekspertizë të tillë. Ky vlerësim mund të bëhet duke u mbështetur në dëshmitë që posedon lidhur me rastin.

Qëllimi i ekzaminimit psikiatrik nga eksperti në procedurën penale

Ekzaminimi psikiatrik zhvillohet për qëllim të ekzaminimit të të pandehurit për të konstatuar nëse:

- a. në kohën e kryerjes së veprës penale i pandehuri ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë së zvogëluar mendore;
- b. si dhe i pandehuri është i paaftë për të përballuar gjykimin që do të zhvillohet ndaj tij lidhur me pasojat e shkaktuara nga vepra penale.

⁶⁰⁹ Neni 507 i Kodit të Procedurës penale

Nevoja për një ekzaminim psikiatrik, apo caktimin ekspertit shtrohet në të gjitha rastet kur i pandehuri:

- manifeston apo shfaq hapur problemet mendore, gjatë seancave dëgjimore, fillestare apo shqyrtim gjyqësor.
- dëshmohet një histori e sëmundjeve mendore të përkohshme apo të përhershme që mund të provohet me dokumentacion përkatës mjekësor.
- aktualisht është në trajtim të caktuara mjekësore psikiatrik në një institucion shëndetësor apo klinik, si rezultat i problemeve mendore.
- ka treguar shenja të një sëmundje mendore, derisa ka pranuar një shërbim të caktuar në një institucion tjetër.
- dyshohet se ka kryer veprën penale në gjendje të paaftësisë mendore apo aftësisë së zvogëluar, dhe gjatë procedurës penale ekziston propozimi i palëve për një ekzaminim psikiatrik.
- Kodi i procedurës penale, ka parapa dy mundësi për të urdhëruar ekzaminimin psikiatrik, gjatë procedurës penale.⁶¹⁰ Në të gjitha rastet kur është e nevojshme ekzaminim ambulator (me paraqitje ditore), *gjykata mund të caktojë një ekspert sipas nenit 146 të këtij Kodi, për të kryer ekzaminimin psikiatrik ndaj një të pandehuri. Me rastin e caktimit të ekspertit, ai është i obliguar që të ju përmbahet dispozitave ligjore të Kodit të Procedurës Penale dhe çdo ekzaminim ose analizë i nënshtrohet rregullave të ekspertizës dhe deklaratës së ekspertit në procedurë.*

Në parim ekspertizat i'u besohen eksperteve që punojnë në institucionet publike. Kjo rrjedh si një kërkesë ligjore, përkatësisht sipas nenit 137 paragrafi 4 dhe 5 të Kodit të Procedurës Penal, ku përcaktohet se *“Po qe se është e mundur dhe nëse nuk krijohet konflikt interesi, ekspertët caktohen nga institucionet profesionale ose organet publike të cilat ofrojnë ekspertët e tyre kur një gjë e tillë kërkohet nga to”*

- ***Observimi në institucionin shëndetësor:***

Nëse eksperti konstaton se për ekzaminimin psikiatrik ndaj të pandehurit nevojitet observim në një institucion të kujdesit shëndetësor, ose nëse i pandehuri refuzon ekzaminimin psikiatrik, eksperti i paraqet kërkesë të arsyetuar gjykatës për marrjen e aktvendimit mbi ndalimin në institucionin e kujdesit shëndetësor.

Pas dëgjimit të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit, gjykata mund të marrë aktvendim për ndalimin e të pandehurit në institucionin e kujdesit shëndetësor deri në dy (2) javë. Ankesa kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon ekzekutimin e tij.

Në urdhër të cilin e lëshon gjykata shënohet koha kur duhet kryer ekzaminimi psikiatrik i cili duhet kryer brenda dy (2) javësh nga lëshimi i urdhrin. Nëse i pandehuri nuk ka angazhuar

⁶¹⁰ Neni 508 Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

mbrojtës, gjykata nxjerr një urdhër për emërimin e mbrojtësit me shpenzime të shtetit. Mbrojtësi mund të marr pjesë në ekzaminimin psikiatrik për të konstatuar aftësinë e të pandehurit për të përballuar gjykimin, përveç nëse eksperti konstaton se prania e tij do të pengonte vlerësimin e drejtë të të pandehurit

Urdhri për ekzaminim duhet të përmbaj:

- të dhënat mbi institucionin shëndetësor që i besohet observimi psikiatrik
- llojin e ekzaminimit psikiatrik që urdhërohet; ambulantor apo ekzaminim i thellë në bazë të vendosjes në institucionin shëndetësor.
- të dhënët personale për të pandehurin dhe veprën penale që dyshohet sipas dosjes së lëndës

Pyetje që i shtrohen ekspertit\ve, siç janë;

- lidhur me gjendjen psikike të pandehurit në kohën e kryerjes së veprës penale.
- shkallën e përgjegjësisë penale, se a është i përgjegjshëm, i papërgjegjshëm apo në gjendje të aftësisë zvogëluar.
- se i pandehuri vuan nga ndonjë sëmundje mendore, çrregullim mendor të përkohshëm apo i përhershëm, apo ngecje në zhvillimin mendor.
- nëse konstatohet ndonjë sëmundje, për, natyrën, llojin dhe kohëzgjatjen e sëmundjes mendore, çrregullimit apo ngecjes në zhvillimin mendor, llojin dhe ndikimin që kishte ajo gjendje mendore tek i pandehuri, shkallën e të kuptuarit të veprimeve dhe pasojave të tij.
- se i pandehuri a është i aftë t'i nënshtrohet gjykimit [të marr pjesë në gjykim].
- se një gjendje e tillë psikike te i pandehuri, a paraqet ndonjë rrezik për veten e tij, apo për të tjerët.
- kohëzgjatja e ekzaminimit sipas urdhrit.
- paralajmërimi ligjor për ekspertin\ët.
- të kërkohet rekomandimi i eksperteve për ndonjë masë eventuale të trajtimit për të pandehurin.

Nëse observimi në institucionin e kujdesit shëndetësor caktohet ndaj personit i cili është në paraburgim, koha e kaluar në institucionin e kujdesit shëndetësor llogaritet në periudhën e paraburgimit.

Në rastin e ekzaminimit psikiatrik të urdhëruar nga gjykata që ka të bëjë me kohën e kryerjes së veprës penale i pandehuri ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë së zvogëluar mendore, eksperti në konstatimin e tij shënon elementet vijuese:

Eksperti në konstatimin e tij shënon elementet vijuese të çrregullimit mendor:

- natyrën,
- llojin,
- shkallën dhe kohëzgjatjen e sëmundjes mendore të të pandehurit;
- llojin e ndikimit që kjo gjendje mendore ka pasur dhe ende ka;

Në rastin e ekzaminimit psikiatrik të urdhëruar nga gjykata për të përcaktuar nëse i pandehuri është i paaftë për të përballuar gjykimin që do të zhvillohet ndaj tij lidhur me pasojat e shkaktuara nga vepra penale eksperti në konstatimin e tij duhet të shënon elementet vijuese:

- *natyrën, llojin, shkallën dhe kohëzgjatjen e sëmundjes mendore të të pandehurit dhe llojin e ndikimit që ky çrregullim mendor e ka në të kuptuarit dhe veprimet e të akuzuarit, veçmas në aftësinë e tij për ta mbrojtur veten, në aftësinë që të konsultohet me personat tjerë duke përfshirë mbrojtësin dhe në aftësinë për ta kuptuar akuzën.*
- **Institucioni kompetent për ekzaminimin psikiatrik;**

Instituti i Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë (IPFK), është një institut që funksionon në kuadër të shërbimeve të shëndetit mendor. Ky institucion në bazë të ligjit është i thirrur dhe kompetent për ekzaminimin apo observimin psikiatrik.

Instituti i Psikiatrisë Forenzike IPFK, ndahet në tri reparte: A, B dhe C. Vendosja e të pandehurve në këtë institucion bëhet vetëm me urdhër të gjykatave.

“Reperti ‘A’ ndryshe quhet edhe reparti i pranimit. Personat në këtë repart paraqiten sipas urdhëresave nga gjykatat. Në kuadër të këtij reparti kryhen edhe ekspertizat psikiatrike ditore ose ambulatore.

Reperti ‘B’ bënë vlerësimin, gjegjësisht trajtime të detyrueshme në ambient të mbyllur. Ndërsa, reparti ‘C’ merret me trajtimin, vlerësimin, ekspertizën psikiatrike-forenzike. Këto ekspertiza kryhen sipas urdhëresave gjyqësore, qëndrimi i personave në ekzaminim mund të jetë deri në katër javë. Në kuadër të institucionit punohet me ekipin multidiciplinar– psikiatri, psikologu, punëtori social dhe infermierët të cilët marrin pjesë në ekzaminimin dhe trajtimin e të pandehurve.

Të gjitha ekspertizat duhet të lëshohen në mënyrë të shkruar, ku eksperti/ët përgjigjen në të gjitha pyetjet e shtruar nga gjykata. Raporti i ekspertizës nënshkruhet nga grupi i ekspertëve gjegjës të cilët kanë punuar në ekspertizë. Kryesuesi i ekipit mund ta përfaqësojë një ekspertizë të tillë para gjykatës. Në parim kur ekspertiza i besohet institucionit shëndetësor, ajo punohet nga grupi i ekspertëve dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë. Në raste e tilla, si rregull nuk lejohet dhe nuk rekomandohet një ekspertizë tjetër e karakterit të njëjtë edhe nëse një gjë të tillë e kërkojnë palët. Përrjashtimisht një ekspertizë tjetër apo super-ekspertizë mund të sigurohet vetëm kur qartë shihet se ekspertiza e parë nuk është punuar sipas standardit të kërkuar dhe për pasojë ka mangësi dhe të meta.

Shembull nga praktika gjyqësore e urdhrat për ekzaminim psikiatrik:

P.nr.00/2016

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda, kryetari i trupit gjykues A. M, me procesmbajtësen L .M, në çështjen penale ndaj të akuzuarit S. I, i akuzuar me dyshimin për veprën penale; Vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 pika 1.3 e 1.5 të KPRK-së, si dhe me dyshimin për veprën penale; Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-ës, duke vendosur sipas propozimit të mbrojtësit të të pandehurit S I, av.K O, i dt.08.07. 2016, e në përputhje me nenin 508, par.1 të KPP-ës, me dt.08.07.2016, lëshon këtë;

URDHËR PËR EKZAMINIM PSIKIATRIK

URDHËROHET-Ekzaminimi Psikiatrik për të pandehurin; S. I i lindur me dt.20.10.1949, nga i ati L, e ëma H gjinisë H, nga fsh- K, Komuna e S, i akuzuar për veprën penale; Vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 pika 1.3 e 1.5 të KPRK-së, si dhe për veprën penale; Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-ës.

Urdhërohet-Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë të bëjë ekzaminimin psikiatrik për të pandehurin S.I. Instituti-(IPFK) të caktojë komisionin mjekësorë i cili duhet të bëjë observimin e drejtpërdrejtë të të pandehurit dhe në bazë të dokumentacionit mjekësor e mbi bazën e tyre të jep mendimin dhe konstatimin mbi gjendjen psikike për të pandehurin.

Pas ekzaminimit psikiatrik për të pandehurin, komisioni i ekspertëve nga kjo fushë pranë IPFK-së duhet të përcaktojë; gjendjen psikike të pandehurit S.I. në kohën e kryerjes së veprës penale e në këtë drejtim të përcaktohet; Se i pandehuri S.I. në ditën kritike në çfarë gjendje psikike ka vepruar (a ishte plotësisht i aftë për të vepruar–aftësia e plotë, me aftësi të zvogëluar apo ka lënguar nga ndonjë sëmundje mendore, çrregullim mendor i përkohshëm apo i përhershëm, apo ngecje në zhvillimin mendor).

Nëse i pandehuri S.I. vuan nga ndonjë sëmundje mendore, çrregullim mendor apo ndonjë ngecje në zhvillimin mendor, ekspertët duhet ta përcaktojnë; natyrën, llojin dhe kohëzgjatjen e sëmundjes mendore, çrregullimit apo ngecjes mendore, llojin dhe ndikimin që kishte ajo gjendje mendore tek i pandehuri, shkallën e të kuptuarit të veprimeve dhe pasojave tij, si dhe të përcaktohet se i pandehuri a është i aftë t'i nënshtrohet gjyqimit dhe a paraqet ndonjë rrezik për veten apo te tjetër.

Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës duhet të marr masa të sigurisë me qëllim që të sigurohet prezenca e të pandehurit në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar që ai të largohet nga IPFK gjatë kohës së ekzaminimit, sepse i njëjti gjendet nën masën e paraburgimit dhe pas ekzaminimit ai duhet të kthehet nën masën e paraburgimit.

I pandehuri S.I. gjendet nën masën e paraburgimit në qendrën e paraburgimit në Lipjan, sipas aktvendimit PPR.nr./2015, të dt.13.05.2015, të Gjykata Themelore në Mitrovicë.

URDHËROHET–Qendra e Paraburgimit në Lipjan dhe Njësia për Transportimin e të Paraburgosurve në Lipjan që të pandehurin/paraburgosurin; S.I. të dërgojnë në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë me qëllim që t'i nënshtrohet ekzaminimit psikiatrik. I pandehuri duhet ndaluar në institucionin për ekzaminim, koha e kaluar në këtë institucion i llogaritet në kohën e paraburgimit. I paraburgosuri S.I. pas

ekzaminimit duhet të kthehet prapë në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan që t'i nënshtrohet masës së paraburgimit. Të konsultohet Instituti (IPFK) për kohën kur duhet dërguar i pandehuri në këtë institucion.

Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës obligohet që brenda afatit prej (2) dy javëve nga (pranimi i të pandehurit në IPFK), të përfundoj ekzaminimin, në të kundërtën obligohet të kërkojë nga gjykata edhe një afat shtesë prej dy javësh për të përfunduar ekzaminimin.

Ekspertët paralajmërohen se nëse ekzaminimi nuk kryhet brenda afatit të përcaktuar mund të kenë pasoja ligjore.

Raporti pas ekzaminimit të përpilohet me shkrim dhe t'i dorëzohet kësaj gjykate.

Rasti të trajtohet me urgjencë nga fakti se i pandehuri gjendet nën masën e paraburgimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka ngritur aktakuzë PP.I.nr.344/2015, ndaj të pandehurit; S.I për veprën penale; Vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 pika 1.3 e 1.5 të KPRK-së, dhe veprën penale; Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-ës.

Me 8 korrik 2016, gjykata ka mbajtur shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale. Gjykata ka aprovuar propozimin e mbrojtësit të të pandehurit S.I, avokatit K.O. për ekzaminim psikiatrik për të pandehurin S.I. Palët tjera në proces nuk kishin kundërshtime në lidhje me këtë propozim.

Në shqyrtimin fillestar sipas kërkesës së palëve në këtë proces penal, dhe në mbështetje të nenit 329 par.4 dhe nenit 508 të KPP-ës. Gjykata e ka parë të domosdoshme dhe të nevojshme që të siguroi një ekzaminim psikiatrik për të pandehurin S.I. me qëllim të sigurojmë të dhënat lidhur me sëmundjen apo çrregullimin eventuale për të pandehurin në kohën e kryerjes së veprës penale e që në përfundim të këtij procesi, gjykata mbi bazën e provave të marr një vendim të drejtë dhe të mbështetur në ligj.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij urdhri, e në mbështetje të nenit 329 par.4 dhe nenit 508 të KPP-ës.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Renda

P.nr.00/2016, e dt.08.07.2021

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari:

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij urdhri nuk lejohet ankesë e veçantë.

- ***Paraburgimi për kryerësit me çrregullime mendore***

Paraburgimi është një prej masave më efektive dhe më e ashpër në procedurën penale, për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurën penale.

Çështje e paraburgimit është e rregulluar me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës [KPP], me çka janë përcaktuara kushtet dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për masën e paraburgimit. Lidhur me masën e paraburgimit si një prej masave më të ashpra që kufizon disa të drejta dhe lirinë e lëvizjes në çdo rast duhet kemi parasysh aktet vendore dhe ndërkombëtare që garantojnë standardet që duhet zbatuar në çdo rast kur urdhërohet masa e paraburgimit.

Në Kosovë përveç akteve vendore, zbatohen edhe standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut të cilat janë të aplikueshme sipas Kushtetutës së Kosovës.⁶¹¹

Me nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, shprehimisht përcaktohet se “Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës”. Sipas kësaj dispozite janë gjithsej shtatë Konventa Ndërkombëtare dhe një Deklaratë që gjejnë zbatim të drejtpërdrejtë në Kosovë, dhe kanë epërsi në zbatim në raport me legjislacionin vendor, në çdo rast kur ka mospërputhje ndërmjet këtyre akteve.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut në nenin 5. 3 ka përcaktuar se “Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni duhet të dërgohet menjëherë përpara një gjykatësi ose një magjistari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksionin gjyqësor”.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, sipas nenit 29 (1) përcakton që “secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente. Secili që arrestohet në momentin e arrestit duhet njoftuar me arsyet e arrestimit”.

Dispozita e nenit 29 paragrafi 2 i Kushtetutës ka përcaktuar se [.....] Çdo kush që privohet nga liria, pa urdhër të gjykatës, brenda 48 orësh duhet të dërgohet përpara gjyqtarit i cili vendos për paraburgim ose lirimin e tij, jo me vone se 48 ore nga momenti kur personi i privuar është sjell para gjykatës ‘’.

- ***Kushte dhe kërkesat ligjore për masën e paraburgimit***

Me nenin 187 të [KPP] janë të përcaktuar kushtet dhe kërkesat ligjore që duhet përmbushen lidhur me masën e paraburgimit. Sipas kësaj dispozite në mënyrë taksative janë numëruar kushtet për masën e paraburgimit, apo siç njihen ndryshe, kushtet e përgjithshme dhe të veçanta lidhur me këtë masë të sigurisë.

⁶¹¹ Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Një prej kushteve bazë që duhet plotësuar në secilin rast është dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale. Njëherazi ky kusht ndryshe quhet edhe kushti i përgjithshme apo bazë që në çdo rast duhet të ekzistojë me rastin e caktimit të masës së paraburgimit.

Ndërsa si kushte tjetra të veçanta për paraburgim, sipas nenit 187 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të KPP, janë kushtet e përcaktuara si në vijim:

- në rastet kur ai fshihet, kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethanat të tjera që tregojnë se ekziston rreziku i ikjes së tij,
- në rastet kur ka arsye për të besuar se ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit.
- në rastet kur peshat e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund ta përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej.
- *Kushtet e veçanta për caktimin e masës së paraburgimit ndaj kryerësve me çrregullime mendore*

Gjykata mund të urdhërojë paraburgim ndaj personit me çrregullime mendore, (neni 509), nëse:

- ekziston dyshim i bazuar se personi i tillë ka kryer vepër penale;
- në bazë të ekzaminimit psikiatrik të urdhëruar nga gjykata, personi ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale;
- personi aktualisht vuan nga çrregullimi mendor, dhe si rezultat i kësaj, ka arsye për të besuar se ai do të rrezikojë jetën apo shëndetin e ndonjë personi tjetër.

Paraburgimi në këto raste mund të urdhërohet vetëm nëse prokurori i shtetit

Paraqet propozimi për shqiptimin e masës së trajtimit të detyruar psikiatrik, siç parashihet me nenin 512 të KPP. Propozimin mund ta paraqes së bashku me kërkesën për paraburgim gjatë apo pas përfundimit të procedurës penale si edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, nëse vërteton se janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 85 dhe 86 të KPRK-së.

Paraburgimi për kryerësit me çrregullime mendore, mbahet në institucionin e kujdesit shëndetësor dhe mund të zgjasë për aq kohë sa i pandehuri është i rrezikshëm, por që nuk kalon afatet e parapara për paraburgim. Nëse i pandehuri ndodhet në paraburgim dhe më pas konstatohet se ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore në kohën e kryerjes së veprës penale, gjykata urdhëron që i pandehuri të mbajë paraburgimin në institucionin e kujdesit shëndetësor nëse ai aktualisht ndodhet në gjendje të çrregullimit mendor.

Gjykata merr aktvendim vetëm pas mbajtjes se seancës dëgjimore dhe dëgjimit të prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe të pandehurit nëse gjendja e tij këtë e lejon, dhe pasi të ketë shqyrtuar mendimin e ekspertit. Aktvendimi i tillë i dërgohet prokurorit të shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, institucionit mjekësor dhe qendrës së paraburgimit. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e urdhrin.

Institucioni i kujdesit shëndetësor vendos për masat për të siguruar sigurinë publike dhe sigurinë e të pandehurit pas konsultimeve me organin kompetent të paraburgimit, duke marrë parasysh nevojat për siguri dhe nevojat terapeutike. Dispozitat e këtij Kodi mbi paraburgimin zbatohen përshtatshëm për paraburgimin e mbajtur në institucionin e kujdesit shëndetësor.

Paraburgimi i tillë mbahet në institucionin e kujdesit shëndetësor dhe mund të zgjasë për aq kohë sa i pandehuri është i rrezikshëm. Institucioni i kujdesit shëndetësor vendos për masat për të siguruar sigurinë publike dhe sigurinë e të pandehurit pas konsultimeve me organin kompetent të paraburgimit, duke marrë parasysh nevojat për siguri dhe nevojat terapeutike.

Shqiptimi i masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik

Procedura për shqiptimin masës së trajtimit të detyruara psikiatrik fillon dhe zhvillohet propozimit me shkrim të prokurorit të shtetit.

Prokurori i shtetit, propozon shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, para hapjes së shqyrtimit gjyqësor, nëse vërtetohet se;⁶¹²

- i pandehuri ka kryer veprë penale në ***gjendje të paaftësisë mendore***
- ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së tillë, siç parashihet në Kodin Penal, përkatësisht arsyet që theksohen me nenit 85 dhe 86 të KPRK .

Nëse prokurori ka paraqitur aktakuzë, ndërsa provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor dëshmojnë se i pandehuri ka kryer veprë penale në *gjendje të paaftësisë mendore*, prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor e ndryshon aktakuzën dhe paraqet propozim për shqiptimin e masën së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik nëse ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së tillë siç parashihet në nenet 85 dhe 86 të KPRK.

Sipas nenit 512 të KPP, rrjedh se propozimi për shqiptimin e masës së trajtimit të detyruar psikiatrik mund të paraqitet nga prokurori i shtetit:

- para fillimit të shqyrtimit gjyqësor dhe
- gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor, nëse procedura penale është filluar me aktakuzë ajo mund të ndryshohet dhe të paraqitet vetëm propozimi për shqiptimin e masës përkatëse të trajtimit të detyrueshëm, nëse plotësohen kushtet për një gjë të tillë.

⁶¹² Neni 512 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovë

Sipas nenit 512 të KPP, ndaj personave që kanë kryer veprë penale në gjendje paaftësisë mendore, procedura për shqiptimin e masës së trajtimit të detyruar psikiatrik fillon dhe zhvillohet sipas propozimit me shkrim të prokurorit të shtetit.

Ndërsa në rastet tjera, kur konstatohet se personi ka aftësi të zvogëluar mendore apo aftësi esencialisht të zvogëluar, procedura penale fillon dhe zhvillohet sipas aktakuzës. Në këto raste prokurori i shtetit në kuadër të aktakuzës mund të paraqes edhe propozimin për shqiptimin e masës së trajtimit të detyruar psikiatrik.

Shembull nga praktika gjyqësore te aktvendimit mbi shqiptimin e masës se trajtimit te detyrueshëm psikiatrik me ndalim:

P.nr.XX/XXXX

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal,(në objektin e degës së gjykatës në Vushtrri) gjyqtari i vetëm gjykues X.X, me procesmbajtësen X.X, në çështjen penale ndaj të pandehurit H....., për shkak të veprave penale; Kanosje nga neni 185 par.4 të KPRK-ës, për shkak të dy veprave penale; Lëndim i rend trupor 189 par.1 pika 1.3 e lidhur me par 5 te KPRK-ës, si dhe veprës penale; Shkelja e urdhrave mbrojtës nga neni 125 te Ligjit mbi dhunën ne familje, në bashkim real me veprat si në piken I, II dhe III. Duke vendosur sipas propozimit për shqiptimin e masës së trajtim të detyruar psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor, propozuar nga prokuroria e shtetit në PTH në Mitrovicë PP.nr.XXX/2013, dt.XX.XX.XXX. Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në seancë të mbyllur, në prezencën e të dëmtuarve; Sh S dhe H S, të pandehurit H S, mbrojtësit të tij av. B M, mbrojtësit të viktimave E.P, pedagogut/ës nga Qendra për punë sociale në Mitrovicë S.Q, prokurores së shtetit në PTH ne Mitrovicë X.X, ekspertit psikiatrik, e në mbështetje të nenit 513 të KPP-ës, dhe nenit 88 par 1 nen par 1.1 dhe nenit 89 të KPRK-ës me dt:10.01. 2014, ka shpallur vendimin, ndërsa me dt:15.01. 2014, perpilon këtë:

A K T V E N D I M

Ndaj të pandehurit:

H....., nga i ati B, e ëma H, e gjinisë M, i lindur me dt.xx.xx.xxxx, në fsh.x, kom. Mitrovicës, ku edhe tani jeton, shtetas i Republikës së Kosovës, shqiptar, i martuar, baba i x fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes se dobët ekonomike, ka qenë në paraburgim nga dt.13.10.2013 e deri me dt:10.01.2014.

Konstatohet se ka kryer këto vepra penale;

I.

SEPSE:

Me dt.13.10.2013 rreth orës 18,00h ne shtëpinë e tij e cila gjendet ne fsh.x, kom. Mitrovicës, seriozisht iu është kanosur se do ta privoi nga jeta te dëmtuarat-bashkëshortes se vet S.. dhe vajzës se vet H..., ashtu që pasi qe i

pandehuri e thërret te dëmtuarën S... e cila ishte ne oborr duke i shtrirë rrobat dhe i thoi: “hajde hyn brenda se po te shohin hallku” dhe kur e dëmtuara hyn brenda e sheh te pandehurin me një sopat ne dore duke i thënë vajzës se “kam me ju pre me sakicë te gjithëve, kallxo kush o kon dje ne shtëpi, se kom me mare do benzinë dhe kam me ju kall tanëve” .

-Me këtë ka kryer veprën penale; Kanosje nga neni 185 par.4 te KPRK-ës.

II

SEPSE:

Ne te njëjtën dite, kohe dhe vend si ne piken I. te dispozitivit si dhe nga motivet e njëjta i ka shkaktuar lëndime trupore te dëmtuarës-bashkëshortes se vet S... ashtu që derisa ishte me sopat ne dore si dhe ne gjendje depresive e ka goditur me duar dhe me pas edhe me bishte te sopates dhe duke e shtyre e përplase për muri me ç`rast i ka shkaktuar lëndime te renda trupore dhe atë: Hematom me parakrahun e dorës se djathte qe paraqesin lëndime te përkohshme te shëndetit te personit tjetër-lëndime te natyrës se renda trupore.

-Me këtë ka kryer veprën penale; Lëndim i rend trupor nga neni 189 par.1 pika 1.3 e lidhur me par 5 te KPRK-ës.

III

SEPSE:

Te njëjtën dite, kohe dhe vend si dhe ne piken I te dispozitivit te aktvendimit dhe propozimit si dhe nga motivet e njëjta i ka shkaktuar lëndime trupore te dëmtuarës-vajzës se tij H...., ashtu që derisa ishte me sopat ne dore si dhe ne gjendje depresive e ka goditur me duar dhe me sopat ne pjesë te ndryshme te trupit me ç`rast i ka shkaktuar lëndime te lehta trupore dhe atë: Kontuzio ne koke qe paraqesin lëndime te përkohshme te shëndetit te personit.

-Me këtë ka kryer veprën penale; Lëndim i rend trupor nga neni 189 par.1 pika 1.3 e lidhur me par 5 te KPRK-ës.

IV

SEPSE:

Ne te njëjtën dite, kohe dhe vend si ne piken I te dispozitivit te aktvendimit dhe aktakuzës e ka thyer urdhrinuk e ka respektuar urdhrin për mbrojtje emergjente qe është caktuar nga ana e Gjykatës Themelore ne Mitrovice, me nr.C.nr.xxx/xxxx, i marr me dt.xx.xx.xxxx, qe gjykata kishte lëshuar Urdhër për mbrojtjen e te dëmtuarës dhe fëmijëve te saj ne kohëzgjatje prej 10 muaj.

-Me këtë ka kryer veprën penale Shkelje e urdhrave mbrojtës nga neni 25 i Ligjit për mbrojtje nga dhuna ne familje.

-Gjykata, konstaton se i pandehuri H S, veprat penale të lartcekura i ka kryer ne gjendje të paaftësisë se plotë mendore.

-Ne mbështetje te nenit 88 par 1 e nenpar 1.1 dhe 89 te KPRK-es, e lidhur me nenin 513 te KPP-es, te pandehurit H S, kjo gjykate i

SHQIPTON

N: TRAJTIM I DETYRUESHËM PSIKIATRIK ME NDALIM NË INSTITUCIONIN E KUJDESIT SHËNDETËSOR

1. Masa e trajtimit të detyruar psikiatrik me ndalim e shqiptuar ndaj të pandehurit H..., do të ekzekutohet në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë.
1. Masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik do të zgjasë për aq kohë sa do të këtë nevojë për trajtim mjekësor- psikiatrik i pandehuri. Kohëzgjatja e masës, do të bazohet në raportet dhe rekomandimet e eksperteve të psikiatrisë pranë Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë
1. Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë, Obligohet të pranoj H S për trajtim mjekësor psikiatrik në kohe siç është paraparë ne diapozitivin e këtij aktvendimi.
7. Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë, obligohet t'i dërgoj raport me shkrim kësaj gjykate mbi gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajtimit brenda periudhës tre-mujore, nga koha e shqiptimit te masës se trajtimit dhe te vazhdoi me raportim te njëjtë derisa H.. të jetë në trajtim në këtë institucion.
7. Gjykata, mund të pushoje apo ndryshojë masën e trajtimit te detyrueshëm psikiatrik me ndalim, atëherë kur e sheh te nevojshme dhe pasi te këtë pranuar raportet dhe rekomandimet e eksperteve te psikiatrisë për ndryshimin apo pushimin e masës, bazuar ne suksesin e trajtimit mjekësor.
1. Shpenzimet e procedurës penale bien ne barre te mjeteve bugjetore te kësaj gjykate.
1. Te dëmtuarit/at S dhe H , kane hequr dorë nga kërkesa pasuroro-juridike.
1. Me këtë vendim njoftohet Qendra për Pune Sociale në Mitrovicë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë, Departamenti i përgjithshëm, ka paraqitur ngritur propozimit për shqiptimin e masës se trajtimit te detyrueshëm psikiatrik me ndalim ne institucionin e kujdesit shëndetësor PP.nr.II.nr.xxx/2013, dt:xx.xx.xxxx, ndaj te pandehurit I S, nga fsh.x, kom. Mitrovicës, me dyshimin për veprën penale Kanosje nga neni 185 par.4 të KPRK-ës, për shkak të dy veprave penale; Lëndim i rend trupor 189 par.1 pika 1.3 e lidhur me par 5 te KPRK-ës, si dhe veprës penale; Shkelja e urdhrave mbrojtës nga neni 125 te Ligjit mbi dhunën ne familje, në bashkim real me veprat si në piken I, II dhe III

Gjykata, pasi ka papranuar lenden penale ka vërtetuara se ka kompetencë lëndore dhe territoriale, ngase veprat penale janë kryer ne territorin e Gjykatës Themelore ne Mitrovicë, dhe veprat penale për te cilat është

konstatuar se i ka kryer i pandehuri H S, rezultojnë te jene ne kompetence lëndore te departamentit te përgjithshëm te kësaj gjykate.

Gjykata ne këtë çështje penale ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me dt:09.01.2014, dhe me dt:10.01.2014, ne seancë prezentë kane qenë te dëmtuarit; S S dhe H S, i pandehuri H S, mbrojtësit te tij av.B M, mbrojtësit te viktimave E.P, Pedagogut/ës nga Qendra për pune sociale ne Mitrovicë S.Q, Prokurori i shtetit ne P.TH- ne Mitrovice, X.X.

Gjykata, në shqyrtimin gjyqësor ka shqyrtuar provat ka dëgjuar ne cilësi te dëshmitareve te dëmtuarit; S M dhe H S, dëshmitarin N S, si dhe ekspertin/en Dr.V.b, provat materiale raportet mjekësore për te dëmtuarit, ekspertizat mjeko-ligjore, ekspertizën e psikiatrisë nga QKUK-Klinika e Psikiatrisë ne Prishtine, foto-dokumentacionin e lendes fotografitë për te dëmtuarat S H dhe S S, dhe një raport te policisë se Kosovës dt:xx.xx.xxxx. Gjykata duke u bazuar ne mendimin e ekspertit dhe raportin e ekspertizës se psikiatrisë, ka vërtetuar se i pandehuri H S është i afte t'i nënshtrohet gjykimit, se i kupton procesin gjyqësor dhe se mund te konsultohet me mbrojtësin e tij.

Prokurori/ja në Prokurorin Themelore në Mitrovicë X.X, ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se duke u bazuar dëshmitë e dëshmitareve ne këtë shqyrtim gjyqësor, pjesërisht edhe nga deklarata e te pandehurit H S, nga mendimi i ekspertit të psikiatrisë Dr.V.B, është vërtetuar se i pandehuri H S ka kryer veprat penale te cilat i vihen ne barre, mirëpo gjate kohës se kryerjes i njëjti ka qene i pallogaritshëm kjo vërtetuar nga ekspertiza e psikiatrisë. Duke i propozuar gjykatës të marre parasysh edhe gjendjen shëndetësore te pandehurit dhe mbi këtë baze ndaj tij te caktoj masën e trajtimit te detyrueshëm psikiatrik me ndalim ne institucionin e kujdesit shëndetësor.

Mbrojtësi i viktimave- në Mitrovicë E.P-si përfaqësues i palës se dëmtuar ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se provat qe janë administruar ne shqyrtimin gjyqësor dëshmojnë se i pandehuri ka probleme me shëndetin dhe si pasoj e kësaj i ka kryer edhe vepra penale qe i vihen ne barre. Duke u bazuar në raportin te ekspertit te psikiatrisë e shohim si te domosdoshme dërgimin e tij, ne trajtim te detyrueshëm mjekësor. Duke i propozuar gjykatës qe pas administrimit te provave ndaj te pandehurit te shqiptohet masa e trajtimit te detyrueshëm psikiatrik, sepse e shohim si te domosdoshme qe një trajtim i tillë do te këtë efekt për te mbrojtur shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e palës se mbrojtur, te pandehurit dhe familjes ne tërësi.

E dëmtuara S....., ne fjalën përfundimtare është pajtuar me fjalën e përfaqësuesit te saj mbrojtësit te viktimave dhe e lute gjykatën qe te pandehurin ta dërgojnë ne shërim dhe se është e gatshme prape të jetoj me bashkëshortin e saj. Ndërkaq ka hequr dore nga kërkesë pasuroro-juridike.

Mbrojtësi i te pandehurit H S, av. B M ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se duke e bazuar provat e administruara ne shqyrtimin gjyqësor e sidomos duke marr për bazë mendimin dhe sqarimin e dhënë nga dëshmitarja-ekspertja Dr.V B, ne lidhje me gjendjen shëndetësore, dhe marr për bazë dokumentacionin përkatës mjekësor qe ekziston ne shkresat e lendes, i propozoi gjykatës qe ndaj te mbrojturit tim te caktoi ndonjëri nga masat e trajtimit te detyrueshëm te parapara me nenin 88 te Kodit Penal te Kosovës. Si dhe ka

propozuar gjykatës që ndaj të pandehurit të ndërprerje masën e paraburgimit. I pandehuri H S, në fjalën përfundimtare e ka përkrahur në tërësi janë e mbrojtësit të tij.

Gjykata, në shqyrtimin gjyqësor ka dëgjuar ekspertin/en e psikiatrisë forensike të Kosovës, Dr.V B, pranë IPFK-ës në lidhje me gjendjen psikike të të pandehurit H S. Ekspertja e psikiatrisë në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se gjate ekzaminimit psikiatrik të realizuare në mënyrë ambulatorie në IPFK-ë nga ekspertet është konstatuare se H S në kohën e kryerjes së veprës ka pasur (ka vuajtur) nga një çrregullimi mendor i quajtur çrregullim deluzional. Ky çrregullim karakterizohet me bindjen e gabuare fikse, të paluhatshme dhe të pandryshuare edhe në prani të fakteve që iu ofrojnë të tjerët. Në aspektin e funksionimit të përgjithshëm këta persona funksionojnë mjaft mirë, pra nuk paraqesin probleme përveç në atë fushë ku janë të ndërlidhura deluzionet. Për këto vepra penale në kohën e kryerjes së tyre aftësia e të gjykuarit ka qene e përjashtuare që nënkupton se H S nuk i ka kuptuar veprimet dhe pasojat e tij, veprat penale e ka kryer në gjendje të paafësisë së plote mendore. Gjithashtu, i pandehuri është i aftë me marr pjesë në gjykim, është i aftë t'i kuptoj mbrojtësin dhe palët tjera në procedurë mirëpo deponimet e tij në lidhje me veprat penale,(aty ku janë të përfshira ato bindje deluzionale) mund të mos jone valide në procedurë. Bazuar në përvojën në rastet e tilla dhe konsultimin e literaturës për rastet e tilla dhe të ngjashëm rreziku me i madhe ekziston për të tjerët se sa për veten e tij. Masa e trajtimit të detyrueshëm me ndalim shihet si e domosdoshme për momentin për arsye se personi në fjale nuk e përdorë terapinë e nevojshme dhe të domosdoshme. Sëmundja bënë pjesë në çrregullimet tjera psikotike ku sipas kualifikimit ndërkombëtar kodohet si:F-22. Sipas praktikës nëse trajtohet kjo sëmundje me rregull dhe në bashkëpunim me personin në fjale por edhe familjar e tij, mund të vijë deri të zbutja dhe zbehja e simptomave të lartshënuara dhe funksionimit të mirë të personit. Ndonëse, është një ndër çrregullimet mjaft rezistencë në terapi.

E dëmtuara S..., e pyetur si dëshmitare në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar, se që (20) njëzetë -vite është në martesë me të pandehurin H. Nga kjo martesë kanë edhe x fëmijë, duke deklaruar se me herët nuk kanë pasur probleme me të pandehurin. Dëshmitarja deklaroi se afërsisht që një vit kanë filluar problemet. Në lidhje me këto probleme në kemi paraqitur rastet në polici, kemi qene edhe në strehimore në Mitrovicë. Pasi jemi kthyer nga strehimorja një kohe afërsisht 2 dy jave nuk kemi pas probleme. Me dt.xx.xx.xxxx, pasi jemi zgjuare nga gjumi H, ka filluar duke iu thënë fëmijëve “kush ka qene dje në shtëpi”. Me pas i pandehuri ka shkuar në qytet, kur është kthyer pas një ore nga qyteti prapë i ka pyet fëmijët se kush ka qene në shtëpi dhe mua dhe vajzën na ka mbyll në dhomë tjetër, na ka pyet se kush ka qene në shtëpi duke na bërtitur, ka filluar të e rrah vajzën, në atë moment e ka pas edhe një sopat në dorë duke na thënë kallëzoni nëse nuk doni me ju rrah. Dëshmitarja deklaroi se të njëjtën ditë, H e ka rrah atë me pak, ndërsa vajzën me tepër. Dëshmitarja deklaroi se atë ka sulmuar në dorë dhe sopatë dhe në pjesë të fytyrës dhe mi ka ngreh flokët, ndërsa vajzën e ka rrah me shume duke e goditur me grushta fytyrës dhe pjesëve tjera të trupit me grushta dhe bishte të sopates dhe nga këto goditje vajza një kohe nuk ka mujt me ngrit nga shtrati. Duke theksuar se H ka nevojë të mjekohet sepse nuk ka arsye tjetër sepse po i bene këto probleme, i njëjti po xhelozon në drejtim timin dhe vajzës. H me herët ka qene në spital dy jave dite është dërguar nga policia, një kohe ka përdor terapi, mirëpo e ka ndërprerë terapinë. Dëshmitarja thekson se ka ekzistua një urdhër i gjykatës për masë mbrojtëse në procedurë civile.

E dëmtuara H..., e pyetur si dëshmitare ne prezencen e pedagogut/es në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar, se ne ditën kur ka ndodhur rasti ne shtëpi kemi qene prezent familja ime, xx, xx, xx dhe xx , sa me kujtohet mua atë dite me ka rrah mua dhe xx tim. Me sa me kujtohet mua atë dite e ka sulmuar edhe nenën dhe e ka godit me shuplaka dhe me bishte sopate, ndërsa nuk kam pa se a ka pas diçka ne dore. Nuk i kujtohet se çfarë iu ka thënë me fjale i pandehuri. Dëshmitarja deklaroi se është frikësuar nga ajo çka ka ndodhe. Dëshmitarja deklaroi se e ka pa një sakicë ne shtëpinë e saj ne dhomën e fjetjes. H e ka pa me sopat ne dore atë dite ne shtëpi, duke theksuar është ndier e frikësuar nga kjo situatë.

Dëshmitari N..., i pyetur si dëshmitar në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se është ne dijeni se edhe me herët kane ndodhe disa probleme nga H, mirëpo ne ditën konkrete e ka thirr ne telefon një kojshi cili me ka thënë hajde se po ndihet zhurmë ne shtëpinë e H, dhe se i mbyti tu i rrah fëmijët. Unë kam shkuar ne shtëpinë e H, kur kam hyr gruan e H e kam gjet ne ballkon i kishte ra te fiket, ndërsa H e kishin marre policia. Dëshmitari ka deklaruar se kur ka shkuar ne shtëpinë e H, policia ia kishte marre atij një sopat, ndërsa fëmijët i gjeta duke bërtit. Ndërkaq, ne raste tjera ne prezencën time e kam dëgjua H, duke iu thënë fëmijëve dhe gruas se tij, se kam me ju mbyt te gjithëve. Dëshmitari ka deklaruar se ka shkuar ne shtëpi, e kam pa S bashkëshorten e H ka gene e alivanosur, dhe e ka vërejtur se S edhe vajza e saj kane pas lëndime. Me sa e di unë probleme ne mes veti kane qe një vit. Sipas dëshmitarit gjërat qe janë duke ndodhur mua po doket se H, ju kane pjek disa gjera te xhelozisë ne koke se gjoja dikush po vjen ne shtëpi, e qe sipas meje këto gjera aspak nuk janë te vërteta dhe nuk mund të qëndrojnë.

Gjykata duke vlerësuar gjitha provat një nga një dhe gjitha së bashku, ne përputhje me nenin 361 te KPPRK-së, ka vërtetuar këtë gjendje faktike;

Se i pandehuri H.. me te dëmtuarit/at janë ne raporte familjare. Me te dëmtuarën S..., është ne raport bashkëshortor, ndërsa e dëmtuarën H., është vajza e tij. I pandehuri H.. deri me dt:xx.xx.xxxx, ka jetuar ne shtëpinë e tij ne fshatin x, komuna e Mitrovicë, se bashku me bashkëshorten, dhe x fëmijët e tij. Gjykata ka vërtetuar se deri para një viti, kjo familje kishte raporte te mira familjare, ndërkaq qe një kohe marrëdhëniet familjare janë përkeqësuar. Gjykata, këtë gjendje faktike e ka vërtetuar nga deklarata e te dëmtuarës, dhe por edhe nga vete mbrojtja e te pandehurit H..... .

Gjykata, me tej ka vërtetuar se si rezultat i problemeve familjare ne familje, ne procedure civile Gjykata Themelore në Mitrovicë, ka lëshuar urdhër-mbrojtje, ku kryesi i dhunës ne familje H..., nga fshati X, është urdhëruar masa, duke i ndaluar kryesit te dhunës ne familje te mos e kryej ose te mos kanosje se do te kryej ndonjë vepër te dhunës ne familje ndaj palës se mbrojtur S.. dhe fëmijëve te saj. Urdhri është lëshuar me dt:xx.xx.xxxx, për kohe te caktuar prej (10) dhjetë muaj. Këtë fakte gjykata e ka vërtetuar nga deklarata e te dëmtuarës S.... dhe nga urdhër-mbrojtja, e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, i dt:xx.xx.xxxx. Kjo gjykata ka vërtetuar se H ... me dt:xx.xx.xxxx, ne shtëpinë e tij në fshatin x, komuna e Mitrovicës i kishte kanosur seriozisht me jetë te dëmtuarën S... dhe H (bashkëshorten dhe vajzën). I pandehuri fillimisht i kishte mbyllur ne dhomë te dëmtuarat ndërkaq me pas me sopat ne dore, i kishte kanosur me fjalët “se nëse nuk me tregoni se kush ka qenë sot në shtëpi, do t’iu prej tanve”. Gjykata, vërtetojë se kanosja e te pandehurit ne drejtim te të

dëmtuarave ka qene mjaft serioze dhe njëherë tek palët e dëmtuara kishin shkaktuar frike dhe shqetësim te madhe, ngase te dëmtuarat kishin frike se mund t'iu ndodhe diçka e keqe në drejtim të jetës se tyre. Kjo edhe nga fakti se i pandehuri H....., vazhdimisht e mbante sakicën brenda ne dhomën e fjetjes. Gjykata, këtë gjendje faktike e ka vërtetuar nga deklarimi i palës se dëmtuar – dëshmitareve S.... dhe H..... dhënë ne shqyrtimin gjyqësor dhe deklarimin e dhënë në policinë e Kosovës.

Gjykata, ka vërtetuar se me dt:xx.xx.xxxx, i pandehuri ne shtëpinë e tij në fshatin X, komuna e Mitrovicës, pas një mosmarrëveshje qe kishë pasur ai i kishte sulmuar fizikisht bashkëshorten dhe vajzën e tij S dhe H..... Të dëmtuarën S.... e kishte goditur disa herë me duar-grushta dhe me sopatë ne pjesë te ndryshme te trupit, ndërsa te dëmtuarën H..... e kishte sulmuar me duar- grushta dhe me bishte sopate kryesisht në koke por edhe ne pjesë te ndryshme të trupit. Gjykata, ka vërtetuar se te dëmtuarat nga goditjes qe kanë marr nga i pandehuri, kane pësuar lëndime te natyrës se rende trupore, dëmtim te shëndetit trupor me pasoja te përkohshme për shëndetin e tyre. E dëmtuara S....., ka pësuar lëndime trupore-hematom dhe frakturë ne parakrahun e dorës së djathtë te shkaktuar nga ndonjë mjete mbretës i cili lëndim trupor kualifikohet si lëndim i renda trupor. Ndërsa e dëmtuara H..... ka pësuar lëndim trupor-kontuziu në kokë te shkaktuar nga ndonjë mjete mbretes i cili lëndim trupor kualifikohet si lëndim i lehet trupor. Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuara nga deklaratat e dëshmitareve S.... dhe H....., dhe N te dhënë ne shqyrtimin gjyqësor, te cilën gjendje faktike nuk e ka mohuar as i pandehuri mirëpo gjykata i ka shqyrtuar me rezerve deponimet e tij tu marr parasysh gjendjen e tij psikike. Gjykata, llojin dhe natyrën e lëndimeve qe kane pësuar te dëmtuarat e ka vërtetuara nga raportet mjekësore, si dhe nga ekspertiza mjeko-ligjore, te lëshuar nga ekspertit i mjekësisë ligjore Dr. N.H.

Gjyqtari i vetëm gjykues, ka vërtetuara se ndaj te dëmtuarës S dhe fëmijëve te tij, Gjykata Themelore në Mitrovicë, ne procedure civile ka lëshuar urdhër-mbrojtje, ku kryesi i dhunës ne familje H, nga fshati X, është urdhëruar masat, duke i ndaluar kryesit te dhunës ne familje te mos e kryej ose te mos kanosje se do te kryej ndonjë vepër te dhënës ne familje ndaj palës se mbrojtur S dhe fëmijëve te saj. Urdhri është lëshuar me dt:xx.xx.xxxx, për kohe te caktuar prej (10) dhjetë muaj. Kjo gjykata vërtetojë se edhe përkundër faktit se te pandehurit H, gjykata kishte ndaluar qe i njëjti te mos i kanoset, te mos i sulmoje te dëmtuarën dhe fëmijët e saj, ai brenda periudhës kohore sa ishte ne fuqi urdhri për mase mbrojtëse ndaj te dëmtuarës S....., kishte kryer veprat penale te kanosjes dhe lëndimeve trupor ndaj palëve te mbrojtura ne urdhër –S... dhe H..... Gjykata, këtë gjendje faktike ka vërtetuara nga deklaratat e te dëmtuarave-dëshmitarëve S dhe H si dhe nga vendimi i Gjykatës Themelore ne Mitrovicë C.nr:xxx/xxxx, dt:xx.xx.xxxx, për lëshimin e urdhrin mbrojtës.

Gjykata, ua fali besimin e plote deklaratave te dëshmitareve S.. dhe H ..., ngase se dy deklaratat e tyre, përputhen pothuajse plotësisht ndërmjet tyre dhe nuk kanë ndonjë dallim nga deklarinimet e tyre te mëhershme te dhënë ne polici e Kosovës. Gjykata edhe për disa arsye u fali besimin deklarimeve te të dëmtuarve-pyetur si dëshmitare në shqyrtimin gjyqësor, nga fakti se te njëjtat përveç se kishin qene dëshmitare okulare kanë përjetuar drejtpërdrejtë, edhe pasojat e veprës penale te kanosjes si dhe lëndimit trupor. Gjithashtu deklarimet e tyre përputhen plotësisht edhe me provat tjera siç janë, raportet mjekësore, dy ekspertizat mjeko ligjore ne emër te te dëmtuarave, dëshminë e dëshmitarit N, si dhe raportin e policisë se Kosovës te dt:xx.xx..

Gjykata, ka vërtetuar se i pandehuri H, veprat penale të lartcekura i ka kryer në *gjendje të paaftësisë së plotë mendore*, ngase në kohën e kryerjes së veprave penale ai ka - ka pasur (ka vuajtur) nga një çrregullimi mendor i quajtur çrregullim deluzional. Në klasifikimin e sëmundjeve mendore kodohet si F22.0 (ICD-10). Për këto vepra penale i pandehuri H në kohën e kryerjes së tyre, aftësia e të gjykuarit ka qenë e përjashtuar që nënkupton se ai nuk i ka kuptuar veprimet dhe pasojat e tij, çka nënkupton se i njetit ka qenë me paaftësi të plotë mendore. Gjykata faktet e lartcekuar i ka vërtetuara nga deklaratimet e ekspertit/es Dr. V.B. dhe në shqyrtimin gjyqësor si dhe nga raporti i ekspertizës psikiatrike hartuar në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë.

Gjykata, i shqiptoj të pandehurit masën e trajtimit të detyruar psikiatrik me ndalim në institucionin kujdesit shëndetësor pasi ka vërtetuar se janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenin 88 dhe 89 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dhe nenit 513 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Gjykata, ka vërtetuar dhe konstatuar se i pandehuri H, i ka kryer veprat penale të cekura si më lart, se veprat penale i ka kryer në *gjendje të paaftësisë mendore*, se ekziston rreziku se i pandehuri H, mund të kryej edhe veprat tjera penale, krejt kjo duke u bazuar në faktin se ai vuan nga një çrregullim mendor-ide deluzive. Gjithashtu nga mendimi i ekspertit të psikiatrisë Dr. V.B., kjo gjykata ka vërtetuar se i pandehuri H, marrë parasysh gjendjen e tij shëndetësore, sjelljet e tij në të kaluarën, ai mund të paraqet rrezik serioz për veten dhe për persona tjerë. Rreziku se i pandehuri mund të kryej vepra penale tjera e bene edhe me bindes fakti se i njëjti ka jetuar në bashkësi familjare me bashkëshorten dhe fëmijët e tij, ndaj të cilëve edhe i ka kryer veprat penale, e që si motiv tek i pandehuri ka ekzistuar gjelozia, e që në baze të ekspertit psikiatrik, kjo ka baze nga sëmundja mendore prej të cilës vuan i pandehuri H. Gjykata, bazuar në raportin e ekspertizës së psikiatrisë si dhe në mendimin e ekspertit, i pandehuri ka nevojë që të trajtohet në aspektin mjekësorë – psikiatrik sepse vuan nga sëmundja mendore e cekur si më lart, ndërsa trajtimi mjekësor është i nevojshëm dhe nga këto arsye në baze të rekomandimit të ekspertit të psikiatrisë dhe raporteve tjera mjekësorë ndaj të pandehurit ka shqiptuar masën e trajtimit të detyruar psikiatrik me ndalim në institucionin në kujdesit shëndetësor, duke vlerësuar se kjo masë do të jetë e dobishme dhe në interes të vetë të pandehurit. Gjithashtu kjo masë është e nevojshme edhe për t'iu shmangur mundësinë që i pandehuri të kryej vepra tjera penale.

-Gjykata vendimin për shpenzimet e procedurës penale e morri në përputhje me nenin 450 e lidhur me nenin 453 të KPP-es.

-Gjykata ndaj të pandehurit H me dt.xx.xx.xxxx, ka ndërpre masën e paraburgimit dhe të njëjtin menjëherë e ka dërguar në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë me qëllim që i njëjti t'i nënshtrohet masës trajtim i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor.

-Nga sa u tha më lart në përputhje me nenin 88, 89 të KPRK-es, dhe nenin 513 të KPP-es gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni penal

P.nr.xxx/xxxx, dt. xx.xx.xxxx

Procesmbajtësja;

Gjyqtari i vetëm gjykues;

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi lejohet e drejta në ankesë, në afate prej 8 ditëve nga dita kur palët e pranojnë aktvendimin me shkrim. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për palën dhe gjykatën. Ankesa, nuk e ndalon ekzekutimin e këtij aktvendimi në përputhje me nenin 174 dhe 175 të Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale.

Karakteristikat e veçanta të procedurës për shqiptimin e masës:

Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik mund të shqiptohet pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor nga gjykata e cila është kompetente për gjykimin e çështjes në shkallë të parë.⁶¹³ Në procedurën sipas propozimit për shqiptim të masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik aplikohen disa rregulla të veçanta, që duhet kemi vazhdimisht parasysh;

- nuk mbahet shqyrtimi fillestar e as shqyrtimi i dytë.
- procedura zhvillohet drejtpërdrejtë në shqyrtimin gjyqësor
- i pandehur duhet të përfaqësohet nga një mbrojtës, pra, mbrojtja është e obliguara sipas nenit 57 të KPP.
- shqyrtimi gjyqësor duhet të jetë i mbyllur për publikun.
- gjithmonë duhet shqyrtohet nëse i pandehuri është i aftë t'i nënshtrohet gjykimit.
- nuk ftohet i pandehuri që të deklarohet për fajin e as për pranimin e fajit, sepse në këto raste s'bëhet fjalë për faj, kemi të bëjmë me person apo të pandehur të papërgjegjshëm.
- përveç këtyre rregullave, zbatohen edhe rregullat e përgjithshme mbi administrimin e provave në shqyrtimin gjyqësor.

Personat që thirren në shqyrtimin gjyqësor:

Përveç personave të cilët duhet të thirren në shqyrtimin gjyqësor, siç mund të jenë dëshmitarët, ekspertët, i dëmtuari, përfaqësuesit e tyre, duhet të thirren edhe ekspertët dhe psikiatri nga institucioni i kujdesit shëndetësor të cilëve iu është besuar kryerja e ekzaminimit psikiatrik mbi aftësinë mendore të të pandehurit, bashkëshorti/ja e të pandehurit dhe prindërit e tij ose prindërit adoptues njoftohen për shqyrtimin gjyqësor.

Vendimet gjyqësore

⁶¹³ Neni 513 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

Nëse gjykata konstaton se nuk ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor apo trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri, ajo e pushon procedurën e shqiptimit të masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik.

Gjykata merr aktgjykim lirues për të pandehurin nëse i pandehuri ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore kur e ka kryer veprën penale dhe nëse prokurori i shtetit nuk ka paraqitur propozimin për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në pajtim me nenin 512 të këtij Kodi.⁶¹⁴

Gjykata merr aktvendim për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik nëse prokurori ka paraqitur propozim për shqiptimin e njërës nga masat.

Në aktvendim me të cilën gjykata ka shqiptuar njërën nga masat, theksohet:

- vepra të cilën është vërtetuar se e ka kryer i pandehuri, kualifikimi juridik i veprës dhe dispozitat e zbatuara të ligjit penal;
- vendimin që i pandehuri e ka kryer veprën në gjendje të paaftësisë mendore;
- masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik që i është shqiptuar të pandehurit.
- arsyet faktike dhe ligjore për shqiptimin e mase se trajtimit
- institucionin shëndetësor ku planifikohet të ekzekutohet masa e trajtimit të detyrueshëm
- obligimin e institucionit shëndetësor për të raportuar mbi zbatimin dhe efektet e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik

Të gjithë personat të cilët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë kundër aktgjykimit, përveç të dëmtuarit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë kundër aktvendimit të gjykatës brenda tetë (8) ditësh pas marrjes së aktvendimit.

Në rastin kur gjykata vendos të pushojë procedurën në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, pas konstatimit se në kohën e kryerjes së veprës penale i pandehuri nuk ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore, prokurori i shtetit mund të heqë dorë nga e drejta e parashtrimit të ankesës kundër këtij vendimi, dhe menjëherë mund të paraqesë aktakuzë.

Aktakuza paraqitet brenda tetë (8) ditësh nga heqja dorë e të drejtës për ankesë. Në rastet nga paragrafi 5. i këtij neni, shqyrtimi gjyqësor rihapet pranë trupit të njëjtë gjykues dhe procedura vazhdon në bazë të aktakuzës së re duke iu nënshtruar këtyre kushteve:

- gjykata mund të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor për përgatitjen e mbrojtjes; dhe

⁶¹⁴ Neni 514 parag.2 i KPPRK

- provat e paraqitura më herët nuk prezantohen përsëri, kur ka ndryshuar përbërja e trupit gjykues ose nëse trupi gjykues e çmon të nevojshme që ndonjë pjesë e provës të prezantohet sërish.

Shqiptimi dhe llogaritja e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik

Kur gjykata merr aktgjykim ndaj personit i cili ka kryer veprë penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore, në atë aktgjykim ajo gjithashtu shqipton masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik nëse ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së tillë nga nenet 88 dhe 89 të Kodit Penal.

Masat nga paragrafi 1. i këtij neni mund të shqiptohen pavarësisht nëse i pandehuri ndodhet në liri apo ndaj tij është shqiptuar dënimi me burgim. Koha e kaluar në institucionin e kujdesit shëndetësor në pajtim me nenin 508, me urdhrin për paraburgim në pajtim me nenin 509 të këtij Kodi ose me masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim, llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Llojet e masave të trajtimit të detyrueshëm

Masat e trajtimit të detyrueshëm të cilat mund t'i shqiptohen kryerësit i cili nuk është penalisht përgjegjës, ka aftësi esencialisht të zvogëluar mendore apo është i varur nga droga ose alkooli janë:

- trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor;
- trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri; dhe
- trajtimi me anë të rehabilitimit të detyrueshëm të personave të varur nga droga ose alkooli.

Sanksioni penal, në pajtim me këtë Kod, mund t'i shqiptohet edhe kryerësit i cili ka kryer veprë penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore, nëse ekzistojnë shkaqe për shqiptimin e sanksionit të tillë.

-trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor

Gjykata mund t'i shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor kryerësit i cili ka kryer veprë penale në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, nëse konstaton se:

- kryerësi ka kryer veprë penale për të cilën është paraparë dënimi me së paku tre (3) vjet burgim;
- ekziston rrezik serioz se kryerësi do të kryejë veprë tjetër penale;
- trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim është i nevojshëm për të shmangur kryerjen e veprës tjetër penale;
- kryerësi është i paaftë për t'u përballur me gjykimin dhe

- trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim është i nevojshëm për të shmangur rrezikun serioz.

Gjykata do ta pushojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik të paraparë pasi të ketë vërtetuar se ka pushuar nevoja për trajtim në institucionin e kujdesit shëndetësor.

Kryerësit me çrregullime mendore i cili ka kryer veprë penale në gjendje të aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore dhe i cili është dënuar me burgim, koha e kaluar në institucionin e kujdesit shëndetësor do t'i llogaritet në kohën e dënimit të shqiptuar për trajtim të detyrueshëm psikiatrik. Nëse koha e mbajtur në ndalim për trajtim të detyrueshëm psikiatrik është më e shkurtër se dënimi me burgim, gjykata mund të urdhërojë që kryerësi të dërgohet në burgim për të mbajtur pjesën e mbetur të dënimit ose gjykata mund të urdhërojë lirimin me kusht.

Me rastin e vendosjes për lirimin me kusht, gjykata përveç kushteve të përcaktuara në vendim, veçanërisht do të merr parasysh suksesin e trajtimit të detyrueshëm të kryerësit, gjendjen e tij shëndetësore, kohën e kaluar në institucionin shëndetësor dhe kohëzgjatjen e dënimit që nuk është mbajtur. Gjykata e cila ka shqiptuar masën e monitoron atë derisa të përfundojë masa.

Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri

Gjykata mund t'i shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri kryerësit i cili ka kryer veprë penale në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, nëse konstaton se:

- ekziston rrezik serioz se kryerësi do të kryejë veprë penale;
- trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i nevojshëm për të shmangur kryerjen veprës tjetër penal ; dhe
- trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i mjaftueshëm për të shmangur rrezikun serioz.

Masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri mund t'i shqiptohen kryerësit ndaj të cilit është shqiptuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor, kur gjykata vërteton se ndalimi në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk është më i nevojshëm dhe se masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri. Gjykata mund t'i shqiptojë trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në liri kryerësit me aftësi esencialisht të zvogëluar mendore dhe i cili është në liri me kusht.

Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri nuk mund të tejkalojë tre (3) vjet nëse i është shqiptuar kryerësit me aftësi esencialisht të zvogëluar mendore. Gjykata mund të shqiptojë trajtimin e detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor:

- kur kryerësi nuk i nënshtrohet trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri siç përcaktohet në paragrafët 1. deri 3. të këtij neni;

- kur kryerësi braktis trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në liri; dhe kur përkundër trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor, ka rrezik serioz se kryerësi prapë do të kryejë veprë penale.
 - *Ekzekutimi i masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik*

Pas përfundimit të procedurës për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, ekzekutimi i saj rregullohet me anë të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

Procedura për ekzekutimin e masave psikiatrike Ekzekutimi i masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik për kryerësit e papërgjegjshëm, është e rregulluar me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

Masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim ekzekutohet në institucionin e kujdesit shëndetësor ose në institucionin tjetër të posaçëm, që ndodhet në vendbanimin e përhershëm ose vendqëndrimin e të pandehurit, ose nëse institucioni i tillë nuk ndodhet në atë vend, në institucionin më të përafërt me vendin ku i pandehuri ka vendbanimin e përhershëm, ose vendqëndrimin ose në vendin ku është zbatuar procedura penale, për të cilin vendos Gjykata, e cila gjithnjë ka parasysh rrezikun që i pandehuri paraqet për mjedisin.

Po sa Gjykata cakton këtë masë, ajo menjëherë ia dërgon vendimin Shërbimit provues kompetent dhe institucionit të kujdesit shëndetësor, institucionit korrektues ose institucionit përkatës për ekzekutimin e kësaj mase. Nëse masa është caktuar së bashku me dënimin me burgim, kryerësi i veprës penale së pari dërgohet në institucionin e kujdesit shëndetësor për trajtim.

Nëse personi ndodhet në liri, gjykata urdhëron transferimin e tij në institucionin e kujdesit shëndetësor ose urdhëron lëshimin e letër rreshtimit, por nëse personi ndodhet në paraburgim, personeli i Shërbimit korrektues të Kosovës e përcjell në institucionin e kujdesit shëndetësor. Personi ndaj të cilit është caktuar kjo masë transferohet në institucionin e kujdesit shëndetësor, i shoqëruar nga punëtorët e kujdesit shëndetësor.

Institucioni i kujdesit shëndetësor i dërgon gjykatës raport mbi gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajtimit të personit ndaj të cilit ekzekutohet masa, së paku një herë në gjashtë muaj dhe më shpesh me kërkesë të gjykatës. Kur institucioni i kujdesit

shëndetësor ose mjeku përgjegjës për shërimin mendor konstaton se më nuk është e nevojshme ta trajtojë ose ta ndalojë kryerësin e veprës penale në institucionin e kujdesit shëndetësor, ai menjëherë e informon gjykatën. Sipas detyrës zyrtare ose me propozimin e të pandehurit, mbrojtësit të institucionit të kujdesit shëndetësor ose të organit të kujdestarisë, gjykata e cila ka caktuar masën nëse konstaton se më nuk është e nevojshme që kryerësi të trajtohet ose ndalohet në atë institucion. Kur pushon masën, gjykata mund ta caktojë masën e trajtimit të detyrueshëm në liri, nëse ekzistojnë arsyet për caktimin e masës së tillë. Pasi që personi të lirohet nga institucioni i kujdesit shëndetësor, organi kompetent i kujdestarisë është përgjegjës për personin ndaj të cilit është ekzekutuar masa në dhënien e ndihmës pas lirimimit nga institucioni i kujdesit shëndetësor.

Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri ekzekutohet në institucionin e kujdesit shëndetësor të caktuar nga gjykata që ka caktuar masën në shkallë të parë. Personi ndaj të cilit është caktuar masa detyrohet të paraqitet në institucionin e kujdesit shëndetësor për trajtim brenda kohës së caktuar nga gjykata.

PJESA E TRETË – PROCEDURA E SHLYERJES SE DËNIMEVE NGA EVIDENCA SI PROCEDURË E VEÇANTË

Procedura e shlyerjes se dënimeve nga evidenca

Kur personi ndaj të cilit zhvillohet procedurë penale dënohet, aje jo vetëm që goditet me sanksionin penal por sipas legjislacionit në fuqi personave të dënuar u kufizohen disa të drejta ligjshme, (si qeshte p.sh personi i dënuar me dënim me burgim mbi gjashtë muaj humb të drejtën e punës, apo kur legjislacioni në mënyrë specifike parasheh që fitimi i një të drejte ligjore varet nga fakti a ka qenë i dënuar apo jo.

Shlyerja e dënimit nga evidenca e të dënuarve nënkupton rehabilitimin e plot të personit të dënuar rehabilitimi duhet kuptuar rikthim i çdo të drejte që ligjshme të akuzuarit i janë kufizuar për shkak të dënimit të shqiptuar. Rrjedhimesh me shlyerjen e dënimit nga evidenca i dënuari përveçse nuk evidentohet me evidencat e të dënuarve me raport me të kaluarën kriminale të tij atij i rikthehen edhe të drejtat e humbura.

Rehabilitimi nënkupton rikthimin e të drejtave sipas dy mundësive dhe atë:

- a) Kur ligji ka përcaktuar kalimin e afatit dhe për shkak të kalimit të afatit të dënuarit ju rikthehen të drejtat si dhe,
- b) rikthimi i të drejtave sipas vendimit gjyqësor.

Shlyerja e dënimit nga evidenca sipas rehabilitimit ligjor ka dy kushte që janë:

- a) të kalojë afati i paraparë ligjor, më saktësisht afatet përcaktohen në nenin 93 të KPRK-se si dhe
- b) brenda kohës sa rrjedh afati ligjor i dënuari të mos ketë kryer ndonjë veprë tjetër penale.

Rehabilitimi gjyqësor parasheh kushte ligjore dhe rrethana që duhet të vlerësojë gjykata. Kushtet ligjore për rehabilitimin gjyqësor apo shlyerjen nga evidenca e të dënuarve sipas vendimit gjyqësor janë:

- a) të ketë kaluar gjysma e afatit të paraparë sipas dispozitës së nenit 96, dhe
- b) gjatë kësaj përdhë kohore të rrjedhjes së aftit i dënuari të mos ketë kryer ndonjë veprë penale,

Ndërsa kushtet që duhet të vlerësohen nga gjykata për të vendosur për rehabilitimin gjyqësor janë:

- a) sjellja e personit të dënuar pas mbajtjes së dënimit,
- b) natyra e veprës penale për të cilën ka qenë i dënuar
- c) rrethana të tjera që mund të kenë rëndësi për të vlerësuar shlyerjen nga evidenca e të dënuarve.

Duhet te kemi parasysh se për te fituar i dënuari sipas rehabilitimit ligjor apo ati gjyqësor edhe nëse plotësohen te gjitha kushtet tjera nuk mund te behet shlyerja nga evidenca e te dënuarve nëse për dënimit qe kërkohet shlyerja janë ne fuqi dënimet plotësuese dhe masat e trajtimit te detyrueshëm për te dënuarin nuk mund te behet shlyerja ndaj dënimit kryesor.

Për disa kategori te dënimeve ligjërish shlyerja nga evidenca e te dënuarve nuk lejohet, e qe janë:

- a). dënimi me burgim mbi pesëmbëdhjetë vite si dhe,
- b).dënimi me burgim te përjetshëm

Ndërsa rehabilitimi për dënimet alternative mund te behet nëse nuk është revokuar dënimi alternativ me vendim gjyqësor dhe nëse ka kaluar koha prej një vitit prej kohës se përfundimit te periudhës se verifikimit.

Shlyerja e dënimit nga evidenca me rehabilitim ligjor mund te behet ne dy mënyra, sipas detyrës zyrtare vet gjykata bën shlyerjen nga evidenca me an te aktvendimit, këtu gjykata vetëm konstaton kalimin e afatit ligjor dhe verifikon faktin se brenda këtij afati nuk është kryer ndonjë vepër tjetër penale nga i pandehuri.

Mënyra tjetër e shlyerjes së dënimit nga evidenca sipas rehabilitimit ligjor është me kërkesën e te dënuarit e cila kërkesë parashtrohet për te konstatuar faktin nga gjykata se shlyerja e dënimit ka arritur ne baze te ligjit, në rast se gjykata nuk konstaton me afat prej tridhjetë ditëve me aktvendim shlyerjen nga evidenca qe ka arritur ne bazë te ligjit i dënuari mund te kërkoje nga gjykata qe ka shqiptuar dënimin te marr akte vendim për shlyerje nga evidenca e te dënuarve,(dispozitat ligjore kur i referohen kërkesës se par qe parashtrohen nga i dënuari japin kuptimin te marrjes se vendimit te tillë për te konstatuar shlyerjen nga evidenca e te dënuarve qe vendimi i tillë duhet te merret nga shërbimi i gjykatës, kjo është kuptueshme pasi qe personeli gjyqësor duhet te jete i kualifikuar pe për te bërë zbatimin ligjit ne kuadër te kompetencave te tyre, pra nuk ka një vendim nga shërbimi gjyqësor –administrata atëherë ne raport me kërkesën qe shtrohet nga i dënuari vendos kolegji i gjykatës). Për te vendosur kolegji fillimisht duhet te marr vendimin e prokurorit kur procedura penale është filluar me kërkesën e prokurorit.

Përkundër se kundër se dispozita nga neni 521 i KPP-se përdor shprehjen gjykata ne praktiken gjyqësore mbizotëron mendimi se termi ligjor i referuar gjykata duhet nënkuptuar kompetencën e kolegjit te gjykatës.

Sa i përket shlyerjes nga evidenca e te dënuarve me rehabilitim gjyqësor apo ne bazë te vendimit gjyqësor, procedura këtu gjithmonë fillohet sipas kërkesës se te dënuarit. Kërkesa e tillë fillimisht shqyrtohet nga gjyqtari qe bene gjurmimin-verifikimin e rrethanave.

Për te bere verifikimin e kërkesës ne radhë te par verifikohet kalimi i afatit ligjor qe është kusht sipas nenit 97 te KPRK-se, pastaj verifikohet për te dhënat nëse është kryer ndonjë vepër penale brenda këtij afati, pastaj mblidhen te dhëna nga policia apo i institucionit ku është vuajtur

dënimit me burgim nga i dënuari, këto te dhëna që mblidhen nga institucionet, i shërbejnë gjyqtarit për të vlerësuar rrethanat që ka për detyrim të vlerësojë gjykata dhe atë në raport me sjelljen e të dënuarit dhe natyrën e veprës penale apo çfarëdo rrethane tjetër që mund të jetë e rëndësishme për shlyerjen nga evidenca e të dënuarve.

Kur behet gjurmimi i të gjitha rrethanave nga gjyqtari ai ka obligim që të parashtrorë propozim të arsyetuar në të cilin propozim mund të propozohet refuzimi i kërkesës apo aprovimi i kërkesës i cili propozim vendoset nga kolegji shqyrtues i përbërë nga tre gjyqtarë.

Në raport me vendimin që merr kolegji shqyrtues është lejuar e drejta e ankesës e që për ankesën e aktvendimit të tillë vendos gjykata e apelit.

Dilemat praktike me këtë procedurë shpesh herë shfaqen kur të dënuarit i refuzohet kërkesa për shlyerje nga evidenca dhe sipas nenit 523 paragrafi 7 atë i mohohet e drejta për të parashtruar sërish kërkesën e tillë në afat prej dy viteve, (në praktiken gjyqësore ka ndodhur raste që për rehabilitimin gjyqësor është parashtruar kërkesa e të dënuarit i cili ka qenë i dënuar me një vit burgim dhe afati që duhet të kalojë për rehabilitim gjyqësor është gjysma e afatit të paraparë për rehabilitimin ligjor që është tri vite, e që nënkuptohet se rehabilitimi ligjor në rrethana të tilla është një vit e gjysmë, dhe i dënuari parashtron kërkesë pasi që të kenë kaluar gjashtëmbëdhjetë muaj, në rrethana të tilla i është refuzuar kërkesa për shkak të mos kalimit të afatit për rehabilitim gjyqësor, rrjedhimisht sipas nenit 523 paragrafi 7 i dënuari nuk ka të drejtë që të paraqesë kërkesë në afat prej dy viteve pasi që i është refuzuar kërkesa), nga kjo rrjedh se dispozita procedurale në esencë i mohon të dënuarit që tashmë të konstatohet shlyerja për shkak se ka rrjedhur afati për rehabilitim ligjor në këto rrethana kemi një kolizion të dispozitave procedurale në raport me dispozitat materiale.

Në rrethana të tilla gjykata nuk duhet të ja mohojë të dënuarit shlyerjen nga evidenca sipas nenit 523 paragrafi 7 duke i kufizuar të drejtën e parashtrimit të kërkesës kjo me faktin se kushti ligjor i përmbushjes së afatit është aspekt material dhe rrjedhimisht në situatën e tillë si të shembullit pavarësisht faktit që ka pas një zhvillim të procedurës për rehabilitim gjyqësor në të cilën procedurë i është refuzuar kërkesa e të dënuarit kur gjykata konstaton se ka rrjedhur afati ligjor për rehabilitim ligjor dhe nuk ka të dhëna që gjatë kësaj periudhë të rrjedhjes së afatit i dënuari ka kryer ndonjë veprë penale shlyerja nga evidenca duhet të behet sipas rehabilitimit ligjor.

PJESA E KATËRT – PROCEDURA E SHLYERJES SE DËNIMEVE NGA EVIDENCA SI PROCEDURË E VEÇANTË

Procedura për shpalljen e letë rreshtimit dhe shpalljeve publike

Shpallja e letë rreshtimit apo shpalljet publike ne procedurën penale behet me qellim te gjetjes dhe arrestimit te te dyshuarit apo ne raport me shpalljet publike gjurmimit për qellim te hetimit apo gjetjes se te dyshuarit. Këtë kuptim letë rreshtimi për qellim te arrestimit te te dyshuarit për zbatimin e procedurës penale ne vend.

Fillimisht për te mundësuar lëshimin e letë rreshtimit duhet te plotësohen dy kushte te përgjithshme dhe atë;

- a) te mos dihet vendbanimi i te pandehurit qofte vendbanimi i përhershëm apo i përkohshëm,
- b) qe gjykata te kërkoj nga policia qe te njoftohet me adresën e te pandehurit.

Pas plotësimit të këtyre dy kushteve te përgjithshme, duhet plotësuar edhe tri kushtet e veçanta dhe atë:

- a) se i pandehuri gjendet ne arrati,
- b) se procedura penale qe zhvillohet kundër ti parasheh dënimin qe mund te shqiptohet me te paktën dy vjet burgim dhe,
- c) se ndaj ti është lëshuar urdhër arresti apo i është caktuar paraburgimi.

Se kush është kompetent për te urdhëruar letë rreshtimin kjo varet nga stadi i zhvillimit te procedurës penale, nëse procedura penale është ne fazën e hetimit urdhrin për letë rreshtim e lëshon gjyqtari i procedurës paraprake pasi qe ta ketë propozuar prokurori, kur çështja është ne fazën pas ngritjes se aktakuzës apo pas fazës se shqyrtimit gjyqësor urdhrin për letë rreshtim e lëshon gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues.

Situata krejt tjetër është pasi te ketë përfunduar dhe te jete dënuar i pandehuri, kur i pandehuri është ne vuajtje te dënimit apo ne trajtim te detyrueshëm-trajtim ky qe nënkupton heqjen e lirisë dhe i pandehuri arratiset, pavarësisht kohëzgjatjes se dënimit apo masës urdhrin për letë rreshtim duhet ta urdhëroj drejtori i ati institucioni ku i pandehuri ka qene duke e vuajtur dënimin apo masën.

Urdhrin për letë rreshtim qe është lëshuar nga gjykata apo nga institucioni ku i pandehuri ka vuajtur dënimin apo masën duhet dërguar ne polici me qellim te ekzekutimit, dhe urdhri i tillë shpërndahet ne nivel vendi nga policia për te bërë ekzekutimin.

Policia mban evidencë për letë rreshtimit qe janë aktive ndërsa kur revokohet letë rreshtimi nga organi qe ka urdhëruar sipas aktvendimit e revokimit te letë rreshtimit policia është e obliguar qe ta heq nga evidenca.

Letërreshtimi lëshohet për ekzekutimin e tillë në nivel vendi si dhe mund të kërkohej lëshimi i letërreshtimit ndërkombëtar kërkesat e tilla për letërreshtimin ndërkombëtar mund të parashtrihen për efekt të procedurës penale me qëllim zbatimin e saj ndaj prokurori apo gjykata, por në këtë situatë duhet të ekzistoj informacioni i sakte se personi i kërkuar nuk gjendet në Kosovë apo se ka prova që i pandehuri banon jashtë Kosovës. Kërkesa e tillë i drejtohet ministrisë së drejtësisë që në rrugën e bashkëpunimit juridiko ndërkombëtar ajo kërkesë duhet të përcjellët tek autoritetet kompetente qofte në kuadër të organizatave ndërkombëtare apo të autoritetet e shtetit kompetent. Letërreshtimi nuk ka ndonjë afat kufizues për efektin e tij megjithatë organi që ka urdhëruar letërreshtimin apo letërreshtimin ndërkombëtar e tërheq nëse plotësohet cilado nga këto kushte ligjore e që janë :

- a) personi i kërkuar është gjetur,
- b) ka kaluar afati i parashkrimit për ndjekje penale,
- c) ka kaluar afati i parashkrimit për ekzekutim të dënimit,
- d) paraqiten shkaqe të tjera që letërreshtimi rezulton i pa nevojshëm e që si shkak rezulton konstatimi i vdekjes së personit të kërkuar.

Shembull i praktikës gjyqësore të dispozitivit të letërreshtimit vendor:

LETËRRRESHTIM VENDOR

- I. URDHËROHET Policia e Kosovës që të pandehurin: N/N, nga i ati N/N, e ëma N/N, e vajzërisë N/N, i lindur me dt.----- në fsh.T/T, ku edhe jeton - Komuna e Drenasit, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal.00000000000, TA ARRESTOJ.
- II. Policia e Kosovës urdhërohet që pas arrestimit të pandehurit ta informoj Gjykatën që ka lëshuar këtë letërreshtim dhe të pandehurin ta sjell në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – Veri – Departamenti për Krime të Rënda.
- III. Ky letërreshtim vlen për gjithë territorin e Republikës së Kosovës pa asnjë kufizim, duke përfshirë Pikat e kalimeve Kufitare, Stacionet regjionale dhe lokale të Policisë së Kosovës.
- IV. Ky letërreshtim ka vlefshmëri ligjore deri në arrestimin e të pandehurit N/N, apo deri në revokimin e tij nga kjo Gjykatë.

Lëshimi i shpalljeve publike – në procedurën penale për qëllim të sigurimit të informatave për sendet që lidhen me veprën penale apo kur këto sende gjenden kur është e nevojshëm që të identifikohen, qoftë për faktin se kujt i takojnë qoftë për faktin se në cilën zonë janë par ato sende për herë të fundit, qoftë për faktin se ato sende kanë ndërruar pronësinë , qoftë për faktin se ato sende, qoftë për faktin se sendet e tilla shërbejnë për të kryer veprën penale apo se mund të shërbejnë si prova në procedurën penale, qoftë për faktin se ato sende ndërlidhen për identifikimin e kufomës mund të urdhërohet shpallja publike për qëllim të marrjes së informatave.

Organi qe zbaton urdhërimin e shpalljes publike është organi qe është ne zbatim te veprimit te procedurës, kjo nënkupton se urdhërimin për shpallje publike mund ta bej policia, prokurori por ne rrethana te caktuara edhe gjykata përkatësisht gjyqtari i procedurës paraprake.

Urdhri për shpallje publike duhet te përmbaj përshkrimin e saktë te sendeve dhe specifiken konkrete se çfarë informatë kërkohet, kjo nuk e ndalon qe shpallja publike te behet edhe përmes mënyrës mediatike ne te cilën mund te prezantohen edhe sendet për te cilat kërkohet informata.

Shpallja publike dhe publikimi i fotografive mund te behet edhe për kufomat apo personat e zhdukur. Kushti qe duhet plotësuar ligjërisht sipas nenit 536 është qe te ekzistoj arsye për dyshim se vdekja apo zhdukja e personave te tillë qe u publikohet fotografia është pasojë e shkaktuar me vepër penale.

Shpallja e letërrshtimit ose kërkesës për shpallje publike me qellim sigurimin e informatave nga publiku – kur urdhërohet letërrshtimi apo shpallja publike qe te dyja këto mund te bëhen te njohura për publikun e gjere edhe te kërkohen informata nga çdo qytetar, shpalljen e tillë e bene policia përkatësisht ministria e punëve te brendshme, por ajo mund te behet publike edhe me ane te mediave. Shpallja e tillë për çfarëdo shkak kur besohet se mund te rezultojë ne informatë te dobishme për procedurën penale mund te behet edhe ne nivel ndërkombëtar përmes rrugëve te bashkëpunimit juridik ndërkombëtar.

Gjithsesi Kosova i përgjigjet kërkesave ndërkombëtare ne rrugë te bashkëpunimit juridik ndërkombëtar kur shpalljet e tilla lëshohen nga autoriteti i një vendi tjetër, për tu shpallur publikisht një letërrshtim apo shpallje publike te lëshuara nga autoritete e huaja ne Kosovë duhet plotësuar vetëm një kusht ligjor qe ne shpalljen e tillë kur bahet fjalë për personin qe kërkohet, shteti qe ka urdhëruar shpalljen publike apo letërrshtimin, dhe ne kërkesën e autoritetit te huaj qe kërkohet te behet shpallja për te siguruar informata nga publiku ne vendin tone, ne atë kërkesë duhet te ekzistoj kërkesa për ekstradim te personit qe kërkohet.

BIBLIOGRAFIA

I. LIBRA DHE BOTIME TJERA

- BAČIĆ, FRANJO: *Kazнено pravo*, Opći dio, Peto, prerađeno i prošireno izdanje, Zagreb, 1998.
- BAJGORA, ALI: *Krimet kundër lirive dhe të drejtave të njeriut në Kosovë*, Pjesa e parë, Prishtinë, 1998.
- Veprat penale kundër lirisë së personit në planin krahasues*, Prishtinë, 1999.
- BIANKU, LEDI;
- KUMBARO, ODETA: *Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut*, Botimi i katërt, Strasburg, 2017.
- BOHLANDER, MICHAEL: *Principles of German Criminal Law*, Oxford and Portland, Oregon, 2009.
- DEMOLLI, HAKI: *Terrorizmi*, Prishtinë, 2002.
- ELEZI, ISMET;
- KAÇUPI, SKËNDER;
- HAXHIA, MAKSIM: *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, Pjesa e Përgjithshme, Tiranë, 2004.
- ELLIOT, CATHERINE;
- QUIN, FRANCES: *Criminal Law*, Third Edition, "Pearson Education", Harlow, 2000.
- FLETCHER, GEORGE: *Basic Concepts of Criminal Law*, Oxford University Press, New York-Oxford, 1998.
- GARAČIĆ, ANA: *Kazneni zakon u sudskoj praksi*, Zagreb, 2001.
- HAJDARI, AZEM: *Procedura penale, Komentari*, Prishtinë, 2009.
- HALL, JEROME: *General principles of criminal law*, Second Edition, Indianapolis, 1990.

- HERRING, JONATHAN: *Criminal law*, Third Edition, “Palgrave Maxmillan“, Bristol, 2002.
- KAMBOVSKI, VLLADO: *E drejta penale*, Pjesa e përgjithshme (botim në gjuhën shqipe), Shkup, 2007.
- KAPLAN, JOHN: *Criminal Law*, Third Edition, Boston, 1996.
- LUARASI, ALEKS: *Kodi penal me praktikë gjyqësore*, Tiranë, 2003.
- MEKSI, SOKRAT;
- ÇIPI, BARDHYL: *Mjekësia ligjore*, Tiranë, 2003.
- MOLAN, MIKE: *Cases and materials on criminal law*, Fourth Edition, London and New York, 2008.
- MUÇI, SHEFQET: *E drejta penale*, Pjesa e përgjithshme, Tiranë, 2006.
- PERKINS, ROLLIN;
- BOYCE, ROLAND: *Criminal law*, Third Edition, Mineola, 1982.
- PETROVIQ, BORISLLAV: *E drejta penale*, Sarajevë/Prishtinë, 2006.
- JEAN, PRADEL;
- CORSTENS, GEERT;
- VERMEULEN, GERT: *E drejta penale evropiane*, Tiranë, 2009.
- ROXIN, CLAUS: *Strafprozessordnung mit Einführungsg. Gerichtverfassungs-, EGGVG Jugenderichstgesetz Straßenverkehrsg.*, München, 2006.
- SAHITI, EJUP;
- MURATI, REXHEP: *E drejta e procedurës penale*, Prishtinë, 2016.
- SALIHU, ISMET: *E drejta penale për të mitur*, Prishtinë, 2005.
- E drejta penale*, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2015.
- E drejta penale*, Pjesa e posaçme, Prishtinë, 2014.
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës*, Prishtinë, 2016.

SALIHU, ISMET;

ZHITIJA, HILMI;

HASANI, FEJZULLAH: *Kodi Penal i Republikës së Kosovës*, Komentar, Botimi I, 2014, Prishtinë.

SAMAHA, JOEL: *Criminal Law*, Tenth Edition, Wadsworth, Cengage Learning, 2011.

SHALA, AFRIM: *Kompetencat e gjyqtarit të procedurës paraprake sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës*, Revista “Justicia”, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Prishtinë, 2009.

Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2010.

Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, Gjilan, 2010.

Përmbledhje e ligjëratave nga “E drejta penale I”, Gjilan, 2011.

Sistemet kryesore të caktimit të dënimit me gjobë në të drejtën penale bashkëkohore, Revista “E drejta”, Nr.2-2011, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Prishtinë, 2011, faqe 129-136.

Roli i shërbimit sprovues në shqiptimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative, Gjilan, 2011.

Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Revista “Avokatura”, nr.14, Oda e Avokatëve të Kosovës, Prishtinë, 2012, faqe 15-31.

Organizimi i sistemit gjyqësor në Republikën e Kosovës sipas Ligjit për gjykatat, Revista shkencore “Norma”, Gjilan, 2012.

Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Moduli Trajnues, Instituti

Gjyqësor i Kosovës, Prishtinë, 2012 (bashkëautor).

Veprat penale kundër të drejtave të votimit, "Opinio Juris",
Revistë shkencore juridike, Akademia e Drejtësisë, Viti I, nr.1,
Prishtinë, 2015.

Disa aspekte praktike të seancës për vërtetimin e fakteve
relevante lidhur me dënimin, Revista shkencore juridike
"Opinio Juris", Akademia e Drejtësisë, Viti II, nr.2, Prishtinë,
2016.

Hyrje në të drejtën penale, Botimi i tretë, Prishtinë, 2019.

Doracaku për procedurë penale, Prishtinë, 2015, (bashkautor).

WEIGEND, THOMAS: *Strafgesetzbuch, Betäubungsmittelg und weitere Vorschriften,*
München, 2006.

II. AKTE JURIDIKE

Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Kodi penal i Republikës së Shqipërisë, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së
Shqipërisë, me ligjin nr.7895, të datës 27.01.1995.

Kodi i Drejtësisë Për të Mitur.

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut

Ligje tjera të paraqitura në fusnota.

Akademia e Drejtësisë
<https://ad.rks-gov.net>
infoad@rks-gov.net
Rr."Muharrem Fejza"-Prishtinë
Tel:+383 38 200 18 660

